AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXLVII
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
LIBRI 52

SKËNDER GASHI

KËRKIME ONOMASTIKE-HISTORIKE PËR MINORITETE TË SHUARA E AKTUALE TË KOSOVËS

PRISHTINË
2015

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SPECIAL EDITIONS CXLVII
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE
BOOK 52

SKËNDER GASHI

ONOMASTIC-HISTORICAL RESEARCH ON EXTINCT AND ACTUAL MINORITIES OF KOSOVA

Approved for publication at the meeting of the Section of Linguistics and Literature,
held on 22th January, 2015, after review by
academician Rexhep Ismajli, academician Hivzi Islami and correspondent member Mehmet Halimi.

Editor: Academician Eqrem Basha, Secretary of the Section of Linguistics and Literature.

PRISHTINA
2015

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXLVII
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
LIBRI 52

SKËNDER GASHI

KËRKIME ONOMASTIKE-HISTORIKE PËR MINORITETE TË SHUARA E AKTUALE TË KOSOVËS

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë,
mbajtur më 22 janar 2015, në bazë të recensioneve të
akademik Rexhep Ismajlit, akademik Hivzi Islamit dhe anëtar korrespondent Mehmet Halimit.

Redaktor: Akademik Eqrem Basha, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

PRISHTINË
2015

Copyright © ASHAK

Përkushtesë

Me respektin më të madh të mundshëm për gjithë atë që mësova nga vepra e tij, këtë botim ia kushtoj Prof. Idriz Ajetit

Autori

PËRMBAJTJA

BASHKËJETESA SASE-SHQIPTARE NË SHEKUJT 14-16 DHE DISA GJURMË ONOMASTIKE E LEKSIKORE SASE NË KOSOVË 13

1. VENERIME HYRËSE. 13
1.1. Shënime për fillet e xehtartisë dhe për minierat e Kosovës 13
1.2. Xehetaria dhe minierat në dritën e burimeve kishtare serbe 20
2. SASËT NË BALLKAN E NË KOSOVË 34
2.1. Sasët në territorin e sotëm të Kosovës 42
2.1.1. Sasët në Novobërdë 43
2.1.2. Sasët në Trepçe 49
2.1.3. Sasët në Janjevë 55
2.1.4. Sasët në Pllakanicë 59
2.1.5. Sasët në Koporiq 60
2.1.6. Sasët në Çuka e Drashnjes 61
2.1.7. Sasët në Bellosicë (Murgull) 61
3. MIKROTOPONIME MESJETARE ME EMRIN ETNIK TË SASËVE 64
4. SASËT NË DRITËN E ANTROPONIMEVE 70
5. GJURMË ONOMASTIKE SASE NË MIKROTOPONIME TË SOTME TË KOSOVËS 77
6. OIKONIME SASE NË KOSOVË 80
7. PËRKIME SHQIPTARE-SASE NË DRITËN E ANTROPONIMEVE 99
8. MBETJE LEKSIKORE SASE NË TË FOLME SHQIPE 102
9. VENERIME PËRMBYLLËSE 109
DAS SÄCHSISCH-ALBANISCHES ZUSAMMENLEBEN IN DEN 14-16 JAHRHUNDERTEN UND EINIGE SÄCHISCHE ONOMASTISCHE UND LEXIKALISCHE SPUREN IN KOSOVA 119
Zusammenfassung 119

BASHKËJETESA E SHQIPTARËVE DHE E RAGUZASVE NË KOSOVË DHE NË REGJIONIN E TOPLICËS NË DRITËN E DISA BURIMEVE RAGUZASE TË SHEKUJVE 14-15 127

01. VENERIME HYRËSE: 127
1. RAGUZASIT NË QYTETE TË KOSOVËS 131
2. SHQIPTARËT NË NOVOBËRDË DHE NË VENDBANIMET PËRRETH NË DRITËN E DOKUMENTEVE MË TË VOGLA RAGUZASE 141
3. ANTROPONIMET E SHQIPTARËVE NË DRITËN E TESTAMENTIT DHE TË LIBRIT 145
3.1. Venerime 1 150
4. MBI DISA EMRA TË DËSHMUAR TË SHQIPTARËVE NË TESTAMENT E NË LIBËR DHE PËRPUTHJEN E TYRE ME EMRA TË SOTËM TË VENDEVE E TË VËLLAZËRIVE KOSOVARE 161
4.1. Venerime 2 178
5. SHEMBUJ TË BASHKËJETESËS E TË BASHKËSHKRIRJES RAGUZASE-SHQIPTARE 203

6. SHQIPTARËT NË PJESËN JUGORE TË "SERBISË" 234
7. RRETH PREJARDHJES SË DISA ANTROPONIMEVE TË DËSHMUARA NË BURIME RAGUZASE 240
7.1. Venerime përmbyllëse 251
DAS ZUSAMMENLEBEN DER ALBANER UND DER RAGUSANER IN KOSOVA UND IN DER REGION TOPLICA IM LICHTE EINIGER RAGUSANISCHER QUELLEN AUS DEM 14 UND 16 JAHRHUNDERT . 253
(Zusammenfassung) 253

SERBËT/ MALAZEZËT E BOSHNJAKËT NË KOSOVË 257

1. VENERIME HYRËSE 257
2. VENDOSJA (ARDHJA) E FISEVE SLLAVE NË BALLKAN DHE PASOJAT E SAJ 257
3. SHPËRNDARJA E FISEVE SLLAVE NË JUG E NË JUGLINDJE TË GADISHULLIT TË BALLKANIT 261
4. RRETH EMRAVE ETNIKË TË SERBËVE 267
5. KUFIJTË E FORMACIONIT SHTETËROR TË SERBISË PARA PUSHTIMIT TË KOSOVËS 268
6. SUBSTRATI PARASLLAV I SHTETIT TË RASHËS 273
7. KRISHTERIZIMI I SLLAVËVE (BULLGARËVE E SERBËVE) 276
8. PUSHTIMI I KOSOVËS NGA DINASTIA E NEMANJIDASVE 278
9. EMRI I KOSOVËS SË SOTME SIPAS BURIMEVE HISTORIKE 278
10. EMRAT SLLAVË PËR KOSOVËN 279
11. SERBËT NË KOSOVË 284
12. BOSHNJAKËT 287

FATI HISTORIK I HEBRENJVE NË HAPËSIRËN ETNOLINGUISTIKE TË SHQIPTARËVE 293

1. HEBRENJTË NË HAPËSIRËN ETNOLINGUISTIKE TË SHQIPTARËVE 293
2. HEBRENJTË NË KOSOVË 303
3. FILLET E AKTUALIZIMIT TË ÇËSHTJES SË HEBRENJVE NË HAPËSIRËN ETNOLINGUISTIKE TË SHQIPTARËVE 311
4. HEBRENJTË E SHQIPËRISË GJATË PERIUDHËS SË SUNDIMIT TË MBRETIT A. ZOGU DHE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE 313
a) Gjatë periudhës së sundimit të mbretit A. Zogu 313
b) Gjatë Luftës së Dytë Botërore. 317
5. A ISHTE EINSTEIN-I NË SHQIPËRI? 319
6. PËRPJEKJET E SHQIPTARËVE PËR SHPËTIMIN E NORBERT JOKLIT 323
7. HEBRENJTË E KOSOVËS: TË MBROJTUR APO TË DORËZUAR? 327
8. STREHIMI I HEBRENJVE, SIPAS TREGIMEVE/RRËFIMEVE PERSONALE 335
a) Në Shqipëri 335
b) Në Kosovë 337
9. HEBRENJTË NË SHQIPËRI E NË KOSOVË PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE 342
10. MOTIVET E STREHIMIT TË HEBRENJVE NGA SHQIPTARËT 346
11. PERSONALITETE TË SHQUARA HEBRAIKE NË QEVERI, NË KULTURË E SHKENCË NË SHQIPËRI 352
12. FATI I HEBRENJVE NË SHTETET FQINJE *353*
a) Në Serbi 353
b) Në Greqi 357
c) Në Bullgari 358

d) Në Maqedoni 360
13. VENERIME PËRMBYLLËSE 360

NDIHMESË PËR NJË HISTORI TË ROMËVE, HASHKALINJËVE DHE "EGJIPTASVE" NË KOSOVË 367

0.1. VENERIME TË PËRGJITHSHME: 367
1. RRETH PREJARDHJES DHE KUPTIMIT TË EMRAVE 368
1.1. Rom 368
1.2. Sinti 369
2. RRETH KOHËS SË DYNDJES DHE SHTRIRJES TERRITORIALE TË ROMËVE 370
3. ARDHJA E ROMËVE NË EUROPË 377
4. FILLET E STUDIMIT TË GJUHËS ROMANI, ROMANÉ, ROMANES 382
4.1. Veçori të përgjithshme të gjuhës rómani, rómanes 387
4.2. Morfologjia e gjuhës rómane, romanes 388
4.3. Ndarja në dialekte e gjuhës rómani 389
4.4. Grupi i Europës Veriore 390
4.5. Grupi i Europës Qendrore 390
4.6. Grupi vllah 391
4.7. Grupi ballkanik 392
4.8. Grupi Barutija 393
4.9. Grupi Topanali; romët topanë 393
4.10. Grupi Maxhuri 394
4.11. Grupi Meçkarija / Majmunxhija (khs. edhe Ursari - Romani) 394
4.12. Grupi Juzhari; quhet edhe konoplarja "mbjellës të bimës së kanpit" ... 394
4.13. Grupet: Dasikane Roma; Gadikane Roma; Mýsýr Mangýr; Kërci (Kýrýtsi); Gjuptin 395
4.14. Grupi Gavutne 396
4.15. Gupi arli, arlij, arlije "vendës" 396
4.16. Grupi Tamara: 396
5. PARAVENDIME RRETH NUMRIT TË ROMËVE 397
6. ROMËT NË HAPËSIRËN GJUHËSORE E ETNIKE SHQIPTARE 400
6.1. Romët në Kosovë 402
7. HASHKALINJTË: 407
7.1. Aškalija (Haškalija)/ Malokija / Cibane Roma / Albanski Roma / Magjupi (Maxhup / Maxhyp) Aškalija (Haškalija)/ Malokija / Cibane Roma / Albanski Roma / Magjupi (Maxhup / Maxhyp) 407
8. GABELËT 410
9. INTEGRIMI I GUPEVE ROME NË SHOQËRINË KOSOVARE 416
10. JETA SOCIALE 418
11. DOKE E ZAKONE: 420
12. RELIGJIONI 420
13. PROFESIONET 422
14. FESTAT 423
14.1. Gjys(m)at e Dimnit/Vasilicat/Viti i Ri i romëve 423
14.2. Dita e Shën Gjergjit 424
14.3. Muzika 424
15. "EGJIPTIANËT" OSE SHPIKJA E NJË ETNIE TË RE ? 424
15.1. "Vërtetimi" shkencërisht i ekzistimit të etnisë "egjiptase" në Kosovë .. 430
16. LUFTA PËR KOSOVËN DHE ROMËT, HASHKALINJTË E "EGJIPTASIT" 439

17. HIMNI I ROMËVE NË GJUHËN ROMANE....443
18. PËRFUNDIM....444
19. MATERIALE....451

PREJARDHJA E GORANËVE NË DRITËN E EMRAVE TË VËLLAZËRIVE E TË VENDEVE....461

1. VENERIME HYRËSE....461
1.1. Hapësira gjeografike e sotme dhe mesjetare e mikroregjioneve të Gorës e të Opojës....464
2. LËNDA ONOMASTIKE HISTORIKE PËR KRAHINAT E GORËS E TË OPOJËS....470
2.1. Venerime përkitazi me Gorën e me Opojën mbi bazën e të dhënave të burimit kishtar serb të vitit 1348....476
2.2. Vazhdimësi e emrave mesjetarë të vendeve në mikrotoponiminë dhe në emrat modernë të vëllazërive në krahinat e Gorës e të Opojës....479
3. VENERIME PËRKITAZI ME GORËN MBI BAZËN E TË DHËNAVE TË BURIMIT OSMAN TË VITEVE 1451-1452....490
4. GORA E OPOJA NË DRITËN E STUDIMEVE GJUHËSORE, ETNOGRAFIKE E HISTORIKE BULLGARE, SERBE, SHQIPTARE E BOSHNJAKE....505
4.1. Mendime e hipoteza përkitazi me gjuhën dhe me prejardhjen etnike të popullatës së Gorës....505
4.2. Sqarime përkitazi me herezinë ballkanike: bogumilët....522
4.3. Përndjekja e bogumilëve....526
4.4. Rreth emrave: bogumil, babun, kuduger....533
4.5. Rreth mundësisë së barazimit të nocioneve goran, pomak, torbesh, gogë, mijak dhe bogumil....538
5. GJENDJA E SOTME DHE TEZA E BARAZIMIT BOGUMIL - TORBESH - GORAN - BOSHNJAK; POTUR....560
5.1. Bestytnitë në mbështetje të prejardhjes bogomile të goranëve....*568*
5.2. Gjurmë të artit e monumente bogumile....571
6. PREJARDHJA E GORANËVE NË DRITËN E ONOMASTIKËS....574
6.1 Metoda e studimit....574
6.2. Paralele midis antroponimisë së banorëve të Gorës dhe të asaj të krahinave fqinje shqiptare....577
6.3. Paralele antroponimike të banorëve të Gorës me ata të krahinave shqipfolëse të Opojës e me të Malësisë së Tetovës....577
7. VENERIME 1....592
8. SHTRESIME GJUHËSORE NË TOPONIMINË DHE NË ETNONIMINË E GORËS....593
8.1. Shtresa latine - ballkanike (vllahe)....593
8.1.1. Emra vendesh....593
8.1.2. Emra vlleh....597
8.1.3. Mikrotoponime me prejardhje aromune-vllahe:....597
8.1.4. Emra vëllazërish (vetëm disa sish) me prejardhje vllahe në pjesën kosovare të Gorës:[320]....598
8.1.5. Emra vlleh të vëllazërive në pjesën e Gorës në Shqipëri:[321]....599
8.1.6. Emra vendesh....600
8.1.7. Emra vëllazërish:....621
8.1.8. Gjurmë leksikore vllahe në të folmen e Gorës....637
9. SHTRESA GREKE....644
9.1. Emra vendesh:....644

9.2. Emra vëllazërish: 650
10. SHTRESA SLLAVE 652
11. SHTRESA TURKE (TEZA E PREJARDHJES TURKE TË GORANËVE) 659
12. SHTRESA SHQIPE 667
12.1. Emra vendbanimesh 667
12.2. Mikrotoponime 669
12.3. Mikrotopnime me prejardhje antroponimike 676
12.4. Emra vëllazërish: Paralele shqiptare-gorane 682
13. AREALI EMËROR I ETNONIMISË SË GORËS 696
13.1. Përputhje të emrave të vëllazërive të sotëm të Gorës me sish të rrethinave të Shkodrës, Ulqinit e të Tivarit 696
13.2. Përputhje të emrave të vëllazërive të goranëve me sish të Malësisë së Tetovës e të Kosovës në shek. 15 697
14. VENERIME PËRKITAZI ME PREJARDHJEN E GORANËVE NË KONTEKSTIN E AREALIT EMËROR 698
14.1 Bashkëjetesa e goranëve me shqiptarët 701
15. VENERIME PËRMBYLLËSE 705
16. REGJISTËR I PJESËRISHËM I PARALELEVE TË EMRAVE TË VËLLAZËRIVE TË GORËS ME SISH TË OPOJËS 715

TURQIT NË KOSOVË 721

MENDIME RRETH DY MINORITETEVE TË SHUARA MESJETARE TË KOSOVËS: KUMANËT E JURUKËT 727

TË DHËNA PËR ÇERKEZËT NË ATDHEUN E TYRE TË KRYEHERSHËM DHE NË KOSOVË 753

BURIMET DHE LITERATURA 765

BASHKËJETESA SASE-SHQIPTARE NË SHEKUJT 14-16 DHE DISA GJURMË ONOMASTIKE E LEKSIKORE SASE NË KOSOVË*

"... Është për t'u vënë re që ndër minatorë Belon-i i përmend edhe shqiptarët; në këtë mënyrë shpjegohet edhe shtegu i dëshmimit të lëndës gjuhësore gjermane në gjuhën shqipe..."

E. Preißig

1. VENERIME HYRËSE.[1]

1.1. Shënime për fillet e xehtartisë dhe për minierat e Kosovës

Nuk ka mbase ndonjë shtet në të cilin në kontekstin e rrjedhave historike të mos ketë pasur jo vetëm lëvizje të brendshme të popullatës vendëse përbrenda territoreve të tyre etnolinguistike, porse edhe grupe etnike që nëpër territore të këtilla u vendosën si pasojë e pushtimeve nga të tjerët. Kështu ndodhi që nga koha e pushtimit romak të Dardanisë në shek. I para erës sonë pas disa luftërave, midis të cilave më e rëndësishmja mbetet ajo e vitit 76 para erës sonë, e njohur në histori si *bellum Dardanicum*, edhe me Kosovën e sotme. Sipas vlerësimeve të përafërsishme, Dardania e dëshmuar për si mbretëri më vete që nga shek. IV para erës sonë, përkatësisht Dardania e quajtur më vonë nga romakët Moesia Superior, do të ketë pasur asokohe 200.000 deri në 250.000 banorë dhe një sipërfaqe prej rreth 25-30.000 km^2.[2] Hapësira etnolinguistike e dardanëve, pararendës të shqiptarëve, përputhet me hapësirën kompakte që (edhe) sot e banojnë shqiptarët, përkatësisht me Kosovën, pjesën Perëndimore të Maqedonisë dhe të ashtuquajturën Serbi e Jugut, përkatësisht Kosova Lindore-Lugina e Preshevës.

---

* Një version më i shkurtër i këtij punimi është botuar gjermanisht nën titullin Albanisch-Sächsische Berührungen in Kosova und einige ihrer onomastischen und lexikalischen Relikte, në revistën Dardania, 4 / 1995, Wien, 1995, f. 86-127.

[1] sh. punimin e tij Deutsche Bergmannswörter in den Balkansprachen nach einem Zeugnis der französischen Renaissance, Germanoslavica, III, 1-2 (1935), f.145.

[2] Enver Hoxhaj, Kërkime për historinë e Kosovës në kohën romake: Ushtria, qytetet, shoqëria dhe popullsia. (dorëshkrim), f. 49.

Pjesa e përcaktuar me kufijtë administrativë, që sot quhet Kosovë, e Dardanisë pararomake, është e njohur gjatë gjithë historisë për pasuritë e saj nëntokësore. Nga burimet historike të shkruara dhe nga më shumë se 120 monumentet epigrafike e nga mbishkrimet varrore të hapësirës së sotme të Kosovës, për të cilat dihet deri më sot, mësohet se, mbase aspak rastësisht, pas nënshtrimit definitiv të Dardanisë, edhe pushtuesit romakë e përqendruan (apo edhe e vazhduan) urbanizimin, përkatësisht etabilimin e administrimit të tyre pikërisht në zonat e pasura me minerale të Kosovës së sotme. Historia na mëson se rrjedhojë e urbanaizimit romak të Dardanisë së pushtuar që nënkupton pra ngritjen e qendrave administruese është themelimi i municipiumeve "bashkive" romake të Ulpianës (në rrethina të Prishtinës) dhe të Municipium-it D. D. mbase në katundin e sotëm Soçanicë të komunës së Leposaviqit që gjithsesi lidhet me shfrytëzimin dhe me administrimin e minierave edhe atëherë aktive të Janjevës, të Novobërdës e të Trepçës, përkatësisht minierave në Malet e Kopaonikut e të Rogoznës që u organizuan si distrikte minierash të drejtuara nga prokuratorë shtetërorë të Romës. Me qëllim shfrytëzimi të këtyre minierave nga të cilat nxirrej kryesisht argjend, plumb dhe bakër, perandoria romake solli kolonë italikë e provincialë të Perëndimit si dhe pelegrinë, të liruar e skllevër nga të dyja pjesët e saj.

Nga studiues të historisë së vjetër të Kosovës mësohet se zhvillimi i xehetarisë në hapësirën e muncipiumeve të mësipërme në kohën romake kishte marrë hov sidomos në shek. II-III. Këtë e ilustron edhe rrethana që gjatë sundimit të perandorit Traian, pikërisht në Municipiumin D. D., që identifikohet me Soçanicën e sotme, ishte prerë edhe monedha me mbishkrimin *Dardanici*. Në çerekun e parë të shek. II Soçanica ishte mbase qendër administrative e distriktit *Metalla Dardanica* e Kopaonikut dhe e Rogoznës. Duket se njëkohësisht me qendrën administrative municipiale do të ketë pasur edhe një *Colonia*. Kjo sepse janë dëshmuar dy lloje prokuratorësh të minierave: *procuratores Augusti* "prokuratorë perandorakë" dhe *procuratores municipi* "prokuratorë muncipialë". Kategorisë së parë i takon p.sh. i liruari *Telesphorus* që dëshmohet në një mbishkrim të viteve 136-137 të gdhendur në një lter të gjetur në Forumin e Municipium D. D. e të sponsoruar nga *coloni arg*[*entariarum Dardanicarum?*]. Mbishkrimi është lexuar: *Antinoo He*[*roi aedem* (?) *iussu*] | *imp(eratoris) Caesaris T*[*raiani Hadriani Aug(usti)*] *et L. Aelii* [*Caesaris Aug(usti) f(ilii)*] | *coloni arg*[*entariarum Dardanicarum*?] | *curante Telesph*[*oro proc(uratore) Aug(usti) lib(erto) fec(erunt)*]. Një tjetër i liruar perandorak që e ushtronte postin e *procurator metallorum* të Soçanicës ishte edhe *Amandus* i dëshmuar në një mbishkrim të kohës së perandorit Antoninus Pius khs.

mbishkrimin [*Anton*]*in*(*us*) *Pi*[*us...*] | [*t*]*rib*(*unicia*) *po*[*t. XVIIII cos.*] | *III p*(*ater*) *p*(*atriae*) [*procos.*] *Amandus* [*Aug(usti)*] | *l*(*i*)*b(ertus) proc*(*curator*) *patrono* | *indulgentissim*(*o*) | *s(ua) p*(*ecunia*) *p*(*osuit*). Grupit të dytë i përket një i quajturi Titienus Verus, i cili në Soçanicë e ushtronte postin e *proc(urator) m(etallorum) m(unicipi) D.D.*[3] Mbetet për t'u parë nëse me këtë do të ketë lidhje edhe etiketa me tekstin IMP DOMIT CAESARIS AVG GER *MET DARD* (nënvizim i imi) SVB C CAL P. T CAES CCXV HIXXIV e gdhendur në gjashtë kallëpe (unca) të legurës së aluminit, të zbuluara në vitin 1993 në një anije të përmbytur në Cezare (Palestinë).[*]

Nga burimet historike dhe nga materiali epigrafik, nga mbishkrimet varrore të ngritura për të huaj e për pak vendës të inkuadruar në rregullimin romak të jetesës dhe nga lterë e faltore të ngritura për nder të hyjnive të ndryshme rezulton se Ulpiana dhe municipiumi i shenjuar me shkurtesat D. D. (që interpretohen si *Municipium Dardanorum* dhe si *Municipium D(amastium) D*[*ardanorum*]) ishin në të vërtetë qendra të administrimit të minierave (khs. distinktivin *Metalla Ulpiana*). Të dya këto qendra romake ishin (ri)ngritur përgjatë arterieve kryesore rrugore - udhëve Lissus - Naissus dhe udhëve sekondare që nga Scupi nëpër Novipazar shpinin për në pjesën boshnjake të provincës së Dalmacisë. Në këtë kontekst duhet kuptuar edhe ngritja nga romakët e stacioneve doganore dhe e posteve vëzhguese (*statio*) të beneficiarëve përgjatë këtyre rrugëve, që për detyrë parësore e kishin mbrojtjen e transportimit të xeheve të Dardanisë për në Dalmaci e më tutje për në Itali nga *latrones* - "cubat" dardanë.[4]

Pikërisht për shkak të karakterit prej kolonish të sajuara nga të liruar, nga skllevër, nga kolonë të vendosur nga pjesët e Perëndimit e të Lindjes së Perandorisë Romake, përbërja etnike e popullatës së këtyre dy qyteteve miniera të Rrafshit të Kosovës, përfshirë këtu vendbanimet në krahinat e sotme të Gallapit e të Karadakut, përkatësisht minierat në e përreth Janjevës, Novobërdës edhe ato të regjioneve malore-mineralore të Maleve të Kopaonikut e të Rogoznës, përkatësisht minierës së Trepçës etj., ishte shumë heterogjene. Vetëm kështu mund të sqarohet mbase fakti përse Dardania ishte qendër vetëm e shfrytëzimit të mineraleve të saj, jo porse edhe një provincë romake në të cilën do të kishte edhe qendra kulturore, teatro e infrastrukturë prej qendrash qytetare si në Ilirinë e Jugut, në

[3] E. Hoxhaj, poaty, f. 110, 111 dhe mbishkr. 15, 45, 48 dhe 49.(dorëshkrim)

[*] Unë nuk e ndjej veten kompetent të gjykoj nëse pjesa MET DARD po u dashka të lexohet si Met(alla) Dard(aniae) ose Met(alli) Dard(anici) dhe nëse ky prodhim do të jetë nga Dardania e Ballkanit - siç mendon autori Ukshin Zajmi, Gjurmë lashtësie në trevat e Gallapit, Gallapi, Revistë periodike e trevës, nr. 6 qershor 2010, f. 61.

[4] E. Hoxhaj, Po aty, f. 90.

Dalmaci e në hapësira të tjera të pushtuara nga kjo perandori.

Është me interes të përmendet në këtë mes konstatimi i dijetarit gjerman Dr. Rolf Ködderitzsch[5] sipas të cilit në gjuhën shqipe nuk paska asnjë emër metali që do të ishte trashëgimi e drejtpërdrejtë indoeuropiane, përkatësisht vendëse e shqipes, sado që përpunimi i metaleve për te pararendësit e shqiptarëve në hapësirat e sotme të tyre etnolinguistike është i dëshmuar mirë. Autori ynë kujton se leksiku vendës i lidhur për emrat e metaleve do të jetë ndërruar në tërësi pa i pas marrë vesh arsyet përse ndodhi kështu. Mua më duket që arsyet për zhdukjen e terminologjisë vendëse të mineraleve dhe të xehetarisë, që ilirët e dardanët e kishin kultivuar qysh para pushtimit të tyre nga Perandoria Romake, duhet të kërkohen te rrethana që ilirët e dardanët kontinentalë ishin kryesisht banorë lartësish dhe blegtorë dhe se (ri)inkuadrimi i popullatës vendëse në fushën e minierave ndodhi shumë më vonë, në kohën kur në miniera mbizotëronte gjuha latine, përkatësisht terminologjia latine e xeheve dhe e përpunimit të metaleve (khs. p.sh. huazimet e vjetra *ar*, *argjend*, *rem*, *plumb* e ndonjë tjetër) apo që terminologjia e huaj e xehetarisë në shqipen të sqarohej me konstatimin e studiuesit Ködderitzsch sipas të cilit "Shqipja, si edhe rumanishtja, është gjuhë e cila ka prirje që shumë shpejt të huazojë" leksik nga të tjerët.[6]

Gjatë periudhës së sundimit bizantin, perandori Justinian me origjinë dardane rindërtoi kështjella të vjetra dhe ndërtoi të reja për ta mbrojtur perandorinë nga sulmet e sllavëve që lypnin vend për t'u ngulur. Me të krishterizuar në shekujt 9-10, sllavët ardhës u përqendruan në ngritjen kishave të ritit bizantin, përkatësisht ortodoks sllav kryesisht mbi themele të atyre të periudhës së krishterimit uniat dhe sosh të reja e, asnjë qytet.

Stepan Nemanjës, themeluesit të bërthamës së shtetit serb të Rashës, një hapësirë kjo e banuar që nga lashtësia paraserbe nga popullata vendëse e romanizuar, vllahe e shqiptare, "iu bë shpejt e qartë se Rasha nuk i ofronte atij mundësi për themelimin e një shteti më të fortë pa e pasur edhe një bazë të fortë ekonomike. Së këndejmi ai u hyri përleshjeve me luftë me Bizantin për të depërtuar në Kosovë e në luginën e Moravës dhe ta zhvillonte kështu bujqësinë. Krahas kësaj, Nemanja mbante porse raporte të mira me raguzasit, tanimë tregtarë të njohur, duke qenë se të

[5] Parashtresë në diskutimin Mythen und Fakten zur Ethnogenese und "frühen Heimat" der Albaner. Historische und sprachhistorische Aspekte, i organizuar nga Südost-Institut, Regensburg, më 24. prill, 2009.

[6] Po ai, po aty.

tillë nuk kishte nga radhët e veta."[7]

Politikën e tij e vazhduan edhe i biri Stefani, i Kurorëzuari i Parë dhe Vukani, ndërsa Stefan Urosh-i I "i ftoi sasët në Serbinë e shkretëruar, që t'i hapnin minierat në hapësirën e Kopaonikut. Ardhjen e sasëve e shfrytëzuan tregtarët raguzas që e kishin në dorë gjithë tregtinë, prandaj blenë puse minierash e miniera të tëra dhe e finansonin rrëmihjen dhe përpunimin e xeheve. Shfrytëzimi i minierave u besohej rëndom, me kontrata të përhershme, shoqërive private." [...] Në burime shkrimore serbe e të tjera sasët përmenden shprehimisht tek në kohën e sundimit të mbretit Milutin (1282-1321), sado që s'ka dyshim që ata kishin ardhur shumë më herët. Dihet qëmoti se sasët ia prenë mbretit Vladislav monedhën e parë serbe, ndërsa për mbretin Urosh (1234-1276) M. Orbini shkruante se Urosh-i kishte dërguar njerëz në Gjermani që prej atje të sillnin sasë, të cilët ishin të zotë në nxjerrjen e xehes, për çka edhe u bë shumë i pasur".[8]

Hedhja në ankand (edhe) e minierave në zonat minerale të hapësirës së Kosovës së sotme ishte e mundshme, sepse princër lokalë i kishin bërë për të vetat jo vetëm ato miniera që ishin shfrytëzuar edhe nga romakët, porse edhe ato që do të kenë qenë përtërirë dhe hapur rishtazi nga minatorët sasë.

Ky veprim shpjegohet mbase më së miri me rrethanën se serbët ardhës si pushtues nuk kishin ndonjë përvojë në nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve.

Duke qenë element ardhës, koha e ngulitjes, përkatësisht e themelimit të kolonive, e mënyrës së organizimit të jetës juridike e të asaj fetare të elementit etnik sas dhe shuarja si rezultat i zhvillimeve historike që e kushtëzuan denacionalizimin, përkatësisht asimilimin e tij me popullatën vendëse dhe largimin e tij nga kjo hapësirë, të gjitha këto aspekte do të trajtohen në kontekstin e të dhënave historike dhe të mbetjeve onomastike e leksikore të tyre në relacion me popullatën vendëse.

Mbi bazën e rrjedhës së ngjarjeve në fushën e xehetarisë, që mund të hetohen nga studimi me vëmendje i lëndës historike që ka të bëjë me periudha të ndryshme të zhvillimit shoqëror e ekonomik të hapësirës së Dardanisë që nga periudha parahistorike, si dhe mbi bazën e analizës së materialit onomastik në vende e në qendra minerale të tipit qytet – minierë të hapësirës së sotme të Kosovës, del se xehetaria kishte në Dardani një traditë të lashtë. Këtë e dëshmon drejtpërdrejt rrethana që historia na mëson se perandori romak Traiani e kishte shpërngulur me forcë fisin ilir të pirustëve (të njohur për xehetarë të shkathtë) të Dardanisë në tokën e

[7] thonë Nikola Čolak-Ive Mažuran, *Janjevo*, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 13.

[8] Po ata, Po aty, f. 15.

Dakëve, për të punuar edhe atje si minatorë në xeheroret e Dakisë. Pirustët dardanë, sikundër dihet, e banonin pjesën midis Prizrenit, Kukësit e Krumës dhe kujtimi për ta ruhet mbase tek emri i vendit *Qafa e Prushit*, përkatësisht tek emri i katundit Prush në Malësinë e Gjakovës.[9] Ka mundësi që pikërisht pirustët dardanë, sepse edhe vetë emri *Pirust* mund të jetë një përkthim latin i emrit *Dardan*, të jenë themelues të kolonisë, qytetit Romula Malva (sot Reşca në rrethin e qytetit Olten) të Rumanisë, në rrënojat e së cilës (koloni) në vitin 1969 u zbuluan një pllakë mermeri me reliefin e portretit të hyjneshës *Dardanica* dhe një pllakë mbishkrimi kushtuar një të quajturi *Aurelius Dardanus*.[10]

Pak më ndryshe veproi pushteti perandorak i Romës edhe me fisin ilir të Delmatëve. Zef Mirdita na mëson se "Këtë na e dëshmojnë të dhënat e Florit, i cili thotë se Augustus-i i dha urdhër Vivi-ut, mëkëmbësit të Dalmacisë, që ta detyronte popullsinë vendase për të punuar në minierat e xeherorëve".[11]

Për t'u kthyer përsëri te xehtaria e Dardanisë meriton të vihet në spikamë se ka një mendim sipas të cilit njëra ndër qendrat minerale të Ilirisë "...ishte edhe Damastioni. Straboni thotë se ai (SG: Damastioni) ishte i pasur me minerale, sidomos me argjend. Edhe pse nuk është caktuar saktësisht se ku gjendej, prapëseprapë në rastin tonë konkret është me rëndësi të theksohet se ai ndodhej diku në trevën ilire.. ..". - thotë Zef Mirdita,[12] për të përfunduar më poshtë se "Straboni [...] duke dhënë shtrirjen gjeografike të fiseve ilire të cilat shtriheshin pas Epidamnit, Apollonisë dhe maleve Keraune, thotë se këto kanë: "*bulinët, taulantët, partinët dhe brygët; aty afër janë xeheroret e argjendit në Damastion rreth të cilave dystët vendosën sundimin e tyre*...". E njëjta gjë është edhe me Palimpsestin e Vatikanit, që është i shek. V-VI të e. s., i cili Damastionin e vendos në Iliri, rreth xeheroreve të argjendit. [...] Në vitin 1961 në jugperëndim të Janjevës, në vendin e quajtur "Bijela zemlja" janë zbuluar mbetje të një vendbanimi antik dhe meqenëse e tërë kjo trevë me Novobërdën e Kishnicën është e njohur si vend xeheror, i cili është shfrytëzuar edhe para pushtimit romak, rreth galerive të xeheroreve, me siguri është ndërtuar vendbanimi për xehetarët. Pastaj duhet theksuar se pikërisht në këtë trevë janë gjetur shumë monedha të Damastionit, kur si

[9] Çabej, Ilirishtja dhe shqipja, në Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, Sesion shkencor, 3-4 mars, 1969, Tiranë 1969, f. 45; Poai, Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe, "Përparimi" 10-11 (Prishtinë), 1972, f. 62.

[10] Dimitru Tudor & Cristian Vlădescu: Die Dardanen in Romula-Malva, në DARDANIA, Zeitschrift für Geschichte, Kultur, Literatur und Politik, Nr. 11/2001, f. 41-49.

[11] Zef Mirdita, Studime dardane, Tiranë, 1981, f. 77.

[12] Po ai, Po aty, f. 79.

Straboni ashtu edhe Palimpsesti i Vatikanit i përmendin xeheroret e argjendit, të cilat gjendeshin në afërsi të Damastionit" për të përfunduar se "Pikërisht këto të dhëna na bëjnë të mendojmë se Damastionin duhet ta kërkojmë në afërsi të Kishnicës, të Janjevës apo të Prishtinës".[13] Në një punim timin të botuar më 1976[14] këtë qytet e kisha lokalizuar edhe unë në rrethina të Janjevës. Për këtë qytet - minierë ka shënime edhe në shekuj të mëvonshëm (sh. më poshtë).

Unë nuk kam kompetenca të gjykoj se sa i drejtë e i bindshëm është identifikimi e lokalizimi i Damastionit në e me Janjevën e sotme që e propozon Zef Mirdita. Në rolin e ndërmjetësuesit midis problemit të shtruar dhe mendimeve të shfaqura deri tani, po i lejoj vetes ta njoftoj lexuesin se ilirologu i shquar kroat Antun Mayer shkruante se në dritën e rrethanës që ka një ngjashmëri të madhe për nga tipi, stili e forma midis monedhave të prera në Paioni me ato të prera në Damastion lejohet paravendimi se Damastioni ishte në fqinjësi me Brygët, përkatësisht se ai do të ketë qenë dikund në veri të Liqenit të Ohrit. Në të mirë të këtij identifikimi do të shkonte, gjithnjë sipas Mayer-it, rrethana se minerale ka vetëm në kufirin midis Shqipërisë e Maqedonisë dhe jo në Jugun e Shqipërisë, prandaj as identifikimi i Damastionit me vendin *Damës,-i* 10 km në veri të Tepelenës nuk mund të qëndrojë. Mayer njofton se edhe K. Jireček-u mendonte se minierat e argjendit të qytetit të Damastionit ishin në veri të Dibrës, sepse edhe Greisebach-u paska parë në qytetin e Tetovës në vitin 1839 copa minerali me vizllimë prej plumbi, të cilat ishin marrë në një minierë argjendi të përmbytur në ujë në Malet e Sharit.[15] Sadoqë nuk propozon ndonjë identifikim të qytetit-minierë Damastion, me çështjen e vendndodhjes së tij u morr tërthorazi edhe N. G. L. Hammond. Ky shkruante se "Unë interesohesha për të vërtetuar se në kohët e lashta ishin hapur miniera argjendi njëlloj, si në veri të Pindit, gjithashtu edhe më larg, në vargmalin e Gramozit, nga veriu, në vendin e quajtur Damastion… Miniera e argjendit në Damastion ka mbetur ende e papërcaktuar".[16]

Ka pasur edhe ndonjë mendim se qyteti-minierë Damastion ka mundësi të identifikohet me Municipium D. D. të Soçanicës, në komunën e

[13] Zef Mirdita, poaty, f. 112-113.

[14] S. Gashi, Ku ishte qyteti Damastion?; Rilindja, 06.12.1976, f. 13. Këtë mendim e konsideroj tani për shumë hipotetik.

[15] Anton Mayer, Die Sprache der alten Illyrier I, Wien 1957, f. 105-107. Në Luginën e Tetovës paska pasur, sipas Projekat Rastko Gračanica-Peć: Istorija: Stara Srbija, geografska i etnografska slika (1912.), edhe xehe të bakrit.

[16] N. G. L. Hammond, Epiri: I. Udhëtime në Epir dhe në Shqipërinë Jugore; II. Epiri dhe pushtimi i Greqisë nga dorët, bot. Qendra e Studimeve Ndërshqiptare, Tiranë, 2004, 74.

sotme të Leposaviqit. Sipas E. Hoxhajt[17] kështu pandehte dijetarja Sokolovka. Kjo kujtonte në të vërtetë që shkurtesat D. D. që zënë vend pas *Municipium* duhet të lexohen si *Damastium Dardanorum*, sepse qytetiminierë Damastion i kohës pararomake duhet kërkuar te Soçanica me xehetarinë e pasur në malet e Kopaonikut e të Rogoznës. Duke e kontestuar këtë identifikim, E. Hoxhaj spikat këto fakte: Së pari që në Soçanicë nuk është zbuluar deri tani asnjë vendbanim që do t'i paraprinte drejtpërdrejt këtij të priudhës romake e i cili do të mund të shihej për i barabartë me Damastionin. Së dyti, monedha të qytetit pararomak të Damastionit janë gjetur në një hapësirë të gjerë të Ballkanit të Jugut e asnjë e vetme në vetë Soçanicën. Së treti, në këtë trevë nuk ka dëshmi të prerjes së monedhave dhe të xehetarisë së kohës pararomake.

1.2. Xehetaria dhe minierat në dritën e burimeve kishtare serbe

Sado të pakta, shënimet e mësipërme mund të shërbejnë për dëshmi se xehetaria në hapësirën e Dardanisë antike i heq rrënjët që nga periudha e para pushtimit romak të Dardanisë. Kjo rrethanë do të mjaftojë mbase për të paravenduar se serbët e ardhur në këto vise në shek. 12, ashtu sikundër që historia e tyre nuk ka periudhë të antikës ballkanike, po ashtu nuk mund të jetë as vazhduese e përvojës së periudhës pararomake e romake në fushën e xehetarisë. Bile nga shkencëtarë të merituar si K. Jireček e të tjerë është thënë jo vetëm një herë se xehetaria që në lashtësinë parasllave të Ballkanit e kishte arritur lulëzimin e vet, u shkretërua pikërisht si pasojë e dyndjes së popujve, përkatësisht të sllavëve.[18]

Kjo edhe është mbase arsyeja përse në dy dokumentet më voluminoze të kishës serbe të shek. 14, përkatësisht në Krisobulat e Deçanit (1330) dhe në krisobulën e sundimtarit serb Stefan Dushan për manastirin e shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit (1348), për në Rrafshin e Dukagjinit dhe për Shqipërinë e Veriut kemi vetëm dy dëshmi për të cilat është pandehur, mbase me të padrejtë, se paskan të bëjnë me miniera të arit apo të argjendit. Pas një trajtimi më të vëmendshëm të këtyre burimeve, rezulton se në këto njoftime kemi të bëjmë në të vërtetë jo me miniera të arit apo të argjendit, porse vetëm me shpëlarës të arit nëpër lumenj që praktikisht e vazhdonin një traditë të para pushtimit serb në fillim të shek. 13 të Kosovës së sotme dhe me mjeshtër të asokohshëm që e vazhdonin traditën parasllave të përpunimit të arit. Për dëshmi të

[17] Kërkime për historinë e Kosovës në kohën romake: Ushtria, qytetet, shoqëria dhe popullsia., f. 108, ref. 547 (dorëshkrim)

[18] khs së voni edhe Miklós Takács, Sächsische Bergleute im mittelaterlichen Serbien und die "sächsische Kirche" von Novo Brdo, Südost-Forschungen, Band L, 1991, f. 31-32.

ekzistimit të shpëlarësve të arit e ndoshta edhe të përpunimit të tij mund të merret urdhri edhe i vetë i sundimtarit serb Stefan Dushan në Krisobulat e Deçanit të vitit 1330 ku e kur ky sundimtar urdhëronte që "Farkëtarët, argjendarët dhe punuesit e shalave e të samarëve si edhe rrobaqepësit dhe të gjithë mjeshtrit duhet të punojnë si edhe *sokalnikët*".[19]

Unë mendoj se, mbështetur në historikun pararomak e pra gjithsesi edhe parasllav të xehetarisë në Kosovën e sotme, kjo urdhëresë nuk mund të mbështetet mbi një situatë të krijuar nga pushtuesit serbë, porse vetëm mbi bazën e një situate të gjetur nga këta në hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve të para pushtimit serb të Kosovës së sotme në shek. 12.

Përveç kësaj, në këtë dokument përmendet edhe një *Radĕi*, banor i katundit Çabiq të Klinës, që ishte argjendar. Duke u mbështetur tek rrethana se njëri ndër banorë të këtij katundi ishte edhe kyefamiljari *Toloje*

[19] Përkundër angazhimit tim për korrektësi të interpretimit të burimeve të shfrytëzuara për këtë trajtesë, unë nuk arrita ta marr vesh kuptimin e mirëfilltë të nocionit *sokalnik*. Kjo sepse termi *sokalnik* konsiderohet edhe në vetë filologjinë sllave të jugut për një fjalë me prejardhje të paqartë. Nga dijetarët serbë të merituar Dj. Daničić, tek Rječnik JAZU XV, bleu 63, Zagreb 1955, f. 887 dhe St. Novaković, Selo, (Reprindt), Beograd, 1965, f. 156, 230, 233 këtij termi i është dhënë vlera e barabartë kuptimore me termin latin *colonus* "*i ardhur; kolon; kolonizues*" të tij. Ky term shenjonte në të vërtetë katundarin (bujkun), i cili ishte i detyruar ta paguante tagrën e quajtur *soć*; kishte porse pozitë pak më të mirë sociale se *meropah*,-u. Me shpresë se do t'i ndihmoj lexuesit të nderuar që ndoshta ky vetë do t'i bie n'fije domethënies së këtij nocioni social, po i sjell shënimet përkatëse lidhur me kuptimin e këtij termi në krisobulën e Banjskës (1313-1318) dhe në krisobulat e Deçanit (1330) nga të cilat mësohet se sokalnikët ishin kategori më vete sociale. Për këtë kategori kishte madje edhe një ligj të veçantë. Kështu, në krisobulat e Deçanit në kontekstin që ka të bëjë edhe me *sokalnik*-ët përkujtohet se familjet e kryefamiljarëve të padjelm ose të pavëllezër mund të bashkoheshin në një të vetme edhe nëse ato merreshin me punë të ndryshme, në mënyrë që atyre të mos u binte shumë barrë pune. Kjo vlente edhe për gjahtarët me fajkua dhe për mjeshtrit, qoftë kur ata nuk kishin djalë apo vëlla, qoftë edhe kur kishin më shumë sish. [khs. tekstin origjinal: "I koji nemaju sina ili brata ili rabotnika, jedinaci, dva da se stišteta, ako i raznu rabotu i zemlju imata, нь na ine rabote, a oranije i vinograd razno. Takožde i sokalnici i koji ljubo majstorije" dhe përkthimin shqip të këtij: "dhe ata të cilët nuk kanë djalë ose vëlla ose punëtor, të vetmit, të bashkohen në dy (familje) edhe nëse kanë punë të ndryshme e toka të ndryshme, punë të tyre vetanake të mbjelljes e të vreshtës. Gjithashtu edhe gjahtarët me fajkua dhe mjeshtrit" dhe për ata që kishin më shumë djelm urdhërohet që njëri nga ata duhej të ishte gjahtar me fajkua. Sipas *Ligjit të sokalnikëve*, të sanksionuar në krisobulën e Deçanit, është shënuar shprehimisht se për manastirin e Deçanit "*sokalnikë*" do të jenë 33 njerëz: në Deçan 3, në Beleg 1, në Prapaqan 6, në Isniq 1, në Strellc 3, në Luboliq 2, në Rostovicë 4, në Prilep 6, në Babaj 2 dhe në Gramaçel 5 sish. Sh. Dečanske hrisovulje, në Glasnik Srpskog Učenog Društva 12 (1880.), bot. Miloš S. Milojević, f. 133.

Sasinović, i cili në vend të patronimit të mirëfilltë e mbante mbase emrin etnik "sas-, i bir i sasit", ka vend të mendohet se edhe në këtë rast kemi të bëjmë me individë sasë mjeshtër ose shpërlarës të arit, të cilët në Rrafsh të Dukagjinit nuk kishin ngritur asnjë koloni të tyre. Më tej duhet përmendur në këtë kontekst paravendimin se gjurmë të një miniere të vjetër (e padëshmuar se vërtet ishte minierë e argjentit) mund të ketë pasur në vendin e quajtur *Rudnik*, jo larg vendit ku janë rrënojat e manastirit Studenica e Vogël në malin Mokna në komunën e Istogut. Me më shumë siguri për ekzistimin e ndonjë minierëze apo pusi mund të merret përmendja e vendit *kolo gvozdeno* "pusi; shtona e hekurit", përskaj së cilës përmenden edhe disa farkëtarë, që ka të bëjë me vend dhe me banorë të katundit Botushë të Malësisë së Gjakovës.[20] Në përkrahje të konstatimit për pasjen në Rrafsh të Dukagjinit shpëlarës të arit do të duhej përmendur se "[...] qysh në periudhën pararomake këndej vazhdonte larja e arit nëpër lumenj. Këtu bien vendbanimet e lëna shkret të shpërlarësve të arit që përmenden në krisobulën e mbretit serb Stefan Dushan për manastirin e shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit. Në këtë krisobulë përmendet një vend i quajtur *Truallishtat e argjendarëve*, i cili ndodhej në hapësirën midis katundeve të sotme Medvec, Mamushë, Piranë e Retijë të Rahovecit, përkatësisht Suharekës: khs. përshkrimin në tekstin e kësaj krisobule: "Katundi Medvec dhe mexha e tij nga Momusha nga Toplluha e te Guri, pastaj tek guri i ngulur sipas shkresës për Malin e Shenjt, nga Guri në Kodër mespërmes Lugut t'Dhimitrit deri në Retime dhe nëpër mal udhës teposhtë e te *truallishta e argjendarëve* te Guri dhe në mal përbri rrugës e te Guri. te Kryqi, udhës e te Pirana e Vjetër".[21] Njo-

[20] khs. Miloš S. Milojević, Dečanska hrisovulja, në Glasnik Srpskog Učenog Društva 12, Beograd 1880, f. 133: "A kovačije i zlatarije i sedlarije i šьv'ci i vsi maistorije da rabotaju jako i sokal'nici." dhe. *raděi zlatarъ*. .. *toloje sasionivikъ* te Dečanske hrisovulje..., f. 20, 22, 89, 131; K. Jireček-J. Radonić, Istorija Srba, II., 173.; M. Šufflay, Serbët dhe shqiptarët, Prishtinë, 1968, f. 51; C. Jireček, Staat und Gesellschaft …, f. 60. Rrethana që kolonia më e vjetër e minatorëve sasë ishte në e përreth Bërskovo-s e cila në lashtësi ishte e banuar nga fisi ilir i pirustëve i cili (fis), siç na mësojnë historiografët romakë, njihej për i shkathët në zanatin e xehetarisë dhe ishte fqinj i dokleatëve e i labeatëve do të tregonte se tradita e marrjes me xehetari në këtë hapësirë vetëm u përtëri nga xehetarët sasë. Qenien e pirustëve xehetarë të mirë e tregon, më tej, edhe rrethana që në kohën e perandorit romak Trajan pirustët u vendosën, pa dëshirën e tyre, deri edhe në Daki në mënyrë që edhe atje ta zhvllonin xehetarinë. (khs. Pavle Radusinović, Stanovništvo Crne Gore do 1945, Beograd, 1978, f. 6.). Khs. edhe tekstin sipri referencës 10.

[21] khs. origjinalin te Hrisovulja cara Stefana Dušana koiomъ osniva rnonastirъ Sv. Arhangela Mihaila i Gavrilja u Prizrenu godine 1348 ? Glasnik Društva Srbske Slovesnosti 15 (1862), bot. J. Šafarik, f. 279 "Selo medvĕd'cь. a megja mou ѡt momouše. ѡt toplouhe ou kamы, tere u bĕlĕgъ svetogorъskьi. ѡt kamena ou brьdo

hësi i shkëlqyeshëm i historisë së Shqipërisë së Veriut Milan Shufflay e mbante këtë truallishtë, mbase gabimisht, për vend me disa xeherore të shkretëruara të arit. Ky dijetar i përmend në këtë kontekst edhe shpëlarësit e arit të cilët relatori Kuripešić i Vatikanit i paska parë me sy të vetë në vitin 1530 midis Novipazarit dhe rrënojave të manastirit të Banjskës, në rrethina të Mitrovicës. Në favor të ekzistimit të minierave të arit dhe në përgjithësi të xeheroreve në Shqipërinë e Veriut, Shufflay e sjell emrin e katundit *Monte del Oro* (1416) në rrethinën e Shkodrës si dhe "...lajmet nga shek. XVII mbi xeheroret e hekurit, sulfurit, argjendit dhe arit në rrethinën e Lezhës dhe në krahinën e Dukagjinit,...", për ta nxjerrë përfundimin se "duket se xehtarët Sasë nuk i kanë përtri xeheroret e vjetra romake vetëm në Serbinë e Vjetër, por edhe në Shqipninë veriore".[22]

Serbët e ardhur as nuk i ndërtuan e as nuk i vazhduan vendbanimet e lashta të tipeve të ndryshme e as ato të tipit qytet-minierë. Së pakut tri qytete-miniera të lashta të Kosovës, Novobërdën, Janjevën e Trepçën feudalët lokalë serbë i bënë, në kuadër të fazës së ekspansionit të "shtetit" të tyre të Rashës, prona të tyre private dhe pikërisht mbase për shkak të mungesës së traditës në nxjerrjen e xeheve që në fillim të shek. 13 i hodhën, siç do të thuhej sot, në ankand në mënyrë që ato miniera t'i riaktivizojnë, mirëmbajnë e drejtojnë mjeshtër popujsh të ndryshëm.

Kjo dëshmohet edhe në dritën e rrethanës që, siç njoftonte Appendini, despoti Gjergj Brankoviq (Đurađ Branković) ua kishte dhënë raguzasve të drejtën e shfrytëzimit të të gjitha minierave Novobërdës, Janjevës e të Kratovës për 200.000 duketë në vit. Fitimet nga ato miniera në dobi të Raguzës ishin aq të larta, sa që kah fundi i shek. 15 në arkën e Republikës kishte shtatë milionë duket. Vartësinë e fatit politik, përkatësisht të mbetjes në pushtet të sundimtarëve serbë nga koncesionet për minierat e theksonte edhe udhëpërshkruesi frëng Betrandon de la Broquière (bashkëkohës i Gjergj Brankoviqit), i cili shkruante se njerëz që i njohin punët mirë i paskan treguar këtij se despoti Brankoviq e paska në pronësi qytetin e quajtur Novo Brdo (Nyeberge) mbi lumin Morava. Këtu nxirren argjent e ar bashkë dhe prej këtu ai fiton 200.000 duketë në vit. Udhëpërshkruesi thotë, në vazhdim, se po të mos ishin këto të ardhura, "mendoj se despoti do të dëbohej qëmoti nga vendi i tij i Rashës."[23] Kjo sepse as familjet

posrĕd d'mitrova dola do rĕtivlje. ì po dĕlou nis pouть na *zlatarьska selišt'a* ou kamы: i na dĕlь prĕs poúть ou kamы. na krsть poutemь na stáre piranы".

[22] Milan Shufflay, Serbët dhe shqiptarët, Prishtinë, 1968, f. 5.

[23] sipas Nikola Čolak-Ive Mažuran: Janjevo, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 16.

feudale serbe nuk do të kenë qenë të organizuara më ndryshe se ato shqiptare të principatës së Arbërit. "Secila prej këtyne familjeve formonte nji palc shtetnuer të vërtetë. Të gjitha mbajshin nji oborr, në të cilin shkojshin e vijshin të mdhajt e kryetarët, ashtu edhe bujarët *zentiluomini, boiari*; kishin ministrat e financavet (*protovestiari*), kancelarët (*logofeti*) "dijakët", rregullojshin administrimin me anën e qefalijvet e të vojvodvet".[24] Kuptimin e këtij termi, Jireček e shpjegon pak më ndryshe. Sipas këtij, fjala *logofet* rrjedh nga "greq. logothétes "Kancelar i Oborrit", te raguzasit "notarius domini regis". E kishte dhe autorizimin e mbikëqyrjes së kishave; ai ishte kësisoji një organ i sundimtarëve të Landeve në raport me kishën e Land-it; Në zyrën mbretërore logofeti ishte një zotëri i madh, i cili e drejtonte punën e zyres, i diktonte e i stilizonte shkresat, në çështje të financave zëvendësohej nga protovestiari."[25]

Kështu do të ketë qenë e organizuar edhe familja e Nemanjidasve, njëri nga pinjollët e së cilës - Stepan Nemanja - me disa trupa të zgjedhura nga ai e pushtoi në vitin 1169 Rashën e cila paska qenë "bashtinë e të gjyshit"- thotë S. Ljubić e pastaj territoret jugore që ishin nën Radoslavin, të vëllanë e Stepanit (Nemanjës) zhupanin e madh pararendës të tij të Rashës dhe pastaj edhe Zetën e Zahumljen,[26] përkatësisht Hercegovinën e sotme (sh. edhe më poshtë). Fundja, p.sh. edhe sundimtari Milutin, përkatësisht Stefan Uroshi I, është cilësuar në një dokument për *zot i Banjskës*[27] ku në vitet 1313-1318 e kishte ngritur, mbi bazën e të drejtës së trashëgimisë, edhe manastirin që njihet me atë emër pikërisht pse pushteti i tij nuk shtrihej më gjerë se një famulli e vogël, toka e së cilës bëhej e tij pse ai me pëlqimin e së ëmës dhe të të vëllait Dragutin e ngriste aty një manastir. Po kështu ndodhi më vonë edhe me qytetin e Novobërdës i cili

[24] sipas Milan Shufflay, Serbët dhe Shqiptarët, f. 234.

[25] Constantin Jireček: Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien Studien zur Kulturgschichte des 13–15 Jahrhunderts, I, Denkschriften des Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch- Historische Klasse, Band LVI, Wien 1912, f. 17, 19.

[26] sh. Sime Ljubić, Opis jugoslovenskih novaca, Zagreb 1875, f. 29. origj.: "*svoju djedovinu*" të cilën Constantin Jireček: Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien, Studien zur Kulturgeschichte des 13-15 Jahrhunderts, I, Denkschriften des Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch-Historische Klasse, Band LVI, Wien 1912, f. 39 e shpjegon: "djedina, dedina "das großväterliche Geschlechtsgut" "pronë gjyshërore e trashëguar nga familja", për ndryshim nga *baština*, "Vatererbe von bašta" "bashta, përkatësisht bashtinë e trashëgueshme nga babai", i njohur edhe në Bullgari; në brigjet bregdetare të Adriatikut është përkthyer si. "patrimonium".

[27] khs. Ljub. Stojanović, Stari srpski rodoslovi i ljetopisi, Beograd, 1883 f. 57: "prijeть kralěvьstvo (ose: vьkrali se) Stefanь peti,, Ourošь vьtorьï Milutinь kralь banьskые. Prenese stolě vь Dardaniju podь Šarь planinou zovimi Prizrěnь. ..".

u bë pronë private e familjes katundare përkatësisht vllahe të Hrebeljanoqëve, përkatësisht të pasardhësve të saj që i kishin shërbyer carit serb St. Dushan. Kështu shpjegohet, konform sqarimit të K. Jireçekut, përse qyteti i Novobërdës hovin më të madh të zhvillimit të tij e mori në kohën e sundimit të knezit Lazar, të birit të tij despotit Stefan Lazarević dhe të Đurađ (shqip Gjergj) Branković-it[28] të cilët njëri pas tjetrit e trashëguan këtë qytet si pronë private të tyre. Nuk ka mbase ndonjë sqarim më të bindshëm për këtë se sa sjellja e knezit Lazar me këtë qytet, në relacion me raguzasit që në këtë qytet ishin vendosur që para kohës kur ky u bë zot i qytetit të Novobërdës. Kur në rrethina të Nishit po zhvilloheshin luftime dhe pritej që ato ta përfshinin edhe Novobërdën, knezi Lazar ua vërtetonte raguzasve privilegjet më 9 janar 1387 dhe atyre (raguzasve) që kishin bashtina në Novobërdë d.m.th. atyre që ishin ngulitur aty me shtëpi e me prona u urdhëronte që ta murosnin dhe ta mbronin qytetin e Novobërdës, ndërsa atyre që nuk ishin ngulur me lang e plang në këtë qytet ua lente të vepronin sipas dëshirës së tyre. Një formë rivaliteti në rrafshin e trashëgimit të së drejtës mbi këtë qytet-minierë vërehet mbase mbi bazën e rrethanës se po këtë letër, me ndryshim vetëm të dy-tri fjalëve, e shpalli më 20 janar në Prishtinë edhe Vuk Brankoviqi. Në versionin e nënshkruar më 9 janar në "qytetin e famshëm Kruševc të zotërisë sime" nga knez Lazari thuhet: "Dhe ata raguzas që kanë bashtina në Novobërdë. ..", ndërsa në shkresën e nënshkruar 11 ditë më vonë në Prishtinë nga Vuk Brankoviqi thuhet "Dhe ata raguzas që kanë bashtina në qytete të miat, ata (duhet) ta murosin qytetin dhe ta ruajnë: ata që janë mysafirë dhe që nuk kanë bashtina, le të veprojnë sipas dëshirës së tyre..." [29] Duket se ky njoftim e hap udhën për të menduar se pjesa dërmuese e banorëve të Novobërdës mund të ketë qenë me prejardhje nga Raguza dhe që, së këndejmi, raguzasit edhe ishin pothuaj se zotër të këtij qyteti. Kjo tregon se shumica e raguzasve ishin banorë të përhershëm të qytetit të Nvoberdës e të vendbanimeve nëpër të cilat ata dëshmohen në shek. 14-15.

Jo vetëm urdhri i mësipërm i knezit Lazar, porse edhe sjellja e tij ndaj këtij qyteti, që dëshmohet në shumë dokumente të tjera, nuk ndryshon aspak nga sjellja karshi lidhjeve të pronës private midis Novobërdës dhe familjes së knezit Lazar. Mjafton, sa për fillim, të përkujtohet se No-

[28] Stojan Novaković, Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje u istoriji srpskoj 14. i 15. veka, Beograd 1880, f. 31.

[29] Në letrën e knezit Lazarit, cit. sipas Fr. Miklosich, Monumenta serbica…, f. 207, 208.] është shkruar: "I ko (i) se je dubrovčaninъ zabaštiniljь u Novomь Br(ьdu)", ndërsa në atë të Vuk Brankoviqit emri i Novobërdës zëvendësohet me "po moihь gradovehь, tьzi da zigju gradь, i da čuvaju, koi li su gostie i ne su se zabaštinili, da imь e na voli kako imь gode".

vobërdën nga knezi Lazar e trashëgoi i nipi Gjergj Brankoviqi. Kjo sjellje nuk është asgjë e re, sepse "Të gjithë sundimtarët mesjetarë kishin, si edhe bujarët e tjerë, përveç të ardhurave shtetërore që u takonin si sundimtarë që ishin, edhe prona të tyre private. Për mesjetën tonë [SG: serbe] kjo shihet fare mirë nga shumë kartëdhurata, në të cilat mbreti, kur përcaktonte se çfarë i falte kishës, tregonte se këtë apo atë e kishte blerë nga njëri apo tjetri bujar, pra nga pronari i mëparshëm, ose një pasuri konkrete e kishte këmbyer me njërin apo tjetrin bujar për një pronë tjetër. Ajo që vlen për familjen mbretërore të Nemanjidëve, vlente edhe më shumë për familjet sunduse që e pasuan atë si p.sh. ajo e Lazarit që nga pozita e bujarëve të lartë, në harmoni me rrethanat politike të mëvonshme, u ngritën në rang familjesh prej sundimtarësh. Në bazë të pronave që këta ua falnin kishave mësojmë p.sh. se pronat private të Nemanjidasve ndodheshin në rrethina të Prizrenit dhe nëpër Rrafsh të Dukagjinit (në origj. serb *Metohija*), më saktësisht në Podrime, pastaj se kishin toka në luginën e Limit deri rreth Bërskovos e Liqenit të Plavës, në Zetë dhe përreth Liqenit të Shkodrës e nëpër Kosovë". Në referencën për këtë pjesë të tekstit, autori sqaronte se "...kam theksuar se në rrethina të Bërskovos, xehe u nxorën së pari në pronat familiare të Nemanjidasve" për të vazhduar me konstatimin se "kryesisht mund të thuhet se prona private (e familjeve) mbretërore u rrit falë pushtimeve me ç'rast ato, dmth. pronat e mbretërve, përfshinin të gjitha tokat e pronat ose, sipas natyrës së ngjarjeve, sundimi i familjeve mbretërore kalonte mbi tokat e pushtuara. Pas shkatërrimit të Nemanjidasve, Brankoviqët kishin psh. toka në Kosovë dhe në Luginën e Sitnicës; për Musiqët dihet se pronat i kishin në Llap, ndërsa Vukashini u ngul me shtëpi dhe zaptoi toka në Maqedoni".[30]

St. Novaković shkruan më tej se "Përmes këtij sqarimi të karakterit ekonomik vendor ose të pasurisë private, do të mund të hedhej shumë dritë mbi shumëçka të errët në historinë serbe. Duke u kujtuar përkitazi me këtë, unë i rash n'fije se pasurimi privat në mesjetën tonë (SG: serbe) u bë shkak i ngritjes së individëve e të dinastive. Pasuria e grumbulluar, feude të mëdha me shtrirje jashtëzakonisht të gjerë, qenë shkaku që pas Dushan-it, atëherë kur u këput vargoi i vjetër i dinastisë së Nemanjidasve, mori krahë demoni i përçarjes dhe i ngritjes së mbretërive e të shteteve në vend të një atdheu e të një shteti të vetëm serb. Xehetaria, ky burim i vetëm i pasurimit shumë në Serbinë mesjetare, ishte mjeti kryesor i atij pasurimi dhe i ngritjes së familjeve gjegjëse bujare. Unë kujtoj se xehetaria dhe, për kohën e atëhershme domosdo e lidhur me të, marrja hov e treg-

[30] sipas Stojan Novaković, Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje..., f. 32-33.

tisë, u ndihmoi fuqishëm para së gjithash edhe vetë Nemanjidasve që të pasuroheshin dhe ta zgjeronin pushtetin e tyre material mbi të tjerët. Si për çudi, edhe historia e ngritjes së xehetarisë në Serbi korrespondon me forcimin e Nemanjidasve. Këtu bien Uroshi I, Milutini e pas tij, pas sundimit shkurt të St. Deçanski*-t, edhe vetë Stefan Dushani. Kësaj ia vuri majën Gjergj Brankoviqi, për të cilin të gjithë historiografët bashkëkohës të tij thonë se minierat ishin burimi kryesor i pasurive të tij".[31]

Një dëshmi për pronësinë mbi miniera e kemi edhe nga fillimi i shek. 15. Kur vasali besnik i qeverisë osmane u bë në vitin 1408 vasali i mbretit të Hungarisë Sigismund-i Luksemburgut, në shenj falënderimi për pjesëmarrjen me ushtri të Stefan Lazareviqit (1374-1427) në luftën kundër Bosnjës në vitin 1411, mbreti i Hungarisë ia fali vazalit të tij minierën e Srebrenicës të pasur me argjend. Asokohe, sipas një dokumenti qirilik serb, banorët e Srebrenicës ishin "të gjithë heretikë bogomilë".[32]

"Po ajo që vlen për përparimin e përgjithshëm të shtetit, duhet të vlejë edhe për përparimin e secilës familje veç e veç. Sikundër që përparimi e hovi i Novobërdës lidhet me knezin Lazar, ashtu duhet - kështu më duket mua - edhe përparimi e hovi i familjes së knezit Lazar - sipas rendit të mendimeve të shtruara më lart - të lidhet për Novobërdën. [...] E gjithë kjo lidhje e Novobërdës për familjen e Lazarit, (sa shihet nga dokumentacioni) mund të na sqarojë se interesat e Lazarit ishin të lidhura për këtë trevë dhe për pronat private të tij. Se knezi Lazar kishte në afërsi të drejtpërdrejtë të Novobedës prona të vetat private, se pikërisht aty ishte feudi i tij,[33] mund të argumentohet katërcipërisht. Kjo dëshmohet në bazë të letrës së Lazar -it të vitit 1380 me të cilën ky i jepte manastirit të Ravanicës edhe disa katunde në rrethina të Novobërdës dhe në trevën e vendburimit të lumit Morava e jugut. Katundet dhe tokat që Lazari ia falte atij manastiri ishin Gllogovica, Prilepnica, Budriga, Kllokoti, Stra-

* I bir i Milutin-it. Në histori njihet për si Stefan Uroshi III i Deçanit. Ky kishte dërguar shkues raguzas te duka Filip i Tarant-it, të birit të mbretit Karl të Sicilisë, dhe ia kishte kërkuar të bijën, Blankën, për grua. Uroshi i kishte autorizuar raguzasit t'i thoshin Filipit se po qe se ia jep të bijën për grua, ky vetë dhe i gjithë shteti i tij do të kalojë në krishterimin e ritit katolik. Mirëpo Papa kërkoi që Uroshi ta përmbushte menjëherë këtë pemtim, përkatësisht që menjëherë ta njihte Selinë e Shenjtë të Romës e pastaj mund të martohej me Blankën. Uroshi e pranoi këtë kusht prandaj Papa i dërgoi më 11 qershor 1323 poklisarët e tij në Oborrin e sundimtarit serb. Uroshi i cili mbeti katolik edhe pas vdekjes së të shoqes siciliane, në një shkresë të datës 5 qershor 1323 ky konsiderohej nga Papa, sipas Sime Ljubić, Opis jugoslovenskih novaca, Zagreb, 1875, f. 75. për "charissimo in Christo filio Urosio regi Rasie illustri".

[31] Stojan Novaković, Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje. .. f. 33-34.

[32] sh. për këtë Bogumili u srednovekovnoj Srbiji, Wikipedia.

[33] Stojan Novaković, Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje. .. f. 34.

zha, Udha e Vranjës (në kufinj të katundit Prilepnica) - *Udha e Sasëve*[**] (Saški [saski] put) e Partesh stundenc (SG: "Kroni i Parteshit"). Se qyteti i Novobërdës ishte pronë e knezit Lazar dhe prandaj e zotëronte edhe doganën e atij qyteti, shihet qartë edhe nga rrethana se këtij manastiri ai ia falte edhe 100 litra argjend nga dogana e Novobërdës. Nga Novobërda, duke pritur kohë më të mira, Lazari ia falte edhe Hilandarit në vitin 1413 100 litra argjend. Vetëm në vijën e trashëgimisë kuptohet edhe falja nga ana e konteshës Milica me të bijtë Stefanin e Vukun (1389-1405) e katundeve Livoç, Gnilan, Pasijan e Budrizi (sot Budrikë) pirgut Vasiljev në bregdet. "Nuk është aspak më pak e njohur se *vetëm në monedhat e Lazarit* gjendet mbishkrimi i vetëm dhe i parë i emrit të Novobërdës, pastaj mbishkrimi italisht *Novomonte*, dhe se në përgjithësi vetëm në monedhat e Lazarit del mbishkrimi *italisht*: *Conte Lazar* dhe *Novomonte moneta argentea*, si edhe në monedhat e të birit të tij Stefanit: *Conte Stefan*. Konsideroj se edhe kjo është njëra nga dëshmitë se Novobërda ishte në pronësi të Lazarit" - konstatonte St. Novakoviq.[34]

Fundja, edhe vetë vendlindja e këtij knezi ishte në rrethina të qytetit të Novobërdës. "Se këtu (në rrethinë të Novobërdës) ishte bashtina dhe vendlindja e knezit Lazar shihet edhe më qartë në letrën e 8 qershorit të vitit 1411 të të birit kur ky i falte disa katunde të rrethinës së Novobërdës: Krilevën, Milojevcin, Gllogovicën, Konjicin, Zacrkvljanin, Shtircin, Ruhotincin, Modri Potokun (S.G.: lagjja e sotme *Mudripotok* e katundit Marec), Konskan e Koincin[*]. Në atë letër katundet që u përmendën më lart e që faleshin, i bir i Lazarit i quante të trashëguara nga i ati" - thotë St. Novakoviq.[35] Prejardhjen vendëse të familjes së Hrebeljanëve sikur e tregon edhe dëshmimi i antroponimit *Hrebelan* ndër banorë të krahinës së sotme të Gallapit, përkatësisht në katundin Slishan në regjionin e Medvexhës. Borxhli i tregtarit raguzas M. Luchari ishte edhe një i quajtur *Hrebelan* nga *Slixani Dolni* (Slishan i Poshtëm).[36]

** Dijetari serb A. Urošević, sh. punimin e tij *Neki detalji iz prošlosti Kosova*, Onomatološki prilozi 1, Beograd, 1979, f. 28 thotë se ky emër (Šaški put) qenka ruajtur si mikrotoponim në katundin Dragovc dhe se këtu paskemi të bëjmë me rrugën që në mesjetën e vonë e lidhte Novobërdën me Janjevën. Ka arsye të besohet që *Udha e sasëve* e vitit 1380 është rruga që e trupon katundin e sotëm Përlepnicë të Moravës dhe quhet *Udha e frengut.*

[34] Stojan Novaković, Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje,... f. 35-36.

* Sot janë të njohura vetëm katundet Krilevë, Gllogovicë e Mudripotok. Ky i fundit është lagje e Marecit.

[35] Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje..., f. 37: "ωтъ svojego bogodarovanьiago mi ωтьčьstva sia priložihь monastirou hilanьdarskomou"

[36] M. Dinić, Iz dubrovačkog arhiva I., f. 73.

Edhe Konstatin Filozofi, adhurues i despotit Lazar, shkrimtar i shek. 15, kur po e përshkruante kthimin nga beteja afër Graçanicës të vëllezërve Stefan e Vuk shkruante se ata u kthyen "në qytetin e tyre Novobërdë, qytet i argjendit, në të vërtetë dhe i arit".[37] Si të këtillë, përkatësisht si vend të pasur me ar e me argjend, këtë qytet e përshkruante edhe Pjetër Bogdani. Në një raport, mbase në krye të herës një libër më vete Geografia shenjte, Pjetër Bogdani njoftonte në vitin 1684 se: "Duke ecur prej Prizrenit drejt veriut arrihet për një ditë udhëtim në Fushë Kosovë, të quajtur Merlino. Është ky vend shumë i rrafshët, rrethuar me xeherore të arit, të argjendit dhe të metaleve të tjera, të ruajtura nga qyteti i Novobërdës, që gjendet në malin mbretëror të Argjentinës. Sa është ky mal i varfër nga jashtë, aqë është i pasur për brenda me xehe. Pas të reshurave të shumta sikur yjet e vizllueshëm dëftohen për së jashtmi në kodra, sasi të mëdha kristali, që shpesh, duke qenë i papërpunuar, shkaktojnë frikë te banorët."[38]

Se qyteti i Novobërdës ishte pronë private e dëshmon dhe njoftimi i udhëpërshkruesit francez Betrandon de la Broquière i vitit 1432, i cili thoshte se këtë qytet "e kishin në pronësi" sundimtarët serbë. Pronë e knezit Lazar ishte edhe qyteti i Krushevcit, për të cilin, në një shkresë përmes së cilës më 9 janar 1387 ua vërtetonte raguzasve pronat e tryre, shkruante se këtë e bënte "në qytetin zulmëmadh të zotërisë sime Krushevc".[39]

Sqarimeve bindëse të mësipërme të St. Novakoviqit u duhet shtuar edhe ndonjë tfillim përkitazi me prejardhjen e familjes, përkatësisht të vetë knezit Lazar. Le të theksohet së pari që historiani raguzas Luccari - Libri i të cilit u botua në vitin 1790 - thoshte se knezi Lazar ishte në krye të herës një *katunar*.[40] Po u nisëm nga kuptimi "vendbanim blegtorësh" që e ka fjala *katun* dhe nga funksioni i *katunarit* "kryepar i katunit; kryepar lokal" del se familja e Lazarit ishte më parë vllahe se shqiptare, ndërsa serbe jo se jo. Fundja, prejardhjen vllahe të tij e tregon edhe vetë titulli *knez* i cili, së pakut jo në shek. 13-15, në serbishten nuk e kishte, siç e merr hstoriografia glorifikuese serbe,

---

[37] Stojan Novaković, Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje..., f. 37.: "vь svoi gradь Novo brьdo, gradь srєbrьnыi vь istinou i zlatnы " khs. edhe V. Jagić. Život Stefana Lazarevića, në Glasnik Srpskog Učenog Društva XLII, 1875, f. 282.

[38] Engjëll Sedaj, Relacionet e Pjetër Bogdanit mbi gjendjen shpirtërore të Shqipërisë e të Serbisë, Gjurmime albanologjike (Seria e shkencave historike), Prishtinë, 1984. f. 246.

[39] Fr. Miklosich, Monumenta spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii, Wien 1871, f. 207: "u slavnomь gradu gospodstva mi Kruševcu".

[40] Sipas Milenko S. Filipović, Strukutra i organizacija srenjovekovnog katuna, në Simpozijum o srednjovjekovnom katunu, Sarajevo, 1963, f. 80.

kuptimin e *mbretit* duke e aluduar prejardhjen e mundshme të fjalës *knez* nga gjerm. *König* "mbret",[41] porse kuptimin e eprorit në kierarkinë e rregullimit social të bashkësive të katuneve blegtorale vllahe. Ky funksion i knezit, si kryepar i katuneve vllahe, del i qartë në një dëshmi raguzase të 15 janarit të vitit 1382 kur një raguzas deklaronte se nga "*a Vlcoslauo Plescich comitem Vlacorum omnium domini regis Rassie et Bossnie*" d.m.th. nga knezi Vlkoslav Pleshiq i të gjithë vllehve të Rashës e të Bosnjes iu kompensua i gjithë malli i plaçkitur. Nga ky njoftim del i definuar shumë qartë funksioni dhe roli i knezit vllah: ai ishte njëkohësisht përfaqësues i pushtetit dhe ndërmjetësues midis katunit, përkatësisht katuneve, dhe shtetit.[42] Se titulli *knez* mbahej vetëm nga vlleht dhe në aso ambientesh (vllahe) emërtonte kryeparin e katunit, do ta tregonte edhe rrethana se në shumicën e vendbanimeve të cilësuara për të vllehve si edhe në katunet shprehimisht të vllehve të Kosovës siç janë vlleht e Barelit, Bobojev'ci, Dragoljev'ci, Kostërçani kishte edhe *primeçurë* (nga lat. e mesme *primicerius* / *primus in c*(a)*era* dhe emërtonte kryetarin, kryeparin që ishte në krye të vllehve qiraxhinj karavanesh; *feçorë* (nga rum. ficior/fecior "ndihmësi i vogël i bariut"; më vonë edhe "ndihmës i muratorit".

Është për t'u vërejtur se titulli *knez* dëshmohet në shekujt 14 e 15 vetëm në ambiente, katune të vllehve. Kështu p.sh. në katunin e vllehve *sremljani* (= katundi i sotëm Cërmjan i Gjakovës?) dëshmohet më 1330 banori *gjur'gъ knezъ branislalikъ* me fëmijët,[43] ndërsa në vitin 1348 në katunin *golubovci* (= katundi Gullboc i krahinës së Llapushës) banori gjithashtu i quajtur *gjurgъ knezъ* me të vëllanë e me të bijtë.[44] Dëshmi të ekzistimit të knezëve që e kishin funksionin e kryeparëve të katuneve e të katundeve vllahe ka edhe për në vetë hapësirën që ishte në pronësi e në sundim të Lazar Hrebeljanoviqit. Për të këtillë unë e mbaj dëshminë: *Rain fauro chnex de Chameniza de Turchi*, që për në vitin 1438 dëshmohet në

[41] Është për t'u vërejtur në këtë mes që, kur po e shkoklonte punën e prejardhjes së nocionit prift, përkatësisht pop në gjuhët sllave, P. Skok, La terminologie chrétienne en slave: L'église, les prêtres et les fidèles, Revue des Études slaves, tome VII, Paris, 1927, f. 184-186 vërente se nuk ka kurrfarë mundësie që varianti *pop* të ketë hyrë e të jetë përdorur te besimtarët e ritit katolik të krishterimit. Duke qenë se ky nocion kishte hyrë te sllavët e Veriut (të Europës Juglindore), nga germanishtja *kuning* (khs. lit. *kùnigas*) "princ; prift" thotë P. Skok, prifti quhej këndej *kъnędz'*. Kjo sepse në Bohemi e në Poloni fjala *kъnędz'* shënonte në krye të herës "princin" dhe "priftin". Ky proces porse nuk mund të dëshmohet në serbishten.

[42] Desanka Kovačević, Srednjovjekovni katuni po dubrovačkim izvorima, në Simpozijum o srednjovjekovnom katunu, Sarajevo, 1963, f. 133-135.

[43] Dečanske hrisovulja..., f. 125.

[44] Hrisovulja..., f. 292.

Librin e borxhlinjve të doganierit dhe tregtarit raguzas M. Lucari që vepronte në Novobërdë.[45] Nga kjo e dhënë del fort e qartë se atributin *knez* e mbante madje edhe një punëtor miniere i kategorisë *fauro*.

Në fundshekullin 15 këtë titull të hierarkisë sociale të ambienteve blegtorale vllahe e gjejmë edhe në katundin Strezovc të periferisë së Novobërdës kur, përkrah banorëve *Gjon* Velikiq; Jovan *Tanoviq* e *Gjona* Vasil, dëshmohet edhe kryefamiljari *Peja knez*; në lagjen Arbanas të Janjevës (përkrah banorëve shqiptarë Dejan *Arbnesh*-i; *Bic*-i, i bir i *Arbanas*-it; *Gec*, i bir i *Lesh*-it; *Bic*, i bir i Marush-it; *Gjon*-i, i bir i Kojin-it; Noka, i vëlla i Gjon Kojin-it; *Gjosha Lesh*-in; Dejan, i bir i *Arbanas*-it; *Tushica*, skamnor; Petr *Nik*-a; *Paca*, i bir i *Gjovan*-it) jetonte edhe *Peja, knezi*; në katundin e paidentifikuar definitivisht Vojmilovc ishte banori *Jovan knez*-i, pronar i një *llazi* dhe në katundin po ashtu të paidentifikuar Smoliç, që mund të jetë katundi i sotëm Smollushë i komunës së Lipjanit apo lagja e sotme e Smonicëve në Mramuer të Prishtinës, jetonte një Kostadini, që ishte dhëndër i *knezit*.[46]

Dhe katunari e knezi (për kuptimin e termit sh. më lart) vllah i quajtur Lazar, të cilin folklori dhe historiografia serbe e quajnë mbret, i kishte kushtet për të qenë katunar e knez. Familja e tij kishte në pronësi disa katunde përreth Novobërdës, qytetin e Krushevcit dhe ndonjë katund në Serbinë e sotme të Jugut. Është keq që nuk ka burime nga të cilat do të mësohej se prej kujt familja Hrebeljanoviq, siç quhej në krye të herës familja e knezit Lazar, i trashëgoi ato prona.

Del e qartë se e ashtuquajtura perandori serbe, shtet serb, nuk kishte në hapësirën e sotme të Kosovës ndonjë organizim qendror; nuk kishte një kryeqendër, kryeqytet, porse vetëm pallate/ rezidenca sundimtarësh lokalë në Prishtinë, Novobërdë, Prizren, Ferizaj,[47] përkatësisht Paun, Neredime, Bellosicë.

Dhe, duke iu rikthyer çështjes së minierave, burimet na mësojnë se punët në ato miniera, prona që trashëgoheshin nga dyer sundimtarësh lokalë serbë, do t'i kryenin sasët - minatorë me nam që në hapësirën e Kosovës së sotme në vetë dokumentacionin kishtar serb dëshmohen në fillim të shek. 14. Së këndejmi ata mjeshtër, në rastin tonë sasët, jo rastësisht kishin shumë privilegje e autonomi, sepse deri në shprishjen e shtetit

[45] M. Dinić, Iz Dubrovačkog arhiva I, f. 72.

[46] Iljaz Rexha, Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës sipas defterit të fundshekullit XV, Vjetar 17-28 i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë, 2002, f. 81, 121, 111, 136.

[47] Oliver Jens Schmit, Die Kosovo Geschichte, Srpska Pravoslavna Crkva, në http.//www.spsportal.org/index.php

serb në mesin e shek. 15, xehetaria dhe përpunimi i xeheve ishte një burim fort i rëndësishëm i të ardhurave të sundimtarëve serbë - sado që "Të ardhurat më të mëdha nga xehetaria nuk i merrnin as sundimtarët serbë e as minatorët sasë. Kjo sepse sasët ishin pronarë të argjendit që e nxirrnin nga galeritë, me përjashtim të së dhjetës që ua paguanin sundimtarëve serbë. Minatorët i blinin të gjitha gjërat e nevojshme, madje edhe artikujt ushqimorë, me argjend të papërpunuar, ndërsa tregtarët delmatë, sidomos ata nga Raguza, e blinin atë metal dhe shumë shpejt u bënë pronarë ose bashkëpronarë dhe shfrytëzues të pjesës më të madhe të minierave, të puseve e të shkritoreve dhe përveç me metale zhvillonin tregti edhe me mallra të tjera. Kjo është arsyeja përse vetëm një numër i vogël sasësh arritën të pasuroheshin. Shtresa, mbase e lartë - banore e qyteteve-koloni të sasëve quhej vetëm në dy vendbanime që e kishin statusin e qytetit, *purgar*. Sado që kuptimi i mirëfilltë i këtij termi (nga gjerm. *Bürger* "qytetas") nuk qenka deri tani pakontestueshëm i qartë, nga studime të historianëve kompetentë mësohet* se ky term e paska pasur në krye të herës kuptimin "qytetas" it. *borghesiani*, përkatësisht *citadini*. Mirëpo ka të dhëna që nën termin *purgari* nuk përfshiheshin të gjithë qytetasit, porse vetëm kryeparët e qytetasve (S. G.: në ambiente, që për në Ballkan e kishin vetëm qytetet e Srebrenicës dhe të Novobërdës) dhe që ishin diç si senate të atyre qyteteve. Mundësia e dytë e kuptimit të këtij termi qenka ajo sipas së cilës *purgar*-ët paskan qenë në të vërtetë gjyqtarë të *curia Teotonicorum* "gjyqeve gjermane, sase" që nëpër koloni sase gjykonin bashkë me vojvodën ose me qefaliun gjegjës dhe me kolegjin e gjyqtarëve, të përbërë nga 12 purgarë. Historianit serb M. Diniq i rezulton se qytetet e Srebrenicës dhe të Novobërdës e kishin trashëguar mënyrën sase të administrimit të qyteteve dhe e kishin ruajtur këtë edhe një kohë pas pushtimit osman të këtyre qyteteve.[48] Mua më rezulton se termi gjerman *purgar* është kuptimisht i barazvlershëm me *popolani* të raguzasve. (sh. për këtë edhe nën Bërgari). Ndryshe, minatorët e rëndomtë sasë quheshin *valturchi, valturzi* ose *vaoturchi*.[49] Kërkimet e hollësishme në arkivat e Ra-

* Mihailo J. Dinić, Za istoriju rudarstva..., I., f. 14.

[48] Po ai, po aty, f. 12,17..

[49] Kështu do të jetë quajtur, sipas V. Simić, Rudarstvo i prerada gvožđa u toponomastici i terminologiji Vlasinskog kraja, Onomatološki prilozi I, Beograd, 1979, f. 88, punëtori i parë, kryepunëtori, në një samokovë për emrin e të cilit në rrethina të Vlasinës së Serbisë po ekzistuaka edhe termi *vatah* i cili po u dashka të jetë në lidhje me variantet *vatruk, vatrok, vatrug* "anëtar i një bashkësie për të shkrirë xehe". Sipas sqarimeve të Nikola Čolak-Ive Mažuran: Janjevo, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000. f. 32, del që *vaoturach* të ketë qenë trajtë e kryehershme e fjalës e cila dëshmohet edhe në trajtat *vaoturk, valturco*. Në Ligjin turk mbi minierat, Kanuni sas, kjo fjalë del në trajtën *vatrok* dhe shenjonte ata njerëz që e blenin xehen. Vetë autorët tanë i cilësojnë

guzës paskan dëshmuar se jo të gjithë sasët ishin minatorë, porse që këta kishin ushtruar edhe zeje të tjera si rrobaqepës, këpucëtarë, kafexhinj[50] etj.

Sundimtarët lokalë serbë, siç do të shihet më poshtë, i vilnin doganat nga ato miniera dhe nga tregtia që zhvillohej në dhe përreth atyre qendrave dhe pothuaj asgjë tjetër: as kishin minatorë profesionistë, as juristë, as klerikë, sepse e gjithë jeta në ato qendra zhvillohej sipas mënyrës sase, përkatësisht raguzase. Duket se ka arsye të paravendohet që ligjet e sundimtarëve lokalë serbë të kenë qenë më shumë dekor, kallxim i forcës së pushtetit në letër se sa rregullatorë kompetentë të jetës në ato qytete, sepse edhe mbledhësit e doganave, prerësit e monedhave dhe gjyqtarët në ato qytete - miniera ishin rëndom sasë e raguzas. Banorë të qyteteve (kështjellave) e të tregjeve (*mercata*) mesjetare ishin familje patricësh e tregtarësh raguzas, kotoras e njerëz të ardhur nga qytete të brigjeve të jugut të Adriatikut, përkatësisht nga Kotori, Tivari, Korçula, Spliti, Zara, apo edhe nga Veriu i Shqipërisë dhe *purgar*-ë, *vaoturach*-ë gjermanë, përkatësisht sasë. Midis banorëve të këtij qyteti kishte edhe tregtarë të ardhur aty nga Italia, përkatësisht nga Venediku e nga Florenca. Kolonët i kishin gjyqet e veta, dhe kishat e veta ndërsa priftërinjtë, që të gjithë katolikë, ishin kryesisht shqiptarë të ardhur po ashtu nga qytete bregdetare të Adriatikut, nga Shqipëria e Veriut dhe vetëm njëri ishte i ardhur mbase nga qyteti Köln i Gjermanisë (më poshtë). Shkurt, këto qytete ishin, siç do të thuhej sot, shtete në shtet në të cilat sundimtarët lokalë serbë e kishin vendin n'trapazan. Ka arsye të mendohet që jeta në këso qendrash zhvillohej sipas ritmit të vet dhe jo të ligjeve që silleshin nga sundimtarë lokalë serbë, kohëzgjatja e qëndrimit të të cilëve në pushtet, fundja, varej nga puna e minatorëve sasë dhe e afaristëve raguzas. Këtë e ilustrojnë mjaft bindshëm gjurmët onomastike (në emra vendesh e vëllazërish) në hapësirën e Kosovës si edhe mbetjet leksikore sase, përkatësisht kontaktet dhe simbioza midis minatorëve gjermanë sasë dhe popullatës vendëse të sjellura në vazhdim të kësaj trajtese. Kjo ndodhi, p.sh. edhe pse në parathënien tjetër të dytë që në formë statuti të qytetit të Novobërdës i shtohej Ligjit mbi minierat të dekretuar nga Stefan Lazareviqi në vitin 1412, në rrafshin e ushtrimit të lirë të besimit/konfesionit

vaoturach-ët "(ri)blerës i xehes" e shtojnë porse edhe sqarimin sipas të cilit këta paskan qenë pronarë të shkrijetoreve. Po kështu e sqaronte këtë term edhe orientalisti shqiptar S. Pulaha, sh. Populsia., f. 478, ref. 6 sipas të cilit me termin *vatrok* kuptohej personi që e blente mineralin e nxjerrë nga xeheroret dhe me shpenzimet e veta e organizonte shkrirjen e tij; zotërues i një fonderie. Në terminologjinë osmane-turke të shek. XVII, këta quheshin *renxhber*(ë). Nga ky dijetar mësojmë se në qytetin e Prishtinës kishte në gjysmën e dytë të shek. XVI, përkrah 12 xehetarëve, edhe 6 renxhberë, përkatësisht *vatrokë*.

[50] M. Takács, Sächsische Bergleute. .., f. 37.

sanksionohej që katolikët, përkatësisht sasët, mund ta ushtronin konfesionin e tyre jashtë mureve të qytetit - në rastin konkret në e përreth kishës së Shën Kollit, me një famullitar gjerman, por që si masë izolimi për këta rekomandohet një jetesë mundësisht si në geto, pa kontakte me popullsinë tjetër. Për këtë qëllim ishin paraparë ndalime të ushtrimit të profesioneve në fushën sociale: kamerierë dhe përkujdesja për fëmijë jetimë dhe kontrollime të tjera ndaj sasëve: akëcili që do të provonte të kthente një burrë apo një grua nga ortodoksia në besimin latin do të dënohej me gjobë të rëndë në të holla; do të humbte lang e plang bashkë me të drejtën e trashëgimisë dhe do të dëbohej nga qyteti. Famullitarit "latin" që do të pagëzonte një ortodoks (= "të krishterë") do t'i pritej hunda. Me këtë masë të fundit ndëshkuese, "humanisti" Stefan Lazareviq shkoi edhe më larg se "Kodi" i Stefan Dushanit.[51]

Në kuadër të privilegjeve që i kishin sasët e raguzasit, sundimtarët serbë nuk mund të përziheshin pothuaj se fare në jetën fetare të kolonistëve katolikë sasë e romanë, kështu që këta sado në një hapësirë ortodokse mundën ta kultivonin ritin katolik të tyre. Kishat e sasëve e të raguzasve të Kosovës mesjetare ishin nën juridiksionin e ipeshkëvive të Kotorit e të Tivarit, ndërsa famullitarët ishin rëndom shqiptarë. Përjashtim bën vetëm famullitari *donus Parcus quondam Pauli Theutonicus* një famullitar gjerman i ardhur këndej nga qyteti i largët i Kölnit të Gjermanisë, i cili në Novobërdë shërbeu në vitet 1421-1422.[52]

2. SASËT NË BALLKAN E NË KOSOVË

Në dritën e materialit të njohur e të përpunuar deri tani onomastik të Ballkanit dhe të relikteve gjuhësore gjermane, përkatësisht sase në gjuhët e këtij Gadishulli, del e qartë se për në hapësirat etnike e gjuhësore të Europës Juglindore, përkatësisht të Hungarisë (sh. më poshtë), Bullgarisë,[53] Rumanisë,[54] Kosovës dhe pas gjitha gjasash edhe të Shqipërisë, duhet marrë në konsideratë edhe një komponent etnike e gjuhësore sase (për këtë sh. nënkapitullin gjegjës të këtij punimi).

---

[51] Gerhard Podskalsky, Theologische Literatur des Mittelalters in Bulgarien und Serbien 865-1459, 2000, f. 512.

[52] M. Takács, po aty, f. 39; khs. edhe M. Dinić, Za istoriju rudarstva, I, f. 6; Dr. Muhamet Tërnava, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV - XVI, Prishtinë, 1995, f. 385.

[53] Bojan Đonov, Etničeskoto nazvanie na rudarite "Sasi" na Balkanite i v prosă za tehnija proizhod, Izvestija na Institut za bălgarski ezik, 16, Sofia (1968), f. 203.

[54] Jon Borcea, Deutsche Sprachelemente im Rumänischen, Jahresbericht des Institutes für Rumänische Sprache, 10 (1904), II, f. 219-239; Diaconița- Djamo, Lucia: Elemente lexicale de origine germană (primate prin diferite filiere), in slavona românească, Omagiu lui Iorgu Iordan, Bucureşti, 1958.

Koha e vendosjes së elementit etnik sas në Ballkan nuk mund të përcaktohet saktësisht. Paravendohet se "gjermanët" do të jenë dukur në këtë pjesë të Europës Juglindore në shekullin 12 ose, sipas gjitha gjasave, në shekullin 14.[55] Hapësira nga e cila sasët u shtrinë edhe në Ballkan do të jetë territori mesjetar i Hungarisë së sotme, sepse jo gjatë pas vdekjes së Andreasit II, Hungaria u sulmua nga mongolët. Këta e shkretëruan dhe e shpopulluan tmerrshëm vendin aq shumë sa që mbreti Bela IV, pas tërheqjes së mongolëve, ftoi kolonistë gjermanë si "mysafirë", të cilëve u dha të drejta të mëdha për t'u marrë me bujqësi, vreshtari dhe për shfrytëzimin e minierave.[56]

Mendimet e dijetarëve përkitazi me shkaqet dhe arsyet e vendosjes së sasëve nga Transilvania[57] (për ku nga burime të shkruara mësohet se në vitin 1224 në hapësirën nga Broos deri tek Draas kishte 50.000 çifliqe të gjermanëve.)[58] në hapësirën e shtetit mesjetar serb janë nga më të ndryshmet. Kështu, mendohet p.sh. se sasët paskan ardhur për shkak të frikës nga mësyerja e tatarëve ose se këta paskan ardhur këndej me ftesë të mbretit serb Uroshi I. të Rashës;[59] të tjerë paravendojnë se këta i paska

[55] Bojan Đonov, Etničeskoto nazvanie..., f. 205. Konsiderohet (p.sh. sipas Stojan Novaković, Novobrdo i Vranjsko Pomoravlje u istoriji srpskoj 14 i 15 veka, Beograd, 1880, f. 5.) se mbreti hungarez Geza II qysh në vitin 1143 thirri në vendin e vet mjeshtër e minatorë gjermanë nga Flandria dhe nga rrjedha e poshtme e Rinit: të gjithë gjermanët që u vendosën në vendin e tij u quajtën *sasë*, sepse pjesën më të madhe të të ardhurve e përbënte fisi i sasëve.

[56] Georg Weber, Geschichte des Mittelalters, vollständig bearbeitet von Prof: Dr. Alfred Baldamus), Fouierverlag, Herausgegeben von A. Kleine., Köln. 2003, f. 974.

[57] Vendosja më e madhe në lindje u bë në kohën e mbretit Geisa II nga viti 1150 kur grumbuj kolonësh nga Flandria dhe sish të Gjermanisë së Poshtme, bashkë me burra punëtorë e luftarakë të *Gau*-ve të ndryshme të Gjermanisë u vendosën në tokën "Përtej Pyllit", përkatësisht në Ttransilvani, e cila ishte shpopulluar nga peçenegët e egjër. [...]. Të gjithë këta kolonë nisën të njihen me emrin përmbledhës *sasë*. Me Bullën e Artë të Andreas II të v. 1215 (e cila u zgjerua edhe në v. 1231) sasëve iu dhanë privilegje të mëdha. Bujarët sasë u liruan nga tatimi; atyre iu zvogëlua detyrimi pa pagesë në luftë dhe detyrimi për mbrojtjen e vendit dhe ndalohej dënimi i tyre pa pas dalë para gjyqtarit" - kontatonte Georg Weber, Geschichte des Mittelalters, Vollständig bearbeitet von Prof: Dr. Alfred Baldamus), Fouierverlag, herausgegeben von A. Kleine., Köln. f. 2003.

[58] Geschichte der Siebenbürger Sachsen, Erster Band von G. D.Teutsch (Text von 1852)

[59] Kështu njoftonte në vitin 1601 Mauro Orbini, i cili në f. 252 të veprës së tij *Il regno de gli Slavi*, shkruante se "Dopò questo cominciò Rè Stephano attendere all'aumente delle sue rendite, et gabelle. Onde mand in Allemagna à levare alcuni Tedeschi, periti à cavare di terra oro, argento, et altri metalli. Et cosi con molte cave, che da detti fece fare accrebbe molto il suo tesoro, et divenne ricchisimo. La qual cosa non seppero fare il suoi predecessori, che vivevano simplicemente, ne si curavano di raccorre i tesori, et

thirrur mbreti serb Radoslav[60] ose i vëllai Vladislavi.[61] Sjellja e sasëve në mbretërinë mesjetare serbe ndodhi, sipas studiuesit serb. Ç. Mijatoviç, në kuadër të masave për popullimin e tokave të mbretërisë, përkatësisht për popullimin e hapësirës së pushtuar nga principata serbe e Rashës. Për realizimin e këtij projekti, pasardhësit e Nemanjës paskan ndjekur rrugë më të mençur nga ajo e pararendësit të tyre. Në vend që të merrnin masa për shtrëngimin e popullatës që ajo t'i popullonte viset rrafshinore e të merrej me bujqësi, mbretërit Vladislav, Stefan Milutini dhe Stefani i Deçanit e paskan nisur popullimin e hapësirave të pushtuara me kolonistë të sjellënga jashtë. Me një veprim të këtillë kemi të bëjmë p.sh. edhe në rastin e truallishtave Brest, Suhagerllë, Leskovica, Vitaçe e Drenok që e kishin për fqinj një vend të arbanasëve ose vendbanimin e quajtur Arbanas, të lëna shkret qëmoti të cilat përmenden në një shkresë të vitit 1403 sipas së cilës këto vende që sundimtari ia falte kishës popullohesin me njerëz të sjellënga vende të huaja.[62]

Kështu, mendohet se sasët i paska sjellur në hapësirat e sunduara nga mbretër serbë Stefan Uroš-i II. (1282-1321), në kohën kur Hungaria e Bullgaria ishin të zëna me mbrojtjen nga sulme të tatarëve. Në këtë kohë mbreti serb e paska organizuar tregtinë dhe financat si dhe paska sjellur minatorë gjermanë (sasë) për të nxjerrë ar, argjend, plumb, bakër e hekur dhe i kontribuoi kështu forcimit të shtetit serb në shek. 14.

Në një studim të tijin për historinë e Kosovës, përkatësisht për kishën ortodokse serbe, historiani zvicran sqaronte se "ethet e arit" të mesjetës së Perëndimit i kishin kapluar dhe kishin lënë gjurmë edhe në minierat e dikurshme të arit e të argjendit në pjesën lindore të Kosovës. Në veri të Gjilanit gjenden mbetje të minierës së njohur deri në shek. 15 të Novobërdës. Këtu jetonin, përkrah minatorëve, edhe zantatlinj të cilët në bu-

ammassare i denari." Cit. sipas M. Dinić, Za istoriju rudarstva u srednjevekovnoj Srbiji i Bosni I, …, f. 1, referenca 1. Khs. edhe Rječnik JAZU 14, (Zagreb, 1955), f. 656.

[60] M. Dinić, Za istoriju rudarstva u srednjovekovnoj Srbiji i Bosni II, Beograd 1962, f. 2.

[61] I bir i sundimtarit të quajtur Stepani i kurorëzuari i parë. Pushtetin ia dorëzoi këtij i ati mbase në vitin 1222 dhe Radoslavi u kurorëzua në Zhiqa në vitin 1230. Për shkak të pamençurisë që e karakterizonte dhe pakënaqësisë së popullatës me mënyrën e tij të sundimit, u detyrua të ikte në Durrës tek familja e së shoqes. Ajo (e shoqja) porse e tradhtoi me një raguzas. Ky u premtoi raguzasve më 1234 beneficione nëse këta do ta kthenin në pushtet. Meqë kjo ide nuk u realiza, ky u bë më 1235 murg.dhe e mori po ashtu emrin Simeon të murgjërisë. Sipas një sqarimi tjetër, Vladislavi - që paska qenë nip i shën Savës - e mori pushtetin nga i vëllai Radoslavi në vitin 1223.

[62] khs. "I prida kraljevьstvo mi selišta zapustěvša otь věka, ime selištu: Brestь i Suhogrъlь i Leskovica i Vitьče i Drěnokъ, a megja Arbanasa na sь vsěmi ljudьmi i naseleni selь těhь, što si je naselilь otь tugihь zemlь. " te St. Novaković, Zakonski spomenici srpskih država, f. 403.

rime të kohës përshkruheshin si "snajdar" dhe "suster". Nga po ky studim mësohet, për ndryshim nga ai i Ç. Mijatoviqit se "Minierat e atjeshme ua bënë të mundshme mbretërve serbë luftërat dhe ndërtimet."[63] (SG: kryesisht të kishave, sepse këta as nuk kishin rindërtuar e as ndërtuar ndonjë kështjellë). Në mbështetje të një studimi tjetër[64] del se profitet nga minierat e mbretërisë serbe mbështeteshin tek miniera e Kosovës (në Novobërdë), tek miniera e Srebrenicës në Bosne për të cilat ai kishte aprovuar ligje të veçanta dhe tek tregtia e shtetit serb të Stefan Dushanit IV me Raguzën.

Të tjerë kujtojnë se sasët i paska sjellë sundimtari Vladislav (khs. më lart), ndërsa për Milutinin dihet se në shtetin që e mbante për të vetin i vendosi disa mijëra kumanë.[65]

Në një kartë ky vetë i përmend disa truallishta, të cilat që nga kohë të mugëta kishin pas qenë lënë shkret e të cilat ky i populloi me njerëz nga jashtë,[66] mbase pikërisht me kumanë.

Për detaj të rëndësishëm në këtë mes duhet parë rrethanën që në shtetin e Rashës të sunduar nga Stefan Dushani kishte edhe mercenarë gjermanë. Kjo bëhet e ditur nga një epizod i jetës familiare të këtij sundimtari serb, përkatësisht nga rrethana që "bashkëshortësia e tij (SG: e Dushanit) me mbretëreshën Helena nuk kishte fëmijë; rreth vitit 1336 po punohej për prishjen e kësaj kurore. Ndërmjet Dushanit dhe kontit austriak Oton u zhvilluan në vitin 1336 negociata që e mbesa Elizabeta e Otonit, e bija e mbretit gjerman Filipit të Bukur, të martohej me Dushanin. Të dërguar austriakë kishin ardhur asaj pranvere në Serbi, duke udhëtuar nëpër det nga Istria deri në Kotor. Duket se ndërmjetësues në këtë punë ishte kalorësi Palman, *kryekomandant i mercenarëve gjermanë në Serbi* (nënvizim imi). Elizabeta e re, të cilën nuk e kishin pyetur nëse pajtohej me këtë martesë të propozuar, u neverit nga ideja që të katan-

---

[63] khs. punimin e tij: Die Kosovo Geschichte, Srpska Pravoslavna Crkva, në http.//www.spsportal.org/index.php

[64] Në **Serbien** (deutsch für serbisch **Srbija**) aus: Österreichisches Musiklexikon.

[65] Në Hungari, duke ikur përpara sulmit të mongolëve, kishin ardhur *kumanët* të cilët mbreti hungarez Bela IV i mori në mbrojtje. Duket se prej këndej i sollën në shtetin e Rashës sundimtarët serbë. Njëri nga kumanët u bë edhe mbret i Hungarisë. Ky është trashëgimtari i Belas, Ladislaus IV. Për shkak se i favorizonte kumanët paganë dhe për shkak se çonte jetë të shfrenuar me jaraneshat e tij kumane, shkaktoi pakënaqësi të mëdha të brendshme në vendin e tij. - sipas Georg Weber, Geschichte des Mittelalters, Vollständig bearbeitet von Prof: Dr. Alfred Baldamus), Fouierverlag, Herausgegeben von A. Kleine, Köln. 2003, f. 975. dhe Čedomilj Mijatović, Studije za istoriju srpske trgovine, Glasnik srpskog učenog društva, 37 (Beograd, 1873), f. 220.

[66] Čedomilj Mijatović, Studije za istoriju srpske trgovine. .., f. 240-241.

disej dikund në një botë të panjohur, në një vend barbarësh në Lindje dhe të martohej për një mbret me fe tjetër e, edhe ashtu të martuar, u sëmur rëndë dhe ndërroi jetë që në vjeshtën e atij viti. Me vdekjen e saj u varros edhe një tragjedi sentimentale intime, e lidhur për një personalitet të historisë sonë (SG: serbe) një tragjedi e pazakonshme si për nga lindja dhe lidhjet e pasojat së pakut përgjysmë mistike. Kur mbretëresha Helena kishte marrë vesh për ato plane të Dushanit, ajo u ngut të pjellte, madje pikërisht një djalë, dhe e qetësoi kështu Dushanin. Dhe, megjithmend, në dimirin e vitit 1336 ose në fillim të vitit 1337 ajo e lindi të vetmin djalë Uroshin dhe kështu e përforcoi pozitën e saj në oborrin mbretëror."[67]

Sado që nga burimi i mësipërm nuk mësohet se prej nga ishin këta mercenarë gjermanë në shërbim të mbretërisë së Dushanit, dhe, për temën tonë, nëse edhe këta do të kenë qenë sasë, një gjë është krejt e qartë që ajo e ashtuquajtura perandori shumëkombëshe serbe kishte nevojë që edhe në zenitin e ekspansionit të saj të mbrohej edhe me mercenarë e nga mercenarë të huaj. Vetëm frika nga shpërthimi i revoltës së joserbëve të perandorisë që serbët e mbanin për të veten mund të jetë arsyeja e pasjes nevojë për mercenarë të huaj. Vetëm sa për krahasim le të përmendet në këtë mes se edhe në ushtrinë e Skënderbeut kishte individë gjermanë, të cilët ishin vetëm ekspertë për armë të zjarrit.[68]

Po ashtu të ndryshme janë edhe mendimet e historianëve e të gjuhëtarëve përkitazi me atdheun e kryehershëm të sasëve të ardhur në Gadishull të Ballkanit. K. Jireçek i del zot mendimit se atdheu i kryehershëm i minatorëve sasë duhet kërkuar në Hungari, më saktësisht në pjesën veriore të këtij shteti - në regjionin e quajtur Zipps[69] - sot pjesë e Sllova-

---

[67] Vladimir Ćorović, Istorija srpskog naroda, në www.rastko.org.yu/rastko-bl/istorija/corovic/istorija, 3.

[68] Dr. Muhamet Tërnava, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV - XVI, Prishtinë, 1995, f. 390.

[69] Čedomilj Mijatović, Studije za istoriju srpske trgovine, Glasnik Srpskog Učenog Društva, 37 (1873), pp. 240-241. Prania e këtyre minatorëve të njohur të mesjetës në hapësirën e Ballkanit Perëndimor dëshmohet edhe në shumë emra vendesh, të cilat janë sajuar nga emri etnik i sasëve. Të këtillë janë p.sh. emrat *Sasa* - katund në regjionin Zagorje dhe *Sase* - katund në rrethina të Slunjit në Kroaci; *Sasevo* - katund në Slloveni, *Sasici* - lagje e katundit Svinjac të Foçës; lagje e katundit Prkinja në Bosnje dhe *Saski Do* – po ashtu në Bosnje; lagje e katundit Seonica dhe *Sasine* - katund në Hercegovinë; *Saski Deo* - lartësi në regjionin Crna Reka të Serbisë (pas M. Pavlović, Altsächsische Bergbauterminologie im Serbokroatischen, Südost- Forschungen 18 (1959), 77); *Saska Reka* në rrethina të Srebrenica-s (Bosnje) dhe në rrethina të Poreqit (Kroaci); *Sase* - katund midis Suva Granica të Serbisë, Drinës e Vishegradit (të dëshmuara në një dokument të shkruar në Kruševc në shek. XV); *Sase* - një çiflik në regjionin e Rudnikut; *Saški potok, Saševo, Sase* - katund në regjionin e Çaçakut; katundi *Sase* dhe

kisë. Sipas këtij lokalizimi të atdheut paraballkanik të sasëve, do të rezultonte se kemi të bëjmë në të vërtetë me sasë të regjionit Siebenbürgen (Transilvani). Ka edhe një mendim sipas të cilit sasët do të kenë ardhur nga Hermannstadt (rum. Cluj) i Rumanisë së sotme, ku këta do të jenë vendosur pas shpërnguljes së tyre në vitin 1144 nga regjioni i Rinit të Poshtëm.[70] Gjallon edhe mendimi sipas të cilit sasët e hapësirës së Ballkanit nuk na qenkan fare sasë të regjionit të Rinit, porse këta po u takuakan fiseve të Frankëve të Poshtëm.[71] Mbi bazën e hetimit të relikteve

Saški potok në bjeshkën Golija; *Saška reka* në Poreç në Serbi (sipas Bojan Đonov, Etničesko nazvanie., f. 203; M. Dinić, Za istoriju rudarstva., I., f. 2); *Saški prohod* afër Kula -s; *Gornja Saška*, *Donja Saška* te Vrška Ćuka; *Sasin- Polje* në rrethina të Pljevljes; katundet *Sase* e *Sasevo* në rrethina të Kratovës; *Sašani* - lagje e vendbanimit Stradaljevo në regjionin e Qustendilit (sipas B. Đonov, Etničesko nazvanie., f. 204); vendi *Sasa* në fqinjësi të Carevo Selo, *Sase* e *Saška reka* në Osogovo në Maqedoni (M. Dinić, Za istoriju rudarstva., I., f. 2); *Saška Rupa* afër Desnicës, Saška *Reka afër* Srebrencës, *Saška Rupa* afër Kreshevës në Bosnje e shumë të tjerë. (sipas M. Pavlović, Altsächsische Bergbauterminologie., f. 77; M. Dinić, Za istoriju rudarstva. , I., f. 2); *Sasovac* - emri i një katundi që shërbente për pjesë të emrit të një bujari të dëshmuar në një dokument të shek. XIV; katund në qarkun Raça të komunës së Bjelovarit në Kroaci; *Sasović* - katund në Bokë (të Kotorrit) (sipas Rječnik JAZU 14, f. 664); *Sase* - katunde në rrethina të Srebrenicës e të Vishegradit (Bosnje), Kratovës e të vargmaleve të Osogovës (Bullgari) (sipas K. Jreček - J. Radonić, Istorija Srba II, 92, f. 175). Ndër gjurmë toponimike të minatorëve sasë bien edhe ato oikonime të cilat janë sajuar nga fjala gjermane *Zeche* "pus miniere dhe organizatë zyrtare e minatorëve". Kësi emrash të vendeve ka gjithandej nëpër Europën Juglindore e Lindore. Me fjalën gjermane. Zeche M. Lazić (Ostaci nemačkih dijalekata na tlu Jugoslavije, BALCANICA, VII, Beograd, 1976, f. 389) e sqaron edhe emrin *Tehovo*, i cili dëshmohet në një shkresë të sundimtarit serb Dushan të vitit 1355 për manastirin Treskavac (Maqedoni) (khs. për këtë S. Novaković, Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka, Beograd 1912, f. 664.). Sqarimi i këtillë e gjen mbështetjen tek interpretimi po me këtë fjalë i emrave të vendeve si *Techensdorf* në Steiermark, *Teesdorf* në Niederösterreich, *Techan* e *Zechan* në Galici, *Tehovac* në Slloveni etj., ndërsa M. Pavlović (Altsächsische Bergbauterminologie., f. 83) këtyre ua shton, përveç emrit *Tehovo*, edhe oikonimin *Tešilo* si edhe emrin e vëllazërisë *Tešanović* e *Tešman* në Bosnje si edhe emrin e lumit *Ćehotina* (nga *Tjehotina "...e, serb. Ь = je; ti > ć…") në rrethina të Foçës dhe emrat e vendeve *Techobus*, *Techomice*, *Techoras* në Bohemi dhe *Techmansdorf* në Karantania (Austri). Këtu bie edhe mikrotoponimi *Saz-hegher* i dëshmuar në vitin 1477 në Hungari, i cili paska të bëjë me kolonët flandriotë që nga hungarezët u quajtën *szász*. As kjo fjalë, ky emër, e as emri etnik *német* "gjerman" nuk qenka me origjinë gjermane, sepse varianti hungarez *Saz* po rridhka nga sllav. "khs. sllav. e vj. *sasinъ* "sas"; polon., sorb. e vj., bellorus. *sas*, sipas Clemér Moór: Die ehemaligen "Sachsenorte" an der oberen Theis, në Süddeutsche Forschungen, III, 1938, f. 398, ndërsa ai *német* nga sllav. *nemec* "i pagojë, shurdhmemec".

[70] M. S. Filipović, Das Erbe der mittelalterlichen sächsischen Bergleute in den südslawischen Ländern, Südost-Forschungen 22/1963, f. 194.

[71] Constantin Jireček, Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien., II, f. 67.

gjuhësore gjermane, është shfaqur mendimi se në hapësirat e Ballkanit Perëndimor me siguri nuk kishte vetëm grupe sasësh minatorë, por edhe pjesëtarë fisesh të tjera gjermane gjithsesi nga regjioni i Rinit.[72] Sasët do të jenë vendosur në Transilvani/Zips nga rrjedha e mesme dhe e poshtme e Rinit, përkatësisht nga hapësirat midis Rinit dhe lumenjve Mosel, Maaß, Lahn e Lippe dhe nga ato më në veri të tyre - nga andej pra ku që nga kohë të lashta piqeshin fiset e sasëve e të frakëve, sepse "të folmet e kësaj hapërsire të gjermanishtes puçen aq shumë me të folmen e tokës së sasëve të Transilvanisë aq sa dëgjuesi (i Transilvanisë) mendon sikur ndodhet në atdheun e tij të kryehershëm". Meqë këshilltari i Gregorius i papatit i përmend në vitin 1195 shprehimisht flandrët ardhacakë, lejohet paravendimi që një pjesë e sasëve të hapësirës së Hungarisë, përkatësisht të Transilvanisë mund të jenë të ardhur nga Flandria.[73]

Ka edhe një shpjegim sipas të cilit sasët nuk janë të ardhur nga Transilvania porse nga regjioni Breisgau. Këta ardhës e paskan bartur emrin e tyre *Breisgau* të prejardhjes tek vendi që nga serbët qenka formësuar më vonë si *Brskovo* afër Srebrenicës. Sipas këtij interpretimi, minatorët që njihen me emrin sasë nuk paskan qenë sasë, të mirëfilltë etnikisht, porse shvebë të cilët i paskan quajtur sasë sepse emri etnik i sasëve ishte përgjithësuar edhe ndër gjermanë për distinktiv profesioni "minator". Për pasojë, minatorët gjermanë, përkatësisht sasët, qenkan shpërndarë në hapësirën e Serbisë mesjetare nga Bërskova e sotme.[74]

Të dhënat e mësipërme e lejojnë paravendimin e besueshëm se sasët do të kenë ardhur në Ballkan para kohës së sundimit të mbretit Stefan Urosh I, përkatësisht në kohën e sundimit të Vladislavit (1234-1240) ose që sasët do të jenë vendosur këndej në kohën e sundimit të të vëllait Radoslavit.[75]

Dëshmia më e vjetër onomastike mbi praninë e sasëve në shtetin serb të mesjetës rrjedh nga një dokument i hartuar gjatë kohës së sundimit të sundimtarit Stefan Urosh Milutini I (1243-1276). Në këtë shkresë është shënuar se kufijtë e ipeshkëvisë së Zahumit shkonin në kodrën Smërdečnik afër Bërskovës "dhe pastaj [...] *kodrës përpjetë mbi sasët* [...]"[76] Në vazhdim, në këtë shkresë trajtohet mënyra e zgjidhjes së kontesteve midis

[72] M. Lazić, Ostaci nemačkih dijalekata na tlu Jugoslavije, Balcanica, VII, Beograd, 1976, f. 389.

[73] G.D.Teutsch, Geschichte der Siebenbürger Sachsen, Erster Band von (Text von 1852), te Google.

[74] M. Dinić, Za istoriju rudarstva..., I., f. 24.

[75] Rječnik JAZU, Zagreb 14, (1955), f. 636.

[76] V. Jagić, Svetostefanski hrisovulj..., f. 8: "ouz' brъdo nad Sase" khs. edhe M. S. Filipović, Das Erbe der mittelalterlichen sächsischen Bergleute in den südslawischen Ländern, Südost-Forschungen 22/1963, f. 194.

sasëve e raguzasve, temë kjo që më vonë është trajtuar edhe në dokumente të tjera. Këto janë, në të vërtetë, rregullore mbi të drejtat, privilegjet dhe detyrimet e raguzasve e të sasëve në shtetin e atëhershëm serb. Dokumenti më i vjetër i këtij lloji rrjedh nga vitet 1240-1272. Përmes këtij dokumenti mbreti Stefan Urosh I i përcaktonte priviliegjet e raguzasve dhe mënyrën se si duhet të zhvilloheshin seancat gjyqësore në të cilat palë në konflikt do të ishin sasë e raguzas: "Nëse kemi të bëjmë me një sas, duhet që njëri (gjyqtar) të jetë vetë sas, ndërsa tjetri (gjyqtar) duhet të jetë një raguzas"[77] - thuhet në këtë dokument. Në një dokument tjetër të këtij sundimtari (sh. më lart) të lëshuar në vitin 1308 urdhërohet që edhe raguzasit duhet t'i përmbushin detyrimet financiare "ashtu sikundër paguajnë sasët".[78] Për sasët si pjesë e shoqërisë së shtetit serb të mes-jetës, flitet edhe në nenin 18 të Kodit të Dushanit (të vitit 1349). Për si qytetarë të shtetit mesjetar të Serbisë, sasët përmenden edhe në një dokument të lëshuar nga mbreti Stefan Dushan në vitin 1355, në të cilin ndër të tjera thuhet: "*asnjëri nga fisnikë të mbretërisë sime, qoftë ai grek, latin apo sas* [...]" dhe "*fisniku i lartë e i ulët që vie në oborr të mbretërisë sime qoftë ai grek, gjerman apo serb*".[79]

Thellësinë e inkuadrimit e mbase edhe të shumësisë numerike të sasëve në shtetin serb të mesjetës e tregon edhe rrethana që në Kodin e sundimtarit St. Dushan, në paragrafin në të cilin flitet për kompensimin e gjakut me të holla, thuhet p.sh. se: "Nëse vrasjen e bën shërbëtori, ta dorëzojë zotëriu, por nëse nuk e dorëzon, zotëriu duhet ta paguajë gjakun ashtu sikundër e paguajnë edhe sasët".[80] Në këtë kontekst bën të përmendet edhe mendimi i dijetarit serb M. Diniq se aplikimi i dënimit me vdekje i sanksionuar në nenin 169 të Kodit të sundimtarit St. Dushan për ata argjendarë që jetonin jashtë qyteteve dhe që ziheshin se kishin prerë tinëz monedha dënoheshin me kallje në turrë zjarri, është ndikim nga e drejta sase e lidhur me minierat dhe jo ndikim i së drejtës romake.[81] Neni

---

[77] Fr. Miklosich, Monumenta spectantia…, f. 51: "[...] Jake bude pra sa Sasinomь, da bude jedan Sasinь a drugi Dubrovčaninь, pred temi da se raspravlaju".

[78] khs. S. Novaković, Zakonski spomenici…, f. 162.: "...kako i Sasi plakjaju".

[79] Po aty, f. 175: "...nitko od vlastela carstva mi, ni Grk, ni Latinin, ni Sasin …".dhe "Vlastela i vlasteličići koji idu u dvor Carstva mi, bilo Grk, ili Nemac, ili Srbin, ili vlastelin, ili bilo ko drugi, te dovede sa sobom razbojnika ili lopova, da se onaj gospodar kazni kao lopov i razbojnik." thuhet në nenin 173 (175) të Kodit të Dushanit), nen që ka të bëjë me aristokratët.

[80] Cit. sipas Franz Miklosich, Die Blutrache bei den Slaven, Wien, 1887, f. 27. khs. përkthimin latinisht: "Si homicidium commiserit servus, tradat eum dominus; si vero eum non tradiderit, solvat dominus mulctam, sicut etiam Saxones solvunt."

[81] M. Dinić, Za istriju rudarstva u srenjevekovnoj Srbiji i Bosni I, f. 13, khs. Muhamet Tërnava, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV - XVI, Prishtinë, 1995, f. 386-387.

i mësipërm paska të bëjë[82] me katundin e sotëm *Zgatar* të rrethinave të Prizrenit, emri i të cilit në krisobulën e vitit 1348 qenka shënuar pahiri apo qëllimisht gabimisht si *Zlatar* dhe për si të këtillë e kishte marrë edhe M. Šufflay. Se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me ndonjë shtrembërim të emrit, porse që Zllatar do të jetë emri i kryehershëm i katundit që sot, mbase nën ndikimin e etimologjisë popullore quhet Zgatar e tregon mbase edhe rrethana që në defterin osman-turk të vitit 1571 emri i këtij katundi është shënuar si *Izlatarça*. Nga këto të dhëna do të dilte[83] se neni i mësipërm paska të bëjë me ndalimin për banorët e këtij katundi që të banonin jashtë tregjeve për shkak se kishin falsifikuar monedha.

2.1. Sasët në territorin e sotëm të Kosovës

Me të drejta e detyrime të sasëve e të raguzasve kanë të bëjnë edhe disa shkresa të sundimtarëve lokalë serbë të hapësirës së Kosovës së sotme, çfarë është p.sh. një dokument i princit Lazar, i shkruar në vitin 1387, me të cilin ky ua vërtetonte raguzasve privilegjet në fushën e tregtisë. Në këtë dokument, i cili s'është tjetër veçse përshkrim apo adaptim i urdhëresave të sundimtarëve të mëparshëm, thuhet p.sh. se: "*... nëse ndonjë raguzas e blen një kal dhe këtë kal e zë ndonjë serb apo ndonjë sas... "*[84] dhe më tej "*Nëse sasët kanë një kontest gjyqësor, ata duhet të trajtohen si edhe serbët: gjysma e gjyqtarëve duhet të jenë sasë dhe gjysma* (tjetër) *duhet të jenë raguazas*".[85] Po këso përmbajtje kanë edhe një dokument i Vuk Brankoviqit (i vitit 1387);[86] një dokument i despotit Stefan Lazareviq dhe një i Grigorit e i Đurađ (Gjergj)

[82] Hajriz Meleqi, Opoja dhe Gora, Dragash, 1994, f. 49.

[83] M. Šufflay, Serbët dhe shqiptarët, Prishtinë, 1968, f. 52.

[84] St. Novaković, Zakonski spomenici, f. 200-201, 207-208: "I ako Dubrovčanin kupi konja, I onogazi konja uhvati Srbin ili Sasin … […]"

[85] St. Novaković, po aty, f. 203, 222, 233. ; Fr. Miklosich, Monumenta serbica …, f. 207-208. "*Ako li uzimaju koju pru Sasi z Dubrovčani, takogere da se sudi kako i Srbe: polovina Sas sudi a polovina Dubrovčan*. .. "

[86] Në një shkresë të 20. 1. 1387, të hartuar në Prishtinë, Vuk Brankoviqi thoshte: "Me mëshirën e Zotit unë Vlkъ Brankovikъ u muarrëm vesh kështu: nëse bëhet ndonjë gjykim midis raguzasve e serbëve, të vendosen gjysma e gjyqtarëve raguzas e gjysma tjetër serbë… nëse bëhet ndonjë gjyq midis sasëve e raguzasve, gjithashtu të gjykohen ashtu si serbët, gjysma (e gjyqtarëve) të jenë sasë e gjysma raguzas…" dhe rekomandon që serbi të mos e thërrasë në gjyq as raguzasin e as sasin dhe të kursehen që të mos shkojnë ose te vetë Vuk Brankoviqi ose te kefaliu. Khs. tekstin origjinal: "Po milosti božieija Vlkъ... ωvakoi učinismo: da se učini koja pra megju dubrovčani i srьbli, da se postave polovina sudi dubrovьčkihь a polovina dubrovčanь a polovina srьblь,… ako li uzimaju kojo pru sasi i dubrovčani, takoge da se sude kako i srьble, polovina sasь sudi a polovina dubrovčanь;" te Franz Miklosich, Monumenta serbica, 208.

Brankoviqit (të shkruara në vitin 1428, përkatësisht 1445). Sasët dhe pozita e tyre në kohën e sundimit turk të Kosovës së sotme pasqyrohen edhe në ligje osmane-turke (Kanuni Sas) të kohës së sulltan Sylejmanit (të vitit 1536) mbi minierat e në shkresa të tjera.[87]

2.1.1. Sasët në Novobërdë

Dëshmia më e vjetër e pranisë së elementit etnik sas në Kosovë, përkatësisht shënimi më i vjetër në trajtën italiane Tudescho (lexo Tudesko) i emrit etnik të sasëve gjermanë rrjedh nga viti 1356 kur në testamentin e një raguzasi të quajtur Domanje Mançetiq është shënuar midis të tjerash se atë vit ai ia kishte kthyer borxhin njëfarë "Teotonicus pro mercato de Trepce"88 "Gjermanit në tregun e Trepçës".

Dëshmi të tjera të kësaj natyre ka edhe nga viti 1440. Ndër banorë të asokohëshëm të Novobërdës ishin "[...] *uno Tedescho rupnich el qual passando alcuni anni in Trepze* [...] "Një minator gjerman që i kishte kaluar disa vite në Trepçe" i cili në vitin 1402 kishte kaluar në Srebrenicë dhe [...] *Nichola Honus Tudiescho* [...] *stette a Naouaberda per tempo passaato a mo si sta Ungaria* "Gjermani *Nichola Honus* për kohën që e kishte kaluar në Novobërdë [dhe që në vitin 1388] kishte kaluar në Hungari [...]". Në të njëjtin vit në Novobërdë dëshmohet edhe një prift, përkatësisht pleban [...] *Pleban Parcus quodam Pauli Theutonicus* [...],[89] përkatësisht "Plebani Parcus, i bir i të ndjerit Paulus, një gjerman" që në Novobërdë kishte shërbyer një vit (1421-1422) e për të cilin dijetari ynë Gaspër Gjini e pranon mendimin e shumicës se ky ishte i përkatësisë etnike sase.[90] E kësaj natyre është edhe përmendja e emrit etnik të sasëve në variantin italian të tij në një testament të viteve 1482-1485, të gjetur në Arkivin e Raguzës, sipas të cilit **"**Messer Martin da Nouamonte nostro compare" dhe "Messer frate Jacomo Todesco" ishin caktuar për epitropë "testamentarë". Tek i pari, *Messer Martin*, kemi të bëjmë me humanistin novobërdas Martio Segano i cili pikërisht në ato vite ishte **"**canonicus" i kishës së Shën Mërisë në Novobërdë.[91] Nga ky shënim mësohet, më tej, se ati

[87] V. Skarić, Staro rudarsko pravo i tehnika u Srbiji i Bosni, Beograd, 1938, f. 14.

[88] Muhamet Tërnava, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI, Prishtinë, 1995, f. 384.

[89] K. Jireček, Trgovački drumovi i rudnici Srbije i Bosne u srednjem veku, Zbornik Konstantina Jirečeka I; Beograd 1957, f. 71.

[90] Ipeshkvia Shkup-Prizren …, "Drita", Ferizaj, 1992. f. 85.

[91] Agostino Petrusi, Martino Segano di Novo Brdo, Vescovo di Dulcigno (Un umanista serbo-dalmata del tardo Quattrocento), Vita e Opere, Roma, 1981, f. 7, 10, 11,12, 13, 14, 15, 21, 23, 24, 142, 145.

Johann, përkatësisht Jacomo Todesco" do të ketë qenë meshëtar në kishën e sasëve gjë që lë të kuptohet se në Novobërdë sasët flisnin gjermanisht dhe se kjo ishte edhe gjuhë e liturgjisë në kishën e tyre.

Krejt qartazi përkitazi me praninë e elementit etnik sas në Novobërdë ka të bëjë edhe një njoftim i drejtpërdrejtë sipas të cilit qyteti mesjetar i Novobedës ishte deri në fillim të shekullit 16 kolonia më e rëndësishme e sasëve: *Novomontana civitias, Germanorum coloniie principio namque Saxones in Mysiae partibus metalla et argendi materiam reeperere. ...*[92] përkatësisht "Qyteti Novomontana, fillimisht një koloni e gjermanëve, sepse sasët gjetën në pjesë të Mizisë metal e argjend". Cilësimi i Novobërdës për koloni e gjermanëve/sasëve gjendet edhe në veprën e humanistit novobërdas Martino Segano, i gjysmës së dytë të shek. 15.[93]

Një dëshmi të drejtpërdejtë onomastike për praninë e sasëve në rrethina të Novobërdës e gjejmë në një letër të princit Lazar të vitit 1380 me të cilën ky i jepte manastirit të Ravanicës, përveç të tjerave, edhe dy katunde në rrethina të Novobërdës dhe në trevën e vendburimit të lumit Morava e jugut. Midis katundeve që ai ia falte atij manastiri përmendet edhe një vend i quajtur (Saški (saski) put),[94] "*Udha e Sasëve*". Duket se *Udha e Sasëve* e vitit 1380 është rruga që e trupon katundin e sotëm Përlepnicë të Moravës dhe sot quhet *Udha e Frengut.* Është shfaqur mendimi se kjo udhë e ka kryet në katundin Draganc të periferisë së Novobërdës dhe e lidhte këtë të fundit me kolloninë e Janjevës.[95]

Prania e sasëve në Novobërdë dëshmohet tërthorazi edhe në udhëpërshkrimin e shtegtarit francez Betrandon de la Broquière të vitit 1432 sipas të cilit qyteti quhet *Novo Berda, Novus Mons,* ital. *Novomonte* ose *Monte*

[92] K. Jireček, Trgovački drumovi i rudnici. .., f. 286.

[93] sh. Agostino Petrusi: Martino Segano di Novo Brdo, Vescovo di Dulcigno (Un umanista serbo-dalmata del tardo Quattrocento), Vita e Opere, Roma, 1981, f. 11.

[94] Fr. Miklosich, Monumenta serbica..., f. f. 198: ".. .i tomu mega Prilĕpnici ou psïe osoie na pčelinu stenu, na kami na Zubьcь, na Radovьcь studencь, oupravъ na vrьhь Draganca ωsutь stubla nizь brьdo putemь na trĕštenu drĕvo na dĕlь. .. na vranjanьskы putь,. .. na studencь na Sĕkurešь, na dĕlь megu ωbĕ vrьbice dole na Vranovu stĕnu na putь kь Pančelu oupravъ na turčinovъ grobь putemь na crьkvište na vrhь stražišta saškimь putemь na šlivu..." "...dhe kufini i tij Përlepnica, te Mshtia e Qenit, te Guri n'Zubc, te Kroni i Radovcit e drejt në maje të Dragancit dhe prej aty (te) Stublla teposhtë kodrës udhës kah Trupi i Qurshisë n'mal. .. te Udha e Vranjës, te Gurra në Sekuresh n'mal midis dy shelgjeve poshtë te Guri i Korbit n'udhën kah Pançeli (SG: katundi i sotëm Pançillovc) drejt e te Vorri i Turqinit udhës kah Truallishta e Kishës në maje të Strazhishtës Udhës së Sasëve e te Kumbulla. ..".

[95] Atanasije Urošević, Neki detalji iz prošlosti Kosova, Onomatološki Prilozi I, Beograd 1979, f. 28.

Novo dhe gjerm. *Neyberghe*,[96] "Mali i Ri", përkatësisht në njoftimin e vitit 1433 të po këtij udhëpërshkruesi sipas të cilit sundimtarët serbë e kanë në *pronësi* një qytet me një minierë të pasur me ar e me argjend, i cili quhet *Neyeberghe*.[97] Me këtë ka të bëjë edhe një letër e vitit 1433 e çelnikut Radiq që ia shkruante manastirit Kostamonit në të cilën thuhet: "Gjithashtu edhe katundet që ia kam falur dhe doganën e malet në *lagjen e sasëve*, d.m.th në Novobërdë e në Rudnik".[98]

Sasët gëzonin privilegje të mëdha, për të mos thënë gati të pakufizueshme. Për vendosjen dhe ngritjen e vendbanimeve, kolonive të tyre, një nen i Kodit të sundimtarit serb Stefan Dushan sanksiononte se sasët kishin të drejtë të prenin pyje e male kurdo që të donin dhe pastaj në tokat e çelura t'i vendosnin njerëzit e tyre. Mirëpo sundimtari serb paraprakisht ua mori këtë të drejtë,[99] por ua la në pronësi gjithë ato vende të çelura në bazë të së drejtës që sasët e kishin gëzuar para nxjerrjes së këtij Kodi. Mbase duke e ditur vartësinë e fitimeve të doganës së shtetit të tij nga veprimtaria e sasëve dhe e raguzasve, Dushani urdhëronte megjithatë që "Askush të mos ia ndalojë sasit malet. Le të presin sa t'u duhet për ta ndërtuar tregun".[100] Sipas mendimit të përgjithshëm, afër minierave që i kishin hapur, sasët ngrinin qytete të reja. Për të këtilla i marrin qytetet e Rudnikut në Serbi dhe të Trepçës e të Novobërdës[101].në Kosovë, gjë që është e vështirë për t'u besuar sidomos për Novobërdën, sa kohë që dihet se xehetaria këtu ka qenë zhvilluar edhe para pushtimit të kësaj hapësire nga perandoria romake. Sido që të jetë, qytetet përbëheshin zakonisht nga kështjella (në terminologjinë topike popullore shqip: *gjyteti*) dhe nga *suburbium* "nënqyteti" - vendbanim përreth gjytetit ose rrëzë minierës. Gjyteti shërbente për strehim në raste rreziku, luante një rol edhe si qendër administrimi. Në gjytet e kishte selinë edhe konti, përkatësisht (serb.) *vojvoda* ose (lat.) *comes* dhe prej aty e administronte jo vetëm gjytetin,

---

[96] K. Jireček, Trgovački drumovi i rudnici Srbije i Bosne u srednjem veku, Zbornik Konstantina Jirečeka I; Beograd, 1957, f. 71.

[97] C. Jireček, Staat und Gesellschaft..., f. 11, 67. Shkrimet e këtij autori janë botuar në librin Le Voyage D' Outremer de Betrandon de la Broquière […], publié et annoté par Ch. Schefer, Paris 1892, ndërsa njoftimi i cituar më lart është në f. 214 të këtij botimi.

[98] Stojan Novaković, Grad, Trg, Varoš, separat nga libri Gradovi i trgovi u staroj srpskoj državi, Beograd, 1892, f. 9.

[99] Stojan Novaković, Novo Brdo i Vranjsko pomoravlje. .., f. 16.

[100] Urdhëresën në Kodin e Dušan -it *отъ съса напрѣда Sasinъ da ne сѣче. A što сѣче, отогазы da ne teži ni ljudi da ne sagja.* "Prej tani e tutje të mos presin më. Dhe aty ku ka prerë, të mos sjell njerëz e të mos mbjell " - cit. sipas Čed. Mijatović, Studije za istoriju srpske trgovine XIII-og i XIV-og veka, III, në Glasnik Srpskog Učenog Društva XXXVII, Beograd, 1873, f. 195.

[101] M. Takács, Sächsische Bergleute..., f. 37.

porse edhe suburbium-in. Në suburbium jetonin, të ndarë në lagje të mëvetëshme, grupe të ndryshme etnike me sisteme të ndryshme të së drejtës. Qendër e suburbium-it ishte tregu. Edhe sasët e raguzasit i kishin lagjet e tyre të veçanta. Këtë e tregon mbase mjaft mirë *Lagja e Sasëve* që u përmend më lart, si edhe *Kisha e Sasëve*, gjurmët e së cilës janë dëshmuar në katundin e sotëm Bostan, rrëzë maleve të Novobrdës.

Sigurisht që lënda e drurit sasëve u duhej sa për rregullimin e shtonave në miniera e puse minierash aq edhe për shkrirjen e mineraleve të nxjerra nga nëntoka. Duket se periferitë e qyteteve - miniera mesjetare të Kosovës ku ishin vendosur sasët, ishin mjaft të pasura me dru. Për pasurinë me pyje p.sh. të Novobërdës e të rrethinës së saj paska një njoftim të gjysmës së parë të shek. 15, kur pasi e kishte sulmuar këtë hapësirë, Evrenos beu e njoftonte sulltan Mehmetin e Dytë se ky vend qenka malor dhe me pyje,[102] përkatësisht: "Duke hyrë në mbretërinë e të birit të sundimtarit Lazar, ku unë do të dëshiroja që ti t'i kesh çadrat në gryka e në vende malore".

Fundja, këtë e dëshmon edhe rrethana e lulëzimit të minierës së Novobërdës në shekujt 12-14 sa kohë që dihet se kusht themelor për asi lulëzimi duhej të ishte bollëku me material për zjarr-djegie.[103]

St. Novakoviq mendon se xehetaria as në Novobërdë e as në Janjevë nuk mund të ishte në duar të serbëve para kohës së pushtimit nga mbreti serb Stefan Urosh II Milutini të Pollogut, Ovçepoles e Zletovos në Maqedoni, përkatësisht para pushtimit të Lipjanit, Gjilanit, Vranjës e Novobërdës sepse deri në vitin 1282 qytetet, përkatësisht regjionet e përmendura më lart ishin nën sundimin bizantin dhe nga fundi i shek. 12 xehetaria kishte lulëzuar në rrjedhat e lumenjve të Sitnicës e të Moravës. Në Novobërdë xehtaria kishte lulëzuar, gjithnjë sipas St. Novakoviqit, midis viteve 1285-1326 kur ky qytet nuk ishte në duar të serbëve.[104] Sado që Novobërda konsiderohet si kolonia më e madhe e më e forta njëherë e sasëve e pastaj e raguzasve, sasët e vendosur në vendbanime të vetat, përkatësisht në lagje të mëvetshme qytetesh mesjetare, i kishin kishat e veta, gjyqtarët e vet që na e përkujtojnë situatën në kolonitë sase në Poloni në të cilat në gjysmën e parë të shek. 12 për kolonitë gjermane

[102] khs. tekstin: "Lazogli (Lazari Despotae filii) regnum ingressus, ubi te veliam angustis in locis et montuosis habere costra etc. "në Epistolarem Turcicarum variorum et diversarum authorum, libri quinqe, Francofur 1599, II, 64 cit. sipas Čed. Mijatović, Studije za istoriju srpske trgovine. .., f. 192.

[103] Sipas Ćedomilj Mijatović,. Studije za istoriju srpske trgovine. .., f. 192.

[104] St. Novaković, Grad, Trg, Varoš,. .., f. 18.

ishte në fuqi "*e drejta gjermane*".[105] Përkitazi me këtë të drejtë, përkatësisht me vetë procedurën gjyqësore të zhvilluar sipas kësaj të drejte ka, sipas M. Takács, një mendim të mbështetur mirë nga Jireçek e nga B. Saria se gjyqësia sase, përkatësisht e drejta mbi minierat e aplikuar nga sasët i ka rrënjët tek ecuria e procedurës së të drejtës mbi minierat, e aplikuar në qytetet-miniera të Hungarisë së Epërme, sidomos në Kremniz (hung. Körmöcbánja, sllovak. Kremnica) dhe Schemnitz (hung. Selmecbánya, sllovak. Banskà Štiavnica), gjë që do ta dëshmonte Hungarinë e Epërme si atdhe të kryehershëm të sasëve të vendosur në shtetin serb të Rashës së mesjetës, përkatësisht (edhe) në hapësirën e sotme të Kosovës. Si edhe në Hungari, "Edhe në Serbinë mesjetare, sasët e gëzonin privilegjin që nën kushte shumë të volitshme t'i shfrytëzonin xehet. Pas gjithë gjasash edhe mbreti serb Stefan Urosh II Milutini (1282-1321) ua dha sasëve privlegjin që këta të fundit të mund të vendoseshin gjithandej ku këta do të pandehnin se ka xehe".[106] Fundja, edhe vala e vendosjes së minatorëve sasë në Kosovën e sotme është pjesë e depërtimit të fiseve gjermane gjatë shekujve 12-15 drejt lindjes, përkatësisht në Çeki, Poloni, Hungari. Sasët e kolonive të tyre nëpër Kosovë e kishin statusin prej qytetari, përkatësisht *purgari* = gjerm. *Bürger* "qytetar". Kjo shihet edhe nga një letër e Republikës së Raguzës që ia dërgonte kolonisë së vet të Novobërdës më 1388 në të cilën (letër) thuhet se qytetarët e këtij vendi quhen *purgari* [Bürger].[107] Atributi *purgar* është i lidhur me rrethanën që Nobvoberda ishte e vetmja koloni e Kosovës së mesjetës që cilësohet për *civitas*, përkatësisht *qytet* në kuptimin mesjetar dhe i barazuar pra me Raguzën, me Venedikun e të gjitha qytetet e mirëfillta mesjetare.

Në të gjitha vendet ku sasët nxirrnin minerale, sasët vetë, raguzasit dhe të krishterë të tjerë, përkatësisht katolikët i themeluan vendbanimet e tyre (citada, castello) të cilat, të ngritura rëndom maje kodrash, kishin në pjesën e poshtme të tyre edhe një treg (mercatum). Në disa nga këto qendra (si p.sh. në Novobërdë) këta i kishin vendet e prerjes së monedhave. Sa i madh ishte numri dhe sidomos pushteti i këtyre minatorëve duket se e dëshmon rrethana se në monedha sundimtarësh të kësaj hapësire, si p.sh. në monedhat e princit Lazar, mbishkrimet janë në alfabetin latin.[108] (sh. edhe më poshtë) Sado të vogla të kenë qenë vendba-

[105] Për përhapjen e të drejtës gjermane në Poloni dhe në Siebenbürgen (Transilvani) të Rumanisë në shek. 12 khs. edhe K. B. Müller, Die Bedeutung von deutschen Blutes in Südosteuropa, Süddeutsche Forschungen, III, 1938, f. 584.

[106] khs. Sächsische Bergleute..., f. 36.

[107] St. Novaković, Grad, Trg, Varoš..., f. 18.

[108] khs. psh. "*grossi de Novaberda*" dhe "*cecha de Prisreno*", të dëshmuara në vitin 1349, përkatësisht 1370: K. Jireček-J. Radonić, Istorija Srba II, f. 202.

nimet, kolonitë e sasëve e të raguzasve, ato i kishin të gjitha veçoritë e vendbanimeve të latinëve, përkatësisht të romanëve e të gjermanëve. Secili nga këto vendbanime, pa e marrë parasysh madhësinë e tyre, kishin kishë të vetën. Ato drejtoheshin nga ardhacakë, ndërsa përfaqësuesit e pushtetit emëroheshin nga Republika e Raguzës.[109]

Në kohën e fillimit të aktivitetit të tyre në fushën e xehetarisë, sasët përbënin në Novobërdë, përkrah popullatës vendëse, grupin më të madh të popullsisë së atij qyteti. Më vonë, e njëjta situatë ishte edhe në Trepçë, ku sasët - deri në forcimin e raguzasve - e mbanin në duar të veta qeverisjen e vendbanimit-minierë.[110] Edhe në hapësirën e Kosovës (edhe) sasët i kishin gjyqet e veta (*curia Teotonicorum* përkatësisht *curia purgarorum*), të përbërë nga qytetarë ashtu sikundër gjyqet e raguzasve përbëheshin nga patricët dhe vetëm më vonë edhe nga *populan*-ët.[111] (khs. më poshtë nën *Bërgari*).

Dëshmia më e vjetër për ekzistimin në Novobërdë të një kishe të sasëve rrjedh nga viti 1346, kur midis kishave (katolike: të Prizrenit, Janjevës, Koporiqit, Pllanës, Rudnikut e Bërskovës) dëshmohet edhe Kisha e Shënkollit në Novobërdë, të cilën e kanë quajtur edhe "*Kisha e Sasëve*". Dihet se ka ekzistuar edhe një kishë e kushtuar Shën Mërisë: "*S. Maria in Dogni Terg*", e cila gjendej në nëngjytetin e poshtëm,[112] përkatësisht në katundin e sotëm Bostan rrëzë Novobërdës.

Kisha e Sasëve është e pandarë nga "Mahalla e Kishës së Sasëve" e qytetit të Novobërdës, e cila dëshmohet edhe në shek. 15.[113] Populata serbe e katundit Bostan rrëzë Novobërdës për "*Saška Crkva*" i mban rrënojat e kishës katolike që janë zbuluar në territor të atij katundi. Në studimin e tij të ngjeshur Miklós Takács[114] ka treguar se kjo kishë nuk qenka ngritur para vitit 1330 dhe se kjo ishte vetëm njëra nga dy kishat sase që ishin në Novobërdë. Kisha e quajtur "e sasëve" nuk qenka pra as ajo e Shën Kollit, as ajo e Shën Mërisë, porse një tjetër, e treta, për të cilën nuk është ditur deri në vitet e '50 -ta të shekullit të kaluar - kur këtu u bënë gërmime arkeologjike. Ka dy mendime përsa i përket aspektit arkitektonik: sipas njërit kjo do të ketë qenë kishë e tipit gotik, ndërsa sipas tjetrit kjo do të ketë qenë e tipit roman. Në pjesë freskash të

[109] K. Jireček, Trgovački drumovi. .., f. 286.
[110] K. Jireček - J. Radonić, Istorija Srba II, f. 90, 407.
[111] Nga: *de popolo* "pjesëtarë të shtresës së qytetarëve".
[112] G. Gjini, Ipeshkvia Shkup-Prizren..., f. 85.
[113] Nedim Filipović, Iz istorije Novog Brda u drugoj polovini XVI vijeka, Godišnjak Istorijskog Društva Bosne i Hercegovine 6, Sarajevo (1954), f. 74.
[114] Sächsische Bergleute im mittelaterlichen Serbien und die "sächsische Kirche" von Novo Brdo, Südost-Forschungen, Band L, 1991, sidomos në f. 48-60.

zbuluara përreth lterit të kësaj kishe është hetuar edhe figura e demit, simbol i evangjelistit Lukas. Sipas tjetrit, "kisha e sasëve" do të ketë qenë e tipit roman dhe e ngritur nga mjeshtër raguzas, sepse sasët nuk paskan pasur traditë në ndërtimin e kishave. Takács ka treguar megjithatë se ajo paska qenë ndërtuar nga sasët, përkatësisht se ishte kishë gotike. Kjo paska qenë, në këtë pikëpamje, një unikat në gjithë Ballkanin. Kjo kishë paska qenë e tipit të kishave që u përhap në shek. 11-12 dhe që ndeshen në hapësirën etnike gjermane, përfshirë edhe Austrinë e Poshtme. Kisha e Sasëve qenka ngritur dy-tre breza pas ngulitjes së sasëve në Novobërdë, duke i ndenjur besnik traditës arkitektonike të kishave të atdheut të tyre të kryehershëm.

Është për t'u shënuar se në Mahallën e Kishës së Sasëve në fund të shekullit 15 jetonin edhe banorët shqiptarë: Gjoni i bir i Markos; Tuna i biri i Jovanit dhe Pop Dom Nikolla,[115] gjë që tregon se jo vetëm kishte një bashkëjetesë sase-shqiptare, porse që edhe famullitari i asaj kishe, si rëndom, kishte qenë shqiptar.

Nga shembujt e mësipërm të kishave të dëshmuara në qytetin e Novobërdës dhe në qytezën e Janjevës, do të mund të kuptohet mbase fare lehtë se sasët i kishin kishat e ndara nga raguzasit. Duket se ka mundësi të paravendohet që sasët do të kenë ardhur në Kosovë para lëvizjes protestantiste të Martin Luterit, prandaj edhe nuk pati ndonjë pengesë që ata të bashkëshkriheshin me raguzas e me katolikë të tjerë me të cilët bashkëjetonin.

2.1.2. Sasët në Trepçe

Mbi bazën e burimeve mesjetare serbe që kanë të bëjnë me hapësirën e Kosovës së sotme del e qartë se sasët dëshmohen shprehimisht për banorë të Kosovës vetëm në shekullin 14.[116] Në krisobulën e mbretit serb Milutin (të hartuar midis viteve 1313 - 1318) përmenden shprehimisht "Sasët e Trepçës".[117] Fundja, karakterin prej miniere të vendbanimit Trepça dhe arsyen e vendosjes së minatorëve sasë aty do ta tregonte edhe rrethana që edhe vetë emri i Trepçës lidhet, sado që jo krejt drejtpërdrejt, me një term që i bie sferës së xehetarisë, përkatësisht aktivitetit të minatorëve. Emri *Trepça* rrjedh pas gjithë gjasash nga folja serbe *trěbiti* "çel,

[115] I. Rexha, Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës., f. 69.
[116] M. S. Filipović, Das Erbe., f. 194.; V. Skarić, Staro rudarsko pravo i tehnika., f. 14.
[117] khs. Vatroslav Jagić, Svetostefanski hrisovulj kralja Stefana Uroša II Milutina, Wien, 1890, 21; *Planina nad Sasьi trebьčkiomi*; "*Sasi trebьčkii*" ; St. Novaković, Zakonski Spomenici, f. 624; C. Jireček, Staat und Gesellschaft. , II, f. 66 sh. edhe referencën 68 të kësaj trajtese.

thyej; prej malin" dhe lidhet kështu me përgatitjen e lëndës për sigurimin e galerive e ndoshta edhe për ngritjen e kolonive të minatorëve shtëpitë e banimit të të cilëve do të kenë qenë të ndërtuara më parë nga dru e shindra se sa nga gurë apo plitharë. I së njëjtës prejardhje do të jetë edhe emri *Trebiq* i një katundi të vogël në komunën e Leposaviqit.[118]

Në të njëjtin vit (sh. më lart), përkatësisht më 7 prill 1313 në Trepçe dëshmohen edhe raguzasit, përkatësisht bujari raguzas Marcus de Lucari për të cilin dihet se lidhje tregtare me sundimtarë serbë mbante së pakut që nga viti 1311. Në Trepçe, përveç shumicës raguzase, kishte edhe tregtarë nga Venediku, Spliti e sidomos nga Kotori.[119]

Ndonjë dëshmi autentike ka edhe përkitazi me praninë e raguzasve dhe të sasëve në qytetet-miniera të Kosovës së shek. 14-15. Kështu, në një kontest midis kontit venedikas Gianinus Giorgi dhe nëpunësve të sundimtarit serb St. Dushan në letrën e shkruar italisht më 24 mars 1349 *in março Trepçe* "në tregun e Trepçes" konti bën të ditur se ky deshi që plumbin që e kishte në Trepçe e që ia kishte shitur një konti kotoras t'ia jepte zyrtarisht *in casa mia in Trepçe* "në shtëpinë time në Trepçe". Kjo punë kontit iu ndalua nga knezi i autorizuar i St. Dushanit sepse gjithë plumbin që ishte nxjerrë në Trepçe sundimtari Dushan ia kishte falur manastirit në ndërtim të shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit që ky ta përdorte për pullazin e manastirit. Kontit venedikas Gianinus Giorgi iu konfiskua xehe plumbi në vlerë prej 10.000 perperësh, ndërsa padinë e shkroi "*in presentia del conte Raia et de Pelnos et de Manuello Tedeschi* "në praninë e kontit Raia dhe të Pelnos-it e të Manuello Tedeski-t" dhe disa kotorasve e raguzasve të Trepçes. Në dialog me kontin serb të autorizuar nga sundimtari Stefan Dushan raguzasi Zhanin premtonte se kontesti do të zgjidhej drejt nga *buona plerçaria, vos Tedeschi o Slaui o Latini*, përkatësisht nga gjykatës gjermanë, sllavë e latinë. Në një shkresë, ankesë të një raguzasi drejtuar kontit dhe gjyqtarëve në Raguzë për dyqanin që ia kishin vjedhur në Tergovishtë (Novi Pazar) i rekomandohet që çështjen t'ua lë në dorë *citadinj nostri in Trepça*[120] "qytetarëve tanë në Trepçe".

Se pothuaj nuk ka ndonjë koloni të madhe të tipit qytet-minierë apo thjesht treg në të cilin nuk do të ketë pasur patjetër sasë e raguzas e tregon edhe shembulli i bashkëjetesës raguzase-sase në Trepçë. Kështu, nga një burim i dt. 23 mars 1349 mësohet se bujari venedikas Ganninus Giorgi i

[118] Këtë emër katundi e gjeta të shënuar te J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 8, Mitrovica, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potku, Prishtinë, 2002, f. 208.

[119] J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë (Prej fundit të shekullit XIII deri në vitin 1455), Prishtinë, 1986, f. 139.

[120] Konstantin Jireček, në Spomenici Srpski, bot. te Spomenik XII, Beograd, 1892, 28, 74.

kishte shitur plumb të Trepçës një bujari raguzas dhe për këtë i kishte dy dëshmitarë sasë,[121] emrat e të cilëve nuk janë dhënë. Këtu bie gjithsesi edhe shënimi që rrjedh nga viti 1348 e në të cilin bëhet fjalë për një *Urburare*, përkatësisht për një notar,[122] që gjithsesi po u dashka të ketë qenë i përkatësisë etnike sase.

Ekzistimin e një vendbanimi që quajtur sipas emrit etnik të sasëve (ndoshta kemi të bëjmë me vetë Mitrovicën?) e gjejmë të dëshmuar në dokumentin raguzas "Lamenta de foris 1446" f. 249 nga i cili mësohet se njëfarë Giuichus Braissich (lexo Gjukus Brajshiq), ankohej se e kishte vjedhur shërbëtori i tij që ishte arratisur *in Sclauonia in Sassi* "në Sklavonia, në Sasi". Se kemi të bëjmë me një vendbanim më vete të paemër apo distrikt të ndonjë vendbanimi të madh i quajtur *Sasi* "Sasët" pse banohej nga këta të fundit dhe që nuk ishte larg nga Mitrovica, mësohet edhe nga deklarata e dëshmitarit Radach Iffcouich (lexo Radak Ifkoviq) sipas së cilës për këtë vjedhje ky kishte dëgjuar, kur ky vetë bashkë me patronin e tij Zuan Serceuich (lexo Zhuan Serçeviq), ishte kthyer në *e Dimitrouç videlicet de nundinis*, përkatësisht në *Dimitrovc* - siç quhej më 1446 Mitrovica e sotme, vend ky në të cilin krye çdo motmoti mbaheshin edhe tregje, përkatësisht panaire.[123] Ka shumë arsye të mendohet se me emrin *Dimitrovci* do të jenë emërtuar në krye të herës banorët përreth kishës kushtuar Shën Mitrit, e cila ka të bëjë me kishën aktive, sot serbe të Mitrovicës, nën kështjellën e Zveçanit.

Mendimi sipas të cilit nën emrin e stom Zhazhë 12 km. në veri të Mitrovicës, përkatësisht në komunën e Zveçanit mund të mëshihet emri *Sase* i kryehershëm më duket interesant, jo porse edhe shpjegimi me tërrnime fonetike të një *Sasi* të dëshmuar në *Shashë nga e cila do të rezultonte një Zhazhë "falë kalimit të *s* > *sh*" të propozuar nga A. Konushevci e i pranuar nga F. Hajrizi.[124] Mendim përafërsisht të ngjashëm shfaqte edhe dijetari serb Aleksandar Loma.[124a] Edhe ky

[121] Poai, poaty, f. 140.

[122] C. Jireček, Staat und Gesellschaft..., II, f. 67; V. Skarić, Staro rudarsko pravo i tehnika, f. 14. Sipas shpjegimit të Nikola Čolak-Ive Mažuran: *Janjevo*, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 15, urburar, sh. *urburarii* e kishte kuptimin e drejtuesit të minierës.

[123] Constantin Jireček, Das christliche Element in der Topographischen Nomenclatur der Balkanländer, Sitzungsberichte der Kais. Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch-Historische Classe, Band CXXXVI, Wien, 1897, f. 83.

[124] Sh. Shala e Bajgorës në vështrimin historik, në Trepça.net, shkurt 2002, i cili e citon punimin Toponomia e Mitrovicës, "Fjala", nr. 6-7, qershor-korrik 2001, f. 19 të Abdullah Konushevcit.

[124a] Khs.Toponimija Banjske Hrisovulje, SANU, Beograd 2013, f. 84.

pandeh se serb. *Žaževo* qenka në të vërtetë trajtë serbe e emrit të katundit të sotëm *Zhazhë* të rrethinave të Mitrovicës dhe se me këtë po u dashka të identifikohet katundi *Sase* i mesjetës së vonë.

Në mbështetje të rrethanës që emrat e vendeve në të cilat ruhet emri etnik i sasëve dalin gjithandej nëpër Ballkan e në Europën Juglindore në përgjithësi në trajtat *Sas-* dhe *Šaš* përkatësisht *Shash*, është e vështirë të gjendet një sqarim i pranueshëm përse se ky emër do të jetë tërrnuar në Zhazhë. Në burime osmane të shek. 15 e 16, emri i këtij vendbanimi do të jetë shënuar në trajtat Žaževo, Žežna, Žace e Žaža të cilat J. Osmani[125] i jep në grafinë shqipe: Zhazhevë, Zhezhna, Zhace e Zhazha. Vështruar në rrafshin jashtëgjuhësor, në të mirë të identifikimit të vendit *Sasi* me *Zhazh*-ën e sotme do të shkonte rrethana që në hapësirat e këtij katundi paska një vend të quajtur *Gradina* përreth së cilës ka pasur gjurmë shtëpish të banimit, si dhe vendi i quajtur "*Te Kisha*" e mbi të gjitha vendi i quajtur *Majdani*, që mund ta ruajë kujtimin për ekzistimin e ndonjë miniere.

Kolonia sase-raguzase e Trepçës e kishte edhe kishën e vet katolike "të bukur të Zonjës së bekuar derisa (aty) ishin sasët dhe dalmatët".[126] Kjo kishë do të ketë qenë pas gjithë gjasash në vendbanimin mesjetar Stari Terg të Mitrovicës, vendbanim ky të cilit pas vitit 1610 i humbi rëndësia e nami që e kishte pasur dhe nuk ishte më i njohur si më parë.[127]

Një kishë të veten katolike famullitare e kishte edhe kolonia sase-raguzase e Rogoznos (në Serbi) e cila përmendej po ashtu më 1303.[128]

Karakteri prej kolonie sase-raguzase i këtij vendbanimi (Rogozno-s) dëshmohet dhe nga rrethana se në Krisobulën për manastirin e Banjskës të sundimtarit serb Milutin në vitet 1313-1318 përmendet edhe një lumë i sasëve, përkatësisht *Saška Reka*. Po u mbështetëm në tekstin e krisobulës, sipas të cilit një pikë e largët kufiri e vendit Rogozno binte "në Bistricë pas shtëpive të Sllavkut, prej aty përgjatë lumit Bistrica, në lugun e Kërcunit e në rrafsh dhe andej kah Rakitovica pas Radishtës bie në Bistricë

[125] Sh. Vendbanimet e Kosovës 8, Mitrovica, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, Prishtinë, 2003, f. 167, 168.

[126] Gaspër Gjini, Ipeshvia Shkup-Prizren nëpër Shekuj, "Drita", Ferizaj, 1992, f. 84.

[127] Xehetaria u mbajt e gjallë në regjionin e Kopaonikut deri në shek. XVI. Në shek. XVII. kjo u tkurr gradualisht kështu që nga fundi i atij shekulli aty kishte vetëm edhe disa farkëtore të mjerueshme të hekurit (K. Jireček, Trgovački drumovi i rudnici..., f. 89). Për sasët në Serbi deri në fillim të shek. XX khs. edhe Gustav Weigand, Die rumänischen Dialekte der Kleinen Walachei, Serbiens und Bulgariens, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache 7/1900, f. 6, 8, 13.

[128] Khs. Gavro Škrivanić, Putevi u srednjovekovnoj Srbiji, Beograd, 1974, f. 126, cit. sipas Gaspër Gjini, Dioçeza. .., f. 84.

(dhe) prej aty në Rastelnicë, prej Rastelnice në *Lumin e Sasëve* dhe nga lumi andej kah mali shkon te Gropat e Vjetra (dhe vazhdon) Malit teposhtë kah Udha e Llapit e në Stubëll. .."[129] mund të paravendohet se kjo përroskë nuk ishte larg nga katundi i sotëm shqiptar Bistricë i komunës së Leposaviqit. Në testamentin e nënshkruar në vitin 1356 të raguzasit Domanie Mançetiq, edhe ky mbase banor i Trepçës, është shënuar se ky e kishte larë borxhin që ia kishte pasur një *Teotonicus pro mercate de Trepce*,[130] "Teutonit në tregun e Trepçës" ndërsa në një dokument raguzas të mesit të shek. 14 për në këtë koloni përmendet edhe një sas që ishte bir i një konti lokal: *Ajano Toldesco fiol de chonte de Rogosna*,[131] "Ajani Toldesko, i bir i kontit të Rogoznos -s" dhe një *Teodescho rupnik* "Teutoni (gjermani), minator", mbase pronar i ndonjë pusi miniere, që për mbiemër të mirëfilltë e mbante variantin italian, përkatësisht raguzas të emrit etnik të sasëve *Teodescho*, që përmendet në vitin 1402.[132]

Shënimet e mësipërme kanë të bëjnë me sasët, të cilët banonin e punonin në e përreth minjerës edhe sot aktive të Trepçës. Dëshmimi i sasëve në këtë vendbanim-minierë e përforcon korrektësinë e paravendimit se vendosja e sasëve minatorë si në hapësirën e sotme të Kosovës, ashtu edhe në regjione të tjera të Gadishullit të Ballkanit është e pandashme nga riaktivizimi i minierave, përkatësisht i xehetarisë në këtë pjesë të Europës Juglindore. Në këtë kontekst sasët u vendosën edhe në Kosovë së pari në vendbanimet-miniera, përkatësisht në tregjet e ardhshme të minatorëve, çfarë në atë kohë ishin Novobërda, Trepça, Janjeva,[133] Kishnica e Vërhllabi (katundi i sotëm Bellosicë në komunën e Podievës, sh. më poshtë) dhe vende të tjera më pak të njohura.

Një çështje më vete që kërkon sqarim të besueshëm është, sipas mendimit tim, të konstatohet se cili është vendi i kyehershëm i dëshmuar me emrin Trepça. Ka mjaft arsye të besohet se miniera e Trepçës shfrytëzohej qysh në periudhën romake, sepse diku këndejpari e kishte pasur

---

[129] Khs. Lj Kovačević, Svetostefanska hrisovulja…, f. 3: "A Rogozno... ou potokъ. ou bьistricou za slav'kovou kouštou. ωt toud ouz rěkou bьistricou. ou bьdnjeve dolє. ou plošou i kako rakitovica po gradište ou bьistricou oupada. ωt toud ou rastěl'nicou. ωt rastěl'nice ou saš'kou rěkou. ".

[130] Cit. sipas Dr. Muhamet Tërnava, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV -XVI, Prishtinë, 1995, f. 384.

[131] Mihailo Dinić, Za istoriju rudarstva u srednjevekovnoj Srbiji i Bosni, II, Beograd 1962, f. 82., referenca 60.

[132] Cit sipas Dr. Muhamet Tërnava, Popullsia e Kosovës…, f. 389.

[133] Mihailo Dinić, Za istoriju rudarstva. .., II, f. 82., referenca 60.

selinë edhe *Procurator*[*] *Metallorum* "guvernatori, administratori për çështje të xeheve"[134] dhe se ky vendbanim ishte i banuar dendur, prandaj edhe gjatë periudhës së sundimit osman, më saktësisht në shek. 16., përkatësisht në defterin e regjistrimit të viteve 1566-1574, Trepça ishte nahie atëherë më vete, e varur porse nga Vuçiterna. Nahia Trepça e asaj kohe kishte 12 mahallë që, intetrpretuar në kuptimin e sotëm, do të thotë 12 katunde. Këtu binte një vendbanim i quajtur *Trepça*, ndërsa pjesë apo lagje të tij ishin *Dolina Trbz* (Dolina Trebza) e *Gorna Trepz* dhe një lagje e quajtur "Mahalla pop Shnajder, varet nga Trepça". Në këtë mahallë jetonte edhe një *Jova*, pop. Me vendbanimin Trepça ka të bëjë mbase mahalla e quajtur "*Trepz*" e të krishterëve që, natyrisht, varej nga nahia e Trepçës.

Gjykuar mbi bazën e përkatësisë gjuhësore të antroponimeve që në gjysmën e dytë të shek. 16 i mbanin banorët e lagjes *Trepz* khs. ndër të tjera: Marko *Bardo*, Nikola *Bac*-i, Marko *Baliq*-i, Pavl *Mazreka*, Pavl *Grila*, *Tusha*, i ardhur; Pero *Bukmir*-i, Marko *Bushad*-i e Luka *Bushad*-i mund të thuhet me plotë të drejtë që pjesa më e madhe e banorëve të kësaj lagjeje, përkatësisht katundi, ishin të përkatësisë etnike shqiptare. Aspak më e ndryshme nuk ishte gjendja as me banorët, përkatësisht me njerëz që mbanin antroponime shqipe edhe në lagjen Mekisha të nahijes së Trepçës. Këtu janë regjistruar edhe kryefamiljarët *Gjin Gash*-i, Jovan *Vlash*-i, Marko *Lika*, Pera *Prend*-i, Pera *Gika*, Nina *Gjec*-i, *Mati* Stepa, Nikolla *Mati*, Nikolla *Gjon*-i, Nika *Suma*, Luka *Deda*, Pavl *Koka* (ose Kuka), *Çeta* Vuka, Pejo *Deda* dhe Pera *Gika*.[135] Pushtuesit osmanë e kishin nxjerrë qysh më 1436 edhe një ligj të veçantë të Trepçës[136] për minierat.

Dihet tashmë se në jug të minierës së sotme të Trepçës gjendet edhe vendi i quajtur *Gjyteti i Trepçës* dhe se miniera sikur është ruajtur nga dy kështjella: nga Gjyteti i Trepçës dhe nga kështjella e Zveçanit. Mirëpo do të duhej në këtë mes të sqarohet se çfarë lidhje ka p.sh. oronimi *Kodra e*

---

* e shkruar gabimisht me *c* në vend se me *k*. Fjala rrjedh nga lat. *prōcūrāre* dhe e ka kuptimin "përkujdesje, administrim; person i autorizuar, vëllimi i kompetenmcave të të cilit është i përkufizuar me ligj". Trajta *prokurator* është variant ital. i fjalës latine (sh. më lart) dhe e ka kuptimin "guveranator i një province të Perandorisë Romake. Kjo fjalë e ka, më tej, edhe kuptimin historik "njëri ndër nëntë nëpunësit më të lartë shtetërorë të Republikës së Venedikut" sipas Schüler Duden- Fremdwörterbuch, Dudenverlag, Mannheim-Wien -Zürich, 1984, f. 364.

[134] Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 8, Mitrovica, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, Prishtinë, 2003, f. 110.

[135] S. Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës në shek. XV-XVI, Tiranë, 1983, f.. 558, 559., 564, 672, 673, 703.

[136] Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 8, Mitrovica, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, Prishtinë, 2003, f. 111.

Trepçës në katundin Bare - disa kilometra larg nga Stari Tergu me oronimin homonim *Trepça* dhe hidronimin *Kroni Trepçës* në katundin Mazhiq që i kam shënuar edhe vetë në terren.[137] Në afërsi të asnjërit nga këto mikrotoponime nuk ka emra të tjerë vendesh që do ta dëshmonin ekzistimin e puseve të minierave, përkatësisht ushtrimin e nxjerrjes dhe të përpunimit të xehes. Përjashtim do të bënte këtu mikrotoponimi *Vrella e Rudarit* në katundin Mazhiq, me kusht që të dëshmohej se ky emërtim do të rridhte nga mesjeta, gjë që më duket paksa e vështirë.

Sipas mendimit të përgjithshëm, miniera Trepça e shek. 14 do të ketë qenë përreth vendit të quajtur Stari Terg, për ku besohet të kenë qenë edhe dy kisha: njëra kushtuar Shën Mërisë, ndërsa tjetra Shën Pjetrit, për të cilat do të pritej që të ishin katolike. Sot në Stari Terg e në Mazhiq janë dy rrënoja kishash. Atë të Stantergut edhe po e quajtkan "Kisha e Sas've" që, megjithatë, më duket një emërtim librar, ndërsa atë të Mazhiqit e quajnë "Xhamia e Mazhiqit". Pa kurrfarë kompetence e them me plotë gojë se nuk duhet qenë njohës i specializuar për të vërejtur se të dyja këto gërmadha janë në të vërtetë rrënoja kishash të arkitekturës bizantine.

2.1.3. Sasët në Janjevë

Sado që nuk ka ndonjë njoftim për kohën e themelimit të kolonisë xehetare të Janjevës së sotme, të dhëna të tërthorta e lejojnë paravendimin që fillet e ngritjes së këtij vendbanimi janë të pandashme nga vendosja aty e elementit etnik sas. Kjo lidhet me përmendjen në një letër të papës Benedikti XI drejtuar ipeshkvit të Tivarit,[138] përkrah atyre në Bërskovo, Rudnik, Rogozno e në Trepçe, e një kishe katolike edhe në famullinë e Graçanicës, përkatësisht të Janjevës.[139] Ngritja, përkatësisht ekzistimi i kësaj kishe katolike është për historianin serb St. Novakoviq[140] dëshmi se para shek. 12 e 13, pushteti serb nuk kishte sovranitet mbi qytetet e

[137] Për hir të korrektësisë po shënoj se këto mikrotoponime i ka evidentuar në terren edhe J. Osmani, khs. Vendbanimet e Kosovës, 8. Mitrovica, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, Prishtinë 2003, f. 89, 90.

[138] khs.: "Benedictus XI. Papa ad petitionem Marini archiepiscopi Antibarenses eidem concedit fascultatem instituendi et destituendi rectores in ecclesia parochialibus "de Briscouia (Bristonia), de Rudenico, de Rogosna et de Trepzo et de Grazaniza in Regno Servie" constituitis, "ubi fides cattolica colitur et ritus Romane eclesie observatur episcopi tamen illarum patrium, qui de suis asserunt diecesibus ecc, lesias esistere supradictas, fidem et ritus huismodi non opservant" cit. sipas J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë, Prishtinë 1986, f. 64, ref. 2.

[139] Sipas mendimit të përgjithshëm, famullia e përmendur në letrën e Papës Benedikti XI për si e Graçanicës ka të bëjë në të vërtetë me famullinë katolike të Janjevës, por që është ngatërruar nga shkruesi i oborrit të Papës.

[140] Novo Brdo i Vranjsko Pomoralvje u istoriji srpskoj 14 i 15 veka, Beograd 1880, f. 29.

Janjevës, Zhegovcit, Novobërdës, Vranjës dhe territoret e pjesës jugore të Kosovës së sotme, sepse sovraniteti bizantin arrinte deri në qytetin e Lipjanit.

Kisha e përmendur në këtë burim nuk ka të bëjë as me Janjevën e sotme e as me kishën ekzistuese të saj, porse me Janjevën e vjetër dhe me kishën e saj të atëhershme, gjë që do të thotë se vendbanimi ka qenë i ngritur shumë kohë përpara vitit 1303. Nuk është e njohur se në ç'kohë, përpara përmendjes më 1303, ajo kishë ishte bërë qendër e famullisë dhe cilit shenjtor i ishte kushtuar. Besohet që popullata shumicë e Janjevës së kryehershme përbëhej nga sasë, të cilët edhe "ia jepnin ngjyrën jetës publike".[141] Njohësi i mirë i historisë së Ballkanit, K. Jireček vërente se ". .. me vendosjen në numër të madh të raguzasve, Janjeva e sotme do të jetë bërë qendër e famullisë në të cilën do të jetë vendosur edhe popullata e Janjevës së vjetër",[142] përkatësisht edhe popullata e vjetër sase.

Duket se arsyeja përse në dokumentin e vitit 1303 famullia nuk përmendet me emrin e vet, porse quhet gabimisht për e Graçanicës, duhet të kërkohet tek rrethana që vendbanimi i sasëve minatorë dhe i kishës së tyre (famullitare?) ishte ende i panjohur për nëpunësit e oborrit të Vatikanit. Ata do të kenë ditur (vetëm me të dëgjuar) se në afërsi të Graçanicës, përkatësisht të ipeshkëvisë bizantine-serbe Λιπενιον Λιπανίον të Lipjanit, kishte një enklavë katolike që e kishte një kishë dhe asgjë më shumë. Unë paravendoj që ka shumë mundësi që kolonia sase e Janjevës së kryehershme mund ta ketë pasur për distinktiv emrin e shenjtores **Agnes, a*/ të uzusit antroponimik të kishës së Perëndimit. Emri i kryehershëm i padëshmuar në burime i vendbanimit të sasëve mund të jetë përkthyer/adaptuar nga raguzasit sllavishtfolës pas vendosjes së tyre në masë në Janjevën e sotme. Kjo aq më parë pse emri/varianti *Janjevo* është me prejardhje sllave. Më parë se nga emri sllav *janj*, i cili në dalmatishten e sllavizuar /kroatishten do të thotë "plep", ndërsa në serbishten *jasen* "frashër" dhe "qengj", ky emër rrjedh nga trajta e adaptuar sllave *Janja* e antroponimit femëror *Agnesa*[143] i cili qenka në të vërtetë me prejardhje greke dhe e paska kuptimin "e dlirë, e papërlyer", por që më vonë gabimisht u lidh me fjalën latine *agnus* "qingj" (përkatësisht *agna, ae* "qingj femër"). Këtë emër e mbante shna Agnesa, Anjeza e cila portretohet me një qengj. Kjo shenjtore u martirizua në kohën e Dioklecianit (rreth vitit

[141] Gaspër Gjini: Ipeshvia Shkup-Prizren nëpër Shekuj, "Drita", Ferizaj, 1992, f. 84-85.

[142] Kështu mendojnë autorët Nikola Čolak-Ive Mažuran: *Janjevo*, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f.20.

[143] Sipas Nikola Čolak-Ive Mažuran, *Janjevo*, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 23.

300). Ajo nderohet për si patrone e virgjërisë.[144] Ka mundësi që kisha e kryehershme e sasëve t'i ketë qenë kushtuar shna *Agnes*ës në bazë të së cilës do të jetë quajtur edhe vendbanimi, emri Janjevo i të cilit, si adaptim kroat, përputhet kuptimisht me emrin e shenjtores.

Përmendja në vitin 1328 e famullitarit katolik të kishës së Janjevës,[145] përkatësisht e plebanit Stephanus Marci, nuk do të thotë ende se Janjeva ishte koloni e mbizotëruar nga raguzasit. Emri i këtij famullitari ose plebani është i gdhendur në mbishkrimin gotik IVNII HOG OPUS FECIT FI ERI PLEBANVS STEPHANVUS MARCI P. P. OP. TESA. A., për të cilin J. Georg von Hahn kujtonte se do të jetë vendosur në vitin 1427, ndërsa M. S. Milojević, mbase me të padrejtë, e konsideronte për të vitit 1327. Ky gur qenka gjetur, sipas I. Jastrebovit "gjatë kohës së ngritjes së kishës së sotme latine mbi themele të kishës së dikurshme pravosllave, i cili (gur) gjendet i murosur në murin perëndimor të kishës bukur lart mbi dyert e perëndimit nga jashtë", përkatësisht në murin e shkollës së vjetër të Janjevës.[146] Se këtu mund të kemi të bëjmë me një pleban/famullitar që shërbente në kishën (ende) të sasëve do të dëshmonte rrethana që Janjeva e sotme për famulli më vete me emrin *Ianeva* përmendet për herë të parë në vitin 1346, kur kjo (famulli) ishte nën juridiksionin e dioçezës së Kotorit.[147] Ndryshe, për si bashkësi/koloni e formuar e raguzasve, Janjeva përmendet, sipas burimeve raguzase, për herë të parë në vitin 1433.[148]

Në të mirë të pohimit se jo vetëm deri atëherë, porse mbase edhe më vonë, shumicën e popullatës së Janjevës e përbënin sasët, tregon edhe rrethana që për këmborën më të vjetër në kishën e sotme të Janjevës dihet se është punuar/derdhur në Gjermani, përkatësisht se ajo do të jetë sjellë këtu nga vendi i saj i lindjes. Ky pohim dëshmohet edhe me rrethanën që në trup të këmborës është edhe mbishkrimi gotik Mihael et ni colavs merecept 1368.[149] Kjo këmborë do të ketë qenë, siç e tregon dedikimi në vetë trupin e këmborës, në krye të herës në kishën e vjetër të sasëve që u dedikohej shën Mëhillit e shën Kollit dhe, vetëm më vonë, pas zhvendosjes së sasëve në truallin e ri të Janjevës, të mbisunduar tani numeri-

[144] Sipas Lutz Mackensen, Das große Buch der Vornamen, Wiesbaden, 1990, f. 215.
[145] Sipas G. Gjini, Ipeshkvia Shkup-Prizren..., f. 84.
[146] Nikola Čolak-Ive Mažuran: *Janjevo*, f. 21.
[147] C. Jireček, Staat und Gesellschaft. .., II, f. 66, 68. : "[...] *in Prisren, Novo Berda, Trepte* (lexo*: Trepce*), *Janeua, Coporichc, Plane* [...] **S**. *Marie de Prisren, S. Petri supra Prisren* [...]".
[148] Gaspër Gjini: Ipeshvia Shkup-Prizren nëpër Shekuj, "Drita", Ferizaj, 1992, f. 84-85.
[149] Sipas Nikola Čolak-Ive Mažuran: *Janjevo*, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 21.

kish nga raguzasit ardhës, do ta kenë sjellë me vete këmborën e kishës së tyre të kryehershme për ta vendosur në kishën e sotme. Vendosja e një këmbore të punuar në Gjermani paravendon ekzistimin ende të një bashkësie të fortë sase, e cila këtë kishë do ta ketë ndjerë për si të veten edhe pas zhdukjes së kishës së tyre në truallin e vjetër të Janjevës.

Është shumë e vështirë të besohet konstatimi tendencioz sllavomadh i studiuesit rus I. Jastrebov se "kisha e tanishme latine në Janjevë, në emër të Shën Kollit, dikur në kohë të moçme (S. G. paska qenë) kishë pravosllave",[150] përkatësisht ortodokse e tipit sllav. Kjo sepse ekzistimi jo vetëm i kishës katolike në Janjevë, porse edhe i atyre në kolonitë sase-raguzase të Novobërdës, Trepçës dhe i atyre në Letnicë, Vushtrri, Prishtinë etj. shpjegohet vetëm si rezultat i tolerimit të oazave katolike të huaja, si imperativ i politikës ekonomike të shtetit serb në ekspansion, të cilit nuk i konvenonte ta humbte burimin më të rëndësishëm të arkës së shtetit që e mbante gjallë nga koncesionet që atij për çdo vit ia paguanin tregtarët raguzas. Vështirë se ka ndonjë shpjegim tjetër përse nuk u prekën qytetet-miniera (edhe) të Kosovës sa kohë që shteti në ekspansion i Nemanjidasve "i kishte qëruar përfundimisht hesapet me katolicizmin, duke i lënë rehat vetëm vendbanimet tregtare sase-raguzase".[151] Kjo do të shihej qartë edhe nga rrethana pse pushtetmbajtësit serbë nuk e prekën enklavën katolike të Janjevës porse jo fort larg nga ajo sundimtari serb Stefan Urosh Milutini e ngriti manastirin e Graçanicës në një lokalitet jo katolik apo së pakut jo me numër mbizotërues të besimtarëve, të huajë, të ritit roman.[152] I njëjti skenar është ndjekur edhe në raste të tjera. Pushtetmbajtësit serbë nuk ngrinin kisha të tyre në Trepçe, porse në Banjskë; nuk ngrinin kishë të tyre në qytetet e Prizrenit, të Vushtrrisë, të Prishtinës e të Letnicës.

"Në një gur tjetër të gjetur po në këtë kohë në Janjevë, porse jo të murosur në mur, është ky mbishkrim latin: *Successo et Aelio agrippina ejus parentibus et ac aselepia de generoorum aeli ingenia et successa Agrippae licet innovanti ingeus genere durel aurelus Nepos. B. M. F. E. C. Havet Rosiae*".[153]

Praninë e sasëve dhe sllavizimin e tyre si rezultat i bashkëjetesës me raguzasit më të shumtë në numër dhe, po ashtu, besimtarë të ritit katolik e tregojnë mbetjet gjuhësore (për këtë më gjerësisht sh. më poshtë) dhe onomastike sase edhe në të folmen kroate të Janjevës dhe onomastikën e

[150] I. Jastrebov, Podaci za istoriju crkve u Staroj Srbiji,. .. f. 357.
[151] Sipas Nikola Čolak - Ive Mažuran: *Janjevo*,... f. 19.
[152] Poata, poaty.
[153] Cit. sipas I. Jastrebov, Podaci za istoriju crkve u Staroj Srbiji..., f. 357.

saj. E kësaj natyre është p.sh. edhe fjala *štona*, e përmbajtur në emrin e një pusi të minierës: "*a Stona in Jagneuo a Planize*" në të cilën një raguzas i quajtur Sergio Radosalich, mbase në gjysmën e parë të shek. 15, i zotëronte 70 pjesë të saj si edhe 8 pjesë në pusin e minierës *Ginouiza* (lexo Ginovica) në vendin *Planiza*,[154] që ka të bëjë me një mal, kodrinë të Janjevës. Për dëshmi, mbetje onomastike të sasëve në Janjevën e sotme mbahen edhe emri *Ceove* i vendit dhe emri *Grat* i kodrës (e quajtur nga popullata edhe *Grap*) në rrethina të kësaj qyteze.[155]

Marrjen e banorëve të Janjevës me xehetari edhe në shek. 16 e dëshmojnë edhe atributet *shafar* që e mbanin 2 banorë dhe *madenxhi* "minator" që e mbanin 4 banorë të bashkësisë së myslimanëve të qytetit të Janjevës.[156]

Janjevën si vendbanim-minierë e përshkruante në vitin 1610 edhe famullitari shqiptar, relator i Vatikanit, Marin Bici. Asokohe ky e kishte parë Jenjevën si vend […] "midis disa kodrinave të zgavrueme prej minierave t'argjantit që aty nxirret me sasi të madhe".[157]

2.1.4. Sasët në Pllakanicë

Plakanica ishte lagje e qytetit të Janjevës. Përmendet në vitet 1548 dhe 1566-1574 si lagje më vete që kishte 65 shtëpi.[158] Qysh në vitin 1548 qenka shënuar se në atë vend shpërlahej xehja. Mbi bazën e toponimeve të sotme *Pranje* dhe *Jezerce* kjo lagje është lokalizuar në rrjedhën e epërme të lumit të Janjevës.[159]

Një regjistrim i plotë i kryefamiljarëve të kësaj mahalle rrjedh nga fundshekulli 15. Asimoti, në këtë mahallë jetonin kryefamiljarët: Pop, i bir i Simonit; Noka, i bir i Osiqit; Matko, i bir i Dejinit; Raja, i bir i Dishinit, (Disha); Toshiq Stepani; Gjura, i bir i Osiqit; Marko Dokiqi; Dimsha, i bir i Armençiqit; Dimitri, i bir i Baliqit; Buçko, i bir i Jakut; Dos - Dusi, i bir i Oliverit; Gjoni, i bir i Milinit; Gjon, i bir i i Mihalit; Buçko Cu**rr**ak?; Boja Miluliqi ;Mikul Stepan, i bir i Budal(l)it; Krasi-

---

[154] Dëshmitë për burimet nga Drançolli, Raguzanët..., f. 66, fatkeqësisht pa përcaktim kohësor. Ka mundësi që kjo të jetë po ajo lagje e quajtur në shek, 15 *Plakanica*, khs. Muhamet Tërnava, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve 14-16, Prishtinë, 1995, fq 158.

[155] Sipas. M. Tërnava, Popullsia. .., f. 384.

[156] Khs. S. Puaha, Popullsia..., f. 552.

[157] Cit. pas Edi Shukriu, At Shtjefën Gjeçovi - arkeolog dhe mbrojtës i trashëgimisë kulturore, në Vjetar i Arkivit të Kosovës, XXXI–XXXII, Prishtinë, 2004, f. 296.

[158] Khs. Nikola Čolak-Ive Mažuran: *Janjevo*, f. 35; S. Pulaha, Popullsia., f. 553.; ljaz Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut tlë Vushtrrisë të vitit 1566/74, f. 106-107; Muhamet Tërnava, Popullsia e Kosovës., f. 158.

[159] Sipas Nikola Čolak-Ive Mažuran: *Janjevo*,. .., f. 35.

miri, i bir i Tolicës; Buçko pop; Tusha Tomashi; Jovan Kaçapori; Petri Doçi; Joka, i bir i Doçpetras; Stepko Gjergjilo; Poshino, i bir i Shumerusit ?[160]

Emri *Plakanica* lidhet me termin e xehetarisë që nuk është dëshmuar si apelativ "plakanica" ose "plakaonica", porse vetëm në funksion të nomen profesionis *plachaonizar* "mjeshtër për shpërlarjen, përkatësisht rafinimin e xeheve, sidomos të argjendit, por edhe të bakrit e të plumbit". Tetëmbëdhjetë kësi mjeshtrish, midis tyre mbase edhe shqiparët *Gonouich Andria* dhe *Mechxa*, përkatësisht *Miexa*, dëshmohen në minierën e Novobërdës në vitin 1438; një në Janjevë në vitin 1446 dhe një *Stepa, i bir i pllakanqarit* dëshmohet në mahallën e pop Liplanit të qytetit të Novobërdës në fund të shek. 15.[161] Trajta *plachaonizar* është një trajtë sllave, përkatësisht raguzase që po e heqka prejardhjen nga leksiku gjerman, por nuk është dhënë fjala konkrete gjermane nga e cila do të rridhte ky term.[162]

Ndonjë minierë apo pus miniere do të ketë pasur edhe në katundin e sotëm Plakanica, në perëndim të Leposaviqit. Në territorin e këtij katundi paska gjurmë që e dëshmojnë shkrirjen e fisnikërimin e xeheve. Ky vendbanim nuk është dëshmuar ndër shkrime për si koloni raguzasish ose sasësh. Kjo porse, si edhe rrethana se dëshmia më e lashtë e emrit të këtij vendbanimi, nuk është më e vjetër se fundi i shek. 18 përkatësisht viti 1766,[163] nuk kanë si ta përjashtojnë mundësinë që edhe ky vend të ketë qenë së pakut një pus miniere.

2.1.5. Sasët në Koporiq

Katundi i sotëm Koporiq i rrethinave të Mitrovicës dëshmohet për herë të parë në krisobulën e viteve 1313-1318 të sundimtarit serb Stefan Urosh Milutin për manastirin e Banjskës. Atëherë dëshmohet në trajtën *Koporići*[164] si edhe më 1566-1574 kur dëshmohet në trajtën *Koporik*,[165] përkatësisht ashtu që mund të lexohet edhe apo vetëm si Koporiq.

---

[160] Sh. Iljaz Rexha: Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës sipas defterit të fundshekullit XV, në Vjetar XXVII-XXVIII i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë 2002, f. 121-122

[161] Sh. I. Rexha, Regjistrimi., f. 67; J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë, f. 209.

[162] Sipas J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë, …, f. 209.

[163] Sh. J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Mitrovica, 8, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, Prishtinë, 2003, f. 201.

[164] Khs. Svetostefanska hrisovulja. .., f. 2.

[165] S. Pulaha, Defteri. .., f. 703.

Për si qendër e një kolonie të mirëfilltë të raguzasve e të sasëve Koporiqi dëshmohet më 1426, kur dëshmohet edhe kisha katolike e këtij lokaliteti, bashkë me ato të Prizenit, Janjevës, Trepçës etj.[166] Khs. tekstin në të cilin numërohen kishat katolike "[...] *in Prisren, Novo Berda, Trepte (*lexo*: Trepce), Janeua, Coporichc, Plane* [...]", të cilat i takonin ipeshkëvisë së Kotorit.[167]

2.1.6. Sasët në Çuka e Drashnjes

Një vend i banuar apo vetëm i shfrytëzuar për xehe nga raguzasit ishte edhe miniera sot e lënë shkret në lartësirën Çuka e Drashnjës (jo larg nga Orllani), emri i së cilës dëshmohet në gjysmën e parë të shek. 15.[168] Se edhe në këtë minierëz do të kenë vepruar minatorë sasë e tregon mbase qartë emri gjerman, sas *Shullcët* i një vëllazërie shqiptare, me banim jo larg nga Çuka e Drazhnjes. (Për këtë sh. më poshtë).

2.1.7. Sasët në Bellosicë (Murgull)

Një minierë-qytet, koloni raguzasish e sasësh ishte edhe Bellosica - vend përreth burimit të lumit Llap, sot lagje e katundit Murgull të komunës së Podujevës. Për si koloni e këtillë, që nënkupton pra edhe praninë domosdo të minatorëve sasë e të tregtarëve raguzas bashkë me gjyqtarë e me një konzul, ky vend përmendet për herë të parë në vitin 1423. Në këtë qytet raguzasit e instaluan më 8 korrik të vitit 1424 një konsullatë të përkohshme të tyre. Si edhe në Trepçe, Novobërdë, në Janjevë e mbase edhe në vendbanime të tjera më të vogla, edhe në këtë qytet kishte një koloni sasësh.[169] Në defterin e regjistrimit të kryefamiljarëve të pandehur për të viteve 1566-1574 emri i këtij vendbanimi dëshmohet (edhe) në trajtën *Blasnica*.[170] Se Bellosica ishte qendër me rëndësi, jo mbase sa edhe Trepça, e dëshmon rrethana që në krye të këtij qyteti kishte në vitin 1426 një qefali.[171]

Pandehet se në këtë vend kishte pasur një minierë nga e cila nxirrej ar e argjend. Kjo dëshmohet me rrethanën që midis viteve 1566-1574 në këtë vendbanim dëshmohet një kryefamiljar që e ushtronte zejen e

---

[166] Sipas Gaspër Gjini: Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj, f. 86.
[167] Te C. Jireček, Staat und Gesellschaft. .., II, f. 66, 68.
[168] Në këtë vend, përkatësisht në *Drasne* jetonte në gjysmën e parë të shek. XV njëfarë *Ruscho* - pas gjithë gjasësh një raguzas. Khs. M. Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I, Beograd 1957, f. 80.
[169] Khs. J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë. .., f. 25, 58.
[170] Khs. S. Pulaha, Popullsia. .., f. 703.
[171] J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë …, f. 59.

xehetarit dhe një *shafar* "kontrollues i puseve të minierave". Qenia e Bellosicës vendbanim-minierë dëshmohet edhe nga gjurmë të xehetarisë dhe nga disa emra vendesh në vendin edhe sot të quajtur Bellosicë, përreth vendburimit të lumit të Llapit. Në gjysmën e dytë të shek. 16 ajo ishte miniera më e vogël në gjithë hapësirën e sotme të Kosovës, rezervat e së cilës qenkan shteruar gradualisht pas shek. 15, kështu që në shek. 18 banorët e saj e braktisën këtë vendbanim dhe u vendosën nëpër kaundet përreth. Pushtuesit osmanë e kishin gjetur Bellosicën qytezë me lagje, me rrugë të shtruara e me dy kisha, ndërsa këta vetë ngritën aty edhe një xhami. Në vitin 1566 Bellosica ishte qendër e nahijes, andaj këtu e kishte selinë edhe mundiri, përkatësisht përfaqësuesi shtetëror turk.[172]

Karakterin prej një vendbanimi minierë të Bellosicës e tregon rrethana se në vitin 1438 p.sh. ndër borxhlinjtë të tregtarit raguzas Michael de Luchari përmendet edhe njëfarë *Milos Chratovac foxer in Bilasiza*[173] që ishte minator në minierën e Bellosicës. Gjykuar mbi bazën e mbiemrit të tij, rezulton se ky nuk ishte kosovar, porse një i ardhur nga Kratova. Përveç kësaj, edhe përroi, vendburimi i lumit Llap qenka quajtur **Lumi i minatorëve* dhe një udhë e prishur që në drejtim të jugut shpie për në Trepçë qenka quajtur po ashtu **Udha e minatorëve.*[174] Duket se kjo minierë nuk do ta ketë humbur rëndësinë e vet deri vonë, sepse udhëpërshkrues italianë dhe tregtarë venedikas të shek. 16. e 17 e quanin ende "*Montana dell' argento*".[175]

Një studim të zgjeruar për këtë "qytet" minatorësh e botoi në vitin 2005 edhe historiani i merituar i mesjetës së Kosovës M.Tërnava. Në mbështetje të burimeve që ky i kishte në dispoziocion konstatonte se vendbanimi përreth xeherores së Bellosicës, përfshirë këtu edhe shënimet që ishin dhënë përkitazi me shpërnguljet, ardhjet, rezistencën e banorëve të rinj, epidemitë etj., në vitet 1566-1574 këtu kishte, megjithatë, rreth

---

[172] Sh. Muhamet Tërnava, Bellasica gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVI, Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, Prishtinë, 35 / 2005, f. 312, 315, 318, 325.

[173] Khs. te M. Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I, f. 58.

[174] Khs. "Der Quellenbach des Lab oberhalb Belosica heißt noch immer Rupnička reka "der Fluß der Grubenarbeiter"; ein alter verfallener Weg südwärts nach Trepča Rupnički put "der Weg der Grubenarbeiter" [autori e citon Evans -in, Antiquarian reserches in Illyricum III-IV, 70] sh. Constantin Jireček: Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien Studien zur Kulturgschichte des 13-15 Jahrhunderts, III, Denkschriften des Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch-Historische Klasse, Band LVI, Wien 1912, f. 45.; khs. J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë., f. 63.

[175] K. Jireček, Trgovački drumovi i rudnici..., f. 286; 258.; Nikola Čolak-Ive Mažuran: *Janjevo*, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 16.

150 shtëpi, përkatësisht kryefamiljarë,[176] prandaj edhe e konsideronte këtë e jo qytezën e sotme të Podievës për qendër regjionale. Unë po i lë pasdore në këtë mes mendimet jo kompetente të historianit tonë në rrafshin e sqarimeve etimologjike sidomos përkitazi me prejardhjen e emrit *Sharban* i cili, duke qenë emër tipik i romanëve ballkanikë, përkatësisht i vllehve, vetëm në imagjinatën e *panalbanistëve*, si autori ynë në këtë rast, do të lidhej me emrin etnik të albanëve/arbërve.

Mua më duket se një dëshmi që nuk mund të lëkundet lehtë e bashkëjetesës potencialisht të mundshme shqiptare-sase qëndron në rrethanën se qyteti, vendbanimi në të cilin raguzas e sasë ishin vendosur me lejen e sundimtarëve lokalë serbë, do të ketë qenë që kohë më parë vendbanim i shqiptarëve. Këtë e tregon pikërisht emri shqip *Murgull* i katundit - në territorin e të cilit u ngrit lagja e sasëve ardhacakë. Dëshmia më e vjetër e përmednjes së këtij katundi rrjedh nga viti 1455 kur është regjistruar në trajtën *Murguli*[177] dhe kishte 15 shtëpi, një të vejë e 2 të pamartuar. Asnjëri nga kryefamiljarët e regjistruar nuk mbante ndonjë antroponim shqip.

Emri *Murgull* i katundit rrjedh nga fjala shqipe *mug* m., *mugë*, f. "gjysmerrësirë, muzg" e zgjeruar me prapashtesën shqipe *-ull* (nga lat. ballkanike *-ul*). Po ky zgjerim dëshmohet dhe tek trajtat *mugëll*, *mugëllon*; të mugulluemit fr. pouse, germe, germination, bou genoner" dhe tek *agull* "zbardhje e ditës" tek trajtat *agull*, *agullim*, (me) *agullue* etj. Tingulli *r* në trajtën Murgull të këtij oikonimi e gjen shpjegimin tek i njëjti proces që e ka rrokur trajtën *mjergull* në vend të *mjegull* të shqipes sikundër ka ndodhur edhe në të folmen arvanitase në Greqi ku fjala *mjergull* ndeshet edhe në trajtën *mjengull*. Emri Murgull i katundit të shqiptarëve do të mund të sqarohej edhe me fjalën shqipe *mugull* "filiz, bisk, lastar, fidan", me kusht që edhe këtu mund të paravendohet shtesa e bashkëtingëllores *r*.

Elementi etnik që ishte mikpritës i sasëve të ardhur minatorë ishin pikërisht shqiptarët të cilët katundin e tyre e kishin quajtur dhe vazhdojnë ta quajnë shqip Murgull

Po u gjykua vetëm mbi bazën e dëshmive të shkruara, do të pritej që element etnik sas paska pasur vetëm në qendra të mëdha xehetare të dëshmuara nëpër burime të shek. 13-15. Dhe këto burime, sikundër do të shihet edhe më poshtë, nuk përmbajnë edhe aq shumë material onomastik që ka të bëjë me qendrat e këtilla urbane-xehetare të mesjetës së vonë. Më shumë dëshmi onomastike sase gjenden në burime të shek. 15-16

[176] M. Tërnava, Bellasica gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVI, f. 303, 304, 307, 308.
[177] Khs. Oblast Brankovića..., f. 284.

edhe në disa vendbanime të Kosovës madje shumë shpesh shumë larg vedbanimeve të njohura si Novobërda, Trepça e Janjeva.[178]

Së këndejmi elementi etnik sas, përkatësisht gjurmët toponimike e antroponimike sase të Kosovës do të ndiqen më poshtë mbi bazën e të dhënave që përmbahen në disa burime raguzase të shk. 15 dhe në regjistrime të hollësishme turke të kryefamiljarëve e të pronave të shekujve 15-16 si edhe mbi bazën e mikrotoponimive, të emrave të vëllazërive e të oikonimeve që mua më dalin të jenë me prejardhje sase.

3. MIKROTOPONIME MESJETARE ME EMRIN ETNIK TË SASËVE

Prania e sasëve për në territorin e sotëm të Kosovës së gjysmës së parë të shek. 14 e më vonë dëshmohet dhe përmes disa mikrotoponimeve të cilat janë shënuar nëpër dokumente kishtare serbe. I këtillë është p.sh. dromonimi (emri i udhës) *Saški put* "Udha e Sasëve", i cili përmendet në vitin 1381 në një urdhëresë të knezit Lazar.[179] Sipas tekstit të urdhëresës, *Udha e Sasëve* nuk ishte larg nga katundi i sotëm Përlepnicë i rrethinave të Novobërdës. Popullata vendëse e quan sot këtë "*Udha e Frengut*". Kjo rrugë shpie për në Kumanovë. Në të mirë të këtij identifikimi shkon rre-

[178] Kjo mund të shihet qartë, përkundër vëllimit të vogël të lëndës onomastike që përmbahet në *Librin* e Michael de Luchari-t; edhe në dritën e faktit që këtu përmenden vendbanimet, përkatësisht puset, vendet me minerale si: *Raichouo Cholo* e *Nixino Cholo* (Lagjet e sotme Rekekollë e Nizhnakollë të katundit Marec rrënzë Novobërdës); *Heinouo Cholo* (katundi i sotëm. Hajnovc në komunën e Kamenicës), jo larg nga miniera aktive e magnezitit në Strezovc; *Sesarouich cholo* përkatëasisht *Cholo Sesarouichi de Negrimonte* dhe *Guxino Cholo* (katundet e sotme Shashar e Gushicë të komunës së Vitisë); *Ruplani* (nga sllav. rupa "gropë; pus miniere" - një vendbanim-minierë i zhdukur i cili pas gjithë gjasësh do të ketë qenë në regjionin midis Novobërdës, Kamenicës e Gjilanit; minierat *Kilaua* e *Plavica* në afërsi të drejtpërdrejtë të Novobërdës (khs. M. Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I, f. 74, 88, 39, 76, 83, 80); emrat e dy minierave të vogla *Slavna* e *Slavomir* jo larg nga Trepça (sh. K. Jireček, Staat und Gesellschaft..., III, f. 45); Mësohet se, sipas testamentit të bujarit raguzas Junii J. de Sorgo të dt. 9 shtator 1409 që kishte vdekur në Trepçë, ky kishte qenë bashkëpronar i të dyja këtyre puseve, khs. J. Drançolli, Raguzasit në Kosovë. .., f. 142-143.; *Pikine* - ndoshta maja e sotme e malit Picel të katundit Bajgorë të Mitrovicës etj. Nëse këtu i inkuadrojmë edhe mikrotoponimet e tipit *Samokova* (nga sllav. *samokovь* " Stabiliment që punon me ujë për thërmimin dhe shkrirjen e xehes së hekurit e të mineraleve të tjera; "shkrijetore me fuqi të ujit", gjerm. "Hammermühle, Hammerwerk, Wasserhammer", çfarë ka nëpër shumë vende të Kosovës, atëherë do të rezultonte që numri i vendbanimeve të këtilla të përkohshme të minatorëve sasë do të ketë qenë mbase fort më i madh se ç'del nga burimet e shkruara.

[179] Khs. Fr. Miklosich, Monumenta serbica…, Wien, 1871, f. 198: "*na vrьhь stražšta saskimь putemь*" " Në majë të Strazhishtës nëpër Udhën e Sasëve".

thana se në këtë katund është dhe mikrotoponimi *Tërgovishta* "Tregu", i cili e dëshmon ekzistimin këtu në shek. 15 dhe para kësaj kohe të një tregu dhe që ky pas gjithë gjasësh nuk ka si të mos lidhet me kështjellën *Prilepac* dhe me aktivitetin xehetar e tregtar të sasëve, përkatësisht të raguzasve.[180]

Një dëshmi tjetër toponimike që lidhet me emrin etnik të sasëve gjendet edhe në krisobulën e sundimtarit St. Dushan të vitit 1348 për manastirin e shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit. Këtu, ndër vende që përbënin kufijtë e katunit *dragoljevci* (katundi i sotëm Dragolevc/ Drugulevc i komunës së Istogut), përmendet edhe emri i kroit *sasinov studencь*[181] "Kroni i Sasit" - emër ky që qenka ruajtur deri në ditët tonat.

Sado që nuk e ndjej veten kompetent të shfaq ndonjë mendim nëse edhe në vendet e quajtura *Samakovë* dhe nëpër vendet që në shek. 15-16 për pjesë të dytë të emrave të tyre e kishin ndajshtesën *cholo* përkatësisht *kolo* "pus miniere",[182] duhet domosdo të ketë pasur popullatë apo mjeshtër sasë, më poshtë po e sjell një pasqyrë të shtrirjes së mikrotoponimeve dhe të oikonimeve të këtij tipi[183] dhe pikërisht: në territorin midis dy minierave aktive: të Novobërdës e të Strezovcit, përkatësisht në lagjen Bullovit të Marecit; në kompleksin

[180] Këtij identifikimi i del krah edhe rrethana që disa dijetarë kujtojnë se njoftimet që vijnë në shek. XV përkitazi me qytetin apo kështjellën (khs. M. Dinić, Trepča u srendjem veku, Prilozi za književnost, jezik, istoriju i folklor, 33 /1967, f. 6. ose ndoshta edhe njoftimet më të besueshme) kanë të bëjnë me këtë katund të sotëm. Mbase pikërisht në dritën e dëshmimit më 1424 si Castrum Prilepac prope Nouam Berdam, e ka shtyrë dijetarin serb M. Dinić (khs. Za istoriju rudarstva..., f. 34) që këtë ta lokalizojë gabimisht në territorin e katundit Bozhevc afër Novobërdës (khs. edhe K. Jireček - J. Radonić, Istorija Srba II, f. 94).

[181] Sh. Hrisovulja cara Stefana Dušana koiomь osniva monastirь Sv. Arhangela Mihaila i Gavrila u Prizrenu 1348 godine?, Glasnik Društva Srbske Slovesnosti 15 (1862), f. 300. Pikërisht në katundin Dragolevc po ekzistuaka, sipas J. Osmani, Venbanimet e Kosovës 12, Burimi (Istogu), Prishtinë, 2004, f. 95, vend i quajtur *Kroni i Sasit*.

[182] V. Simić, Rudarstvo i prerada gvožđa u toponomastici i terminologiji Vlasinskog kraja, në Onomatološki Prilozi I, Beograd, 1979, f. 91, ky term e paska kuptimin e çarkut, rrotës së vendosur vertikalisht me të cilën rrotulloheshin stabilimentet e quajtura serbisht *mehovi* dhe të stabilimenteve në shkrijetoret dhe ato të farkimit të hekurit. Deri në fund të shek. XIX, ky stabiliment qenka quajtur në Majdanpek thjesht *točak* "rrotë, çikrik".

[183] Megjithatë, në dritën e sqarimit se me termin *vatrok* kuptohej personi që e blente xehen e nxjerrë nga minatorët dhe me shpenzimet e veta e organizonte shkrirjen e tij; zotërues i një fonderie (më gjerësisht sh. ref. 40) do të dilte që, së pakut jo të gjitha vendet e quajtura *Samokovë* "shkrijetore të improvizuara, të përkohshme; të lëvizshme" jo domosdo duhet të jenë të lidhura pikërisht dhe vetëm me sasët e me raguzasit, porse që ato mund të kenë qenë edhe ndërmarrje të vendësve.

afër rrafshnaltës Bare 2 km afër kompleksit Rapuha të Krilevës dhe në vetë qendrën e këtij katundi (khs. mtp. *Ara e Samakovës*) dhe në pikën kufitare midis katundeve Prapashticë, Marec, Gllogovicë e Krilevë, në vendin e quajtur *Roga e Verdhë* paska vende në të cilat po u shihkan mbeturina mineralesh të copëtuara apo të shkrira.[184] Këtu do të binte edhe vendi i quajtur *Samakovë* në hyrje të lagjes Suteskë të Mramorit, i cili në defterin turk të viteve 1566-1574 dëshmohet si *Samoko.*[185] Të këtilla në këtë regjion janë edhe mikrotoponimet *Lugu i Samakov's* në katundin Prapashticë dhe vendet në të cilat paska skorje si në lagjen e Vrajollëve të Marecit jo larg nga Kështjella e Novobërdës në të cilat po u shihkan madje edhe gjurmë të kolonisë së sasëve si edhe në lagjet Metevit "Metajt" dhe në kompleksin e quajtur *Hantinabari* të lagjes Gërbesh të katundit.[186] Vende që mbajnë emra të cilët e dëshmojnë marrjen e banorëve vendës apo të të adhurve me zejen e xehtarisë në rrethina të Trepçës ka edhe në katundin Rahovë të Mitrovicës, ku gjallojnë edhe sot mikrotoponimet *Kërshi i Samakovës, Majdani* nga arab. *majdän* "xeherore", turq. *maden* dhe, duke e paravenduar ndikimin e etimlogjisë popullore të njësimit të ermit *cholo* "pus miniere" me turq. *kulla* "kështjellë", edhe mikrotoponimi *Kulla* në kodrën e quajtur Majdani. Një vend i quajtur *Majdani* është shënuar nga J. Osmani edhe për në Stantërg.[187]

Vende të quajtura *Samakovë,* ka edhe në katundet Gragjenik e Gjyrishec të Kameincës. Në katundin Sedllar të kësaj komune ekzistojnë edhe sot mikrotoponimet *Samakova* dhe *Prroni Samakovës* si edhe në katundin Kremenatë ku janë mikrotoponimet *Prroni Samakovës* dhe *Te Valavica*. Mbeturina mineralesh të shkrira gjenden edhe në vendin Kallavari të katundt serb të Kllobukarit, komuna e Novobërdës. Vende me gjurmë mineralesh të shkrira, të quajtuara po shtu Samakova, ka edhe në katundet Lisockë e Krilevë të komunës së Kamenicës. Vende me skorie mineralesh të shkrira, apo të samakovave - siç i quajnë gjithandej - ka edhe në katundin Gmicë të Kamenicës, ndërsa gjurmë miniere ka edhe në katundin Velegllavë të Kamenicës. Këtë e dëshmojnë mikrotoponimet *Gropat e argjanit* dhe *Rogat e argjanit*, për të cilat popullata shpjegon se

[184] Sipas Qazim Namani, Lashtësia iliro-shqiptare në Malësinë e Gallapit, VJETAR i Arkivit Kombëtar të Kosovës, 29 - 30, Prishtinë, 2003 f. 47-48.
[185] Sh. M. Tërnava, Popullsia, f. 71.
[186] Të shënuara në terren nga Ali S. Berisha, Gallapi i Prishtinës, 2007, Dorëshkrim.
[187] Sh. Vendbanimet e Kosovës 8, Mitrovica, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potku, Prishtinë, 2002, f. 104, 112.

ishin miniera.[188] Si gjithandej nëpër Kosovë, edhe këtu këta grumbuj mbeturinash të xeheve quhen Samaokovë. Me fjalën *samakovë* / *samokovë* popullata shqiptare i kupton grumbujt e mineraleve të copëtuara a të shkrira dhe jo ndonjë stabiliment në bazë të punës së të cilit blloqet, copat më të mëdha të mineraleve janë copëtuar e shkrirë. E pra, kjo fjalë rrjedh nga sllavishtja *samokov* fjalë për fjalë "që farkon vetë" dhe ishte "mjet, stabiliment me forcë të ujit për farkimin e hekurit dhe të xeheve të tjera; farkëtore e vënë në lëvizje përmes ujit; Në vise të sllavëve të jugut përmendet edhe para pushtimit turk", ndërsa shkurt pas kësaj periudhe për në hapësirën e Bullgarisë së sotme i përmend edhe humanisti kosovar Martino Segano (i vdekur në vitin 1485) " perlustratis Samocovi silvis et vastis solitudinibus Haemi".[189] Për ilustrim sillen dëshmitë nga burimet në të cilat është shkruar: *Këtu është (uji) që i sillte samokovat, të cilat farkonin hekur; Ka samokov për farkim të xehes.* Në Fjalorin e Shulekut kuptmi i fjalës *samokov* është dhënë në gjermanisht si *Hammermühle* (*Hammerwerk*; magna; *samokov za plasu Brechhammer*; samokovë me ujë "*Wasserhammer*"; samokovë për hekur "*Eisenhammer*"[190] Sipas këtyre shpjegimeve del se *samokova*: ishte stabiliment i ngjashëm me dërstilën që me forcën e ujit vente në lëvizje çekanë për t'i copëtuar xehet. Këtë ide na e bën të kuptueshme fjala *Hammer* "çekan" që përmbahet në korrespsondentet gjermane *Wasserhammer* "Çekanë të vënë në lëvizje me ujë" *Hammer*mühle "mulli me çekanë" të fjalës sllave samokov.[191] Nga puna në terren më ka rënë të shoh se shumica e vendeve të quajtura Samokovë edhe ndodhen buzë përrenjve, përkatësisht përrockave e lumenjve. Një vendbanim i quajtur *Samokov* dëshmohet në regjistrimin e viteve 1566-1574,[192] mirëpo ky nuk është identifikuar në terren, ndërsa sot nuk ka ndonjë oikonim që do ta mbante këtë emër.

Karakterin vendbanim-minierë të disave nga katunde të krahinës së Gallapit e të asaj të Karadakut e dëshmojnë emrat mesjetarë të vetë këtyre katundeve, kur këta e kishin për pjesë të dytë fjalën *cholo* për-

[188] Këta emra vendesh janë shënuar në terren nga Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 13, Dardana (Kamenica) dhe Artana (Novobërda), Prishtinë, 2004, f. 100, 103, 110, 135, 141, 146, 168, 183, 220.

[189] Khs. Agostino Petrusi: Martino Segano di Novo Brdo, Vescovo di Dulcigno (Un umanista serbo-dalmata del tardo Quattrocento), Vita e Opere, Roma, 1981, f. 94-95.

[190] Sqarimet sipas Oblast Brankovića. .., f. 358.

[191] Ky term i kishte [sipas V. Simić, Rudarstvo i prerada gvožđa u tponmastici i terminologiji Vlasinskog kraja,. .., f. 94] dy kuptime: kuptimi primar ishte shenjimi i stabilimentit për shkrirjen dhe për farkimin e hekurit lëndë e parë dhe shndërrimin e tij në mall ndërsa kuptimin e dytë (nga shek. XVII e këndej) e kishte çekiq i madh i vënë në lëvizje me forcën e ujit për farkimin e hekurit.

[192] S. Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjate shek. XV-XVI, Tiranë, 1983, f. 691.

katësisht *kolo* "pus miniere". I këtillë ishte p.sh. edhe katundi i sotëm Gushica i komunës së Vitisë, ku është lokalizuar kështjella *Labutza* e rindërtuar nga Jusitiniani.[193] Ky katund është shënuar në vitin 1438 si *Guxino cholo*,[194] ndërsa më 1566-1574 si "*Katundi Gushino*" dhe *Grushino*[195] përkatësisht *Gushina Kulla*.[196.] Të kësaj natyre janë edhe emrat *Nixino Cholo* i vitit 1438 dhe i dëshmuar edhe më 1566 -1474 si *Nikshina Kulla*[197] dhe *Raikouo Cholo* që kanë të bëjnë me lagjet e sotme Nizhnakollë e Rekekollë të kaundit Marec rrënzë kështjellës së Novobërdës si edhe vendi *Sirze Cholo*[198] (lexo Sirce Kollo) që nuk mund të mos ketë qenë në territor të katundit të sotëm Sfircë, andej e këndej kufirit administrativ midis Kosovës e Serbisë. Megjithatë, ka shumë arsye të besohet se pusi i minierës së quajtur *Sirze Cholo* mund të identifikohet me vendin Trepana të pjesës së Sfircës që i takon Kosovës.*

Me vendbanime të tipit mesjetar: vendbanime-miniera të krahinave të Gallapit e të Karadakut kemi të bëjmë mbase edhe në vendet *Gjurgjeva Kulla*, vendbanim i braktisur dhe *Ivanov Kulla*** në nahijen Bugarina[199] që e përfshinte territorin midis katundeve Mramuer e Marec të viteve 1566-1574; *Ravna Kulla*, e braktisur, *Litovça Kulla*, *Martinova Kulla* dhe *Stanimirova kulla* në nahijen Kara Tonlu,[200] përkatësisht Karadak "Mali i Zi", të cilat ende nuk janë identifikuar në terren; me vendin e dëshmuar në defterin e regjistrimit të viteve 1566-1574 në trajtën *Umurova Kulla*[201] dhe sipas një transliterimi tjetër si "*Katundi Omurova Kulla*",[202] të cilin unë e kam identifikuar me kompleksin e tokës të quajtur *Murakova* midis katundeve Mirash e Rahovicë të Ferizajt në të cilin (kompleks) ka gjurmë të një vendbanimi ku është nxjerrë apo vetëm është përpunuar edhe xehe. Duket se riemërtimit të propozuar nga Komisioni i Standardizimit të

[193] Khs. Edi Shukriu: Gradina e Gushicës dhe Municipiumi Labutza, Vjetar XVII-XXVIII i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë 2002.
[194] Khs. M. Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I, 72.
[195] Khs. M. Tërnava, Popullsia. .., f. 60.
[196] Khs. Selami Pulaha, Popullsia. .., f. 695.
[197] Po ai, po aty. .., f. 695.
[198] Sh. M. Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I, f. 42.
* Në këtë pjesë të katundit gjenden mbeturina tjegullash. Kujtoj se emri Trepana vetëm krejt rastësisht mund të afrohet me fjalën turke taraphane "vend i prerjes së monedhave", sepse nuk ka kurrfatrë mbështetje që në këtë vend të ketë pasur ndonjë taraphane.
** Kështu është e shkruar tek S. Pulaha, Popullsia, f. 698.
[199] Khs. Selami Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës, f. 698.
[200] S. Pulaha, po aty, f. 712.
[201] Po ai, po aty, f. 711.
[202] Khs. M. Tërnava, Popullsia, f. 110.

Toponimeve të Kosovës të katundit Svërçin / Surçin për Murakaj[203] i mungon përputhja territoriale. Në dritën e trajtave paraturke *Cholo* dhe të atyre aktuale *koll,ë -a* dëshmohet mbase bindshëm se po këta emra të transliteruar nga orientalistë tanë si *kulla* nuk kanë të bëjnë gjë me fjalën me prejardhje turke *kullë,-a* "kështjellë; fortesë", porse duhen parë vetëm si transliterime të gabueshme të termit sllav të minierave *kolo* "pus miniere". Mbase nuk është fort e guximshme të paravendohet se edhe emri *Kollë* i katundit të komunës së Vushtrrisë i dëshmuar në defterin turk të viteve 1566-1574, të cilin edhe M. Tërnava[204] e ka transliteruar si *Kulla*, do ta heqë prejardhjen nga kjo fjalë dhe se edhe në territorin e këtij katundi do të ketë pasur dikurë një pus miniere, emrin e të cilit nuk e dimë ende.

Është me rëndësi të vërehet se hapësirat përreth puseve të minierave larg kolonive të raguzasve e të sasëve ishin të banuara dendur nga popullata shqiptare. E këtllë na del p.sh. gjendja në shumë vendabnime-puse minierash, sot të panjohura me ata emra, banorët e të cilëve në fundshekullin 15 nuk kishin as ndonjë antroponim sas e as ndonjë *nomen profesionis* të krijuar me ndonjë fjalë gjermane, gjë që do të tregonte se banorët aktualë të atyre vendbanimeve të fundshekullit 15 nuk merreshin më aktivisht me xehetari. Kështu, p.sh. në pusin e shënuar në fundshekullin 15 për katund më vete të quajtur *Kollo Avranos* (Evrenos) në nahijen Karatunlu (sot Karadaku i Gjilanit/Karadaku i Shkupit) jetonin, midis të tjerësh, edhe shqiptarët: Nika Lika; Mil Vlashi; Mihal Gjoni; Petri Gjoni, Mihajl Lika e Nika Gjona.[*] E këtillë është gjendja edhe në katundin, përkatësisht pusin *Kollo Martinova* ku jetonin banorët: Bogdan Niko, Radic Magarac, Radeta Radosavi, Gjinesh Lopçari, Jovan Radosavi, Nikolla Berjoni?, Radosav Radmili, Stepan Boja, Vukashin Zagorec,[*] Mark Gjurini, Bozhiq i vëllai i Miliqit, Radivoji skamnor, Branko Radic, Rajini i vëlla i Vukashinit dhe e veja Jovana; në vendbanimin pus miniere *Stanimir* jetonin Dimitri Vlladisavi, Jovan Vukashini e Nikolla Dançuli dhe të vejat Daca, Radota, Olivera dhe Radosava.; në vendbanimin pus miniere *Kolo Janova* kishte vetëm tri shtëpi me kryefamiljarë: Oliver, lopçari; Nikola Oliveri dhe Nikola Petro; në vendbanimin pus miniere *Kolo Ujranoviq* ishin kryefamiljarët Jovan

[203] Khs. Dr. Jusuf Osmani, Vendbanmet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpca, Prishtinë, 2004, f. 104.

[204] khs. Popullsia, f. 93.

* Mendoj se do të ishte më e drejtë që ky emër të lexohej si Gjoni.

[*] Nëse ky transliterim është i besueshëm, atëherë ky emër do të jetë një dëshmi e formimit të një mbiemri me prapashtesën *-ec*, tipike për bullgarshten, përkatësisht dëshmi për praninë e një bullgari në Kosovën e asaj kohe.

Vraja, Lika, i vëlla i Jovanit, Andreja, i vëlla i Markut, Leshjan Gjona, Tomash Leshjani, Petri Leshjani, Petri Mihaili, Petri Jovani, Mark Milini.[205] Rrethana që në këto vende nuk kishte më njerëz me antroponime sase e dëshmon korrektësinë e konstatimit të pranueshëm të K. Jirečekut se tërheqja intensive e sasëve nga minierat kishte filluar menjëherë pas pushtimit turk të qytetit të Novobërdës. Kujtoj se vetëm kështu mund të sqarohet rrethana përse banorët e vendbanimeve të këtij tipi në fundshekullin 15 ishin të banuara vetëm nga vendësit.

4. SASËT NË DRITËN E ANTROPONIMEVE

Dëshmitë më të vjetra të patronimeve të sajuara nga emri etnik i sasëve gjenden në Krisobulat e Deçanit të vitit 1330. Këtu, për në katundin mesjetar *seroš* dëshmohet banori i quajtur *sasinь inoševikь* dhe një banor i quajtur *toloje sasinovikь* i katundit *čabikь* (sot - Çabiq, në komunën e Klinës).[206]

Po ndodhi të ketë të drejtë, këtu do të duhej të inkuadroheshin, sipas M. Pavloviqit[207] edhe antroponimet *Altoman*, *Rudl* e *Toloje*, të cilat gjithashtu dëshmohen në këto krisobula. Në të mirë të korrektësisë së paravendimit të këtij dijetari do të shkonte mbase rrethana që, vështruar edhe në aspektin jashtëgjuhësor, antroponimet e këtilla dëshmohen në zonën midis Prizrenit, Gjakovës e Deçanit në të cilën për në mesjetë është dëshmuar truallishta e një vendbanimi të "shpërlarësve të arit". Ky vend ndodhej, sipas tekstit të krisobulës së vitit 1348, në hapësirën midis katuneve Medvec, Mamushë, Retijë e Piranë midis Suharekës e Prizrenit[208]

---

[205] I. Rexha, Regjistrimi …, f. 155.

[206] Miloš S. Milojević, Dečanska hrisovulja..., f. 53-54: A se drugii katunь […] sasinь inoševikь…, "dhe katuni tjetër […] sasi Inoševik". Meriton të merret në konsideratë mendimi i Mih. J. Dinić, Za istroiju rudarstva …, I., f. 9, ref. 49 dhe f. 13, referenca 52 sipas të cilit në këto raste nuk kemi të bëjmë me sasë të mirëfilltë etnikisht, porse me minatorë vendës të cilët qenkan quajtur kështu si rezultat i rrethanës që emri *sas* e kishte marrë funksionin e nomen professionis, "xehetar, minator" i cili do t'u jetë dhënë edhe minatorëve vendës. Kjo aqë më pare pse nuk ka dëshmi që në Rrafsh të Dukagjinit do të ketë pasur miniera të shfrytëzuara nga sasë të mirëfilltë dhe pse ambientet në të cilat dëshmohet antroponimi *sasin* dhe patronimi *sasinovik* ishin vendbanime meropsësh, përkatësisht bujqrobërish. Kjo edhe për arsye se në gjysmën e pare të shek. XIV, të gjitha funksionet e rëndësishme në fushën e xehtraisë në Novobërdë i paska kryer në të vërtetë popullata vendëse.

[207] khs. Altsächsische Bergbauterminologie…, f. 77.

[208] Khs. tekstin origjinal në Hrisovulja..., f. 279: *Selo mєdvěd'cь. a megja mou ѡt momouše. ѡt topolouhe ou kamы, tєrє ou bělěgь svetogrorьskыi. ѡt kamєna ou brьdo posrěd d'mitrova dola do rětivlje. i po dělou nis poutь na zlatarьska sєliš'ta ou kamы.* "Katundi Medvec dhe kufini i tij me Mamushën nga Toplluha e në shkamb, pastaj tek

dhe në të cilën ndodhet miniera e Devës, në rrethina të Gjakovës.

Më shumë material të kësaj natyre përmbajnë Testamenti i tregtarit raguzas Gostisse Brathoslaglich (lexo Gostiša Bratoslaljić) i vitit 1411 dhe Libri i borxhlinjve i tregtarit Michael de Luchari që kishin jetuar e punuar në qytetin mesjetar të Novobërdës. *Libri* i këtij të fundit do të jetë përpiluar, pas gjithë gjasash, midis viteve 1435 e 1438 dhe ka të bëjë me aktivitetin afarist të këtij tregtari në Novobërdë e në rrethinën e saj të gjerë. Midis borxhlinjve të tregtarit Gostisse Brathoslaglich ishin edhe personat *Pometcho Erich*, Ratcho *Rafina* e *Chanzo Chatusich* ndërsa përmendet edhe gjyqtari *Johannes* de Volcio. Këta persona i mbajnë antroponimet gjermane *Erich*, *Hanz-o* e *Johann* si dhe mbiemrin Rafina, prejardhjen e të cilit unë nuk e ndjej veten të zotin ta sqaroj.

Në Librin e Michael de Lucharit përmendet edhe një banor që mbase ishte pronar i pusit në vendin *Raichouo Cholo* (sot Rekekollë në katundin Marec, në rrënza të Novobedës) i qajtur *Guriza Sasinouich*.

Një mbiemër të dalë nga emri etnik i sasëve e mbante mbase edhe banori *Lazar* [*]*Sasaroviq*, edhe nëse këtu kemi të bëjmë me një person të ardhur nga katundi sot Shashar i komunës së Vitisë khs, [...] "*Stepan Dimitrouich vauturach de Negrimonte in cholo Sesarouich de Negrimonti*"

Të përkatësisë etnike sase ishin edhe personat *Bogossau Hanzouich* i katundit të sotëm Stojanovc (në Libër: *Stoianouzi*) afër Novobërdës dhe banorët *Martin Hanzouich*, *Pauao Hanzouich*, *Tanus* (... che ira fante. ..) *Hanzo* e pas gjasësh edhe banorët *Haidin Andrich*, *Pometcho Hainoga* dhe personat që për mbiemër e kishin emrin etnik gjerman në trajtën italiane *Theutonicus* dhe personat e quajtur *Changius*. Duket se po ky antroponim, porse në një trajtë tjetër, dëshmohet edhe në një dokument të vitit 1418, në të cilin raguzasi Baro Lukareviq i përgjigjej kontit Herkules Este nga Ferrara, se në Novobërdë janë dy minatorë fort të vyeshëm: Nochola Hanze (Change) e Zan (Gan) Lapor.[209]

Duket se praninë e sasëve në qytetin e Novobërdës, përkatësisht në katundet përreth tij, e dëshmojnë edhe kryefamiljarët, disa nga të cilët ishin edhe pronarë bashtinash, që e mbanin mbiemrin me prejardhje gjermane *Shliman*. Të këtillë ishin Gjura *Shliman*-i, banor i mahallës Pop Dimitri Gerinoviq; Gjura *Shliman*-i në lagjen Pop Filipi të Novobërdës;

guri i mexhës i (pronave) të Malit të Shenjtë (SG: Athos, në Greqi). Nga Shkambi e në kodër mespërmes Lugut të Dimitrit deri tek Retimja dhe nëpër mal udhës teposhtë tek Truallishtat e rrëmihësve të arit e në Shkamb".

[209] M. Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I., f. 27, 28, 29, 44,74, 76.dhe M. Dinić, Trepča u srednjem veku, f. 9-10.

Shliman quheshin edhe dy pronarë bashtinash në katundin e sotëm Krilevë të rrethinës së Novobërdës[210] që përmenden në fund të shek. 15.

Një vendbanim i vogël, paralagje e qytetit të Novobërdës ishte edhe mahalla Inoshiq (Noshiq?), e cila ende nuk është identifikuar në terren. Ka mundësi që ky emër të jetë ruajtur në emrin e ndonjë vëllazërie të katundeve përreth qytetit mesjetar të Novobërdës. Ka shumë arsye të besohet që vendi përbrenda kësaj lagjeje të ketë qenë së pakut ndonjë pus miniere, përkatësisht të ketë jetuar aty edhe një apo më shumë minatorë. Sa kohë që një banor i kësaj lagjeje në vend të mbiemrit të bazuar në vijën e gjakut, e mbante ofiçin *plakaniçar* "shpërlarës i arit, i xehes" duhet besuar se ky vend ishte vendbanim minatorësh. Edhe rrethana tjetër, përkatësisht që në këtë lagje ishte një banor me patronimin sas *Hans*, përkatëshisht *Nikola* Hanc* do të tregonte se kjo lagje banohej edhe nga minatorë sasë apo nga pasardhës të tyre. Në këtë vendbanim jetonin edhe banorët Boja *Tanovac* e Petro *Arnaut*-i të cilët pas gjithë gjasësh do të kenë qenë banorë shqiptarë vendës. Po të jetë kështu, edhe këtu do të dëshmohej një shembull i bashkëjetesës shqiptare-sase. Duke qenë se një banor i Mahallës së Pop Nikolla Liplanit të qytetit të Novobërdës e mbante ofiçin *plakançar* "shpërlarës i arit, i xehes" (khs. edhe banorin Nikolla, i bir i *hutman*-it të kësaj lagjeje) duhet besuar se edhe kjo lagje ishte vendbanim minatorësh. Edhe rrethana tjetër, përkatësisht ajo që në këtë lagje ishte një banor me patronimin sas *Hans*, do të tregonte se kjo lagje ndodhej më afër bërthamës së qytetit mesjetar të Novobërdës. Në tri lagjet e mësipërme të Novobërdës nuk kishte kësokohe mbiemra apo ofiqe me prejardhje sase që tregojnë zeje.

Ka shembuj të tjerë të kësaj natyre. I këtillë është rasti me antroponimin sas, përkatësisht gjerman *Gerhard* i shkruar edhe si *Gert* në trajtën e tij përkëdhelëse *Gerd-* përkatësisht *Gerdat-* (khs. më lart *Gon Gerdatich*), i cili në këtë burim dëshmohet edhe në trajtën *Gerdal*.[211] Nuk kemi asnjë dëshmi nga terreni për vazhdimësinë e këtij antroponimi nga popullata shqiptare e kësaj pjese të hapësirës së saj etnolinguistike. Mirëpo ka një dëshmi shkrimore të vitit 1455 që tregon se edhe shqiptarët, apo pikërisht vetëm këta, e mbanin edhe antroponimin *Gerd-*. Dëshmia e vitit 1455 rrjedh nga një vendbanim bukur larg nga hapësira që e mbulon *Libri* i tregtarit raguzas. Në atë burim të vitit 1455 dëshmohet se antroponimin *Gerd-* e mbante banori *Gerdaš*, *Arbanas*-i, i tregut të Obicës në

[210] I. Rexha, Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës, 71,113.

[*] Botuesi i defterit e lejon mundësinë që ky emër të lexohet edhe si *Hanc* khs. I. Rexha, Regjistrimi...,. f. 65.

[211] M. Dinic, Iz Dubrovačkog Arhiva I, f. 44.

rrethina të Ferizajt,[212] i cili ose ishte blegtor që me lang e plang ishte zhdjergur në një vendbanim fushor ose ishte thjesht "shqiptar". Banori *Gerdaš Arbanas* jetonte në tregun, vendbanimin e zhdukur Obica[213] të rrethinës së Ferizajt. Paravendimi se shqiptarët e kësaj ane e mbanin në shek. 15 edhe antroponimin *Gerd-*, mund të jetë i pranueshëm nëse trajtat e dëshmuara në *Libër*: *Gerdat* e *Gerdal* s'janë tjetër veçse trajta deminutive të temës emërore *Gerd-* të zgjeruara me prapashtesa të tjera në krahasim me trajtën *Gerdaš* të dëshmuar në vitin 1455.

Duket se një emër gjerman, përkatësisht sas e mbante edhe banori Vlaia de Gon *Godin* për të cilin në Librin e patricit raguzas M. de Lucari nuk ka ndonjë shënim se prej ç'vendi ishte. I ati i banorit me emrin sllav Vlaia, që ishte i bir i Gjonit, e mbante paronimin sas *Godin.*[214] Po më 1388 dëshmohen edhe "*Nikolich Iuregouich de Nouaberda nepos Martin Vriglia Changi. .. Trossani de Nouaberda testibus*, përkatësisht "para dëshmitarit Nikolich Juregoviq nga Novabërda, dëshmoi i nipi i *Martin Vriglia*-s *Changio nepote Trossani* nga Novabërda". Për këta në dokument nuk thuhet shprehimisht se ishin sasë por, sipas M. Diniqit në bazë të emrave, po dalka se Martinus Verglia, e posaçërisht *Changius*, paskan qenë sas.[215] Ky mendon që *Changius* mund të jetë ndoshta borxhliu Chanzo Chatusich i tregtarit raguzas Gostisse Bratoslaich i vdekur në Novobërdë në vitin 1411. Për historianin e merituar serb Mih. J. Diniq, duket se të njëjtin emër e mbanin edhe i vëllai Martin i borxhliut

---

[212] Khs. Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455. godine. Sarajevo 1972, f.32.

[213] Në dritën e mikrotoponimit *Lugu i Obicës* në katundin Manastirc i cili (lug) gjarpëron edhe në katundet Neredime e Epërme dhe Pleshinë të komunës së Ferizajt si edhe të mikrotoponimeve *Gradishi*, *Zabelet e Varoshit* dhe *Livadhi i Kishës* në katundin Manastirc, të shënuara nga J. Osmani, sh. Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpca, Prishtinë 2004, f. 96, 98, 108, 118, ka shumë arsye të besohet se vendbanimi, përkatësisht tregu i quajtur Obica do të ketë qenë në territor të katundit të sotëm Manastirc. Tregu *Obica* është dëshmia më e mirë e rrethanës së konstatuar se në mesjetën e vonë kishte në Kosovën e sotme vendbanime të fortifikuara, ndërsa jashtë mureve të tyre ngriteshin tregjet. Emri i këtij lumi do të jetë në lidhje birësie me emrin *Őbnica*, të një dege të lumit Kolubara të Serbisë. Emri i këtij lumi është, [sipas Ivan Duridanov, Illyrische Flussnamen in Serbien, Linguistique Balkanique IV, Sofia 1963, f. 104] me origjinë ilire. Sipas këtij, nga një rrënjë e zgjeruar ilire *Ab-in* ose *Ab-on* "më vonë do të mund të krijohej në sllavishten (serbishten) një **Obьnъ* përkatësisht një **Obъnъ* më vonë *Ob(a)n*, gjinore *Obna*". Një toponim *Obna* po u përmendka për në rrjedhën e poshtme të lumit Sava më 1545.

[214] Ka mjaft arsye të besohet se ky emër nuk mund të ndahet lehtë nga një antroponim gjerman rrënjë, i cili te ky popuull dëshmohet dhe vazhdo të gjallojë në trajtat *God*(*e*)*bert*, *Godefried*, *God*(*e*)*hard*, *Godo* e *Godwin*. Khs. për këtë Mackensen, Das große Buch der Vornamen, VMA-Verlag, Wiesbaden, 1990, f. 78.

[215] Cit. sipas M. Tërnava, Popullsia. .., f. 385.

Hanzo: *Martin, frar de Hanzo* dhe *Pauao Hanzouich* që ishte dorëzan për të vëllanë Martin; *Tonchus* (Tomasius) *Canzouich* me të bijtë Peter, Dmittar e Giurach që kishin qenë borxhlinj të tregtarit raguzas Mih. Luchari. Duket se, kështu paravendon dijetari ynë, këtë mbiemër e mbante edhe personaliteti Novobërdas *Nicolaus Camzouich* (lexo Hamzoviq) *de Nouomonte* i cili në vitin 1472, tani si "raguzas" dërgonte "ambasadorë" të vetë në Raguzë për të kërkuar hua nga Republika.

Njerëz që në vend mbiemrash të tipit antroponimik mbanin sish të motivuar nga zeja me të cilën merreshin ata apo edhe pararendësit e tyre ka edhe në disa mahallë të qytetit të Novobërdës. Kështu, në lagjen e Pop Nikolla Liplanit janë regjistruar edhe banorët *Nikolla, i bir i hutman* -it; në mahallën tjetër, të quajtur Skliçiq, ishin edhe një *Marko hutman* e Stepa, i bir i *pllakaniqarit*, ndërsa bashkëkatundarë të tij ishin edhe *Dimitri Matosh*-i; *Gjon*-i i bir i Pavl-it; *Gjon*-i i bir i Jovan-it; *Kola Arnaut*-i; Zhujko, i bir i Zojiq-it; *Petri Arbanas*-i; *Gjo*-i i bir i Pavl-it;[216] tre *plakaniqarë* dhe një *chruzmar* (lexo kërçmar "pronar kafeneje; kafexhi") që jetonin në lagjen Pop Dimitri Gerinoviq; në mahallën e Pop Gura shuster-it jetonin edhe kryefamiljarët Niciq, i bir i *shuster*-it; *Gjerg*-i, shuster e Shteric[217] shusteri, ndërsa banorë të tjerë të kësaj lagjeje ishin edhe Petko, i bir i *Arbnes*-it; Nikolla i bir i *Gjon*-it; Jovan-i i bir i Kërçova-s dhe Peja i bir i *Gjon*-it; në lagjen Sveta Petka punonte kryefamiljari *Vitomir, shuster* dhe tre bashkëkatundarë të tij që gjithashtu për mbiemër e mbanin distiniktivin *shuster* të profesionit; Atributin *shuster* për zejen që e kishin ushtruar pararendësit e tyre, e mbase edhe vetë disa kryefamiljarë të regjistruar në këtë defter, e mbanin edhe ndonjë nga banorë të katundeve *Arbanash*: *Jovan* -i, *shuster*; të katundit të paidentifikuar *Çerishta:* Jovan-i, i bir i *shuster*-it; të katundit poashtu të paidentifikuar Ob(ë)rnafca: Petri, i bir i *shuster*-it dhe, së fundi, një bashtinë në katundin Shillovë të komunës së Gjilanit ishte e një *shnajder*-i[218] "rrobaqepës".

Emra vendbanimesh, përkatësisht lagjesh të sajuar nga nocioni gjerman Schuster "këpucëtar" në qytetet mesjetare të Novobërdës e të Vushtrisë kishte deri në fund të shek. 16. Kështu, për në të dyja këto qytete

[216] Khs. Iljaz Rexha: Regjistrimi i vendbanimeve..., f. 70, 72, 108, 113, 117, 88 67.

[217] I. Rexha, Regjistrimi..., f. 70, 72. Ka arsye të paravendohet që ky mund të jetë variant i emrit të katundit ende të paidentifikuar që në një burim serb të fillimit të shek. XV përmendet si *Štirci.*

[218] I. Rexha, Regjistrimi..., f. 70, 72.

dëshmohen në regjistrimin osman-turk të vitveve 1566-1574: *Mahalla Shuster* e Novobrdës dhe Mahalla Shuster e të krishterëve të Vushtrrisë.[219]

Pas mbiemrave familjarë të dalur nga terma gjermanë të mineralogjisë e të xehetarisë, si p.sh. *hutman, kramar, shuster* etj. duhet parë, vetëm një terminologji të huazuar nga gjermanishtja e të favorizuar edhe nga shkrues dokumentesh dhe kurrsesi domosdo edhe njerëz me përkatësi etnike sase. Kjo shihet më së miri edhe tek rrethana se kësi mbiemrash nuk u ruajtën as tek popullata shqiptare e as tek ajo serbe e Novobërdës sado që dihet se në dokumentacion shumë individë të popullatës vendëse e mbanin për mbiemër ose atribut një *nomen professionis* me prejardhje gjermane, sase, qoftë ai mbiemër i lidhur me xehetarinë e me mineralogjinë qoftë me zeje të tjera. Kanë vazhduar të ruhen, përkundrazi, vetëm disa apelativa të gjermanishtes që kanë të bëjnë me galeritë (khs. më poshtë fjalën *shtonë*), me shkrirjen e mineraleve (khs. *rozhnjak*) e ndonjë tjetër dhe kjo vetëm në mikrotoponime. Kjo rrethanë do të tregonte se në këso rastesh kemi të bëjmë me kontinuitet territorial termash gjermanë për vende konkrete në të cilat u zhvillua aktivitet xehetar, mineralogjik pas gjithë gjasësh me pjesëmarrjen aktive edhe të pararendësve të banorëve të sotëm shqiptarë në vendbanimet e të cilëve ka mikrotoponime të kësaj natyre.

Mbase nuk ka as edhe një arsye të dyshohet që sasët, në kuartet e tyre të qyteteve-miniera në *mercata*-t e kolonive të tyre të përbashkëta me raguzasit në Kosovën dhe në Rashën e mesjetës e flisnin gjermanishten, ashtu si edhe bashkëkombasit e tyre nëpër kolonitë e tyre në Poloni, Hungari e në Sllovaki, përkatësisht në regjionin Zips - gjendje kjo për të cilën për në shek. 17 nunciusi i papës, Ruggieri, shkruante se "Zejtarët janë pothuaj të gjithë gjermanë, shumë nga sish janë të ardhur, kështu që në shumë vende nuk mund të dëgjohet gjuhë tjetër përpos gjermanishtes".[220] Kjo na e përkujton përcaktimin ligjor përkitazi me përjashtimin e të drejtës për vendosjen e të tjerëve, madje edhe të vetë hungarezëve, në bashkitë e sasëve. Mbreti Bela i hungarezëzve ua ndalonte psh. sasëve të vendit Schmegen të regjionit të Zips-it, që këta nuk guxojnë t'i shesin truall ndërtimi e as tokë buke askujt tjetër përpos gjermanëve, përkatësisht sasëve. Sipas këtij urdhri të mbretit hungarez në sheshin/tregun e vendbanimit shtëpi banimi mund të kishin vetëm sasët. Bile, kur po fliste

[219] Khs. për këtë Dr. Iljaz Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566/74, në Vjetar 31-32 i Arkivit të Kosovës, Prishtinë 2004, f. 98, 103.

[220] Khs. K. B. Müller, Die Bedeutung von deutschen Blutes in Südosteuropa, Süddeutsche Forschungen, III, 1938, f. 584, 585, 610-614.

në këtë kuadër për vendbanimin Spalatro, banorët e të cilit nuk ishin ardhës mbreti hungarez Geisa II. i lavdëronte këta: unë nuk dua të lejoj që asnjë hungarez ose ndonjë i huaj tjetër të banojë në qytetin e tyre, përveç nëse ata e lejojnë një gjë të tillë.[221]

Unë paravendoj se as gjendja nëpër kolonitë raguzase-sase të Kosovës së shekujve 14-16 nuk do të ketë qenë ndryshe. Edhe në këto qendra sasët e ruanin identitetin e tyre etnik e fetar të shprehur edhe në tipin e kishave e të shtëpive të tyre; në veshjen nacionale e gjithsesi duke e kultivuar edhe gjuhën e tyre. Pikërisht mbi bazën e këtyre realiteteve edhe duhet të kërkohet e të gjendet burimi i pjesës më të madhe të gjermanizmave si në leksikun e shqipes, duke përfshirë këtu në rend të parë të gjithë termat e lidhur me mineralogjinë, përkatësisht me titujt e hierarkisë në zejen e xehetarisë dhe të zejeve të tjera e po ashtu edhe në emrat e vëllazërive dhe në mikrotoponimet me prejardhje sase të Kosovës.

Dëshmi të antroponimeve sase, përkatësisht të elementit etnik sas në qytetin mesjetar të Novobërdës gjenden deri në gjysmën e parë të shek. 16. (1539-1543). Këso dëshmish gjenden në shënimet e priftit Damjan Vasiljeviq në të cilat janë dëshmuar personat *Nikola Saksen, Petar Nemičić*, si dhe një banor me mbiemrin *Štrihinić*. Sipas A. M. Solovjev,[222] tek bartësit e këtyre emrave, e në rend të parë tek bartësit e mbiemrave *Saksen* e *Nemičić* që e paskan kuptimin "i bir i sas-it", përkatësisht "i bir i gjermanit", po u dashka të shihen pjesëtarë të përkatësisë etnike sase, përkatësisht gjermane.

Më shumë dëshmi antroponimike për sasët në hapësirën e sotme të Kosvës në periudhën mesjetare e njëkohësisht edhe dëshmi për degjermanizimin, përkatësisht asimilimn e minatorëve sasë ka në defterin osman të regjistrimit të vilajetit të vasalit turk Vuk Brankoviq të vitit 1455. Këtu janë regjistruar edhe këto dëshmi nga fusha e antroponimisë dhe e patronimisë: Bogoslavi, i bir i *Barman*-it nga katundi Shajkovc i Podievës; Bogdani, i bir i *Artuit* - banor i katundit Zhilivodë të Vushtrrisë; Petrani, i bir i *Bernardit* i kaundit Topillë të Ferizajt; Jakovi, i bir i *Hajanit*, nga Manastirci i Ferizajt; Gjurko, i bir i *Rozhmanit* nga Vushtrria; Radihna, i bir i *Johanit*, nga katundi Kotor i Skenderajt; *Hena*, lopçar nga Pasjani i Gjilanit; *Hajani*, i bir i Nefandas, nga Dërsniku i Klinës; Vlku, i bir i *Henicas*, nga Gremja e Ferizajt; *Alan*-i, i bir i Dujakut nga katundi i dikurshëm i Podujevës; *Pauli*, i bir i Pajas dhe Radivoji, i bir i *Paulit* të katundit Kupina (sot Kërpimeh i Podujevës?); Radislavi, i bir i *Alanit*,

[221] Geschichte der Siebenbürger Sachsen, Erster Band von G.D.Teutsch (Text von 1852)

[222] Aleksandar Solovjev-G. P Vasenko. Serbskie zapisi na grečeskoi rukopisi 16 veka, (Recension) në Jugoslovenski Istoriski Časopis 1-4, 1937, f. 316.

banor i katundit të zhdukur *Kravaja*, i cili pas gjithë gjasësh nuk ishte larg nga Podujeva; *Hajani*, vëlla i Vladislavit; Raçanit, nga Koliqi i Prishtinës dhe ndoshta edhe *Nemçe*, i bir i Kalojanit, nga katundi Kollë i Vushtrrisë, si edhe Nikola *Nemeščeruni*,[223] nga katundi Hallaq i Prishtinës.

Përveç shembujve të sjellëantroponimikë e patronimikë të Kosovës së sotme në shek. 15, ka edhe një numër të konsiderueshëm banorësh, mbiemrat e mirëfilltë familjarë të të cilëve janë zëvendësuar me fjalë gjermane, kryesisht me sosh që tregojnë profesione si: *shnajder, shtrihiniq* e *shuster* dhe dëshmohen edhe në regjistrimin e vitit 1455 (sh. edhe më lart). Duke qenë se ka mundësi që këtu të kemi të bëjmë me fjalë gjermane të përvetësuara nga popullata vendëse si pasojë e bashkëjetesës me minatorët sasë, nuk mund të këmbëngulet me arsye që edhe bartësit e mbiemrave të këtillë të konsiderohen për persona të përkatësisë etnike sase, në rend të parë pse edhe emri etnik i sasëve - ashtu siç ndodhi me emrat etnikë *arbanas* e *vllah* që u bënë sinonim për "blegtor"; *grek* e *cincar* "vllah" që u bënë sinonime për "tregtar" - mund ta ketë marrë edhe ky funksionin e fjalës "minator" në përgjithësi.[224]

5. GJURMË ONOMASTIKE SASE NË MIKROTOPONIME TË SOTME TË KOSOVËS

Disa gjurmë onomastike sase dëshmohen edhe në disa mikrotoponime aktuale të Kosovës. Të këtilla duket të jenë *Shtomna* - përrua e burim uji; *Kodra Shtomnës*; *Lugi Shtomnës* - luginë e livadh si dhe emri *Shtomna* i malit në katundin Gadish të komunës së Gjilanit, në afërsi të vendit xeheror Gllama.[225] Këta emra e kanë për bazë termin gjerman të xehetarisë Stollen[226] "galeri miniere", shqip *shtonë*. Vetëm tërthorazi le të përmendet që sipas regjistrimit turk të viteve 1566-1574 në këtë kaund, përeç banorëve të tjerë që mund të konsiderohen për të përkatësisë etnike shqiptare, jetonte edhe banori Gjor-e Gjon-i.[227]

---

[223] Sh. Oblast Brankovića. .., f. 125, 261, 45, 127, 29, 34, 48, 184, 241, 247, 248, 20, 34, 247, 248, 291, 224, 109, 234.

[224] Kështu mendonte M. S. Filipović, Das Erbe, f. 194.; M. Dinić, Za storiju rudarstva. , I, f. 40. Këtë paravendim e kundërshton, me të drejtë, medievisti kosovar M. Tërnava, Populsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI, Prishtinë, 1995, f. 388.

[225] Është shfaqur mendimi se edhe fjala *glama* mb. *glamьski,* e cila dëshmohet vetëm në dokumente që kanë të bëjnë me xehetarinë, qenka në të vërtetë me prejardhje gjermane. Mbizotëron porse mendimi se kjo fjalë është në të vërtetë me prejardhje nga greqishtja *μαλαγμα* "argjend i përzier me ar". Khs. Max Vasmer, Die griechischen Lehnwörter im Serbokroatischen, Berlin 1944, f. 61.

[226] Për kuptimin e fjalës khs. V. Skarić, Staro rudarsko pravo i tehnika u Srbiji i Bosni, 118.

[227] Khs. M. Tërnava, Populsia..., f. 103.

Mikrotoponime që e ruajnë kujtimin për marrjen e popullsisë me xehetari ka edhe në katundin Cernicë të Gjilanit. Këtu janë ruajtur deri sot edhe mikrotoponimet *Shlakna* "zgurë, skorje, mbeturina të mineraleve të shkrira" dhe *Kovanica* serb. "farkë, farkëtore". Një vend i quajtur *Shlakna* është edhe në kaundin Gumnishtë dhe *Madeni* e *Mas Samakove* në katundin Nasalë të komunës së Gjilanit.[228]

Me prejardhje sase janë edhe mikrotoponimet *Cehat*, dy gropa afër vendit të quajtur Kalaja; *Shpella e Cehave*, gropë dhe shpellë në katundin Gadish* sikundër quhen edhe dy gropa në të dyja anët e lumthit Kizhnica afër Graçanicës, ku gjendet edhe përroi i qajtur *Dečki potok* (më hollësisht për këtë shih nën *Kishnica*); ngriturina *Ceovi* në Novobërdë dhe *Ceovi* në katundin Binçë të komunës së Vitisë;[229] emri *Ceove* i një kodre në rrethina të Janjevës[230] dhe, sipas K. Jireček, edhe mikrotoponimi *Ceovine* në Koporiq afër Soçanicës[231] e ndonjë tjetër. Të gjithë emrat e radhitur më lart rrjedhin nga termi gjerman i xehetarisë *Zeche*. "llogari, borxh" që e lidhur me kontekstin e minierave mund ta ketë pasur edhe kuptimin e pusit të marrë me qira. I gurrave sase qenka edhe emri i dëshmuar në mesjetë *Grat* (i shqiptuar sot si Grap) i një kodrinëze në territorin e Janjevës,[232] për të cilin nuk jepet ndonjë sqarim në rrafshin e etimologjisë së emrit.

Të kësaj prejardhjeje janë, më tej, edhe mikrtoponimet *Shlakna* që gjallojnë në katundet Cernicë e Kishnapole po ashtu të komunës së Gjilanit, të cilat rrjedhin nga termi gjerman i mineralogjisë *Schlake*[233] "skorje, shkrumb". Me prejardhje sase do të jetë, pas gjasësh, edhe emri i shtegut *Udha e Penezit*. i cili kalon përmes një gryke në katundin Strofc në shpatije të Bjeshkëve të Çiçavicës në komunën e Vushtrrisë përgjatë të cilit (shteg) ka gjurmë të marrjes me xehetari. Një vend i quajtur *Prroni Penezit* qenka në veriperëndim të katundit Kotorr të Drenicës.[234] Në këto mikrotoponime ruhet trajta shqipe popullore *penez* e emrit gjerman të monedhës *Pfennig*.[235] Në hapësirën e sotme të Kosovës ndeshen edhe disa emra të

[228] Këto mikrotoponime i ka shënuar në terren J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 6, Gjilani, Prishtinë, f. 204, f. 70, 110, 141.

* Mikrotoponimet *Shtomna* dhe *Ceha*, bashkë me atë *Baraza* (SG: Barza) i ka shënuar ë terren edhe J. O. VK., 6, Gjilani, Prishtinë. 2004, f. 78.

[229] M. S. Filipović, Das Erbe..., f. 215.

[230] Cit. sipas M. Tërnava, Popullsia..., f. 385.

[231] K. Jireček, Staat und Gesellschaft. .., III, f. 45.

[232] Muhamet Tërnava, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve 15-16, Prishtinë, 1995, f. 385.

[233] Për kuptimin e fjalës khs. B. Klajić, Veliki Rječnik stranih riječi, Zagreb, 1968, f. 1279.

[234] Sipas: Rexhep Doçi, Onomastika e Drenicës I, Prishtinë 2005, f. 17.

[235] Në të folme të Kosovës ekziston edhe fjala *penez,-i*, e cila nuk e shënon pikërisht monedhën Pfening, porse secilën monedhë të vogël, që mbahet si stoli rreth qafe apo në pjesë veshjeje të grave e të fëmijëve. Përkitazi me etimologjinë e kësaj fjale khs. F.

vëllazërive, të cilat duket të jenë me prejardhje sase. Për i këtillë do të mbahet emri i vëllazërisë serbe *Utmanc*i në katundin Jasenovik të rrethinave të Novobërdës. Sipas gojëdhanës, që vërtetohet porse edhe nga etimologjia jonë e propozuar, emri i kësaj vëllazërie i heq rrënjët nga një pararendës i saj që ishte *utman* (dmth. gjerm. Hutmann) "Kryetar i një grupi prej 8 punëtorësh në një pus miniere", që në turqisht quhej *emin.* Tradita e popullatës lokale serbe mban mend se pararendësi i paravenduar i tyre dhe disa pasardhës të tij paskan qenë "*nastojnici na ce´ove*", "drejtues i ceheve".[236] Korrektësinë e këtij sqarimi e mbështet edhe dëshmimi i banorit *Buça Hutman*-i, i cili në fundshekullin 15 jetonte në Mahallën Kovaç Radosav-i të Novobërdës,[237] andej pra ku ndodhet edhe katundi fqinj Jasenovik i Novobërdës.

Përkitazi me mendimin e M. Dinić,[238] sipas të cilit mbiemri familjar *Changius* i një banori të kaundit *Spanzi* (sot Spancë) në të ashtuquajturën Serbi e Jugut dhe *Martin Vriglia Changi de Nouaberda*, duhet të konsiderohet për emër me origjinë sase, duhet vërejtur se ky mbiemër ruhet edhe sot e gjithë ditën tek emri *Kangjovit* i një vëllazërie shqiptare në katundin Orllan të komunës së Prishtinës. Një rrethanë që në këtë rast do të duhej të merrej në konsideratë do të ishte edhe ekzistimi i mikrtoponimit *Fusha e Kangjit* në katundin Mramor të rrethinave të Prishtinës si edhe ekzistimi i vetë apelativit *kangj,-i* "gjel; këndues" që ndeshet edhe në vetë të folmen e banorëve të vëllazërisë së Kangjëve. Duke qenë se kjo vëllazëri jeton në një pjesë të Orllanit, në të cilën ekziston edhe mikrotoponimi *Trojet e Gjenovizit* - një vend i pasur me relikte të kulturës materiale që nuk gjendet larg nga hapësira në të cilën gjallon edhe sot vëllazëria shqiptare *Shullcët* me emrin e saj tipik gjerman (sh. më poshtë) duket se këtu vërtet kemi të bëjmë me një emër me prejardhje sase. Kjo etimologji do të ishte e pranueshme nëse interpretimi popullor sipas të cilit *kangj* e ka në këtë zonë kuptimin "gjel, këndues" dëshmohet për

---

Miklosich, Die Fremdwörter in den slawischen Sprachen, Denkschriften der Wiener Akademie der Wissenschaften 15 (1866), f. 117. cit. sipas M. S. Filipović, Das Erbe..., f. 215 dhe penéz-i: pennés-zi g. një monedhë e hollë e vjetër argjendi e lakueshme, e cila shërben vetëm si stoli. Hahn. penez-a danaro. Rossi. Bogdan 2. 62. khs. die Fremdwörter in den slavischen Sprachen 45. sh. edhe Fr. Miklosich, Die slavischen Elemente im Albanischen, Wien, 1870, f. 28. Ka edhe një mendim sipas të cilit, fjala gjermane *Penning* qenka reflektuar në sllavishten e vjetër kishtare si pěnęd'źь sh. Knut Knutsson, Zur Frage über die ältesten germanischen Lehnwörter im Slavischen, recension në Zeischrift für slavische Philologie, Bd. XV, Leipzig 1938, f. 137.

[236] sipas M. S. Filipović, Das Erbe. .., f. 215

[237] I. Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut tlë Vushtrrisë të vitit 1566/74, në Vjetar 31-32 i Arkivit të Kosovës, Prishtinë, 2004, f. 103.

[238] sh. Za istoriju rudarstva, I, f. 6.

vetëm si etimologji popullore që e ka për mbështetje përputhjen e këtij emri me fjalën *kangj*, përkatësisht *kangjel* të italoshqiptarëve, ku kjo fjalë e ka kuptimin "këngë". Me prejardhje sase është edhe emri *Shullcët* i vëllazërisë e cila jeton në shpatie të malit Çuka e Drazhnjes - e pasur me minerale - në fqinjësi me katundin Orllan. Këtu bie edhe emri i vëllazërisë serbe *Kramovići*[239] (shqip: Kramovit) në katundin Cernicë të Gjilanit, emër ky që nuk mund të ndahet lehtë nga termi gjerman i mineralogjisë *Kram* "Shtëpi afër pusit në të cilën jetojnë minatorët, kur nuk punojnë në minierë" (më gjerësisht shih nën Kramovik). Ndër emrat sasë të vëllazërive të popullatës së rrethinave të Novobërdës në këtë mes duhet të inkuadrohet edhe mikrotoponimi *Fusha e Henajve* dhe *Maja e Henajve* (një rrafshinë sipër katundit Llabjan të Novoberdës) në të cilat s'ka përse të mos ruhet emri i zhdukur i një vëllazërie shqiptare **Henaj* që do të ketë jetuar në këtë katund. (më gjerësisht për këtë sh. nën *Henc*) si edhe emri *Rafuna* i një vëllazërie të katundit Meshinë të Kamenicës, e cila qenka e ardhur këtu nga një katund homonim i rrethinave të Lebanës në të ashtuquajturën "Serbi e Jugut".

6. OIKONIME SASE NË KOSOVË

Altomanci

Ndër oikonime të para që do të mund të inkuadroheshin në këtë kontekst do të ishte emri *Altomanzi*, i përmendur në Librin e tregtarit raguzas Mich. de Lucari në gjysmën e parë të shek. 15 i cili paska të bëjë me trajtën e kryehershme të mirëfilltë të emrit të katundit të sotëm Tomanc të populluar nga pjesëtarë të etnisë serbe të komunës së Kamenicës.[240]

Po të jetë kështu, emri origjinar i këtij vendbanimi do të ishte i pandashëm nga emri familiar gjerman *Altman* "burrë i moçëm; me përvojë", i cili ndër gjermanë dëshmohet edhe sot në trajtat *Oldmann*, *Oltmann* dhe përdoret edhe si emër personal.[241] Po të jetë kështu, me këtë rast do të kishim të bënim me një dëshmi se ajo pjesë e elementit etnik sas, që nuk u shpërngul pas pushtimit osman të Kosovës, jo vetëm ishte shqiptarizuar në pjesën më të madhe të tij, porse, pjesërisht, edhe do të jetë serbizuar.

---

[239] Ekziston gojëdhana sipas së cilës pararendësit e kësaj vëllazërie të sotme serbe qenkan të ardhur nga katundi Kramovik i Suharekës, përkatësisht i Rahovecit dhe se *Kramović*-ët e Cernicës qenkan në lidhje gjaku e farefisi me shqiptarët e atij katundi të Rahovecit. Një vëllazëri e quajtur Kramovikët, qenka, sipas J. Osmanit, Vendbanimet e Kosovës 11, Peja dhe Deçani, Prishtinë, 2004, f. 202 edhe në katundn Raushiq të Pejës.

[240] Sipas J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 13, f. 176.

[241] Hans Bahlow, Deutsches Namenlexikon, bot. Suhrkamp Taschenbuch Verlag, Baden-Baden, f.31.

Bërgari

Në hapësirën e Kosovës ka edhe disa emra vendbanimesh me prejardhje sase. I kësaj prejardhje është p.sh., pas gjithë gjasash, emri i katundit të zhdukur *Donji Brgari* me 14 shtëpi, i cili, për herë të parë e të fundit përmendet në regjistrimin e pronave e të kryefamiljarëve të vilajetit të quajtur Vëllk (Vuk Brankoviq) të vitit 1455.[242] Ky katund ishte në një timar me katundet e sorme Dumnicë e Poshtme dhe e Epërme të Podujevës dhe me katundin Tërdevc midis Vushtrrisë e Podujevës, dhe me katundin Pelaçevica, përkatësisht Bellaqevcin e sotëm të Fushë Kosovës. Në dritën e rrethanës që ky katund i zhdukur përmendet menjëherë pas Bellaqevcit të sotëm më bën të mendoj se katundi *Brgari* do të ketë qenë midis Prishtinës dhe katundit Bellaqevc të Prishtinës. Nëse ky paravendim do të mund të dëshmohej edhe në terren apo nga burime që unë nuk i njoh, do të rezultonte së pakut që identifikimi i këtij katundi me *katunь bьlgarski* "katuni i bullgarëve" të viteve 1313-1318, sot shq. Bugariq, serb. *Srbovac*, është i paqëndrueshëm.[243]

Emri *Brgari* i katundit të zhdukur rrjedh nga fjala gjermane *Bürger*, përkatësisht nga trajta më e vjetër e saj **Burgar*.[244] Ka shumë arsye të paravendohet që tek ky emër ruhet trajta raguzase *purgar* e fjalës gjermane *Burger* e cila në dokumentacionin raguzas shënonte pozitën sociale të sasëve në kolonitë e përbashkëta të tyre. Kjo shihet nga një letër që Republika e Raguzës ia dërgonte kolonisë së vet të Novobërdës më 1388, në të cilën thuhet se qytetarët e këtij vendi quhen *purgari* [gjerm. Bürger].[245]

Nëse ky sqarim mund të qëndrojë në këmbë të veta, atëherë këtij do t'i dilte krah pikërisht etimologjia e propozuar sipas së cilës do të duhej pritur që banorët e vendbanimit Brgari t'i takonin shtresës aristokrate sase që përbëhej nga sasë të pasur e të privilegjuar, siç ishin sasët në të gjitha vendbanimet që banoheshin nga ata. Në të mirë të këtij paravendimi do të fliste edhe trajta mbase raguzase e shumësit *Brgari* e këtij oikonimi, trajtë që përdoret për të emërtuar pjesëtarë të një bashkësie në rastin tonë të sasëve të privilegjuar. Vështruar jo krejt shkëputur nga pikëvështrimi gjuhësor për mundësinë që këtu mund të kemi të bëjmë me një vendbanim sasësh do të fliste rrethana që, nga njëra anë, në katundin e sotëm Dobrevë ishte dogana që e mbanin raguzasit dhe, nga ana tjetër, po në këtë

[242] Oblast Brankovića. .., f. 63, ref. 80, 82.

[243] Khs. Latif Mulaku, Mbi disa toponime mesjetare shqipe të Kosovës, Onomastika e Kosovës, Prishtinë 1979, f. 165.

[244] Për analogji me disa emra vendbanimesh në Rumani khs. Lucia Djamo-Diaconița, Elemente lexicale de origine germana. .., f. 93.

[245] St. Novaković, Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje. .., f. 18.

rreth gjendet edhe katundi me emër të gurrave leksikore sase, germane *Hade*, (trajta më e vjetër e emrit ishte *Halda*, sh. më poshtë). Po u muarr në konsideratë kuptimi i emrit *Gracka* i vendbanimit (i sajuar pas gjithë gjasësh nga slav. *gradь* "kështjellë, gjytet", përkatësisht nga mbiemri *gradsko*, që do ta supozonte një trajtë **Gradsko* të këtij vendbanimi) nuk do të mund të hedhej poshtë mendimi që vendbanimi i zhdukur *Brgari* (ndoshta nga një trajtë sllave e *Burgeri) mund të ketë qenë një kohë emër i katundit të sotëm të Grackës së Lipjanit jo larg nga miniera e thëngjillit në Hade dhe po ashtu jo larg nga miniera e magnezitit në Golesh, përkatësisht në Magurë. Në këtë rast emri Grackë do të ishte përkthim jokorrekt i vonë i emrit **Burgar*-i gjë që do të mbështetej edhe nga rrethana se katundi i sotëm Grackë nuk përmendet para gjysmës së dytë të shek. 16.[246] Si i këtillë, emri *Brgari* do të ishte semantikisht i barasvlershëm me emrin *Popollan't* të një vëllazërie serbe në katundin Strezovc, ku edhe sot është miniera aktive e magnezitit, përkatësisht me emrin *Popolanët* të një katundi që qenka në pjesën veriperëndimore të Kamenicës.[247] Kjo vëllazëri e mban një emër që ka dalë nga apelativi roman, përkatësisht dalmat *popolani* "qytetar; pjesëtar i shtresës qytetare, kryetar i gjyqeve raguzase" me të njëjtin kuptim si nocioni sas, gjermam Burger, shm. në variantin raguzas *burgari*.

Dudman

Është shfaqur mendimi se me prejardhje sase do të jetë edhe emri *Dudman* që është evidentuar edhe në trajtën *Dudmani* i katundit i cili në të tri regjistrimet turke të kryefamiljarëve (më 1455, 1477 e më 1487) ishte evidentuar në të njëjtin timar me katundin Milidrugovce, pas gjithë gjasësh katundi i sotëm Metërgovc në verilindje të Orllanit.[248] Nëse ky identifikim është i qëndrueshëm, atëherë katundi me emrin e zhdukur *Dudman* /*Dudmani* do të duhej të kërkohej jo larg Metërgovcit të sotëm. Prejardhjen sase të këtij emri e kishte propozuar, sipas M. Tërnavës,[249] dijetari boshnjak Adem Handxhiq. Asnjëri nga këta të dy nuk e kanë arsyetuar këtë etimologji të propozuar. Nëse emri *Dudman*/ *Dudmani* i vendbanimit të gjysmës së dytë të shek. 15 do të jetë me prejardhje sase, atëherë ky

[246] Nëse katundi dypjesësh i dëshmuar më 1566-1574 si Dolno e Gorno Gradçe (khs. për këtë I. Rexha, Regjistrimi..., f. 81, referenca 80) me të vërtetë ka të bëjë me katundin e sotëm Gracë të komunës së Lipjanit.

[247] Khs. për këtë I. Rexha, Regjistrimi…, f. 81.

[248] Sh. Oblast Brankovića. .., f. 331 dhe referencat në poatë faqe të librit.

[249] Popullsia e Kosovës gjatë shek. XIV-XV, f. 386; A. Handžić, Nekoliko vjesti o Arbanasima na Kosovu i Metohiji sredinom XV vijeka, Simpozijum o Skenderbegu, Prishtinë, 1969, f. 203.

oikonim do të mund të lidhej me trajtën e krijuar si rezultat i belbëzimit, i shqiptimit të paqartë Duden/Dudden të antroponimit Lude. Emri në trajtën Dude/Dudo ishte i preferushëm për derën feudale sase të vjetër të Ludolfinderëve dhe dëshmohet që në vitin 951.[250] Rrethana që ky vend nuk ishte larg nga Orllani, në rrethina të të cilit gjallojnë edhe sot emrat sasë të vëllazërive shqiptare Shullcët e Kanxhovit, sikur flet në të mirë të korrektësisë së kësaj etimlogjie në pikëshikimin gjuhësor. Përveç identifikimit në terren të këtëij emërtimi të zhdukur mbi bazën e ndonjë mikrotoponimi apo emri të vëllazërisë, për t'u sqaruar mbetet edhe rrethana përse më 1455 asnjëri nga 13 kryefamiljarët, një e vejë e 3 beqarë të këtij katundi nuk kishin as emër e as mbiemër me prejardhje sase.

Gllamë

Gllama quhet një kodër masive që ndan Janjevën nga Graçanica dhe një kodër në hapësirën e Novobërdës, përkatësisht afër katundeve Kuretishtë e Strazhë. Në fundshekullin 15 një vend i quajtur *Gllama* ishte qendër e nahijes. Në po atë regjistrim ishin evidentuar edhe dy katunde emrat e të cilëve I. Rexha i ka lexuar si *Glami Dolna* e si *Gorna Glami* - në vend të *Gllama*. Katundi Gorna Glami ishte asokohe i banuar në mos kryekreje së pakut në pjesën dërmuese nga shqiptarët. Banorë të këtij katundi ishin asokohe: Gjon Andreja, Gjon Marin-i, Nua i bir i Marin-it; Gjon Stepa, Gjon Varrak-i*, Noka Varraki-i* (SG: u), Andreja Gjona, Lisna Dacko, Martin Backo, Nua Marin-i, Dodko Nikolla, Noko Nikolla, Tushka Domko, Duka (IR: Doka) Andreja, Dimitri Gjin-i, Jovan Gjin-i, Lina (IR: Gjina) e vejë; Gjon, i bir i Jovan-it, Gjon, i bir i Gjukiqit. Këtu ishte edhe një bashtinë e quajtur *Bashtina Gjergj*, ndërsa kaundi *Glami Dolna* banohej mbase kryesisht nga shqiptarë e raguzas. Banorë të këtij katundi ishin Gjon Braja, Dimitri Span-i, Dimitri Gjon-i, Pava Marin-i, Vllasota Jovan-i, Dimsha Marin-i, Jova Marin-i, Peja, i vëlla i Lisina-s, Andreja Gjoni dhe Peja Vllahoviq. [251]

Sot ka në katundin Bresalc një mahallë e quajtur *Gllama* dhe mikrotoponimet *Arat e Gllamës*, *Shpati Gllamës* dhe *Gllamici*; në katundin Livoç i Epërm të komunës së Gjilanit është mikrotoponimi *Gllama*,[252]

---

[250] Sipas Hans Bahlow, Deutsches Namenlexikon, Suhkramp Taschenbuch, 65, Baden-Baden, 1985, f. 104-105.

* Është e vështirë të besohet që ky emër të jetë shkruar edhe në origjinal me *rr*. Më e drejtë më duket që ky emër do të duhej të shquhej me *-u*.

[251] I. Rexha, Regjistrimi..., f. 104-105.

[252] Këtë mikrotoponim e ka shënuar në terren Ali S. Berisha, Gallapi i Prishtinës, 2007 (Dorëshkrim)

ndërsa në katundin Llajshevc të krahinës së Gallapit, po ashtu një mikrotoponim *Gllama*.

Është e qartë që emrat e këtyre vendeve dalin nga termi mineralogjik *glama, argentum glame, de glama, glamma* i dëshmuar në Novobërdë më 1436 "De argento glame..." dhe ka të bëjë me këtë xehe të nxjerrë vetëm në këtë minierë. Çështje që duhet parë mbetet nëse këta emra duhet të lidhen me refleksin serb *glama*, përkatësisht *glamsko srebro* "argjernd që përmban edhe ar" të greqishtes së re μάλαγμα "ar" sikundër mendon S. Novakoviq, apo që këta të krahasohen me termin gjerman të mineralogjisë *Galmei* "kalaminë, xehe e zinkut" - si propozon K. Jireçek.[253]

Sado që në të dyja rastet kemi të bëjmë me trajta të metatetizuara, mua më duket më e lehtë në *gllama* të shndërrohet *Galmei* e gjermanishtes se sa μάλαγμα e greqishtes. Në të mirë të prejardhjes gjermane të këtij termi të ruajtur vetëm në emra vendesh të pasura me xehe flet faktori jashtëgjuhësor, përkatësisht dëshmimi nëpër këtë zonë i minatorëve sasë e i zejtarëve dhe i tregtarëve raguzas gjatë shek. 14-16.

Gllarevë

Më shumë për të mirë të plotënisë së mendimeve të shfaqura përkitazi me gjurmët sase në Kosovën e sotme se sa si shprehje të pajtimit tim me të gjitha mendimet e shfaqura rreth kësaj teme, po shënoj se për si me prejardhje sase është mbajtur edhe emri i katundit të sotëm Gllarevë të komunës së Klinës, i cili më 1330 është dëshmuar në trajtën *iglarev´cь*[254]

Emrin e këtij katundi F. Miklosich e shpjegonte për të dalë nga fjala sllave *iglarь*, lat. "opifex acuarius", "gëmushë, therrë".[255] Mirëpo M. Pavloviq – përkundrazi – mendonte se emri *iglarev´c*, përkatësisht mikrotoponimi *iglarev studenc* i vitit 1330 na qenka me prejardhje sase, përkatësisht gjermane. Në këtë emër M. Pavloviq e gjente fjalën gjermane *Hügel* "kodër", përkatësisht një trajtë të paravenduar nga ai **Iglau* të gurrave sase, e cila iu paska nënshtruar të njëjtit fenomen të ndryshimit si tek emri **Bergsau* > Brskovo.[256]

[253] Khs. Romani u gradovima Dalmacije tokom srednjega veka, Beograd 1962, f. 103.
[254] Sh. Dečanske hrisovulje..., f. 93.
[255] Sh. Fr. Miklosich, Die slawischen Ortsnamen aus Appellativa, Denkschrift der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften, Wien, 1927 Bd. 21, f. 254; khs. edhe sh. Dj. Daničić, Rječnik iz književnih starina srpskih, I., Belgrad, 1863, f. 391.
[256] Sh. M. Pavlović, Ostaci dubrovačkih i saških govornih osobina u Janjevu, f. 298; Govor Janjeva, Novi Sad, 1970, f. 299.

Hade

Me prejardhje sase duket të jetë edhe emri i vendbanimit *Hade* i rrethinave të Prishtinës, i cili në regjistrimin osman-turk të vitit 1455,[257] si edhe në atë të viteve 1566-1574 dëshmohet në trajtën *Halda*,[258] përkatësisht Hade.[259] Emri i këtij katundi rrjedh nga apelativi gjerm. *Halde*, "grumbull i mbeturinave të hedhura të mineraleve e të dheut para galerisë; gropë e grumbuj të skorjes, zgurës në afërsi të shkritores së mineraleve". Emri *Hade* i këtij vendbanimi të Kosovës do të jetë së këndejmi i së njëjtës prejardhje si edhe oikonimi *Haodina* në Bosnje e mbase si edhe ai *Hodinci* afër Jastrebacit dhe *Hodovo* afër vendit Stolac, gjithashtu në Bosnje.[260]

Trajta *Halda*, në të cilin më 1455 dëshmohet emri që po trajtojmë, flet bukur fort në të mirë të etimologjisë së propozuar dhe e lejon kështu edhe paravendimin e harkut kohor të kalimit të tij pas shek. 16 nga **Halde* në *Hade*.

Sipas kësaj që u tha, do të rezultonte që vendbanimi *Halda* i vitit 1455 nuk ishte shuar, përkatësisht shkretëruar - siç e paravendonin botuesit e defterit turk.[261] Nëse shpjegimi ynë është i qëndrueshëm, nuk do të mund të pranohej as paravendimi sipas të cilit emri i këtij vendbanimi do të lidhej me trajtën *Haode*, përkatësisht me emrn e kolonëve sllovakë, duke u mbështetur në një gojëdhanë se në katundin fqinj Rufc të Hades paska pasur sllovakë.[262] Njoftimi për ekzistimin e ndonjë kolonie të mbajtur për sllovake në rastin tonë do të fliste më shumë pikërisht në të mirë të origjinës së sasëve tanë nga regjioni Cips i Sllovakisë, se sa për ekzistimin e ndonjë kolonie sllovake në kuptimin e mirëfilltë të emrit etnik *sllovak* në hapësirën e Kosovës në mesjetën e vonë.

Në krahasim me gjendjen në vitin 1455, në regjistrimin e vitit 1497 konstatohet një pakësim i numrit të banorëve të këtij katundi. Kjo rrethanë sikur përputhet plotësisht me konstatimin se pas pushtimit osman të Kosovës xehetaria pësoi një rënie intensive e cila mori fund me shuarjen e veprimtarisë së minatorëve sasë në këto anë kah fundi i shekullit 17 kur në

[257] Sh. Oblast Brankovića., f. 221, referenca 186.
[258] M. Tërnava, Popullsia., f. 9.
[259] S. Pulaha, Popullsia. f. 681.
[260] Khs. V. Skarić, Staro rudarsko pravo i tehnika, f. 17, 191; M. Pavlović, Altsächsische Bergbauterminologie., f. 83. apo [sipas V. Simić, Rudarstvo i prerada gvožđa u toponmastici i terminologiji Vlasinskog kraja, në Onomatološki Prilozi I, Beograd, 1979, f. 90] "pjesë të vogla minerali në formë shpuze nga e cila përfitohej masë hekuri më e butë dhe më e lehtë për farkim".
[261] Sh. Oblast Brankovića., f. 221, referenca 186.
[262] Kështu mendonte A. (tanasije) Urošević, Kosovo, Beograd, 1965, f. 285.

vitin 1685, mbase për herë të fundit, përmenden *lavoratori christiani*[263] "punëtorët e krishterë", që domosdo ka të bëjë me sasët e me raguzasit.

Hajnoc

Edhe emri i katundit të sotëm *Hajnovc/Hajnoc* të komunës së Kamenicës do të jetë me prejardhje sase. Emri i këtij vendbanimi është dëshmuar për herë të parë, me sa dimë deri tani, në gjysmën e parë të shek. 15. Në Librin e borxhlinjve të tregtarit raguzas Michael de Luchari të Novobërdës përmenden edhe dy banorë të këtij katundi: *Milos Chachoie* dhe *Nichola Dodixich de Hainouzi*.[264] Në defterin turk të regjistrimit të kryefamiljarëve të kazasë së Novobedrës në fundshekullin 15, emri i këtij katundi është shënuar në trajtën *Hajnovça*.[265] Është për t'u shënuar se në këtë kohë në katund nuk kishte asnjë njeri që mbante ndonjë antroponim apo mbiemër të mirëfilltë gjerman apo që në bazë të emrit të zejes që ushtronte dikush ndonjëri nga pararendës të tyre të këtij katundi të mund të paravendohej ekzistimi i minatorëve sasë.

Emri i këtij katundi përmendet në vitin 1761 edhe në Kadastrin e manastirit të Deviçit afër Skënderajt[266] dhe në vitin 1875 në hartën bashkëngjitur udhëpërshkrimit të tij përgjatë luginave të Drinit e të Vardarit të Johann Georg von Hahn, kur dëshmohet në trajtën *Heinofze*.[267] Dëshmia e parë e trajtës së sotme serbe *Ajnovce* rrjedh nga viti 1904 në një hartë austriake, ku është shënuar në trajtën *Ajnevce*, ndërsa në një hartë tjetër të vitit 1914 është shënuar si *Hajnove*. Në vitin 1915 emri i këtij katundi është shënuar si *Ajnovce*.[268]

Oikonimi *Hajnovc* e ka për bazë antroponimin sas, përkatësisht gjerman *Hein* (lexo Hajn). Duke u nisur jo vetëm nga rrethana jashtëgjuhësore, përkatësisht nga fakti që katundi Hajnovc ndodhet në atë zonë të Kosovës në të cilën gjatë mesjetës së vonë ndodheshin xeheroret më të mëdha e më të njohura e njëkohësisht edhe kolonitë më të mëdha të xehetarëve sasë e të tregtarëve raguzas i hapet udha paravendimit se te ky emër vendbanimi kemi të bëjmë me toponimizim të emrit të një vëllazërie, të zgjeruar me prapashtesën sllave *-ovci*: Hainovci. Si i këtillë, këtu

[263] sh. K. Jireček, Trgovački drumovi i rudnici. .., f. 215.
[264] sh. M. Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I., f. 61, 53.
[265] I. Rexha, Regjistrimi i popullsisë. .., f. f. 96.
[266] Sh. Gliša Elezović, Rečnik Kosovsko-metohiskog dijalekta II, Beograd, 1934, f. 416 ku ky emër është shënuar në trajtën *Hainovci.*
[267] Khs, J. G. von Hahn, Putovanje kroz porečinu Drina i Vardara, Beograd, 1876 (harta).
[268] Sh. Mil. Ant. Vujičić, Rečnik mesta u oslobodjenoj oblasti Stare Srbije (po službenim podacima), Beograd, 1914, f. 53.

do ta kishim antrponimin sas, gjerman Hain të cilin, fundja, e gjejmë të dëshmuar edhe tek mikrotoponimi *Hainouo Cholo*, "Pusi i Hainit" i cili është dëshmuar githashtu në gysmën e parë të shek. 15.[269] Prejardhjen antroponimike gjermane, përkatësisht sase, të emrit të këtij vendbanimi do ta përforconte rrethana se mundësia më e pranueshme për sqarimin e prejardhjes së këtij emri është trajta e shkurtër *Hain* e emrit gjerman *Heinrich*, që dëshmohet edhe tek sasët në Transilvani,[270] ndërsa një trajtë tjetër e shkurtër *Heinz* e këtij antroponimi dëshmohet edhe në qendrën e njohur xehetare të Bërskovos, për të cilën dihet se ishte pronë e Nemanjidasve të Rashës dhe xehetaria nën përkujdesjen e sasëve filloi aty pikërisht në kohën e Stepan Nemanjës. Një qytetar i Bërskovo-s i quajtur *Hajnc* (Heinz) *Biberanis* e kishte ngritur aty një kapellë kushtuar Shën Mërisë. Qytetari Hajnc ishte pas gjithë gjasësh një sas, sepse në Bërskovo ishte një koloni e njohur sasësh dhe aty ishte ngritur edhe famullia e parë sase, përkatësisht katolike në hapësirën e Ballkanit.[271] Në dritën e shpjegimeve të mësipërme, mua më del se sqarimi i propozuar nga A. Urosheviq i këtij oikonimi si të ishte i dalur nga apelativi *hajn* "një lloj peshku",[272] nuk është i qëlluar.

Halabak

Po u pranua mendimi i Y. E. Boeglin,[273] ndër emra me prejardhje sase të hapësirës së Kosovës do të duhej të inkuadrohej edhe emri i katundit *Halabak* i rrethinave të Podujevës. Në emrin e këtij vendbanimi Boeglin e kërkon një trajtë të oikonimizuar të një trajte të paravenduar nga ky **Alb Bach* "Përroi i Bardhë" me prejardhje gjermane. Autori e mbron etimologjinë e vet të këtij emri me rrethanën që, sipas tij, katundi Halabak i Podujevës nuk qenka larg nga Janjeva, në të folmen popullore të së cilës paska jo pak huazime gjermane. Përmes këtij interpretimi Boeglin mëtonte të sqaronte se në regjionin e Llapit ka edhe hidronime të tjera të sajuara nga rrënja *alb* "bardh", sado që ky nuk e sjell asnjë dëshmi historike të përmendjes së toponimit *Halabak*. Autorit nuk i ishte e njohur se popullata e katundit Halabak është shqiptare dhe se kjo nuk ka ndonjë lidhje me atë të Janjevës, prandaj as në të folmen e saj nuk ka aq elemente gjermane që Boeglin i paravendonte për në të folmen e Janjevës.

---

[269] Sh. M. Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I., f. 74.

[270] Sipas infor@ siebenbuerger.de. Këtu, për si rrjedhoja të emrit Heinrich, përkrah trajtave *Hener, Henneges, Henning, Hensel* e *Henrich*, konsiderohen edhe trajtat: *Heintz e Heinz*.

[271] Sh. për këtë Istorija Crne Gore I (2), Titograd, 1972, f. 52.

[272] khs. Toponimi Kosova, Beograd, 1975, f. 190.

[273] La rivière "Lab" en Serbie, ONOMA 12 (1968), 2-3, f. 320-332.

Në këtë kontekst do të duhej përmendur se emri i katundit Halabak nuk përmendet para shek. 19. Dëshmia më e vjetër e cila ka të bëjë me territorin e këtij katundi rrjedh nga viti 1455, kur ky vendbanim dëshmohet me emrin *Crvence* - emër që në të vëretë ka të bëjë me përrockën homonime që buron në rrethina të katundit Halabak, emrin e së cilës (përroskë) Boeglin e rinkonstrukton si *Alb-Bach*. Si vlera kuptimore e emrit Halabak të katundit (sh. më poshtë) ashtu dhe sidomos vlera kuptimore "Kuqlina" e emrit më të vjetër sllav të katundit *Crvenica* me vetëm 7 shtëpi që në vitin 1455 i takonte Llapit,[274] përkatësisht të ndonjë lagjeje të Halabakut, e vendosur në brigje të përrockës që buron në veri të këtij katundi e që edhe sot quhet *Cërvenica*, e lejojnë nxjerjen e përfundimit se nuk do të ketë ekzistuar ndonjë emër **Alb-Bach* si relikt më i lashtë i ruajtur deri në mesjetën e vonë. Nga ana tjetër, në hapësirën gjuhësore të shqipes ka edhe vëllazëri të tjera që e mbajnë emrin *Halabak* si p.sh. vëllazëria e Halabakëve në katundin Pozharan midis Ferizajt e Gjilanit dhe vëllazëria sllavishtfolëse *Alabakovci* e katundit Brod të regjionit të Gorës (Dragashit) e të cilat nuk kanë ndonjë lidhje farefisërie me banorët e Halabakut të Llapit. Përveç kësaj, në të folme popullore të kosovarishtes gjallon edhe mbiemri *halabak* që e ka kutimin "budalla, i trashë, kokëtrashë; malok". Në këtë mes do të duhej të merrej parasysh edhe rrethana që një degë e lumit Jelidere të Bullgarisë po u quajka,[275] *Alabak*.

Henc

Me prejardhje sase do të jetë pas gjithë gjasësh edhe emri i katundit të sotëm *Henc,-i* i komunës së Fushë Kosovës, jo larg nga miniera e magnezitit në Golesh, përkatësisht në Magurë.

Nëse mund mund të dëshmohet se një vendbanim i quajtur *Henilce* vërtet ka të bëjë me katundin e sotëm Henc, atëherë do të mund të paravendohej se dëshmia më e vjetër e përmendjes së emrit të këtij vendbanimi rrjedh nga vitet 1566-1574.[276] Për e sigurt mund të merret se ky katund dëshmohet në Kadastrin e Deviçit, në vitet 1773 e 1776 kur përmendet në trajtat serbe *Enac* e *Enace*[277] dhe më 1867 si *Hença*. Duket se ky oikonim do të jetë toponimizim i emrit të një vëllazërie, një para-

[274] khs. Oblast Brankovića. .., f. 318 dhe referencën 316.
[275] Sipas Constantin Jireček, Geschichte der Bulgaren, f. 20.
[276] Khs. M. Tërnava, Popullsia …, f. 240.
[277] Sipas J. Osmani, Venbanimet e Kosovës, 1, Prishtina, Kastrioti dhe Fushë-Kosova, Prishtinë, 2003, f. 326. Ka shumë arsye të dyshohet se këtu kemi të bëjmë me transliterime jo korrekte, sepse në serbishten emri i këtij katundi do të duhej të shënohej vetëm si *Ence*, e jo edhe si *Enace*.

rendës i së cilës do ta ketë mbajtur antroponimin gjerman, përkatësisht sas *Hen-*. Në të mirë të këtij paravendimi do të fliste rrethana që antroponimi Hen- nuk dëshmohet në shek. 15 në asnjë vendbanim i cili nuk do të ishte vendbanim - minierë apo që nuk do të ndodhej në afërsi të ndonjë vendbanimi të kësaj natyre. Dëshmitë e vetme të një antroponimi Hen- rrjedhin nga gjysma e dytë e shek. 15, përkatësisht më 1455 dhe pikërisht në katundet: Greme të komunës Ferizajt: Vëllk-u, i bir i *Henic*-ës dhe *Hena*, lopçar, në katundin Pasjan të Gjilanit: (në të cilin ishte edhe një banor i quajtur Dabizhiv-i, i bir i *Gjon*-it).[278] Përveç këtyre dëshmive historike, antroponimin *Hen* e ndeshim të jetë ruajtur deri në ditë tonat edhe në katundin Llabjan, jo larg nga Novobeda, ku janë mkrotoponimet *Fusha e Henajve*, *Lama e Henajve* dhe *Çuka e Henajve* - kodra më e lartë në territorin e këtij katundi. Këto mikrotoponime, të zgjeruara me prapashtesën karakteristike shqipe *-aj* të emrave që shenjojnë kolektivitet, sikur e dëshmojnë mjaft bindshëm ekzistimin dikur të një vëllazërie sase, ndoshta të shqiptarizuar *Henaj*[279] në këtë katund.

Hubovc

Me prejardhje sase dhe pikërisht nga një term i xehetarisë është pas gjithë gjasash edhe emri Hubovc (serb. Bosce) i katundit të komunës së Kamenicës, i cili nuk përmendet para shek. 19. Emri i këtij katundi dëshmohet atëherë në trajtat *Hubovica* e *Hubova*,[280] ndërsa trajta serbe *Bosce* e tij dëshmohet në një hartë gjeografike gjithashtu të shek. 19 dhe në një regjistër të vitit 1915 të vendbanimeve të pushtuara nga Serbia.[281]

Ka mjaft mbështetje gjuhësore e jashtëgjuhësore të cilat do të flisnin në të mirë të prejardhjes së emrit të këtij katundi nga termi gjerman i xehetarisë *Hub*. Kjo fjalë, sipas V. Skarić,[282] e ka kuptimin "Vend pranë *kram*-it, në të cilin xehja e sjell shoshitet ose sitet". Emri i këtij vendbanimi do të ishte, si të thuash, toponimizim i një *nomen professionis* **Hubovci* "Punëtorë që punojnë në *Hub*, që merren me sitjen e xehes së derdhur".[283] Po u gjykua mbi bazën e trajtës *Bosce* të emrit të këtij katundi, trajta *Hubovci* e këtij vendbanimi do të mund të konsiderohej, për-

[278] Sh. Oblast Brankovića. .., f. 34, 184.

[279] Nëse emri *Hena* është me të vërtetë me prejardhje sase, ka vend që edhe mbi bazën e profesionit që e ushtronte ky individ të mendohet se kishte madje që në shek. XV disa sasë të cilët nuk ishin më minatorë.

[280] Sallnamja e Kosovës, Regjistrim i popullsisë i viteve 1896/97 (dorëshkrim), f. 331, 340.

[281] Mil. Ant. Vujičić, Rečnik mesta. .., f. 52; Trajta shqipe e emrit ka dalë si rezultat i reduktimit të rregullt të togut konsonantik sllav *-v*(*a*)*c* në shqipen si *c*.

[282] Staro rudarsko pravo i tehnika. .., f. 106.

[283] Po aty, referenca 21.

kundër zgjerimit me prapashtesën sllave -ovc, një emër i vazhduar nga shqipfolësit. Kujtoj se emri i këtij vendbanimi nuk ka gjë të përbashkët me mbiemrin bullgar *hubav* "i bukur".

Karanoc

Me prejardhje sase do të jetë edhe emri i lagjes *Karanoci* dhe emri i përroit *Lugu i Karanocit* në katundin Sankoc, jo larg nga miniera e magnezitit në malin Magura të bjeshkëve të Çiçavicës. Ky emër i hapësirës së Kosovës, bashkë me emrin e qytetthit *Karanovac* si dhe mbiemrin familjar *Karan* të Bosnjës, mund të rrjedh nga fjala gjermane *Karren* "karrocë". Në regjionin e qytetthit Karanovac të Bosnes po u dëgjuaka edhe sot apelavi gjerman *Karren* në trajtën *karan* "karrocë".[284]

Kilus

Me prejardhje sase do të jetë edhe emri i zhdukur i një minierëze apo pusi miniere afër Novobërdës, i cili në dy burime shkrimore të viteve 1402 e 1411 dëshmohet si *Chilus* dhe si *fossa Chilus*.[285] Ky emër rrjedh nga një term mineralogjik i gjermanishtes së mesme *kil-houwe* "lloj çekani i vogël për thërrmimin e gurëve të shkriftë". Nëpër burime raguzase të hartuara në Kosovë, kjo fjalë dëshmohet në trajtën *chilauze*.[286] Kjo fjalë nuk ndeshet nëpër të folme shqipe të Kosovës. Përkundrazi, në leksikun dhe në toponiminë e rrethinës së minierës Lubinje (në rrethina të Priedorit - Bosnje) kjo fjalë ndeshet në trajtat *kilava* e *kilavica* dhe si emër familjar *Kilovaća* e edhe si emër i një lagjeje *Kilovac* - në juglindje të Fojnicës në Bosne.[287]

Kishnicë

Edhe emri i minierës dhe i vendbanimit *Kishnicë*/*Kizhnicë* në komunën e Prishtinës është, sipas M. Pavloviqit,[288] me prejardhje sase. Ky emër po rrjedhka nga fjala gjermane *Kiste* "lopatë me të cilën lahet xehja; dollap mbeturinash, llamarinë grrithëse, në të shumtën e rasteve një lloj

[284] M. S. Filipović, Das Erbe. .., f. 209.
[285] C. Jireček, Staat und Gesellschaft..., II. f. 45.; M. Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva, I., f. 27, 28; Mathias Lexers, Mitteldeutsches Taschenwörterbuch, 36 Auflage, Stuttgart, 1981, f. 107; Khs. edhe Milovan Antunović -Kobliska, Za pravilno tumačenje značenja i porekla nekolikih starih rudarskih i topioničarskih naziva, Onomatološki prilozi, 3, Beograd, 1982, f. 75: *kilhove, Keilhaue* "poiche de mineur, pic-a-roc".
[286] M. S. Filipović, Das Erbe..., f. 208, 217, 218.
[287] Po ai, Po aty, f. 209.
[288] Khs. Altsäcsische Bergbauterminologie. .., f. 80.

binari i ulët dhe i gjerë nga druri ose nga hekuri, rëndom e pajisur me një vegëz për ndarjen e lymit, pezullim, çuarje etj. me rastin e përgatitjes "[289] së xehes për përpunim. Sipas M. S. Filipoviqit, nga ana tjetër, këtu do të duhej inkuadruar edhe mikrotoponimin *Kižnićko Brdo* dhe *Kižnićki potok* të cilat për në Kishnicë nuk po i përmendka M. Pavloviq, ndërsa përjashta hapësirës së Kosovës këtu po u dashka të hynte edhe emri i termave *Kiževina* në rrethina të qytetit të Shtipit në Maqedoni dhe emri *Kiževak* i një burimi në rrethina të Novipazarit.[290] Duket se me rastin e interpretimit të prejardhjes së këtyre mikrotoponimeve do të duhej të merrej në konsideratë mendimi i antropogjeografit serb A. Urošević, i cili besone se venbanimi Kishnica e paska marrë emrin nga emri homonim i lumit në të cilin (emër) do të duhej të kërkohej fjala gjermane *Kies* "zhur, zhavor" përkatësisht *Kiesgrube* "Gropë zhavori".

Në të mirë të korrektësisë së etimologjisë së propozuar nga ky vetë, A Urosheviq sjell edhe një dëshmi toponimike për ta përligjur praninë e elementit etnik sas në këtë venbanim-minierë. Kjo rrethanë do të mnd të dëshmohej, githnjë sipas A. Uroševiq, mbi bazën e mikrotoponimit **Tudeski potok* tek i cili po u ruajka trajta romane, përkatësisht italiane raguzase *Tudesco, Tedesco* e emrit etnik të gjermanëve, përkatësisht të sasëve. Trajta e mundshme **Tudeski potok* paska kaluar së pari, kështu thotë autori Uroshević,[291] në **Dećki potok*, sepse popullata vendëse e paska harruar kuptimin e etnonimit *Tudeski-* dhe pse rrokja *Tu-* e emrit etnik qenka kuptuar nga popullata serbishtfolëse si të ishte parafjala serbisht *tu* "këtu". Fillimisht trajta e mundshme e kryehershme **Tudeski potok* qenka kuptuar si *Deski potok* e më vonë si *Dećki potok*. Një gjë me peshë që duhet theksuar në këtë mes është rrethana që në procesin e emërtimit të kryehershëm **Tudeski potok* nuk do të kenë marrë pjesë as shqiptarët, as serbët, sepse emri rrjedh nga trajta romane, në rastin tonë raguzase, *Tudesco* e emrit etnik të gjermanëve, përkatësisht të sasëve. Mua më duket se ka më shumë arsye të besohet që emri etnik i sasëve *tudesh* në variantin italian ose u soll në Kosovë nga vetë ai grup sasësh që më parë kishte jetuar në Raguzë dhe qysh atje e kishte marrë këtë emër, ose kështu u quajtën nga banorë të kolonisë fqinje raguzase të Janjevës. Mbase këtu nuk do të ndryshojë asgjë as rrethana që Miklosich shënonte që më 1870 se variantet italiane todesco, tedesco paskan depërtuar edhe në shqipen e në serbishten, sepse dëshmia *tudeschi* shm. *-te* "teutones" që ndeshet në Fjalorin e Frano Bardhit mund të jetë një huazim librar, huazim i

[289] V. Skarić, Staro rudarsko pravo i tehnika. .., f. 21.
[290] M. S. Filipović, Das Erbe., f. 209.
[291] Neki detalji iz prošlosti Kosova, Onomatološki prilozi I, Beograd, SANU, 1979, f. 28.

syrit, meqë nuk dihet që kjo fjalë të jetë dëshmuar në terren në ndonjë të folme të Veriut të Shqipërisë apo të Kosovës, ndërsa dëshmitë *tudešak, tudeškinja* Miklosich i mban me të padrejtë për të serbishtes, sepse të folmen sllave të Raguzës ky e mbante gabimisht për të folme serbe[292] e jo kroate.

Përkitazi me këtë duhet shtuar më tej se fjala *kizhavinë*/*kizhovinë* ndeshet edhe në të folme shqipe, madje pikërisht në ato zona në të cilat kishte e ka miniera dhe gjurmë mineralesh të shkrira dhe që, kjo fjalë, e ka gjithandej kuptimin "Vend në të cilin rrjedh ujë i ngjyrosur me erë të pakëndshme mineralesh". Ky kuptim i fjalës tek shqipfolësit përputhet plotësisht me kuptimin "rrjedhë uji që përmban hekur" Kjo fjalë ndeshet sipas M. S. Filipoviqit, mbase tek popullata serbishtfolëse, në regjionin e Kopaonikut, ku del në trajtën *kiže*.[293] Fjalën *kizhavinë* më ka rënë ta shënoj në katundin Bajgorë të krahinës së Shalës, në territorin e të cilit (katund) gjendet kodra e zhveshur e Picelit e cila mbase, pikërisht kjo, në Ligjin turk të Trepçës mbi minierat dëshmohet për si minierë më vete me emrin *Pikine.*[294]

Përveç në leksik, termi mineralogjik *kizhavinë* ndeshet edhe në mikrotoponimi. Mikrotoponime të sajuara nga kjo fjalë ndeshen kryesisht në hapësirën që e mbulojnë malet e Kopaonikut, përkatësisht në atë zonë ku gjendet edhe miniera aktive e Trepçës. Vetëm sa për ilustrim po i sjell shembujt: *Kizhavina* "Burim i vogël uji me kundërmim mineralesh" në katundin Melenicë dhe *Kizhevinat* - disa puse minierash përgjatë brigjeve të lumit *Kizhenica* në katundin Magjere të Mitrovicës[295] dhe mikrotoponimi *Gropa e kizhave* - një pus miniere në katundin Junik të Gjakovës.

Në dritën e shembujve toponimikë në të cilët përmbahet trajta *kizh*-përkatësisht mbiemri *kizhavinë* duket se ka mjaft arsye të besohet se trajta serbe *Kišnica* e emrit të vendbanimit e minierës është në të vërtetë një serbizim kohësisht i ri i një trajte *Kižnica si rezultat i ndikimit të etimologjisë popullore serbe, gjë që do ta dëshmonte edhe rrethana se në të folmen lokale serbe të rrethinave të Kizhnicës nuk gjallon as apelativi *kiža* e as mbiemri *kižovina.*

Këtij paravendimi i del mbase krah rrethana se edhe emri i sotëm shq. Kizharekë, serb. Kišna Reka i një katundi të krahinës së Drenicës qysh

[292] Khs. Franz Miklosich, Die romanischen Elemente im Albanischen, Wien, 1870, f. 66, njësia 853.
[293] M. S. Filipović, Das Erbe., f. 209.
[294] S. Rizaj, Rudarstvo Kosova i susednih krajeva, Prishtinë, 1968, f. 169.
[295] Mikrotoponim i shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 8, Mitrovica, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, Prishtinë, 2002, f. 89.

më 1455 dëshmohet në trajtat *Kržna Reka*, *Kržna Rika, Knaže Rika*[296] - trajta këto që gjithsesi janë më të afërta me artikulimin fonetik shqiptar *kizha* se sa me atë serb *kiša* të termit gjerman *Kiese*. Nëse emri i këtij katundi mund të lidhet pra me mbiemrin *kizhavinë* "ujë i ngjyrosur me kundërmim mineralesh", atëherë edhe ky do të duhej të konsiderohej oikonim me prejardhje sase, apo vendbanim i emërtuar nga vendësit me fjalën gjermane *Kiese* që kishte hyrë në të folmen e tyre, gjithsesi si rezultat i kontakteve, i bashkëjetesës së tyre me minatorët sasë. Këtu do të binte pas gjithë gjasësh edhe emri i vendbanmit *Kishnapole* në komunën e Gjlanit, në territorin e të cilit (katund) gjallon edhe mikrotoponimi i sajuar po ashtu nga një term gjerman i xehetarisë, *Shlakna*.

Duket se mundësia që një minierë, përkatësisht një vendbanim apo një lumë ta ketë marrë emrin sipas lopatës, sikundër mendon M. Pavloviq,[297] ose nga një minierë e piritit, çfarë nuk ka në minierën e Kishnicës -siç mendonte A. Urosheviqi, është fare e vogël. Më e logjikshme më duket që të gjithë emrat e përmendur të vendeve në këtë kontekst të kenë dalë nga fjala *kizhavin*/*kizhovinë*

Kramovik

Duket se i vetmi emër vendbanimi në Rrafshin e Dukagjinit, emri i të cilit do të mund të shihej për me prejardhje sase është emri i katundit të sotëm *Kramovik* i rrethinave të Suharekës. Dëshmimi më i vjetër i emrit të këtij vendbanimi rrjedh nga një defter turk i regjistrimit të kryefamiljarëve e të pronave në vitin 1591, kur dëshmohet në trajtën *Kramovik*[298] dhe kishte 17 shtëpi e 9 bashtina. Ky oikonim mund të rrjedh, sipas mendimit tim, nga fjala gjermane, përkatësisht sase *Kram* "Shtëpi afër pusit në të cilën jetojnë minatorët, kur nuk punojnë në minierë".[299] *Kram*-i është në të vërtetë vendi në të cilin sillet xehja për t'u larë ose "Shtëpiza në të cilën rrinë qymyrxhinjtë" (në Kreševo); "një kasolle për misër" (në Jajce), ku ende ndodhet edhe një vend i quajtur *Kram*.[300] Fjalën gjermane përkatësisht sase *Kram* të fushës së minierologjisë e gjejmë të ruajtur edhe në emrin e vëllazërisë serbe *Kramovići* në katundin Cernicë të rrethinave të Gjilanit. Trajta *Kramovnik* e këtij oikonimi do të ketë mundur të dilte nga një trajtë e paravenduar **Kramovnik* e cila si rezultat i ndërmjetësimit të

[296] Oblast Brankovića. .., f. 232-234.
[297] Khs. Ostaci dubrovačkih i saških govornih osobina u Janjevu. .., f. 298.
[298] S. Pulaha, Popullsia. .., f. 319-320.
[299] Vladislav Skarić, Staro rudarsko pravo i tehnika..., f.99.
[300] M. S. Filipović, Das Erbe. .., f. 206.

shqipfolësve tek të cilët togu konsonantik *vn* i huazimeve sllave kalon rregullisht në *n* dhe zhdukjes së plotë të atij togu.[301]

Letnicë

Një vendbanim i minatorëve sasë e i tregtarëve raguzas është pa fije dyshimi edhe katundi i sotëm Letnicë i komunës së Vitisë. Fundja, karakterin prej vendbanimi-minierë dhe të qendrës kishtare lokale të raguzasve e të sasëve të Vitisë e tregon edhe rrethana se ky vendbanim ishte në fundshekullin 15 i ndarë në dy pjesë, përkatësisht në *Pazar Letnica* dhe në pjesën bazë të vendbanimit të quajtur vetëm Letnica, me emrin tjetër *Brajko Koli*[302] "Pusi i Brajkut" e mbi të gjitha edhe gjetja aty e mbishkrimit varror të padatuar HIC NICOLAVUS IAZIT PATRIZIUS RAGUSINUS i cili ka të bëjë me një patric raguzas si edhe ruajtja deri në ditë tonat e mikrotoponimit *Varnica* me prejardhje kroate "farkëtore; shkrijetore" në territor të këtij katundi.[303] Kujtoj se është me rëndësi të përmendet rrethana që në pjesën bërthamë të vendbanimit *Pazar Letnica* kishte një banor, i cili në vend të patronimit të mirëfilltë e mbante ofiçin *tudesh* (khs. më poshtë) që mund të merret për mundësi që pararendësi i tij apo edhe ai vetë kishte qenë i përkatësisë etnike sase.[*] Përveç banorëve që mbanin antroponime e patronime thjesht sllave të variantit raguzas, në këtë vendbanim jetonim në fundshekullin 15 edhe banorët: Andreja Pava; Gjura Matosh-i; Jovan Jak-o; Gjon Andreja; Marin Petr-i; Tuna, skamnor; Deriçko, skamnor; Voja Tudesh-i; Gjon Lika; Gjurko Kolbarda; Dimitri Lik-a; Gjura Gjon-i; Jovan Lika, ndërsa në vendbanimin *Letanic* që mund të ketë qenë pjesë e Letnicës, e njohur me emrin tjetër *Brajko Koli*, jetonin vetëm tre kryefamiljarë: Branko, i bir i Gjon-it; Gjon-i, i bir i Branko-s dhe i regjistruari rishtas Nina, i bir i Gec-it.[304]

Kur po shkruante rreth relikteve gjuhësore raguzase e sase në të folmen e Janjevës, M. Pavloviq e shfaqte mendimin se emri i këtij katundi do të duhej të sillej në lidhje me fjalën gjermane *Letten* "prodhime poçarie".[305] Përveç tek kjo ngjashmëri fonematike të emrit të katundit tonë me apelativin gjerman *Letten* M. Pavloviq e mbështet etimologjinë e vet

[301] Khs. Për këtë tekstin sipri referencës 332 dhe referencën 333 të kësaj trajtese.

[302] Khs. I. Rexha, Regjistrimi. .., f. 156, 159. Vërejtje e imja. Ka shumë arsye, edhe jashtëgjuhësore, që ky emër të lexohet si Brajkovo Kolo, në kuptimin "Pusi i Brajkut".

[303] Këto të dhëna u nxorën nga libri i Jusuf Osmanit, Vendbanimet e Kosovës, 7, Vitia, Prishtinë, 2004, f. 99.

* Khs. për këtë sqarimet nën *Kishnicë* dhe referencat 292, 293 të këtij punimi.

[304] Sh. I. Rexha, Regjistrimi. .., f. 156, 159.

[305] M. Pavlović, Ostaci dubrovačkih i saških govornih osobina u Janjevu. .., f. 299, të cilën unë nuk e gjeta nëpër fjalorë të gjermanishtes.

edhe tek rrethana se në rrethina të Letnicës paska edhe të tjera toponime me prejardhje sase si *Shashar, Shashkovc, Vërnez, Vërnakollë, etj*.

Shashar

Me origjinë sase në këtë regjion do të ishte, sipas M. Pavloviqit edhe emri i katundit Shashar, i cili s'paska si të sqarohej ndryshe përveç me emrin etnik të sasëve.[306] Emri i këtij vendbanimi është dëshmuar në gjysmën e parë të shek. 15. në Librin e tregtarit raguzas Michael de Luchari i cili për një kohë të gjatë jetoi në Novobërdë khs: "*Stepan Dimitrouich vauturach de Negrimonte in cholo Sesarouichci de Negrimonti*",[307] një dëshmi kjo që tregon se ky vend edhe në atë kohë ishte ende një pus aktiv miniere dhe se emri i shënuar në trajtën *Sesarouichci* duhet të ketë qenë shqiptuar si **Shasharoviqi*, përkatësisht *Shashar*. Këtë e tregon mbase edhe trajta *Shasharina* e emrit të këtij vendbanimi që ishte dëshmuar në fundshekullin e 15 kur në këtë katund nuk kishte më njerëz me antroponime sase, porse kryesisht sish me sosh shqipe e sllave. Në këtë kohë, në katund jetonin edhe banorët e quajtur: *Gjurgji Tanush*-i; *Marko Gjin-i*; *Gjon Nikolla*; *Dimitri Gjon-i*; *Andreja Gjon-i*; *Tan Gjurin-i*; *pop Zoto* e të tjerë[308] dhe trajta *Shashar* e dëshmuar e këtij vendbanimi në regjistrimin e viteve 1566-1574.[309] Organizimin e vendbanimit plotësisht sipas tipit të vendbanimeve-miniera, përkatësisht sipas modelit të kolonive raguzase e sase e dëshmon mbase ruajtja në kujtesën kolektive të banorëve të këtij katundi e mikrotoponimit *Zagradi* (i dëshmuar në regjistrimin e pronave e të kryefamiljarëve në vitet 1566-1574), përkatësisht *Zagradije* (sot administrativisht pjesë e katundit Shashar[310]) që shënon pjesën e vendbanimit të populluar nga sasë e raguzas për të cilët kjo e kishte funksionin e tregut. Karakterin minator të këtij vendbanimi e tregon mbase dhe mikrotoponimi sllavisht *Varnica* "farkëtore, shkrijetore" në territor të këtij katundi. Në këtë pus miniere nxirrej e përpunohej xehja e plumbit dhe e zinkut.[311] Sipas regjistrimit osman të viteve 1566-1574, ky katund kishte 14 kryefamiljarë, asnjëri nga të cilët nuk mbante antroponim apo patronim që do ta dëshmonte praninë e sasëve.[312] Kjo e dhënë tregon se sasët ishin tërhequr apo ndoshta ishin asimiluar para shekullit 16.

[306] Po ai, Po aty, f. 229, 258.
[307] M. Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I., f. 74.
[308] I. Rexha, Regjistrimi …, f. 156.
[309] S. Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI, Tiranë, 1983, f. 712.
[310] Khs. J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 7, Vitia, Prishtinë 2004, f. 135.
[311] Mikrotoponimet janë shënuar në terren nga Jusuf Osmani, sh. Vendbanimet e Kosovës 7, Vitia, Prishtinë 2004, f. 133.
[312] Khs. M. Tërnava, Popullsia. .., f. 118.

Duket se një vendbanim i tipit minierë ishte edhe katundi i sotëm Binçë i komunës së Vitisë në të cilin dëshmohet topogërmadha *Kalaja* që zë një hapësirë të gjerë nëpër të cilën shihen copa të xehes së plumbit e të argjendit dhe jo larg nga ky vend ekzistojnë edhe mikrotoponimet *Samakova* e *Pazarishta*. Edhe në lagjen *Shushkët* të këtij katundi kujtesa kolektive e banorëve e ka ruajtur mikrotoponimin *Qarshia e Vjetër* nga turq. *çarşi* "treg, pazar" i cili sikur e tregon organizimin e vendbanimit sipas mënyrës raguzase e sase, përkatësisht vendbanim bashkë me sheshin, përkatësisht tregun e vendbanimit në territorin e këtij katundi. Fundja, se kjo zonë ishte e pasur me puse minerash të shfrytëzuara nga sasë e dubrovnikas do ta tregonin edhe mikrotoponimet e tipit *Madeni*, çfare ndeshen në katundet Gushicë e Ramjan i Epërm dhe ato të tipit *Samakova* në katundet Binçë e Kabash të komunës së Vitisë.[313]

Tek trajta *Shashar* e emrit të këtij vendbanimi duhet parë pas gjithë gjasësh një emër të dalë nga emri etnik i sasëve me kalimin e *s* > *sh* të tingullit nistor të emrit. Një kalim i këtillë përbrenda hapësirës jugore të Ballkanit del kryesisht nëpër ambiente në të cilët ka e kishte shqipfolës. Sikur emri i kryehershëm në trajtën **Sasar*- të ishte vazhduar nga folës të kroatishtes ose të serbishtes, do të duhej që ky të arrinte në trajtën **Sasovci* ose nën një trajtë tjetër çfarë ndeshet në pjesën më të madhe të emrave në hapësirën gjuhësore të serbishtes.

Shashkovc

Edhe dëshmimi më i vjetër i katundit *Shashkovc*, jo larg nga Janjeva, rrjedh nga viti 1566-1574, kur përmendet në trajtën Shashkofc.[314]

Tek emri i këtij vendbanimi po u dashka, sipas M. Pavloviqit,[315] të kërkohet etnonimi i sasëve. Në të mirë të këtij sqarimi po fliska, gjithnjë sipas Pavloviqit, edhe rrethana jashtëgjuhësore që ky vendbanim ndodhet jo larg nga Janjeva dhe pse po u ditka se në këtë vendbanim paska pasur minatorë sasë. Si trajta e dëshmuar në shek. 16 ashtu edhe e sotmja *Shashkovc* po e dëshmuaka toponimizimin që herët të emrit etnik të sasëve. Edhe reliktet gjuhësore sase në terminologjinë e minaralogjisë dhe të zejeve xehetare të Janjevës po dëshmuakan se sasët paskan qëndruar për kohë të gjatë në këtë vend dhe se ata, pikërisht këtu, edhe qenkan degjermanizuar.[*] Një e vërtetë që

[313] Mikrotoponimet janë shënuar në terren nga Jusuf Osmani, poaty, f. 64,, 67, 82, 89,108.
[314] Khs. S. Pulaha, Populllsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI, Tiranë, 1983, f. 702.
[315] Ostaci dubrovačkih i saških govornih osobina u Janjevu...,
[*] Kjo bëhet e qartë mbase në dritën e të dhënës se pas përtëritjes së Patriarkanës së Pejës dhe aktivitetit të ngjeshur të famullitarëve, mësuesve e të përshkruesve të librave,

në këtë kontekst duhet marrë parasysh është rrethana që në shek. 15 kishte në hapësirën e sotme të Kosovës banorë që e mbanin antroponimin *Šašat* (lexo: Shashat). Ja disa shembuj: Bogdan-i, i bir i *Shashat*-it; Jovan-i, i bir i *Shashat*-it; *Shashat*-i, plak (pa lidhje farefisërore) në katundin Gornje Rushince[316] - pas gjithë gjasësh katundi i sotëm Rufc në Rrafshin e Kosovës. Të pandashme nga emri etnik i sasëve do të ishin, në këtë kontekst, edhe mikrotoponimet *Shashkovci*, *Arat e Shashkovcit* dhe *Udha e Shashkovcit* në katundin Gadish të rrethinave të Gjilanit, të cilat mund të merren për si trajta të toponimizuara të një emri të vëllazërisë me pararendës të etnisë sase të quajtur **Shash*, përkatësisht **Shash-ko*. Duket se i së njëjtës prejardhje është edhe mikrotoponimi *Shashapotoku* në katundin Dobranjë në shpatije të katundit Magurë dhe minierës Golesh afër Prishtinës dhe mikrotoponimi *Zabeli i Shashkut*[**] në katundin Nikodim të komunës së Ferizajt. Emri *Shashapotoku* mund të ketë dalë nga një trajtë e vjetër serbe **Šašin potok* me ndërmjetësimin e shqipes në fenomenin e aglutinacionit. Nëse emri personal i përmbajtur në këtë oikonim është me të vërtetë antroponimizim i emrit etnik të sasëve mbetet, sipas mendimit tim, çështje që duhet parë. Kjo sidomos në dritën e antroponimit *Shash* që përmbahet në mikrotoponimin *Zabeli i Shashkut* (khs. më lart) dhe emri *Šaškovci* i një vëllazërie/lagjeje në katundin me popullatë "myslimane" Lubinjë e Poshtme të Prizrenit[*] si edhe për shkak se pothuaj nuk ka as edhe një shembull që gjatë mesjetës, për emër etnik të një etnie të tërë të shërbejë emri personal i një individi.

Me rastin e përpjekjeve për sqarimin e emrit personal *Sas*[317] duhet pasur parasysh edhe mundësinë që ky antroponim të sqarohet ndoshta me apelativin sllav *sas-a* lat. *carex*[318] "shavar, vullë, llashkë, shqirrë" sidomos pse në të njëjtin vend (siç është rasti me katundin Dobranjë) ndeshen emra vendesh si p.sh. *Shashkovci* e *Shashnica* ose si emri i vëllazërisë serbe *Šašinci* në luginën e Vranjes - pas gjithë gjasash me kuptim të ndryshëm, gjë që e bën sqarimin të kontestueshëm. Vetëm sa për t'u diskutuar nga të tjerë po shtoj këtu se një vend i quajtur *Sasaj* ekziston edhe në rrethina të Sarandës.

---

pikërisht në katundin Shashkovc të Janjevës zhvillohej në vitin 1649, sipas Nikola Čolak-Ive Mažuranić, Janjevo..., f. 59, aktivitet i kishës serbe në përshkrimin e librave

[316] Oblast Brankovića,..., f. 233.

[**] Të cilin e ka shënuar në terren Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpca, Prishtinë, 2004, f. 114.

[*] Edhe këtë emër e ka shënuar në terren J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 18, Prizreni, Prishtinë 2006, f. 164.

[317] Që për si emër personal mbi bazën e emrit etnik të sasëve, tek gjermanët ndeshet edhe sot në trajtën *Sasso* dhe *Sasse*, sh. Lutz Mackensen, Das große Buch der Vornamen, Wiesbaden, 1990, f. 174.

[318] F. Miklosich, Die slawischen Ortsnamen aus Appellativa. .., f. 326.

Vërnakollë/ Vërnez

Për gjurmë onomastike sase në krahinën e Karadakut, përkatësisht të komunës së Vitisë M. Pavlović i sheh edhe emrat e katundeve *Vërnakollë* e *Vërnez* (kroat. Vrnavo Kolo dhe Vrnez). Emri i parë po e heqka prejardhjen, sipas M. Pavloviqit nga gjerm. *Vornau*, përkatësisht nga gjerm. *vorn* "para, përpara" dhe sllav. *kolo* "pus miniere"[319] dhe e arsyeton këtë mendim të tijin me sqarimin se (...) ky vend, në krahasim me të tjerat, megjithmend gjendet në një rrafshnaltë, ndërsa emri *Vërnez*, sipas këtij dijetari, qenka krijuar nga parafjala gjermane *vorn* "para, përpara" dhe mbiemri *i zi* i shqipes. Nëse ky sqarim është i qëndrueshëm, atëherë emri *Vërnez* do të ishte një toponim shqiptar-sas dhe si i këtillë do të ishte edhe një dëshmi e kontakteve dhe e bashkëjetesës shqiptare-sase.

Mirëpo është fort e vështirë të pranohet se në toponimin *Vërnez* ruhet mbiemri shqip (*i*) *zi* ose që ky mbiemër do t'i jetë përngjitur qoftë edhe si rezultat i etimologjisë popullore parafjalës gjermane *vorne* ose që këtu të kemi të bëjmë me apelativin shqip *vorr,-i* "varr" fig. "gropë, pus" dhe me mbiemrin shqip (*i*) *zi* sikundër mendon M. Pavloviq.[320]

Tek emri *Vërnez* kemi të bëjmë më parë me një emër që e përmban prapashtesën shqipe të zvogëlisë *-ez, zë* (khs. p.sh. emrin e vendit *stьlpezi* të shek. 13. - sot Shtupeq në krahinën e Rugovës ose të njëjtën prapashtesë në trajtën e saj të metatetizuar tek emrat e katundeve *Firzë* nga shq. *fier* në Kosovë, *Bulshizë* nga shq. *bulk* në Shqipëri etj.).

Studiuesi kosovar Albert Ramaj më njoftonte se vendbanime të mirëfillëta kroate në Karadakun e Shkupit/Gjilanit janë Letnica, Shashari dhe Zagragja (vendbanbim fort i vogël me rreth 10 shtëpi). Për banorët e katundeve Vërnakollë e Vërnez, A. Ramaj më shpjegonte se ata qenkan në të vërtetë shqiptarë të kroatizuar. Banorë të këtyre katundeve banin deri vonë kësula të bardha, plisa dhe flisnin një gjuhë të përzjerë shqip-kroatisht ndërsa lutjet në kishë i thoshin vetëm në gjuhën shqipe. Katundi Vërrnakollë banohej më shumë nga shqiptarë se nga kroatë, ndërsa në Vërnez ka pasur më pak shqiptarë se kroatë. Pjesa më e madhe e banorëve të këtyre katundeve u larguan nga Kosova për në Kroaci gjatë viteve 1991-1993 dhe sidomos në mars të vitit 1999. Aktualisht, në Letnicë jetojnë rreth 30 kroatë, ndërkohë që në Shashar vetëm 10 sish, kryesisht njerëz të shtyrë në moshë.

[319] M. Pavlović, Govor Janjeva. .., f. 299.
[320] Po ai, po aty.

7. PËRKIME SHQIPTARE-SASE NË DRITËN E ANTROPONIMEVE

Në dritën e rrethanës se kishte edhe sasë jo të pasur, përkatësisht minatorë të rëndomtë me të cilët do të kenë punuar edhe minatorë shqiptarë (gjë që u dëshmua në kapitujt e mësipërm) dhe në dritën e rrethanës se në tregun (*mercata*) e *suburbium*-it, përkatësisht në *treg* duhet të ketë pasur edhe kontakte sase-shqiptare, pa e injoruar mundësinë që sasë, raguzas e shqiptarë të jenë takuar të dielave edhe në kishat e qyteteve, në të cilat famullitarët ishin rëndom shqiptarë, kujtoj se mund të flitet për një bashkëjetesë sase-shqiptare. Përveç kësaj, kjo bashkëjetesë, e cila do të ketë përfunduar mbase edhe me asimilimin e një pjese të sasëve të varfër të cilët nuk u larguan nga qyteti i Novobërdës kur ky, pas Betejës së Kosovës, sulmohej nga turqit, derisa edhe e pushtuan definitivisht. Kjo ka të bëjë, në të vërtetë, me pasojat që i pati shkatërrimi nga osmanët i despotatit (S.G të Brankoviqëve) dhe ndajmbathja e tij despotati vazal Perandorisë së Osmanëve. Pasoja kryesore e kësaj ndajmbathjeje ishte edhe nxjerrja, përpunimi dhe kryesisht eksporti i xehes së argjendit që nxirrej në minierat e Kosovës nuk eksportohej më për në Itali porse administrohej nga autoritet e Perandorisë Osmane.[321]

Duket se sasët e pasur e braktisën qytetin pikërisht në atë kohë. Shumica e tyre u vendosën në Raguzë e në qytete të tjera delmate e disa në Italinë Jugore. Ka pasur edhe të tillë që janë kthyer në Gjermani, ndërsa ndonjë nga ata, si *Nicola Honus Tudiesco* e shiti pasurinë e vet në Novobërdë dhe u shpërngul për në Hungari.[322] Të varfërit porse mbetën të jetonin edhe më tej në vendbanimet e tyre të kryehershme. Çështja e rrallimit të popullsisë së Kosovës mesjetare në përgjithësi dhe të asaj të qytetit të Novobërdës të asaj kohe në veçanti duhet parë, sipas dijetarit zvicran O. J. Schmitt, edhe apo kryesisht në kontekstin e një periudhe të krizës gjitheuropiane (dergjët, ftohja e klimës, të korrat e liga që u përcollën me sëmundje dhe me uri) që e kishte përfshirë edhe gjithë popullatën e krishterë të Ballkanit. Një pjesë e kësaj popullate, përkatësisht "osmanët që deri asokohe nuk ishin banorë qytetesh" ishte prekur më pak" nga këto ndeshtrasha. Megjithatë, rrënjët e suksesit të osmanëve duhen parë kryesisht tek pasojat e rënda që i la dergja e murtajës te popullata e krishterë e Ballkanit dhe te përçarja e brendshme e princërve të

[321] Sipas Oliver Jens Schmit, Die Kosovo Geschichte, Srpska Pravoslavna Crkva, në http.//www.spsportal.org/index.php

[322] Miklós Takács: Sächsische Bergleute im mittelalterilichen Serbien und die "sächsische Kirche" von Novo Brdo, Südost-Forschungen, Bd. L, 1991, f. 39.

krishterë. Si pasojë e këtyre faktorëve, pas vdekjes së Stefan Dushanit IV, Kosova e sotme u copëtua ndërmjet fisnikëve të ndryshëm ortodoksë: Balšić-ët (shq. Balshajt), përkatësia etnike e të cilëve (shqiptare, serbe apo vllahe) është e paqartë, për kohë të shkurtër e kontrollonin hapësirën nga Adriatiku deri në Prizren; Lazar Hrebeljanović-it i takonin Prishtina dhe qyteti-minierë i Novobërdës, ndërsa Vuk Brankoviqi e sundonte territorin e sotëm midis Prishtinës e Pejës.[323]

Edhe përkundër rrethanës se një numër i popullatës së krishterë të qytetit të Novobërdës u deportua për në Stamboll dhe përkundër dergjës së murtajës që këtë qytet (Novobërdën) e përfshiu në vitin 1468[324] materiali onomastik, përkatësisht antroponimet e dëshmuara më 1455 si dhe mikrotoponimet e oikonimet me prejardhje sase dhe ndonjë vëllazëri e sotme shqiptare me emra gjermanë si *Shullcët* e *Kangjovit* e Orllanit dhe *Henajt* e Llabjanit p.sh. mbeten dëshmia më e mirë se sasë nuk kishte pasur vetëm në qytetet, përkatësisht minierat e njohura të Novobërdës, Trepçës e Janjevës porse edhe nëpër katunde të rrethinës së Kamenicës, të vetë Novobërdës, në katunde të krahinës së Llapit e të Rrafshit të Kosovës. Ka shumë arsye të paravendohet se pikërisht sasët që ishin ngulitur përreth puseve të minierave anekënd krahinave të Gallapit e të Karadakut janë burimi i gjermanizmave në të folmet lokale e në mikrtoponiminë e këtyre hapësirave dhe se pikërisht kjo pjesë e sasëve së pakut pjesërisht edhe do të jetë asimiluar, përkatësisht shqiptarizuar. Nëse ky konstatim i imi mund t'i përballojë të vërtetës historike, atëherë do të rezultonte se nuk e kishin mirë asnjëri nga dijetarët (të gjithë joshqiptarë) që deri tani u morën me këtë problematikë, se sasët e hapësirës së Kosovës vetëm na qenkan sllavizuar, përkatësisht kroatizuar e më vonë serbizuar. Kjo aq më parë sa kohë që dihet se vetëdija e përkatësisë etnike, përkatësisht gjuha gjermane u kultivua kryesisht nga shtresa e të kamurve, e cila, siç u pa më lart, edhe u tërhoq e para nga Novobërda e edhe nga kolonitë e tjera siç ishin Janjeva, Trepça e Bellosica dhe nga qytete të tjera ku këta përbënin minoritet popullsie (më gjerësisht sh. më poshtë).

Nga të dhënat që për qytetin mesjetar të Novobërdës përmbahen në Defterin e regjistrimit të kryefamiljarëve e të pronave në vitet 1566-1574, mësohet se popullsia e saj ishte më pak e përzier se sa në gjysmën e parë të shek. 15. Në fund të shek. 16 në Novberdë në asnjërën nga 23 lagjet e këtij qyteti, përkatësisht në katundet e sotme përreth tij nuk kishte ndonjë

[323] Sh. punimin e tij Die Kosovo Geschichte, Srpska Pravoslavna Crkva, në http.//www.spsportal.org/index.php

[324] Sipas Miklós Takács, Sächsische Bergleute. .. f. 42.

banor që do të mbante ndonjë antroponim gjerman, përkatësisht sas;[325] as në qytetin e Janjevës me 7 mahallët e saj nuk kishte asokohe asnjë njeri me antroponim sas;[326] e njëjta situatë del edhe në Trepçë ku në 22 lagjet e saj nuk ka njerëz me antroponime gjermane, përkatësisht sase.[327] Popullsia e këtyre qyteteve mbante tani antroponime orientale, përkatësisht turke dhe pjesa më e madhe e tyre ishte popullatë vendëse e islamizuar.

Sado që nuk ka ndonjë burim nga i cili do të mësohej *vetëm* thellësia e bashkëjetesës shqiptare-sase, ky realitet historik mund të mësohet tërthorazi, përkatësisht mbi bazën e dëshmimit të pranisë së shqiptarëve në kolonitë raguzase-sase siç ishin gjatë shek. 14-16 Novobërda, Trepça, Bellosica, Letnica me rrethinë, Janjeva dhe vendbanime-miniera më pak të njohura të Kosovës dhe jashtë saj nëpër burime të shkruara.

Duke qenë se prania dhe aktiviteti i minatorëve sasë në qendrat minatore-qytete të Kosovës së mesjetës është fakt që nuk mund të vihet në dyshim, bashkëjetesa sase-shqiptare mund të dëshmohet në shembullin e pranisë së shqiptarëve që e nënkupton edhe bashkëjetesën (edhe) me sasët në qytetin mesjetar të Novobërdës dhe të rrethinës së saj të largët. Kjo vërehet si dita me diell me faktin e pranisë së njerëzve që ishin në raporte tregtie me tregtarin raguzas Michael de Luchari. Në librin e borxhlinjëve të këtij tregtari dëshmohen njerëz me antroponime apo me patronime shqiptare që ishin të inkuadruar si *hutmanë* ose ishin partnerë afaristë të raguzasve e të sasëve. Të këtillë ishin psh.: *Gon* Mali, foxer, *Gergas Zataj* e conpari foxeri, *Gez Buxatouich*, foxer der Pod (gradie), *Lex conpare* de Gurchouzi, *Mioman Gonouich* Benschouschi, *Gon* Choxiza foxer, *Ginas Sesserouich*, *Gin Nafora*, foxer, Iuan *Gonouich* foxer, conpare sue; *Gergas* frar de Nichola *Zachtaj* foxer, Andria *Gan* foxer de Pdogradie, Andria *Gonouich* hutman de Podgradie, Gurag de *Gon Arbanexo* chruzmar e foxer e Andria suo frar sortor sono in Chratoua de gran tempo dieno dare per resto, *Mechxa* foxer e plachaonizar, Andria *Gonouich* e plachaonizar, Pauao *Gonzeuich*, foxer, Nichola de *Gin Nafora*. .. piego per lui Petar bratanaz de *Gin* in Trepza. .., *Andria Nicholich Arbanexo* de Matia foxer, *Lazor* fauro de Padgradie, *Gin*, *Gon Vlchata*, foxer *Gon Belaz*, foxer per lui piegi *Gon Mali* e *Gon Vogoli*, Bogdan *Spanaz*, hutmann, *Gergj Daize* de Plauize foxer, *Gon Progonouich*, foxer, *Radossau Gonouich*, hutman ne per sie in Janeuo, *Dmitar Buxatouich*, foxer, *Radossau Zoto* in Sirze e fiol suo sartor, *Andria e Tanus*

[325] Khs. Pulaha, Popullsia., f. 539-549.
[326] Khs. Pulaha, Popullsia., f. 551-556.
[327] Khs. Pulaha, Popullsia., f. 557-565.

conpari nostri de Liuada, *Gergas* conpare de Raichouo cholo, *Tanus Bogdanouich* de Gurchouzi piego per lui *Lex* conpare"[328] e shumë të tjerë.

Nëse këta persona ishin me të vërtetë shqiptarë etnikë, do të rezultonte se shqiptarët nuk ishin vetëm punëtorë krahu, përkatësisht *Hauer*, *Sortierer* e *plachaonizar*, porse edhe *Hutmanë*"[329] e partnerë tregtarë të raguzasve e të sasëve. Këta shembuj dëshmojnë se as përputhjet onomastike-territoriale midis emrave sasë (gjermanë) të disa vëllazërive të sotme shqiptare (khs. shembujt *Kangjovit*, *Shullcët*) jo larg nga Novobërda, përkatësisht në qendra më të vogla xehetare të Kosovës së sotme nuk janë të rastit.

8. MBETJE LEKSIKORE SASE NË TË FOLME SHQIPE

Në të folme lokale të shqipes dhe në variantin letrar të saj kanë mbetur disa fjalë për të cilat konsiderohet se janë me prejardhje sase. Kështu, konsiderohet p.sh. se me ndërmjetësimin e sllavishtes, përkatësisht të raguzasve, në shqipen letrare ka hyrë p.sh. fjala gjermane *Zeche*[330] e cila në shqipen është ruajtur në trajtën *xehe***.** Dëshmimi më i vjetër i kësaj fjale në shqipen rrjedh nga shek. 17, kur Pjetër Bogdani e përmend në veprën e tij "Çeta e Profetënve" (Cuneus Prophetarum).[331] Me këtë rast është e nevojshme të theksohet se kjo fjalë nuk ndeshet nëpër të folme të Kosovës. Mirëpo ekzistimi i mikrotoponimit *Cehat*, i cili shenjon mbetje të një miniere apo së pakut gjurmë të një pusi miniere plotësisht të rrënuar me shumë shtona e horizonte në katundin Gadish, do të tregonte se këtu kemi të bëjmë me një emër vendi, i cili rrjedh nga fjala gjermane *Zeche*.[332] Kë-

[328] M. Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I., f. 38, 39, 44, 47, 51-53, 56, 63-65, 67, 69, 71, 78, 79, 83.

[329] Përkitazi me kuptimin e këtij termi ka interpetime të ndryshme. Sipas V. Skarić, Stara rudarska terminologija u Srbiji i Bosni f. Hutman do të thotë, "nëpunës të cilin e zgjedhin minatorët; gjyqtar për çështje jo fort të rëndësishme të lidhura me xehetarinë; kryepar i të gjithë minatorëve të varur". Sipas S. Pulahës, Popullsia shqiptare e Kosovës në shek. XVI- XVI, Tiranë, 1983 f. 715, ky term e paska kuptimin "Kryetar i një grupi prej 8 punëtorësh në një pus miniere", ndërsa sipas Nikola Čolak-Ive Mažuran: Janjevo, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 15, ky term e paska kuptimin "rojtar i minierës", sepse "postet, shërbimet kryesore në minierat saseraguzase ishin: drejtuesit ose urbar-ët dhe hutman-ët (gjerm. Huttemann) rojtarët e minierave.".

[330] E. Çabej, Studime gjuhësore II, Prishtinë, 1977, f. 309.

[331] Khs. " …Kah ecen e rrjedh tue kjane dhe plot me zeha ari…" cit. sipas Idriz Ajeti, Mbi gjuhën e divanit të sheh Maliqit, Studime gjuhësore I, Prishtinë, 1971, f. 31.

[332] sh. Vl. Skarić, Staro rudarsko pravo i tehnika…, f. 106. Kjo fjalë gjermane e ka (sipas K. Jireček-J. Radonić, Istorija Srba II, f. 176) pas gjithë gjasësh edhe kuptimin "Vend ku janë bërë punë xeherore".

tu kemi të bëjmë me një vazhdimësi dhe me ruajtjen e një termi gjerman të xehetarisë në trajtën e tij të pasivizuar, sepse në këtë të folme nuk ndeshet fjala xehe si pjesë e leksikut aktiv. Pikërisht "pasivizimi" i fjalës gjermane dhe ruajtja e saj vetëm në mikrotoponimi sikur e vërteton bashkëjetesën sase-shqiptare në këtë vendbanim dhe në rrethina të tij.

Në të folme të Kosovës është ruajtur edhe fjala gjermane *Rabusch*, "një shkop në të cilin, me të gdhendur vijash shenjohet vëllimi dhe sasia e mallit të dhënë hua".[333] Kjo fjalë dëgjohet tek shqiptarët si *rabush,-i* po me kuptimin e shënuar më lart. Bile ekziston edhe frazeologjizma "shkrueje n'rabush" në kuptimin "mbaje mend se ç'më ke borxh". Me prejardhje gjermane është edhe fjala *ham,-i*, "pajisje prej lëkure që kali e banë në qafë kur tërheq diçka",[334] p.sh. qerren.

Materiali mikropotonimik i Kosovës tregon se në emra vendesh të kësaj hapësire është ruajtur edhe ndonjë nocion, term gjerman i xehetarisë. I kësaj natyre është apelativi toponimik që ndeshet në emra vendesh të tipit *Rozhnjak, Roshnjak*. Ali S. Berisha i ka shënuar në katundin Prapashticë të komunës së Prishtinës mikrotoponimet *Lugu i Rozhnjakut* e *Livadhet e Rozhnjakut*, të cilat i ka përcjellur me shënimin se xehja "është shkrirë në Keqekollë."[335] Pothuaj githandej nëpër Kosovë me këtë emër shenjohet një pjesë e sheshtë, e madhe sa një lëmë e rëndomtë, e katundit. Domethënia e këtillë përputhet kuptimisht me "Vend ku fërgohet xehja dhe koncentrati i saj në mënyrë që nga zjarri të lirohen materjet e dëmshme si p.sh. surfulli dhe arseni";[336] kështu quhej edhe dheu i mbetur në këso vendesh, pasi të jetë marrë xehja e fërguar, përkatësisht dheu përpara stabilimentit në të cilin është fërguar. Fjala *rozhnjak, roshnjak* është së këndejmi një korelat semantik i gjerm. *Röstmühren, Röstsadel*. Ky term, në trajtën *roşt* ishte huazuar edhe në turqishten. Në kanuni-Sas, procesi i fërgimit, pjekjes së xehes emërtohej si *roşt etmek, roşti virmek*, që gjithsesi rrjedh nga gjerm. *rosten* "fërgoj; pjek".

Me prejardhje sase, përkatësisht gjermane janë edhe fjalët *shton/ë,-a-* "zgavër horizontale e natyrshme ose e shpuar; birë, gropë"[337] etj. dhe

[333] N. Jokl, Die magyarischen Bestandteile des albanischen Wortschatzes, Wortgeschichte - Studien aus der südosteuropäischen Sprachen, Ungarisches Jahrbuch 7 (1927), konsideron se kjo fjalë është me origjinë hungareze, por që në gjuhën shqipe ka hyrë me ndërmjetësimin e minatorëve me prejardhje nga Hungaria, përkatësisht përmes gjermanishtes së mesme që d.m.th. përmes sasëve.

[334] Vl. Skarić, Staro rudarsko pravo i tehnika,…, f.105.

[335] Khs. punimin e tij Gallapi i Prishtinës, 2007, Dorëshkrim.

[336] Vl. Skarić, Poaty, f. 103, 82.

[337] M. S. Filipović, Das Erbe …, f. 215, 217.

vantallak,-u "arë, truall, vend me plisa të mëdhenj dheu." Po qe se është i drejtë mendimi i shprehur nga N. Jokl sipas të cilit,[338] fjala e shqipes *fang-u* po rrjedhka nga germanishtja e lashtë *gotweaggs* "fushë; arë; rrafsh" dhe që, sipas I. Ajetit[339] po u përmbajka edhe në një emër vendi të katundit Mihaliq të rrethinave të Vushtrrisë dhe i paska kuptimet: "tokë e keqe që s'punohet: fushore-vend me bar", atëherë do të rezultonte që një gjermanizëm i vjetër i shqipes do të jetë edhe emri i barishtes *fang-u.* bot. Andropogon ischaemum L.; Festuca ovina L.

Fjalën *shtonë* e kam shënuar vetë në katndet Koliq e Zhilivodë të Prishtinës e të Vushtrrisë, pandaj besoj se ndeshet edhe në krahina të tjera të Kosovës. Prejardhjen sase të kësaj fjale e dëshmon, në vija të largëta, edhe rrethana që kjo përmbahet edhe në mikrotoponimin e dëshmuar për në territorn e Janjevës, mbase në shek. 15 dhe në emrat e vendeve *Štona* të dëshmuar në vitin 1739 afër Fojnicës, *Šćona*, në vendin Hodžići dhe në katundin *Šćaona Gomionica* afër Kiseljakut dhe Visokos, në Bosne dhe në emrat *Šćona*, një vend me minerale afër Kratovos, *Štona* e *Štojna*, burime uji në katundin Dolovi afër Olovos në Maqedoni.[340]

Emra vendesh të dala nga fjala *shton/ë,*-a dëshmohen pra në ato zona në të cilat ka gjurmë pusesh e minierash të lëna shkret ose mbetje mineralesh të shkrira dhe shenjon një galeri horizontale të rrëmihur. Si e këtillë, trajta shqipe *shtonë* edhe për nga kuptimi përputhet me trajtën *štona* të dëshmuar në rrethina të Kratovës, ku ky term e ka kuptimin "hyrja në minierë". Dëshmimi dhe përhapja gjeografike e kësaj fjale përputhet territorialisht me hapësirën që zënë malet e Kopaonikut, përkatësisht me vargmalet që nisin nga Novobërda, përkatësisht nga qyteti i Gjilanit dhe malet përreth Vushtrrisë e Mitrovicës paraqet një zonë aktive xeherore të Kosovës, për në të cilën dihet sigurisht se gjatë mesjetës së vonë kishte koloni në të cilat jetonin edhe sasë. Edhe sot e gjithë ditën fjala *shtonë* e shqipes e ka po atë vlerë kuptimore si edhe fjala gjermane *Stollen,* "hyrje horizontale në një minierë".[341]

Dëshmimi më i moçëm i mundshëm që e dimë deri tani i kësaj fjale në burime të shkruara rrjedh ndosha nga shek. 15, por e sigurt është një dëshmi e shek. 16. Kjo fjalë përmendet në përkthimin turqisht të Kanun-i Sas të kohës së sulltan Syleimanit (1520-1566) të Ligjit Novobërdas mbi

[338] Sipas I. Ajeti, Shqiptarët dhe gjuha e tyre, Prishtinë, 1994, f. 99.
[339] Po ai, po aty.
[340] V. Skarić, Staro rudarsko pravo i tehnika …, f.106.
[341] Edhe në të folmet popullore në Shqipëri të Veriut, në Dibër si dhe në disa glosarë e fjalorë, kjo fjalë e ka pothuaj se gjithmonë kuptimin e burimit përreth një grope, kanali të punës.

minierat. Në këtë dhe në shumicën e teksteve turke kjo fjalë del në trajtën *iştolna*. Nëse Kanun-i Sas i shek. 16 është përkthim i tekstit të përpiluar serbisht të kohës së sundimit të despotit Stefan Lazareviqit të shek. 15,[342] atëherë për me siguri mund të pranohet se fjala *štolna* do të jetë përmbajtur po në këtë trajtë edhe në dorëshkrimin e shkruar me alfabetin çirilik të gjysmës së dytë të shek. 16.[343] (khs. edhe versionin e shkruar me shkronja latine të vitit 1638) dhe shprehjet: *O zakonu štonskom*., *O pre-uzbienie štone* (Paragrafët 42, 44 e 45) të versionit të këtij ligji në shek. 16.[344] Gjykuar mbi bazën leksiokore të Fjalorit të Vuk Karadžić-it dhe të Fjalorit të Akademisë Jugosllave të Shkencave, në serbishten përkatësisht në kroatishten nuk ekziston kjo fjalë. Kjo rrethanë e lejon paravendimin se fjala shtonë, e Ligjit serb mbi Mnierat në mos qoftë bartur nga një ligj sas, atëherë do të jetë huazuar drejtpërdrejt nga gjermanishtja lokale e Kosovës, përkatësisht nga varianti i folur nga sasët i saj.

---

[342] Nga shkrime serbe të historiografisë mësohet se ky Ligj nuk qenka ruajtur në origjinalin e tij, porse vetëm një përshkrim përkatësisht kopjim me dorë i tij i gjysmës së dytë të shek. XVI. Këtë dorëshkrim e paska blerë në një auksion bashkëshortja e ambasadorit të asokoshëm serb Franc Hočevar pas Luftës II Botërore dhe ia paska falur Akademisë së Shkencave të Serbisë. Këtë Ligj e paska botuar në vitin 1962 historiani Nikola Radojčić. Me interes për një segment të dredhive të pushtetmbajtësve serbë që t'i ruajnë interesat ekonomike familjare të tyre nëpër krahinëza të Kosovës është deklarimi në këtë kontekst i të birit të kontit Lazar, despotit Stefan Lazarević i cili kur po e nënshkruante këtë Ligj shkruante se " … unë, pasardhës i tij, despoti Stefan, në toka të etërve të mij.[...]. Duke e parë gjithë atë ngadhënjim mbi tokat e etërve të mij dhe me këshillën e patriarkut, kir Spiridonit dhe nga arhijerejë të tjerë si dhe sosh të s'ime ëmë, konteshës Milica, …mora udhë në anën e Lindjes, …drejt amirit të Madh Pajazitit, që e sundonte si krahun e Lindjes ashtu edhe atë të Perëndimit. Dhe me ndihmën e Zotit e të lutjeve e çlirova këtë vend dhe qytetet e etërve të mij nga amiri i Madh Pajaziti. U ktheva në vend dhe erdha në qytetin tim të Novobërdës dhe u mblodh i gjithë kuvendi i qytetit dhe kërkoi nga zotëria ime t'ua bëj ligjin mbi minierat që e kishte zoti i parë i ndjeri i shenjt prindi im knezi Lazar [...]. Lus atë që, n'dhashtë Zoti do të jetë trashëgimtar pas nesh në fronin e zotërisë sime, që kjo bulë e imja e artë të mbetet e pandryshuar ashtu sikundër që as unë nuk i ndryshova porse vetëm i vërtetova shkresat dhe urdhrat e mbretëve e zotërinjëve të mëparshmëm. Së këndejmi, për t'i vërtetuar, po i mbështes këto shkrime të miat me këtë bulë të artë. Në Nekudim më 29 janar 1412" sipas Despot Stefan Lazarević: Predgovor i pogovor Zakona o rudnicima i Zakona Novog Brda iz 1412. godine. në //Kosovo.com / Projekat Rastko / Projekat Rastko Gračanica - Peć //:

[343] Branislav Đurđev, Turski prevod rudarskog zakona za Novo Brdo despota Stefana Lazarevića, Prilozi za orijentalnu filologiju 15 (1975), 214; B. Đonov, Saskite rudarsko-pravni zaemki v bălgarskite redakciji na "Saskija zakon", God. na Sof. Univ., Fak. za filolog., 65/2 (1072), f. 72.

[344] Vl. Skarić, Stari turski rukopis o rudarskim poslovima i terminologiji, Spomenik SKA, vëll. 79, Beograd, 1935, f. 16.

Sa i përket trajtës shqipe *shtonë,-a* ka vend të paravendohet se kjo do të jetë një zhvillim i brendshëm i shqipes nga një trajtë më e vjetër *shtomna*, e cila aështë ruajtur në mikrotoponimin kosovar *Shtomna*. Një zhvillim i këtillë është në përputhje të plotë me refleksin shqiptar të grupit konsonantik *-vn-* n *-mn-* e në *-n-* (khs. psh. emrat serbë të vendeve *Ravni Lug* shq. *Ranilluk*; *Ravna Banja* shq. *Ramabajë*; *Ravna Buća* shq. *Ramabuçë*; *Ravna Dubrava* shq. *Randubravë*; *Ravnište* alb. *Ramnishtë*; *Guvno selo* shq. *Gumnasellë* etj.[345] Një refleks i këtillë, gjykuar mbi bazën e dëshmimit të disa toponimeve, dëshmohet që në fillim të shek. 13. Shembujt e sjellur më lart e lënë mundësinë të hapur që trajta shqipe *shtonë,-a* do të jetë refleks i një trajte serbe *štovna* në të mirë të të cilit do të fliste edhe substantivi *štovnat*, që përmendet në ligjin sas mbi minatorët që kishin në pronësi puse minierash.[346] Kjo dëshmi e vërteton ekzistimin e trajtës *štovna*, e cila mund të jetë refleks i gjerm. *Stollen*. Trajta shqipe *shtonë*, mund të jetë, sikundër do ta tregonin shembujt nga mikrotoponima, refleks shqiptar i një trajte sllave të jugut *štovna*; trajta shqipe do të jetë formuar në analogji me shembujt që u përmendën nga toponimia e shek. 13 të Kosovës së sotme.

Me prejardhje sase është pas gjithë gjasësh edhe fjala *vantallak, -u*, e cila në të folmen e Moravës së Epërme (rrethina e largët e Gjilanit) e ka kuptimin "grumbuj të mëdhenj dheu; fushë me plisa të mëdhenj dheu". Kjo fjalë e zgjeruar me prapashtesën turke *-llak* (turq *-lık*) rrjedh mbase nga gjerm. *Wand* "copë e madhe minerali; plis dheu; shkëmb i madh". Duke qenë se ky apelativ i shqipes ndeshet pothuaj se vetëm në të folmen e Moravës, do të duhej lënë të hapur mundësinë që ky apelativ të ketë hyrë këndej nga greqishtja e mesme si pasojë e ndikimit bizantin mbi popullatën e kësaj pjese të hapësirës etnolinguistike të shqiptaërve. Në të mirë të këtij paravendimi do të fliste shtrirja e fjalës *vandak* kryesisht në zonat jugore të gegërishtes dhe në dialektin toskë të Jugut të Shqipërisë; kjo fjalë dëshmohet edhe ndër fjalorë të gjuhës shqipe si p.sh. në Fjalorin e Bashkimit ku del në trajtën *vannak*. Sipas N. Jokl[347] kjo fjalë ka hyrë në shqipen përmes greq. së mesme *βαντακι* "turrë, duek drithi, lëndë djegëse, dru". Këtë e tregon ç'është e drejta, gjithnjë sipas N. Jokl-it, ruajtja e

[345] Kështu mund të besohet, në dritën e rrethanës se emri i katundit të sotëm, *Rani Lug* (shq.. Ranilluk) i rrethinave të qytetit të Gjilanit dëshmohet në shek. XI. (përkatësisht në vitin 1019) pikërisht në trajtën *Rani Luk*, me kusht që ky emër të rrjedh nga një sllav. **Ravni Lug*.

[346] Vl. Skarić, Stari turski rukopis o rudarskim poslovima i terminologiji…

[347] Khs. Balkangermanisches und Germanisches im Albanischen, separat nga "Festschrift der 57. Versammlung deutscher Philologen und Schulmänner in Salzburg", 1929, f. 118-120, 107, 116, 119, 121-123, 134, 135-137.

grupit konsonantik *-and* në toskërishten, sepse sikur të kishim të bënim me një huazim më të vjetër, atëherë ky grup do të duhej të reflektohej si *-end-*. Fjala *vandak* e shqipes rrjedh nga lat. vulg. *bandum* me ndërmjetësimin e trajtës βαντακι të greqishtes së mesme; fjala latine popullore do të rrjedh nga një trajtë gjermane e perëndimit **banda* (khs. got. *bandwa*).[348] Duke qenë se trajta dialektore *vantallak*, që dëshmohet pikërisht në krahinën e Moravës ku ka edhe emra vendbanimesh me prejardhje nga greq. e mesme si p.sh. *Smira* (serb. Smirna) ose *Berijovcë* i cili, përmes etimologjisë popullore serbe si rezultat i tendencës së sllavizimit onomastik të terreneve të banuara nga serbët, ka kaluar nga një trajtë e mundshme **Perivojce*,[349] e ku deri në fundin e shek. 12 kishte qendra të rëndësishme kishtare bizantine si Binça, Prinipon (sot Përlepnica?) dhe *Preamoron* (një vendbanim e qendër kishtare e zhdukur që do të ketë qenë përbrenda mikroregjionit të quajtur serbisht Izmornik në rrethina të Gjilanit.[350]) prandaj nuk bën të hiqet nga syri se ky apelativ në këtë të folme të ketë hyrë si një gotizëm i greqishtes së mesme.

Fundja ka së pakut një dëshmi që e tregon ndërmjetësimin e shqipes në formësimin e emrave me prejardhje nga gotishtja. Një kësi "gjurme e gotëve në Epir duhet të jetë emri i vendit Γότιστα në rrethin e Joaninës, khs. got. guta "got,-i". Këtu kemi të bëjmë me të njëjtin formim si tek emri i vendit Φργκίστα (Φρ. Δυτική dhe Φρ. Άνοτολική në Eurytani i cili rrjedh nga emri i frankëve. Asnjëri nga të dy emrat nuk do të kenë kaluar tek grekët me ndërmjetësimin e sllavëve, sepse sikur të kishte ndodhur kështu do të duhej pritur një palatalizim sllav i guturaleve. Këta emra grekëve do t'u jenë ndërmjetësuar nga një popull tjetër. Për shkak të fjalëformimit të këtyre dy toponimeve për gjuhë ndërmjetësuese unë e marr shqipen. Në gjuhën shqipe prapashtesa - *ištë* përdoret dendur në emra vendesh khs. *gurištε* "vend gurinor" ; *gur* "gur, shkëmb"; *zalištε* "vend me zhavor"; *zał; rapištε* "mal me dru rrapi" - *rrap* etj." shkruante Max Vasmer.[351]

Ndër apelativa të prejardhjes gjermane, përkatësisht sase në të folme të shqipes bie edhe fjala *shkakën*, e cila ndeshet faktikisht pothuajse vetëm nëpër mikrotoponime në ato hapësira në të cilat edhe gjenden

[348] Po ai, po aty.

[349] Po të jetë kështu, emri i këtij vendi do të mund të rrjedhte nga greq. περιβολ(ον) "kopsht".

[350] Që dëshmohet në një dokument të Vasilit II (Basilios II) të vitit 1019.

[351] Khs. Beiträge zur slavischen Altertumskunde, XVII Balkangermanisches und Verwandtes, Zeitschrift für skawische PhilologieXVIII, Heft 1- Leipzig, 1941, f. 58.

gjurmë të vjetra të nxjerres dhe të përpunimit të xehes. Kjo fjalë e shqipes rrjedh nga gjerm. *Schlacke*[352] "skorje, shkrumb".

Për praninë e shqiptarëve në Kosovë, në kontekstin e bashkëjetesës shqiptare - sase - serbe do të dëshmonte edhe sllavizma *korubë,-a* që në variantin kosovar të së folmes shqipe të krahinës së Gallapit, është një term edhe xehetar që shenjonte një lug, gurrë të gjatë në formë të rrumbullakët të punuar nga dërrasa, që shërbente për kullimin e koncentratit përfundimtar të xehes.[353] Fjala *korubë* e ka sot në të folmen e krahinës së Gallapit vetëm kuptimin e të anjurit të të gjitha almiseve të punuara nga druri, të ajtjes së lisit për shkak të ndonjë sëmundje dhe të fryrjes tepër të bukës ndore. Pasi të jetë dëshmuar nëse kishte pasur aktivitet xehetar, bën të shihet nëse edhe emri Korab i maleve në kompleksin e bjeshkëve në rrethina të Gjakovës mund të lidhet me këtë term xehetar serb.

Njëra ndër huazime të drejtpërdrejta gjermane, përkatësisht sase dhe pikërisht nga sfera e jetës shtëpiake, në rastin tonë madje të asaj të kuzhinës që domosdo do t'i paravendonte kontaktet e ngushta të bashkëjetesës së thellë shqiptare-sase do ta tregonte mbase mjaft mirë sidomos folja shqipe *me mestitë*. Në variantin kosovar të gegërishtes, sidomos në krahinën e Gallapit, kjo folje përdoret për të treguar se një tretje i është hedhur bylmet më shumë se normalisht. Kjo folje e së folmes lokale të krahinës së Gallapit, në të cilën në shekujt 14-16 më shumë se gjithkah tjetër nëpër Kosovë kishte kolonistë sasë, e ka kuptimin e foljes *mesten* të gjermanishtes, ku kjo folje e ka kuptimin e ushqimit të intensifikuar të bagëtisë e të shpezëve që janë në rend për t'u therë, përkatësisht për t'u prerë. Këtu bie pas gjithë gjasash, përkrah termit *ham,-i* "pjesë e pajisjes së kalit që ngjitet për ta tërhequr qerren apo karrocën" edhe fjala *rud,ë-a* që shenjon "bigën" e qerres që e tërheqin vetëm kuajt, për dallim nga biga e qerres së tërhequr nga qetë që te shqiptarët quhet gjithandej thjesht vetëm *big, ë-a*. Për prejardhjen sase, gjermane të kësaj fjale në shqipen bën të këmbëngulet edhe përkundër rrethanës që fjala *Ruder* e ka në gjermanishten kuptimin e termit detar të lopatës, rremit që përdoret për vënien në lëvizje dhe për drejtimin e lundrës. Ka mundësi që këtu kemi të bëjmë me bartjen e kuptimit të *Ruder* të gjermanishtes edhe për drejtimin e mjeteve lëvizëse edhe në kontinent.

---

[352] V. Skarić, Stara rudarska terminologija…, f. 16.; Preißig njofton se të gjithë minatorët që punojnë nëpër miniera të Maqedonisë, mbeturinat e mineraleve i shenjojnë me fjalën gjermane *Schlacke*. Së këndejmi do të mund të pranohej se këtu kemi të bëjmë me një emër vendi i cili është sajuar nga ky huazim nga gjermanishtja.

[353] Khs. V. Simić, Rudarstvo i prerada gvožđa u toponomastici i terminologiji Vlasinskog kraja, në Onomatološki prilozi I, Beograd, 1979, f. 91

9. VENERIME PËRMBYLLËSE

Gjykuar mbi bazën e të dhënave të dëshmuara nëpër burime të shkruara mund të pohohet se element etnik sas kishte, së pakut gjatë sh. 14-17, në kolonitë raguzase-sase në minierat-qytete të Novobërdës, Trepçës, Bellosicës, Janjevës etj. Gjykuar sipas prejardhjes sase, gjermane te disa antroponimeve dhe patronimeve që dëshmohen në shekujt 14-16 me dozë të lartë sigurie mund të paravendohet se sasë kishte në katundet e sotme: Shajkovc, Kërpimeh, Koliq, Herticë dhe Turuçicë midis Prishtinës e Podujevës dhe në vetë Podujevën e sotme; në katundet Zhilivodë, Grabovc dhe Kollë të komunës së Vushtrrisë dhe në vetë këtë qytezë; në katundet Topillë, Greme dhe Manastirc të Ferizajt; në katundin Kotor të Skënderajt, në katundin Dragolevc të Istogut; në Serosh të Rahovecit dhe Hallaq e Rufc jo larg Prishtinës.

Në dritën e emrave të vendeve me prejardhje sase, të dëshmuara nëpër burime dhe mikrotoponimeve të ruajtura deri në ditë tonat rezulton se sasë do të ketë pasur edhe në katundet Gadish, Kishnapole e Përlepnicë të Gjilanit, në katundet Bajgorë e Magjere të Mitrovicës, në katundin Strofc të Vushtrrisë dhe në Graçanicë afër Prishtinës. Nëse sqarimet e mia për disa emra të vëllazërive janë të qëlluara, do të rezultonte se minatorë sasë kishte pasur edhe në katundet Jasenovik e Llabjan afër Novobërdës, Cernicë afër Gjilanit dhe në Orllan e në Herticë të Podujevës.

Emrat sasë të vendbanimeve do të tregonin, nga ana tjetër, se minatorë sasë kishte mbase edhe në rrethina të Gjilanit e të Vitisë (khs. Oikonimet: *Hubovc*, *Shashar*, *Vërnez*, *Vërnakollë*, *Letnicë*); në rrethina të Prishtinës (khs. oikonimet: *Hade*, *Henc*, *Brgari*, *Kishnicë* dhe *Shashkovc*); në rrethina të Rahovecit (khs. oikonimin *Kramovik*) dhe në rrethina të Klinës (khs. oikonimin *Gllarevë*).

Në bazë të kronologjisë së përmendjes nëpër burime të shkruara që i kemi deri tani të disa vendbanimeve me prejardhje sase (khs. *sasinъ studencъ Hainouo cholo*, *Cholo Sesarouichi* të viteve 1330 e 1438) dhe të disa patronimeve sase të zgjeruara me prapashtesa shqipe e sllave bëhet e qartë se prania e sasëve në Kosovë dëshmohet së pakut që para gjysmës së parë të shek. 14.

Nëse mbi bazën e dëshmimit të kategorisë sociale ekonomike të argjendarëve, të shpëlarësve të arit dhe të ndonjë minierëze pusi si dhe në bazë të antroponimeve, sado që të pakta për nga numri, të dëshmuara në dy burimet më voluminoze kishtare serbe të shek 14, mund të paravendohet se sasë kishte edhe në rrethina të Istogut, Klinës (khs. dëshmitë e v. 1330: *Toloje Sasinović* dhe *Raděi*, *argjendar* në katundin Çabiq), në Rahovec, përkatësisht jo larg nga Prizreni (khs. mikrotoponimin *Truallishtet e*

Argjendarëve të vitit 1348) e nga Gjakova (khs. Mikrotoponimin *"Shtona e hekurit"* të vitit 1330 në katundin e sotëm Botushë), atëherë kjo do ta vërtetonte korrektësinë e pohimit të medievistit të shquar M. Šufflay përkitazi ne shpërlarësit e arit, me argjentarët e me minierat në rrethina të Prizrenit dhe me njoftimet përkitazi me ekzistimin e minierave të hekurit, argjendit dhe të arit në krahinën e Lezhës të lëna batall si dhe të dhënat për shpëlarësit e arit midis Novipazarit dhe rrënojave të manastirit të Banjskës.[354]

Nëse qëndron kjo që u tha më lart, atëherë pa pasur shumë frikë nga ndonjë lajthitje mund të thuhet se sasë kishte më shumë se sa mund të mësohet nga burimet, sepse gjurmë onomastike sase ka edhe jashtë, madje territorialisht edhe shumë larg qendrave nëpër të cilat sasët dëshmohen nëpër burime të shkruara.

Mbi bazën e dëshmive antroponimike të sjella këtu nga burime të shek. 15 e 16 rezulton se sasët në Kosovën e asaj kohe kishin ruajtur disa antroponime me prejardhje gjermane si p.sh.. *Alan, Borman, Erik, Hajan, Haidin, Hainoga, Hans, Hena, Johan, Paul, Rafina* dhe *Shliman* ndrësa nga patronimet sase i kishn ruajtur: *Alan, Artur, Bernard, Bormarn, Hajan, Hanz*(*-ović*), *Hans, Henica, Johan, Kanc, Kangius, Martin, Paul, Rožman* e ndonjë tjetër. Këta mbanin dhe ndonjë patronim sllav si *Dujko, Inošević, Nenada, Raja,* por edhe patronimet shqipe si *Tanuš* e *Prog-onouich*. Ka pak shembuj kur sasët mbanin për emër personal emrin etnik të tyre (khs. *Sasin* dhe *Nemče*) dhe raste kur në vend të patronimeve të mirëfillta mbanin variantin e huaj të emrit etnik të gjermanëve dhe emrin Sas të zgjeruar me prapashtesa sllave: *Nemeščerun, Nemišić Saksen, Sasinović, Šašarović* dhe variantin italian *Theutonicus* përkatësisht *Tudiesco*. Është punë e vështirë t'i bihet n'fije nëse pas atributeve me prejardhje gjermane që shenjojnë zeje si *šnajder, šuster, štrihinić* dhe *vrugnar* mëshihen njerëz të përkatësisë etnike sase apo këso atributesh mbanin edhe qytetarë vendës që mund t'i kenë ushtruar ato zeje.

Gjatë shek. 15-16 sasët ishin bartës edhe të antroponimeve sllave: *Bogdan, Bogoslav, Bogosav, Branko, Đurko, Đurica, Jakov, Lazar, Nikola, Pavao, Petran, Pometko, Radihna, Radislav, Radivoje, Ratko, Toloje* dhe *Vlk*. Mbi bazën e lidhjeve familjarëve të njerëzve që mbanin emra apo miemra sasë, del se sasët mbanin edhe antroponimet sllave: *Petrin, Račan* dhe *Vlkosav*.

Në mbështetje të rrethanave sociale, fetare e politike që nga koha e ngulitjes në shek. 14 e deri tek ajo e largimit në shek. 17 të sasëve nga

[354] M. Shufflay, Serbët dhe shqiptarët, Prishtinë, 1968, 51. khs. edhe referencat 16, 17, 18, 54 55 të kësaj trajtese time.

hapësira e sotme e Kosovës mund të nxirret përfundimi që procesit të sllavizimit (për këtë sh. më poshtë) jo vetëm onomastik të sasëve në pjesën më të madhe i ndihmuan raguzasit, me të cilët sasët jetonin në simbiozë të ngushtë. Njëra ndër komponentet vendimtare është në këtë mes rrethana që sasët e raguzasit ishin në raporte varësie reciproke ekzistenciale nga fusha e ekonomisë për të dyja etnitë që lidhen me xehetarinë dhe me plasimin për përfitime ekonomike të atyre mineraleve. Këtij paravendimi i del krah edhe rrethana që si sasët e raguzasit e pas gjithë gjasësh edhe shqiptarët ardhës qytetarë të Republikës së Raguzës, nga Tivari, Ulqini e nga qytete të Shqipërisë së Veriut si Pulti, Shkodra, Drishti etj. ishin pjesëtarë të ritit katolik romak të krishterimit. E pandashme nga kjo është rrethana që në të gjitha kolonitë raguzase-sase jo vetëm të Kosovës së mesjetës, përkatësisht në famullitë e Novobërdës, Trepçës, Janjevës, Prishtinës, Prizrenit etj. (të cilat ishin herë nën juridiksionin e ipeshkëvisë së Tivarit e herë nën atë të Kotorit[355]), porse edhe në hapësirën e shtetit serb të Rashës priftërinjtë ishin shqiptarë. Këtu bie edhe komponenta po ashtu e theksuar nga historianë të mesjetës e martesave të përzjera të sasëve katolikë me raguzas[356] e me shqiptarë. Në mënyrë të veçantë duhet marrë në konsideratë rrethana e theksuar nga shumë dijetarë e epërsisë kulturore të tregtarëve raguzas në relacion e minatorët sasë. Kjo epërsi, që e nënkupton edhe faktorin e kroatizimit onomastik e etnik të sasëve, reflektohet nga përkatësia raguzase, përkatësisht kroate e emrave të sasëve të sllavizuar. Pothuaj të gjithë emrat sllavë të sasëve janë emra sllavë të vetë raguzasve, në krye të herës romanë, po ashtu të sllavizuar, si *Dujak*, *Pavao* e *Radihna* dhe patronime të tjera që janë karakteristike për hapësirën gjuhësore të kroatishtes. I prejardhjes raguzase do të jetë mbase edhe varianti lat. *Teotonicus* i sasëve, i cili s'është tjetër veçse ndërmjetësim raguzas i varianteve italiane *Theotonici*, *Tedesco*, *Tudiesko*[357] të këtij emri. Kjo shihet mirë mbase në dritën e dëshmisë së emrit *Chanussius Petri Saxinouich* në vitin 1364 të një burri nga Bosna, i cili

[355] Sh. Josephi Valentini, Acta Albaniae Veneta, Seculorum XIV et XV; S. O., Pars Prima, dok. 247, 222.

[356] K. Jireček - J. Radonić, Istorija Srba II, f. 91-92.

[357] Sh. për këtë te Petar Skok, Toponomastički prilozi, Časopis za slovenski jezik, književnost in zgodovino, Ljubljana 1928, f. 12.; K. Jireček- J. Radonić, Istorija Srba II, 90; Khs. edhe emrin familiar *Teutović* të banorit Raiko të katundit Soba në rrethina të Vranjës (të shënuar nga. A. V. Solovev, Povelja kralja Stefana Dušana o crkvi Sv. Nikole u Vranju, Prilozi za književnost, jezik, istoriju i folklor, 7 (1927), f. 114.; pastaj dëshminë e vitit 1440: "*pleban parcus quondam Pauli Theutonicus*" në Novobërdë (sh. M. Dinić, Za istoriju rudarstva..., f. 82) dhe sqarimet për domethënien e këtij emri në Rječnik JAZU 18, f. 259.; K. Jireček, Romani u gradovima Dalmacije tokom srednjega veka, Zbornik Konstantina Jirečeka 2, Beograd 1962, 334.

asokohe ishte vendosur në Raguzë[358] dhe mbi bazën e mbiemrit *Sasic* (të dëshmuar po në Raguzë në vitin 1289), nëse kjo trajtë është lexim korrekt i variantit *Dommicia, uxor Jurse filii condam Desine Sasig*[359] të dokumentit latin, nuk do të mund të lehej anash lehtë mundësia që disa herë sasë e raguzas kishin ardhur bashkë nga Raguza në koloni të formuara nëpër Kosovë, përkatësisht që një simbiozë sase-raguzase kishte ekzistuar, së pakut pjesërisht, qysh para ardhjes së tyre në Kosovë.

Thellësia e bashkëjetesës raguase-sase shihet edhe nga rrethana që pothuajse të gjitha distinktivet për profesionet e lidhura me xehetarinë dhe të lidhura me kierarkinë sociale të disa raguzasve janë me prejardhje gjermane, përkatësisht sase. Kështu p.sh. edhe qytetari nga Spliti "ser Antoni de Spalato..." ishte një *purguar*, përkatësisht Burger.

Raguzasit i kontribuan sllavizimit onomastik të sasëve edhe në dritën e rrethanës që këta të fundit ishin organizatorët e jetës qytetare në qytetet-miniera të Kosovës së shek. 14-16; ata ishin të vetmit tregtarë nëpër ato dhe qytete të tjera që e kishin në dorë pothuaj gjithë tregtinë dhe ekonominë e Kosovës gjatë këtyre tre shekujve. Përveç që i mbanin doganat pothuaj në të gjitha qyetet mesjetare të Kosovës, në duar të raguzasve ishte edhe prerja e monedhave në emër të sundimtarëve lokalë. Minoriteti sas, i ardhur në grupe më vete apo bashkë me raguzasit jetonte së këndejmi në ato "qytete romane" - të rrethuara nga vendbanime të popullatës vendëse shqiptare, çfarë kishte edhe në vetë ato qytete-minera, koloni raguzase-sase. Disa dijetarë porse, si M. Dinić[360] për qytetin e Novobërdës dhe G. Gjini (sh. më lart) për qytetin e Janjevës mendojnë se ato më me të dejtë do të mund të merreshin për qytete sasësh.

Si do të sqarohej ndryshe shënimi i fratit françeskan Stephanus Gaspari (Shtjefën Gaspri ?) i vitit 1671, i cili shënonte se në qytetin e Novobërdës kishte edhe atëherë 18 familje, përkatësisht 70 frymë katolikësh.[361] Kësaj bashkësie katolike i takonin atëherë edhe kishat dhe banorët katolikë[362] në vendbanaimet e quajtura *Kuci*, *Bardici* dhe *Gilasi*.[363] Gjykuar mbi bazën e prejardhjes shqipe të emrave të vendbanimeve sot të panjohura *Kuci* e *Bardici* dhe mbi bazën e përkatësisë etnike shqiptare të banorëve të katundit *Gilasi* që unë e kam identifikuar në hapësirën e katundit të sotëm Koliq të Prishtinës, do të rezultonte se popullatë katolike shqiptare nuk kishe vetëm

[358] M. Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I., f. 29, 44.
[359] C. Jireček, Die Romanen …, f. 143.
[360] M. Tërnava, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI, Prishtinë, 1995, f. 388.
[361] M. Dinić, Za istoriju rudarstva. .., II, 80.
[362] P. B. Dema, O.F.M., Shqypnija Katolike në vjetë 1671, Hylli i Dritës, 7-8 (1932), 415.
[363] Këtë emër të zhdukur të vendbanimit unë e kam identifikuar me mikrotoponimet *Guri Glasit* dhe *Kisha e Glasit* në territorin e katundit Koliq të komunës së Prishtinës.

në këto katunde, porse edhe në vetë Novobërdën. Njoftimi i Pjetër Bogdanit i vtit 1685 i cili ka të bëjë me qytetin e Novobërdës tregon qartazi se qëkur ky qytet kishte rënë në duar të turqve këtu kishin mbetur vetëm edhe dhjetë shtëpi shqiptarësh katolikë. Mirëpo ky shkruante se *Li miei Albanesi si sono oferti in numero 300 soli d`impadronissi del luogo senza spargimento di sangue...*;[364] ("300 shqiptarë të mij janë ofruar që pa derdhur gjak ta çlirojnë qytetin"). Dhe këtij njoftimi të Bogdanit s'ka se si të mos i besohet, sa kohë që dihet se 5 vite para se ta hartonte këtë raport ky e kishte vendosur selinë e vet në qytetin e Janjevës dhe në librin e tij "Çeta e Profetënve" e shfaqte dëshirën "për të ndritunë atë të vobek dhee t'Arbënit e të Sherbísë, i cilli e madhe pjesë flet arbënisht, tue kjanunë dalunë dheut së Arbënit". Përkatësinë etnike shqiptare të popullatës së Kosovës 70 vite para të së ashtuquajturës "Shpërngulje e Madhe e serbëve" nga Kosova e dëshmon edhe rrëfimi i Pjetër Budit qysh në vitin 1621: "në këto treva ndejta 17 vjet dhe u mundova me mish e me shpirt me i forcue këta njerëz e këta priftën. .. me libra të përkushtuem që i shkruejta në gjuhë të tyne, për serbët dhe për shqiptarët."[365] Po këtë gjendje e dëshmon edhe shënimi i përmbajtur në një dokument të vitit 1653, përmes të cilit qytetarët katolikë *Seba Đinović*, *Ivan Dejanović* dhe *Seba Kukumagić* të qytetit të Novobërdës i ishin drejtuar Kongregacionit të Shenjtë[366] - dëshmi kjo që tregon se në mos që të tre, së pakut dy nga ata qytetarë ishin shqiptarë, katolikë të serbizuar. Kjo bëhet e qartë nga varianti *Đinović* i antroponimit karakteristik gjithshqiptar *Gjin* i zgjeruar me prapashesat sllave *-ov,-ić*; nga varianti sllav *Ivan* i po këtij antroponimi dhe patronimi *Seba* i të dyve nga ata, që është trajtë e shkurtër e antroponimit *Sebastian* i uzusit antroponimik të kishës katolike.

Sasët nuk janë mbajtur mend si etni e veçantë në kujtesën kolektive të shqiptarëve. Përkundrazi, grupet etnike romane (raguzas, kotoras, tivaras, venedikas, italianë) të ardhura nga qyete të brigjeve të Adriatikut kjo traditë i quan me emrin përmbledhës *gjenoviz*, emër ky që ndeshet në shumë mikrtoponime e në legjenda të lidhura për disa vendbanime të zhdukura që lidhen me praninë e raguzasve.[367] Është me interes të theksohet fakti që

[364] Sh. A. Theiner, Vetera Monumenta Slavorum Meridionalum Historiam Illustrantia, Zagrabiae 1875, f. 220-221.

[365] Pas Stephen Schwartz: Kosova, Prejardhja e një lufte, Prishtinë, Rokullia, 2005, 8, 14.

[366] Khs. Kosta N. Kostić, Trgovinski centri i drumovi po srpskoj zemlji u srednjem i novom veku (istorisko- geografska rasprava), Beograd 1899, f. 252, referenca 2.

[367] Vetëm sa për ilustrim po i sjell këtu shembujt: *Trojet e Gjenovizit* në katundet Orllan e Koliq dhe *Vorret e Gjenovizit* në katundin Vërbovc të Vushtrrisë pastaj *Udha e Gjenovizit* - një udhë e vjetër e cila nis në katundin Bërvenik (në Serbi); kapërcen nëpër vendin me minerale Picel në katundin Bajgorë të krahinës Shalë e Bajgorës në komunën e Mitrovicës dhe që nëpër Bjeshkët e Nemuna arrin deri në katundin Junik, prej ku e merr emrin *Udha e Ltië* dhe përfundon dikund afër Shkodrës në luginën e

pikërisht në ato vendbanime për në të cilat prania e raguzasve dhe e romanëve të tjerë ose është dëshmuar në dokumente ose është ruajtur në traditë, nuk ka sot mikrotoponime romane[368] por, përkundrazi, emra sasë të vëllazërive. Duke qenë se mikrotoponime sase ka në aso vendbanimesh në të cilat pothajse pa përjashtim ka topogërmadha që shenjojnë qytete a kështjella të lashta, të para ngulitjes së kolonëve raguzas e sasë, të banuara vetëm nga apo dhe nga shqiptarët dhe duke qenë se pothuaj të gjitha vendet me emra të prejardhjes sase janë për shekuj me radhë vendbanime të shqiptarëve dhe se nëpër disa sosh ka vëllazëri shqiptare me emra sasë lejohet të flitet për një bashkëjetesë e mbase edhe për një simbiozë sase-shqiptare. Një këso bashkëjetese mund të shihet mjaft qartë mbi bazën e materialit onomastik të dëshmuar në Librin e tregtarit raguzas Michael de Luchari të gjysmës së parë të shek. 15 (sh. shembujt në kapitullin 7 të këtij punimi) dhe të dëshmimit të disa zejtarëve shqiptarë banorë të qytetit të Novobërdës në fund të shek. 15. Asokohe për banorë të qytetit të Novobërdës përmenden edhe zejtarët *Petri, Arbanas*; *Petri, i bir i Arbanas*-it (tjetër?); *Andria, i bir i Arbanas*-it, pastaj *Gjon*-i, argjentar nga një katund jo larg nga Novobërda.[369] Në kuadër të një bashkëjetese sase-shqiptare duhet inkuadruar mbase edhe përmendjen në vitin 1400 të argjentarit *Johannes* Progonouich de Nouamonte aurifex habitator Ragusii*[370] i cili në atë vit ishte larguar nga qyteti i Novobërdës dhe ishte vendosur (sërish?) në Raguzë. Simbioza sase-shqiptare nuk është e hetueshme vetëm në Novobërdë, porse edhe tjetërkah. Si do të sqarohej ndryshe rrethana që ndër banorë të Raguzës kishte edhe të tillë që mbanin antroponime shqipe e patronime sase? Të këtillë ishin p.sh. banori i Tivarit *Thanussi Sasinouich*[371] i përmendur në vitin 1375 e ndoshta edhe *Chanussi*

lumit të Valbonës në Shqipëri. Këtu bien gjithsesi edhe mikrotoponimet *Lugu i Llatincit, Kroni i Llatincit* dhe *Guri i Llatincit* në katundin Llabjan afër Novobërdës e ndoshta, (nëse miratohet mendimi i O. Frank, Zur serbokroatischen Ortsnamenkunde, Leipzig, 1932), edhe emri i katndit *Mleçan* (nga serb. Mlečan, shm., *-i* "Venedikas") në komunën e Klinës i cili do të ishte një vendbanim romanësh, përkatësisht venedikasish.

[368] Me përjashtim të emrit *Marec* të katundit, i cili dëshmohet në trajtën *Maroueuzi* (lexo Marojevci), që ta përkujton trajtën karakteristike për hapësirën gjuhësore të kroatishtes *Maroje* të emrit personal *Marin*.

[369] Sh. Nedim Filipović, Iz istorije Novog Brda..., f. 73. Në këtë mes duhet shtuar se nga pushtimi turk e pësuan edhe zanatlinjtë, punëtorët dhe ushtarët shqiptarë të këtij qyteti. Kjo shihet qartë nga regjistrimi i popullsisë i vitit 1455 (sh. për këtë Oblast Brankovića, f. 209-210) dhe nga ai i vitit 1497 khs. Nedim Filipović, Iz istorije Novog Brda., f. 69.

* Nëse këtu nuk kemi të bëjmë me një gjermanizim të antroponimit *Gjon* të shqiptarëve.

[370] M. Dinić, Za istoriju rudarstva…, f. 82.

[371] sh. Dr. Ludovicus Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček et Dr. Aemilianus de Šufflay, Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia, Volumen II (Annnos 1344-1406) Vindobonae, MXMXVIII, dok. 324.

(Thanussii?) *Sasinouich*;[372] (nëse këtu nuk kemi të bëjmë me të njëjtin person); pastaj banori *Domince Sasen* (= Saxon?) i qytetit të Ulqinit i përmendur në vitin 1387 e ndonjë tjetër. Se kjo simbiozë nuk ishte sporadike dhe që këtu nuk kemi të bëjmë me dëshmi të rastit, e tregon rrethana që edhe ndonjë sundimtar lokal i Shqipërisë së Veriut mbane kontakte afariste me sasë. Këso marrëdhëniesh kultivonte p.sh. sundimtari Lekë Zaharia, pas gjithë gjasësh një pararendës i Nikollë Zaharisë, kështjellarit të Buduas, një familje kjo që në shek. 15 pronat dhe selinë i kishte përreth qytezave të Denjës e të Shatit mbi Dri[373] dhe një banor i quajtur *Bartholomai* i qytetit të Ulqinit që është dëshmuar në vitet 1374 e 1442.[374]

Nën këso rrethanash me të drejtë do të mund të paravendohej se sasët e Kosovës së shek. 14-17 jo vetëm u kroatizuan përmes raguzasve porse që, si rezultat i kontakteve të drejtpërdrejta me shqiptarët qytetarë të Raguzës dhe vendës të Kosovës, edhe u shqiptarizuan. Dëshmitë më transparente që e dëshmojnë kroatizimin, jo serbizimin, e sasëve, është përbërja etnike kroate e banorëve të qytetit të Janjevës, e pasqyruar në burimet osmane-turke të shek. 16 kur shihet qartë se të gjithë banorët vendës të këtij vendbanimi mbanin antroponime karakteristike kroate dhe shqiptare. E njëjta situatë del edhe në katundet e komunës së sotme të Vitisë, përkatësisht të katundeve nën juridiskionin e famullisë së Letnicës, kah edhe sot ekzistojnë oazat kroate të Letnicës, Vërnezit, Vërnakollës e mbase edhe të Shasharit, për të cilat famullitari vendës kërkonte në shek. 17 mesharë në kroatishte. Për ndonjë serbizim të mundshëm mund të flitet vetëm për individë të qytetit të Novobërdës dhe të një grushti vendbanimesh rrënzë e në periferi të Novobesdës, si p.sh. për banorët e katundit të sotëm serb të Bostanit rrënzë rrënojave të kalasë së Novobërdës në të cilin (katund) janë edhe sot rrënojat e kishës së sasëve. Procesi i shqiptarizimit, përkundrazi, duket të jetë shumë më i gjerë se ai i serbizimit. Kjo shihet qartazi sidomos mbi bazën e materialit antroponimik që ka të bëjë me të gjitha qendrat xehetare e sosh të tjerave të Kosovës së mesjetës së vonë, në të cilat atëherë janë dëshmuar persona që mbanin emra personalë ose mbiemra familjarë me prejardhje shqipe. Nga burime të kësaj natyre dëshmohet gjithashtu se midis individëve të tillë shqiptarë kishte jo vetëm minatorë të thjeshtë, porse edhe eprorë në hierarkinë profesionale. Sa i përket hapësirës etnolinguistike të shqiptarëve në të cilat pati përkime sase-shqiptare, me plotë bindje mund të thuhet se ato,

[372] Po aty, Doc. 691, 410.

[373] khs. Dr. Konstantin Jireček, Shqipnija në të Kaluemen, në Vëzhgime iliro-shqiptare / Përpiluem pej Ludwig von Thallóczy-t, Shkodër, 2004, f. 20.

[374] Dr. Ludovicus Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček et Dr. Aemilianus de Šufflay, Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia, Volumen II (Annnos 1344-1406) Vindobonae, MXMXVIII, 324.

mbase në rend të parë për shkak të mungesës apo të moszbulimit të vendeve me minerale, në Rrafshin e Dukagjinit kishin përfunduar para gjysmës së dytë të shek. 15. Te një përfundim i këtillë na shpie rrethana që në hapësirën që në vitin 1485 e ngërthente sanxhaku i Shkodrës nuk ndeshet as edhe një dëshmi e ndonjë antroponimi apo patronimi me prejardhje sase.

Përkitazi me mundësinë e shqiptarizimit të një pjese të elementit etnik sas duhet vërejtur që, për ndryshim nga serbët që jetojnë në Kosovë tek të cilët nuk ndeshet ndonjë patronim me origjinë sase, ndër shqiptarë ka së pakut tre emra vëllazërish me prejardhje sase. Kjo rrethanë e lë shtegun të hapur për të paravenduar se këtu nuk kemi të bëjmë me një shqiptarizim onomastik, por me shqiptarizim etnik të minatorëve sasë që nuk ishin shpërngulur me të tjerët. Nëse mnd të qëndrojë ky konstatim, atëherë konstatimi i dijetarit të madh K. Jireček[375] sipas të cilit me të shuar të zejes së xehetarisë kah fundi i shek. 17 sasët u kthyen në atdheun e tyre të kryehershëm ose u vendosën në Raguzë e nëpër qytete të tjera të Dalmacisë, në Itali e ndonjëri edhe në Hungari. Ky pohim do të duhej relativizuar sepse ka raste që tregojnë se sasët, përveç që, si rezultat bashkëjetesës së gjatë në kolonitë raguzase të Kosovës, në pjesën më të madhe mund të jenë shkrirë në raguzas ka dëshmi onomastike se një numër i vogël, mbase kryesisht jashtë kolonive të madha, edhe u bashkëshkri me shqiptarë.

Kur bëhet fjalë për degjermanizimin e sasëve duhet vërejtur që pothuaj të gjithë dijetarët serbë që u morën me këtë problematikë kujtojnë se sasët në të vërtetë vetëm qenkan serbizuar. Këtë qëndrim jo të drejtë e korrigjoi dijetari kosovar M. Tërnava[376] i cili me të drejtë i jep krah tezës që rezulton nga hulumtimet e K. Jirečekut se sasët në të vërtetë u kroatizuan. Kësaj teze i del krah realiteti historik i kohës: që nga koha e ardhjes së sasëve në Kosovë këta bashkëjetonin kryesisht me raguzasit që i kishin partnerë afaristë; sasët si edhe raguzasit ishin katolikë; sado që në koloni më të njohura sase-raguzase si në Novobërdë e në Janjevë sasët i kishin kishat e tyre të veçanta gjithmonë porse në *mercata*- t, sheshet e qyteteve jo shumë larg njëra-tjetrës ku edhe popullata e thejshtë sase, raguzase e shqiptare do të jetë takuar së pakut çdo të dielë, nuk mund të përjashtohet mundësia që në lokalitete më të vogla kishat katolike të kenë qenë të përbashkëta; përkatësia e ritit katolik roman e të dyja këtyre elementeve (duke përfshirë këtu edhe faktorin katolik shqiptar) do t'i ketë favorizuar martesat e përziera që domosdo e nënkupton një simbiozë. Dhe, kjo simbiozë zgjati sa edhe shfrytëzimi aktiv nga këto dy

[375] khs. Die Bedeutung von Ragusa in der Handelsgeschichte des Mittelalters, Wien, 1899, Referenca 9.

[376] Për gjithë problematikën në shqyrtim sh. librin e tij Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI, Prishtinë, 1995, sidomos f. 388-390.

palë i minierave të Kosovës, përkatësisht së pakut tre shekuj. Kroatizimin e sasëve do ta ketë përshpejtuar edhe rrethana që sasët ishin shumë më të pakët në numër se sa raguzasit. Të gjithë këta faktorë e bëjnë fort të lëkundshëm e pak të besueshëm pretendimin e p.sh. dijetarit serb M. Diniq, sipas të cilit sasët na qenkan serbizuar. Kësaj teze, historiani ynë M. Tërnava ia vë përballë mungesën e bindshme të faktorëve historikë, religjiozë e socialë që do ta favorizonin serbizimin e sasëve sa kohë që serbët ishin ortodoksë, se në kolonitë sase-raguzase të Kosovës nuk kishte jetë të organizuar kishtare ortodokse e mbi të gjitha se nëpër ato qendra koloniale nuk kishte popullatë kompakte serbe. Deklarimi i ndonjë banori të Novobërdës siç ishin individët *Seba Đinović, Ivan Dejanović* dhe *Seba Kukumagić* me antroponime shqipe në trajtën sllave të tyre dhe me patronime katërcipërisht të uzusit onomastik të kishës së Romës, nuk mund të jetë për historinë ndonjë dëshmi e qenies së Novobërdës qytet i serbëve. Një shembull të bindshëm të serbizmit të raguzasve kroatë e paraqet edhe vëllazëria sot serbe *Popolan*ët të rrethinave të Kamenicës. Përkundrazi, pikërisht rasti i parë i theksuar më lart duhet parë për model të ndikimit të propagandës së kishës serbe dhe për dëshmi të tendencës së serbizimit të banorëve katolikë me prapavijë shqiptare të qytetarëve të Novobërdës. Edhe mbi bazën e këtij argumenti po shtoj, në frymën e tezës së M. Tërnavës, se në ato koloni xehetare-tregtare të sasëve e të raguzasve, përveç kosovarëve vendës si punëtorë krahu e më rrallë drejtues të vegjël të punës nëpër miniera, por edhe partnerë afaristë, kishte - sidomos në Novobërdë, Janjevë e në Trepçë shqiptarë të ritit katolik të ardhur bashkë me raguzasit nga qyteti - republikë i Raguzës, sish nga regjioni i Matit, përkatësisht nga Drishti, Pulti, Shkodra, Ulqini, Tivari, Kotori që nuk ishin qytetarë të rëndomtë porse kryesisht argjendarë dhe se vetëm me ndonjë përjashtim që s'çon në peshë, të gjithë priftërinjtë në ato qendra ishin shqiptarë, kryesisht të ardhur në ato qendra. E pandashme, madje esenciale në këtë mes do të jetë edhe gjuha e liturgjisë në ato kisha. Nuk ka as ndonjë mundësi minimale që gjuhë e liturgjisë të ketë qenë serbishtja. Përkundrazi, ajo mund të ishte në rend të parë vetëm kroatishtja e ushtruar nga priftërinj shqiptarë - shtetas të Republikës së Raguzës e ndoshta edhe shqip nga priftërinj të ardhur nga Veriu katolik i Shqipërisë. Të gjithë këta faktorë historikë të shpijnë tek korrektësia e tezës së M. Tërnavës, së cilës i bashkohem edhe vetë, se elementi etnik sas, përveç që u kroatizua, pjesërisht edhe do të jetë shqiptarizuar.

E kontestueshme del edhe çështja në ç'kohë filloi e kur përfundoi procesi i degjermanizimit të sasëve. Edhe në këtë pikë dijetarit të merituar serb M. Diniq ia ka anda të besojë se procesi i sllavizimit të sasëve paska përfunduar para fundit të gjysmës së parë të shek. 15, përkatësisht pak vite pas pushtimit osman. Korrektësinë e kundërshtimit edhe të kësaj teze nga historiani

kosovar M. Tërnava e dëshmon edhe materiali onomastik, përkatësisht prania e njerëzve me antroponime sase në defterin osman të regjistrimit të kryefamiljarëve në vitin 1455 dhe mungesa e antroponimeve të tilla në regjistrimin osman të fundshekullit 15(1498/1499 ?) madje edhe në vendbanime që mbajnë emra me prejardhje sase. Fundja, edhe njoftimet përkitazi me të folurit e gjuhës gjermane nëpër miniera tregojnë se zhdukja e gjermanishtfolësve vërehet që në vitin 1555 kur udhëpërshkruesi frëng kishte shënuar se njerëzit që banojnë nëpër miniera (në Maqedoni) përdorin gjuhë të ndryshme si sklavinishten (serbishen), bullgarishten, greqishten e shqipen,[377] përkatësisht se që nga viti 1600 gjuha gjermane nuk përmendet më nëpër miniera,[378] sadoqë në vitin 1685, mbase për herë të fundit, përmenden *lavoratori christiani*[379] "punëtorët e krishterë" që ndoshta ka të bëjë me sasët e me raguzasit. Procesit të degjermanizimit të sasëve do t'i ketë kontribuar patjetër rrethana e konstatuar nga K. Jireček se as në shtetin mesjetar serb e as në Bosnje nuk ka pasur ndonjëherë masa të mëdha kompakte sasësh.[380]

Edhe pse temë bosht e këtij punimi nuk është struktura etnike e popullsisë së Kosovës së sotme në fund të shek. 16, pikërisht rezulatet e dala nga burimet që u përdorën për këtë trajtesë tregojnë se jo vetëm elementi etnik shqiptar i ardhur bashkë me raguzasit si qytetarë të Raguzës dhe individë priftërinj e tregtarë nga qytete të Shqipërisë së Veriut, porse edhe ai vendës patë dorë në degjermanizimin e sasëve, prandaj teza për kinse ardhjen e shqiptarëve në Kosovë pas së ashtuquajturës "Shpërngulje e Madhe" e serbëve nga Kosova pas vitit 1689 mund të jetë një lajthitje e qëllimshme, e motivuar politikisht, e lansuar nga historiografia serbe e shek. 19.

Thellësia reale e një simbioze sase-shqiptare në Kosovë, përkatësisht e shqiptarizimit të mundshëm të elementit etnik sas, do të mund të shihej edhe më mirë mbi bazën e gjurmimeve të mëtejshme në fushën e mikrotoponimisë së Kosovës.

---

[377] Khs. cit. origj. "Ceux qui habitent aux miniers de Siderocopsa, sont gents ramasses et usent de langage different, comme Eslawon, Bulgare, Grec, Albanais", te E. Pressig, Deutsche Bergbauwörter in den Balkansprachen, f. 144-145.

[378] C. Jireček, Staat und Gesellschaft…, III, f. 45.

[379] Sh. K. Jireček, Trgovački drumovi i rudnici..., f. 215.

[380] Sipas Dr. Muhamet Tërnava, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI, Prishtinë, 1995, f. 388-390.

DAS SÄCHSISCH-ALBANISCHES ZUSAMMENLEBEN IN DEN 14-16 JAHRHUNDERTEN UND EINIGE SÄCHISCHE ONOMASTISCHE UND LEXIKALISCHE SPUREN IN KOSOVA

Zusammenfassung

Aufgrund der Angaben, die in den einzelnen Urkunden zu finden sind, kann man sicher behaupten, dass es Sachsen in Novobërdë, Trepça und Janjevo gegeben hat. Nach den Vor- und Familiennamen sächs. Ursprungs zu urtielen, wie sie in den Quellen aus dem 14.-16. Jh. erwähnt werden, kann man annehmen, dass es möglicherweise in folgenden Dörfern Sachsen gab: Shajkovc, Kërpimeh, Koliq, Herticë und Turuçicë bei Podievë und in Podievë selbst; Zhilivodë, Grabovc und Kollë bei Vuçitern und in Vuçitern selbst; Topillë, Greme und Manastric bei Ferizaj (serb. Uroševac), Kotor bei Skenderaj, Dragolevc bei Istog; Serosh bei Rahovec; Hallaq und Rufc bei Prishtina.

Aus den in Quellen und von Zeitgenossen erwähnten Toponymen sächs. Ursprungs geht hervor, dass es auch in den Dörfern Gadish, Kishnapole und Përlepnicë bei Gnjilan, in den Dörfern Bajgorë und Magjere bei Mitrovica, im Dorf Strofc bei Vuçitern und in Graçanica bei Prishtina Sachsen gegeben hat. Wenn meine Erklärungen einiger Eigennamen richting sind, gab es Sachsen auch in den Dörfern Jasenovik und Llabjan bei Novobërdë, Cernicë bei Gnjilan und in Orllan und Hërticë bei Podievë.

Die Oikonime sächs. Ursprungs würden andererseits zeigen, dass es sächs. Bergleute wahrscheinlich in Gjilan und Viti gab (vgl. die Oikonime: Hubovci, Shashar, Vërnez, Vërnavo Kolo, Letnica); wieters in der Umgebung von Prishtina (vgl. die Oikonyme: Hade, Henc, Brgari, Kishnica und Shashkovc); in der Umgebung von Rahovec (vgl. das Oikonym Kramovik) und Kamenica (vgl. den Ortsnamen Hainovc) und bei Klina (vgl. das Oikonym Iglarevo).

Aus den chronologischen Erwähnungen, welche wir bis jetzt von den einzelnen Oikonymen sächs. Ursprungs bezitzen (vgl. Hainouo cholo, Cholo Sesarouichi aus der ersten Hälfte des 15. Jh.) und aus einigen sächs. Patronymen mit serb. derivativen Suffixen bzw. in der serb. Formen wird eindeutig klar, dass die Sachsen in Kosova ab den 30-er Jahren des 15 Jh. in Erscheinung getreten sind.

Wenn man aufgrund der Erwähnungen jener Anthroponyme annimmt, dass es auch in der Umgebung von Rahovec bzw. unweit von Gjakovë und Prizren Sachsen gegeben hat, lässt sich das auch mit der Ansicht von M. Šufflay in Verbindung bringen, dass die Anwesenheit verlassener Bergwerke bei Prizren und die Berichte über Eisen-, Silber- und Goldbergwerke im Gebiet von Lesh (Albanien) zeigen, dass die Sachsen nicht nur im mittelalterlichen Serbien alte und römische Bergwerke erneuert haben, sondern auch in Nordalbanien bzw. im Gebiet der Ebene des Dukagjin in Kosova. Zur Unterstützung dieser Meinung sollte man noch erwähnen, dass "... noch von der vorrömischen Zeit das Waschen des Goldes in den Flüssen andauerte". Hierher gehören verlassene Siedlungen der Goldwäscher bei Prizren, die in der Urkunde des Zaren Stefan Dušan für das Erzengelkloster und Goldwäscher, welche 1530 Kuripešić zwischen Novi Pazar und den Ruinen des Klosters Banjska gesehen hat, erwähnt werden. Ferner sind Spuren eines alten Silberbergwerks in der Nähe der Siedlung Rudnik unweit des Ortes, wo sich die Überreste des Klosters Mala Studenica auf der Mokna- Gebirge bei der Stadt Istog befinden, vorhanden. Darauf verweist uns die Nennung des Ortes Kolo gvozdeno "Einsengrube", neben welchen auch einige Schmieden erwähnt werden. Der erwähnte Erzort (und die Eisenschmiede) war in der Nähe des heutigen Dorfes Botushë bei Gjakovë.

Wenn all das stimmt, könnte man zweifellos sagen, dass es in den meisten Gebieten Kosovas Sachsen gab, mehr, als man aus den Quellen ersehen kann. Es gibt nämlich mehr sächs. onomastische Spuren außerhalb und sehr weit weg von den damals bekannten Bergwerkzentren als in den Zentren selbst.

Kann man aus dieser Beobachtung schließen, dass die Sachsen nicht nur in den großen Siedlungen gelebt und gearbeitet haben, dass sie nicht nur in den bekannten Kolonien wie Novobërdë und Trepça waren, sondern auch in weniger bekannten Orten und in den ländlichen Siedlungen oder gibt es für die Erwähnung des sächs. onomastischen Materials in diesen Siedlungen besondere Gründe? Das bleibt meiner Meinung nach dahingestellt. Wenn man allerdings die erste Variante in Betracht zieht, wäre es klar, dass eine solche zerstreute Ansiedlung der neuangekommenen Sachsen auch ihre Entgermanisierung gefördert hätte.

Aus den hier erwähnten anthropnoymischen Beispielen aus dem 14., 15. und 16. Jh. geht hervor, dass die Sachsen im heutigen Kosova in dieser Zeit in den meisten Fällen slaw. PN trugen: *Bogdan*, *Bogoslav*, *Bogosav*, *Branko*, *Đurko*, *Đurica*, *Jakov*, *Lazar*, *Nikola*, *Pavao*, *Petran*, *Pometko*, *Radihna*, *Radislav*, *Radivoje*, *Ratko*, *Toloje* und *Vlk*. Aufgrund der Verwandtschaftsverbindungen der Personen, welche sächs. Personen - oder Familiennamen trugen, kann man sagen, dass die Sachsen auch diese slaw. PN hatten: *Petrin*, *Račan* und *Vlkosav*. Die Sachsen dieses Gebietes trugen allerdings auch einige dt. PN wie z.B. *Alan*, *Borman*, *Erik*, *Hajan*, *Haidin*, *Hainoga*, *Hans*, *Hena*, *Johan*, *Paul* und *Rafina*, während die Zunamen fast regelmäßig dt. PN waren wie: *Alan*, *Artur*, *Bernard*, *Borman*, *Hajan*, *Hanz*(*-ović*), *Hans*, *Henica*, *Johan*, *Kanc*, *Kangius*, *Martin*, *Paul*, *Rožman*. Sie trugen aber auch slaw. Patronyme wie *Dujko*, *Inošević*, *Nenada*, *Raja* und alb. PN oder Patronyme wie *Tanuš* und *Progon -ouich*. Es gibt wenige Fälle, in denen Sachsen als PN ihr Ethnonym trugen (vgl. *Sasin* und *Nemče*) und statt ihrer richtigen Patronyme ebenfalls ihr Ethnonym in folgenden Formen Trugen: *Šašarović*, *Sasinović*, *Saksen*, *Nemeščerun*, *Nemišić* und *Theutonicus*. Allerdings ist es schwer, etwas Bestimmtes darüber zu sagen, ob es sich bei den Attributen, die mit *šnajder*, *šuster*, *štrihnić* und *vrugnar* ersetzt wurden, um Sachsen handelt oder ob auch andere diese Familiennamen als Berufsnamen getragen haben; es ist aber nicht übertrieben anzunehmen, dass es sich hier nicht nur um Sachsen handelt.

Die auf dem Erzbau beruhende Anwesenheit und Tätigkeit der Sachsen in Kosova wurde durch die Expansion des Osmanischen Reiches auf dem Balkan abgebrochen. “Ein Teil der Sachsen - vermutlich die Ärmeren- blieb an Ort und Stelle, während die Mehrheit, nämlich die Wohlhabenden, flüchtete. Sie ließen sich meisten in den dalmatinischen Städten, hauptsächlich in Ragusa, nieder; einige flüchteten bis nach Süditalien. Es gab sogar welche, die nach Deutschland zurückkehrten oder nach Ungarn auswanderten. Ein gewisser *Nicola Honus Tudiesco* z.B. machte 1390- ein Jahr nach der Schlacht auf dem Amselfeld- sein Vermögen zu Geld und übersiedelte von Novobërdë nach Ungarn” Aus diesem onomastischen Bild könnte man folgern, dass sich das sächs. Element in Kosova fast vollständing onomastisch slawisiert hat.

Läßt man die sprachlichen und außersprachlichen Komponenten außer acht, unter denen die onomastische Slawisierung der Albaner und der Vlachen stattgefunden hat, darf man hier hervorheben, dass bei der onomastischen Slawisierung der Sachsen den größten und entscheidendsten Anteil die Ragusaner hatten, mit denen die Sachsen regelmäßig in Symbiose lebten. Dabei ist noch zu erwähnen, dass Sachsen und Ragusarnern durch ihre Zugehörigkeit zur gleichen Religion einander näher gebracht wurden, aber man muss auch besonders die kulturelle Übermacht der ragus. Kaufleute in Bezug auf die sächs. Bergleute in Betracht ziehen. Dies kann man schließlich auch aufgrund der slaw. PN selbst, welche

die Sachsen trugen, erkennen. Fast alle ihre slaw. Namen werden auch als PN der Ragusarner belegt; noch deutlicher zeigen das die PN *Dujak*, *Pavao* und *Radihna* und die FN *Katušić* und Patronyme die für das kroat. Sprachgebiet charakteristisch sind. Dieses Ursprungs ist auch der ethnische Name der Sachsen *Teotonicus*, welcher eigentlich die ital. (bzw. ragus.) Form ihres Ethnonyms ist. Bei Ragusanern wurden sie auch ital. *Theotonici*, *Tedesco*, *Tudiesko* gennant. Aufgrund des Namens "*Chanussius Petri Saxinouich*", eines Mannes aus Bosnien aus dem Jahr 1364, der sich in Ragusa (Dubrovnik) niedergelassen hatte und aufgrund des Zunamens *Sasić* (aus dem Jahr 1289), falls dies die korrekte Lesung der lat. Urkunde ist ("*Dommicia, uxor Jurse filii condam Desine Sasig*") kann man die Möglichkeit nicht ausschließen, dass Sachsen und Ragusaner manchmal zusammen nach Kosova gekommen sind, bzw., dass die sächs.-ragus. Symbiose schon in Ragusa vorhanden war. Hier muß man noch erwähnen, dass (nach dem Wortschatz im *Buch* des Michael de Luchari zu beurteilen) fast die ganze Bergwerksterminologie in den ragus.-sächs. Kolonien eigentlich deutschen Ursprungs ist.

Die Ragusaner trugen auch dadurch zur onomastischen Slawisierung der Sachsen bei, weil diese die Organisatoren des städtischen Lebens in den Stadtzentren Kosovas im 14-17. Jh. waren (besonders in den Bergwerkskolonien); sie waren die einzigen Kaufleute in diesen Städten, und vor allem war fast das gesamte Wirtschaftsleben in ihren Händen, sogar das Prägen der Münzen. Die dazugekommenen Sachsen, die den Ragusanern gegenüber in der Minderheit waren, lebten demnach in diesen "romanischen Städten" - umgeben von den Siedlungen der bodenständigen alb. Bevökerung, die es bestimmt in diesen Städten gab. In der alb. Überlieferung wurden diese ethnischen Gruppen bzw. die Ankömmlinge aus den Küstenstädten, d.h. Ragusaner u. a., stets nur als *Gjenoviz* "Genuesen" bezeichnet. Dies kann man durch vielen zeitgenössischen Flurnamen beweisen. Hier könnte man noch die Tatsache erwähnen, dass gerade in den Gebieten, in denen es Benennungen gibt, welche die Erinnerung an die Romanen, "Genuesen" d.h. Ragusaner bewahren, keine romanische Flurnamen vorkommen, sondern im Gegenteil sächs. Flurnaamen und sächs. Familiennamen. Neben den Ragusanern, kamen nach Nvoberdo und anderen Minen- Städte Kosovas auch italienische Händler die hauptsächlich aus Venedig hierher kamen. Da sich die sächs. Flurnamen andererseits in diesen Siedlungen befinden, wo es regelmäßig Benennungen gibt, die Städte oder Befestigungen kennzeichnen, in denen auch (oder nur) Albaner gelebt haben, und da fast regelmäßig alle Oikonyme sächs. Ursprungs seit Jahrhunderten alb. Siedlungen bezeichnen und einige heutige alb. Sippen sächs. Namen tragen, kann man auf jeden Fall von einem alb. - sächs. Zusammenleben sprechen. Solch ein Zusammenleben kann man klar auch aufgrund des onomastischen Materials, welches das *Buch* der Schuldner des ragus. Kaufmannes Michael de Luchari aus der ersten Hälfte des 15. Jh. enthält und aus der Anwesenheit eines Goldschmiedes, eines Bewohners von Novobërdë, Ende des 15. Jh. ersehen. Damals wurden auch die Handwerker *Petri, Arbanas*; *Petri, Sohn des Arbanasen*; *Andria, Sohn des Arbanasen*, dann *Gjon*, Goldschmied aus einem Dorf unweit von Novobërdë, erwähnt. Man darf vor allem aus der Erwähnung aus dem Jahre 1400, nach der ein *Johannes Progonouich de Nouamonte aurifex habitator Ragusii* aus Novobërdë ausgesiedelt wurde, auf alb.-sächs. Berührung schließen. Dies wäre glaubwürdig, wenn man sicher sein könnte dass, *Johann* nicht als eine "europäisierte" Form des Albaner- Namens *Gjon* annehmen kann. Ein alb.-sächs. Zusammenleben in Novobërdë wird auch aus Erwähnungen über Albaner wahrscheinlich, die als Grubenarbeiter, "Hutmänner" angestellt waren oder als Handelspartner fungierten, was häufig vorkam: "*Gon* Mali, foxer, *Gergas Zataj* e conpari foxeri, *Gez Buxatouich*, foxer der Pod (gradie); *Lex* conpare de Gurchouzi, Mioman *Gonouich* Benschouschi, *Gon* Choxiza foxer, *Ginas* Sesserouich, *Gin Nafora*, foxer, Iuan *Gonouich* foxer, conpare sue; *Gergas* frar de *Nichola Zachtaj* foxer, Andria *Gan* foxer de

Pdogradie, Andria *Gonouich* hutman de Podgradie, Gurag de *Gon Arbanexo* chruzmar e foxer e Andria suo frar sortor sono in Chratoua de gran tempo dieno dare per resto, *Mechxa* foxer e plachaonizar, *Andria Gonouich* e plachaonizar, Pauao *Gonzeuich*, foxer, Nichola de *Gin Nafora*. .. piego per lui Petar bratanaz de *Gin* in Trepza. .., Andria *Nicholich Arbanexo de Matia* foxer, Lazor fauro de Padgradie, *Gin*, *Gon* Vlchata, foxer *Gon* Belaz, foxer per lui piegi *Gon* Mali e *Gon Vogoli*, Bogdan *Spanaz*, Hutman, *Gergj Daize* de Plauize foxer, *Gon Progonouich*, foxer, Radossau *Gonouich*, hutman per sie in Janeuo, *Dmitar Buxatouich*, foxer, *Radossau Zoto* in Sirze e fiol suo sartor, *Andria e Tanus* conpari nostri de Liuada, *Gergas conpare* de Raichouo cholo, *Tanus Bogdanouich* de Gurchouzi piego per lui *Lex* conpare" und einige mehr.

Diese Symbiose bemerkt man nicht nur in Novobërdë sondern auch anderswo. Wie könnte man anders die Tatsache erklären, dass es unter den Bewohnern von Ragusa im 14. Jh. auch solche gab, die alb. PN und sächs. Patronyme trugen? So z.B. der aus Antivari stammende *Thanussi Sasinouich* aus dem Jahre 1375 und vielleicht auch *Chanussi* (*Thanussii*?) *Sasinouich*, (wenn es sich hier nicht vielleicht um die gleiche Person handelt); dann noch der Bewohner von Ulqin *Domince Sasen* (=Saxon?) aus dem Jahre 1387. Dass eine Symbiose nicht sporadisch war, und dass es sich hier nicht um zufällige Beispiele handelt, zeigt auch die Tatsache, dass zeitweilig ein regionaler nordalbanischer Herrscher Geschäftsbeziehungen mit Sachsen pflegte. Solche Beziehungen hatte anscheinend der Herrscher Lekë Zaharia, allen Anscheinen nach ein Nachfolger von Nikola Zaharia, eines albanischen Verwalters von dem Burg in Budua (heute Budva in Montenegro), eine Familie die im 15 Jahrhundert ihre Landgüter und ihr Herrschersitz in der Umgebung von den Städten Danja und Shati in den oberen Ufern von Drini- Fluss in Nordalbanien hatten.

Unter solchen Umständen könnte man wohl mit Recht annehmen, dass das sächs. Element in Kosova nicht nur slawisiert bzw. kroatisiert und serbisiert, sondern als Resultat dieser Kontakte auch albanisiert wurde. Dies zeigt sich besonders daran, dass aufgrund des anthroponymischen Materials, das sich auf alle mittelalterlichen Bergwerkszentren sowie auch auf Städte in Kosova bezieht, sehr deutlich die Anwesenheit von Personen erkennbar ist, die alb. Vor- oder Familiennamen trugen. Ebenso geht daraus hervor, dass es unter ihnen auch alb. Bergleute gab. Was den Zeitraum eines solchen Berührungsprozesses betrifft, kann man zuverlässig sagen, dass er in der Ebene des Dukagjin vor der zweiten Hälfte des 15. Jh. beendet war. Zu diesem Schluss führt uns die Tatsache, dass in dem Sandschak von Shkodra aus dem Jahr 1485 keinen einzigen sächs. PN oder Patronym gibt. Wenn man die Möglichkeit der Albanisierung einigen Sachsen auch außersprachlich betrachtet, scheint es, dass sich die Sachsen von Kosova möglicherweise mehr albanisiert als slawisiert haben. Zur Unterstützung dieser Annahme kann man anführen, dass die Sachsen und die Ragusaner, aber wahrscheinlich auch ein Teil der Albaner (besonders in den mittelalterlichen Bergwerkszentren und Marktplätzen) Katholiken gewesen sind und dass, mit Ausnahme des Pfarrers *donus Parcus quandam Pauli Theutonicus*, ein aus Köln stammender Priester, der während den Jahren 1421-1422 in Novobrdë diente, alle Pfarrer in den ragusanisch - sächsischen Kolonien im Gebiet des mittelalterlichen serb. Staates bzw. in den Pfarrkirchen von Prizren, Novobërdë, Trepça und Janjevo (welche wechselweise zum Bistümern von Tivar (Antibari) und Kotor gehörten) fast durchwegs Kotoraner oder Albaner aus Ragusa, Shkodra, Pulti und anderen Orten der katholischen Nordalbanien waren. Den Prozess der Entgermanisierung könnte der Umstand beschleunigt haben, dass die Sachsen auch durch Heiraten mit anderen Katholiken, also Raguraner und Albanern, sich verschmolzt haben; das umso eher, weil die alb.- ragus. Symbiose nicht bedeutungslos ist und weil dieser Prozess auch in Ragusa selbst beobachtet wird, daher sicherlich auch in den ragusan. Kolonien im heutigen Kosova.

Wie könnte man anders die Notizen des Franziskaner-Paters Stephanus Gaspari aus dem Jahre 1671 erklären, welcher notiert, dass es in Novobërdë 18 Familien bzw. 70 katholische Seelen gab die allesamt albanische Namen trugen und in denen Katholiken lebten. Zu dieser Gemeinde gehörten auch die Kirchen in den heute verschollenen Dörfern Kuci, Bardici, und Gilasi, Nach dem alb. Ursprung der Namen der verschollenen Dörfer *Kuçi* und *Bardiqi* und nach der heutigen ethnischen Zugehörigkeit der Bevölkerung des von mir identifizierten Dorfes Gilasi zu urteielen, dürfte nicht nur in diesen Dörfern, sondern auch in Novobërdë selbst eine katholische alb. Bevölkerung gegeben haben. Der Bericht von Pjetër Bogdani aus dem Jahr 1685 zeigt dies klar, wo er von der Lage in Novobërdë berichtet dass, damals noch zehn Häuser übriggeblieben waren, als es in die Hände der Türken kam: "Li miei Albanesi si sono oferti in numero 300 soli d'impadronissi del luogo senza spargimento di sangue... " die Burg von Novobërda zu befreien. Das gleiche zeigt auch die Notiz aus dem Jahre 1653, wonach die Bürger Novobërdas: Seba Đinović, Ivan Dejanović und Seba Kukumagić zwei von denen die Kurzform des westlichen christlichen Namen *Sebastian*, und der einer den typischen albanischen PN Gjin im Funktion seines Patronyms sich an die Heilige Kongregation als "Serben katholischer Blutes" wenden.

Die Albanisierung der Sachsen setzt voraus, dass man die sächs. PN, Patronime, Flurnamen und Oikonyme in Kosova nicht gesondert vom gesamten mittelalterlichen onomastischen Material betrachtet. Die Tatsache dass, die erwähnten sächs. PN und ON mit slaw. (serb.) derivativen Suffixen gebildet sind, zeigt keinesfalls, dass es nur sächs.-serb., bzw. sächs. - ragus. Berührungen gegeben hatte, denn diese Namen werden gerade in der Zeit belegt, als der Prozess der onomastischen Slawisierung der Albaner in diesem Gebiet abgeschlossen war, bzw. in der Zeit, als die Albaner ebensolche slaw. Namen trugen wie die Slawen selbst. Daher waren die slawischen PN bei den Albanern sehr häufig vertreten.

In Verbindung mit der Möglichkeit der Albanisierung eines Teiles des sächs. Elements kann man bemerken, dass es im Unterschied zum Fall des serb. Volkes, bei den Albanern dt., sächs. SN gibt, bei den Serben (in Kosova) hingegen nicht. Diese Sachlage lässt die Meinung zu, dass man nicht nur von einer onomastischen, sondern auch von einer ethnischen Albanisierung einzelner Sachsen sprechen kann. Da es tatsächlich auch Beispiele ethnischer Albanisierung der Sachsen gibt (darauf verweisen dt. Namen einiger alb. Sippen), kann man der Behauptung von K. Jireček nicht gänzlich zustimmen, der meint, dass Sachsen nach Abnahme der Bergbautätigkeit, d. h. Ende des 17. Jh., in ihre Heimat zurückkehrten oder sich in Ragusa aufhielten, sondern man muss vielmehr annehmen, dass sich diese auch mit den Albanern verschmolzt haben.

Wenn man die Anwesenheit und Tätigkeit der Sachsen als unbestritten annimmt, kann man die sächs.-alb. Berührungen in Kosova auch aufgrund der alb. Personen- und Zunamen der Menschen erkennen, die in Handelsbezeichnungen mit dem ragus. Kaufmann Michael de Luchari standen, welcher in dieser sächs.- ragus. Kolonie tätig war. In diesen Anmerkungen wird deutlich, dass in den Bergwerken von Novobërdë, aber nebenbei auch in Janjeva, Trepça u. a., wenn auch die Bevölkerungsstruktur sehr heterogen war, ebenfalls Albaner arbeiteten.

Der Grad einer möglichen ethnischen Albanisierung der Sachsen bzw. einer alb.-sächs. Symbiose innerhalb Kosovas wird aufgrund des onomastischen Materials aus den Gebieten, in denen es während des Mittelalters Sachsen gab, deutlich erkennbar. Es bedarf allerdings noch intensiver und systematischer Materialsammlungen auf dem Terrain.

BASHKËJETESA E SHQIPTARËVE DHE E RAGUZASVE NË KOSOVË DHE NË REGJIONIN E TOPLICËS NË DRITËN E DISA BURIMEVE RAGUZASE TË SHEKJUVE 14-15

Përmbajtja

BASHKËJETESA E SHQIPTARËVE DHE E RAGUZASVE NË KOSOVË DHE NË REGJIONIN E TOPLICËS NË DRITËN E DISA BURIMEVE RAGUZASE TË SHEKUJVE 14-15 127

01. VENERIME HYRËSE: 127
1. RAGUZASIT NË QYTETE TË KOSOVËS 131
2. SHQIPTARËT NË NOVOBËRDË DHE NË VENDBANIMET PËRRETH NË DRITËN E DOKUMENTEVE MË TË VOGLA RAGUZASE 141
3. ANTROPONIMET E SHQIPTARËVE NË DRITËN E TESTAMENTIT DHE TË LIBRIT 145
3.1. Venerime 1 150
4. MBI DISA EMRA TË DËSHMUAR TË SHQIPTARËVE NË TESTAMENT E NË LIBËR DHE PËRPUTHJEN E TYRE ME EMRA TË SOTËM TË VENDEVE E TË VËLLAZËRIVE KOSOVARE 161
4.1. Venerime 2 178
5. SHEMBUJ TË BASHKËJETESËS E TË BASHKËSHKRIRJES RAGUZASE-SHQIPTARE 203
6. SHQIPTARËT NË PJESËN JUGORE TË "SERBISË" 234
7. RRETH PREJARDHJES SË DISA ANTROPONIMEVE TË DËSHMUARA NË BURIME RAGUZASE 240
7.1. Venerime përmbyllëse 251
DAS ZUSAMMENLEBEN DER ALBANER UND DER RAGUSANER IN KOSOVA UND IN DER REGION TOPLICA IM LICHTE EINIGER RAGUSANISCHER QUELLEN AUS DEM 14 UND 16 JAHRHUNDERT 253
(Zusammenfassung) 253

BASHKËJETESA E SHQIPTARËVE DHE E RAGUZASVE NË KOSOVË DHE NË REGJIONIN E TOPLICËS NË DRITËN E DISA BURIMEVE RAGUZASE TË SHEKUJVE 14-15[*]

"Zhvillimi i shpejtë dhe i madh ekonomik i shtetit serb të mesjetës mund të kuptohet vetëm nëse merret parasysh fakti se ai ua kishte besuar rolin udhëheqës dubrovnikasve në të gjitha degët ekonomike: në xehetari, në zejtari dhe në tregti. […] *Me hapjen e xeheroreve në Novobërdë, Janjevë, Trepçë etj., në shek. XIV dhe me funksonimin e tyre gjithnjë e më të madh, ky territor merr një rëndësi të tillë për qytetet e Dalmacisë, posaçërisht për Dubrovnikun, çfarë më vonë do ta ketë Amerika e posazbuluar për Evropën"* […][1] *"Nga shek. 13 deri në atë 16 pothuaj se e gjithë tregtia e Ballkanit ishte në duar të Raguzës e të raguzasve. Tregtarë e afaristë raguzas kishte gjithandej kah kishte miniera e sheshe qytetesh. Pa Raguzën dhe rolin e saj jo vetëm në fushën e ekonomisë, historia e Ballkanit e asaj kohe do të rrjedhte gjithsesi krejt ndryshe."*[2]

01. VENERIME HYRËSE:

Për si ilustrim i citateve të shenjuara në referencën 1 të kësaj trajtese duhet të theksohet se pas rënies së Perandorisë së Vjetër Otomane, venedikasit e gjenovasit (shqip në miktoronime Gjenovizët) nuk i humbën liritë që i kishin, porse këta nuk mundën t'i bënin ballë konkurrencës së raguzasve, të cilët shumë shpejt e morën në duar të tyre gjithë qarkullimin përbrenda Gadishullit, kjo sepse me perandorinë osmane

[*] Një version i shkurtër i këtij punimi, nën titullin Antroponimia e shqiptarëve në Serbinë e Jugut gjatë shekullit XV në dritën e burimeve onomastike raguzase, u botua në revistën "Dituria" (Prishtinë) të studentëve më 1978; Versioni më i gjatë i këtij punimi nën titullin Antroponimia e shqiptarëve të krahinës së Gallapit, Moravës e të Serbisë Jugore gjatë shekullit XV në dritën e burimeve onomastike raguzase të shek. XV u botua në "Gjurmime albanologjike" (Prishtinë) 6/1976, f. 103-118 dhe një version më i gjatë i përkthyer në germanisht Personennamen der Albaner in Kosova und im Teilgebiet Toplica im Lichte der ragusanischen Quellen aus dem XV. Jahrhundert u botua në revistën "DARDANIA", Wien 5/1996, f. 37-72.

[1] Muhamet Tërnava, Populsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI, Prishtinë, 1995, f. 272.

[2] Nikola Čolak-Ive Mažuran: Janjevo, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 9.

raguzasit kultivonin marrëdhënie të mira që nga viti 1365. Nga sulltanë osmanë-turqë këta merrnin letra në sllavisht (serbisht) dhe u paguanin atyre (sulltanëve) një haraç prej 12.500 duketësh venecianë. Së këndejmi, raguzasit jetonin të lirë nëpër qytete; ata i mbanin të papenguar shërbimet fetare dhe karvanet e tyre kalonin pa u pas dëmtuar fare nëpër hapësirat e Perandorisë. Lulëzimi i poezisë (serbe-kroate) në Raguzë ia dha këtij qyteti epitetin *Athina e sllavëve të Jugut*. Por tërmeti i tmerrshëm i vitit 1667 e paralizoi fuqinë dhe famën e Raguzës brenda ditës - konstatonte C. Jos. Jireček.[3]

Mungesën e materialit antroponimik nëpër burime kishtare serbe të shek. 13-15[4] për disa regjione të veçanta ose për një numër vendbanimesh të Kosovës së sotme e plotësojnë në njëfarë mënyre disa dokumente të sundimtarëve serbë të drejtuara përfaqësuesve të Republikës së Raguzës (kroat. Dubrovnik, shqip në shek. 17: *Rush*) ose shkëmbime të thjeshta njoftimesh midis tyre dhe Këshillit të Madh e të Vogël të Republikës së Raguzës e të sundimtarëve lokalë serbë dhe anasjelltas. Së këndejmi, tema qendrore e këtij punimi do të trajtohet më shumë nga aspekti i dëshmimit të pranisë së mohuar nga historiografia serbe e shqiptarëve në këtë pjesë të hapësirës etnolinguistike të tyre sesa me dëshmimin e pranisë, historikisht të dëshmuar, të shtetasve të Republikës së Raguzës nëpër kolonitë raguzase-sase të Kosovës së shek. 14-17.

Marrëveshje me karakter tregtar me Republikën e Raguzës nuk kishin lidhur vetëm sundimtarë serbë, porse edhe sundimtarë lokalë përbrenda Principatës së Arbërit, përkatësisht të *Regnum Albania*-s së shpallur nga Anzhuinët.[5]

Lidhjet e sundimtarëve shqiptarë të Principatës së Arbrit me Republikën, përkatësisht me tregtarë të Raguzës i dëshmojnë edhe disa të dhëna nga burime të shkruara. Kështu p.sh., K. Jireček ka konstatuar se përjashta qytetit (SG: të Shkodrës), përkatësisht në "(Sub-Scutari në Nënshkodra) banojshin tregtarë raguzanë afër nji kishe të Shna Vlashit." Raporte të drejtpërdrejta me Republikën e Raguzës kishte edhe i ati i heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu i cili "Qysh më 1413. .. ishte qytetar i Raguzës, mbas vendimit të Consilium Pogatorum-it (mbi pranimin e zotit Gjon Kastriot si qytetas e si shefitar t'onin me të gjitha

[3] Khs. librin e tij Geschichte der Bulgaren, Prag, 1876, cit. sipas Textor Verlag Frankfurt am Main, 2008, f. 460.

[4] Khs. S. Gashi: "Emrat e shqiptarëve në shekujt 13-15 në dritën e burimeve kishtare serbe".

[5] Khs. P.sh. Aleksandar Solovjev: Nepoznat ugovor Dubrovnika s arbanaškim vladarom iz početka XIII veka, Arhiv za društvene i pravne nauke, XVII (LXIV), Beograd, 1933.

privilegjet e imunitetet, qi u epen qytetarvet nderi)" dhe në maj të v. 1426 nga Republika e Raguzës kërkonte edhe një mjek personal. Sundimtarit shqiptar "...me 18 kallnuer 1430 kshill' i madh i Raguzës vendosi t'i dërgonte. ..nji dhunti stofnash me nji vlerë 150 perperësh e ambasadorit të tij Nikoll Sumës nji cohë 50 perperësh".[6] Këto raporte ishin të kushtëzuara edhe nga rrethana se "Udha nëpër pronën e Gjonit (SG. Kastriotit) shkonte tutje gjatë rrugës së sotçme Shkodër - Denjë - Pukë për Prizren në vendin e Gjergj Vukoviqit (Brankoviqit) e të Despot Stefan Lazareviqit", përkatësisht për në Novobërdë. E, Gjon Kastrioti ua lejonte tregtarëve raguzas kalimin nëpër tokat e tij përmes një shkrese të shkruar sllavisht më 25 shkurt 1402.[7] Elementi etnik, vendës në Principatën e Arbërit, që e zhvillonte tregtinë me qytetet mesjetare të Kosovës mund të ishte edhe element etnik roman, sepse: "Në Drisht, Ulqin e Tivar ka pasun në mes të qytetarëvet shumë teprica Romakësh të moçëm ase Romanësh, të cilat mund të njihen nga emnat e familjevet […]. Tregtia ishte e gjallë, sidomos në Prizren e në Novo Brdo. Prej së mbrêndmi vinte sidomos argjênd e dyllë e çoheshin atje pëlhurna, krypë deti, peshk liqêni i krypun.".[8] Po ashtu mësohet se për si mik i raguzasve përmendet shpesh shqiptari *Vlasio de Matarango*, "Vlash Mataranga" zot i hapësirës së vendderdhjeve të lumenjve Vergo e Dêvol dhe fqinj i Durrësit e i Karl Topisë luftarak...![9] Fundja kështu e sheh gjendjen K. Jireček, sipas të cilit tregtia zhvillohej "edhe përmes detit në qytetet bregdetare të Kotorit, Tivarit, Ulqinit që ishin nën sundmin serb e që banoheshin nga latinët ose në limanin e Shën Sirgjit në lumin e Bunës, prej nga karavanet shkonin në rend të parë në deponë e vendit Prizren dhe në qytetin malor të lulëzuar rishtaz të Novoberdës".[10] Në këtë kontekst bën të përmendet se tregtarët raguzas e kishin mbrojtjen e pushtetit. Me nenin 160 (162) të Kodit të Dushanit këtyre u garantohej kompensimi i mallit të plaçkitur. Në këtë nen ishte sanksionuar: Nëse ndodh që cilitdo mysafir, tregtar apo murg, hajni apo pirati t'i marrë çkadoqoftë, ose atyre t'u ndodhë çfarëdoqoftë pengese të gjithë ata të shkojnë tek mbretëria ime, në mënyrë që mbretëria t'ua paguajë atë që u ka humbur, ndërsa cubin/ hajnin do ta ndiqnin* më tej, në emër të mbretërisë,

[6] K. Jireček, Kruja e qarku i saj bërthamë e Shqipnis mesjetore, në Vëzhgime iliro-shqiptare, Shkodër 2004, f. 75-77.

[7] K. Jireček, po aty, f., 79, 81.

[8] K. Jireček, po aty, f.. 118.

[9] sh. Konstantin Jireček, Die Beziehungen der Ragusaner zu Serbien unter car Uroš und König Vlkašin, në Sitzungsberichten der königl. Böhm. Gesellschaft der Wissenschaften, Mitgetheilt am 19. Oktober 1885, Prag 1885, f. 19.

[10] Sh. punimin e tij Die Beziehungen der Ragusaner. .., f. 9.

* Në origjinal: *ište*.

qefalitë dhe fisnikët të cilëve u ishte dorëzuar udha dhe roja gjegjëse. Dhe, secili mysafir e tregtar dhe *latin* (duhet) t'i lajmërohet rojës së parë me gjithë mallin që e ka me vete dhe që e transporton dhe këtë ta dorëzojë; mallin ia përcjell roja rojes në tërësinë e tij. Nëse ndodh të humbet diçka, porota të përbëhet nga njerëz të besueshëm: sish që me krejt shpirtin do të pohojnë çfarë u është humbur dhe që me ata porotë qefaliu dhe vendrojet t'ua paguajnë"[11] dëmin.

Marrja e nështetësisë raguzase, përkatësisht e titullit qytetar i Raguzës nga ana e Gjon Kastriotit nuk duhet parë si diçka të veçantë e aq më pak si ndonjë pikë dobësie të tij, kjo sepse në këtë kohë jo vetëm nga feudalët shqiptarë, porse edhe nga ata të Bosnes e të Duklës/Zetës, marrja e beneficionit qytetar i Raguzës konsideroj për punë e shenjtë. Kështu kishte vepruar edhe Aleksandri, i bir i princit bullgar Joan Asen Komneni - sundimtar i Vlorës e i Kaninës i cili (pas vdekjes së t'et), në vjeshtën e vitit 1368 në emër të vetin dhe të 13 bujarëve nën vartësinë e tij, midis të cilëve ishte edhe një i quajtur Kastrioti, i drejtohej Republikës së Raguzës me lutje që të bëhej qytetar i komunës së Raguzës. Kjo kërkesë që u miratua nga Raguza ka të bëjë në të vërtetë me synimin e princit bullgar për ruajtjen e sundimit të mëtejshëm mbi krahina që për një kohë të shkurtër ishin bërë pjesë e perandorisë jetëshkurtër të Stepan Dushanit e që, pas vdekjes së tij, rrezikoheshin nga shthurja.[12]

Lidhjet me komunën, përkatësisht me Republikën e Raguzës i vazhdoi edhe Gjergj Kastrioti - Skëderbeu i cili, sipas një shkrese të shkruar sllavisht dëshmonte më 2 prill të vitit 1459 se nga Raguza kishte marrë njëherë 500 e herën tjetër 1.000 duketë të artë raguzas. Ndërmjetësues dhe dëshmitarë në të dyja rastet ishin përfaqësuesit zyrtarë të Skënderbeut në Raguzë, çelniku Rajan dhe i dërguari i Skënderbeut në Raguzë Pavєlь Gazulь, përkatësisht Pal Gazulli.[13]

[11] Khs. tekstin origjinal: "Ako se gde dogodi bilo kome gostu ili trgovcu ili kaluđeru, te mu uzme što razbojnik ili lopov, ili bilo kakva smetnja, da svi ti idu k Carstvu mi, da im plati Carstvo mi što budu izgubili. A Carstvo mi da ište od ćefalija i vlastele kojima bude put predan i straže predane. I svaki gost, i trgovac, i Latin, da se obrati prvoj straži sa svim što ima i nosi, i straža straži da ga predaje sa svime. Ako li se zgodi te što izgubi, da je porota verodostojni ljudi: što po duši reknu da su izgubili, sa onim porotnicima, to da im plate ćefalije i straže." Cit. sipas Svetozar Pajić Dijak, Zakonik cara Stefana Dušana, http//www.oldserbia.plus.co.yu/index.htm

[12] Ramiz Abdyli: Karta e Aleksandrit, sundimtarit të Vlorës dhe Kaninës, dërguar Raguzës më 1368, "Gjurmime albanologjike", Seria e shkencave historike, 14/1984, f. 225-234.

[13] Khs. Fr. Miklosich, Monumenta serbica..., f. 481-482.

1. RAGUZASIT NË QYTETE TË KOSOVËS

Sado që lashtësia dhe shtrirja e elementit etnik raguzas në Kosovën e mesjetës nuk është objekt kryesor trajtimi në këtë punim, e do puna që së pakut vetëtimthi të përmendet megjithatë se dokumenti më i vjetër që e dëshmon praninë e dubrovnikasve në tokat e Dardanisë antike të pushtuara nga serbët në shek. 12, përkatësisht në Kosovën e sotme, është një kontratë e Stepanit, mbretit të parë të kurorëzuar, e lidhur nga ai me Republikën e Raguzës midis viteve 1215-1219.[14]

Për si datë e fillimit të kontakteve të raguzasve me qytetin e Novobërdës merret 11 janari i vitit 1326 kur mbreti serb Stefan Uroš II (i bir i Milutin-it) i njohur për si Stefani i Deçanit i cili në një shkresë të asaj date e njoftoi princin raguzas se qiramarrësi i doganave të Novobërdës Luca M. de Lucari i kishte kthyer të gjitha borxhet.[15] Është pikërisht Luca M. de Lucari ai mbi materialin që përmban Libri i tij i evidencës afariste që e zhvillonte në Novobërdë, do të ngritet pjesa më e madhe e kësaj trajtese. Nga kjo e dhënë rezulton se Novobërdo dë të jetë bërë koloni (edhe) e raguzasve kohë përpara këtij viti. Kjo sidomos në dritën e rrethanës që miniera e Novobërdës ishte shfrytëzuar edhe nga dardanët e nga romakët dhe se pikërisht kjo (Novobërda) mund të identifikohet edhe me emrin paralatin *Damastion* (khs. për këtë edhe më poshtë). Në dritën e së kaluarës duhet të shtrohet pra edhe pyetja përse nga pushtuesit serbë të shek. 12 të Kosovës nuk u ruajt emri parasllav i këtij vendbanimi-miniere, porse në gjuhët e të gjithë kolonistëve u quajt "Mali i Ri" (khs. gjerm. Nyeberghe, lat. mesjetare Nomonte, serb. Novo Brdo) dhe sidomos kush ishte iniciator, zot shtëpie, në Novobërdë e cila qysh në shek. 12 e kishte, si p.sh. edhe Shkodra, Drishti, Kotori etj., *Statutin* në latinisht

[14] Khs. Ugovor Stefana Prvovenčanoga s Dubrovčanima iz god. 1215-1219, te Konstantin Jireček, Glasnik Srpskog Učenog Društva, Knj. XLVII, Beograd, 1879, f. 304-305. Ky ishte djali më i madh i zhupanit serb Stepan Nemanja, i cili e trashëgoi këtë të fundit në fron në vitin 1195, kur Stepan Nemanja u tërhoq nga pushteti dhe u bë murg. Emri i murgjërisë i këtij të fundit ishte Simeon. Në vitin 1198 ky e ngriti Hilandarin dhe vdiq aty më 13 mars të vitit 1200. Të birin Stepan e paska kurorëzuar për mbret (ndoshta në vitin 1222) papa Honorio III, pasi që Stepani ishte martuar me të bijën e dukës venedikas Enrik Dandola. Këtë e dëshmon një bashkëkohës, i cli, sipas Sime Ljubić, Opis jugoslovenskih novaca, Zagreb, 1875, f. 29, shkruante: "eodem tempore Stephanus dominus Servie et Rascie, qui megajupanus appellabatur, missis apocrisariis ad romanorum sedem, impetravit ab Honorio summo pontifice coronam regni, direxit namque legatum a latere suo, qui veniens coronavit eum, primunque constituit regem terre sue".

[15] sh. Dr. Jahja Drançolli, Raguzanët në Kosovë, Prishtinë, 1986, f. 74.

të qytetit dhe gëzonte status special.[16] Po të ishte që zotër e banorë të këtij qyteti në shek. 12 të ishin pushtuesit serbë, Statuti i qytetit do të duhej të ishte - si i trashëguar nga Perandoria e Bizantit - në greqisht ose në gjuhën e pushtuesit të ri, përkatësisht serbisht. Se qyteti i Novobërdës e kishte Statutin e vet, mbase të hartuar e të aprovuar në latinisht nga kolonë raguzas e sasë duket se e dëshmon rrethana që pushtuesit serbë, pretendentë të zotërimit të këtij qyteti, e kishin gjetur edhe në shek. 15 një *Kuvend* të Qytetit. Kjo bëhet e ditur nga një shkresë e nënshkruar jo në Novobërdë, porse në katundin Nekudim të rrethinave të Ferizajt, nga i biri i kontit Lazar, despotit Stefan Lazarević me rastin e nënshkrimit të Ligjit mbi Minierat më 29 janar 1412. Ky tregonte se, përkitazi me aprovimin e këtij ligji, paska qenë më parë në qytetin e Novobërdës dhe se *i gjithë kuvendi i qytetit* (nënvizim i im) paska kërkuar "nga zotëria ime t'ua bëj ligjin mbi minierat që e kishte zoti i parë i ndjeri i shenjtë prindi im knezi Lazar [...]".[17] Po u pat parasysh fakti i dëshmuar se në kohën kur Novobërdës i kanosej rreziku nga pushtuesi osman, si konti Lazar ashtu edhe Vuk Branković-i urdhëronin pikërisht raguzasit që këta t'i përforconin muret e qytetit dhe ta mbronin atë (sh. më poshtë).

Në këtë kontekst duhet përkujtuar se hordhi të bërthamës serbe të Rashës pushtuan hapësira të Kosovës së sotme në shek. 12 dhe se "vetëm pushtimi i Kosovës dhe i Maqedonisë nga mbretër serbë i sollën serbët në kontakt me kulturën qytetare të versionit bizantin"[18] – sado që edhe vetë "bëthama serbe" e Rashës kishte qenë dukatë vasale e Bizantit.

Koloni raguzasish kishte edhe në qytetet e Janjevës, Trepçës, Letnicës, Bellosicës, Vushtrrisë, Prishtinës, Pejës e të Prizrenit. Kolonitë e të gjitha këtyre qyteteve-miniera ishin të përbëra nga bujarë raguzas në funksion të tregtarëve e gjyqtarëve dhe të përfaqësuesve zyrtarë, përkatësisht konzujve të Republikës së Raguzës. Nga burimet mësohet p.sh. se konzulata e parë e Republikës së Raguzës në Janjevë dëshmohet më 7 maj të vitit 1423 me rastin e një kontesti gjyqësor midis një qytetari raguzas dhe njëfarë Milašin Milošević-it, mbase qytetar i Janjevës. Pas

[16] Khs. tekstin: "*Historians have found a statute in Latin dating from 12th centuary in wich Novo Brdo was already granted a special status.*" që e sjellin autorët Gail Warrander e Verena Knaus, në librin e tyre Kosovo (the Bradt Travel Guide) bot. Bradt Travel Guides Ltd, UK & The Globe Pequot Press Inc. USA (Paperback), 2008, f. 235.

[17] Sipas Despot Stefan Lazarević: Predgovor i pogovor Zakona o rudnicima i Zakona Novog Brda iz 1412. godine. në //Kosovo.com / Projekat Rastko / Projekat Rastko Gračanica - Peć //:

[18] Sipas Oliver Jens Schmitt, Kosovo, Kurze Geschichte einer Zentralbankanischen Landschaft, Böhlau- Wien-Köln-Weimar, 2008, f. 33.

vitit 1458 konzuj të Republikës së Raguzës në Janjevë ishin 16 patricë, disa nga të cilët, duke pas qëndruar gjatë në Janjevë, u zgjodhën radhazi për konzuj. Në numër edhe më të madh raguzasit dëshmohen për si, ndihmësgjyqtarë, betarë (porotë) edhe kur asnjëra nga palët e akuzuara në konteste nuk ishte raguzas, veçse qytetarë të Janjevës. Më së shumti raguzas pati midis viteve 1420 e 1423, kur në Janjevë kishte 88 raguzas, numri i të cilëve në vitiet 1450-1461 ra në gjithsej 14. Me rëndësi për t'u përmendur në këtë mes është rrethana që bashkë me patricë raguzas, në Janjevë kishin ardhur edhe njerëz të thjeshtë me familje të tyre të mëdha, prandaj në këtë koloni kishte edhe raguzas profesionesh të ndryshme si argjendarë, muratorë, zdrukthtarë. Në koloninë raguzase të Janjevës kishte edhe doganierë, çfare ishte njëfarë Pribislav-i i Kotorit. Duke qenë qytetarë të Republikës së Raguzës, banorët e kolonive minatore, pa marrë parasysh sa kohë jetonin nëpër ato koloni, e kishin të drejtën që nga Republika e tyre të kërkonin mbrojtje dhe ndihmë.[19]

Nga fushat e ekonomisë me të cilat merreshin këta, del shumë i qëlluar konstatimi i dijetarit kosovar J. Drançolli sipas të cilit "... Raguzanët në Kosovë dhe më gjerë nuk erdhën për t'u bërë konkurrencë xehetarëve sasë në nxjerrjen dhe në përpunimin e xeheve, por si shtresë, e cila së shpejti do të kontribuonte për finalizimin e prodhimtarisë së tyre dhe me anë të tregtisë do ta finalizonin atë në kapital monetar. Të mësuar me transaksione tregtare dhe duke hetuar mundësinë për mbifitime të mëdha, ata dilnin si financues për zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese xehetare dhe për hapjen e xeheroreve, përkatësisht galerive, të reja".[20] Përveç me shitblerjen e mineraleve, të posedimit të puseve të minierave e të bashtinave, prerjen e monedhave, drejtimin e doganave, të gjyqeve etj., raguzasit ishin në Kosovën e shekujve 14-15 blerës të druve e të prodhimeve blegtorale dhe të drithërave. Përkitazi me këtë aktivitet të fundit ka edhe një urdhëresë të mbretit serb Stefan Uroš të nënshkruar në rezidencën e tij në katundin e sotëm Neredime të rrethinave të Ferizajt më 14 gusht të harkut kohor midis viteve 1336-1348 përmes së cilës ky urdhëronte që askush: as fisnikët lokalë e as sundimtarët lokalë të mos i pengonin as raguzasit blerës e as shitësit, bujqërit vendës të drithit. Në të kundërtën parashiheshin dënime në të holla, perperë.[21]

---

[19] Për emrat e konzujve, të të akuzuarëve raguzas të Janjevës e të porotëve khs. Nikola Čolak-Ive Mažuran: Janjevo, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 26, 29.

[20] J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë..., f. 206.

[21] Fr. Miklosich: Munumenta serbica Spectantia historiam Serbiae,, Bosnae, Ragusii, Viennae, 1858, f. 119.

Për në qytetin e Prishtinës mund të paravendoset se një koloni raguzase do të ketë ekzistuar së pakut që nga shek. 14. Për këtë mësojmë tërthorazi dhe pikërisht në lidhje me kishën katolike të qytetit të Prishtinës, për kohën e ndërtimit të së cilës Gaspër Gjini mendon se, pas gjasash, do të jetë ndërtuar midis viteve 1346 e 1387. Kjo për dy arsye: e para pse kisha katolike e Prishtinës nuk përmendet në dokumentin papënor të vitit 1346 kur përmendeshin kishat katolike të Prizrenit, të Janjevës, Pllanës, Koporiqit, Rogoznos dhe së dyti: pse raguzasi *Ratcho de Suesda* (lexo Zvezda) në testamentin e tij të hartuar më 9. XI. 1387 për përfundimin e punimeve në kishën e Shën Mërisë në Prishtinë i lente pesë duketë.[22] Kjo kishë s'ka si të mos jetë e bashkësisë katolike, përkatësisht latine, raguzase sa kohë që paravendohet se në vitet 1437-1438 në Prishtinë kishte së pakut 200 raguzas,[23] ndërsa në vitin 1438 280 sish[24] dhe se kjo koloni e tyre ishte e gjallë dhe aktive edhe deri në pjesën e dytë të shek. 16. Në defterin e regjistrimit (të pandehur për të viteve 1566-1574) të kryefamiljarëve, raguzasit e qytetit të Prishtinës dëshmohen për të përqendruar në të ashtuquajturën "*Mahalla e Latinëve*" në të cilën kishte 5 kyefamiljarë, një pronar bashtine dhe 2 bashtina të tjera që i kishin ndërruar pronarët. Midis atyre 5 kryefamiljarëve ishte edhe një pop Marko.[25] Mirëpo, raguzas kishte edhe në ndonjë lagje tjetër të këtij qyteti. Këtë do ta ilustronte mbase edhe rrethana e dëshmimit të emrit *Dubrovnik-u* në funksion të mbiemrit të mirëfilltë të banorit Koja (Dubrovniku) i Mëhallës "Shtitar" të Prishtinës, i cili ishte pronar i një bashtine.[26] Me praninë e një kolonie raguzase në qytetin e Prishtinës, e cila domosdo do ta kishte edhe kishën e vet, që do t'u ketë shërbyer edhe raguzasve të rrethinës së këtij qyteti, do të jetë e lidhur edhe rrethana që ishin pikërisht raguzasit ata që gjatë viteve 1404-1441 i mbanin doganat jo vetëm në Prishtinë, por edhe në katundin e sotëm Dobrevë (shq. Miradi) "*Dohanam de Dobrievo et de Pristina*", në të cilën doganën e

[22] Sh. J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë. .., f. 123; Gaspër Gjini, Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj, bot. "Drita", Ferizaj, 1992, f. 86. e jep emrin e këtij raguzasi, mbase jo korrekt, në trajtën Mark Zvizdiqi.

[23] Sipas J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë, Prshtinë, 1986, f. 67.

[24] Khs. Dr. Jahja Drançolli, Qytetet e Kosovës gjatë mesjetës, Buletin i Fakultetit Filozofik XXVI, Prishtinë 1996, fq, 46.

[25] Sh. S. Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shekujve 15-16, Tiranë 1983, f. 530 dhe Prof. Dr. Iljaz Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566/74, në Vjetar 31-32 i Arkivit të Kosovës, Prishtinë 2004, f. 93.

[26] S. Pulaha, Popullsia..., f. 530.

paguanin edhe tregtarë raguzas të qytetit të Vushtrrisë.[27] Gjurmë onomastike të raguzasve në nomenklaturën mesjetare topike të qytetit të Prishtinës do të jenë emri i lagjes *Shtitar* nga slav. *štit* "mburojë", në të cilën (lagje) jetonte edhe raguzasi *Koja Dubrovniku*[28] dhe emri i katundit të sotëm *Llukar* që në shek. 16 ishte lagje e Prishtinës nga kroat. *luk* "hark i shigjetës; shigjetar" gjerm "Bogenmacher" - një zeje kjo që ushtrohej në Raguzën mesjetare[29] – sado që ka mjaft arsye të mendohet se edhe emri i këtij katundi është me prejardhje antroponimike sidomos në dritën e rrethanës që në regjistrimin turk të viteve 1566-1574 pikërisht në këtë katund, përkatësisht në lagjen Llukar të Prishtinës, dëshmohen edhe kryefamiljarët: Mati *Luka*, Gjura *Luka*, *Luka* Milo dhe shtëmbari Petri *Luka*[30] të cilët e kishin vazhduar antroponimin *Luk,ë -a* të pararendësve të tyre. Një dëshmi se ishin pikërisht raguzasit ata që harkun e shigjetën (këtu duhet kuptuar domosdo edhe mburojën) e përdornin gjatë shek. 15 dëshmohet me rastin e sulmit osman mbi qytetet, përkatësisht kështjellat Prizrenac, Prilepac* e Novobërdë nga sulltan Murati II në verë të v. 1425, kur qeveria e Raguzës u lejoi qytetarëve të saj që me qëllim mbrojtjeje të qytetit të Novobërdës të merrnin me vete nga një hark dhe nga 50 shigjeta.[31]

Të dhëna të bollshme për praninë e raguzasve ka edhe për në qytetin e Prizrenit në të cilin deponoheshin mallrat e ardhura nga Venediku e sidomos nga qytete të brigjeve të këndejme të Adriatikut dhe prej aty shpërndaheshin për në Novobërdë e në qytete të tjera të Ballkanit ku kishte

---

[27] Sipas Dr. Jusuf Osmani, Venbanimet e Kosovës, 1, Prishtina, Kastrioti dhe Fushë-Kosova, Prishtinë, 2003, f. 340.

[28] Prof. Dr. Iljaz Rexha, Disa vendbanime. .., f. 94.

[29] Constantin Jireček, Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien Studien zur Kulturgschichte des 13-15 Jahrhunderts, III, Denkschriften des Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch- Historische Klasse, Band LVI, Wien 1912, f. 41.

[30] Nga Prof. Dr. Iljaz Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut tlë Vushtrrisë të vitit 1566/74, në Vjetar 31-32 i Arkivit të Kosovës, Prishtinë 2004, f. 94.

* Këto dy të parat ishin kështjella të banuara në rrethina të Novobërdës. Qytetit, përkatësisht *castra* -s Prizrenac nuk po iu ditka vendi. Është shfaqur mendimi se kështjella Prilepac do të ketë qenë në pllajën e malit *Guri i Hoxhës*, në perëndim të katundit, në vendin e quajtur *Prilepci* përmbi bregun e majtë të lumit të Prilepnicës. Këtu po u shihkan gjurmë muresh, pas gjithë gjasësh të kështjellës Prilepac. (J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 13, f. 72, 73). J. Osmani (Vendbanimet e Kosovës, 13, f. 213) e identifikon kështjellën *Prizrenac* me topogërmadhën *Kalaja* në maje të kodrës Kulina përmbi lumin e katundit Bresalc të komunës së Novobërdës. Funksioni i asaj kështjelle paska qenë mbrojtja nga aty e minierave të qytetit të Novobërdës.

[31] Për shënimin rreth harkut e shigjetës khs. Drançolli, Raguzanët..., f. 93.

koloni raguzasish. Në qytetin e Prizrenit paska pasur një lagje të raguzasve. Për fat të keq autori J. Drançolli nuk jep ndonjë njoftim tjetër për të. Për ilustrim, ky shkruan se qysh në shek. 14 në Prizren vëreheshin dyqane të punuara sipas stilit raguzas dhe raguzasit kishin edhe shtëpi të vetat në këtë qytet.[32] Republika e Raguzës e kishte në qytetin e Prizrenit qysh në vitin 1332 përfaqësuesin e vet "diplomatik" përkatësisht konsullin e përhershëm që kujdesej jo vetëm për çështje të tregtisë, porse edhe për bashkësinë e raguzasve aty. Detyrë e konsullit ishte të organizonte së pakut dy herë në vit panaire në hapësirën e quajtur nga ata *Sclavonia* (që nënkuptonte territorin nga Istria, përgjatë brigjeve të Adriatikut deri te derdhja e Bunës dhe brendinë e Gadishullit të Ballkanit) dhe e përfaqësonte Raguzën përpara sundimtarëve vendës.[33] Kjo shihet p.sh. edhe nga dëshmia e vitit 1341, sipas të cilës raguzasi *Give de Bona* e kishte të vëllain doganier në Prizren.[34] Këta nuk janë të vetmit raguzas që përmenden në shek. 14. Komuniteti raguzas kishte në Prizren edhe dy kisha apo kapela katolike të tij;[35] e mbante doganën e qytetit, farkëtoren e monedhave dhe kishte edhe një spital.[36] Me qëllim të mbrojtjes së kolonisë së vet dhe të interesave ekonomike të saj, bujarët raguzas hynin edhe në aleanca kundër sundimtarëve serbë, siç ishte rasti i Nikola Altomanović-it i cili e mirëpriti pushtimin e Prizrenit nga Gjergj Balsha në vitin 1372. Në një shënim në "Diversa Cancellarie" të dt. 10. shtator 1372 tregohet se, Gjergj Balshës, me rastin e pushtimit nga ai të qytetit të Prizrenit *capita domorum mercatorum, qui tunc habitant in Prisreno* "Kryeparët e familjeve tregtare të cilat në këtë kohë jetonin në Prizren" ia dhuruan atij katër parzmore (*coracias*), secila në vlerë prej 5 funtash argjendi.[37]

Një koloni e rëndësishme raguzasish e sasësh ishte edhe Trepça, e cila në vitet 1407-1414 ishte, pas Novobërdës e Prishtinës, kolonia më e madhe e raguzasve. Edhe në këtë qytet është dëshmuar farkëtorja e monedhave,[38] e cila, kuptohet, ishte në duar të raguzasve. Gjatë viteve 1411-1412 në Trepçë kishte 235 ose 236 raguzas. Midis bujarëve, tregtarëve e gjyqtarëve të ardhur nga Spliti, Venediku, Kotori kishte edhe këtu sish të ardhur nga

[32] J. Drançolli, Raguzanët..., f. 215.
[33] Khs. J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë, Prishtinë, 1986, f. 47.
[34] M. Tërnava, Populsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI, Prishtinë, 1995, f. 275.
[35] Sh. Gaspër Gjini, Ipeshkvia..., f. 96.
[36] Khs. Dr. Jahja Drançolli, Qytetet e Kosovës gjatë mesjetës, Buletin i Fakultetit Filozofik XXVI, Prishtinë, 1996, f, 43.
[37] Sipas Konstantin Jireček, Die Beziehungen der Ragusaner zu Serbien unter car Uroš und König Vlkašin, në Sitzungsberichten der königl. Böhm. Gesellschaft der Wissenschaften, Mitgetheilt am 19. Oktober 1885, Prag 1885, f. 27.
[38] Khs. Jahja Drançolli, Qytetet e Kosovës gjatë mesjetës., fq, 49.

Shkodra e nga Tivari. Ndër qytetarë që janë dëshmuar të kenë marrë pjesë në konteste gjyqësore të lidhura me afarizmin në Trepçë përmenden, sipas J. Drançollit, edhe personat: *Stepchum Progonouich* (viti 1408), *Zuitchi Ginovich* (viti 1409, 1415, 1417, 1425), *Michoy Gonovich* (viti 1409), *Nicoliça Giergas* (viti 1412, 1413, 1422, 1423), *Michelius Albanensem* (viti 1417), *Michael Progonovich* (viti 1425)[39] e ndonjë tjetër.

Të dhëna për praninë dhe aktivitetin e raguzasve në qytetin e Pejës ka në punimet e historianëve kosovarë M. Tërnava e J. Drançolli. Kështu, në librin që për kohë të gjatë do të shërbejë për fjalë e fundit përkitazi me strukturën etnike të popullsisë së Kosovës në shek. 14-16 të M. Tërnavës, në testamentin e raguzasit Milovac Radosalić të hartuar në vitin 1439 "disa dëshmitarë deklarojnë se kanë qenë *in partibus Sclavoniae in loco vocato in lingua Sclava Pech* "Në regjionin Sklavonia në vendin e quajtur në gjuhën sllave Peq" dhe deklaron se "Ndonjë dëshmi tjetër mbi praninë e raguzasve në Pejë nuk kemi gjetur"[40] Megjithatë, historiani tjetër kosovar J. Drançolli sjell, përfshirë edhe të dhënën e mësipërme, më shumë të dhëna përkitazi me këtë temë.[41] Ky tregon se tregtarë raguzas janë dëshmuar në qytetin e Pejës, që në vitin 1326. Ka një dëshmi sipas së cilës në Pejë kishte në vitin 1415 një "konzullatë" raguzase. Të tilla u themeluan me dhjetëra gjatë gjysmës së parë të shek. 15.[42] Duke qenë se këto të dhëna nuk kanë ndonjë rëndësi në rrafshin onomastik, nuk po i përmendi më hollësisht.

Nëpër qytete-miniera siç ishin Novobërda, Trepça, Janjeva, Bellosica dhe në qytete të tjera të Kosovës si në Prizren e në Pejë, kishte përveç raguzasve e sasëve edhe tregtarë nga Venediku e nga Kotori. Një e dhënë interesante për afarizmin e një venedikasi në Novobërdë rrjedh nga 14 qeshori i vitit 1401 kur përmendet venedikasi Benedikt Contareno të cilit, për shkak të një kontesti të padrejtë ndaj një raguzasi të quajtur M. Zinzanul, despoti Stefan Lazarević urdhëroi që atij t'i konfiskohet i gjithë argjendi që ky e kishte në Novobërdë dhe pjesa tjetër e tij (argjendit) që të tjerë ia kishin borxh atij.[43] Dëshmia më e vjetër e pranisë, përkatësisht e afarizmit të një kotorasi në Novobërdë është ajo e vitit 1319 kur njëfarë Konstantin Petrus de Bratisti kishte ardhur në Novobërdë për të blerë gra skllave.[44] Po kështu kishte ndodhur njëzet vite më parë edhe në qytetin e

[39] Po ai, po aty, f. 144, 147.
[40] Sh. M. Tërnava, Popullsia e Kosovës gjatë shek. XIV-XVI, f. 276.
[41] për këtë sh. gjerësisht te J. Drançolli, Rauzanët., f. 101-106.
[42] Khs.Jahja Drançolli, Qytetet e Kosovës, f. 47.
[43] Sipas Sime Ljubić, Opis jugoslovenskih novaca, Zagreb, 1875, f. 31, referenca 1.
[44] Khs. Momir Jović, Dubrovačka vlastela u Novom Brdu, Studia humanistica (Prishtinë) 10 (1975), f. 229.

Prizrenit kur në vitin 1299 raguzasi Vladimir Grupsi në këtë qytet e kishte blerë skllaven e quajtur Deana. Dëshmi për tregtimin e skllaveve ka edhe për në qytetin e Prishtinës. Kështu në vitin 1421 dy raguzas që bananin në Prishtinë u morën vesh për shitjen një tregtari osman të skllaves dhjetëvjeçare boshnjake të quajtur Milica, ndërsa një vit më vonë në Prishtinë ka një kontest gjyqësor midis dy raguzasve lidhur me grabitjen e një skllave të quajtur Helena, që i përkiste një turku të quajtur Oruç.[45]

Le të sqarohet në këtë mes që, sipas K. Jireček-ut,[45a] skllavëri kishte edhe në qytetet bregdetare të Adriatikut. Kjo merret vesh edhe në statutin e qytetit të Kotorit. "Në qytete tregtare të Italisë kishte asokohe numër të madh skllevërish shtëpiakë të importuar të të dyja gjinive. Sipas Kodit të Stefan Dušan-it, skllavi (ortok) me fëmijët e tij ishte "pronë e përjetshme " (baština vječna) e fisnikut ose e pronarit të tokave, por që nuk guxonte kurrë të jepej si prikë. Këta guxonte t'i lironte vetëm zotëriu, e shoqja ose i biri. Në kohën e sundimit të dinastisë së Nemanjidasve kishte përkrah të palirëve të tjerë si skllevër shtëpie ashtu edhe skllevër agrarë. Në Perandorinë Bizantine të tillët ishin zhdukur kaherë. Të këtillë kishte edhe në Hungari. Zhupani i Madh St. Nemanja i liroi të gjithë skllavët e vet kur hoqi dorë nga froni dhe shkoi e u bë murg. Në skllavëri kishin rënë edhe disa mercenarë turq që mbreti serb Urosh II i kishte thirrur kur kishte shpërthyer një kryengritje kundër tij. Në krisobulat serbe për feudet e manastireve ndeshen skllavë që bëjnë punë fushe, që lëvrojnë, korrin, fshijnë, që punojnë në vreshta, përkrah të tjerëve që kanë kuaj dhe e përcjellin ikonomin (administratorin) e feudit kur ky shkon tek mbreti ose kudoqoftë tjetër.

Një qendër tjetër xehetare raguzase-sase ishte edhe katundi i sotëm Bërvenik i krahinës së Gallapit. Një dëshmi për aktivitetin e raguzasve në këtë lokalitet, të mbështetur në kujtesën kolektive të këtij vendbanimi e të syresh të rrethinës, e kemi mbase tek mikrotoponimi *Trojet e Gjenovizit*[*] të këtij katundi, në të cilin paska qenë edhe një bazilikë e rëndësishme e qytetit.[46]

Unë po shtoj se gojëdhëna e mësipërme, si për çudi, paska porse mbështetje historike. Në një shkresë të Clemens-it, ipeshkvit të ipeshkëvisë së

[45] Khs. J. Drançolli, Raguzanët. .., 109, 136 - 137.

[45a] Nga Constantin Jireček: Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien Studien zur Kulturgschichte des 13–15 Jahrhunderts, III, Denkschriften des Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch- Historische Klasse, Band 58, 2 Abhandlung Wien 1914, f. 73.

* Këtë mikrotoponim e ka shënuar në terren Ali S. Berisha, Gallapi i Prishtinës, 2007 Dorëshkrim

[46] Sipas Dr. F. Pushkolli, Llapi gjatë historisë, Prishtinë, 1998, f. 37-38. Unë e citoj sipas Ali S. Berisha, Gallapi i Prishtinës, 2007 Dorëshkrim.

Kotorit, të nënshkruar më 6 janar të vitit 1346 drejtuar mbretit serb Stefan të Rashës e njoftonte këtë të fundit se dinjitari kotoras do t'i plotësojë vendet vakante, përveç të tjerash, edhe në kishat e Shën Mërisë në Prizren, të Shën Pjetrit sipër Prizrenit dhe të Shën Trifonit në Bërvenik.[47]

I vetëdijshëm se trajtimi i aspektit jashtëgjuhësor të pranisë së raguzasve në Kosovën mesjetare është, megjithatë, punë e historianëve, po e shtoj vetëm edhe të vërtetën historike se beneficionet që, për leverdi ekonomike, sundimtarët lokalë serbë apo të serbizuar të Kosovës së sotme u vazhduan edhe nga Gjergj Brankoviqi. Arsye për vazhdimin më tej të beneficioneve të raguzasve nëpër kolonitë e tyre të përbashkëta me sasët nga ana e Gjergj Brankoviqit është rrethana e rënies së tij në një vasalitet të dyfishtë. Pas vdekjes së Stefan Lazarević-it, Đurađ Branković'i (Gjergj Brankoviqi) u shtrëngua ta pranonte si pushtetin sovran të mbretit kroat-hungarez Sigismund, ashtu edhe atë të sulltanit Murat II. Kjo ndodhi në vitin 1302 dhe në këso vartësie ra shumë shpejt e gjithë bujaria serbe. Kësisoj, osmanët e nisën dhe e arritën pushtimin e kështjellave më të rëndësishme: më 1396 Zveçanin e Trepçën; më 1412: Novobërdën, pa e pas inkuadruar, në këtë kohë, gjithë hapësirën e Kosovës së sotme nën sovranitetin politik osman. Kjo mbase sepse deri në vitin 1459 ekzistonte formalisht një shtet serb, pasi që perandori bizantin ia kishte dhënë titullin e lartë *dhespot* që paraqet lidhjen e aristokracisë serbe të "Despotat"-it me perandorin bizantin.

Gjergj Brankoviqi u zotua që sulltanit t'ia paguante 50.000 duketë në vit dhe se do t'ia vente në dispozicion 2.000 kalorës që do të ishin nën komandën e njërit nga të bijtë ose nga prijës ushtarakë të tij. Gjithë këtë barrë të marrë përsipër, Gjergj Brankoviqi mund ta bënte vetëm falë të ardhurave që i vilte nga minierat në Novobërdë e në Janjevë. Falë këtyre burimeve financiare të minierave të Kosovës, Gjergj Brankoviqi pati mundësi ta financonte edhe ndërtimin e kështjellës së fortë, në një hapësirë të banuar nga vllehtë, të Smederevës. Nëse ky veprim i tij mund të merret si shenj i pasigurisë, i lëkundjes së shtetarëve serbë në një pjesë të perandorisë së tyre në vend të huaj, mbetet detyrë për historianët. Kjo do të ishte përgjigje pyetjes që shtrohet logjikisht, përse gjithë këto të ardhura despoti vasal nuk i përdori për mbajtjen e kështjellës së Novo-

[47] sh. A. Theiner, Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium, I, Romë, 1853, f. 215: "*Sane Venerabili frate nostro Sergio Catharensi, quam super suis exigentibus meritis Catharensi ecclesie tunc vacanti prefecimus in Episcopum et pastorem nobis insinuante percepimus, quod licet [...]sacncte Marie de Prisren, sancti Petri supra Prisren* (dhe) *sancti Triphonis de Beruenich*".

bërdës apo për ato të Vushtrrisë, të Zveçanit, të Zhegovcit e të ndonjë tjetre në hapësirën e sotme të Kosovës.

Pasojë e drejtpërdrejtë e vasalitetit, lojalitetit të Gjergj Brankoviqit ndaj pushtuesit otoman ishte neutraliteti, përkatësisht mospjesëmarrja e ushtrisë së dhespotatit serb në Betejën e Dytë të Kosovës, të drejtuar nga János Hunyadi në vitin 1448. Si për çudi, heroit hungarez nuk i erdhi në ndihmë as lidhja e bujarëve shqiptarë të Shqipërisë së Mesme e të Veriut e cila, me në krye Gjergj Kastriotin - Skënderbeu me Hunyadi-n e kishte bashkëplanifikuar këtë ndërmarrje. Disfata e Hunyadi-t, e përkrahur nga kryqëzatorët polakë, pati pasoja më të rënda se ato të Betejës së Parë (1389), sepse prej tani e deri në fundin e shek. 17 regjionet me popullatë të krishterë ranë në pozitë të mbrojtjes së përhershme ndaj Perandorisë Osmane.[48]

Nga materiali i pasur arkivor i Republikës së Raguzës për këtë punim timin do t'i përdor vetëm ato burime të cilat në masë të konsiderueshme apo kryekëput përmbajnë lëndë onomastike të banorëve të vendbanimeve përbrenda Kosovës së sotme. Për të këtilla i konsideroj disa dokumente më të vogla të cilat janë në të vërtetë thjesht korrespondencë me karakter tregtar, ekonomik midis sundimtarëve lokalë serbë dhe Republikës së Raguzës - shumica e të cilave rrjedhin nga vitet 1382-1445 dhe testamentin e tregtarit Gostissa Brathoslaglich (lexo: *Gostiša Bratoslalić*) të vitit 1411 (në tekstin e mëtejmë do të citohet shkurt si *Testamenti*) si dhe Librin e evidencës së borxhlinjve të tregtarit raguzas Michael de Luchari* (në tekstin e mëtejmë do të citohet shkurt si: *Libri*) të viteve 1438-1440[49] ose 1432-1438. Për Michael de Luchari-n mësohet se ishte patric raguzas, mbledhës i doganës në tregun e Novobërdës disa kohë para vitit 1421[50] dhe se aty e kishte edhe një dyqan të vetin. *Libri* i tij ka të bëjë me aktivitetin e tij tregtar në qytetin e Novobërdës.

Pikërisht mbi bazën e këtyre dy dokumenteve do të trajtohet prania e shqiptarëve në diritën e antroponimeve dhe të mbiemrave familjarë në qytetin mesjetar të Novobërdës, në lagjet e këtij qyteti si dhe në vendbanimet në rrethina të tij të afërta e të largëta, përkatësisht në vendbanimet

[48] Sipas Oliver Jens Schmit, Die Kosovo Geschichte, Srpska Pravoslavna Crkva, në http.//www.spsportal.org/index.php dhe Nikola Čolak-Ive Mažuran: Janjevo, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 30.;

* Në shkrime serbe emri i këtij doganieri e tregtari transliterohet si Mihajlo e Miho Lukarević.

[49] Të publikuar nga Mihailo Dinić, Iz dubrovačkog arhiva I, Beograd, 1957.

[50] Sipas Momir Jović, Dubrovačka vlastela u Novom Brdu 1439-1455, Studia humanistica (Prishtinë) 10 (1975)., f. 229.

midis qyteteve të Prishtinës-Podujevës-Gjilanit (në Kosovë) dhe Kurshumlisë-Krushevcit-Prokuples-Vranjës e Nishit (në Serbi).

Duke qenë se pothuaj gjithandej kah kishte raguzas kishte edhe minatorë sasë, rrethanat dhe motivet e kolonizimit të tyre në Kosovë, vëllimi i autonomisë, përkatësisht i privilegjeve që i gëzonin këta në rrafshin sociologjik, juridik, fetar e mbase edhe gjuhësor dhe sidomos në rrafshin e raporteve të tyre me sundimtarë serbë do të hetohen më mirë nëse këto ndiqen krahpërkrah me ato të sasëve. Për ta përfituar një pasqyrë sa më të plotë përkitazi me gjurmët e këtyre dy grupeve etnike të rëndësishme për historinë e Kosovës së shekujve 14-15, rekomandoj që ky punim të konsiderohet pjesë organike e punimit tim përkitazi me elementin etnik sas dhe me gjurmët e tij në Kosovë.

2. SHQIPTARËT NË NOVOBËRDË DHE NË VENDBANIMET PËRRETH NË DRITËN E DOKUMENTEVE MË TË VOGLA RAGUZASE

Ndër dokumente të para të sundimtarëve lokalë serbë të shek. 14 që kanë të bëjnë me raporte tregtare por që, megjithatë, nga ato mësohet edhe për praninë e shqiptarëve në qytetin mesjetar të Novobërdës, bie edhe një njoftim me shkrim i vitit 1399 i konteshës Eugenia, përkatësisht murgeshës Milica, të vejës së knezit Lazar. Kjo e njoftonte Raguzën se njeriu i saj *Nicholetus filius Gergasi de Novobërda*,[51] i cili në të vërtetë ishte doganier në këtë qytet (Novobërdë), nuk i kishte kthyer ende borxhet e veta. *Gergasi* ishte Novobërdas i cili jetonte në Raguzë ku e kishte edhe familjen.[52] Duket se ky njeri i Milicës (përkatësisht *Gegrasi*) mbante padyshim njërin ndër antroponime karakteristike shqiptare *Gjergj,* përkatësisht Gergas, i dëshmuar madje edhe në trajtën shqipe të shquar Gergas*i*. Mirëpo, nga ky dokument mësohet se Gergasi nuk ishte i vetmi shqiptar i vendosur nga Raguza në Novobërdë në atë kohë. Ai e kishte edhe një vëlla që quhej *Gincho* (khs.: *Gincho Nicholich de Nouaberda fradel de Gergasi*[53] - "Ginko Nikoliq-i i Novobërdës i vëllai i Gergas-it"), i cili ishte shpërngulur apo kthyer për në Dubrovnik. Prej atje i shkruante ai më 5 gusht 1399 konteshës Milica. Përkatësinë etnike shqiptare të këtij personi e tregon antroponimi *Gincho* (lexo *Ginko*), që në të vërtetë është një formë fonetikisht e morfologjikisht e ndryshuar e antroponimit shqiptar *Gjin*.

[51] Sh. Mihailo Dinić: Za istoriju rudarstva u srednjovekovnoj Srbiji i Bosni II, Beograd 1962, f. 73.

[52] Sipas J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë. .., f. 78-79.

[53] M. Dinić, Za istoriju rudarstva..., f. 94.

Me persona të përkatësisë`etnike shqiptare, shtetas të Republikës së Raguzës, kemi të bëjmë pas gjithë gjasash edhe në rastet e *Johann Progonouich aurifex de Nouaberda,*[54] përkatësisht "*Gjon Progoniviq-i, argjentar i Novobërdës", i cili duket se më 1440 ishte shpërngulur apo kthyer nga Novobërda për në Raguzë, sepse në dokument përmendet si. .. *habitator Ragusii...*[55] përkatësisht "banor i Raguzës". Me përkatësi etnike shqiptare do të ketë qenë pas gjasësh edhe *Radossau Gonouich hutman,*[56] (për kuptimin e termit *hutman* sh. më poshtë) një qytetar janjevas që në këto vite jetonte në Novobërdë. Është mirë të vërehet se *Johann*-i e kishte për patronim antroponimin karakteristik shqiptar *Progon* të zgjeruar me prapashtesën sllave të gjinores -*ov (ić*), ndërsa *Radossau* për patronim e kishte antroponimin shqiptar *Gjon* të zgjeruar me po atë prapashtesë sllave. Me përkatësi etnike shqiptare ishte edhe zejtari *Mechxia Albanexe*, përkatësisht "Mekshi shqiptar", të cilit raguzasi *Thassouez* i kishte mbetur borxh 10 aspra. Për këtë arsye ai edhe e përmend këtë në testamentin e vet që e kishte hartuar në Novobërdë më 4. gusht 1402: "*die dare Mechxia Albanexe Aspri. X. che resto dare per calçce*",[57] përkatësisht "t'i jepen shqiptarit Meksha* 10 aspra që i mbeten për t'ia dhënë për gëlqeren". Këtu bie gjithsesi edhe personi *Lesh*-i, i bir i Peter *Span*-it, i cili ishte "*voivoda Novimontis*" dhe përmendet në vitin 1454.[58] Një patronim shqiptar e mbante pas gjithë gjasësh edhe feudali *Sergio Tani,* i cili përkrah çifligarëve të tjerë raguzas të Novobërdës, përmendet në vitet 1439-1445.[59] Nuk ka porse asnjë dëshmi se ai do të ketë qenë dubrovnikas [së pakut jo në dokumentin e cituar më lart.]. Për prejardhjen shqipe të këtij emri flet në rend të parë rrethana që emri *Tani* është në të vërtetë një trajtë e shkurtër e antroponimit gjithshqiptar**Tanush* me prejardhje

[54] M. Dinić, po aty.
[55] Poai, po aty.
[56] Poai, po aty.
[57] Sh. Injac Zamputi-Luan Malltezi, Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV, Vëllimi 1, Tiranë 1987, Dok. 241.
* Ka arsye të besohet se autorët Zamputi - Malltezi ta kenë transliteruar këtë emër gabimisht si Merksha.
[58] Cit. Sipas Gaspër Gjini, Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća, Zagreb 1986, f. 108.
[59] Sh. Momir Jović, Dubrovačka vlastela u Novom Brdu 1439-1455, Studia Humanistica 2 (1975), Prishtnë, f. 242, referenca 10.
** Për të këtilla konsiderohen nga unë jo vetëm antroponimet thjesht shqipe, porse edhe format shqipe të antroponimeve të gjithkrishtera për të cilat është dëshmuar se barteshin nga shqiptarët - pa marrë parasysh nëse këta (shqiptarët) ishin të krishterë të ritit orthodoks apo të atij katolik.

latine nga lat. *Tanussius*[60] dhe që ky emër dëshmohet dendur gjatë shek. 13 në Tivar, Ulqin, Raguzë, Dibër përkatësisht gjithandej ku edhe atëherë kishte shqiptarë: khs. p.sh. Τανουση (1220)- i ati i dhëndrrit të Georg Ataliates-it i kohës (1216-1234) kur kryeipeshkv i ipeshkëvisë së Ohrit ishte Demetrios Chomatian- i; *Tanusius filius Gini colonie Dibrensis; Petrus de Tanusio, subdiaconus Antivarensis* (1247);. ..*sevasto Tanusius colonis Bessossi; Tanus Barbuca* (1276) *Scura Tanusius* - nga Shqipëria e Jugut dhe e Veriut.[61] Në këtë kuptim, për si pjesëtar të etnisë shqiptare mund të merret edhe gjykatësi nga shtresa e *popolanëve* me origjinë nga katundi i quajtur edhe sot *Kastrat* në rrethina të Kurshumlisë, i quajtur *Nichola Castrati*, i cili përmendet në vitin 1454.[62] Këtë person duhet konsideruar për shqiptar së pari jo vetëm pse e mban antroponimin e gjithkrishter *Nichola* (shq. Nikollë), porse edhe pse vendbanimi prej nga vie ai e mban një emër në trajtë shqipe të dalur nga emri në krye të herës latinisht i një vendbanim i tipit *Castra* "kështjellë; gjytet" apo nga emri homonim i fisit *Kastrati* të shqiptarëve.

Për praninë e shqiptarëve në Novobërdë flasin edhe emrat shqiptarë të disa priftërinjve e të famullitarëve katolikë të këtij vendbanimi që gjithashtu ishin në marrëdhënie afariste me tregtarë të Republikës së Raguzës. Kështu p.sh. në një dokument të vitit 1382 është shënuar se si "*presbyter Ginus filius Gergi de Nouaberda*"[63] i kishte mbetur borxh raguzasit Jakov Gundulić 25 duketë ari. Ndër famullitarë të Novobërdës, shumica nga të cilët ishin të përkatësisë etnike shqiptare, prandaj edhe mbanin antroponime ose patronime shqipe, ishin edhe *Dom Georgius Gega; Nichola de presbitero Tanussio habitatori in Novo Monte diocesis Catarensis. ..*", "*Nikola de presbitero Tanussio*" përkatësisht Dom Gjergj Gega; Nikolla i kryepriftit Tanush, banor i Novobërdës së dioçezës së Kotorrit, të cilin ipeshkvi i Tivarit e kishte emëruar për vikar (mëkëmbës)

[60] Sipas Constantin Jireček, Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters, Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Bd. LXVIII, Wien 1908, f. 59.

[61] khs. Koço Bozhori, Dokumente bizantine për historinë e Shqipërisë (shek. VII-XV), Tiranë 1978, f. 54; Dr. Ludoovicus de Thalloczy - Dr. Constantinus Jireček - Dr. Aemilianus de Šufflay: Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia,Vindobonae 1918, dok.160, 185, 333.

[62] Sh. Momir Jović, Dubrovačka vlastela. .., f. 233; I. Rexha, Sllavizimi i onomastikës së vendbanimeve mesjetare arbane në arealin e Novabërdës, Nishit, Vranjës dhe Shtipit. .., f. 135 na mëson se tre kryefamliarë të këtij katundi e mbanin për mbiemër emrin e katundit të tyre: Gjuka Kastrati, Nkolla Kastrati de Zhivko Kastrati, por nuk e përmend burimin prej nga i ka nxjerrë këta emra.

[63] M. Dinić, Za istoriju rudarstva u srednjovekovnoj Srbiji i Bosni, I, Beograd 1962, f. 43.

të vetin [...] *super omnes ecclesias illarum patriam Novimontis et Sclavonie.* ..[64] përkatësisht "Mbi të gjitha kishat e atjeshme të vendit (qytetit) të Novobërdës e të Sklavonisë".

Me origjinë shqiptare ishte edhe prifti *Michaeli Martinj de Sancto paulo de pollato*,[65] përkatësisht *Michael Martini de S. Paulo de Pollato*[66] "dom Mikel Martini nga Shën Pali/Shupali i Pultit", i cili në Novobërdë kishte ardhur më 6 mars 1405 dhe kryente këtu funksionin e plebanit* të plebanisë së Rashjes. Këtij i rekomandohej që ta priste zotin Paskual de Babalio, kanonik raguzian dhe pleban i Novobërdës të cilin ai do ta mbante për kapelan** të vetin.[67] Ky nuk ishte i vetmi klerik i ardhur nga krahina e Pultit. Sipas K. Jireček-ut "Në *Diversa* të Arkivit të Raguzës përmenden një varg klerikësh të ipeshkëvisë dhe të hapësirës së Polatum, Polato, ose Ypolato, Ippolato (serb. e vj. Pilot), i cili ngërthente më vete territor shumë më të madh se Pulti i sotëm. .. Prej këndej rridhnin klerikët "dompnus Georgius 1398 (në Novobërdë), Dompnus Marcus 1405 (në Novobërdë) i adhur këtu nga S. Stephano de Ypolato"[68] dhe në vitin 1390 edhe një *Johannes dictus Ghin de Dagno* përkatësisht Johannes i quajtur Gjin nga Danji i rrethinave të Shkodrës si dhe njëfarë *Marcus Caput Apis de Dagno*[69] (rreth vitit 1398) e ndonjë tjetër.

Famullitarët dhe priftërinjtë e përmendur këtu mbanin antroponimet shqipe *Gin, Gerg, Tanus/Tanussio*; emrat e gjithkrishterë *Martin* e *Michael* dhe mbiemrat, patronimet shqipe *Gega* e *Progon*, përkatësisht *Progonouich.*

Njëri ndër shqiptarë të Veriut të Shqipërisë që ishte në shërbim të sundimtarit lokal, vazalit Đurađ Branković të osmanëve, ishte edhe duka, përkatësisht mbikëqyrësi i doganave në minierën e Novobërdës, *Leš Spanović*[70] i cili përmendet në një dokument të vitit 1426. Nga burime mësohet se në këtë rast kemi të bëjmë me një shqiptar të Drishtit nga

[64] Sh. M. Dinić, Za istoriju rudarstva... II, f. 94.
[65] Sh. I. Zamputi - L. Malltezi, Dokumente..., dok. 502.
[66] Sh. Agostino Petrusi: Martino Segano di Novo Brdo, Vescovo di Dulcigno (Un umanista serbo-dalmata del tardo Quattrocento), Vita e Opere, Roma, 1981, f. 11
* *pleban*: fjalë e vjetëruar latine, latine e mesme me kuptimin famullitar i një famullie.
** *kapellan*: ai që përkujdeset për kapellën: godinë e vogël [private] kishtare, pa grixhë.
[67] Khs. Dokumente për Historně e Shqipërisë të shek. XV, I, (1400 - 1405), përgatitur nga Injac Zamputi e Luan Malltezi, Tiranë, 1987, Dok. 502, f. 561-562.
[68] sh. Dr. Constantin Jireček, Das christliche Element in der Topographischen Nomenclatur der Balkanländer, Sitzungsberichte der. Kais. Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch-Historische Classe, Band CXXXVI, Wien, 1897, f. 19.
[69] Sh. Agostino Petrusi: Martino Segano di Novo Brdo,. .., f. 11.
[70] Sh. M. Dinić, Za istoriju rudarstva. .., II., f. 41.

familja e Shpanajve, përkatësisht Spanajve. Duka i Branković-it mbante, sikundër shihet, antroponimin shqiptar *Lesh* dhe patronimin, poashtu, shqiptar *Span* - të zgjeruar me prapashtesat sllave *-ov* dhe *-ić*. Dera e Shpanajve/ Spanajve të Drishtit ishte mbase po aq apo përafërsisht po aq e fortë sa edhe ajo e Dukagjinëve, sakohë që për malet e hapësirës së Drishtit, përkatësisht të hapësirës në jug të Drinit të mesëm, që sot quhet Dukagjin, nëpër burime venedikase e raguzase përkrah emrit "monti delli Ducagini" përdorej edhe emri "monti delli Spani". Familja e Spanajve kishte raporte të mira me Gjergj Brankoviqin e Kosovës, sakohë që edhe kreu i këaj familjeje *Peter Span Albanensis* i cili përmendet gjatë viteve 1430-1456, në vitin 1441 ishte përcjellës i despotit Đurđ Branković në Raguzë dhe e kishte deponuar pasurinë e tij atje. Më shumë të dhëna për këtë familje sjell K. Jireček "Familja fisnike mâ e nâlta ishin Shpanajt (Span, Spano, serbisht Spanovići). Nji degë e kësaj familjeje në qv. XV ka qênë në shërbim të Venedikut. Nji tjetër ishte partizane e Sërbvet. Prej sish përmêndet shpesh ndër librat e arqivës raguzjane nji Peter Span, shqiptari katholik, vdekun pas 1485-s[*]. Ky kishte tre djelm: Bozhidarin († para 1474), Lleshin (Alexius, filius Petri Spani ose Lješ Spanović) në 1454 vojvodë i despotit Gjergj në qytetin malsuer Novo Brdo (në 1474 ishte gjallë) dhe Hrvoje (gjallë në 1478). Mbas 1474 përmendet edhe i biri i Bozhidarit Pjetri me t'âmën Gojsavën e të shoqen Ljubosavën.".[71] Anëtar i kësaj familje do të ketë qenë pas gjasësh edhe *Rancho Spani*, argjendar i Prishtinës që po ashtu ishte me origjinë nga Drishti.[72] Mua më duket se ka arsye të besohet që as emri i lagjes *Mahalla Spanoviq* e Novobedës me 12 kryefamliarë, e dëshmuar në fundshekullin 15[73] nuk mund të ndahet lehtë nga pasardhësit e *Lesh Spanit*.

3. ANTROPONIMET E SHQIPTARËVE NË DRITËN E TESTAMENTIT DHE TË LIBRIT

Pjesën më të madhe të materialit onomastik e përmbajnë dokumentet e karakterit thjesht tregtar siç janë Testamenti i Gostisse Brathoslaglich-it (në tekstin e mëtejmë i cituar shkurt: *Testamenti*) i vitit 1411 dhe Libri i Michael de Luchari-t (në tekstin e mëtejmë i cituar shkurt: *Libri*) i viteve

* Duket se, në mos ky vetë, ky do të jetë pinjoll me emër të përtërirë të Pjetër Spanit që më 1444 ishte njëri ndër pjesëmarrës të Besëlidhjes së Lezhës - me në krye Gjergj Kastriotin - Skënderbeun.

[71] Nga Dr. Konstantin Jireçek, Shkodra e krahina e saj në mesjetë, në Vëzhgime iliro-shqiptare, Shkodër 2004 (përkatësisht Illyrisch-albanische Forschungen, Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy I. Band, München und Leipzig 1916) f. 120.

[72] Khs. J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë …, f. 132.

[73] Khs. I. Rexha, Regjistrimi …, f. 69.

1432-1440 - që të dytë ishin tregtarë raguzas në Novobërdë. Michael de Luchari i mbante edhe doganat në Novobërdë. Në *Librin* e tij ky mbante evidencën e borxhlinjve të cilët, me dorëzanë, merrnin hua, kredi nga ky tregtar. Në rrafshin jashtëgjuhësor, dijetari ynë J. Drançolli konstaton me të drejtë se ajo pjesë e popullatës që e fitonte bukën e gojës në minierën e Novobërdës e në puset përreth "ishte e detyruar të jetonte në të shumtën e rasteve me ndihmën e kredive".[74]

Mua më është mbushur mendja që, mbështetur nga vendet prej kah vinin huamarrësit dhe dorëzanët, tregtari Michael de Lucari i Novobërdës u jepte hua kryesisht njerëzve që vinin nga vendbanime në të cilat kishte puse minierash, përkatësisht atyre për të cilët tregtari kishte njëfarë sigurie se kishin prej kah t'i kthenin borxhet (khs. për këtë p.sh. rastin e huamarrësit nga katundi Velegllavë i Kamenicës). Në dritën e shënimeve të tregtarit raguzas Gostissa Bratoslalich (f. 28, 29) se borxhlinj të tij ishin edhe njëfarë *Miser*: "i mjerë, fatzi¸ i shkretë i varfër" i *despot Stephano*; njëfarë *Vochassin risnicar* "administrues i arkës"; njëfarë *Dobrassin fante de voyvoda* "D. i bir i vojvodës"; argjentari *Giura horexe* dhe ndonjë sas, çfarë do të ketë qenë borxhliu *Nicoliça Cancou* nga një vend i panjohur, lejohet të nxirret përfundimi që te ky tregtar merrnin hua jo vetëm punëtorë krahu të minierës së Novobërdës e të puseve në rrethina të saj të afërta e të largëta, porse edhe njerëz që kishin poste drejtuese e edhe ndonjë argjendar.

Këto të dyja janë burimet më voluminoze të cilat në aspektin onomastik, përkatësisht në aspektin e toponimeve, antroponimeve e patronimeve e mbulojnë hapësirën midis qyteteve të Prishtinës-Podujevës-Kamenicës-Gjilanit (në Kosovë) dhe të Kurshumlisë-Krushevcit-Medvegjës-Prokuples-Vranjes e Nishit në hapësirën gjuhësore të shqipes, të ashtuquajtur Serbi e Jugut.

Këto dokumente janë me rëndësi të madhe sidomos për onomastikën e atyre vendbanimeve, të cilat sot i takojnë Kosovës, sepse për këto pothuaj se fare nuk mund të gjenden të dhëna në burimet kishtare serbe të shek. 13-15. Një pasqyrë bukur e plotë përfitohet nga këto materiale për antroponiminë, përkatësisht për strukturën etnike të banorëve të qytetit të Novobërdës - njërit ndër qytetet më të njohura të mesjetës së vonë në gjithë hapësirën e Ballkanit, i vetmi që përkrah Srebrenicës e mbante atributin *civitates* - e të katundeve përreth.

Këto burime, të cilave u prijnë Vendimet e Këshillit të Raguzës të vitit 1365, i botoi historiani serb Mihailo Dinić.[75] Si *Testamenti* ashtu

[74] Khs.Dr. Jahja Drançolli, Qytetet e Kosovës..., f. 49.
[75] Nën titullin Iz Dubrovačkog Arhiva I., Beograd, 1957.

edhe *Libri* dhe dokumentet e tjera raguzase që u shfrytëzuan për këtë punim janë të shkruara në variantin mesjetar të latinishtes vulgare, popullore por, në aspektin morfologjik, në frymën e kroatishtes.

Duke u nisur nga shqiptimi i sotëm i disa emrave të vendeve e të vëllazërive që janë dëshmuar në këto burime, do të kishte mjaft arsye të besohet se nuk do të na shpëtojnë shumë gabime për t'i supozuar disa nga veçoritë grafike e fonologjike të shkrimit në këto burime. Fonemi *x* duhet të lexohet si *sh* (khs. *Buxatouich*, *Lex*, *Pruxeu*, *Nichxa*, *Mexincheuiza* lexo: Bushatoviq, Lesh, Prushev, Niksha, Meshinçevica dhe si *zh* (khs. *Xiucho Castrat e Giuxi* Castrat; lexo Zhivko Kastrat, Givzhi Kastrat); *s* duhet të lexohet si *sh* (khs. *Baosich*, *Pristeuaz*, *Ruscho* lexo Baoshiq, Prishtevac, Rushko) dhe si *z* (khs. *Sdrauaz*, *Sisinzi*: lexo Zdravac, Zizinci); fonemi *ch*, kur është në fund të emrit, duhet të lexohet si *q* (khs. *Baoxich*, *Ruchich* lexo Baoshiq, Rukiq) dhe si *k* (khs. *Buiach*, *Ducha*, *Lecha* lexo: Bujak, Duka, Leka), si edhe kur është në ballë të emrit (khs. *Chosouiza*, *Chmetouzi* lexo Kosovica, Kmetovci); fonemi *z* duhet të lexohet si *c* (khs. *Gez*, *Chaletinzi*, *Toponiza*, *Belaz*, *Chameniza* lexo Gec, Kaletinci, Toponica, Belac, Kamenica); grupi i zanoreve *ou* duhet të lexohet si *v* (khs. *Progonou* lexo Progonov); grupi i zanoreve, përkatësisht diftongu *-ie-* lexohet si *-je-* (khs. *Grachoieuzi* lexo Grahojevci) dhe fonemi *v* duhet të lexohet si *u* (khs. *Vglexa* lexo Uglesha)

Duke qenë se është vetë i shkurtër, në *Testament* ka më pak material onomastik. Ndryshe qëndron puna me Michael de Luchari-n, i cili në *Librin* e vet që pasqyron vetëm një segment të afarizmit të dyqanit të tij, përkatësisht atë të dhënies hua, prandaj i ka shënuar emrat e mbiemrat e të gjithë huamarrësve, përkatësisht borxhlinjve dhe të dorëzanëve të tyre dhe në shumë raste edhe emrat e katundeve nga të cilat vinin ata. Nga një material i këtillë edhe pritet me të drejtë se mund ta japë një pasqyrë më të plotë të onomastikës së këtij regjioni dhe të njerëzve të tij që në gjysmën e parë të shek. 15 ishin në marrëdhënie me këta dy tregtarë raguzas.

Në dritën e shënimeve dhe të vetë materialit antroponimik, që përmbahen në *Testament* e në *Libër*, del qartazi (me sa mësohet për ata persona të cilët në këto dokumente janë cilësuar shprehimisht për të ardhur) se popullsia e Novobërdës, sidomos ajo e paralagjeve *Podgradie* dhe *Gima* të tij, ishte shumë heterogjene. Aty kishte njerëz të ardhur nga Mati i Shqipërisë (khs. *Andria Nicholich Arbanexo de Matia*), nga katundi Sakato po ashtu i Shqipërisë (khs. *Gergas frar de Nichola Zachataj*); nga qyteti Kreševo i Bosnes (khs. *Voichna* sic! *Petrouich de Chrexeuo*, f. 89), nga Kratova e Maqedonisë (khs. *Ilia de Cratoua* në v. 1411 dhe *Ilia de Chratoua* e *Nichola Chratouaz* në vitin 1438); nga Kërçova në Maqedoni

(khs. *Miliza dona de Dmitar Chizeuaz*); nga Nish-i në Serbi (khs. *Petcho suster de Nix*); nga Prishtina (khs. *Bossidar Pristeuaz* dhe *Petar Gonouich Pristeuaz*); nga Trepça (khs. *Petar bratanaz de Gin in Trepza* f. 83) dhe nga Shtimja në Kosovë (khs. *Radossau Moixich de Stimla*); nga Ragusa (khs. *Radoie conparo de Dragos de Raguxi* dhe *Braicho Brezanin de Raguxi*) dhe nga Spliti në brigje të Adriatikut (khs. *Anta fiol de ser Antoni de Spalato*; ky i fundit ishte *Purgar*,[76] sh. më poshtë). Nga gjurmime të deritanishme mësoshet se në Novobërdë kishte edhe njerëz të ardhur nga Kotori, nga Ulqini e nga Venediku. Mirëpo përveç popullatës vendëse, pjesën dominante të kolonëve të Novobërdës e përbënin raguzasit dhe sasët.*

Përbërja kaq heterogjene e popullsisë së Novobërdës në fillim të shek. 14 sqarohet lehtë po të kihet parasysh rrethana e pranuar përgjithësisht se qyteti i Novobërdës ishte qendra më e madhe tregtare në gjithë Ballkanin dhe i kishte dalur nami për i pasur me argjend e me ar, prandaj edhe paska pasur në atë kohë rreth 40.000 banorë. Duket se pikërisht tek kjo rrethanë duhet kërkuar e gjetur sqarimi përse në këtë zonë ka (në krahasim me pjesën tjetër të hapësirës etnolinguistike të shqiptarëve) aq shumë gjurmë të puseve të minierave dhe gjurmë të shkritoreve të vëna në lëvizje me ujë** buzë lumenjsh e përroskash të këtij regjioni. Nga shënimet e mësipërme mund të pandehet edhe përkatësia etnike e kryehershme e disa banorëve të këtij qyteti. Mësohet p.sh. se përveç raguzasve, shqiptarëve e serbëve, në Novobërdë kishte edhe ndonjë bullgar (khs. *Iuan fiol de Radossau Bugarin de Lisize****), grekë (khs. *Lazor Grech de Gurchouzi*) dhe ndonjë hungarez (khs. *Vuchossau Ugarzich de Hrospinzi*) të cilët mbase më parë duhet të shihen për individë vendës të sllavizuar për nga onomastika si në rastin e parë e të tretë, shqiptarë apo të shqiptarizuar siç do të ishte rasti i dytë sesa si të ardhur nga Bullgaria, Greqia e Hungaria. Fundja këta edhe ishin banorë vendës të katundeve të sotme Prapashticë, përkatësisht lagjes *Lisica* të këtj katundi, katundit Gjurkvoc dhe katundit Hrospinci të krahinës së Gallapit. Katundin e fundit, i cili në *Libër* përmendet edhe si *Hrospinzi*

[76] Sh. Momir Jović, Dubrovačka vlastela u Novom Brdu 1439-1455, Studia Humanistica 2 (1975), Prishtnë, f. 229.

* Më hollësisht sh. për këtë punimin tim Bashkëjetesa sase-shqiptare në shekujt 14-15 dhe disa gjurmë onomastike e leksikore të tyre në Kosovë.

** Khs. për këtë vendet e quajtura *cholo*, përkatësisht - Kolla "pus miniere" dhe *Samokova* "lloj dërstile e vënë në lëvizje me ujë për thërmimin dhe shkrirjen e mineraleve" në punimin tim Bashkëjetesa sase-shqiptare në shekujt 14 - 15 dhe disa gjurmë onomastike e leksikore të tyre në Kosovë.

*** Kemi të bëjmë me malin, përkatësisht lagjen e sotme *Lisica* të katundit Prapashticë të komunës së Prishtinës (lokalizim imi)

arbanexo, Iljaz Rexha[77] e identifikon me katundin e sotëm Hropinci midis Gajtanit e Medvegjës,[****] që sot bien në të ashtuquajturën Serbi e Jugut. Në këtë katund, që në defterin turk të fundshekullit 15 ishte evidentuar në trajtën *Hropishnica*, jetonte edhe banori, mbase i etnisë shqiptare, i quajtur Petri, i bir i *Gjon*-it.[78]

Në *Testament*, që në thelb është vetëm një listë e shkurtër e borxhlinjve dhe të dorëzanëve të tyre, ndeshen këta persona që mbanin emra apo mbiemra shqiptarë: Dean *Precal*, *Gerglach* dhe *Vlac* (f. 28) *Gionaç* Oliuerin, *Voch* Milatchouich dhe Nichola don *Gion* (f. 29). Sikundër mund të kuptohet nga epiteti *don*, në këtë rast më parë mund të kemi të bëjmë me një prift, përkatësisht famullitar, meshtar për të cilin nuk merret vesh nëse ishte vendës apo i ardhur, se sa me ndonjë "zotëri" individ.

Këta borxhlinj mbanin antroponimet shqipe Prekal, Gjergj-, Gjon/ Gjonaç, Vok dhe Vlash. As për asnjërin nga këta e as për shumicën e borxhlinjve të tjerë që përmenden në Testament nuk dimë se prej nga ishin. Mirëpo duke qenë se pas emrave e mbiemrave të disa borxhlinjve të tjerë jepen edhe emrat e vendbanimeve prej nga ishin ata, si psh. *Bossin de Maroze*, *Stepan de Macres* etj, që dëshmohen në *Testamentin* e raguzasit Brathoslaglich (f. 29) ka arsye të besohet se kemi të bëjmë me borxhlinj që vinin nga katundi i sotëm Marec dhe lagjja e tij *Markesh* - (të dyja rrëzë Novobërdës), ose nga katundet *Makresh* (serb. Makreš) e Marovcë (serb. Marovce) të Medvegjës, përkatësisht të së ashtuquajturës Serbi e Jugut.

Emra personalë apo mbiemra shqip ose mbiemra të formuar me mjete gramatikore të shqipes mbanin këta borxhlinj të Michael de Luchari-t: *Biba pastorach de Nouach Sarzinou* (f. 63); *Bauaz* (sic!) *Bibal* (f. 82.)*; Dmitar Buxatouich de Groxeta* (f. 51); *Nichola Dodizich de Hainouzi* (f. 39); *Ducha e suo fiol Iuan de Grubxinzi in Toponiza* (f.78); *Gergas*

[77] Iljaz Rexha: Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës sipas defterit të fundshekullit XV, në Vjetar XXVII-XXVIII i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë 2002, f. 87

[****] Medvegjën e mbajnë, sipas Website www.medvedja.org.rs, për qytet të periudhës së sundimit romak. Në shek. I të erës sonë, kur legjionet romake kaluan në jug të Savës e të Danubit dhe kur kjo hapësirë iu ndajmbath provincës Moesia e Epërme, Medvegja e sotme quhej *Idimum*. Nëpër këtë qytet kalonte udha kryesore ushtarake "Via militaris" që niste në *Singidunum* (sot Beograd) nëpër *Viminacium* (sot Kostolac) dhe në qytetitn *Naissus* (sot Niš) ku ajo bigëzoj në rrugë shpienin njëra për në Selanik e tjetra për në Maqedoni/Bullgari/Turqi. Në dritën e rrethanës që vendbanimi *Idimum* e kishte në të vërtetë statusin e një

[78] Po aty, f. 87.

Dapsich becharo (f. 67); *Gergas conpare de Raichouo cholo* (f. 79); *Gergi Daizetich de Plauize* (f. 69); *Gergas frar de Ni. Za(cha)taj* (f. 51*); Gergas Zataj* (f. 39); *Gez fante de Dmitar Soimirouich* (f. 66); *Gin Zemerich. .. de Varuariza* (f. 82); *Petar bratanaz de Gin Nafora* (f. 47); *Nichola Gin Nafora* (f. 68); *Petar bratanaz de Gin in Trepza* (f. 83); *Ginas Zessarouich* (f. 44); *Andria Ginouich de Boxotinzi* (f. 45); *Lecha Ginouich de Podgradie* (f. 62); *Andria Gon foxer de Podgradie* (f. 62); *Gurag de Gon Arbanexo chruzmar e foxer e Andria suo frar sortor* (f.. 62); *Vlatcho Biogradaz piegi per Gon foxer con stava con Progon* (f. 56); *Gon Belaz foxer* (f. 50); *Gon Choxiza foxer* (f. 44); *Gon Gerdatich* (f. 68); *Gon Gradiuanta* (f. 49*); Gon Mali foxer in posta de Gon* (f. 38); *Gon Miralin* (f. 67); *Gon Progonou foxer* (f. 46); *Gon Vlchata foxer* (f. 67); *Gon Vogoli piego per Gon Mali foxer in posta de Gon* (f. 52); *Gon Vranaj* (f. 50); *Haidin foxer* [...] *per Gon* (f. 64); *Vlaia de Gon Godin* (f. 44); *Voin de Gon* (f. 42); *Andria Gonouich de Boxotinzi* (f. 75); *Andria Gonouich Gaize de* (sic !) (f. 51); *Andria Gonouich de Gurchouzi* (f. 85); *Boxidar dito Vlaich de Gon* (f. 66); *Iuan Gonouich foxer* (f. 47); *Mioman Gonouich Benchouschi foxer* (f. 39); *Nichola Gonouich de Grachoieuzi* (f. 55); *Petar Gonouich Pristeuaz* (f. 68); *Radoslau Gonouich hutman de Podgradie* (f. 55); *Pauao Gonzeuich de Podgradie foxer* (f. 52); *Milos Mexouich in posta de Gon* (nga *Chmetouzi in Moraua)* (f. 52); *Lecha Goianouich* (f. 52); *Lex Buxatouich e fradeli de Groxeta* (f. 51); *Lex conpare de Gurchozi* (f. 81); *Marcho Maluxat* (f. 69); *Mechxa plachaonizar in Podgradie* (f. 64); *Milos Mexouich de Leuatriza in posta de Gon* (f. 52); *Radie e Radincho fradeli de Miechxa* [...] (f. 75); *Michxa Lechich orese* (f. 39); *Petcho Progonouich de Boxotinz*i (f. 45); *Dmitar Spani orexe* (f. 71); *Tanus Bogdanouich de Gurachouzi foxer* (f. 51; 81); *Thanus... fante de Hanzo* (f. 42); *Vochmio Vladich de Mohouaz in Topaniza* (f. 74); *Vochxa de Sirze* (f. 69); *Gurag Zoto de Sirze* (f. 81) dhe *Radossau Zoto in Sirze* (f. 78).

3.1. Venerime 1

Në dritën e materialit onomastik të sjellëmë lart mund të nxirret përfundimi se si midis personave të cilët dëshmohen në dokumente më të vogla raguzase që rrjedhin nga vitet 1382-1454, ashtu edhe midis borxhlinjve të tregtarëve raguzas Gostisse Brathoslaglich dhe Michael de Luchari të viteve 1411-1438 ka persona të cilët i mbajnë antroponimet shqipe *Biba*, *Gerg* var.* *Gergas*, *Gergi*, *Gerglach*, *Georgius*; *Gez*, *Gin* var. *Ginas*, *Ginus*, *Gincho*; *Gon* var. *Gion*, *Gionaç*, *Gonaz*; *Lecha*; *Lex*;

* Shkurt për *variant.*

Maluxat; *Miechxa*; *Nichxa*; *Progon, Span, Tanus* var. *Thanus, Tanussio*; *Vlac*; *Voch* var. *Vochmio, Vochxa* dhe se mbajnë edhe mbiemra të cilët kanë dalë nga antroponimet shqipe apo nga brumi leksikor i gjuhës shqipe: *Bibal, Buxatouich, Dodixich, Gega, Ginouich, Gonouich* var. *Gonzeuich, Lechich, Mexouich, Nichxa, Progonou* var. *Progonouich, Spani, Tani, Trassa, Vlax, Vogoli* dhe *Zoto*.

Mbi bazën e paravendimit se edhe në këtë pjesë të territorit etnogjuhësor të shqipes antroponime shqipe mbanin në pjesën më të madhe të rasteve apo gjithmonë vetëm shqiptarët, do të lejohej paravendimi se asokohe pikërisht shqiptarët ishin bartës si të antroponimeve sllave *Bogouaz, Boxidar, Iuan, Mioman, Nouach, Petcho, Radossau, Radoslau, Vlaia* var. *Vlatcho* dhe *Voin* ashtu edhe bartës të antroponimeve të gjithkrishtera në trajta sllave të tyre si *Andria, Dmitar, Gurag, Iuan, Marcho, Nichola, Pauao* dhe *Petar*. Personat që mbanin antroponime shqipe mbanin edhe patronimet me prejardhje sllave si: *Bodganouich, Dapsich, Daizetich, Milatchouich, Nicholich, Vladich, Vlchata, Zessarouich* si dhe emra familjarë të sajuar (vështruar në pikëshikimin etimologjik) nga brumi leksikor i kroatishtes si: *Batuzeuich, Gradiuant*a, *Miralin, Pava,-o* e *Zemerich* e ndoshta edhe emra me prejardhje sase si *Gerdatich* e *Godin*.

Bartësit e antroponimeve shqiptare ishin të katundeve: *Boxoieuzi*, përkatësisht Boxotinizi (= katundi i sotëm serb Bozhevc afër Novobërdës), *Groxeta* (emër i zhdukur i një vendbanimi që ishte në territor të katundit të sotëm serb Dragancë afër Novobërdës),[*] *Gurchouzi*, përkatësisht *Gurachouzi* (katundi i sotëm Gjurkovc i Kamenicës), *Hainouzi* (katundi i sotëm Hajnoc i Kamenicës), *Liuada* (ndoshta lagjja Golemivadë e katundit Marec ose Livadicë në komunën e Podujevës); *Mohouaz* (katundi i sotëm Muhovc i Kamenicës), *Plauiza* (lëndina e sotme Pllavica në Novobërdë), *Podgradie* (një lagje e dikurshme e qytetit të Novobërdës); lagjes *Gima* që në bazë të konfiguracionit të terrenit ka arsye të besohet se kështu do të jetë quajtur lagjja e sotme Bujakët e Marecit; *Raichouo Cholo*, (lagjja e sotme Rekekollë e katundit Marec në kufi me Novobërdën); *Rachita* (lagjja Rakita e katundit Rakinicë të Orllanit), *Sirze Cholo*, përkatësisht *Suirzi* (katundi i sotëm shqiptar Sfircë i Kamenicës), *Trepza* (miniera e njohur e Trepçës afër Mitrovicës), *Leuatriza*, katundi i sotëm Turuçicë afër Orllanit[**] dhe *Uaruariza* - lexo Varvarica (i cili ishte në territorin e

[*] I lokalizuar nga Mihailo Dinić, Za istoriju rudarstva u srednjovekovnoj Srbiji i Bosni, I, Beograd 1962, f. 33.

[**] Të lokalizuara nga unë, sh. punimin tim: Rreth lokalizimit të katër vendbanimeve të krahinës së Gallapit, "Fjala", 6/1977, f. 12.

katundit të sotëm Zajçec të Kamenicës) dhe nga vendbanimet e paidentifikuara *Hrospinzi*, (sh. më lart) *Grachoieuzi* dhe *Trupostiza*.

Pjesa më e madhe e personave të dëshmuar në këto dy burime jetonte porse në vetë qytetin e Novobërdës dhe në lagjet e tij, përkatësisht në katundet e sotme përreth këtij qyteti gërmadhë. Vendbanimet e shënuara në *Libër* dhe në regjistrime osmane-turke për si lagje të Novobërdës nuk duhet marrë në kuptimin e ngushtë të fjalës lagje. Nga vetë pozita gjeografike që e ka kështjella e Novobërdës rezulton se qyteti-kështjellë i Novobërdës me minierat në kodrat e në lagjet e sotme të Marecit e përreth tij, ishte qendër gravitimi për punë nëpër miniera; për tregti; qendër kishtare katolike për punë të liturgjisë (pagëzimi, kurorëzimi etj.) nëse/meqë në vendbanimet përreth nuk do të ketë pasur kisha të tjera katolike. Nga burimet mësohet për ekzistimin në Novobërdë të dy kishave katolike. Njëra nga këto është dëshmuar në vitin 1346 bashkë me kishat katolike të Prizrenit, Janjevës, Koporiqit, Pllanës, Rogoznos e të Bërskovës. [79] Kjo do të jetë Kisha e Shënkollit, e njohur në literaturë si "Kisha e sasëve".[80] Përveç kësaj, është dëshmuar se në Novobërdë ka pasur edhe një kishë kushtuar Shën Mërisë: "S. Maria in Dogni Terg", e cila gjendej në Sheshin e Poshtëm.[81] Ekzistimin e kësaj kishe e dëshmon tërthorazi edhe e dhëna në testamentin e priftit mbase italian Gjergj Fisi, i cili jetonte në Novobërdë. Në testamentin e tij ai thotë se "*Së pari po i lë Shën Marisë për të dhjetën dhe për frytet e para 4 groshë*".[82] Si njëra ashtu edhe kisha tjetër, përkatësisht "Kisha sase" e Shënkollit ashtu edhe ajo e shën Mërisë ishin, menjëherë pas pushtimit osman të Novobërdës më 1 qershor 1455, të shkretëruara përbrenda dhe kishin mbetur pa kulme e pa këmbana. Tri vite më vonë njoftohet se këto dy kisha nuk kishin as kryqa, as libra dhe as ornamente të tjera. Edhe përkundër gjendjes së këtillë, papa Kalikst-i III i udhëzonte famullitarët e Janjevës e të Trepças që, pas vdekjes së Petar Cetrumović, për famullitar të kishave të Shënkollit e të shën Mërisë së Novobërdës ta vendosnin *Gin Merić*-in. Në shkresën e tij papa premtonte se të gjithë atyre që, ditën e Shën Vlashit, Zonjës së Madhe dhe ditën e Shënkollit, i vizitojnë këto kisha, që rrëfehen në to dhe që u falin atyre kishave në rrënim, do t'u falen mëkatet. Megjithatë, kisha e Shënkollit u shndërrua në vitin 1466 në xhami. Përkundër pushtimit, pushteti osman u soll mjaft arsyeshëm kundrejt

[79] C. Jireček, Staat und Gesellschaft. .., II, f. 66, 68.

[80] Khs për këtë së fundi Miklós Takács, Sächsische Bergleute im mittelalterilichen Serbien und die "sächsische Kirche" von Novo Brdo, Südost-Forschungen, Bd. L, 1991.

[81] Gaspër Gjini, Ipeshkvia Prizren- Shkup-Prizren nëpër shekuj, Drita, Zagreb, 1992, f. 85.

[82] Sh. Dokumente për Historinë e Shqipërisë të shek. XV, përgatitur nga Injac Zamputi-Luan Malltezi, Tiranë, 1987, dok. 390, f. 463.

popullsisë së Novobërdës dhe të rrethinave të gjera të saj. Ajo nuk ushtroi dhunë dhe as presion për islamizimin, por marrë në përgjithësi, e respektoi gjendjen ashtu siç e kishte gjetur kur e pushtoi këtë qytet. Me themelimin e kadillukut (Qarkut administrativ e gjyqësor) në Novobërdë me në krye kadiun (gjyqtarin) i cili i aplikonte ligjet dhe urdhëresat e pushtetit qendror, popullata e nënshtruar mbrohej në masë të konsiderueshme nga dhuna e nga hujet e teket e spahinjve. Thënë ndryshe, edhe përkundër vendosjes së pushtetit osman, sulltani nuk e shuajti autonominë e gjyqeve raguzase për gjytetarët raguzas, derisa për shkaqe praktike vetë qytetarët raguzas preferonin zgjidhjen e kontesteve ose para kadiut ose përmes këshillave vendëse të pajtimit.[83]

Për "Kishën e Sasëve" tani e kohë më parë dihet se nuk ishte përbrenda kështjellës, qytetit të Novobërdës, porse në katundin e sotëm Bostan rrëzë bjeshkës mbi majën e së cilës është qyteti i shkretëruar i Novobërdës. Unë nuk di nëse nga arkeologët është lokalizuar Kisha e Shën Mërisë, por duke u nisur vetëm nga përcaktori "*in Dogni Terg*" "në Sheshin e Poshtëm" kujtoj se ka shumë arsye të supozohet se as kjo kishë nuk ishte përbrenda mureve të qytetit, aq më parë kur dihet se "sheshet" ishin vende tregtie rëndom përreth kishave dhe gjithmonë jashtë mureve të qyteteve. Nëse përreth mureve të qytetit të Novobërdës kishte pra vetëm dy kisha katolike, atëherë do të jetë vështirë të kuptohet numri relativisht i madh i klerikëve të lartë e i famullitarëve të rëndomtë që dëshmohen të kenë shërbyer në qytetin e Novobërdës dhe rolit të këtij qyteti si seli përfaqësuese e ipeshkëvisë së Tivarit (ndonjëherë edhe e Kotorit) jo vetëm për qytetin e Novobërdës, porse edhe për gjithë katolikët e Sklavinisë, përkatësisht të shtetit mesjetar të Rashës. Kjo do të tregonte se Novobërda ishte deri në kohën e pushtimit definitiv osman më 1 qershor 1455 jo vetëm qendër ekonomike e madhe, porse edhe qendër mburojë e katolicizmit.[84] Nëse këtë funksion kisha katolike e luante vetëm për kolonët katolikë raguzas e romanë të tjerë, shqiptarë qytetarë raguzas e të principatave të Shqipërisë së sotme dhe sasë, të shpërndarë në rrethina të Novobërdës apo kishte edhe popullatë vendëse katolike kjo, për mendimin tim, mbetet çështje që duhet të provohet. Shkurt, qyteti i Novobërdës do të ketë qenë vetëm kështjella me minierat përreth e jo një qytet aq i madh siç e paraqet tradita gojore sa që macja

[83] Nikola Čolak-Ive Mažuran: *Janjevo*, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 30.

[84] Përkitazi me këtë njohësi ynë i mirë i Kosovës mesjetare J. Drançolli (khs. punimin e tij Qytetet e Kosovës..., f, 48) konstatonte se "Rënia e qytetit la mbresa të mëdha në Hungari., në Itali e në Dalamaci, meqë Novobërda, përveç rolit të madh tregtar, konsiderohej edhe si një ndër qendrat kryesore për mbrojtjen e krishterimit."

paska ecur disa orë nëpër çati shtëpish. Në shpatijet e rrëpinshme të kodrës, në majën e së cilës është kështjella, nuk ka mundësi të ketë pasur "kuarte apo distrikte" të qytetit në të cilin do të mund të jetonin 40.000 banorë - siç thuhet edhe në disa shkrime.

Për si "lagje" të Novobërdës janë evidentuar në të vërtetë lagjet e sotme të katundit Marec dhe të ndonjë katundi në rrethina të largëta që atëherë ishin si të thuash nën juridiksionin e kështjellës së Novobërdës. Rregullimi i këtillë administrativ sikur dëshmon se qyteti i quajtur Novobërdë mund të ketë qenë një qendër municipale e padëshmuar ndër burime p.sh. si **Municipium Damastionica*. Meqë ra fjala për Damastionin bën të thuhet se ka pak arsye të besohet së pari që kështjella e Novobërdës të jetë vepër arqitektonike serbe. Kjo edhe përkundër rrethanës se ky qytet ishte pronë private* dhe seli e kontit Lazar, katunar dhe bir i vllahut Hrebeljan, përkatësisht Hrebeljanović,[85] i lindur në katundin Përlepnicë jo larg Novobërdës, i cili e ngriti aty edhe sistemin e doganave dhe kishte aty, si edhe pasardhësit e tij, vojvodët përkatësisht mëkëmbësit e tij. Kjo sepse merret përgjithësisht për si fakt se hovin më të madh të zhvillimit Novobërda e përjetoi, sipas K. Jireček-ut, pikërisht në kohën e sundimit të kontit Lazar, të birit të tij despotit Stefan Lazarević dhe të nipit të tij Gjergj Branković-it,[86] vazal i pushtuesit turk. Udhëpërshkruesi freng Betrandon de la Broquièr shënonte se despoti Gjergj vetëm nga miniera e Novobërdës vilte të ardhura në lartësi prej 200 mijë duketësh ari në vit.[87] Mua më duket se shpjegimi më i mirë përse sundimtarët lokalë serbë mundën të mbeteshin në pushtet dhe të pasuroheshin nga të ardhurat e mëdha të minierave të Kosovës është pikërisht vazaliteti i tyre ndaj pushtetit osman i cili edhe ua bëri të mundshme bashkëjetesën e pushtetit paralel, përkatësisht (siç e konstaton këtë J. Drançolli për qytetin mesjetar të Vushtrisë[88]) "dypushteti: pushteti osman dhe Brankoviq". Përkundër kësaj, në Novobërdë nuk është dëshmuar sigurisht ekzistimi i ndonjë kishe serbe, përkatësisht ortodokse. Për ekzistimin e ndonjë kishe serbe në këtë qytet mund të flitet vetëm nëse dëshmohet se në Novobërdë kishte pasur dy kisha kushtuar Shën

* Për këtë sh. më gjerësisht në punimin tim Bashjkëjetsa sase-shqiptare në shekujt 14 - 15 dhe disa gjurmë onomastike e leksikore sase në Kosovë

[85] Duket se origjinën kosovare të Lazar Hrebeljanit e tregon edhe e vetmja dëshmimin e mëvonëshme e antroponimit Hrebelan në hapësirën e sotme të Kosovës. Në defterin e vitit 1455 (khs. Oblast Brankovića..., f. 286) në katndin Reçicë të krahinës së Llapit dëshmohet banori Hrebeljan, i bir i Gaqe-s (origj. Hrebeljan, sin Gaće)

[86] Sipas Stojan Novaković, Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje,. .., f. 31.

[87] J. Drançolli, Raguzanët,. .., f. 65.

[88] Khs.Dr. Jahja Drançolli, Qytetet e Kosovës. .., fq, 47.

Kollit, sepse për një kishë të kushtuar këtij shenjtori dihet se ishte kishë katolike. Pasiguria lidhet me rrethanën se turqit, qysh më 1455 një kishë të Shën Kollit e paskan shndërruar në xhami dhe për këtë kishë po u supozuaka të ketë qenë ortodokse.[89] Mirëpo për praninë e klerikëve serbë ortodoksë në qytetin e Novobërdës e të rrethinës së tij nuk ka ndonjë dëshmi që do të ishte më e vjetër se shekulli i 16 kur në "Pomenik"-un e Pejës midis mitropolitëve të Novobërdës përmenden edhe mitropolitët Dionisie, Vasilie e Viktor.[90] Këtu nuk kishte as gjyqe e as gjyqtarë serbë. Dihet se deri në vitet '30 të shek. 15, gjyqtarë në Novobërdë ishin patricë e qytetarë raguzas. Po të merret parasysh se vetë qyteti i Raguzës kishte 79 familje patricësh dhe që vetëm në Novobërdë jetonin 21 syresh, del e qartë se sa e rëndësishme ishte Novobërda për raguzasit, të cilët pra e kishin edhe gjyqin, përkatësisht gjyqtarët e vet dhe jetesës aty ia jepnin tonin roman. Ndonjëri nga ata, si p.sh. *Ser Antoni de Spalato Purgar* "qytetar" ishte nga qyteti i Splitit. Mirëpo, e ndodhur përpara pushtimit osman të qytetit, aristokracia raguzase nuk kishte më lëvërdi as të punonte e as të jetonte në Novobërdë. Kjo pasiguri e kjo ndruajtje bëri që të bie edhe vëllimi i fitimeve të kësaj aristokracie. Kjo u reflektua edhe në rënien e numrit të gjyqtarëve raguzas në Novobërdë. Këtu duhen kërkuar arsyet përse në harkun kohor midis viteve 1439-1455 në konteste gjyqësore dëshmohen 21 herë 15 *popolanë*, përkatësisht gjyqtarë - pjesëtarë të shtresës së qytetarëve. Nga emrat e mbiemrat e gjyqtarëve *poplanë* dhe të palëve në kontest (khs. gjyqtarët Vlachola Dabisinovich, Nixa Rendich, Marinze Ni. de Gabro, Radovanus o. soc. Radogne, Vitchus Miosich, Jacobus Blaxii de Crancho, Givichus Besantich, Novach Chichaich, Novach Bogichijevich, Nicola Soimierovich, Vlachota Gamba, Boxiguchs Pavlovich, Pavchus Stiepasinovich, Nicola Cudilinouich, Boxigchus Pavlovich dhe Nicola Givichi Castrat dhe të palëve në kontest: Vlachussa Latiniza e Pascho Givchi Zelubinovich d. Reomecha)[91] del qartazi se ndoshta me përjashtim të gjyqtarit të fundit, të gjithë mbanin antroponime e patronime sllave në variantin kroat të tyre që nënkupton se ata do të kenë qenë vetëm qytetarë të Republikës së Raguzës. Karakterin prej një kolonie të mirëfilltë raguzase të Novobërdës e tregon mbase rrethana që raguzasit kishin (dhe sidomos) në këtë qytet jo vetëm eksterritorialitet gjyqësor, sikur mendon dijetari ynë J. Drançolli,[92] porse mbase edhe

[89] Khs. për këtë M. Takács, Sächsische Bergleute im mitteraalterlichen Serbien und die "sächsische Kirche" von Novo Brdo, Sürost-Forschungen, Bd. L, 1991, f. 43.

[90] Sh. Stojan Novaković, Srpski pomenici XV-XVI veka, në Glasnik Srpskog Učenog Društva XLII, Beograd, 1875, f. 35.

[91] Sipas M. Jović, Dubrovačka vlastela. .., f. 232, 233.

[92] Khs. Dr. Jahja Drançolli, Qytetet e Kosovës. .., fq, 43.

eksterritorialitet gjuhësor. Kësaj duhet shtuar edhe rrethanën se në Novobërdë vepronte që nga viti 1349 edhe farkëtaria për prejren e monedhave të njohura si *grossi di Nouaberda* "Groshët e Novobërdës" dhe se katolikët e Novobërdës kishin ndërtuar këtu edhe një spital.[93] Duket se qenien në qarkullim të groshëve të Novobërdës e dëshmon edhe rrethana se borxhlinjtë e M. Luchari-t merrnin nga ai hua pikërisht groshë.

Fundja edhe vetë emri Novus Mons, Novomonte, Monte Novo, gjerm. Nyberghe serb. Novo Brdo i dëshmuar në trajtat Novaberda, Nouaberda Novo Berda është një emërtim që tregon diçka të re, diçka që ardhësit e gjetën kur erdhën. Çfarë kishte ndodhur me këtë qytet para pushtimit serb në shek. 12, përkatësisht 13 mbi themele të të cilit qytet mund të jetë (ri)ndërtuar kështjella mesjetare dhe çfarë emri do të ketë pasur ai qytet, mbetet çështje që duhet të hulumtohet.

Deri tani nuk ka pasur ndonjë tentim për identifikimin e kësaj kështjelle me ndonjërën nga të 24 kështjellat e rindërtuara e të ndërtuara nga perandori dardan Justiniani, porse është debatuar rreth identifikimit e lokalizimit të një qyteti të quajtur Damastion, të përmendur në burime që në shek. 4 të e. s. Është dëshmuar se minierat e Novobërdës janë shfrytëzuar së pakut qysh në periudhën e sundimit romak dhe se në një vend të quajtur *Damastion* janë prerë edhe monedha shumë kohë përpara "rizbulimit" në mesjetë të Novobërdës. Kjo rrethanë i ka shërbyer ndonjë historiani kosovar që qytetin e Novobërdës ta identifikojë me qytetin Damastion të shek. 4. për vendndodhjen e të cilit ka mendime nga më të ndryshmet.[94]

Në kujtesën kolektive të shqiptarëve kolonët romanë, katolikë të brigjeve kroate e italiane të Adriaikut njihen me emrin e përgjithshëm *llatin* "latin". Kështu quhen edhe sot e gjithë ditën nga shqiptarët pasardhësit e raguzasve të Janjevës dhe ata të katundeve të banuara nga kroatë të komunës së Vitisë e madje (mbase jo krejt rastësisht) edhe vetë shqiptarët katolikë p.sh. të katundit Stubëll të kësaj komune.

Me rëndësi të veçantë në këtë mes e që do të duhej pasur parasysh në këtë kontekst do të jetë shënimi sipas të cilit P. Budi, Doctrina Cristiana 226a i dallon qartë për nga përkatësia etnike priftërinjtë *arbëreshë* nga ata *latinë:* "Prifti lëtijë, e j Arbëreshë".[95] Nga këndej mësohet pra që "latinë" ishin priftërinjtë e rrjedhimisht pjesëtarët romanë të krishterimit në rastin tonë delmatët, përkatësisht romanët e brigjeve të Adriatikut, e jo pra edhe

[93] Khs. Dr. Jahja Drançolli, Poaty, f. 48.

[94] Më gjerësisht rreth këtij qyteti khs. punimin tim Bashkëjetesa sase-shqiptare në shekujt 14-15 dhe disa gjurmë onomastike e leksikore sase në Kosovë.

[95] Khs. E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes II, Tiranë 1976, f. 61

shqiptarët e këtij riti të besimit të krishterimit në sterenë (pjesën kontinentale) e hapësirës katolike të Praevalis-it.

Tradita shqiptare i ka ngatërruar ndonjëherë raguzasit me gjenovezët, gjë që e dëshmojnë disa mikrotoponime në e përreth vendbanimeve për të cilat dihet se ishin të banuara nga kolonë raguzas e romanë të tjerë. Tradita gojore shqiptare i ka ngatërruar raguzasit shumë më shpesh me romakët e mirëfilltë të perandorisë romake dhe i ka quajtur *rim* "romak". Më shpesh për *latini* "latinë" e më rrallë për *dubrovčani* i mbanin raguzasit edhe shkrimet kishtare serbe të të gjitha kohëve. Është një e vërtetë e pamohueshme se as vetë raguzasit, së pakut jo në asnjë burim të tyre të shkruar kroatisht, nuk e quanin veten asnjëherë *raguzani*, por vetëm *dubrovčani*. Së këndejmi më është mbushur mendja që, megjithë ekzistimin aktualisht të mbiemrit *Raguž* në Kroaci dhe të atij *Ragusis* në Greqi, e dhëna e sjellë nga orientalisti ynë I. Rexha sipas të cilit ndër defterë të shek. 15-16 për në nahijen e Prokuples po u dëshmuaka një vendbanim, sot i panjohur *Raguzan*, duhet të provohet.[96]

Lidhja emocionale e popullatës së Marecit dhe e asaj të katundeve përreth me Novobërdën është ruajtur në traditën gojore. Kështu p.sh., kujtesa popullore tregon se ndërtimi i kështjellës paska zgjatur shumë kohë. Njëri ndër muratorë kishte ardhur këtu krejt i ri. Pas shumë vitesh, për punëtor krahu erdhi këtu edhe i biri të cilin ky nuk e kishte parë kohë të gjatë. Duke pasur frikë se edhe të birit do t'i kalojë jeta duke punuar në këtë kështjellë, mjeshtri i vjetër e mbyti të birin duke ia lëshuar mbi krye një gur të madh nga lart, ku po punonte vetë. Në kujtesën popullore është ruajtur edhe akti i tërheqjes së qytetarëve të huajë nga kështjella. Tradita e njeh atë popullatë herë si *rim* "romak", *gjenoviz* e herë si *llatin* "roman, dubrovnikas, katolik". Tradita thotë se romanët, përkatësisht gjenovezët qenkan tërhequr për shkak se dimri i fundit para tërheqjes së tyre paska zgjatur tri vjet. Rrënjët e kësaj gojëdhëne duhen kërkuar mbase tek e vërteta historike që lidhet me rrethimet për disa muaj të qyteteve të Prizren'c-it e të Novobërdës nga ushtria osmane pikërisht dimrit, në muajin shkurt të vitit 1427 dhe tek rrethimi poashtu i dëshmuar historikisht prej 48 ditësh më 3 shtator 1439 si dhe tek rrethimet e tjera deri në vitin 1444 kur qyteti i Novobërdës ra definitivisht në duar të osmanëve, që pati për pasojë tërheqjen e shkallëshkallëshme të raguzasve nga ky qytet. Tradita popullore nuk di gjë për sundimtarë serbë.

[96] I. Rexha, Sllavizimi i onomastikës së vendbanimeve mesjetare arbane në arealin e Novabërdës, Nishit, Vranjës dhe Shtipit, Vjetar i Arkivit Kombëtar të Kosovës XXIX-XXX, Prishtinë 2003, f. 153.

Nga burimet nuk ka të dhëna që në Kosovë të ketë pasur gjatë mesjetës kolonë të ardhur edhe nga Gjenova. Megjithatë, në mikrotoponminë e Kosovës ka disa mikrotoponime që e ruajnë emrin e kësaj popullate, përkatësisht të këtij qyteti tregtarësh të Italisë mesjetare. Kështu p.sh. në lagjen e Kangjëve në katundin Orllan ekziston mikrotoponimi *Trojet e Gjenovizit*. Një vend i quajtur *Trojet e Gjenovizit* është edhe në katundin Koliq midis Podujevës e Prishtinës dhe *Vorret e Gjenovizit* janë në katundin Vërbovc të komunës së Vushtrrisë. Këtu bie edhe dromonimi *Udha e Gjenovizit* e cila nis në katundin Bërvenik të Serbisë, i njohur gjatë mesjetës për vendbanim-minierë, koloni raguzase e sase. Prej këtu udha kalon kah maja e lartë me përmbajtje minerale *Picel* dhe bie në katundin Bajgorë të krahinës së Shalës. Prej këtu kjo udhë vazhdon nëpër Bjeshkët e Nemuna dhe bie në katundin Junik. Këtu kjo udhë e ndërron emrin dhe quhet *Udha e L'tisë* "Udha e Latinëve" dhe përfundon diku jo larg Shkodrës, përkatësisht në luginën e lumit Valbona në Shqipëri.

Është mbase me interes të shënohet që pikërisht në atë zonë të hapësirës etnolinguistike të shqiptarëve përbrenda së cilës në shek. 14 dëshmohen kolonë sasë e raguzas, në krahinat e Gallapit e të Karadakut, ka edhe sot mikrotoponime në të cilat ruhet distinktivi "latin", që gjithsesi ka të bëjë me katolikët sasë e romanë, përkatësisht me gjermanë e me raguzas dhe pjesëtarë, individë, popujsh të tjerë të brigjeve të këndejme e të andejme të Adriatikut. Kështu, p.sh. në katundin Lladovë të komunës së Gjilanit është, mikrotoponimi *Te Kroni Llatinit*, ndërsa në katundin Partesh të po kësaj komune, i banuar nga popullatë serbe, është mikrotoponimi *Vorret e llatin've*, nja 100 metra në jug të shkollës së katundit.[97] Këtu bien edhe mikrotoponimet *Lugu i Llatincit, Kroni i Llatincit* dhe *Guri i Llatincit* në katundin Llabjan rrënzë kompleksit të maleve në majën më të lartë të të cilave është kështjella e Novobërdës.

Nga kjo që u tha më lart rezulton se popullata shqiptare jo vetëm e regjionit të Gallapit do të ketë qenë në kontakt edhe me gjenovezë. Këta ishin tregtarë të qytetit shtet të Gjenovës të cilët, si edhe venedikasit më parë, pas kryqëzatës së IV të vitit 1204 e cila ishte sponsorizuar nga Republika e Venedikut, e morën primatin mbi rrugët detare të Mesdheut për në Konstantinopojë.[98] Kontaktin e drejtpërdrejtë do ta tregonte në

[97] Këto mikrotoponime i ka shënuar në terren J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 6, Gjilani, Prishtinë. 2004, f. 145, 76.

[98] Në Jeruzalemin që më 1099 ishte në duar të kryqëzatorëve, tregtarëve vendedikas iu dha një dozë autonomie; një e treta e çdo qyteti, për pushtimin e të cilit këta do të ndihmonin, u jepej venedikasve dhe do t'u lejohej këtyre që në çdo qytet të Mbretësisë së Jeruzalemit ta zotëronjë nga një kishë e nga një treg, [sipas: Robert Payne, Die Kreuzzüge, Zweihundert Jahre Kampf um das Heilige Grab, Patmos Verlag, GmbH &

këtë mes edhe vetë trajta me *z* (khs. ital. *Genovese* lexo gjenoveze "gjenovas") e ruajtur nëpër mikrotoponime të Kosovës. Raguzasit, nga ana tjetër, njihen në traditën shqiptare si *latinë*. Dëshmia më e mirë për këtë janë mikrotoponimet e katundit Llabjan (sh. më lart) të cilat janë toponimizim i emrit etnik në funksion të emrave të vendeve të banimit apo të vendeve që i kishin në zotërim latinët, përkatësisht raguzasit, khs. sllav. "latinci".

Personat që mbanin antroponime shqipe ose antroponime të shqiptarëve (khs. më lart) ishin, për sa i bie prejardhjes: 1. qytetarë ardhës të Republikës së Raguzës dhe të qyteteve të tjera të bregut kroat të Adriatikut dhe 2. sish të ardhur nga Shqipëria. Për sa i bie profesionit, shqiptarët e përmendur në këto burime ishin: 1) priftërinj, nëpunës, tregtarë dhe pronarë tokash, përkatësisht çifligarë dhe 2) qytetarë vendës të qytetit të Novobërdës, të lagjeve të atij qyteti dhe të katundeve përreth tij e që për nga profesioni ishin rrëmihës, zanatlinjë dhe njëri ishte madje edhe gjykatës. Së pakut tre sish, si p.sh. banori *Lesh* i Gjurkovcit, *Tanush*i nga Livada dhe *Gjergj*-i nga Rekekolla ishin në raporte kumbarie me raguzas të ardhur (për këtë khs. më poshtë). Ardhacakët jetonin kryesisht në qytetin e Novobërdës, ndërsa shumica e vendësve ishin banorë vendbanimesh përreth qytetit, përkatësisht jashtë mureve të tij.

Grupit të parë i takojnë: klerikët *Presbyter Ginus filius Gergi*; *Dom Georgius Gega*; *Nichola de Tanus*, *Presbyter Tanussio*; *Nichola Progonouich*; *Michaeli Martinj de Santo Paulo de polato* (nga vendi Shpal/ Shupal i krahinës së Pultit) – banorë të qytetit të Novobërdës dhe prifti *Nichola don Gion* i përmendur në Testament, për të cilin nuk tregohet nëse ishte i ardhur apo vendës; çifligari *Sergio de Tani* dhe argjendari *Johannes Progonouich de Nouaberda* si edhe shumë nga tregtarë të shpërndarë nëpër qendra minerale e urbane të Kosovës mesjetare, siç ishin p.sh. edhe tregtarët e dëshmuar në qytetin e Pejës: *Stepchum Progonouich* [në rasën emërore emri i këtij individi do të duhej të ishte Stepcho] (viti 1408), *Zuitchi Ginovich* (viti 1409, 1415, 1417, 1425), *Michoy Gonovich* (viti 1409), *Nicoliça Giergas* (viti 1412, 1413,1422, 1423), *Michelius Albanensem* (viti 1417), *Michael Progonovich* (viti 1425) etj. Grupit të dytë i takojnë gjyqtari *Nichola Castrati*, *Dmitar Spani orexe* "argjendar", *Nichxa Lechich oresse* "argjendar"; *Gurag de Gon Arbanexo chruzmar* "kafexhi" *e foxer* "rrëmihës në minierë" dhe i vëllai *Andria* (*suo frar*) *sortor*, "rrobaqepës"; *Gergas Dapsich becharo* "kasap, mishshitës"; *Radoslau Gonouich hutman* "kryetar i një grupi prej 8

Co. KG; Albatros Verlag, Düsseldorf, 2001], ecuri që u ndoq, për sa u përket kishave e tregjeve, edhe në Ballkan sidomos nga raguzasit.

punëtorësh në një pus miniere"[99] *de Podgradie; Radossau Gonouich* dhe *Bogdan Spanaz*; partner tregtar; *Lex conpare*[100] *de Gurchouzi*; *Tanus conpare de Liuada*; *Gergas conpare de Raichouo Cholo*; *plachaonizar* "shpërlarës xehesh": khs. *Mechxia Albanese* përkatësisht *Mechxa plachaonizar in Podgradie* (f. 64) i cili i kishte dhe dy vëllezër: *Radie e Radincho fradeli de Miechxa* [...] (f. 75). Mirëpo pjesa më e madhe e tyre ishin *foxer* "minator, xehetar" *hauer* gjerm. *Hauer* "rrëmihës mineralesh: punëtor që shkoç minerale nga toka" si: *Andria Gon, Dmitar Buxatouich, Gez Buxatouich, Gon Belaz, Gon Choxiza, Gon Mali, Gon Progonou, Gon Vlchata, Iuan Gonouich, Mioman Gonouich, Pauao Gonzeuich* dhe *Radossau Trassa*. Për disa bartës të emrave shqip nuk ka të dhëna se prej nga ishin e as çfarë profesionesh ushtronin. Nga shembujt e mësipërm mësohet porse që, në mos të gjithë, së pakut pjesa më e madhe e zanatlinjve, tregtarëve e mjeshtërve të punës në miniera ishin nga radhët e popullatës vendëse. Kjo sqarohet me rrethanën se sidomos që nga koha e rrezikimit të qytetit nga pushtuesit osmanë, popullata vendëse i mori mbi vete shumicën e aktiviteteve në këtë qendër urbane: afarizmin, mjeshtrit e ndryshme e sidomos xehetarinë që e morën nga zotërimi i sasëve. Kjo po u dëshmuaka në dritën e rrethanës se ndër mjeshtër të xehetarisë që nga Novobërda u dërguan në Mbretërinë e Sicilisë nuk po u përmendkan më sasët.[101]

Mbi bazën e rrethanës se një numër jo i vogël i personave që përmenden në *Testament* e në *Libër* dhe që ishin bartës të emrave shqip apo të emrave të shqiptarëve të asaj kohe dhe që ishin banorë të qytetit të Novobërdës, të lagjeve dhe të katundeve përreth tij, me dozë të madhe sigurie mund të merret për si argument që ka mbështetje se shqiptarët ishin shumë kohë para lindjes së këtyre burimeve banorë si të të gjithë

[99] Sipas S. Pulaha, Popullsia…, f. 715.

[100] Nëse këtu kemi të bëjnë me ndonjë gabim shkrimi *conpare* në vend të *compare*. Në këtë rast do të duhej paravenduar se te Lesh conpare kemi të bëjmë me një Lesh compare "kumbarë" nga lat.-roman. *compater*, it. *compare* që edhe në vetë shqipen reflektohet në dy trajta përkatësisht *kumār*-i compare, dhe *kuntri* që Fr. Miklosich Rom. Elemente, f. 16 e merr për vetëm si një deformim të kúmptẹr. Shramm., Anfänge des albanischen Christentums. f. 135 thotë se *compare* paska hyrë në shqipen qëmoti nga lat. *cómpatre* dhe *cómmātre*. Kjo e dyta e padëshmuar në shqipen sepse për këtë në shqip është fjala *ndrikull*, sado që shumë rrallë mund të dëgjohet edhe *kumareshë*. Vetëm si mundësi hipotetike që kjo fjalë të jetë përdorur këtu në njërin nga kuptime të saj, përkatësisht në kuptimin e ndihmësit, khs. Neues italienisch-deutsches und Deutsch- italienisches Wörterbuch I, Milano 1896, f. 172 nga Giuseppe Rigutini dhe Oscar Bulle apo në kuptimin e *shok* 2. *bashkëshort*; *bashkëshorte* (khs. Henrik Lacaj & Filip Fishta, Fjalor latinisht-shqip, Tiranë, 1966, f. 86) përkatësisht "i afërm për nga gjaku; kushëri"

[101] Sipas M. Jović, Dubrovačka vlastela u Novom Brdu. .., f. 229-230.

hapësirës prej nga rridhnin borxhlinjtë e tregtarëve raguzas ashtu edhe të vetë qytetit të Novobërdës. Kjo sepse shqiptarët si qytetarë të Novobërdës dëshmohen edhe në regjistrimet osmane-turke të shek. 15, përkatësisht vetëm rreth dhjetë vite pas pushtimit turk në kohën kur kjo koloni raguzasish romanë të sllavizuar e sasësh gjermanë edhe ashtu kishte nisur të dobësohej.

Në dritën e përputhjeve të disa emrave të vëllazërive të shqiptarëve të cilët dëshmohen në *Testament* ose në *Libër* - qoftë si banorë vendës të Novobërdës, qoftë si minatorë të puseve të atjeshme të minierave - me emra të dëshmuar në këto dy dokumente (sh. më poshtë) mund të nxirret përfundimi se Novobërda në shek. 15 banohej kryesisht nga pararendës të banorëve të katundit të sotëm Marec, lagjeve të tij dhe banorëve të katundeve përreth, popullsi kjo e cila, pasi që raguzasit dhe sasët u tërhoqën nga qyteti, nuk shkoi me ta, porse mbeti ta vazhdonte jetën në katundet e saj të sotme.

4. MBI DISA EMRA TË DËSHMUAR TË SHQIPTARËVE NË TESTAMENT E NË LIBËR DHE PËRPUTHJEN E TYRE ME EMRA TË SOTËM TË VENDEVE E TË VËLLAZËRIVE KOSOVARE

Përveç antroponimeve dhe patronimeve shqipe që i mbanin disa borxhlinj e dorëzanë të tyre (sh. më lart), në *Testament* e në *Libër* ka edhe disa emra personalë e mbiemra familjarë për të cilët nuk del e qartë as nëse bartësit e tyre ishin të përkatësisë etnike shqiptare e as nga cilat vendbanime ishin ata. Materiali onomastik që vetë e kam mbledhur në terren na e bën porse të mundshme të konstatojmë se ka jo pak përputhje midis emrave të dëshmuar në këto burime dhe emrave të sotëm të vendeve e të vëllazërive të katundeve përreth qytetit të Novobërdës e më larg tij, përkatësisht bëhet i mundshëm identifikimi në terren i emrave mesjetarë.

Kështu p.sh. antroponimi *Bib*, përkatësisht varianti i shënuar në Libër *Bibal* (khs. Bogouaz *Bibal*, f. 82.) do të jetë i së njëjtës prejardhje dhe i identifikueshëm me emrin e një të veje të quajtur *Bibala* në lagjen Pop Filipi të qytetit të Novobërdës dhe me emrin *Bibalo* të një bashtine në katundin Arbanash që do të ketë qenë lagje e katundit të sotëm Zebincë të komunës së Novobërdës.[102] Këto dy dëshmi antroponimike të fundshekullit 15 tregojnë se antroponimi *Bib*- ishte pjesë e uzusit antroponimik të popullatës vendëse. Kjo vërtetohet edhe në dritën e ruajtjes edhe deri në

[102] I. Rexha, Regjistrimi..., f. 71, 108.

ditë tonat të antroponimit *Bib* në funksion të emrit të vëllazërisë. I këtillë është rasti me emrin *Bibaj* të vëllazërisë në katundin që në *Libër* dëshmohet në trajtën *Nichoeuzi* (lexo Nikojevci, sot Nishec afër Orllanit), nga i cili kishte njerëz që ishin në kontakt, përkatësisht ishin borxhlinj të tregtarit raguzas Michael de Luchari. Se këtu kemi të bëjmë`me një antroponim, të cilin e mbanin shqiptarë të kësaj krahine, e tregon fakti që përbrenda vëllazërisë së sotme *Bibaj* të katundit Nishec ka disa familje, të cilat e kanë mbiemrin (lokal, jo administrativ) *Bib-* dhe ky antroponim vazhdo të ruhet brez pas brezi në mikrotoponimet e tipit antroponimik në katundin Prapashticë - jo larg nga Nisheci - si p.sh. *Roga e Bibit*, *Ara e Bibit* dhe *Livadhi i Ali Bibit*, që dëgjohet edhe si *Livadhi i Ali Bibës*. Emri *Bib-* dëshmohet dendur në mikrotoponiminë e shumë vendbanimeve gjithandej nëpër Kosovë.*

Njëri ndër banorë të lagjes Podgradie të Novobërdës quhej *Buiach* (khs. *Buiach Longo foxer de Podgradie* (f. 37). Në rrafshin rrëzë kalasë, përkatësisht krejt afër rrënojave të njërës nga dy kishat e qytetit të Novobërdës jeton sot vëllazëria e *Bujak*ëve. Një kësi përputhje emërore-territoriale nuk mund të jetë krejt e rastit, porse është një dëshmi bindëse se jo vetëm kjo e sotmja, porse që edhe pararendësit e kësaj vëllazërie ishin, madje shumë kohë para lindjes së këtij dokumenti, banorë të kësaj lagjeje të qytetit të Novobërdës. Në të mirë të korrektësisë së identifikimit të mbiemrit *Buiach* me vëllazërinë e sotme të *Bujak*ëve të Novobërdës shkon mbase edhe rrethana që një vendbanim më vete me 43 kryefamiljarë i quajtur *Bujakofqa* (mbase pikërisht vëllazëria-lagja e sotme e Bujakëve) dëshmohet edhe në defterin e kazasë së Novobërdës në fund të shek. XV, përkatësisht në vitet 1498/99.[103]

Në krahinën e Gallapit është ruajtur, vetëm ndër emra vëllazërish e nëpër mikrotoponime, deri sot edhe antroponimi *Bushat* (në Libër *Buxat-*), i cili në *Libër* është shënuar në funksion të patronimit (khs. *Lex Buxatouich* e të tjerë, f. 51). Këtë emër e mban edhe sot një pjesë, bark (*:Bushatët*) e vëllazërisë më të madhe *Robellët* të lagjes Laçiq të katundit Desivojcë (në

* Territorialisht larg nga këto dy katunde të krahinës së Gallapit, përkatësisht në katundin Jezerc të Ferizajt, i kam shënuar këto mikrotoponime: *Livadhi i Bibit, Kroni i Bibit, Mrizi i Bibit* të cilat janë të lidhura me vëllazërinë Bibaj të Jezercit, e shpërngulur në periferi të Ferizajt ku e ka themeluar edhe vendbanimin e ri të quajtur Bibaj. Ky antroponim ruhet edhe në mikrotoponimet *Kroni Bibës* në katundin Petrovë të Ferizajt, *Krojet e Bibës* në katundin Joviq të Rahovecit etj.

[103] Iljaz Rexha, Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës sipas defterit të fundshekullit XV, në Vjetar XXVII-XXVIII i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë 2002, f. 125.

Libër: *Desiuoieuzi*), edhe nga i cili kishte borxhlinj të tregtarit Michael de Luchari.

Një përputhje tjetër emërore-territoriale e kemi edhe tek emri i vëllazërisë *Gagica*, gjithashtu në katundin Desivojcë, emër që mbase është i së njëjtës prejardhje si edhe mbiemri familjar i shënuar në *Libër* si *Gogizi* (khs. *Mioman de Gogizi* f.76). Mbiemri familiar *Dodishiq* (khs. *Nichola Dodixich*, f. 39) i një banori të katundit *Heinouzi* (sot Hajnoc, serb. Ajnevce në komunën e Kamenicës) është padyshim i së njëjtës prejardhje si edhe emri i sotëm *Dodaj* i vëllazërisë në katundin Sfircë (në Libër: *Suirzi* /*Suirze Cholo*), ku gjithashtu kishte shqiptarë, përkatësisht borxhlinj të Michael de Luchari-t - siç e tregojnë mbiemrat familjarë me prejardhje shqipe si *Maluxat, Vochxa* dhe *Zoto* të banorëve të këtij katundi* të dëshmuar në Librin e M. Lucari-t.

Nga emrat e sotëm të vëllazërive të hapësirës etnolinguistike shqiptare nga e cila vinin shumica e njerëzve të përmendur në *Testament* e në *Libër* hetohet se popullata shqiptare e kësaj zone e kishte në përdorim edhe antroponimin, përkatësisht patronimin *Gan* (khs. *Andria. .. Gurag Gan in Podgradie*), por që - si edhe në disa raste të tjera - nuk mund të dihet prej nga ishin. Mirëpo këtë të panjohur duket se mund ta zgjidh emri *Ganec*-ët i një vëllazërie në katundin Brainë afër Orllanit. Në të mirë të prejardhjes së personave *Andria* e *Gurag* nga katundi i sotëm Brainë flet edhe vetë parafjala *in* "në" e shënuar pas emrave të tyre, gjë që tregon se ata ishin të vendosur në lagjen Podgradie, jo porse se ishin vendës të asaj lagjeje. Ky njoftim i tërthortë e lejon paravendimin se këtu kemi të bëjmë me punëtorë të ardhur në Novobërdë nga katundi i sotëm Brainë, përkatësisht nga hapësira e vëllazërisë së **Ganëve, Ganecëve* të sotëm. Ky paravendim gjen mbështetje tek rrethana që në asnjërin nga më shumë se 70 katundeve të krahinës së Gallapit, me përjashtim pra të Brainës, nuk ka sot emër vëllazërie që e ka për bazë antroponimin *Gan*-.

Në Libër dëshmohet edhe një person i quajtur *Gec* (khs. *Gez Buxatouich*, f. 38), për të cilin nga *Libri* nuk mund të merret vesh se prej nga ishte. Po u përpoqëm ta gjejmë se nga cili katund ishte personi Gec Bushatoviq-i, atëherë konstatohet se emrin Bushat e gjejmë sot në dy katunde jo larg nga Novobërda: në Rogoçicë të Kamenicës dhe në Keqekollë të Prishtinës. Në të dyja këto katunde ka nga një vëllazëri të quajtur *Geci*, ndërsa në Keqekollë, përveç vëllazërisë së Gecëve ekziston

* Vetë Dodajt dhe vëllazëritë e tjera të Sfircës besojnë se vëllazëria e D. qenka islamizuar e fundmja në katund. Në këtë katund jeton edhe vëllazëria e Klaiqëve, emri i së cilës më duket të jetë me prejardhje kroate. Nuk dihet nëse Dodajt e Klaiqët janë në lidhje farefisërie.

edhe mikrotoponimi *Livadhi i Gecit* që tregon qartazi se jo vetëm që personi *Gez* i *Librit* mund të ishte nga njëri prej këtyre dy katundeve porse edhe që - e kjo është më e rëndësishmja në këtë mes - edhe këtu kemi të bëjmë me një vazhdimësi të këtij antroponimi pikërisht në ato vendbanime nga të cilat mund të ketë qenë personi *Gez* i dëshmuar në gjysmën e parë të shek. 15.

Është fakt që dihet se pjesa më e madhe e priftërinjve katolikë në kolonitë raguzase-sase të Kosovës mesjetare (sikundër ishte edhe vetë Novobërda) ishin shqiptarë të ardhur në këto koloni nga Ragusa, Kotori, Tivari, Ulqini e pas gjithë gjasësh edhe nga Shqipëria e Veriut katolik. Së këndejmi mund të konsiderohet se edhe *Dom Georgius Gega*, i cili përmendet më 1382, ishte njëri ndër ardhacakët shqiptarë. Mirëpo sa kohë që dëshmohet, nga ana tjetër, se p.sh. në katundin Prapashticë (jo larg nga Prishtina) ekziston mikrotoponimi *Livadhi i Gegës*; në katundin Koliq (gjithashtu në komunën e Prishtinës) mikrotoponimi *Shpati i Gegës*; në katundin Desivojcë (të Kamenicës) *Brija Gegës* e të tjerë emra vendesh, lejohet të nxirret përfundimi se antroponimin *Gega* e mbante edhe popullata vendëse shqiptare e kësaj hapësire.

Ka ende shembuj të kësaj natyre. I këtillë është rasti me antroponimin sas, përkatësisht gjerman *Gerhard* në trajtën e tij përkëdhelëse *Gerd-* përkatësisht *Gerdat-* (khs. *Gon Gerdatich*, f. 68), i cili në këtë burim dëshmohet edhe në trajtën *Gerdal*. Nuk kemi asnjë dëshmi nga terreni për vazhdimësinë e këtij antroponimi nga popullata shqiptare e kësaj pjese të hapësirës së saj ertnolinguistike. Mirëpo ka një dëshmi shkrimore të vitit 1455 që tregon se edhe ndonjë shqiptar, apo pikërisht vetëm shqiptarët, e mbanin antroponimin Gerd-. Dëshmia e vitit 1455 rrjedh nga një vendbanim bukur larg nga hapësira që e mbulon Libri i tregtarit raguzas. Në atë burim të vitit 1455 dëshmohet se antroponimin Gerd- e mbante banori *Gerdaš, Arbanas* i cili jetonte në tregun, vendbanimin e zhdukur Obica[104] të rrethinës së Ferizajt. Paravendimi se shqiptarët e

[104] Khs. Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455. godine, Sarajevo 1972, f.. 32. Në dritën e mikrotoponimit *Lugu i Obicës* në katundin Manastirc i cili (lug) është edhe në katundet Neredime e Epërme dhe Pleshinë të komunës së Ferizajt si edhe të mikrotoponimeve *Gradishi, Zabelet e Varoshit* dhe *Livadhi i Kishës* në katundin Manastirc, të shënuara nga J. Osmani, sh. Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpca, Prishtinë 2004, f. 96, 98, 108, 118, ka shumë arsye të besohet se vendbanimi, përkatësisht tregu i quajtur *Obica* do të ketë qenë në territor të katundit të sotëm Manastirc. Tregu *Obica* është dëshmia më e mirë e rrethanës së konstatuar qëmoti se në mesjetën e vonë kishte në Kosovën e sotme vendbanime të fortifikuara, ndërsa jashtë mureve të tyre paralagje, përkatësisht tregje. Në këtë rast Obica do të ishte treg nën vendbanimin e fortifikuar, kujtimi për të cilin do të jetë ruajtur tek

kësaj ane e mbanin edhe në shek. 15 edhe antroponimin *Gerd-*, mund të jetë i pranueshëm nëse trajtat e dëshmuara në *Libër Gerdat* e *Gerdal* s'janë tjetër veçse trajta deminutive të temës emërore *Gerd-* të zgjeruara me prapashtesa të tjera në krahasim me trajtën *Gerdaš* të dëshmuar më 1455.

Banori *Vlashin* i katundit të sotëm serb Jasenovik afër Novobërdës e mbante patronimin *Govorkoviq* (khs. *Vlaxin Gouorchouich de Jasenouich*, f. 42). Sot nuk ka më në këtë katund ndonjë mbiemër të këtillë familjar. Emri *Govor-*, porse, është ruajtur nga popullata shqiptare e krahinës së Gallapit. Këtë e tregon qartazi emri i vëllazërisë *Govorët* në katundin Prapashticë, jo larg nga Novobërda, ku kujtesa kolektive di të kallxojë se kjo vëllazëri na qenka më e vjetra e katundit. Përveç vëllazërisë së quajtur kështu, në territor të këtij katundi ekziston edhe mikrotoponimi *Ara e Govorit* një dëshmi kjo që tregon se në këtë katund ka qenë në përdorim antroponimi *Govor*, i cili në funksion patronimi apo emri të vëllazërisë dëshmohet në mbiemrin *Gouorchouich* të dëshmuar në Libër. Antroponimi *Govor* nuk ka gjë të përbashkët as me fjalën serbe *govor* "të folurit" e as me foljen *govoriti* "flas" (më shumë për prejardhjen e emrit sh. kapitullin 7 të këtij punimi). Pandehjen se mbiemri i dëshmuar *Gouorchouich* ishte njëri nga antroponime të shqiptarëve do ta mbështeste rrethana se personi që e mbante këtë mbiemër quhej *Vlash*, përkatësisht mbante një antroponim të gjithkrishterë në trajtën shqipe të tij. Kemi të bëjmë me trajtën "lindore" *Vlasius* shq. *Vlash* të antroponimit që në sferën Perëndimore të kirishterimit del në trajtën *Blasius*, shq. *Blaç*.

Me një rast të vazhdimësisë emërore-territoriale kemi të bëjmë edhe tek mbiemri *Gjuko* (khs. *Pircho e Giucho de Nixa*. .., f. 68). Banori Gjuko ishte, sikundër shihet nga shënimi, nga vendi *Niksha*, përkatësisht nga *Nixino cholo* = lagjja e sotme Nizhnakollë e Marecit. Se edhe këtu kemi të bëjmë me një person të përkatësisë etnike shqiptare, i cili në krye të herës do të ketë jetuar në qytetin e Novobërdës e më vonë do të jetë

topogërmadha *Gradishi* në katundin Manastirc. Përveç kësaj edhe vetë fakti që një treg ndodhet në një vendbanim Manastirc, emri i të cilit nuk mund të ndahet nga fjala dhe objekti manastir, flet për një të kaluar me funksion të rëndësishëm prej qyteti përkatësisht qendre famullitare që do ta ketë pasur katundi i sotëm Manastirc. Emri Obica i tregut rrjedh nga emri i përrockës *Obica*. Ka mundësi që emri Obica i rrjedhës së ujit të jetë në lidhje farefisërie me emrin *Obnica* të njërës ndër degë kryesore nga të cilat formohet lumi Kollubara i Serbisë. Emri i këtij lumi është, sipas Ivan Duridanov, [Illyrische Flussnamen in Serbien, Linguistique Balkanique IV, Sofia 1963, f. 104] me origjinë ilire. Sipas këtij, nga një rrënjë e zgjeruar ilire *Ab-in* ose *Ab-on* "më vonë do të mund të krijohej në sllavishten (serbishten) një **Obьnъ* përkatësisht një **Obъnъ* më vonë *Ob(a)n*, gjinore *Obna*". Një toponim *Obna* po u përmendka për në rrjedhën e poshtme të lumit Sava në vitin 1545.

zhdjergur në lagjen e sotme Nizhnakollë, e tregon krejt rastësisht testamenti i shkruar më 3. 11. 1403 i kryepriftit raguzas me prejardhje shqiptare (?) *presbyter Georgius Fissi*, i cili lë të merret vesh se *Ancora ogio in caxa de Giucho mio neput* "Edhe sot në shtëpinë e Gjukës, nipit tim" nga Novobërda i ka disa rraqe dhe se kyfarë *Giucho* do të jetë "epitrop*imi".[105] Mendimi im i mësipërm mund të jetë i pranueshëm nëse shtëpia e priftit ishte në Novobërdë, ku edhe kishte shërbyer kryeprifti *Fissi*. Përkatësia e mundshme etnike shqiptare e kryepriftit Fissi do të dëshmohej tërthorazi në dritën e emrit shqip Gjuka që e mbante nipi i tij si edhe në dritën e vazhdimësisë së këtij emri nga vëllazëria e sotme *Mgjukalitë* që jeton po në Nizhnakollë. Mungesën e të dhënave se prej nga ishte presbyteri Fissi, sikur e plotëson dëshmimi i këtij mbiemri në vitin 1670 kur midis nxënësish të shkollës së Janjevës dëshmohet edhe një *Natale Fischouich.** Nëse *Fissi* e *Fishoviq*/*Fiskoviq* janë trajta të një të vetmit mbiemër, atëherë do të lejohej mundësia të kemi të bëjmë me një farefis pjesëtarë të të cilit jetonin në Novobërdë e në Janjevë.

Në dritën e rrethanës se pikërisht në lagjen Nizhnakollë (rrënzë malit në majë të të cilit është qyteti i Novobërdës) jeton vëllazëria *Gjukalitë* (ky emër dëgjohet shpesh edhe në trajtën *Mgjukalitë*), nuk është aspak hipotetike të besohet se personi i dëshmuar *Giucho* i *Librit* të Michael de Luchari-t ishte pjesëtar i një vëllazërie që për pararendës e kishte një individ të quajtur *Giucha*, vëllazëri që do të ketë ekzistuar edhe në kohën e hartimit të *Librit*, apo që kyfarë *Gjuka* mund të jetë pararendës i vëllazërisë së sotme. Këtë e përforcon edhe dëshmimi i të nipit Gjuka në testamentin e mësipërm të priftit shqiptar Georgius (Gjergj) Fissi. Sido që të jetë, përputhja territoriale-emërore midis antroponimit të dëshmuar *Giucho* dhe emrit të vëllazërisë së sotme *Gjukalitë* (kjo trajtë e mbiemrit do të ketë dalë më vonë, nën ndikimin e formantit turk të formimit të emrave të vëllazërive me prapashtesën *-li* dhe formantit shqip të shumësit *-të*) nuk mund të jetë e rastit, porse edhe një dëshmi në të mirë të qenies së pararendësve të kësaj vëllazërie banorë të qytetit mesjetar të Novobërdës, përkatësisht të njërës nga lagjet e tij.

Në *Libër* përmendet edhe një banor i quajtur *Hanzo* (lexo Hanco) që ishte i vëlla i Martinit (khs. *Martin frar de Hanzo* f. 39), për të cilin nga

* = testamentar; personi që shkruesi i testamentit e autorizon që ai (testamenti) të përmbushet ashtu siç e ka shkruar ai vetë.

[105] Khs. I. Zamputi-L. Malltezi, Dokumente. .., Dok. nr. 390.

* Autorët Nikola Čolak-Ive Mažuran: Janjevo, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 60. e kanë transliteruar këtë emër si Božidar *Fišović*. Unë mendoj se ky emër mund të lexohet edhe si *Fiskoviq*.

Libri nuk mund të merret vesh se prej nga ishte. Disa mikrotoponime të tipit antroponimik në vendbanime jo larg Novobërdës lënë të kuptohet se ndonjëri apo shumë nga emrat e dëshmuar në Libër e në burime të tjera me prejardhje raguzase janë ruajtur deri në ditë tonat pikërisht nga shqiptarët, një pjesë e vendbanimeve të tyre të sotme të të cilëve gjenden rrënzë rrënojave të kështjellave mesjetare apo edhe syresh më të lashta. Kështu do të ketë ndodhur mbase edhe me antroponimin Han-. Këtë emër e ndeshim sot p.sh. në lagjen *Osiq*(ët) jo larg nga vendi Çuka e Drashnjës, në të cilin një sipërfaqe me diametër prej përafërsisht 2 hektarësh pëmban gjurmë të një vendbanimi të fortifikuar. Këtu janë edhe mikrotoponimet: *Bregu i Hanollit* dhe *Udha e Bregut t'Hanollit* (Emri *Hanoll* është më parë zgjerim me prapashtesën romane *-ol* se sa me atë turke *-ol* nga *-oglu* "i bir i" i temës emërore *Han-*). Edhe në lagjen Haxhovit të Marecit, që praktikisht është pjesë e Novobërdës, ku gjithashtu është topogërmadha *Gradishta*, e gjemë këtë antroponim të përmbajtur tek hidronimi *Kroni i Han Musës.* Antroponimi *Han* përmbahet pas gjithë gjasësh edhe tek emri i lëndinës *Fusha e Han Lacit* në katundin Mramuer të Prishtinës.

Nga *Libri* nuk mund të mësohet se prej nga ishte personi *Marko* që e mbante mbiemrin *Malushat* (khs. *Marcho Maluxat* f. 69). Duke qenë se në katundin Sfircë, prej nga kishte borxhlinj të tregtarit raguzas dhe dorëzanë të atyre huamarrësve është vëllazëria *Malushanët*, ka shumë mundësi që personi Marko i dëshmuar në Libër të ketë qenë nga ky katund, përkatësisht se edhe këtu kemi të bëjmë me një ruajtje brez pas brezi të një antroponimi dhe me një përputhje emërore-territoriale në relacionin shek. 15 - ditët tona. Ky paravendim bëhet më i besueshëm mbi bazën e faktit se Marko *Maluxat*-i nuk ishte i vetmi person nga ky katund e nga ky regjion që punonte në Novobërd dhe që i kishte ardhur puna të merrte hua tek tregtari raguzas. Për një tjetër *Malushat* tregohet se ishte nga katundi Rakitë i GolIakut = lagjja Rakita e katundit të sotëm Rakinicë të Orllanit (khs. *Thohol e Maluxat de Rachita in Golach*, f. 75). Nga Libri nuk mund të mësohet as për prejardhjen e banorit të quajtur *Matko* që për dhëndërr e kishte njëfarë Rastin-in (khs.; *Rastin foxer genero de Matcho*, f. 44). Mirëpo prania e një emri *Matcho* (që është në të vërtetë antroponimi Mat-i [khs. greq. Ματθαϊος, lat. *Matthaeus*, nga hebr. *Matithyâh*] i zgjeruar me prapashtesën *-ko*) tek shqiptarët e krahinës së Gallapit dëshmohet dendur përmes një morie prej mikrotoponimesh të tipit antroponimik si p.sh. *Lugu i Mat`s* dhe *Prroni i Mat`s* në lagjen Rusinovc të katundit Nishec (në Libër *Nichoieuzi*) të Orllanit, ndërsa në lagjen dhe vëllazërinë Bibaj të po këtij katundi ekziston edhe mikrotopo-

nimi *Vorri i Mat`s*; në katundin Gmicë (në Libër: *Dminzi*) ekziston vëllazëria e *Matosh*ëve etj. Fakti që antroponimi *Mat*- dëshmohet sot pikërisht në ato vendbanime për në të cilat në Libër dëshmohet se kishte persona që i kishin borxh tregtarit raguzas Michael de Luchari, i lë vend mundësisë që banori *Matcho* i gjysmës së parë të shek. 15 të ishte nga njëri prej këtyre katundeve në të cilat edhe sot gjenden gjurmë të qenies në përdorim të antroponimit *Mat*-. Në të mirë të kësaj mundësie do të shkonte edhe rrethana që antroponimi *Mat* është ndër emra të përdorur fort dendur nga shqiptarët, gjë që e tregojnë edhe disa dëshmi të shek. 16 kur përmenden p.sh. edhe banorët *Mat*-i *Tanush*-i, Pavl *Mat*-i (banorë të lagjes Pop Simon të Novobërdës (= lagjja e sotme Simòjt e katundit Marec[*]), Nikolla *Mat*-i (banor i lagjes Sveti Nika të Novobërdës), Dimja *Mat*-i e Pavl *Mat*-i (banorë të lagjes Marko Krsti të Novobërdës) dhe Marko *Mat*-i (banor i lagjes Kuriçka të Novobërdës) e të tjerë të dëshmuar në vitet 1566-1574.[106] Se emri *Matcho* ishte një antroponim (edhe) i shqiptarëve e tregon edhe shënimi i hartuar më 16. 3. 1404, në të cilin përmendet njëfarë *Matko Tani* nga Ulqini, (përkatësisht "Item Matcho de thanj de dulcigno)"[107] që ishte banor i qytetit të Novobërdës.

Njëri ndër borxhlinj, emri i të cilit është shënuar në Testament, quhej Milko (khs. *Milcho fiastro de Vigan*, f. 29). Për vendin prej nga do të vinte *Milko*, në Testament nuk ka ndonjë shënim. Mirëpo duke qenë se në lagjen Nizhnakollë (në Libër: *Nichxino Cholo*) në territor të katundit Marec është mikrotoponimi *Prroni i Millakut*, nuk është mbase fort e guximshme të thuhet se pikërisht ky mikrotoponim e tregon si prejardhjen e borxhliut të vitit 1411 nga lagjja *Nichxino Cholo* ashtu edhe kontinuitetin emëror-territorial si rezultat i banimit pandërprerje të këtij vendbanimi nga shqiptarët deri edhe në ditë tonat.

Ndër trajta antroponimesh të gjithkrishtera që nuk kanë prejardhje shqipe e që janë shënuar në Libër, por që përsëri i gjejmë të dëshmuar në ambiente shqiptare do të jetë edhe antroponimi *Shin*. Duket se po ky emër është shënuar në Librin e tregtarit raguzas si patronim *Simigouich* (lexo: Shimigoviq) i banorit *Nixa*,[108] pa përcaktimin e vendbanimit se prej kah vinte. Po ky emër përmbahet mbase në emrin *Shimçiq* të një mahalle të katundit Marec. Duket që ky emër mund të jetë një trajtë e

* Lokalizim i imi.

[106] Khs. Selami Pulaha, Qytetet e Rrafshit të Dukagjniit dhe të Kosovës gjatë gjysmës së dytë të shek. XVI në dritën e të dhënave të reja të regjistrimeve kadastrale osmane, "Studime historike" (Tiranë) 4/1980, f. 200, referenca 33.

[107] Sipas. I. Zamputi-L. Malltezi, Dokumente..., Dok. nr. 420.

[108] Khs. M. Dinić, Iz dubrovačkog arhiva I., f. 29.

shkruar gabimisht në vend të **Shinçiq*. Si i këtillë ky emër mund të ketë të bëjë me vëllazërinë e sotme *Shinovit* të lagjes Vakovc të Marecit. Në këtë lagje është edhe emri i malit *Zabeli i Shinit*.[109] Antroponimi *Shin*, në funksion të emrit personal të banorëve të hapësirës etnolinguistike të shqiptarëve dshmohet që më 1330 kur mësohet se gjyshi i banorit të quajtur Ranko i katundit Babe (Babaj - Gjakovë) quhej *Shin*,[110] ndërsa një banor i mëhallës Cvetko Samarxhi i qytetit të Shkupit quhej Odor, sin na *Šine*, përkatësisht Odor-i, i bir i Shin -it.[111]

E ruajtur edhe në mikrotoponime të tipit antroponimik është edhe trajta *Pavao* (khs. *Pauao Mlicha, foxer de Podgradie*, f. 51) dhe Pava, i bir i Andreja-s, banor i katundit të paidentifikuar *Litovc Kulla* të kazasë së Novobërdës të dëshmuar në fundshekullin 15[112] e antroponimit të gjithkrishter *Paulus*, shq. *Pal*. Në dritën e mikrotoponimit *Konaku i Pav's* në të cilin fjala *konak* e ka kuptimin "tban, kasolle bariu" në katundin Busi të Prishtinës mund të konsiderohet se edhe ky antroponim u ruajt e u vazhdua nga shqiptarët e kësaj hapësire. Duke qenë se antroponimin në trajtën *Pavao*, të cilin e gjejmë në kontekstin e ekonomisë së blegtorisë, por që në atë kohë do ta kenë bartur në rend të parë ardhësit raguzas e kroatë të tjerë, shtrohet pyetja nëse raguzas paska pasur edhe përjashta vendbanimeve - miniera, përkatësisht jashtë kolonive xehetare-tregtare të Kosovës së shek. 14-15? Mbi bazën e sqarimit etimologjik të mikrotoponimeve të këtij tipi, përkatësisht të trajtës *Pavao* të antroponimit, kësaj pyetjeje mund t'i jepet përgjegje pozitive. (më shumë për këtë sh. *Venerime 2* të kësaj trajtese).

Një banor tjetër për prejardhjen e të cilit nuk mund të mësojmë gjë nga Libri, e mbante mbiemrin Rukiq (khs. *Radochna Ruchich*, f. 45.). Përveç këtij, për të cilin me shumë gjasë mund të thuhet se ishte nga ndonjë katund i rrethinave të Novobërdës, në një dokument raguzas të shek. 14, përkatësisht të dt. 15. 02. 1363 përmendet edhe njëfarë *A. Pasche frar die don Rucha che fo moridato in Nouaberda*[113], përkatësisht "A. Paske, i vëlla i don Ruk-ut që ka vdekur në Novobërdë", gjë që tregon se përmendja e këtij emri në Libër as nuk është dëshmia më e vjetër e as e vetmja e këtij antroponimi. Edhe antroponimi *Ruch*, përkatësisht *Ruk*, pa e marrë parasysh prejardhjen e

[109] Këtë emër e ka shënuar në terren Ali Berisha, Gallapi i Prishtinës, Prishtinë, dorëshkrim
[110] Khs. Dečanska hrisovulja..., f. 13.
[111] Khs. Turski Dokumenti za istorijata na makedonski narod, Opširen popisen Defter nr. 4 (1467-1468), red. nga M. Sokoloski e Dr. A. Stojanovski), Shkup, 1971, f.422.
[112] Sh. I. Rexha, Regjistrimi..., f. 65, 159.
[113] Khs. M. Dinić, Za istoriju rudarstva..., II., f. 39, referenca 17.

tij në rrafshin gjuhësor, është ruajtur tek shqiptarët e këtij regjioni. Këtë e tregon sheshazi emri *Rukovcët*, përkatësisht *Rukovci* i vëllazërisë të cilin e mbajnë dy vëllazëri: njëra në katundin Lisockë të Kamenicës dhe tjetra në katundin Koliq të Prishtinës. Antroponimi *Ruk* dëshmohet ndër shqiptarë në vitin 1485 në trajtat *Ruk* e *Ruç*[114] dhe gjendet i ruajtur e i vazhduar edhe ndër mikrotoponime aktuale të Kosovës. Këtë e tregon p.sh. mikrotoponimi *Ara e Ruçinës* në Katundin Zajçec, që ndodhet në kufi me minierën e magnezitit në katundin Strezovc të Kamenicës, jo fort larg nga Novobërda. Mbi bazën e shembujve të sjellëmë lart mund të paravendohet se edhe personi *Radochna Ruchich* ishte nga një vendbanim i rrethinave të Novobërdës.

Në Libër përmbahet edhe shënimi *Milun fauro e Ruscho suo fiol de Drasne* (f. 80), përkatësisht "Milun-i minator dhe Rusko i biri nga Drashnja". Për personin Rusko nga vetë shënimi mësohet se ishte nga vendi Drasne. Në shpatije të vendit të pabanuar Drashnja përkatësisht në territor të katundit Orllan të Prishtinës ekzistojnë edhe sot mikrotoponimet *Roga e Rushit* dhe *Ara e Rushit.* Duke qenë se në këtë rast kemi të bëjmë me një përputhje të plotë emërore e territoriale si të vendit Drasne të mesjetës dhe Drashnje të ditëve tona, ashtu edhe të antroponimit Rushko me Rush që përmbahet në emrin e rogës e të arës, do të mund të konstatohej se edhe kalimi i rëndomtë i *s* intervokalike në *sh* tek antroponimi Rus(cho) në Rush është kryer në vend, nga popullata shqipfolëse e këtij vendbanimi. Duke qenë se jo larg nga Drashnja është lagjja, përkatësisht vendi, Rusinovc përkatësisht *Çuka e Rusinovcit*, emër ky tek i cili nuk e kemi kalimin s $\rightarrow$ *sh*, gjurmimi më tej i këtij fenomeni në këtë të folme bëhet i domosdoshëm. Nga materiali antroponimik, që përmbahet në dy regjistrimet osmane-turke të viteve 1455 e 1485 dhe nga disa dokumente kishtare serbe të po këtij shekulli shihet se antroponimi në trajtën shqipe Rush është dëshmuar në shek. 15 në atë pjesë të Kosovës së sotme, e cila binte nën juridiksionin e sanxhakut të Dukagjinit (khs. psh. dëshminë: e veja e *Rush*-it në katundin Istrahaliq në Mal të Zi[115] dhe dëshminë në një dokument serb të vitit 1454, në të cilin midis pleqnarëve të rrethinës së Suharekës ishte edhe një person i

[114] Khs. psh. Radoslav-i, i bir i Ruç -it; Pepa, i bir i Ruç-it -banorë të katundit Medon në Mal të Zi khs. Selami Pulaha, Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, Tiranë,1974, f. 198, 155.

[115] S. Pulaha, Defteri …, f. 427.

quajtur *Rush Ginoviq* nga katundi Studençan.[116] Këtu bie porse edhe dëshmia Pava, i vëlla i *Rusha*-s banor i katundit të paidefitikuar *Zhipa*, që në fundshekullin 15 përmendet për vendbanim i kazasë* së Novobërdës.[117]

Testamenti dhe *Libri* përmbajnë edhe trajta antroponimesh shqipe të dala nga mbiemri shqip (i) *vogël* (khs. *Vochxa e Prodan de Sirze Cholo*, f. 69 dhe *Gon Vogoli...*, f. 52, 76). Tregtari nuk ka shënuar se prej nga vinte borxhliu i tij *Gon Vogoli*. Në mbështetje të rrethanës se në lagjen Petrolija të Novobërdës (banorët e së cilës mbanin pothuaj të gjithë antroponime e patronmime shqipe) jetonte në fundshekullin 15 banori Jovan-i, i bir i *Voglin*-it[118] e në lagjen Protopop të këtij qyteti dëshmohet në shek. 16 edhe një banor tjetër shqiptar i quajtur Luka *Vogli* (emri mund të lexohet edhe si *Voglo*),[119] ka vend të besohet se edhe banori *Gjon Vogli* që dëshmohet gati një shekull para Luka *Vogli*-t do të ketë qenë banor vendës i qytetit të Novobërdës dhe se këtu kemi të bëjmë jo me dy, porse me një familje Vogli e cila në Novobërdë kishte jetuar së pakut më shumë se një shekull pandërprerje. Për borxhliun *Voksha* tregtari e ka dhënë vendbanimin e tij: *Sirze Cholo*, përkatësisht katundi i sotëm Sfircë. Në këtë katund ka edhe sot një lagje -vëllazëri e cila quhet *Voc*, përkatësisht *Vocët*. Ky emër është variant semantik i emrit *Voksh*. Të dyt rrjedhin nga mbiemri shqip i, e *vogël*.

Një borxhli i Michael de Luchari -t quhej *Gon Vranaj* (khs. *Gon Mali e Peia fiol de Miralia piegi e Gon Vranaj* [...] *per Gon Belaz foxer* [...]. *Proualia*, f. 50). Sado që nuk dihet se ku ishte lagjja e quajtur Provalia e Novobërdës, një gjë është e qartë se mbiemri Vranaj i borxhliut *Gon* nuk ka gjë të përbashkët me emrin Vranje të qytetit në Serbi, (Ç'është e drejta Michael de Luchari e shkruan emrin e këtij qyteti si *Vragna*), porse ky mbiemër do të jetë në të vërtetë emër i ndonjë vendbanimi në afërsi të Novobërdës. Së këndejmi mund të paravendohet se mbiemri i dëshmuar në Libër në trajtën *Vranaj* ka të bëjë me lagjen, përkatësisht me vëllazërinë e sotme *Vrajollët*, që jeton rrëzë malit mbi të cilin është qyteti i Novobërdës. Në këtë mes ka vend të besohet se këtu kemi të bëjmë jo vetëm me një vazhdimësi të pakëputshme territoriale-emërore porse edhe me një çështje me rëndësi për morfologjinë historike të së folmes shqipe

[116] Khs. A. V. Solovjev, Odabrani spomenici srpskog prava, Beograd 1926, f. 216.

* Term administrativ turk me prejardhje arabe, në kuptimin *rreth*, territor nën administrimin e një kadiu.

[117] I. Rexha, Regjistrimi…, f. 157.

[118] I. Rexha, Regjistrimi…, f. 70.

[119] Sipas S. Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV- XVI (Studime dhe dokumente), Tiranë 1983, f. 544.

të krahinës së Gallapit, përkatësisht me dëshminë më të vjetër që e dimë deri tani të prapashtesës *-aj* në funksion të formimit të emrave të prejardhjes, të vëllazërive, e cila nuk gjallon më në këtë të folme. Vendin e kësaj prapashtese karakteristike shqipe e kanë zënë prapashtesat e huaja -iq, -oviq, -ovit dhe/ose *-oll* që jo domosdo duhet të jetë prapashtesë turke (siç e tregon trajta Vrajolli e mbiemrit që e mbajnë familje të veçanta të kësaj vëllazërie, trajta e shumësit për gjithë vëllazërinë *Vrajollët*) ose prapashtesa sllave *-ovit* që dëgjohet në variantin *Vrajevit* të emrit të po kësaj vëllazërie. Dëshmimi i prapashtesës *-aj* në emrin Vranaj të kësaj vëllazërie e tregon katërcipërisht përkatësinë etnike shqiptare të Vranajve marecas të shek. 15.

Në dritën e rrethanës së ditur se kishte lëvizje individësh minatorë e afaristësh që nga qyeti i Novobërdës shkonin në Janjevë, mund të paravendohet se një dëshmi të kontinuitetit shqiptar në të banuar në rrethina të qytetit të Novobërdës e kemi edhe tek banori i mahallës Arbanas të qytetit të Janjevës *Paca*, i bir i Gjovan -it[120] i cili mbase tok me bashkëqytetarin e tij Vuk Novabrda do të jetë shpërngulur nga Novobërda në Janjevë. Emri *Paca* i këtij banori ruhet sot e gjithë ditën tek emri *Pacollët* i njërës nga vëllazëritë e katundit Marec, rrënzë malit ku është kështjella e Novobërdës.

Në antroponiminë shqipe, përkatësisht të shqiptarëve, që tek shqiptarët vazhdo të bëjë jetë edhe sot e gjithë ditën, mund të inkuadrohet edhe antroponimi Balshë i cili në Libër dëshmohet në funksion patronimi në trajtën Baosh- përkatësisht Baoshiq (khs. *Sdrauaz Baoxich de Prupori*[*], f. 43, 74; *Nenada Baoxich de Hosruchouz,*[**] f. 75), pikërisht për shkak të arealit të gjerë emëror që e mbulon ky antroponim i lashtë shqiptar dhe për shkak të dendurisë së dëshmimit të tij në hapësirën etnolinguistike shqiptare. Në krahinën e Gallapit dhe në gjithë Kosovën e sotme ky antroponim ndeshet vetëm në trajtën *Bal,ë -a*. Nëse edhe emri *Basha* –p.sh. i një vëllazërie të katundit Koretin të Kamenicës e të tjerë duhet parë për si trajtë të emrit Balë, Balshë apo për variant të trajtës jo shqipe Baosh- është çështje që duhet parë. Antroponimi shqip Bal,ë -a është i së njëjtës prejardhje si edhe emri Balshaj serb. Balšići i derës feudale të Zetës. Megjithë mendimin e shfaqur se kjo familje sundmitarësh paska prejardhje normane,[121] nuk ka deri më sot asnjë

[120] Khs. I. Rexha, Regjistrimi..., f. 121.

* Katund i paidentifikuar. Sipas defterit të regjistrimit të vitit 1455 ky katund i përkiste nahijes së Llapit.

** Emër i panjohur sot i vendbanimit.

[121] Khs. p.sh. Petar Skok, Dolazak Slavena na Mediteran, Split, 1934, f. 89.

sqarim më të pranueshëm etimologjik të emrit Balsha se sa sqarimi i pranuar nga shumë filologë përmes mbiemrit shqip (i,e) *balë* "i, e bardhë" që është një sinonim i mbiemrit gjithshqiptar i, e *bardhë* dhe se trajta deminutive me *-sh* është po ashtu në harmoni me formimin e trajtave të përkëdhelisë së emrave në gjuhën shqipe: khs. për këtë emrat *Voksh* nga *vogëlsh*; *Niksh* trajtë deminutive tipike shqiptare e emrit Nikollë etj. Duke u nisur nga rrethana se në këtë krahinë nuk është dëshmuar ndonjë popullatë sllavofone që në serbishte do të jetë quajtur me atributin përbuzës *balije*, me prejardhje shqipe duhet të konsiderohet edhe mbiemri *Baliq* (khs. *Todora surela de Balich per lui Vlaia de Gon*, f. 80 "Todora e motra e Baliq -it për të Vllaja i Gjon-it"), i cili dëshmohet për mbiemër e emër vëllazërish shqiptare përkrah trajtës *Balaj*.

Se në shembujt e sjellë deri tani nuk kemi të bëjmë me dukuri të rastit apo me përputhje krejt të rastësishme e jashtë kontekstit historik të përkufizuar territorialisht të emrave personalë e të vëllazërive të dëshmuara në burimet që u përdorën në këtë punim me emra të sotëm vëllazërish e me mikrotoponime të tipit antroponimik, e dëshmon rrethana se këtu kemi edhe një kontinuitet shqiptar të emrave të zhdukur të vendbanimeve që ekzistonin në shek. 15 e që për si të tilla, përveç në *Testament* e në *Libër*, nuk përmenden më në asnjë burim të shkruar më vonë. Të këtilla janë vendbanimet e asokohshme *Brisouiza*/*Brixouiza* (khs. *Stoian Vuchaxinouich de Brisouiza*, f. 41).*; Fylip de Brixouiza*, f. 85); *Goginci* (khs. *Mioman de Goginzi*, f. 76); *Gorunzi* (khs. *Radisa Pribilouich de Gorunzi*, f. 53); *Groxeta* (khs. *Lex Buxatouich de Groxeta*, f. 51); *Gumnista* (khs. *Guriza Nizich de Gumnista*, f. 74); *Lixize* (khs. *Radossau Bugarin de Lixiza* f. 81); *Machrexa* (khs. *Jouan Lucharouich de Machrexa* f. 81); *Nichxino Cholo* (khs. *Nouach de Nichxino Cholo* f. 39), *Plauize* (khs. *Gergi Daizetich de Plauize*, f. 89); *Raichouo Cholo* (khs. *Gergas de Raichouo Cholo* f. 79); *Rachita* (khs. *Tochol de Rachita*, f. 76) e ndonjë tjetër.

Kështu p.sh. emri i vendbanimit të cilin tregtari raguzas e shkruante në dy trajta: *Brisouiza* e *Brixouiza* (lexo Brizovica e Brishovica) është ruajtur në emrin e malit *Brezovica* në Katundin Zajçec;[122] emri *Goginci*, është ruajtur në emrin e vëllazërisë *Gagica* të Desivojcës. Ka jo pak arsye të paravendohet mundësia që trajta *Gagica* është e re dhe se trajta e kryehershme e emrit të kësaj vëllazërie është pikërisht ajo: *Goginci* që edhe është shënuar në Librin e Michael de Luchari-t. Si e këtillë, kjo do ta kishte për rrënjë emrin shqip *gog*/*ë*,*-a* "rumun, vllah; murator" i

[122] Sqarim: Të gjitha identifikimet në terren të toponimeve që përmenden në këto burime i kam bërë vetë. Për ato që do të jenë identifikuar nga të tjerë, jepen referenca të veçanta.

zgjeruar me prapashtesën sllave *-inci*, si edhe emri i vendbanimit *Gorunzi*, që në terren e kam identifuar me emrin e malit *Goruni* në katundin Desivojcë të Kamenicës. Emri i këtij mali është pas gjithë gjasësh, sipas H. Barić, me prejardhje rumune (khs. rum. *gorún*, *gorón*, *gorín* gjerm. Wintereiche",[123] shqip *qarr*, *-i* bot. Quercus cerris "lloj dushku me lëkurë t'ashpër dhe me lende të mëdha"; lis"; emri i vendbanimit *Groxeta* është ruajtur në kompleksin me ara *Grošeta* (nga mbiemri rumun *gros* "i trashë, i plotë; i shpeshtë") në katundin serb Dragance afër Novobërdës;[124] emri i katundit *Gumnista* është ruajtur tek emri Gumnishta i një lagjeje të katundit Cërnicë të Gjilanit; emri *Lixize* (lexo Lizice, Lishice !?) i *Librit* është ruajtur tek emri i malit dhe i lagjes *Lisica* në pjesën perëndimore të katundit Prapashticë të Prishtinës; vendbanimet e përmendura në Libër *Machrexa, Nichxino Cholo* dhe *Raichouo Cholo*[*] janë ruajtur në emrat e lagjeve: *Makresh, Nizhnakollë* e *Rekekollë* të katundit Marec; vendbanimi *Plauize* është ruajtur te emri *Pllavica* i lëndinës në Novobërdë ndërsa emri *Rachita* i vendbanimit është ruajtur ndoshta tek emri *Rakita* i një lagjeje të katundit Rakinicë afër Orllanit.

Një kontinuitet emëror-territorial e kemi edhe tek emri i shënuar në vitin 1419 në trajtën *Vidina*. Ky vend përmendet në kontekstin e një shkrese sipas të cilës despoti Stefan Lazareviq, pas një grindjeje të madhe me raguzasit nga të cilët kërkoi që brenda tri ditësh të largoheshin nga të gjitha qytetet që ishin nën sundimin e tij, urdhëroi që të konfiskohet malli i një karavani që duhej të nisej nga Novobërda ose nga vendi *Vidina.*[125] Ky vend është lagja e sotme *Vitia* e Marecit, jo larg nga mahalla e Bullajve, përkatësisht nga minierëza apo pusi *Bulice* i përmendur në vitin 1488.

Sado që qëllim i këtij punimi nuk është trajtimi hollësisht i materialit toponimik të kësaj krahine, bën të vërehet se disa emra vendbanimesh nga të cilat vinin borxhlinj e dorëzanë të tregtarëve raguzas, janë shënuar në aso trajtash, nën të cilat mund të dalin vetëm atëherë, nëse vazhdohen nga banorë shqipfolës. Kështu p.sh. emri i sotëm i katundit *Vllasa* është shënuar në Libër si *Vlaxzi* (lexo Vlashci). Ndërmjetësimi shqiptar përkatësisht origjina e kryehershme shqiptare e emrit të këtij vendbanimi shihet tek rrethana që trajta bazë e tij, e pazgjeruar me papashtesa, del në trajtën shqipe *Vlash* që në të vërtetë është trajta karakteristike shqipe e

[123] Khs. Po ilirskim tragovima, Južnoslovenski Filolog II. (1921), f. 56.

[124] Lokalizim i M. Dinić, te Za istoriju rudarstva …, f. 33; Iz Dubrovačkog Arhiva I, f. 51.

* Duket se emri *Raichouo chholo* i vendit është i lidhur me një borxhli të tregtarit raguzas Gostise Radoslalich të vitit 1411, (sh. M. Dinić, Iz dubrovačkog arhiva, I, f. 28, kur është evidentuar borxhliu i quajtur *Raycho de caro de flume*, përkatësisht "Rajko i pusit në lumë."

[125] Sipas J. Drançolli:, Raguzanët. .., f. 89.

emrit kishtar të Perëndimit *Blasius* i cili në kishën e Lindjes reflektohet në trajtën *Vlasius*, ndërsa tek kroatët e tek sllovenët sllavë katolikë në trajtat *Blaž*, *Blažo*, *Blažko* dhe tek raguzasit katolikë e tek serbët orthodoksë si *Vlaho*, *Vlahoje* etj.[126] Oikonimi *Vlaxzi* e heq prejardhjen nga antroponimi *Vlash* i shqiptarëve i zgjeruar me prapashtesën sllave *-ci*. Dëshmi për qenien në përdorim tek shqiptarët të kësaj trajte të antroponimit të gjithkrishter kemi në regjistrimin turk të kryefamiljarëve të kazasë së Novobërdës në fundshekullin 15. Atëherë në lagjen, e banuar pothuaj vetëm nga shqiptarët, Protopop të qytetit të Novobërdës dëshmohet banori *Vlash Gjon*-i, në katundin Mikatovc (ndoshta katundi i sotëm Miganovc i komunës së Kamenicës) dëshmoet banori Nova, i biri i *Vlash*-it dhe në katundin pus miniere, Kulla Avranos (Evrenos) të paidentifikuar në terren dëshmohet banori Mil *Vlash*-i.[127]

Vetëm me ndërmjetësimin e folësve të gjuhës shqipe fjala latine *castra* ose varianti bizantin *kastros*[128] e saj mund të kalojë në *kastra*t, përkatësisht toponimet e tipit *Kastrati* janë toponime të formuara nga shqipfolësit, ashtu sikundër ka ndodhur me emrin *Kastrat* të "Serbisë së Jugut" përkatësisht jo larg nga qyteti i Leskovcit, i cili dëshmohet më 1434 (khs. *Nichola Castrati*; *Nichola Giuxi Castrat*[129] dhe *Xiucho* (lexo Zhivko) *Castrat de popolani*.[130]) Ndryshe ka ndodhur me reflektimin e këtij termi, përkatësisht të emrave të ngriturinave arkitektonike parasllave në hapësirën etnolinguistike serbe të pas shtrirjes së këtij populli e të pushtetit të tij në hapësirat etnolinguistike shqiptare e romane ballkanike. Kështu p.sh. dijetari i merituar serb i gjuhësisë Ivan Popoviq vërente se "Kështu p.sh. rrënojat në anën e majtë të derdhjes së Moravës quhen në të vërtetë *Kulić* (nga *kula* "kshtjellë" e prejardhjes turke), ajo në anën e djathtë, në katundin Dubavica, quhet porse *Kustar*, gjë që, natyrisht, s'është gjë tjetër veçse fjala latine *castrum*. Vështruar në pikëshikimin fonetik, [SG: fjala latine] *castrum* do të duhej të jepte në krye të herës një *Kostrъ dhe pastaj, në vazhdim, **Kostar* (si *ostar*, në variantin letrar *ošar*, nga paleosllavishtja. *ostrъ*). **Kostar* do të jetë tërrnuar në *Kustar*

[126] Khs. Petar Skok, Iz slovenačke toponomastike II., separat nga Etnolog VII, në Glasnik etnografskog muzeja u Ljubljani (1934), f. 66; France Bezlaj, Stratigrafija Slovanov v luči onomastike, Južnoslovenski filolog, 23 (1985), f. 25.

[127] Khs. I. Rexha, Regjistrmi. ., f. 66, 79, 155.

[128] Sh. Petar Skok, Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika II., Zagreb 1971, f. 166.

[129] Sh. Momir Jović, Dubrovačka vlastela..., f. 233.

[130] Sh. M. Dinić, Za istoriju rudarstva..., II, f.. 4. Duket se Zhivko Kastrati i popolanëve ishte nga katundi i sotëm Popolanët i cili, sipas I. Rexhës Regjistrimi …, f. 81, referenca 80, gjendet në pjesën veriperëndnëore të Kamenicës.

pas gjithë gjasësh në mënyrë analoge, duke u mbështetur mbi atë *Kulić*, duke qenë se *Kustar* e *Kulić*, si topogërmadha binjake, ndodhen [pikërisht] në vendderdhjen" e lumit të Moravës.[131]

Emri *Kastrat*,-i i katundit të Leskovcit është emër shqip e jo emër serb sepse dihet kaherë që fjala latine *castrum* dhe varianti ballkanik i saj *castra* "kështjellë" dhe ajo bizantine *kastros* reflektohen, sikundër e tregojnë toponimet *Kostrc* e *Kostur*, në gjuhët sllave në trajtën *kostrьcь/ kostrc* e *kostur*, kurse në shqipen* ka hyrë në trajtat *kastri*, *kastrati*, *kastrioti* (khs. p.sh. emrin e katundit *Kastri* në Shqipërinë e Veriut, të cilin M. Šufflay e interpreton për emër me origjinë latine, ndërsa Fr. Nopcsa[132] ka treguar se katundi *Kastri* me të vërtetë ka qenë një kështjellë. Se tek emrat e shqyrtuar më lart nuk kemi të bëjmë me raste të izoluara e tregojnë edhe emra të tjerë të vendbanimeve të këtij regjioni të cilët janë sajuar nga trajta shqipe të antroponimeve të gjithkrishtera. I kësaj natyre është p.sh. oikonimi *Nixino Cholo* - i lagjes Nizhnakollë të Marecit. Pjesa e parë e emrit është në të vërtetë trajta deminutive shqipe *Niksh* e antroponimit të gjithkrishter *Nicolaeus* shq. *Nikollë*, i zgjeruar me prapashtesën gjinore të sllavishtes *-in*, *-o*.

Njëfarë ndërjetësimi i shqipfolësve do të mund të shihej edhe tek emri *Gima* (f. 52) i një lagjeje të Novobërdës. Ky emër është i së njëjtës gurrë si edhe emri i vëllazërisë shqiptare i cili ndeshet edhe në trajtat *Gima*, *Gimaj Gimanj* (në Greqi) dhe *Gimolli* (në Kosovë). Gima quhet në të vërtetë njëri ndër tri barqet (dy të tjerat janë *Peci* e *Lopçi*) që i takojnë fisit të Shalës, që e popullon regjionin e quajtur Bajgorë në komunën e Mitrovicës. Ky fis shtrihet edhe në Shqipërinë e Veriut. Dihet porse që emri *Gima* rrjedh nga një antroponim me prejardhje latine, i cili është ruajtur tek emri i familjes *Giman* të Splitit mesjetar roman dhe tek emri i vendit *Gmanjsko Polje* e ndoshta edhe në trajtën *Žmanj* që dëshmohet po ashtu në pjesën kroate të brigjeve të Adriatikut.[133] Duke u mbështetur

[131] Khs. Bemerkungen über die vorslavischen Ortsnamen in Serbien, në: Zeitschrift für slavische Philologie Bd. XXVIII, Heidelberg 1960, fq 105: "Die Ruine an der linken Seite der Morava - Mündung heißt nämlich Kulić (aus *kula* "Burg" türk. Herkunft), die an der rechten Seite, im Dorf Dubravica, *Kustar*, was natürlich nichts anders als lat. *castrum* ist. Lautgesetzlich musste *castrum* zuerst *Kostrъ ergeben, dann weiter **Kostar* (wie *ostar*, schriftspr. *oštar*, aus urslaw. *ostrъ*). **Kostar* wandelte sich zu *Kustar* offenbar analogisch, mit Anlehnung an *Kulić*, da *Kustar* und *Kulić* an der Mündung als Ruinenzwillinge stehen".

* Kryesisht në emra vendesh, sepse kjo fjalë nuk ka hyrë në leksikun e shqipes.

[132] Sh. Arheološke crtice iz Albanije, Glasnik Zemaljskog Muzeja u Bosni i Hercegovini XIX (1907), Sarajevo, 1907, f. 1-2.

[133] Khs. Petar Skok, Slavenstvo i romanstvo na jadranskim otocima (Toponomastička istraživanja), Jadranski Institut JAZU, Zagreb 1950, f. 117; Mate Suić, Nekoliko

mbi këta shembuj, do të mund të paravendohej se trajta *Gima* nuk ka arritur domosdo me ndërmjetësimin e raguzasve. Sidomos jo sepse një emër homonim dëshmohet nëpër burime të shkruara po në këtë trajtë edhe tek shqiptarët në regjionin e Toplicës (në Serbi të Jugut) dhe tek arvanitasit e Greqisë.[134]

Një vazhdimësi e shkëputur ka gjasë të hetohet edhe tek emri i zhdukur i katundit *Babali* me gjithsej 9 shtëpi i cili me këtë emër përmendet në regjistrimet osmane të viteve 1455, 1477 e 1487 e që ishte në një timar me katundet e sotme Zllatar në lindje të Ferizajt dhe Brajsalić (ndoshta katundi i sotëm Bresalc i rrethinave të Novobërdës). Asnjëri nga banorët e këtij katundi nuk mbante ndonjë emër apo trajta karakteristike emrash për raguzasit dhe asnjë emër shqip. Katundi kishte porse një murg dhe një lopçar.[134a] Emri i këtij katundi s'ka mbase se si të ndahet nga antroponimi përkatësisht patronimi që e mbante edhe kanoniku raguzas Paskual de Babalio, që pritej të vinte në Novobërdë në vitin 1405.(khs. më lart)

Përveç në emra me prejardhje shqipe, një vazhdimësi dhe ndërmjetësim të shqipfolësve të këtij regjioni e gjejmë edhe tek emri me prejardhje sllave i shënuar në Libër në trajtën *Topaniza* (sot shq. Topanicë, serb. Topolnica) të Kamenicës, emër ky me prejardhje apelativike nga sllav. përkatësisht serb. *topola* "plep,-i" dhe prapashtesa (*n*)-*ica*. Në vitin 1321 emri *Topoьlnica*[135] përdorej si distinktiv për mikroregjionin që serbisht quhet Kriva Reka.

Mbi bazën e trajtës së dëshmuar më 1321 (khs. më lart) mund të konsiderohet se kalimi nga *Topoьlnica* në *Toponica* ka ndodhur përmes shqipfolësve para gjysmës së parë të shek. 15. Një vazhdim i ndërmjetësimit shqiptar mund të shihet edhe tek trajta *Hogosh*/*Hogosht*, serb. Ogošte e vendbanimit të kësaj pjese të hapësirës gjuhësore të shqipes. Emri i këtij vendbanimi del në një dokument serb të vitit 1345 në trajtën *Holgošta*, ndërsa në regjistrimin osman-turk të v. 1455 si *Hogošte*.[136] Trajta serbe *Ogošte* dëshmohet për herë të parë në vitin 1892.

---

primjera toponomastičke stratifikacije u srednjoj Dalmaciji, Simpozijum, Pretslavenski etnički element na Balkanu u etnogenezi južnih slavena, Sarajevo 1969, f. 152.

[134] Sh. për këtë Dr. E. Çabej, Studime gjuhësore VI (Gjon Buzuku dhe gjuha e tij), Prishtinë, 1977, f. 152.

[134a] Khs. Oblast Brankovića…, f. 134.

[135] Khs. " *i po Lipljanju i po Morave i po Topolьnici i po Vranju...* " te St. Novaković, Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje u istoriji srpskoj 14. i 15. veka, Beograd, 1880, f. 12.

[136] Sh. Oblast Brankovića..., f. 196.

4.1. Venerime 2

Në mbështetje të shembujve të përpunuar më lart rezulton se s'ka se si të mos jetë dëshmuar vazhdimësia e drejtpërdrejtë shqiptare e disa emrave që dëshmohen në dy burimet raguzase të gjysmës së parë të shek. 15, qofshin ata (emra) antroponime, emra familjesh apo emra vëllazërish. Në këtë mes kemi të bëjmë me dy farë kontinuiteti: 1. Kontinuitet emëror dhe 2. Kontinuitet emëror-territorial. Llojit të parë të vazhdimësisë i takojnë emrat e sotëm të vëllazërive dhe mikrotoponimet e tipit antroponimik të cilat nuk ndodhen pikërisht në vendet që përmenden në këto dy burime, porse në vendbanime të tjera nga të cilat, megjithatë, rrjedh pjesa më e madhe e njerëzve të dëshmuar në këto burime, përkatësisht në *Testament* (1411) dhe në *Libër* (1438); llojit të dytë i takojnë rastet kur emrat e dëshmuar në këto burime identifikohen edhe sot në po ato trajta pikërisht aty ku dëshmoheshin në gjysmën e parë të shek. 15, sado që jo në pak raste ata emra janë zgjeruar edhe me prapashtesa të huaja.

Prej këndej mund të nxirret përfundimi se pjesa më e madhe e antroponimeve dhe e mbiemrave (pa e marrë parasysh etimologjinë e atyre emrave) të shënuar në *Testament* e në *Libër* kanë të bëjnë me individë e me pjesëtarë të vëllazërive shqiptare të qytetit të Novobërdës dhe të vendbanimeve të sotme që gravitonin në këtë qytet si punëtorë krahu apo edhe si zanatlinj. Kjo do të thoshte më tej, sidomos në dritën e rrethanës se nuk ka kurrfarë dëshmie të shkruar se në këto vise pati ndonjë "ekspansion" të shqiptarëve, se edhe bartësit e antroponimeve katërçipërisht të prejardhjes sllave ishin në të vërtetë shqiptarë etnikë. Kjo sepse edhe tek emrat joshqiptarë të vëllazërive të këtij regjioni ka një vazhdimësi të pandërprerë shqiptare deri në ditë tonat. Në mbështetje të vëllimit të shembujve të nxjerrë nga këto dy burime (sh. kapitullin 2. 1) dhe të vazhdimësisë shqiptare të emrave mesjetarë mund të nxirret përfundimi se popullata e regjionit midis Prishtinës, Podujevës e Kamenicës i kishte në përdorim edhe antroponimet: *Biba*, *Bujak*, *Duka*, *Gan*, *Gec*, *Han*, *Malushat*, *Mat* (*-ko*), *Mil* (- ko), *Meksha*/*Mjeksha*, *Pavao*, *Ruk*, *Rus* dhe *Rush* (për emrat e tjerë sh. gjithashtu kapitullin 2. 1.) si edhe mbiemrat *Baliq*, *Baoshiq*, *Beshiq*, *Bushatoviq*, *Govorkoviq*, *Lekiq* dhe *Vranaj*.

Gjykuar mbi bazën e antroponimeve dhe të mbiemrave familiarë të dëshmuar kryesisht në këto dy burime që u shfrytëzuan në këtë punim, bartës të të cilëve ishin shqiptarët e qytetit të Novobërdës dhe të vendbanimeve përreth tij që kishin punë me tregtarët raguzas Gostisse Brathoslaglich e Michael de Luchari, do të mund të shtrohej paravendimi se bartësit e antroponimeve dhe të emrave shqiptarë të familjeve në gjysmën e parë të shek. 15 ishin: doganierë (khs. *Nicholetus filius* [...]

Gergasi de Nouaberda, f. 2.); priftërinj (khs. *presbyter Ginus filius Gergi de Nouaberda,* f. 4.); gjyqtarë (khs. *Nichola Castrati,* f. 3); çifligarë (khs. *Sergio de Tani,* f. 3.), kumbarë të raguzasve (khs. *Gergas conpare de Raichouo Cholo*; *Lex* conpare de Gurchouzi f. 79, 81), argjendarë (khs. *Johannes Progonouich aurifex de Nouaberda*; f. 3); *Dmitar Spani orexe*, f. 71 - për disa nga argjendarët khs. edhe f. 30); kafexhinj (khs. *Gurag de Gon Arbanexo chruzmar e foxer*, f. 62); prodhues të gëlqeres (khs.:. .. *de dare Mechxia Albanese* [...] *per calçe*, f. 38), në pjesën më të madhe të tyre porse punëtorë krahu, rrëmihës xehesh (khs. sa për shembull *Radossau Gonouich hutman, Dmitar* e *Gez Buxatouich foxer, Andria Gon foxer, Gon Belaz, Gon Choxiza, Gon Mali* - që të gjithë "*foxer*" dhe shumë e shumë të tjerë (khs. fq38, 44, 50, 55, 56, 70 të *Librit*).

Edhe në dritën e të dhënave nga defteri i fundshekullit 15 rezulton se një pjesë e mirë e banorëve vendës të krahinës së Gallapit dhe sidomos e atyre të rrethinave të afërta të qytetit mesjetar të Novobërdës, e fitonin bukën e gojës me punë krahu: shumë nga këta ishin edhe atëherë *rrëmihës, shpërlarës të zehes* (khs.: Vidaq-i, *plakançar*; Bojisha, i bir i *Plakaçar*-it, në mahallën *Stepan Protopop, Novobërdë* (në shembujt e tjerë, më poshtë ky emër është shkurtuar si NB[*]); Jovan-i, *plakançar*; Stepa, i bir i *pllakançar*-it, në mahalla e Pop Nikolla Liplanit; Jovan-i, *plakançar,* në mahallën Skliçiq, NB; Raja *plakançar*, në mahallën pop Radosllav; NB Nikolla, plakançar, në mahallën e Pop Nikolin-it NB; Jovan-i, *plakançar*; *Raja, plakançar* në mahallën e pop Millanit NB.; Stepa, *plakançar*, në mahallën e Pop Boshko-s, NB; Nikolla, *plakançar* në mahallën Lasiç, NB; Radic-i, *plakança*r, në katundin Izvor; Lazar, *plakançar*, në mahallën Stepan Protopop, NB (= shkurt. për Novobërdë);[137] *hutmanë,* (khs.**:** Nikolla i bir i *Hutman*-it, në mahallën Pop Nikolla, NB; Marko *hutman* në mahallën pop Radosllav-i, NB)[138] jo vetëm në minierën kryesore të Novobërdës, porse edhe nëpër puse minierash. Përveç kësaj, kjo popullatë e ushtronte zejen e *argjendarisë* (khs. Nen-a, i bir i *zllatarit*, në mahallën Velika Vrata, NB; Gjovan-i, *argjendar*, në mahallën Ismolic; (Lagjja/vëllazëria e sotme Smonicët e Mramorit?); Gjon, *zllatar*, nga fshati *Gurina* (Ndoshta katundi i sotëm Gjyrishec i Kamenicës); Dukin, shërbëtor, në mahallën Pop Boshko, NB; Pavli, i bir

[*] Shkurtesë për Novobërdë.

[137] Rexha, Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës sipas defterit të fundshekullit XV, në Vjetar XXVII-XXVIII i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë 2002, f.65, 66, 67, 68, 69, 72, 73, 78.

[138] Po ai, po aty, f. 68.

i *zllatarit*; Nikolla, *argjendar* në katundin Kamenica, Sako, *zllatar*, në katundin Makreshi Sredna; Bashtina Deshtan/ Deshjan?, në dorën e Gjovan-it, *argjentar*, në katundin e panjohur Vitli Gaça; Jova Marin-i, i vëlla i *zllatarit*, në katundin Glami Dolna; Niksha, *argjendar*, në katundin Gorna Makovac; Jovan-i, *argjendar*, në mahallën Plakanic të Janjevës, Pavl *zllatar*, në katundin e panjohur Sharrotina);[139] *rrobaqepës* (khs. Gjura *rrobaqepës*; në mahallën Pop Vllatko, NB; Jovan-i, i bir i *Shnajder*-it, në mahallën Sveti Petra, NB; Dimitri, *rrobaqepës* në mahallën Shashka Çrkva, NB; Raja, *rrobaqepës*; Raja, *rrobaqepës* (tjetër?); Jak-o, rrobaqepës, në mahallën Sveti Petka, NB; (SG: në mahallë ka 5 *pllaknçarë* dhe një *kërçmar*); Jak-o, *rrobaqepës* në mahallën Pop Petroilja - Petrovalja, NB; Nina Gjergj-i, *rrobaqepës*, në mahallën e Pop Dançul-it, NB; Vlad-ko, *rrobaqepës*, në mahallën Boja Bili, NB; Gjura, *shnajder* në katundin Robovac); Petri, i bir i *shnajder*-it, në katundin e panjohur Obrnafça;[140] *këpucëtarë* (khs. Shteric, *shuster*; Jovan, i bir i *Shuster*-it, në katundin Çerishta; Gjergji, *shuster*; Nina, *shuster*, Gjura, *shuster*, Jovan, *shuster* në mahallën Pop Gura shuster; Bashtina e *Shnajder-it*, në katundin Shillova; Dimitri *Shuster*-i, pronar bashtine, në katundin e panjohur Çerishta, Petri, i bir i *Shuster*-it, në katundin e panjohr Obrnafça,; Gjura *shuster*, në Dollna Mahalla e Janjevës; Ivan-i, i bir i *Shuster*-it, Gjura *shuster*, në Dollna Mahalla e Janjevës; Lazer, *çizmexhi* në mahallën Shashka Çrkva, NB);[141] *Kasapë, mishshitës*: (khs.: Raja, mesar; *Gjon-i, mesar* në mahallën Pop Vllatko, NB f. 66; Nina, i bir i *Mesar*-it, në mahallën Skliçiq, NB f. 68; Vukashin-i, *kasap*, Bogdan, *mishtar* në mahallën Pop Gjura shuster, NB; Kostandin-i, *mishtor* në mahallën Pop Petroilja;[142] *lëkurëpunues* (khs.: Raja, *kozhuhar*, në mahallën Lasiç (IR: Leshiç?), NB; Vuka, kovaç, në mahallën e e Marko Stepan-it; Pavel, *kozhuhar* në Mahallën e Re, NB; Stepan-i, *kozhuhar*; Raduhina *kozhuhar*, në katundin Kalogjerçi; Oliver, *kozhuhar*; Stepan, *kozhuhar* në mahallën Pop Shinçiq, NB; Radic *kozhuhar*, në katundin Tullari),[143] *qeleshepunues* (khs. Petri, i bir i Stepa-s, *kllobuçar* në mahallën Pop Gura Shuster),[144] *farkëtarë:* (khs.: Dimsha, i bir i *Kovaç*-it në mahallën e Pop Prodan-it, NB; Nikolla Pop *Kovaç*-i, në mahallën e Pop Stepan Rashiq-it, NB; Marko Pernoka, *kovaç* në mahallën e Marko

[139] Po ai, po aty, f. 67, 72, 80, 84, 105, 108, 121, 150.
[140] I. Rexha, Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës …, f. 66, 68, 70, 72, 74, 80.
[141] Po ai, po aty, f. 69,71, 72, 88, 113, 114, 117, 122.
[142] Po ai, po aty, f. 66, 68.
[143] Po ai, po aty, f. 65, 73, 74, 126, 141, 142.
[144] Po ai, po aty, f. 72.

Stepanit, NB; Bashtina *Kovaç*-i, në katundin Marojefcot Marec; Raja, i bir i *Kovaç*-it, në katundin Dobërçan; Stepan *Kovaç*-i, në katundin e panjohur Miloça Kolla; Stepa, *kovaç*, në katundin Koloxheriç; Petri *Kovaç*-i dhe Jovan, *Kovaç*-i në katundin Miholinci i Madh; Petko *kovaç*, në katundin e panjohur Patin?; Bogoja, i bir i *Kovaç*-it dhe *Bashtina Kovaç* në katundin e panjohur Çerishta; Dimitri kovaç, Katundi Gadimla; Në katundin Gjurashefc (sot Gjyrishec të komunës së Kamenicës) kishte asokohe 8 (tetë) farkëtarë/kovaçë: dy të quajtur Nikolla dhe të tjerët: Dimitri, Petri, Marko, Radosav, Sava dhe Dimitri Gjon-i, *kovaç*; Nikolla, i bir i *Kovaç*-it, në katundin e panjohur Vojmillofça; Martin-i, bir i *Kovaç*-it, në katundin e panjohur Taniça; Nikolla *Kovaç*-i, në katundin Rava Bana tjetër (pjesë);Vukosav-i, *kovaç*, në katundin Ruplani; Milko, *kovaç*, në katundin e panjohur Milletinça?; Jovan *Kovaç*-i e Marko Jovan-i, *kovaç* në katundin Kalogjeriç; Gjura *Kovaç*-i, në katundin Latnic; Petr-i *Kovaç*-i, në katundin Vukojovça; Marko *kovaç*-i e Kola *kovaç*-i, në katundin Sfindoll; Leshjana, *kovaç*, në katundin Koshtajani; Niko, i bir i *Kovaç*-it, në katundin e panjohur Radvina; Jovan-i, kovaç, në katundin Smira; Jovan, i bir i *Kovaçit* dhe Gjurko Kovaç-i, në katundin Dollna e Gorna Rakoça);[145] *sharraxhinj e rojtarë të malit*: Dimitri, i bir i *Dërvodel*-it, në katundin Janova; Mark *Shumar*-i, në katundin Velika Petrila);[146] *Vorbëtarë* (khs. Nina, i bir i *Gërnçar*-it, në katundin Gorna Glami),[147] *pronarë kafenesh* (khs. Todor i *Kërçmar*-it, Mahalla e Pop Dimitri Gerinoviq-it, NB);[148] e madje edhe *peshkatarë* (khs.: Dimitri, i bir i Ribar-it në *mahallën Stepan Protopop*, NB);[149] *kacaxhinj:* (khs. Stepa gvozdar, në katundin e panjohur Zhipa); *mullijs* (khs. Stojko *Vodenari*, në katundin e panjohur Gostoshiç); *bukëpjekës:* (khs.: Vuk *Beçariq* në mahallën Arbanas të Janjevës; Stepan *Beçarçiq* në mahallën Sveta Petka, NB; *gjahtarë me fajkua* (khs. Shahin Bulic, në Dollna Mahalla të Janjevës; Gjura *lisiqar*, në katundin e panjohur Kollo Avranos); *shërbëtorë:* (khs.: Dukin, *shërbëtor*, në mahallën Pop Boshko, NB) e madje edhe *rrëmihës varresh*: (khs. Simoci, *grobar*, në katundinVukojovça,)[150] Një numër i mirë syresh ishin porse lopçarë, delmerë e barinj (khs.: Miho, *govedar*, në mahallën Petroilja, NB; Martin-i, *govedar* në katundin Stojanovc; Jovan-i, *govedar*, në katundin Kosoviça; Gjon-i,

[145] Po ai, po aty, f. 69, 73, 75, 96, 99, 113, 114, 119, 124, 127, 128, 133, 136, 138, 141, 144, 149, 150, 153, 162, 163.
[146] Po ai, po aty, f. 121, 145.
[147] Po ai, po aty, f. 107.
[148] Po ai, po aty, f. 70.
[149] Po ai, po aty, f. 66.
[150] Po ai, po aty, f. 157, 160, 122, 155, 72, 148.

govedar në katundin Grosheta; Stepan *ovçar*, në katundin Dobërçan; Stepan, i bir i *Govedar*-it, në katundin Dobërçan; Boja, i bir i *Govedar*-it, në katundin Nikshina Kolla; Bozha, *govedar*; në katundin Livada; Jovan-i, i bir i *Govedar*-it, në katundin e panjohur Ner Lisa?; Jovan, *ovçar*, në katundin Papratinça; Tudora (SG: Tudori) *govedar*, në katundin Radoshefci; Jovan-i, *govedar*, në katundin e panjohur Molofça; Raja, *govedar*, në katundin Gorna Makovac; Dançull *govedar*, në katundin e panjohur Çerishta; Nikolla, i bir i *Govedasha*-s, në katundin e panjohur Turinçefci; Marko, *govedar*, në katundin e panjohur Orizojofci?-, Radisha, *govedar*, në katundin Retkoçerja; Boja, govedar, në katundin Petrili Arbanash; Dabizhiv-i *govedar*, në katundin Dujk, f. 142; Petri *govedar*, Katundi Velika Petrila Petri *govedar*, në katundin Gadisha; Jovan *govedar*, në katundin Gorna Bonesh.-a; Noko *govedar*, në katundin Gorna Bonesh; Vuk-u *govedar*, në katundin Bunesh-a; Gjinesh-i, *govedar*, në katundin e panjohur Kola Martinova; Jovan-i *govedar*, në katundin e panjohur kollo Avranos; Gjurashi-i, i bir i *govedarit*, në katundin Gorna Pozharan; Jovan, i bir i *govedarit* (tjetër), në katundin Gorna Pozharan; Niko, i bir i *govedarit*, në katundin Dollna Zhegra; Raja *govedar*, në katundin Gorna Zhegra; Jovan *çobani*, në katundin e panjohur Gostoshiç);[151] Leshjan-i, govedar, në katundin *Oporoshtiç* e të tjerë.

Rrethana që në këto burime raguzase dëshmohen relativisht më shumë antroponime e patronime shqipe tregon se popullata shqiptare do të ketë jetuar në këto anë shumë kohë para lindjes së këtyre burimeve. Këtë e vërteton rrethana se jo vetëm patronimet porse, në disa raste, edhe antroponimet janë të zgjeruara me prapashtesa sllave. Kjo gjendje e anulon mundësinë e vendosjes këtu të popullatës shqiptare nga krahina e Matit që G. Stadtmüller e mbante për "bërthamën mesjetare shqiptare"[152] nga e cila qenka rrezatuar ekspansioni i shqiptarëve jashtë kufijve të principatës së Arbrit, përkatësisht të Arbanonit. Sikur shqiptarët të ishin ardhur nga kjo farë "bërthame", atëherë jo vetëm që këta njerëz nuk do të kishin aq shumë antroponime sllave e trajta të zgjeruara me prapashtesa sllave, porse do të sillnin me vete e do të ruanin antroponimi thjesht apo së pakut kryesisht shqipe. Mungesën e të dhënave në këto dy burime se prej nga vinin disa nga borxhlinj e dorëzanë e kompensojnë dëshmitë mikrotoponimike në të cilat janë ruajtur emra të dëshmuar në këto dhe në

[151] Po ai, po aty, f. 79, 82, 86, 89, 91, 98, 99, 103, 106, 108, 114, 116, 117, 126, 139, 140, 142, 145, 152, 153, 154, 155, 161.

[152] Khs. librin e tij Forschungen zur albanischen Frühgeschichte, zweite Auflage, Wiesbaden, 1966, f. 43, 88, 117 vv

dokumente të tjera të mesjetës së vonë. Kësisoj, duke i identifikuar me material të terrenit vendbanimet e disave prej borxhlinjve, dëshmohet se ka një vazhdimësi të pandërprerë në të banuar të shqiptarëve në këtë pjesë të hapësirës gjuhësore të shqipes.

Një pyetje që shtrohet në këtë kontekst është kjo: a gjallojnë edhe sot po në atë vend ku në gjysmën e parë të shek. 15 dëshmohen antroponimet gjegjëse? Përgjegjja është *jo*. Në pjesën më të madhe të territorit prej nga vijnë personat e dëshmuar në *Libër*, nuk ndeshen sot as gjurmë të antroponimeve *Gerg, Gin, Gon, Tanush* dhe *Zoto*. Si mund të sqarohet kjo rrethanë? Emrat *Gerg, Gin, Gon, Progon* e *Tanush* nuk i mbante asnjë person për të cilin nga *Testamenti* ose nga *Libri* nuk do të dihej se prej nga ishte. Kjo do të thotë pra që bartësit e këtyre antroponimeve nuk ishin të ardhur p.sh. as nga Kratova, Kërçova, Kovin-i, Kreševa, Sofia, Smedereva e as nga krahina e Matit (në Shqipëri). Emrin *Gerg* e mbante një person, i vëllai *Gincho* i të cilit edhe më 1399 jetonte ende në Raguzë; emrin Gin, përkatësisht *Ginus* e mbante një *presbyter*,* bile aq më tepër këtu kemi tëj bëjmë me një klerik katolik i cili nuk ishte banor vendës, porse më 1382 ishte ". .. *habitator Ragusii*. .. "banor i Raguzës"; emrin *Tanus*, përkatësisht trajtën deminutive *Tani* të tij e mbante një pronar tokash, për të cilin pandehet të ishte jo raguzas, porse pas gjithë gjasash një ulqinak dhe një prift i cili ishte me prejardhje nga një qytet kroat i brigjeve jugore të Adriatikut.

Kjo do të tregonte se shumica e bartësve të emrave Gerg, Gin, Gon dhe Tanush nuk ishin në këtë hapësirë e në këtë hark kohor vendës të qytetit të Novobërdës e të vendbanimeve përreth, porse element ardhacak. Përveç për disa priftërinj që mund të paravendohet se do të kenë ardhur nga Shqipëria e Veriut, nga Kotori, Tivari ose nga Ulqini, për një pjesë të konsiderueshme të bartësve të antroponimeve e të patronimeve shqipe mund të thuhet se ishin qytetarë (shqiptarë) të Republikës së Raguzës e të qyteteve të tjera bregdetare të jugut të Adriatikut. Ka shumë arsye të besohet se edhe famullitari, emri i të cilit nuk është dhënë në dokument, të cilit "Në vjetin 1457 i dha Papa (famullitarit në Novo Brdo) auktoritet epishkopuer në pikëpamje të rrfimit mbasi në Rashën e pushtueme prej Turqvet, nuk guxojshin me

* Nga greq. *presbýteros* "më i moçëm", shkalla krahasore e *présbys* "i vjetër, i moçëm në moshë" 1. më i moçmi në bashkësi në kohën e krishterimit të vjetër. 2. anëtar i një kryesie evangjeliste. 3. nocion lat. për prift:. ..", sipas Schüler DUDEN Fremdwörterbuch, Manncheim-Wien-Zürich, 1984, f. 360.

u ndaluem epishkopët as prelatë të tjerë"[153] do të ketë qenë nga Veriu katolik i Shqipërisë.

Prania e shqiptarëve në Raguzë është gjë e njohur për historinë. Marrëdhëniet tregtare e kulturore raguzase-shqiptare mund të ndiqen mbi bazën e burimeve që nga shek. 11. Më të bollshme janë porse dokumentet që kanë të bëjnë me harkun kohor midis shekujve 13-17.[154] Madje edhe vetë nocioni "gjuhë shqipe" është dëshmuar për herë të parë pikërisht në Raguzë.

Dëshmia më e vjetër e kontakteve midis shqiptarëve e raguzasve rrjedh nga viti 1278, kur në një burim raguzas është shënuar një kontakt jo subtil, sepse kemi të bëjmë me një njoftim përkitazi me plaçkitjen nga shqiptarët të një shoqërie raguzasish dikund midis Bërskovos e Kotorit: "Ne po vinim nga Bërskova për në Kotor […] dhe të gjithë ne ishim nën mbrojtjen e kotorrasve, sepse për në Kotorr po na dërgonte Zoti e mbreti, kur ne u zumë rob, dhe kur ishim duke ecur, ja që erdhën shqiptarët e na sulmuan, edhe mua, të quajturin Dimitrius, më zunë rob." [155]

Duke e lënë mënjanë këtë njoftim, të dhëna të tjera që dëshmojnë se në qytetin e Raguzës e në rrethinë të tij ka pasur njerëz që e flisnin guhën shqipe kemi edhe në vitin 1285, kur në një seancë gjyqësore për punë hajnie dëshmitari Matheus filius Marci de Mençe dëshmonte se "... *audiui unam uocem, clamantem in monte in lingua albanesca*... " "dëgjova një zë që në mal thërriste në gjuhën shqipe", ndërsa më pastaj afër vreshtës së Benediktit të Gondulës e kishte parë. .. *unum Arbanensen.* .. "një shqiptar" tek po bante rrush dhe *duas scopinas, plenas musto*. [156] Ky njoftim bëhet i besueshëm në dritën e konstatimit të historianit të mirënjohur Milan Šufflay "Siç mund të shihet nga masa kompakte shqiptare afër Dubrovnikut dhe Kororrit në shekullin XIII, këtu ka pasur kudo edhe mbeturina autoktone ilire, të shpërngulura nga një bërthamë "shqiptare". Këtë konstatim e pranonte edhe dijetari Ilia Sindik

[153] Khs. Milan Shufflay, Serbët dhe shqiptarët, Prishtinë, 1968, f. 201. sepse: "Epishkopi i Lezhës banonte ç'prej 1478 në katundin Kallmet e mbas ramjes së Shkodrës (1479), këjo epishkopi u quejtë "titularis ecclesia in partibus infidelium".

[154] Khs. Jahja Drançolli, Disa aspekte të marrëdhënieve shqiptare-raguzase gjatë mesjetës, në Çështje të studimeve albanologjike - Materiale nga Simpoziumi shkencor i mbajtur në Prishtinë më 20 dhe 21 dhjetor 1985, II, Prishtinë 1987, f. 54.

[155] Khs. tekstin origjinal: "*Nos veniebamus de Brescova in Catarum* [...] *et omnes eramus in custodia Catarinorum, quia dominus rex mittebat nos Catarum, quando eramus cepti, et eundo sic venerunt Albanenses et assaliverunt nos, et ego dictus Dimitrius fui captus*" sh. C. Jireček, Staat und Gesellschaft. .., II, f. 24, referenca 3.

[156] Sh. K. Jireček, Romani u gradovima Dalmacije..., f. 51 dhe E. Çabej, Studime gjuhësore VI, Prishtinë, 1986, f. 174.

i cili në librin e vet për Dubrovnikun dhe rrethinën e tij shkruante : "Në qytet dhe rrethinë ka pasur shqiptarë që në shekullin XIII. Nga fundi i shekullit XIII ata i gjejmë si tregtarë, si punëtorë të kategorive të ndryshme dhe veçanërisht si fretër dhe si priftërinj, sepse dubrovnikasit nuk i kushtoheshin me qejf profesionit të priftit në kohën kur ishte në lulëzim tregtia dhe detaria".[157] Në dritën e këtyre të dhënave bëhet plotësisht e kuptueshme përse në kolonitë raguzase të Kosovës së shek. 14 dëshmohen aq shumë shqiptarë shtetas të Raguzës, midis të cilëve pjesën dërmuese e përbënin pikërisht tregtarë e priftërinj.

Këtu e ka vendin të përmendet edhe shënimi më 1332 i abatit Brocardus (alias Gullielmus Adae), sipas të cilit *Et licet Albanenses alian omnio linguam a latina habent et diverssam, tamen litteram latinam habent in usu et in omnibus suis libris*. ..[158] "Dhe, sado që shqiptarët e flasin një gjuhë krejtësisht të ndryshme nga latinishtja, ata i kanë në përdorim megjithatë shkronjat latine dhe i përdorin ato në të gjitha librat e tyre" e që ka të bëjë me banorët e qyteteve të Drishtit, Shkodrës, Ulqinit e Tivarit të cilët Brocardus-i i mbante për "latinë".[159] Siç del nga sa u tha më lart, në Raguzë dhe në qytete të tjera bregdetare shqiptarët ishin kyçur pothuaj në të gjitha fushat e jetës. Pjesa më e madhe e tyre ishin porse priftërinj si p.sh. "domnus Petrus Ispanus. post mortem nichole ispanj", nga *driuaste,* përkatësisht qyteti i Drishtit (i dëshmuar më 4. 8. 1402); *Dom Gion albanensis capellanus*... (i dëshmuar më 28. 4. 1405); "*Et dompnum Gion Longum* (i dëshmuar më 10. 12. 1403) ose qytetari i

---

[157] Cit. sipas Idriz Ajeti, Shqiptarët dhe gjuha e tyre, Prishtinë, 1994, f. 39. Sindik e mbështeste këtë konstatim mbase tek K. Jireček, Romani u gradovima Dalmacije. .., f. 51: "Kah fundi i mesjetës, në kohën e lulëzimit të tregtisë e të ndërtimit të anijeve kur studimet teologjike për vetë dubrovnikasit kishin pak forcë tërheqëse, në Dubroivnik kishte shumë shqiptarë nga bjeshkët e Shqipërisë së Veriut, tregtarë, mjeshtër e sidomos murgjë e priftërinjë."

[158] Khs. Directorium ad passagium faciendum. .., në Requeill des historiens de croisades (Documents latins et français relatifs a l`Armenie) II Brocardus, Paris 1906, f. 484.

[159] Khs. "*Hoc inter cetera facit ad dictum regnum filius capienum, quod sunt ibi duo nationes, una videlicet Albanensium et alia Latinorum,. .. Latini habend sex civitates cum suis episcopis: prima Antibarum, archiepiscopalem; deinde Chatarensem, Dulcedinensem, Suacienensem, Scutarensem et Drivascensem, quas quidem soli Latini inhabitant...*," op. cit.. f. 484. "Pushtimit lehtë të mbretërisë së përmendur i kontribuon, midis të tjerash, dhe kjo rrethanë që: Aty janë dy etni dhe pikërisht ajo e shqiptarëve dhe ajo e latinëve,. .. Latinët i kanë gjashtë qytete me ipeshkëvit e tyre: së pari Tivarin - seli e ipeshkëvit, pastaj Kotorin, Ulqnin, Shasin, Shkodrën, Drishtin; këto qytete banohen vetëm nga latinët". Ndryshe e sheh dhe e sqaron këtë çështje romanisti ynë Ruzhdi Ushaku. Khs. për këtë punimin e tij Gjurmë të kriptoshqiptarëve dhe të shqipes në Kronikën e Priftit të Dioklesë (Shekulli XII), në librin e tij Hulumtime etnolinguistike, Prishtinë, 2000, f. 201-219.

respektuar si *Johannem albanensem sartorum* (i dëshmuar më 21. 02. 1402), *Bostichus albanensis* (i dëshmuar më 21. 11. 1402), *Laçari Albanensis* (i dëshmuar më 22. 08. 1400) *pripchi ginouich* (i dëshmuar më 23. 04. 1404) *Jon Albanasin* (i dëshmuar më 5. 11. 1403)[160] e shumë të tjerë.[161] Se shqiptarët ishin të lidhur fort me qytetin e Raguzës dhe se e ndjenin atë qytet për të vetin e tregon edhe rrethana se shqiptarët e quanin Raguzën me emrin shqip të tyre *Rush.*[162] Së këndejmi nuk është aspak e pazakonshme të pritet që elementi etnik shqiptar i këtyre qyteteve bregdetare ishte inkuadruar në të gjitha llojet e profesioneve e së këndejmi edhe në tregti e në xehetari, në jetën kishtare e edhe në atë administrative. Pa e pas vërejtur shprehimisht, nga një trajtesë e dijetarit kosovar I. Ajeti[163] mësohet se ndër qytetarë shqiptarë të Republikës së Raguzës do të ketë pasur edhe përkthyes. Është meritë pikërisht e këtij dijetari kosovar i cili hetoi që elementi gjuhësor shqiptar përmbahet, sado tërthorazi, madje edhe në ndonjë dokument monumetal të kancelarisë së kishës serbe. Kështu, në dokumentin e rëndësishëm: Krisobulën e sundimtarit serb St. Dushan të vitit 1348 përkitazi me themelimin e Manastirit të shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit përmbahet, sipas I. Ajetit, edhe shprehja *semlj tretilj bratijamlj* që s'është tjetër veçse përkthim i shqipes "vet i treti, d.m.th. me të tre vëllazërit". Po kjo shprehje përmbahet porse edhe në versionin sllavisht të një shkrese që në origjinalin osmanisht do të jetë nënshkruar nga (sulltani?) Murat II në shkurt të vitit 1442 përmes së cilës ai u jepte beneficione raguzasve që gjithkah kah kanë punë e aktivitete tregtare: ". .. nëpër Romani, nëpër tokat bullgare e vllahe, nëpër (tokat) serbe e arbanase (shqiptare), nëpër Bosne dhe nëpër të gjitha vendbanimet e tyre, vendbanimeve jourbane dhe qyteteve të mbretërisë së tij që gjatë rrugëtimit të mos paguajnë askund doganë deri në vendin kur vinë në tregun e vendit të mbretërisë së tij dhe vetëm atëherë të paguajnë taksë për atë që do të shesin. .. ashtu siç është ligji në Adrianopojë, në Filipopol (Pllovdiv) e në Kratovë." Në këtë

[160] Injac Zamputi-Luan Malltezi, Dokumente. .., dok. 320, 471, 366, 279, 282, 494, 348.

[161] Në dritën e rrethanës që një prift katolik e mbante edhe në regjistrimin osman-turk të fundit të shek. XV atributin *Dom* (khs. Pop Dom Nikolla, prift në lagjen *Spanoviq* të qytetit të Novobërdës) tregon se priftërinj katolikë të përkatësisë etnike shqiptare në këtë qytet kishte edhe në shek. XV. Nëse në këtë rast kemi të bëjmë me një prift nga radhët e vendësve apo nga ajo e të ardhurve, mbetet çështje që duhet të provohet.

[162] Edhe Gottfried Schramm, sh. Anfänge des albanischen Christentums, Rombach, Freiburg im Briesgau, 1999, f. 32, 155, 181, trajtën shqipe Rush e sheh të dalur konform me ndërrimin karakteristik për shqipen të *s* intervokalike në *sh* nga Ragusium. Ky kalim paska ndodhur, spas autorit, në vitin 1000, ndërsa në trajtën e tij të shkruar dëshmohet në vitin 1685 tek Pjetër Bogdani.

[163] Khs. Shqiptarët dhe gjuha e tyre, Prishtinë, 1994, f. 82.

dokument theksohet më tej se për të gjitha borxhet që i kanë apo që i bëjnë raguzasit në tokat serbe ose në Bullgari ose në Srebrenicë e borxhliu i bie mohut, dubrovnikasi të betohet *vet i treti* (nënvizim i imi) d.m.th. bashkë me dy raguzas të tjerë dhe t'i paguhet borxhi.[164]

Jo që unë gjeta diç të re, por kryesisht në mbështetje të analogjisë, këtij konstatimi të mësuesit të nderuar të dijes albanistike në hapësirat e Kosovës, ia shtoj edhe shprehjen *samъ drugi* "vetë i dyti" duke e lënë të hapur mundësinë që edhe këtu mund të kemi të bëjmë me një shprehje shqipe, jo si ndikim i shqipes, porse si relikt shqiptar i ndërdijes gjuhësore të hartuesit apo të përkthyesit të tekstit në të cilin dëshmohet kjo shprehje. Dhe, mbase jo krejt rastësisht, kjo shprehje dëshmohet në një shkresë të sundimtarit serb Stefan Urosh të nënshkruar në rezidencën e tij në "Ribnik", mbase buzë Bistricës, nën Prizren më 25 prill të vitit 1357 përmes së cilës ky ua konfirmonte raguzasve beneficionet e mëhershme. Në këtë kontekst parashihej që, në raste kontestesh, palët duhej *t'i drejtohen gjyqit* dhe [...] *latini t'i sjell serbit* gjysmën e dëshmitarëve latinë *dhe gjys*mën *tjetër serbë* [...] *dhe tregtari t'i bëjë be latinit vet' i dyti*.[165]

Unë ia lejoj vetes që hetimit të mprehtë e të drejtë në aspektin filologjik të prof. Ajetit t'ia shtoj një vërejtje timen që tek shprehja *samъ trьtihь* (khs. më lart) kemi të bëjmë me dy dëshmi të të njëjtit relikt, për të mos thënë ndikim të shqipes në dy ambiente të ndryshme. Dëshmia e parë e frazeologjizmës shqipe *vet i treti* në krisobulën e vitit 1348 lidhet me territorin e Kosovës, ndërsa dëshmia e dytë duhet të lidhet me Raguzën. Në rastin e parë kemi të bëjmë me një dëshmi të përkthimit në serbisht të frazeologjizmës shqipe gjë që tregon, në vija më të largëta, se shqiptarët e mbërthyer pa dëshirën e tyre përbrenda shtetit ekspansionist të Rashës nuk ishin vetëm barinj e bujkrobër, porse edhe priftërinj, ndonjëri nga të cilët do të ketë arritur të ishte, nëse jo hartues sipas diktatit, së pakut shkrues i njërit ndër monumentet e mëdha të shkruara të

---

[164] Khs. origj. te Fr. Miklosich, Munumenta sebrbica..., f. 410: " [...] po Romanje, po bougarskoi i po vlaškoi zɛmlji, po srьbljehь, po arbanasɛhь, po Bosnɛ i po svɛhь inɛh *misthɛ*, zɛmljahь i gradovɛhь gospostva mi, da ne plakaju putemь ωdь svojehь trьgь nijednɛ carěnɛ ni dohotka posionoga, takmo da plakaju, gdɛ dogju s trьomь ou mjesto carstva mi, što prodaju [...] kakono je zakonь ou Ɛndronopoliju i ou Filipopolju i ou Kratovɛ. [...] za sve dougovɛ, koje imaju ili ωdь oučinɛ doubrovčanɛ ou srьpskoi zɛmli ali ou boulgarьskoi ali ou Srьbrьnicɛ, tɛr imь doužnikь *oudrь ou bahь*, da sɛ zakounɛ doubrovьčaninь *samь trьtihь* svoje droužine, i da mou sɛ toi plati. "

[165] Khs. Tekstin origj. [...] da gredu pred car stvo mi na sud [...] da da latininь srьblinu polovinu latinь a polovinu srьblь svědokɛ [...] da se klьne tьzi trьgovьcь samь drugi, [...]" tek Fr. Miklosich, Monumenta serbica …, f. 162.

kishës serbe të Kosovës së shek. 14. Unë kujtoj se vetëm kështu mund të sqarohet dëshmimi i frazeologjizmës shqiptare në një tekst kaq të rëndësishëm historik. Ajo që profesorit të nderuar i shpëtoi pa e theksuar është rrethana që në rastin e dytë kemi të bëjmë me një dokument të hartuar në Raguzë. Në dritën e rrethanës që fjala për vend/qytet përdoret në variantin delmat të saj: *misto* dhe jo në atë serb *mesto* tregon mjaft qartë se ky dokument është përkthyer nga një folës i variantit delmat të sllavishtes. Unë nuk kam kompetenca të vlerësoj nëse varianti i botuar nga Fr. Miklosich është përkthim në serbishten mesjetare (që nuk praktikohej në Republikën e Raguzës) nga ndonjë origjinal osman-turk. Mirëpo vërej që në këtë dokument, përveç frazeologjizmës *samă trătihă* "vet' i treti" është edhe një frazeologjizëm tjetër shqip dhe pikërisht ai: *oudră ou bahă*. Unë kujtoj që edhe në këtë rast kemi të bëjmë potencialisht me një përkthyes shqiptar (njohës i dalmatishtes, i serbishtes e ndoshta edhe i turqishtes) - qytetar të Republikës së Raguzës i cili, shprehjen adekuate romane/raguzase do ta ketë përkthyer si shqip "i bie; i ka rënë mohut". Po qe se kam të drejtë, kjo do të ishte edhe një dëshmi se, duke pasur edhe shkrues e përkthyes shqipfolës në shërbim të Republikës së Raguzës, s'është çudi që midis shumë afaristësh e sidomos priftërinjsh të ardhur në Kosovë kishte me të vërtetë shtetas/qytetarë shqiptarë të Republikës së Raguzës. Së këndejmi, nuk është aspak e çuditshme që në Kosovë, përkatësisht në qytete-miniera si Novobërda, Trepça etj. ndeshim shumë shqiptarë profesionesh të ndryshme të cilët kishin ardhur këndej me raguzas e me bashkëqytetarë vendbanimesh të tjera bregdetare të Adriatikut. Ndoshta këtu duhet kërkuar edhe sqarimi për termin *freni, frenik, frenić* me të cilin në Ligjin turk mbi minierat *Kanun-i Sas* (kryesisht të Novobërdës) emërtohej/quhej "pronari i kalit" të përdorur në punët për nxjerrjen dhe përpunimin e xehes. Kjo aq më parë pse në historigrafinë e sllavëve të Jugut deri tani nuk po u ditka prejadhja dhe kuptimi i këtij termi. Arsyeja për këtë enigmë do të kërkohej mbase tek mundësia që këtu kemi të bëjmë me një term thjesht profesional, me pasuri leksiokore të dialektit argo, të fshehtë të një grupi zejtarësh, prodhuesish. Këtë paravendim e mbështesin në rend të parë disa emra, kryesisht mbiemra familiarë me prejardhje kroate, të cilit i bartnin shqiptarët e asaj kohe si p.sh. *Ginas Zessarouich* (= antroponimi shqip *Gin* dhe mbiemri kroat *Zessar + ouich*) dhe *Gon Miralin* (= antroponimi shqip *Gon* dhe mbiemri kroat *Miralin* nga kroat. *miralin* "admiral") si edhe një shembull i ruajtjes nga shqiptarët të një antroponimi gjerman, përkatësisht sas tek një individ që e mbante një mbiemër kroat - siç është rasti me banorin *Chanzo Chatusich* (f. 29). Antroponimi sas *Hanco* ose *Kanco* ka mundësi që jeton deri në ditë tona tek emri i

vëllazërisë shqiptare *Kangj*(ët), përkatësisht *Kangjovit* në katundin Orllan midis Podujevës e Prishtinës. Në mbështetje të këtyre emrave do të mund të konstatohej hapur se paska pra të dhëna të cilat i hapin udhë pranimit për të vërtetë se ndër bartës të antroponimeve shqiptare me mbiemra raguzas, përkatësisht kroatë duhet parë edhe qytetarë shqiptarë të Raguzës që përkohësisht apo më gjatë jetonin e vepronin në Kosovë. Nëse pra ka vend që bartësit e antroponimeve *Gerg*, *Gin*, *Gon*, *Progon* dhe *Tanush* të dëshmuar në këto dy burime dhe në këtë hapësirë mund dhe duhet parë për shqiptarë të ardhur nga Raguza, atëherë fondi antroponimik në shek. 15 i elementit shqiptar vendës të krahinës së Gallapit dhe të hapësirës që sot quhet Serbi e Jugut do të reduktohej në emrat e ruajtur deri sot me prejardhje joorientale të vëllazërive dhe në antroponimet e dëshmuara në funksion të mikrotoponimeve, përkatësisht antroponimet e "*pasivizuara*" të shqiptarëve.[166]

Disa antroponime të dëshmuara në *Libër* (si p.sh. emrat *Gan*, *Govor*, *Han*, *Mat*, *Pava* dhe *Ruk*) që tek shqiptarët i gjejmë të ruajtur në funksion emrash të vëllazërive ose në mikrotoponime me prejardhje antroponimike, dëshmohen për antroponime të romanëve të qyteteve të brigjeve jugore të Adriatikut. Kjo do të merrej për si dëshmi se raguzas e qytetarë qytetesh të Dalmacisë nuk kishte pasur vetëm në Novobërdë, porse se sish qenkan vendosur edhe nëpër shumë vendbanime të tjera të Kosovës së sotme. Ky paravendim duket i besueshëm në dritën e rrethanës se kishte edhe raguzas që ishin pronarë pusesh të minierave e zotërues bashtinash. Kjo pozitë sociale e raguzasve është dëshmuar në mënyrë të veçantë në testamentin e vitit 1395, sipas të cilit raguzasi *Hrvatin Tvrtković* ishte pronar i një pusi miniere (në origj. *charo)* në *Nouaberda* [...] dhe i një *villa onome Striezoueçi*": ". .. *villa Striexoueçi*" i një katundi të quajtur Strizoveçi = katundi dhe miniera e sotme Strezovc e boksitit jo larg nga Novobërda. [167] Është për t'u vërejtur që antroponimi *Strez* nuk është dëshmuar asnjëherë e askund tjetër në Kosovën e sotme përveç tek emri *Strezovc* i katundit dhe tek mbiemri *Strezoviq*, përkatësisht përveç në një ambient të populluar nga raguzas (khs. borxhliun *Millos Stresouich* të tregtarit raguzas Gostissa Radoslalich të vitit 1411[168]) vendbanimi i të cilit nuk është dhënë në këtë burim, porse ka arsye të

[166] Për shkak të pranimit të besimit islam, që nënkupton automatikisht ndërrimin rrënjësisht të uzusit antroponimik të shqiptarëve, emrat e ruajtur në funksion emrash të vëllazërive dhe nëpër mikrotoponime mbeten e vetmja dëshmi e thërmizave të uzusit antroponimik paraislam të shqiptarëve.

[167] Sh. Mihailo Dinić, Dubrovčani kao feudalci u Srbiji i Bosni, Istorijski časopis 9 - 10, Beograd 1959, f. 147 referenca 29.

[168] Sh. Mihailo Dinić, Iz dubrovačkog arhiva I., f. 28

besohet që vinte nga Strezovci i sotëm. Se kjo nuk është një gjë e rastit e tregon mbase fort bindshëm rrethana që në regjistrimin osman të kryefamiljarëve e të pronave më 1455 dëshmohen edhe kryefamiljarët *Bogdan, Hrvojica* e Bogovac-i, i bir i *Hrvoje*-s në katundin Vërban të Vitisë dhe murgu *Antun* Kallojor, në kishën e quajtur e Shënkollit që ishte regjistruar menjëherë pas katundit të sotëm Zebincë të Kamenicës dhe banori Stepan-i, i bir i *Kreshimir*-it, në katundin e paidentifikuar ende në terren Jurkovce, që asokohe i takonte Prishtinës,[169] kurse në defterin turk të regjistrimit të kazasë së Novobërdës në fundshekullin 15, pikërisht për në lagjen Kosovica të Strezovcit ku raguzasi Tvrtković e kishte në pronësi një katund, bashtinë, përmendet edhe kryefamiljari i quajtur *Dimitri Dalmat*-i.[170]

Me prani të raguzasve katolikë dhe me bashkëjetesë e me bashkëshkrirje të tyre me elementin vedës shqiptar kemi të bëjmë edhe me emrin *Latin* të bashtinës në katundin e paidentifikuar *Varvariça* që gjithsesi ndodhej në rrethina të Novobërdës dhe është i pandashëm nga një kishë e kushtuar shna Barbarës.[171] Duke u mbështetur tek kuptimi "katolik, raguzas" që e kishte ncioni *latin* ka vend të pohohet se edhe këtu mund të kemi të bëjmë me një raguzas - pronar toke. Megjithatë, në dritën e rrethanës që në këtë katund jetonin edhe banorët me patronime apo antroponime shqiptare si Nikolla *Preniq*-i; Radoja *Gjergj*-i e *Prena*, i bir i Beran-it dhe banorët Raja i bir i *Buliq*-it e Vuka *Dush*-i,[172] ky mendim i imi bën të mbetet vetëm një paravendim. Një shembull tipik bashkëjetese dhe bashkëshkrirjeje raguzase-shqiptare e kemi edhe në katundin Grosheta, (sot pjesë e katundit serb Dragancë të Novobërdës) në të cilin jetonin edhe kryefamiljarët: Nino, i bir i *Blino*-s; *Gjon*-i, lopçar; Vlad, *Arbanash*-i dhe Pava *Arbanash*-i.[173] Po patëm të drejtë sidomos në pikën që trajta *Pava* e antroponimit të gjithkrishter *Paulus* (shq. *Pal*) është trajtë karakteristike për kroatët, atëherë këtu do të kishim një shembull konkret të shqiptarizimit të elementit raguzas. Këtë e tregon qartë sidomos emri etnik apo i profesionit *arbanash* "shqiptar; i shqiptarizuar; bari" që nga të tjerët do t'u jetë vënë bashkëkatundarëve Vlad e Pava.

[169] Khs. Oblast Brankovića..., f. 246, 266, 267.
[170] Khs. I. Rexha, Regjistrimi..., f. 83.
[171] Më gjerësisht për këtë shih punimin tim Oikonime e mikrotoponime nga emra shenjtorë(e)sh dhe nocionesh kishtare.
[172] Iljaz Rexha, Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës sipas defterit të fundshekullit XV, Vjetar XXVII-XXVIII i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë, 2002, f. 86.
[173] Po ai, po aty, f. 90, 91.

Se raguzas nuk kishte vetëm në qendra të mirënjohura, por edhe në vende më të vogla dhe fort rrallë apo fare të padëshmuara në burimet shkrimore e mbi të gjitha se raguzasit nuk ishin vetëm tregtarë, por që edhe ata zotëronin në tërësi apo ishin pronarë bashtinash, shtëpish dhe bashkëpronarë pusesh të minierave e tregojnë edhe rastet e tri puseve të minierave në periferi të Janjevës: "*a Stona in Jagneuo a Planice*" nga e cila një raguzas i quajtur Sergio Radosalich zotëronte shtatëdhjetë pjesë; pusi i minierës *Ginoviza* po në vendin Planiza nga i cili (pus) raguzasi i lartpërmendur zotëronte tetë pjesë, ndërsa një raguzas tjetër, *Nichole Soimirouich*, e kishte po ashtu një pus që e shfrytëzonte, porse në burim nuk jepen as emri e as vendndodhja e atij pusi.[174] E kësaj natyre është edhe e dhëna nga një kontest trashëgimie sipas të cilit shqiptari Nikoleta, i bir i Novobërdasit Gergas (qytetar i Raguzës) kishte deklaruar në Raguzë se pranonte që burrit të së motrës Katarina nga pasuria e t'et, Nichsa de Bascha Ratcho Miloslavich-it, t'ia jepte 100 perperë. *Nichsa Bascha* deklaroi ndërkaq, po si qytetar i Raguzës, se të gjitha të drejtat për një shkrijetore të veten në Krivarekë ia lente Ratcho Miloslauoich-it për 32 *lira* argjend.[175]

Jo vetëm sa për freskim të kësaj trajtese të ngarkuar me emra, por për të treguar se Novobërda nuk ishte vetëm qendër xehetare, tregtare e kishtare, porse se nga gjiri i saj kishte dalur së pakut edhe një humanist, le të sjellim në vazhdim edhe njoftimet për një humanist jo pak të njohur Novobërdas. Fjala është për Martino Segano-n, për të cilin historiografia shqiptare nuk e ka thënë deri më sot asnjë fjalë, ndërsa veprën e tij e botoi të tërësishme studiuesi italian Agostino Petrusi. Ky libër është shumë i rëndësishëm për ndriçimin e periudhës së humanizmit ndër shqiptarë, sepse sjell edhe shumë të dhëna bibliografike për humanistët që ne i mbajmë për shqiptarë të kësaj periudhe.

Studiuesi italian Agostino Petrusi ka treguar në librin e tij[176] se humanisti Martino Segano ishte një Novobërdas i lindur, i cili në vitet 1482-1485 ishte "canonicus" i kishës së Shën Mërisë në Novobërdë: "cano-

[174] Emrat e puseve janë marrë nga J. Drançolli, Raguzanët..., f. 66.

[175] Sipas J. Drançolli, Raguzanët..., f. 78.; L. Tallóczy e K. Jireček sh. Kruja e qarku i saj bërthamë e Shqipnis mesjetore, (titulli i origjinalit: Zwei Urkunden aus Nordalbanien, Zeitschrift fur slawische Philologie, Bd. 21, Berlin 1899), në Vëzhgime iliro-shqiptare, përpuiluem prej Dr. Ludwig von Thallóczy, Shkodër, 2004 f. 80) sqarojnë se prej "nji lire argjendi në monedha raguzane u pritshin në 1383 njizet, por në 1422 njizetedy perperë".

[176] Martino Segano di Novo Brdo, Vescovo di Dulcigno (Un umanista serbo-dalmata del tardo Quattrocento), Vita e Opere, Roma, 1981, f. 7, 10, 11,12, 13, 14, 15, 21, 23, 24, 142, 145.

nicus di S. Maria di Nuovamonte". Kjo dëshmohej edhe në një testament të gjetur në Arkivin e Raguzës, sipas të cilit **"**Messer Martin da Nouamonte nostro compare" dhe "Messer frate Jacomo Todesco" ishin caktuar për epitropë "testamenstarë". Emri i këtij humanisti përmendet në këtë kontekst edhe si presbitero *Martino Segun de Nouomonte ibi habitanti*, sado që të shtunën e 11 qershorit 1474 ai, si "viris dominis Martino de Novomonte (ishte) student in collegio Campionis civitatis Padue", përkatësisht që "viri domini presbiteri Martini de Novomonte quondam Joanini de Segonis, canonici Sancte Marie de Novomonte provintie Servie" e kishte mbrojtur tezën e vet të doktoranturës nga fusha e së drejtës kanonike, gjë që lë të kuptohet se gjatë viteve 1474-1475 ai ishte efektivisht në Padovë. Lidhjen e M. Seganos me qytetin e tij të lindjes - Novobërdën e tregon edhe rrethana që shkollimi i tij financohej nga qyteti i Novobërdës. Në qershor 1474, autoriteti Novobërdas *Nicolaus Camsouch de Nouomonte* ia dërgoi famullitarit *Antoniu Petrocich*, që jeteonte në Venedik, 100 duketë që ky i fundit ato të holla t'ia jepte famullitarit Novobërdas *presbitero Martino Segun* që asokohe ndodhej në Padovë.[177] Nga fundi i jetës së tij, përkatësisht gjatë viteve 1482-1485, M. Segano u bë ipeshkv i Ulqinit.

Nga dokumentacioni mësohet se ai ishte një **"**certo Giovannino de Segonis" dhe se ishte kanonik i kishës Sancta Maria di Novomonte in Serbia". Por Petrusi kujton se formimi kulturor i Seganos nuk ka ndodhur vetëm në ambiente të Padovës, porse që fillet e formimit kulturor ky do t'i ketë marrë në ambientin e pararendësve të tij të bashkësisë katolike të Novobërdës" dhe, për këtë ambient, Segano sqaron në referencën 14 se në famullitë e Janjevës, Novobërdës, Trepçës, Letnicës etj. kishte, përveç besimtarëve sasë (të emigruar nga Hungaria) që punonin në ato miniera, edhe shumë katolikë të ardhur nga Dalmacia, nga Raguza e nga Shqipëria gjatë shekujve 13-14 të ipeshkëvisë së Kotorit.

Martino Segano është autor i veprave të shkruara latinisht midis viteve 148-1485: *Breve descrizione dell'Isola di Malta*; *De via per Thraciam in Ierusalem*; *De Abyssinis seu Aethiopibus*; *Anottazione della Terra Sancta*, midis të cilave edhe një vepër për Skënderbeun*: Narrazione di Giorgio Castriotto*. Përveç këtyre, ka edhe disa vepra të tjera, të humbura, autor i të clave është Segano i ynë, të cilin Petrusi e konsideron për njërin ndër humanistët më të informuar përkitazi me historinë e vjetër dhe me atë mesjetare të Serbisë e të Kroacisë. Ky sjell të dhëna se Segano njihej edhe me humanistin shqiptar Marin Beçikemin.

[177] Sipas Mihilo. J. Dinić, Za istoriju rudarstva u srednjevekovnoj Srbiji i Bosni, I, SAN, Posebna izdanja 14, Beograd, 1955, f. 6, referenca. 30.

Sado që, thotë Petrusi, nuk dihet shumë për nivelin e zhvillimit kulturor të Novobërdës, ky paravendon se kultura intelektuale kishte në Novobërdë një respekt të madh prandaj pas gjithë gjasash do të kenë ekzistuar edhe shkolla e mjeshtër që kanë mundur të përgatisnin të rinj për studime edhe jashtë.

Duke e paraqitur Novobërdën si qendër kulturore serbe, Petrusi sjell të dhëna për shkrime në latinisht e në greqisht nga autorë "latinë" e grekë të cilët paskan vepruar në kuadër të Oborrit të knezit Lazar dhe të të birit Stefan, prandaj për këtë Petrusin, Segano nuk qenka i vetmi humanist serb (sic !) i Novobërdës. Humanistë të tillë qenkan, sipas Petrusit, p.sh. Nikon Hierosolymites, ati shpirtëror i konteshës Helena, të bijës së Lazarit që një kohë të gjatë e paska kaluar jetën në manastirin e Vraninës. Murgu grek qenka i njohur për autor i një vepre përkitazi me kishën e Jeruzalemit. Hovin e lulëzimit të humanizmit në Novobërdë Petrusi e ilustron edhe me praninë aty të ndonjë humanisti me origjinë bullgare ndonjëri nga të cilët paska shkruar edhe një biografi të knezit Lazar.

Duket se M. Segano, si edhe shumë miq të tij, u largua nga Novobërda pak para vitit 1467 kur pushteti turk internoi shumë qytetarë të Novobërdës për në Stamboll dhe kur "kishat latine të Shën Kollit e të Shën Mërisë u shndërruan në xhami", sado që për këtë të fundit, të njohur për një kohë edhe si *Kisha e Sasëve*, thuhet se kishte vazhduar të funksiononte deri kah fundi i viteve 1497-1498.

Kjo lidhet me gjendjen e katolikëve, të vlerësuar për si dramatike, në qytetet mesjetare të Kosovës së pushtuar nga turqit.[178] Në dy dokmente të vitit 1578 të publikuara nga Giannelli bëhet fjalë për 15.000 katolikë të Novobërdës, Janjevës, Trepçës e të Letnicës. Mirëpo, sikundër vëren vetë Giannelli[179] në analizën e atyre dokumenteve, në këto vende nuk kishte më shumë se 2.300 katolikë. Petrusi nuk e sheh këtë shifër për të ekzagjeruar, po u patën parasysh rrethanat e krijuara në shek. 15,[180] përkatësisht pushtimi i këtyre vendeve nga turqit osmanë. Këtu do të duhej përfshirë pra, sipas meje, edhe deportimi i novobërdasve katolikë në Stamboll, që u përmend më lart, si dhe rrallimi i popullsisë në

[178] Për këtë le të krahasohet Theiner, Vetera Monumenta Slavorum... I, e ribotuar në Osnabruck, 1968, f. 499, 517-518, 525-526.

[179] khs. Documenti inediti sullo stao di alcune communità cattoliche della Serbia meridionale nel 1578, në Richerche slavistiche, 3, 1953, f. 37, khs. edhe Cordignano, Geografia ecclesiastica dell'Albania dagli ultmi decenni del sec. XVI alla metà del sec. XVII, në Orientalia Crisiana, 36, 4, Roma, 1934, f. 234 e 236.

[180] Agostino Petrusi: Martino Segano di Novo Brdo, Vescovo di Dulcigno (Un umanista serbo-dalmata del tardo Quattrocento), Vita e Opere, Roma, 1981, f. 14, referenca 19.

përgjithësi për shkak të epidemisë së murtajës në vitin 1468, për të cilën shkruan edhe dijetari hungarez Takács.[181]

Duke u kthyer tek deportimi, ka vend të mendohet se qeveria osmane nuk ndërmori ndonjëherë deportime të popullsisë vendëse. Të dyja deportimet për të cilat dihen: ai nga Novobërda dhe ai nga Stublla, kanë të bëjnë vetëm me deportimin e popullatës katolike e parë nga pushteti osman-turk për si ekspozitura të Romës. Kjo qeveri (osmane-turke) nuk deportoi asnjëherë në mënyrë të organizuar popullatë vendëse ortodokse: Kjo rrethanë mbase mund të kuptohet sa kohë që sundimtarët lokalë serbë, kryesisht ata të Novobërdës, e pranuan pozitën prej vasali të pushtuesit turk, me të cilin edhe u miqasuan dhe sidomos pse edhe vetë kontesha Milica e dërgoi të bijën Oliverën që në harem të pjellte trashëgimtarë për sulltanin Bajazit.

Në këtë prizmë duhet parë edhe rrethana përse asnjë qeveri e Serbisë që e mbante një sovranitet të tipit vazal mbi një pjesë të Kosovës së sotme në asnjë kohë nuk u interesua për fatin e kishave katolike të minierave-qytete të Kosovës së sotme, përkatësisht të atyre në Trepçë, Novobërdë, Letnicë, në Janjevë e mbase edhe në Bellosicë, përkatësisht Murgull dhe në qytetet e Prishtinës e të Prizrenit. Nuk ka dyshim se kjo ka ndodhur për shkak se kisha ortodokse serbe dhe pushteti serb nuk i ka konsideruar këto kisha kurrë ndonjëherë për të vetat, sepse ato ishin faltore të elementit katolik të privilegjuar kryesisht raguzas e delmat dhe sas, edhe pse ortodoksia serbe ishte, që nga pushtimi nga kjo në vitin 1119 të Kosovës së sotme, në luftë të hapur.

Jo krejt e qartë mbetet përkatësia etnike e vetë Seganos. Nga *Kujtimet* e tij mësohet se ky e mbante veten për *natione Catharensis origine autem Servian(us) ex Novomontio alier Novabardo dicto* "i përkatësisë etnike kotorase nga Novomontio e quajtur ndryshe Novobardo" Autori i librit, Petrusi, sqaron se mbiemri *Segano* nuk dëshmohet shpesh. Ka vetëm një dëshmi të këtij emri dhe pikërisht në vitin 1536 kur pikërisht në Kotor përmendet një *Vincentio Segoni fiol de Zoan salinar der Cattaro*. Petrusi beson se familja Segano është efektivisht me prejardhje nga Kotori e cila do të ketë emigruar në Novobërdë, apo që ka ndodhur e kundërta, ajo ishte familje në krye të herës vendëse e Novobedrës, por që në Kotor emigroi pas pushtimit turk.

Edhe hulumtuesi Pinelli që i paska recenzuar veprat Tracatus de Mysiae Superiorus seu Servia [et Minoris] descriptione" të Seganos, qenka i bindur, sado që e pranon mendimin se popullsia e qytetit të

[181] Sh. punimin e tij Sächsische Bergleute im mittelalterlichen Serbien und die "sächsische" Kirche von Novo Brdo, në Südost-Forschungen Band L, 1991, f. 42.

Novobërdës paska qenë e përzier pjesërisht gjermane e pjesërisht serbe (S.G. raguzase), se veprat e vetë Seganos po treguakan qartë se autori [S.G. Martino Segano] **"**ishte një serb nga Serbia Qendrore". Duket se Petrusi do të ketë rënë nën ndikimin e historiografisë serbe e cila madje edhe vetë Raguzën e konsideron për qytet serbësh si edhe letërsinë e zhvilluar atje përfshirë pra edhe humanistin Martino Segano, e madje edhe Marin Držić-in kroat, për serbë. Kjo lajthitje e qëllimshme e historiografisë serbe bëhet e qartë në dritën e rrethanës pse jo vetëm popullata katolike sllavishtfolëse e Raguzës, porse edhe ajo katolike e ambienteve kosovare në Binçë, Janjevë, Letnicë, Vërnez, Vërnakollë e mban veten për pasardhëse të kroatëve - qofshin këta nga Dalmacia apo nga Raguza. Nga një burim i vitit 1435 mësohet se p.sh. famullitari Andrea i Janjevës e refuzoi ofertën për të qenë vikar (mëkëmës) i ipeshkvit për Serbinë në shenj revolte pse dhespoti Gjergj i Rashës kishte përvetësuar shumë kisha[182] katolike dhe e favorizonte konvertimin me dhunë të katolikëve në ortodoksë. Reagimet e kësaj natyre edhe në kontekstin e privilegjimit të kishës ortodokse serbe në relacion me atë katolike nga pushteti otoman vazhduan së pakut deri në shek. 17. Këtë e tregon edhe segmenti që për t'u mbrojtur nga mundësia e ndalimit të ushtrimit të katolicizmit nga pushteti, janjevasit u obliguan që patriarkut serb të Patrikanës së Pejës t'i jepnin një shumë vjetore në të holla, në mënyrë që ky të ndërmjetësonte tek qeveria otomane në të mirë të katolikëve. Për ndryshim nga Janjeva katolike që kërkonte leje për meremetimin e kishës së saj, patriarku serb që rezidonte në Graçanicë, i kishte dhjetë kisha të pajisura mirë dhe dinjitarët e saj kishin të ardhura të mira. Kjo është mbase arsyeja përse kryeipeshkvi Andrea Bogdani e luste më 1 nëntor 1664 nga Janjeva Kongregacionin që përmes të të dërguarve të shteteve mike të angazhohet për mbrojtjen e katolikëve nga sulmet e patriarkut të Graçanicës.[183]

Duke iu kthyer sërish raguzasve të mirëfilltë, mua më duket se përfundimin më të qëlluar të aktivitetit të raguzasve në shtetin mesjetar të Rashës, e ka nxjerrë hstoriani kosovar Muhamet Tërnava (khs. pasusin e marrë për moto në fillim të këtij punimi dhe faqet 271-277 të librit të tij). Një segment interesant nga studimi i Tërnavës është e dhëna që e sjell ky se raguzasit kishin, në periudha të ndryshme, privilegje e detyrime të ndryshme. Kështu, nga M. Tërnava mësohet se mbreti serb Milutin-i në

[182] Khs. Gaspër Gjini, Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj..., f. 98. Ky post iu besua presbyterit Tanush, i cili ishte banor i Novobërdës.

[183] Khs. Nikola Čolak-Ive Mažuran: Janjevo, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 64-65.

një marrëveshje që e lidhte me Raguzën, pas një lufte që e kishte bërë kundër saj, megjithatë e përtërinte marrëveshjen me raguzasit dhe u garantonte atyre edhe privilegje të tjera si lirimin nga obligimet ushtarake, nga ngritja e mureve rrethuese të reja të qyteteve dhe nga detyrimi i mbrojtjes së qyteteve.[184] Mbase duke qenë se raguzasit kishin bashtina dhe kishin bërë plang në Novobërdë e në rrethina të saj, gjë që nënkupton se ata ishin si të thuash zotër të atyre qyteteve, nga sundimtarë lokalë serbë të mëvonshëm, si p.sh. nga konti Lazar, raguzasit konsideroheshin për qytetarë të feudeve, përkatësisht të principatave të tyre, prandaj kishin edhe obligime ndaj qytetit. Se sa "vendës" ishin dubrovnikasit në Novobërdë e tregon mbase rrethana që, kur në rrethina të Nishit po zhvilloheshin luftime dhe pritej që ato (luftime) ta përfshinin edhe Novobërdën, konti Lazar ua vërtetonte privilegjet më 9 janar 1387 dhe atyre raguzasve që kishin bashtina në Novobërdë, d.m.th. atyre që ishin ngulitur aty me shtëpi e me prona u urdhëronte që ta murosnin dhe ta mbronin qytetin e Novobërdës, ndërsa atyre që nuk ishin ngulur me lang e plang në këtë qytet ua lente të vepronin sipas dëshirës së tyre. Duket se po këtë letër me ndryshim vetëm të dy-tri fjalëve, e shpalli më 20 janar në Prishtinë edhe Vuk Brankoviqi.* Në versionin e nënshkruar më 9 janar në "qytetin e famshëm Kruševac të zotërisë sime" nga kont Lazari thuhet: "Dhe ata raguzas që kanë bashtina në Novobërdë. .. ", ndërsa në shkresën e nënshkruar 11 ditë më vonë në Prishtinë thuhet "Dhe ata raguzas që kanë bashtina në qytete të miat, ata (duhet) ta murosin qytetin dhe ta ruajnë: ata që janë mysafirë dhe që nuk kanë bashtina, le të veprojnë sipas dëshirës së tyre. ..".[185] Duket se ky njoftim e hap udhën për të menduar se pjesa dërmuese e banorëve të Novobërdës mund të ketë qenë me

[184] Khs. M. Tërnava, Popullsia e Kosovës në shekujt 14-16, Prishtinë, 1995, f. 272.

* I bir i qesarit e sevastrokratit Branko të St. Dušan-it. Një motër e kishte të martuar për zotin e Durrësit, Gjergj Thopinë. Për ta marrë pushtetin, e paska tradhtuar kontin Lazar në Betejën e Kosovës. Për ta siguruar veten dhe familjen e tij ky lidhi më 9 maj 1390 marrëveshje me Raguzën, sipas së cilës kjo e fundit i premtonte se në rast nevoje do ta strehonte atë, të shoqen e të bijtë dhe pastaj do t'i dërgonte në një vend të sigurt. Në një kartë të dt. 21 nëntor 1392 shihet se ky kishte lidhur paqe me turqit dhe zotohej që këtyre të fundit do t'u paguante një gjobë vjetore. Përmes dhëndrrit dhe të motrës që i kishte në Durrës V. Brankoviqi u pat dhënë venedikasve më 9 prill 1394 beneficione për të kaluar nëpër territoret që i zotëronte si dhe të drejtën që qytetarët venedikas ta kenë të drejtën e bashtinës. Sipas Sime Ljubić, Opis jugoslovenskih novaca, Zagreb, 1875, f./ 158-159.

[185] Në letrën e knez Lazarit është shkruar: "I ko (i) se je dubrovčaninъ zabaštiniłь u Novomь Br(ьdu) ", ndërsa në atë të Vuk Branković-it emri i Novobërdës zëvendësohet me "po moihь gradovehь, tьzi da zigju gradь, i da čuvaju, koi li su gostie i ne su se zabaštinili, da imь e na voli kako imь gode" cit. sipas Fr. Miklosich, Monumenta serbica …, f. 207, 208.

prejardhje nga Raguza dhe që, së këndejmi, edhe ishin pothuajse zotër të këtij qyteti. Dhe, kur më 1441 qyteti u sulmua nga ushtria osmane, dubrovnikasit me të vërtetë e mbrojtën qytetin "pa pasur aspak frikë as nga shigjeta e nga shpata turke e as nga kërcënimet e mbretit të hidhur Musa"* - shkruanin ata vetë në një letër.[186] Sado që është treguar nga historianë se në qytetet miniera të Kosovës nuk kishte raguzas që do të kishin jetuar nëpër to brez pas brezi, por në to kishte gjithherë raguzas që në to kishin jetuar prej një deri në 25 vite me radhë, vetë vëllimi i autonomisë, i kompetencave, përkatësisht i detyrimeve karshi qyteteve tregon se shumica e raguzasve ishin banorë të përhershëm të qytetit të Novobërdës e të vendbanimeve nëpër të cilat ata dëshmohen në shek. 14-15. Në dritën e urdhëresave drejtuar raguzasve të qytetit të Novobërdës (khs. më lart) lejohet paravendimi se ky ishte faktikisht qytet i raguzasve. Kjo sidomos përderisa në ato shkresa nuk thuhej p.sh. që raguzasit duhet t'u bashkohen forcave serbe për ta fortifikuar e mbrojtur qytetin. Vështruar mbi bazën e ngjarjeve të kohës, përkatësisht në dritën e rrethanës që vazali osman Vuk Brankoviq pothuajse njëkohësisht me këto ngjarje, duketët e fituar nga dhënia me qira raguzasve të minierës së Novobërdës i investonte për ngritjen e qytetit të Smederevës dhe jo për mbrojtjen e Novobërdës. Kjo rrethanë e lejon paravendimin se raguzasit vendës do të kenë ngritur edhe kisha të vetat. Çështje më vete është nëse predikuesit, famullitarët ishin kroatishtfolës, përkatësisht nëse liturgjia mbahej vetëm në kroatisht, apo në latinishten mesjetare, sado që pjesa dërmuese e pritërinjve ishin shqiptarë të ardhur nga qytete bregdetare të Dalmacisë e nga Shqipëria e Veriut. Kjo aq më parë sa kohë që për Dalmacinë dhe për Shqipërinë kjo është krejt e qartë, sepse aty u ruajt për kohë të gjatë një popullatë e dendur romane e dëshmuar dendur nëpër burime: Në Raguzë flitej edhe në shek. 15 edhe romanisht dhe pikërisht një idiomë romane, që nuk ishte sjellur nga Italia por që, bashkë me

* Duket se këtu është fjala për figurën historike kosovare të njohur në folklorin serb si Musa Kesedžija, që ishte sundimtar lokal shqiptar i një pjese të krahinës së sotme të Llapit. Nga ky njoftim rezulton se sundimtari lokal shqiptar ia kishte kthyer shpinën pushtetit pushtues serb dhe tani e përkrahte pushtuesin e ri. "Emri Musa është në të vërtetë variant serb i antroponimit *Muzak*, të dëshmuar dendur për antroponim i shqiptarëve. M. Shufflay, (Serbët dhe shqiptarët, Prishtinë 1968, f. 225) shkruan se këtë emër e mbante familja e fuqishme e Muzakajve, "djepi i të cilëvet ishte nëpër rrethet e Vlonës, në Muzakin e Vlonës. Ky mbiemën duket si me qenë i rrjedhun prej greqishtes. Hahn-i sheh në këtë diminutivin ri-grek t'emnit Muzë, Mojsi. Gjithsesi nuk asht nji mbiemën fisi, por qyteti. I pari i kësaj familje përmendet ndër shkresat e vjetit 1280 "*Johannes dictus Muzac*".

[186] Sipas Stojan Novaković, Novo Brdo i Vranjsko Pomoravlje, f.31. Më gjerësisht për rolin e raguzasve në mbrojtjen e Novobërdës khs. J. Drançolli, Raguzanët. .., f. 94..

rumanishten e folur gjerë e gjatë në Lindje, mund të merret për [gjuhë] romane ballkanike."[187] Kjo idiomë cilësohej në çerekun e parë të shek. 15 si "latinum idioma" dhe dëshmitarët sllavishtfolës ankoheshin përpara gjyqit të Dubrovnikut në vitin 1401 se nuk i kuptonin të folmet latine: "*nescio linguam latinam*". Për elementin roman të sllavizuar, si p.sh. për atë të ujdhesës Krk thuhej në gjysmën e dytë të shek. 16 (në vitin 1553) se banorët e saj e flisnin "gjuhën sllave, por të ndryshme nga të tjerat,. .."[188] gjë që mund të vlejë edhe për të folmen e Raguzës në këtë hark kohor.

Praninë në hapësirën e Karadakut të sotëm të folësve të romanshtes së tipit dalmat sikur e dëshmon rrethana që në *Libër* ka një person që ishte me prejardhje nga katundi i sotëm Shashar i krahinës së quajtur *Negriomente* (khs. shembullin: "*Stepan Dimitrouich vauturach de Negrimonte in cholo Sesarouichci de Negrimonti*").[189] që gjithsesi ka të bëjë me krahinën "Mali i Zi" siç qenka quajtur edhe nëpër shkrime kishtare serbe të shek. 14 krahina, emri i së cilës më vonë u përkthye në turq. *Karadag* dhe vazhdoi të ruhet nga banorët shqiptarë të kësaj krahinëze. Duket se për si rast të përkthimit në sllavisht të këtij nocioni e kemi dëshminë nga defteri turk i viteve 1566-1574 kur për në katundin e atëhershëm Lisica (sot lagje me po këtë emër e katundit Prapashticë të komunës së Prishtinës) është regjistruar edhe banori Jovan *Crnagor* (crnagorac).[190] Sa kohë që burimet shkrimore raguzase të fillimit të shek. 15 e dëshmojnë bindshëm praninë e shqiptarëve si popullatë shumicë të kësaj zone, ka arsye të besohet se nuk e kanë mirë ata që provojnë të dëshmojnë se kinse shqiptarët na qenkan të ardhur këndej në shek. 17. Kundër kësaj teze flasin edhe disa burime osmane-turke të fundit të shek. 15 (përkatësisht të vitit 1498), të cilat e dëshmojnë praninë e shqiptarëve në qytetin e Novobërdës. Askohe për banorë të këtij qyteti përmenden edhe: *Gon Arbanas* - argjendar; *Petri Arbanas*; *Petri*, i bir i *Arbanas* -it; 4 banorë të tjerë që për mbiemër të mirëfilltë e kishin trajtën turke *arnaut* të

[187] Khs. "für Dalmatien und Albanien ist das ebenfalls ganz klar, da dort eine dichte romanische Bevölkerung noch lange erhalten blieb und von den Quellen reichlich bezeugt wird: in Dubrovnik sprach man noch im XV. Jh. auch romanisch, und zwar ein romanisches Idiom, das nicht aus Italien importiert worden war, sondern zusammen mit dem weit im Osten gesprochenen Rumänischen als Balkanromanisch gelten kann;" Nga: I. Popović: Die Einwanderung der Slaven in das Oströmische Reich im Lichte der Sprachforschung, Zeitschrift für Slawistik, Bd. III, 1958, f. 709.

[188] Sipas K. Jireček, Romani u gradovima Dalmacije, Zbornik Konstantina Jirečeka II, Beograd, 1962, f. 88, 89.

[189] M. Dinić, Iz dubrovackog arhiva I., f. 74.

[190] Muhamet Tërnava, Populllsia e Kosovës gjatë shekujve 14-16, Prishtinë, 1995, f. 226.

emrit etnik apo të profesionit nacional të tyre ("blegtor") e që ishin gjithashtu zanatlinj dhe kështjellarë (rojtarë) të kështjellës së Novobërdës.[191]

Më shumë të dhëna për praninë e shqiptarëve në lagjet e qytetit të Novobërdës, të cilat në të vërtetë ishin katunde që gravitonin në atë qytet, ka në defterin turk të regjistrimit të kryefamiljarëve të kazasë së Novobërdës në fundshekullin 15. Më poshtë po sjellim emrat shqip e të shqiptarëve që jetonin në ato lagje, ashtu siç i ka transkribuar orientalisti kosovar I. Rexha. Kështu: në *mahallën e Pop Haralijes* jetonte edhe *Gjoni*, i bir i Filipit; në mahallën *Shimçiq*[*] jetonin kryefamiljarët: *Gjon*-i, i bir i *Arbanas*-it; *Gjon*-i, i bir. i Zojiq-it e Kostadin *Tushiq*-i; në mahallën e Pop Simonit[**] kryefamiljari *Ulkash* Zojiq-i; në mahallën Inoshiq (Noshiq?): Boja *Tanovac* e *Petra? Arnaut* -i; në mahallën Sveti Petri: *Tush*-ko Jovan -i e *Petri Arbanas*-i; në mahallën Prodashiq: Stepa, i bir i *Gika*-s; në mahallën Protopop: *Gjon*-i i bir i *Don*-it; Dimitri i bir i *Leshan*-it; Gjurisha i bir i *Preniq*-it; *Gjon*-i i bir i Protopopit; *Uklesh* Jovan-i; Petri, i bir i *Gjon*-it; *Likogjiko*, i bir i Ralin-it; *Uklesh* Jovan-i dhe *Vlash Gjon*-i; në mahallën e Pop Vllatkos: *Gjon* mesar "mishshshitës"; në mahallën *Velika Vrata* "Porta e Madhe": Nikolla, i bir i *Gjin*-it; në mahallën Raja Vasil: *Gjon*-i i bir i tij; *Tushan*- i, i bir i Gjurko-s; *Gjon*-i, i bir i Tusjan-it dhe *Gjon*-i i bir i *Leshjan*-it; në mahallën e *Pop Nikolla Liplanit:* Peja, i bir i *Gjon*-it; *Gjon Doda* dhe Gjon-i, i bir i Vojç-it; në mahallën *Skliçiq*: Dimitri *Matosh*-i; *Gjon*-i i bir i Pavl-it; *Gjon*-i i bir i Jovan-it; *Kola Arnaut*-i; Zhujko, i bir i *Zojiq*-it dhe *Petri Arbanas*-i; në mahallën *Shashka crkva*: *Gjon*-i i bir i Marko-s e *Pop Dom Nikolla*; në mahallën *Spanoviq*, që mbante emër shqip, përkatësisht antroponimin e shqiptarëve *Span*, të zgjeruar me prapashtesën sllave *-ović*, nuk kishte asnjë banor me emër shqip; në mahallën e pop Goshiq -it: Gjura, i bir i *Bushat* -it (?) e Petri, i bir i *Lik* -ut; në mahallën e Pop Prodan-it: Peja, i bir i *Barda*-s e *Kokgjin* -i, skamnor; në mahallën e pop Millanit: *Gjoniko*, i bir i Zojiq- it; Goja, i bir i *Gjon*-it e Doka (Duka) i vëlla i Jovan-it; në mahallën e Pop Petroilja -Petrovalja?: *Gjon*-i, i bir i Vojin-it; Marko, i bir i *Gjon*-it; *Petri Arbnes*- i; *Petri Gjon*-i; Stepa, i bir i *Pren*-i t (?); Mihal-i, i bir i *Gjin*-it; Jovan-i, i bir i *Voglin*-it; Peja, i bir i *Arbnes*-it dhe Martin-i, i bir i *Gjon*-it; në mahallën Sveta Petka: *Gjon*-i, i bir i Pavel-it dhe *Gjon*-i, i bir i Kolan-it; në mahallën e Pop Dimitri Gerinoviq-it: *Gjon*-i, i bir i

[191] Khs. Nedim Filipović: Iz istorije Novog Brda u drugoj polovini XV i prvoj polovini XVI vijeka, Godišnjak Istorijskog Društva BiH, VI/1954, f. 83.

* Unë kujtoj se ka mundësi që ky emër të identifikohet me emrin Shinovit të një lagjeje, përkatësisht vëllazërie të Marecit.

** Kemi të bëjmë me lagjen e sotme Simajt, përkatësisht *Simojt* të Marecit.

Stefo-s; Jovan-i, i bir i *Arbina*-s; *Gjon*-i, bir i Dimitri-t; Berasav, i bir i Zojiq-it dhe *Gjon*-i, i bir i *Shin*o-s;[*] në mahallën e Pop Filipit: Mat-i, i bir i *Mazko*-s e Gjorgj-i *Tani*-i; në mahallën e *Pop Gjon*-it (me vetëm 3 shtëpi, nuk kishte njerëz me antroponime shqipe); në mahallën e Pop Gura shuster-it: Petko, i bir i *Arbnes*-it; Nikolla, i bir i *Gjon*-it; Peja i bir i *Gjon*-it dhe *Gjergj-i*, shuster; në mahallën e Pop Dançul-it (një lagje thjesht vllahe, khs: Sako, dhëndër i Dançul-it e Dançutiq-i dhe Dimitri Dançul-i) jetonte kryefamiljari shqiptar Nina *Gjergj*-i; në mahallën Ismolic;[**] *Gjon* Mara; në mahallën e Pop Boshko-s: *Gjon*-i, argjentar nga katundi i paidentifikuar në terren *Gurina*; në mahallën e Pop Stepan Rashiq-it: Marin-i, i vëlla i *Gjon*-it; Gjura, i bir i *Gjin*-it; Mareko, i bir i *Gjin*-it dhe Peja, i bir i *Nik*-ut; në mahallën e Pop Nikolin-it: Peja, i bir i *Gjon*-it dhe *Tusha Gjon*-i; në mahallën Lasiç- sot e panjohur me këtë emër - në të cilën kishte edhe vlleh (khs.: Nikolla, dhëndër i Dançul-it dhe e veja Dança), jetonin edhe kryefamiljarët shqiptarë *Dukaç Zojiq*-i e Peja *Lesh*-iq-i dhe në mahallën e Boja Bili-it; *Lazar Arbanas*-i; Niko *Mirush*-i e Jovan *Leshiq*-i.[192]

Në dritën e gjithë kësaj që u tha deri tani duket se mendimi i dijetarit boshnjak N. Filipović, se ". ..duket që kjo dyndje e shqiptarëve në Novobërdë është pjesë e një migracioni bukur të madh të shqiptarëve, migracion ky që përveç regjistrimeve (të kryefamiljarëve e të pronave) të vilajetit të Brankoviqit shënohet edhe në burime të tjera të gjysmës së parë të shekullit 15"[193] mbetet i paqëndrueshëm. Sikundër shihet nga materiali i trajtuar në këtë punim, në Novobërdë kishte banorë vendës të përkatësisë etnike shqiptare edhe në gjysmën e parë të shek. 15 e ka edhe sot. Si mund të sqarohen ndryshe përputhjet emërore-territoriale të materialit onomastik të ditëve tona me atë të dëshmuar në *Testament* (1411) dhe në *Libër* (1438), përveç si dëshmi e lashtësisë në të banuar të shqiptarëve të kësaj krahine. Në këtë mes bën të përmendet edhe shënimi i vitit 1853 kur në një letër të nënshkruar nga shumë qytetarë të Novobërdës - midis tyre edhe një banor që e ndjente veten për "*katolik i*

[*] Para përafërsisht 20 vitesh vdiq "plaku jetik" Shin,-i - banor i katundit Marec, bartësi i fundit i antroponimit Shin që dëshmohet në shek. XV pikërisht në këtë ambient.

[**] Mendoj se mund të jetë lagjja e sotme Smonicët e Mramorit, afër Prishtinës.

[192] Sh.Iljaz Rexha: Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës sipas defterit të fundshekullit XV, në Vjetar XXVII - XXVIII i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë 2002, f. 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74.

[193] Khs. punimin e tij: Iz istorije Novog Brda u drugoj polovini XVI vijeka, Godišnjak Istorijskog Društva Bosne i Hercegovine 6 (1954).

gjakut serb" e që quhej *Seba Ginović*[194] - sado që mbante antroponimin e sferës së krishterë të Perëndimit *Sebastian* në trajtën e shkurtuar *Seba* dhe patronimin thjesht shqiptar të sajuar nga antroponimi *Gjin* i zgjeruar me prapashtesën sllave *-ović*, përmenden edhe shqiptarët. Nëse rasti i Novobërdasit *Seba* mund të lidhet me dukurinë e konstatuar nga C. Jireček, sipas të cilit - si pasojë e pozitës së privilegjuar të raguzasve si në shtetin mesjetar serb ashtu edhe në kohën e sundimit të perandorisë osmane - shumë ortodoksë, për të fituar liri e siguri, u bënë katolikë dhe të nënshtruar të Raguzës,[195] mbetet çështje që duhet të ndiqet më tej. Mirëpo, në mbështetje të burimeve historike mësohet se raguzasit ishin pra besimtarë të ritit katolik të krishterimit. Ata do të kenë pasur, siç mund ta tregojë emri *Ceceli* i katundit të Vushtrrisë, madje edhe një kishë kushtur shna Cecelisë, që nuk njihej nga kosovarët vendës. Në shkrime zyrtare e private ata e përdornin gjithnjë e gjithkund dalmatishten, përkatësisht variantin dalmat të sllavishtes së Jugut dhe alfabetin latin. Në këtë alfabet janë të shkruara edhe të gjitha mbishkrimet varrore të tyre nëpër kolonitë e tyre në Kosovën e shek. 14-15. Së këndejmi duket që pretendimi për prejardhjen serbe të raguzasve në qendrën e tyre si edhe nëpër kolonitë e tyre në Kosovë mund të shihet vetëm si devijim i realitetit historik, sepse nën këto rrethana historikisht të dëshmuara, s'ka vend të besohet që të ketë pasur serbë katolikë.

Për praninë e shqiptarëve në Novobërdë e në rrethinë të saj flet edhe shënimi sipas të cilit ipeshkvi i ipeshkvisë së Tivarit e i asaj të Shkupit shqiptari Petrus Bogdanić përkatësisht Pjetër Bogdani e njoftonte selinë e Shenjtë më 1685 se "*Le miei Albanesi, si sono offeriti in numero 300* [...], "Shqiptarët e mij në numër prej 300 sish" janë ofruar se do ta çlirojnë qytetin e Novobërdës nga turqit [...] *senca sparginento di sangue*...,[196] "pa derdhur gjak", shënim ky nga i cili vetvetiu do të duhej shtruar pyetjen kah na dolën tani gjithë këta shqiptarë katolikë të rrethinës së Novobërdës dhe cilët janë pasardhësit e tyre sot?

Bashkëkombësit e Bogdanit janë paraardhësit e atyre shqiptarëve që për aty ishin dëshmuar së pakut që nga gjysma e parë e shek. 14, ndërsa në regjistrimin turk të viteve 1566-1574 aty jetonin edhe shqiptarët *Jova Bac*-i, *Gika Fran*-i, *Voja Gjexhiq*-i, *Luka Gjon*-i, *Pavl Koka, Luka Span-*

[194] Khs. Kosta N. Kostić, Trgovinski centri i drumovi po srpskoj zemlji u srednjem i novom veku (istorijsko- geografska rasprava), Beograd 1899, f. 252, referenca 2.

[195] Khs. Constantin Jos. Jireček, Geschichte der Bulgaren, Prag 1876, cit. sipas Textor Verlag Frankfurt am Main, 2008, f. 460

[196] Sh. A. Theiner, Vetera monumenta slavorum meridionalum historiam illustrantia, Zagrabiae, 1875, f. 220 -221.

i, *Pejo Spa*-i, *Mat Tanush*-i, Koka *Xhosh*-i, *Papa Xhosh*-i dhe rreth 10 persona që në funksion patronimi apo antroponimi e mbanin antroponimin *Mat,-i* të shqiptarëve.[197]

Se pjesa më e madhe e popullatës së katundeve përreth Novobërdës, të cilat sot e kanë statusin prej lagjesh të Marecit, ishte popullatë vendëse e tregon rrethana se ndër banorë të evidentuar në regjistrimin e kryefamiljarëve e të pronave të kazasë së Novobërdës në fundshekullin 15 kishte jo pak banorë që kishin ruajtur antroponime apo patronime me prejardhje shqipe. Kështu p.sh. në katundin Nikshina Kolla (kujto *Nixino cholo* të burimit raguzas = lagjja e sotme Nizhnakollë e Marecit) jetonin edhe banorët: *Liko*, i bir i Militas-it, *Niksha*, i vëlla i Pejo-s, *Niksha* Dimitr-i, *Gjon*-i skamnor, Gjura *Prenk*-u, Dabizhiv *Prenko*, Stepan *Prenko*, Daba Rakço, Stepan *Gjin*-i, *Lusha* Disha, Pl(l)ana *Preka*, por edhe individë me emra kroatë si *Pava*, skamnor dhe *Pava*, i bir i Perko-s[198] e të tjerë. Në të mirë të kësaj shkon sidomos rrethana e ruajtjes, përkatësisht e përtërirjes së antoponimit në trajtën *Niksha*, që tregon se vendi ishte i banuar shumë kohë para se ky të dëshmohej në dokumente të shek. 15.

Në katundin *Livada* (i cili ka mundësi të jetë lagja e sotme Golemivadë: nga një *Golema livada "Livadhi i Madh" në territorin e katundit Marec) jetonin edhe banorët: Nikola *Lek*-a, Stepan *Pjak*-a, Nina i bir i *Gjuka*-s;[199] në katundin Rajkova Kolla (= lagja Rekekollë e Marecit, kujto *Raichouo cholo*-n e burimit raguzas) jetonin edhe banorët: Petrdan *Noka*, *Gropa* Dimitr-i, Andreja *arbnesh*-i, Stepa *Dona* dhe kroatët, përkatësisht raguzasit, Strezo *Stepin*-i e *Pava* Peterdan-i, e ndoshta edhe Jela Struna(?)[200] e Lazar Rajko; në katundin Modri Potok, (= Lagja e sotme *Mudripotok* e Marecit) jetonin edhe banorët: Petri *Gjergj*-i, thjeshtër i Berin-it, i vëlla i Petr-it, Nina, i bir i *Gjinovac*-it, *Gjon*-i, i bir i majstorit, Nina, i bir i *Gjon*-it, Marko, i bir i *Nik*-ut, Ilja, i bir i *Mill*-it, *Gjon* Belica dhe Pava *Gjonko* që duket se është një shembull bindës i bashkëjetesës dhe i bashkëshkrirjes shqiptare-raguzase. Duket se gjurmë raguzase në antroponiminë e banorëve të Kosovës së fundshe-kullit 15 kemi edhe tek emri në trajtën deminutive *Stipe* për Stepan, Stefan (khs. banorin *Stipa* Kallogjeriq të katundit, përkatësisht lagjes

[197] Prof. Dr. Iljaz Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566/74, në Vjetar 31-32 i Arkivit të Kosovës, Prishtinë 2004, f. 103.

[198] I. Rexha., Regjistrimi..., f. 98.

[199] I. Rexha., Regjistrimi..., f. 99.

[200] I. Rexha., Regjistrimi. .., fq 100. Duket se ka aryse të besohet që ky Lazar Rajko do të ketë qenë në lidhje farefisërore me atë Rajko-n që ishte pronar i pusit të minierës të quajtur *Raichouo cholo*, në lagjen e sotme Rekekollë të Merecit.

Kllokoq të Marecit në të cilën jetonin edhe banorët: *Nua* Dinisha, Boja, i bir *Leshjan*-it, Nina, i bir i Bojin -it, Dabisha Radoviq) dhe *Stpia*, i bir i *Marin*-it banor i katundt Glami Dolni, përkatësisht Gllama e Poshtme e rrethinave të Gjilanit. Mundësinë që këtu vërtetë të kemi të bëjmë me një mbiemër të sjellënga raguzas do ta përforconte rrethana që menjëherë pas këtij vendbanimi-minierë përmendet edhe vendbanimi tjetër që ishte një pus miniere *Litoça Kolla*, deri tani i paidentifikuar në terren, i cili në vitet 1566-1574 kishte 5 shtëpi.[201] Ka arsye të besohet se edhe tek patronimi *Robiq* (khs. banorin Bojica *Robiq* të katundit, përkatësisht të lagjes Mudripotok të Marecit)[202] kemi të bëjmë me një mbiemër raguzasish ose me një gjurmë onomastike raguzase në këtë hapësirë (më shumë shembuj të bashkëjetesës shqiptare-raguzase sh. më poshtë).

5. SHEMBUJ TË BASHKËJETESËS E TË BASHKËSHKRIRJES RAGUZASE-SHQIPTARE

Një segment i temës së gjerë të pranisë dhe të fatit të raguzasve në qytetet-miniera të Kosovës dhe sidomos në qytetin mesjetar të Novobrdës që deri tani ka mbetur pothuajse i paveneruar nga studiues, është fakti se raguzasit nuk jetonin vetëm në qytetet minira, porse kishte edhe sish që, në kërkim të puseve të reja minierash, ishin vendosur në vendbanime më të vogla. Kjo është arsyeja mbase pse të tillët as që përmenden në dokumentacionin raguzas, sepse i gjithë dokumentacioni i lidhur me raguzasit në Kosovë ka të bëjë pothuajse vetëm me ata që jetonin në Novobërdë, Trepçë, Prishtinë e në Janjevë.

Përkundrazi, ka ndonjë emër vendbanimi në afërsi të drejtpërdrejtë të Novobërdës dhe të ndonjërit bukur larg këtij qyteti mesjetar, të cilët na japin arsye të besojmë se janë emra sllavë të variantit raguzas të kroatishtes. I këtillë duket të jetë emri i katundit *Brisouiza/Brixouiza* që përmendet në Librin e Michael de Lucari-t. Këtë katund dijetari serb M. Diniq e ka identifikuar me malin e quajtur *Brezovica* në territorin e katundit Zajçec të Kamenicës. Ky vend dëshmohet për katund më vete edhe në defterin turk të regjistrimit të kryefamljarëve në fundshekullin 15 me emrin në trajtën *Brezoviça*[203] dhe në atë të viteve 1566-1574 në trajtën *Brezovica.*[204] Tek trajta e dëshmuar në *Libër* kemi të bëjmë me një variant kroat, përkatësisht dalmat (librar?) *briza* "mështekën" bot. Betula verrucosa Ehrh. Nëse këtu kemi të bëjmë vetëm me një variant librar të

[201] Prof. Dr. Iljaz Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës..., f. 85.
[202] I. Rexha., Regjistrimi..., f. 10, 105.
[203] Të cilin I. Rexha, Regjistrimi. f. 98 nuk e ka identifikuar në terren.
[204] S. Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjate shek. XV-XVI, Tiranë, 1983, f. 683.

përshtatur variantit ikavisht të Mihael de Lucari-t apo me një reflektim besnik të shqiptimit lokal të emrit të këtij vendi nuk mund të thuhet asgjë e sigurt. I kësaj natyre është edhe dëshmimi i emrit *Biograd*, përkatësisht i ktetikut *Biogradac* të një borxhliu të M. Lucar-it: *Vlatcho Biogradaz piegi per Gon foxer con stava con Progon* (f. 56). Katundin *Biograd* unë e kam identifikuar në terren me emrin e malit mollak *Beligrati* në hapësirën e katundit Turuçicë (përreth të cilit sot nuk mund të vërehen gjurmë të ndonjë vendbanimi të zhdukur) të krahinës së Gallapit. Në variantin e dëshmuar në gjysmën e parë të shek. 15 përmbahet varianti kroat *bio* i mbiemrit "i bardhë".

Megjithë përputhjen fonematike të emrit *Maroze* (lexo Maroce; khs. emrin e borxhliut *Bossin de Maroze*) dhe *Marouzi* (lexo Marovci; khs. emrin e borxhliut *Dmiter de Marouzi*) që dëshmohen në *Testamentin* e tregtarit raguzas Gostisse Bratoslalich të vitit 1411,[205] me emrin e katundit të sotëm Marvoce të komunës së Medvegjës, mua më duket se këtu kemi të bëjmë me një variant individual të emrit të katundit *Maroeuzi* (sot Marec) se sa me katundin e sotëm të komunës së Medvegjës. Kjo aq më parë pse në këtë regjistër për si borxhli është evidentuar edhe njëfarë *Maroe Ragosaglich* (lexo Maroje Radoslaliq). Në *Librin* e tregtarit tjetër raguzas, Michel de Luchari ndeshet porse edhe varianti *Maroieuzi*[206] (lexo Marojevci). Varianti *Maroeuzi* është zgjerim prapashtesor i antroponimit në trajtën kroate, përkatësisht raguzase *Maroje* (nga Marin) + prapashtesa *-euzi* (lexo *-evci*) dhe emërton kështu pasardhësit e një pararendësi të qajtur *Maroje*. Pikërisht antroponimi në trajtën *Maroje* më duket më i përshtatshmi për t'u zgjeruar me prapashtesën *-evci* nga e cila (trajtë) mund të dalë varianti shqip **Marojevcët* → *Marevcët* → *Marecët* dhe vetëm pas toponimizimit të emrit të vëllazërisë të ketë dalë oikonimi Marec-i. Se me cilën vëllazëri të Marecit ka të bëjë *Maroeuzi* i vitit 1438 është e vështirë të thuhet, sepse në Marec nuk ka sot ndonjë vëllazëri të quajtur *Marec-ët ose *Marecajt. Duket se vëllazëria e *Marojevc*-ësve, nga e cila më vonë e mori emrin i gjithë katundi i madh (Pas Junikut e Jezercit të Ferizajt, Mareci do të ishte katundi i tretë për nga madhësia në Kosovë) i Marecit ose ishte vëllazëri raguzasish, gjë që është e vështirë për t'u besuar sepse nuk ka ndonjë rast që do të tregonte se në koloni raguzasish do të kenë ardhur vëllazëri të tëra raguzasish; fundja, kategoria sociale e fisit dhe e vëllazërisë është specifikë e blegtorëve e jo edhe e banorëve të qyteteve bregdetare romane. Nga ana tjetër, ka arsye të paravendohet se lagja *Marojevci* do të

[205] Sh. M. Dinić, Iz dubrovačkog arhiva, I., f. 28-29.
[206] Po ai, po aty, f. 89.

jetë ngritur përreth ndonjë pusi miniere (vendin e të cilit deri sot nuk e dimë), pronar i të cilit do të ketë qenë ndonjë raguzas i quajtur *Maroje*. Fundja, në të mirë të korrektësisë së këtij paravendimi do të fliste rrethana se në trajtën *Marojefc* ky katnd përmendet edhe në regjistrimin osman të fundshekullit 15. Në dritën e rrethanës së njohur se pjesa dërmuese e raguzsve u tërhoqën pas pushtimit turk të Novobërdës, nuk mund të pritet ndonjë prani e dukshme e raguzasve në këtë katund. Megjithatë, midis 53 kryefamiljarëve të këtij katundi në fundshekullin 15 kishte edhe sish me emra shqiptarë dhe një me emër të gjithkrishter në variantin kroat. Banorë të Marojefcit ishin asokohe edhe: *Gjon* Radoj -i, Marin *Dac*-i, Stepan *Dac*-i, Pavel *Buza*, Stepan *Gjon*-i, Nikola *Gjon*-i, Jovan *Vllas*-i,* Marko *Gjon*-i, emri *Niksha* i bashtinës në dorë të banorëve të fshatit (SG: khs. Nikshnio kollo, përkatësisht Nizhnakollën e sotme) Petri, i bir i *Dac*-it dhe Jovan *Jon*-i.[207] Është për t'u shënuar se emri i këtij katundi në regjistrimin turk të viteve 1566-1574 dëshmohet në trajtën *Marofc*[208] që s'është mbase tjetër veçse një variant i **Majojevci*. Për njeri me emër të variantit raguzas e konsideroj krye-familjarin Marin *Dac*-i, sado që ky antroponim (Marin) dëshmohet për emër i shqiptarëve në Rrafsh të Dukagjinit, por për në këtë pjesë të hapësirës etnolinguistike shqiptare, ky antroponim mund të jetë vetëm i sjellur nga raguzasit. Ky rast, po qe se mund t'i qëndrojë forcës së të vërtetës, sikur do ta dëshmonte një bashkëjetesë midis shqiptarëve e raguzasve të ardhur (sh. edhe më poshtë).

Ky nuk mbetet shembulli i vetëm që dëshmon se raguzasit nuk jetonin vetëm në kështjellën e Novobërdës, porse edhe në katundet e sotme përreth Novobërdës. I kësaj natyre është edhe vetë emri i lagjes *Vakovc*i të Marecit, përballë kështjellës së Novobërdës. Ky emër është pas gjithë gjasësh trajtë raguzase *Vaca*, *Vacoe* e antroponimit që në Perëndimin katolik dëshmohet në trajtën *Bac* (lexo: Bak). Ky antroponim është dëshmuar në një mbishkrim në qytetin Burnum (Itali) të kohës së sundimit romak në trajtën *Baculus* (sh. CIL III 2830); në vitet 1003 e 1144 është dëshmuar si *Baculi*, *Bacula.*[209] Për prejardhjen latine të kryehershme të këtij antroponimi do të fliste edhe përdorimi i këtij emri

* Që mbase mund të lidhet me lagjen Vllasi, përkatësisht vëllazërinë shqiptare, të quajtur Vllasalitë, përballë kështjellës së Novobërdës.

[207] I. Rexha., si më poshtë, f. 75.

[208] Khs. I. Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut tlë Vushtrrisë të vitit 1566/74, në Vjetar 31-32 i Arkivit të Kosovës, Prishtinë 2004, f. 104.

[209] Khs. C. Jireček, Die Romanen in den Städten Dalmatiens..., f. 146.

tek francezët në trajtat *Bacchus* e *Bacones*.[210] Në Ballkan ky emër dëshmohet tek rumunët si mbiemër familjar në trajtat *Vacula* e *Vaculeşti*. N. A. Constantinescu[211] beson se trajta rumune e këtij emri vjen nga greqishtja Βάκχος. Më pak e besueshme më duket mundësia e lidhjes së këtij emri me variantin *Vako* të cilin G. Weigand (përkrah trajtave *Vaco*, *Vačo* e *Valjo*) e sheh për trajtë të shkurtër bullgare të emrit Vъsil.[212] Prejardhjen antroponimike të këtij emri do ta dëshmonte edhe mikrotoponimi ekzistues *Lama e Vakut* të këtij katundi. Një dëshmi të qenies në përdorim të antroponimit *Vak* e kemi për në katundin Velegllavë, ku jetoi Vak *Loti*, i njohur në historinë më të re të Kosovës për pjesëmarrje dhe drejtim të një përleshjeje me forcat serbe në malin e quajtur Kika. Nga ana tjetër, një banor (i quajtur Zahir) i vëllazërisë së Shinajve të këtij katundi njihej në rrethin e tij pothuajse vetëm me ofiçin *Bakë*, ashtu sikundër një pjesëtar i vëllazërisë së Makollëve fqinj njihej vetëm me ofiçin *Hut* i cili (ofiç), më parë se me emrin shqip *hut* të shpendit, mund të lidhet me ofiçin nomen professionis *hutman* të mesjetës së vonë.

Njëri ndër mbiemra të sjellë në këto anë nga raguzas, qendër banimi e të cilëve nuk ishte mbase vetëm kështjella e Novobërdës, porse edhe katunde përreth, mund të jetë edhe mbiemri *Buliq* nga i cili mund të ketë dalur emri i lagjes *Bullovit* i Marecit. Edhe ky antroponim është dëshmuar në fundshekullin 15 në afërsi të drejtpërdrejtë të qytetit të Novobërdës dhe pikërisht në Mahallën e pop *Shinçiq*-it që s'mund të jetë tjetër veçse vëllazëria e *Shinajve* të Vakovcit, krejt afër lagjes së Bullajve të Marecit, ku (në fundshekullin 15) dëshmohet banori i quajtur Nikola *Buliko*. Një dëshmi tjetër të këtij antroponimi e ndeshim edhe në katundin e paidentifikuar Binest Kuça (khs. emrin Cërvenica të dëshmuar në v. 1455 për një pjesë të katundit të sotëm Halabak/Radashevc të komunës së Podujevës) i cili përmendet bashkë me katundet e sotme Makovc dhe Radashefc të Prishtinës. Banor i këtij katundi ishte edhe njëfarë Matko *Buliq*. Banorë të tjerë të këtij katundi ishin edhe: Dimitri *Alshiq*-i; Stepiq Burin-i; *Matko Buliq*;* Buça Nikoliq-i; Petri *Jozin*-i; Jovan *Jozin*-i; Nikola *Jozin*-i; Stepan Bisaliq-i; Daba Nikaliq-i; Petri Dabalin-i; Ilsha Petliq-i; Lazar Buçin-i; *Gjon* Stepan-i; Raja Buqin-i; popi Bogosav; bashtina Jovan Vllajiq; Vuk-u, i bir i pop-it; Gjura Vllah dhe Bashtina

[210] Khs. A. Dauzat-Ch. Rausting, Dictionnaire de noms de famille et prénoms de France, Paris, pa vit të botimit, f. 44.

[211] Khs. Dicţionar onomastic romînesc, Bucarest 1968, f. 166.

[212] Prof. Dr. Gustav Weigand: Die bulgarischen Rufnamen, Ihre Herkunft, Kürzungen und Neubildungen, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache (Rumänisches Seminar), 15/1909, f. 112.

* I. Rexha, Regjistrimi…, f. 105 e ka transliteruar këtë emër si *Toliq*.

Jako, në dorë të Puka-s?.[213] Mbiemrin *Buliq* të banorit Matko e gjejmë të ruajtur deri në ditë tonat tek emri i mahallës/vëllazërisë *Bulliqët*, përkatësisht *Bullovit* të Marecit. Sado që unë nuk kam zotësi të propozoj ndonjë zgjidhje për prejardhjen e këtij emri, kujtoj ky emër nuk mund të ketë ndonjë lidhje etimologjie me fjalën turke *bula* "zonjë turke" me të cilën dijetari bullgar Boris Simeonov[214] i sqaronte emrat e vendeve *Bùlin dol*, *Bùlin kàmik*, *Bùlin klàdenec*, *Bùlina padina*, *Bùlinska bàra*, *Bùlinsko ljicè* dhe *Bùlov kàmik* të qarkut Godečko.

Po ky mbiemër dëshmohet edhe në lagjen *Dollna Mahalla* të qytetit të Janjevës: *Shahin Bulic*. Banorë të tjerë të kësaj mahalle ishin edhe: Noka Radiq-i; Buçko Marin-i; Buçko Marin-i, tjetër; Boja Dujk-u; pop Dimitr-i; Vuk Buçin-i; Gjuka Berat-i;* Boja, i bir i Domaniq-it; Kola *Progon*-i; Bozha *Prenko*; Marko Maljin-i; Daba, i bir i Vllah-ut; Buçko vllah-u; Ilja, dhëndërr i popit; Vido *Lujiq*; Mojsi Atanas-i dhe Koja, i bir pop Radic-ës.[215]

Me këtë antroponim ka lidhje mbase edhe emri *Bulice, Buliqe* i një minierëze, e cila bashkë edhe me dy të tjera: *Plavice* e *Rim* për si reparte të minierës së Novobërdës përmenden në ligjin turk për minierat në vitin 1488. Minierëzën *Bulice* S. Rizaj e kishte identifikuar gabimisht me katundin e sotëm Bolevc të rrethinave të Kamenicës, ashtu si edhe minierëzën *Rim* me katundin e sotëm Rimanishtë të Prishtinës. Unë kujtoj se minierëza *Bulice* duhet të identifikohet me lagjen *Bullajt*, përkatësisht Bullovit - të katundit të Marecit, në të cilën ka edhe një mikrotoponim *Samakova* "vend me mbeturina mineralesh të shkrira". Për minierëzën *Rim* i bashkohem mendimit të J. Osmanit[216] sipas të cilit kjo duhet kërkuar në vijën e rrjedhës së ujit që çon në vendin *Rapuha* të katundit Krilevë, fqinj të Marecit, ku edhe sot po ekzistuaka mikrotoponimi *Stanet e Rimit*, ndërsa *Pllavica* duhet të identifikohet me kompleksin homonim të një pjese të Novobërdës së sotme.

Me kontinuitet të pandërprerë onomastik-territorial kemi të bëjmë edhe në rastin e mbiemrit familjar *Alshiq* të banorit të katundit Radashevc (khs. më lart), sepse emrin Alshiqe e mban edhe sot një lagje dhe një rrjedhë uji e këtij katundi.

Për gjurmë të drejtpërdrejtë raguzase duhet parë edhe emri i lagjes Nizhnakollë për të cilin dhe nga vetë *Libri* mësohet se kishte qenë

[213] I. Rexha., Regjistrimi..., f. 65,105-108.
[214] Etimologičen rečnik na mestnite nazvanija ot Godečko, Sofija, 1966, f. 130-131.
* I. Rexha e ka transliteruar këtë emër si *Berrat*.
[215] I. Rexha, Po aty, f. 122.
[216] Venbanimet e Kosovës, 1, Prishtina, Kastrioti dhe Fushë-Kosova, Prishtinë, 2003, 160.

shkrietore, pronë e raguzasit *Nichxa de Bascha* (lexo Niksha e Baska) tek i cili në gjysmën e dytë shek. të 15 njëfarë *Milos Dragolich* i Novobërdës e lente peng shkrijetoren e vet.[217]

Nuk është mbase larg medsh që edhe emri i vendit mineralor Drashnje përkatësisht Çuka e Drashnjes të jetë në lidhje me emrin e një pusi miniere, pronar i së cilës do të ketë qenë në krye të herës ndonjë raguzas i quajtur **Drasin*. Një dëshmi të këtij antroponimi në funskion patronimi *Drasiniq* e kemi tek raguzasi i quajtur *Dobrasini Drasinich* i qytetit të Novobërdës, i cili përmendet në një kontest me një bashkëvendës të tij në Novobërdë në vitin 1415[218] si edhe tek patrici raguzas Dragoe *Drasenouich* i po këtij qyteti, i cili përmendet gjatë viteve 1445- 1448.[219]

Në dritën e të dhënave të mësipërme ka arsye të besohet që raguzasit të ketë lënë edhe ndonjë gjurmë në emërtime vendbanimesh. Për të këtillë i konsideroj emrat *Strezovc* që ishte pronë e një delmati (khs. më lart). Ky emër vendbanimi duket të jetë i pandashëm nga atroponimi *Strez, Strezoje* që është katakteristik për brigjet e Adriatikut.

Me shumë gjasë që nuk po propozoj diçka të vështirë për t'u pranuar, kujtoj me prejardhje antroponimike nga një emër që e bartnin raguzasit mund të rrjedh edhe emri *Krilevë*/Krilevo i rrethinës së Novobërdës i cili do të mund të jetë formuar nga antroponimi sllav *Kril-* i raguzasve, i zgjeruar me prapashtesën posesive sllave *-evo* "i, e Kril-it, e pasardhësve të Kril-it". E vetmja dëshmi e këtij emri për në hapësirën e Kosovës rrjedh nga viti 1458 kur midis qytetarëve të kolonisë raguzase të Janjevës përmendet i akuzuari *Radislav Krilo.*[220]

Një çështje me rëndësi jo vetëm për temën që është shtruar në këtë punim, porse edhe për historinë e krahinës së Gallapit në mesjetën e vonë është edhe bashkëjetesa e mundshme e shqiptarëve dhe e raguzasve, përkatësisht mundësia e shqiptarizimit të pjesërishëm të kësaj shtrese të të ardhurish. Të dhëna përkitazi me këtë temë nuk ofrojnë dokumentet raguzase, sepse ato kanë të bëjnë kryesisht me çështje juridike, përkatësisht me konteste midis shtetasve raguzas që vepronin në qytete të Kosovës.

---

[217] sipas Atanasije Urošević, Neki detalji iz prošlosti Kosova, Onomatološki prilozi I, Beograd 1979, f. 29.

[218] Sipas Dr. Muhamet Tërnava, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV - XVI, Prishtinë, 1995, f. 287.

[219] Khs. Momir Jović, Dubrovačka vlastela..., 237.

[220] Nikola Čolak-Ive Mažuran: *Janjevo*, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 29.

Mirëpo dëshmia sipas së cilës njëfarë *Lesh*-i, ishte kumbar i një raguzasi, e tregon mbase mjaft mirë bashkëjetesën e mundshme midis kosovarëve vendës dhe raguzasve të ardhur. Material të kësaj natyre ofron për këtë hapësirë defteri i regjistrimt të popullsisë i kazasë së Novobërdës i fundshekullit 15, i përgatitur për shyp nga orientalisti kosovar Iljaz Rexha.

Duke qenë se është fort e vështirë, për të mos thënë e pamundshme, që përbrenda një formacioni shtetëror serb moto politike e të cilit që nga ngulitja me dhunë në Ballkan ka qenë fillimisht shkatërrimi i gjithçkafes së krishterë e më vonë serbizimi e ortodoksizmi i gjithçkafes që merr frymë ndryshe, të përcaktohet përkatësia etnike e njerëzve mbi bazën e prejardhjes gjuhësore të antroponimeve dhe sidomos e atyre banorëve që mbajnë emra të gjithkreshtë, për ktiter bazë të konsiderimit për kroatë, përkatësisht për raguzas do të merren vetëm ata individë të cilët mbanin antrponime në trajta karakteristike për kroatishten.

Një trajtë tipike kroate është, sipas mendimit tim, *Tuna* nga *Antun* e emrit të gjithkrishter *Antoinius*. Kjo trajtë kroate dëshmohet, jo rastësisht, kryesisht në vendbanime afër ose jo larg vendeve në disa nga të cilat është dëshmuar se ka pasur puse minierash të vogla. Më poshtë po i sjellim të gjithë shembujt e dëshmimit të këtij antroponimi (edhe në funksione patronimi e toponimi) që në kazanë e Novobërdës dëshmohen në fundshekullin 15. Kështu, në mahallët e kallogjer Gliqor-it, të Pop Haralijes; të Pop Vllatko-s (në këtë lagje jetonte edhe banori *Gjon* mesar "mishshitës"); në mahallën *Shashka crkva* të qytetit të Novobërdës jetonin banorët: *Tuna* i bir i Jovan -it; *Tunisha*, i bir i Zoja-s; Jova *Tuna* e *Tuna*, i bir i Jovan-it (këtu jetonin edhe banorët *Gjon*-i i bir i Marko-s dhe Pop *Dom* Nikolla); në katundin Mozgova me manastirin e tij Sveti Nikola jetonte edhe banori Jovan-i, i bir i *Tuna*-s; në katundet Dobërçan (këtu jetonin edhe banorët *Prena* Radica, *Gjon*-i, i bir i Vasil-it e *Mazko* Jovan-i) ishte banori Raja, i bir i *Tuna*-s; një bashtinë në katundin Vërbicë quhej Bashtina *Tuna*; në katundin Dejakofca (unë mendoj se kemi të bëjmë me katundin e sotëm Dajkovc) ku jetonte edhe familja ardhëse vllahe e *Brakul* Prishliq-it, ishte banori Jovan *Tuna*; në katundin *Arbanash* që, sipas I. Rexhës,[221] do të ketë qenë në arealin e katundit të sotëm Zebincë të komunës së Novobërdës, përkrah banorëve: Dabo, i bir i *Gjin*-it; Andreja, i bir i *Gegiq*-it; Lazar *Gjin*-i; Nina, i bir i *Gjergj*-it: *Pjak-a*, i bir i Vukç-it; *Lesha* Dabiq-i, rrobaqepës, Pop *Dom Zota* ku ishte edhe një bashtinë e quajtur Bashtina *Gjon*-i, jetonte edhe banori *Tuna*, i bir i Dimitr-it; në katundin e paidentifikuar Ostrovic ishte bashtina e

[221] Khs. Regjistrimi..., f. 107

quajtur *Tuniq*. Këtë trajtë kroate e ndeshim edhe në defterin turk të registrimit të kryefamiljarëve të territorit të Vuk Brankoviqit të vitit 1455, kur është shënuar se njëri nga tre murgjërit e kishës së lënë shkret e sot të panjohur të Shën Kollit (në origj. Sveti Nikola) që ishte në nahijen e Llapit, quhej *Antun* dhe kur në katundin Llapnasellë është regjistruar edhe banori Nikola *Hrvatï*.[222] Me prejardhje dalmate, romane do të jetë edhe mbiemri **Pepone* të cilin në fundshekullin 15 e mbante banori Marko, i bir i *Pepush*-it i mahallës *Arbanas* të qytetit të Janjevës dhe pronari me mbiemrin *Piponoviq* i një bashtine në katundin Medejovça, përkatësisht sot Medvegjë, të krahinës së Gallapit.[223]

Një shembull më vete të bashkëjetesës shqiptare-raguzase e paraqet antroponimia e disa banorëve të katundit Tullar të Medvexhës në të cilin, përkrah kryefamiljarëve me antroponime shqipe si *Gjergj Gjon*-i, *Dimitri Gjon*-i, *Marko Gjon*-i (që nuk ishin vëllezër) e Bogdan *Gjinkala*, jetonin edhe kryefamiljarët *Tuna*, i vëlla i *Tuna*-s (sic!); Ulik *Ivan Tunko*; *Tuna Ivanish* -i dhe Nina *Tunash*; një banor tjetër i quajtur Nina *Tunash*-i ishte banor i katundit të paidentifikuar *Patin*. E këtillë ishte gjendja edhe në katundin Bushkova Petrili, që do të ketë qenë ndonjëra nga lagjet e katundit *Petrilë* të Medvexhës. Në këtë katund, përkrah banorëve Radic *Likoviq*-i; Mark *Leshiq*-i e Mark *Gjona*, të cilët kanë antroponim apo patronim shqip, jetonin edhe banorët *Pava* Radic; Niko, i vëlla i *Barl*-it; *Stepa Nishiq*; *Tuna Matko*; *Anta Bogdan*; *Raja Antoniq* e *Petri Antoniq* të cilët s'ka dyshim se mbanin antroponime në trajta kroate të tyre dhe ajo në një pjesë të katundit Gubavac (sot shqip Gubavc) të Medvegjës në të cilin përkrah banorëve me antroponime apo patronime kroate si: *Tuna*, i vëlla i Raja-s; *Tuna Donko* e *Vinko Vuçko* jetonte edhe kryefamiljari *Niko Gjergj* -i; në katundin e paidentifikuar Raka, ku ndër të tjerë, jetonin edhe shqiptari Mihal *Gjon*-i e kroati *Tuna*, skamnor; në katundin e paidentifikuar Vukojovça të nahijes Morava, në të cilin ishte edhe manastiri i quajtur Nikolla, përkrah banorëve *Gjon* skamnori, Bozhidar *Gjon*-i; Nikolla *Gjon*-i ; *Jak-o Gjik* -a e Nina *Prenk*-u?, jetonte edhe kryefamiljari *Jozin Gjon*-i; në katundin e paidentifikuar Bellaniq jetonin kryefamiljarët Radic *Gjona* e *Tuna* Kostandin-i dhe Nikolla *Tuna*.[224] Një bashkëjetesë midis shqiptarëve, raguasve e sasëve vërtetohet edhe në katundin Letnicë. Në fundshekullin 15, përkatësisht një shekull më vonë, në këtë katund jetonin edhe Stepa *Man*-ko; Novic *Tomino*; *Dimino* (Diminko) Stojan-i; *Gjin* Pepa; Dujko Petr*u*; Andreja *Gjin* -i; Jako *Pep*-a; Pavel *Gjin*-i; në një

[222] Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455. godine, Sarajevo, 1772, 216, 266.
[223] Sh. I. Rexha, Regjistrimi..., f. 121, 147, 148.
[224] Po ai, po aty, f. 146.

vendbanim, emri i të cilit është shënuar si *Latnic*, jetonin: *Tunislav* Jak-o; Dejan *Gjon*-a; Spana, e vejë, ndërsa në pjesën qendrore të katundit të shënuar si Katundi Pazar Letnica jetonin kryefamiljarët Jovan *Binço*; Nikola Milk-o; Andreja *Pav*-a; Jovan Bogdan-i; Mil-i, skamnor; Nikolla Jovan-i; Gjura *Matosh*-i; Oliver-i, skamnor; Jovan Jak-o; Jaksh-a, skamnor; Jovan Bogdan-i; Stojan Dimitr-i; *Gjon* Andreja; Marin Petr-i; Dimitri Marko; Deriçko, skamnor; *Tuna*, skamnor; Voja *Tudesh*-i; Marko, skamnor; Marko Pejan-i; Jovan Oliver-i; *Gjon Lik*-a; Leshjana, e vejë; Gjurko Kolbarda; Radonja Ivan-i; Nina Miloviq-i; Dimitri *Lik-a*; Jovan Milkoviq-i; Vuk Jovan-i; Gjura *Gjo-i*; Leshjan *Pavino*; Noka Pavl-i; Voja *Pavish*-a; Jovan Ulik-a, Nokila Manko; Jaksha Petr-i; Koja, i vëlla i Gjuko-s; Leshjana, e vejë; *Bilja*, e vejë; Vida, e vejë. Rishtazi të regjistruar: Nikola Petr-i, Mana, e vejë,[225] Në katundin e paidefitikuar Zhipa, banorët e të cilit mbanin pothuaj të gjithë antroponime shqipe, ishte edhe një kryefamiljar i qajtur Nikola *Tun*-in; në katundin e paidentifikuar *Gostoshiç*, ku jetonin kryefamiljarë shqiptarë e vlleh: Dimitri *Dançul*-i e Jovan *Danqul*-i; *Gjon*, skamnori e Dimitri *Perlesha* ishte edhe *Tuna* Stepan-i; në katundin Dolna Zhegra (sot Zhegër) përkrah kryefamiljarëve Radic *Gjon*-i; *Noksha Buzak*-iq; *Gjon* Bogdan-i; Nikolla e Andreja *Gjergj-i*; jetonte edhe banori Jak-o, i vëlla i *Tuna*-s.[226] Se këtu kemi të bëjmë me variantin kroat Tuna (nga Antun) të antroponimit *Antonius*, *Anton* të kishës së ritit roman e tregon dëshmimi në fundshekullin 15 i variantit tipik shqiptar *Nue*, përkatësisht *Ndue* i këtij antroponimi në katundin Kllokoq (lagjja e sotme Kllokoq e Marecit: khs. emrin e kryefamiljarit *Nua* Diminsha); në katundin e paidentifikuar *Mizka*: khs. emrin e kryefamiljarit *Nua* Petr-i Tanjiq); Golemi Gllama "Gllama e Madhe" në rrethina të Gjilanit (khs. kryefamiljarin *Nua*, bir i Marin-it) dhe në katundin, po ashtu të paidentifikuar ende *Petrizani* (khs. emrin e kryefamiljarit *Nua*, i vëlla i Andreja Gjurin-it).[227] Në krahinat e Gallapit e të Karadakut ky antroponim dëshmohet shumë shpesh edhe në regjistrimin osman të kryefamiljarëve në vitet 1566-1574.[228] Dëshmimi i kësaj trajte karakteristike shqiptare të antroponimit Anton(ius) të kishës katolike e hap domosdo çështjen nëse shqiptarët e hapësirës etnosin-

[225] Po ai, po aty, f. 144, 145, 156

[226] Sh. I. Rexha, Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës sipas defterit të fundshekullit 15, Vjetar 27-28 i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë, 2002, f. 64, 66, 68, 87, 90, 100, 107, 142, 143, 144, 147, 148, 152, 156, 160, 161.

[227] Khs. I Rexha, Regjistrimi., f. 101, 102, 107,117.

[228] Khs. për këtë shembujt tek Prof. Dr. Iljaz Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut tlë Vushtrrisë të vitit 1566/74, në Vjetar 31-32 i Arkivit të Kosovës, Prishtinë, 2004.

guistike shqiptare të Gallapit e të Karadakut i përkisnin ritit katolik të krishterimit. Në favor të kësaj flet shumë qartazi pikërisht trajta e këtij antroponimi. Duke qenë temë më vete, kjo çështje është trajtuar në një punim të veçantë.[229]

Me një shembull të pranisë edhe në fund të shek. 15 të individëve bartës të emrave të gjithkrishterë në variantin kroat të tyre kemi të bëjmë edhe me variantin kroat *Stipe* të antroponimit të gjithkrishterë Stefan khs.: Bozhidar *Stipa*, banor i katundit të paidentifikuar *Miholinci i Madh* që në fundshekullin 15 i takonte nahijes së Kremenatës (sot katund i komunës së Kamenicës) dhe *Stipa* Kalogjeriq, banor i lagjes Kllokoq të Marecit, gjë që lejon të paravendohet se këtu kemi të bëjmë me dalmatë, përkatësisht me raguzas folës të variantit dalmat të kroatishtës, përkatësisht të dialektit ikavisht të kësaj gjuhe. Përveç kësaj, përkatësia etnike e gjuhësore kroate e raguzasve sikur dëshmohet qartë edhe mbi bazën e dëshmimit të trajtës tipike për kroatishten *Jozo* të antroponimit të gjithkrishter *Josef*: khs. Petri, i bir i *Jozaniq* -it në katundin Krilevë afër Novobërdës; *Jozan* Kidiq-i banor i katundit të paidentifikuar *Polana*, i nahijes Bana, ku binin edhe katundet e sotme Vllasë dhe Gugullovc të Kamenicës[230] dhe kryefamiljarët Petri *Jozin*-i, Jovan *Jozin*-i, e Nikolla *Jozin*-i të katundit Binest Kuça (mbase kemi të bëjmë me katundin ende të paidentifikuar Kuçiq, Kuçi të periferisë së Novobedës) - shembuj që mbase e tregojnë edhe një bashkëjetesë të raguzasve e të shqiptarëve. Bën të theksohet në këtë mes se trajta raguzase/kroate *Jozo* (deminutiv i trajtës kroate *Josip*), përkatësisht shq. *Jozë* në vend të trajtës tipike shqiptare *Zef* ndeshet vetëm tek shqiptarët e besimit të krishter të ritit katolik në komunën e Vitisë. Nëse këtu kemi të bëjmë me gjurmë të raguzasve/kroatëve të shqiptarizuar apo të shqiptarëve të kroatizuar është një çështje që duhet gjurmuar veçmas. Sido që të jetë, për mua mbetet për t'u sqaruar përse raguzasit kroatë u ruajtën në Janjevë, Letnicë, Vërnakollë, Shashar, jo porse edhe në Novobërdë, Trepçë, Bellosicë, Prishtinë, Pejë, Prizren e dikund tjetër. Këtu shtrohet pyetja nëse ka mundësi që disa raguzas - sidomos sish nga ata që nuk i përkisnin shtresës së patricëve dhe që - pas pushtimit osman - nuk u rikthyen në atdheun e tyre të kryehershëm, të jenë shqiptarizuar. Kjo ka të bëjë në rend të parë ndoshta me *Maroeueuzi*-t (Marojevci-t) e Marecit të sotëm. Ka shumë mundësi që një rast të mundshëm të serbizimit të raguzasve e paraqet emri *Popolanët* i një vëllazërie serbe, përkatësisht i një

[229*] Khs. për këtë punmin tim në dorëshkrim Kishat, manastiret, priftërinjtë, murgjët, qytetet e konfesionet e kosovarëve në shekujt 13-15.

[230] Khs. I. Rexha, Regjistrimi…, f. 96, 101, 113, 131.

vendbanimi të vogël në veriperëndim të Kamenicës që në fundshekullin 15 dëshmohej për katund më vete i quajtur *Popovca*,[231] popullata e sotme e të cilit (katund),[232] e mban veten për të përkatësisë etnike serbe. Kjo sepse ky emër rrjedh padyshim nga apelativi roman, përkatësisht dalmat i sferës së jurisprudencës raguzase *popolani* "qytetar; pjesëtar i shtresës qytetare, kryetar i gjyqeve raguzase" dhe është një korelat semantik i nocionit gjerman, sas *Burger*.[233] Këtë tezë do ta përforconte edhe rrethana jashtëgjuhësore se këtu kemi të bëjmë me banorë të një vendbanimi në rrethina të minierës së Strezovcit që, nga njëra anë, një kohë kishte qenë pronë e një raguzasi dhe, nga ana tjetër, një raguzas e kishe në këtë vendbanim edhe një bashtinë të veten.

Në këtë mes do të duhej të shihej mundësia në mos i ngjashëm për nga kuptimi "popolanë" mund të jetë edhe emri që sot dëgjohet si *Popovlan*, afër katundit Mushtisht të Suharekës. Mua më duket e vështirë të besohet që emri i këtij katundi të ketë lidhje me nocionin *pop* "prift" të serbishtes, sepse në këtë rast ai do të duhej të formohej me prapashtesën *-ovci.*

Sado që nuk e ndjej veten kompetent për ta gjykuar kohën e përfundimit të sllavizimit, përkatësisht të kroatizimit të romanëve të Raguzës, ma merr mendja se vetëm raguzasit mund të jenë ata që në hapësirën etnolinguistike të krahinave të Gallapit e të Karadakut të Shkupit do ta kenë sjellur edhe antroponimin në trajtën italiane të tij *Gjovan*. Po qe se ky paravendim mund të qëndrojë, atëherë do të mund të thuhej pa shumë droe për të rrëshqitur në rrafshin e nxjerrjes së ndonjë përfundimi jashtëgjuhësor të paqëndrueshëm, se raguzas kishte edhe në katundet e paidentifikuara Hankovc e Treboshina (khs. emrat e kryefamiljarëve: *Gjovan* Jorg-ini e *Gjovan* Gjuk-a); në mahallën *Arbanash* të qytetit të Janjevës (khs. emrat e kryefamiljarëve: *Gjovan*-i, i bir i *Kaçap*-it dhe *Pac*-a, i bir i *Gjovan*-it); në katundin Grashticë të Prishtinës, në të cilin është topogërnmadha Gjyteti (khs. kryefamiljarin Vida *Gjovan*-i); në katundin e paidentifikuar *Patin* (khs. emrin e kryefamiljarit Jovan *Gjovan*-i); në katundin Shillovë të Gjilanit (khs. patronimin *Gjovan*-i të kryefamiljarit Gjura); në katundin sot të panjohur me emrin *Jastrepc* (khs. emrin e bashkëpronarit *Gjovan* të mukatasë së Mihonicës); në katundin e paiden-

[231] Po ai, po aty, f. 81.

[232] Kjo sepse një katund i banuar në krye të herës nga serbë, i quajtur Popolan, është edhe në komunën e Suharekës. Tradita thotë se banorët serbë paskan ardhur në këtë katund nga katundi Mogillë i komunës së Vitisë. Ky katund po u përmendka që nga viti 1465. J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës. 4, Theranda, Prishtinë. 2003, f. 115.

[233] Sh për këtë punimin tim Bashkëjetesa sase-shqiptare...

tifikuar Vitli Gaça (khs. emrin e pronarit *Gjovan* të bashtinës Destan dhe kryefamiljarin Stepa, i bir i *Gjovan*-it të atij katundi).[234]

Mbase nuk ka shumë arsye të dyshohet se emra, përkatësisht patronime tipike kroate mbanin edhe banorët Vido *Lujiq* i Lagjes së Poshtme (në origj. Dolna Mahala) të qytetit të Janjevës dhe pronari *Mihonica* i mukatasë* në katundin e paidentifikuar Jastrepc/Jastrebac (khs. më lart). Varianti kroat *Miho* është ruajtur ndër shqiptarë të hapësirës së krahinave të Llapit, Gallapit e të Karadakut vetëm si emër femëror *Mihane*.

Mbi bazën e rrjedhave historike, përkatësisht të rrethanës se, vështruar në pikëshikimin gjeografik, ka një ndërprerje territoriale të shtrirjes së elementit katolik shqiptar nga hapësira e Arbanonit mesjetar që përfundonte me rrethinën e Prizenit dhe larg-larg deri në Klinë, duhet të konstatohet se elementi katolik shqiptar i gjithë Malësisë së Karadakut paraqet si njëlloj *oaze katolike* shqiptare. Kjo sepse në hapësirën nga qyteza e Klinës e deri në rrethina të afërta të Vitisë dhe nga aty e deri në rrethina të Shkupit e në gjithë hapësirën e Luginës së Preshevës, të Maqedonisë Perëndimore dhe deri në rrethina të Prizrenit nuk ka shqiptarë të krishterë të ritit roman. Arsyet përse elementi katolik raguzas, përkatësisht kroat e sas u ruajt në vendbanime të komunës së sotme të Vitisë duhen parë mbase tek rrethana e pushtimit turk që heret të Novobërdës, kryeqendrës koloniale të raguzasve e të sasëve. Për pasojë, qendrat më të vogla, më pak të rëndësishme se Novobërda e pasur raguzase e sase katolike, si Janjeva e Vitia, përkatësisht vendbanimet si Letnica, Vërnezi, Vërnakolla, Shashari vazhduan të gjallojnë, sepse popullata raguzase e sase e këtyre kolonive nuk i braktisi vendbanimet e saj, siç vepruan bashkatdhetarët e tyre të Novobërdës me rrethinë, të Trepçës e të Bellosicës (Murgullës), [në mahallën Pop Cvetko me 21 shtëpi, 12 beqarë dhe një e vejë të së cilës jetonin në vitet 1566/1574 edhe banorët mbase delmatë/kroatë *Nova Puqoriq* (Pucoriq), *Nikola Nova*, *Nikola Stipiq*, *Leshjan Stipiq*, *Jovan Stipiq* dhe *Avram Stipiq*.][235] të Prishtinës e të Vushtrrisë dhe të qyteteve të Rrafshit të Dukagjinit, porse,- duke qenë njësi kompakte etnike e fetare- mbetën të jetojnë në ngulimet e tyre dhe ta ndjejnë veten për kroatë deri edhe në ditë tona. Kjo e vërtetë sqarohet bindshëm edhe nga K. Jireček i cili vërente se sasët nuk ishin shumë në numër dhe se këta ishin ardhur e ishin vendosur në të njëjtat koloni me raguzasit dhe pjesërisht edhe u shpërngulën bashkë me këta të fundit dhe se duke qenë

[234] Khs..I. Rexha, Regjistrimi..., f. 88, 98, 99, 109, 119, 121, 138.

* Tokë apo pronë tjetër e patundshme që për kohë të gjatë merrej me qira minimale vjetore.

[235] Khs. I. Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut tlë Vushtrrisë të vitit 1566/74, në Vjetar 31-32 i Arkivit të Kosovës, Prishtinë, 2004, f. 53.

katolikë edhe këta - si edhe raguzasit - përmes martesash u shkrinë së shpejti në popullsinë katolike raguzase nëpër tregje.* Ruajtja deri në ditë tonat e identitetit nacional kroat të banorëve të Letnicës, Shasharit, Vërnezit, Vërnakollës e pjesërisht të Vitisë e vë në pikëpyetje ekzistimin në këtë hapësirë të shqiptarëve katolikë si popullatë shumicë nga e cila, kështu mund të paravendohet për rrethana të mesjetës së vonë, do të pritej ta absorbonte elementin raguzas, po ashtu katolik. E njëjta gjë do të pritej, sikur kjo pjesë e hapësirës etnlinguistike të shqiptarëve të ishte e banuar me shumicë nga serbët, kisha e shteti i të cilëve do t'i ortodoksizonte e serbizonte pjesëtarët e këtyre kolonive raguzase.

Me përjashtim të banorëve kroatë të ritit katolik të Binçës, të cilët i konsideronte për serbë ortodoksë, përkatësinë e ritit katolik të banorëve të katundeve Shashar, Vërnez, Vërnakollë e Letnicë (të cilët ky porse, konform idesë së pansllavizmit dhe anësisë së tij për idenë e Serbisë së Madhe, i mbante për serbë), si dhe të atyre të Stubllës nuk e mohonte madje as konzulli rus Ivan Jastrebov. Sipas shënimeve të mbledhura në terren nga ky vetë në vitin 1885 në Binçë paska pasur 45 shtëpi serbësh ortodoksë dhe 12 shtëpi shqiptarësh (këta qenkan fandë të ardhur para 20 vitesh d.m.th. 1865 nga rrethi i Gjakovës); në Shashar paska pasur 30 shtëpi "serbësh" të besimit katolik; në Vërnez: 40 shtëpi serbësh të besimit katolik; në katundin Stubëll 60 shtëpi shqiptarësh katolikë; në katundin Vërnakollë 40 shtëpi shqiptarësh katolikë dhe në katundin Letnicë 40 shtëpi "serbësh" të besimit katolik.[236]

Rrethana e ruajtjes së identitetit nacional kroat e lejon paravendimin që në këto koloni do të jetë folur pa ndërprerje dalmatishtja, përkatësisht kroatishtja - rrethanë kjo që e nënkupton edhe të vërtetën se gjuhë e liturgjisë në këto koloni nuk mund të ketë qenë shqipja, porse kroatishtja. Kjo shihet mbase bukur qartë edhe nga fërkimet midis Romës e pushtuesve serbë të enklavave të banuara nga katolikë.

Nga fragmenti i botuar i tekstit të letrës së papës Bennedikti XI të vitit 1303 nga dijetarët kroatë Nikola Čolak-Ive Mažuran: "*Venerabili fratri Marino Archiepiscopo Antibarensi salutem etc. Regimini universalis ecclesie, disponente domino, presidentes ad ea libentius intendimus, que animarum salutem, ecclesiarum commode, nec non augmentum respiciant fidei orthodoxe. Ex tenore siquidem tue petitionis accepimus, quod licet et Bristonia, de Rudinico, de Rogosna, et de Trepzo et de Grazaniza ecclesiae parochiales in regno Servie constitute sunt in locis, ubi fides catholica colitur et ritus Romane ecclesie observatu; Episcopi tamen illa-*

* *treg* në kuptimin mesjetar të fjalës: pjesë e qytetit, jashtë mureve të qytetit - fortifikatë.
[236] Nešto o Gornjoj Moravi, Glasnik Srpskoga Učenog Društva, 60, Beograd, 1885, f. 127.

rum patrium, qui de suis asserunt diocesibus ecclesias existere supradictas, fidem et ritus imismodi non observat, ex quo ecclesiis ipsis et earum parochianis grave imminet detrimentum. Nos autem in his remedium adhibere cupientes, fraternitati tue, de qua fiduciam gerimus in domino specialom, instituendi et destituendi Rectores in eisdem ecclesiis, in quibuscumque diocesibus fueriut, profatis Episcopis a fide et ritibus antedictis taliter deviantibus, plenam et liberam tibi concedimus auctoritate presentium facultatem: ita tamen, quod ipsis Episcopis, in quorum diocese fuerint, si eos ad fidem et ritus predictos redire contigerit, nullum preiudicum generetur. Datum ut supra."[237] po rezultuaka në të vërtetë se papa Benedikti XI e shprehte në këtë letër brengosjen e tij për katolikët e famullive të Bërskovos, Rudnikut, Rogoznos, Trepçës e të Janjevës në kuptimin që dinjitarët e lartë (eparhët) ortodoksë të mos i vënë ata katolikë nën pushtetin e tyre, sepse kjo do të kishte për pasojë humbjen e pagesave, taksave e shpërblimeve që ata besimtarë do të duhej të vazhdonin t'ia paguanin (falnin) kishës katolike. Për këtë arsye papa e autorizonte përmes kësaj letre kryeipeshkvin e Tivarit Marinin që ky ta kishte mujshinë e emërimit dhe të shkarkimit të drejtuesve të atyre famullive.[238] I një rëndësie të veçantë është edhe konstatimi në këtë letër se ipeshkvët e këtyre anëve "të cilët vërtetojnë se në famullitë e tyre ekzistojnë kishat e përmendura të (Bërskovës, Rudnikut, Rogoznës, Trepçës dhe Graçanicës), nuk e praktikojnë fenë e saj dhe ritin".[239] Sakohë që, duke u nisur nga rrethana e ditur historikisht që Bërskovo, Rudniku e Rogozno ishin katërcipërisht koloni sase-raguzase në të cilat nuk kishte shqiptarë, së pakut jo në atë masë që do të duhej të evidentoheshin veçmas, ka plotë arsye të besohet që as Trepça e Janjeva nuk ishin të banuara në mënyrë dominante nga shqiptarë të krishterë të ritit katolik.

Se Vatikani, përkatësisht qendrat ipeshkvnore të tij në Tivar apo në Kotor angazhoheshin për enklavat katolike, përkatësisht raguzase-sase edhe për vjeljen atje të taksave shihet edhe nga përmbajtja e një letre të papës Klementi VI (1342-1352) të dërguar nga Avinioni më 7 janar 1346: "Carisssimo in Christo filio Regi Rassie salutem etc. Ad fovendum in visceribus caritatis ecclesiarum prelatos, et eos preccipue, qui pontificiali preminent dignitate, ac eorum bona et iura eo te facilius nostris precibus invitamus, quo in bonum operum executione tuum affectum magis promptum et facilem credimus invenire, maxime, cum exinde tibi apud deum, cuius prelati huiusmodi sunt ministri retributionis eterne premium

[237] Shih: *Janjevo*, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 19.
[238] Po ata, po aty, f. 25.
[239] Sipas G. Gjini, Ipeshkvia..., f. 106.

rependatur in celis et apud homines laudis preconium acquiratr. Sane venerabili fratri nostro Sergio Catharensi Episcopo, quem nuper suis exigentibus meritis Catharensi ecclesie tunc vacanti prefecimus in Episcopum et pastorem nobis insinuante, percepimus, quod licet Catharensis Episcopus, qui fuit pro tempore, de Canal, Tribunia, Drazaviza, Resson, Budua, Lastua, Prisren, Novabeida, Trepte, Ianeva, Coporich,, Plane, Ostacia, Berschova, Rudnich, Lipnich, Chelminia, Save, Mazovia, Golubezi et Albia dicta, Belgrad Villas et Castra et nonnulla alia loca Catharensis et Sclavoniensis diocesium, eciam infra tui Regni limites constituta, que a fidelibus christianis diversarum linguarum inhabitantur, tamquam diocesanus ipsorum Castrorum, Villarum et locorum regere et gubernare consueverit ab antiquo, et perceptio decimarum proveniencium de proventibus terrarum et possessionum ac aliorum bonorum in dictis Castris, Villis, locis et eorum districtibus consistencium, ex quo infra parrochias ecclesie seu ecclesiarum parrochialium non existunt, ad Episcopum Catharensem, qui est pro tempore, pertinere noscatur: tamen nonnulli inquitatis filii, qui cum malefecerint, gloriantur, tuo suffulti favore dictum Episcopum, eisque Vicarios et officiales quominus dicta locta *regere et gubernare ac decimas ipsas percipere valeant*, pro sue libito voluntatis impetiverunt hactenus, et ecim impedire presumunt in animarum suarum periculum, et ipsius Episcopi et ecclesie predicte non modicum preiudicium et scandalum plurimorum. Cum itaque, fili carissime, sit virtutis opus, ecclesias et personas ecclesiasticas, presertim pontificali dignitate preditas, benigno favore prosequi, ac as pro Regis eterni gloria in suis manutenere iuribus, et a malignantium molestiis defensare, serenitatem Regiam regamus et hortamur attente, quatenus eundem Episcopum et Ecclesiam predictam habens pro nostra et apostilice sedis reverentia propensius commendatos, ac eidem Episcopo in regimine et gubernatione dictorum Castrorum, Villarum, locorum et perceptione decimarum huismodi ac aliis suis oportunitatibus Regia benignitate assistens, eum super regimine et gubernatione dictorum Castrorum, Villaruum et locorum acperceptione decimarum huiusmodi non molestes, nec permittas, prout decet regiam excellentiam, ab aliquo molestari; ita quod exinde tibi a deo perhennis vite premium, et a nobis condigna proveniat actio gratiarum. Datum Avinione VII Ianuarii. Pontificatus nostri Anno Quatro."[240]

Përmes kësaj letre, papa e luste mbretin serb St. Dushan që (ky i fundit) ta përkrahte, ta ndihmonte ipeshkvin e Kotorit në mbledhjen nga besimtarët e famullive katolike të të dhjetës për kishën katolike dhe në

[240] Ky dokument është botuar nga A. Theiner, Monumenta Hungariae, I, f. 701, nr. 1061.

udhëheqjen, qeverisjen e disa qyteteve, ndër të cilat përmenden edhe Prizreni, Novobërda, Trepça, Janjeva (Ianova), Koporiqi, Pllana, Bërskovo dhe Rudnik-u:

Papa Klementi VI reagonte përmes kësaj letre edhe kundër uzurpimit nga Dushani të kishave katolike të Prizrenit, Trepçës, Novobërdës, të Janjevës etj. duke theksuar në këtë mes se në ato vende banonin katolikë me *diversarium linguarium* "gjuhë të ndryshme",[241] që në kontekstin historik s'ka si të kuptohet ndryshe përveç se kemi të bëjmë me gjuhët delmate përkatësisht romane ballkanike, kroate dhe shqipe të elementit ardhës shqiptar katolik nga Veriu i Shqipërisë dhe nga qytete delmate të Jugut të Adriatikut. Unë kujtoj se interpretimi i shprehjes *diversarum linguarum* "gjuhë të ndryshme" të këtij dokumenti kinse nën këtë mund të nënkuptohet edhe *shqipja e elementit katolik vendës* kosovar do të duhej të shihej më shumë se vetëm dëshirë e shkencës patriotike. Kjo sepse, teza e këtillë do të ishte e nxjerrë nga konteksti, në të cilin përmenden edhe vendet Canal, Tribunia, Drazaviza, Resson, Budua, Lastua, Plane, Ostacia, Berschova, Rudnich, Lipnich, Chelminia, Save, Mazovia, Golubezi dhe Albia ose Belgrad dhe katunde e qytete/kështjella të tjera, të gjitha vende të Kotorit e të Skllavonisë, e pra edhe kolonitë sase-raguzase Prisren, Novaberda, Trepte, Ianeva, Coporich..

Në të mirë të qenies katolikë të kryehershëm të kosovarëve të sotëm të Rrafshit të Kosovës, të Drenicës, Llapit, të Gallapit dhe të Moravës e të Karadakut nuk shkon as konstatimi i J. Drançollit[242] pse "Hapësira e ritit katolik në Mbretërinë Nemanide përputhet tërësisht me trojet ku jetonin shqiptarë, të cilët sundoheshin nga serbët." Ky konstatim nuk bën të kuptohet ashtu që raguzasit vetëm na e paskan rritur numrin e të krishterëve të ritit roman në Kosovën e shek. 13-15, porse që ata ishin të vetmit katolikë të mirëfilltë të privilegjuar, të toleruar nga sundimtarët serbë. Kjo sepse raguzasit ishin bashkëthemelues me sasët gjermanë dhe themelues të kolonive të tyre në qytete të Kosovës si Novobërda, Prishtina, Trepça, Vushtrria, Janjeva, Bellosica. Ata nuk mund të merren as për faktor i propagandës në të mirë të ritit katolik të krishterimit në Kosovë, siç shprehet J. Drançolli, sepse është vështirë të besohet që pjesën më të madhe të besimtarëve të ritit katolik "e përbënin së pari shqiptarët, më pastaj raguzanët, sasët, kotorrasit dhe italianët". Është e vështirë të merret për si i qëlluar në rrafshin historik mendimi i J. Drançollit sipas të cilit "Përqafimi (S.G.: nga shqiptarët) i ritit latin në Kosovë dhe në viset e skajshme të saj, sidomos në kohën e mbretërve të fundit nemanjidë, sipas

[241] Sipas G. Gjini, Ipeshkvia. .., f. 106.; khs. edhe tekstin nën referencën time 216.
[242] Khs. Feja në Kosovë gjatë mesjetës, "Dardania sacra", 2, Prishtinë, 2000, f. 112.

të gjitha gjasave, ishte një formë reagimi i shqiptarëve ndaj shtypjes së shtetit dhe të kishës rasiane, që pikërisht në atë kohë i asimilonte dhe i konvertonte shqiptarët e nënshtruar." Nga ky paravendim do të rezultonte pra që shqiptarët e kësaj hapësire nuk ishin katolikë. Ata, sikundër e kuptoj unë citatin e mësipërm, na paskan qenë bërë katolikë pikërisht në kohën e pushtimit serb në shek. 12 të Kosovës së sotme, për t'u dhënë shkas sundimtarëve serbë që t'i përndjekin, t'i konvertojnë, t'i asimilojnë. E, cilit konfesion i paskan përkitur shqiptarët para presionit të kishës ortodokse autoqefale pushtuese serbe? Pse, së pakut shqiptarët e hapësirës së sotme etnolinguistike të tyre, me përjashtim të Rrafshit të Dukagjinit, nuk paskan qenë, para ardhjes së serbëve, besimtarë të krishterë të kishës ortodokse bizantine, nga e cila u shkëputën serbët e ardhur. Unë kujtoj që edhe autori ynë, si edhe shumë të tjerë, urdhëresat e sundimtarëve serbë për përndjekjen e latinëve "katolikëve" që në të vërtetë nuk kanë të bëjnë kryekreje vetëm me hapësirën e Kosovës së sotme, porse me hapësirën e perandorisë jetëshkurtër dyshekullore të shtetit serb në ekspansion, që ngërthente edhe Shqipërinë e Veriut dhe Malin e Zi, i marrin për si kallëp thuajse ato paskan të bënin edhe me hapësirën e (gjithë) Kosovës së sotme.

Kisha katolike e Janjevës

Në këtë trajtesë timen është thënë më shumë se një herë se në të mirë të qenies katolikë të kosovarëve nuk flet aspak rrethana që, sikundër mendon J. Drançolli, "numri i priftërinjve shqiptarë në Kosovë, në krahasim me ata të huaj, ishte shumë më evident." [...] sakohë që dihet se në këtë rast kemi të bëjmë me priftërinj shqiptarë të ardhur nga radhët e qytetarëve shqiptarë të Republikës së Raguzës dhe nga Tivari, Shkodra, Pulti e Drishti të Shqipërisë së Veriut. Kësaj teze të historianit tonë nuk i ndihmon as mendimi i tij se "edhe ndërtimet sakrale të shek. XIII-XIV nuk mund të firmosen si ndërtime sakrale serbe, meqë po në atë kohë ngriten *shumë* (sic!) kisha, kuvende e katedrale katolike si, p. sh. në Janjevë, Novobërdë, Mitrovicë, Prishtinë, Trepçë, Vuçitërnë etj.", sepse sikundër shihet katërçipërisht edhe autori

ynë flet në të vërtetë për tempuj të ritit katolik të krishterimit, pikërisht nëpër koloni raguzase e sase të hapësirës së sotme të Kosovës të cilët (tempuj), besoj fort, nuk janë ngritur nga popullata vendëse kosovare.

Mjafton që në këtë mes të përmendet rrethana e ditur katërçipërisht se kisha katedrale e Novobërdës është e ndërtuar në stilin roman e madje edhe nga material ndërtimor gurë të gdhendur e kolonada çfarë nuk gjenden në rrethina të Novobërdës. Përveç kësaj, në ballin e njërit nga mure të kalasë së Novobërdës është veçuar me gurë ngjyre tjetër simboli i spirancës që nuk mund të jetë simbol i popullatës vendëse, kontinentale, porse simbol i një shteti të fuqishëm detar. Kisha tjetër katolike e Novobërdës quhet jo rastësisht "Kisha e Sasëve"; Dihen së pakut dy dinjitarë gjermanë: plebani *Pauli Theutonicus* dhe meshtari *Jacomo Todesco* të cilët kishin shërbyer sigurisht në kishën e sasëve, njëri në vitin 1388 e tjetri para vitit 1474. Edhe kisha katolike, sot në rrënoja, e Stantërgut njihet për si kishë e ngritur nga kolonët sasë, prandaj edhe është quajtur *Kisha e Sasëve*.[243] Për kishën e kryehershme të Janjevës, burimet tregojnë se është ngritur nga sasët. Bile, edhe këmbona e vjetër, me mbishkrim gotik, e saj ishte sjellë nga qyteti i largët i Köln-it të Gjermanisë.

Fundja, elementi katolik sllavishtfolës i Janjevës, e mban veten për pasardhës të raguzasve, ndërsa banorët e katundeve kroate të famullisë së Letnicës dhe të vetë kësaj (Binça, përkatësisht pjesa kroate e popullatës së saj, Shashari, Vërnezi, Vërnakolla) e lidhin prejardhjen e tyre me Dalmacinë e me Bosnjën. Në traditën gojore të janjevasve bën jetë edhe gojëdhëna se pararendësit e tyre qenkan të ardhur nga Polonia. Se katolikët e Kosovës ishin oaza qytetarësh të ardhur nga qyteti i Raguzës dhe nga vendbanime të Republikës së Raguzës, të vendosur në kolonitë e tyre në Novobërdë, Janjevë, Letnicë, Prishtinë, Bellosicë, Trepçë, tregon edhe rrethana që, kur ishte puna për ndonjë çështje madhore, ata u drejtoheshin dinjitarëve dhe Vatikanit të gjithë bashkë. Kështu ndodhi p.sh. me një letër, përkatësisht memorandum të 25 shtatorit 1578, të shkruar kroatisht, por me aflabetin cirilik,[244] të cilën e kishin nënshkruar katolikë të Janjevës, Letnicës, Novobërdës e të Trepçës. Vatikani i trajtonte të gjitha këto oaza si "katolikë të Serbisë". Se këta katolikë ishin kryesisht raguzas e sasë dhe krejt pak romanë të qyteteve të bregut jugor të Adriatikut dhe shqiptarë katolikë të Veriut të

[243] Khs. së fundi Oliver Jens Schmit, Die Kosovo Geschichte, Srpska Pravoslavna Crkva, në http.//www.spsportal.org/index.php

[244] Khs. Atanasije Urošević, Neki detalji iz prošlosti Kosova, Onomatološki Prilozi I, SANU Beograd 1979, f. 29; Nikola Čolak-Ive Mažuran: *Janjevo*, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 36-37.

Shqipërisë dhe sish qytetarë të Republikës së Raguzës, nuk kishte nevojë të theksohej në mënyrë të veçantë.

Kjo rrethanë e lejon paravendimin se kjo popullatë e fliste kroatishten e variantit delmat edhe në shtëpi edhe në kishë. Ky detaj do të tregonte, më tej, që marrja nga klerikë e historianë kosovarë për si argument kinse të qenies katolikë të shqiptarëve të Kosovës e rrethanës pse në kolonitë raguzase e sase të Kosovës së mesjetës pjesa dërmuese e famullitarëve ishin shqiptarë qytetarë të Republikës së Raguzës; klerikë shqiptarë të Tivarit, Kotorit, Pultit, Shkodrës, Drishtit dhe jo, pra, katolikë vendës, kosovarë tregon në të vërtetë vetëm se në kolonitë raguzase e sase të Kosovës kishte në shek. 15 katolikë me gjuhë të kishës kroatishten dhe jo shqipen. Sikur shqipja në ambientet katolike të Kosovës së mesjetës, sidomos në Rrafshin e Kosovës, në krahinat e Llapit, Gallapit e të Moravës, të kishte qenë gjuhë e liturgjisë, element katolik shqiptar vendës do të duhej të kishte edhe sot në rrethina të Novobërdës, dhe sidomos në Marec, Krilevë dhe në katundet e zhdukura *Kuçiq* të fundshekullit 15 dhe në *Gilassi* të dëshmuar në shek. 17 (që unë e kam identifikuar me pjesën e katundit Koliq të Prishtinës, ku janë ruajtur mikrotoponimet *Guri Glasit*, *Kisha e Glasit* dhe *Reka e Glasit*) i dëshmuar si vendbanim më vete në të cilin në vitet 1639 e 1659 kishte ende banorë të krishterë të ritit roman. I njëjti konstatim do të vlente edhe për koloninë raguzase ose kotorase të Bellosicës (Murgullës së Podievës), të Prishtinës e të Vushtrrisë dhe të qyteteve të Rrafshit të Dukagjinit, porse që - duke qenë njësi kompakte etnike e fetare- mbetën të jetonin, si për çudi, në ngulimet e tyre sekondare si Janjeva e Vitia me rrethinë dhe ta ndjenë veten për kroatë edhe në ditë tonat. Si ndodhi që vetëm një katund (Stublla) dhe një lagje e tij (Kabashi) të jenë edhe katolikë edhe shqiptarë është çështje që duhet të shihet. Kjo aq më parë që as kisha më e madhe e rrethinës, ajo e Letnicës, nuk mund të jetë kishë shqiptare, porse kishë e raguzasve mesjetarë, gjurmë të të cilëve janë ruajtur, për sa dimë deri sot, së pakut deri në fillim të shek. 17. Këto dëshmi bëhen të besueshme me ekzistimin e tri mbishkrimeve. I pari është një mbishkrim varri, i padatuar, i gjetur në Letnicë i kushtuar shprehimisht një patrici raguzas: HIC NICOLAVUS IAZIT PATRIZIUS RAGUSINUS, ndërsa dy të tjerat janë pllaka guri të vendosura në vetë kishën e Letnicës. Në pllakën e vendosur afër lterit është mbishskrimi: *I. H. S.* (Jesus homunum Salvator) *Hac in fossa sunt venerabilis Johannis Jole ossa 1511* "në këtë var janë eshtrat e të nderuarit Johan Jole " ndërsa në mbishskrimin tjetër, të vendosur në anën e djathtë të kësaj kishe, është

mbishkrimi me tekstin *S*. .. (Speculum) *de Mare Vizcova figliola de Cate 1600 morse A DD IX Marzo* "Varri i Mara Vickoviqit, të bijës së Katës, e vdekur më 9 mars 1600". Nga vetë mbishkrimi i parë mësohet se ai gur varri ishte i një patrici raguzas të paemër, ndërsa për Vickoviqët, I. Jastrebov,[245] mendon, në punimin nga i cili u cituan dy mbishkrimet e fundit, se ishte një familje fisnikësh raguzas gjë që dëshmohet me gjetjen në çiflikun e saj të një shtatoreje që pasqyron një grua të re me fëmijën në parzëm dhe me një mollë të gurtë në dorën e djathtë. Jastrebov dëshmon se ajo ishte një familje raguzase, pasardhësit e së cilës po jetuakan edhe sot në Dubrovnik me të njëjtin mbiemër. Nga kjo familje rridhte edhe konti Vicković, konsulli gjeneral i Austrohungarisë në Selanik.

Një dëshmi konkrete se në kisha katolike të kolonive raguzase (edhe) në shek. 17 gjuhë e liturgjisë e pra edhe e shtëpisë ishte kroatishtja e kemi pikërisht për kishën e kolonisë raguzase të Letnicës dhe të 6 katundeve (me rreth 400 frymë) përreth saj, të banuara me popullatë katolike.[246] Në raportin e hartuar në vitin 1671 famullitari katolik - mbase italian - atë Bernandini që ishte me shërbim në këtë hapësirë, e njoftonte vizitatorin Shtjefën Gaspri se këndej qenkan dy kisha, njëra nga të cilat në lagjen Senica (Letnica). Për kishën e Letnicës ai thotë se kësaj i duhen petka prifti, meshar dhe ungjill në gjuhën ilire: "Viene bisogno d'una pianeta, missale et evangelistario Illirico",[247] përkatësisht se "*Edhe këtu*. .. (S.G. kishin nevojë) *për ungjill dhe mesharë në ilirisht*" (sllavisht). Sa kohë që dihet se Perëndimi për *ilirë* i quante në atë kohë dalmatët e kroatët dhe për *ilirisht* gjuhën e tyre, çdo koment tjetër rreth çështjes së gjuhës së kishës në Letnicë me rrethinë e mbase edhe në Janjevë e në kisha të tjera katolike të Kosovës së shekujve 14-17 më duket i panevojshëm. Se as katolikët e Prishtinës nuk ishin shqiptarë vendës do ta tregonte rrethana që në raportin e vet të vitit 1623 relatori Pjetër Mazrreku njoftonte se qyteti i Prishtinës kishte asokohe 20 shtëpi katolike me 100 besimtarë. "Do të ishte mirë", thoshe ky më tej në raportin e vet, që këtyre katolikëve t'u ndihmohej "sepse numri i tyre para do kohe është shtuar me ardhjen e 10 familjeve nga Shqipëria".

Me rëndësi të veçantë janë në këtë mes të dhënat që përmbahen në raportin e dt. 30 nëntor të vitit 1584 të të dërguarit të Romës, A.(leksandar)

[245] Nešto o Gornjoj Moravi, Glasnik Srpskoga Učenog Društva, 60, Beograd, 1885, f. 132.
[246] Duket se kemi të bëjmë me katundet e sotme Stublla, Vërnakolla, Binça dheTerzijaj. Për dy të tjerat nuk di të them gjë të saktë.
[247] Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 7, Vitia, Prishtinë, 2004, f. 100.

Komulović dhe përcjellësit të tij italian T.(omasso) Ragi. Komulović njoftonte p.sh. se në Letnicë (Montenegro) dhe në katër katundet përreth kishte 500 frymë katolikësh, për të cilët përkujdesej një kapelan. Ky vend shihej nga raportuesi për i përshtatshëm që aty të ngrihet një shkollë e cila do të ishte e rëndësishme për të gjithë të krishterët e Serbisë, duke qenë se ndodhej në mes të regjionit. Përveç kësaj, këtu nuk ka turq, ndërsa vendësit nuk paguajnë tatim, sepse djemtë u janë marrë për jeniçerë. Kjo lë të kuptohet se vendësit do të mund ta mbanin shkollën me shpenzime të veta.

Për Novobërdën Komulović-i thotë se është vendbanim i gjerë me kështjellë të madhe, e njohur për miniera të argjentit. Deri para pak kohësh Novobërda ishte seli e ipeshkvit. Aty janë dy kisha, një kapelan dhe 600 besimtarë të krishterë. Për nga profesioni, shumica e tyre janë argjendarë. Të krishterët e Novobërdës kanë nevojë për një mësues, të cilin do ta mbanin ata vetë.

Për Janjevën ky raporton se është e pasur me miniera ari e argjendi; se ka më shumë se 1.000 të krishterë dhe se famullinë e drejton një kapelan. Janjevasit kërkojnë një ipeshkëv ndaj të cilit do të sillen mirë dhe do ta mbajnë sa të jetë gjallë.

Trepça, sipas relatorit, e pasur me miniera ari e argjendi, ka 400 katolikë që e kanë një kapele të rregulluar, të cilën e drejton kapelani. Në dy katunde të afërta ka edhe 100 katolikë të tjerë dhe një kapelan.

Sipas interpretimit të autorëve të monografisë (khs. referencën 212), në Prishtinë, Krushevc, Novipazar, Prokuple e në Nish janë 250 katolikë, 50 nga të cilët janë shqiptarë, ndërsa të gjithë të tjerët janë tregtarë raguzas. Ashtu si Novobërda, edhe Prishtina ka pasur ipeshkvin e vet, porse aty nuk ka as kishë, prandaj Komulović kishte urdhëruar të rregullohej një kapelëz e cila sadopak do t'i plotësonte nevojat e besimtarëve.[248]

Është fort e vështirë, për mendimin tim, të mund të besohet që qytetarët e këtyre kolonive për të cilat nuk mund të gjendet as edhe një arsye për të dyshuar se nuk ishin pasardhës të raguzasve kroatishtfolës, të kenë kërkuar mësues që fëmijëve të tyre do t'ua mësojnë shqipen. Kjo aq më parë sa kohë që duhet të dihet se në këso ambientesh, përkatësisht në kolonitë raguzase-sase, konform rrethanave historike, shqipja nuk ka mund të jetë për kolonët raguzas as gjuhë e kulturës e prestigjit, as e pushtetit e aq më pak gjuhë amtare, e tamlit, e shtëpisë. Mbase vetëm edhe shtrimi i pyetjes përse këso kërkesash nuk kishin shtruar katolikët tivaras mbase gjithsesi, edhe këta, kroatishtfolës, të

[248] Sipas Nikola Čolak-Ive Mažuran: Janjevo,..., f. 39.

Bellosicës (sot katundi Murgull i Podujevës), Trepçes, Vushtrrisë, të Prizrenit e të Prishtinës e sqaron vetvetiu korrektësinë e paravendimit tim se në rastet e Novobërdës, Janjevës e të Letnicës kemi të bëjmë me ambiente - enklava ende (shek. 17) kompakte etnike raguzase, përkatësisht kroate. Kjo aq më parë sa kohë që pikërisht në këtë kohë, gjysma e parë e shek. 17, vetë relatorët e Vatikanit, shumica absolute nga të cilët shqiptarë jo kosovarë, tregojnë se elementi katolik i këtyre ambienteve ose po shpërngulej ose po konvertonte në besimin islam për shkak se shumë puse minierash që kishin qenë prona të tyre ishin shteruar dhe, për pasojë edhe të haraçit të lartë të sanksionuar nga pushteti osman, edhe të kamur të dikurshëm ishin varfëruar deri në atë shkallë sa edhe ta merrnin kërrutën e lypësit.

Në këtë mes nuk ka kurrfarë arsyeje të mohohet as prania e katolikëve shqipfolës e as ajo e meshtarëve që e njihnin shqipen, sidomos në qytetet e Novobërdës e të Janjevës për të cilat edhe nga burimet mësohet se së pakut që nga shek. 15 kishte edhe banorë shqiptarë. Me këtë entitet mund të ketë të bëjë edhe relacioni i kosovarit Pjetër Budi dërguar Romës në vitin 1621 në të cilin ky shkruante "N'këtë kamë ndenja 17 vjet e sa ku mujta u mundova me i ndihmue e me i forcue ata popuj e ata meshtarë me kujdes të madh. .. me libra të devoçëm qi shkrova në gjuhë t'tyne si për ata te Servis si për ata të Shqypniës" e mbi të gjitha pse në këtë relacion P. Budi shprehte keqardhjen që këndej nuk ka shkolla shqipe. Këtë ankesë të P. Budit do ta ketë përmbushur, për fat të keq vetëm përkohësisht, Pjetër Mazrreku aty kah viti 1665 kur ky, menjëherë pasi i kreu studimet në Itali, erdhi në Janjevë dhe iu përvesh mësimit të fëmijëve katolikë në gjuhën shqipe. Nuk dihet porse sa kohë vazhdoi ky aktivitet, sepse pasardhësi i tij Vinçenc Matoviç, me gjasë një raguzas, dalmat, kroat, i mësoi fëmijët e kësaj shkolle në serbisht,[249] përkatësisht në kroatisht.

Sado që për asnjërën nga kishat që sunduan në Kosovën e sotme nuk ishte e rëndësishme përkatësia etnike e gjuhësore e besimtarëve, porse vetëm konfesioni, për çështjen e gjuhës së liturgjisë në kishat katolike të Kosovës rëndësi të veçantë ka relacioni i Gjergj Bardhit i viteve 1641/42. Ky sqaronte se dioçeza, përkatësisht ipeshkëvia, katolike e Shkupit ishte e ndarë në dy pjesë: në "Serbia Superiore" dhe "Serbia Inferiore". Në "Serbia Superiore", të cilës i takonin Prokuplja, Novobërda, Trepça, Janjeva, Karadaku i Shkupit, Shkupi e Kratova, të gjithë katolikët flisnin "ilirisht", përkatësisht sllavisht, ndërsa në

[249] Sipas S. Pulaha, Popullsia..., f. 33.

"Serbia Inferiore" (Prizren, Gjakovë, Guri, Shegjeç) katolikët flisnin "epirotisht" d.m.th. shqip.[250] Këtë njoftim të Gj. Bardhit e vërteton rreth 150 vite më vonë, përkatësisht në relacionet e vitit 1784 dhe 1791/92 edhe Matteo Mazrreku. Ky, që për vete shkruante se përkundër mbiemrit (shqip) që e mban, gjuhë amëtare e tij nuk ishte shqipja, njoftonte porse se në "Serbia Inferiore" (Prizren, Gjakovë, Guri, Shgjeç, Zym, Zogaj), katolikët flisnin vetëm "epirotisht",[251] d.m.th. shqip., ndërsa ata në Pejë e në Karadakun e Shkupit, përkundrazi, flisnin sllavisht.[252] Këtë gjendje e dëshmonte në një relacion të vetin edhe Pjetër Mazrreku, në të cilin për hapësirat e banuara me katolikë në Jug të Ballkanit thoshte se "Gjuhët e popujve jugorë janë të shumëllojshme. Katolikët në Prizren flasin shqip e serbisht, kurse ata në fshatra vetëm shqip. Në rrethin e varfër të Prizrenit, vazhdon ai, nevojiten 5 meshtarë, por të atillë që ta dinë shqipen. Çdo komb ashtu edhe shqiptarët duan të kenë meshtarë në gjuhën e vet", një kërkesë kjo që në raportet e veta Vatikanit e shprehte radhazi edhe Pjetër Bogdani, të formuluar si nevojë për shkollimin e djelmoshave shqiptarë. [253]

Sa për Janjevën, kryeipeshkvi M. Bici vërente në vitin 1611 se në këtë hapësirë flitet *lingua Dalmata* "gjuha dalmate". Kjo bëhet e besueshme edhe në bazë të "gramatikave ilire" të përmendura edhe nga ipeshkvi i Shkodrës Pjetër Bogdani, nip i kryeipeshkvit Bici, i cili në vitin 1651 e luste kongregacionin (mbase pikërisht për shkollën e Janjevës) për libra shqip, pastaj për fjalorë turqisht e arabisht, për alfabetin grek dhe për pesë "gramatika ilire".[254]

Sipas regjistrit të shkruar me dorë nga mësuesi dhe misionari në Janjevë (Gagneuo) Vincenzo Matteuich (Vinçenco Mateviç), nxënës të shkollës së Janjevës, në vitin 1670 ishin: Andrea da Procupio, Marco Massarechi da Vucitarno; Luca Bogdani; Vincenzo Bogdani; Antonio Bogdani; Giocianni Jankouich; Marco Kokich da Prisetino; Giovanni Raspassanouich da Montenegro; Giuseppe Matteuich; Vincenzo Lisirich;

---

[250] Sipas P. Bartl.; Relation Bardhi 1641/42= Zamputi II, 262..
[251] P. *Bartl*, Quellen II, 129
[252] APF, SOCG 872, f. 137 v., 138, 139, 141 v., cit. sipas P. Bartl.
[253] Sipas S. Pulaha, Popullsia..., f. 33.
[254] Nikola Čolak-Ive Mažuran: Janjevo, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 59.

Luca Plebanouich; Vincenzo Perich; Demetrio Mircouich; Giouanni Deanouich; Antonio Paulouich; Antonio Gorglich; Matteo Gorglich; Girolamo Deanouich; Stephano Stepanouich; Vincenzo Stepanceuich; Demetrio Rodich; Natale Fischouich; Gabriele Gionich; Demetrio Docich; Francesco Matteuich.*

Në shkollën e Janjevës kishte pra, nxënës të ardhur nga Prokuplja, nga Vushtrria e nga Prishtina. Pjesa më e madhe syresh ishte porse nga vetë Janjeva. Gjykuar në dritën e rrethanës që mbiemrat e katër nxënësve të kësaj shkolle ishin shënuar në trajtën e shquar të shqipes, khs. *Massarechi*, *Bogdani* dhe se ndër ta kishte edhe sish që mbanin antroponime të gjithkrishtera në trajta shqipe të tyre si si *Jeronim* si edhe patronimin *Gjoniq*, *Mateviq* lë të kuptohet që këtu mësonin edhe 7- 10 nxënës shqiptarë dhe nga një nxënës të ardhur mbase nga kolonitë raguzase të Letnicës e të Prokuples.

Nga burimet mësohet se mësuesi Mateuich ishte ardhur në Janjevë nga kolonia raguzase e Trepçës, sepse kryeipeshkvi e shihte aktivitetin e këtij mësuesi më të rëndësishëm për Janjevën se sa për Trepçën, meqë shkolla në Janjevë ishte e vetmja e llojit të vet në gjithë hapësirën e ipeshkvisë së Shkupit. Së këndejmi Kongrecaioni e financonte drejtpërdrejt këtë shkollë dhe i dërgonte asaj edhe libra. Së rrjedhojë të kësaj duhet kuptuar edhe rrethanën që numër i madh misionarësh e famullitarësh janjevas, pas shkollimit të tyre në Kolegjin Ilir e sosh të tjera të Italisë, ktheheshin në Janjevë ku njëherësh kryenin punën e mësuesve e atë të famullitarëve.

Nga paraqitja e mësipërme e gjendjes mua më rezulton se në shek. 17-18 gjuhë e liturgjisë në kishat katolike në njërën pjesë të ipeshkësisë së Shkupit, përkatësisht në Shkup, Kratovë, Prokuplje, Novobërdë, Trepçe dhe në Karadak të Shkupit ishte sllavishtja, përkatësisht kroatishtja ndërsa në pjesën tjetër, përkatësisht në Prizren e Gjakovë me katundet përreth tyre, gjuhë e liturgjisë ishte shqipja. Po u soll ndërmend rrethana e ditur historikisht se vendbanimet në të cilat në kishë, e mbase edhe në shtëpi, flitej kroatisht ishin të banuara që nga

* Botuesit e këtij regjistri, sh. Nikola Čolak-Ive Mažuran: Janjevo, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 60 i kanë transliteruar, përkatësisht kroatizuar emrat kështu: Andrija nga Prokuplja, Marko Mazareki nga Vuçterna; Luka Bogdani; Vinko Bogdani; Antun Bogdani; Ivan Janković; Marko Kokić nga Prishtina; Ivan Raspasanović nga Karadaku; Josip Matević; Vinko Lisirić; Luka Plebanović; Vinko Perić; Demetrije Mirković; Ivan Deanović; Antun Pavlović; Antun Grgić; Mateo Grgić; Jeronim Deanović; Stjepan Stjepanović; Vinko Stjepančević; Demetrije Rodić; Božidar Fišović; Gabrijl Đonić; Demetrije Docić; Franjo Matević.

shek. 14-15 kryesisht nga raguzas e sasë (siç është rasti me Novobërdën, Letnicën me disa katunde përreth, Trepçën e me Janjevën) ose në to kishte kolonë dubrovnikas (siç është rasti me Shkupin, Kratovën e Prokuplen) rezulton se katolikët e kësaj pjese të ipeshkëvisë së Shkupit nuk do të kenë qenë shqiptarë, por kroatë, pasardhës të kolonëve raguzas të instaluar këndej që nga shek. 14. Këtë mendim e përforcon edhe rrethana që si praktikimi ashtu edhe tkurrja e ritit katolik në këtë hapësirë ishin dhe mbeten historikisht të pandashme nga rrethanat ekonomike, përkatësisht nga shfrytëzimi i minierave. Studiuesi gjerman Peter Bartl konstaton se "duket që tkurrja e katolicizmit në Novobërdë e në Trepçë ndodhi për shkak të shuarjes së xehetarisë. Pjetër Mazrreku njoftonte në vitet 1623/24 se këto vende paskan qenë deri para 30 vitesh të pasura me xehe të arit e të argjendit dhe paskan tërhequr kështu katolikë nga Shqipëria, nga Bosnja dhe nga tjetërkah.[255] Qysh në vitin 1633 Trepça nuk kishte mundësi ta mbante më as edhe një famullitar,[256] ndërsa në Novobërdë famullitari i fundit përmendet në vitin 1642."[257] Nga ana tjetër, Prokuplja që asokohe kishte 1.500 shtëpi, ishte porse famulli katolike më vete dhe duke qenë seli e kolonisë së tregtarëve raguzas kishte në vitin 1610 12 familje raguzase dhe se ende kishin mundësi ta mbanin një kapele dhe një famullitar.[258] Më vonë këtu paskan ardhur edhe 10 familje katolike shqiptare nga krahina e Pultit. Famullia e Prokuples përmendet edhe një herë në vitin 1642 dhe më nuk dihet gjë për fatin e saj.[259]

Rrethanat e përshkruara nga relatorë shqiptarë dhe përfundimi i studiuesit gjerman tregojnë mbase katërçipërisht se elementi etnik e gjuhësor i besimtarëve katolikë të krahinave të sotme përreth qendrave si Trepça e Novobërda nuk ishin shqiptarët vendës të këtyre anëve, porse *vetëm* elementi i ardhur nga Raguza, Bosna, Shqipëria e Veriut dhe nga ndonjë vend tjetër. Së këndejmi mund të thuhet mbase me të drejtë se as gjuha e liturgjisë në këtë hapësirë, në qytete-miniera nuk do të ketë qenë shqipja – sado që pjesa dërmuese e priftërinjve, famullitarëve ishin shqiptarë.

Karakterin raguzas të elementit konfesional katolik të banorëve të Trepçës, Novobërdës e të Janjevës, pa e përjashtuar Shkupin, Kratovën e Prokupljen, e tregojnë edhe njoftimet e relatorëve të besueshëm

[255] Zamputi I, 342., cit. sipas Bartl.
[256] *Zamputi* I, 434. cit. sipas Bartl.
[257] Relation Bardhi 1641/42= Zamputi II, 262. cit. sipas Bartl.
[258] *Zamputi* I, 174, 176. cit. sipas Bartl.
[259] *Zamputi* I, 176. cit. sipas Bartl.

Marino Bizzi-t e të Vinzenz Zmajević-it të viteve 1630, përkatësisht 1703. Nga raportet e këtyre dy relatorëve mësohet se ipeshkëvia e Shkupit e përfshinte hapësirën e Kosovës dhe të Maqedonisë dhe se "katolikët që jetonin në këtë hapësirë ishin kryesisht shqiptarë ose raguzas". Gravitimin e parisë katolike drejt atyre qendrave më të forta katolike raguzase, gravitim që po ndodhte si rezultat i shuarjes së xehetarisë në ato qendra, e tregon edhe rrethana që Shkupi ishte vetëm 24 vite qendër, përkatësisht seli ipeshkvnore vetëm për Andrea Bogdanin, sepse pasardhësi, nipi i tij Pjetër Bogdani, e barti selinë e ipeshkëvisë në vitin 1680 në Janjevë e cila ishte e ka mbetur edhe sot qendra më e madhe e minoritetit kroat të Kosovës, pasardhësve të raguzasve, sado që mbase qysh nga themelimi i kësaj kolonie aty ka pasur, si edhe sot, edhe shqiptarë.

Pamje e Janjevës, dhjetor 2009. Foto e huazuar nga Kosova.com

Treguesi më i besueshëm se në vendbanime me popullatë katolike si në Shkup, Kratovë, Prokuple gjuhë e liturgjisë ishte sllavishtja, përkatësisht kroatishtja mbase e tregon rrethana që familje shqiptare katolike të ardhura po vendoseshin jo në ambiente në të cilat do të flitej shqip, porse "ilirisht", përkatësisht sllavisht. Rast ilustrues në këtë kontekst është Kratova. Kur ipeshkvi i Tivarit e vizitoi këtë vendbanim në shkurt të vitit 1639 konstatonte se të 38 familjet katolike të këtij vendi janë shqiptarë të ardhur nga

Dibra të cilët në ndërkohë paskan nisur ta kuptojnë edhe "ilirishten", përkatësisht sllavishten. Madje edhe prifti ishte shqiptar (i quajtur Nikollë Kolesi) i cili "sllavishten e kuptonte krejt pak". Duket se famullitari Kolesi rridhte nga dera e familjes Kolesi nga e cila kishin dalë edhe dinjitarë të tjerë katolikë. I këtillë do të jetë p.sh. famullitari don Atanas Collesi i kishës së Shënkollit në Janjevë, që dëshmohet në vitin 1610,[260] si edhe Andrea Koleshi - njëri nga katër kosovarët pjesëmarrës të Kuvendit të Arbënit të mbajtur në katundin Macukull,[261] përkatësisht në katundin Mërqi të Lezhës më 14 dhe 15 janar të vitit 1703.

Nuk ka arsye të mos besohet se kështu do të ketë ndodhur edhe në ambientet katolike raguzase të Prokuples e të Prishtinës për të cilat Pjetër Mazrreku njoftonte se para krejt pak kohësh, d.m.th. para vitit 1623/24, aty ishin vendosur nga 10 familje shqiptare katolike: në Prokuple ato ishin ardhur nga Pulti, ndërsa në Prishtinë nga një vend i pacaktuar nga Shqipëria e Veriut.[262] Kjo vlen edhe për bashkësinë katolike të Shkupit, e cila në vitin 1703 ishte fort e vogël, kështu që në shek. 19 këtu kishte mezi një dyzinë katolikësh të cilët i cilësonin për "agjentë të tregtarëve shkodranë", pas gjithë gjasash, pra, shqiptarë.[263]

Është çështje më vete nëse mund të flitet për një ekspansion të elementit katolik shqiptar në Rrafshin e Dukagjinit, pse në njoftime të relatorëve - kryesisht shqiptarë - të Vatikanit ka shënime konkrete për ardhjen e disa familjeve katolike nga Shqipëria e Veriut.[264] Natyrisht që

---

[260] Khs. Nikola Čolak-Ive Mažuran, Janjevo..., f. 41.

[261] Pjesëmarrës të tjerë kosovarë në këtë kuvend ishin Pjetër Kolamari, Feta Kuka dhe prifti katolik Mark Belaçi.. Me rëndësi për temën tonë është njoftimi i lëshuar në këtë Kuvend sipas të cilit "Na katolikët jemi nji fuqi prej katërdhetë mijë kordhëtarësh, luftarë trima e të paepshëm. Me ne madje kanë me u bashkue tanë shqiptarët e ritit grek [shqiptarët që njihnin kryepeshkopin ortodoks grek t'Ohrit] dhe të ritit sërb [shqiptarët që ndiqnin kishën ortodokse serbe] bashkë me fqinjët." sipas sh. Stephen Schwartz: Kosova,. Prejardhja e një lufte, Prishtinë, "Rokullia", 2005, f. 14.

[262] *Zamputi* I, 342, 344. cit. sipas Bartl.

[263] Relation Bogdanovic 1853 = APF, SC Albania 34, f. 1019 v. cit. sipas P. Bartl.

[264] Nga këto burime mësohet p.sh. se në vitin 1638 nga Pulti në Prizren ishin ardhur gjashtë familje me 20 frymë; se në Suharekë nga Dukagjini ishin ardhur 15 familje shqiptare me gjithsej 120 anëtarë; Gjergj Bardhi gjeti në vitin 1638 në katundin Dobrushi dy familje me 36 anëtarë që para pak kohësh paskan ardhur nga Dukagjini. Në Kratovë, të gjithë katolikët paskan qenë shqiptarë të ardhur nga Dibra. Edhe raportet e kohës më të re të vizitatorëve sjellin njoftime për migracion të shqiptarëve katolikë. Kështu, Matteo Mazrreku njoftonte në vitin 1792 përkitazi me disa katunde në rrethina të Gjakovës, në të cilat ishin vendosur katolikë të ardhur nga vise malore të dioçezës së Lezhës. Në katundin Romanzi (?) kishte 16 shtëpi katholikësh me 139 anëtarë, që këtu ishin ardhur nga Shqipëria. Këtu paskemi të bëjmë, sipas shënimit të relatorit, me "gente veramente salvatica, rozza, senza veruna civiltà, e tanto erano poveri, e senza l'abiti, che le loro

korrektësia e këtyre njoftimeve nuk mund të vihet në dyshim. Mirëpo, njoftimet për disa raste të ardhjes së elementit katolik në hapësirën e Rrafshit të Dukagjinit nuk bën të përgjithësohen dhe në bazë të tyre të konstruktohet ndonjë tezë që nuk mund t'i përballojë forcës së argumenteve. Këtu ka vend të vihet në dyshim si korrektësia e dijes, përkatësisht propagandës serbe se Kosova na u paska "pushtuar" nga një grusht shqiptarësh të cilët lëviznin përbrenda hapësirës etnolinguistike të tyre ashtu si edhe korrektësia e kallëzimeve popullore të ngritura në nivel të faktit historik se popullsia shqiptare e Kosovës na paska pas qenë e tëra e konfesionit katolik të krishterimit. Kjo sepse nga materiali onomastik që përmbahet në regjistrimin osman-turk të kryefamiljarëve e të pronave të vitit 1485 rezulton se pjesa dërmuese e popullatës së Rrafshit të Dukagjinit ishte shqiptare vendëse e besimit katolik. Relatorët njoftojnë shumë vonë për ardhjen e 44 familjeve me 506 anëtarë. Është për t'u vërejtur që këto pak familje kishin ardhur këndej gjatë një harku kohor prej më shumë se 100 vitesh, përkatësisht midis viteve 1638-1750. Vendosja e tyre po ndodhte në kohën kur islamizimi i popullatës shqiptare të kësaj zone po bënte hapa të mëdhenj drejt konvertimit tërësisht të shqiptarëve në besimin islam. Nuk ka e mbase as nuk mund të pritet të ketë ndonjë shënim që këta ta kishin ndërruar shqipen me ndonjë gjuhë tjetër të liturgjisë.

Në këtë frymë duhet të vlerësohet edhe njoftimi i vitit 1685 i Pjetër Bogdanit i cili i paska dalluar mirë emrat Shqipëri [= hapësira e ashtu-quajtur "bërthamë" e saj] dhe Serbi dhe, në këtë kontekst, për popullatën e Kosovës shkruante se ajo, në pjesën më të madhe të saj flet shqip sepse ajo qenka e ardhur nga Shqipëria dhe e përhapi kështu fenë e shenjtë [= besimin katolik] në vendin e despotit [= despotët mesjetarë serbë]. Së këndejmi *shkiet* [emri shqip për sllavët] për antonim për besimin katolik e kanë "arbanaska vera"[265] ["feja shqiptare"]. Në dritën e rrethanave të ditura ka arsye të besohet se P. Bogdani fliste aty në të vërtetë për atë pjesë krejt të vogël katolikësh të Veriut që kishin ardhur në Kosovë të cilëve ky ua mveshi misionin e madh të katolicizimit të të gjithë shqiptarëve. Ky proces nuk ndodhi ndonjëherë p.sh. në Rrafsh të Dukagjinit, sepse popullata e kësaj hapësire ishte edhe ashtu e besimit katolik, ndërsa ajo e (Rrafshit të) Kosovës e besimit ortodoks. Kjo sepse elementi katolik i kësaj pjese të Kosovë, sikundër u tha disa herë në këtë trajtesë, përbëhej nga kolonë sasë,

carni tutte si vedevano, ma altretanto erano superbi, e caminavano orgogliosi, come se fossero vestiti di veluto, e seta." Në Janosh, një katund tjetër i rrethinave të Gjakovës, që të 26 familjet me 191 anëtarë na ishin të ardhura para 40 vitesh (SG) në vitin 1752) nga Shqipëria.

[265] Oliver Jens Schmitt: Kosovo, Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft,, Böhlau-Verlag, Wien, Köln, Weimar, 2009, f. 143.

raguzas dhe nga pak romanë nëpër qytetet-miniera. Ardhësit shqiptarë të konfesionit katolik nga krahina e Fandit të Madh e të Vogël të Mirditës, përkatësisht nga Veriu i Shqipërisë, nuk krijuan territore gjeografikisht të përkufizuara si "koloni katolike shqiptare". Ardhësit nuk ishin në numër të madh që të mund ta ndryshonin as strukturën etnike e as atë konfesionale të Kosovës së sotme dhe të banorëve të saj të atëhershëm. Duke qenë se kemi të bëjmë me grupe të vogla familjesh, elementi ardhës vendosej kryesisht nëpër kolonitë ekzistuese katolike. Një pjesë krejt e vogël e të ardhurve u vendos edhe në pak katunde të mëvetshme apo në lagje të veçanta katundesh[266] dhe e sollën me vete institucionin e "fisit".

Edhe më absurde duket e pavërteta e lansuar nga historiografia serbe se Kosova na qenka "shqiptarizuar" si rezultat i invazionit të shqiptarëve të islamizuar!!! të ardhur nga Shqipëria e Veriut, pas vitit 1689, përkatësisht pas të së ashtuquajturës "Shpërngulje e madhe e serbëve".

Vija e ndarjes midis katolikëve shqipfolës të Rrafshit të Dukagjinit dhe katolikëve kroatishtfolës të qyteteve miniera të Trepçës, Novobërdës dhe të rrethinave të Vitisë përputhet me vijën që në shekullin 15 i ndante vetë shqiptarët e konfesionit katolik nga ata të konfesionit ortodoks. Kjo përputhet përafërsisht me njësitë administrative të sanxhaqeve të Shkodrës dhe të despotatit të Vuk Brankoviqit, përkatësisht Rrafshit të Dukagjinit dhe Rrafshit të Kosovës.[267]

Do theksuar në këtë mes se etnonimi *latin* i ndeshur krahas me atë *arbanas* nëpër burime ka të bëjë edhe me shqiptarët dëshmon rrethana që Peja (e rrjedhimisht edhe kisha) e pushtuar nga turqit pas vitit 1455 ishte deri atëherë nën sundimin e *latinëve*, përkatësisht Dukagjinëve.[268] Kështu del nga letra me një sërë pyetjesh e Gjergj Brankoviqit i cili, pas shuarjes së patrikanës së Pejës në vitin 1459 e pyeste kryepatriarkun e Stambollit Genadij S-holarij midis të tjerash a mund të emërohen kryepeshkopi dhe patriarku nëse katedra e kryepeshkopit dhe e patriarkut nuk është më në shtetin e tij. S-holari iu përgjigj: Sundimtari dhe sinodi i peshkopëve mund ta vendosin kryepeshkopin dhe patriarkun, pse më nuk ekziston vendi në të cilin më parë ishte katedra e tij, vetëm në një vend tjetër ku do të jenë kryepeshkopi dhe patriarku. Për pasojë, seli e arqipeshkvit dhe e

[266] Për si shembull tipik mund të merret vëllazëria/lagja e Fonollëve (= Fanajve) të katundit Prapashticë të krahinës së Gallapit.

[267] Khs. S. Pulaaha, Popullsia. .., f. 19.

[268] Branislav Đurđev, Odnos između Ohridske arhiepiskopije i srpske crkve od pada Smedereva (1459) do obnavljanja Pećke Patriajršije (1557) RADOVI knj. 38, Odeljenje društvenih nauka Akademije Nauka i umjetnosti BiH, Sarajevo, 1970, f. 192. Khs. dhe http://sr.wikipedia.org/sr-el/

patriarkut të kishës serbe u bë Smedereva dhe patriarkati i saj përfshinte vetëm viset e Serbisë në veri të Krushevacit dhe të Moravës Perëndimore. Peja si patriarkat i kishës serbe do të përtëritet në vitin 1557.

Rrethana që *latinë* quhen Dukagjinët tregon se latine, përkatësisht katolike ishte në mos vetë popullata e Pejës me rrethinë të gjerë, së pakut që kisha e administrata serbe e shek. 15 me latinë kuptonte edhe shqiptarët e ritit katolik të krishterimit.

Është keq që nuk ka shënime nga shek. 13-15 për numrin e banorëve katolikë të ritit roman të qendrave që dihen (Novobërda, Trepça, Janjeva, Letnica) për koloni të tyre. Përkitazi me këtë çështje kaq të rëndësishme ka vetëm paravendime. Kështu p.sh. në dokumente të botuara nga A. Theiner,[269] gjendja e katolikëve në qytetet mesjetare të Kosovës së pushtuar nga turqit përshkruhet për dramatike. Në dy dokumente të vitit 1578 të publikuara nga Giannelli (khs. edhe më lart) bëhet fjalë për 15.000 katolikë të Novobërdës, Janjevës, Trepçës e të Letnicës. Vetë Giannelli vërente[270] në analizën atyre dokumenteve se në të gjitha këto vende bashkë asokohe nuk do të ketë pasur më shumë se 2.300 katolikë. A. Petrusi, botues dhe komentues i veprave të humanistit Novobërdas Martino Segano të fundit të shek. 15, nuk e sheh këtë shifër për të fryrë, po u patën parasysh rrethanat e krijuara në shek. 15, përkatësisht pasojat që i solli pushtimi i këtyre vendeve nga turqit. Këtu do të duhej përfshirë edhe deportimi në vitin 1467 i pjesës dërmuese të popullatës së krishterë përkatësisht katolike të Novobërdës për në Stamboll, në mënyrë që humbjen e popullsisë së këtij qyteti, të shkaktuar nga arratisja e elementit kolonizues si pasojë e rrethimeve të herëpashershme midis viteve 1451-1481 të qytetit të Novobërdës nga ushtritë osmane dhe sidomos pas shtënies katërdhjetë ditë me radhë me armë të rënda zjarri mbi këtë qytet në vitin 1455 ta bënte edhe më të madh. Rrudhjes së numrit të popullsisë në përgjithësi dhe të asaj katolike në veçanti do t'i ketë "kontribuar" edhe kërdia që bëri epidemia e murtajës e përhapur në këtë qytet në vitin 1468.[271]

---

[269] Vetera Monumenta Slavorum., I, e ribotuar në Osnabruck 1968, f. 499, 517-518, 525-526.

[270] Khs. Documenti inediti sullo stato di alcune communità cattoliche della Serbia meridionale nel 1578, në Richerche slavistiche, 3, 1953, f. 37, khs. edhe CordigNano, Geografia ecclesiastica dell'Albania dagli ultmi decenni del sec. XVI alla metà dl sec. XVII, në Orientalia Cristiana, 36, 4, Roma, 1934, f. 234 e 236. Të dhënat e kësaj reference i kam huazuar nga Agostino Petrusi: Martino Segano di Novo Brdo, Vescovo di Dulcigno (Un umanista serbo-dalmata del tardo Quattrocento), Vita e Opere, Roma, 1981, f. 14, referenza 19.

[271] Sipas Miklós Takács, Sächsische Bergleute im mittelalterlichen Serbien und die "sächsische Kirche von Novo Brdo, në Südost-Forschungen Band L, 1991, f. 42.

Pikërisht çështja e deportimit mund të shërbejë si një shkas për ta trajtuar edhe përkatësinë etnike të qytetarëve të Novobërdës. Kjo çështje ka të bëjë në rend të parë me dredhimin nga historiografia serbe e pejzazhit etnik (jo vetëm) të Novobërdës, në favor të së pavërtetës se Novobërda na paska qenë qytet i banuar nga popullata serbe. Së pari, ka vend të pohohet se nuk dihet deri tani që qeveria osmane të ketë ndërmarrë ndonjëherë deportime të organizuara të popullsisë vendëse ortodokse.

Dijetari hungarez M. Takács,[272] shkruan se pas pushtimit osman të Novobërdës sasët e patën të njëjtin fat si edhe popullata ortodokse sllavojugore vendëse. Kjo do të thotë që edhe një pjesë e sasëve do të ketë qenë deportuar në Konstantinopojë në v. 1467, ku sasët e morën besimin islam dhe u turqizuan. Një dëshmi për këtë fenomen do të ishte, sipas tij, ruajtja e kujtimit me cilësimin turk "Saz" për pjesëtarë të dikurshëm të etnitetit sas. Një deportim tjetër pati afër katër shekuj më vonë.

Të dyja deportimet për të cilat dihen: ai i popullatës së Novobërdës në vitin 1468 dhe ai i 68 banorëve të Stubllës në vitin 1846, kanë të bëjnë mbase me deportimin vetëm apo kryesisht të popullatës katolike, e parë nga pushteti turk për si ekspoziturë e Romës. Kjo rrethanë mbase mund të kuptohet sa kohë që sundimtarët lokalë serbë, kryesisht ata të Novobërdës, e pranuan pozitën prej vazali të pushtuesit turk, me të cilin lidhën edhe krushqi aq të trashë sa që kontesha Milica, e veja e kontit Lazar, e dërgoi të bijën Oliverën në harem të Bajazitit, jo si konkubine e rëndomtë, porse me të drejtën e premtuar që ajo të pillte atje trashëgimtarë për sulltanin.

Në këtë prizëm duhet parë edhe rrethana përse asnjë qeveri e Serbisë që e mbante një sovranitet të tipit vasal mbi Kosovën e sotme (pa Rrafshin e Dukagjinit) në asnjë kohë nuk u interesua për fatin e kishave katolike të minierave-qytete të Kosovës së sotme, përkatësisht të atyre në Trepçë, Novobërdë, Letnicë, në Janjevë e mbase edhe në Bellosicë, përkatësisht Murgull dhe në qytetet e Prishtinës e të Prizrenit. Nuk ka dyshim se kjo ka ndodhur për shkak se kisha ortodokse serbe dhe pushteti serb nuk i ka konsideruar këto kisha kurrë ndonjëherë për të vetat, sepse ato ishin faltore të elementit katolik, kryesisht raguzas e delmat dhe sas, me të cilët ortodoksia serbe ishte, që nga pushtimi nga kjo në vitin 1119 të Kosovës së sotme, në luftë të hapur.

Sado që është temë e patrajtuar kjo nëse në shqipen ka ndonjë element të çakavishtes, përkatësisht të versionit dalmat të kroatishtes, në të mirë të kontakteve gjuhësore e onomastike shqiptare-raguzase, si rezultat

[272] Sh. Sächsische Bergleute im mittelalterlichen Serbien und die "sächsische Kirche" von Novo Brdo, Südost-Forschungen, Band L, 1991, f. 43

i bashkëjetesës, do ta paravendoja huazimin lokal të emrit kroat *siječanj* të muajit *janar*, i cili është i përhapur skaj më skaj të krahinës së Gallapit si *seçk,-u* emër ky të cilin e kam shënuar në katundin Rimanishtë, ku mbase jo krejt rastësisht, porse si dëshmi e bashkëjetesës dhe e konkurrencës së dy gjuhëve, ekziston edhe mikrotoponimi kuptimisht i barasvlershëm *Roga e Kallnorit*. Gjithandej në krahinën e Gallapit emri *seçk* shënon jo emrin e muajit, por një frymë të ftohtë që fryn gjatë muajit janar.

Në dritën e dëshmive të sjella më lart sikur mund të dëshmohet se jo të gjithë raguzasit ishin vendosur vetëm nëpër qytete dhe se këta nuk do të jenë larguar nga Novobërda e nga vende të tjera të Kosovës menjëherë pas pushtimit otoman të Kosovës së sotme. Kjo vlen sidomos për ata raguzas që jetonin në vende më të vogla ku këta kishin hapur puse minierash më të vogla dhe që nuk u rikthyen në Raguzë, prandaj shmica syresh edhe mund të jenë shqiptarizuar apo edhe serbizuar.

6. SHQIPTARËT NË PJESËN JUGORE TË "SERBISË"

"*Në Prokop* (SG: Prokupje) *u bindëm në korrektësisë e të dhënave që i kishim marrë në Nish, se jo thjesht vetëm qytetet e Prokupjes e të Kurshumlisë, porse se edhe e gjithë krahina e Toplicës me përjashtim të vendderdhjes dhe të vendburimit* (të lumit Toplica) *banoheshin me shumicë nga shqiptarët dhe se këta e zotëronin edhe gjithë faqen jugore të maleve të Jastrebac-it dhe deri tek maja e tij kah kalon kufiri aktual i Serbisë*" J. G. von Hahn.[273]

Prania e shqiptarëve në gjysmën e parë të shek. 15. në hapësirën që sot quhet Serbi e Jugut në të cilën sot janë qytetet Kruševac, Kuršumlija, Leskovac, Niš, Prokuplje e Vranje, argumentohet si në bazë të antroponimeve shqipe të dëshmuara në *Libër* dhe në disa dokumente të hartuara e të lëshuara nga sundimtarë lokalë serbë apo të serbizuar, të cilat dokumente kanë të bëjnë me raporte tregtie me Republikën e Raguzës, ashtu edhe në mbështetje të dëshmimit të emrave të vendbanimeve që ekzistojnë edhe sot.

Më shumë material antroponimik përmbahet edhe për këtë hapësirë përsëri në *Librin* e borxhlinjve të raguzasit Michael de Luchari. Këtu janë evidentuar antroponime e patronime të disa borxhlinjve nga vendbanimet: *Makedonzi*, *Ostatouzi*, *Priduoriza*, *Petrila*, *Prupore*, *Slisan*, *Spanzi*,

[273] Sh. Reise von Belgrad nach Saloniki, Wien 1861, f. 17.

Vienoua, Hrospinzi Arbanexo; nga katundet e zhdukura *Gonzi*,[274] *Kupuszi*, *Liuada*, *Sila*, *Tolenouzi*, *Trupostiza*,[275] që do të ketë qenë i banuar me shqiptarë; nga qyteti i Vranjës e të tjerë. Midis këtyre borxhlinjve e qytetarëve ka edhe një numër sish që mbanin antroponime të cilat ndeshen edhe sot si emra të shqiptarëve. Kështu p.sh. në katundin *Gonzi* është shënuar më 1437 edhe një borxhli i cili e mbante antroponimin e shqiptarëve *Vlash* (khs. *Vlatcho Vlax de Gonzi*, f. 81) dhe një person me mbiemrin familiar *Zoto* (khs. *Gurag Zoto de Gonzi*, f. 81). Emra personalë e emra familjarë me prejardhje shqipe mbanin edhe personat *Gonac* (khs. *Gonaz e suo fiol de Hrospinzi Arbanexo*, f. 50. "Gonac-i dhe i biri nga Hrospinci i arbëneshëve") dhe personi *Andria* me patronimin shqiptar *Gonouich* (khs. *Andria Gonouich de Trupostiza*, f. 53.); *Spani* (khs. *Dmitar Spani*, *Bogouaz Spanaz*, f. 51.), *Zoto* (khs. *Gurag Zoto de Gonzi*, f. 81.) si edhe një *Gin* -i (khs. *Priexda Pezetulouich e fradel de Ostatouzj piego Gin per lui*. .."). Këtu kemi të bëjmë me vendbanime të cilat deri në vigjiljen e Kongresit të Berlinit ishin të banuara me popullatë shqiptare. Këtë e dëshmon ruajtja deri në ditë tonat e disave nga këta emra në funksion mbiemrash familjarë të shqiptarëve të dëbuar nga këto hapësira e të vendosur nëpër Kosovë. Kështu "muhaxherët" kosovarë i kanë ruajtur emrat: *Makedonzi* si Maqedonci; *Ostatouzi* si Statovci; *Slisan* si Slishani; *Spanzi* si Spanca; *Vienoua* si Vjanova. Nga defteri osman-turk i regjistrimit të kryefamiljarëve në fundshek. 15, mësojmë se *Gonzi* i dëshmuar në *Librin* e tregtarit raguzas quhej tani Gjonça dhe se banorë të tij ishin edhe Bogdan Nikoviq-i, një banor me mbiemrin Gjon-i; Nikolla Gjon-i; Gjergj Leshjan-i e të tjerë.[276]

Një kapitull më vete përbën edhe çështja e pranisë së raguzasve dhe e bashkëjetesës së tyre me popullatën ndenjëtare shqiptare në vendbanimin mineral të Medvegjës, ku është, e mbase ishte edhe në mesjetë, një minierë e plumbit, cinkut dhe e arit. Vendi ku është kjo minierë dhe ajo vetë, quhet sot *Lesce*. Kjo aq më parë sa kohë që Medvegja e some,[*]

[274] Katundi që sot nuk ekziston më me këtë emër *Gonzi* (lexo Gonci) nga i cili kishte borxhlinj apo dorëzanë tek tregtari raguzas që vepronte në Novobërdë dëshmohet në fundshekullin 15, kur i takonte nahijes Ostrovica, në trajtën *Gjonça*. Duhet të ketë qenë, sipas I. Rexhës, Sllavizimi i onomastikës së vendbanimeve mesjetare arbane në arealin e Novabërdës, Nishit Vranjës dhe Shtipit, f. 132-133, midis Medvegjës dhe Duboçicës së Leskovcit. Duket që ky vendbanim regjistrohet për herë të fundit në defterin e viteve 1566-1574.

[275] Kjo sepse, sipas G. Gjini, Ipeshkvia Shkup-Prizren..., f. 113, ref. 21, Bogumil Hrabak, Dubrovačka naseobina u kopaoničkom rudniku Belom Brdu, Ogledi, Beograd, 1953, f. 58, ref. 12, e citon emrin e këtij vendi si "*de Trupovstica in Albanezi*".

[276] Sh. Prof. Dr. Iljaz Rexha, Regjistrimi. .., f. 143-144.

[*] Sipas Website www.medvedja.org.rs.

paska qenë qytet që nga koha e sundimit romak. Në shek. 1 të erës sonë, kur legjionet romake kaluan në jug të Savës e të Danubit, dhe kur kjo hapësirë iu ndajmbath provincës Moesia e Epërme, Medvegja e sotme quhej *Idimum*. Nëpër këtë qytet kalonte udha kryesore ushtarake "Via militaris" që niste në *Singidunum* (sot Beograd) nëpër *Viminacium* (sot Kostolac) dhe në qytetitn *Naissus* (sot Nish) ku ajo bigëzoj në rrugë shpienin njëra për në Selanik e tjetra për në Maqedoni-Bullgari-Turqi. Në dritën e rrethanës që vendbanimi *Idimum* e kishte në të vërtetë statusin e një *mansio* "qëndrim, ndalesë, stacion; 2. bujtinë, banim" dhe *mutatio* që në kontekstin aktual e kishte kuptimin "vend për këmbimin, ndërrimin e kuajve" fitohet bindja se Medvegja e sotme ishte në kohën romake një *statio* dhe jo ndonjë qytet në kuptimin e mirëfilltë aktual të kësaj fjale.

Së këndejmi kujtoj që identifikimi i vendbanimit *Latnic* që në defterin osman-turk të fundshek. 15 është evidentuar bashkë me katundet Ratkoçerja (Ratkocer/Retkocer), *Petrili Arbanash* e *Bushkova Petrili* (sot Petrilë, serb. Petrilje), *Oporoshtiç* (sot shq. Poroshticë), *Gubavac* (sot Gubavc), *Gjonça* (katundi *Gonzi* i dëshmuar në gjysmën e parë të shek. 15, sot i panjohur me këtë emër) mund të merret për si potencialisht i mundshëm. Duke qenë minierë, ka shumë mundësi që edhe këtu të ketë pasur tregtarë raguzas. Kjo aq më parë pse ndër borxhlinj të të dy tregtarëve raguzas kishte edhe njerëz nga katunde të komunës së sotme të Medvegjës. Mbase nuk është fort e guximshme të mendohet që e raguzasve dhe e katolikëve të tjerë të ketë qenë kisha aktuale e Medvegjës, e ngritur në stilin romanik të bazilikës me kambanare sipri portës në anën perëndimore. Kisha ndërpritet/ ndahet nga dy palë dyer: në perëndim e në jug. Në të mirë të qenies së Medvegjës vendbanim i shqiptarëve e i raguzasve do të fliste edhe antroponimia e Medvexhës së sotme emri i së cilës në fundshekullin 15 ishte shënuar si *Medejovça*. Në këtë vendbanim, qendër e asokohshme regjionale, jetonin edhe banorët me emra shqiptarë si *Gjon Preniq*-i e Petri *Gjergja* dhe banorët raguzas siç ishte p.sh. zotëruesi i kryhershëm i bashtinës *Piponoviq* si edhe banorët me emër apo mbiemër *Marin*-i; banorët e quajtur Admin e Vota[277] e ndonjë tjetër.

Në kategorinë e emrave shqip, të emrave të shqiptarëve, mund të inkuadrohej me gjasë dhe mbiemri *Baoxich* (khs. Sdrauaz *Baoxich de Prupori*, f. 45.) dhe pikërisht mbi bazën e arealit emëror të gjerë dhe të dendurisë së dëshmimit të këtij emri për emër i shqiptarëve në hapësirën etnolinguistike të tyre. Emri i dëshmuar në këto burime si *Baoxich* (khs. më lart) do të jetë trajtë e serbizuar e emrit që, vështruar edhe etimologjikisht, tek shqiptarët dëshmohet e edhe ruhet më tej në trajtën origjinare

[277] Po ai, po aty, f. 146-147.

të tij si *Balsh, -a*, emër ky që e mbante edhe dera e njohur feudale, sundimtare e Zetës mesjetare *Balshaj* serb. *Balšići* të Malit të Zi të sotëm.

Libri përmban, sikundër u pa deri tani, pak material onomastik mbi bazën e të cilit do të mund të rindërtohej struktura e plotë e antroponimisë së shqiptarëve në atë pjesë të hapësirës etnolinguistike të tyre që sot quhet Serbi e Jugut. Kjo në rend të parë edhe për shkak se regjioni është zonë e skajshme e aktivitetit të tregtarit raguzas Michael de Luchari dhe pse për këtë regjion ka në përgjithësi pak burime shkrimore jo vetëm për periudhën midis shekujve 14-15. Edhe në mbështetje të këtyre pak thërmizave onomastike mund të merret vesh se shqiptarët e këtij regjioni ia dolën ta ruajnë mëvetësinë etnike të tyre e bashkë me këtë vetvetiu edhe një pjesë të antroponimisë së tyre (kryesisht atë me karakter pagan) e cila edhe këndej, si gjithandej kah kishte shqiptarë, u shënua, ani pse rastësisht e pjesërisht, nëpër burime shkrimore. Krejt kjo lë të kuptohet se materiali onomastik shqiptar dhe ai i shqiptarëve, i dëshmuar në këtë regjion, as nuk është i sjell këndej si rezultat i ndonjë zgjerimi territorial të shqiptarëve e, aq më pak, mund të jetë rezultat i ndonjëfarë ndikimi shqiptar mbi ndonjë popullatë të kësaj zone e cila nuk do të ishte shqiptare. Antroponimet e dëshmuara shqipe në gjysmën e parë të shek. 15 në këtë pjesë të atdheut të kryehershëm të shqiptarëve mund të merren për si dëshmi se edhe kjo pjesë e hapësirës etnolinguistike shqiptare ishte e banuar dendur (në mos kryekëput) nga shqiptarët. Për shkak të dredhive politike të shtetit në ekspansion të Serbisë, të përkrahur nga Rusia dhe të miratuar nga Fuqitë e Mëdha të Perëndimit të Europës, në këtë zonë u aplikua gjatë viteve 1876-1881 një spastrim etnik radikal nga popollsia shqiptare. Kjo ndodhi dëshmohet qartë edhe nga Raporti i G. F. Gould, përfaqësues i Anglisë në Beograd, drejtuar lordit Solisbury më 26 nëntor 1878, i cili shkruante: "Dëgjoj se, kohëve të fundit, qeveria serbe po sillet me egërsi të madhe dhe të panevojshme, mos të them mizorisht, ndaj shqiptarëve në krahinat e dorëzimit. Nëse informata ime është e saktë, madje kam arsye të besoj se është ashtu, banorët paqëdashës dhe punëtorë të zellshëm të mbi 100 fshatrave shqiptare të Luginës së Toplicës dhe të Vranjës u dëbuan […]. Këta njerëz fatkeq që nga kjo kohë janë duke shtegtuar poshtë e përpjetë duke vuajtur nga uria në vendin e egër përtej kufirit të ri serb. Ata nuk ishin lejuar t'i mblidhnin të lashtat e tokës së tyre, të cilat korreshin nga ushtarët serbë, megjithëse herë pas here dërgonin delegatë dhe shumë peticione të drejtuara qeverisë serbe, duke i ofruar nënshtrimin e tyre dhe duke përmendur se do të bëhen të nënshtruar besnikë të princit Milan. Çdoherë kur kërkonin ta tejkalonin vijën e reparteve të rojave, vriteshin dhe në disa raste nga dëshpërimi i

dukshëm kishin marrë masa hakmarrëse, të cilat serbëve u kushtonin bukur shtrenjtë…”.[278]

Popullata shqiptare e këtyre viseve u vendos pjesërisht në Kosovë, ndërsa në pjesën më të madhe emigroi për në Turqi, Egjipt e në Siri. “*Çlirimi i Serbisë së Jugut nga sundimi turk solli me vete ndryshime të konsiderueshme në rrafshin e* (strukturës së) *popullsisë. Kjo ndodhi në mënyrë të veçantë në regjionin perëndimor të lumit të Moravës. Nga vendbanime të dikurshme të shqiptarëve këtu mbetën vetëm pak sosh. Shumica e tyre* (SG: e shqiptarëve) *u dëbuan. Katundet e tyre u popullуan me elemente sllave, me ç’rast në këto katunde nuk u vendosën vetëm njerëz nga katunde fqinje, porse pjesërisht edhe sllavë nga regjionet perëndimore* [...] *Sipas të dhënave të shumë autoktonëve, katundet sllave të cilat më parë i kishin për fqinj ato shqiptare - si p.sh. pjesërisht atykëtu në segmentin midis Leskovcit e Vranjës - e kanë ruajtur në të folmen e tyre një veçori fonetike të shqipes*” - thoshte O. Bloch.[279]

Më hollësisht për dëbimin e shqiptarëve nga kjo hapësirë mësohet nga studime me karakter gjeohistorik e etnologjik, të cilat kanë mbështetje tek burimet. Dihet qëkur se para dëbimit të shqiptarëve në vitet 1876/ 1878, në regjionin përreth Prokupjes, Dobrić-it, Vranjes e Nishit kishte 545 vendbanime të banuara nga shqiptarët. Nga ky numër, 347 vendbanime banoheshin vetëm nga shqiptarët, ndërsa popullsia e 198 katundeve ishte e përzier, shqiptare e serbe.[280] Shqiptarët e këtij regjioni nuk ishin vetëm banorë katundesh, porse ata jetonin edhe nëpër qytete siç ishte p.sh. rasti me qytetin e Prokupjes. Në këtë qytet, përveç raguzasve, jetonin edhe shqiptarë. Për këtë e kemi një dëshmi nga Pietro Maserecio alias Pjetër Mazrreku të viteve 1623-1624, i cili në shërbim të Propagandës Fide e njoftonte Vatikanin përkitazi me gjendjen e katolikëve në Ballkan. Në Procopie (serb. Prokuplje) Mazrreku, për si katolikë, i gjeti në këtë qytet disa familje raguzase e shqiptare. Katolikë kishte edhe në disa katunde të largëta të Procopias. Mirëpo, sipas raportit të shqiptarit Pjetër Mazrreku, këta katolikë nuk paskan qenë popullatë vendëse, porse të vendosur andej nga krahina e Pultit.[281] Prania e shqiptarëve edhe në mesjetën e vonë në

[278] Sipas M. Pirraku, Për kauzën e shtetësisë së Kosovës, bot. Radio Frée Kosova, Prishtinë 2008, f. 207-208.

[279] Sh. Südslawische Dialektstudien III (Die Dialekte des südlichen Serbien),Wien, 1903, 5.

[280] sipas: Sabit Uka, Vendbanimet e sanxhakut të Nishit të banuara me popullatë shqiptare dhe të përzier deri në vitet 1877/78, Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 12, Prishtinë 1982, f. 108 -111.

[281] Sipas. Krunoslav Draganović: Izvješće apostolskog vizitatora Petra Masarechija o prilikama katol. naroda u Bugarskoj, Srbiji, Srijemu, Slavoniji i Bosni g. 1623. i 1624, STARINE JAZU 39(1938), f. 1-49. Khs. tekstin origjinal në f. 22 të punimit të cituar

këtë regjion të quajtur më vonë "Serbi e Jugut", dëshmohet edhe mbi bazën e jo pak oikonimeve me prejardhje shqipe të cilat dëshmohen në shumë burime të shkruara të shekujve 14-15. Me prejardhje shqipe është p.sh. emri i katundit *Tanuš* tanimë i zhdukur - njëri nga katunde afër Dubočic-ës që dëshmohet në vitet 1444-1446.[282] Është meritë e I. Rexhës[283] që ka treguar se njëri nga tre kryefamiljarët (në katund ishte regjistruar edhe një beqar) e këtij katundi quhej Nikola, i bir i *Tanushiq*-it, rrethanë kjo që tregon, gjithnjë sipas I. Rexhës, se ky katund ishte banuar edhe ndonjë brez më parë nga një vëllazëri që e kshte për pararendës një shqiptar të quajur *Tanush*.

Oikonimet e dëshmuara në *Libër Gonzi*, *Kastrat* dhe *Zur*, *Spanzi*, e *Prexolin* - ky i fundit një emërtim i zhdukur i vendbanimit që do të ketë qenë në rrethina të Vranjës - dhe *Vlaxzi*- katundi i sotëm shqiptar Vllasë midis komunave të sotme të Kamenicës e të Medvexhës; *Muzać* (i dëshmuar edhe si *Muzaća*/*Musać* dhe *Muzaće*) - afër Prokuplje-s; *Kuć* dhe *Pljakovce* (në shek. 19 i shënuar edhe si *Pljakova*); *Kodra* - katund në rrethina të Kosanica-s; *Geglja* - katund në rrethina të Jablanica-s; *Buštran* dhe *Kriva Feja* afër Pčinj-it; *Mazarići* në rrethina të Poljanica-s e të tjera, të cilat të gjitha pa përjashtim janë formime oikonimike nga antroponime, emra vëllazërish e apelativa shqip [Emri *Tanuš* është me prejardhje antroponimike. Kjo është trajtë e oikonimizuar e emrit të vëllazërisë, i cili rrjedh nga antroponimi shqip Tanush (> lat. Tanussius); emri *Gonzi* rrjedh nga trajta e etnonimizuar e antroponimit shqiptar *Gon* (shq. Gjon) i zgjeruar me prapashtesën derivative sllave *-ci*; oikonimi *Spanzi* rrjedh nga antroponimi i shqiptarëve *Span* (> gr. σπανός "qeros, pa mjekërr) i zgjeruar gjithashtu me prapashtesën derivative sllave *-ci*; oikonimi *Musaća*/*Musać*/*Muzaće* është formuar nga antrtoponimi shqip Muzak/Muzaq (nga shq. muzat/mëzat); bazë e oikonimit dhe e emrit të vëllazërisë *Kuć* është mbiemri, përkatësisht antroponimi Kuq (> mb. shq. kuq); emri *Mazarići* është formuar nga ofiçi shqip *mazarak* (> maz "i vogli i pelës" + suf. *-ar*, *-ak*); oikonimi *Pljakovci* është formuar nga antroponimi shqiptar *Plak* (nga mbiemri shqip *plak*) i zgjeruar me prapashtesën serbe -

---

më sipër: "Facendosi partenza da questi luoghi doi giornate lontano u' è Procopie, doue sono dieci case di mercatanti Raguei (!), i quali con molta spesa [73 v.] et difficoltà eressero alcuni anno sono una Cappella, et mantengono il Cappellano. V'erano altre tante case d'Albanesi, transferiti dal loro buchi sterili di certa parte d'Albania chiamata Puletti (!) à questa terra molto fertile, et abondante.. .."

[282] Khs. Olga Zirojević - I. Eren, Popis Kruševca, Toplice i Dubočice u vreme prve vladavine Mehmeda II: 1444-1446, në Vranjski Glasnik 4, Vranje, 1968, f. 398.

[283] Sh. Sllavizimi i onomastikës së vendbanimeve mesjetare arbane në arealin e Novabërdës, Nishit, Vranjës dhe Shtipit…, f. 156.

ov; *-ci*, ndërsa bazë e oikonimit *Geglja* do të jetë pas gjithë gjasësh emri *gegë*, *-a* më parë në funksion të vëllazërisë se sa si distinktiv i përkatësisë dialektore, përkatësisht etnike e fisit të gegëve dhe e ka kuptimin "vend i banuar nga pasardhës ose pjesëtarë të Gegës, përkatësisht të gegëve". Emra vendbanimesh me prejardhje apelativike shqipe janë në këtë hapësirë: *Zur* (i dëshmuar në *Libër*), *Bushtran*, *Kriva feja* dhe *Kodra* që janë formuar nga fjalët shqipe *zhur*; *busht*/*ër*; *venj*/*ë*,-a bot. Taxus Iuniperis "dëllenjë" dhe *kod*/*ër*,*-ra*. Këtu bie edhe emri i vendbanimit *Kastrat*, i cili më parë shënon banorët që jetonin rrënzë një *castra* "kështjellë" se sa që do të ketë shenjuar pjesëtarë të fisit (në kuptimin e mirëfilltë mesjetar të tij) *Kastrati* (>lat. *castra* "qytet, fortifikatë") të ardhur në atë vendbanim.

Në të mirë të korrektësisë së përfundimeve në rrafshin jashtëgjuhësor, përkatësisht të pranisë së etnisë shqiptare në krahinat e Gallapit, Moravës, Karadakut e të Serbisë, sot të quajtur "e Jugut" do të fliste mbase edhe prejardhja e disa antroponimeve dhe e toponimeve të dëshmuara në dokumentet që u shfrytëzuan për hartimin e kësaj trajtese.

7. RRETH PREJARDHJES SË DISA ANTROPONIMEVE TË DËSHMUARA NË BURIME RAGUZASE

BEC- (khs. Diuaz *Bezich*, f. 8*)

Ky emër rrjedh nga fjala shqipe *bec*,-i "qengj i njomë; i ri".[284] Kemi të bëjmë me njërin nga antroponimet gjithshqiptare i cili, në funksion të mbiemrit familjar përkatësisht të vëllazërisë, ndeshet si në pjesën Jugore ashtu edhe në atë Veriore e Lindore të hapësirës gjuhësore të shqipes. Ky emër është i motivuar nga terminologjia baritore. Trajta e dëshmuar *Beciq* në *Libër* është zgjerim me prapashtesën sllave *-ić*. I kësaj prejardhje është edhe emri *Bec* i katundit në rrethina të Gjakovës.

BIB, -I / BIBË,-A (*Nouach Sarthinou setha Biba*; *Bogouaz Bibal*, f. 9.)

Ka shumë gjasë që ky antroponim të jetë me prejardhje latine. Ky emër dëshmohet kryesisht në hapësirën e dialektit gegë dhe është trajtë shqipe e antroponimit latin *Vibius* /*Baebius*, i cili ndër shqiptarët është reflektuar edhe në trajtat *Beb* e *Bep*. Ndonjë dijetar, si p.sh.. Fr. Nopcsa, kujton se emri *Bib*, *Bibë* është antroponim i shqiptarëve i cili është i lidhur me uzusin antroponimik, përkatësisht me shenjtorët e kishës katolike dhe se ky emër, si i këtillë, po u dashka të ishte trajtë shqipe e emrit të gjithkrishter *Josef*. Me të padrejtë Nopcsa

* Numrat e faqeve, pas shembujve të shkruar kursiv, i referohen botimit të M. Dinić-it, Iz Drubrovačkog Arhiva I.,)

[284] Sh. Eqrem Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, A - B, Tiranë 1976, f. 188.

i radhiste në këtë kategori edhe antroponimet e shqiptarëve *Zef* e *Pepë*.[285] Në faqen pasuese të të njëjtit punim, Nopcsa e lejonte mundësinë e konsiderimit të antroponimit Biba për emër pagan të shqiptarëve.

BUS HAT (khs. *Gez Buxatouich*, f. 38)

Antroponimi *Bushat* do të ketë qenë, në krye të herës, kryesisht antroponim i njerëzve të bashkësive baritore, të katuneve. Sipas E. Çabej, përmes emrit personal semantikisht të motivuar kështu, pjesa baritore e popullatës shqiptare do ta ketë shprehur dëshirën që famulli i ri i bashkësisë të ketë tokë buke dhe të merret me bujqësi.[286] (në rrafshin e motivimit semantik khs. për këtë gr. Γεώργιος nga gr. γεώργιος, ‚bujk" dhe antroponimin shqip *Bulk*[287] nga shq. *bulk,-u*, sot *bujk,-u* nga lat. *bubulcus*.).

Në dritën e rrethanës që antroponimi *Bushat* dëshmohet për emër i shqiptarëve të Kosovës edhe para infiltrimit të personave shqiptarë të Veriut të Shqipërisë (kujto p.sh. mikrotoponimin *Bušatove kuće* të shek. 14 dhe ka vetëm një dëshmi të një individi emri i të cilit përcillet me atributin *arbanexe* "*arbënesh, shqiptar*") në Kosovë vinin ose si qytetarë të Raguzës ose si klerikë nga Tivari, Kotori etj. mund të mbrohet mendimi se këtu kemi të bëjmë me një antroponim vendës të shqiptarëve të Kosovës, si pjesë e uzusit antroponmik nacional të tyre.

GAN,-I -(khs. *Andria Gan*; *Gurag Gan* foxer de Pdgradia, f. 9, 69)

Antroponimi *Gan* ndeshet ndër rumunë e ndër bullgarë dhe në hapësirën e sotme të Maqedonisë, (sh. më poshtë). G. Weigand[288] kujtonte se tek bullgarët p.sh., antroponimi *Gan* do të jetë trajtë e shkurtër e emrit *Gergana*, përkatësisht se kemi të bëjmë me mashkullorizim të një emri femëror. N. A. Constantinescu[289] vëren nga ana e tij se ky emër tek rumunët dëshmohet në trajtat *Gan*, *Gane*, *Ganescu*, *Ganeşti* dhe *Ganeasa*, *Ganicel* etj. dhe mendon se prejardhja e këtij emri është e paqartë, mirëpo nuk ia mbyll shtegun mundësisë që këtu të kemi të bëjmë me një kontatim me emrin bullgar *Gan* (nga *Gergana*). Mirëpo nëse antroponimi *Gan* nuk është trajtë e shkurtër e ndonjë emri, porse forma e kryehershme e një emri të padëshmuar deri tani në hapësirën e Kosovës, atëherë ky do të mund të konsiderohej emër në raport farefisërie dhe i së njëjtës prejardhje si edhe antroponimi *Ganus*, i cili dëshmohet qysh në vitet 1178 e

[285] Sh. Prinosi starijoj povijesti sjeverne Albanije, Glasnik Zemaljskog Muzeja u Bosni i Hercegovini, 30 (1910), f. 360.

[286] Sh., Studime gjuhësore 1, Prishtinë, 1977, f. 85.

[287] Me kusht që sqarimi im i emrit të zhdukur të vendbanimit *Bulkovce* (të dëshmuar më 1455, sh. Oblast Brankovića. .., f. 89) përmes një antroponimi shqip të padëshmuar **Bulk*, ‚bujk" (sh. Punimin tim "Cili është katundi *Bulkovce* i vitit 1455?„ ‚Rilindja'' 23. VIII. 1978, f. 13) të jetë i pranueshëm.

[288] Sh. Die bulgarischen Rufnamen, ihre Herkunft, Kürzungen und Neubildungen, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache (26-29 (1921), f. 122.

[289] Sh. Dicționar onomastic romînesc, Bukarest 1963, f. 62.

1342 ndër banorë romanë të qytetit të Splitit dhe të ujdhesës së Krk-as.[290] Një dëshmi për praninë e një venedikasi që kishte jetuar në Kosovë dhe që e mbante këtë emër e kemi nga viti 1349 kur përmendet bujari venedikas *ser Ganninus Giorgi* i cili jetonte në Trepçë. Kësi emri, përkatësisht mbiemri, mbante më 1481edhe mjeshtri i kërkuar i xehetarisë Iuan, përkatësisht *Gan Lapora* i Novobërdës.[291] Po ky antroponim ndeshet porse edhe në një paralagje të qytetit të Shtipit kur në një shkresë të viteve 1293-1302 të sundimtarit serb Stefan Urosh përkitazi me katundet dhe me njerëzit që ky ia falte manastirit të Hilandarit, përmendet edhe një Bratil-i, dhëndër i *Gan*-it.[292] Mua më duket më i pranueshëm mendimi se këtu kemi të bëjmë me një emër roman të shqiptarëve se sa me një emër pagan, sikundër mendonte Fr. Nopcsa.[293]

GEC,-I (khs. *Gez Buxatouich*; *Gez*, fante der Dmiter Soimirouch, f. 8 ?)

Emri *Gec* është pas gjithë gjasash trajtë e shkurtër e antroponimit *Geg*/*ë*,*-a* (sh. më poshtë). Trajta *Gec* ka dalë pas gjithë gjasësh në bazë të rrugës zhvillimore të gjedhës që ka vepruar edhe tek trajtat *Lec*,-i*; Pec*,-i. Trajta e shkurtër Lec do të jetë krijuar përgjatë fazave zhvillimore përbrenda shqipes: *Nicolaeus* < *Nikollë* < *Kolë* < *Kolec* < *Lec*. Po ky fenomen do ta ketë prekur pas gjithë gjasësh edhe emrin *Pec*,*-i*, përkatësisht *Petrus* < *Pjetër* < *Petrec* < *Pec*. Së këndejmi do të mund të paravendohej se trajta Gec do të jetë pas gjithë gjasësh zhvillim përmes fazave *Gegë* < *Geglec* < *Gegec* < *Gec*. Variante bullgare të antroponimit Gergo janë: *Geko*, *Geto*, (*Geco*?), *Gečo*.[294]

GEG/ Ë, -A (khs. *Dom Georgius Gega*, f. 5.,14)

Është krejtësisht e qartë që mbiemri familiar i dëshmuar *Gega* përputhet me distinktivin për folës të dialektit (gegnisht, gegërisht) me përhapje absolutisht më të gjerë përbrenda hapësirë etnolinguistike të shqiptarëve, distniktiv ky që përpak se nuk e ka marrë nuansën e përkatësisë "etnike" përbrenda hapësirës dialektore të quajtur *Gegni*,*-a* (tosk. *Gegëri*,*-a*) në të cilën flitet dialekti *gegnisht* (tosk. *gegërisht*). Mirëpo sikundër e tregojnë shembujt nga mikrotoponimia (sh. për këtë kapitullin 2 të këtij punimi), emri *Gegë*, *Gega* është dëshmuar shumë shpesh në funksion të antroponimit të mirëfilltë të shqiptarëve dhe pikërisht në hapësirën territoriale të dialektit të gegërishtes, përkatësisht ndër vetë gegët. Mbi bazën e këtij fakti do të mund të thuhej se nuk është e lehtë të besosh se antroponimi *Gega* do t'i ketë shënuar pjesëtarët, banorët e Gegnisë dhe folësit e gegnishtes. Së këndejmi mund të besohet më shumë se këtu kemi të bëjmë me

[290] Khs. C. Jireček, Die Romanen in den Städten Dalmatiens. .., f. 37.
[291] Khs. J. Drançolli, Raguzanët në Kosovë …, f. 140, 207.
[292] Khs. Fr. Miklosich, Monumenta Serbica. .., f. 62: "Bratilь, Ganovъ zętь, sь dětiju".
[293] Khs. Prinosi starijoj povijesti sjeverne Albanije,. .., f. 361.
[294] Khs. Prof. Dr. Gustav Weigand: Die bulgarischen Rufnamen, Ihre Herkunft, Kürzungen und Neubildungen, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache (Rumänisches Seminar), 15/1909, f. 112

një antroponim të cilit ende nuk ia dimë kuptimin. Kjo nuk do të thotë porse që nuk ka vend që ky emër të sillet në lidhje me përputhjen mbase jo krejt të rastësishme të tij me fjalën rumune *ghioaga*, e cila në bullgarishten del në trajtën *gega* dhe e ka në këtë gjuhë kuptimin "shkop i bariut"[295] dhe ndeshet p.sh. edhe në mikrotoponimin bullgar *Gegovi kolibi* "Tbanet, kasollet e Gegës" dhe që ka të bëjë me një vëllazëri të popullatës së pomakëve në katundin Sv. Petka në Bullgari.[296] Nëse kjo nuk është vetëm një përputhje fonematike e rastit, atëherë do të mund të paravendohej se tek antroponimi *Gega* kemi të bëjmë me një antroponim që e shenjonte bariun. Në këtë rast antroponimi Gega do të ishte i motivuar me zejen dhe jetën prej bariu, ashtu sikundër përmes antroponimit Bushat është shprehur dëshira që bartësi i atij emri të ketë tokë buke dhe të merrej me bujqësi. Ndryshe mendonte Fr. Nopcsa.[297] Ky i dilte zot mendimit se jo vetëm emri Gega, porse edhe antroponimet e shqiptarëve *Gjec,-i* e *Gjekë,-a* qenkan trajta shqipe të emrit të gjithkrishter Gjergj, përkatësisht *Georgius*.

GOVOR,-I (khs. Vlaxin *Gouorchouich* de Jasenouich, f. 42)

Mbiemri i dëshmuar në trajtën *Gouochouich* (lexo Govorkoviq) është pas gjithë gjasash i formuar nga substantivi *govor* "të folurit" dhe prapashtesa sllave -ko, *-v-,-ić*. Si i këtillë, mbiemri Govorkoviq do të binte ndër emra sllavë të shqiptarëve, emër ky që në shek. 13, përkatësisht në vitin 1289, ndeshet të jetë bartur edhe nga popullata romane e Zarës (khs. mbiemrin *Govornico* / *Governica*, përkatësisht "[...] quodam Sergius de G(overnico) civis Iadrae. .. "), të cilin K. Jireček[298] e ndonjë dijetar tjetër si Mate Šimundić,[299] e sqarojnë si emër sllav nga slav. *govornik*, lat. "orator", shq. "folës". Këtij sqarimi parimisht të drejtë bën t'i shtohet edhe mendimi i P. Skok-ut, i cili ka të bëjë me emrin e vendbanimit *Govorljevo*, përkatësisht *Govrljevo*. Përsa i bie prejardhjes së emrit të këtij vendbanimi P. Skok mendonte se emrin në trajtën Govorljevo duhet parë si një mbiemrorizim të antroponimit *Gavril*/*Gavrl*. Skok-u e lente porse në këtë mes të hapur edhe mundësinë që emri Govorljevo, i dëshmuar në një mbishkrim varri të vitit 1820 të jetë një emër sllav kryesisht në dritën e rrethanës pse ndër antroponime sllave ka një numër të madh antroponimesh të cilat janë sajuar nga rrënja sllave *govor* "të folurit". Për *o*-në e mirëfilltë në togun *-or-* Skok-u kujton se i takon shqiptimit torbesh, e cili tog në të folme jotorbeshe është tërrnuar me *-r* -në sonantike.[300] Pikërisht trajta Govorljevo e këtij oikonimi, të cilin P. Skok e trajtonte shkurtazi, e hap shtegun së pakut për ta shtruar pyetjen a mos me këtë

[295] Khs. D. Scheludko, Lateinische und rumänische Elemente in Bulgarischen, Balkan-Archiv 2(1927), f. 285.

[296] Khs. Iv. Batakliev, Čepino (specialno-geografski proučavanja), Sofia, 1930, f. 170.

[297] Sh. Prinosi starijoj povijesti sjeverne Albanije,. .., f. 360.

[298] Sh. Die Romanen in den Städten Damlatiens. .. f. 29.

[299] Značenje nekolikih stranih osobnih imena tuđega podrijetla, Onomatološki prilozi II (Belgrad) 1981.

[300] Khs. P.Skok Iz toponomastike Južne Srbije II,, (Skopska Kotlina), Glasnik Skopskog Naučnog Društva 15-16 (1936), f. 109.

emër mund të kenë lidhje farefisërore edhe emri i zhdukur i katundit *Govъпъ* i viteve 1292-1300,[301] përkatësisht emri i katunit *govnečije* të vllehve i vitit 1330, emri i katundit *Goven* në Mal të Zi[302] dhe antroponimi *Goven* i një banori të katundit Rzhaniça në Mal të Zi, i shënuar në vitin 1485.[303] A mos është ndoshta trajta Govorljevo, e në këtë kontekst edhe antroponimi i dëshmuar tek romanët zariotë rezultat i prirjes sllave që emrat e pakuptueshëm përmes një pseudorotacizimi, rrënjën për ta të pakuptueshme emërore *Gov-* t'ia afrojnë ndjesisë sllave gjuhësore?.

LEK / Ë,-A (khs. *Lecha Ginouich*, f. 8.)

Dihet kaherë për si çështje e padiskutueshme se emri i gjithkrishter Alexander, përkatësisht gr. Ἀλεξανδρος dhe trajta e shkurtër e tij Ἀλεξιος është reflektuar në shqipen si *Lesh*/*Llesh*.[304] Ka shumë arsye të besohet që trajta e shkurtër shqipe *Lekë* është një refleks i ri i emrit të gjithkrishterë Alexander. Përkrah trajtave Lesh, Llesh e Lekë tek shqiptarët ekzistojnë edhe reflekset, përkatësisht trajtat e shkurtra, *Aleks*, *Leks*, *Leksh* dhe *Sandër*. Sikur trajta e shkurtër e këtij antroponimi të gjithkrishter të ishte në Kosovën mesjetare refleks serb i këtij emri të gjithkrishterë, do të duhej të dilte (edhe) në trajtën deminutive *Aca* të serbishtes.*

MJEK (-SH,-A) (khs. *Miechxa*, f. 18)

Emri *Miechxa* është zhvillim deminutiv shqiptar me prapashtesën e përkëdhelisë *-sh* i apelativit shqip *mjek,-u*. Po qe se ky shpjegim mund të merret për i qëlluar, atëherë do të mund të thuhej se antroponimi Mjeksh, përkatësisht *Miechx,-a* do të jetë njëri ndër antroponime pagane të shqiptarëve. Si i këtillë, ky dhe vetëm ky antroponim nuk do të ketë gjë të përbashkët, përveç një përputhjeje të rastësishme fonematike, as me antroponimin *Mechxa* (lexo Meksha) e as me të tjera antroponime të cilat mund të rrjedhin nga mbiemri sllav *mekъ* "i, e butë" [khs. psh. *mekjav'c* - banor i katundit Çabiq dhe *mekinja* – banor i katundit Jablьčno të dëshmuar në vitin 1330.[305]] Kjo aq më parë pse vetë hartuesi i *Librit* i dallon mirë emrat *Mechxa* e *Miechxa* e edhe pse në hapësirën gjuhësore të shqipes që të dy këta emra gjallojnë në dy forma të ndryshme, ç'është e drejta vetëm në funksion emrash të vëllazërive, në trajtat *Mjek* e *Mekë* përkatësisht *Meka*, *Mekaj* dhe *Mjeku* e *Mjekiqi* që ndeshen edhe në mikrotoponime me prejar-

[301] Khs. Fr. Miklosich, Monumenta serbica spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii, Wien 1858, f. 58.

[302] M. S. Milojević: Dečanska hrisovulja, Glasnik Srpskog Učenog Društva 12 (1880), 52.

[303] Khs. Selami Pulaha, Defteri..., f. 108.

[304] Sh. për këtë: Eqrem Çabej, Der Name Alexander in der albanischen Volkssprache, Eteria Makedhonikon Spudhon - Makedoniki Vivliothiki, A.P. 57, Thessaloniki 1980, f. 157-159.

* Komunikim me gojë i nxënësit dhe mikut tim Naim D. Shala.

[305] Sh. M. S. Milojević, Dečanske hrisovulja..., f. 23, 58.

dhje antroponimike. Bile në antroponiminë moderne aktuale të shqiptarëve ka një korelat semantik (*i, e*) *butë* tek emri femëror *Bute* që ndeshet ndër vajza e gra të Rrafshit të Dukagjinit, por më shumë të krahinës së Rugovës. Ka ç'është e drejta edhe një mundësi tjetër e kjo është që antroponimi i dëshmuar i shqiptarëve Meksh të jetë në lidhje etimologjike me antroponimin e shqiptarëve Meks/ Meksh. Në këtë rast mund të paravendohet se kishte të drejtë dijetari Fr. Nopcsa[306] i cili këtë emër të shqiptarëve e shihte për emër pagan. Si i këtillë, emri *Mechxa* do të mund të sqarohej me emrin shqip të shtazës *meksh,-i* "i vogli i buallicës" nëse ky interpretim nuk bie ndesh me kohën kur kjo shtazë paraqitet në këtë pjesë të Ballkanit që e banojnë shqiptarët. Nëse ky shpjegim është i pranueshëm, atëherë do të mund të paravendohej se fjala e shqipes së folur në Dardaninë antike, *mjek* me prejardhje latine ishte e gjallë në leksikun aktiv të shqipes edhe në shk. 15. Vetëm më vonë, siç e tregojnë mikrotoponimet e tipit *Kroni i heqimit*, kjo fjalë u zvendësua me fjalën orientale *heqim* "mjek", jo porse me fjalën sllave *vrač* "magjistar, mjek popullor".

NAFORA (khs. *Gin Nafora*, f. 8)

Mbiemri *Nafora* i një shqiptari nuk dëshmohet kurrë përpara e as pas viteve 1438-1440 në asnjë vend të ambientit ernik të shqiptarëve për mbiemër të tyre. Ky mbiemër i individit shqiptar - banor i Novobërdës mesjetare - e heq prejardhjen nga greq. ναφόρα "bukë e bekuar; ostie".[307] Rrethana që një individ i quajtur *Gin* e mban një mbiemër jo vetëm me prejardhje greke, porse nga një term kishëtar i ortodoksisë greke, dëshmon se ky person nuk mund të jetë ndonjë individ nga Jugu orthodoks i Shqipërisë së sotme, sepse njerëz të vendosur nga kjo hapësirë nuk janë dëshmuar në Novobërdën mesjetare, e aq më pak nga Veriu katolik i Shqipërisë, porse një kosovar vendës i cili e paska ruajtur një atribut të qytetarit të perandorisë së Bizantit, përkatësisht të kishës së krishterë të ritit bizantin.

NIKS H (khs. Pircho e *Giuka de Nichxa* f. 68; top. Nichxino Cholo, f. 15.)

N. Jokl e ka treguar bindshëm se emri shqiptar *Nikshi* i vëllazërisë në krahinëzën e Kelmendëve (Shqipëri e Veriut) është një formë deminutive e emrit të gjithkrishterë *Nicolaus*, përkatësisht Nikollë, i trajtësuar përmes prapashtesës shqipe të zbutnisë *-sh* (khs. *gogsh* "i bir i rumunit, i vllahut" nga *gog*/*ë,-a* "rumun; vllah"). Këtu bie edhe emri i fisit malazias *Nikšići*, tani sllav, dhe i kryeqendrës së tyre të banimit *Nikšić*(i) që është formuar përmes gojës së shqipfolësve (nga trajta deminutive shqipe *Niksh* e antroponimit të

[306] Sh. Prinosi starijoj povijesti sjeverne Albanije,. ..,. f. 361.

[307] Khs. Dr. Franz Miklosich, Fremdwörter in den slawischen Sprachen, Denkschriften der Wiener Akademie, XV (1866), f. 113.

gjithkrishterë *Nikollë* < *Nikë* + prapashtesa sllave *-ić*,*-i*)[308] dhe vazhdo të jetojë edhe sot. Këtë sqarim të Joklit e ka pranuar edhe I. Popoviq.[309]

PREK AL (khs. Dean *Prechal*, f. 7.)

Ky është një antroponim shqiptar i cili shtrihet kryesisht në pjesën Veriore të hapësirës gjuhësore të shqipes. Emri *Prekal* është trajtë deminutive e antroponimit *Prenk* i zgjeruar me prapashtesën e zvogëlisë *-al* (khs. p.sh. edhe trajtën *Kuqal* të antroponimit Kuq). Ekziston një mendim ende i diskutueshëm sipas të cilit antroponimi i shqiptarëve *Pren*/*Prend* (që në të vërtetë janë trajta të emrit të kryehershëm *Prenk*), qenka me prejardhje ilire, përkatësisht që qenka në lidhje birësie me emrin e hyjneshës ilire *Ana Perenna*. Sipas këtij mendimi, emri i hyjneshës ilire Ana Perenna qenka ruajtur tek shqiptarët tek emri i shenjtores Shna Prenja.[310] Një mendim tjetër për prejardhjen e këtij emri e pat dhënë para gati më shumë se një shekulli konti Fr. Nopcsa. Ky dijetar kujtonte se emri *Pren* i shqiptarëve, i cili del edhe në trajtat *Prelash*, *Preç*, *Prek*, *Prelë*, *Prenash*, *Prenk*, *Prenoz* dhe *Prenush* është me prejardhje nga emri lat. *Primus* "i parë, parak"[311] (khs. edhe antroponimet e rumunëve *Părv*/*an, -oci*, *Pîrvu* - nga slav. *prъvъ* "i parë, i pari").

PRODAN, PROGON (khs. *Vochxa* e Prodan de Sirze cholo, f. 8)

Një emër i shqiptarëve i dëshmuar dendur gjatë shekujve 13 e 14. Ky antroponim përmbahet në emrin e një dinastie të shqiptarëve të quajtur *Progono* (i dëshmuar në burime veneciane). Një vëllazëri në Mal të Zi e mbante emrin *Progonović*, ndërsa në krye të Pashtroviqëve, një vëllazëri po në Mal të Zi, qëndronte një *comes Progonus*. Në dokumente greke emri i kësaj vëllazërie është shënuar edhe si Πρόγονος.[312]

Sipas mendimit të përgjithshëm, antroponimi Progon është një emër karakteristik i shqiptarëve.[313]

Relativisht më gjerësisht me këtë emër është marrë P. Skok.[314] Ky e merr për të mundshme që antroponimi Progon të rrjedh nga emri grek Πρόδρομος

[308] Sh. Zur Ortsnamenkunde Albaniens, Zeitschrift für Ortsnamenforschung 10 (1934), 193.

[309] Sh. Geschichte der serbokroatischen Sprache, Wiesbaden 1960, f. 482.

[310] Khs. psh. E. Cozzi, Credenze e superstitioni nella Montagna dell`Albania, Anthropos 9 (1914), f. 449 - 467. (cituar sipas N. Jokl, Albanische Bibliographie; Indogermanisches Jahresbuch 4 (1816), f. 100-101.

[311] Khs. punimin e tij Prniosi. .., f. 360.

[312] Sh. P. Skok, *Zum Balkanlatein*, f. 478; Georg Stadtmüller, Forschungen zur albanischen Frühgeschichte, Wiesbaden 1966, 168, referenca 35.

[313] Kështu mendon madje edhe A. M. Se1iščev, Slavjanskoe naselenie v Albanii, Sofija, 1931, f. 61.

[314] Khs. P. Skok Zum Balkanlatein VI, Zeitschrift für romanische Philologie 54 (1934), f. 478 dhe Dolazak Slavena na Mediteran, Split, 1931, f. 194.

(ofiç i shën Gjonit Pagëzues:, ‚pararendës, paraardhës") ashtu si edhe emri Prodan ndër romanë mesjetarë dhe ndër sllavë të Dalmacisë. Trajta shqipe *Progon* përshkohet, sipas Skok-ut nga po ajo paqartësi e kalimit të *d* → *g* të cilën ky e supozon të jetë i pranishëm edhe tek fjala e shqipes *ogiç*/*ugiç*, ‚dash përçor" që mund të jetë një huazim i shqipes nga sllavishtja *vodić,* ‚prijatar". Ndryshe, antroponimi Progon mund të nxirret edhe nga fjala greke πρόγονος, ‚pararendës".

RUK,- (khs. *Radochna Ruchich* dhe *don Rucha*, f. 19.)

Duke u nisur nga emrat e dëshmuar *radomirъ ručica*, banor i katunit të bullgarëve *katunъ blьgarski* (sot serb. Srbovac, shq. Bugariq në komunën e Mitrovicës) që dëshmohet në vitet 1313-1318;[315] Radoslav-i, i bir i *Ruç*-it dhe Papa, i bir i *Ruç*-it, banorë të katundit Suhagerllë të Istogut që dëshmohen më 1485,[316] trajtë që mund të konsiderohet si e palatalizuar e antroponimit të kryehershëm *Ruk*, atëherë do të mund të thuhej se këtu kemi të bëjmë me një emër, të cilin popullata shqiptare e Kosovës e mbante edhe deri në shek. 14. Në rrethina të Istogut ky emër ndeshet edhe sot dendur si emër i grave *Rukmane*. Qenien në përdorim të këtij antroponimi tek shqiptarët e dëshmon edhe një numër jo i vogël i mikrotoponimeve në të cilat ky është ruajtur si i shtanguar deri në ditë tonat. Le t'i sjellim në këtë mes emrat e vetëm disa vëllazërive shqiptare: *Rukovcët* - vëllazëri në katundin Lisockë të Kamenicës; *Rukiqët* - vëllazëri në katundin Tërstenik të komunës së Skënderajt; *Qafa e Rukës, Sheu i Rukës* dhe *Livadhi i Rukës* në katundin Kuqishtë të krahinës së Rugovës; *Mali i Rukut, Molla e Rukit* dhe *Ara e Rukit* në katundin Gllarevë të Klinës; *Ruçovit* - vëllazëri në katundin Bresalc të komunës së Prishtinës dhe *Ara e Ruçinës* në katundin Zajçec të Kamenicës.

Duket se ky emër nuk mund të ndahet nga antroponimi roman *Ruger* [Nga ky antroponim rrjedhin, si forma të shkurtra e formime me prapashtesa sllave emrat: *Rogate* i shënuar në Split (khs. Rogerius de Rugota) dhe Rugota (khs. Johannis de Rugota) etj. të shënuar në Raguzë[317] (= Dubrovnik) si edhe antroponimet e rumunëve *Ruga*, *Rugescu* dhe *Rugaş*[318] dhe, së fundi, edhe emri femëror i shqiptarëve *Rugjin*/*ë*, *-a*. Le të thuhet në këtë mes se ka një shpjegim sipas të cilit edhe emri *Rugovë* i krahinës po rrjedhka nga një trajtë vllahe e emrit roman *Rug*.[319] Sado që kjo etimologji më duket më e bindshme se ajo sipas së cilës emri Rugovë po rrjedhka nga fjala shqipe *rrugë,* (sepse me prapashtesën gjenitive sllave *-ovo* në shqipen nuk formohen emra vendesh nga apelativa të rëndomtë) ka vend që në këtë mes të mendohet se jo i gjithë regjioni i sotëm i Rugovës përfshihej në mesjetën e vonë nën këtë emër, porse ka mundësi që këtu kemi të bëjmë me zgjerim të emrit të një vendbanimi të vetëm si rezultat i zgje-

[315] Khs. Lj. Kovačević, Svetostefanska hrisovulja, Spomenik SKA IV (1890), f. 31.
[316] Khs. S. Pulaha: Defteri..., f. 344.
[317] Sh. C. Jireček, Die Romanen in den Städten Dalmatiens. .., f. 54-55.
[318] Sh. Iorgu Iordan, Toponimia romineasca, Bucarest, 1963, f. 125.
[319] Khs. Milica Grković, O toponimu Rugova, Onomatološki prilozi III, SANU, Beograd, 1982, f. 188-189.

rimit të hapësirës së kullotave të një vëllazërie që për pararendës e kishte një person bartës të një emri roman ballkanik *Rug*. Atroponimi *Rug* nuk është dëshmuar ndonjëherë në katunde të quajtura të "arbanasëve" e as në vendbanime të tjera të shqiptarëve. Përkundrazi, në ambiente të cilësuara për vllahe, dëshmohet dendur, duke filluar që nga shek. 13.

RUSH- (khs. *Milun fauro e Ruscho suo fiol de Drasne*, f. 80; *Rušъ Ginovikъ* të vitit 1454)

Ky antroponim bie në grupin e emrave të dëshmuar dendur ndër shqiptarë. Përveç dëshmisë në *Libër*, ky është evidentuar edhe në një dokument kishtar serb të vitit 1454, në të cilin del se njëri nga të 24 pleqnarët që nga kisha dhe pushteti aktual serb ishin zgjedhur për t'i përcaktuar mexhët e kontestueshme midis katundeve Pagarushë, Jançishtë e Hoçë ishte edhe një burrë nga katundi Studençan i Suharekës, i quajtur *Rušъ Ginovikъ*.[320] Përveç në këto dy dokumente, antroponimi në trajtën *Rush* dëshmohet në shek. 15 edhe në atë pjesë të banuar me shqiptarë, kryefamiljarët dhe pronat e së cilës binin nën juridiksionin e sanxhakut të Shkodrës, khs. p.sh. të vejën e *Rush*-it, në katundin Istrahaliq në Mal të Zi.[321] Sot ky antroponim ndeshet më dendur si antroponim i vajzave në trajtat *Rushe* e *Rrushe* dhe etimologjia popullore i lidh me fjalën shqipe *rrush,-i*. Fenomeni më i rëndësishëm është në këtë mes në të vërtetë kalimi s < *sh* i emrit me prejardhje latine *Russinus* që sqarohet me mbiemrin latin *russus* "i kuq". Ndër sllavë, ky antroponim del në trajtat *Rusa, Rusin, Rusko, Rusoje, Rusota, Rusek, Rusmir* e në trajta të tjera.[322] Kalimi i s < *sh* si veçori e shqipes dëshmohet, përveç tek emri modern Rushe/Rrushe i vajzave, dhe tek mikrotoponimet moderne *Roga e Rushit* dhe *Ara e Rushit* që ndodhen pikërisht në Çukën e Drashnjez, përkatësisht në *Drasne*-n e gjysmës së parë të shek. 15, për ku dëshmohet edhe banori i quajtur Rushko, përkatësisht *Ruscho*. Nëse emri i këtij pusi prej miniere mund të lidhet me antroponimin *Ruscho* [khs. bujarin raguzas *Tomchus f. de Ruscho de Dersa* që më 1373, po transportonte mall nga Selaniku për Novobërdë dhe *Ruscho Pribisaulich* të cilit bashkëkombasi i vet Radich Cusatouich nga "Trepza turcha" (një lagje e qytetit - minierë të Trepçës) ia plaçkiti 75 funta argjend, pronë e dy raguzasve të tjerë, që ky po i transportonte për në Trepçë,[323]] të dëshmuar ndër raguzas që vepronin në Kosovë, është çështje që do provuar.

Me më shumë kompetencë përkitazi me këtë mbiemër duhet marrë qëndrimin e romanistit, ballkanologut e sllavistit P. Skok. Kur po bënte fjalë përkitazi me mbiemrin *kuq* të shqipes, ky vërente që ky mbiemër është formuar nga lat. *cocceus* sipas modelit siç u formuan mbiemrat *rojo* e spanjolishtes, *roxo* e portugalishtes dhe e bizantinishtes ρούσ(σ)εος(-ιος). Ky mbiemër, gjithnjë sipas

[320] Khs. Aleksandar Solovjev, Odabrani spomenici srpskog prava, Beograd 1926, f. 216.
[321] Khs. S. Pulaha, Defteri..., f. 254.
[322] Khs. K. Jireček, Die Romanen in den Städten Dalmatiens. .., f. 341.
[323] Sipas J. Drançolli, Raguzanët. .., f. 98, 152.

P. Skok, në dakorumanishten është reflektuar si *rus* "e kuqe; e lëkuqme, bjonde" vetëm për shenjimin e ngjyrës së qimeve të shtatit të lopës; në arumanishten si *arus* "blond, bălau, plăvit"; në greq. ρο□σσος "blond" dhe në serbokroatishten *ruš* (edhe në antroponimet *Rusin*, *Rusko*). Në shqipen po u dëshmuaka vetëm tek emri i vendit *Barbullush* që rrjedh nga ofiçi *barba russa* "mjekërrkuq" në funksion të patronimit, i dëshmuar në vitin 1402 për në rrethina të Shkodrës. Në dritën e rrethanës që ky mbiemër dëshmohet në Ballkan nën trajtat *rush*, *rus* Skok e lë të hapur çështjen nëse *roş* e dakorumanishtes dhe *oroş* e arumanishtes rrjedhin nga e lat. *roseus* apo *russeus*. Kjo në rend të parë sepse lëkundje të këtilla midis *o* në vend të *u* dëshmohen edhe ndër gjuhë të tjera në të cilat, nga latinishtja ka depërtuar ky nocion.[324] E. Çabej në një recension për fjalorin e Tache Papahagi-t *Dicţionarul dialectului general şi etimologic*, këtë fjalë e shihte të dalë nga lat. *russus* "i kuq".[325]

SPAN, I (Khs. *Dmitar Spani* dhe *Lesh Spanović*, f. 8, 33; *Bogouaz Spanaz* e *Bogdan Spanaz*)

Norbert Jokl[326] dhe E. Çabej[327] kujtojnë se ky emër i shqiptarëve rrjedh nga bizantinishtja, përkatësisht nga mbiemri i greq. së mesme σπανός "qos, i pa lesh në mjekër; tullac". Fjala e greqishtes së mesme ka hyrë në leksikun e shqipes si *sperk* e *shperk* "tullac; qos", ndërsa *span* e *shpan* vetëm në funksion të mbiemrit (khs. emrin e përbërë të derës feudale shqiptare *Pjetërshpani* (nga Pjetër + Shpan) të shek. 15 dhe emrin e dëshmuar në *Libër* (1438, f. 41) të katundit të banuar nga shqiptarët *Spanzi* (shqiptarët e dinë trajtën Spancë) në pjesën Jugore të Serbisë, përkatësisht në atë lindore të Kosovës. C. Jireček[328] ka vërejtur se emri *Span-* në funksion të mbiemrit familjar përkatësisht të patronimit, është dëshmuar edhe ndër individë banorë qytetesh bregdetare e ishujsh (si p.sh. në Korčula) të Adriatikut. Në dritën e kësaj rrethane Jireček e përkrah tezën se ky emër grek është shtrirë në këtë hapësirë përmes latinishtes. Kjo edhe pse në shqipen, ç'është e drejta, shumë herët kishte depërtuar fjala latine *caries* "të kalburit, kalbje" nga një **caira*, përkatësisht *caria* si *kere*, *kerε* f. "tullac", *keros -zi*, geg. *Keros* "i zgjebosur, tullac " *kirosse* f. *tullace* "[329] dhe bie kështu ndër latinizmat më të vjetra të shqipes.[330] Ky konstatim më bën të besoj se emri *Span* i shqiptarëve megjithmend ka hyrë në përdorim në gjithë hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve në periudhën bizantine.

---

[324] Petar Skok, Zum Balkanlatein, Zeitschrift für romanaische Philologie, XLVIII, 1928.

[325] Zur aromunischen Wortforschung, Studii şi cercetări lingvistice, 1-XXVII/1976, f. 5.

[326] Griechisch-albanische Studien, Festschrift Hofrat Paul Kretschmer (Beiträge zur griechischen und lateinischen Sprachforschung), Wien-Leipzig-New York 1926, 78-95.

[327] Disa faza më të moçme të shqipes në dritën e gjuhëve fqinje, Studime gjuhësore IV, Prishtinë 1986, f. 310.

[328] Sh. Die Romanen in den Städten Dalmatiens. .. f. 341.

[329] G. Meyer, Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache, Straßburg, 1891, 223.

[330] Petar Skok, Bilješke iz rječnika balkanskog latiniteta, Živa antika, Shkup 4 (1954) f. 183.

TANUS H (khs. Andria e Tanus conpari nostri de Liuada, f. 78.)

Ky antroponim gjithshqiptar rrjedh nga antroponimi *Tanussius* me prejardhje latine dhe bie ndër emra të vjetër të shqiptarëve, pa dallim krahine e konfesioni.

TRASHA (khs. Radossau *Trassa*, f. 46)

Një emër familjar dhe antroponim (vetëm femëror) pagan i shqiptarëve, i dalë nga mbiemri shqip (i,e) *trashë*. Paravendohet se ky emër e ka të njëjtën gurrë si edhe antroponimi i dëshmuar në burime shkrimore për si emër i ilirëve *Trossius*.[331] Se emri *Trassa* është me të vërtetë me prejardhje mbiemërore dhe se semantikisht i motivuar me nocionin e trashësisë në kuptimin e shëndetshmërisë do ta tregonte edhe korelati sllav *Debeli Rag foxer* i dëshmuar në *Libër* (1438), edhe nëse kjo dëshmi nuk do të mund e duhej të shihej si një calque linguistique, përkthim i fjalpërfjalshëm i emrit shqiptar, por qoftë edhe vetëm si një përputhje semantike serbe - shqiptare. Qenien në përdorim tek shqiptarët të një antroponimi të motivuar me dëshirën për shëndet sikur e tregon rrethana se ndër shqiptarë në Malin e Zi të sotmin dhe në krahinën e Rugovës (në Kosovë) vazhdo të bëjë jetë antroponimi femëror *Trashe*.

VLAS H -I (khs. *Vlac*, f. 5, 7)

Vlash është një variant shqip i antroponimit *Blasius* - karakteristik të gjithkrishter. Në këtë pjesë të hapësirës etnolinguistike të shqiptarëve ky antroponim ka depërtuar në trajtën që është karakteristike për kishën e Lindjes[332] (khs. trajtat *Vlaho* e *Vlahoje* tek serbët ortodoksë). Për reflekset e trajtës *Blasius* khs. p.sh. variantet kroate e sllovene *Blažko* të këtij emri. E vetmja gjurmë e trajtës karakteristike për kishën e Perëndimit (*Blasius*) është ruajtur tek shqiptarët në emrin *Blaç* të katundit të krahinës së Opojës, përkatësisht në rrethina të Prizrenit.

VOGËL/ VOGLI (khs. Gon Vogoli dhe Voch Milatchouich, f. 22, 28)

Mbiemër me origjinë shqipe nga mbiemri shqip (i,e) *vogël*. Këtë kuptim të mbiemrit Vogli sikur e dëshmon korelati sllav apo përkthimi i po këtij mbiemri për shkaqe praktike nga vetë tregtari raguzas në serb. *Mali* khs. "*Gon Vogoli piego per Gon Mali*". Nga mbiemri shqip *i vogël* rrjedhin edhe mbiemrat e shqiptarëve *Vocrra, Vocrri, Vokrri, Vokshi* si dhe emri përkëdhelës *Voc*.

ZOTO (khs. Radossau Zoto, f. 9)

Këtu kemi të bëjmë me një emër familjar shqip që rrjedh nga fjala shqipe *zot,-i* jo në kuptimin "perëndi", por në atë "zot shtëpie; zotëri". Historianë e gjuhëtarë e kanë gjetur këtë fjalë shqipe të përmbahet tek emri *Zotovići* i një ka-

[331] Khs. për këtë Stuart E. Mann, An Albanian Historical Grammar, Hamburg, 1977., f. V.

[332] Sh. Petar Skok, Iz slovenačke toponomastike, separat nga: Glasnik Etnografskog Muzeja u Ljubljani, Ljubljana 1934, f. 66.

tuni (vendbanimi blegtoral) të Hercegovinës i cili në burime shkrimore dëshmohet në vitin 1313 dhe që mbahet për katund shqiptarësh.[333] P. Skok, nga ana tjetër, për me prejardhje shqipe nga fjala *zot* "zotëri" e shihte edhe apelativin *zot* në kuptimin "Turin" që ndeshej në të folmet šatrovaćki e osaćanski të Kroacisë dhe e inkuadronte këtu edhe emrin *Zotovići* të një vëllazërie sllavishtfolëse në Mal të Zi.[334] Korrektësinë e këtij sqarimi e tregon mbase edhe rrethana se ndër shqiptarë ekziston antroponimi femëror *Zoje*, *Zojë* "zonjë, zonjë shtëpie", i cili ndeshet më dendur në regjionin e Rrafshit të Dukagjinit. Se mbiemri *Zoto*, *Zoti* do të ketë qenë në përdorim edhe në krahinën e Gallapit do ta dëshmonte mbase emri aktual i vëllazërisë *Alizotët* (nga antroponimi oriental Ali dhe apelativi zot,-i "zot shtëpie, zotëri") në katundin Metërgovc afër Orllanit. Këtu kemi të bëjmë me një antroponim pagan të shqiptarëve.

7.1. Venerime përmbyllëse

Materiali onomastik i trajtuar në këtë punim nga disa dokumente më të vogla të viteve 1382-1438 të sundimtarëve lokalë serbë që kanë të bëjnë me raportet e tyre me Republikën e Raguzës si dhe nga materiali i kësaj natyre i përmbajtur në Testamentin (1411) e raguzasit Gostisse Brathoslaglich dhe në Librin e borxhlinjve e të dorëzanëve (1434-1438) të tregtarit raguzas Michael den Lucari që në këto vite jetonin në qytetin e Novobërdës, ka të bëjë kryesisht me banorë të qytetit mesjetar të Novobërdës dhe të disa katundeve që ishin nën juridiksionin e këtij qyteti si dhe me disa vendbanime në rrethina të qyteteve të Vranjës, të Kurshumlisë dhe në përgjithësi në regjionin e Toplicës në Serbinë e ashtuquajtur "e Jugut". Mbi bazën e këtij materiali dëshmohet qartazi prania e bartësve të antroponimeve dhe të patronimeve shqipe, përkatësisht dëshmohet prania e folësve të shqipes në këtë pjesë të hapësirës etnolinguistikle të shqiptarëve. Bartësit shqiptarë të antroponimeve ose të partonimeve me prejardhje shqipe ishin: **1**. tregtarë, zanatlinj ose priftërinj - qytetarë të Republikës së Raguzës dhe disa të tjerë të ardhur në Novobërdë nga Ulqini ose nga qytete të tjera të brigjeve të Adriatikut jugor dhe 2. banorë vendës të Novobërdës e të vendbanimeve përreth, të cilët ishin në raporte me tregtarë raguzas. Midis tyre kishte gjyqtarë, minatorë, kumbarë raguzasish, në pjesën më të madhe të tyre porse ishin punëtorë të thjeshtë krahu, rrëmihës në minierat e kësaj hapësire. Në këto burime përmenden, ç'është e drejta, edhe disa persona, të cilët mbanin antroponime apo patronime shqipe, që ishin në shërbim të sundimtarëve lokalë, përkatësisht nëpunës të lartë të dukëve lokalë serbë apo të serbizuar. Po u

[333] Sipas Milenko S. Filipović, Struktura i organizacija srendjovekovnog katuna, Simpozijum o srednjovjekovnom katunu, Sarajevo, 1963, f. 56.

[334] P. Skok, Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika, III, Zagreb, 1973, f. 660.

nisëm nga fakti se pothuaj shumica absolute e njerëzve që mbajnë antroponime shqipe rridhte nga shtresa e thjeshtë e popullit, do të mund të merrej për si e sigurt se këtu kemi të bëjmë me popullatë autoktone. Këtë e tregon edhe rrethana se ndër mbiemra të sotëm vëllazërish të shqiptarëve dhe në disa mikrotoponime me prejardhje antroponimike ndeshen disa nga antroponime joshqiptare, të cilët pikërisht për në këtë hapësirë dëshmohen në burimet raguzase të shfrytëzuara për këtë punim. Kjo rrethanë e bën të qartë kontinuitetin në të banuar të këtyre viseve nga shqiptarët dhe ndikimin e gjuhëve, përkatësisht uzuseve onomastike të huaja mbi ta. Këtij paravendimi i del krah, sado paradoksale të duket, pikërisht numri relativisht i vogël i bartësve të antroponimeve shqipe të njerëzve që dëshmohen në këto burime. Korrektësia e këtij paravendmi dëshmohet në dritën e të vërtetës se populli shqiptar i kësaj pjese të hapësirës së tij etnolinguistike arriti ta ruante vetëm një pjesë të korpusit antroponimik gjithshqiptar të karakterit pagan dhe disa antroponime nga koha e krishterimit të hershëm. Kjo gjendje duhet parë si rezultat i ndikimit të kishës së huaj, ndikim i favorizuar për shkak të mungesës së një kishe autonome shqiptare dhe të një klase feudale shqiptare e cila këtë popull, në atë kohë, do ta përfaqësonte politikisht. Pikërisht dëshmimi i një numri të vogël të antroponimeve e të patronimeve shqipe (edhe) në këtë pjesë të hapësirës gjuhësore të shqipes për ku prania e shqiptarëve në shek. 14-15 nuk mund të vihet në dyshim, dëshmon se emrat shqip të njerëzve nuk mund të jenë kurrsesi as rezultat i ndonjë ndikimi të korpusit antroponimk të shqiptarëve mbi ndonjë popullatë joshqiptare e as rezultat i ndonjë migrimi të shqiptarëve në këtë regjion. Fundja, kjo bëhet e qartë në dritën e dëshmimit edhe të emrave shqip të vendbanimeve dhe të emrave të vendbanimeve me prejardhje nga leksiku i latinishtes, trajtat e dëshmuara mesjetare të të cilave janë ruajtur si rezultat i vazhdimësisë në të banuar të shqiptarëve në këtë pjesë të hapësirës etnolinguistike të tyre, ashtu edhe vazhdimësia shqiptare e emrave dhe e mbiemrave me prejardhje të huajë - të ruajtur në mikrotoponime e në emra vëllazërish të popullatës shqiptare të kësaj hapësire. Nga materiali onomastik i trajtuar në këtë punim rezulton se ajo pjesë e raguzasve, e vendosur përreth puseve të minierave larg qytetit të Novobërdës e që nuk ishte larguar menjëherë pas pushtimit turk të Novobërdës në vitin 1454, bashkëjetoi e ndoshta edhe u asimilua me shqiptarët vendës.

DAS ZUSAMMENLEBEN DER ALBANER UND DER RAGUSANER IN KOSOVA UND IN DER REGION TOPLICA IM LICHTE EINIGER RAGUSANISCHER QUELLEN AUS DEM 14 UND 16 JAHRHUNDERT

(Zusammenfassung)

Durch das hier bearbeitete onomastische Material aus einigen ragusanischen Quellen, die sich hauptsächlich auf die mittelalterliche Stadt Novobërdë und auf mehrere Dörfer dieser Stadt sowie auf einige Siedlungen aus der Umgebung der Stadt Vranje und auf die Gegend Toplica in Südserbien beziehen, wird die Anwesenheit der Träger albanischer Personen- und Familiennamen klar bestätigt. Die Träger alb. PN oder FN albanischen Ursprungs waren: 1. Albanische Kaufleute, Handwerker oder Priester - Bürger der Ragusanischen Republik, aus Ulqin oder aus irgendeiner adriatischen Küstenstadt in diesen Gegenden angesiedelt, und 2. Ortsbewohner aus den Siedlungen, mit denen die ragusanischen Kaufleute in Handelsbeziehungen standen. Unter ihnen gab es Richter, Bergknappen, Handelspartner, größtenteils aber gewöhnliche Arbeiter. Es werden allerdings noch einige Personen genannt, die alb. PN oder FN trugen und die in Dienste der Lokalherrscher bzw. der Staatsbeamten oder Herzöge standen. Wenn man von der Tatsache ausgeht, daß (fast) die absolute Mehrheit der Träger alb. PN oder FN aus dem Bauernvolk stammt, könnte man als gesichert annehmen, daß es sich um die bodenständige albanische Bevölkerung handelt. Das beweist auch die Tatsache, daß es unter den heutigen Albaner- Sippennamen und in einigen Flurnamen anthroponymischen Ursprungs einige nichtalbanische PN zu finden sind, welche in den ragusanischen Quellen erwähnt werden. Das macht eindeutig die alb. Kontinuität und Besiedelung der Albaner in diesen Gebieten und teilweise auch den Einfluß von fremden Namen begreiflich. Diese Vermutung hat ihre Gründe auch in der relativ kleinen Zahl der alb. Namen, welche in diesen Quellen erwähnt werden. Die Wahrheit dessen kann man dadurch bewiesen, daß es dem alb. Volk gelungen war, nur einen Teil des Korpus der gesamtalbanischen heidnischen Namen zu bewahren. Dies ist durch den tiefen fremden Einfluß zu verstehen, der bedingt ist durch das Fehlen einer autonomen albanischen Kirche und einer albanischen feudalen Klasse, welche dieses Volk in jener Zeit politisch representieren hätte können. Gerade die geringe Zahl der belegten alb. Personen- und Familiennamen, und das in einem Gebiet, in welchem es heute Albaner gibt, zeigt, daß es sich auf keinen Fall weder um einen alb. anthroponymischen Einfluß noch um irgendeine Migration der Albaner in diese Gebiete handelt. Das wird klar in Lichte der Erwähnung der alb. ON und Namen lat. Ursprungs, deren heutige Formen über die Sprecher des Albanischen und schließlich über die albanische namentliche und territoriale Kontinuität der in diesen Quellen belegten Personen- Familien- und Ortsnamen - ohne Rücksicht auf ihren Ursprung - entstanden sind.

SERBËT/MALAZEZËT E BOSHNJAKËT NË KOSOVË

Përmbajtja

SERBËT/ MALAZEZËT E BOSHNJAKËT NË KOSOVË.....257

1. VENERIME HYRËSE 257
2. VENDOSJA (ARDHJA) E FISEVE SLLAVE NË BALLKAN DHE PASOJAT E SAJ 257
3. SHPËRNDARJA E FISEVE SLLAVE NË JUG E NË JUGLINDJE TË GADISHULLIT TË BALLKANIT 261
4. RRETH EMRAVE ETNIKË TË SERBËVE 267
5. KUFIJTË E FORMACIONIT SHTETËROR TË SERBISË PARA PUSHTIMIT TË KOSOVËS 268
6. SUBSTRATI PARASLLAV I SHTETIT TË RASHËS 273
7. KRISHTERIZIMI I SLLAVËVE (BULLGARËVE E SERBËVE) 276
8. PUSHTIMI I KOSOVËS NGA DINASTIA E NEMANJIDASVE 278
9. EMRI I KOSOVËS SË SOTME SIPAS BURIMEVE HISTORIKE.....278
10. EMRAT SLLAVË PËR KOSOVËN.....279
11. SERBËT NË KOSOVË.....284
12. BOSHNJAKËT 287

SERBËT/ MALAZEZËT E BOSHNJAKËT NË KOSOVË

1. VENERIME HYRËSE

Çështja e atdheut të kryehershëm të sllavëve mbetet e diskutueshme. Përkitazi me këtë problem ka tri mendime.

Mendimi klasik, i pranuar gjithandej, rreth kësaj teme mbetet ai i dijetarit gjerman L. Niederle, sipas të cilit atdheu origjinar i sllavëve ishte në veri të Karpateve, përkatësisht në hapësirat e sotme të pjesës lindore të Polonisë, të pjesës jugore të Bjellorusisë dhe një pjesë e Ukrainës.

Sipas teorisë së T. Lehr-Splawinski-t (1946), hapësira e atdheut të kreyehershëm të sllavëve shtrihej edhe më në perëndim që nga rrjedha e mesme e Elbës (në pjesën lindore të Gjermanisë së sotme) deri në jugperëndim të Ukrainës, ndërsa sipas teorisë së J. Udolph (1979), atdheu origjinar i sllavëve ishte hapësira që nga shpatijet veriore të Karpateve, përkatësisht hapësira midis Takopane (në pjesën jugore të Polonisë) e Bukovina[1] (në jugperëndim të Karpateve, pjesërisht edhe në Transilvani).

2. VENDOSJA (ARDHJA) E FISEVE SLLAVE NË BALLKAN DHE PASOJAT E SAJ

Sido që të jetë, depërtimi i fiseve sllave në Ballkan pati pasoja tmeruese, sado që "*edhe para këtyre ngjarjeve,* [...] *për shkak të luftërave të shpeshta të cilat ndodhën në Ballkan gjatë shekujve 3 e 4 të epokës sonë disa vise të Ballkanit ishin deri në fillimin e shek. 5 plotësisht të shkatërruara. Regjione të tëra kishin mbetur shkret, arat kishin mbetur djerrë dhe qytetet ishin braktisur nga banorët e tyre. Iliria ishte e shkretëruar; gjithashtu edhe Thrakia dhe Dardania dikur e pasur ishin shkretëruar; fushat kishin mbetur të papunuara dhe të mbuluara nga eshtra të të mbyturve*".[2] Për këto shkretërime njoftonte në çerekun e fundit të shek. 4 të e. s. edhe Eusebius Hieronymus, një kronist me prejardhje ilire i qytetit të Stridonit (i lindur në vitin 340 p.e.s. dhe i vdekur në moshën 80 vjeçe), në lib-

[1] Sipas Urheimat der Slawen,Universität Potsdam.
[2] Sh. S. Stanojević, Vizantija i Srbi II, Novi Sad 1906, f. 175.

rin e tij *Epistolae* ("Letra"). Kur po njoftonte për sulmet e gotëve, sarmatëve, kaudëve e barbarëve të tjerë, ai shkruante: "Më rrënqethet shtati kur mendoj të tregoj për shkatërrimet në kohën tonë. Në vazhdim të njëzet vjetëve, bile edhe më tepër, gjaku romak derdhet për çdo ditë ndërmjet Konstantinopolit dhe Alpeve Jule: goti, sarmati, kaudi, alani, huni, vandalët dhe markomanët shkretërojnë, plaçkisin dhe grabisin Skythinë, Trakinë, Maqedoninë, Dardaninë, Dakinë, Thesalinë, Ahenë, Epirin, Dalmatinë dhe gjithë Panoninë. U morën robër peshkopë, u vranë pesbyter dhe shërbyes të tjerë të ndryshëm të kishës. U shkatërruan kishat. Pranë altarëve të Krishtit u vendosën si në grazhd, kuajt. Kockat e martirëve u nxorën nga varret. Kudo zi, kudo ofshe dhe hija e madhe e vdekjes...".[3]

Në vitin 548 ndodhi pastaj sulmi i sllavëve me ç'rast sllavët - shkruan Prokupios (historiograf i shek. 6 i Bizantit me origjinë nga Palestina) - "*siç e kanë zakon, nuk e kursyen askend dhe qëkur u gjendën në Bizant s'kishin asgjë tjetër ndërmend përpos që ta mbytnin secilin që ra nën mëshirën e tyre. E gjithë Iliria dhe Trakia u mbuluan nga kufoma të pavarrosura... sllavët nuk i therrnin viktimat e tyre me shpatë apo me heshtë, porse për së gjalli i ngulnin në hunj duke i mbytur kështu nën tortura nga më të tmerrshmet*".[4]

Përveç kësaj, zvogëlimit të numrit të banorëve dhe zhdukjes së rëndësisë së qyteteve si qendra të mundshme kulturore të dardanëve ndikoi edhe tërmeti katastrofal që më 518 e goditi Dardaninë dhe kryeqytetin e saj Scupi. Historiografi latin me prejardhje dardane Marcellius Comes shkruante në veprën e tij Cronicon ndër të tjera se "*Si pasojë e tërmeteve të pandërpreshme në provincën e Dardanisë u shembën 24 kështjella. Dy nga ato u shkatërruan bashkë me banorët e tyre; gjysma e godinave të banimit të katër kështjellave të tjera u shkatërruan dhe gjysma e banorëve të tyre vdiqën. Shtëpitë e trembëdhjetë kështjellave u shembën si pasojë e kësaj katastrofe; një e treta e shtëpive u rrënua dhe banorët e tyre vdiqën; një e katërta e shtëpive të banimit të shtatë kështjellave u shemb dhe një e katërta e njerëzve që jetonin aty vdiqën, ndërsa nga droja e shembjes banorët e kështjellave fqinje i braktisën ato. Tërësisht u shkatërrua edhe kryeqyteti Scupi, sado që banorët e tij, të cilët iknin përpara armikut, nuk vdiqën. Në gjithë provincën për shkak të tërmetit u çanë malet; Copa shkëmbenjsh u shkëputën nga masivet e tyre dhe lisat u derdhën në luginë. Në një gjatësi prej përafërsisht tridhjetë milash toka u ça në një gjerësi prej dymbëdhjetë hapash. Kështu u krijua një e çarë, në të cilën ranë shumë nga banorët e kështjellave të cilët përpiqeshin të*

[3] Cit. Sipas Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Tiranë, 2002, f. 354.
[4] St. Stanojević, po aty, f. 175.

shpëtonin nga shkëmbinjtë që rrokulliseshin dhe nga sulmet e barbarëve. Në një kështjellë të regjionit Gavissa[*] *] e cila* (kështjellë) *quhej Sarnonti*[**] *nga toka e përvëluar shpërtheu si nga një vatër zjarri një curril i pafashitshëm uji të valë*".[5] Një pjesë e madhe e popullatës së Dardanisë u shtërngua kështu t'i braktis qytetet e fushat dhe të kërkojë strehim në male të larta duke u marrë atje me blegtori. Do të ishte prandaj iluzore që nën këso rrethanash të pritet që në truallin e Dardanisë të ruhen, përkatësisht të gjenden dëshmi shkrimore - bartës të të cilave do të ishin dardanët apo ndonjë popullatë tjetër. Përveç kësaj, nuk bën të harrohet që Dardania as në kohën e zenitit të Perandorisë Romake nuk kishte qendra të mëdha e me peshë kulturore. Popullata parasllave e Dardanisë, proto-shqiptarët dhe protorumunët, mbeti të jetë bartëse e kontinuitetit etnik e pjesërisht edhe të atij onomastik të antikës, jo porse edhe të kulturës së kësaj periudhe historike. Kjo popullatë i vazhdoi veçoritë etnike nga antika dhe asgjë tjetër: as pushtetin dhe as format e vjetra të organizimit shoqëror romak. Së këndejmi vetëm një numër fort i vockël emrash (kryesisht të maleve të larta, lumenjve të mëdhenj dhe qyteteve e kështjellave të njohura) dhe emrash të njerëzve (të dëshmuara në mbishkrime epigrafike) arriti ta mbijetojë valën e sllavizimit.

Duket se pikërisht depërtimi i masës sllave në tokat asokohe të Perandorisë Romake të Lindjes shkaktoi një kataklizmë për popujt vendorë që u reflektua me shfarosjen e me sllavizimin p.sh. të popullatës së romanizuar trakase e pjesërisht edhe të asaj dardane dhe "zhdukjes" së ilirëve (në përgjithësi) dhe të dardanëve (në veçanti) nga kronikat e historiografëve helenë, romakë e bizantinë. Krejt kjo dëshmon se ardhja e sllavëve në Ballkan është në të vërtetë jo përqafim e vazhdim i kulturës antike të këtij gadishulli, porse shkatërrim me zjarr e shpatë i saj apo, siç kishte thënë njëherë ilirologu Hans Krahe, sllavët janë varrosës të kulturës antike të Ballkanit. Kjo e nënkupton edhe rrethanën që sllavët e ardhur, le që nuk ndërtuan asnjë qytet, porse i rrënuan edhe ato që i gjetën. Duke mos i njohur e duke mos i vazhduar rrënimet antike që i shkaktuan këta u quajtën më vonë nga sllavët ardhës thjesht "gradina; gradište". Këtë gjendje e dëshmon mbase më miri njoftimi i Gulliellmus Adae /Brocardus i cili, për sa i përket principatës/bërthamës shtetërore të Serbisë shënonte në vitin 1332 se "Kjo mbretëri ka fare pak, përkatësisht pothuajse asnjë vend të fortifikuar, por kemi të bëjmë në të vërtetë vetëm me çifliqe e kasolle, pa fortifikime e pallate qofshin ato të mbretit apo të

[*] Unë e kam identifikuar këtë me krahinën e sotme Gallap.
[**] Unë e kam identifikuar këtë me burimin termal Banja e Sijarinës.
[5] Grup autorësh, Ilirët dhe Iliria te autorët antikë,Tiranë 1961, f. 451.

bujarëve - të gjitha janë nga kashta e nga druri. Kurrë nuk kam parë këtu ndonjë fortifikatë apo shtëpi prej guri ose (balte) tullash, përveç në qytetete bregdetare të latinëve."[6] Është e vështirë të pandehet që ky popull i cili në bërthamën e vet shtetërore nuk kishte qytete, të ketë ngritur të tilla në hapësirat e Kosovës së sotme të pushtuar nga ata, ku qytete e kështjella të ngritura me gur (madje edhe me ish "çiklopikë") kishte që nga periudha e shtetit të dardanëve. Në këtë kontekst do të rezultonte që edhe selia e përkohshme sundimtarit serb St. Dushan, siç edhe dëshmohet në burime serbe, ishte një "qytet i drunjtë" dhe jo kështjella parasllave e qytetit të Prizrenit. Rezidencat e Milutinit në Vërhllab, përkatësisht në Bellosicë dhe e Hrebeljanoviqëve vlleh e trashëguar nga dhe e pasardhësit të tyre - dera vazale e Brankoviqëve, në Novobërdë ishin në kështjella-qytete të pushtuara nga ata, ndërsa selia më e moçme e *Paun*-it dhe e Nerodimes (në rrethina të Ferizajt) ishte shtëpi e thjeshtë prej druri e balte, prandaj nuk mund të gjenden as gjurmë të tyre. E këtillë do të ketë qenë edhe "rezidenca" nga e cila nuk ka as edhe një gjurmë të dukshme. Të drunjta ishin edhe një pjesë e mirë e kishave "serbe" në hapësirën e sotme të Kosovës së shek. XIV.

Përkitazi me gjendjen e gjetur nga sllavët dhe pasojat që i solli ardhja e tyre në Gadishullin e Ballkanit shkroi edhe dijetari i merituar serb I. Popović.[7] Sllavët, sipas këtij studiuesi, paskan ardhur në Ballkan "padyshim" në shek. VI "pothuajse pa u pas penguar fare nga pushteti bizantin" dhe që atëherë qenkan bërë popullatë ndenjëtare. Kjo po u dëshmuaka edhe me kontinuitetin sllav të shumë emrave të vendeve, midis të cilave qenkan edhe *Lipljan* nga *Ulpiana*; *Skopje* nga *Scupi*. (SG: tjetërkund ky ka thënë se te Scupi ka kontinuitet shqiptar dhe se trajta sllave *Lipljan* është një formim mbi baza të etimologjisë popullore serbe [SG: i pas shek. XII?) që u lind si rezultat i barazimit të atij emri, për sllavët, të panjohur kuptimisht, me emrin *lipa* bot. Tilia "bli,- ri"]) dhe *Cibrica* në Bullgari nga Κέβρος e *Ogosta* nga *A*(u)*gusta* në Bullgari.[8]

Në relacion me Dardaninë antike, përkatësisht me Kosovën e sotme, kjo paska ndodhur, sepse "Serbët e pushtuan pothuaj gjithë Serbinë qysh

---

[6] Directorium ad passagium faciendum, në Recueil des historiens des croisades, Documents arméniens II., III: Brocardus, Paris 1906, f. 478

[7] Khs. punimin e tij Bemerkungen über die vorslavischen Ortsnamen in Serbien, në Zeitschrift für slavische Philologie Bd. XXVIII, Heidelberg 1960, f. 114: "1. Die Serben besetzten fast ganz Serbien schon bei dem frühesten südl. Einfall auf dem Balkan; dass dieses Gebiet den ersten serbischen Feudalstaaten nicht angehörte, kann an dieser Tatsache nichts ändern, da, wie gezeigt, Ortsnamen bewiesend genug sind. "

[8] I. Popović: Die Einwanderung der Slaven in das Oströmische Reich im Lichte der Sprachforschung, Zeitschrift für Slawistik, Bd. III, 1958, f. 706.

me rastin e invadimit më të hershëm drejt jugut të Ballkanit; që kjo hapësirë nuk u takoi shteteve të para feudale të serbëve, nuk e ndryshon aspak këtë fakt sepse, siç u tregua, toponimet janë dëshmi e mjaftueshme për këtë" - thoshte Popoviq.

3. SHPËRNDARJA E FISEVE SLLAVE NË JUG E NË JUGLINDJE TË GADISHULLIT TË BALLKANIT

E pandashme nga mënyra e vendosjes së sllavëve në toka të popujve josllavë të lashtësisë (dardanëve, makedonëve, trakasve përkatësisht protobullgarëve e helenëve) është edhe rrethana e njohur mirë në historinë e në gjuhësinë e Ballkanit se pjesa e sllavëve që u vendos në lindje të Gadishuillit të Ballkanit, përkatësisht bullgarët, zunë vend në territorin që në kohën e ardhjes së tyre banohej ende nga një popullatë tataro-mongole e quajtur bullgarë.[9]

Dhe këta sllavë të vendosur në këtë ambient arritën ta sllavizojnë atë popullatë, e ruajtën porse emrin josllav, tataro-mongol, të popullatës - mbi të cilën sllavët e ardhur u vendosën si superstrat antropologjik, gjuhësor e etnik - për emër të tyrin nacional. Ajo pjesë e të njëjtit trung sllav (të bullgarëve) të cilës nuk i mjaftoi territori i protobullgarëve tataro-mongolë u shtri në territoret në të cilat jetonte fisi josllav i maqedonasve. Edhe kjo pjesë e sllavëve e pësoi të njëjtin fat si pjesa e tyre e vendosur në Bullgarinë e sotme, përkatësisht edhe këta për si distinktiv për identitetin e tyre e morën emrin e popullatës josllave dhe të shtetit të saj: makedonë e Makedonia. Asnjëri nga emrat nacionalë të këtyre sllavëve nuk është me origjinë sllave, ashtu sikundër as emrat e serbëve e të kroatëve nuk janë emra sllavë.

[9] Për nacionalitetin e bullgarëve: nga Franz Miklosich, Über die Nationalität der Bulgaren, Estratto dalla Miscellanea die Fillogia, dedicata alla memoria die professori Caix e Canello, Firenze, 1885, f. 4. "Dass sie (SG: die Bulgaren) keine Slaven waren, darf als unbestreitbar angesehen werden. […] Hinter den Slaven im Osten wohnen nichtarische Völker, [...] Von denen Völkern haben die Türken zahlreiche Eroberungszüge gegen Westen unternommen, bei denen wohl die die Hunnen, die Bulgaren, die Avaren, die Chazaren, die Petschenegen und die Kumanen, sowie einige minder bedeutende Völkerschaften als Türken erkennt.". 1 "Dass der Name Bulgaren ein türkisches Volk bezeichnet, ergibt sich daraus, dass bis zum heutigen Tag die türkischen Bewohner des Gouvernement Kazan sich entweder nach den Glauben Muselmänner, oder nach der Abstammung Bulgaren nennen." […] "Ich Beabsichtige den Gegenstand weiter zu verfolgen und hoffe darzuthun, dass der Anspruch der Türken auf die Bildung des Bulgarischen Nationalität auf festere Stützen ruht, als der der Finnen: die für diese angeführten Gründe sind nochmaliger Prüfung bedürftig"

Fiset sllave të ndodhura territorialisht më afër Perandorisë Bizantine paraqiten që herët me emra të tyre të veçantë, jo edhe ndonjë fis sllav me emrin *makedon*. Mësohet se bizantinët paskan ditur për fiset sllave të sagudatëve, rinhinëve, draguvitëve, smoljanëve, bërzitëve etj. Shkapërderdhja e sllavëve dhe pushtimi hap pas hapi i territoreve të reja është arsyeja përse trevat e banuara nga ata i quanin në shumës *Sklavinie*.[10]

Dëshmia më e vjetër porse, në të cilën veçohen emrat e dy fiseve të veçanta sllave ballkanike nga shumë sosh që do të kenë ekzistuar (sh. më lart) rrjedhin nga mesi i shek. X. Në veprën *De administrando imperio,* autor i së cilës është perandori bizantin Konstantin VII Porphyrogennetos († 959), përmenden një herë sllavët si *Sklavoi* me shënimin e gabueshëm (SG. sic.!) se ata "quhen edhe avarë" dhe pastaj i përmend veçmas *tou thematos Peleponnesou Sklavoi* "sklavët e provincës së Peloponezit". Në vazhdim ai i përmend fiset e sllavëve Milingen e Ezerit dhe pastaj edhe ata *Hrovatoi* "kroatët" dhe *Serbloi* "serbët" për të vazhduar pastaj me *Zahlumo*i "zahumlanët", *Terbuniotai*, *Kanalitai*, Diokletianët dhe së fundi *Arentanët* ose *Paganët* bashkë me *Bulgaroi* "bullgarët" dhe *Raousaioi* "Raguzanët" romanë.

Për sa i takon prejardhjes së emrave të dy etnive të mëvonshme: serbe e kroate, dijetarë sllavistë e kanë përqafuar sqarimin e emrit *serb* si emër të dalë nga indishtja e lashtë, përkatësisht nga indoiranishtja (për këtë sillet rëndom krahasimi me emrin *Serboi* të një popullate të Kaukazit Verior), ndërsa për emrin *hravati* në vend të sqarimit tradicional si emër iranian, propozohet së voni edhe sqarimi si një emër nga gjuhët tyrkmene - më saktësisht si emër me origjinë avare. Mbetet, në këtë kontekst, të sqarohet nëse përmendja në shekullin 10 e serbëve dhe e kroatëve ka të bëjë me dy etni të veçanta sllave apo mos kemi të bëjmë me përmendjen e shtresës së lartë josllave e cila i sundonte sllavët (SG: = avarët) - sado që këta ishin shumicë - sikundër ishte edhe rasti me protobullgarët josllavë që një kohë sundonin mbi sllavët e ardhur të cilët, më vonë, e morën për të vetin emrin e protobullgarëve tataromongolë. Sido që të jetë, s'ka dyshim se emrat me prejardhje josllave *serbë* e *kroatë* shenjonin më vonë dy popullata të ndryshme sllave.

Nga sa u tha më lart vërehet se nga fiset sllave që kishin depërtuar në territorin e Perandorisë Bizantine, në shekullin 10 nuk përmendet asnjë sish që do të kishte zënë vend në viset e banuara nga dardanët e nga ilirë të tjerë.

---

[10] Sipas Mihailo J. Dinić, O nazivima srpske srednjovekovne države, Prilozi za književnost, jezik, istoriju i folklor, vëll. 32, Bleu 1-2, Beograd, 1966, f. 26.

Çështje "shumë më e vështirë është ajo nëse edhe në Jugosllavi, përkatësisht në Ballkanin Perëndimor sllavët, me rastin e ardhjes së tyre, gjetën këndej përkrah romakëve edhe ilirë. " - thotë autori ynë. Sado që ky njëherë e hedh poshtë mendimin pozitiv të P. Skok për një kontakt të sllavëve me ilirët, ngre zë kundër mendimit të autorit Schütz i cili "në librin e tij "Die geographische Terminologie des Serbokroatischen" ishte përpjekur ta dëshmonte të përkundërtëm, përkatësisht që Ballkani Perëndimor (më saktësisht sterea, pjesa kontinentale e tij) në kohën e dyndjes së sllavëve na paska qenë një hapësirë e pa njerëz, kështu që sllavët e paskan gjetur këtë hapësirë si një vakum". Vetë I. Popović thotë se megjithatë "edhe këtu duhet t'i kemi parasysh elementet josllave, përkatësisht parasllave" dhe se "Nëse në këtë mes kemi të bëjmë me ilirë ende të ruajtur apo me ilirë të romanizuar, mbi bazën e gjendjes së sotme të dijes, për fat të keq, nuk mund të vendoset".[11] Megjithatë, për I. Popoviq-in, mbetet punë e kthjellët se këta autoktonë flisnin që të gjithë gjuhë indoeuropiane: "Në kohën e fillimit të sllavizimit, kemi të bëjmë gjithandej me gjuhë indoeuropiane: në perëndim (në Jugosllavinë e sotme, duke e përjashtuar Serbinë Lindore dhe Maqedoninë) pastaj në Shqipëri flitej ilirisht, në lindje (në Bullgari, në Serbinë Lindore e pjesërisht [edhe] në Maqedoni) - trakisht; së fundi, për në jug të Maqedonisë duhet marrë në konsideratë edhe makedonishten"[12] parasllave.

Autori ynë konstatonte në vazhdim se "edhe në Serbi u zhvillua, sado që më dobët se në Maqedoni, në Bullgarinë Perëndimore e në Dalmaci simbioza midis romanëve autoktonë dhe barbarëve (SG. ilirëve e traksve) të romanizuar dhe sllavëve ardhacakë, kështu që as në këtë vend nuk u ndërpre kontinuiteti midis lashtësisë romake dhe mesjetës sllave".[13] Po këtë mendim autori ynë e elaboronte edhe në një punim tjetër të tijin. Këtu ky konstatonte se: "Mund të merret se që në shek. VI i gjithë Ballkani, me fare pak përjashtime, ishte bërë vend i sllavëve dhe se rrjeti i vendbanimeve sllave ishte i dendur pothuaj gjithandej, jo vetëm në Jugosllavi e në Bullgari, të cilat edhe mbetën

[11] I. Popović: Po aty, f. 713.

[12] I. Popović: Die Einwanderung. .., f. 712.

[13] khs. cit. origj. "2. Auch in Serbien entwickelte sich, wenn auch schwächer als in Mazedonien, Westbulgarien und Dalmatien, die Symbiose zwischen den altangesessenen Romanen und romanisierten Barbaren und den slavischen Einwanderern, so dass auch in diesem Land die Kontinuität zwischen dem römischen Altertum und dem slavischen Mittelalter nicht unterbrochen sein kann." Ivan Popović: Bemerkungen. .. f. 114.

vende të sllavëve, porse gjithashtu edhe në Greqi e në Shqipëri, në të cilat pas sllavizimit ndodhi desllavizimi".[14]

Mbi bazën e kësaj analize, I. Popoviq konstaton edhe se " […] ne kemi dëshmi të sigurta se në stere [SG: pjesën kontinentale] materialin gjuhësor - sllavët, së pakut në lindje, praktikisht në hapësirën bullgare - jo gjithherë e morën nga grekët e nga romakët, porse edhe drejtpërdrejt nga popuj të tjerë, përkatësisht nga barbarët [SG: ilirët e trakët] autoktonë" […] Me fjalë të tjera, kur sllavët u dyndën në Ballkan, Gadishulli ishte së pakut pjesërisht ende i banuar nga barbarë dhe jo kryekreje nga latinë, përkatësisht grekë [...]"Sllavët nuk ndikuan mbi këta popuj vetëm në rrafshin kulturor porse ndodhi një përzierje biologjike e ardhësve sllavë me popullatën parasllave - thotë autori ynë. [15]

Përveç kontinuitetit të emrave trakas e romanë-ballkanikë, I. Popoviq gjen në hapësirën e sotme të Serbisë edhe toponime me prejardhje ilire, përkatësisht dardane.[*] Më shumë gjurmë toponimike ilire në hapësirën që sot e zë Serbia Lindore sjell dijetari bullgar I. Duridanov.[**]

Këtë pjesë të trajtesës së tij, I. Popoviq e mbyll me bindjen e tij se "Gjuha trakase, ç'është e drejta, nuk ka vdekur ende, sepse ajo vazhdo të jetojë në formën e saj të shqipes"[16] së sotme, për ta përfunduar këtë me konstatimin, përkitazi me huazimet sllave të shqipes, për të cilat ky thotë se: "disa albanologë e marrin vendosjen e sllavëve në Shqipëri si një dyndje të mëvonshme (shek. VII) e cila ngjau në kohën kur shqiptarët tashmë banonin në Shqipëri; siç kujtoj se e kam treguar edhe vetë bindshëm (në ZfsPh.XXVI), kjo tezë është kryekëput e gabueshme, sepse të gjithë emrat parasllavë të Shqipërisë, që sot përdoren nga shqiptarët, shqiptarët i morën me ndërmjetësimin e sllavëve".[17]

Ky pranonte megjithatë se "Ç'është e drejta, nuk mund të pranohet që i gjithë ndikimi sllav mbi shqiptarët të ketë ndodhur që në krye të herës në hapësirën e sotme të Shqipërisë; aq më parë duhet të llogarisim edhe

[14] "Es ist also damit zu rechnen, dass bereits im VI Jh. Der gesamte Balkan, mit ziemlich geringen Ausnahmen, zu einem slavischen Land geworden ist, und dass das Netz der slavischen Siedlungen fast überall dicht war, nicht nur in Jugoslavien und Bulgarien, die eindeutig slavisch gebieben sind, sondern auch in Griechenland und Albanien, wo es nach der frühen Slavisierung zur Entslavisierung gekommen ist" Nga: I. Popović: Die Einwanderung. ..," f. 709.

[15] Po ai, po aty, f. 712.

[*] Emra ilirë të vendeve e të lumenjve në Serbi (Sipas sllavistëve Ivan Popović e Ivan Duridanov), tek Kërkime onomastike IV, f. 9 -19 (në dorëshkrim)

[**] Edhe për këtë khs. trajtesën time të cituar në referencën paraprake

[16] Popović: Die Einwanderung. .., f. 713.

[17] Po ai, po aty, f. 709.

me atdheun e kryehershëm të shqiptarëve diku në pjesën qendrore të Ballkanit, pas gjithë gjasash pikërisht në pjesën lindore të Serbisë, në pjesën perëndimore të Bullgarisë dhe në pjesën veriore të Maqedonisë". Në të mirë të tezës së tij autori ynë i sillte dëshmitë e ndërmjetësimit të shqipfolësve nga goja e të cilëve sllavët i morën emrat e qyteteve më të mëdha të kësaj hapësire. Për këtë autori ynë i sjell shembujt Nish, Shkup, Shtip, Ohër etj: për të përfunduar se "Në këtë mënyrë protoshqiptarët në atdheun e tyre të kryehershëm në pjesën qendrore të Ballkanit do të kenë qenë nën ndikimin si të serbishtes ashtu edhe të bullgarishtes."[18] Përkundër rrethanës që I. Popoviq ishte ithtar i tezës së prejardhjes trakase të shqipes (khs. më lart) sipas së cilës vendi i formimit të shqipes do të dilte të ishte Dardania e lashtë, ky autor sikur, një herë për një herë heq dorë nga qëndrimi i tij, sepse kjo tezë ia prish pak punën në një segment kardinal të dijes së sllavistikës. Dhe ky segment ka të bëjë me shkaqet që dy gjuhë sllave sot territorialisht fqinje: serbishtja e bullgarishtja janë aq të ndryshme njëra nga tjetra. Përkitazi me këtë autori ynë përpiqet ta relativizojë deri në mohim mendimin e dijetarit holandez Wan Wijk i cili thoshte se rumunët ose së pakut një pjesë e këtij populli ishte popullatë autoktone në hapësirën e Ballkanit Jugor, (kjo) dëshmohet përmes rrethanës se serbët dhe bullgarët ishin në mesjetën e hershme të ndarë nga një popullatë autoktone josllave. Kjo popullatë josllave, sidomos në Dardani ishte popullatë romane: "Një shembull i bazuar mbi nomenklaturën gjeografike ka treguar që emrat e vjetër romanë të qyteteve janë konservuar para së gjithash në provincat Dacia Mediterranea, Dardania e Praevaalis, apo thënë ndryshe në zonën që e ndan Danubin, në veri e në verilindje të Sofjes, në Adriatik dhe që sajon një zonë të ndërmjetme, ngase këtu nuk mund të gjendet ndonjë gjurmë e fiseve të vjetra bullgare e serbo - kroate. Të gjitha të dhënat përputhen bashkërisht nëse paravendojmë që të dyja grupet sllave ballkanike ishin të ndara nga një zonë romane e Ras-it (SG: Rashës) përafërsisht më 1200 apo pikërisht në këtë periudhë",[19] ndërsa sllavisti i merituar rumun Emil

[18] I. Popović: Die Einwanderung. .., f. 717: "Allerdings kann nicht angenommen werden, dass der ganze slavische Einfluß auf die Albaner erst auf dem Gebiet des heutigen Albanien stattgefunden hat, vielmehr müssen wir auch mit der früheren albanischen Heimat irgendwo im Zentrum des Balkans rechnen, wohl gerade in Ostserbien, Westbulgarien und Nordmazedonien.";.[...] "So konnten die Uralbaner in ihrer frühen zentralbalkanaischen Heimat sowohl unter serbischem als auch unter bulgarischem Einfluß stehen".

[19] N. Van Wijk: Les langues slaves (de l`unité à pluralité), Hage 1956, f. 103.: "Un examen approfondi de la nomenclature géographique a montré que les anciens noms des villes romains furent conservés surtout dans les provinces Dacia Mediterranea, Dardania et Praevaalis, autrement dit dans la zone qui relie la Danube, au Nord et au Nord-

Petrovici kujton se ajo popullatë që i ndante këto dy degë të sllavëve, përkatësisht bullgarët e serbët, ishte pikërisht popullatë shqiptare.[20]

I. Popoviq i kundërvihej dijetarit holandez: "Megjithatë merret për e pranueshme që rumanishtja ose thënë më mirë protorumanishtja nuk u kristalizua në Daki, porse në Ballkanin e mirëfilltë dhe pikërisht në hapësirën e pjesës lindore të Serbisë dhe atë perëndimore të Bullgarisë; kështu sqarohet teoria e Van Wijk-ut sipas së cilës serbokroatishtja nga njëra dhe bullgarishtja nga ana tjetër u zhvilluan aq ndryshe sepse pikërisht në kohën e dyndjeve të para të sllavëve të jugut këta ishin të ndarë njëri nga tjetri nga një zonë e gjerë romane në Serbinë Lindore e në Bullgarinë Perëndimore. Dhe, me gjithë mend, ndryshimet midis serbokroatishtes dhe bullgarishtes - vështruar në këndin e sllavistikës - janë shumë të mëdha e shumë të lashta. Megjithatë, unë i konsideroj dallimet serbokroate-bullgare të jenë paraballkanike dhe besoj se ato u zhvilluan që në atdheun e kryehershëm sllav"[21] të tyre.

Të vërtetën për përhapjen me forcë të serbëve, përkatësisht të pushtimit të hapësirës etnlinguistike shqiptare të Dardanisë antike në shek. XII nga serbët e mbështesin edhe histsorianë serbë të gjuhësisë. Kështu, dialektologu serb A. Belić konstatonte p.sh. se zhvillimi i dialekteve të serbishtes është i pandashëm nga procesi i kolonizimit serb të Kosovës së sotme. Menjëherë pas pushtimit të Kosovës në vitin 1912, ai shkruante se: "Drejtimin e kolonizimit serb mund ta karakterizojmë përgjithësisht sipas qendrave dhe selive të sundimtarëve serbë si para ashtu edhe pas Betejës së Kosovës. Këto qendra e seli u shtrinë në shek. XIII nga *Ras*-i (

Ouest de Sofia, a l'Adriatique, et qui forme la région intermédiaire mentionée plus haut, où l' on ne trouve aucune trace d' anciennes tribus bulgares et serb-croates. Toutes les données concordent donc ensemble, si nous admettons que les deux groupes de Slaves Ballkaniques étaient séparés par une zone romane de Ras probablement jusqu'en 1200, ou même au délà cette époque".

[20] Sh. Istoria poporului român aglindită în toponimie, Studi de dialektologie şi toponimie, Bucureşti, 1970, f. 242.

[21] I. Popović: Die Einwanderung. .., f. 715-716: "Doch wird gewöhnlich angenommen, dass sich das Rumänische, oder, besser gesagt, das Urrumänische, nicht in Dacien, sondern auf dem eigentlichen Balkan kristallisiert hat, und zwar auf dem Gebiet Ostserbiens und Westbulgariens; auf diese Weise erklärt sich die Theorie van Wijks, nach welcher sich das Serbokroatische einerseits, das Bulgarische andererseits deshalb so verschieden entwickelt haben, weil sie bereits zur Zeit der ersten südslavischen Einwanderung auf dem Balkan durch eine breite romanische Zone in Ostserbien und Westbulgarien getrennt waren. Und tatsächlich sind die Unterschiede zwischen dem Serbokroatischen und dem Bulgarischen - vom slavistischen Standpunkt aus - sehr scharf und sehr alt. Trotzdem halte ich die serbokroatisch-bulgarischen Unterschiede für bereits vorbalkanisch und glaube, dass sie schon in der slavischen Urheimat entwickelt worden sind".

SG.: *Arsia* parasllave, serb. Raška, afër Novi Pazarit) në drejtim të Prishtinës. Prej këndej depërtoi pastaj në shek. XIV, gjatë kohës së sundimit të carit Dushan, në drejtim të Prizrenit e të Shkupit. [...] Në mbështetje të gjithë kësaj mund të thuhet se gjuha e shtetit të vjetër serb e kishte për qendër Rashën. Kjo gjuhë shërbeu për bazë të zhvillimit të këtyre dialekteve. Derisa gjuha jonë (mendohet serbishtja S. G.) në jug të Maleve të Sharit dhe të Shkupit u zgjerua në drejtim të Prilepit e të Velesit dhe në vende të tjera e ruajti formën e saj arkaike, nën ndikimin e të folmeve jugore maqedone rrëzë Sharit u krijua në Prizren e në vendbanimet përreth tij në drejtim të Shkupit e të Kumanovës e folmja e Prizrenit, veçoritë më të moçme të së cilës i heqin rrënjët nga shekulli 12".[22]

4. RRETH EMRAVE ETNIKË TË SERBËVE

Emri etnik sllav i kësaj popullate është *Slověne* emër që, sipas Al. Rosetti[23] në latinishte qenka reflektuar si *Sclavus* dhe prej andej paska kaluar në dakorumanishten si *schiau* (shkiau), arum. *şcl'au* (lexo *shklau*), shq. *shqa* në kuptimin "bullgar, grek shkizmatik, grek" dhe në greqishten nga shek.IX në trajtën *Sklavenos* në kuptimin "sllav". A. Brückner, nga ana tjetër, kujton se lat. *Sclavus* dhe greq *Sklavenoi* që nga shek. X e kishte kuptimin e pol. *niewolnik*, "skllav", gjerm. *Sklave*, frëngj. *esclave*, vllahisht, përkatësisht romanisht *schiavo* dhe që më vonë ky term qenka zgjeruar me prapashtesën *-ia-*,[24] prandaj në trajtën serbe popullore *slovinъ* ky term, i zgjeruar me prapashtesën *-inje*, tregon kolektivitet. Mendimin sipas të cilit emri *sllav* e kishte në krye të herës kuptimin "skllav, shërbëtor" e kishte përkrahur edhe Max Vasmer-i. [25] Për mbështetje të këtij paravendimi, ky i sillte edhe dëshmitë *sklavъ* m. "shërbëtor" (i sulltanit) nga dy burime serbe të vjetra të vitit 1480. Vasmer kujton që emri *sllav* po rrjedhka nga greq. e mesme, bizantine, Σκλάβος "skllav", i dalur nga emri Σθλαβηνός, Σκλαβηνός: slav. *slověninъ* i sllavëve. Vetë trajta sllave *slovinъ* rrjedh [...] nga lat. *Sclavi* dhe shënonte, sipas M. Pešikan[26] sllavët në përgjithësi, por më shpesh ata në territoret skajore të viseve të banuara

[22] Sh. A. Belić, Stara Srbija s istorisko-jezične tačke gledišta, Beograd 1912, f. 7 - 9.

[23] Sh. Istoria Limbii Române, de la prigini pînă în secolul al XVII-lea, Editura Pentru Literatură, Bucureşti 1968, f. 286, 378

[24] Sh. Słownik etymołogiczny jezyka polskiegom,Warszawa, 1974, f. 501.

[25] Die griechischen Lehnwörter im Serbo-kroatischen, Abhandlungen der Preußischen Akademie der Wissenschaften, Jahrgang 1944, Phil.-hist. Klasse, Nr. 3, Berlin, 1944, f. 134.

[26] Sh. Zetsko-humsko-raška imena na početku turskoga doba (prvi deo) në Onomatološki prilozi, III, SANU, Beograd 1982, f. 35.

me sllavë khs. *slovinjci* në veri të Polonisë dhe emrat e popujve: *sllovak, slloven, sllavon.*

Në dokumentacionin raguzas të mesjetës, emri *Slovigna*, *Slovigne*, *Slovinia*, *Schlovinie* shënonte si Sllavoninë e sotme ashtu edhe shtetin serb të Rashës, i cili herë-herë quhej edhe *Servia*/*Serbia*, *Raška* dhe *Sclavonia*.

Sa i përket trajtës shqipe të emrit etnik të sllavëve, mbetet fort e besueshme dhe e pranuar gjithandej, që shqiptarët e Kosovës e ruajtën emrin e kryhershëm të sllavëve, ndoshta pikërisht atë të para diferencimit të tyre etnik të sllavëve në serbë e kroatë, bullgarë/maqedonas *sclavus*. Kjo trajtë është reflektuar në shqipen në krye të herës si *shkla* e pastaj, si rezultat i zhvillimeve të brendshme fonetike të shqipes, në *shkja* e së fundi në *shka*. Edhe emrat e territoreve të banuara nga sllavë, përfshirë këtu edhe Ukrainën dhe Greqinë ortodokse, u quajtën nga shqiptarët *Shkleni*, *Shkjeni*, *Shkini*. Këto reflekse shqiptare të emrit *sclavus* e *Sklavinia* janë në harmoni të plotë me fenomenin e kalimit të grupit latin të bashkëtingulloreve *sc-* në *sh* në shqipen.(khs. p.sh. emrat e qyteteve *Scupi* - shq. *Shkup*i; *Scodra* - shq. *Shkodër* dhe huazimet latine të shqipes). Duket se trajta e kryehershme shqipe e emrit do të ketë qenë *shkla* e cila më vonë nën ndikimin e fenomenit të kalimit të togut *kl* në *k* e më vonë në *q* në shqipen vetë (khs. *klumësht - kumsht, qumësht*; *klenë - kjenë, qenë* etj.). ka kaluar nëpër fazën *shkja* për ta dhënë të sotrmen *shka*. Pikërisht trajta shqipe e emrit popullor të pushtueseve dhe të sunduesve serbë e dëshmon një kohë të lashtë të kontakteve midis shqiptarëve e shkieve, përkatësisht serbëve.[27]

5. KUFIJTË E FORMACIONIT SHTETËROR TË SERBISË PARA PUSHTIMIT TË KOSOVËS

Kurdoherë që të flitet për shtetin serb, përherë mendohet për regjionin e ngushtë malor me qendër qytetin apo lumin Ras, përkatësisht Rasha. Mirëpo në shek. X "as Serbia as serbët e kohës së para sundimit të Nemanjidëve nuk kanë luajtur ndonjë rol të madh në Ballkan" thotë Birnbaum[28] dhe se ajo krijesë prej shteti nuk e kishte forcën e as formimin e një shteti të mirëfilltë në historinë e mesjetës së hershme të Ball-

[27] Më gjerësisht për këtë khs. trajtesën time "Një koloni - oazë e hershme serbe në Rrafsh të Kosovës".

(Rreth toponimit Slovinje shq. Sllovi), të botuar në revistën Studime të ASHK të Kosovës në fund të vitit 2014 dhe tek Kërkime onomastike IV Gjurmë ilire, latine, greke e sllave në toponiminë e Kosovës (ende në dorëshkrim).

[28] Überlegungen zum mittelalterlichen Serbien, Südost -Forschungen, Bd. 53, 1994, f. 314.

kanit. Viset e banuara me serbë ishin herë pas here përsëri nën sundimin e Bizantit. As viset e hinterlandit - të sunduara nga zhupanë të mëdhenj të Rashës, sado që kjo nuk ishte asokohe nën sundimin e perandorit bizantin, nuk luanin kurrfarë roli me rëndësi në këtë hapësirë, deri atëherë kur Stepan Nemanja ia bashkëngjiti Rashës Duklën dhe kur i vuri nën sundim qytetet Kotor, Tivar, Budva të Dalmacisë Jugore dhe Ulqinin - përkatësisht që nga koha kur u sigurua dalja në Adriatik.

Çështje më vete që mbetet për t'u sqaruar në këtë mes është ajo e kuptimit gjeografik dhe territorial-politik të termit "shteti serb". Dy janë burimet mbi të cilat mund të mbështeten vlerësimet që do të shpinin drejt ndriçimit të këtij nocioni: vepra *De administrando imperio* e shkruar në shek. X, autor i së cilës është perandori bizantin Konstantin VII Porphyrogennetos[*] dhe kronika e priftit të Dioklesë (Duklës), gjithashtu e shek. X. Kjo e fundit ka dalë në dritë nën disa redaktime. Njëri nga ato është p.sh. ajo e F. Šišić.[29]

Mbi bazën e analizës së këtyre dy burimeve bazë dhe të vetmeve për këtë periudhë kohore, kufijtë gjeografikë dhe territorialë-politikë të Serbisë është përpjekur t'i përcaktojë edhe Relja Novaković.[30] E gjitha që do të thuhet në këtë nënkapitull mbështetet mbi rezultatet e këtij autori. Vetë Porfirogeneti - thotë Novaković lë të kuptohet se ai në kronikën e tij fliste për dy aspekte, dy kuptime të nocionit *Serbi*a: një herë për Serbinë në kuptimin e ngushtë gjeografik, pikërisht për atë territor që më vonë rëndom u quajt Rasha - aty ku Porfirogeneti i përshkruan kufijtë e Dioklesë. Dioklea (Dukla), sipas Constantine Porphyrogenitus (në tekstin e mëtejmë Porfirogenet), i kishte "kufijntë malorë me Serbinë". Po ashtu nga kufij malorë Serbia e shek. X ndahej edhe nga Travunia e Zahumla[31] (= Hercegovina e sotme): "Sikundër shihet, Porfirogeneti në të tria rastet e veçon Serbinë si territor më vete dhe e vendos në veri të Duklës, ndërsa në relacion me Travuninë e me Zahulmlen, Serbia, sipas tij, shtrihej qartazi në verilindje dhe në lindje […] Pra, në vendet e mësipërme të kronikës së tij arkontet e sipërpërmendura nuk i lidh për Serbinë, gjë që do të thotë se nuk i konsideron pjesë përbërëse të saj, porse i përshkruan si principata më vete të cilat vetëm kufizohen me Serbinë. Kur e përshkruan

[*] Constantine Porphyrogenitus, De administrando imperio, botuar nga Gy. Moravcsik-J. Jenkins, Budapest 1949.

[29] Ljetopis Popa Dukljanina, Beograd - Zagreb, 1928.

[30] Sh. punimin e tij, O granicama Srbije i srpske države u X veku, Zbornik folozofskog fakulteta 11/ Beograd, f. 153-178.

[31] Relja Novaković, f. 153-154.



Ekspansioni i Nemanjiqëve 1196 - 1355

Paganinë, ai as që e përmend Serbinë, sepse kjo nuk ishte në kontakt me atë kapitulli "Mbi serbët dhe vendin në të cilin ata banojnë *tani*". Në bazë të një kallëzimi të Porfirogenetit që ka të bëjë me ngjarje në kohën e knjazëve Višeslav e Časlav, del se Serbia në shek. X nuk shtrihej përtej Rasit (Rashës së mëvonshme) sepse pas një përleshjeje ndërmjet bullgarëve dhe serbëve, serbët ia kthyen mbretit bullgar Borisit të birin e zënë rob të cilin nëpër Serbi e përcollën bijtë e Milutinit dhe atë "e sollën të tërin deri në kufi, deri në Ras".[32]

[32] Poai, Poaty, f. 155.

Në gjithë kronikën e bashkëkohanikut të Porfirogenetit, atë të priftit të Dioklesë, Serbia me këtë emër përmendet vetëm dy herë, ndërsa në gjithë tekstin e mëtejmë e quan *Ras* dhe banorët e saj *rasianë*. Duke folur për të parën herë për Serbinë, prifti i Dioklesë "Serbinë, e cila quhet edhe Zagorje, e ndanë në dy treva: njërën nga lumi i madh Drina në drejtim të perëndimit deri tek mali Pina, të cilën e quan edhe Bosna, ndërsa të dytën nga ky lumë i madh Drina në drejtim të lindjes deri tek Lapia (Llapi) dhe Liqeni Labeat (= Liqeni i Shkodrës*)*, të cilën ky e quan Rasha." ["*alteram vero ab eodem flumine Drina contra orientalem plagaam usque ad Lapiam et lab. quam Rassam vocavit*".[33] Për një pikë tjetër kufiri të Serbisë mësohet sërish nga e dhëna që del te prifti i Dioklesë, e cila ka të bëjë me përshkrimin e shtegut të ikjes së zhupanit rasian i cili, i mundur nga mbreti hungarez Bela në një betejë afër lumit të Limit iku deri afër lumit të Ibrit. Nuk është prandaj aspak e rastit që dijetari kroat Fr. Rački, mbi bazën e të dhënave në kronikat e Porfirogenetit dhe të priftit të Dioklesë mendon se "Serbia duhet të kërkohet në rrethin e Drinës së poshtme, Limit, Ibrit dhe Rashës", duke shtuar në vazhdim se Rasi ishte kufi midis Serbisë e Bullgarisë.[34] Stojan Novaković[35] e interpreton ndryshe këtë vend të tekstit të priftit të Dioklesë. Ai kujton se kufiri lindor i Serbisë së shek. X po u dashka të shtyhej në kufirin ujor që e krijojnë lumenjtë Llap e Toplica, Kosanica e Jabllanica. Sa i takon nocionit *Lapia* St. Novaković i del zot mendimit se me këtë emër duhet kuptuar regjioni i Prishtinës qytet ky që, sipas tij, në mesjetë quhej sipas vendit Lipjan, ku ishte edhe ipeshkëvia e Lipjanit". Këtë interpretim të emnakut të vet, R. Novaković e vë në dyshim dhe çuditet se si Novaković-i plak ka mundur të mendojë se Serbia paska arritur të shtrihej aq gjerë, sa kohë që dihet se në shek. X nuk paska pasur kushte për zgjerim të Serbisë dhe konstaton se në shekullin 10, duke u mbështetur gjithnjë në tekstin e Porfirogenetit,"Serbia nuk ka mundur të shtrihej deri në Llap ose deri në lindje të këtij lumi", për të vazhduar me konstatimin se "përmendja e lumit *Lap* nuk duhet marrë, mendoj unë, kallëp dhe të mendohet se paskemi të bëjmë me gjithë rrjedhën e tij për së gjati" (...) Sipas kësaj do të rezultonte se kufiri i Serbisë paska pas mundur të arrinte deri në Prishtinë e në Lipjan. Në kësi rasti do të duhej pyetur si do të ishte e mundshme që kufiri midis *dy* shteteve të kalojë si të thuash mespërmes fushës së Kosovës. Është e vështirë ta besosh një gjë të tillë". [36]

[33] Cit. sipas R. Novaković, Po aty, f. 155.
[34] R. Novaković, Po aty, f. 156.
[35] Në Glasnik XLVIII, Beograd, 1880, f. 110; cit. sipas R. Novaković, Po aty, f. 155.
[36] R. Novaković, Po aty, f. 155, 158.

R. Novaković e konteston edhe shtrirjen e Serbisë në shek. X deri në Liqenin Labeat, përkatësisht të Shkodrës: "E çfarë kufiri do të na ishte ai që do të shkonte *vetëm* deri në Liqenin e Shkodrës dhe si do të mund të përfundonte *pikërisht* aty? Unë mendoj se prifti i Dioklesë, përkundër paqartësisë së tij, nuk do ta shkruante një budallallëk të tillë. Edhe nëse e marrim se përmendja e Liqenit Labeat ka të bëjë me shek. X, e madje edhe me atë 11, është plotësisht e qartë se Serbia as gjeografikisht e as në kuptimin territorial-politik kurrë deri në shek. XI, e as deri në gjysmën e dytë të shek. XII, nuk është shtrirë *pikërisht* deri tek Liqeni i Shkodrës". Me interes është në këtë mes të shtohet edhe venerimi i R. Novaković, sipas të cilit nga burimet e shek. X nuk është krejt e qartë nëse me emrin Ras duhet kuptuar lumin apo qytetin Ras. Megjithatë ky e lejon mundësinë e vagullt që mund të kemi të bëjmë me qytetin Ras, i cili asokohe do të ketë qenë i rrënuar dhe i braktisur nga banorët e tij.[37]

Le të kalojmë tani tek kufiri lindor i Serbisë në shek. X në relacion me dy burimet e përmendura të atij shekulli. Këtu porse kemi parasysh vetëm dëshminë e Porfirogenetit për kufirin e Serbisë deri në Ras, ndërsa prifti i Dioklesë thotë për atë kufi se shkonte "*usque ad Lapiam et lab"*. Sikundër u tha më lart, rrethanat historike në shek. IX dhe fillimit të shk. X ishin të pafavorshme për Serbinë sepse forca bullgare, e cila disaherë e kishte zaptuar edhe Serbinë ishte asokohe në kulmin e saj, derisa përfundoi më 924. Gjatë shek. X apetitet e zgjerimit territorial të Serbisë ishin drejtuar për kohë të shkurtër kah perëndimi, ndërsa për ndonjë shtrirje në lindje nuk kemi dëshmi. "Pra nuk ka kurrfarë shenjash se kufijtë e shtetit serb të shek. X shkonin më larg shpatijeve perëndimore të Kopaonikut, e aq më pak se do të jenë shtrirë përtej shpatijeve lindore e jugore të tyre. [. ..] as nuk ka gjithashtu kurrfarë baze për t'u besuar se kufijtë e saj lëshoheshin në shek. X edhe më në jug të shpatijeve të Bjeshkëve të Thata e të Bjeshkës së Moknës, të Zhlebit e të Hajlës" [. ..] "Me përmendjen e lumt Llap prifti i Dioklesë nuk do ta ketë menduar të tërë gjatësinë e tij, sepse ajo rrjedh edhe nuk e ka atë kuptim, porse do ta ketë menduar vetëm rrjedhën e poshtme të tij, atë që kalon pak a shumë nëpër terren të hapur. Midis Ibrit të mesëm dhe rrjedhës së epërme të Llapit ka një varg prej malesh që i takojnë masivit të Kopaonikut të jugut dhe, në relacion me atë masiv, pjesa e epërme e Llapit paraqet një pikë krejtësisht të parëndësishme dhe sikur akëcili të donte ta paraqiste brezin kufitar *në atë* drejtim, më parë do të vinte në konsiderim Ibri e Kopaoniku se sa një lumë kaq i vockël malor çfarë është Llapi në rrjedhën e tij të epërme e të mesme. Për shkaqet e theksuara më lart kujtoj

[37] R. Novaković, po aty, f. 160, 169.

se "*usque ad Lapiam et lab*" e priftit të Dioklesë duhet interpretuar ashtu që kufiri i Serbisë në shek. X nuk ka shkuar më në jug se treva e Zveçanit e as më në jug të kurorës së maleve që shtrihet nga Bjeshka e Thatë deri në Hajle".[38] Këto përfundime R. Novaković i mbështet tek rrethanat ekzistuese historike e politike të shek. X. "Pra, vetëm në drejtim të veriut, lindjes dhe jugut kishte kushte të volitshme për përhapjen e nocionit Serbi, sepse në territoret në këto drejtime nuk ishte formuar deri atëherë kurnjë krijesë territoriale-politike me po atë apo me një përbërje të ngjashme etnike siç ishte rasti me Bregdetin dhe me Bosnën, veçse kjo u arrit vetëm me shtyrjen qoftë të pushtetit bullgar qoftë të atij bizantin dhe me ndajmbathjen territoriale dhe bashkimin përbrenda shtetit që e bëri shteti gjithnjë e më i fortë i Serbisë [. ..] Vetë fakti që Časlav-i ishte në paqe me Bizantin dhe se perandorët i drejtohen atij në formë urdhërash flet në të mirë të mendimit se në drejtim të lindjes dhe të jugut kufijtë e shtetit serb nuk binin në Kosovë, në luginën e Sitnicës e të Llapit, e as nuk e kanë kapërcyer vargmalin e Kopaonikut. Nuk ka kurrfarë dëshmish që Bizanti do t'ia ketë dhënë Časlav-it - si vazal që e kishte ndonjërën nga këto krahina".[39]

6. SUBSTRATI PARASLLAV I SHTETIT TË RASHËS

Le të kthehemi për pak edhe një herë tek vendosja e serbëve në Ballkan, përkatësisht në Rashkë - një vend që më vonë do të bëhet bërthamë e shtetit serb në ekspansion. Dihet krejt qartë që tokat në të cilat u vendosën serbët sllavë nuk ishin të pabanuara. Nga burimet e periudhës parabizantine mësohet se në Gadishullin e Ballkkanit - përveç grekëve - jetonin popujt autoktonë të kësaj zone si dardanët e ilirë të tjerë, trakasit, dakasit, mizët, besët, tribalët etj. Po e lamë anash rezultantën historike që del nga kjo rrethanë, përkatësisht pra atë se serbët dhe fiset e tjera sllave janë ardhës, interesimi ynë do të përqendrohet në rolin dhe fatin e substratit etnik-gjuhësor shqiptar e vllah që e ka luajtur në formimin e etnisë serbe dhe pikërisht edhe në vetë regjionin që mbahet për bërthamë e shtetit serb të mesjetës. Duke mos dashur të përballet pothuaj asnjëherë me substratin, dija serbe e historisë dhe e filologjisë e ka mohuar madje edhe ekzistimin në këto zona si të elementit shqiptar ashtu edhe atë të elementit vllah. Këtë qëndrim jokorrekt e të ngjyrosur politikisht, dija serbe ka synuar ta arsyetojë duke u përpjekur të tregojë se kinse termi "vllah" që shënonte elementin autokton etnik të romanizuar të Dardanisë

[38] R. Novaković, Po aty, f. 169, 170, 171.
[39] R. Novaković, Po aty, f. 175.

e të gjithë Ilirikut e të Trakisë parasllave nuk e paska kuptimin e përkatësisë etnike, porse vetëm atë të blegtorit

Si oponentë karshi bujqve, blegtorët janë konsideruar gjithherë si të përkatësisë josllave. Ka shumë shenja që dëshmojnë se midis tyre kishte romanë e shqiptarë (të cilët shpesh janë radhitur nën të njëjtin nocion ekonomik), mirëpo ka edhe shumë raste që dëshmojnë se ata ishin sllavë të mirëfilltë gjë që e provon se vllah në Serbinë e vjetër, qysh në shek. XIII, shënonte më parë një klasë sociale, duke e ndarë nga ajo nacionalja". Duke e heshtur arsyen e ekzistimit të emërtimeve me origjinë vllahe të maleve të mëdha si *Vlašić, Durmitor, Korona, Negrišor, Rumska, Bukor* etj., Novaković e mbron përsëri me ngulm tezën e vet duke e arsyetuar këtë me konstatimin se e gjithë toponimia tjetër përreth këtyre maleve është e origjinës sllave.

Këtij mendimi, të cilin ka historianë serbë që e mbajnë edhe sot, i kundërvehej qysh në shek. XIX Fr. Miklosich.

Elementi i shkapërderdhur etnik vllah i Ballkanit ka qenë njëri ndër faktorë të rëndësishëm në formimin e popujve e të kulturave në këtë Gadishull. "Kjo popullatë. vllehtë e cincarët, kanë qenë një element i rëndësishëm në jetën e popullit serb [...], ata ushtruan një ndikim të fortë mbi serbët në çdo kuptim, në zhvillimin e kulturës së tyre materiale, të gjuhës etj.", thotë p.sh. historiani i njohur Stanojević[40] për të vazhduar pastaj duke e shtuar pyetjen: "Nëse ne e pranojmë se shqiptarët i kanë kontribuar formimit të etnisë sllave të këtyre viseve, përse nuk bën të pranojmë se këta i kanë kontribuar edhe formimit të gjuhës sllave? Apo, a nuk është shpjegimi i këtij gjysmëvokali më i natyrshmi ai nëse paravendohet se popujt josllavë të këtyre trevave, kur ata u sllavizuan dhe e morën gjuhën sllave, e ruajtën **ë**-në e sllavishtes, sepse këtë vokal tashmë e kishin të njohur nga gjuha e tyre, ndërsa tingujt e tjerë[*] i lanë anash, sepse nuk i kishin në gjuhën e tyre dhe për këtë arsye i shkëmbyen me vokale të tjera? "

Nëse mbahet parasysh ky konstatim dhe në anën tjetër nëse sillet ndërmend rrethana se pikërisht brenda një treve të tillë formohet në shek. XII një shtet serb i cili as nuk quhet Serbi porse (mbi bazën e lumit apo qytetit joserb *Ras*, nga **Arsia*) *Raška* do të duhej besuar se ky shtet serb u organizua në një trevë e cila banohej dendur nga popullsi josllave, autoktone. Këtë na e zbulon edhe emri i malit *Stari Vlah* i cili ngrihet mespërmes shtetit serb të mesjetës. Kësaj duhet shtuar edhe rrethanën që mbase

[40] Sh. Ljuob(omir) Stanojević, Pristupna akademska beseda, govorena na svečanom skupu Akademije 11. jan. 1896, Glas, SKA, LII, Drugi razred, 34, Beograd, 1896, f. 19.

[*] S. G. teknikisht nuk ka mundësi të jepen këtu.

edhe vetë emri *Raška* nuk është emër sllav i vendit. Ndër burime shkrimore latine emri i këtij vendi shënohet në trajtat *Rassa, Rasia,, Rassia, Rascia* dhe *Raxia* (S. G.: kjo e fundit duhet shqiptuar si Rashia). Dijetari i merituar kosovar Prof. Idriz Ajeti shkruante më 1966: "dihet për e sigurt se Raša është relikt i emrit prasllav Arsia që në të folmet serbokroate dhe në toponiminë e Jugosllavisë është ruajtur me metatezën e njohur *Ar - Ra*. Trajtën Ras, Raša e ndeshim pastaj në Serbinë Perëndimore, në ujdhesa dhe bregdetin kroat, në Istrinë veriore. Emri ynë mund të sillet në lidhje me ind. e vj. *Arsati* "furishëm, në sasi të mëdha; rrjedh, qarkullon". [41] Dijetari i merituar Prof. E. Çabej e lejon mundësinë sipas së cilës "emri mesjetar i sanxhakut të Novipazarit Raša, Raška mbase është refleks i shqipes. *rash* (për rafsh) dhe shton se kjo shpjegohet me ndërrimin e *fsh* në *sh* në të folmen e Veriut, gjë që dëshmohet edhe në fjalorin e Frang Bardhit (1635).[42] Kjo fjalë me të cilën Çabej e sqaronte toponimin Raška/ Rasha, del në shqipen edhe në trajtën *rrafsh*. Ka shumë arsye të besohet se trajta serbe Raška ka dalë nga trajta parasllave Ras dhe se "përmes emrit etnik Rašanin (S. G.: "banor i Rashës") kemi fituar Raška"[43] dhe jo si rezultat i ndonjë kontunieteti sllav mbi bazën e kalimit të *s* në *š*.

Edhe tek vetë serbët ka një dysi për sa i përket trajtës së emrit: karshi më të shpeshtës *Raška* përdoret rrallë edhe ajo *Raša*. Duket se ky dualizëm është punë trashëgimi, sepse po kjo lëkundje dëshmohet edhe ndër burime historike. Nga burimet nuk mund të mësohet nëse ky emër ishte i gjinisë mashkullore apo femërore, sepse ky emër del p.sh. më 1504 si *Raška*, ndërsa ndonjëherë *Ras*. Po ky dualizëm del edhe në shkrimet bizantine: një herë si emër femëror *té Ráse* dhe një herë si mashkullor *Ráson*. Mbisundon mendimi se e kryehershme është trajta Ras ose Rasa. Fundja. është fenomen i njohur ky që ardhësit jo rrallë e marrin për emër etnik emrin e vendit ku nguliten. Le t'i kujtojmë në këtë mes p.sh. sllavët e quajtur maqedonas emri i të cilëve është në të vërtetë emri i popullit parasllav të makedonëve dhe i shtetit të tyre; bullgarët e sotëm nuk e kanë për emër nacional të tyrin ndonjë emër sllav, porse emrin e protobullgarëve tataro-mongolë ashtu sikundër emri mesjetar i serbëve *Rassiani* i heq rrënjët, pra nga emri *Arsia* i lumit apo i qytetit - si atdhe i dytë i tyre ballkanik - ku u vendosën në krye të herës.

---

[41] Sh. Neki zajednički izrazi šiptarske e srpskohrvatske leksike, Buletin i punimeve shkencore të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, III, Prishtinë 1966, f. 7

[42] Sh. Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XIV, Studime filologjike, Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i historisë dhe i gjuhësisë, 3 /1964, f. 61.

[43] Sipas Asim Peco, Nazivi dolina uz reke u srpskohrvatskom jeziku, Južnoslovenski filolog, XXX, 1-2, Beograd 1973, f. 510.

Se një shtet serb i Rashës u krijua në një zonë të mbizotëruar nga një substrat ilir e roman ballkanik, përkatësisht shqiptaro-vllah e tregon gjithsesi edhe rrethana se as emrat e dy lumenjve më të mëdhenj të regjionit: *Lim* dhe *Ibër* nuk janë as emra sllavë e as reflekse sllave emrash parasllavë. Emri *Lim* i lumit është sqaruar qysh nga Miklosich-i plak e nga Norbert Jokl me fjalën shqipe *lymë, lumë* "balta që sjellin lumenjtë e përrojet" dhe askush deri tani nuk e ka vënë në dyshim këtë etimologji. Këtë shpjegim e pranon edhe dijetari serb i madh i gjuhësisë Ivan Popović.[44] Sa i përket emrit të dytë, është shfaqur mendimi jokompetent se ky emër mund të sqarohet me mbiemrin shqiptar *i bardhë*,[45] një mendim që mua më duket i guximshëm, sidomos në dritën e rrethanës se ka shumë mundësi që emri i këtij lumi të jetë me prejardhje paraindoeuropiane.

7. KRISHTERIZIMI I SLLAVËVE (BULLGARËVE E SERBËVE)

Serbët e shtetit të Rashës, Porfirogeneti i cilëson në shek. X për "serbë të krishterizuar". Se sa do të ketë mbetur në këtë krishterim nga ai paganizëm militant (siç e quan Gottfried Schramm[46]) që i karakterizonte gjithë sllavët e Ballkanit, nga të cilët ishte cari bullgar Borisi I ai që ndër të parët u pagëzua më 865 pikërisht në Ballshin e sotëm e Shqipërisë. U deshtë porse të kalojë kohë fort e gjatë derisa të gjithë sllavët paganë të Europës Juglindore të krishterizoheshin më shumë se sipërfaqësisht dhe që besimin e ri ta ndjenin për të vetin.

Mbase pikërisht rezistenca e elementeve pagane; rrymat e ndryshme sektare si bogumilizmi dhe sidomos lojërat e sundimtarëve serbë me ritet e krishterimit për e në momente të ndryshme historike-politike bënë që riti ortodoks të ngulitej tek ata së pakut ndonjë shekull më vonë pas mëvetësimit të kishës serbe nga ajo e Bizantit. Megjithë pavarësimin kisha ortodokse serbe, vështruar në rrafshin e rregullimit kishtar, terminologjisë kishtare dhe kulturës, mbeti e është një version/kopje serbe e ortodoksisë greke. Dhe për pjesë e hapësirës në të cilën u etablua kjo ortodoksi merret edhe hapësira e Kosovës në të cilën porse para etablimit të kishës serbe jetonte popullata e krishterë shqiptare e ritit bizantin e cila nuk kishte arritur ose nuk ishte përpjekur të shkëputej nga kisha bizantine mbase pse nuk kishte formuar një klasë të veten të organizuar feudale.

Mbretër serbë ngritën në hapësira të Kosovës, popullata e së cilës ishte nënshtetase e Bizantit dhe e ritit ortodoks të tipit bizantin, nja katër

[44] Khs. punimin e tij Elemente të gjuhës shqipe në gjuhët tjera, "Përparimi" 1-2, 1957, Prishtinë, f. 20.

[45] Sh. Grup autorësh, Novi Pazar i okolina, NIP Književne novine, Beograd, f. 90.

[46] Anfänge des albanischen Christentums, Frieburg im Briesgau, 1999, f.145.

kisha/manastire të mëdha kryesisht mbi themele të kishave paleokristiane, romake e bizantine, ndërsa pjesën dërmuese absolute të tyre e shpallën për të tyren. Për shkak të mungesës së kompetencave profesionale, pohimin tim të mësipërm e mbështes në konstatimin e etnologut të merituar kosovar Mark Krasniqi, i cili përkitazi me këtë çështje shkruante: *"Pothuaj të gjitha kishat ortodokse në Kosovë ishin aty shumë kohë para se serbët të vinin në këtë territor. Ato ishin ndërtuar gjatë kohës së sundimit bizantin në këtë hapësirë të banuar nga shqiptarët. Kemi të bëjmë pra, me monumente të një kulture të huajë, të cilat Serbia i përvetësoi dhe sot ia prezanton botës për si monumente të vetat historike.* [...] *Në ndërkohë, disa nga këto kisha i meremetuan dhe i zgjeruan sundimtarët serbë të dinastisë së Nemanjidasve, por nuk i ndërtuan ato që nga themelet. Këtë e dëshmon jo vetëm historiani i njohur Konstantin Jireček, por edhe shkencëtari serb Pero Slijepčević, i cili shkruan se "Serbët nuk do të kenë pasur as mundësi e as aftësi arqitektonike të ndërtonin këso kishash, të cilat nuk qenkan të tyret, porse ato po rrjedhkan nga një kohë, në të cilën serbët bile as që ishin në Kosovë"*.[47]

Një e vërtetë e konstatuar nga shumë historianë joserbë është që kisha autoqefale serbe nuk u pengua së vepruari as pas pushtimit të Kosovë nga Perandoria Osmane, pas disfatës së koalicionit të krishterë euroqendror e ballkanik (në të cilën kishin marrë pjesë feudalë të krishterë të Shqipërisë dhe disa feudalë vendës kosovarë për të cilët dihet) në Fushë të Kosovës në vitin 1398. Kjo sepse, së pari, dyert sundimtare serbe e pranuan vasalitetin në relacion me pushtuesit osmanë dhe, së dyti, nën presionin e qendrës ortodokse të Konstantinopojës, Perandoria Osmane jo vetëm që nuk shfuqizoi, porse e favorizoi kishën serbe. Dhe nëpër manastire serbe u zhvilluan më tej traditat dhe kultet për princin Lazar dhe mitin e Kosovës.

Vërehet qartazi që derisa në Kosovë para pushtimit otoman nuk kishte as 100 kisha funksionale (asokohe, pra para pushtimit osman, kishte shumë kisha e manastire të lëna shkret dhe truallishta syresh) pas pushtimit osman, sidomos gjatë shek. XVII-XVIII, numri i tyre rritet

[47] Cit. sipas Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë 2006, f. 50. Ky është në të vërtetë një formulim i akademik ut Mark Krasniqi në referatin me titull pune të tij Kosova Sot, të mbajtur në parlamentin e Belgjikës e të botuar edhe në Prishtinë në vitin 1992. Duket sikur ky konkludim është sajuar jo mbi thëniet adekuate të Jovan Radonć, Rimska Kurija i južnoslovesnske zemlje, Beograd, 1950, pa e pas dhënë numrin e faqes së cituar, as të K. Jireček, Istorija Srba, I, Beograd, 1952, bashkautor i së cilës është edhe vetë J. Radonić, e as të Pero Slijepčević, të botuar në revistën "Ogledi", 1934, por në bazë të mendimit që do të rezultonte nga qëndrimi i prof. Krasniqit përkitazi me këtë çështje.

dukshëm, sepse u tolerua përvetësimi/rindërtimi dhe ndërtimi në formë fushate i kishave në hapësirat e Kosovës, që ishin nën pushtetin paralel të vazalëve serbë.

8. PUSHTIMI I KOSOVËS NGA DINASTIA E NEMANJIDASVE

Pa marrë parasysh se sllavë të ardhur mund të ketë pasur në hapësirat e Dardanisë së lashtë, çështje që duhet të shihet në këtë kontekst është detyrë e dijes së sllavistikës. Kjo degë e dijes do të duhej ta bënte prerjen, përkatësisht dallimin e gjurmëve leksikore e onomastike sllave të lashta, bullgare e serbe. Është porse gjithandej e vërtetë se mujshia e pushtetit dhe e kishës serbe u instalua pas pushtimeve me hope/ekspansionit të principatës së Rashës[48] në shek. XIII e XIV, kur kjo principatë u zgjeruara edhe në Maqedoni, Bosnje, Hercegovinë, Dalmaci të jugut e në Shqipëri të Veriut.

Si e gjithë historia e sllavëve të Jugut të Ballkanit, ashtu edhe ajo e serbëve në Kosovë është histori e pushtimeve, e ekspansionit territorial, e jetësuar kryesisht sa me imponimin e ortodoksisë së variantit sllav mbi popujt e pushtuar nga ata që rezultoi me sllavizimin si të toponimisë dhe të antroponimisë së shqiptarëve të Dardanisë së lashtë (edhe ashtu të krishterë të ritit ortodoks dhe shtetas të Bizantit) ashtu edhe përmes dëbimeve të njëpasnjëshme të organizuara sinkronikisht të popullatës vendëse nga viset etnike të tyre. Mjafton të përmenden në këtë mes projektet e hartuara nga I. Garašanin, V. Čubrilović, I. Andrić.

Duket se motivi për dëbimin e shqiptarëve ishte mitizimi i ikjes së popullatës së krishterë shqiptare e serbe për në Vojvodinë, pas disfatës së luftës kudër Perandorisë Otomane të drejtuar nga Austro-Hungaria, arratisje që historiografia serbe e quajti "Shpërngulja e madhe e serbëve". Se nga Kosova nuk ishte shpërngulur masë e madhe serbësh e shqiptarësh e dëshmuan me fakte dijetarët si A. Ducellier e N. Malcolm.

9. EMRI I KOSOVËS SË SOTME SIPAS BURIMEVE HISTORIKE

Kur pushtuesit serbë të Kosovës në shek. XII e vendosën pushtetin dhe kishën e tyre në tokat e shqiptarëve, nuk kishin ndonjë emër për këtë hapësirë. Për ta kjo (hapësirë) ishte vetëm *grčka zemlja*, përkatësisht "Tokë e Bizantit". Mirëpo ka dëshmi se këta e gjetën emrin e vjetër të saj *Dardania*. Kjo bëhet e ditur në jetëshkrime e në gjenealogji të sundimtarëve serbë pikërisht për atë pjesë të Kosovës së sotme ku ardhësit serbë e vendosën selinë e tyre kishtare. Për këtë hapësirë serbët përdorën emrat *Dardania* dhe *Vendi i Dardanëve/Trevat e Dardanëve*. Këta emra

[48] Sipas Rudolf Flotzinger, http. www. Österreichisches Musiklexikon, ac. at.

ndeshen p.sh. në jetëshkrimin e Stefan Uroš Milutin-it, kur po përshkruheshin ngjarjet e vitit 1270, ku e kur thuhet se: "*Milutin-i mbret i Banjskës i barti selitë në Dardani nën Malin Shar të quajtur Prizren*".[49] Po në këtë kontekst emri *Dardania* përmendet edhe kur po shkruhej rreth vendosjes së selisë së kishës serbe në Pejë. Në burimin përkatës thuhet se "Së fundi mbreti i parë e zhvendosi selinë e tempullit të ipeshkëvisë në Zhdrellë (afër) Pejës së Hvostno-s "*trevat dardane*".[50] Po kështu vepronte edhe humanisti kosovar Martino Segano[51] i qytetit mesjetar të Novobërdës, i cili kur po shkruante për *Serviani*-t "S.G: banorët e Servias" thoshte se ata janë *Reliqui populi, vicini Macedonibus. .. qui ab eodem auctore Dardani vocantur*.[52] "Mbetje e një populli, fqinj i makedonëve. .. të cilët po nga ai autor quhen dardanë" Dhe, këta dardanë, thoshte Segano, i kishin qytetet: "Novum Montum që është metropola e regjionit [...] Sunoiza, Trepiza (SG.: Trepça), Jalecium (S.G. Jelač), Brorum, (S.G.: Boreč ?) Priseremum (S.G.: Prizreni) et Avuzia".[53]

Humanisti kosovar Martino Segano, në vepërzën e vet në të cilën e përshkruante rrugën nga Beogradi nëpër Dardani dhe nëpër tokën e tribalëve deri tek Mali i Ballkanit, përkatësisht shkruante edhe "*Altera via inferior quae ex eodem Belgrado per Dardanos et Triballos montem Haemum transgressa prope Hebrum cum superiori via cogniungitur*".

10. EMRAT SLLAVË PËR KOSOVËN

Tokat nën administrimin e mbretërisë serbe, përfshirë edhe Kosovën e sotme, janë njohur nën emrat *Sclavonia*, *Ras*, *Rasia* dhe *Servia*.

---

[49] Khs. Ljub. Stojanović, Stari srpski rodoslovi i ljetopisi, Beograd 1883 f. 57: "*prijetь kralěvьstvo (ose: vьkrali se) Stefanь peti,, Ourošь vьtorьï Milutinь kralь banьskые. Prenese stolě vь Dardaniju podь Šarь planinou zovimi Prizrěnь*. .. " dhe versionin e redaktuar po nga Lj. Stojanović në Stari srpski rodoslovi i ljetopisi, në Zbornik za istoriju, jezik i književnost srpskog naroda, vëll. XVI, SKA, Sremski Karlovci 1927, f. 195: "*Malo bьistь, priimi kralěvstvo; Milutinь, Stefanь Urošь vtori. Prenese stolě u Dardaniju podь Šarь'planinou, zovomi Prizrenь, i carstvova 48 letь*"

[50] Khs. Lj. Stojanović në Stari srpski rodoslovi i ljetopisi, në Zornik za istoriju, jezik i književnost srpskog naroda, vëll. XVI, SKA, Sremski Karlovci 1927, f. 194: "*posležde i hramь vaznesenie gospodne vtori arhiepiskopiju, prenese stolicu u Dardanske predele va ždrelo hvostanskoe Peći*".

[51] Ky kishte qenë një kohë famullitar vendës në qytetin e Novobërdës, ndërsa në vitin 1474 gjendej në Padovë, ku e mbrojti tezën e tij të doktoranturës dhe ku i dërgoheshin me një ndërmjetës raguzas 100 duketë.[51] Ky kishte qenë edhe ipeshkëv i Ulqinit. Vdiq në vitin 1485.

[52] Khs. Agostino Petrusi: Martino Segano di Novo Brdo, Vescovo di Dulcigno (Un umanista serbo-dalmata del tardo Quattrocento), Vita e Opere, Roma, 1981, f. 102.

[53] Sh. Agostino Petrusi: Martino Segano di Novo Brdo …, f. 102.

Nocionin *Sklavonia*, me prejardhje të huaj, europerëndimore, për shtetin e serbëve, përfshirë këtu edhe Kosovën e pushtuar nga ata në shek. XII, përkatësisht qytetet-miniera të Trepçës e të Novobërdës, duhet kuptuar vetëm si rezultat të njohjes së pushtimeve serbe. Kjo shihet nga një dokument i vitit 1382 kur është shënuar se njëfarë "*Dom Georgius Gega; Nikola de presbitero Tanussio* banor i Novobërdës i dioçezës së Kotorrit" nga ipeshkvi i Tivarit ishte emëruar për vikar (mëkëmbës) të tij [...] "*super omnes ecclesias illarum patriam Novimontis et Sclavonie*...", përkatësisht "Mbi të gjitha kishat e atjeshme të vendit (SG: = qytetit) të Novobërdës e të Sklavonisë".[54] Varianti *Sklavinia* për formacionin shtetëror të Rashës është përdorur edhe në një dokument raguzas që ka të bëjë (vetëm) me Trepçën (Lamenta de foris 1446, f. 249) nga i cili mësohet se njëfarë Giuichus Braissich (lexo Gjukus Brajshiq), ankohej se atë e kishte vjedhur shërbëtori i tij që ishte arratisur "*in Sclauonia in Sassi*" (lexo: në Sklavonia, në Sasi). Këtu kemi të bëjmë me një vendbanim të quajtur *Sasi* "Sasët" që nuk ishte larg nga Mitrovica.[*] Kjo mësohet edhe nga deklarata e dëshmitarit Radach Iffcouich (lexo Radak Ifkoviq) sipas së cilës për këtë kishte dëgjuar, kur ky vetë bashkë me patronin e tij Zuan Serceuich (lexo Zhuan Serçeviq) ishte kthyer në "*e Dimitrouç videlicet de nundinis*" përkatësisht në Dimitrovci - siç quhej më 1446 Mitrovica e sotme - vend ky që kishte edhe tregje vjetore, përkatësisht panaire.[55] Një dëshmi të kësaj natyre e kemi edhe për qytetin e Pejës për ku në vitin 1327 përmendet një ulqinak, qytetar i Raguzës, për të cilin thuhet se ishte *habitantis ad presens in Pech in partibus Sclauonie* përkatësisht. .. *de Pechio*. .. *de Sclauonia* [...] *habitantis ad presens in Pech in Sclavonie* "prej tani banor në Pejë në pjesën Sklavovia", për të cilin qytetar thuhej se aty (në Pejë) merrej me tregëti[56] dhe në testamentin e një raguzasi rreth të cilit dëshmitarët deklaronin në vitin 1327 se kishin

[54] M. Dinić, Za istoriju rudarstva u srednjovekovnoj Srbiji i Bosni, II, Beograd 1962, f..94.

[*] Ky vend përmendet më 1313 Khs. Vatroslav Jagić, Svetostefanski hrisovulj kralja Stefana Uroša II Milutina, Wien, 1890, 21; *Planina nad Sasьi trebьčkiomi*; "*Sasi trebьčkii*", St. Novaković, Zakonski Spomenici …, f. 624; Constantin Jireček: Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien, Studien zur Kulturgschichte des 13 -15 Jahrhunderts, II, Denkschriften des Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch-Historische Klasse, Band LVI, Wien 1912, f. 66. Ka një mendim sipas të cilit vendi *Sase* mund të jetë katundi i sotëm *Zhazhë* i rrethinës së Mitrovicës.

[55] Sipas Dr. Constantin Jireček, Das christliche Element in der Topographischen Nomenclatur der Balkanländer, Sitzungsberichte der. Kais. Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch-Historische Classe, Band CXXXVI, Wien, 1897, f. 83.

[56] M. Dinić, khs. Nastanak dva naša sednovekovna grada, Prilozi za knjževnost, jezik, istoriju i folklor, nr. 31, bleu 1-2, Beograd, 1965, f. 198. Te Dr. Jahja Drançolli, Raguzanët në Kosovë, 1986, f. 103 është shënuar se ky dokument na qenka i vitit 1376.

qenë *in partibus Sclauonie i loco vocato in lingua Sclaua Pech.*[57] Në dokumente raguzase, p.sh. në një të tillë të vitiit 1326, qyteti i sotëm i Pejës cilësohet të ketë qenë në *Sclauonia*.

Vetë sundimtarët serbë nuk e përdorën emrin e parë (Serbia, Servia), porse as nuk bënë ndonjë dallim/ndryshim midis emrit të dytë *Ras*, *Rasia* Rasha dhe atij të tretit. Emri i dytë, përkatësisht shprehja "*raške zemlje*" "tokat e Rashës" përdoret përfundimisht deri në mbarim të sundimit të Uroš-it I (1318-1321).

Për formacionin e organizuar në formë principate apo shteti të Serbisë, në dokumentacionin raguzas përdoret edhe varianti *Raxia* (lexo Rashia). Kështu, në një dokument të hartuar më 18 shtator 1402 në Dubrovnik, përmes të cilit bëhet e ditur se njëfarë Marcholnus giuroyeuich (Markolin Gjurojeviq) u zgjodh komit i brigantinit që në Shkodër shkon *pro dompno Johanne protouestiario Rassie* "për dom Johanin, protovestjar të Rashjes".[58] Po ky emërtim përmendet edhe në një dokument raguzas të 16 marsit 1405 nga i cili mësohet se: "Zoti Paskual de Babalio, kanonik raguzian dhe pleban i Novobërdos, bën dëshmi se ai i premton dhe detyrohet ndaj dom Mikel Martinit [Michaeli Martinj] nga Shënpali i Pultit, i cili është i pranishëm, që sa më parë ai t'i paraqitet (?) tek i thëni zoti Paskual, të mbetet në zotërim të plotë të plebanisë së Novobërdos të Rashjes ["in plenaria possessione plebanie nouimontis rassie. .. "] [dhe, kur të shkojë aty Paskali, do ta mbajë si kapelan të vetin"],[59] që shihet shumë qartë se nën jurisdiksionin e Rasia-s /Rashës kishte rënë edhe qyteti i Novobërdës.

Po ky emër ndeshet edhe në dokumentacionin venedikas. Kjo shihet nga një shkresë sipas së cilës Senati i Venedikut kishte vendosur më 16 mars 1403 që të dërgohet një njeri tek Stefani (SG: Stefan Llazarević-i) i Rashjes për marrëveshje tregtare. Në këtë shkresë thuhet se "Territoret dhe vendet e të madhërishmit, zotit kont Stefanit të Rashjes [Comites stefanj de Raxia] janë pranë territoreve dhe vendeve tona të Shkodrës dhe të Drishtit dhe, siç e dinë të gjithë, ndër vendet e në viset e të thënit, zotit kont Stefanit të Rashjes, bëhet tregti dhe fitime shumë të mëdha, sidomos prej raguzianëve dhe të tjerëve;. ..".[60] E njëjta gjë përsëdytet

[57] Khs. M. Dinić, Nastanak dva naša sednovekovna grada..., f. 197.

[58] sh. Dokumente për Historinë e Shqipërisë të shek. XV (1400-1405), përgatitur nga Injac Zamputi e Luan Malltezi, Tiranë, 1987, Dok. 255, f. 333.

[59] Po aty, po ata, Dok. 502, f. 563 -564.

[60] Sh. Dokumente për Historinë e Shqipërisë të shek. XV (1400-1405) përgatitur nga Injac Zamputi e Luan Malltezi, Tiranë, 1987, Dok. 308, f. 369

edhe në një dokument të shkruar më 7 qershor 1403 në Venedik.[61]

Për emërtimin *Serbia* mund të flitet vetëm pas kohës së Nemanjës, sado që ky nocion nuk përdorej as atëherë, porse vetëm shprehja "tokat serbe". Kjo që u tha vlen në të vërtetë për vetë sundimtarët serbë, sepse fqinjët e tyre kroatë vazhduan deri në vitin 1377 formacionin shtetëror serb ta quanin edhe më tutje "*raška zemlja*". Po kështu veprojnë edhe hungarezët dhe sidomos që nga koha e fillimit të vendosjes së rashianëve në Hungari, ku ky emër me kohë e mori edhe një kuptim pejorativ. Edhe dubrovnikasit, venedikasit dhe popuj e vende të tjera të Perëndimit, krahas emrit *Sclavonia*, e përdorin më shpesh nocionin *Rasia*, *Rassia*. Administrata bizantine nga ana tjetër nuk e ka përdorur kurrë emrin e kështjellës Ras si emër të një formacioni shtetëror serb.

Le ta përfundojmë këtë çështje me citatin e një anonimi i cili më 1308 flet edhe për *regnum Rasie*, përkatësisht për formacione shtetërore të serbëve e të cilin e sjell M. Dinić.[62] Autori anonim thotë se regnum Rasie "përbëhet nga dy pjesë, njërës që është më e rëndësishme dhe quhet Rasia në të cilën bien Rasha. Hum-i, Dioklea dhe Bregdeti; dhe tjetrës e cila quhet Servia. Kjo është në Hungari. Në këtë mbretëri ka pasur gjithmonë një mbret, ndërsa tani janë dy. Ai që e sundon Rashkën - në drejtim të Greqisë - është kryesori (*maior*) dhe quhet Urosh [...]. Tjetri, i cili për nga mosha është më i moçëm, është *rex Servie* "mbret i Serbisë" dhe quhet Stefan Dragutin. Ky i fundit mbahet për rex Servie edhe në burimet e shkruara latinisht, përkatësisht në ato të Napolit, Venedikut dhe në zyrat e papatit. Sipas një shkrese të papatit Sclavinia (jo Sllavonia e sotme) përbëhej nga Serbia, Rasha, Dalmacia etj. Tradita e mbajtjes së dy emrave të ndryshëm për dy mbretëri të veçanta të serbëve përfundon në fillim të shek. XV. Kjo ndodhi pas shuarjes së emrit Serbia për tokat në Panoni dhe kalimit e përhapjes së këtij emri mbi atë tjetrin – Raška.

E gjithë kjo që u tha më lart është një dëshmi se territori i Kosovës nuk është përfshirë as nën nocionin Rasha e as nën atë më të riun Serbia, që shënon pjesë të tokave të pushtuara – të banuara nga serbët të ndara ndërmjet veti dhe të njohura si dy shtete serbësh.

Me emrin "Mbretëria e Serbisë", përfshirë, këtu edhe hapësirën e Kosovës së sotme, krijesën shtetërore të Serbisë e njihte edhe Selia e Shenjtë. Kjo shihet në një shkresë të Vatikanit që ka të bëjë me kishat e famullitë katolike të atëherëshme në: Bërskovo, Rudnik, Trepçë, Graçanicë, të cilat në vitin 1303 përmenden për kisha katolike "[...] *de*

[61] Po aty, Dok. 346, f. 425.

[62] Sipas Mihailo J. Dinić, O nazivima srednjovekovne srpske države [Sklavonija, Srbija, Raška], Prilozi za književnost, jezik, istoriju i folklor, 1-2 (1966), f. 33.

Briscovia (e shkruar Bristonia), *de Rudinico, de Rogosna et de Trepczo et de Grazaniza*[*] *ecclesie parochiales in Regno Servie* [...]". Kjo traditë u ndërpre nga fillimi i shek. XIII.[63]

Dëshmia më e vjetër e një emri të vendit në Kosovë, të formuar nga emri popullor i serbëve, është e vitit 1348.[64] Këtu kemi të bëjmë, sipas M. Bukumirić, me katundin e sotëm Serbica e Poshtme në rrethina të Prizrenit, sepse në këtë katund paska edhe sot kishë e varre dhe se po këtu është edhe lumi Jagllednica që po me këtë emër përmendet në krisobulë.[65]

Pushtetet serbe e zbatuan këtë traditë edhe më vonë me rastin e zgjerimeve territoriale, përkatësisht të ripushtimeve të Kosovës dhe në Vojvodinë. Këtu i kanë rrënjët emrat e dy vendbanimeve si *Srbobran* e *Srbica* (shqip Skenderaj) në Kosovë. Emri i parë është riemërtim administrativ serb i vendbanimit që në krisobulën e Banjskës të viteve 1313-1318, e njohur edhe si Krisobula e Shën Stefanit, quhej *katun blgars'ki*[66] "katuni i bullgarëve" dhe që nga popullata shqiptare - si rezultat i kontinuitetit në të banuar të këtyre anëve - quhet edhe sot e gjithë ditën *Bugariq*, ndërsa i dyti i periudhës së pas vitit 1912, përkatësisht i periudhës së kolonizimit të Kosovës me kolonë nga Mali i Zi, Lika e nga Serbia. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me vendbanimin *Srbobran* të komunës së Istogut, banorët e të cilit u quajtën në bazë të dy familjeve që në këtë katund paskan ardhur nga vendbanimi homonim (*Srbobran*) i Vojvodinës.

Me prapavijë politike "historiografia dhe kisha serbe e quajti Kosovën edhe *Stara Srbija* "Serbia e Vjetër" dhe e mveshën me epitete si "Zemra e Serbisë"; "Jerusalemi i Serbisë", "Bërthama shtetërore, kishtare e kulturore e Serbisë".

Nocioni gjeografik "*Stara Srbija*" u lind në shekullin 19 nën ndikimin e ndryshimeve shtetërore që ndodhën pas mëvetësimit të Principatës së Serbisë. Kur kjo u paraqit nëpër harta si territor i mëvetshëm, gjeografët e panë të nevojshme të krijonin një emërtim të ri për ato hapësira të shtetit mesjetar të Serbisë që nuk ishin përfshirë përbrenda Principatës së Serbisë. "Serbi e Vjetër" u quajtën viset e atëhershme qendrore, jugore e

[*] Kemi të bëjmë, në të vërtetë, me Janjevën.

[63] Po ai, po aty, f. 28.

[64] Sh. Hrisovulja. .. 1348, f. 274, 302: khs. "*i pridasmo mu ot crkovne zemle ot arbanasъ špinadiju. a megja špinadii kako ide poutь is korišeo u srьbice do megje srьbič'ke; selo srьbice*".

[65] Sipas Mileta Bukumirić: Iz onomastike južne Metohije, Onomatološki prilozi V, SANU, Beograd 1984, f. 414.

[66] Sh. Lj. Kovačević, Svetostefanska hrisovulja, Spomenik SKA, IV, Beograd, 1890, f. 8.

juglindore të Serbisë mesjetare", përkatësisht hapësira territoriale e rënë nën pushtetin serb si rezultat i ekspansionit-pushtimeve nga dinastia e Nemanjidasve, sidomos ato që u pushtuan nga "perandoria serbe" jetëshkurtër e drejtuar nga St. Dushani. Kjo ide u elaborua nga antropogjeografi serb Jovan Cvijiq.[67] Ky emërtim nuk u përdor as nga shkenca e Perëndimit e as nga ajo e shteteve të Ballkanit. Kështu ndodhi edhe me emërtimin më të ri Kosovo i Metohija, po ashtu me prapavijë politike, i cili përdoret vetëm nga serbët.

11. SERBËT NË KOSOVË

Sikundër rezulton nga ç'u tha më lart, Kosova ishte nga viti 850 e deri në fillim të shek. XI nën sundimin bullgar, ndërsa perandorët bizantinë vazhduan ta kundërshtojnë mëvetësimin e kishës serbe dhe ta dominojnë këtë territor deri kah mbarimi i shek. XII.

Kjo lidhet me marrjen dhe me forcimin e pushtetit të zhupanit të Madh Stepan Nemanja në shtetin e Rashës që nga viti 1180. Stepan Nemanja dhe sidomos i biri Rastko, i njohur më vonë si shën Sava (pas orientimit përfundimisht kah Bizanti, përkatësisht riti orthodoks) kur ky u shpërblye nga Bizanti me lejen për themelin e kishës autoqefale serbe, me selinë kryesore në Pejë - peshkop i parë i së cilës u bë vetë shën Sava (sado që ky ende nuk e kishte titullin e patriarkut) - shkruan Birnbaum.

Zhupani i Madh i Rashës Stepan Nemanja e kishte rrëzuar më 1166 nga pushteti të vëllanë Tihomir, i cili deri atëherë ishte kryezhupan i Rashës dhe pak vite pas vdekjes së tij, më 1172, u detyrua porse t'i nënshtrohej perandorit bizantin Manuel. Pas vdekjes së Manuelit më 1180 Stepan Nemanja nuk e ndjente më veten t'i kishte gjë borxh Perandorisë Bizantine. Në vitet që pasuan ai e zgjeroi shtetin e Rashës duke ia bashkëngjitur atij regjionet e Duklës, pjesë të Shqipërisë së Veriut, regjionin e Humit si dhe qytete të bregdetit jugor të Dalmacisë që sundoheshin nga vëllezërit e tij e më vonë edhe Dubrovnikun. Me të pushtuar të Duklës, Stepan Nemanja u pagëzua sipas ritit katolik dhe më vonë iu kthye përsëri ritit orthodoks.

Dëshmia e parë konkrete e depërtimit të serbëve në Kosovë, përkatësisht të pushtimit të pjesëve të saj rrjedh nga viti 1198. Kemi të bëjmë me një shkresë të birit të Stepan Nemanjës të këtij viti, në të cilën zhupani i Madh i Rashës Stepan Nemanja tregon se "*od grčke zemlje*"

[67] Sipas Projekat Rastko Gračanica - Peć: Istorija: Stara Srbija, geografska i etnografska slika (1912.)

(dmth. nga Bizanti) i pushtoi *Lab s Lipljanjem* [68] "Llapin e Lipjanin" për të treguar më pastaj se nga Arbanoni e kishte pushtuar edhe Pultin: "od Arbanas Pilot".[69]

Nëse dëshmia e vitit 1198 është një tregim i hartuar më vonë mbi ngjarje të ndodhura më parë, atëherë duhet pranuar që[70] shteti i Rashës do të jetë zgjeruar pastaj edhe në verilindje - në Nish dhe se këtij shteti iu ndajmbathën më vitin 1184/85 si toka të pushtuara dhe disa rajone të Kosovës. Vetëm në fillim të shek. XIII (1208) shteti serb i Rashës do ta okupojë Kosovën Perëndimore, por jo edhe zonat e Prizrenit. Më 1216 e pushtuan edhe Prizrenin dhe tashmë i gjithë territori i Kosovës bënte pjesë në botën e mbretërisë serbe."

Se Perandoria e Bizantit, përkatësisht kisha e saj, nuk i kishte çuar duarët nga Kosova e sotme - pjesë e asaj perandorie - vërtetohet edhe nga reagimi i ipeshkvit të Ohrit, Dimitar Homatian, i cili ia kishte dërguar një letër protestuese ipeshkvit serb Savës në vitin 1220, sepse ky prelat serb e kishte larguar ipeshkvin (me gjasë ai ishte me prejardhje greke) e Prizrenit (qytet që Nemanjidasit e kishin pushtuar në vitet 1214 - 1216), edhe pse ai ishte zgjedhur sipas normave të parapara kanonike dhe Sava e kishte zëvendësuar atë me një serb.[71]

Serbët do ta mbajnë Kosovën për dy shekuj të nënshtruar, duke filluar nga viti 1216 e deri më 1450.

Se nën çfarë rrethanash jetonte popullata shqiptare e Kosovës nën pushtuesin e ri - shtetin e Rashkës, nuk kemi ndonjë shënim. Mirëpo,

---

[68] Fr. Miklosich, Monumenta serbica spectantia historiam Serbiae, Bonae, Ragusii, Viennae 1858, f. 4.

Është për t'u shënuar që (sipas hr.wikipedia.org/wiki/Povijest_Srba_prije_Nemanjića) Vukani, pas i dogji më parë, e pushtoi Lipjanin në vitin 1093. Pas evitimit të luftës që perandori bizantin Alexius Komnenos nuk e pa për të arsyeshme, që kufiri midis Bizantit dhe territoreve të pushtuara nga Vukani të mbetes Zveçani, si qytet i Vukanit, ndërsa Lipjani mbetej edhe më tej nën sovranitetin e bizantit. Kjo marrëveshje dhe ky kufi qe jetëshkurtër, sepse Vukani e sulmoi dhe e plaçkiti përsëri Kosovën (e sotme) derisa në këtë hapësirë nuk erdhi strategu i Durrësit Johan Komnen. Vukani u tërhoq dhe i ofroi këtij paqe dhe kthimin e robërve të luftës. Në vend se t'ia kthente robërit e luftës, Vukani dërgoi ushtarë të cilët një sulm të befasishëm natën e mundën ushtrinë bizantine dhe depërtuan kështu deri në Shkup, në Vranjë e në Pollog. Ky sulm bëri që Aleks Komneni të vinte prapë nën Zveçan. Kësaj radhe atij iu dorëzuan robërit e luftës dhe si garancion se Vukani nuk do të sulmojë më, Komnenit iu dhanë peng edhe bijtë e të vëllait Marko Uroš e Stefan Vukani.

[69] Khs. J. Šafarik, Pamatky drevniho pisemnctivi jihoslovanov, Dil predechazi serbal i vydal Pavel Josef Šafarik, v Praze, 1873, f. 3.

[70] Sipas Dr. Don Shan Zefi: Kisha katolike (shqiptare) në Kosovë – një e vërtetë historike që s'mund të mohohet; "Zëri i Ditës", 27. dhjetor 2002, f. 7.

[71] Po ai, Po aty.

mbase nuk do ta kenë pasur më mirë se bashkëkombasit në Veriun e Shqipërisë, që po ashtu ishte pushtuar nga Nemanjidët. Kemi porse një relacion të murgut Gullielmus Adae i njohur me emrin Brocardus i cili, në kuadër të projekteve për kryqëzatat, i kishte vizituar edhe viset bregdetare shqiptare dhe më 1332 shkruante ndër të tjera: "mirëpo shqiparët, një komb i madh, do të mund të organizonin më shumë se 15.000 kalorës - luftëtarë trima e të vyeshëm, sipas mënyrës dhe traditës së vendit, për të gjitha ndërmarrjet. Kjo sepse të sipërpërmendurit, si latinët ashtu edhe shqiptarët, rënkojnë nën sundimin e padurueshëm dhe robërinë më të rëndë e të urryer nga ata të sundimit sllav nga i cili populli është i shtypur, ndërsa kleri i larguar nga postet dhe i poshtëruar. Ipeshkvët e abatë burgosen shpesh. Fisnikët shpronësohen dhe izolohen. Kishat ipeshkvnore si edhe të tjerat janë shuar dhe u janë marrë të drejtat, manastiret janë në rrënim e sipër dhe të prishura; të gjithë së bashku porse edhe secili individualisht do të donte t'i ulë duart e tij në gjak të sllavëve, sikur këtyre t'u dilte përballë një Prinz francez, të cilin këta do ta bënin prijës të luftës kundër këtyre sllavëve të poshtër, armiqve të besimit tonë të vërtetë."[72] Ngjarja vendimtare e shpartallimit të pushtetit serb mbi Kosovën është depërtimi i osmanëve në Gadishullin e Ballkanit, përkatësisht fitorja e ushtrisë osmane mbi atë të koalicionit të krishter në betejën që u zhvillua në Fushë të Kosovës (sot Gazimestan) afër Prishtinës. Se çfarë ka mundur të ndodhë gjatë dy shekujsh të sundimit serb mbi popullatën shqiptare të Kosovës së sotme, më duket se më së miri e ilustron analiza që historiani serb Stanojeviq ua bën pasojave të pushtimit turk: "Dhe, Beteja e Kosovës, përveç pasojave të tjera që i pati kjo, i dha fund asaj periudhe të historisë serbe, e cila filloi me fitoren në Velbuzhd dhe e cila i jepte popullit serb shpresën për ta arritur asimilimin e plotë dhe definitv të tokave (shteteve) serbe të jugut dhe e ndërpreu zhvillimin më tej të procesit të asimilimit etnik, i cili asokohe kishte përfunduar në bregdetin jugor serb, në Podunavlje e në Posavinë. Depërtimi turk dhe fitorja e turqve e ndërpreu atë punë në viset serbe të jugut dhe e rrënoi atje procesin e nivelimit kulturor e etnik, i cili atje po zhvillohej bukur dhe drejt".[73]

Megjithëse serbët, qoftë si pjesë e komenwellth-it bizantin, të perandorisë së tyre jetëshkurtër apo si vasalë të Perandorisë Osmane e sunduan

[72] Guillelmus Adae - Brocardus, Directorium ad passagium Faciendum, pjesë të zgjedhura të botuara në Dardania, Zeitschrift für Geschichte, Kultur und Information, 4/1995, Wien, f. 51.

[73] Ljuob(omir) Stanojević, Pristupna akademska beseda, govorena na sevečanom skupu Akademije 11. jan. 1896, Glas, SKA, LII, Drugi razred, 34, Beograd, 1896, f. 20.

Kosovën, ata nuk kanë qenë kurrë popullatë shumicë e kësaj hapësire. Serbët e kolonizuan Kosovën me hope, saherë që për këso ndërmarrjesh pati rrethana të volitshme politike. Vetë historiografë serbë shkruajnë se "Pjesa më e madhe e popullsisë serbe është me prejardhje nga ardhacakët të cilët në këto 100 deri 200 vitet e fundit u dyndën nga vise të ndryshme të afërta.[…]. Shumë më e fortë është rryma e dyndjeve nga Malet e Malit të Zi dhe nga Kolashini, të cilët serbët e moçëm dhe ardhacakët i quajnë Erë. Kjo është një popullatë e shëndoshë, e plleshme, jeton në familje të mëdha e në bashkësi vëllazërish dhe është më e aftë për luftë me arbanasët. Kjo rrymë ngërthen më vete hapësirat përreth Mitrovicës e Vushtrrisë, shtrihet në jug porse edhe deri në Graçanicë. Në Neredime, Çagllavicë e në Graçanicë ka mjaft ardhacakë (S.G: serbë) nga Metohia (S.G: Rrafshi i Dukagjinit) e nga Prizreni."[74]

Një pjesë, në mos atë më të madhen të kolonistëve e përbëjnë ardhësit nga hapësira e quajtur Mal i Zi. Pjesa dërmuese e tyre, duke e ndjerë veten për serbë (midis të cilëve, siç u tregojnë mbiemrat e tyre, ka porse shumë sish me mbiemra shqiptarë në trajta sllave të tyre, përkatësisht shqiptarë të sllavizuar) u instalua në Kosovë, (sidomos në Rrafsh të Dukagjinit) në kohën e së ashtuquajturës Reformë agrare. Trajtimi më i plotë e më serioz i këtij segmenti të historisë së Kosovës mbetet libri i dijetarit kosovar Dr. Milovan Obradović.[75] Sipas këtij historiani, në emër të reformës agrare, në Kosovë erdhën 58.263 serbë, malazezë e sllavishtfolës të tjerë.

12. BOSHNJAKËT

Sdo që në ndonjë defter osman të regjistrimit të kryefamiljarëve dhe pronave të tyre në shek. XV fort rrallë evidentohet edhe ndonjë i tillë emri i të cilit përcillet me atributin "boshnjak", ose "i ardhur nga Bosna", pjesa dërmuese e sllavishfolëve boshnjakë është[76] e ardhur në Kosovë gjatë shek. XVIII, XIX e XX, përkatësisht pas Kongresit të Berlinit 1878 dhe pas Luftës së Parë e të Dytë Botërore. Këta erdhën nga Sanxhaku, Mali i Zi (kryesisht nga Plava e Gucia), Bosnja e Hercegovina, Serbia e nga Kroacia. Numër më i madh sish u vendosën në Pejë dhe në rrethina

[74] Sipas Projekat Rastko Gračanica - Peć: Istorija: Stara Srbija, geografska i etnografska slika (1912).

[75] Sh. librin e tij *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu* (1918-19419, Priština, 1981.

[76] Sipas http; bs. Wikipedia.org/wiki/Bo% C5% A1njaci_ Kosova dhe Historija kosovskih Bošnjaka në bs.Wikipedia.org/wiki/Bošnjaci_Kosova - 32k –

[*] Khs. për këtë edhe trajtesën time "Prejardhja e goranëve në dritën e emrave të vëllazërive e të vendeve, në këtë libër".

të tij (Vitomiricë, Dobrushë e ndonjë katund tjetër), në Deçan e në ndonjë katund përreth tij (si p.sh. në Rostovicë), në Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Prishtinë e në Istog. Dijetari "boshnjak", mr. Redžep Škrijelj, ka shënuar se boshnjakët, si muhaxhirë "të perëndimit" u vendosën edhe në Mazgit e në Obiliq), në Vushtrri e në Zveçan, e madje edhe në ndonjë katund të Drenicës. Mbetet për t'u parë sa e qëndrueshme është teza e këtij studiuesi sipas së cilës boshnjakët, thjesht, na qenkan shqiptarizuar. Kjo sepse shumë të shtyrë në moshë e të rinj "kanë ruajtur ende veçori [S. G. fonetike, leksikore, leksikologjike, sintaksore, folklorin, mënyrën e jetesës etj.] të së folmes së tyre të mëparshme të arealit dialektor të Plavës e Gucisë"- thotë ky.[77*]

Ashtu siç e hesht prejardhjen në krye të herës shqiptare të një pjese të madhe të banorëve të Sanxhakut e të Malit të Zi që sot po e mbakan veten për "boshnjakë", autori ynë dhe historiografia "boshnjake", e lavruar në Sarajevë, Novi Pazar e pjesërisht në Kosovë, orvatet tani që për boshnjakë t'i nxjerrë edhe torbeshët, përkatësisht goranët sado që as etnia e as e folmja e tyre nuk është variant boshnjak i serbishtes, përkatësisht serbishtes as goranët vetë nuk janë boshnjakë, porse vlleh të bullgarizuar që në regjionin e Gorës erdhën nga Jugu i Ballkanit të ndjekur për shkak të doktrinës së bogomilizmit që e praktikonin.

Apetitet e boshnjakëve për ekspansion dhe boshnjakizim të të gjithë besimtarëve myslimanë të Ballkani shkojnë aq larg sa po shtie rrënjë ideja që në perspektivën iluzore të ngrihet një shtet i madh i myslimanëve në Ballkan i cili, nën patronatin e Bosnjës, do të përfshinte Bosnjën, Sanxhakun, pjesët myslimane e boshnjake dhe shqiptare të Malit të Zi, gjithë Shqipërinë, Kosovën dhe pjesën shqiptare të Maqedonisë.

Në shenj korrektësie ndaj titullit të këtij botimi duhet theksuar që në hapësira të banuara me shqiptarë në fillim të dhjetvjetësishit të dytë të shek. XIV për në rrethina të largëta të Mitrovicës përmendet një *katun i bullgarëve*, emri i të cilit është ruajtur tek popullata shqipfolëse në trajtën *Bugariq*, ndërsa popullata serbe e quan *Srbobran*. Në mbështetje të antroponimisë që e mbanin banorët e atëhershëm të këtij katundi, rezulton se ai do të ketë qenë jo vendbanim i bullgarëve etnikë, porse i vllehve të ardhur nga Bullgaria. Më shumë individë që në vend të patronimit të mirëfilltë mbanin ofiqet bullgar ose i bir i bullgarit dëshmohen në regjistrimin osman të vitit 1455 të hapësirave të sotme të Kosovës, jo porse edhe në Rrafsh të Dukagjinit. Emra bullgarë mbanin sidomos murgë

[77] Sh. *katounь blьgar'ski* te Lj Kovačević,.Svetostefanska hrisovulja, Spomenik SKA, IV, Beograd, 1890, f. 8.

manastiresh. Numri i bullgarëve në Kosovën mesjetare është aq i vogël, sa nuk ia vlen të trajtohet më gjerë.

E njëjta gjë vlen edhe për grekët. Individë me ofiçin "greku/grekja; i bir i grekut" dhe murgj me emra grekë bartësit e të cilëve jo domosdo do të kenë qenë grekë etnikë janë dëshmuar për në hapësira të banuara me shqiptarë në territorin e sotëm të Malit të Zi dhe në Kosovën e sotme që nga gjysma e parë e shek. XIII dhe në ndonjë defter regjistrimi osman të kryefamiljarëve të Kosovës së sotme në shek. XV. Edhe këta ishin pakicë e parëndësishme, për të cilën në rrafshin demografik s'ia vlen të gjurmohet më gjerë. Ndryshe porse qëndron puna në rrafshin gjuhësor e onomastik. Në këtë mes duhet shkokluar çështja se nga kush shqipfolësit kosovarë i huazuan e i ruajtën jo pak fjalë të greqishtes së mesme (bizantinishtes) dhe mikrotoponime e oikonime me prejardhje greke.[78]

[78] Gjerësisht për këtë çështje sh. trajtesën time Mbetje onomastike e leksikore greke (bizantine) në Kosovë, NË librin (ende në dorëshkrim) Shtresime Gjuhësore në Toponiminë e Kosovës

FATI HISTORIK I HEBRENJVE NË HAPËSIRËN ETNOLINGUISTIKE TË SHQIPTARËVE

Përmbajtja

FATI HISTORIK I HEBRENJVE NË HAPËSIRËN ETNOLINGUISTIKE TË SHQIPTARËVE 293

1. HEBRENJTË NË HAPËSIRËN ETNOLINGUISTIKE TË SHQIPTARËVE 293
2. HEBRENJTË NË KOSOVË 303
3. FILLET E AKTUALIZIMIT TË ÇËSHTJES SË HEBRENJVE NË HAPËSIRËN ETNOLINGUISTIKE TË SHQIPTARËVE 311
4. HEBRENJTË E SHQIPËRISË GJATË PERIUDHËS SË SUNDIMIT TË MBRETIT A. ZOGU DHE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE 313
   a) Gjatë periudhës së sundimit të mbretit A. Zogu 313
   b) Gjatë Luftës së Dytë Botërore. 317
5. A ISHTE EINSTEIN-I NË SHQIPËRI? 319
6. PËRPJEKJET E SHQIPTARËVE PËR SHPËTIMIN E NORBERT JOKLIT 323
7. HEBRENJTË E KOSOVËS: TË MBROJTUR APO TË DORËZUAR? 327
8. STREHIMI I HEBRENJVE, SIPAS TREGIMEVE/RRËFIMEVE PERSONALE 335
   a) Në Shqipëri 335
   b) Në Kosovë 337
9. HEBRENJTË NË SHQIPËRI E NË KOSOVË PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE 342
10. MOTIVET E STREHIMIT TË HEBRENJVE NGA SHQIPTARËT 346
11. PERSONALITETE TË SHQUARA HEBRAIKE NË QEVERI, NË KULTURË E SHKENCË NË SHQIPËRI 352
12. FATI I HEBRENJVE NË SHTETET FQINJE *353*
   a) Në Serbi 353
   b) Në Greqi 357
   c) Në Bullgari 358
   d) Në Maqedoni 360
13. VENERIME PËRMBYLLËSE 360

FATI HISTORIK I HEBRENJVE NË HAPËSIRËN ETNOLINGUISTIKE TË SHQIPTARËVE

"*Ne shqiptarët, krenarinë tonë e mbështesim përveç në historinë tonë antike të vjedhur* (*S.G. nga të tjerë*) *edhe në katër shtyllat që na mbajnë fort në mesin e popujve të civilizuar të Europës: Gjergj Kastrioti - Skenderbeu, Nënë Tereza, Ismail Kadare dhe shpëtimi e strehimi i hebrenjve gjatë historisë.*"[**]

1. HEBRENJTË NË HAPËSIRËN ETNOLINGUISTIKE TË SHQIPTARËVE

"Nga dëshmitë që jep Bibla kuptohet qartë se apostujt e Krishtit e predikuan Krishterimin, në radhë të parë, duke ndjekur diasporën e hebrejve, të cilët ishin të shpërndarë nëpër botë, për shkak të disa ekzodeve të tyre nga luftërat e shkatërrimet, të mësyrë nga babilonasit

---

[*] Fahri Xharra: Pse shqiptarët mercenarë? Publikuar në Kosova.Info, më 01.05.2013.

[**] Para këtij epizodi historik, sidomos që nga shkatërrimi i Judeas nga romakët, Gadishulli iberik (hebreisht i quajtur Sefarad ose Sfarad) ishte i banuar (edhe) nga ebreitë. Midis shekujve 9. e 13. Spanja u zhvillua si një qendër e rëndësishme shpirtërore-mendore e judaizmit. Në kohën e sundimit arab-islamik të maurëve lulëzuan këtu shumë bashkësi ebreite si psh. në Toledo, Saragosa e në Sevilja dhe ebreitët ia dhanë tonin politikës, ekonomisë dhe kulturës së këtij vendi. Në mënyrë të veçantë u favorizuan shkencat profane të mjekësisë e të astronomisë dhe studimet gramatikore krahasimtare të hebreishtes dhe të gjuhëve të tjera semitike, por edhe të gjuhëve të tjera të Gadishuillit iberik. Kjo sepse bashkësi vendëse ebreite kishte në Spanjën e sotme që nga koha e sulmeve të fiseve germane të Alanëve, Vandalëve e të Sueven-ëve. Gotët e Perëndimit, të cilët në vitin 484 e themeluan perandorinë (Reich-un) e tyre ndeshën këtu një popullatë numerikisht të konsiderueshme ebreite. Duke i parë këta si arianë, i trajtuan këta për të barabartë prandaj edhe u sollën miqësisht ndaj tyre, aqë më parë pse këta qëkur ishin në Francë dhe në Afrikën bizantine të Veriut i kishin rezistuar propagandës katolike. Vetëm diç më shumë se 100 vite ndryshoi porse qëndrimi i germanëve ndaj ebreitëve. Kjo lidhet me pranimin e krishterimit nga ana e mbretit Reccared të gotëve të Perëndimit në vitin 589 nën presionin e klerit katolik. Këtij iu dha për detyrë që ta krijonte një Spanjë të tërësishme katolike gjë që nënkuptonte përndjekjen e atyre që kishin besim tjetër. Shteg i shpëtimit ishte për disa nga ebreitët konvertimi i tyre në katolicizëm, ndërsa për një pjesë tjetër largimi nga vendi. Ndryshe do të zhvillohet puna pas vitit 711, kur Spanjën e pushtuan arabët maurë.

dhe persët dhe, së fundi, nga romakët që e pushtuan të gjithë Lindjen e Mesme, Afrikën e Veriut dhe Egjiptin. [...] Ishin disa ekzode të mëdha të hebrenjve që i shtynë të ngrejnë kolonitë e tyre në viset më të afërta të bregdetit, si në Qipro, Korinth, Athinë, Selanik, Filipe të Maqedonisë, si dhe në Romë, Marsej, Spanjë, vende që dëshmohen dendur në *Letrat e Apostujve*. [...] Fillimisht, apostujt i kanë bërë mbledhjet nëpër sinagogat e hebrenjve, për të sjellë Frymën e re shpëtimtare për të cilën kishin nevojë të gjithë bashkëkombësit e tyre, sepse Ligji i Moisiut që e ndiqnin ata nuk ua siguronte atyre dot mirë qëndresën, njësinë dhe identitetin. [...] Në sinagoga, ku apostujt predikonin ungjillin shpëtimtar, veç hebrenjve dëgjonin edhe vendësit që ishin njerëz të përshpirtshëm [...] ose drejtpërdrejt në gjuhën e tyre, ose hebraisht dhe i kuptonin ato (predikime) me ndihmën e përkthyesve.

[...] Po ta kemi parasysh hapësirën që atëherë quhej Maqedoni, ajo do të përfshinte jo vetëm një qendër të rëndësishme, siç ishte Shkupi (Astipus[*]), porse edhe Durrësin (Dyrrachium) dhe qendra të tjera të rëndësishme edhe në brendësi të tokave të banuara nga *albanët*. [...] Në Gadishullin e Ballkanit, ata do të kenë predikuar së pakut tri vjet, nëse (ato) nisën në vitin 57 kur (Shën) Pali e shkroi letrën drejtuar romakëve. Kaq kohë do të ishte e mjaftueshme për të ngritur një numër të konsiderueshëm bashkësish të krishtera.. [...] që u quajtën kisha. [...]."

Gjurmë të kolonive hebraike në kontekstin e dëshmive më të hershme të krishterimit tek arbrit Dh. Qiriazi gjen në emërtime vendesh që janë ruajtur deri në ditë tonat si *Jeriko* (Orikum) në Vlorë, *Onheizm* (sot Sarandë), Fterrë në Bregun e Detit duke paravenduar që [...] "emërtimi Jeriko nuk e përjashton praninë e një kolonie hebraike aty të paktën që nga shek. I para Krishtit" [...].

Në kontekstin e pranisë së lashtë të hebrenjve në Sarandë, Dh. Qiriazi konstaton se "Në njërin nga mozaikët e Sarandës, i cilësuar nga specialistët (për) i shek. IV pas Krishtit, dallohet shumë mirë shandani me shtatë krerë i hebrenjve [...] që dëshmon se mozaiku ka qenë dysheme e një sinagoge. [...]. Duke i marrë për dëshmi të krishterimit që herët të popullatës së Shqipërisë së sotme, gjurmë sinagogash Dh. Qiriazi gjen edhe në dysheme, mozaiqe bazilikash apo baptisterë" [...] në Elbasan, Arapaj të Durrësit,[**] Lin të Pogradecit, Shën Gjini të Tiranës e gjetkë"

[*] S.G: Me emrin antik *Astibos* njihet Shtipi i sotëm i Maqedonisë dhe jo qyteti i sotëm Shkupi, përkatësisht qyteti antik me emrin *Scupi* të tij.

[**] Sipas autorit kosovar A. Ramaj, Rettung von Juden in Albanien, në: G2W - Glaube in der 2. Welt (Ökumenisches Forum für Religion und Gesellschaft in Ost und West) 2/2007 35. Jahrgang, f. 17-19 (Themenschwerpunkt: Rettung von Juden in Albanien),

[...] "Veç kësaj, në gjuhën shqipe janë trashëguar që nga Mesjeta e hershme mbiemra të tillë hebrenj ose me prejardhje hebraike, si *Zhiti*, *Zhitro*, *Kofina*, *Averban*, *Abeshi* etj., të cilët dëshmojnë për prani të elementit hebre në këto vise, të paktën para islamizimit, sidomos kur mbiemra të tillë i hasim edhe tek elementi mysliman." [...][1]

Me ndonjë ndryshim krejt të vogël, sidomos përsa i përket shkakut të ngulitjes së hebrenjve në Shqipëri, të dhënat që i sjell Dh. Qiriazi i konfirmon edhe Apostol Kotani, njëri ndër njohës të mirë të historikut të hebrenjve në Shqipëri dhe bashkëkryesues i Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Izrael". Në një bisedë të zhvilluar me të, Kotani përgjigjej se "në Sarajevë, argumentova se […] hebrenjtë e parë kanë ardhur në Shqipëri rreth viteve 70 (të erës sonë), pas një lufte 4-vjeçare të romakëve për të pushtuar Izraelin. Atëherë romakët morën disa anije me skllevër hebrenj, si shenjë e fitores. Një nga këto anije u përplas në bregdetin tonë të Jonit dhe mendohet që këta hebrenj të jenë vendosur në fshatin Fterrë (S.G.: 10 km larg Sarandës). Aty ka shumë emra njerëzish dhe toponime me prejardhje hebraike." Studiuesi Kotani sqaron më tej se "Nuk ishte e rastit, që në Sarandë pranë shtëpisë së Kulturës, është zbuluar një mozaik me një shandan hebre. Studimet arkeologjike nxorën në dritë aty një sinagogë dhe ajo i përket vitevet '70 të erës sonë."[2]

Në një punim të tijin të botuar më herët, A. Kotani tregon në Shqipëri hebrenj kishte edhe para dëbimit të tyre nga Spanja (1492). Kjo dëshmohet, sipas këtij studiuesi, edhe në një korrespondencë të vitit 1368 midis administratës së qytetit të Durrësit dhe asaj të Venedikut, nga e cila merret vesh se banor i Durrësit ishte edhe njëfarë magister Davidi. Prania e hebrenjve në Durrës dëshmohet edhe në një shkresë, përgjigje që administrata e republikës së Venedikut në vitin 1401 ia dërgonte qytetit të Durrësit. Këtë prani e thekson edhe M. Sufflay i cili, në bazë të burimeve të përdorura nga ai vetë, thoshte se në Durrës ka plot familje hebraike dhe se ato janë të varfëra.[3]

Mund të ndodhë që këta të jenë ata hebrenj që nga Vlora ikën për shkak të sulmit mbi Vlorën nga një flotë europiane në vitin 1685 dhe që u vendosën në Berat. Në këtë kontekst mësohet se hebrenjtë ishin, dy vëlle-

prania e ebreitëve në qytetin e Durrësit po u dëshmuaka edhe në vitin 1281.

[1] Dhori Qiriazi, Krishterimi në Shqipëri, Tiranë, 2000, f. 6-14. Teksti i cituar më lart është lekturuar lehtë nga unë. Edhe nënvizimet në kursiv janë të miat.

[2] Cit. sipas Denisa Kona, Të pathënat mbi shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri, në http://dielli.blog.al/page/86/, që së pari ishte botuar në gazetën *Ballkan* të Shqipërisë.

[3] Apostol Kotani, Disa të Dhëna mbi qëndrimin dhe trajtimin e izraelitëve në Shqipëri, Studime Historike, 4/1990 (Tiranë), f. 45.

zërit e përmendur shprehimisht për hebrenj, të cilët nga Berati ishin nisur për në Kostur, që atje ta merrnin mbi vete trashëgiminë që u ishte lënë.[4]

Konstatimet e mësipërme të Dh. Qiriazit dhe të A. Kotanit dolën të qëndrueshme edhe pas gjurmimeve që pikërisht në Sarandë i bënë profesorët izraelitë Ehyd Netzer e Gideon Foerster. Këta arritën ta nxjerrin përfundimin që, në kohë më të lashta - së pakut nga shek. VII, bazilika e Sarandës do të ketë shërbyer si sinagogë.[5]

Përveç kësaj, në hapësirën që në antikë e zinin ilirët e mirëfilltë (*Illyri proprie dicti*) dhe dardanët ilirë gjenden gjurmë të hebrenjve *romaniotë* (= të cilët, pas dëbimit të tyre nga Judea romakët i kishin vendosur në hapësira të Perandorisë së Bizantit). Për të këtilla gjurmë mbahen sinagoga në qytetin antik të Astibos-it (sot Shtip në Maqedoni) që mbahet për e shek. II; "Vorret e Çifutëve" në Shkopet të krahinës së Matit në Shqipëri dhe disa gurë varrezash në Mal të Zi.[6]

Për njëfarë lashtësie biblike të elementit judaik, aludohet kohëve të fundit edhe për Veriun e Shqipërisë, përkatësisht për në zona të Komanit e të Dushmanit, në rrethina të Pukës. Mbështetjen për këtë tezë e lidhin me shënimet që i ka lënë *Edith Durham* me rastin e vizitës që ajo ia kishte bërë fisit të Berishajve. Malësorët këmbëngulin për t'i treguar asaj për një mrekulli në afërsi të fshatit. Ajo shkruante në librin e saj *High Albania* se ajo që ia tregonte malësori "Ishte një koritë e zakonshme (*trough*), e gdhendur trashë nga një bllok guri dhe e mbuluar me dërrasa, me kujdes të madh. Pa dyshim vepër e duarve të njeriut, mund të ishte punuar në çdo kohë, në çdo vend ku kishte gurë. Megjithatë, besohej se ishte e mbinatyrshme, shumë e çmuar dhe e pasur në kuptim. Nuk ishte krijim i njeriut. Kishte qëndruar aty për një mijë vjet, siç rrëfenin gjyshërit dhe katragjyshërit e tyre. I përkiste një epoke kur hebrenjtë (*the Jews*) na paskan qenë zotër të atyre anëve. Unë (E. Durham) u thashë se hebrenjtë nuk kishin qenë ndonjëherë zotër të atyre anëve, çka u dha [malësorëve] kënaqësi të madhe.

Gojëdhëna (*tale*) se hebrenjtë dikur na paskan qenë zotër të Shqipërisë është mjaft e përhapur. I referohet, pas gjasë, traditës se në ato vende kishte një fe tjetër, para krishterimit; dhe meqë kjo fe tjetër nuk ishte as e krishterë, as myslimane, njerëzit kishin nxjerrë përfundimin se ishte hebraike (*Jewish*), meqë nuk njihnin tjetër. Ka shumë mundësi që, në thellësi të maleve, paganizmi të ketë lulëzuar deri vonë.

---

[4] Apostol Kotani, Disa të dhëna mbi qëndrimin dhe trajtimin e izraelitëve në Shqipëri, "Studime historike", 4/1990 (Tiranë), f. 45

[5] sipas Albert Ramaj, Rettung von Juden in Albanien. ..

[6] Po ai, po aty.

Bashkë me këtë është lansuar hipoteza që bartës të judaizmit në pjesë të Malësisë së Veriut na paskan qenë ardhësit kumanë në këto vise. Kjo mundësi paravendohet në kuadrin e rrethanës që në veprën e njohur dhe kontraversiale të Arthur Koestler, *The Thirteenth Tribe*, lexohet, sipas studiuesit Mikhail Artamonov, themelues i khazaristikës moderne, ka mundësi që kumanët, ose së paku një pjesë e tyre të kenë adoptuar fenë judaike njëlloj sikurse kushërinjtë e tyre në stepat ruse, khazarët. Në fakt, dy djemtë e princit kuman Kobiak quheshin *Isaak* dhe *Daniel*, emra tipikë judaikë. Edhe pse vepra e Koestler-it është qortuar nga shumë anë, konvertimi i khazarëve në fenë judaike nuk është vënë kurrë në diskutim, kjo sepse po u ditka që Komani dhe mikroregjioni Dushmani në hapësira të regjionit të Pukës mund të kenë qenë ngulime të kumanëve.[7]

Ideja se pjesë të etnisë së shqiptarëve mund të jenë me prejardhje hebraike ka qenë e njohur që në shek. XII edhe tek shqiptarët në krahinën e Epirit. Nga interpretimet që i janë bërë pjesës së shkrimit të shtegtarit hebre Benjamin Ben Jonah von Tudela (Mass'ot Rabbi Benjamin, i vdekur në vitin 1173) i cili tregonte për shkallën e lartë të arsimimit të hebrenjve të Greqisë mësohet se vlera shpirtërore të tyre reflektoheshin deri edhe tek populli bjeshkatar i shqiptarëve, për të cilët Benjamini fliste me admirim. Për shqiptarët Tudela shkruante se "Ata e quajnë veten vlleh. Ata zhdirgjen teposhtë maleve shpejt si gazelet për ta plaçkitur tokën e grekëve.[...] Shqiptarët nuk e ndjejnë veten për të besimit të krishterë. Ata u vejnë fëmijëve të tyre emra hebraikë; madje disa sish besojnë se ata na qenkan me prejardhje hebraike. Ata i mbajnë hebrenjtë për vëllezër të tyre. Po i takuan hebrenjtë, i plaçkitnin, porse nuk i mbysin, siç veprojnë me grekët. Ata (S.G.: shqiptarët) nuk kanë kurrfarë feje." Me shumë rëndësi do të jetë shënimi i tij se "Prej aty ka dy ditë udhë deri në Gorzy, një vend i braktisur me pak banorë, disa grekë e hebrenj," për të cilin autori anonim i shkrimit[8] mendon se kemi të bëjmë me Korçën e sotme.

Duke qenë se nga këto shënime të Tudela-s nuk mësohet se cili do të ishte konkretisht ai vend i Greqisë, mbase i Epirit apo i rrethinave të Selanikut, i banuar (edhe) nga hebrenjtë, të cilët mund të ishin pre e malësorëve/cubave shqiptarë, përkatësisht se këtu nuk mund të gjendet kurrfarë dëshmie se mund të kemi të bëjmë me hebrenj e me shqiptarë të Janinës - siç ia ka anda të besojë autori kosovar A. Ramaj[9] kujtoj se

[7] Xha Xhai, Kur nuk laheshim, në: http://xhaxhai.wordpress.com/2009/09/30/arber-dhe-kumane/
[8] Sipas Juden in der Welt: Griechenland, http://www.hagalil.com/
[9] Khs. shkrimin e tij Rettung von Juden in Albanien, në: G2W - Glaube in der 2. Welt (Ökumenisches Forum für Religion und Gesellschaft in Ost und West) 2/2007 35. Jahrgang, f. 17-19.

studiuesi zviceran Gstein vërente me të drejtë se rezulton që Benjamini i Tudela-s nuk fliste në këtë pjesë të cituar të udhëpërshkrimit të tij për hebrenjtë e Shqipërisë, përkatësisht të Janinës, porse *për shqiptarët*.[10] (nënvizimi im). Së këndejmi, duhet të merret për si shumë hipotetik konstatimi i studiuesit kosovar A. Ramaj, sipas të cilit hebrenjtë e përmendur në citatin e mësipërm të Tudela-s na qenkan hebrenj të Janinës. Këtu nuk ndihmon asgjë as pjesa "Prej këtu (S.G. Janina?) janë dy ditë udhë deri në Gorzy, një vend i braktisur me pak banorë, disa grekë e hebrenj" e citatit të mësipërm.

Nga kjo pjesë e tekstit të Tudela-s mësohet porse rrethana që nuk është vërejtur nga studiues të deritashëm shqiptarë se hebrenj do të ketë pasur edhe në Korçë. Kjo bëhet e besueshme nga konstatimi i autorit, sipas të cilit Gorzy është porse Korica (S.G.: Korça) e sotme në Shqipërinë e Jugut. E re në këtë mes është njoftimi i autorit të mësipërm se "Jo larg nga (S.G.: vendi i papërcaktuar saktësisht i banuar nga hebrenjtë) është Castoria (S.G. Kosturi) me një bashkësi (S.G. hebraike) që po ashtu e përmend Benjamini, vendbanim i Tobia ben Eleasar-it, i cili e kishte përjetuar dhe raportonte-njoftonte për përndjekjen e hebrenjve gjatë kohës së Kryqëzatës së parë nga Gjermania. Ndryshe, autori i shkrimit të mësipërm theksonte se "bashkësi të moçme hebrenjsh kishte në Janinë, në Artë e në Prevezë." Hebrenjtë e përmendur tërthorazi në kontekstin e pjesës së shkrimit të Tudela-s për shqiptarët, "e flisnin një greqishte të kryehershme të vërshuar nga fjalë latine dhe këtë gjuhë e përdornin mbase edhe në këndimet e tyre për liturgjinë në lutjet e përjavshme të Sabbat-it e të Purim-it.[11]

Sipas dijetarit zviceran, Benjamini i Tudela-s shënimi i mësipërm i Tudela-s ka të bëjë në të vërtetë me indiferencën dhe me lëkundjen e shqiptarëve midis dy riteve të krishterimit. Kjo sepse, gjithnjë sipas H. Gstein, "Kur kisha e vjetër e pandarë e krishterë e shekullit të parë u përça në vitin 1054 përfundimisht në një kishë europiane-perëndimore dhe në një lindore-ortodokse, popujt e tjerë të Europës Juglindore - grekët, rumunët, romanët ballkanikë, serbët e bullgarët - e vazhduan me vendosmëri ortodoksizmin. Vetëm shqiptarët u shpartalluan në katolikë e ortodoksë. Një shpartallim, një ndarje kjo që për arsye të kryqëzatave dhe për shkak të konfrontimeve midis Bizantit e Venedikut në brigjet lindore të Adriatikut u thellua edhe më shumë". [...] Duket se qysh atëherë shumë shqiptarëve do t'u ketë humbur

[10] Cit. sipas Heinz Gstein, Albanerglaube, në: G2W, -Glaube in der 2. Welt (Ökumenisches Forum für Religion und Gesellschaft in Ost und West) Nr. 5 /2002, f. 15.

[11] Juden in der Welt: Griechenland, http://www.hagalil.com/

andja/apetiti për fenë."[12] Nëse mund t'i besohet deklarimit të mësipërm, do të kishte shumë arsye të besohet se pikërisht qëndrimi indiferent i shqiptarëve ndaj fesë do të jetë arsyeja pse viset e banuara me shqiptarë edhe ishin fushë e rivalitetit midis dy riteve të krishterimit për përvetësimin e tyre.

"Prania e mirëfilltë e hebrenjve dëshmohet kah fundi i shek. XV. Kjo është e lidhur me ripushtimin nga sundimtarë spanjollë të qytetit të Granadës në vitin 1492, me ç'rast u çua deri në fund *Reconquista*[*] e Gadishullit Iberik. Më 31 mars të atij viti (1492) çifti, dikur sundimtarë njësish të veçanta, i mbretërive katolike të Spanjës së sotme, që u martuan falë ndërmjetësimit të një hebreu me autoritet, Isabella e Kastilias dhe Ferdinandi II i Aragonës e nënshkruan të ashtuquajturin *Edikti i Alhambra*-s (që ishte përpunuar nga Inkuizicioni) sipas të cilit urdhërohej dëbimi i (180.000; sipas disa autorëve ishin 300.000 ose 800.000) hebrenj deri më 31 gusht 1492 nga të gjitha territoret e mbretërisë së Spanjës, nëse deri më atë ditë të gjithë hebrenjtë nuk do të konvertonin në krishterimin katolik. Kohë për t'u kujtuar nëse do të konvertonin apo do të largoheshin nga vendi pa mjete financiare dhe pa kurrfarë kompensimi për pasuritë që i kishin, hebrenjve u ishte dhënë një afat prej tre muajsh. Me ediktin e nënshkruar nga çifti bashkëshortor i mbretërive të bashkuara spanjolle filloi dhe pothuaj se mbaroi dëbimi i pashembullt i një grupi etnik i cili në Gadishullin Iberik kishte jetuar shekuj me radhë dhe që ishte plotësisht i integruar në shoqërinë spanjolle.

Një pjesë e hebrenjve të dëbuar nga Spanja gjetën strehim në Beira, një regjion kufitar në veri të Portugalisë. Mbreti Huan (Johann) II. e shfrytëzoi gjendjen e vështirë të të dëbuarve duke ua lejuar hyrjen në Portugali atyre hebrenjve që do ta paguanin tatimin e lartë të quajtur *coima*. Njëkohësisht, ky ua shtroi kusht të strehuarve që brenda një afati të përcaktuar të konvertoheshin në besimin e krishter.[13] Ata që pranuan të konvertoheshin në katolicizëm qenë të detyruar që këtë ta dëshmojnë ashtu që në dyer të shtëpive të tyre do ta venin kryqin.[14]

---

[12] * Nocion historik që shenjon ripushtimin nga ushtritë e krishtera të Gadishullit Iberik, i cili që nga viti 711 ishte i pushtuar nga arabët maurë. Reconquista nis në shek. XI dhe përfundon në vitin 1492 me pushtimin e qytetit të Granada-s nga çifti bashkëshortor Ferdinand II e Isabella.

[13] Geschichte der Juden von São Tomé, http://de.wikipedia.org/wiki/Geschichte_der_Juden_

[14] Juliette Laurent: Jüdische Traditionen in Belmonte (Portugal) (September 2007), në http://www.dw-world.de/dw/article/0,,2763572,00.html

Pasardhësi Manuel I i mbretit portugez e nxori në vitin 1496 një dekret të ngjashëm me ediktin spanjoll të Alhambra-s përmes të cilit hebrenjve u urdhërohej që deri në tetor të vitit 1497 të largoheshin nga Portugalia.[15]

Megjithatë, kjo nuk mundi t'i pengonte hebrenjtë e ashtuquajtur "Maran"-ë që besimin e tyre ta praktikonin tinëz. Hebrenjtë e konvertuar para shekujsh, dolën hapur në vitet e '80-ta të shek. XX si "Të krishterë të rinj" dhe iu kthyen publikisht rrënjëve tradicionale të tyre. Hebrenjtë të pasur të Marokut e të Amerikës Veriore e financuan ndërtimin e një sinagoge në vendbanimin Belmonte. Ka individë e estrada që flasin dhe këndojnë tani në gjuhën e tyre[16] *ladino* (për këtë sh. më poshtë)

Një e treta e hebrenjve, të cilët duhej të largoheshin nga Spanja, u drejtuan kah Portugalia, ndërsa rreth 25.000 sish shkuan në Holandë. Një numër i konsiderueshëm hebrenjsh do të ketë shkuar në Afrikën e Veriut, kryesisht në Maroko, ndërsa pjesa tjetër u strehua në Francë, në Itali e në Egjipt. Në Spanjë mbetën vetëm *conversos*-ët, përkatësisht hebrenjtë e konvertuar në ritin katolik të krishterimit, pasardhësit e të cilëve, megjithatë, do të jenë objekt sulmi në shekujt e pastajmë. Njëra nga arsyet bazë për dëbimin e këtyre hebrenjve ishte dyshimi i kishës katolike të Spanjës se ata nuk ishin konvertuar siç do ta dëshironte kisha katolike. Ata quheshin, si në Spanjë ashtu edhe në Portugali, *Cristianos nuevos*/ *Cristãos novos* "Të krishterë të rinj". Arsyetimi për dëbimin (edhe) të këtyre hebrenjve ishte dyshimi se këta na paskan qenë kriptohebrenj dhe se këta edhe më tej po i praktikuakan, tinëz, ritet hebraike.

Hebrenjtë e dëbuar nga Spanja njihen me emrin hebraik *sefardë* (= hebrenj të Spanjës). Sefardët janë hebrenj, pararendësit e të cilëve deri në vitin 1492 kishin jetuar në Spanjë e pjesërisht edhe në Portugali. Të gjithë këta e flasin një gjuhë të përbashkët, *sefardishten*, e cila i heq rrënjët nga iberoromanishtja mesjetare. Nocionet *Sepharad* ose *Sfarad* dhe *sephardim* rrjedhin nga hebraishtja me të cilat njihej Gadishulli i Iberisë dhe gjuha e folur nga hebrenjtë e atyshëm. Integrimi i hebrenjve në shoqërinë spanjolle edhe në relacion me trevat dialektore të spanjolishtes reflektohet edhe në rrethanën që p.sh. hebrenjtë e Saragossa-s flasin pjesërisht romanisht e pjesërisht edhe arabisht. Ndoshta kjo edhe do të jetë arsyeja që hebrenjtë ballkanikë quhen ndryshe edhe *romaniot*-ë. Bashkësia më e madhe e hebrenjve të Spanjës është e përqendruar në qytetin e Barcelonës.

Hebrenjtë e përndjekur e zgjodhën hapësirën e Perandorisë Osmane për vendstrehim, sepse këtu kishin më pak arsye të jetonin në frikë se sa

[15] Geschichte der Juden.

[16] Juliette Laurent: Jüdische Traditionen in Belmonte (Portugal) (September 2007), në http://www.dw-world.de/dw/article/0,,2763572,00.html

në vende të krishtera. Perandoria Osmane ishte asokohe në zenitin e fuqisë dhe të zgjerimit territorial të saj. Në vitin 1462 osmanët e kishin pushtuar Bosnjën e vetëm 20 vite më vonë edhe Hercegovinën në jug të saj dhe përpiqej që pushtetin e saj ta siguronte me një trajtim tolerant të popullatës lokale. Kjo tolerancë u shkoi për shtati edhe hebrenjve: sulltani i kishte urdhëruar mëkëmbësit/guvernatorët e tij në Ballkan që hebrenjtë e Spanjës e më vonë edhe ata të Portugalisë, t'i pranojnë pa kurrfarë parakushtesh, "sa më miqësisht, ngrohtësisht". Thuhet që sulltani Bayezid II. të ketë thënë në këtë kontekst "Sa të marrë janë mbretërit spanjollë që i përzënë qytetarët e tyre më të mirë dhe i lënë ata në mëshirën e armiqve të tyre më të ashpër".[17]

Kështu edhe ndodhi. Duket se pjesa më e madhe e tyre (rreth 90.000 - 100.000) u vendosën së pari në Greqi, në kolonitë e tyre më të mëdha në Selanik[*] dhe në Verria si edhe në Stamboll, pastaj në Maqedoni e në Bosnje dhe, së fundi, në brigjet në të djathtë të Danubit, para së gjithash në Beograd e në rrethina të tij. Dobi nga kjo vendosje/kolonizim patën të gjitha palët. Hebrenjtë gjetën strehim e mbrojtje, osmanët i morën "falas" teknikën moderne të përpunimit të qumështit dhe prodhimin e pasqyrës e të tjera, që për ta ishin deri atëherë të panjohura. Po deshëm, ky qe "spiunazhi më i madh industrial" i gjithë historisë së njerëzimit" - thotë Wolf Oschlies.[18] Të tjerë thonë se sulltani i çmonte aftësitë intelektuale si dhe shkathtësinë e hebrenjve si argjendarë, punues të armëve, përpunues të mëndafshit e të prodhimit të tekstileve.[19]

Në këtë kontekst duhet vlerësuar edhe vendosjen e hebrenjve në qytete të Shqipërisë, sepse pas vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, (edhe) Shqipëria kishte rënë përfundimisht nën sundimin osman.

Apostol Kotani sqaron në këtë kontekst: "Ndërsa në vitet 1490, kur filloi gjenocidi ndaj hebrenjve në Portugali dhe në Spanjë, një numër i madh prej tyre erdhën këtu, zbarkuan në Vlorë tek Triporti, […] Pikërisht aty ku ka qenë qyteti më i zhvilluar në jug deri në shekullin V, që pastaj në luftrat iliro-romake, u shkatërrua. Kështu, hebrenjtë e parë u vendosën në Vlorë, Berat dhe në Elbasan.

---

[17] Wolf Oschlies, Geschichte und Ende der Juden in Serbien www.shoa.de/content/view/218/46/ - 89k

[*] Këtë e ilustron më së miri rrethana që, sipas http://de.wikipedia.org/wiki/Griechenland#Judentum, në vitin 1920 vetëm në Selanik kishte 40 sinagoga.

[18] Poai, poaty.

[19] Lena Kalaitzi-Oflidis und Simos Oflidis: "Neunzehnhundertdreiundvierzig nach Christus" http://www.hagalil.com/europa/griechenland/5768/thesaloniki.htm

Për hebrenjtë në Vlorë njofton[20] në vitin 1565 Garlier de Pinon në librin Voyage en Orient i cili thoshte se në Vlorë ka edhe banorë me prejardhje hebraike.

Hebrenj do të ketë pasur edhe në qytetin e Lezhës. Kjo bëhet e ditur tërthorazi nga një njoftim i Ciro Giannelli-t i cili tregonte se Këshilli i Pleqve i Lezhës ankohej në një letër që ky (Këshill) ia dërgonte papës së Romës më 23 prill 1565 kundër peshkopit të qytetit se ky, përveç të tjerash, luante publikisht me letra e me zare me hebrenjtë.[21]

Në shek. XVII ata u larguan. Ardhja e dytë e tyre ka qenë rreth vitit 1848. Erdhën këtu duke pasur një kujtesë për mikpritjen e shqiptarëve. Ardhja vazhdoi deri në vitet '30. Studimin e parë për hebrenjtë në Shqipëri e ka bërë konsulli amerikan Herman Bernshtein më 1932-1933. Dhe unë e kam shfrytëzuar."[22]

Autori kosovar A. Ramaj na mëson se vendosjen/strehimin e hebrenjve të dëbuar nga Spanja në qytetet bregdetare të Durrësit e të Vlorës dhe, prej këndej, edhe në Elbasan e në Berat po e dëshmuakan, përveç gjetjeve arkeologjike që u përmendën më lart, ". .. edhe dorëshkrime të vlefshme të "Sefer Thora"-s që ishin ruajtur për 500 vite me radhë në qytetin e Vlorës, të cilat porse u zhdukën në vitin 1930. Se Vlora ishte një qendër e rëndësishme hebraike në Shqipëri tregon edhe rrethana që në vitin 1520 këtu kishte pasur 609 shtëpi hebrenjsh. Në këtë qytet ishte edhe një sinagogë e cila u rrënua në kohën e Luftës së Parë Botërore. Shumë hebrenj gjetën strehim nëpër qytete të Shqipërisë edhe si pasojë e politikës antihebraike të Papës Pali IV (1555-1565)" Nga ky autor mësohet, në vazhdim, se "Shumica e hebrenjve u larguan në fillim të shek. XIX nga trevat veriore e qendrore të Shqipërisë dhe u vendosën në Jug si edhe në vende përjashta kufijve të Shqipërisë, përkatësisht në Greqi.[23]

Nga shënimet e udhëpërshkruesit frëng Ami Boue mësohet se hebrenj kishte edhe në qytetin e Vranjës, të cilin Boue e quante "qytet i shqiptarëve". Në këtë qytet asokohe kishte 656 shtëpi shqiptare e 140 të krishtera të ritit ortodoks, kishte porse edhe hebrenj, çerkezë e të tjerë.

[20] Sipas Apostol Kotani, Disa të dhëna mbi qëndrimin dhe trajtimin e izraelitëve në Shqipëri, "Studime historike", 4/1990 (Tiranë), f. 45.

[21] Po ai, po aty

[22] Cit. sipas Denisa Kona, Të pathënat mbi shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri, në http://dielli.blog.al/page/86/ që së pari ishte botuar në gazetën shqipe Ballkan.

[23] Albert Ramaj, Rettung von Juden in Albanien

Në qytetin e Manastirit kishte, sipas një statistike austro-hungareze të v. 1905, 71.000 ortodoksë "sllavo-maqedonas", 34.200 shqiptarë; 12.000 turq "osmanlinj" ; 15.000 hebrenj; 2.500 magjupë dhe 200 çerkezë. [24]

Të dhëna për shtrirjen e hebrenjve në hapësirat etnolinguistike të shqiptarëve, përkatësisht në vilajetet shqiptare, përmbahen në regjistrimin e popullsisë në vitin 1910. Asokohe në vilajetin e Janinës kishte 5077 hebrenj, në vilajetin e Manastirit 6497; në vilajetin e Kosovës 3171 hebrenj, ndërsa në atë të Shkodrës nuk është regjistruar asnjë hebre. Bashkësitë më të mëdha hebraike ishin pra jashtë territorit të shtetit të sotëm të Shqipërisë, përkatësisht në qytetet e Manastirit: 6435 persona, në Janinë: 4373 frymë, në Shkup 2327 dhe në Prevezë (sot pjesë e Greqisë) 431 hebrenj. Sipas regjistrimit të kontestueshëm të popullsisë në vitin 1930, në gjithë Shqipërinë për hebrenj ishin deklaruar zyrtarisht vetëm 204 banorë. Bashkësia e tyre u pranua zyrtarisht tek më 2 prill 1937.[25]

2. HEBRENJTË NË KOSOVË

Përkitazi me lashtësinë e hebrenjve në Dardani, përkatësisht në Kosovë, kohëve të fundit shkroi historiani kosovar me kompetencë për historinë e vjetër dhe për arkeologjinë, Naser Ferri[26] dhe kolegia e tij Exhlale Dobruna.[27] Ferri njofton se shpërndarja e hebrenjve nga atdheu i tyre i kryehershëm kishte nisur që në shek. VI p. e. sonë, ndërsa arritja e tyre në Ilirik, përkatësisht në Dardani do të ketë ndodhur pas humbjes së shtetësisë mbi tokat e banuara e të administruara nga abreitët, në kohën e perandorit Vespazian (që sundoi midis viteve 69-79 të erës sonë). Pas disfatës definitive të vitit 135 të e. sonë, pjesa më e madhe e çifutëve të dëbuar u strehuan në Afrikën e Veriut, në Spanjë, Gjermani dhe në vende të Europës Lindore. Një pjesë e çifutëve, thotë më tej autori ynë, bashkë me njësitet e ushtrisë romake që kishin luftuar në Lindje apo edhe shtigjeve të tjera kishin arritur edhe në Ilirik, respektivisht në Dardani si skllevër,

[24] Në veprën e tij La Turquie d'Europe, I., Paris, 1840, f. 147, cit. sipas Fatos Baxhaku, Einige Ethnische Angaben über die Bevölkerung der Grenzzone zwischen Albanern, Serben und Bulgaren (Zweite Hälfte des 19. Jhd.) Dardania, Zeitschrift für Geschichte, Kultur und Information, 2-3, Wien, 1995, f. 45,56.

[25] Albert Ramaj: Rettung von Juden in Albanien

[26] Gurmët e judeo-krishtërimit në Dardani, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 30/2, Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2011, f. 199-215

[27] Motivi i Dorës në monumentet mbivarrore të Dardanisë si dëshmi e pranisë së hebrenjve gjatë antikitetit në këtë trevë, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 30/2, Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2011, f. 79-85.

zejtarë, artistë, bankierë, tregtarë apo si ushtrues punësh të tjera. Gjetjet arkeologjike e dëshmojnë praninë e hebrenjve gjatë shekujve të parë të erës sonë edhe në pjesë të tjera të Ilirikut. Autori antik Straboni (64/63 p. e. s.-24 të e. sonë) thoshte se "në botë vështirë se mund të gjendet ndonjë vend ku nuk ka hebrenj". Dëshmia konkrete arkeologjike për praninë e hebrenjve, përkatësisht të judeo-krishterimit në Dardaninë e periudhës romake është një pllakë prej guri e murosur në murin rrethues të Patrikanës së Pejës. Pllaka prej guri është me dimensione 57x40 cm, ndërsa trashësia nuk i dihet sepse është e murosur në murin e trashë në lartësi prej 4 m të Patrikanës së Pejës. Mbi të janë gërvishtur numrat 1898. Kjo tregon se pllaka do të jetë sjellë aty nga ndonjë vend tjetër (S.G. ndoshta nga vendbanimi antik i Fushës së Pejës). Pllaka ka një paraqitje figurale në qendër të së cilës është heksagrami apo simboli çifut Mogen David i cili nga të dyja anët ka nga një qiparis dhe nën këto janë figurat e tre peshqve. Sipas veçorive tipologjike dhe ikonografike, pllaka ka elemente romake, hebraike dhe krishtere dhe si e tillë e dëshmon prezencën e judeo-krishterimit në Dardani para shpalljes së Ediktit të Milanos. Për sa i përket destinimit të pllakës, N. Ferri sqaron se njëra nga mundësitë është që kjo të ketë qenë pjesë e një osuari, meqë çifutët në antikë shpeshherë i mblidhnin eshtrat e të ndjerëve në recipiente prej guri, mbi të cilat venin simbole religjioze. Në bazë të materialit prej të cilit është punuar, mund të thuhet që pllaka (apo pjesa e osuarit) është prodhim lokal dhe mund ta ketë punuar edhe ndonjë çifut gurgdhendës (S. G. vendës) për vete apo për ndonjë familjar të tijin. Kjo mundësi është aq më reale po të merret parasysh fakti që në kuadër të vendbanimit antik në Fushë të Pejës janë zbuluar gjurmë të ekzistimit të një punëtorie gurëgdhendëse e periudhës antike. Për autorin tonë, "monumenti në fjalë [...] është dokument i rrallë i cili flet mbi prezencën e hershme të hebrenjve dhe të judeo-krishtërimit në Dardani, respektivisht në trevën e Pejës së sotme, si dhe lidhur me fillet e arritjes së besimeve monoteiste në këtë trevë".

Kolegia e tij, Exhlale Dobruna për gjurmë hebraike në Dardani e sjell skalitjen e pëllëmbës së dorës në monumente mbivarrore. E këtillë është një stelë mbivarrore prej mermeri, mbase e fundit të shek. II ose fillimit të shek. III, e zbuluar në nekropolin lindor të Scupi-t antik. Mbizotëron mendimi se meqë kjo stelë me motivin e pëllëmbës, përkatësisht të duarëve të ngritura, është zbuluar në atë pjesë të nekropolit ku materiali i gjetur (sarkofagu dhe llambat) tipologjikisht i korrespondon vetëm atij të gjetur në Siri dhe në Palestinë, do t'i ketë takuar një të ndjeri me prejardhje semite. "Në ditët e sotme, çka edhe është me më rëndësi, motivin e dorës në këtë paraqitje ikonografike e hasim në pllakat e varrit

të hebrenjve në varrezat që gjenden në lagjen Velania të Prishtinës [...] që është për t'u besuar se ka të bëjë me një trashëgimi të këtij zakoni të lashtë semit. Bazuar në këtë fakt, do të theksonim se ky motiv i skalitur në stelën e Skupit antik flet në të mirë të pranisë së hebrenjve që herët në trevën dardane, të cilët këtë motiv, duke e bartur me vete, e ruajtën deri në ditët e sotme mu edhe në këtë trevë." - përfundon autorja jonë.

Në dritën e burimeve të drejtpërdrejta të lidhura me dëbimin e hebrenjve nga Spanja dhe me strehimin e tyre (khs. më lart), nuk më duket i besueshëm pohimi i autorit kosovar A. Ramaj i cili thotë se na paska dëshmi që hebrenj në qytetin mesjetar të Novobërdës paska pasur qysh në vitin 1442, përkatësisht 1498 dhe se këtyre të fundit u qenka lejuar administrata autonome.[28] Është paksa e vështirë të besohet, së pari, që në Novobërdë do të ketë pasur hebrenj 50 vite përpara valës së dëbimit të tyre nga Spanja dhe së dyti pse Novobërda ishte në atë kohë koloni kryekëput e raguzasve dhe e sasëve në të cilën, si jeta e përditshme, administrata, gjyqësia, religjioni (i ritit katolik) dhe liturgjia zhvillohej sipas mënyrës raguzase e krejt pak pjesërisht edhe sipas asaj sase, të mund të ketë pasur madje edhe një "administratë autonome" hebraike. Kjo sepse, nuk ka ndonjë burim që do të dëshmonte se aty do të ketë pasur edhe ndonjë administratë shqiptare (sado që pjesa dërmuese e priftërinjve të ardhur kryesisht nga krahina e Matit dhe e popullatës vendëse ishte shqiptare) apo "administrata" të elementeve të tjera etnike: venedikase, pse aty kishte edhe ndonjë tregtar nga Bullgaria e ndonjë nga Serbia të ketë pasur edhe aq hebrenj sa që Republika e Raguzës do t'ua lejonte atyre ndonjë "administratë autonome". E pambështetje duket edhe pandehja sipas së cilës një banor hebre paska pas jetuar në vitin 1442 në Prishtinë. Këtë pandehje e hidhte poshtë dijetarja D. Kovačević.[28a] Mirëpo për praninë e hebrenjve në Novobërdë e në rrethina të saj nuk ka asnjë dëshmi më të vjetër se ato që përmbahen në regjistrimin e hollësishëm osman-turk të kryefamiljarëve dhe të pronave i cili, (duke qenë i padatuar) mbahet të jetë hartuar në vitin 1526, përkatësisht midis viteve 1566-1574. Në këtë kohë për banorë të qytetit të Novobërdës është regjistruar edhe *Bashkësia e Çifutëve*. Këtë bashkësi e përbënin asokohe familjet e kryefamiljarëve: *Isak Abraham*-i, *Posojo Abraham*-i, *Mojse Abraham*-i dhe *Mojse Betamin*-i. Përveç kësaj, në qytetin e Novobërdës kishte edhe një *Bashkësi e katalanëve* të vjetër, që përbëhej vetëm nga kryefamiljari *Abraham Solimon*-i dhe familja e tij, si edhe një Bashkësi e hebrenjve të kthyer nga Kastilja që, edhe kjo!, përbëhej vetëm nga një familje, me kryefamiljarin të

[28] Po ai, po aty.

[28a] Sipas M. Tërnava, Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-xvi, f. 395.

quajtur po ashtu (!) *Abraham Solimon*-i.* I rëndësishëm për historikun, përkatësisht për paravendimin prej nga do të kenë ardhur këta në qytetin e Novobërdës, më duket shënimi: "Meqenëse kanë në duart e tyre temesytet (vërtetimet) për dhënien e xhizjes së bashku me bashkësitë e tyre në Selanik, u regjistruan në defterin e ri sipas mënyrës së sipërshkruar".[29] Në dritën e këtij shënimi ka vend të besohet që hebrenjtë me prejardhje në krye të herës nga Katalonja e nga Kastilja e Spanjës nuk ishin ardhur drejt nga këto regjione, porse nga kolonia/bashkësia hebraike e qytetit të Selanikut. Duket se po këto (gjashtë) familje hebraike do të kenë qenë evidentuar edhe në regjistrimin e viteve 1544-1545.[30] Kështu mendojnë edhe autorët Gail Warrander e Verena Kraus,[30a] të cilët, pas konstatimit se për Novobërdën " Histoirians have found a statite in Latin dating drom 12th century in wich Novo Brdo was aalready granted a special Status. The town had its heyday in the 15th and 16th centuries". sqarojnë se "Records from the 15th century at least four Jewish families who traded with Skopje (where there were over 3.000 Jews) and Saloniki".

Historia e hebrenjve në Selanik nis me arritjen e gati të 20.000 hebrenjve që në vitin 1492 ishin dëbuar nga Spanja, si edhe hebrenjtë nga Sicilia e Italia e Jugut që asokohe sundohej nga Spanja. Pas këtyre erdhën në vitin 1497 edhe hebrenjtë që për atdhe e kishin Portugalinë. Në vitin 1506 hebrenjtë e ngritën shtypshkronjën e parë hebraike në Ballkan, pas së cilës u hapën edhe shumë të tjera. Vetëm 15 vite pas kësaj, Selaniku u bë qendër intelektuale e judaizmit, qendër e poezisë fetare e laike dhe kryeqytet i arsimimit, teologët, filozofët e juristët e së cilës çmoheshin gjithandej nëpër Europë.[31]

Në Selanik ishte 30 sinagoga, talmudthora, jeschiwote dhe një varg shkollash laiciste hebraike, të ngritura disa nga Alliance Israelite Universelle e disa nga shoqata humanitare e hebrenjve të Gjermanisë […] Nga pesë gazeta të përditshme në spanjolisht, tani ekziston vetëm një.

---

* Sipas M. Tërnavës, poaty, f. 396 banorë të kolonisë ebreite të Novobërdës ishin: Isak Abraham, Joasaj Abraham, Mojse Abraham, Kuhne Katilan, Abraham Solamon, Krosi Kistilla (?) dhe Abraham Sallamon.

[29] S. Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI, Tiranë, 1983. f. 543 dhe I. Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566/74, në Vjetar 31-32 i Arkivit të Kosovës, Prishtinë 2004, f. 100-101.

[30] Sipas Nikola Čolak-Ive Mažuran: *Janjevo,* Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 34.

[30a] Sh. Kosovo, The Bradt Travel Guide, 2007, f. 236.

[31] Lena Kalaitzi-Oflidis und Simos Oflidis: "Neunzehnhundertdreiundvierzig nach Christus" http://www.hagalil.com/europa/griechenland/5768/thesaloniki.htm

Hebrenjtë e kishin përkrahur Lëvizjen e Turqve të Rinj e cila i ka fillet në Selanik. Ata (hebrenjtë) merrnin pjesë me të madhe në jetën politike e parlamentare. Në Selanik jetonte edhe sekti (hebre) i Dönmeh-ëve, i cili pas rënies së Lëvizjes së Sabbatai Zewi, vetëm sa për sy e faqe ishte konvertuar në islam. Kur, në kuadrin e shkëmbimit të popullsive, popullata turke (e Selanikut) u shtrëngua të largohej nga qyteti, prej këtu u shpërngulën edhe Dönmeh-ët dhe shkuan në Stanboll e në Izmir (Smyrna).[31a]

Në vitin 1610, në kohën kur në qytetin e Novobërdës me rrethinë të saj ende ishte aktive zeja e xehetarisë kishte, përkrah 40 shtëpive/familjeve katolike dhe 100 shtëpive ortodokse edhe 100 familje, pa e pas dhënë numrin e saktë të secilës bashkësi hebraike dhe myslimane.[32] Duket se pikërisht për shkak të shuarjes së xehetarisë dhe të islamizimit masovik të popullatës së qytetit dhe të rrethinës së tij (në vitin 1641/42 qyteti që tani kishte katër xhami), ai banohej nga 50 familje ortodokse dhe 120 familje myslimane[33] familjet hebraike (si edhe ato raguzase e sase) do të jenë larguar nga Novobërda. Ka shumë mundësi që bashkësitë hebraike të themeluara më vonë në Prishtinë, Prizren, Pejë e në Gjakovë do ta kenë pikënisjen nga bashkësia hebraike e Novobërdës. Se bashkësia hebraike e Novobërdës nuk do të ketë qenë aty e përkohshme, kalimtare, mbase dëshmohet edhe nga rrethana që në dy katunde të rrethinave të Novobërdës e të Kamenicës ka edhe sot vende që e ruajnë kujtimin për varreza të hebrenjve. Kështu, vende të quajtura *Vorret e Çifutëve* ka në katundin serb Jasenovik, rreth 3 km në lindje të Novobërdës dhe në katundin serb në të cilin ka porse edhe disa familje "muhaxherësh" shqiptarë, Kostadincë, 12 km në verilindje të Kamenicës.[34] Ndoshta është mirë të shtohet në këtë mes se në Novobërdë kishte në vitet 1438-1440 (edhe) banorë të këtyre dy katundeve që ishin punëtorë krahu në minierë e borxhlinj ose dorëzanë tek tregtari raguzas Michael de Lucari, që asokohe vepronte në Novobërdë. Mirëpo në dritën e rrethanës që në librin e Mich. Lucari-t (1438-1440) nuk është evidentuar asnjë person me emër apo me mbiemër hebre ose me etnonimin "hebre", qoftë banor i Novobërdës qoftë i ndonjërit nga këto dy katunde, flet në të mirë të faktit që hebrenjtë do të jenë ngulitur këtu e këndej në gjysmën e shek. XVI. Kjo përforcohet edhe me rrethanën që

[31a] sipas Juden in der Welt: Griechenland, http://www.hagalil.com/

[32] Sipas Peter Bartl, Geistliche Visitationsberichte als Quellen zur albanischen Volks- und Kirchengeschichte, version i përpunuar i punimit të botuar më parë në anglisht në botimin e përgatitur për shtyp nga Arshi *Pipa* e Sami *Repishti*, Studies on Kosova. New York 1984, (Kosova and Macedonia as Reflected in Ecclesiastical Reports, S. 23-39).

[33] Ibidem, 262.

[34] Sipas Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 13, Dardana (Kamenica) dhe Artana (Novobërda), Prishtinë 2004, f. 219, 134.

ndonjë hebre nuk është dëshmuar as në defterët osmanë të shek. XV, përkatësisht të viteve 1455* e 1498-1499.**

Për prejardhjen e kryehershme nga Spanja të bashkësive hebraike të Kosovës flet rrethana që "kur studiuesi i njohur spanjoll Manuel Manrique de Lara e vizitoi Prishtinën në vitin 1911, i shoqëruar nga hebreu me autoritet Moshe ben Rafel Attias i njohur në Sarajevë me emrin Moše Rafajlović, gjeti në Kosovë këngë kastiliane të kënduara ende prej hebrenjve të Prishtinës dhe të qyteteve të tjera të Kosovës. Bashkësia e ngushtë e hebrenjve kosovarë e kishte ruajtur gjuhën spanjole deri në shek. XX."[35] Kjo do të jetë ajo gjuhë kastiliane e hebrenjve sefardinë e quajtur "Judesmo, Ladino, Judeo-Espagnol", struktura e së cilës edhe pas 400 e më shumë vitesh pas vendosjes në hapësirat e Ballkanit i kishte ruajtur konvencionet gjuhësore të atdheut të kryehershëm të Iberisë. Kjo ishte pra një gjuhë në gjendjen strukturale të saj të konservuar, të shtanguar të shek. XV, por që në rrafshin e leksikut, në ndërkohë ishte pasuruar me shumë turcizma e sllavizma.[36]

Gjuha që flisnin këta hebrenj është *ladino*, spanjishte e hebrenjve ose *ladino-spanjole* /*Djudeo(-Espanyol)* ose *Djudezmo*; në Maroko e njohur me emrin *hakitia*. Kjo është tradicionalisht gjuha romane e hebrenjve sefardinë. Së këndejmi kjo quhet ndonjëherë edhe gjuha sefardine. Nuk bën të ngatërrohet me ladinishten* e Alpeve.

Varianti hebre i spanjollishtes e ka për hebrenjtë sefardinë të njëjtin funksion që tek hebrenjtë ashkenasim e ka jidishtja. Të dyja këto janë të vetmet gjuhë josemite të hebrenjve, të cilat shpesh shkruhen me alfabetin hebraik.

Në vitet 1990 gjuha *ladino* e hebrenjve flitej ende nga rreth 150.000 njerëz, dy të tretat e të cilëve jetojnë në Izrael. Të gjithë folësit e kësaj gjuhe e zotërojnë rrjedhshëm së pakut edhe një gjuhë tjetër. Sado që kjo gjuhë nuk e ka askund statusin prej gjuhe zyrtare, në Izrael e në Turqi ka

---

* Khs. defterin Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455. godine, Orijentalni Institut u Sarajevu, Sarajevo 1972. të botuar nga Hamid Hadžibegić, Adem Handžić dhe Ešref Kovačević.

** Prof. Dr. Iljaz Rexha, Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës sipas defterit të fundshekullit XV, në Vjetar XXVII-XXVIII i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë 2002, f. 86, 126.

[35] Stephen Schwartz: Kosova,. Prejardhja e një Lufte, Prishtinë, "Rokullia", 2005, f. 15.

[36] Wolf Oschlies, Geschichte und Ende der Juden in Serbien www.shoa.de/content/view/218/46/ - 89k

* *Ladinishtja*, e quajtur ndryshe *retoromanishte* është gjuhë romane më vete, që flitet në Dolomitet, përkatësisht në veri të Italisë e që quhet edhe ladinishtja e Dolomiteve dhe ka disa nënidioma.

gazeta, revista e programe radiofonike. Folës të kësaj gjuhe ka përveç në Izrael e në Turqi edhe në Bullgari, Greqi, Bosnje-Hercegovinë dhe në Maqedoni. Në Izrael e në Turqi kjo gjuhë ndodhet përpara shuarjes/ vdekjes, ndërsa në vendet e tjera, që u përmendën më lart, është para shuarjes, ose ka vdekur kaherë.[37]

Të dhënat e dhjetëvjetëshit të parë të shek. XVII që u sollën më sipër, bëhen të besueshme në dritën e shënimeve që gjenden në njoftimet që i sjellin relatorët shqiptarë, të cilat unë po i citoj sipas një punimi të historianit gjerman Peter Bartl.[38] Kështu në një relacion të Marin Bicit të vitit 1610 është shënuar p.sh. se nga 40.000 shtëpi të qytetit të Shkupit *la maggior parte sono Albanesi di Natione, i altri Asiatici* "pjesa më e madhe e banorëve ishin shqiptarë etnikë, ndërsa (myslimanët) tjerë ishin aziatikë" dhe se midis tyre kishte hebrenj, "serviani" dhe pak grekë. Të dhëna më të hollësishme për këtë qytet sjell pak vite më vonë relatori P. Mazrreku, sipas të cilit qyteti i Shkupit kishte 23.000 familje myslimane, 120 familje hebraike[**] dhe 328 sosh ortodokse, ndërsa në vitet 1641/42 në këtë qytet kishte 22.000 familje myslimane, 200 orthodokse dhe 150 familje hebraike. Të dhënat e para për numrin e hebrenjve në qytetin e Kratovës janë të viteve 1638/39: Përkrah 38 familjeve/shtëpive katolike (shqiptare), aty kishte edhe 40 familje/shtëpi hebraike, 100 familje ortodokse dhe 300 familje/shtëpi myslimane.

Në vitet e '60-ta të shek. XIX Shkupi kishte 19.000 myslimanë, 8.000 ortodoksë, 800 katolikë dhe 800 hebrenj, ndërsa sipas shënimeve bullgare, qyteti i Shkupit kishte në vitin 1881 2.694 shtëpi, në të cilat jetonin 5.115 myslimanë, 3.053 bullgarë dhe 476 hebrenj.[39]

Autori kosovar A. Ramaj tregon se "në vitin 1737 vetëm në qytetin e Gjakovës kishte rreth 600 hebrenj, ndërsa në Prishtinë rreth 350 sish ishin të organizuar në një bashkësi të veten. Hapësira e Kosovës u vlerësua nga hebrenjtë e këtushëm, gjatë kohës së luftërave çlirimtare të kosovarëve në vitet 1909-1912, për si e pasigurt, kështu që në vitin 1912 e bënin mend

---

[37] Juliette Laurent: Jüdische Traditionen in Belmonte (Portugal) (September 2007), në http://www.dw-world.de/dw/article/0,,2763572,00.html

[38] Sipas Peter Bartl, Geistliche Visitationsberichte als Quellen zur albanischen Volks- und Kirchengeschichte, version i përpunuar i punimit të botuar më parë në anglisht në botimin e përgatitur për shtyp nga Arshi *Pipa* e Sami *Repishti*, Studies on Kosova. New York 1984, (Kosova and Macedonia as Reflected in Ecclesiastical Reports, f..23-39).

[**] Në këtë qytet (sipas Albert Ramaj: Rettung von Juden in Albanien) një sinagogë qenka ngritur në vitin 1361.

[39] Sipas Fatos Baxhaku, Einige Ethnische Angaben über die Bevölkerung der Grenzzone zwischen Albanern, Serben und Bulgaren (Zweite Hälfte des 19. Jhd.) Dardania, Zeitschrift für Geschichte, Kultur und Information, 2-3, Wien, 1995, f. 50.

të shpërnguleshin në juglindje të Ballkanit - bastionin e fundit turk në Europë. Kjo ndërmarrje porse nuk u realizua. Kryerabini i Beogradit Isaj Alkalaj erdhi vetë në Kosovë. Ai, pas gjithë gjasash me argumentin se Perandoria osmane gjendej në gjithë Ballkanin në fazën e saj të shprishjes, ua mbushi mendjen bashkëkombësve të vet që të heqin dorë nga kjo ndërmarrje e planifikuar nga ata."[40]

Në një studim të botuar në të përditshmen kosovare "Koha ditore" të dt. 3. 5. 2004, studiuesi shqiptar Dr. Apostol Kotani, i mbështetur mbi burimet lokale dhe në ato të organizatave ndërkombëtare hebraike, konstatonte se deri në vitet 1910-1912 në Kosovë kishte më shumë se 3.000 hebrenj. Pas Luftës Ballkanike në Kosovë mbetën vetëm 300 hebrenj. Bashkësi hebrenj kishte në Prishtinë, Pejë e në Prizren.

Duke u kyçur në debatin përkitazi me pakësimin, përkatësisht shkaqet e largimit apo të dëbimit të hebrenjve nga Kosova, studiuesi Max Brym shkruante në këtë kontekst se: "Në shtypin e Shqipërisë dhe në atë shqipfolës të Kosovës u lind një debat përkitazi me fatin e hebrenjve të Kosovës në shekullin e kaluar. Një autor shkruante në "Gazeta shqiptare" të dt. 1.2.2004 se: "Në kohën e pushtimit të Kosovës nga nazistët, fashistët gjermanë, na qenkan deportuar dhe mbytur rrum 500 hebrenj."

Nga parafrazimi i punimit të Dr. A. Kotani-t nga Max Brym[41] mësohet se pas Luftës Ballkanike një masë e madhe shqiptarësh u dëbua për në Turqi, sepse Serbia i konsideronte kosovarët (zyrtarisht) për agjentë të Turqisë. Në këtë kuadër edhe hebrenjtë u keqtrajtuan si edhe shqiptarët, përkatësisht kosovarët.

Në vazhdim mësohet se "në vitin 1937 nën patronatin e Akademisë Serbe të Shkencave u botua me titullin "Dëbimi i shqiptarëve", elaborati i anëtarit Vasa Čubrilović i kësaj akademie. Si pasojë e politikës diskriminuese të Serbisë ndaj shqiptarëve, në kuadrin e së cilës parashihej edhe shpronësimi i qëllimshëm, pësoi edhe bashkësia e vogël e hebrenjve të Kosovës. Përkitazi me këtë Dr. Kotani e citon David Levy-n i cili theksonte se "Hebrenjtë në Kosovë kanë rënë në gjendjen më të vështirë të historisë së tyre", një raport ky që Levy ia dërgoi në vitin 1937 Ekzekutivit Zionist.

Ky theksonte më tej se, "ç'është e drejta, fati i hebrenjve të Kosovës nuk përmendet në asnjë libër. Këtë zbraztësirë e mbylli zoti Dr. Kotani me librin e tij. "Në fund të Luftës së Parë Botërore (gjatë viteve 1915-1918 Kosova qe pushtuar nga Austro-Hungaria," dhe se "bashkësitë

[40] Albert Ramaj, Bedrängte Juden im Kosovo im Zweiten Weltkrieg, në http://david.juden.at/kulturzeitschrift/70-75/73-ramaj2.htm

[41] Sh. punimin e tij Historische Debatte in Kosova/Kosovo: Die Juden in Kosova und Albanien, http://www.hagalil.com/archiv/2004/05/kosova.htm

hebraike përjetuan askohe njëfarë rritje të lehtë) por që "hebrenjtë u atakuan rishtazi (S.G.: nga pushteti i Mbretësisë së SKS). Nacionalizmi serb i akuzoi hebrenjtë (kosovarë) për "Antisllavizëm" dhe për "Kolaborim me armiqtë e kombit të serbëve." Hebrenjtë ishin të varfër dhe e mbanin veten gjallë rëndom si tregtarë të vegjël. Klientë të tyre ishin katundarët shqiptarë.

Në kohën e barbarisë naziste autoritetet shtetërore të Beogradit e njoftonin RSHA-në në Berlin se: "*Serbien ist judenfrei*" (S.G. "Në Serbi nuk ka më hebrenj."). Dihet për veprat e kësaj natyre të ustashëve fashistë të Kroacisë. Në Maqedoni nga 7762 hebrenj u mbytën 6982 sish. Në gjithë këto hapësira kishte kolaboratorë dhe rezistencë antifashiste. Antisemitizmi eliminator nuk u shpreh asokohe në Kosovë e në Shqipëri. Ky fakt historik është i rëndësishëm dhe ka rëndësi edhe në momentin aktual." - sqaron M. Brym, për të përfunduar se: "Rrjedhimisht nuk ka kombe të mira ose të këqija, çdo gjë ka dy anë dhe është detyrë që njerzishmëria dhe toleranca të zhvillohen kundër mostolerancës. Nëse në shtypin shqiptar ka një qëndrim përkitazi me traditën antifashiste kjo është mirë e jo keq. Edhe më e mirë është rrethana që Dr. Apostol Kotani kërkon sot për Kosovën konsekuenca aktuale për traditën antifashiste të saj."[42]

3. FILLET E AKTUALIZIMIT TË ÇËSHTJES SË HEBRENJVE NË HAPËSIRËN ETNOLINGUISTIKE TË SHQIPTARËVE

Çështja e pranisë, e bashkëjetesës me theks të veçantë ajo e strehimit të hebrenjve nga shqiptarët në hapësirën etnolinguistike të tyre, përkatësisht në Shqipëri e në Kosovë, u aktualizua sidomos pas viteve të '90-ta të shekullit që shkoi.

Ka mundësi që zbardhja e dokumentuar e kontributit të qytetarëve dhe të shtetit të Shqipërisë për daljen krah hebrenjve vendës dhe atyre të përndjekur që nga koha e forcimit të nacionalsocializmit (që nga vitet e '30-ta të shek. XX) në Gjermani do ta ketë marrë së pakut njërën nga shtysat kryesore me rastin e qëndrimit në Shqipëri të senatorit Tom Lantosh dhe kongresistit me prejardhje arbëreshe Josef DioGuardi dhe takimit të këtyre të dyve me drejtuesin e asokohshëm të Shqipërisë, Ramiz Alia në fillim të viteve të '90-ta të shekullit 20. Sipas rrëfimit të Shirley Cloyes DioGuardi të Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane në tubimin ndërkombëtar, përkatësisht konferencën e Asociacionit të Historisë Orale të mbajtur në Pragë "Diktatori i fundit i Shqipërisë, Ramiz Alia, deshi të impresiononte atë dhe ai nga arkivi nxori gjithë

[42] Po ai, po aty.

dokumentacionin për rolin unik të shqiptarëve në shpëtimin e hebrenjve gjatë Holokaustit. [...] Deri atëherë askush nuk i kishte parë këto dokumente. Bashkëshorti im, Xho DioGuardi, kishte një mik të afërt në Izrael, që gjithë këtë material e dërgoi në Yad Vashem (Institucion i përkujtimit të martirëve të Holokaustit në Jeruslaem), ku është bërë dëshmimi i autentitetit."[43]

Këtu duhet shtuar porse edhe rrëfimin e Apostol Kotanit, njohës i mirë i historikut të hebrenjve në Shqipëri dhe bashkëkryesues i shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Izrael nga deklarimi i të cilit në një intervistë me të mësohet se që në vitin 1968 të shekullit të kaluar kishte kërkesa për trajtimin e çështjes së hebrenjve në Shqipëri: "Ishte viti (19)68 kur më morën në Institutin e Marksizëm-Leninizmit për vëllimin e katërt të Historisë së Shqipërisë. Kur ende nuk isha larguar nga Instituti, vjen një kërkesë nga një profesor francez për Enver Hoxhën, i cili i kërkonte të dhëna për trajtimin e hebrenjve në Shqipëri. Kjo detyrë mu ngarkua mua që, të them të drejtën, e mora pa qejf, se nuk dija shumë për këtë popull. Megjithatë, në dhjetor të vitit (19)68 dorëzova 17 faqe daktilografike për hebrenjtë në vitet e luftës. Një shkrim më të zgjeruar për hebrenjtë e botova në "Studime historike" nr. 4 në fillim të vitit (19)90."[44]

Trajtesa më e plotë deri tani e kësaj çështjeje është monografia: "Hebrenjtë në Shqipëri, pranimi dhe shpëtimi" i autorit Shaban Sinani, e publikuar në vitin 2008 nga Shtëpia botuese "Naim Frashëri" (Tiranë).

Meqë unë vetë nuk e kam lexuar këtë monografi, e gjithë pjesa më poshtë e kësaj trajtese time mbështetet në paraqitjen e rezultateve të kësaj monografie nga Admirina Peçi[45] dhe nga Radio Deutsche Welle[46] e nga ndonjë autor tjetër.

Në këto prezantime thuhet, ndër të tjera: Nëse në shumë vende u zbuan, e iu shitën nazistëve, hebrenjtë në Shqipëri në të gjitha periudhat e vërshimeve të tyre janë mirëpritur. Dokumentet dëshmojnë se gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin më se 2 mijë hebrenj, vendas dhe të ardhur nga Europa Qendrore dhe Ballkani që u shpëtuan. [...] përmes dokumentesh origjinale të botuara për herë të parë, (autori) nënvizon se Shqipëria shihej si atdhe i dytë për hebrenjtë. Sipas autorit Shaban Sinani

[43] Sipas Gordana Knežević, Radio Evropa e Lirë, e shtunë, 10 korrik, Intervistë me zonjën Shërli Klojs DioGuardi, këshilltare për çështjet e Ballkanit në Lidhjen Qytetare Shqiptaro-Amerikane.

[44] Cit. sipas Denisa Kona, Të pathënat mbi shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri, në http://dielli.blog.al/page/86/., që së pari ishte botuar në gazetën shqiptare "Ballkan".

[45] http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/344519/titulli/Shaban-Sinani-Si-u-priten-hebrenjte-ne-Shqiperi më 02/11/2009; http://www.revistakuvendi.net/Publicistike/207.html

[46] në emisionin e saj të dt. 01.02. 2010.

"rezulton se jo vetëm Lidhja e Kombeve por, edhe organizatat më të mëdha hebraike të kohës, vendin më të sigurt për të shpëtuar hebrenjtë gjetën Shqipërinë (për këtë sh. edhe më poshtë).

Studimi i fundit mbi hebrenjtë në Shqipëri i Shaban Sinanit ofron këndvështrime të reja të pa trajtuara më parë, si për shembull, për rolin e ambasadorit të parë amerikan Herman Bernshtajn, me kombësi hebraike në Shqipëri në vitet 1930-1933, i cili përgatiti një marrëveshje, sikurse është pohuar, në bashkëpunim me ambasadorin shqiptar në Uashington, Faik Konica. Sipas studiuesit Sinani, hebrenjtë në Shqipëri nuk erdhën rastësisht, sepse qysh në vitin 1932-1933 fillojnë bisedimet dy dhe shumëpalëshe me qeverinë mbretërore për të krijuar një mundësi që në Shqipëri të instaloheshin grupime të mëdha hebrenjsh të Evropës Qendrore. Këto bisedime janë bërë nga Lidhja e Kombeve, janë bërë nga Komisariati i Lartë i Refugjatëve, janë bërë dhe nga organizata izraelite (S.G. për këtë shih edhe më poshtë). Ka pasur edhe bisedime të nivelit dypalësh midis Shteteve të Bashkuara dhe qeverisë mbretërore. Edhe këto bisedime janë bërë për të vendosur në masë hebrenj në Shqipëri.

Vitin e kaluar (SG.: 2009) është botuar njëri prej relacioneve të fshehta që bënte fjalë për mundësinë që Shqipëria të kthehej në një farë "atdheu të dytë" për hebrenjtë. Ky relacion është botuar në shtypin izraelit." - sqaron Sinani.

4. HEBRENJTË E SHQIPËRISË GJATË PERIUDHËS SË SUNDIMIT TË MBRETIT A. ZOGU DHE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

a) Gjatë periudhës së sundimit të mbretit A. Zogu

Arsyet përse hebrenjtë u pranuan dhe u ndihmuan në Shqipëri, siç është theksuar nga pothuaj të gjithë ata që janë marrë me këtë çështje, janë toleranca e njohur fetare e shqiptarëve me theks të veçantë mosekzistimi i antisemitizmit ndër shqiptarët, institucioni i mikpritjes dhe ai i "besës". Duket porse që faktori kryesor ishte në këtë mes statusi që mbreti Zog ia kishte dhënë me kushtetutë e me ligje fesë në shtetin që e drejtonte.

Përkitazi me këtë temë mësohet edhe nga një ligjëratë e dt. 13 prill 2004 e Bernd J. Fischer-it profesor i historisë dhe shef i Departamentit të Historisë në Universitetin e Indianës, Fort Wayne, i botuar edhe në shqip.

Autori ynë theksonte se "Toleranca fetare në Perëndim në kohën tonë shpeshherë matet me trajtimin e hebrenjve - në këtë aspekt shqiptarët e kanë kryer detyrën më së miri. Ndërsa të tjerët në Ballkan, dhe në mënyrë

të dukshme në pjesën tjetër të Europës, kanë institucionalizuar diskriminimin, kanë marrë pjesë në mënyrë pasive apo shpesh edhe në mënyrë entuziaste në disa nga krimet më monstruoze kundër njerëzimit në lidhje me hebrenjtë, shqiptarët, duke marrë përsipër rrezikun, e hapën vendin e tyre dhe shpesh edhe shtëpitë e tyre jo vetëm për hebrenjtë e Shqipërisë, por gjithashtu edhe për hebrenjtë e huaj.[...]

"Është e qartë, mendoj unë, se duke e parë politikën fetare të Mbretit Zog në tërësi, del se ai e shihte këtë si një forcë të mundshme përçarëse, që mund ta pengonte rrugën e krijimit të shtetit të unifikuar perëndimor dhe modern që ai kërkonte. Zogu qe i vendosur ta zvogëlonte efektin e mundshëm përçarës të fesë në Shqipëri, duke ndjekur një politikë të kombëtarizimit të fesë, duke e nxitur dhe mbështetur pavarësinë politike e administrative të feve të ndryshme në Shqipëri nga çdo ndikim i huaj dhe duke ndjekur një politikë e cila do të mund të përshkruhej si avancim i mëtejshëm i diversitetit fetar.

Në rrafshin e kombëtarizimit të fesë, autori thekson se politika e Zogut e pati për mbështetje Kushtetutën e Monarkisë të vitit 1928 dhe Ligjin mbi "Komunitetet Fetare Shqiptare" i cili u miratua nga parlamenti i kontrolluar prej tij në janar të vitit 1930. Kësisoj, Zogu e shpalli Shqipërinë vend josektar, duke ia rezervuar shtetit të drejtën e kontrollit mbi komunitetet fetare. Duke u bazuar në nenin 8 të atij Ligji u sanksionua që "drejtuesit fetarë, vartësit e tyre të drejtpërdrejtë, ipeshkvët dhe famullitarët e tyre, duhet të ishin me prejardhje shqiptare dhe gjuhë shqipe".[...] Kushtetuta e vitit 1928 garantonte se "Të gjitha fetë dhe besimet nderohen dhe sigurohet liria e praktikimit të tyre. Feja nuk guxon në asnjë mënyrë të krijojë pengesa juridike dhe nuk mund të përdoret për qëllime politike."

Autori tregon në vazhdim se shumë punë për kombëtarizimin e fesë ishte bërë tashmë qysh përpara vendosjes së monarkisë. Kështu, në Kongresin e Tiranës në vitin 1923 myslimanët sunitë u shkëputën nga kontrolli i jashtëm. Kësisoj u sanksionua lidhja me shumë praktika tradicionale, shkëputja e xhamisë nga kalifati, heqja e titullit të beut bashkë me praktikën e poligamisë dhe ndalimi i mbajtjes së detyruar të perçes nga gratë. Në vitin 1922 në Prishtë, bektashinjtë shqiptarë e deklaruan veten të pavarur nga bektashinjtë e Turqisë.

Po në këtë vit (1922) edhe komuniteti ortodoks, në kuadrin e të cilit përpjekjet e Fan Nolit qenë të rëndësishme, organizoi Kongresin në Berat. Këtu u deklarua se Kisha Ortodokse Shqiptare do të ishte tash e tutje autoqefale dhe se gjuha shqipe do të përdorej në vend të asaj greke për qëllime liturgjike. [...] Pas shumë pengesash, në vitin 1929 Zogu i

mori çështjet vetë në dorë dhe krijoi një sinod i cili u njoh më në fund nga Patriarku vetëm në vitin 1937. Megjithëse me njëfarë vonese, të konsiderueshme, Zogu ia arriti qëllimit që edhe një tjetër kishë kryesore e Shqipërisë të kombëtarizohej plotësisht.

Më shumë telashe Zogut i dolën me shqiptarët katolikë. Zogu argumentoi se nëpërmjet shkollave katolike italianët po ndikonin mbi studentët shqiptarë politikisht dhe nga ana kulturore. [...] Zogu qe i shqetësuar në mënyrë të veçantë për inkursionet italiane në Veri dhe e kuptoi se italianët po përpiqeshin ta zëvendësonin influencën e tij me të tyren. [...] Zogu, ashtu siç vepronte shpesh, reagoi ashpër. Megjithëse motivet e tij mund të kenë qenë krejt të arsyeshme, politika e tij u keqkuptua dhe u zbatua dobët, duke çuar në mbylljen e shkollave fetare, pa bërë një përgatitje të kujdesshme e të mjaftueshme për të siguruar se dëmi që shkaktoi kjo lëvizje në lidhje me arsimin në Shqipëri në përgjithësi do të mbahej në minimum. Pas shumë vitesh dhe marrëveshjesh të reja me Italinë, shumica e shkollave u rihapën. [...] Mbreti Zog nisi programe të zgjeruara, duke përfshirë komunikim dhe transport të përmirësuar, që kishte si qëllim lejimin e kombinacioneve fetare e kulturore ndërmjet grupeve të ndryshme fetare shqiptare. Zogu vuri theksin më shumë në arsimin kombëtar. Ai e përdori ushtrinë për të integruar shqiptarët nga ana fetare duke ngulur këmbë që njësitë ushtarake të krijoheshin me individë nga rajone të ndryshme dhe që u përkisnin besimeve të ndryshme. Ai gjithashtu futi edhe disa masa detyruese lidhur me kodet e veshjes. Shembulli më i mirë këtu do të ishte ndalimi nga ana e tij e mbajtjes së perçes. Martesa e tij me Geraldinën, (e cila ishte një katolike romane që edhe e praktikonte këtë rit), që ishte e motivuar nga shumë faktorë, mund të shihet gjithashtu nën dritën e theksimit të tij lidhur me pranimin e diversitetit fetar.

Përsa i përket inkurajimit të diversitetit të mëtejshëm fetar, politika e Zogut lidhur me hebrenjtë është e spikatur. Së pari, Zogu i pranoi plotësisht hebrenjtë shqiptarë si pjesë e komunitetit fetar. Komuniteti hebraik u njoh zyrtarisht në prill të vitit 1937. Por Zogu shkoi edhe më tutje dhe madje duket se dëshironte të pranonte emigrimin e hebrenjve drejt Shqipërisë. Si rrjedhim i këtyre politikave të tolerancës, anëtarë të komunitetit hebre të Shqipërisë e kanë quajtur periudhën e Zogut si "*Epoka e artë e hebrenjve në Shqipëri*".

Rol të rëndësishëm në procesin pranimit të hebrenjve të emigruar në Shqipëri ka luajtur ambasadori amerikan Herman Bernstein, i cili shërbeu në Shqipëri ndërmjet viteve 1930 dhe 1933. Ky ishte vetë hebre dhe qe në gjendje të kishte ca kohë në disponim për të bërë studime mbi

hebrenjtë në Shqipëri. [...] Kontributi i tij kryesor për komunitetin hebre në Shqipëri qenë bisedimet e tij me Zogun për vendosjen e familjeve hebraike nga Austria dhe Gjermania menjëherë sapo ardhja e Hitlerit në pushtet e bëri të qartë për shumëkënd se hebrenjtë ishin të rrezikuar në të gjithë Europën. Përpjekjet e Bernstein-it rezultuan me ardhjen e shumë hebrenjve të Europës Qendrore drejt Shqipërisë në vitin 1933, për të kaluar pastaj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Afrikën e Jugut, në Turqi e në vende të tjera. Kjo u bë e mundshme nga konsullatat shqiptare, që lëshuan viza turistësh dhe sosh tranzite. Regjistrimet tregojnë, për shembull, se 100 hebrenj erdhën nga Vjena në shkurt të vitit 1939, ndërsa 95 të tjerë erdhën, po ashtu, kryesisht nga Austria por dhe nga Gjermania. Sapo erdhën në Shqipëri emigrantët e rinj gjetën përkrahje nga Komuniteti i hebrenjve të Shqipërisë, shumicës së të cilëve iu dha edhe leja e qëndrimit, në mënyrë që ata të mund të punonin. Qeveria e Zogut, atëherë, mori pjesë aktive jo vetëm në sjelljen e këtyre hebrenjve në Shqipëri, por ishte gjithashtu e interesuar për mirëqenien e tyre sapo ata të arrinin. [...]"

Diversiteti i mëtejshëm fetar në Shqipëri do të kishte bërë një hap gjigant përpara sikur Zogu të kishte mundur ta negocionte me sukses një plan që e kishte bërë që në mërgim gjatë luftës në Angli. Në janar të vitit 1944, në një intervistë me anëtarë të Shoqatës Anglo-Çifute, Zogu ofroi sponsorizimin e një plani për një vendosje masive të hebrenjve në Shqipëri - me sa duket të rreth 50.000 familjeve për t'u dhënë atyre tokë që ishte në pronësi të shtetit, nëse hebrenjtë britanikë do ta ndihmonin atë ta rimerrte fronin mbretëror. Duket se Shoqata e mori këtë seriozisht sa që edhe u konsultua me Ministrinë britanike të Punëve të Jashtme, e cila e hodhi poshtë këtë ofertë me shpejtësi. Zogu, në këtë pikë, ishte natyrisht i dëshpëruar, duke pasur parasysh se asnjë instancë zyrtare nuk e kishte lejur ta formonte një qeveri në mërgim dhe në të vërtetë nuk e kishin njohur atë asgjë më shumë se sa një qytetar privat. Megjithatë, kjo qe, padyshim, një ofertë unike dhe ndoshta mund të konsiderohet si përkushtim i Zogut për diversitetin fetar." [...][47]

Këtë mundësi e përforcon në një intervistë të zhvilluar me të edhe dr. Patrice Najbor. Duke u përgjigjur në pyetjen nëse "…në Londër, më 1943, ka pasur bisedime me mbretin Zog për sa i përket vendosjes

[47] Bernd J. Fischer, The Jews of Albania during the Zogist and Second World War Period. në: www.albanisches-institut.ch, përkatësisht versioni shqip Hebrejtë e Shqipërisë gjatë periudhës zogiste dhe Luftës së Dytë Botërore http:albanisches-institut.ch/pdf/tex9pdf. Teksti i mëposhtëm u lekturua lehtë nga unë. Këtij nuk iu bë asnjë ndryshim lëndor. Edhe nënvizimet (kursivet) përbrenda këtij teksti janë të miat.

së 25.000 familjeve hebraike në Shqipëri, nëse ai do të vinte në pushtet" ai thoshte në këtë kontekst se "Në fakt ka pasur bisedime për vendosjen e kolonive hebraike në Shqipëri. Këto projekte kishin një interes të dyfishtë, për t'i dhënë hebrenjve një vend pritës, një tokë azili dhe për t'i sjellë Shqipërisë intelektualë, inxhinierë, mjekë, mësues etj. të cilët do të merrnin pjesë në zhvillimin e vendit. Në këto projekte kishte një aspekt njerëzor dhe një aspekt ekonomik. […]. Në fakt, Sir Martin Gilberti në veprën e tij "Winston Churchill: le prophète de la vérité" tregon për një përpjekje të bërë në janar 1939, në të cilën një diplomat shqiptar (Çetin Saraçi), i dërguar nga mbreti Zog, i propozonte Churchill-it (që në këtë kohë ishte vetëm anëtar i Parlamentit) në një vend në jug të Francës, që Shqipërinë ta bëjë një vend të shenjtë mbrojtës për hebrenjtë. Për ta bërë këtë Churchill-i duhej ta frenonte vrullin e Musolinit dhe ta garantonte pavarësinë e Shqipërisë, në mënyrë që plani i shpëtimit të merrte jetë. Fatkeqësisht Churchill-i e kishte lënë mënjanë këtë plan.[48]

b) Gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Me pushtimin italian të Shqipërisë në prill të vitit 1939, gjendja ndryshoi si për hebrenjtë shqiptarë (S.G. = të Shqipërisë), ashtu edhe për ata të huajë. Zyrtarisht, natyrisht, feja ishte e lirë në Shqipëri dhe Kushtetuta e rishikuar e vitit 1939 shprehej se të gjitha fetë të respektohen dhe praktikimet e tyre të jashtme garantohen me ligj. Por fashistët, siç e dimë, shpesh kishin probleme me konceptin e sundimit të ligjit. […] Në përgjithësi është e sigurt të thuhet se politika italiane ishte përçarëse si në aspektin social ashtu edhe në atë fetar. [...] Pati gjithashtu trysni mbi regjimet kukulla shqiptare për t'i larguar hebrenjtë e huajë, si edhe kufizime të tjera, por duket se (të gjitha) këto u administruan në një mënyrë me gjysmëzemre, meqenëse (fundja) nuk u largua asnjë hebre.

Kufizime shtesë pati edhe për hebrenjtë vendës të Shqipërisë. [..] Hebrenjtë u përjashtuan nga veprimtaritë politike, sociale e kulturore. Atyre, për shembull, nuk u lejohej të hynin në Partinë Fashiste Shqiptare [..] dhe nuk mund të futeshin në Ushtrinë Shqiptare. Por edhe në terma shumë të përgjithshme jetët e hebrenjve në Shqipëri gjatë periudhës së sundimit të Italisë ishin mjaft të zakonshme. Me sa shihet, në atë kohë kishte pak nevojë për t'u fshehur dhe ditët e shenjta të hebrenjve celebroheshin haptazi. [...]

[48] Sipas Benji Oz Roli i mbretit Zog në shpëtimin e hebrejve në vitet 1928-1939, Intervistë me Dr Patrice Najbor, http://ardhmëria.co.uk/? P. 213 Mart 17, 2011.

Me ardhjen e gjermanëve gjendja për hebrenjtë u përkeqësua disi. Pushtuesit e rinj gjermanë nisën të pyesnin/kërkonin listat e të gjithë hebrenjve në Shqipëri si nga komuniteti hebre, ashtu edhe nga regjimi kukull i Mehdi Frashërit. Kjo kërkesë ishte, padyshim, një shenjë ogurzezë sepse, në rrethana të tjera, një veprim i tillë ishte hapi i parë drejt arrestimit, shpërnguljes dhe zhdukjes së komuniteteve hebre. Por listat nuk iu dhanë gjermanëve as nga komuniteti hebre i Shqipërisë, as edhe nga regjimi kukull dhe gjermanët nuk e ndoqën më këtë çështje. Hezitimi i tyre për të vepruar në këtë mënyrë mund t'i dedikohet, pjesërisht, Herman Neubacher-it, ish-kryebashkiak i Vjenës, i cili u bë përfaqësuesi special për Ballkanin i Ministrisë së Jashtme Gjermane dhe njëkohësisht përfaqësuesi personal i Ministrit të Jashtëm Gjerman Joachim von Ribbentrop në Shqipëri. Për një periudhë kohe ai qe figura më e fuqishme në Shqipëri. Përgjegjësia e tij ishte ta mbante Shqipërinë me sa më pak trupa, por për këtë ai kërkonte bashkëpunim real të qeverisë shqiptare. […] pushtimi gjerman i Shqipërisë pati, relativisht, pak shenja fashizmi. Shtypi vendas pati liri të konsiderueshme, Reichsführer Heinrich Himmler u ndalua përkohësisht të krijonte një divizion Shqiptar Waffen SS. Nuk pati organizata fashiste dhe nuk u kërkua punë e detyruar. Dhe më e rëndësishmja në këtë mes është rrethana që ka të bëjë me faktin se hebrenjtë nuk u përndoqën. Ata, natyrisht, që u ndjenë shumë më pak të sigurt me gjermanët dhe shumë prej tyre - sidomos hebrenjtë e huaj (sipas vlerësimeve të vitit 1943 ata ishin afërsisht 800 nga Austria, Gjermania, por edhe nga Polonia, Bullgaria e nga Jugosllavia) - qëndruan të fshehur, të mbrojtur njësoj nga myslimanët, ortodoksët dhe katolikët shqiptarë. Nuk njihet asnjë rast kur ky besim të jetë tradhtuar, nuk dihet asnjë rast kur një hebre të jetë ekspozuar tek gjermanët dhe nuk dihet, gjithashtu, asnjë rast i një familjeje pritëse shqiptare që të ketë kërkuar shpërblim për shërbimin […]

Konfrenca e Wansee vlerësoi se në Shqipëri në vitin 1941 ishin 200 hebrenj. Ka të ngjarë që kjo shifër të mos jetë e saktë. Është vlerësuar se në fund të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri ka pasur 1800 hebrenj - një arritje e shënuar dhe e pakonkurrueshme në Ballkan e ndoshta edhe në Europë si tërësi."[49]

[49] I gjithë teksti i cituar (i lekturuar lehtë nga unë) është marrë nga punimi i Bernd J. Fischer, Hebrenjtë e Shqipërisë gjatë periudhës zogiste dhe Luftës së Dytë Botërore, i botuar edhe në shqip tek http:albanisches-institut.ch/pdf/tex9pdf.

5. A ISHTE EINSTEIN-I NË SHQIPËRI?

Një vend të dukshëm në monografinë e S. Shabanit e zë edhe çështja e ngritur nga autori i saj nëse edhe shkencëtari hebre me famë botërore Albert Einstein do të ketë qëndruar shkurt, ilegalisht mbase vetëm për tri ditë, në Shqipëri në vitin 1931 dhe nëse ky, në Pogradec, do ta ketë marrë një pasaportë shqiptare, me emër të ndryshuar, të rrejshëm.

Në të mirë të këtij paravendimi autori sjell edhe të dhëna të karakterit dokumentar dhe memoaristik, në kuadrin e të cilit vend të spikatur zënë rrëfimet që babait të autorit ia kishte treguar Kozma Basho (1927-1994) që e kishte nip dhe e trajtonte si djalin e tij në fillim të viteve '50. Dr. Basho i kishte thënë atij, që Einstein-i paska ardhur në Shqipëri në fillim të viteve '30, kishte qëndruar 3 ditë dhe kishte marrë pasaportë shqiptare. Dr. Basho kishte ndërhyrë te Mbreti, e kishte shoqëruar Einstein-in gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri, kohë kur e kishte pritur edhe vetë Mbreti Zog. Madje Dr. Basho kishte shkëmbyer edhe disa letra me Einstein-in në të cilat ky i fundit e falënderonte për mirësinë e treguar dhe i tregonte për vështirësitë e jetës së tij. Mjerisht, këto letra u dogjën në shkurt të vitit 1945 (bashkë me shumë libra e dokumente të tjera) gjatë shtetëzimit të shtëpisë dhe klinikës së Dr. Bashos.

Në kuadër të "dokumentimit" tregimtar, bie edhe ajo e prof. dr. Skënder Koja-s, ish-drejtor i Institutit të Fizikës Bërthamore (1971-1987). Ky i ka treguar autorit se Ajat Bega, ish-bankieri i mirënjohur i Bankës Kombëtare Shqiptare, e paska takuar Ajnshtajnin në Tiranë. Prof. Koja paska biseduar vetë me të dhe dëshmia e A. Begës ishte sa më poshtë: "E kam takuar Ajnshtajnin në Tiranë në fillim të viteve '30, kur ky erdhi në Bankë e më kërkoi veprime të Bankës Shqiptare me një bankë të shtetit gjerman, veprime që banka jonë nuk i kishte kryer ndonjëherë, për shkak të mosekzistencës së lidhjeve me bankat gjermane në atë kohë. Më tha emrin, të cilin nuk e kisha dëgjuar deri atëherë. Atëherë mu desh të pyes dhe dola në mjediset e pasme të bankës, ku pashë që dera e drejtorit (i cili ishte italian) ishte e hapur. Trokita dhe hyra duke i thënë që një i huaj me emrin Albert Ajnshtajn kërkonte një veprim bankar që nuk e kishim bërë ndonjëherë. Drejtori shtangu dhe më tha që ky ishte një nga emrat më të mëdhenj të botës. I thashë se ai ishte tek sporteli. Atëherë drejtori la punët që kishte, e priti me nderime dhe unë nuk di të them ç'bëri me të, se nuk më ngeli mua të merrem me problemin për të cilin ky njeri i ishte drejtuar Bankës Shqiptare".

Një e dhënë tjetër gojore është edhe ajo e Geraldina Apponyi-Zogu (Nëna Mbretëreshë) (1915-2002) e cila në një intervistë dhënë një gazetari anglez para se kjo të rivinte në vitin 2002 në Shqipëri. Kjo

intervistë u botua në atë kohë në revistën angleze “Style”, nën titullin “Kthimi i Mbretëreshës”. Ajo i deklaroi gazetarit se Mbreti Zog i kishte thënë që: “Ajnshtajni ka ardhur në Shqipëri, është takuar me të dhe ka marrë pasaportë shqiptare”. Ajo nuk përcaktoi datë, por shtypi shqiptar i asaj kohe (2002) shkroi se kjo kishte ndodhur më 1938, duke e lidhur gabimisht me vitin e martesës së saj në Shqipëri. Historikisht dihet që Ajnshtajni udhëtoi për të fundit herë nga Southemptoni (Angli) në Amerikë në tetor të vitit 1933.

Teza bazë e autorit të monografisë është ajo e një qëndrimi ilegal, të fshehtë të Einstein-it në Shqipëri, sado që në kronografinë zyrtare të jetës së Einstein-it nuk gjendet asnjë e dhënë për një udhëtim të mundshëm të tij në Shqipëri dhe për zotërimin e një pasaporte shqiptare. Për autorin e monografisë në këtë mes “Marrin rëndësi në mënyrë të veçantë disa burime që përshkruhen në 'Guide to the Papers of Herman Bernstein (1876-1935) 1899-1935', RG 713 (Regest nr. 713). Sipas këtyre të dhënave, në arkivat e ministrit të atëhershëm fuqiplotë të SHBA në Tiranë, pikërisht në vitet 1930-1933 gjenden dokumente që përmbajnë nota diplomatike për veprime rutinore konsullore, ose për dhënie vizash apo lehtësim procedurash vistimi”, - shkruan Sh. Sinani. Por, sipas tij, mbi të gjitha e përforcon argumentin e mundësisë së një vizite të fshehtë të Einstein-it në Shqipëri letërkëmbimi i ambasadorit Bernstein personalisht me të dhe interesimi i shprehur zyrtarisht prej këtij të fundit për ardhjen e tij në Shqipëri, interesim i shprehur edhe për një tjetër personalitet amerikan me një rol historik në fushën e edukimit, Charles Telford Erickson. Në të mirë të kësaj mundësie autori sjell një fotografi të nobelistit Albert Einstein me ambasadorin amerikan Herman Bernstein, të marrë nga arkivi i viteve 1928-1934 i Bernshtajn-it, kur ky i fundit ishte ambasador i Amerikës në Shqipëri.

Në të mirë të kësaj autori shton edhe se “Në koleksionin e fotove të periudhës së shërbimit të tij (SG. ambasadorit Berstein) diplomatik në Shqipëri gjendet, krahas A. Enistein-it, ndër të tjera edhe një prej dy miqve të tij të tjerë shumë të rëndësishëm jo vetëm për mbrojtjen e hebrenjve para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, por edhe në themelimin e shtetit të Izraelit: Judah Leon (Leib) Magnes dhe Chaim Weizmann”, - argumenton Sinani, ndërsa fokusohet pikërisht në arkivat e ambasadorit Bernstein, si një prej burimeve kyçe ku duhen vijuar hulumtimet.

Përkundër mungesës së dokumenteve të shkruara, autori dr. Shaban Sinani ngul këmbë se Ajnshtanji do të ketë qenë ilegalisht, incognito në Shqipëri. Një mbështesë për këtë autori e gjen tek vendimet e Lidhjes së

Kombeve të viteve 1921 dhe 1926, të cilat e ngarkonin Shqipërinë për të dhënë dokumentacion identifikimi për hebrenjtë.

Së dyti, ishte lidhja me dr. Bashon, i cili mund ta bënte këtë punë pa probleme duke ruajtur fshehtësinë, për shkak të pozicionit të tij në atë kohë, pozicion që u përmend më sipër.

- A e ka përmendur Ajnshtajni apo biografët e tij "historinë e tij shqiptare"? Nga sa kam lexuar dhe mundur të hulumtoj unë: - Jo, veç duhet ditur që jeta e tij ka kaluar nëpër vështirësi të shumta, ndaj jo më kot vetë ai ka shkruar: "Më duhen shekuj që të përshkruaj peripecitë e pafund të jetës sime".[50]

Qëndrimi incognito dhe pajisja e A. Einstein-it me pasaportë të Shqipërisë është kontestuar kohëve të fundit nga Barbara Wolff - arkiviste në arkivin Albert Einstein në Hebrew University të Jerusalemit. Në artikullin e saj "A ishte Einstein-i shqiptar", të botuar në të përditshmen zvicrane *Berner Zeitung* ajo, duke e marrë për shkas filmin dokumentar Rescue in Albania përkitazi me shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri, të autorëve kosovarë Dardan Islami e Alush Gashi, që ishte xhiruar në vitin 2009 të shfaqur në Bern me rastin e jubileut të 100-të të shtetësisë së Shqipërisë.



Faksimil i pasaportës zvicerane të A. Einstein-it

[50] Admirina, Peçi: në http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/344519/titulli/Shaban-Sinani-Si-u-priten-hebrenjte-ne-Shqiperi më 02/11/2009 dhe në http://www.revistakuvendi.net/Publicistike/207.html

Që në krye të shkrimit të saj, autorja këmbëngul se "Einstein nuk ka qenë asnjëherë në Shqipëri dhe nuk ka pasur kurrë pasaportë shqiptare." Kjo sepse, sipas gazetës, Einsteini gjatë gjithë kësaj kohe ka mbajtur pasaportë zvicerane deri në vitin 1940 kur e mori shtetësinë amerikane. Në vazhdim, autorja sqaron se "Strehimi në Shqipëri i Albert Einstein-it, rrugës për në SHBA, për të shpëtuar nga deportimi nazist, është një pohim i përhapur shumë, sidomos viteve të fundit jo vetëm ndër shqiptarët. Përveç gazetave, filmave dokumentarë etj. rreth këtij qëndrimi janë bashkuar edhe shkencëtarë seriozë, përfshirë madje edhe qendra të ndryshme e revista hebraike në botë. Ndërkaq, gazeta "Berner Zeitung" në një artikull të zgjeruar provon të hedhë poshtë këtë tezë, duke konsultuar burime relevante, kryesisht biografë zyrtarë të Einsteinit, etj.

"Një film dokumentar shqiptar tregon se si civilët shqiptarë kanë shpëtuar shumë hebrenj nga deportimi drejt vdekjes së sigurt. Ai është shfaqur kohë më parë edhe në Bernë në përkujtim të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë", shkruan "BZ" për filmin "Rescue in Albania (Shpëtimi në Shqipëri).

Por në një aspekt, sipas gazetës, ky film dhe një pjesë e historiografisë dhe publicistikës shqiptare, madje dhe botërore, çalon. Është fjala për pohimin që dëgjohet edhe në filmin e përfolur se "në vitin 1935 edhe Albert Einstein përfitoi nga mikpritja shqiptare, për të kaluar nga Evropa në SHBA. Ai ka qëndruar tri ditë në Durrës, në rezidencën mbretërore, para se të vazhdonte me anije rrugën e tij për në botën e lirë. Gjithë këtë rrugë ai e bën i pajisur me pasaportë shqiptare", thuhet në filmin e përmendur, pa u cituar ndonjë burim.

Mirëpo, vazhdon gazeta, ky pohim i dëgjuar në film është një mit që qarkullon prej vitesh në internet dhe ka njohur një përhapje të madhe. Ai, pa iu verifikuar vërtetësia, është përdorur herë pas here edhe nga gazeta serioze. Në vitin 2004, Shaban Sinani, profesor historie dhe ish-drejtor i Arkivit Shtetëror të Shqipërisë, në një punim mbi shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri shkruan si vijon:

"Nga burime të tërthorta kuptohet se në atë kohë, shkencëtari i famshëm hebre Albert Einstein kishte ndaluar inkognito në Shqipëri".

Kjo fjali pastaj është marrë nga historianët tjerë shqiptarë dhe është parë më vonë edhe në revistën religjioze "Glaube in der 2.Welt" ose në një shkrim të revistës mujore të Berlinit "Jüdische Zeitung", që bën fjalë për hebrenjtë në Kosovë. Edhe "Jüdische Allgemeine" në një mënyrë më të përgjithësuar ka shkruar rreth kësaj në vitin 2009: "Madje edhe vetë Albert Einstein duket të ketë qëndruar inkognito në Shqipëri". Ndërsa gazeta "Welt" e vitit 2011 shkruan: "Është e vërtetë se Albert Einstein në

vitin 1935 ka ikur në Amerikë me një pasaportë shqiptare, të cilën ai e ka marrë gjatë një qëndrimi të shkurtë në Mbretërinë e Shqipërisë".

A ka qenë pra Einstein në atë kohë të errët në Shqipëri? – shtron pyetjen gazeta "Berner Zeitung". "Kjo gjë përjashtohet", thotë Barbara Wolff për gazetën. Wolff, për shkak të thashethemeve që qarkullojnë, i ka hyrë edhe njëherë verifikimit me themel të qëndrueshmërisë së mitit shqiptar të Einsteinit. Për këtë eksperte të Einsteinit është e qartë: "Pas vitit 1933, Einstein me siguri nuk e ka shkelur tokën shqiptare dhe Einstein nuk ka pasur kurrë pasaportë shqiptare".

Në vitin 1935, periudhë kjo për të cilën pretendohet që ai të ketë qenë në Shqipëri, shkencëtari i madh kishte kohë që ndodhej në SHBA. Barbara Wolf lidhur me këtë thotë: "Einstein në tetor të vitit 1933 udhëton në SHBA, si turist, me pasaportë zvicerane. Në këtë kohë ai e kishte dorëzuar pasaportën gjermane. Në fakt në vitin 1934 Einsteinit i qe revokuar shtetësia gjermane".

Edhe Hans-Rudolf Ott, kryetar i Shoqatës "Einstein" në Bernë përjashton kategorikisht "intermecon shqiptare" të Einsteinit. "Albert Einstein në tetor 1933 ka braktisur Evropën përmes Southampton-it dhe ka udhëtuar me anije për në SHBA. Deri në vdekje ai nuk është kthyer kurrë më në Evropë."

6. PËRPJEKJET E SHQIPTARËVE PËR SHPËTIMIN E NORBERT JOKLIT

I lidhur ngushtë (edhe) me evakuimin e hebrenjve në Shqipëri është edhe fati tragjik i Norbert Jokl-it, i cili për 35 vjet me radhë qe profesor për albanologji dhe bibliotekist i Bibliotekës Universitare të Vjenës, por që u deportua në moshën 65-vjeçare më 6 maj 1942 për në Maly Trostinec (të Ukrainës), ku, bashkë me shumë hebrenj të tjerë u mbyt me gaz helmues.

Përpjekja e parë e Joklit për t'i shpëtuar deportimit ishte paraqitja nga ai në vjeshtë të vitit 1939 e kërkesës për njohjen e "statusit të mulatit të shkallës 1"- kërkesë kjo që u refuzua. Ka arsye të besohet se ky refuzim mund të ketë lidhje me qëndrimin e tij të prerë të shfaqur në përgjigjen një shkrese zyrtare të dt. 19 prill 1938, të cilës Jokli iu përgjigj shkurt e në mënyrë lakonike: "Në shkresën Tuaj të dt. 9 prill, e cila për shkak të adresës së gabueshme më arriti me vonesë, e ndjej veten të nderuar të sqarohem: Unë nuk jam arian dhe i takoj Bashkësisë Fetare Hebraike. Me respekt. ..".

Pas refuzimit të kërkesës për njohjen e statusit prej mulati të shkallës së parë, Jokli u përpoq që me ndihmën e kolegëve të tij shkencëtarë e

bibliotekistë ta gjente një mundësi për t'u arratisur jashtë shtetit. Por edhe përpjekjet e miqve dhe të kolegëve të tij, si p.sh. ato të linguistit të njohur të Kopenhagës Holger Pedersen dhe ato të profesorit italian Carlo Tagliavini nga Padova mbetën shterp. Madje edhe intervenimi i ministrit të punëve të jashtme dhe dhëndrit të Musolinit, kontit Ciano tek ministria e punëve të jashtme në Berlin për lejimin e udhëtimit të Joklit për në Shqipëri u refuzua.[51]

Profesioni i tij si bibliotekist, udhëtimi i tij për në Shqipëri, në vitin 1937 e pikërisht me rastin e 25-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, me ç'rast Jokl u nderua nga shteti shqiptar me çmimin "Urdhni i Skënderbeut".; fama dhe ora e mirë që e kishte në Shqipëri ishin për të shpresa e fundit.

Për sa u përket përpjekjeve të qeverisë së shtetit shqiptar për ta shpëtuar N. Joklin nga deportimi, te I. Maksuti gjejmë të dhënat sipas të cilave [...] "Në një letër të dt. 16 tetor 1941 të ministrit të arsimit në qeverinë e atëhershme shqiptare Ernest Koliqi, drejtuar konsullit shqiptar Nikollë Rrota në Vjenë, thuhet se ky e ka angazhuar N. Joklin për organizator të bibliotekave të Shqipërisë me një rrogë mujore prej 600 frangash ari. Jokl planifikonte të shkonte në Shqipëri e ta merrte me vete edhe bibliotekën e tij personale, të cilën pas vdekjes dëshironte t'ia dhuronte ministrisë së arsimit të Shqipërisë.[52] Mirëpo këtij nuk iu dha leja e udhëtimit.

Duket se mosangazhimi i autoriteteve austriake për shpëtimin e Joklit ishte rezultat i rivalitetit midis Fakultetit Filozofik dhe e Bibliotekës Nacionale në Vjenë, (drejtuesit e të cilave duket se ishin të informuar mirë për deportimet e kryera për në Lindje) se cila nga këto do ta trashëgonte bibliotekën e pasur personale të N. Joklit. Kjo shihet qartë në një letër të cilën dekani i Fakultetit Filozofik Viktor Christian, tri ditë pas arrestimit të Joklit më 7 mars 1942 ia dërgonte "SS-Hauptsturmführer"-it drejtues i Zyrës Qendrore për Emigruesit [sic!], thuhet: "Siç po marr vesh, Dr. Norbert Jokl nga Vjena, dikur profesor inordinar në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Vjenës, do të deportohet në cilësinë e tij si hebre" dhe edhe se "gjoja paska përpjekje nga ana e qeverisë italiane, që Norbert Joklin - bashkë me bibliotekën e tij - t'i sjellin në Shqipëri.[...] "Nëse ndodh që Joklit nuk i jepet leja e udhëtimit për në Shqipëri, porse

[51] Sh. Skënder Gashi, Biblioteka e pasur - shkak i likudimit (Të dhëna të reja përkitazi me likuidimin e Norbert Joklit dhe fatin e bibliotekës së tij).

[52] Izer Maksuti: Norbert Jokl - Figurë e shquar e albanologjisë të publikuar në *www*.illyria.de - Albanischer Studentenverein - Unioni i Studentëve Shqiptarë - Hamburg,

qo do të deportohej për në Poloni, Ju lutem që bibliotekën e tij t'ia jepni pa një pa dy Fakultetit filozofik".[53] Vetëm disa ditë më vonë, më 4 maj 1942, drejtori gjeneral i Bibliotekës Nacionale, Dr. Paul Heigl i drejtohej me një shkresë ministrit gjegjës në të cilën thoshte se këtij na i paska rënë në veshë, që dekani Christian paska "konkuruar për t'iu dorëzuar atij biblioteka e konfiskuar e hebreut Dr. Norbert Jokl". Ky na qenka i mendimit që "bibliotekat e specializuara si kjo nuk do të bënte t'i dorëzohej në tërësi një seminari, sepse shumëçka nga ai material i vlefshëm nuk do të mund të shfrytëzohej nga opinioni i gjerë [...]".

Duke e pasur parasysh sigurimin e literaturës për shqipen dhe "në interes të opinionit të gjerë dhe të shërbimit në rritje të shkëmbimit" ky lutej që "e gjithë biblioteka e Joklit t'i jepej Bibliotekës Nacionale [...]". Duplikatet e rastësishme, merret vesh, Biblioteka Nacionale do t'ia jepte Bibliotekës Universitare, përkatësisht Institutit të Orientalistikës.

Kontribut me peshë në rrafshin e angazhimit të intelektualëve, të klerit katolik e të politikanëve shqiptarë të kohës për shpëtimin e N. Joklit për ta strehuar atë në Shqipëri, sjell shkrimi i Kolec Çeftas,[54] pjesën më të madhe të të cilit po e sjell më poshtë:

"Në "Shejzat", "numer perkujtimuer" kushtuar 74-vjetorit të lindjes së prof. Ernest Koliqit, Messing ka dhanë një Memorandum mbështetë mbi një deklaratë të Kolë Rrotës, ish-Konsull i Shqipnisë dhe lektor në Universitetet në lidhje me vdekjen e profesor Joklit, ku bahet fjalë për kërkesën e Joklit shpreh Kolë Rrotës, që të merrej vesh me autoritetet shqiptare, nëse do të ishte e mundun të transferohej në Shqipni, për emnimin e prof. Joklit si administrues i bibliotekës shqiptare me një rrogë mujore 600 franga ari, për burgosjen e vdekjen e tij, për kërkimet për të gjetë se ku gjindej biblioteka e pasun e dorëshkrimet e Joklit. (Ma gjatë lexo: "Shejzat" numer perkujtimuer).

Nga bisedat e dikurshme e të shumta me Pader Justin Rrotën, mbaj mend edhe një fakt tjetër mendoj i panjohun: "Kur më 1938 filluen përndjekjet naziste kundër çifutenve në Austri, françeskanët me Fishtën, Justinin në bashkëpunim me Kolë Rrotën u përpoqën ta tërhiqnin Joklin në Shqipni. Ideja e Fishtës, në fillim, ishte ta mbante Joklin në Kuvendin Françeskan. U ba gati edhe dhoma, njashtu si u mbajt Luigj Gurakuqi në periudha të vështira të jetës, sidomos gjatë viteve 1921-1923. E synuen t'i nxirrej nënshtetësia shqiptare. Pastaj ky variant u ndryshue, nderhyn edhe Koliqi e të tjerë, por ngjarjet precipituen shpejt dhe Jokli u arrestue".

[53] Sh. Skënder Gashi, Biblioteka e pasur - shkak i likudimit...

[54] Një letër e pabotueme e Fishtës në mbrotje të Joklit, e publikuar tek Trepca.net 25 gusht 2003.

Shumë vite ma vonë, më 1950, në një letër të Kolë Rrotës, dërguar Justinit, lexojmë: "Sa për zhdukjen e të ndjerit prof. Joklit në vjetin 1942, po të diftoj se unë atëherë jam mundue me gjithë shpirt me e shpëtue prej thojve të nazistave. Shkurt, ky mbaroi në Minsk, po ashtu si u banë therorë miliona e miliona njerëzish tue u helmue me gaz". Edhe në korrispondencën me Kolën, të vëllanë, edhe me Lambercin, Justini asht interesue për dorëshkrimet e Joklit, veçanërisht për "Fjalorin etimologjik" si edhe për bibliotekën e tij.

Po japim një letër të panjohun e të pabotueme të Fishtës,[55] drejtue Françesko Jakomonit, më 23 shtator 1939, shkrue në emen të të gjithë intelektualëve shqiptarë, me të cilën, pasi shpreh vlerësimin ma të naltë për Joklin, shfaqë dëshirën që të gjindet mundësia me ardhë Jokli në Shqipni, në ndonjë nëpunësi, të përshtatshme me famën e tij, si shkencëtar e gjuhëtar i shquem.

Shkodër, 23 shtator 1939

Shkëlqesi,

Mendoj se ma i miri gjuhëtar i gjuhës shqipe në Evropë, asht profesor Norbert Jokli, me kombësi çifute që, para Anshlusit, ishte bibliotekar i Universitetit te Vjenës e profesor gjuhësie në të njajtin universitet.

Tashti, më shkruejnë nga Vjena, se autoritetet lokale i kanë thanë këtij albanologu të shquem të largohet, brenda 30 ditësh, prej territorit të Raihut.

Ai, tashma, asht i ndrymë, beqar, me një fat mjaft modest. Atij, natyrisht, i duhet të rropatet me gjetë ndonjë vend, kudo të jetë, sa me jetue. Duket se don me shkue në Amerikë.

Shkelqesi, pa dyshim, do të ishte një fatkeqësi e madhe për gjuhën kombëtare shqipe, në qoftëse ky shkencëtar, me famë europiane, që unë e njoh e që, me autoritetin e tij të padiskutueshëm, ka mbajtë gjatë interesin e filologëve ma të përmendun për gjuhën shqipe, të jetë i shtrënguem me braktisë Europën.

Kombi shqiptar, i tani, do t'ju dijë për nder shumë, nëse Shkëlqësia e juej të mund të gjejë mundësinë ta bajë me ardhë në Shqipni, tue i caktue aty një vend, edhe pse jo aq fitimprurës, megjithatë të përshtatshëm për famën e tij si shkencëtar e gjuhëtar i shquem.

Jam i sigurt se do ta merrni në konsideratë dashamirëse këtë propozim timin, që unë e paraqes në emen të të gjithë intelektualëve shqiptarë.

[55] Tani mësohet se Gjergj Fishta kultivonte raporte të mira edhe me aambasadorin amerikan Bernstein në Shqipëri. Elez Biberaj zbuloi në Ivo Institut për Kërkime Hebreje një letër të Gjergj Fishtës, të shkruar për amasadorin, më 27 maj 1933 me rastin e botimit të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Kjo letër u botua në gazetën "Dielli". sipas Ilirian Agolli, Libri "Pavarësia" i Elez Biberajt, Zëri i Amerikës, e premte, 16 nëntor 2012.

Përfitoj nga rasti, për t'Ju lutë të pranoni ndjenjat e respektit ma të madh dhe me mirënjohje të thellë.

I Shkëlqesisë suej
i devoçëm e mirënjohës
P. Gjergj Fishta OFM
Shkelqesisë së tij
Françesko Jakomoni, Luogotenente

7. HEBRENJTË E KOSOVËS: TË MBROJTUR APO TË DORËZUAR?

Sado që, vështruar historikisht - që nga shek. III e deri në atë XX të erës sonë - hapësira etnolinguistike e shqiptarëve dëshmohet për zonë në të cilën hebrenjtë jo vetëm gjetën strehim, porse edhe që u pranuan pa rezerva e pa paragjykime dhe përkundër faktit që nuk ka asnjë dëshmi për ndonjë përndjekje të hebrenjve nga hapësira e gjithmbarshme etnoglotologjike e shqiptarëve, kjo e vërtetë vihet në dyshim për periudhën e mbarsur me dhunë të Luftës së Dytë Botërore.

Fati i hebrenjve të hapësirës së sotme të Kosovës dhe të Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht ruajtja apo zhdukja fizike e tyre duhet dhe është trajtuar në varësi se në cilën nga tri zonat e Kosovës së pushtuar: në atë nga nazistët gjermanë; nga fashistët italianë apo në atë nga fashistët bullgarë jetonin pjesëtarët e bashkësive hebraike. Sikundër dihet, "pjesa jugperëndimore e Kosovës, e banuar me shumicë nga shqiptarët, me qytetet Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe regjionet përreth ishin në vitet 1941-1943 nën protektoratin italian, përkatësisht pjesë e "Shqipërisë së Madhe". Sado që qeveria "kuislinge" e Shqipërisë ishte edhe qeveri e pjesës nën protektoratin italian të Kosovës, të dhënat historike nuk tregojnë se kjo qeveri as në Shqipëri e as në Kosovë do t'ua ketë dorëzuar italianëve apo gjermanëve listat e qytetarëve hebrenj të këtyre hapësirave. Pjesa veriore e Kosovës e banuar me shumicë serbe si Mitrovica e Trepça të cilave ia kishin bashkëngjitur edhe Podujevën me rrethina, ishin nën administrimin ushtarak gjerman, ndërsa Gjilani, Vitia dhe regjioni i Kaçanikut ishte pushtuar nga bullgarët. Që nga 8 shtatori i vitit 1943 e gjithë "Shqipëria e Madhe" u pushtua nga gjermanët.[...][56]

[...] Gjendja e hebrenjve në pjesën veriore të Kosovës nën pushtimin gjerman ishte shumë më e vështirë se ajo e hebrenjve në "Shqipërinë e

[56] Albert Ramaj: Rettung von Juden in Albanien. ..

Vjetër"; e ngjeshur me më shumë rreziqe se sa ajo e hebrenjve në pjesën jugperëndimore të Kosovës që ishte pjesë e "Shqipërisë së Madhe". Pjesa më e madhe e hebrenjve të pjesës veriore të Kosovës, përkatësisht hebrenjtë e qytetit të Mitrovicës tentonin të iknin në pjesën e quajtur "Shqipëri e Madhe" të Kosovës dhe prej aty në "Shqipërinë e Vjetër". Shumicës së hebrenjve të pjesës veriore të Kosovës u punoi fati falë rrethanës që organet përgjegjëse për çështje të kufirit u lëshonin hebrenjve pasaporta shqiptare me emra fiktivë. Për të mbijetuar, këtyre refugjatëve u erdhën në ndihmë hebrenjtë vendës në pjesën kosovare të "Shqipërisë së Madhe" dhe në "Shqipërinë e Vjetër". Këtë mundësi provuan ta shfrytëzonin madje edhe shumë hebrenj të Serbisë (kryesisht sefardinë) që banonin në Beograd dhe sish të Kroacisë duke shpresuar edhe këta se, duke u vendosur përkohësisht në Veri të Kosovës, do të mund të kalonin në Shqipëri.[57]

Sipas rezultateve të studimit të Dr. Apostol Kotani-t[58] "Autoritetet në vend se t'i përmbushnin kërkesat e gjermanëve, u preferuan hebrenjve (kosovarë) që të shkonin në Shqipëri. Që nga prilli i vitit 1942 për në Shqipëri shkuan rreth 500 hebrenj. Kontigjenti i parë shkoi në Berat, kontigjenti i dytë prej 195 hebrenjsh shkoi në Kavajë, ndërsa kontigjenti i tretë prej 175 hebrenjsh shkoi në Krujë. Në krye të herës, njerëzit (S.G.: ebreitët) u strehuan në qendra strehimi. Kur kolaboracionistë të nazimit, siç ishte p.sh. mjeku fanatik Spiro Liton-i, tentuan t'i kontrollonin këto qendra strehimi me qëllim që (hebrenjtë) e strehuar t'ua dorëzonin nazistëve, mjeku (Spiro Liton-i) u likuidua.

Hebrenjtë në Prishtinë

Për fatin e hebrenjve të ardhur në ndërkohë në Prishtinë mësohet nga një punim i Apostol Kotanit.[59] Aty, ndër të tjera thuhet: "Në vitin 1941 Kosova u nda më dysh: deri në Mitrovicë sundonin nazistët, kurse nga Prishtina e këndej sundonin italianët. Izraelitët e viseve të tjera të pushtuara nga nazistët si Zagrebi, Mitrovica, Tetova, Shkupi etj. u grumbulluan në Prishtinë. Aty, tregon Zhulia Kantozi, njëra prej izraeliteve, kishte rreth 2000 vetë. Kur erdhën gjermanët në Mitrovicë dhanë urdhër që të gjithë izraelitët të viheshin në gjendje arresti, dhe të përqendroheshin në kampe dhe t'u dorëzoheshin autoriteteve gjermane të pu-

[57] Po ai, po aty

[58] Cit. sipas Max Brym, Historische Debatte in Kosova/Kosovo: Die Juden in Kosova und Albanien, http://www.hagalil.com/archiv/2004/05/kosova.htm

[59] Sh. Disa të Dhëna mbi qëndrimin dhe trajtimin e izraelitëve në Shqipëri, "Studime Historike", 4/1990 (Tiranë), f. 47

shtimit. Ndër izraelitët dhe popullsinë shqiptare të Prishtinës u dha alarmi. Menjëherë përfaqësues të shqiptarëve shkuan në karabinierinë italiane, që tregoheshin më tolerues, dhe iu lutën që të mos i dorëzonin, por t'i transferonin në Shqipëri dhe, kështu u veprua. Vetëm 50-60 vetë nuk mundën të shpëtonin dhe ranë në duart e nazistëve, kurse një pjesë e madhe e tyre shpëtuan në rrugë të ndryshme." [...]

"Një grup tjetër prej rreth 300 vetësh, tregon Zhulia Kantozi, (SG.: në një anketë të v. 1968) u nisën (SG: nga Prishtina) me makina për në Shqipëri. Në fillim ata u alarmuan pasi u kishin folur keq për shqiptarët, si njerëz të egër që për një fjalë të therrin pa një pa dy. Por, kur u sqaruan, u pushtuan nga një ndjenjë e madhe gëzimi, dikush nxori edhe një flamur shqiptar dhe filluan të brohorisin për Shqipërinë." [...]

"Një grup tjetër prej rreth 50-60 vetësh, tregon doktor Spiro Lito, që rrezikoheshin të binin në duart e nazistëve, u shpëtuan gjithashtu prej shqiptarëve në një rrugë tjetër. Një oficer italian, me ide socialiste njoftoi doktor Liton që shërbente në spitalin e Prishtinës se gjermanët donin t'i merrnin e t'i dërgonin në kampet e shfarosjes. Njoftime erdhën edhe nga shumë shqiptarë, (SG. të Prishtinës) bile edhe nga ndonjë njeri me përgjegjësi në pushtet. U kërkua që të bëhej çmos për t'i shpëtuar. Pasi u pleqërua problemi me urgjencë, u vendos dhe u organizua një vizitë mjekësore ndër ta dhe u sajua se ata ishin të prekur nga tifoja e morrit dhe duhej të largoheshin menjëherë për të mos infektuar të tjerët."

Megjithëse kishte konstatuar se shqiptarët janë populli më pak nacionalist në Ballkan dhe se njësoj si zviceranët, kurrë s'kanë bërë lufta pushtuese; s'kanë përndjekur kënd për arsye race, përkatësie etnike, feje,[*] autori amerikan Bernd J. Fischer[60] e sheh fort më ndryshe çështjen nëse autoriteteve naciste iu dorëzuan hebrenjtë të Kosovës. Ky shkruan: "Hebrejtë e Kosovës - ose të "Shqipërisë së Re", siç u quajt nga shumë veta gjatë luftës - qenë të pa fat. Shumë hebre nga Kroacia dhe Serbia kërkuan strehim në Kosovë. Megjithëse në fillim u trajtuan mirë, shumë hebre u kthyen në fund në Beograd ku dhe u ekzekutuan. Edhe italianët përmbushën kërkesat gjermane në Kosovë, duke hartuar listat e hebrenjve. Për pasojë shumë prej hebrenjve u arrestuan dhe të tjerë u dërguan në Shqipëri me marifete të ndryshme, duke përfshirë, me sa duket, faktin se ata kishin tifon dhe se kishin nevojë të dërgoheshin në një spital në Shqipëri. […] Ata që ishin me fat për t'u përfshirë në këtë grup

[*] Sipas Mehmet Elezi, Ambasador i Republikës së Shqipërisë, Bernë, 100 vjet pavarësi: Shqiptarët në anën e fitimtarëve, në Alb, Info, 28/11/2012

[60] Sh. Hebrejtë e Shqipërisë gjatë periudhës zogiste dhe Luftës së Dytë Botërore, i botuar edhe në shqip tek http:albanisches-institut.ch/pdf/tex9pdf

pothuajse u liruan menjëherë. Por shumë të tjerë nuk ishin me aq fat. Divizioni SS Skanderbeg, të cilin e organizoi Himmler-i në Kosovë në pranverë të vitit 1944, arrestoi 281 hebre dhe i dërgoi në një kamp në Prishtinë para se ata të transportoheshin për në Reich. Të tjerët iu shtuan atyre më vonë, nga 400 hebre që u dërguan në kampin e përqendrimit të Bergen-Belsen, vetëm rreth 100 prej tyre mundën të mbijetojnë. […] Autori ynë thotë se "Në analizën përfundimtare, 100% e hebrenjve të Shqipërisë mbijetuan nga lufta - madje edhe 60% e hebrenjve të Kosovës gjithashtu e mbijetuan Luftën (khs. më lart).

Arsyet e mosshpëtimit të paravenduar të hebrenjve të pjesës së hapësirës së Kosovës, që asokohe nuk ishte në përbërje të "Shqipërisë së Madhe", autori kosovar A. Ramaj i sheh tek rrethana që "pas shprishjes së Perandorisë Osmane, Principatës së Serbisë iu fal, si trofe lufte, Kosova e banuar kryesisht me shqiptarë dhe, si edhe në shumë shtete të Europës Perëndimore, edhe në Principatën e Serbisë u aprovuan "ligje për racat" të cilat kishin të bënin kryesisht me hebrenjtë e me romët. Përkeqësimin e gjendjes së hebrenjve në kuadrin e Mbretërisë Serbe-Kroate-Sllovene e tregon edhe rrethana që edhe kryerabini Isak Alkalaj u shtërngua që, në vitin 1938, të largohej nga parlamenti i Serbisë.[61]

Për ta "zbutur" këtë krim, në stilin e thënies popullore shqiptare "majma lulakun t'i thom qasaj (që fëmijën) e ki kopil" historiografia serbe ua atribuon edhe kosovarëve të pjesës veriore të atdheut të tyre dorëzimin tek autoritetet pushtuese gjermane të bashkëqytetarëve të tyre hebrenj. Autori kosovar Albert Ramaj pohon që "Faji për dorëzimin e hebrenjve të pjesës veriore të Kosovës tek nazistët gjermanë duhet t'u ngarkohet nacionalistëve shqiptarë e serbë. Rol të neveritshëm luajti në këtë mes organizata nacionaliste serbe "Zbor", që në vitin 1925 ishte themeluar nga Dimitrije Ljotić. Popullata hebraike e Serbisë dhe ajo në veriun e Kosovës lëngoi në mënyrë të veçantë në kohën e aktivitetit të gjeneralit Milan Nedić. Gjithashtu i lartë ishte rrezikimi i hebrenjve gjatë kohës së regjimit *ustaš* në Kroaci (1941-1945) kur shumë hebre u likuduan në kampin e njohur kroat të përqendimit në Jasenovac i quajtur simbolikisht "Auschwitz-i i Ballkanit".

Për aktor të viktimizimit të bashkëqytetarëve hebrenj të kosovarëve, historiografia serbe e fajëson Divizionin SS "Skanderbeg" të Armëve që me iniciativën e gjermanëve ishte ngritur në mars të vitit 1944, pas kapitullimit të Italisë, kur gjermanët e kishin pushtuar gjithë Shqipërinë. Aktivitetet e Divizionit "Skanderbeg" (i cili në kohët më të mira kishte

[61] Albert Ramaj, Rettung von Juden in Albanien. ..

9000 trupa) nën udhëheqjen e kosovarit Bedri Pejani, një antisemiti të njohur, ishin orientuar sidomos kundër hebrenjve, serbëve dhe magjupëve (romëve). B. Pejanit dhe divizionit të tij "Skanderbeg" po u bieka faji për deportimin e hebrenjve të Kosovës në kampe të përqendrimit. Në Prishtinë e në Gjakovë (këtu hebrenjtë ishin shqipfolës) brenda pak ditësh qenkan arrestuar rreth 400 hebrenj, shumica e të cilëve mbase do të jenë vrarë. Çështja se sa hebrenj saktësisht iu dorëzuan gjermanëve nga divizioni "Skanderbeg" është e diskutueshme. Sipas Dželetović-Ivanov fjala është për 400 sish, ndërsa sipas Noel Malcolm-it, i cili mbështetet në të dhënat zyrtare të vetë B. Pejanit, rreth 281 hebrenj. W. Oschlies, nga ana tjetër, konstatonte që në gjithë Kosovën në vitin 1941 kishte 550 hebrenj. Deri në vitin 1945 nga këta qenkan vrarë 210 ose 38.18% e tyre.[62]

Korrektësinë e shifrës 281 të hebrenjve të dorëzuar nga kosovarët, të dhënë nga historiografia serbe e nga Noel Malcolm e gjeta tek kopja e raportit sekret të dt. 2 tetor 1944 përkitazi me ngritjen dhe gjendjen e Divizionit 21 të armatosur malor SS "Skanderbeg" të shqiptarëve, të cilin tani e kam në tavolinën e punës. Ky dokument është një raport që në kohën e hartimit dhe të shpërndarjes (10 tetor, 1944) në instancat kompetente të Wehmacht-it gjerman ishte sekret. Me kohë porse ishte zbuluar nga shërbimi sekret britanik. Dokumenti është gjetur para disa vitesh në një arkiv të Zvicrës. Është i evidentuar nën: "Div. St., Qu, më 2.10.1944; Ia Tgb.-Nr. 175/44 g. Kdos". Komandanti gjerman i Divizionit (August Schmidhuber) njoftonte tekstualisht se në Kosovë "Përmes dy aksioneve në befasi, Divizioni ndërmori arrestimin e të gjithë hebrenjve (281 sish) dhe asgjësimin e një organizate komuniste shumanëtarëshe e cila përmbante 210 funksionarë komunistë", ndërsa në një shkrim tjetër përkitazi me këtë Divizion thuhet se "Hebrenjtë e Kosovës, nëse nuk mundën të iknin u arrestuan dhe u deportuan në Kampin e Përqendrimit Bergen-Belsen. Nën patronatin e kësaj njësie (S.G. Divizionit SS "Skanderbeg") ishte një kamp në Shkup, në të cilin u sollën hebrenjtë para se të transportoheshin në kampe gjermane të përqendrimit."

Komandanti Schmidhuber i Divizionit jepte për Bedri Pejanin vlerësimin: "Premtimet e kryetarit të atëhershëm të Komitetit Kombëtar në Prizren, Bedri Pejani, të cilat ai edhe me shkrim ia parashtroi Führer-it të SS të Reich-ut, (= Himmler-it, vër e përth.) nuk qenë asgjë tjetër përpos premtim fjalamadh i kalibrit shqiptar. Bedri Pejani vetë, i cili në ndërkohë u shkarkua nga ministri i tij i punëve të bredshme Deva, është

[62] Wolf Oschlies Geschichte und Ende der Juden in Serbien www.shoa.de/content/view/218/46/ - 89k

një dallaveraxhi politik i formatit të lartë - cilësi që me artin e politizimit në mërgatë dhe në vend arriti ta ruajë për vete deri në moshën e tanishme të tij të shtyrë, një jetesë të rehatshme në vendin e vet."

Sipas historianëve kosovarë, Myrteza Studenica e Hakif Bajrami, formacionit SS të pushtuesve gjermanë mund t'i jenë dorëzuar shumë-shumë vetëm ndonjë individ apo ndonjë familje hebraike dhe kurrsesi pjesa dërrmuese e hebrenjve të Kosovës.



Kopie aus dem Bundesarchiv

Përmes publikimeve të këtilla, kështu kujton autori kosovar A. Ramaj,[63] synohet që shqiptarët, përkatësisht kosovarët, t'i minimizojnë krimet e asaj kohe. Kjo mbase ka të bëjë, sipas autorit tonë, me rrethanën që në Kosovë ka filluar tani një respekt karshi antisemitëve si Bedri Pejani[*] ose edhe Xhafer Deva (që nga fundi i vitit 1943 ministër i punëve të brendshme i Shqipërisë së Madhe). Në një postim të tijin të kohëve të fundit në facebook, A. Ramaj tregon se nga rreth 3.000 dokumente të nxjerra nga arkiva të Europës përkitazi me divizionin SS "Skanderbeg" paska gjetur dëshmi sipas të cilave në vetëm një qytet të Kosovës brenda 45 ditësh shqiptarët e atij divizioni paskan arrestuar 510 njerëz, midis të cilëve paska pasur hebrenj, komunistë e të tjerë, pa pas dhënë shifra të sakta sa nga ata ishin hebrenj.

Mirëpo vetë hebreu Max Brym[64] vërente për Shqipërinë se "Menjëherë pas pushtimit, nazistët donin që edhe në Shqipëri hebrenjtë të regjistroheshin dhe të deportoheshin. Këta hasën porse, megjithatë, në pengesa

[63] Albert Ramaj: Rettung von Juden in Albanien, www.albansiches-institu.ch

[*] Bedri Pejani u dekorua nga presidentja e Kosovës me "Urdhrin e Lirisë".

[64] Historische Debatte in Kosova/Kosovo. ..

të paparashikuara. Në Shqipëri kishte, sidomos në Jug, një lëvizje të fortë partizane. Kundërshtimi ndaj intervenimit të nazistëve ishte aq i fortë sa që edhe vetë ministri i punëve të brendshme Xhafer Deva, i emëruar në atë post nga nazistët, e zhagiste përpilimin e listave. Ai e dinte, pas gjithë gjasash, se po të vepronte kështu, do të pozicionohej jo vetëm kundër partizanëve, porse edhe kundër ligjeve të Kanunit të shqiptarëve.

Samuilo Mandil, tregtar hebre i ikur nga Beogradi në Shqipëri, botoi më 20.2. 1945 në gazetën "Bashkimi" artikullin "Izraelitët në Shipni" përkitazi me shpëtimin e hebrenjve në këtë shtet. Në këtë artikull ai ua dinte shqiptarëve për nder, që hebrenjtë i kishin fshehur dhe, kësisoj, i kishin shpëtuar. Ky shprehej i habitur se si u bë që madje edhe gjatë vitit 1942 në Shqipëri erdhën hebrenj nga shumë shtete. Nga ky artikull merret vesh se hebrenjtë, edhe në kohën kur Shqipëria ishte nën okupimin e Italisë (1939-1943), kishin mundësi të bënin jetë normale, e cila ndryshoi pas okupimit (3.9.1943) të Shqipërisë nga gjermanët.

Në këtë artikull të tijin Samuilo Mandil përmend se, ndryshe nga ç'u veprua në Shqipëri, autoritetet në Mitrovicë, pra në Kosovën që deri në vitin 1941 i takonte Jugosllavisë, nazistëve iu qenkan dorëzuar 53 hebrenj. Në këtë tekst nuk është thënë shprehimisht nëse ata zyrtarë lokalë ishin eksponentë serbë të Ljotić-it e/ose të Nedić-it apo shqiptarë.

Rrethana që hebrenjtë ishin dorëzuar në Mitrovicë, që asokohe ishte nën sundimin gjerman dhe jo nën Prishtinën e "Shqipërisë së Madhe" të Italisë, flet në të mirë të faktit që ky dorëzim kishte ndodhur në "pjesën gjermane" të veriut të Kosovës, përkatësisht me bekimin e autoriteteve kuislinge serbe të Lotić/it e të Nedić-it. Kjo do të zbardhej edhe në dritën e rrethanës që "Në mbrojtjen e hebrenjve gjatë kësaj kohe ishin angazhuar plot shqiptarë me funksione shteti, si Musfafa Kruja (kryeministër i Shqipërisë së asaj kohe), i cili kishte bërë që shumë hebrenj të largoheshin urgjentisht nga Kosova dhe të strehoheshin në Shqipëri. Në këtë kohë edhe prefektët e Prishtinës, Riza Drini dhe Hysen Prishtina, por edhe shumë të tjerë, ishin angazhuar me tërë qenien e tyre në këtë mision.[65]

Përkitazi me angazhimin e pjesëtarëve të pushtetit të kryeministrit Mustafa Kruja për shpëtimin e hebrenjve vendës e rishtas të ardhur të Kosovës, njofton edhe studiuesi kosovar A. Ramaj. Ky shkruan se edhe (92-vjeçari) Isuf Qolja nga Berati kishte shpëtuar duke u strehuar

[65] Khs. Katrin Boeckh, Von den Balkankriegen zum Ersten Weltkrieg, www. Hagail.com/antisemitismus/osteuropa/jogoslawien.htm

në "Shqipërinë e Madhe" italiane, përkatësisht në Kosovë. Një familje hebraike, e cila tani jeton në München, ishte strehuar dhe shpëtuar nga shqiptarët e Kosovës. (një bir i kësaj familjeje, Max Brym, boton trajtesa përkitazi me hebrenjtë në Kosovë e në Shqipëri). Nga ky studiues mësojmë se sekretari i asokohshëm i komunës së Prishtinës, Preng Uli, falsifikonte dokumente udhëtimi për hebrenjtë e ardhur nga Kroacia, nga Serbia e syresh të Kosovës, për t'ua bërë këtyre të mundshme ikjen për në Shqipëri. Me logon gjerm. *Bussen* të firmës S.A.T.A (Tiranë) ky i sillte pastaj hebrenjtë, me dokumente të falsifikuara si të Shqipërisë, nga Kosova në Shqipëri. Kësi shtegu, u arrit strehimi i jo pak hebrenjve. Kështu, p.sh. në prill të vitit 1942 u arrit që rreth 100 hebrenj të Kosovës të strehoheshin në Berat dhe rrafsh 80 të tjerë në Prezë. Në korrik të vitit 1942 rreth 100 persona që kishin ikur nga një burg i Prishtinës arritën të shpëtonin duke u transferuar në Shqipëri. Një familje shqiptare e rajonit të Deçanit e kishte marrë në mbrojtje një familje hebraike dhe e strehoi këtë deri në fund të Luftës."[66]

Kryeministër i protektoratit italian të "Shqipërisë së Madhe" ishte nga dhjetori i vitit 1941 deri në janar të vitit 1943 Mustafa Merlika Kruja, të cilin italianët e kishin zgjedhur me paramendim për këtë post. Ky, bashkë me sekretarin e tij Engjëll Çoba, bëri shumë për shpëtimin e hebrenjve të Kosovës dhe në pjesën tjetër të Shqipërisë së asaj kohe. Guvernatori i mbretit Vittorio Emanuele III në "Shqipërinë e Madhe", Francesco Jacomoni di San Savino, e lavdëron guximin dhe "burrërinë" e kryeministrit Mustafa Kruja. Jacomini shkruante: "Konzuli i Përgjithshëm/Gjeneral gjerman kishte kërkuar nga ky (M. Kruja) dhe ia kishte drejtuar këtij një notë verbale, përmes së cilës qeveria naziste e kërkonte dorëzimin e më shumë se 300 hebrenjve, të cilët - të arratisur nga Jugosllavia - ishin strehuar në Shqipëri. Komanda ushtarake gjermane në Beograd kishte përpiluar të dhëna të sakta me emrat dhe me vendbanimet e hebrenjve në Beograd. Mustafa Kruja erdhi tek unë dhe më luti që ata, pa asnjë therë në këmbë, të mbeteshin në Shqipëri. Duke qenë se në vend (Shqipëri) nuk kishte as edhe një ushtar gjerman, të cilët do të mund t'i identifikonin hebrenjtë, ne u muarrëm vesh që të gjithë refugjatët hebrenjtë t'i zhvendosim/transferojmë ngutazi në regjionin e Gjirokastrës. [...] Ata (hebrenjtë) do të duhej të merrnin pasaporta shqiptare me emra të

[66] Albert Ramaj: Bedrängte Juden im Kosovo im Zweiten Weltkrieg, G2W -Glaube in der 2. Welt (Ökumenisches Forum für Religion und Gesellschaft in Ost und West) 2/2007 35. Jahrgang, f. 20-21.

rrejshëm dhe, nëse e do nevoja, të ndihmoheshin edhe materialisht. Kësisoj, Mustafa Kruja mundi t'i përgjigjej disa ditë më vonë konsullit të përgjithshëm/gjeneral gjerman, se të gjitha gjurmimet përkitazi me individë me emër e me mbiemër në Kosovë, qenë të pasuksesshme. Jacomini sqaronte në vazhdim se "Përkitazi me gjithë këtë ndodhi ne nuk e kishim njoftuar zyrtarisht Romën, porse thjesht në rrafshin privat […] ambasadorin Luigi Vidau. Ky ishte një njeri me zemër. Me ndihmën e tij ne u përkujdesëm që në përfaqësitë tona në botën e jashtme hebrenjtë në Gjermani, në Bohemi, Poloni, Hungari e në Rumani të merrnin pasaporta. Në këtë mënyrë, ata mundën të silleshin në Shqipëri dhe të ishin të sigurt nga përndjekjet."[67]

8. STREHIMI I HEBRENJVE, SIPAS TREGIMEVE/RRËFIMEVE PERSONALE

a) Në Shqipëri

Përmasat e strehimit të hebrenjve nëpër familje shqiptare në Shqipëri i ka pasqyruar autori hebre Harvey Sarner në librin e vet "Shpëtimi në Shqipëri", kushtuar 120 familjeve shqiptare që gjatë Luftës së Dytë Botërore ua shpëtuan jetën 350 hebrenjve. Me rastin e përkujtimit më 27 janar të "Ditës së Kujtesës" në nderim të viktimave të nazistëve gjatë Luftës së II Botërore dhe Holokaustit, Shqipëria nderoi edhe dhjetëra familje shqiptare që strehuan dhe mbrojtën qindra hebrenj që trokitën në dyert e tyre për të shpëtuar jetën. Njëra ndër to është edhe familja Kazazi në Tiranë, kreu i së cilës, furxhiu Bedri Kazazi, që në pranverën e vitit 1943 strehoi hebreun Daniel Solomon-i, bashkë me bashkëshorten Ester, vajzën Matilda dhe djalin Solomon. Myzafer Kazazi, tani burrë 77 vjeç, shpalos kujtimet që lidhur me këtë ngjarje i mban mend qëkur ishte 10 vjeç. Përveç hollësive të tjera, ky rrëfen se për ta shmangur rrezikun e zbulimit të katër hebrenjve nga nazistët, Kazazët ua kishin ndërruar emrat: "Davidin, kryefamiljarin e thërrisnim Daut, të shoqen, Esterin, e thërrisnim Fatime, Matildën e vogël, Hatixhe, kurse djalit nga Solomon ia vumë emrin Memo". Familja hebraike e David Solomonit u largua nga Shqipëria për në Izrael pas mbarimit të luftës.

[67] Khs. www.albanisches-institut.ch: Francesco Jacomoni di San Savino: La Politica dell' Italia in Albania. Bologna 1965, f. 288-289 cit. sipas Albert RAMAJ: Bedrängte Juden im Kosovo im Zweiten Weltkrieg. ..

Shpëtimtari i tyre, Bedri Kazazi, nuk jetoi ta merrte "Medaljen e Mirënjohjes" si fisnik jo hebre që atij ia akordoi shteti i Izraelit.[68]

Ambasadori i Shqipërisë në Uashington, Aleksandër Sallabanda theksoi me këtë rast se dëshmitë e mirëqenies së hebrenjve në trojet shqiptare janë të hershme. Para disa vitesh në Sarandë u zbuluan gjurmët e një sinagoge të periudhës romake, ndërsa i ashtuquajturi "mesia i fundit Sabbatai Zevi në shek. XVII, pas përndjekjes nga Stambolli e Selaniku gjeti strehim në Ulqin e në Berat. Dhe një nga dëshmitë më konkrete është ajo në shënimet e ish-ambasadorit amerikan në Shqipëri më 1934, Herman Bersntein, i cili shkruan: "Nuk ka asnjë gjurmë diskriminimi kundër hebrenjve në Shqipëri, sepse Shqipëria ndodhi të jetë një nga vendet e rralla në Evropë ku paragjykimet dhe urrejtja fetare nuk ekzistojnë, edhe pse shqiptarët janë të ndarë në tre besime".

Përveç në formë intervistash, ekspozitash e filmash, çështja e strehimit të hebrenjve në hapësirat etnolinguistike shqiptare është shtjelluar dhe në formë librash. Ndër këto shquhen, nga mesi i viteve '90 të shekullit 20, librat e Harvey Sarner (1997) në SHBA: "Shpëtimi në Shqipëri: 100% e hebrenjve në Shqipëri u shpëtua nga holokausti" dhe ai i Jutta Neumann "Via Albania", e cila i përshkruan në hollësi rrethanat në të cilat jetuan familja e saj dhe hebrenj të tjerë në të ashtuquajturën "Shtëpia e Emigrantëve". Kjo e fundit shkruante në "The Washington Jewish Week" (7-8/1999): "Shqiptarët, si ata myslimanë ashtu edhe ata të krishterë, janë gjithandej njerëz mikpritës, zemërgjerë e të dashur. Duhet theksuar porse që [shpëtimi i hebrenjve] nuk mund t'i atribuohet vetëm mikpritjes tradicionale të shqiptarëve. Ky shpëtim është në pjesën më të madhe edhe shprehje e guximit individual. Në mendësinë e shqiptarëve kryet e vendit e zinte më shumë domosdoshmëria t'u ndihmohet njerëzve nevojtarë, sesa siguria e familjeve të tyre. Në Yad Vashem në afërsi të Jerusalemit ndodhet një listë e gjatë e shqiptarëve, të cilëve shteti i Izraelit ua ka ndarë titullin e nderit "Të drejtë midis popujsh". Po u pat parasysh rrethana se Shqipëria e asaj kohe kishte diç më shumë se një milion banorë, atëherë del se ky numër "i të drejtëve" është pakrahasueshëm i madh".

[68] Radio "Deutsche Welle", 27.01.2010.


MBRETNIJA SHQIPTARE
BASHKIJA FERIZAJ
Nr.Ekatra

Ferizaj me 8-X-942-XX.

L E J E - U D H T I M I

Lejohet Zonja Hysnije Ragip banues në Ferizaj për me udhtue deri në Tiranë.

Kj leje ka afat prej datës së lëshimit deri me datë 23-V-1943-XXI

Kryetar'i Bashkis
(Zel Lora)

MBRETNIJA SHQIPTARE
TAKSE 030
MONOPOLI

Dokument i lëshuar më 8 tetor 1942 nga Bashkia e Ferizajt për familjen hebraike *Kolonomos* nga Mnastiri[*]

Pas mbarimit të Luftës, nga Shqipëria u rikthyen në vendet e tyre ose u shpërngulën për në Izrael e në SHBA edhe pjesa dërmuese e hebrenjve. Në f. 139 të librit të saj "Escape Through the Balkans" (University of Nebraska Press, 1996) Irene Grunbaum shkruan: "Lamtumirë Shqipëri! Ti më fale strehim dhe aq shumë mikpritje, lumturi e aventura. Lamtumirë Shqipëri! Po vie dita dhe do t'ia kumtoj botës se sa trima, të patrembshëm, të fortë e besnikë janë bijtë e tu dhe se ata nuk mund t'i frikësojë as vdekja e as djalli. Dua të tregoj […] se si e mbrojtën këta një çupëz refugjate: Këta nuk lejuan që asaj t'i ndodh gjë e keqe dhe për këtë ata e vunë në rrezik jetën e tyre. Dyert e tua të vogla, o e vogla Shqipëri mbetën të hapura. Nëpunësit e tu i injoruan ligjet, sa herë që u deshtë që të përndjekurve të ngratë t'u jepej edhe një shans, që ta mbijetojnë më të keqen ndër luftërat! Shqipëri, vetëm falë njerëzisë tënde ne e mbijetuam pushtimin [gjerman - G.S.]. Ne të falënderojmë, Shqipëri!".[69]

b) Në Kosovë

Për numrin e hebrenjve në Shqipëri e në Kosovë dhe për motivet e strehimit të tyre nga shqiptarët mësohet shumë edhe nga kujtimet e të

[*] Foto (e zbuluar para një viti në SHBA) e huazuar nga Artikulli *Spas od holokausta: Albanska obećana zemlja za Jevreje* i autores Gresa Kraja, i botuar në Portalin e rdios "Slobodna Europa" më 29. 1. 2015.

[69] Sipas A. Ramaj, Rettung von Juden in Albanien. ..

mbijetuarve të holokaustit, të shprehura në formë intervistash apo të shpalimit të kujtimeve me rastin e manifestimeve të ndryshme kushtuar këtij episodi të hidhur të historisë së hebrenjve dhe të Europës.

Kështu, p.sh. profesori izraelit i psikologjisë - ligjërues edhe në Universitetin e Prishtinës - Rabin Moshe Landsman, në një bisedë/intervistë në radion "Europa e Lirë", në 65-vjetorin e viktimave të Holokaustit, thoshte se "Arsyeja kryesore që e mundësoi shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri, ishte e ashtuquajtura "*besa*" - kodi shqiptar i nderit.[…] Kjo për shkak të idesë që, kur një person është mysafir në Shqipëri, atëherë Kanuni kërkon që të mbrohet mysafiri, qoftë edhe me jetë. Edhe pse disa njerëz thonë që Kanuni sot nuk respektohet shumë, gjatë Luftës ai ka qenë një tipar i fuqishëm i vlerave të kombit shqiptar. […] Shumica (S.G.: e hebrenjve) u shpëtuan falë pikërisht kësaj (besës). Me fjalë të tjera, njerëzit i strehonin dhe i fshihnin refugjatët - shumë shpesh ata ishin njerëz që nuk i njihnin, por ata e bënin këtë për shkak se njerëzit ishin në rrezik dhe për shkak se donin ta bënin".[...]

Ky konstatonte se "Kushtet për hebrenjtë në Shqipëri dallonin shumë nga ato të hebrenjve në Kosovë. Ashtu siç ndoshta e dini, hebrenjtë që gjendeshin në Shqipëri shpëtuan qind për qind. Ka pasur shumë hebrenj që asokohe janë fshehur nga shqiptarët - ndoshta shumë më tepër sesa kemi qenë në gjendje ta dokumentojmë. Shqipëria ishte i vetmi vend në Evropë ku ka pasur më shumë hebrenj në fund të Luftës sesa që kishte në fillim të saj.[*] Në fillim të Luftës kishte rreth 150, ndërsa në fund të saj ishin rreth 750, që do të thotë se shqiptarët i kanë strehuar dhe fshehur edhe refugjatët hebrenj. Dallimi qenësor i pozitës së hebrenjve të Shqipërisë e të Kosovës është ai se në Shqipëri: ata ishin të integruar shumë mirë në bashkësinë shqiptare, flisnin shqip dhe kishin lidhje shumë të forta biznesi dhe sosh personale me shqiptarët. Hebrenjtë nga Kosova - shumica e tyre nga Prishtina, Deçani dhe nga veriu, flisnin serbisht dhe u larguan gjatë luftës, më 1999. Ekziston një grup prej rreth 45 individësh që jetojnë në Prizren, e që ende jetojnë si një bashkësi.

Profesori Moshe Landsman flet në këtë intervistë dhe për shpëtimin e hebrenjve në Deçan, vepër kjo kryesisht e familjes Rezniqi e mbështetur nga farefisi i saj dhe nga bashkëkombës të rrethinës. Përkitazi me këtë

[*] Këtë rrethanë e vë në spikamë edhe Max Brym [sh. Rettung in Albanien www.albansiches-institu.ch], i cili përitazi me këtë thoshte: "Merret vesh që nuk u shkrua ndonjë "Histori e Botës", porse e meriton të theksohet përherë që Shqipëria ishte i vetmi vend i pushtuar nga fashistët në të cilin pas Luftës së Dytë Botërore kishte më shumë ebreitë se më parë. Këtë përfundim e nxjerr historiani i SHBA- Harvey Samer në librin e tij "Rescue in Albania" të botuar në vitin 1998.

njofton, përsëri, "Radio Europa e Lirë" më 17.07.2010, në një intervistë me Lekë Rezniqin, pinjoll i familjes Rezniqi.[70]

Në fjalën e mbajtur në konferencën e Asociacionit të Historisë Orale, në Pragë në korrik të vitit 2010, L. Rezniqi kishte treguar atje se familja e tij kishte strehuar më shumë se 40 familje ebreite. Veprën e familjes Rezniqi të Deçanit, përkatësisht të stërgjyshit të tij Asllan Rezniqi dhe të tjerave, e vërtetoi e mbesa e Haim Abravanel-it, e cila jeton në Izrael. Në bazë të kësaj dëshmie dhe një verifikimi që zgjati disa vite, Instituti Yad Vashem e nderoi familjen Rezniqi me titullin "fisnik mes kombeve", pikërisht më 17 shkurt 2008-ditën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Nga ky rrëfim i pinjollit të familjes Rezniqi të Deçanit mësohet se Asllan Rezniqi, edhe vetë tregtar që jetonte në Gjakovë, kishte bashkë-punuar me shumë tregtarë hebrenj. Duke e parë rrezikun që vinte nga lëvizjet naziste, bashkëpunëtorët e tij hebrenj që ishin nga Maqedonia dhe nga Greqia, i kishin kërkuar atij të strehonte hebrenj në Kosovë, derisa të krijoheshin kushtet që ata të mund të kalonin në Shqipëri, që atëherë njihej si vend më i sigurt, si "tokë e premtuar" për hebrenjtë.

Me theks të veçantë në gjithë këtë që ka bërë familja Rezniqi është rasti i mjekut hebraik Haim Abravanel nga Shkupi, emrin e të cilit e mban edhe "Shoqata e Miqësisë Kosovë - Izrael". Ky kishte qenë mobilizuar nga forcat naziste si mjek. Kur kontingjenti ku ishte ai po kalonte nëpër Deçan, Asllan Rezniqi arriti ta nxirrte doktorin hebre nga kontigjenti, e pajisi me rroba nacionale shqiptare. Motiv bazë, ndoshta, paska qenë edhe rrethana që familja Rezniqi e Deçanit, midis të cilëve edhe gjyshi Mustafë Rezniqi, i rrëfyesit, ishte prekur nga epidemia e tifos dhe disa anëtarë të saj kishin vdekur si pasojë e kësaj epidemie. Mjeku hebre Haim Abravanel, bashkë me disa hebrenj të tjerë, u strehua në Deçan dhe më pas, me dëshirën e tij, u kthye përsëri në Shkup. Duke iu referuar institucionit të besës, rrëfyesi tha në këtë tubim se "Banorët e Deçanit e kanë ditur se të gjithë hebrenjtë që po qëndrojnë në shtëpinë e Asllan Rezniqit janë në besë të tij" dhe se "Edhe vetë banorët e Deçanit kanë ndihmuar pastaj hebrenjtë që nga shtëpia jonë të kalojnë në Shqipëri, qoftë nga rruga e Kukësit, qoftë nga bjeshkët." Strehimin e hebrenjve dhe përcjelljen e tyre ilegalisht për në Shqipëri e ndihmuan edhe vendësit e Asllan Rezniqit si Halim Spahia, Hasan Xërza e ndonjë tjetër.

[70] Një bisedë me L. Rezniqin, e zhvilloi më 27. janar 2010 edhe Gëzim Baxhaku, Porodica Rezniqi - zaštitnici Jevreja Në http://www.fildzanviska.ba/clanak_510.htm

Familja hebraike e Dr. Abravanel-it në Kosovë, Deçan
Mustafë Rezniqi ka themeluar para gjashtë vitesh Shoqatën e Miqësisë Kosovë - Izrael "Doktor Haim Abravanel"

Kulla e hebrenjëve në Deçan

Përkitazi me fatin dhe numrin e hebrenjve që edhe sot jetojnë në Kosovë, shkruante edhe Max Brym.[71] Bashkëbiseduesi i tij, Votim Demiri - një burrë me prejardhje hebraike nga Prizreni, i tregonte autorit se deri në fund të shek. XX në Kosovë paska pasur rreth 300 hebrenj, ndërsa tani paskan mbetur krejt 50 të tillë. Pjesën më të madhe, 40 sish, e përbëkan dy familje të mëdha hebraike të Prizrenit. Hebrenjtë e këtij qyteti, për shkak martesash, qenkan asimiluar, porse nuk e mohojnë prejardhjen hebraike të tyre. Bile, e bija e tij po studiuaka në Izrael. Bashkëbiseduesi e siguronte autorin

[71] Es gibt noch Juden im jüngsten Staat der Welt, Jüdische Zeitung, 17.3. 2010.

se as në Kosovë e as në qytetin e tij nuk ka antisemitizëm. Rrethanën që pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999 nga popullata shqiptare u atakuan disa familje hebraike ai e shpjegon se ndodhi "jo pse ishin hebrenj, porse pse ia mbanin krahun pushtetit të Serbisë. Hebrenjtë që e dinin shqipen dhe nuk ishin krah i regjimit të Miloševiqit, nuk pësuan kurrfarë represioni".

Në vazhdim, bashkëbiseduesi i paska treguar autorit se "në dokumente shënohet në vitin 1448 (!) ekzistimi i gjashtë familjeve hebraike në Novobërdë afër Prishtinës. Kjo paska ndodhur si pasojë e dëbimit të hebrenjve nga Spanja në vitin 1492 dhe me këtë rast këndej paskan ardhur shumë hebrenj sefardikë. Ai e njoftonte autorin (SG.: gabimisht) se falë këtyre hebrenjve që edhe në Spanjë ishin marrë me xehetari, na qenka zhvilluar edhe xehetaria jo vetëm në Novobërdë, porse në gjithë Kosovën. Bashkëbiseduesi i kishte treguar autorit se shqiptarët gjatë kohës së fashizmit strehuan rreth 1200 hebrenj vendës e refugjatë nga shtetet fqinje. Këtë deklarim të bashkëbiseduesit, autori Brym e përforcon me konstatimin e studiuesit kosovar Albert Ramaj në një shkrim të tij gjermanisht: "Në kohën kur asnjë shtet i Europës nuk ishte i gatshëm të pranonte/strehonte hebrenj, ambasada e Shqipërisë në Berlin u jepte atyre viza (për të shkuar në Shqipëri). Madje edhe në vitin 1942, pra kur Shqipëria ishte nën okupimin Italian, bëheshin përpjekje që përmes ambasadës shqiptare në Gjermani t'ua bënin të mundshëm udhëtimin e hebrenjve nga shtete të ndryshme për në Shqipëri. [...] Kështu, në Shqipëri u strehuan hebrenjtë nga Gjermania, Austria, Jugosllavia, Hungaria, Kroacia, Rumania, Bullgaria, Egjipti, Polonia dhe nga Turqia. Midis këtyre kishte personalitete të shquara si p.sh. prof. Stanislav Zuber, shkrimtari dr. Leo Mathia dhe artistja Joli Jakob. Një profesor universitar i Londrës dr. Finer, dëshironte që i shoqëruar nga John Walter, i bir i botuesit të "Times"-it të Londrës, të udhëtonte për në Shqipëri "për t'u informuar aty për mundësinë e vendosjes së hebrenjve në Shqipëri". Nga burime të tërthorta rezulton se edhe Albert Einstein e kishte vizituar asokohe Shqipërinë incognito. [...]" (për këtë sh. më lart).[72]

Votim Demiri, kryetar i Bashkësisë Hebraike në Kosovë tregon se ky është bir i njërës nga tri motrat hebraike të familjes Bahar Prizreni. Nëna dhe dy tezet e personazhit tonë, që asokohe ishin të moshës katër deri në dymbëdhjetëvjeçe, ishin deportuar në kampin "Bergen Belsen". Kjo kishte ndodhur pas kapitullimit të Italisë në vitin 1943, kur në Kosovë u kthyen sërish gjermanët dhe kuislingët e tyre, të cilët i kishin

[72] Deutsche Welle, emisioni i dt. 27.01.2013; Mbijetesa e hebrejve në Kosovë, Zëri.info, 27. 01. 2013

listat e përgatitura të hebrenj. Nga Kosova (Prizreni?) me këtë rast qenkan deportuar 92 ebreitë, nga të cilët paskan shpëtuar vetëm tri motrat, njëra nga të cilat ishte e ëma Suzana Bahar e Votim Demirit. Ato i kanë rrëfyer birit, përkatësisht nipit të tyre se nga andej janë kthyer më këmbë, por nuk e dinin saktësisht se si. Pas themelimit të shtetit të Izraelit në vitin 1948, si shumë bashkëkombës të tjerë që e kishin mbijetuar Holokaustin, nga vende të ndryshme të botës në shtetin e ri ebreit u vendosën edhe dy tezet e Votim Demirit, ndërsa ëma e tij mbeti në Prizren. Familja e tij vazhdon t'i ruajë kontaktet me familjarët që shkuan në Izrael.

Demiri sqaronte se prania e hebrenjve në këto hapësira daton që nga shekulli 15 dhe se, ndryshe nga ç'i kishte thënë M. Brym-it, aktualisht në Kosovë jetojnë 56 familje hebraike, kryesisht në Prizren. Në Kosovë nuk ka sot asnjë trashëgimi të prekshme të hebrenjve, përveç asaj shpirtërore, sepse ata nuk patën mundësi të shpëtojnë tjetër veç jetës së tyre - thotë V. Demiri.[73]

9. HEBRENJTË NË SHQIPËRI E NË KOSOVË PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

"Në vitet '50 të sh. 20 në Shqipëri jetonin rreth 200 hebrenj vendës. [...] Vetëm pas rrëzimit të diktaturës komuniste hebrenjtë vendës të Shqipërisë, me ndihmën e qeverisë së asokohshme, e patën mundësinë të shkojnë në Izrael apo në SHBA. Në vitet 1990 e 1991 në Izrael shkuan 350 (!) dhe në SHBA 37 hebrenj "vendës" të Shqipërisë. Në ndërkohë, po në vitet 1990/91 disa nga hebrenjtë e shpërngulur u kthyen në Shqipëri, së paku përkohësisht: Ata blejnë banesa/apartamente në mënyrë që Atdheun e tyre ta përjetojnë për disa muaj, ndërsa kohën tjetër të vitit të jenë në Izrael ose në SHBA. Në pjesën e qytetit të Vlorës në të cilën kishin jetuar shumica e hebrenjve u vendos një pllakë përkujtimore me emrat e të gjithë hebrenjve që kishin jetuar aty dhe një rruge iu ndërrua emri në "Rruga e Ebreitëve". Besohej se me ekzodin e fundit të viteve 1990/91 qenka përmbyllur kapitulli "Ebreitët në Shqipëri". Por, sigurisht që nuk është kështu. Ka ende hebrenj në moshë që nuk duan të largohen nga Shqipëria. E, këtu janë edhe hebrenjtë e "përkohshëm" të Shqipërisë." - thotë studiuesi A. Ramaj.[74]

Kësaj duhet t'i shtohet rrethana që shteti i Shqipërisë e zyrtarizoi kohëve të fundit si besim të gjashtë (përveç atyre mysliman, ortodoks, katolik, bektashi dhe ungjillor) dhe besimin hebraik. Kjo u bë publike me rastin e qëndrimit ditë më parë të kryerabinit të Izraelit Jona Meceger në

[73] Po ai, po aty
[74] Rettung von Juden in Albanien. ..

Shqipëri, të cilin e pritën edhe presidenti dhe kryeministri i Shqipërisë. Kryerabini i Izraelit deklaroi me këtë rast: "Jam shumë i kënaqur që ndodhem në Shqipëri dhe që u jap këtë lajm hebrenjve që jetojnë këtu. Ky është një moment historik. Së shpejti do të marrim hapa të rëndësishëm për komunitetin tonë këtu. Përveç sinagogave, duam të ngremë një qendër për popullsinë hebraike në Shqipëri si dhe të krijojmë varrezat e hebrenjve." Ky e prezantoi në këtë mes edhe kreun e komunitetit fetar të hebrenjve në Shqipëri, rabinin Joel Kaplan.[75]

Autori A. Ramaj[76] njofton se bashkësi bukur të mëdha hebraike (serbishtfolëse) kishte në Prishtinë e në Prizren. Bashkësia hebraike e Prishtinës s'kishte kurrfarë lidhjesh (përveç atyre të natyrës ekonomike) me shqiptarët; këtu ekzistojnë edhe varrezat e ebreitëve.[*] Në gjithë Kosovën nuk ka tani asnjë sinagogë[**] dhe asnjë bashkësi ebreitësh. Ka krejt pak ebreitë (fjala është për rreth 40 individë dhe për një shoqatë ebreite).

Portalet kosovare Kosova.info, Koha.net dhe Kosova.com njoftojnë se në kuadrin e "Javës së tolerancës dhe pajtimit në Kosovë", në vendin ku ishte dikur sinagoga, Prishtina zyrtare inauguroi më 23 maj 2013 në oborrin e godinës së Qeverisë pllakën përkujtimore (Monumentin e Holokaustit) për hebrenjtë që pësuan nëpër kampe të përqendrimit në Europë, i cili "do të shndërrohet në një rikujtim të përhershëm të pranisë së rëndësishme të komunitetit të vogël hebraik të Kosovës."

Kjo lidhet me rrethanën që hebrenjtë ose *jahuditë*, sikundër quheshin ata nga baorët e Prishtinës "Me shtëpia dhe me zanatet e tyre ishin të përqendruar në qendër të qytetit, konkretisht në Çarshinë e Prishtinës, aty ku sot gjendet Kuvendi i Kosovës, qendër kjo e vjetër atraktive me origjinalitet të theksuar në shumëçka, të cilën më vonë do ta shkatërrojnë komunistët e asaj kohe pa "dhimtë", as pa më të voglën ndjesi se po prishin diçka që duhej ruajtur." Hebrenjtë ushtronin në këtë qytet më së e shpeshti zanatin e kallajxhinjve, prej të cilit përfitonin mirë dhe jetonin mirë.[77]

---

[75] Sh. Hebrenjtë me fe zyrtare në Shqipëri http://www.zeri.info/kategoria/1 14-09-2011.

[76] Sh. Bedrängte Juden im Kosovo im Zweiten Weltkrieg, G2W -Glaube in der 2. Welt (Ökumenisches Forum für Religion und Gesellschaft in Ost und West) 2/2007, 35. Jahrgang, f. 20-21.

[*] S.G. Të njohura në popull si "Vorret e Jahudive",që ndodhen në një shpat kodre sipri "Toukbahçes".

[**] S.G: Unë e mbaj mend që nga fëmijëria, se në vitet e '50-ta të shekullit 20 një sinagogë ka qenë në arealin e godinës së komunës së Prishtinës, përkatësisht afër vendit ku sot është Trekëmbëshi – simbol i "Vëllazërim-Bashkimit". Sinagoga u rrënua pothuajse njëkohësisht me kishën katolike që ishte në arealin e godinës së hotelit "Grand" dhe Sheshit Zahir Pajaziti.

[77] Faton Abdullahu, Hebrenjtë e Prishtinës dhe shqiptarët, Kosova Press, 4 dhjetor 2011.

Varrezat hebraike në Prishtinë

Përkitazi me hebrenjtë e qytetit të Prishtinës, autori (Brym) njofton në këtë shkrim se edhe varrezat e vjetra të hebrenjve të këtij qyteti ruhen me pietet. Shqiptari i moshuar me plis ua tërheq vërejtjen vizitorëve që, në shenj respekti ndaj të vdekurve, edhe këta duhet ta kenë kokën të mbuluar me kapele (ashtu siç e ka ai me plisin e vet) kur t'i vizitojnë këto varreza. Kur ndonjëri, pas këtyre këshillave të tij e pyet nëse edhe ky është hebre, ai e mohon këtë dhe përgjigjet: "Unë jam shqiptar (dhe) mysliman, por është me rëndësi që të vdekurit të nderohen dhe fetë e tjera të respektohen". Ai i tregonte autorit se është ngritur një grup pleqsh, në mënyrë që ky të mos mbetet i vetmi që përkujdeset për ruajtjen e dinjitetit të këtyre varrezave.

Për të pafajshëm për deportimin e disa hebrenjve nuk i sheh qytetarët e Prishtinës as Faton Abdullahu. Kur po e trajtonte çështjen përse Prishtina paska mbetur pa qytetarët e saj hebrenj, ky theksonte se kjo rrethanë" [...] nuk i bën nder askujt, as traditës sonë, as feve tona, as bujarisë shqiptare [...], për të konstatuar se "Ne nuk mund të krenohemi si (SG.; vëllezërit tanë) në Shqipëri, të cilët krenohen me të drejtë se, pas

LDB-së, Shqipëria ishte i vetmi ku numri i hebrenjve ishte rritur, ndërkohë që në të gjitha vendet ku ata kishin jetuar ishte zvogëluar."[78]

Në vazhdim autori ynë sqaron se "Ky dallim ndërmjet nesh dhe shqiptarëve të Shqipërisë ndaj hebrenjve determinohet nga rrethanat e ndryshme nën të cilat Kosova e Shqipëria ndodheshin para dhe gjatë pushtimit të nazistëve e të fashistëve. Shqiptarët e Kosovës ishin të pushtuar nga serbët dhe përjetonin diskriminime sistematike nga më të ndryshmet. Ardhja e gjermanëve në Kosovë do të përjetohet nga shqiptarët si një lloj çlirimi nga sundimi diskriminues serb dhe si jetësim i qëllimit politik të tyre, bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Duke u ndjerë më mirë në ato rrethana të reja (pas largimit të pushtuesve serbë), edhe miqësia me pushtetin e ri fashist/nacist ishte më e mirë prandaj edhe përkushtimi ndaj parimeve të asaj politike ishte më i theksuar, sado që njëri nga parimet e pushtuesit të ri në ato vite ishte lufta çfarosëse kundrejt ebreitëve. [...]

Kjo ishte, thotë autori ynë, arsyeja pse disa shqiptarë në ato kohëra qenë ekzekutues të kësaj politike, kundër hebrenjve, sado që qytetarët e Prishtinës u kishin dalë në ndihmë bashkëqytetarëve të tyre ebreitë.[79]

Krejt ndryshe e paraqet gjendjen Čedomir Prlinčević, një qytetar hebre i Prishtinës dhe deri në vitin 1999 kryetar i bashkësisë së hebrenjve të këtij qyteti, (një kohë edhe drejtor i Arkivit të Kosovës) i cili deklaronte se "në vitin 1999 edhe ata pak hebrenj që kishin mbetur u dëbuan nga shqiptarët pothuaj se në tërësi. Kosovarët e vazhduan aktualisht punën e SS-ëve të cilët në prill të vitit 1942 hebrenjtë e Mitrovicës e të Prishtinës, gjithsej ndoshta 150 frymë, i deportuan për në Beograd ku edhe u mbytën. "Më vonë, disa hebrenj u kthyen dhe në Prishtinë e themeluan një bashkësi prej rrafsh 100 anëtarësh, në krye të së cilës ishte (vetë) Čedomir Prlinčević. Nga viti 1999 në kryeqytetin kosovar nuk mbeti asnjë hebre për be. E gjithë pasuria e tyre u plaçkit nga shqiptarët. Kështu njoftonin mjete të informimit, përkitazi me të cilat Aleksandar Lebl në mënyrë precize vërente se: "Hebrenjtë e Prishtinës mund ta marrin me vete një pjesë të pasurisë së tyre; aktualisht këtyre do t'u kthehen pasuritë e patundshme të cilat këta (nëse nuk kthehen) mund t'i shesin ose t'ua ofrojnë shtetit që ai t'i blejë ato".[80]

Në kuadër të shqiptarofobisë në shërbim të politikës së Serbisë, Prlinčević sjell në këtë shkrim edhe një të pavërtetë sipas së cilës disa hebrenj ishin lidhur familjarisht me shqiptarë, prandaj në regjistrime të

[78] Faton Abdullahu, Hebrenjtë e Prishtinës dhe shqiptarët, Kosova Press, 4 dhjetor 2011.
[79] Po ai, Po aty.
[80] Wolf Oschlies Geschichte und Ende der Juden in Serbien www.shoa.de/content/view/218/46/ - 89k

popullsisë nuk deklaroheshin më për hebrenj. Këtë e paskan bërë përsëri, porse, atëherë kur këta, pas vitit 1999 u dëbuan nga shqiptarët. Këtë deklarim në frymën e politikës ditore e demanton realiteti i përmbajtur në burime historike dhe në përshkrimin e gjendjes së hebrenjve nga autori hebre Max Brym (khs. më lart).

10. MOTIVET E STREHIMIT TË HEBRENJVE NGA SHQIPTARËT

Një çështje me peshë shumë të madhe në kontekstin e angazhimit të shqiptarëve për strehimin dhe shpëtimin e hebrenjve është sqarimi i motivimeve nga të cilat u prinë shqiptarët për këtë vepër të tyre njerëzore. Janë, kryesisht, dy sqarime: toleranca e njohur fetare e shqiptarëve dhe virtyti i besës. Përkitazi me këtë është thënë:

"Le të ndalojmë për pak çaste dhe t'i shqyrtojmë motivimet e mundshme për këto politika të paktën të buta si përkitazi me hebrenjtë e Shqipërisë, ashtu edhe përkitazi me hebrenjtë e huaj, përkatësisht të ardhur në ndërkohë nga shtete të tjera dhe të strehuar përkohësisht në Shqipëri. Unë mendoj se motivacioni i Zogut për sa u përket të gjitha politikave të tij fetare, ka qenë nacionalizmi dhe mbijetesa e tij politike, jo domosdoshmërisht të radhitura në këtë formë. Zogu ka qenë akuzuar si antikatolik, por nuk jam i sigurt nëse kjo qëndron. Unë mendoj se ai besonte në konceptin e tij të një shteti modern perëndimor, në të cilin nuk kishte vend për paragjykimet fetare dhe në të cilin feja nuk do të luante rol politik. Motivimet e fashistëve gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin të ndryshme. Për italianët, qëndrimi i tyre disi i butë lindte pjesërisht nga mungesa në rrugën e traditës së antisemitizmit, italianët gjithashtu dëshironin t'i pengonin gjermanët kurdo u jepej shansi. Italianët gjithashtu ishin të ndërgjegjshëm se antisemitizmi thjesht nuk rezononte me shqiptarët dhe ata ishin të mençur sa duhet për ta kuptuar se antisemitizmi aktiv për pasojë do të kishte dhënë pak në rrugën e kapitalit politik. Motivacioni i gjermanëve ishte, mbi të gjitha, *pragmatizëm*. Neubacher ka pasur të ngjarë të mos kishte qenë i interesuar në mënyrë të veçantë për të shpëtuar hebrenjtë, por e ndjeu se detyra e tij do të lehtësohej dhe do të forcohej pozita e gjermanëve nëse ai do të arrinte të përmbushte nocionin e "sovranitetit relativ". Por cili ishte *motivi i shqiptarëve*, që morën në shtëpitë e tyre jo vetëm hebrenjtë e Shqipërisë, por edhe hebrenjtë e huaj, i mbrojtën ata dhe i mbajtën të sigurt shpesh për muaj me radhë, madje për vite, cili ishte motivi? Pjesë e përgjigjes ishte *mungesa e kërcënimit*. Hebrenjtë e Shqipërisë, të shtuar madje edhe me refugjatë ebreitë të ardhur - ishin, padyshim, në numër të kufizuar, kështu që ata *nuk përbënin*

kërcënim. Por unë jam i mendimit se ka më tepër për të shpjeguar këtë qëndrim. *Tradita shqiptare e mikpritjes dhe besa*, natyrisht, që luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Por, në fund të fundit, një pjesë e motivacionit u inspirua nga një tolerancë më e thellë fetare, gjë e cila mund të tregohet nga një koment i Herman Bernstein, që e ka shkruar në fillim të viteve 1930. Ai ka thënë: "Në Shqipëri nuk ka asnjë gjurmë diskriminimi kundër hebrenjve sepse Shqipëria është njëra ndër vendet e pakta në Europë ku paragjykimi dhe urrejtja fetare nuk ekzistojnë."[81]

Komponente me rëndësi e mbrojtjes së hebrenjve vendës dhe të atyre të ardhur rishtazi në Shqipëri është qëndrimi politik i qeverisë së Shqipërisë në atë kohë që "çështja e hebrenjve" në këtë shtet ishte punë e brendshme e shtetit shqiptar. "Dokumentet bëjnë të qartë se çështja e hebrenjve në Shqipëri ka qenë edhe objekt diskutimesh politike, madje ka qenë edhe çështje e një takimi të përbashkët të përfaqësuesve të Ribentrop-it dhe përfaqësuesit të Gestapo-s Myler më 21 tetor të vitit 1943. Në këtë proces-verbal thuhet se për të gjithë hebrenjtë e territoreve të reja të Rahjut (Kroaci, Shqipëri, Serbi) do të zbatohet formula e "zgjidhjes përfundimtare." Sa i takon rastit të Shqipërisë, duke qenë se qeveria e këtij vendi e konsideron çështjen e hebrenjve çështje të brendshme, deri në një këshillim tjetër nuk do të ndërmerret asnjë veprim, thuhet në këtë procesverbal. Në të vërtetë nga Rahju janë kërkuar listat e hebrenjve edhe në prill të vitit 1944 e edhe në qershor të vitit 1944. Listat ishin të plota, listat janë edhe sot të plota dhe listat i kanë pasur të gjitha qeveritë bashkëpunuese, kolaboracioniste. Por asnjëra nga qeveritë e Shqipërisë nuk i dha këto lista." - thotë prof. Shaban Sinani.[82]

Në këto burime është bërë fjalë edhe për marrëveshje dypalëshe e shumëpalëshe. Njëra nga ato dhe, më e rëndësishmja, është ajo e arritur midis ambasadorit amerikan Herman Bernstein të SHBA-s në Shqipëri dhe ministrit shqiptar të punëve të jashtme në Washington Faik Konica për instalimin e së paku të 500 familjeve hebraike në territoret që do të bonifikoheshin prej tyre, kryesisht në rrjedhën e Bunës dhe të Drinit. Raportohet se edhe qeveria britanike ka pasur të njëjtin interesim, që ka vazhduar deri në pragun e pushtimit fashist, për të krijuar një etnitet të hebrenj në Shqipëri që do të ishte i ngjashëm me atë në atdheun e tyre të

[81] I gjithë teksti i përzgjedur në citatet e mësipërme (të lekturuara lehtë nga unë),është marrë nga punimi i Bernd J. Fischer, Hebrejtë e Shqipërisë gjatë periudhës zogiste dhe Luftës së Dytë Botërore, i botuar edhe në shqip tek http:albanisches-institut.ch/pdf/tex9pdf.

[82] Sipas Admirina, Peçi: http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/344519/titulli/Shaban-Sinani-Si-u-priten-hebrenjte-ne-Shqiperi më 02/11/2009 dhe në http://www.revistakuvendi.net/Publicistike/207.html.

lashtë në Palestinë. Ky projekt pati edhe pëlqimin e Lidhjes së Kombeve. Para tre muajsh është botuar një raport i njërit prej përfaqësuesve të bashkësisë hebraike që kanë inspektuar Shqipërinë në vitet '30, për të parë sa e mundshme ishte kjo ide. Aty bëhet shumë e qartë se kjo përfaqësi që erdhi në Shqipëri për ta parë sa mirëkuptim do të gjente ky projekt, kishte gjetur pëlqimin e autoriteteve vendase."[83]

Sipas studiuesit Shaban Sinani, një rol vendimtar në sjelljen historike të shqiptarëve ndaj hebrenjve ka luajtur jo vetëm toleranca e mirënjohur ndërfetare e shqiptarëve por dhe sjellja e tyre ndaj të huajve, sidomos në kohë rreziku. "Tradicionalisht shpëtimi i hebrenjve në Shqipëri është trajtuar si një çështje virtyti. Shqiptarët janë mikpritës, shqiptarët rrezikojnë për mikun, janë njerëz të besës. Pra kjo është mënyra se si është vlerësuar tradicionalisht.[84]

Besa, si përbërës themelor i motivit të strehimit të hebrenjve nga shqiptarët e zë vendin qendror edhe në filmin dokumentar "*Besa*" që ishte pjesë e projektit me titull: "Myslimanët që shpëtuan hebrenj gjatë luftës", për realizimin e të cilit fotografi i njohur izraelit Norman H. Gershman kishte punuar për pesë vite me radhë. Me këtë projekt në mendje ai vizitoi edhe Shqipërinë dhe Kosovën, të cilat i përfshiu në një libër të veçantë me titull "Besa: Kodi i Nderit; Shqiptarët që shpëtuan hebrenj gjatë Luftës së Dytë Botërore".

Filmi u shfaq në ambiente të Kongresit Amerikan më 29 qershor 2010.[85] Filmi bazohet në të dhëna gojore, dokumenta dhe në rreth 20 intervista me personazhe reale, shqiptarë apo familje të cilat kishin shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Vetëm tre muaj më vonë, (më 6 tetor 2010) në organizimin e autorit të sipërpërmendur kjo ekspozitë u hap edhe në Prishtinë. Disa nga veprat e përfshira në këtë libër janë zgjedhur për një ekspozitë tematike "Besa: Kodi i Nderit" në nderim të shqiptarëve që ndihmuan hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore, në selinë e Këshillit të Evropës në Strasburg, që u hap me rastin e ditës së Holokaustit e cila porse përkoi edhe me 60-vjetorin e Këshillit të Evropës. Ekspozita "Besa: Kodi i Nderit" u organizua me ndihmën e qeverisë shqiptare, Komisionit Izraelit në Kujtim të Holokaustit, Yad Vashem dhe Këshillit të Europës. Siç pohojnë edhe vizitorët, nuk ka mënyrë më domethënëse për të nderuar rolin e kësaj organizate të dedikuar për të bërë realitet parimet demokratike dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Këta individë treguan se humanizmi nuk njeh dallime etnike, fetare, apo

[83] Po ajo, po aty
[84] Sipas: http://www.revistakuvendi.net/Publicistike/207.html
[85] Marrë nga radio "Zëri i Amerikës", 30 qershor, 2010.

gjuhësore. Shqipëria ishte një vend ku gjatë Luftës së Dytë Botërore asnjë hebre nuk iu dorëzua nazistëve dhe numri i hebrenjve madje u shtua, falë mikpritjes dhe humanizmit që treguan shqiptarët.

Organizatorët e ekspozitës theksojnë se individët që nderohen në këtë veprimtari janë shembull i triumfit të shpirtit njerëzor dhe tregojnë se edhe në periudhat më të errëta ka individë që udhëhiqen nga parimet më të larta të njerëzimit:

Regjisori kryesor i filmit Jasson Williams e pranon, se *Besa* është diçka e veçantë. Ai mendon se tri elemente shërbyen që shqiptarët të vepronin në mbrojtje të hebrenjve; "E para ishte qeveria shqiptare gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore që hapi kufijtë për këta të ikur e të përndjekur; e dyta ishte roli pozitiv i klerikëve myslimanë, katolikë e ortodoksë që u bënin thirrje besimtarëve të ndihmonin e fshihnin hebrenjtë që kërkonin strehim; dhe së treti ishte fjala e dhënë, *Besa* ajo që i lidhte këta faktorë, duke krijuar të veçantën që mungonte në Evropë në atë periudhë".[86]

Shumë nga individët e nderuar në librin e fotografit Gershman dhe në ekspozitë nuk jetojnë më, por historitë e tyre mbeten të pavdekshme. Të 17 familjet e zgjedhura (shqiptare) për këtë ekspozitë janë një shembull i vogël i kontributit të madh që shqiptarët e dhanë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ata kujtohen në këtë aktivitet për guximin dhe për vetëmohimin e tyre, por mbi të gjitha për humanizmin që e treguan ndaj një personi tjetër në nevojë. Është një zgjedhje e përshtatshme, thekson Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës Terry Davis, që tregon se mirësia e njeriut triumfon edhe në kohërat më të errëta: "Në mes të tmerreve dhe akteve çnjerëzore të Luftës së Dytë Botërore kishte akte të guximit dhe të mirësisë njerëzore, shembuj të faktit që thellë brenda vetes njeriu është i lindur i mirë. Sot jemi mbledhur për të nderuar disa nga këta individë, shqiptarë të cilët, pavarësisht nga rreziku që u kanosej, ndihmuan hebrenj duke i shpëtuar nga nazistët."

Në këtë kontekst është thënë edhe se "një popull mysliman ia zgjati dorën një populli të një besimi tjetër dhe e shpëtoi atë. Në të vërtetë nuk është vetëm virtyti, janë dhe faktorë të tjerë shumë të rëndësishëm për shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri, faktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, por absolutisht nuk mund të përjashtohet edhe fakti që shqiptarët në sjelljen ndaj hebrenjve qenë konvergjentë. Pra është një virtyt, i cili gjendet tek myslimanët dhe të krishterët, tek të pasurit dhe të varfrit, tek të majtët dhe të djathtët" e shqiptarëve.

[86] Ardita Simiçia, Ekspozita "Besa: Kodi i Nderit" në Strassburg, radio "Zëri i Amerikës". 29.04.2009.

Kështu, p.sh. profesori i psikologjisë nga Izraeli - ligjërues edhe në Universitetin e Prishtinës, Rabin Moshe Landsman, në një bisedë/ intervistë në radion "Europa e Lirë", në 65-vjetorin e viktimave të Holokaustit, thoshte më 27 janar se "Arsyeja kryesore që e mundësoi shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri, ishte e ashtuquajtura "*besa*" - kodi shqiptar i nderit. […] Kjo për shkak të idesë që, kur një person është mysafir në Shqipëri, atëherë Kanuni kërkon që të mbrohet mysafiri, qoftë edhe me jetë. Edhe pse disa njerëz thonë që Kanuni sot nuk respektohet shumë, gjatë luftës ai ka qenë një tipar i fuqishëm i vlerave të kombit shqiptar. […] Shumica u shpëtuan për shkak të kësaj. Me fjalë të tjera, njerëzit i strehonin dhe i fshihnin refugjatët - shumë shpesh ata ishin njerëz që nuk i njihnin, por ata e bënin këtë për shkak se njerëzit ishin në rrezik dhe për shkak se donin ta bënin".[...]

Përkitazi me rolin e institucionit të "besës" shkruante edhe humanistja, luftëtarja konsekuente daneze për të drejtat e njeriut, Christine von Kohl. Ajo thoshte: "Përkundër të gjitha tmerreve që tek shqiptarët i kishin, Lufta për Çlirim dhe Lufta Civile, gjermanëve nuk iu dorëzua asnjë hebre. Vetëm në momentin e fundit, në pranverë të vitit 1944, Gestapo i ndërmori në Tiranë hapat e parë për regjistrimin e hebrenjve që jetonin në Shqipëri. Duke e pasur parasysh rrezikun e madh që e nënkuptonte mëshehja/strehimi i hebrenjve, mbrojtja [në bazë të "besës"], që u ishte ofruar atyre (hebrenjve), ishte vlerë morale për t'u çmuar e tyre. Përkitazi me këtë ka një vistër deklarimesh të besueshme të dëshmitarëve. [...] Për trimërinë dhe për shkathtësinë mendore të mikpritësve shqiptarë, tek të cilët kishin banuar hebrenjtë, tregon, ndër të tjera, edhe raporti i Mark Menahem, i cili jetonte i fshehur në një familje në Tiranë. Kur gjermanët trokitën në derë, e zonja e shtëpisë, burri i së cilës nuk kishte qëlluar në shtëpi, e shtriu atë në shtratin e të shoqit e prezantoi Markun si bashkëshortin e saj. [...] Josef Jakoel ka njoftuar që një mik i tij deshi që, pas Luftës, shpëtimtarit të tij shqiptar t'ia jepte në shenj falënderimi një sasi të hollash dhe se ai e mori këtë përgjigje: " Unë të kam trajtuar për si mik, unë ta kam dhënë "besën", por ne nuk e shesim atë."[87]

Duke e vënë në spikamë institucionin e *besës* dhe komponentën "*mysliman*" të shqiptarëve (me inkuadrimin këtu ndonjëherë edhe të shqiptarëve të ritit katolik e të atij ortodoks) si një fenomen unik në botë, ekspozita shëtitëse e fotografive "Besa-një kod nderi" e fotografit amerikan Norman Gershman,[88] përveç në Nju Jork, Vjenë, Vaduz (Lihten-

[87] Christine von Kohl, Albanien, München, 2003, cit. sipas Albert Ramaj +
[88] Sipas Alb.info, 15.01.2013.

shtajn) dhe Frankfurt, u shfaq edhe në kishën Dreikönigskirche të Dresdenit, e në vazhdim edhe në Leipzig, Zittau, Rothenburg, Martinshof dhe në Görlitz të Gjermanisë. Në Rothenburg e gjetkë, vizitorët e patën mundësinë të njiheshin me portretet e 12 nga 69 shqiptarëve të nderuar për "Të drejtat e popujve" në përkujtimoren e Jerusalemit "Yad Vashem", njerëzve të thjeshtë nga Shqipëria, që si shqiptarë të besimit mysliman në Luftën e Dytë Botërore kanë bërë më shumë se disa të krishterë në pjesën tjetër të Evropës përsa i përket strehimit dhe shpëtimit të hebrenjve.

Një ekspozitë e këtillë (mbase po ajo me fotografitë e autorit Grrshman), me fotografitë e 70 myslimanëve që gjatë Luftës së Dytë Botërore shpëtuan hebrenjtë, me titullin "Myslimanë të drejtë", u organizua edhe nga Këshilli i Hebrenjve dhe u hap në distriktin qendror Bloomsbury të Londrës. Sado që këtu përmendet familja boshnjake Hardaga që e paska shpëtuar familjen hebraike Kavilio të Sarajevës dhe se kjo e fundit ia "ktheu borxhin" duke e shpëtuar atë gjatë luftës së viteve të 90-ta në Bosne, ,Fiyaz Mughal, drejtues i organizatës humanitare "Faith Matters" dhe njëri ndër autorët e libërthit me titullin "Roli i myslimanëve të Drejtë" tha me këtë rast se "Besa, kodi kombëtar i nderit në Shqipëri, i ngjashëm me kodin Pashtu në Afganistan, u priu myslimanëve që (hebrenjve) t'u siguronin strehim gjatë okupimit nacist. Pikërisht falë kësaj, numri i hebrenjve në Shqipëri në të vërtetë u rrit gjatë Luftës së Dytë Botërore",[89] gjë që mbase tregon qartë se kemi të bëjmë me shpëtuesit shqiptarë të hebrenjve.

Vepra e strehimit dhe e shpëtimit të hebrenjve nga shqiptarët e Shqipërisë dhe të Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore u shënua, sipas "Zëri i Amerikës", 30. 11. 2012 me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Veprën humanitare të shqiptarëve e lavdëruan me këtë rast senatori i Nju Jork-ut Charles Shummer, kryetarja e komisionit të punëve të jashtme në Kongresin amerikan, Ileana Ros Lehtinen, ndërsa kongresisti Dana Rohrabacher paraqiti në Dhomën e Përfaqësuesve rezolutën për 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë dhe me këtë rast theksoi "I jemi mirënjohës popullit shqiptar për aktin e tyre. Jam krenar që ndodhem mes jush në këtë takim për ta falënderuar popullin shqiptar, i cili i tregoi botës se qeniet njerëzore në kohë krizash janë në gjendje të veprojnë me guxim". Kjo veprimtari u organizua nga Lidhja Qytetare Shqiptaro-Amerikane nën drejtimin e çiftit Joe dhe Shirley Dioguardi. Prapavia politike e këtij aktiviteti ishte apeli tek shteti i Izraelit që ta njohë Kosovën shtet të pavarur.

[89] Sipas radios "Slobodna Europa", 21.04.2013.

Institucionin e besës për si faktorin vendimtar për strehimin dhe shpëtimin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore e spikati këto ditë në Tel Aviv edhe presidenti Bujar Nishani i Shqipërisë, i cili (sipas Kosova.com të 19 e 20 qershorit, 2013, në takimin e tij me disa anëtarë të familjeve izraelite, të shpëtuara nga shqiptarët, gjatë periudhës së Holokaustit, u shpreh se akti shqiptar për mbrojtjen e hebrenjve gjatë periudhës së holokaustit përbën një qëndrim të vetëdijshëm që mbështetet tek dashuria dhe respekti për njeriun, pavarësisht fesë dhe racës dhe (tek) kodi moral i fjalës së dhënë e sakrifikimit për mikun - Besa.

11. PERSONALITETE TË SHQUARA HEBRAIKE NË QEVERI, NË KULTURË E SHKENCË NË SHQIPËRI

Nga Albert Ramaj[90] mësojmë se "Në Shqipëri ka një varg njerëzish me prejardhje hebraike me rrënjë në Shqipëri apo që kishin raporte me të, të cilët kishin dhënë e japin ende kontribut në fushën e kulturës e të politikës. Kështu, p.sh. ministri i parë i Postës i Shqipërisë së çliruar në vitin 1912 ishte Lef Nosi, një hebre i konvertuar në ortodoks, pasardhësit e të cilit jetojnë në Tiranë. Aleksandër Moisiu (1879-1935): aktor në Burgtheater të Vjenës dhe bashkëthemelues i Lojërave Festive të Salzburg-ut ishte me origjinë shqiptare-hebraike si edhe, natyrisht, i afërmi i tij prej gjaku (ish) presidenti i Shqipërisë Alfred Moisiu (i lindur në v. 1929). Një stërnip i Aleksandër Moisiut është aktori gjerman Gedeon Burkhard (i lindur në v. 1969); i njohur nga seria e filmit kriminalistik "Kommissar Rex"): edhe ky ka pra rrënjë hebraike-shqiptare. Një hebre i njohur ishte edhe Robert Schwarz/Shvarc, i cili qëndroi në Shqipëri deri kur vdiq (në v. 2003); i biri Edvin shkruan shpesh nëpër gazeta shqiptare përkitazi me hebrenjtë, hebraizmin, antisemitizmin. Pati edhe shkencëtarë hebre të cilët nuk patën ndonjë liddhje biografike me Shqipërinë, por që u morën me çështje të kulturës, gjuhës e të historisë së shqiptarëve. I këtillë ishte linguisti vjenez Norbert Jokl (*1877), i cili në vitin 1942 u likuidua gjatë transportimit për në kamp të përqendrimit; bashkë me likuidimin e tij humbi edhe dorëshkrimi i një fjalori etimologjik i gjuhës shqipe. Një historian, që duke u marrë me historinë shqiptare të mesjetës së vonë kishte bërë emër, ishte hebreu kroat Milan von Šufflay (1879-1931). Sado që ky jetonte e ligjëronte në Kroaci, qeveria e Shqipërisë i ndihmonte me konsekuencë gjurmimet e tij siç ishte p.sh. projekti i tij i madh vëllimi III i *Acta Albaniae*.

[90] Rettung von Juden in Albanien …

12. FATI I HEBRENJVE NË SHTETET FQINJE

a) Në Serbi

Pa dashur që të tërhiqet ndonjë paralele e shabllonit "bardh-zi" në relacionin shqiptarë - sllavë të Jugut përsa i bie bashkëjetesës me elementin etnik hebre, po i barti më poshtë vetëm të dhënat që i sjell studiuesi (historiani) Wolf Oschlies[91] përkitazi me fatin e hebrenjve në Serbi dhe të dhënat që kanë të bëjnë me hebrenjtë në Bullgari, Maqedoni e në Greqi.

Historiani gjerman W. Oschlies e shpreh mendimin se ka gjasë që në regjionin e Beogradit hebrenjtë do të kenë zënë vend që në kohën e antikës romake, përkatësisht që në shek. III.[92] - disa shekuj përpara ardhjes së sllavëve në Ballkan. Ky tregon se qysh në shek. XVI e XVII hebrenjtë kishin "disa" sinagoga, porse dihet vetëm për atë "Sinagogën e Vjetër" që u ndërtua në shek. XVIII (më vonë e rindërtuar shumë herë) e cila gjatë Luftës së Parë Botërore u përdor si lazaret dhe që u rrënua gjatë Luftës së Dytë Botërore.[93]

Për si uverturë e parapërgatitje për dëbimin e hebrenjve nga kjo hapësirë, autori e vë në spikamë evidentimin (regjistrimin) etnokulturor të grupeve të mëdha etnike gjë që e nënkupton marrjen në konsideratë të ndryshimeve (të qenies ndryshe) gjuhësore, fetare etj. Në mesin e shek. XVII, hebrenjtë e Beogradit evidentoheshin si hebrenj "turq" (= sephardim-ët) dhe si hebrenj "gjermanë", (= ashkenazim-ët).

Dëbimi i parë, për të cilin dihet, i hebrenjve nga Serbia, përkatësisht nga qyteti i Beogradit, u realizua sipas vendimit të marrë nga "Këshilli i Qeverisë" i dt. 8 janar 1807 kur u dëbuan disa qindra hebrenj me qëllim të "pengimit të konkurrencës (hebraike) kundrejt tregtarëve serbë".[94]

Autori ynë na mëson se në principatën gjysmësovrane të Serbisë (= Pashallëku i Beogradit) në vitin 1874 jetonin vetëm 1.754 hebrenj, ndërsa në territoret e anketuara nga kjo katër vite më vonë u krijuan grupe larg më të mëdha hebrenjsh: në Niš - 1.706, në Pirot - 360 etj. Pas Kongresit të Berlinit, hebrenjtë u tërhoqën e u përqendruan para se gjithash në Beograd, i cili kishte gjithnjë e më shumë hebrenj: 2.599 (në vitin 1889), 3.099 (në vitin 1895), 4.192 (në vitin 1910). Hebrenjve që ende nuk ishin

---

[91] Geschichte und Ende der Juden in Serbien www.shoa.de/content/view/218/46/ - 89k

[92] sh. edhe Chaim Frank, në www.hagalil.com/antisemitismus/osteuropa/jugoslawien.htm; W. Oschlies, Geschichte der Juden in Serbien.

[93] Wolf Oschlies Geschichte und Ende der Juden in Serbien www.shoa.de/content/view/218/46/ - 89k

[94] Po ai, po aty.

të kënaqur, autoritetet vendëse ua ofronin vazhdimin e udhës për në Lindjen e Afërme, punë kjo që në vitin 1883 shtypi i Beogradit e rekomandonte haptazi.: "Të gjithë hebrenjtë, që dëshirojnë të shkojnë në Jeruzalem, mund ta bëjnë këtë me të gjitha dokumentet e nevojshme duke ua hequr edhe shpenzimet e udhëtimit. Kur të arrijnë atje, të shpërngulurve do t'u ndahet tokë pune dhe të gjitha të tjerat që i duhen një bujku të pavarur."[95]

Në vitin 1938 në Beograd jetonin 10.338 hebrenj, 8.500 nga të cilët ishin sephardinë.

Pak ditë pas marshimit/hyrjes së gjermanëve në Beograd, Gestapoja ngriti aty një "Referat për çështje të hebrenjve" si edhe një "Sektor-Departament" përkatës në qeverinë e qytetit. Organizatave ebreite "Lidhja" dhe "Unioni" iu ndalua çfarëdo aktiviteti dhe iu konfiskua e gjithë pasuria. Në vend të këtyre u formua një "Përfaqësi e komunitetit hebre" (Pretstavništvo jevrejske zajednice), e cila u ngarkua me detyrë që ta bëjë një "regjistrim popullsie" dhe të gjithë hebrenjtë e përfshirë në atë regjistrim të shenjohen me shirit/fashë të verdhë (16 prill 1941). Pasoi largimi i hebrenjve nga çdo marrëdhënie pune, arrestimet, puna e detyrueshme (10 orë në ditë për burrat e moshës 14 deri në 60 vjeçare; për gratë nga mosha 16 deri në 40-vjeçare); mosnjohja e asnjë të drejte për hebrenjtë, (30 maj 1941); ekzekutimet (nga qershori i vitit 1941); kampet e përqendrimit dhe kampet e likuidimit në pjesë të qytetit - të gjitha këto me brutalitetin e përshpejtuar midis prillit e gushtit të vitit 1941 dhe të parat në një vend të pushtuar nga gjermanët.

Pas një analize krahasimtare përkitazi me likuidimin e hebrenjve në Serbi e në Greqi autori i punimit të tij të diplomës Maximilian Sekira arrin në përfundimin se "likuidimi i hebrenjve të Serbisë nga mesi i vitit 1941 deri në maj të vitit 1942 nuk ishte vetëm gjenocidi i parë i ushtruar mbi hebrenjtë nga nacionalsocialistët; ky gjenocid nuk u zhvillua në mënyrën që tashmë ishte bërë e rëndomtë: hebrenjtë e gjinisë mashkullore të Serbisë u përzgjodhën vjeshtën e vitit 1941 nga Wehrmacht-i për si grup që do të viktimizohej dhe që u pushkatuan në kuadrin e "Masave të shlyerjes". Likuidimi i hebrenjve të Serbisë u përmbyll në pranverë të vitit 1942 me aktin e mbytjes së grave hebraike dhe të fëmijëve të tyre me gaz helmues përmes një makine mobile të gazit. Në Greqi gjenocidi rrodhi ndryshe. Popullata e këtushme hebraike

[95] Po ai, po aty.

nuk u mbyt në vend (në Greqi), porse u deportua në kampet e asgjësimit në Auschwitz - Birkenau."[96]

Sipas llogaritjeve të Muzeut Historik Hebraik në Beograd, përmasat e holokaustit të ushtruar mbi hebrenjtë ishin këto përmasa: Në Luftën e Dytë Botërore, Jugosllavia pati 1,7 milion viktima. Midis këtyre, viktima qenë 82% (në Serbi 85%) e 82.000 hebrenjve të cilët, sipas të dhënave më të reja, jetonin në Mbretërinë e Vjetër të Serbisë.

Në vigjiljen e Luftës së Dytë Botërore në gjithë "Mbretërinë e Jugosllavisë" së atëhershme jetonin rrafsh 82.000 hebrenj, rreth 35.000 nga të cilët jetonin në Serbi. Këtij numri iu shtuan (edhe) rreth 5.000 refugjatë hebrenj nga Gjermania, Austria dhe nga Çekosllovakia. Një e treta e të gjithë hebrenjve të Jugosllavisë jetonin kompakt vetëm në 11 qytete: Në Zagreb e në Osijek (Kroaci), në Sarajevë (Bosnje), në Suboticë, Senta, Novi Sad, Zrenjanin, Zemun dhe në Beograd (Serbi), në Shkup e në Manastir (Maqedoni). Vështruar thjesht në rrafshin e zhvendosjes së hebrenjve, gjendja ndryshoi pra krejt pak; në aspektin numerik, humbje të mëdha pësoi sidomos elementi hebre i Serbisë [...]

Fushata për dëbimin e hebrenjve nga Serbia, "pas shumë valëve të emigrimit (të hebrenjve) u përsëdyt në vitet 1948-1952, kur gjysma e të mbijetuarve hebrenj u shpërngul në shtetin e sapoformuar të Izraelit." - sqaron W. Oschlies

Në Serbi (gjithnjë sipas autorit W. Oschlies) jetojnë rrafsh edhe vetëm 2.200 hebrenj, ndërsa sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2002 madje vetëm edhe 1.158 të tillë, të shpërndarë në nëntë bashkësi, më të mëdhatë në Beograd dhe në Vojvodinë (Novi Sad, Zemun, Suboticë, Zrenjanin etj.)"[97] Në këtë kontekst vihet në spikamë edhe rrethana që " shumë hebrenj të Serbisë (sidomos ata të Beogradit) ashtu edhe ata të Kroacisë tentuan të vendoseshin në pjesën veriore të Kosovës dhe prej aty të shkonin në "Shqipërinë e Madhe".[98]

Me rastin e përkujtimit të holokaustit, këtij përvjetori të historisë së hidhur të popullit hebre dhe të sjelljes së qeverive në shtete të Ballkanit në kohën e ndodhjes së kësaj tragjedie dhe të qenies gjallë të antisemitizmit edhe sot, me ç'rast presidenti i Serbisë Boris Tadić, përfaqësues të qytetit të Beogradit, të Lidhjes së komunave hebraike të

[96] khs. Die Vernichtung der Juden in Serbien und Griechenland. Diplomarbeit, Universität Wien. Historisch-Kulturwissenschaftliche Fakultät BetreuerIn: Suppan, Arnold, në http://othes.univie.ac.at/2015/

[97] Wolf Oschlies Geschichte und Ende der Juden in Serbien www.shoa.de/content/view/218/46/ - 89k; de.wikipedia.org/wiki/Serbien_im_Zweiten_Weltkrieg - 49k

[98] Khs. www.david.juden.at/kulturzeitschrift/70-75/73-ramaj2.htm - 20k

Serbisë dhe pjesëtarë të koreve diplomatike vunë kurora lulesh tek Monumenti për viktimat e gjenocidit në "Staro sajmište" ku ishte edhe kampi nazist, gazetari Nebojša Grabež mblodhi rezultatet e gjurmimeve të historianes Branka Prpa, të kryetarit Aleksandar Nećak të Lidhjes së komunave të hebrenjve, të gazetares dhe shkrimtares Nevena Simin të Novisadit; të shkrimtarit Filip David dhe të publicistit e kryetarit të Komisionit për përcjelljen e antisemitizmit në kuadrin e Lidhjes së komunave ebreite, Alekasndar Lebl. Autorit të shkrimit përkitazi me këtë temë[99] i rezultonte se gjatë okupimit gjerman dhe pushtetit kuisling të Nedić-it, në territorin e Beogradit, hebrenjtë u zhdukën në mënyrën më trishtuese në dy kampe klasike të përqendrimit - *Sajmište* e *Banjica*, dhe në dy kampe grumbullimi - *Topovske šupe* e *Milišićeva ciglana*. Nëpër kampin Sajmište gjatë vitit 1942 kaluan gjashtëmijë e pesëqind hebrenj, kryesisht gra e fëmijë, nga të cilët gati të gjithë përfunduan në kamionë për t'u transferuar ose u pushkatuan në Jajince. Vlerësohet se gjatë Luftës së Dytë Botërore në Serbi u zhduk rreth 85% e popullatës së gjithmbarshme hebraike". Historianët vlerësojnë se në *Jajince* u likuiduan prej rreth 68 mijë deri në 80 mijë hebrenj, romë, antifashistë e të tjerë. Shumë hebrenj u deportuan nga Serbia në kampe të tjera përqendrimi nëpër Europë.

"Kur flitet për shek. XX, mund të them se nga rreth 12 mijë hebrenj të Beogradit, gjallë mbetën vetëm rreth 1500 kryesisht sish të martesave të përziera. Ja ky është rezultati! Pra bashkësia hebraike e Beogradit u asgjësua dhe ajo nuk ekziston më. Asaj i gjenden vetëm gjurmë" - thotë historiania Prpa.[*]

Në këtë si lloj reportazhi, konstatohet se "Përkundër këtij fakti trishtues, edhe sot ndodhin në Serbi shumë raste të antisemitizmit".

I pyetur se si po reflektohet antisemitizmi në Serbi, Aleksandar Nećak, kryetar i Lidhjes së komunave hebraike, u përgjigj: "Nuk ka sulme fizike mbi ne, por kemi forma të ndryshme të antisemitizmit." Forma më e shpeshtë është paraqitja e përhershme e literaturës antisemite në panaire e madje edhe në librari me nam, ndër të cilat ka libra që u hapën udhë krimeve më të mëdha në historinë e civilizimit.

[99] sh. Jevrejska zajednica postoji samo u tragovima, Radio Slobodna Evropa, 27.01.2010.

[*] Autori kosovar A. Ramaj njofton se autorja Prpa, historiane dhe drejtore e Arkivit Historik të Beogradit paska thënë në një punim të sajin se para Luftës së Dytë Botërore në Beograd jetonin 12.500 ebreitë, ndërsa pas Luftës kishin mbetur vetëm 1500. Një pjesë e atyre 11.000 të tjerëve do të jetë mbytur, porse shumë ebreitë të Jugosllavisë gjetën strehim në Shqipëri. Sipas gjurmimeve më të reja, në Shqipëri u shpëtuan dhe mbijetuan edhe rreth 400 ebreitë të Dubrovnikut, për të cilët deri tani besohej se ishin likuiduar në Auschwitz.

Shkrimtari Filip David hartoi para pak kohësh një regjistër prej më shumë se 100 librash me përmbajtje të hapur antisemite e naciste "Mendoni se reagoi dikush? Askush! "- thotë ky shkrimtar.

Në një bisedë në emisionin *Most* ("Ura") të Radios "Europa e Lirë" në serbisht, që moderatori Omer Karabeg e zhvilloi me z. Dubravka Stojanović[*]: "Problemi qëndron tek manipulimi me historinë.. .. shlyhen holokausti dhe kampet e Beogradit, shlyhen ato që i bënë ljotićevc-ët dhe policia e Nediće-it që i ndihmuan Gestapo-s duke burgosur njerëz dhe duke i çuar ata nëpër kampe. Këto pjesë të historisë, thjesht, harrohen. Këto mund t'i shohim më së miri në librat e sotëm shkollorë të historisë në të cilat për këto krime nuk flitet fare, porse Nedić-i paraqitet, siç shkruan në to, për si shpëtimtar i substancës së qenies serbe.

Një pyetjeje tjetër, të shtruar nga moderatori O. Karabeg, zonja Dubravka Stojanović përgjigjej: "Çështje thelbësore për mua është se si qe e mundshme që nga viti 1945 e deri më sot as në shkolla, as në kuadër festash e festimesh dhe në gjithë ato manifestime që i patëm, kurrë nuk dëgjuam gjë për atë holokaustin të cilin as edhe e përkujtuam ndonjëherë. Përse ky (holokausti) qe pjesë e harruar e Luftës së Dytë Botërore; për ç'arsye nuk u kultivua kujtimi për hebrenjtë e mbytur edhe nuk u kultivua në atë mënyrë siç u kultivuan kujtimet për viktimat e tjera? Çështja e holokaustit është çështje primare e përgjegjësisë historike meqë në këtë morën pjesë numër i madh i shoqërive europiane, sepse kjo nuk ishte çështje vetëm e Gestapo-s dhe e Wehrmat-it, të cilave iu bashkuan shumë qeveri lokale, kuislinge e të tjera. Kjo është njëra ndër çështjet themelore të cilën Europa e gjurmon, ndërsa ne nuk merremi me të sa e meriton kjo"

b) Në Greqi

Prania e hebrenjve në Greqi dëshmohet që nga shekulli 3 para erës sonë. Mbetjet mbase më të lashta të një sinagoge, e cila pandehet të jetë ngritur midis viteve 150-200 para erës sonë, u gërmuan në ishullin Delos. Sinagoga më e vjetër ekzistuese, në përdorim, është ajo e Kahal Shalom-it në Rodos, e ngritur në vitin 1577. Në vitin 1920 në Greqi kishte 24 bashkësi hebraike dhe vetën në Selanik kishte 40 sinagoga. Nga 77.000 hebrenj, sa jetonin në Greqi deri në vitin 1940, vetën në Selanik jetonin 55.000 ebreitë sefardimë. Përkundër aksioneve për shpëtimin e tyre, siç ishte ai i arqipeshkvit Damaskinos ose ai i qytetarëve të Zakynthos-it, holokaustit i shpëtuan vetëm 14% e

[*] Që nga viti 2008, docente në seksionin për histori, të Katedrës për historinë bashkëkohore të përgjithshme në Beograd.

hebrenjve.[100] Po kështu ndodhi, sipas studiuesit Max Brym, edhe me hebrenjtë e Janinës. Ky shkruante se: "Bashkësia (hebraike, e Janinës) kishte në vitin 1939 1950 anëtarë. Më 24 mars 1944 për në Auschwitz u deportuan 1860 persona."[101]

Sot në Greqi jetojnë rrafsh 5000 hebrenj. Shumë sish martohen me të krishterë/të krishtera (dhe) kjo i kontribuon tkurrjes së hebraizmit në këtë vend.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, "Nga rreth 50.000 ebreitë të Selanikut, 46.061 sish u deportuan drejt Polonisë. Mbijetuan rreth 2.000 sish, një numër i vogël syresh u kthye në Selanik, sado që u panë si ngarkesë për qytetin. Rreth 2.000 individë që sot e përbëjnë bashkësinë hebraike, preferojnë që sa më pak të bien në sy-të eksponohen. Megjithatë, që nga viti 1997 kur Selaniku u shpall kryeqytet kulturor i Europës, në qytet ekziston një muze hebraik.[102]

c) Në Bullgari

Përkitazi me fatin e hebrenjve në Bullgari e në Maqedoni, studiuesi Bernd J. Fischer[103] konstatonte se statistika përkitazi me hebrenjtë e shpëtuar në Shqipëri "është në kontrast të prerë me gjendjen në Bullgari, e cila pretendon gjithashtu të ketë shpëtuar hebrenjtë e saj. Në Bullgari, sidoqoftë, hebrenjtë e huaj, si edhe hebrenjtë në Maqedoninë e pushtuar nga Bullgaria, iu dorëzuan gjermanëve".

E veçantë për Bullgarinë është se në këtë shtet deri në vitin 1943 nuk paska pasur ndonjë komponentë të theksueshme antisemitizmi. Siç raporton i dërguari Bec i Gjermanisë në Bullgari më 7 qershor 1943 hebrenjtë konsideroheshin nga bullgarët për si bashkëqytetarë. Ai shkruante porse që ". .. Unë jam thellësisht i bindur se kryeministri dhe qeveria (S.G. bullgare) e dëshirojnë dhe e synojnë një zgjidhje përfundimtare të çështjes së hebrenjve. Këta janë porse duarlidhur nga mentaliteti i popullit bullgar, të cilit i mungon iluminimi ideologjik, të cilin ne (S.G.: gjermanët) e kemi. I rritur me armenë, grekë e magjupë,

[100] Sipas Lena Kalaitzi-Oflidi und Simos Oflidis: "Neunzehnhundertdreiundvierzig nach Christus" http://www.hagalil.com/europa/griechenland/5768/thesaloniki.htm

[101] Hebrejtë e Shqipërisë gjatë periudhës zogiste dhe Luftës së Dytë Botërore, i botuar edhe në shqip tek http:albanisches-institut.ch/pdf/tex9pdf

[102] Sipas Lena Kalaitzi-Oflidi und Simos Oflidis: "Neunzehnhundertdreiundvierzig nach Christus" http://www.hagalil.com/europa/griechenland/5768/thesaloniki.htm

[103] Hebrejtë e Shqipërisë gjatë periudhës zogiste dhe Luftës së Dytë Botërore, i botuar edhe në shqip tek http:albanisches-institut.ch/pdf/tex9pdf

bullgari nuk sheh kurrfarë dëmi nga hebrenjtë, që do të mund ta arsyetonte marrjen e masave të veçanta"[104] ndaj hebrenjve.

Mirëpo autoritetet bullgare aprovuan megjithatë, sipas referimeve gjermane, legjislaturë antihebraike e cila i afrohej asaj gjermane. Kjo filloi me aprovimin e Ligjit mbi mbrojtjen e kombit nga parlamenti bullgar më 24 dhjetor 1941. Me këtë ligj u reduktuan të drejtat e hebrenjve dhe u hap udha për përndjekjen e tyre.[105] Në korrik të vitit 1942 parlamenti bullgar e miratoi Ligjin për autorizimin e Këshillit të Ministrave për zgjidhjen e çështjes hebraike", të cilin e nënshkroi mbreti Boris. Pasoi vendimi i Komisariatit për Hebrenjtë, përmes të cilit urdhërohej që të gjithë njerëzit me prejardhje hebraike duhej domosdo ta mbanin distinktivin e Yllit të Davidit. Këshilli i Ministrave e aprovoi më 2 mars 1943 "Zhvendosjen-shpërnguljen" e 20.000 hebrenjve. Atasheu për Policinë Hoffmann i përfaqësisë gjermane në Sofje, e njoftonte Berlinin më 5 prill 1943 se "Këshilli i Ministrave e kishte miratuar vendimin e komesarit për hebrenjtë, që të sigurohen mjetet e transportit dhe kampet për hebrenjtë nga Maqedonia e Trakia, si edhe për ata të territorit të Bullgarisë së Vjetër. Njëkohësisht u aprovua një ligj sipas të cilit hebrenjve që do të shpërngulen u merret nënshtetësia bullgare. Ligji u aprovua edhe nga Sobranje (Paralamenti) i Bullgarisë." […] Sado që legjislatura antihebraike e Bullgarisë përputhej pothuajse plotësisht me ligjet gjermane, pati kundërshtime nga ana e popullit bullgar. […] Zyrtari gjerman dr. Pau raportonte më 3 prill 1943 se "Vendimi për shpërnguljen në hapësira të Lindjes (së Europës) hasi në disa kundërshtime. Ministri bullgar i punëve të brendshme ishte p.sh. i mendimit për koncentrimin e hebrenjve në kampe brenda Bullgarisë dhe për angazhimin e hebrenjve për punë publike, konkretisht në ndërtimin e rrugëve. Përkrah kësaj, kishte dhe ka qarqe që e miratojnë shpërnguljen (e hebrenjve), porse për në Palestinë. Në këtë mes operohet kryesisht në rrafshin humanitar. Në Sobranje, u shtrua para pak kohësh kërkesa që të ndërpritet deportimi i hebrenjve sepse fati që hebrenjtë i pret në shtetet e Lindjes (së Europës) i shkel rregullat elementare të njerzishmërisë."[106]

[104] Justiz und NS-Verbrechen Lfd.Nr.690a (Ausschnitt), http://www1.jur.uva.nl/junsv/excerpts/690002.htm

[105] Po aty.

[106] Justiz und NS-Verbrechen Lfd.Nr.690a (Ausschnitt), http://www1.jur.uva.nl/junsv/excerpts/690002.htm

d) Në Maqedoni

Sikundër u pa më lart, hebrenj kishte edhe në Maqedoni, përkatësisht në Manastir e në Shkup. Si edhe gjetiu, edhe këtu pati një bashkëjetesë të haromonishme midis vendësve dhe hebrenjve. Për bashkëjetesën e hebrenjve me popullatën shumicë shqiptare të qytetit të Shkupit, flet mbase edhe rrethana që në gojën e qytetarëve, siç u tha me rastin e hapjes së Muzeut Hebraik të Shkupit, kjo bashkëjetesë njihej me sintagmën "bashkar e barabar",[107] që mbase do të jenë formuar nga fjala shqipe *bashk* dhe huazimi turk *barabar* i shqipes.

"Kjo bashkëjetesë përfundoi dhunshëm në fund të vitit 1943. Ushtarë të pushtuesit bullgar i grumbulluan hebrenjtë në Shkup. 7. 144 njerëz - pothuaj se e gjithë bashkësia hebraike - u deprotuan prej aty me tren më 3, 25 dhe 29 mars 1943 për në kampin e shfarosjes në Treblinka.[108]

Pas mbarimit të Luftës, rreth 50 të mbijetuar e rithemeluan Bashkësinë Hebraike. Kjo bashkësi ka sot rreth 200 frymë.[109]

Radio "Zëri i Amerikës" njoftoi se më 12. 3. 2012 në qendrën përkujtimore të Holokaustit në Shkup u zhvilluan ceremoni përkujtimore për shtatë mijë hebrenjtë e Maqedonisë, me rastin e 69-vjetorit të deportimit të mbi shtatë mijë hebrenjve nga Maqedonia gjatë Luftës së Dytë Botërore për në kampin nazist të Treblinkës. Me këtë rast u tha se asnjë nga hebrenjtë e këtij komuniteti nuk i shpëtoi shfarosjes. Për deportimin e komunitetit hebraik nga qytetet e Shkupit, Manastirit dhe Shtipit, autoritetet maqedonase i fajësojnë forcat bullgare të kohës që kontrollonin territorin e Maqedonisë së sotme.[110]

13. VENERIME PËRMBYLLËSE

Nga sa mund të mësohet nga literatura e shfrytëzuar për këtë punim dhe nga shkrimet e autorëve që citohen në këtë trajtesë, ngulimet hebraike në hapësirat etnohistorike të shqiptarëve zënë fill që në shek. I–IV të erës sonë. Ky hark kohor është përcaktuar në dritën e studimeve kompetente nga arkeologë shqiptarë e të huaj të mozaiqeve të zbuluara në vende që mbahen se ishin bazilika/sinagoga hebrenjsh. Të këtilla janë zbuluar në Durrës, Vlorë, Sarandë, Elbasan, Tiranë (Shqipëri) dhe në

[107] Simone Böcker, Leben, lernen und Ladino, www.juedische-allgemeine.de/article/view/id/10536

[108] Sipas Benz, Dimension, Dimension des Völkermords. Die Zahl der jüdischen Opfer des Nationalsozialismus, f. 327.

[109] Simone Böcker, poaty.

[110] Radio "Zëri i Amerikës" 12.3.2012.

Shtip, Shkup e në Manastir (sot Maqedoni), prandaj edhe paravendohet se në këto vende do të ketë pasur, patjetër, koloni hebrenjsh. Për gjurmë të lashta, mbase të para shek.VII merren edhe "Vorret e Çifutëve" në Shkopet të krahinës së Matit në Shqipëri dhe disa gurë varrezash në Mal të Zi. Valët më të moçme të arratisjeve të hebrenjve lidhen me rezistencën e tyre ndaj pushtimit romak dhe me deportimin e dhunshëm të tyre nga romakët (në vitin 70 të erës sonë) nga atdheu i tyre si trofe lufte.

Sado që është dëshmuar se në disa qendra të Shqipërisë si Durrësi, Vlora e Janina hebrenj kishte edhe në shek. XII, vala më e madhe e vendosjes së hebrenjve në hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve ndodhi në shekullin 15. Kjo është e lidhur me dëbimin e hebrenjve më 1442 nga Spanja dhe pesë vite më vonë edhe nga Portugalia. Duket se pjesa më e madhe e hebrenjve u vendos asokohe në Selanik e pjesërisht edhe në qytete të Shqipërisë në të cilat ngulime hebrenjsh kishte edhe shumë shekuj më parë.

Për sa i përket hapësirës së sotme të Kosovës, dëshmia konkrete arkeologjike për praninë e hebrenjve, përkatësisht e judeokrishterimit në Dardaninë e periudhës romake, para shpalljes në vitin 313 të Ediktit të Milanos, është një pllakë prej guri e murosur shumë shekuj më vonë në murin rrethues të Patrikanës së Pejës. Konsiderohet se kjo pllakë do të jetë sjellë aty nga ndonjë vend tjetër (S.G. - ndoshta nga vendbanimi antik i Fushës së Pejës). Pllaka ka një paraqitje figurale në qendër të së cilës është heksagrami apo simboli çifut Mogen David i cili nga të dyja anët ka nga një qiparis dhe nën këto janë figurat e tre peshqve. Sipas veçorive tipologjike dhe ikonografike, pllaka ka elemente romake, hebraike dhe krishtere dhe si e tillë e dëshmon prezencën e judeokrishterimit në Dardaninë e periudhës romake. Përsa i përket destinimit të pllakës, N. Ferri sqaron se njëra nga mundësitë është që kjo të ketë qenë pjesë e një osuari, meqë çifutët në antikë shpeshherë i mblidhnin eshtrat e të ndjerëve në recipiente prej guri, mbi të cilat venin simbole religjioze. Në bazë të materialit prej të cilit është punuar, mund të thuhet që pllaka (apo pjesa e osuarit) është prodhim lokal dhe mund ta ketë punuar edhe ndonjë çifut gurgdhendës (S. G. vendës) për vete apo për ndonjë familjar të tijin. Kjo mundësi është aq më reale po të merret parasysh fakti që në kuadër të vendbanimit antik në Fushë të Pejës janë zbuluar gjurmë të ekzistimit të një punëtorie gurgdhendëse të periudhës antike. Për autorin tonë, "monumenti në fjalë [...] është dokument i rrallë i cili flet mbi prezencën e hershme të hebrenjve dhe të judeokrishtërimit

në Dardani, respektivisht në trevën e Pejës së sotme, si dhe lidhur me fillet e arritjes së besimeve monoteiste në këtë trevë".

Kolegia e tij, Exhlale Dobruna, për gjurmë hebraike në Dardani e sjell skalitjen e pëllëmbës së dorës në monumente mbivarrore. E këtillë është një stelë mbivarrore prej mermeri, mbase e fundit të shek. II ose fillimit të shek. III, e zbuluar në nekropolin lindor të Scupi-t antik. Mbizotëron mendimi se meqë kjo stelë me motivin e pëllëmbës, përkatësisht të duarve të ngritura, është zbuluar në atë pjesë të nekropolit ku materiali i gjetur (sarkofagu dhe llambat) tipologjikisht i korrespondon vetëm atij të gjetur në Siri dhe në Palestinë, do t'i ketë takuar një të ndjeri me prejardhje semite. "Në ditët e sotme, çka edhe është me më rëndësi, motivin e dorës në këtë paraqitje ikonografike e hasim në pllakat e varrit të hebrenjve në varrezat që gjenden në lagjen Velania të Prishtinës [...] që është për t'u besuar se ka të bëjë me një trashëgimi të këtij zakoni të lashtë semit. Bazuar në këtë fakt, do të theksonim se ky motiv i skalitur në stelën e Skupit antik flet në të mirë të pranisë së hebrenjve që herët në trevën dardane, të cilët këtë motiv, duke e bartur me vete, e ruajtën deri në ditët e sotme mu edhe në këtë trevë." - përfundon autorja jonë.

Një koloni e vogël hebrenjsh dëshmohet në shek. XVI për në qytetin e lashtë Novobërdë të Kosovës. Duket se këta do të jenë hebrenj të ardhur nga Selaniku.

Gjatë gjithë këtyre shekujve në hapësirat etnolinguistike të shqiptarëve nuk pati shenja antisemitizmi. Para dhe pas Luftës së Parë Botërore bashkësi hebrenjsh kishte në Elbasan, Vlorë, Berat, Delvinë, Sarandë, Shkup, Manastir, Shtip, Prishtinë, Pejë, Prizren. Jetesa e hebrenjve (edhe) në këto hapësira u turbullua sidomos gjatë Luftës së Dytë botërore. Të dhënat arkivore, historike dëshmojnë se Shqipëria ishte i vendimi vend i Europës në të cilin gjatë viteve të Luftës kishte më shumë hebrenj se ç'kishte pasur më parë. Shqipëria, si edhe Danimarka, është i vetmi vend i Europës që nazistëve nuk ua dorëzoi asnjë hebre. Pjesa dërmuese e hebrenjve të Maqedonisë, përkatësisht të Shkupit, të Manastirit, Shtipit etj. u deportuan në kampe të përqendrimit nga qeveria bullgare, që atëherë e kishte pushtuar Maqedoninë. Pandehet se edhe ndonjë (ose disa) hebrenj të Kosovës, përkatësisht nga sish që ishin strehuar në Mirtovicë e që pritnin të kalonin në Shqipëri na qenkan transferuar në Shqipëri, kinse me listë që do t'u dorëzohej nazistëve. Shifrat që jepen përkitazi me hebrenjtë të Kosovës, që kinse do të kenë pësuar midis viteve 1941-1945 sillen nga 150 (sipas Čedomir Prlinčević); 210 ose 38% e hebrenjve (sipas W. Oschlies); 281 ose 40% e hebrenjve të Kosovës (sipas Bernd J. Fischer dhe N. Malcolm) ose madje 500 të tillë

sipas një shkruesi nga Shqipëria). Meqë ende nuk janë hapur arkivat në Beograd e në Prishtinë, të gjitha të thënat më sipër mbeten hamendje të cilat i demanton sjellja e shqiptarëve ndaj ebreitëve të gjithë hapësirës gjuhësore-kombëtare të shqiptarëve.

Ka porse edhe individë hebrenj që e vënë në dyshim thënien e përhapur gjithandej se Shqipëria na qenka i vetmi vend i Europës që i strehoi dhe i shpëtoi jo vetëm të gjithë hebrenjtë vendës, porse edha ata të vendosur përkohësisht në Shqipëri. I këtillë është p.sh. përkthyesi i disa veprave nga gjermanishtja në shqip dhe përkthyesi për 16 vite me radhë i seksionit gjerman të Radio Tiranës, Robert Schwartz, familja e të cilit, kur ky ishte vetëm 6 vjeç, ishte arratisur nga Sarajeva dhe ishte vendosur në Shkodër.

"Në një rrëfim autobiografik, shkruar si letër të birit, Robert Schwartz shpreh mospajtim me frazën e komunistëve të Tiranës se Shqipëria ishte vendi i vetëm që shpëtoi hebrenjtë në Europë. Kjo, sipas tij, s'është e vërtetë, sepse, ta zëmë, Danimarka i kishte shpëtuar të gjithë hebrenjtë, duke i çuar natën në Suedi. Edhe Bullgaria njihet për kujdesin ndaj hebrenjve, por edhe Italia. Schwartz nënvizon se pas Luftës së Dytë Botërore komunistët shqiptarë u vunë haraç tregtarëve hebrenj, u sollën keq ndaj tyre, ua morën pasurinë, sidomos floririn, i rrasën nëpër burgje etj. Gjatë Luftës së Dytë i ati i Robertit, Juliusi, kishte në Tiranë një dyqan shitjeje materialesh elektrike, të cilin e kishte hapur me një ortak: "Edison, Ahmet Hoti & Shoku". Shoku ishte Julius Schwartz, i cili nuk guxonte të vendoste emrin e tij në tabelën e dyqanit derisa në Tiranë ishin gjermanët dhe mbështetësit e kolaboracionistit Xhafer Deva. Pas përfundimit të luftës, familja Schwartz u godit nga komunistët e Enver Hoxhës: në dhjetor 1944 u konfiskua dyqani dhe u arrestua gjyshi i Robertit, Siegfried Schwartz, i cili pas pak muajsh vdiq nga zemra në burg. Në mars 1953 për pak u arrestua edhe Robert Schwartz-i. Atëbotë ai po kryente shërbimin ushtarak dhe dikush e kishte denoncuar se në ditën e vdekjes së Stalinit, më 5 mars 1953, paskësh qeshur bashkë me disa shokë. Vetë Schwartz thotë me ironi se i shpëtoi burgosjes, "sepse isha 'snajperi' më i mirë i divizionit".[111]

Duket se çështja e strehimit dhe e shpëtimit të hebrenjve u ngjyros jo pak edhe për përfitime në rrafshin politik. Mua më duket se këtë e ilustron mjaft mirë kryeministri i Republikës së Shqipërisë i cili (sipas gazetës amerikane "The Hill" kishte thënë: "Si Kryeministër i Shqipërisë, unë nuk dua të sugjeroj se virtytet dhe vlerat që bashkatdhetarët dhe

[111] Enver Robelli, Udhëtarët e dobishëm, në "Koha ditore", 12 shkurt 2013.

bashkatdhetarët e mia shfaqën janë unike për traditën tonë. Historia tregon se në shumë vende (S.G. në rend të parë shembulli ekzemplar i Danimarkës) - midis tyre Polonia, Holanda, Norvegjia, Franca, Italia, Greqia dhe vetë Gjermania - kanë pasur njerëz të drejtë që shpëtuan hebrenjtë dhe anëtarë të minoriteteve të tjera të pambrojtura nga tmerret e holokaustit.", prandaj nuk janë vetëm shqiptarët ata që i strehuan e i shpëtuan hebrenjtë.

Kjo bëhet e qartë edhe në dritën e rrethanës që "Monumenti zyrtar izraelit Yad Vashem, kushtuar viktimave të holokaust-it, ua ka njohur meritat gati 25 mijë të të ashtuquajturve "njerëz të drejtë" të cilët i kanë rrezikuar jetët e tyre për t'i mbrojtur hebrenjtë gjatë regjimit nacist.[112], midis të cilëve bien pra edhe 69 shqiptarë.

[112] Sipas "Slobodna Europa", 21.4.2013.

NDIHMESË PËR NJË HISTORI TË ROMËVE, HASHKALINJVE DHE "EGJIPTASVE" NË KOSOVË"

Përmbajtja

NDIHMESË PËR NJË HISTORI TË ROMËVE, HASHKALINJËVE DHE "EGJIPTASVE" NË KOSOVË 367

0.1. VENERIME TË PËRGJITHSHME: 367
1. RRETH PREJARDHJES DHE KUPTIMIT TË EMRAVE 368
1.1. Rom 368
1.2. Sinti 369
2. RRETH KOHËS SË DYNDJES DHE SHTRIRJES TERRITORIALE TË ROMËVE 370
3. ARDHJA E ROMËVE NË EUROPË 377
4. FILLET E STUDIMIT TË GJUHËS ROMANI, ROMANÉ, ROMANES 382
4.1. Veçori të përgjithshme të gjuhës rómani, rómanes 387
4.2. Morfologjia e gjuhës rómane, romanes 388
4.3. Ndarja në dialekte e gjuhës rómani 389
4.4. Grupi i Europës Veriore 390
4.5. Grupi i Europës Qendrore 390
4.6. Grupi vllah 391
4.7. Grupi ballkanik 392
4.8. Grupi Barutija 393
4.9. Grupi Topanali; romët topanë 393
4.10. Grupi Maxhuri 394
4.11. Grupi Meçkarija / Majmunxhija (khs. edhe Ursari - Romani) 394
4.12. Grupi Juzhari; quhet edhe konoplarja "mbjellës të bimës së kanpit" ... 394
4.13. Grupet: Dasikane Roma; Gadikane Roma; Mýsýr Mangýr; Kërci (Kýrýtsi); Gjuptin 395
4.14. Grupi Gavutne 396
4.15. Gupi arli, arlij, arlije "vendës" 396
4.16. Grupi Tamara: 396
5. PARAVENDIME RRETH NUMRIT TË ROMËVE 397
6. ROMËT NË HAPËSIRËN GJUHËSORE E ETNIKE SHQIPTARE 400
6.1. Romët në Kosovë 402
7. HASHKALINJTË: 407
7.1. Aškalija (Haškalija)/ Malokija / Cibane Roma / Albanski Roma / Magjupi (Maxhup / Maxhyp) Aškalija (Haškalija)/ Malokija / Cibane Roma / Albanski Roma / Magjupi (Maxhup / Maxhyp) 407
8. GABELËT 410
9. INTEGRIMI I GUPEVE ROME NË SHOQËRINË KOSOVARE 416
10. JETA SOCIALE 418
11. DOKE E ZAKONE: 420
12. RELIGJIONI 420
13. PROFESIONET 422
14. FESTAT 423
14.1. Gjys(m)at e Dimnit/Vasilicat/Viti i Ri i romëve 423

14.2. Dita e Shën Gjergjit 424
14.3. Muzika 424
15. "EGJIPTIANËT" OSE SHPIKJA E NJË ETNIE TË RE ? 424
15.1. "Vërtetimi" shkencërisht i ekzistimit të etnisë "egjiptase" në Kosovë .. 430
16. LUFTA PËR KOSOVËN DHE ROMËT, HASHKALINJTË E "EGJIPTASIT" 439
17. HIMNI I ROMËVE NË GJUHËN ROMANE 443
18. PËRFUNDIM 444
19. MATERIALE 451

NDIHMESË PËR NJË HISTORI TË ROMËVE, HASHKALINJËVE DHE "EGJIPTASVE" NË KOSOVË

"Përkundër rezervave të mëdha që i kisha, unë e miratova më në fund intervenimin e NATO-s në Kosovë, në mënyrë që të përfundonte krimi mbi shqiptarët dhe që të dëbuarit të mund të ktheheshin. Tani po përjetojmë dëbime të reja; jemi dëshmitarë se si sot urrejtja po vazhdon kundër romëve. Së këndejmi apeloj tek ministri i punëve të jashtme Joschka Fischer dhe tek ministri i mbrojtjes Rudolf Scharping, të cilëve iu dasht po ashtu t'i mposhtin rezervat kundër këtij intervenimi por që tani po konfrontohen po ashtu me përndjekjen e romëve e të serbëve, që ta rishikojnë këtë çështje. Dhe, në emër të Fondacionit të ngritur nga unë për romët e për sintit në të mirë të popullit rom, unë i përkrah kërkesat e Shoqatës për popujt e rrezikuar"

Günter Grass, më 3 shtator 1999.[1]

0.1. VENERIME TË PËRGJITHSHME:

Popullatës me ngjyrë çokollate të lëkurës, e cila është e shpërndarë gjithandej jashtë atdheut të saj të kryehershëm të Indisë e të Pakistanit nëpër Europën Perëndimore, Veriore, Jugore, Juglindore dhe nëpër shtete të Ballkanit dhe si rezultat i migrimeve edhe në shtetet tejoqeanike, përkastësisht SHBA e gjetiu në kontinentin e Amerikës iu kthye, duke filluar prej diç më pak se 30 vitesh, emri përmbledhës *rom* (për emrat e tjerë sh. më poshtë) e rrjedhimisht edhe emri i gjuhës së asaj popullate *rómane* / *romanes.*

Fillimisht, romët vetë nuk përdornin ndonjë emër përmbledhës për veten. Në vend të një emri të këtillë, ata kishin emra grupesh të veçanta të etnisë së përbashkët. Këta emra të grupeve, degëve të së njëjtës etni, mbështeteshin atëherë e sot ose tek gjeografia, përkatësisht tek emrat e

[1] Unter den Augen der KFOR: Massenvertreibung der Roma, Aschkali und Kosovo-Ägypter aus dem Kosovo, Report von Tilman Zülch und Paul Polansky mit einem Appell von Güngther Grass, http/www.gfbv.de/dokus/roma2_. htm

regjionit-rajoneve të prejardhjes së tyre ose tek profesionet e ushtruara nga ata - varësisht mbase nga kastat të cilave u përkisnin në atdheun e kryehershëm të tyre, Indi. Ka gjithsej rreth 60 emërtime për grupe të ndryshme të etnisë së njohur me emrin e kryehershëm dhe këtë modern etnik *rom*.[2]

Varësisht nga vendi ku jetojnë, përkatësisht nga shkalla e asimilimit të kësaj popullate, romët vetë e quajnë sot veten: *rom* (njëjës mashk.), *romni* (nj. f.), *roma* (Rom[a]) (shm. m.), *romnia* (romnia) (shm. f.)**;** *sinto, sintica*, (Sintizza), *sinti* (e), *sintice* (lexo: Sintizze); *manuš, manuš*(*a*) - në Francë; *kaló* / *kalé* - në Spanjë dhe *beaš* (skllavë të dikurshëm të bojarëve?, apo rasa rrjedhore e rum. *bajesi* - "shpërlarës ari"). Beasët e Sllavonisë e të Hungarisë jugore e flasin dialektin e rumanishtes së vjetër.

1. RRETH PREJARDHJES DHE KUPTIMIT TË EMRAVE

1.1. Rom

Emri i parë *rom*, përkatësisht shumësi i tij *romá* shm. shqip romë, ndryshe nga dy grupet e tjera variante, nuk përdoret vetëm si etnonim i mirëfilltë, sepse kuptimi i parë i saj është "burrë, bashkëshort dhe njeri" fem. *romni* "grua; e shoqja, bashkëshortja e një romi", ndërsa në kuptimin e dytë është një emër përmbledhës për të gjitha grupet e popullatës së shkapërderdhur gjithandej që e quan veten rom. Me këtë nocion nënkuptohen edhe *sinti*-t e *kale*-t dhe të gjitha 60 nëngrupet e kësaj etnie. Emri rom ka pra kuptim të dyfishtë. Së pari, si nocion përmbledhës, kjo fjalë e emërton popullatën rome në përgjithësi, ndërsa i dyti i emërton romët "e mirëfilltë" si grup specifik - për ndryshim nga grupet simotra të *sinti*-ve dhe të *kale*-ve. Kuptimin etnik e kanë pothuaj pa përjashtim sinti, (të quajtur në Francë *Manuš* dhe *Romanicel*, *Romano*) dhe *Kalo-Caló* përkatësisht shumës *Kale* - *Calé* - siç njihen këta në Spanjë.

Për prejardhjen dhe domethënien e emrit *rom* ka mendime të ndryshme. Kështu p.sh. dijetarë indas e kanë shfaqur mendimin se emri i romëve po rrjedhka nga emri *Rama* i hyjnisë indase[3] të Diellit, emër ky që në indishten e vjetër e ka edhe kuptimin e dytë për "njerëz që i ushtrojnë artet e bukura, përkatësisht muzikën dhe vallëzimin".[4] Këtë sqarim e aktualizoi

[2] Christiane Kostov Fennesz - Juhasz/ Dieter W. Hawachs/ Mozes F. Heinschnik: Sprache und Musik der österreichischen Roma und Sint http:/www-gewi.kfunigraz.ac.at./romani/downlaod/files/_ab5.pdf.

[3] Sipas Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken, Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

[4] Geschichte und Sprache der Roma http://www.kbk.at/roma/Container/Vortrag-2000-M%E4rz.htm

kohëve të fundit linguisti bullgar Hristo Kyčukov. Korrektësia e këtij interpretimi duhet të provohet më bindshëm. Dijetarë europianë, nga ana tjetër, mbase duke u nisur nga paravendimi pse romët e shpërngulur nga India rridhnin nga kasta të ulëta të shoqërisë së asokohshme indase, përkatësisht nga kastat *dom* e *changar* të muzikarëve e të valltarëve, kujtuan se emri etnik i romëve do të mund të jetë i barabartë për nga kuptimi me emrin e kastës indase *dom*[5] të fisit indas joindoeuropian të dravidëve, pjesëtarët e të cilit i takonin një kaste shumë të ulët të shoqërisë indase. Mirëpo në Fjalorin e sanskritishtes si edhe në eposin Mahabharata dhe në kallëzimet Visnbu-purana përmendet populli, fisi, *romas*, *romakah*, *romakash* etj. Bile, sipas emrit të kësaj popullate quhen edhe disa male e lokalitete në regjionin Rajasthan e në regjione të tjera të Indisë, gjë që e hedh poshtë lidhjen e kësaj popullate me *dom*-ët joindopeuropianë.[6]

Nga emri *rom* u zhvillua në rrjedhë të kohës një kompleks kuptimesh nga më të ndryshme. Përkrah shprehjes si *Romani chib* "gjuha, [organ i të folurit]; gjuha rómane", *Romano pacape* "besimi rom, feja rome" emri *rom* dhe mbiemri *rómano* karakterizonin edhe shumë sfera të institucioneve shoqërore e kulturore duke filluar që nga dasma e bashkëshortësia për të vazhduar me mënyrën e banimit e të ushqimit e deri tek ndjenjat dhe botëkuptimet si p.sh. *Romani duk* "vaji, zia, pikëllimi rom", *Romani baxt* (lexo baht) "fati rom, i romëve", *Romano djit* "shpirti rom", *Romani godji* "mençuria, spirtualiteti rom" etj.[7]

Distinktivi *rom* për etnikumin e ardhur nga India në Europë nuk ka asgjë të përbashkët as me emrin e qytetit të Romës, as me emrin e Perandorisë Romake dhe as me emrin e rumunëve.

1.2. Sinti

Popullata rome përbëhet (sh. edhe më lart) nga dy grupe të mëdha të quajtura *rom* dhe *sinti*. "Roma" quhen të gjithë ata romë që jetojnë në Europën Juglindore e atë të Mesme, përkatësisht ato grupe romësh që fillimisht nga Azia e Vogël përmes Ballkanit - duke filluar nga sheulli 14 dhe në hope edhe gjatë shek. XIX e XX - u shpërngulën në vende të Europës Perëndimore dhe në SHBA.

---

[5] Geschichte und Sprache der Roma: http://www.google.at/search?q=Ky%C4%8Dukov%2C+Roma+-Volksgruppe&ie=UTF-8&oe=UTF-8&hl=de&btnG=Google+Suche&meta=

[6] Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm

[7] Po ai, po aty.

"Sinti"-t janë grup etnik, emri i të cilit e heq prejardhjen nga emri i provincës *Sindh* të Pakistanit dhe që në hapësirën gjuhësore të gjermanishtes, pjesërisht edhe të rumanishtes, arriti nga fundi i shek. XIV. Që atëherë kjo popullatë mbahet për ndenjëtare dhe për gjuhë amtare e ka gjermanishten.[8]

Për shkak të rrethanës se në Europën Perëndimore shumë pjesëtarë të grupit etnik *sinti* nuk duan të trajtohen për romë, në këtë hapësirë u farkua nocioni përmbledhës "romë e sinti" dhe njëkohësisht edhe termat "*rom, sinti, manush* dhe *kalé* me kuptimin "njeri, njerëz", një emërtim përmbledhës ky për një kastë inidase të vallëzuesve, muziktarëve dhe të këngëtarëve.

2. RRETH KOHËS SË DYNDJES DHE SHTRIRJES TERRITORIALE TË ROMËVE

Mendimet e dijetarëve për prejardhjen e romëve dhe për gjuhën e tyre, të shfaqura gjatë shekujve 17 e 18, mund të cilësohen për si spekulime nga më të egrat. Ka pasur p.sh. një mendim sipas të cilit romët e kryehershëm në Gjermani e hiqnin prejardhjen e tyre nga çifutët e Gjermanisë.[9] Një mendim tjetër ishte ai sipas të cilit romët qenkan një përzierje e dalë nga etiopiasit, trogloditët (degë e mongolëve) dhe nga egjiptasit, ndërsa për gjuhën e romëve thuhej p.sh. më 1781 se ajo qenka një përzierje e gjermanishtes, jidishtes, hebraishtes dhe fjalësh fantastike".[10]

As deri në ditë tonat nuk dihej edhe aq shumë për popullatën (rome), me përjashtim të asaj pjese që jeton në Japoni e në Kinë, që njihet për si popullatë nomade dhe që ka emra të ndryshëm. Popuj të ndryshëm kanë emra të ndryshëm për këtë popullatë. Kështu p.sh. hungarezët e quajnë popullatën rome *Cigáni* /*Cigany* ose edhe *pharao népe*; për holandezët pjesëtarët e kësaj popullate janë "*paganët*"; në Finlandë i quajnë *mustalainë* "të zinjtë";[11] për gjermanët e pjesës veriperëndimore të këtij shteti dhe për suedezët romët janë *tatarë* sepse praninë e tyre e lidhnin me depërtimet tatare, përkatësisht mongole në ato vende. Francezët i quajnë edhe *bohemiens* në bazë të emrit të njërës nga dy njësitë: Bohemia (që e përbëjnë Çekinë e sotme) prej nga romët janë vendosur në Francë. Popuj të

[8] Po ai, po aty.

[9] Annelore Hermes, (Referentin im Bundesbüro der GfbV (Göttingen), Noch in keinem Land sind ihre Menschen- und Bürgerrechte gesichert.

[10] Dieter W. Halwachs: Romani - Versuch eines einführenden Überblicks http://www gewi.kfunigraz.ac.at/romani/ling_all/ling_all.de.html

[11] Po ai, po aty.

tjerë, si p.sh. anglezët, spanjolët, italianët, shqiptarët e grekët e quajnë këtë popullatë me emrin e atdheut të supozuar gabimisht të kryehershëm të tyre, përkatësisht Egjiptin (për këtë të fundit sh. më poshtë)

Për shumicën e pjesëtarëve të kësaj popullate ndodhi para rreth njëmijë vitesh një ekzodus nga atdheu i saj i kryehershëm në Indi e në Pakistan. Mbështetur mbi bazën e të dhënave nga dija e historisë dhe e gjuhësisë krahasimtare, prejardhja nga India e romëve qenka dëshmuar që para 200 vitesh nga Johann Christian Rüdiger. Ky është i pari që në librin e tij "Von der Sprache und Herkunft der Zigeuner aus Indien" ("Rreth gjuhës dhe prejardhjes së ciganëve nga India") të botuar qysh më 1782 e hetoi birësinë e gjuhës së romëve (që është edhe gjuhë e sinti-ve) me gjuhët e folura në Indi dhe e determinoi gjuhën rómane/romanes si njërën nga gjuhët indoeuropiane.[12] Thelbi i kësaj gjuhe është sanskritishtja. Sipas leksikut bazë dhe të sistemit gramatikor, gjuha *rómani*/ *romanes*, përkatësisht *romani chib* është një gjuhë neoindoarabe, përkatësisht indoeuropine.[13] Dijetari Pott përcaktoi se djepi i gjuhës romani është India Veriore dhe se kjo gjuhë "është në lidhje birësie me sanskritishten zulmëmadhe", prandaj është një gjuhë indoariane, përkatësisht indoeuropiane e cila flitet pa përjashtim vetëm jashtë Indisë. Vendi i gjuhës romani në gjirin e degës indoiraniane të indoeuropeishtes pasqyrohet në tabelën e hartuar nga Dieter Halwachs, të cilën ne për shkaqe teknike nuk po e paraqesim në formë tabele, por të thjeshtësuar grafikisht: *Gjuha indoariane* → *sanskritishtja* → *prakritishtja* → *bengalishtja* → *gujaratishtja* → *gjuha hindi* → *kashmiri* → *maharati* → *panxhapi* → *romani* → *sind-hi* etj. [13]

Motivet për shkaktimin e migrimit të romëve janë të natyrës politike e ekonomike: në rend të parë shpërthimi i konfrontimeve luftarake. Dëbimi dhe përndjekja, por ndoshta edhe skamja, i detyruan këta të shpërnguleshin. Romët ushtronin në të shumtën e herës profesionet e dajrexhinjve, muziktarëve e të tregtarëve. Në dritën e këtij supozimi, do të dilte se i aushtuquajturi "motiv i lindur i nomadizmit" i romëve duhet parë si një paragjykim biologjik dhe si një klishe e një qëndrimi romantik.[14] Ky konstatim do të qëndronte nëse nuk u besohet njoftimeve nga shkrimtarë e historianë të Persisë së shek. X (për këtë sh. më poshtë).

---

[12] Sipas Geschichte und Sprache der Roma http://www.kbk.at/roma/Container/Vortrag-2000-M%E4rz.htm

[13] Dieter W. Halwachs: Romani - Versuch eines einführenden Überblicks http://www-gewi.kfunigraz.ac.at/romani/ling_all/ling_all.de.html.

[14] Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

Megjithatë, si harku kohor i kësaj dyndjeje ashtu edhe çështja e vendit prej nga ndodhi kjo dyndje kanë mbetur për disa dijetarë deri në ditë tonat një çështje e kontestueshme. Kontestuese është nëse romët u shpërngulën nga viset midis Indisë Veriore e të Persisë (sot Iran) si edhe shtigjet e shtegtimit dhe farefisëria e mundshme e tyre me grupe etnike të ngjashme të romëve që sot jetojnë në të njëjtën hapësirë. Dyndja nga India nuk ndodhi në formë të ndonjë shpërnguljeje të organizuar, porse në grupe të vogla dhe në kohë të ndryshme, midis shekujve 5 e 7 kur ndodhi dyndja migrative midis Indisë e Persisë dhe më vonë dyndja pas pushtimit të Persisë e të Indisë nga arabët midis shekujve 7 e 10. Ka të dhëna sipas të cilave shahu Adashi i Persisë e pushtoi në shekullin 3 Indinë Veriore dhe e shndërroi atë në koloni. Pasojë e këtij pushtimi ishte që një masë indasish shkuan të punonin në Persi. Praninë e indasve, përkatësisht romëve në Persi burimet e dëshmojnë që nga shekulli 5 i erës sonë.[15] Vështruar nga këndshikmi i një joromi, një lajm të kësaj natyre e gjejmë tek poeti kombëtar persian Firdusi i cili në Librin Mbretëror "Shah-Name" (Historia e vendit në 60.000 vargje) shkruan rreth vitit 1010 të erës sonë: "Bahram Gur (420-438), Shah i Persisë, donte ta zbuste mundimin e të nënshtruarëve të tij duke sjellur nga India [...] 10.000 muzikantë, valltarë e zhonglerë. Mbreti i furnizoi ata me farë drithërash, gjedhë e gomarë në mënyrë që t'i bënte ata ndenjëtarë në shtetin e vet [...], mirëpo ata u bishtëruan, siç thuhet, farës së drithërave e gjedhëve dhe vazhduan të silleshin gjithandej me gomarë duke e ushtruar zejen e argëtuesve elitarë". Përafërsisht të njëjtën gjë e kumton rreth vitit 950 të e. s. edhe historiani persian: Që popullit të vet t'ia lehtësonte punën (mbreti i Persisë) e luti mbretin e Indisë Shangul që t'ia dërgonte 12.000 muziktarë.[16]

Mbi bazën e rezultateve linguistike mund të përfundohet se grupi kryesor i të ashtuquajturve romë *Phen* kishte arritur në hapësirën e perandorisë bizantine nga Armenia para arabizimit të Azisë së Mesme. Paravendohet se këtu (në Azinë e Mesme) kjo popullatë ardhësish do të ketë rënë në kontakt me ithtarë të ndonjë sekti gnostik, përkatësisht me atë të sektit të *Atsigani*-ve ose *Athinganoi*-ve, që jetonin kryesisht në Frigi, një hapësirë në Anatolinë (Anadollin) Perëndimore. Athinganët shquheshin për shumë urdhëra e ndalime që kanë të bëjnë me pastërtinë dhe papastërtinë e trupit. (Nuk mund të përjashtohet lehtë mundësia që romët ta kenë marrë asokohe dhe nën ndikmin e Athinganëve përfytyrimin e papastërtisë rituale të trupit). Emri grek *Athinganoi* e ka

[15] Katja Sturm - Schnabl, Franz Miklosich - ein "Europäer". ..
[16] Po ajo, po aty.

kuptimin "ata që s'bën të preken", pra të evitohet çdo kontakt trupor me të pafetë, përkatësisht me të "papastërtinë", sepse vetë Athinganoi mund të të bëjë të papastër.[17]

Ka dijetarë që mendojnë se prej këndej mund të rrjedh emri kolektiv i përhapur gjerë e gjatë *cigan* me të cilin pothuaj të gjithë popujt e Europës i quajnë romët dhe se ky emër do të ishte, në mos i kryehershmi, njëri ndër emrat më të vjetër të kësaj popullate, të cilin këtyre ua dhanë të tjerët. Mendohet, më tej, se emri *cigan* do të rrjedh ndoshta nga pahlavishtja, persishtja e vjetër, përkatësisht nga fjala *asinkar* "hekurpunues" nga *asin* "hekur" dhe *kar-* "punues, punëtor". Kjo fjalë qenka edhe sot në përdorim në persishten e në turqishten në trajtën *asinkar*.[18] Të tjerë kujtojnë se emri kolektiv *cigan* për romët rrjedh nga fjala persishte *Ciganch* me kuptimin "muziktar, valltar" ose nga fjala e greqishtes së mesme, përkatësisht bizantine *atciganoi* (khs. më lart *Athinganoi*) "i paprekshëm, që s'bën të preket".[19] Po u gjykua mbi bazën e dokumenteve të shkruara, duket se mendimi i fundit është më i afërmi për të qenë i pranueshëm. Në trajtën *Adsinkani* romët, sinti-t e kale-t përmenden në shkrimin biografik për shën Gjergj Antonsikun, shkrim që është hartuar në vitin 1068 në manastirin Iviron të Athos-it në Greqi.[20] Prejardhjen e termit *cigan* nga greq. *athíganos* e kishte pranuar edhe romanisti, sllavisti e ballkanologu zulmëmadh kroat P. Skok. Kjo po u dëshmuaka, sipas këtij diejtari, edhe në mbështetje të reflektimit të kësaj fjale në sllavishten e vjetër kishtare si *athinaninъ* e *aciganinъ*. P. Skok vërente që "në të folmen e fshehtë (argot) të vorbëtarëve të Prishtinës jevgu quhet *paverac*, *paverica* "zjarri"; *pavernjak* "kalanicë" (gegavci-t në Srem), një kompozitë e përbërë nga parashtesa (SG.: shqipe?) *pa-* dhe *vera* "me fe të keqe". Rrjedh nga emri grek □θίγγανος. Prej këndej edhe emri europian për këta *zingari* (disimilimi *n–n* > *n–r*. Sipas këtij indikacioni etimologjik, jevgët erdhën në Europë nga Ballkani, ku edhe ka shumë sish."[21] Nga greqishtja rrjedh edhe varianti europian *zingari*. Në italishten *zíngaro* e *zíngano* rrjedh nga varianti latin *Secani*, ndërsa në hungarisht

[17] Geschichte und Sprache der Roma http://www.kbk.at/roma/Container/Vortrag-2000-M%E4rz.htm. Autori i këtij shkrimi, që po citohet në këtë fusnotë, këtë citat e ka nxjerrë nga e Kenrick, f. 18.

[18] Katja Sturm-Scnabl: Franz Miklosich - ein "Europäer" im 19. Jahrhundert: http:/www.inst.at/studies/sektion01.htm.

[19] Sipas Annelore Hermes, (Referentin im Bundesbüro der GfbV (Göttingen), Noch in keinem Land sind ihre Menschen- und Bürgerrechte gesichert.

[20] Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

[21] Khs. Etimologijski rječnik hrvatskog ili srpskog jezike I, Zagreb, 1971, f. 261.

czigany e në rumanisht *ţiganu* paskan hyrë nga sllavishtja. Mbi bazën e indikacioneve që mund të nxirren nga etimologjia, Skok përfundon se romët paskan ardhur në Europë përmes Ballkanit, ku edhe ka më së shumti pjesëtarë të kësaj etnie. Gjuha e këtyre qenka e afërt me gjuhën e fisit Dardi të Kafiristanit dhe me gjuhën e fiseve që jetojnë në Hindukush. Gjuha e romëve është varant i gjuhës *pali* - një zhvillim i vonë i sanskritishtes. Një variant që emrin e romëve do ta binte në lidhje me Egjiptin, Skok e gjen te varianti *Jeđupak* në qytete të bregut kroat të Adriatikut, (kah dalin edhe trajtat *Mađupi, Đupi e Jeđupi*,[22] emër që do të jetë refleks i greq. *egyptiakos*[23] "egjiptas" (më gjerësisht sh. më poshtë). Të tjerë mendojnë ndryshe: "Nocioni "Zigeuner" (SG: cigan, magjup, rom) është një emër i huaj i cili zgjon asociacione negative; përmes këtij termi zgjohen e riaktivizohen stereotipe, paragjykime e projeksione. Së këndejmi ky nocion nuk është i pranueshëm për shumëkend. Përveç kësaj, termi cigan është një emër përmbledhës, me të cilin shënohen grupet nga më të ndryshmet të romëve në gjithë Europën, pra shtresa heterogjene shoqërore të cilat të përbashkët e kanë vetëm faktin se "pararendësit" e tyre janë me origjinë nga India (që në të vërtetë në të shumtën e herës u dëbuan nga andej) dhe nga aty - pjesërisht që para 1000 vitesh - përmes shtigjesh të ndryshme u ngulitën në Europë".[24]

Mbështetja historike e shtegtimit të ciganëve, përkatësisht të romëve është tek e dhëna historike sipas së cilës midis viteve 450 e 500 heptalitët, të njohur me emrin hunët e bardhë, e sulmuan Indinë Veriore dhe për pasojë shumë banorë të kësaj hapësire ikën në mbretërinë persiane. Këta refugjatë, që kryesisht ishin muziktarë, u quajtën nga persët *Luri*, ndërsa në Afganistan i quajnë *Nuri*. Nuk dihet nëse pararendësit e këtyre romëve, tani endacakë, janë - siç mendon R. Djurić - farefis, përkarësisht pjesë e romëve e të sintive të Europës.[25] Në persishten, fjala *luri* emërton ciganët, romët në Siri, Palestinë dhe në Egjipt, ndërsa vetë fjala *luri* shm. *nawar* do të thotë "ai që punon me zjarr; farkëtar".[26]

Një grup tjetër farefis me sintit përkatësisht me ciganët, romët janë edhe *zott*-ët (kjo është fjalë variante e indishtes *jat*) dhe ka të bëjë me ata që rrisin buaj e buallica - një popullatë që në fillim të shekullit 8 u depor-

[22] Sipas M. Tërnava, Popullsia e Kosovës në shekujt 14 - 16, Prishtinë 1995, f. 398.

[23] Sh. Petar Skok, Etimolgijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika I, Zagreb 1971, f. 261.

[24] Geschichte und Sprache der Roma tttp//www.kbk.at/roma/Container/Vortrag-2000-M%E4rz.htm.

[25] Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

[26] Geschichte und Sprache der Roma http://www.kbk.at/roma/Container/Vortrag-2000-M%E4rz.htm.

tua nga provinca Sindh (dikur) e Indisë dhe u vendos në hapësirën midis Eufratit e Tigrit. Persinë e pushtuar nga arabët nuk e braktisën përnjëherë të gjithë ardhësit nga India. Në Lindjen e Afërme ka edhe sot grupe etnike me origjinë nga India të cilat flasin dialekte të indishtes. Por ata të cilët atëherë ia mësynë Perëndimit, do të jenë larguar nga vendi (India) përafërsisht rreth vitit 750. Këtij paravendimi i del krah, përsëri, gjuha. Pas pushtimit të Persisë (atdheut të dytë të romëve) nga arabët, arabishtja u bë së shpejti gjuhë e vendit dhe fjalë arabe hynë në persishten. Duke qenë se në variantet e gjuhës rómani të romëve pothuajse nuk ka huazime nga arabishtja, (linguisti britanik Kenrick i supozon 10 të tilla, gjë që nuk u pranua nga dijetarë të tjerë), mund të përfundohet se romët nuk do të kenë jetuar për kohë të gjatë nën sundimin e arabëve, porse që menjëherë pas pushtimit do të jenë tërhequr drejt Perëndimit e Veriut në hapësirën gjuhësore të armenishtes.[27]

Historikisht është e dëshmuar se pjesa më e madhe romëve, sinti-ve e të tjerëve indas për të cilët po flitet këtu, u larguan nga India Veriore në kohën e ekspeditave pushtuese e plaçkitëse që midis viteve 1000 - 1027 të erës sonë i ndërmori sundimtari Mahmudi i Ghazni-t (Afganistan).[28]

Sido që të jetë, mendimi i përgjithshëm është se pararendësit e romëve janë larguar nga India para vitit 1000 të erës sonë, sepse variantet e gjuhës rómani të romëve nuk janë prekur nga ndryshimet (p.sh. në rrafshin e fonetikës) që indishtja i pësoi pas këtij caku kohor.[29]

Një monografi për të folmet dhe dyndjet e romëve të Europës e ka hartuar i pari Fr. Miklosich.[30] Ky dijetar slloven i ra n'fije se gjuha e ciganëve (Tziganesc) paraqet, në pikëpamje të fonetikës, një shkallë më të lashtë se sa ajo e dialekteve të indishtes së mesme e të asaj të re. Së këndejmi, ky gjuhëtar shkëputjen e ciganëve, romëve nga të afërmit e tyre indas e vendos në një kohë të largët të papërcaktuar më hollësisht, por që sigurisht paska ndodhur midis shekujve 5 e 11. Miklosich-i ia doli ta përcaktonte saktësisht atdheun e kryehershëm në Indi të romëve, përkatësisht luginat në jug të bjeshkëve të Hindukush-it dhe në Veriun ekstrem të provincës kufitare të veriperëndimit,[31] përkatësisht krahina Punjab (lexo: Penxhab) të Indisë.

---

[27] Katja Sturm-Schnabl, Po aty.

[28] Rajko Djurić; Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

[29] Katja Sturm-Schnabl (Wien)Franz Miklosich - ein "Europäer" im 19. Jahrhundert.

[30] Khs. Über die Mundarten und Wanderungen der Zigeuner Europas, Wien 1875 dhe Beiträge zu Kenntnis der Zigeuner- Mundarten I, II, Wien, 1874.

[31] Robert Dycke, Zigeuner, ein verfemtes Geschlecht ein Beitrag von orchesterkolleg@gmx.de**;** http:// www. Karpatenwilli. Com/zigeuner. htm.

Pararendësit e romëve të ditëve tona erdhën në Europë pas një ekzodusi përmasash të mëdha, por që as sot e gjithë ditën nuk i dihet arsyeja e vërtetë. Midis ekspertëve ka porse mospajtime përsa i bie kohës së shpërnguljes së romëve nga krahina Penxhab e Indisë. Po u përmblodhën të dhënat e ndryshme, arrihet në supozimin e besueshëm se nga atdheu i kryehershëm i tyre romët u dyndën midis shekujve 5 e 10, përkatësisht 8 e 12 të erës sonë, duke shtegtuar nëpër Pakistan, Iran, Turqi dhe vende të Gadishullit të Ballkanit për të kaluar prej këndej më vonë në Europë. Mirëpo ka edhe supozime sipas të cilave dyndja e romëve nuk kishte përfunduar në mijëvjeçarin e parë, porse që ajo paska vazhduar edhe për kohë të gjatë në shumë hope.

Së këndejmi edhe besohet se itinerari i dyndjes së romëve në vende të Europës ndodhi nga India përmes Persisë, Afganistanit, Armenisë, Greqisë së Madhe[*] dhe përmes hapësirës gjeografike të sllavëve të jugut, sepse në shtresën më të lashtë gjuhësore të të gjitha varianteve të gjuhës rómani ndeshen huazime të lashta nga persishtja, armenishtja, greqishtja dhe nga gjuhët sllave. Kjo tezë mbështetet në rrethanën se në Azinë e Vogël kahja e dyndjes së romëve i mori dy drejtime. Romët e sotëm të Europës erdhën këndej përmes Greqisë dhe hapësirës së sllavëve të jugut, ndërsa grupet e tjera shkuan në drejtim të Afrikës dhe një pjesë e tyre ndoshta kaluan në Spanjë përmes Egjiptit.[**] Koha e dyndjes nga Azia e Vogël bie para ardhjes në këtë territor të turqve (sellxhukëve) në shekullin 11, sepse në gjuhën rómani nuk ka asnjë fjalë turke të asaj kohe. Në këtë kontekst nuk duhet të merret parsysh ndikimi i turqishtes i shekujve të fundit si pasojë e pushtimit të Ballkanit nga Perandoria Osmane,[32] që u ushtrua mbi gjuhët e popujve të nënshtruar në hapësirat etnike të të cilëve romët kishin qenë edhe para apo ishin vendosur pas pushtimit turk.

Pikërisht mbi bazën e pranisë së shumë fjalëve greke në gjuhën rómani dijetari Wlislocki arriti në përfundimin se: "...Greqia duhet të konsiderohet për atdhe i kryehershëm europian i të gjitha grupeve cigane të shpërndara gjithandej nëpër Europë, atdhe në të cilin këta do të kenë jetuar disa shekuj derisa më në fund e vërshuan Europën e Mesme."[33] Ndikimi i thellë i bizantinishtes, përkatësisht i greqishtes së mesme mbi

[*] Kështu përdoret në tekstin e cituar në referencën që pason.

[**] Shih f. 11, përkatësisht fusnotën 42 të këtij punimi.

[32] Katja Sturm-Schnabl (Wien) Franz Miklosich - ein "Europäer" im 19. Jahrhundert; Geschichte und Sprache der Roma http://www.kbk.at/roma/Container/Vortrag-2000-M%E4rz.htm.

[33] Robert Dycke, po aty.

gjuhën rómani shihet midis të tjerash tek numërorët themelorë të cilët, përveç nga leksemat e indishtes së vjetër, përbëhen vetëm edhe nga leksemat greke. khs. ind. e vj. **ekka** rom. *jekh/jek* "një"; ind. vj. **d(u)va** rom.: *duj* "dy"; ind. vj. **tr(n)** rom. *trin* "tre"; ind. vj. **catva:ra** rom. *štar* "katër"; ind. vj. **pañća**- rom. *pandž*/*panć* "pesë"; ind. e vj. **śaś**/ ś**at** rom. *šov* "gjashtë"; greq. **εφτά** rom. *efta* "shtatë"; greq. **οχτώ**/**οφτώ** rom. *oxto*/*ofto* "tetë"; greq. **ένιά** rom. *enja* "nëntë"; ind. e vj. **daśa** - rom. *deš* "dhjetë"; ind. e vj. **virnśati**, rom. *biš* "njëzet"; greq. **τριάντα** rom. *tr(ij)anda* "tridhjetë"; greq. **σαράντα**, rom. s*aranda* "katërdhjetë; dyzet"; ind. e vj. **śata**, rom. *šel* "njëqind".[34]

Së këndejmi mbetet i pabesueshëm supozimi i pambështetur se atdheu i kryehershëm i kësaj popullate paska qenë Egjipti, përkatësisht "Egjipti i Vogël" - një hapësirë territoriale të cilën vendësit egjiptas e paskan quajtur **Gyppe*. Kjo hipotezë nuk është bindëse, sepse nuk dihet që në Egjipt të ketë pasur ndonjë krahinë të qajtur **Gyppe*, përveç një regjioni të Greqisë në të cilin në mesjetën e hershme është dëshmuar një koloni romësh, por jo egjiptasish.

Romët u vendosën në hapësirën e Greqisë (Kretës e Peloponezit) nga Azia e Vogël para shekullit 11 kur këtu (në Azi të Vogël) edhe ndodhi bi-gëzimi i romëve në dyndje, përkatësisht i gjuhës së tyre *rómani* në dy grupe të mëdha linguistke: në grupin *Phen* dhe në atë *Ben* - ndarje që dëshmohet qartë në pikëpamje linguistike.

Si rezultat i dyndjes nga Greqia, grupe të mëdha romësh u vendosën edhe në hapësirën e Europës Lindore - në shtetet e sotme të Rumanisë, Bullgarisë, në hapësirën e ish-Jugosllavisë, në Sllovaki, në Çeki dhe në Hungari. Disa të tjerë e vazhduan shtegtimin në drejtim të Europës Perëndimore. Bukën e gojës e fitonin romët duke u marrë në rend të parë me profesionin e farkëtarisë, si farkëtar veglash të punës, pikës remesh, mprehës gërshërësh, thurës shportash dhe tregtarë kuajsh; disa të tjerë duke punuar edhe si muziktarë, dajrexhinj dhe artistë. Lëvizja e romëve nga Ballkani për në Europë nisi në shek. XIV-XV.

3. ARDHJA E ROMËVE NË EUROPË

Në fillim të shek. XV në Europën Perëndimore arriti një valë migruese e fiseve të ndryshme cigane, përkatësisht rome. Të tërhequra nga Azia e Vogël, nëpërmes Greqisë dhe vendeve të Ballkanit, këto fise

[34] Dieter W. Halwachs: Romani - Versuch eines einführenden Überblicks http://www-gewi.kfunigraz.ac.at/romani/ling_all/ling_all.de.html.

arritën shumë shpejt në vende të ndryshme të Europës: Austri, Bohemi, Gjermani, Itali, Zvicër dhe Francë.[35]

Në Europën Qendrore romët e sintit erdhën në vazhdën e migrimit të parë. Ka porse burime shkrimore të cilat dëshmojnë se romët ardhës u regjistruan që në shek. XIV në hapësirën e Karpateve dhe të Ballkanit. Kështu p.sh. më 1322 për banorë të ishullit të Kretës dëshmohen dhe të *Gype*-s të Peloponezit; më 1346 përkatësisht 1347 dëshmohen në Korfus; më 1385 në Vllahi; më 1399 në Bohemi; më 1477 në Hungari. Jo vetëm autorja Katja Sturm-Schnabl,[36] porse edhe njohësi i mirë i çshtjes së romëve R. Djurić[37] kujtojnë gabimisht se romët na qenkan dëshmuar më 1348 edhe në Kosovë, përkatësisht në shtetin serb të mesjetës dhe në Maqedoni (sh. për këtë më poshtë trajtimin etimologjik të emrit *magjup*); më 1361, përkatësisht më 1362[38] në Dubrovnik, ndërsa më 1378 edhe në Zagreb; më 1392 në Hildesheim (Gjermani) përmenden sintit;[39] romët në landin Burgenland të Austrisë përmenden për herë të parë në vitin 1389;[40] më 1427 dëshmohen para portave të Parisit, ndërsa më 1500 edhe në Angli.

Kur në të nisur të shek. XV përmes Bizantit e Ballkanit në vendet gjermanishtfolëse dhe në ato në të cilat fliten gjuhë romane u dukën për herë të parë grupe romësh që e heqin prejardhjen nga India dhe nga vendësit u panë si pjesëtarë të një populli me lëkurë të errët të ardhur nga Lindja, përkrah emrave të tjerë si "Egjiptas", "Ciganë" (të njohur qysh në brumin leksikor të bizantinishtes), "Paganë" dhe "Tatarë", në ndërkohë për romët u përdor, kryesisht në gjuhët romane e nën ndikimin e tyre edhe në gjermanishten, edhe nocioni "Saracenë".

Në Spanjë romët dëshmohen në gjysmën e dytë të shek. XV ku kishin arritur si pasojë e shtegtimeve të tyre nga Gjermania e nga Franca. Paraqitja e parë e tyre në këtë vend është dëshmuar nga një kopje e një letre përcjellëse e cila u zbulua para pak vitesh. Kjo letër ishte shkruar më 8 maj 1425 nga Alfonsi V., mbret i Aragonës, me të cilën ky prijësit "kontit"

---

[35] Zigeuner in Spanien; http://www.villa.spanien-immobilien-costa-blanca.com/index.php?p=42

[36] Katja Sturm/Schnabl, Po aty.

[37] Rajko Djurić; Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

[38] Siç njofton Orhan Galjus, Roma im Kosovo: Die vergessenen Opfer (Versioni gjerman i artikullit anglisht "Roma of Kosovo: the Forgotten Victims" aus dem Web-Journal "The Patrin" http://www.geocities.com/~patrin/kosovo.htm) në http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/balkan.htm.

[39] Sipas Anelore Hermes (Referentin im Bundesbüro der GfbV (Göttingen): Sinti und Roma, Basisfakten und Überblick, http://www.gfbv.de/voelker/europa/roma.

[40] Geschichte und Sprache der Roma

rom Thomas dhe njerëzve të tij, meqë ishin shtihuar si pelegrinë nga "Egjipti i Vogël", i garantonte qarkullim të lirë nëpër mbretërinë e Aragonës. Në vitin 1447 - siç njoftojnë "Anales de Cataluña" - një grup prej "*egipcianos*"-ve u vendos në qytetin e Barcelonës, ndërsa më 1462 grupe ciganësh paraqiten edhe në Andaluzi - në qytetin Jaén, ku këta u pritën me shumë kërshëri e me dhurata. Këtij populli të huaj, spanjolët i dhanë emra të ndryshëm: *egipcianos, gitanos, griegos, zincalés, bohemios, húngaros, faraones*; e ndonjëherë i ngatërronin, madje, edhe me saracenët. (khs. më lart) romët e Spanjës e quanin veten *calé, calorró, romanó, cañí* e edhe *pindoró*.[41] Vlerësohet se sot në Spanjë ka midis 60 - 100.000 romë.

Romët ishin vendosur në Spanjë pas dëbimit të arabëve maurë që në këtë vend kishin ardhur nga Siria përmes Egjiptit dhe Afrikës Veriore. Një pjesë e madhe e romëve u largua nga Spanja me rastin e dëbimit të arabëve maurë e të hebrenjve nga ky vend në vitin 1492.[42]

Varianti që e flasin romët e Spanjës quhet *Caló* / *Kale*. Ciganët e Spanjës e quajnë dialektin e vet *a chipi callí*. Sot ky variant flitet shumë rrallë dhe është prandaj një variant jostandard i andaluzishtes-spanjollishtes, përkatësisht i katalanishtes me elemente *rómani* në leksik që do ta ketë origjinën nga një variant *Caló-Romani*. Përkrah një numri shumë të madh fjalësh spanjole, ky dialekt përmban edhe fjalë sllave e greke. Në shekullin 16 shumë ciganë të Spanjës e paskan kuptuar ende greqishten vulgare - popullore.[43] Kjo rrethanë tregon se romët e Spanjës nuk kanë gjë të përbashkët me Egjiptin, sado që, si pasojë e prezantimit rrejshëm me rastin e ardhjes së tyre në Spanjë në shek. XV si pelegrinë e pendestarë nga Egjipti, ciganët e atjeshëm (që njihen edhe me shtatë emra të tjerë të përdorur rrallë në krahasim me emrin e përgjithshëm Gitanos) quhen ndonjëherë edhe *egipcianos*. Kjo rrethanë, në vazhdim, e tregon në të vërtetë edhe prejardhjen e romëve të vendosur atje nga Greqia si atdhe europian, ballkanik i tyre. Si pasojë e dyndjeve dhe si pasojë e deportimeve në tokat përtej Atlantikut nga Gadishulli Iberik e nga Franca Jugore, varianti *Kale* i romëve dhe i idiomës së tye gjallon edhe në vende të Amerikës Latine. Nocioni *kale* rrjedh nga fjala rome *kalo* "i zi; zi".

Mirëpo, R. Djurić kujton se ky mbiemër nuk përdoret për ta shenjuar ngjyrën e zezë të lëkurës, siç mund të mendohet në e parë, sepse lëkura e kale-ve nuk ka ndonjë ngjyrë të ndryshme nga ajo që e kanë dy grupet e

[41] http://www.kbk.at/roma/Containe.r/Vortrag-2000-M%E4rz.htm.

[42] Zigeuner in Spanien: http://www.villa.spanien-immobilien-costa-blanca.com/index.php?p=42.

[43] Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

tjera: romët e sintit. E pasqaruar ka mbetur deri tani nëse *kale*-t janë pasardhës të ndonjë populli indas, si p.sh. pasardhës të popullit Kalinga i cili përmendet në shumë gojëdhëna e burime indase, apo origjinën e mirëfilltë, të kryehershme, e kanë nga krahina Kalisthan e Indisë.[44]

Vendosja e pandehur e romëve *Cale* në Spanjën Jugore nga brigjet e Afrikës përmes Gjibraltarit nuk është dëshmuar deri më sot me asnjë dokument, prandaj mbetet vetëm gjasa që ndonjë grup ciganësh do të ketë ardhur ndoshta edhe përmes këtij shtegu.[45]

Dhe, romët (jo vetëm në Spanjë) nuk jetonin në këto hapësira në asnjë mënyrë vetëm në "kampe romësh", sepse këta - pothuaj menjëherë pas vendosjes së tyre në ambiente të reja -, u bënë, në pjesën më të madhe, banorë ndenjëtarë qytetesh e katundesh të atdheut të tyre të ri (shih për këtë edhe nën *Profesionet*).

Sinti-t jetojnë edhe në Gjermani, Francë, Itali, Kroaci, Austri dhe në Slloveni. Në Austri jetojnë pesë grupe romësh: sinti-t, romët e Burgenland-it, lovara-t, kalderash-ët dhe romët arlije.[46] - siç quhen edhe hash-kalinjtë e Kosovës.

Emri në njëjës *sinto* i sinti-ve, kështu besohet, ishte emri i një populli të regjionit Sind-h, në rrjedhën e poshtme të lumit Ind, regjion që ky që sot ndodhet në territorin e Pakistanit. Kjo krahinë dëshmohet ndër burime shkrimore dhe dihet se ishte shtet më vete, i cili në shekullin 10 ra nën sundimin e Gasnawid-ëve - një fisi arab i Afganistanit, gjë që, kështu supozohet, edhe do ta ketë shkaktuar dyndjen e popullatës së saj. Emri sinti është sqaruar me fjalën indase *sinte* me kuptimin "ujk". Këtij grupi etnik i takon edhe fisi i vogël i Mansus-ëve. Ky inkuadrim ndodhi pas konstatimit të dijetarëve të një ngjashmërie midis dialektit të sinti-ve dhe të mansus-ëve. Sintit *kale* njihen edhe me emrin *valštike*- "Sintit e Welsit" që e ka kuptimin "Sintit e Francës". Mirëpo këta e preferojnë për vete emrin *manu***s** edhe për ta dalluar veten nga sintit *jenischen*, që veten e quajnë *baéngere* nga *bar* "gur,-i", përkatësisht "gurgdhendës; muratorë". Nga folës sinti të gjuhës rómani emri *manuš* përdoret edhe në kuptimin *njeri*, për dallm nga *rom* "magjupisht".[47]

---

[44] Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

[45] Zigeuner in Spanien: http://www.villa.spanien-immobilien-costa-blanca.com/index.php?p=42.

[46] Dagmar Eklaude Roma rücken ins Rampenlicht http://www.kfunigraz.ac.at/ainst/unizeit/archiv/2002/heft4/2_04_01.html.

[47] Sinti und Roma, Eine Studie der Evangelischen Kirche in Deutschland http://www.wuwien.ac.at/usr/h92/h9251606/bal/Jenisch/Jenisch_Geschichte.html.

Megjithatë, materiali që është në disponim tregon se këto dialekte iu afruan njëri-tjerit falë gjëllimit bashkërisht për shumë shekuj në të njëjtën hapësirë gjeografike. Emri i këtij grupi rrjedh nga fjala *manus* "njeri", por edhe "gjini, fis". Në këtë rast nuk mjafton vetëm zbërthimi etimologjik i emrit, porse më me rëndësi është mbase edhe prejardhja religjioze e sociale e bartësve të emrit: Në Indinë e lashtë kishte një grup më vete njerëzish, detyrë e të cilëve ishte të përgatitnin gjellra e trejte që flijoheshin për të afërm të vdekur. Ky grup quhej *Manushya* "njerëz", ndërsa ceremoniali i flijimit quhej *Pinda*.[48] Ky sqarim jashtëgjuhësor e plotëson dhe e vërteton, megjithatë, etimologjinë e propozuar më lart.

Gjuha e romëve si kolektivitet, duke përfshirë këtu pra edhe sintit (për këtë sh. më poshtë), ndahet në 13 variante (dialekte) të ndryshme. Gjuha e sintive dhe e romëve e quajtur *rómanes* ose *sintitikes* është zhvilluar nga sanskritishtja - degë e indishtes. Shumica e varianteve të gjuhës rómani të nëngrupit sinti janë të ndikuara (edhe) nga gjermanishtja jo vetëm në pikëpamje të leksikut, porse edhe në strukturën gramatikore. Vështruar gjeografikisht, grupi sinti i romëve ka shtrirje në hapësirën gjuhësore gjermane, përkatësisht në shtetet gjermanofone duke i përfshirë këtu edhe fqinjët e drejtpërdrejtë të tyre si: Austria, Hungaria, Holanda, Franca, Italia, Sllovenia, Bohemia. Sintit që jetojnë në Rusi quhen disa herë edhe *Esterajxara* gjë që lë të kuptohet se kemi të bëjmë me sinti të vendosur atje nga Austria, siç quhen (*Estrexarija*) edhe sinti-t që jetojnë në Itali, Sllloveni, Hungari e në Sllovaki. E njëjta gjë, pra për *sinti* të shpërngulur nga Austria, vlen edhe për grupin *Estrekari* të sintive të vendosur në Itali, të cilët gjuhësisht dallohen qartë nga *Sinti Piemontese*, përkatësisht të Piemontit.

Përbrenda grupit sinti të romëve, grupi *Gadžkane Sinti* "sintit e Gjermanisë" veçohen nga romët *Lalere Sinti*, pjesa e të cilëve e vendosur në Austri e quan veten *Bemtike Sinti* "Sintit e Bohemisë". Në lidhje me sintit është me rëndësi të përmendet edhe nocioni *lalera* (njëjës l*alero*). Ka historianë, që kujtojnë se nën *lalera* duhet kuptuar një nëngrup etnik të fisit të sinti-ve. Ky supozim është i gabueshëm sepse me emrin *lalero* në gjuhën e romëve emërtohen në të vërtetë sintit dhe se vetë jala është e burimit rom me kuptimin "i shurdhër". Këtu kemi të bëjmë, sipas Djurić-it, me të njëjtin fenomen që ndodhi edhe me emrin sllav të *nemec*/*nemac* të gjermanëve.[49]

[48] sipas Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

[49] Po ai, po aty.

Ka edhe grupe të tjera si *Čučara* "punues sitash e kullojsash" nga rum. *ciur* "sitë" që në krye të herës jetonin vetëm në Rumani, ndërsa sot edhe në shtete europiane dhe në SHBA. Në mbështetje të vlerës kuptimore të emrit të këtij nëngrupi romësh, duket se këtu bien edhe romët *sepetides*/*sepečides* "punues shportash" të njohur në Turqi dhe në disa shtete të Ballkanit (për këtë sh. më poshtë). Nocioni *rumeni* ka të bëjë me variantin *rómani* të Turqisë; nocioni *kallajxhi* e *drindari* "shkalës leshi" ka të bëjë me romë që jetojnë në Bullgarinë Verilindore ku bie edhe grupi *kalajdži*, ndërsa nocioni *bugurxhi* ka të bëjë me romët që hasen në Kosovë e në Maqedoni.

Popullatat vendëse në trojet e të cilave u vendosën romët e ardhur që nuk e flasin gjuhën *rómani* dhe që nuk e kanë ngjyrën e lëkurës si të romëve, përkatësisht joromët, quhen nga romët me emrin përbuzës *gaxhe* "katundar, bujk; pronar çifliku, barbar; i huaj, jocigan". Kjo fjalë është zhvillim nga *Gago* (mash. nj.) *gaxhi* (fem. nj.) *gaxhe* shm. Supozohet se me *Cindo,-e* "të bërit synet" emërohen kinse shqiptarët.[50]

4. FILLET E STUDIMIT TË GJUHËS ROMANI, ROMANÉ, ROMANES

Përmes Konventës për mbrojtjen e minoriteteve Këshilli i Europës u ka siguruar romëve një marrje nën mbrojtje në gjithë Europën. Në këtë kuadër ekziston edhe "Karta Europiane e gjuhëve të regjioneve e të minoriteteve" (1991), në të cilën gjuha e romëve, *rómanes* është evidentuar, bashkë me gjuhën jidish, në grupin e gjuhëve pa territor të përcaktuar (non-territorialen).[51] Gjuha rómani është një gjuhë e cila deri tani nuk është alfabetizuar, një gjuhë që është ruajtur vetëm duke u trashëguar gojarisht brez pas brezi dhe që nuk e ka asnjë standard të kodifikuar. Situata e këtillë e kësaj gjuhe është refleks i situatës sociopolitike të romëve, sinti-ve e të kale-ve. Grupi etnik i romëve është mbase grupi për të cilin ka më së shumti paragjykime dhe që vuan më së shumti nga përbuzja dhe nga diskriminimi në gjithë Europën.[52] Në aspektin politik, ekonomik e kulturor, etnikisht të stigmatizuar, të përbuzur, të përndjekur deri në shkallë

[50] Sinti und Roma, Eine Studie der Evangelischen Kirche in Deutschland http://www.wu-wien.ac.at/usr/h92/h9251606/bal/Jenisch/Jenisch_Geschichte.html.

[51] Annelore Hermes - aus: pogrom 199/1998 Europa muss die Roma schützen Noch in keinem Land sind ihre Menschen- und Bürgerrechte gesichert http://www.gfbv.de/voelker/europa/roma2.htm

[52] Sipas Annelore Hermes, po aty.

gjenocidi, mbijetesa qe e mundshme vetëm në grupe të vogla, prej nga rrjedh edhe heterogjeniteti i tyre gjeografik, social e kulturor.[53]

Së këndejmi folësit e kësaj gjuhe nuk patën mundësi që vetë të ngrinin struktura të mëdha politike e ekonomike dhe të merrnin pjesë në pushtetin politik e ekonomik. Nëse kihet parasysh se variantet standarde janë normalisht rrjedhojë e qendrave politiko-ekonomike të pushtetit, atëherë bëhet e qartë përse gjuha rómani nuk ka asnjë standard të kodifikuar dhe ndër të tjera edhe për shkak të heterogjenitetit të përmendur gjuhësor nuk do të zhvillohet së afërmi ndonjë standard i pranuar nga të gjithë romët.

Për shumicën e romëve, varianti gjegjës është rëndom i kufizuar vetëm në komunikim brenda grupit. Veçoria bazë e gjuhës *rómani*, vështruar në pikëshikimin sociologjik, është në rend të parë pozita e saj si gjuhë, si variant intim: folësit e saj i flasin në të shumtën e herës edhe dy apo më shumë gjuhë, prandaj për gjuhë komunikimi të grupit në jetën publike e gjysmëpublike e përdorin gjuhën e popullatës gjegjëse shumicë.

Ky ledh në dimensionin e funksionit të gjuhës *rómani* është në lidhje me mungesën e standardit dhe të alfabetizimit të kësaj gjuhe. Këtu janë shkaqet kryesore që gjuha *rómani* jo vetëm në ambiente të popullatës shumicë ka një prestigj të ulët, porse edhe përse edhe shumë romë vetë e konsiderojnë gjuhën e tyre, në relacion me ato të popullatave shumicë, për më pak të çmueshme. Prestigji i ulët, reduktimi në pak rrafshe, bilinguizmi dhe presioni për asimilim nga kultura e popullatave shumicë e bëjnë gjuhën *rómani* një gjuhë të "dominuar" raportet e së cilës me gjuhët në kontakt ishin dhe janë jo në raport bilateral porse, përkundrazi, në raport asimetrik. Rezultat i kësaj janë kontaktet dhe fenomenet e ndryshme gjuhësore, duke filluar nga huazimet leksikore e deri tek reduktimi në njëgjuhësi, humbja e gjuhës, përkatësisht gjunjëzimi i gjuhës *rómani* përpara gjuhës së popullatës shumicë.

Kështu, shumë grupe romësh e kanë ndërruar gjuhën e tyre, pa e pas humbur porse ndjenjën e përkatësisë etnike të tyre. Edhe sot jetojnë në Rumani, në Bullgari, Greqi e në Serbi romë që gjuhë amtare e kanë rumanishten, por që e ndjejnë veten romë. Ka natyrisht edhe grupe rome të cilat bashkë me humbjen e gjuhës, përkatësisht të varianteve të gjuhës *rómani*, e kanë humbur edhe ndërgjegjen etnike.[54]

Tentativa e parë për standardizimin e gjuhës rómani u ndërmor më 1986 kur në një simpozium të mbajtur në Sarajevë u diskutuan konceptet e para të standardizimit të kësaj gjuhe. Kongresi i katërt botëror i Unionit të

[53] Dieter W. Halwachs: Romani - Versuch eines einführenden Überblicks http://www-gewi.kfunigraz.ac.at/romani/ling_all/ling_all.de.html.

[54] Po ai, po aty.

Romëve (i mbajtur në vitin 1990) e ngarkoi një grup ndërkombëtar prej linguistësh, detyrë e të cilit do të ishte që të paraqiste propozime për standardizimin e alfabetit dhe të gjuhës rómani. Kjo gjuhë mund të studiohet tani në universitetet e Pragës, Njitras (në Sllovaki) e të Parisit. Në shumë vende është përpunuar lëndë gjuhësore në mënyrë që kjo gjuhë të ruhet jo vetëm për folësit aktualë, porse edhe për brezat që vijnë, nga presioni i lartë asimilues i kulturës së Perëndimit.[55]

Teksti më i vjetër që dihet deri tani në gjuhën *rómane* është botuar në vitin 1547. Ky është në të vërtetë një tekst dygjuhësh *rómane* dhe i hartuar nga Andrew Borde. Ky nuk ia doli porse që ta sqaronte prejardhjen e gjuhës *rómane*.

Është meritë e dijetarit John Sempson i cili në veprën e tij "The Dialect of the Gypsies of Wales" i pari e bëri diferencimin e *Romani - chib* përkatësisht të gjuhës *rómane* në grupin *Ben-*, përkatësisht në grupin juglindor dhe në grupin *Phen* - përkatësisht në grupin europian. Sipas këtij dijetari, gjuha e kryehershme e përbashkët romani e filloi bigëzimin e saj në dy degë pikërisht në kohën e dyndjes gjatë shtegtimit të romëve nëpër Persi, përkatësisht Iranin e sotëm në drejtim të Europës përafërsisht që nga shekulli 12. Kjo ndarje vlen edhe sot.[56]

Mbi bazën e zhvillimit të ndryshëm fonetik të nocionit për "motër": sanskritisht *bhagini*, studiuesi Sampson e dallon grupin juglindor "*Ben*" nga grupi perëndimor, përkatësisht europian "*Phen*". Vendimtare për këtë ndarje është zhvillimi i mediave aspirata b^h, d^h, g^h në variantin europian të rómani, të cilat në variantet e grupit "Phen" të gjuhës rómani janë shndërruar në teneus aspiratae p^h, t^h, k^h.[57] Grupit *ben-* i takojnë dialektet në Palestinë, Transkaukazi, Persi (Iran) dhe në Azi të Vogël. Grupi *phen* ngërthen më vete gjuhën e boshëve të Armenisë, gjuha e të cilëve quhet *lomavr* si edhe romët, sinti e kale, pra të gjitha grupet europiane të gjuhës *rómani*, *romanes*.[58]

Për hulumtime të mirëfillta rreth gjuhës *rómani* mund të flitet vetëm atëherë kur nis gjuhësia e mirëfilltë krahasimtare dhe pikërisht me punimin e Johann Christian Christoph Rüdiger: "Rreth gjuhës dhe prejardhjes së ciganëve nga India", të botuar më 1782. Një vit më vonë botohet libri i

[55] Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

[56] Po ai, po aty.

[57] Dieter W. Halwachs: Romani - Versuch eines einführenden Überblicks http://www-gewi.kfunigraz.ac.at/romani/ling_all/ling_all.de.html.

[58] Katja Sturm-Schnabl (Wien) Franz Miklosich - ein "Europäer" im 19. Jahrhundert; Geschichte und Sprache der Roma http://www.kbk.at/roma/Container/Vortrag-2000-M%E4rz.htm.

Grellmann-it "Ciganët" - libër që jo vetëm i pranon rezultatet filologjike të pararendësit të tij, porse edhe i zgjeron ato. Një botim tjetër që paraqet një vepër monumentale për gjuhën *rómani* dhe që për kohë të gjatë shërbeu bazë për gjurmimin e kësaj gjuhe, është libri i botuar 60 vite më vonë (1844) i gjuhëtarit Pott: "Ciganët në Europë e në Azi". Përfundimi i Pott-it ishte që: Gjuha *rómani* duhet parë si gjuhë që i takon grupit verior të gjuhëve të indishtes dhe që është në lidhje birësie me sanskritishten. Gjuha *rómani* është, së këndejmi, gjuhë indoiraniane dhe flitet pa përjashtim vetëm jashtë Indisë.[59] Mbi bazën e krahasimit të gjuhës *rómani* me sanskritishten dhe me gjuhët e reja neoindase dijetari Ralph L. Turner ka arritur në librin e tij "*The Position of Romani in Indo-Aryan*" të vitit 1926 në përfundimin se gjuha *rómani* do të ketë pasur marrëdhënie me grupin e gjuhëve indoariane të Indisë Qendrore, prandaj pararendësit e romëve kanë jetuar në hapësirën e Indisë Qendrore prej nga rreth vitit 250 para erës sonë u tërhoqën në veriperëndim të Indisë ku do të kenë qëndruar një kohë të gjatë.[60]

Zhvillimit të studimit të gjuhës *rómani* i ndihmuan shumë edhe punimet e botuara midis viteve 1872 e 1881 të sllavistit të Universitetit të Graz-it Franz Miklosich (lexo Mikloshiq). Meritë e këtij është përpjekja e parë për ndarjen e gjuhës *rómani* në dialekte. Ndarja e tij e gjuhës *rómani* në 13 "të folme" mbështetet kryesisht mbi vëllimin e ndikimit të gjuhëve vendëse në hapësirën e të cilave janë vendosur romët e ardhur. Në punimin e tij më të rëndësishëm deri më sot "The Position of Romani in Indo-Aryan" Ralph L. Turner arriti në vitin 1926 që mbi bazën e krahasimit të gjuhës romani dhe të sanskritishtes me gjuhët e ndryshme të indishtes së re të dëshmojë se do të ketë pasur gjithsesi dhe patjetër kontakte të gjuhës *rómani* me grupin e gjuhëve të Indisë Qendrore, prej nga romët u tërhoqën në vitin 250 para erës sonë në hapësirën veriperëndimore të Indisë. Kjo po u dëshmuaka me disa paralele në fushën fonetike midis gjuhës *hindi* dhe asaj *rómani*. Thënë përmbledhtazi, është çështje ende e pazgjidhur nëse gjuha e romëve ka lidhje të ngushtë birësie me indishten e re *sind-hi* të Indisë Perëndimore; me gjuhët *kafire* të Indisë Veriperëndimore apo me gjuhët e reja indase të pjesës qendrore të kësaj hapësire gjuhësore.

Me këtë çështje u mor edhe dijetari bullgar K. Kostov. Ky, nga ana e tij, hetonte se gjuha e romëve paska disa veçori të përbashkëta me indishten e vjetër aq sa edhe me indishten e mesme (*pali*) ose/dhe me disa gjuhë të indishtes së re (si p.sh. me atë *hindi*) - sidomos përsa i përket

[59] Sipas Dieter W. Halwachs: Romani - Versuch eines einführenden Überblicks http://www-gewi.kfunigraz.ac.at/romani/ling_all/ling_all.de.html.

[60] Po ai, po aty.

alternimit të tingujve *sth*, *şt*, *tr*, *bh* të indishtes së vjetër ose të atij (alternimi) ṭth, (th), ṭth (ṭh) t, *bh* në gjuhën hindi. Khs. shembujt:

Ind. e vj.	romane	pali	hindi
hasta	vast "dora"	hattha	häth
osṭha	vušt "goja"	oṭtha	òth
trīni	trin "tre"	tinni	tīn
bhrätr	phral "vëlla"	bhăda	bhăī[61]

Mirëpo në pikvështrimin e alternimit dhe të reflektimit të *a* të shkurtër dhe asaj të gjatë *ā*, gjuha e romëve ka ndjekur një zhvillim të mëvetshëm dhe devijon kështu si nga indishtja e vjetër ashtu edhe nga variantet pali e hindi. Zanorja a e shkurtër e ind. së vj. jep në gjuhën e romëve *e*, ndërsa *a* e gjatë reflektohet në *a* të gjatë ose në *a* të shkurtër të mbyllur. Khs. shembujt e mëposhtëm:

Ind. e vj.	romane	pali	hindi
hasta	vast "dora"	hattha	hāth
oşṭha	vušt "goja"	oṭtha	ōth
trīni	trin "tre"	trinni	trīn
bhrātr	phral "vëlla"	bhāda	bhārï

Gjuha *rómani* është gjuhë që i takon grupit veriperëndimor të gjuhëve indo-iraniane. Gjuha e kësaj popullate, si pasojë e dyndjeve të gjata në vende të ndryshme dhe për shkak të moskultivimit të saj me shkrim, është sot e vërshuar nga fjalë të gjuhëve në hapësirën e të cilave janë vendosur folësit e saj. Pikërisht duke u mbështetur tek ndikimet e huaja, dijetarët si Grellmann (1787), Pott (1844) dhe së fundi Franz Miklosich kanë mund ta ndjekin edhe rrugën e shtegtimit të kësaj popullate. Këta dijetarë kanë hetuar se në gjuhën e romëve ka edhe disa elemente gjuhësore nga armenishtja, prandaj edhe e paravendojnë një bashkëjetesë, përkatësisht një qëndrim për kohë më të gjatë të romëve në dyndje edhe në hapësirën gjuhësore të armenishtes. Mbi bazën e një shtrese huazimesh nga arabishtja (si gjuhë e pushtuesve, jo porse si dëshmi e jetesës së pararendësve të romëve në Egjipt apo në ndonjë hapësirë tjetër në të cilën

[61] Kiril Kostov, Vъrhu proizhoda na ciganite i tehnija ezik, në Bъlgarski ezik, 2, 1953, 344.

arabishtja do të ishte gjuhë e vendit) dhe nga persishtja Miklosich e paravendon edhe një bashkëjetesë të romëve me folësit e gjuhëve dhënëse, përkatësish me arabishten e me persishten. Këto huazime janë marrë në vend, në Persi - jo në ndonjë vend arabishtfolës, si p.sh. Egjipti. Duke u mbështetur në këto elemente të dëshmuara gjuhësore të huaja në gjuhën e romëve, është përforcuar mendimi se atdheu i kryehershëm i romëve është India. Dëshmitë gjuhësore, sidomos porse elementet e huaja, lënë të kuptohet se romët jetonin në Indi - atdheun e tyre të kryehershëm së pakut deri në shekujt 9 e 10 të erës sonë. Deri më sot nuk është sqaruar nëse nga atdheu i kryehershëm pati vetëm një apo më shumë valë të shpërnguljes, dyndjes së romëve.

Në kuadër të dy kryedialektve, njihen tri dialekte të gjuhës *rómani*: dialekti armen, europian dhe një dialekt i Azisë së Vogël. Kjo ndarje dialektore e gjuhës *rómani* është bërë në bazë të bashkëtinglloreve të zëshme fundore b^h, d^h, g^h. Sot ka një hendek shumë të madh midis dialekteve të romëve aziatikë dhe të atyre europianë. Atdheu europian i romëve konsiderohet Greqia, përkatësisht Kreta e Peloponezi (khs. koloninë rome në Gypo/Gyppo) ndërsa atdhe i romëve të Europës Perëndimore konsiderohet Europa Juglindore. Nga kjo hapësirë romët janë shpërndarë (migrimi i fundit më i madh ka ndodhur më 1906, por që vazhdon edhe sot) në Perëndim të kontinentit tonë.

4.1. Veçori të përgjithshme të gjuhës rómani, rómanes

Gjuha *rómani* e romëve, sinti-ve dhe e *kale*-ve është një tufë variantesh heterogjene e lidhur për një bërthamë homogjene leksikore e morfologjike. Sintaksa dhe fonetika e disave nga variantet i janë nënshtruar ndikimit të strukturave të gjuhëve primare të kontaktit, gjuhëve të popullatës shumicë të vendeve ku këta janë vendosur. Zhvillimi i këtillë është rezultat si i shumëgjuhësisë së të gjitha grupeve të folësve të gjuhës rómani ashtu edhe i presionit të përhershëm nga strukturat e popujve shumicë drejt asimilimit të romëve.

Në rrafshin e leksikut, gjuha *rómani* karakterizohet me shtresa të ndryshme huazimesh. Të ashtuquajturat "fjalë nga trashëgimia e indishtes" dhe huazimet e hershme nga persishtja, armenishtja dhe greqishtja bizantine e përbëjnë të ashtuquajturin fond të leksikut të kryehershëm të pjesës aziatike të gjuhës rómani. Numri i fjalëve të trashëguara është relativisht i vogël. Konsiderohet se në këtë gjuhë ka 700 fjalë me burim nga indishtja, 70 huazime nga persishtja, 40 nga armenishtja; 10 fjalë nga arabishtja (?) dhe rreth 230 leksema me origjinë greke të periudhës bizantine, përkatësisht nga greqishtja e mesme. Por nuk ka

asnjë variante të gjuhës rómani në të cilën do të dëshmoheshin të gjitha këto, më shumë se 1000 leksema.[62]

Mbi bazën e huazimeve mund të ravijëzohet drejtimi i shtegtimeve të romëve, sintive e kale-ve drejt Europës. Stacioni i parë pas shpërnguljes nga pjesa veriperëndimore e nënkontinentit të Indisë ishte Persia, gjë që dëshmohet edhe nga prania e disa leksemave iraniane në gjuhën *rómani*. Duke qenë se në gjuhën rómani pothuajse nuk ka asnjë huazim nga gjuhët arabe lejohet nxjerrja e përfundimit se folësit e gjuhës *rómani* ishin larguar nga hapësira gjuhësore e persishtes në drejtim të Armenisë para arabizimit ose - thënë më mirë - para kreolizimit të kulturës persiane dhe pastaj e vazhduan shtrirjen e tyre drejt sferës bizantine të ndikimit. Në të mirë të kësaj teze flasin jo vetëm huazimet nga armenishtja dhe një ndikim jo vetëm leksikor nga greqishtja bizantine. Shpërngulja nga Azia e Vogël do të ketë ndodhur para turqizimit të Azisë së Vogël, i cili do të ishte më drejt të quhej kreolizim i të dy kulturave.

Kjo vërehet mbi bazën e rrethanës se në leksikun e grupeve rome që shtegtuan në Europën Qendrore e Perëndimore nuk ka asnjë element të vjetër leksikor nga osmanishtja, përkatësisht nga turqishtja e vejtër. Të gjitha këto të dhëna e kanë forcën ta vënë në dyshim hipotezën e prejardhjes së romëve nga Egjipti, përkatësisht lidhjen e emrit të cilitdo nëngrup etnik të romëve me emrin e Egjiptit.

Gjuha e folur nga romët europianë karakterizohet edhe me një shumësi të madhe "huazimesh më të reja" fjalësh nga greqishtja, rumanishtja, gjuhët sllave të jugut dhe me elemente leksikore të fondit gjithballkanik, gjë që dëshmon se ardhësit romë ishin inkuadruar në ato shoqëri, përkatësisht se gjuha e tyre ishte në kontakt me gjuhët e përmendura më lart[63] dhe jo me arabishten e folur në Egjipt.

4.2. Morfologjia e gjuhës rómane, romanes

Gjuha *rómani* i ka dy gjini: mashkulloren e femëroren. Kategoria e numrit përfshin njëjësin dhe shumësin. Një veçori shquese e gjuhës *rómani*, që këtë e dallon nga gjuhët europiane, është sistemi i rasave. Sistemi dyshkallësh i fleksionit të emrit sipas tri rasave primare dhe pesë të tjerave sekondare është një trashëgimi e gjuhës rómani nga indishtja. Rasa primare janë: Kasus rektus "rasa e mohimit", Kasus obliquus "rasa e varshmërisë, e parregullsisë" dhe thirrorja. Rasa sekondare janë dhanorja, rrjedhorja, vendorja, instrumentali - sociativi dhe gjinorja.

[62] Po ai, po aty.

[63] Geschichte und Sprache der Roma http://www.kbk.at/roma/Container/Vortrag-2000-M%E4rz.htm.

4.3. Ndarja në dialekte e gjuhës rómani

Pasojë e migrimeve në drejtime të ndryshme pas braktisjes së Azisë së Vogël është vërshimi i gjuhës *rómane* me fjalë të gjuhës në hapësirën e së cilës u vendosën më shumë romë dhe jetuan aty shumë gjatë para se t'i vazhdonin dyndjet në vende të tjera. Kështu do të ketë ndodhur me romët e vendosur në hapësirën gjuhësore të rumanishtes përkatësisht të vllahishtes, për ku dëshmohen së pakut që nga gjysma e parë e shek. XIV. Mbi bazën e shumësisë së fjalëve me prejardhje rumune, vllahe u bë në gjuhësi edhe një ndarje tjetër e dialekteve të gjuhës rómani.

Ndarja e parë e varianteve të gjuhës *rómani* rrjedh, sikundër u tha më lart, nga Fr. Miklosich në punimet që i shkroi midis viteve 1872-1881. Miklosich-i e bëri këtë mbi bazën e huazimeve më të reja të cilat, rrjedhimisht, edhe janë më të shumtat. Kjo ndarje, të cilës më 1964 iu kthye dhe e zgjeroi Ventzel, është në kundërthënie dhe më pak e pranueshme se ajo që e kishte bërë Gilliat-Smith (1915-1916). Ky i fundit i dallonte prerazi "Variantet vllahe" të modeluara, të ndikuara thellë nga rumanishtja, ndikim që shpjegohet me historinë e përbashkët 500-vjeçare, nga "Variantet jo-vllahe" tek të cilat nuk mund të vërehet ndonjë ndikim i rumanishtes. Në grupin e varianteve vllahe bien edhe variantet *kalderaš* "bakërpunues" dhe *lovara* "tregtarë kuajsh" që fliten nga romët e Austrisë dhe nga *xhambazët* në Maqedoni e në Kosovë. Xhambazët, që në Banat të Panonisë e në Ballkanin Jugor njihen për tregtarë kuajsh, e flasin të njëjtin variant të gjuhës rómani si edhe *Gurbetët*. Emri i xhambazëve rrjedh nga *džamba* "bretkocë". Të dy këto grupe kanë shtegtuar nga Azia e Vogël deri në Rumaninë e sotme, ku për herë të parë dëshmohen në burime shkrimore në vitin 1382. Në Rumani dhe në Moldavi, këta ranë në skllavëri e cila për ta zgjati prej vitit 1400 deri në fillim të gjysmës së dytë të shekullit 19, përkatësisht deri në vitin 1891.

Varianti *rómani* i *kalderaš*-ëve është varianti më i përhapur territorialisht i gjuhës *rómani*.

Për dialekte jo vllahe (*Non-Vlax-Dialekte*) merren variantet e sintive, të romëve të Burgenland-it në Austri dhe varianti i *arlije*-ve, të cilat nuk janë fare të ndikara nga rumanishtja, sepse pararendësit e këtyre erdhën në Europën Qendrore, Perëndimore e Veriore dhe në Ballkan drejtpërdrejt nga Azia e Vogël, për ku këta po u dëshmuakan

që në shek. IX[64], prandaj në këto varinate - dialekte dëshmohet një shtresë e fortë e leksikut bazë me prejardhje nga greqishtja[65] e re.

4.4. Grupi i Europës Veriore

Variantet e gjuhës rómani më të përhapura territorialisht në Veriun e Europës janë shumë heterogjene. Mbi bazën e ndarjes territoriale të këtij grupi mund të dallohen gjashtë nëngrupe të gjuhës rómani. Kështu në Britaninë e Madhe krahas Anglo-Romani ka edhe një Welsh-Romani. Varianti i vetëm i plotë i gjuhës romani të Skandinavisë është varianti i folur në Finlandë. Romët vendës të Suedisë, Norvegjisë e të Danimakrës, të cilët nga popullata shumicë mbahen për tatarë, i flasin variantet *Para - Romani*. Variantet baltike, si p.sh. *rómani* e Letonisë janë në raporte të ngushta me variantet e Europës Verilindore të *Xaladitka-Roma* të Rusisë dhe me variantin romani *Polska-Roma*[66] të Polonisë.

4.5. Grupi i Europës Qendrore

Përbrenda grupit qendror (të Europës) dallohen gjithashtu dy nëngrupe: ai verior dhe ai jugor i Europës Qendrore të varianteve të gjuhës rómani. Kriter vendimtar për dallimin midis tyre është thellësia e ndikimit të hungarishtes mbi variantet jugore. Së këndejmi, këto dialekte edhe janë quajtur "dialekte hungareze të gjuhës rómani" ose si "*Romungro*" dhe folësit e tyre si "*Romungri*", *Rumungre* e *Ungrike Roma* (në Sllovaki quhen edhe *Servi*). Në këtë vend romët janë të ndarë në dy grupe: Në grupin e romëve ndenjëtarë të quajtur *Rumungres* dhe në atë të pasardhësve të romëve endacakë *Vlachika-Roma*[67]- një emër depreziativ i përdorur nga romë të grupit vllah për romët e tjerë në hapësirën gjuhësore të hungarishtes (Hungari, Sllovaki, Çeki), si p.sh. për *vend*-ët përkatësisht *Vend-Gypsies* në Hungarinë Lindore, të quajtur edhe *Grenc-Roma*. Këta janë farefis me romët e Burgenlandit (Austri) dhe me romët *Gurvari* të Prekomurjes së Sllovenisë etj.[68] Lidhjen e këtyre

[64] Sipas Kiril Kostov, Vъrhu proizhoda na ciganite i tehnija ezik, në Bъlgarski ezik, 2, 1953, f. 343.

[65] Sipas Katja Sturm-Schnabl (Wien) Franz Miklosich - ein "Europäer" im 19. Jahrhundert; Geschichte und Sprache der Roma http://www.kbk.at/roma/Container/Vortrag-2000-M%E4rz.htm.

[66] Halwachs: Romani - Versuch eines einführenden Überblicks http://www-gewi.kfunigraz.ac.at/romani/ling_all/ling_all.de.html.

[67] Birgit Lettenbauer Roma in der Slowakei Dann soll ich mich auch als Roma bekennen" http://www.pragerzeitung.cz/?c_id=3014.

[68] Sinti und Roma, Eine Studie der Evangelischen Kirche in Deutschland http://www.wu-wien.ac.at/usr/h92/h9251606/bal/Jenisch/Jenisch_Geschichte.html.

romëve me hapësirën e Sllovenisë dhe me popullatën e saj e tregon mbase fort mirë nocioni *Vend-Gypsies* "Magjupët Vendi" një emër ky që s'ka si të ndahet nga emri përbuzës *windish* që e përdorin austriakët për ta shenjuar gjuhën sllovene. Të dyja këto emërtime janë me konotacione pejorative, gjë që lidhet mbase me rrethanën se romët e këtij grupi kanë një traditë më të gjatë banimi këndej se sa p.sh. në krahasim me ato të grupit vllah të cilat gjithashtu e përdorin këtë term. Degëzimi i mëtejshëm i grupit jugor të Europës Qendrore në variante të Hungarisë e të Sllovakisë nga njëra anë dhe të grupit vllah nga ana tjetër është gjithsesi shumë hipotetik dhe si i këtillë duhet konsideruar për ndarje të përkohshme. Ka shumë gjasë që së pakut varianti hungarez të mund të ndahet më tej në nëngrupe të tjera. Po kjo vlen edhe për variantet veriore të Europës Qendrore. Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një klasifikim thjesht gjeografik, me një numërim të atyre trevave në të cilat fliten variante të gjuhës rómani në pjesën veriore të Europës Qendrore. Edhe në këtë rast mungojnë, ç'është e drejta, gjurmime të hollësishme mbi bazën e të cilave do të mund të bëhej një nënndarje më e saktë.

Në kundërshtim me grupin vllah dhe me atë ballkanik, tek folësit e varianteve të Europës Qendrore nuk ka emra grupesh të sajuara nga emri i profesioneve që i ushtronin e i ushtrojnë romët. Për diferencimin e dy varianteve të grupeve të Europës Qendrore përdoren - siç u sqarua më parë - nocione gjeografike.

4.6. Grupi vllah

Grupi i varianteve vllahe është relativisht homogjen. Folës të varianteve të ndryshme mund të merren vesh njëri me tjetrin. Kjo ndihmohet nga rrethana e përhapjes gjer e gjatë nëpër botë e këtij varianti dhe angazhimi në rrafshin e të drejtave të njeriut e të qytetarit të përfaqësuesve të romëve të grupit vllah, sipas të cilëve gjoja paska filluar të formësohet një "romanai - vllahe e përbashkët", variant i cili ndoshta në të ardhmen do të mund të lëshonte shtat në rrafshin ndërkombëtar-politik si variant - gjuhë standard(e) për të gjithë romët. Mbi bazën e homogjenitetit të këtij varianti është e mundshme vetëm një ndarje e këtij varianti në Roma-vllahisht të *veriut* dhe në atë të *jugut*.

Romët e grupit gjuhësor dialektor vllah nuk duhet ngatërruar me vllehtë orthodoksë që ndeshen në Shqipëri e në Maqedoni dhe që quhen aromunë.[69]

[69] Sipas Zweite Reise zur Erkundung der Lage der Roma und Ashkalia im Kosovo Vierzehn Tage Augenzeuge in einer eingeschlossenen und bedrohten Enklave der Ashkalija.

4.7. Grupi ballkanik

Variantet ballkanike të gjuhës rómani fliten në Ballkanin Qendror dhe në atë Jugor: në Rumani, Bullgari, Maqedoni, Greqi, Shqipëri, në Kosovë, në Serbi të Jugut, por edhe në Moldavi e në Turqi. Nga emrat për disa grupe të veçanta, folësit e të cilave herë-herë quhen edhe *Xoraxane* (lexo: horahané) "romë turq", përkatësisht myslimanë, mësohet se disa sish (emra) kanë prejardhje turke. Kështu p.sh. supozohet se emri *Arlije*, *Erlides* i grupit rom rrjedh nga turq. *yerli* "autokton, vendës" dhe i shënon romët myslimanë me gjuhë komunikimi turqishten. Edhe emrat *bugurdži* "shpues birash", *kalajdži* "kallajxhi", *sepecides* "thurës shportash" janë emra me prejardhje turke të romëve që jetojnë në Izmir të Turqisë dhe në Violos të Greqisë. Romë *sepecides* jetojnë edhe në njësinë federale Burgenland të Austrisë. Variantet ballkanike përmblidhen nën emrin e përbashkët "Dialekte ballkanike jugore" dhe mbi bazën e zhvillimit të përbashkët fonetik dallohet si grup më vete i përbërë nga *Bugurdži-Drindari-Kalajdži* i ndryshëm nga grupet e tjera: nga variantet *rómani* të Iranit, nga varianti *rumeli*, i cili shtrihet nëpër gjithë Bullgarinë. Për këtë të fundit duhet të merret në shqyrtim sqarimi mbushamendës i djetarit bullgar K. Kostov, sipas të cilit në gjuhën *romané* përveç një tingulli *r* që fonematikisht është i barasvlershëm me *r*-në bullgare ka edhe një *ɾ* cerebrale e cila, duke qenë karakteristike për indishten e vjetër e atë të re, duket se përmbahet edhe në emrin *romà*, gjë që do të tregonte se edhe vetë emri *rom* i etnisë rrjedh nga indishtja. Kjo trajtë e emrit etnik përputhet plotësisht, por vetëm rastësisht, me emrin *rum* me të cilin në Ballkan në krye të herës shenjohej Roma, ndërsa më vonë edhe Perandoria e Bizantit, e cila nga turqët u quajt Rumeli,-a.[70] Ky grup dallohet edhe nga variantet *erlidesn*, nga varianti *Ursari-Romani* - "arushaxhinj" nga rum. *urs* "ari, arushë" (khs. edhe *Mečkari*) që flitet në Rumani e në Moldavi, nga *Krim-Romani*, nga varianti që flitet në Volos të Greqisë dhe nga varianti i Izmirit të Turqisë ku jetojnë *sepecides*-it vendës, nga *Arlije*-Romani, një "dialekt i madh" që me të drejtë konsiderohen variante të ndryshme dhe nga varianti rómani që flitet në Prilep - Maqedoni.

Grupi *bugurxhi* (bugurdži, burgidžija; bugurdži / burgudži) quhet ndryshe edhe *kovačija*. Ky emër është në të vërtetë fjalë sllave e jugut *kovač* për "farkëtar". Në turqishten *burgu* është "shpuesi", ndërsa emri *burguci* (varianti i sllavizuar: burgudži) do të thotë "ai që farkon apo përdor shpues, turjelë". Romët që merreshin me farkatari quhen në disa

[70] Kiril Kostov, Vъrhu proizhoda na ciganite i tehnija ezik, në Bъlgarski ezik, 2, 1953, f. 346 dhe referencën përkatëse.

vende edhe me fjalën turke *demirci* (lexo demirxhi), "ai që merret me hekurishta". Kovaçët, përkatësisht burguxhinjtë janë, si në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni, kryesisht të besmit mysliman, ndërsa burguxhinjtë e Bullgarisë janë shndërruar në të krishterë orthodoksë.

Ka një mendim sipas të cilit romët Arlije- dhe Bugurdži-Romani janë romë të ardhur nga krahina Burgenland e Austrisë, përkatësisht se janë Burgenland-Romani. Këta i takojnë të njëjtit nëngrup romësh si edhe 80% e romëve të Maqedonisë që për gjuhë amëtare i kanë dialektet, përkatësisht variantet bugurdži, arlije ose arlijski dhe xhambazi të gjuhës rómani. Romët e tjerë të Maqedonisë flasin pa përjashtim maqedonisht, por shpesh i njohin edhe shqipen e turqishten.

Grupet etnike e gjuhësore të romëve në Ballkanin e jugut janë: Grupi I.: romët Bugurxhi, romët Drindari dhe romët Kallajxhi ndërsa grupi II: variantet arli, variantet erlides, variantet Iran, romët e Krimesë, romët e Prilepit, romët Rumeli/Paspatian, romët sepetides dhe romët *Ursari*.[71]

Më poshtë po i rendisim nëngrupet rome të Kosovës e të Maqedonisë.[72]

4.8. Grupi Barutija

Sikundër tregon edhe vetë emri me prejardhje turke "barut", romët e quajtur kështu kanë prodhuar dikur barut për ushtrinë osmane. Romët e këtij grupi bien ndër romët më të vjetër vendës të qytetit të Shkupit. Sado që sot nuk e ushtrojnë më këtë zeje, ata e kanë ruajtur megjithatë emrin e kryehershëm të tyre.

4.9. Grupi Topanali; romët topanë

Ky emër do të thotë thjesht "banor, vendës i lagjes Topana" përkatësisht Tophane siç quheshin dikur një lagje e Prishtinës dhe një e qytetit të Shkupit. Duket se ky grup romësh qëndron në lidhje farefisërie me romët *barutci*. Ka gjasë që në kohën e sundimit osman këta romë ta kishin pasur për zeje e detyrë t'i pastrojnë e t'i mirëmbajnë topat e ushtrisë osmane. Së këndejmi mund të supozohet se këta janë ndër romë të vjetër të këtyre dy qyteteve. Romë topanli ka sot në lagjen Topana të Shkupit, por jo edhe në atë Tophane të Prishtinës. Ndoshta një pjesë e

[71] Sipas Dieter W. Halwachs: Romani-Versuch eines einführenden Überblics http:/www. Gewi.kfunigraz.ac.at/romani/ling_all.de. htm.

[72] Emrat e grupeve dhe pjesa më e madhe e sqarimeve rreth tyre janë marrë nga punimi i Rüdiger Berninghaus: Roma - Gruppen in Mazedonien und im Kosovo; http:/koeler fluechtlingsrat.denachrichten/0700.doc.

këtyre romëve turqishtfolës të Prishtinës është tërhequr nga kjo lagje dhe është vendosur dikur në lagjen e sotme të romëve, në dalje të qytetit të Prishtinës, në të djathtë të rrugës për në Mitrovicë.

4.10. Grupi Maxhuri

Ka gjasë që tek ky emër të kemi të bëjmë me një stërkeqje të fjalës turke *muhacir* "muhaxher, ardhacak". Këta do të kenë jetuar si nëngrup më vete në qytetin e Shkupit, por nuk përjashtohet mundësia që në Ballkanin e Jugut të ndeshen edhe grupe të tjera që e mbajnë po këtë atribut, por që megjithatë nuk sajojnë grupe më vete. Sipas mendimit të përgjithshëm, maxhurët janë romë të ardhur nga Serbia në fillim të shek. XIX.

4.11. Grupi Meçkarija / Majmunxhija (khs. edhe Ursari - Romani)

Sikundër e tregon edhe vetë emri sllav *mečka* "arushë", emri i këtij grupi të romëve shenjon romë që luajnë me arusha e (më rrallë) me majmunë të ushtruar. Ky grup që e flet një dialekt jovllah, ndeshet në Rumani (atje këta quhen Ursarja), në Bullgari, në Maqedoni ka pak kësi romësh, në Kosovë nuk ka fare, ndërsa në Shqipëri këta e përbëjnë grupin më të madh të romëve. Unë kujtoj se pikërisht analiza gjuhësore e emrit të këtij nëngrupi të romëve do ta zbulonte edhe prejardhjen e tij. S'ka mbase arsye të mos pranohet për i drejtë interpretimi im sipas të cilit emri *meçkari* i këtyre romëve është në të vërtetë përkthim sllav i emrit rumun *urs*, përkatësisht *ursă mare* "arushë e madhe". Ky përkthim do të tregonte, në vija më të largëta, se romët *meçkari* janë në të vërtetë romë të Rumanisë e të Moldavisë dhe se dialekti i tyre i përket variantit vllah, përkatësisht variantit *Ursari-Romani* që flitet në Rumani e në Moldavi.

4.12. Grupi Juzhari; quhet edhe konoplarja "mbjellës të bimës së kanpit"

Në maqedonishte *juže* do të thotë "litar". Ky grup i vogël romësh e kishte për profesion kryesor punimin e kanpit, përkatësisht të litarit, të kapistrave dhe të artikujve të tjerë nga bima e kanpit. Mirëpo ky grup është sot më fort i njohur për tregtarë mobilë që shesin kryesisht shala, samarë e gjësende të tjera prej lëkure. Disa nga këta romë do të jenë vendës në Shkup, Kumanovë, Ohër e në Dibër. Deri para 30 vitesh kësi romësh ka pasur edhe në qytetin e Prishtinës. Më së shpeshti shiheshin në pjesën ku sot qëndron monumenti trekëmbësh – ku ishte një sinagogë hebrenjsh -, godina e postës dhe e Kuvendit të Kosovës si edhe në tregun e vjetër të Prishtinës në pjesën midis hotelit Grand dhe Stadionit të qytetit në të cilën (pjesë) ishte edhe kisha e vjetër katolike raguzase e Prishtinës.

4.13. Grupet: Dasikane Roma; Gadikane Roma; Mýsýr Mangýr; Kërci (Kýrýtsi); Gjuptin

Dasa-t janë diç si sinonim për joromët. Në disa regjione *dasa* quhen kryesisht të krishterët. si p.sh. romët *dassikane* "romët serbë, orthodoksë"; "Ata që jetojnë jashtë bashkësisë (SG. rome) quhen *dasa* (njëjës. *das*). Emri *dasa* na shpie prapa, në kohë kur në Indi depërtuan indoeuropianët, arianët dhe që këtyre nga vendësit iu dha emri *dasya*. Dasya-t dëshmohen ndër burime të lashta indase gojore e të shkruara. Romët Dasa ishin atëherë palë me orientime të përkundërta etnike e sociale".[73]

Niveli i njohurive të mia nuk më jep të drejtë që të këmbëngul me kompetencë në paravendmin se trajta *Gadikane Roma,* përkatësisht *gaxhe* e emrit të këtij grupi të romëve mund të ketë ndonjë lidhje me emrin e grupit *Gadžkane Sinti* "sintit gjermanë", të cilët veçohen nga romët *Lalere Sinti,* pjesa e të cilit e vendosur në Austri e quan veten *Bemtike Sinti* "Sintit e Bohemisë". Mirëpo shpresoj se zbardhjes së ndonjë të panjohure nganjëherë mund t'i ndihmohet edhe duke e vënë një "të vërtetë" nën pikëpyetje qëllimmire. Romët gaxhikane flasin kryesisht maqedonisht, sado që jo edhe aq mirë, ndërsa gjuhën e tyre e njohin shumë zbehtë. Këta janë kategorikisht kundër cilësimit të tyre për romë.

Distinktivi i përdorur më rrallë *mýsýr*, *mangýr* për romët *gaxhikane* sqarohet gjithsesi përmes turqishtes. Në këtë gjuhë, *mýsýr* i ka dy kuptime: kuptimin "misër, kallamboq" dhe "Egjipt"; Është paksa e vështirë të arsyetohet kuptimi i dytë i kësaj fjale. Në turqishten fjala *mangýr* do të shënonte një monedhë të vogël prej bakri ose një rriskë petaqe nga qymyri pluhur për nargjile. Sipas një interpretimi, emri i mësipërm është në të vërtetë vetëm një emër tjetër për romët gaxhikane; një burim i konsideron këta romë për popullatë të përzier me sllavë orthodoksë, përkatësisht me maqedonas e me serbë. Këtë do ta dëshmonte ndoshta edhe emri sinonimik *kauri, kaurli* (nga persishtja *gebr* përmes turqishtes *gâur, gâvur* në turqiashten e Kosovës *gjaur* "i pafe, jomysliman, i krishter; shka, serb") që përdoret për këtë grup të romëve.

Varianti *kërci* i emrit për romët e këtj grupi do të rrjedh nga turqishtja *kýrýk* "i thyer". Grupi *kërci* nuk pranohet më nga të tjerët për grup të veçantë romësh.

---

[73] Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

Varianti *gjuptin* që dëgjohet për grupin *gaðikane* (për emrat e tjerë khs. më lart) të romëve përdoret më së shpeshti në pjesën juglindore të Maqedonisë dhe lidhet, pas gjithë gjasësh nën ndikimin e etimologjisë popullore me emrin e Egjiptit, përkatësisht të "egjiptianve" apo më drejt me emrin *Gype* të kolonisë rome të periudhës bizantine në Greqi.

4.14. Grupi Gavutne

Në gjuhën rómani *gavutno* do të thotë "banor katundi, katundar". Në rrethina të Prizrenit kjo fjalë po u përdorka si një emër me kuptimin shm. "shqiptarë". Së këndejmi mund të supozohet se emri gavutne e ka kuptimin "rom i katundit", por romë që nuk i takojnë ndonjë "fisi" të caktuar prej romësh.

Pas Luftës së Dytë Botërore një grup romësh u shpërngul nga katundi Morani në juglindje të Shkupit dhe u vendos në qytetin e Shkupit, prandaj edhe u quajtën e quhen *Gavutne Moranska*.

4.15. Gupi arli, arlij, arlije "vendës"

Është grup i romëve të besimit mysliman. Formojnë një grup të madh gjuhësor në Ballkanin Jugor: në Maqedoni e në Kosovë dhe janë farefis me romët "bullgarë" *Erli/Yerli* të qytetit të Sofjes e të rrethinës së tij. Për të këtillë mbahen, përgjithësisht, hashkalinjtë e Kosovës (sh. më poshtë).

4.16. Grupi Tamara:

Emri i këtij grupi është gjithsesi me prejardhje nga indishtja. Tamarët përmenden në shumë burime indase, midis të tjerash edhe si themelues të qytetit të Delhi-t. Në Gadishullin e Ballkanit ky emër i romëve është ruajtur tek grupe romësh në Maqedoni e në Serbi.[74]

Për në Shqipëri, sipas H. Matoshit,[75] ERRC-ja vëren se romët trajtohen këtu me emërtime joqytetare dhe në baza raciste, si fise nomade, ndër të cilat shquhen *meckara, kabuzie, cergara* ose *skodrara* dhe *kurtofa*. Të gjithë së bashku quhen *arixhinj*. Romët dhe jevgjit perceptohen nga shumica si të dallueshëm. Por edhe ata vetë e bëjnë shpesh këtë dallim. Për një rom, jevgjiti nuk ka gjuhë dhe nuk e mban traditën, ai martohet me një të bardhë dhe flet shqip, ndërsa për jevgjit, romët janë primitivë (gabelë), nuk i dërgojnë fëmijët në shkollë, derisa veten e quajnë "qenie humane" dhe para administratës thjesht shqiptarë!

[74] Po ai, po aty.
[75] Sh. shkrimin e tij "Racizmi dhe lajmi pa etikë", Koha. net, 28.9.2013.

Së këndejmi, statistikat zyrtare të Shqipërisë flasin për më pak se 1000 romë (sic!), ndërsa shifrat e ERRC-së dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, që merren me të drejtat e njeriut dhe të pakicave kulturore e etnike, thonë se në Shqipëri jetojnë mbi 120 mijë romë.

5. PARAVENDIME RRETH NUMRIT TË ROMËVE

Romët, që i takojnë grupit indoeuropian të popujve, janë - me përjashtim të hapësirës së Azisë Lindore - të përhapur në të gjitha shtetet e rruzullit tokësor, e pra edhe në Europë. Në këtë kontinent romët përbëjnë minoritetin më të madh.

Shënimet më të vjetra përkitazi me numrin e romëve, përkatësisht të kryefamiljarëve romë në një pjesë të hapësirës gjeografike të Ballkanit, rrjedhin nga shek. XVI. Sipas një statistike zyrtare të kohës së Perandorisë Osmane të vitit 1522, në hapësirën territoriale që sot quhet Bullgari kishte 5.701 kryefamiljarë romë; në hapësirën e cila më vonë u quajt Serbi kishte 4.382 kryefamiljarë romë; në territorin që quhet Maqedoni kishte 720, kurse në hapësirën e quajtur Shqipëri 374 familje rome që ishin të detyruara të paguanin tatim" për Perandorinë Osmane. Administrata osmane-turke, kështu thotë Rubin Zamon, i paska dalluar egjiptasit nga romët: Mbi bazën e një shembulli nga koha e fillimit të sundimit osman në Ballkan po mundka të shihet se administrata osmane "e bënte dallimin midis romëve (Çingene) dhe të egjiptasve (Kiptiane)".[76]

Sipas shënimeve të paverifikuara, popullata e sintive dhe e romëve, bashkë me të gjitha grupet dhe nëngrupet e tjera që i përkasin kësaj bashkësie, arrin në gjithë botën shifrën prej rreth 12, përkatësisht 8,5 milion njerëzish. Grupet më të mëdha të romëve për nga numri janë të vendosura në shtete të Europës Juglindore. Kështu, në secilin nga këto shtete ka prej 300.000 deri në një milion romë. Vendi në të cilin ka më së shumti pjesëtarë të grupit etnik të romëve është padyshim Rumania. Romët përbëjnë në këtë shtet 8% të popullsisë së gjithëmbarshme të Rumanisë prej 23 milionësh. Në Rumani jetojnë kryesisht romë, ndërsa sinti ka fare pak. Në këtë vend po u flitka gjuha e mirëfilltë "*romanes*". Sipas disa vlerësimeve të tjera, në Rumani paska prej një milion e gjysmë deri në tre milion romë. Deri në kohën e rënies së regjimit të Ceausescu - t, romëve të Rumanisë u mohohej mëvetësia etnike; në Spanjë ka 400.000 deri në 500.000 romë, në Gjermani ka 60.000 deri në 70.000 sinti dhe 40.000 romë. Romët me nënshtetësi gjermane kanë ardhur në

[76] Rubin Zemon: Ethnologische, historische und archäologische Angaben über den Ursprung der Ägypter auf der Balkanhalbinsel http://www.egjiptianet.de/.

Gjermani prej 150 deri 80 vite më parë nga vende të Europës Juglindore, krysisht nga Hungaria. Sipas një prognoze më të re, përhapja dhe numri i të gjitha grupeve etnike: romëve, sintive, kalé-ve dhe të nëngrupeve të tyre në Europë del kështu: Bullgari [gabim i autorit, që citohet më poshtë] 15.000; Bosne (para luftës) 300.000; Bullgari 800.000; [SG: në burime të tjera ky numër sillet prej 350.000, përkatësisht 420.000 - 500.000]; Danimarkë 5.000; Gjermani 130.000; Estlandë 3.000; Finlandë 12.000; Francë 600.000; Greqi 350.000; Britani të Madhe 120.000; Itali 100.000; Irlandë 28.000; Jugoslavi (Serbi) 450.000; Kroaci 35.000; Letoni 4.000; Lituani 5.000; Luksemburg 600; Maqedoni 350.000; Moldavi 60.000; Holandë 35.000; Norvegji 25.000; Austri 35.000; Poloni 45.000; Portugali 40.000; Rumani 2.500.000; Sllovaki 400.000. [Zyrtarisht, sipas regjistrimit të vitit 2001 në këtë vend kishte 89.920 ose 1,7 % e popullsisë, ndërsa jozyrtarisht thuhet se ka midis 300.000 e 500.000 sish]; Slloveni 15.000; Suedi 20.000; Shqipëri 100.000; Zvicër 35.000; Spanjë 800.000; Turqi 600.000; Republika Çeke 300.000; Ukrainë 60.000; Hungari 600.000; Bjellorusi 20.000; Qipro 2.000.[77] etj.

Sipas të dhënave të njohësit të mirë të historisë së romëve Rajko Đurić[78] romët e pësuan keq sidomos në Bosnje e në Kosovë. Para luftërave të viteve të `90-ta në Bosne kishte 30.000, ndërsa tani ka mezi 28.000; në Kosovë deri në vitin 1999 paska pasur 264.000, ndërsa tani paska vetëm rreth 270.000 sish.

Në një raport mbi gjendjen e minoritetit rom në Greqi, përkatësisht në Thraki, thuhet se romët qenkan vendosur në Greqi në shek. XI në vazhdën e migrimeve të tyre përmes Armenisë. Këtu paska sot rreth 25. 000 romë të besimit mysliman, të cilët e mbajnë veten për "turq". Paska edhe romë të besimit orthodoks, të ardhur nga Thrakia Lindore. Nga popullata shumicë romët quhen rëndom *Atsigani* "që s'bën të preken" ose me emrin përçmues *Gifti* "magjupë".[79]

Pothuajse në asnjë shtet nuk ka të dhëna zyrtare të besueshme përsa i përket numrit të banorëve të deklaruar për romë. Të dhëna statistikore përkitazi me përkatësinë etnike të romëve në bazë të regjistrimeve të popullsisë e të regjistrimeve të natyrës tjetër janë evidentuar vetëm në ish-shtetet socialiste. Mirëpo shifrat që kanë dalë nga ato regjistrime janë larg nën numrin real të pjesëtarëve të etnisë rome. Shifrat e dhëna për

[77] Birgit Lettenbauer Roma in der Slowakei "Dann soll ich mich auch als Roma bekennen" http://www.pragerzeitung.cz/?c_id=3014.

[78] Në një intervistë në radion "Europa e Lirë" (serbisht) më 8 nëntor 2008.

[79] Sipas, Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

madhësinë e këtij grupi etnik mbështeten, në të shumtën e rasteve, vetëm mbi hamendje zyrtare e jozyrtare.

Në rastin e romëve, kësaj i kontribuon rrethana që shumica prej tyre nuk duan të paraqesin popullatë të mëvetshme, porse preferojnë ta marrin gjuhën dhe konfesionin e popullatës shumicë. Në vazhdën e mohimit të prejardhjes dhe të identitetit të tyre, romët i shfrytëzojnë për këtë edhe regjistrimet e popullsisë për t'u regjistruar edhe zyrtarisht si pjesëtarë të një popullate tjetër, në të shumtën e rasteve të popullatës shumicë me të cilën bashkëjetojnë ose të deklaroheshin për pjesëtarë të një kategorie të privilegjuar (p.sh. myslimanë ose më herët edhe "jugosllavë"). Në këtë mënyrë romët e fshehin prejardhjen e tyre të vërtetë pas një identiteti më të respektueshëm duke shpresuar mbase se kështu do t'i krijojnë vetes kushte më të mira për mbijetesë.[80] Për pasojë, pothuaj në të gjitha regjistrimet e popullsisë, romë dalin gjithherë më pak se ç'ka në të vërtetë. Krejt ndryshe operojnë me shifra organizata të romëve dhe funksionarë romë e organizata për të drejtat e njeriut. Këta japin pothuaj gjithmonë shifra që janë shumë larg gjendjes reale.

Në hapësirën e ish-Jugosllavisë kishte pas Luftës së Dytë Botërore rreth një milion romë, mëvetësia etnike e të cilëve nuk ishte e pranuar – prandaj edhe nuk figurojnë në statistika të regjistrimeve të popullsisë. Sipas regjistrimit të popullsisë më 1981 në Maqedoni kishte 43.223 romë "të deklaruar", ndërsa sipas të dhënave të tjera paskan qenë 52.103. Në regjistrimin e vitit 1991 në Maqedoni paska pasur 55.580 romë. Përfaqësuesit e romëve thonë se sot në Maqedoni paska prej 150 deri në 250. 000 romë.

Deri para luftës (1992) në Bosnje-Hercegovinë kishte përafërsisht rreth 80.000 romë, shumica e të cilëve ose kanë rënë në luftë, janë mbytur ose janë dëbuar. Edhe në republikat e Serbisë e të Malit të Zi jetojnë sot rreth 700.000 romë, përfshirë këtu edhe rreth 70.000 (?!) romë të dëbuar nga Kosova.[81]

Edhe për sa i përket numrit të banorëve romë në Kosovë, të dhënat janë të ndryshme. Kështu, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1981 këtu paska pasur rreth 34.000 persona të regjisruar shprehimisht si "romë". Ministria për Informim e Jugosllavisë e përhapte sipas parimit

[80] Yvonne Bangert, http://www.gfbv.de/voelker/europa/greece/209_roma.htm; entnommen aus pogrom - bedrohte völker Heft 2 / 2001.

[81] Orhan Galjus, Roma im Kosovo: Die vergessenen Opfer (Versioni gjerman i artikullit anglisht "Roma of Kosovo: the Forgotten Victims" aus dem Web-Journal "The Patrin" http://www.geocities.com/~patrin/kosovo.htm) në http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/balkan.htm.

"dy parë grushta nji okë" opinionin se më 1998 (në regjistrimin e popullsisë që kosovarët e bojkotuan) në Kosovë paska rreth 97.000 romë, ndërsa në këtë numër nuk qenkan përfshirë të ashtuquajturit "egjiptianë", çfarë paska pasur rreth 23.000, që janë regjistruar ndër "të tjerë". Në dhjetor të po atij viti (1998) Slobodan Milošević thoshte se në Kosovë paska 150.000 romë dhe këtë shifër e ka aprovuar madje edhe institucioni me renome Gesellschaft für bedrohete Völker me seli në Heidelberg. Deklarimet e organizatave të romëve se në Kosovë paska prej 350 deri në 500.000 romë i kapërcejnë të gjithë kufijtë e së mundshmes. Ndonjë organizatë joqeveritare në Gjermani vlerëson se para luftës në Kosovë paska pasur midis 120.000 ose 150.000 romë, përkatësisht se rreth 8 për qind e popullatës së gjithmbarshme të Kosovës na paska pas qenë e përkatësisë etnike rome e të asaj hashkali. Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 1991, kështu beson ndonjë organizatë joqeveritare, romët dhe hashkalinjtë përbënin porse vetëm 2,5 të popullsisë së përgithshme të Kosovës. Sipas të dhënave të një roganizate tjetër, në Kosovë po jetuakan gjithsej 18 mijë romë, ndërsa 32 mijë të tjerë qenkan egjiptas dhe hashkalinj. Në Gjermani, sipas të dhënave të kësaj shoqate, po jetuakan aktualisht rreth 86 mijë romë nga Kosova, një e treta e të cilëve kërcënohet nga riatdhesimi, përkatësisht dëbimi për në Kosovë. Gjatë Luftës në vitin 1999, nga Kosova qenkan dëbuar apo arratisur rreth 120 mijë romë. Sipas të dhënave të aktivistëve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, qenkan shkatërruar 70 nga gjithsej 75 lagjet (vendbanimet) rome sa kanë qenë në Kosovë.

Në vitin 1993 hashkalinjtë kosovarë (për këta sh. më poshtë) e paskan organizuar vetë një regjistrim intern të popullatës hashkali, rezultatet e sakta të të cilit nuk po u ditkan, sepse ato shënime paskan humbur gjatë kohës së luftës. Liderë të hashkalinjve thonë se në Kosovë paska rreth 87.000 hashkalinj (duke i përfshirë edhe ata që më vonë do ta quajnë veten "egjiptas").

6. ROMËT NË HAPËSIRËN GJUHËSORE E ETNIKE SHQIPTARE

Përkitazi me kohën e vendosjes së grupit të romëve me të gjitha nëndegët e kësaj etnie në Kosovë nuk ka pothuajse kurrfarë të dhënash. Ka pasur vetëm një mendim, të cilin unë porse e konsideroj të gabueshëm, sipas të cilit romët paskan qenë në Kosovë edhe para shekullit 14 (sh. më poshtë, tek etimologjia e fjalës *magjup*). Dëshmi më të vjetra të shkruara mbeten, për mendimin tim, të dhënat mbi kryefamiljarët romë në defterin turko-osman të regjistrimit nëpër regjione

të Ballkanit në shek. XVI (sh. më lart). Ka edhe një shpjegim, sipas të cilit romët paskan ardhur në Kosovë bashkë me ushtrinë turke.[82]

Në vende të ndryshme të Ballkanit popullata rome njihej historikisht dhe deri vonë me emra të ndryshëm, porse askund me emrin e ri rom. Kështu ishte edhe në Kosovë. Këtu grupi etnik i romëve si kolektivitet quhej nga shqiptarët *magjup* e *gabel*; nga serbët nj. *ciganin* m. *ciganka* f. dhe nga turqishtfolësit quheshin *çingene*. Në hapësirën gjuhësore të shqipes pa Kosovën, kjo popullatë njihet tradicionalisht me emrat: *magjup, evgjit, cigan, gjypsh, xhip, jevg* dhe *gabel. Magjupë* janë për kosovarët romët, të cilët për gjuhë amtare e kanë shqipen, ndërsa për nga religjioni i takojnë fesë myslimane. Nga shqipja, këtë nocion e kanë marrë edhe serbët e Kosovës, tek të cilët, sipas I. Ajetit,[83] ky emër del në trajtat *džupa*, *džupa* "jevge". Magjupët, për pasojë të identifikimit me kosovarët shqipfolës, e kanë marrë si veshjen tradicionale shqiptare, institucionin shqiptar të fisit, ashtu edhe antroponiminë e shqiptarëve. Të gjitha nëngrupet e magjupëve të Kosovës janë popullatë (relativisht) ndenjëtare.

Mirëpo këtyre tridhjetë viteve të fundit kanë filluar që edhe në Kosovë, kryesisht për shkaqe politike, përkatësisht me qëllim të paraqitjes së Kosovës nga pushteti serb/jugosllav si një "konglomerat" prej popujsh nga më të ndryshmit duke dashur ta portretojnë Kosovën sikur kjo të mos jetë tokë e shumicës shqiptare, por si vendbanim i tipit p.sh. të ndonjë qyteti të Vojvodinës në të cilin ka individë nga më shumë se të 20 etnive, të hynë në përdorim edhe emra (etnikë?) të tjerë si *rom, hashkali, egjiptianë*, kështu që si nga vetë pjesëtarët e këtij grupi etnik (folës të gjuhës rómani), ashtu edhe nga popullata shumicë e ambienteve në të cilat jetojnë romët, nisi të përdoret nocion modern, i institucionalizuar, *politikisht* i diktuar *rom*. Stimulimi i programuar vetëm për Kosovën i këtij minoriteti shkoi aq larg sa Televizioni i Prishtinës ishte asokohe (në vitet 1974 - 1989) si edhe RTK sot, i vetmi në botë që transmetonte edhe një emision lajmesh në gjuhën *rómani*. Megjithatë, për distinktiv popullor të popullatës rome, në të folmen e përditshme shqipe në Kosovë përdoren edhe sot e gjithë ditën pothuajse vetëm nocionet e vjetra, përkatësisht *magjup* e *gabel*, të cilat gati se e kanë humbur kaherë karakterin përçmues që ndoshta mund ta kishin pasur ndonjëherë. Distinktivet *magjup* e *gabel* përdoren edhe nga vetë këto dy degë të popullatës që, sipas termit më të ri, quhen romë. Në regjione të ndryshme romët njiheshin nga kosovarët edhe me emra të tjerë, përkatësisht përkrah

[82] Anelore Hermes, Referentin im Bundesbüro der GvbV (Göttingen): Basisfakten und Überblick, http://www.gfbv.de/voelker/europa/roma.

[83] Khs.Shqiptarët dhe gjuha e tyre, Prishtinë, 1994, f. 95.

nëngrupit të *gabelëve* njihej edhe ai i *çergashëve*. Çergashët e Kosovës janë mbase farefis, pjesë e ndarë e romëve që jashtë Kosovës njihen edhe emrat *Cergarja* "banues çadrash", rumanisht të quajtur edhe *Cortorara*, ku bie ndoshta edhe fisi *Cerharja* i Lovarëve në Hungari e që e flasin një dialekt të përzier.[84] Pjesën dërmuese të romëve në Kosovë e përbëjnë magjupët, përkatësisht hashkalinjtë.

Për ta bërë më të thjeshtë e më të qartë çështjen e nocioneve që e shënojnë përkatësinë etnike të grupeve të ndryshme të romëve, për grupet rome të Kosovës në këtë punim do të përdoren nocionet që përdoren edhe nga vetë pjesëtarët e grupeve të kësaj popullate që si kolektivitet quhen romë. Këtu do të përdoret pra nocioni ndërkombëtar, modern *rom* për atë pjesë të popullatës që vetë e quan veten kështu, përkatësisht për ata pjesëtarë të grupit etnik të romëve që e flasin njërën nga 13 variantet e gjuhës rómane / romanes; për nëngrupet e tjera të romëve do të përdoren gjithashtu nocionet që i përdorin vetë ato nëngrupe, ndërsa për nëngrupet (për nga origjina) që nuk e flasin ndonjë variant të gjuhës rómane / romanes përkatësisht për (romët) që flasin shqip, do të përdoren paralel nocioni kolektiv *magjup* dhe emrat e nëngrupeve: *hashkali* dhe *gabel*.

6.1. Romët në Kosovë

Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 1991 (të cilin shqiptarët e kishin bojkotuar) në Kosovë paska pasur 47.806 pjesëtarë të grupit etnik rom ose 2,5 për qind e popullsisë së gjithmbarshme. "Pas gjithë gjasësh me dhjetëra mijëra romë do të jenë regjistruar si shqiptarë, serbë apo turq". Qendrat me më së shumti romë janë: Prishtina me 6.625, Mitrovica me 4.074, Obiliqi me 3.767, Gjilani me 3.484 dhe Fushkosova me 3.384 romë.[85] Edhe për romët që jetojnë si ndenjëtarë apo si nomadë që herë

[84] Pa pretendime se mund t'i kontribuoj diçka zbardhjes së kësaj enigme, po e riprodhoj një tregim popullor përkitazi me prejardhjen e përbashkët nga India të romëve dhe të zogut që ndër shqiptarë njihet me emrat: zog i udhëve, (zog) dervish, çuruli për të cilin thonë se e ka origjinën nga India. Pas pushtimit të Indisë nga Perandoria Osmane, ushtarët osmanë paskan angazhuar indas që t'u prijnë karavaneve. Këtyre karavaneve u paskan shkuar mbas zogj të këtij lloji që ushqehen me kokrra drithi që i nxjerrin nga bagla bagëtish, pra, në rastin tonë, nga bagla kuajsh dhe kështu paskan arritur përnjëherë në vise të Ballkanit romët dhe zogu i quajtur *çurruli* etj. Forcën sqaruse ky tregim e gjenë mbase tek emri i një grupi të romëve, përkatësisht tek ermi i romëve arli. Deri tani nuk ka ndonjë sqarim më mbushamendës se emri arli rrjedh nga mbiemri turk *yerli* (dëgjohen edhe variantet *arli*, *erlides* dhe *arlije* dhe të gjitha e kanë kuptimin "vendës", gjë që nuk e përjashton pra mundësinë që ky grup i romëve të jetë vendosur në Kosovë nga Turqia).

[85] Sinti und Roma, Eine Studie der Evangelischen Kirche in Deutschland http://www.wuwien.ac.at/usr/h92/h9251606/bal/Jenisch/Jenisch_Geschichte.html

pas here vendosen në Kosovë në vazhdën e shtegtimit të tyre paravendohet prejardhja nga India. Këtë prejardhje po e dëshmuakan rezultatet e studimeve të deritanishme nga fusha e kulturës materiale e shpirtërore dhe të gjuhësisë.

Zëdhënësi i presidentes së Kosovës thoshte në një intervistë se "Sipas regjistrimit të popullsisë më 2011, janë më pak se 9.000 romë në Kosovë, por ka disa grupe etnike minoritare që mund ta quajnë veten si egjiptianë ose ashkali. Të gjithë këta së bashku përfaqësojnë rreth 50,000 banorë. "

Të ashtuquajturit *romë etnikë* ose *romë të mirëfilltë* e identifikojnë veten për romë dhe për amtare përbrenda familjes dhe të komunikimit jashtë saj midis njëri-tjetrit e kanë gjuhën *rómani* /*romanes*. Këta e kanë identitetin e tyre të mëvetshëm etnik e gjuhësor. Këta dallohen njëri nga tjetri nga njëra anë nga përkatësia e grupeve të ndryshme të mëdha gjuhësore të romëve, si p.sh. grupeve përkatësisht varianteve *arli* e *vlahÿ*[86] dhe, nga ana tjetër, nga përkatësia nëngrupeve të ndryshme të cilat definohen kryesisht nga profesionet që i ushtrojnë familjet e mëdha dhe nga dialektet e mëvetëshme të tyre. Më të njohurit janë *kovaçët* të quajtur edhe *bugurxhi* si edhe tregtarët me kuaj, të quajtur *xhambaz*. Nga këto dy grupe rrjedhin shumica e familjeve të romëve.[87]

Mirëpo ka midis tyre edhe sish që e flasin edhe shqipen apo serbishten dhe sish që e njohin edhe turqishten. Ka në mesin e romëve të Kosovës edhe një numër sish që nuk e kanë ruajtur gjuhën e tyre dhe që atë e kanë zëvendësuar me shqipen. Ky fenomen ka ndodhur kryesisht në Rrafshin e Dukagjinit.

Në pjesën më të madhe të tyre romët janë të besimit islam, porse ka edhe një pakicë të krishterë të ritit katolik dhe të atij orthodoks. Romët, në krahasim p.sh. me hashkalinjtë, janë më këmbëngulës në ruajtjen e traditave të tyre.

Romët e Kosovës e ndajnë veten në dy grupe, përkatësisht në *rom-arli* dhe në *rom-gurbet* (dëgjohen edhe variantet *kurbat* dhe *kurbet*, *gurbetija* / *gurbetçija*). Emri i tyre rrjedh nga turq. *gurbet* "i huaj". Janë të shkapërderdhur në gjithë territorin e ish-Jugosllavisë dhe në viset përreth. Për nga gjuha, këta janë të afërt me kalderashët e pjesërisht edhe me xhambazët e Kosovës e të Maqedonisë.

---

[86] sipas Übergriffe auf Roma im Kosovo Gesellschaft für bedrohte Völker appelliert an KFOR: Schützen Sie die Minderheiten http://www.gfbv.de/voelker/europa/kosovo/roma.htm

[87] Christiane Fennesz-Juhasz/ Dieter W. Hawachs/ Mozes F. Heinschnik: Sprache und Musik der österreichischen Roma und Sint http:/www-gewi.kfunigraz.ac.at./romani/downlaod/files/_ab5.pdf

Emri i grupit *arli* dëgjohet në Bullgari e në Greqi edhe në variantet *erlides / yerlides* dhe *arlije* dhe lidhet përsëri me një fjalë turke: *yerli* "vendës". Grupi *arli* i romëve është i besimit mysliman dhe në të shumtën e rasteve për amëtare e ka gjuhën turke. Më shpesh jetojnë në paralagje të qyteteve më të mëdha. Në rastin e Kosovës kjo vlen për periferitë e qyteteve të Prishtinës, Gjilanit e të Prizrenit në të cilat flitet edhe turqishtja.

Ka gjasë që romët *arli* të kenë qenë të pranishëm në Ballkan qysh para kohës së invadimit osman të këtij Gadishulli. Këta janë ndenjëtarë dhe e përbëjnë grupin e tretë për nga madhësia të romëve në Maqedoni. Ndeshen krejt më pak në pjesën perëndimore dhe veriperëndimore të Maqedonisë se sa në pjesët e tjera të këtij vendi. Dialekti rómani (*romanes*) i tyre nuk i takon grupit vllah, prandaj është më së pakut i vërshuar nga ndikimi rumun. Dialekti i këtij grupi është i ndikuar më shumë nga turqishtja.

Emri *Gurbet* do të thotë në turqishte "i huaj, të huajë". Emri i këtij grupi të romëve del në Orient (Iran, Afganistan) si *Ghorbat* ose *Kurbeti*. Përkitazi me variantin *kurbat* "magjup; ai që punon sita" të emrit të kësaj dege të magjupëve C. Tagliavini[87a] sqaronte se dijetari rumun V. Bogrea e lidhte këtë emër, mbase pa të drejtë, me ddistinktivin rumun *cobret* "zingaro"

Duke qenë se gurbetët ishin shumë mobilë, në disa vise i barazojnë me çergarët, prandaj edhe i quajnë *çergarë*. Në disa vende të tjera (sidomos në Bosne-Hercegovinë) këta romë e quajnë veten edhe "Kale Roma (Crni Cigani "magjupë të zinj") si antipod kundrejt romëve ndenjëtarë që quhen "Parne Roma (Bjeli Cigani, "magjupë të bardhë"). Romët *Gurbeti* janë pothuajse grupi i tretë për nga madhësia i romëve në Maqedoni dhe janë të përhapur nëpër gjithë shtetin. Një pjesë e këtyre romëve janë të krishterë orthodoksë. Dialekti i tyre i takon grupit vllah dhe dallohet për një shumësi nënvariantesh.

Emri i grupit *rom-gurbet* lidhet me fjalën turke *gurbet* "i huaj"- i quajtur kështu për shkak të dyndjes vonë në regjionin e Ballkanit. Edhe dialektet, përkatësisht variantet e gjuhës romané që i flasin këto dy grupe quhen *roma-arli*, përkatësisht dhe *roma- gurbet* ose *gurbetxhi*. Romët *arli* jetojnë kryesisht në periferi të qyteteve dhe në katunde të Rrafshit të Kosovës, ndërsa romët-*gurbet* jetojnë kryesisht në Rrafshin e Dukagjinit.

[87a] sh. Gli Studi Albanesi nella "Dacoromania", Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju, Knj. III, Sv. 1-2, Beograd, 1926, f. 251.

Varianti, dialekti që e flasin romët arli quhet *roma-arli*, por edhe *horhané.*

Edhe vetë grupi rom që e flet këtë dialekt quhet *Xoraxane* / *Xolaxane* Roma (Khorakhane; Khorakane; lexo: horhane) ose edhe *Korane Roma* "romë myslimanë, përkatësisht turq". Me emrin *Xoraxane* quhen në gjuhën rómani në rend të parë turqit e ndonjëherë edhe shqiparët. Pas gjithë gjasësh, fjala horhane mund të vënet në lidhje me fjalën kur'an, përkatësisht "sipas kur'anit" në kuptimin më të gjerë mysliman. Këta romë-turqë flasin në të shumtën e herës më mirë turqisht se sa *rómanes* dhe, natyrisht, janë myslimanë për nga religjioni. Gjuhën serbe, përkatësisht maqedonisht e flasin fort keq. Ka jo pak raste kur kuptimi i termit horhane përdoret edhe pa vend, sidoms në rastet kur për romë të këtij grupi konsderohen edhe romë të tjerë vetëm pse mbajnë emra personalë të sferës turke përkatësisht orientale të antroponimisë dhe pse janë myslimanë. Së këndejmi del se termi rom *Xoraxane* (lexo horhane) duhet kuptuar më shumë si një emër përmbledhës për (të gjithë) romët se sa si emër për një grup të caktuar syresh. Ndryshe nga romët në Bosne dhe ata të ardhur nga ky vend, romët horhane nuk janë nomadë, por ndenjëtarë. Shumica e romëve horhane janë shpërngulur në Europën Veriore qysh para shpërthimit të konflikteve të fundit në ish-Jugosllavi.

Një nëngrup më vete e përbënin romët që veten e quanin *arabaxhi*. Emri i këtij nëngrupi vjen nga fjala turke *araba* "qerre" dhe i shenjon pra ata romë që për profesion kryesor e kanë punimin, përkatësisht meremetimin e qerreve dhe transportimin me qerre të mallrave.

Në Kosovë kishte edhe romë që e quanin veten *roma-kovaçi*, që shquheshin për zejen e farkëtarisë dhe sish të nëngrupit të romëve *xhambazë* (kujto gabelët e Rrafshit të Dukagjinit) që merreshin me tregtinë e kuajve. Xhambazët janë me origjinë nga Rumania. Ndeshen edhe ndër romë të Austrisë dhe nëpër ish-Jugosllavi. Të dyja këto nëngrupe pothuajse janë shuar dhe nuk ndeshen më ndër banorë të Kosovës. Këta romë i flisnin variantet *kovaçki* dhe *xhambaski* të gjuhës rómane. Emri i romëve *xhambazë* (*džambazija*, *džanbazija*, *džambaz*) të cilët nganjëherë ndryshe quhen edhe *çergari*, e heq prejardhjen nga fjala turke *cambaz* (trajta e sllavizuar džambaz) "tregtar kuajsh, akrobat, dallaverxhi" ose nga fjala *džamba*. "bretkocë" (khs. më lart). Në Kosovë, kjo fjalë e ka edhe kuptimin e njeriut, tregtarit llafazan. Duket se, duke qenë tregtarë kuajsh, këta do të ketë qenë shumë mobilë. Duket se popullata shqiptare e Rrafshit të Dukagjinit i ka përfshirë këta nën emrin përmbledhës *gabelë* (shih për këtë etimologjinë e fjalës gabel), ndërsa ata të Rrafshit dhe të pjesëve të tjera të Kosovës me emrat *çergarë* e *gabelë.*

Sot në Kosovë nuk ndeshet më asnjë gabel i grupit xhambaz, i cili do të merrej me zanatin e vjetër.

Ndryshe nga p.sh. romët arli, xhambazët e flasin një dialekt i cili i takon grupit të ashtuquajtur vllah të gjuhës rómani. Kështu flasin edhe romët e rrethinave të Zrenjaninit në Vojvodinë, të cilët e quajnë veten *Švabski cigani* "Romë të Shvabisë". Disa linguistë kujtojnë se ky dialekt është po ai që në të vërtetë flitet nga romët e grupit *gurbet*. Nga romët e tjerë xhambazët konsiderohen për nëndegë e grupit të madh Lovara (emri i tyre rrjedh nga hung. *lo* shm. *lovak* "kal; kuaj") të romëve të cilët janë të shtrirë gjer e gjatë në Europën Lindore dhe në Burgenland të Austrisë. Përveç me pakicë në Kosovë, romët e këtij nëngrupi jetojnë edhe në Maqedoni, ku paraqesin grupin më të madh rom dhe përjashta saj. Sado që romët xhambazë janë sot si në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni e gjetiu banorë ndenjëtarë, këta quhen ndonjëherë edhe çergarë, çergashë.

Pjesa më e madhe e romëve të quajtur edhe sot e gjithë ditën romë çergarë/ çergashë janë si në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni serbë, përkatësisht maqedonas të krishterë të ritit orthodoks. Pjesëtarët e këtij grupi flasin serbisht, përkatësisht maqedonisht dhe bëjnë jetë bredhacakësh, në të shumtën e rasteve në hapësirën gjuhësore të serbishtes dhe (për aq sa janë) administrativisht janë të lidhur për Serbinë.

Këta e mbajnë veten për romë të vërtetë e për të këtillë shihen edhe nga romë të tjerë. Thuhet se këta po e folkan gjuhën "më të mrë" rómani dhe po i ruajtkan ende në pjesën më të madhe traditat e vjetra. Ky grup i romëve nuk e ka për qejf ta dëgjojë për veten termin çergash - për shkak të konotaciont të keq "endacak, nomad" që e ka ky emër.

Këta janë ata romë bredhacakë që në të kapërcyer nëpër Kosovë dhe vetëm gjatë stinëve të nxehta të motmotit jetonin nën tenda që i ngulitnin gjatë shtegtimit të tyre. Këta quheshin *çergarë, çergashë.* Atributi çergar për këtë grup romësh rrjedh nga fjala turke *çerge* (çadër, tendë, në mënyrë të veçantë "tendë magjupsh"), për t'i shenjuar kështu romët që jetojnë nëpër tenda, nën tenda; "magjupë tendash". Këta endeshin me qerre të tërhequra nga mushka, me qerre të mbuluara me çadra ose pjesë qylymash. Këta merreshin kryesisht me kallajitje remesh, ndërsa gratë shquheshin si fallxhesha, por edhe si hajnesha pulash e rraqesh të shtëpisë. Vendoseshin kryesisht në periferi të katundeve, madje edhe të katundeve malore të thella. Kur përhapej lajmi se janë vendosur çergarët kallajxhinj, burrat e katundeve përreth i çonin tek ata remet për t'i kallajitur dhe shumë rrallë, sepse kishin frikë se do të vjedhin - sidomos gratë çergare - i thërrisnin edhe në katund. Këta dalloheshin nga romë të tjerë sepse gratë e këtij nëngrupi kishin një veshje tjetër në krahasim me

romët (magjupët) vendës. Këta mbanin kapela republikë dhe nuk flisnin shqip. Gjuha amtare e tyre ishte serbishtja. Gratë çergare bartnin fustane dhe kokën e kishin të mbuluar me shamia të një ngjyre karakteristike të verdhë për romët. Veshja e çergarëve ishte përafërsisht si e romëve të Vllahisë, përkatësisht të Rumanisë. Dialekti, varianti që e flet grupi i romëve çergari quhet *çergarski.* Të gjitha këto nëngrupe të romëve që flasin secili variantin e vet të gjuhës rómani martesat i bëjnë, megjithatë, vetëm përbrenda nëngrupit që i takojnë.

Me përjashtim, pra, të një numri të vogël romësh që për gjuhë amtare e kanë marrë shqipen (si p.sh. gabelët në Rrafshin e Dukagjinit), pjesa absolute më e madhe e romëve janë folës të serbishtes. Romë serbishtfolës ka kryesisht në qytete, përkatësisht në periferi qytetesh në të cilat ka edhe element etnik serb. Kështu p.sh. romët e pjesës lindore të Kosovës, përkatësisht të qytetit të Gjilanit me rrethinë, si edhe romët në pjesën veriore të Kosovës (Mitrovica me rrethinë) brenda shtëpisë flasin serbisht dhe shqipen e njohin pak apo fare. Romë serbishtfolës ka edhe në qytezën e Graçanicës, në Lipjan dhe në rrethinë të tij. Romët serbishtfolës e morën jo vetëm gjuhën. por edhe religjionin, përkatësisht orthodoksinë serbe dhe ndodhen kështu në fazën e heqjes dorë edhe nga kultura e tyre specifike. Bile ata janë serbizuar deri në atë masë sa që edhe muzika e tyre është e ndryshme nga ajo që e bëjnë magjupët që flasin shqip. Popullata shqiptare i quan të gjithë romët që nuk flasin shqip *shkije-magjup* dhe /ose *gabelë.*

7. HASHKALINJTË:

7.1. Aškalija (Haškalija)/ Malokija / Cibane Roma / Albanski Roma / Magjupi (Maxhup / Maxhyp) Aškalija (Haškalija)/ Malokija / Cibane Roma / Albanski Roma / Magjupi (Maxhup / Maxhyp)

Hashkalinjtë e mbajnë veten për grup të mëvetshëm etnik dhe nuk duan të kenë gjë të përbashkët, përkatësisht të identifikohen me romët. Të dy grupet etnike dallohen rëndom në bazë të ngjyrës së zeshkët të lëkurës. Mirëpo, midis romëve e hashkalinjve ndeshen herë pas here edhe tipe bjondinë e lëkurëbardhë.[88] Hashkalinjtë besojnë (si edhe "egjiptasit"-sh. më poshtë) se në Ballkan paskan ardhur nga Egjipti me ushtrinë e Lekës së Madh. Mirëpo ka disa vite që si atdhe i kryehershëm i hashkalinjëve përmendet edhe një regjion i quajtur **Hashk* i Persisë,

[88] Nga: Nicolaus v. Holtey, Schalomdiakon, Mitglied der Pax Christi Bewegung, Zwei Reisen zur Erkundung der Lage der Ashkali und Roma im Kosovo, Heidelberg, 22. 2. 2000.

përkatësisht i Iranit. Hashkalinjtë janë kryesisht myslimanë, por ka shumë sish që u takojnë edhe sekteve të dervishëve.[89] Kjo rrethanë do të fliste në të mirë të dyndjes së pararendësve të hashkalinjve të sotëm nga hapësira e variantit shiit të fesë islame, përkatësisht nga Persia/Irani i sotëm pas separatizmit shiit nga islami i propaguar nga Muhameti. Në të mirë të këtij paravendimi do të fliste rrethana që në gjuhën romané nuk ka elemente të arabishtes. Ky paravendim do të bëhej i besueshëm nëse shiitët/ dervishët hashkalinj nuk e përvetësuan këtë sekt, si edhe shqiptarët, pas pushtimit osman. Prejardhja dhe kuptimi i termit hashkali është, megjithatë, e paqartë. Hashkalinjtë njihen edhe me emra të tjerë si p.sh. *malokija*, *cibane Roma*, *romë shqiptarë*, *magjupë*. Emri *malokija* për hashkalinjtë rrjedh nga shqipja *malok* dhe e ka kuptimin "malësor, njeri trashanik" dhe bie ndër emra me përhapje shumë të kufizuar. Emri *cibane* është një fjalë rome që i shenjon shqiptarët. Emri *magjup* është një distinktiv shqip për romët ndenjëtarë dhe që (si edhe fjala *Gypsy*) gabimisht të shpie tek emri i egjiptasve. Pikërisht përkitazi me nocionin anglisht të emrit etnik të romëve bën të përkujtohet mendimi i dijetarit bullgar K. Kostov se këtu kemi të bëjmë me një lajthitje, sepse në gjuhën e romëve nuk ka elemente të arabishtes, gjë që e nënkupton rrethanën e pamohueshme se ata nuk kanë bashkëjetuar në ambiente të Egjiptit, sepse në gjuhën e tyre ka shumë elemente gjuhësore greke e sllave të jugut, gjë që tregon se ata për kohë të gjatë para se të dyndeshin në Europën e Perëndimit kishin bashkëjetuar me grekë e me sllavë të Jugut.[90] Emri *magjup* në shqipen nuk i emërton vetëm hashkalinjtë (për fjalën magjup sh. më poshtë). Edhe vetë emrat e ndryshëm që përdoren për hashkalinjtë (khs. më lart) e tregojnë padyshim afërsinë e hashkalinjve me shqiptarët. Këtë e tregon edhe rrethana që gjuha shqipe është bërë gjuhë amtare për pjesën më të madhe të hashkalinjve, sado që mund të ndeshet rrallë edhe ndonjë hashkali që di ta flasë gjuhën rómani. I gabueshëm është porse paravendimi sipas të cilit hashkalinjtë janë një "etni e re" e dalë si rezultat i përzierjes së romëve me shqiptarë, sepse martesa të ndërsjellta midis hashkalinjve e shqiptarëve pothuaj se nuk ka pasur ndonjëherë, sado që hashkalinjtë dëshmohen vetëm në hapësira të banuara nga shqiptarët siç janë Kosova dhe pjesa perëndimore e Maqedonisë**.**

Gjatë kohës së sundimit osman, hashkalinjtë punonin në çifliqe të feudalëve shqiptarë, kryesisht në Rrafshin e Dukagjinit dhe në kohën e vonë osmane e morën për gjuhë të tyre gjuhën shqipe. Disa herë hashkalinjtë konsiderohen edhe për romë *arli* të shqiptarizuar

[89] Po ai, po aty.
[90] K. Kostov, Vъrhu proizhoda na ciganite i tehnija ezik, në Bъlgarski ezik, 2, 1953, f. 345.

Në Kosovë, hashkalinjtë u janë ndajmbathur shqiptarëve aq shumë, sa që jo rrallë e mohojnë edhe prejardhjen e tyre. Edhe në regjistrime të popullsisë, si edhe si azilkërkues në Perëndim, ata prezantohen si shqiptarë. Megjithatë nga shqiptarët mbahen për romë dhe konform kësaj përkatësie edhe trajtohen; shprehja "*shqiptarë të dorës së dytë*", që nganjëherë përdoret nga shqiptarët për hashkalinjtë,[91] sikur tregon se procesi i asimilimit të hashkalinjve mund të ketë përfunduar.

Nga grupet e tjera rome, hashkalinjtë mbahen ende për romë, por me rezervën që i shquan hashkalinjtë si përkrahës të shqiptarëve dhe gjithmonë të deklaruar për shqiptarë.

Për t'u ndarë nga romët, hashkalinjtë në Kosovë, si p.sh. në Ferizaj me rrethinë, në qytetin e Pejës, në Istog e gjetiu kanë themeluar shoqata të tyre, ndërsa në Podujevë madje edhe një organizatë të quajtur "Shpresa Demokratike".

Në dhjetor të vitit 1999 hashkalinjtë e themeluan edhe "Partinë Demokratike të Hashkalinjve".[92]

Nga bartësit vetë të etnonimit, emri i këtij grupi etnik shqiptohet si *hashkali,-të*. Kjo është dëshmi se varianti pa *h*, përkatësisht *ashkali* është një variant serb në përputhje me fonetikën serbe, sipas së cilës bashkëtingullorja *-h-* bie khs *Asan* për Hasan; *amam* për hamam etj. As për këtë grup etnik nuk ka të dhëna përkitazi me kohën e vendosjes në hapësirën gjuhësore të shqipes. Hashkalinjtë vetë (si edhe "egjiptianët") thonë se nuk kanë asgjë të përbashkët me romët dhe se prejardhja e tyre nuk është nga India. Kështu, në kujtesën kolektive të hashkalinjve është ruajtur tradita sipas së cilës këta (bashkë me "egjiptianët") e paskan prejardhjen nga një krahinë e Persisë (Iranit) që qenka quajtur *Hashk*, nga e cila po e heqka prejardhjen edhe emri etnik (hashkali) i tyre, prandaj edhe nuk paskan gjë të përbashkët me romët, për të cilët thuhet pra se janë të ardhur nga India. Nuk di që deri tani në cilindo punim për romët të jetë shfaqur e lere më të jetë dëshmuar se emri hashkali paska ndonjë lidhje me emrin të një krahine të Persisë.

Grupi i hashkalinjve e ka për amtare gjuhën shqipe. Ky grup (si edhe ai i ashtuquajtur i "egjiptianëve") nuk e njeh gjuhën rómani. Hashkalinjtë dhe "egjiptianët" janë shqiptarizuar jo vetëm për nga gjuha, por edhe për nga veshja. Procesi i shqiptarizimit të hashkalinjve ka përfshirë edhe

---

[91] Sipas Nicolaus v. Holtey, Schalomdiakon, Mitglied der Pax Christi Bewegung, Zwei Reisen zur Erkundung der Lage der Ashkali und Roma im Kosovo, Heidelberg, 22.2.2000.

[92] Sipas Rüdiger Benninghaus, Roma Gruppen in Mazedonien und im Kosovo; http://koelner-fluechtlingsrat.de/nachrichten/0700.doc.

emrat personalë, ndërsa thellësinë e shqiptarizimit të përfunduar e tregon edhe rrethana se shumë nga hashkalinj e "egjiptianë" e njohin edhe institucionin e fisit, përkatësisht se shumë nga këta u janë ndajmbathur fiseve shqiptare me të cilat kanë jetuar në një vendbanim dhe ata emra fisesh, si edhe shqiptarët, i mbajnë edhe për mbiemra familjarë.

Mëvetësinë albanofone të hashkalinjve e të "egjiptasve" e vërteton tërthorazi edhe rrethana që nga romët serbishtfolës hashkalinjtë quhen "*šiptari*" "shqiptarë", ndërsa gjuha e hashkalinjve quhet nga ata (serbët) *horahane*, *romharli* ose *hashkali*, përkatësisht *magjupski* - gjuhë që, për romët serbishtfolës është thjesht *šiptarski* "shqip". Grupi i romëve, nga ana tjetër, e paska ruajtur mëvetësinë etnike, përkatësisht gjuhën e vet.

Bashkëjetesën e gjatë hashkalinjve me shqipfolësit, përkatësisht lashtësinë e shqiptarizimit të hashkalinjve e tregon, në rrafshin e jetës shpirtërore, edhe rrethana që në disa përralla shqiptare protagonist është *magjupi*, veprat e të cilit shihen me simpati dhe emri magjup nuk ka aty kurrfarë kuptimi përbuzës.

Asimilimi i romëve, përkatësisht i hashkalinjve (duke i përfshirë këtu edhe të ashtuquajturit "egjiptas") paska përfunduar që nga koha kur këta e kanë harruar, përkatësisht humbur gjuhën e tyre. Dhe "pika e fundit të rrënimit të gjuhës është humbja e saj. Humbja e gjuhës është e barabartë me vdekjen e gjuhës nëse i tërë grupi i folësve të saj ka hequr dorë nga përdorimi i saj i variantit rómani, përkatësisht nëse i nënshtrohet humbjes së gjuhës" - thotë Dieter W. Halwachs.[93]

8. GABELËT

Ashtu sikundër që në pjesët e tjera të Kosovës popullata shqiptare e njeh vetëm termin tradicional *magjup* për të gjitha nëndegët e romëve, edhe në Rrafshin e Dukagjinit ka një nocion të veçantë për romët të cilët për gjuhë amtare nuk e kanë shqipen, përkatësisht për romët që e kanë ruajtur gjuhën e tyre. Distinktiv për këtë degë të romëve është në Rrafshin e Dukagjinit fjala *gabel*, ndërsa gjuhën e tyre e quajnë *gabelçe* e *gabelisht*. Edhe në këtë zonë njihen romët çergarë / çergashë të cilët këtu vinin kryesisht nga Nikshiqi i Malit të Zi. Në Rrafshin e Dukagjinit pothuajse nuk dëgjohen fare emrat rom e hashkali. Hashkalinjtë e quajnë veten këndej thjesht, pa kurrfarë kompleksi, *magjup*.

Emri *gabel* është i përhapur kryesisht në gegërishten e Veriut. Ky emër nuk del tek autorët e vjetër shqiptarë (të shekujve 16 e 17). Te këta

[93] Halwachs, Dieter: Gurbet, Geschichte und Sprache, http:// romani. Kfunigraz.ac.at/rombase/cd/data/ethn./groupsat/data/at-gurbet de.pdf.

gjithkund del vetëm emri *magjyp* (sh. më poshtë) për "rom" dhe të mëvonëshmit e ashtuquajtur "egjiptas".

Duke u nisur nga kuptimi "gëzofçi" që në fjalorin e vet e jep Rossi si edhe mbi bazën e rrethanës se njëra ndër profesionet e romëve është edhe përpunimi i lëkurave dhe tregtia me kuaj (khs. grupin *xhambaz* të romëve) Gustav Meyer mendonte se emri *gabel* për romët rrjedh nga venecianishtja, përkatësisht nga e folmja e Milanos *gabela*, fjalë që në të folmen e Friulit gjallon si *gabele* dhe e ka kuptimin "pelë coftele". Shpjegimi i mësipërm kundërshtohet me të drejtë nga C. Tagliavini - thotë mentori i gjuhësisë shqiptare Prof. E. Çabej[94] - i cili e lejon mundësinë që ky emër të sqarohet ndoshta përmes fjalës veneciane *gabella* me kuptimin "tatim", duke lejuar me këtë rast një zhvillim kuptimi të kësaj fjale si në spanjollishten *gavilla* "krah karthenjsh, duaj, fundërri, skotë e keqe". Një shpjegim tjetër i mundshëm, gjithnjë sipas E. Çabej, do të ishte shpjegimi i këtij emri me mjete leksikore të shqipes. Në të fomen shqipe të Borgo Erizzo-s, përkatësisht të Arbanasit në periferi të Zarës, Tagliavini e kishte shënuar fjalën *gabel* e cila në atë të folme do të thotë "ai që zë zogj" "Ky kuptim[95] të shpie te *gaboj* që do të thotë edhe "gënjej, mashtroj", *gabë* "rrenë". Sufiksi *-el* në fjalë si *buzel*, *coftel* ka një funksion përçmimi, prandaj *gabel* mund të hynte në këtë grup fjalësh. Edhe përhapja dialektore e këtij formanti kryesisht në geg.(ërishten) ver(iore),[96] pajton me sferën e përdorimit të kësaj fjale". Sikur fjala gabel ta kishte me të vërtetë prejardhjen nga venecianishtja *gabela* / *gabele* "pelë coftele", atëherë do të rezultonte se gabel është emër i dhënë nga shqiptarët grupit të romëve që gjetiu quhet *xhambaz*, përkatësisht emri i romëve të grupit vllah. Në regjionin e Vojvodinës një nëngrup romësh që merrej kryesisht me tregtinë e kuajve quhet nga të tjerët në gjuhën rómani *trgovco* "tregtar". Kjo rrethanë do të shkonte në të mirë si të përkatësisë së grupit vllah ashtu edhe të mendimit se emri gabel mund të ketë diç të përbashkët me fjalën veneciane gabela/gabele "pelë coftele".

Është përgjithësisht e njohur se nocioni *hashkali* është i ri në relacion me emrin kolektiv *magjup*, i cili përdoret nga të gjithë shqiptarët, po edhe nga vetë hashkalinjtë, përkatësisht magjupët. Lashtësinë e variantit *magjup* në vend të hashkali do ta tregonte edhe etimologjia (nëse është e qëlluar) e emrit *magjup*.

Është shfaqur mendimi se magjupët po u dëshmuakan të pranishëm në Kosovën e sotme qysh në shek. XIV. Bazë e një mendimi të tillë ka qenë

[94] Sh. Studime etimologjike në fushë të shqipes, IV, Tiranë 1966, f. 234.
[95] Sh. Xhuvani-Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, f. 34.
[96] Po ata, po aty.

së pari interpretimi, përkatësisht shpjegimi i gabueshëm i fjalës *magjup'nica* që dëshmohet në krisobulën e njohur me emrin Krisobula e Banjskës e viteve 1313-1318.[97] Këtu fjala, termi *magjup'nica* nuk e ka kurrsesi kuptimin e etnisë. Në këtë dokument kjo fjalë përdoret në rasën vendore: "*u magjup'nici stojanije*" dhe e ka kuptimin e vendit ku mbahen rezervat e drithit, të hambarit, të magjes që në vija më të largëta mund të nënkuptohet edhe furra. Kategoria sociale e përmendur në këtë kontekst kishte të bënte me (serb.) "*žitotreblenije*", përkatësisht me marrjen me çështje të lidhura me deponimin dhe shpërndarjen e drithërave. Fjala **magjup'nica* përmendet në kontekstin e detyrimeve që i kishin disa nga kategoritë sociale, përkatësisht detyrat ndaj kishës që i kishin *meropsët*, *gjerekarët* "gjahtarët me fajkua"dhe të ashtuquajturit *maistor*-ët e shtetit mesjetar të Rashës. Sikundër dihet, meropsët ishin praktikisht bujkrobër, gjerekarët ishin gjuetarë me fajkua, me petrit, ndërsa maistorët, mjeshtër, përkatësisht muratorë. Magjupët ishin mbase të ngarkuar të gatuanin bukë për manastirin. Ndryshe qëndron puna me dëshminë e vitit 1330 në Krisobulat e Deçanit. Këtu përmendet shprehimisht kategoria sociale *magjup'ci*,[98] për të cilët nuk thuhet gjë as përkitazi me përkatësinë etnike e as me profesionin e tyre, por që në bazë të etimologjisë së fjalës mbase s'ka dyshim se kemi të bëjmë me një nomen profesionis, përkatësisht me një kategori sociale të bukëpjekësve, të lidhur, skllevër manastiresh. Rrethana që *magjup'ci* përmenden si banorë të Plavës së sotme në Mal të Zi, pra në një vis malor dhe që nga 8 *magjup'ci*-t që përmenden atje, asnjëri nuk kishte emër personal josllav, tregon se, vështruar edhe në aspektin jashtëgjuhësor, emri magjup nuk është këtu në funksion të emrit etnik, porse - siç do të shihet më poshtë - një nomen profesionis. Kjo aq më parë pse ky dokument është më i vjetër se sa koha për kur pandehet ardhja e magjupëve në Kosovën e sotme. Unë kujtoj se këtu mund të inkuadrohet edhe emri i katundit të vogël, sot i panjohur, *Mađupić* (lexo Maxhupiq) i dëshmuar më 1455 dhe në dy regjistrime të mëvonëshme të popullsisë: 1477 e 1487 në regjionin e Zubinpotokut. Ky emër i katundit me 2 shtëpi e një të vejë mund të lexohet edhe Međupić (Mexhupiq).[99] Duke e analizuar dhe shpjeguar pikërisht emrin *magjup'ci* që përmendet në Krisobulat e Deçanit, Franz Miklosich-i kishte shfaqur mendimin se emri *magjup-* ka "mbase të bëjë me njerëz të cilët manastirit i jepnin bukë".[100] Në një punim

[97] sh. Lj. Kovačević, Svetostefanska Hrisovulja, SPOMENIK SKA IV, Beograd 1890, f. 6.
[98] sh. sh. Miloš S. Milojević, Dečanske hrisovulja, Glasnik Srpskog Učenog Društva 12, Beograd 1880, f. 60.
[99] Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455 godine, Grup autorësh, Sarajevo, 1972, f. 17.
[100] Sipas Rječnik hrvatskoga ili sprskoga jezika JAZU, vëll. IV, f. 359.

tjetër të tijin[101] ky autor na mëson, nga ana tjetër, se edhe shkrimtarë të vjetër shqiptarë emrin *magjup* e lidhnin me emrin e shtetit të Egjiptit. Kështu, p.sh. P. Bogdani 1, 118 dhe 1. 26 shkruante: pęr tu leuduem magiụpevet "per minacciare agli egizii"; me i nzierre δeut se magiụpevet "ut educerem eos de terra Aegypti", ndërsa Fr. Bardhi nocionet magijp, magiụp, madjip i sqaronte si "arabs; aegyptius" (Aegyptus është gabim shtypi); magjup që banon në qytet". Miklosich-i vetë i sillte nga fjalorë të ndryshëm edhe sqarimet Mscr. marǵupę disonesto, carnale. Shkodër.; margụpi-a disonesta. Cam. 1. 65. magiupíi-ia disonestà. Rossi. maǵụp-i. Shkodër. "përdhosës i çunave"; maǵụpi-a. Shkodër.; "dashuri trupore me çuna" marǵụpój. Shkodër. Autori ynë (Miklosich-i) nuk e pranonte për të bindshëm sqarimin e J. G. von Hahn i cili kujtonte se emri *magjup* mund të lidhej me geq. μάργος që përmes një trajte *μαργοπός do të ketë dalë nga μαστροπός. Vetë Miklosich-i mendon se fjala magjup qenka një huazim sllav i shqipes nga madjupac ndërsa, sipas Rossi-t, vetë fjala maǵụp paska lidhje birësie me të latinishtes mancipium "skllav".102 Max Vasmer vërente më tej se fjala *magjup* ka hyrë në serbishten mesjetare nga greqishtja e mesme μάγκυφ (mágup) e cila në bizantinishten ka hyrë nga lat. *manceps*. Fjala greke μάγκυφ μάγκυψ, gjithnjë sipas Vasmer-it, e ka kuptimin "skllav bukëpjekës"; "bukëpjekës i manastirit".[103]

Së këndejmi mund të nxirret përfundimi se emrat e dëshmuar në mesjetën e vonë në shkrimet kishtare serbe nuk përcaktojnë ndonjë etni, por një kategori sociale të bukëpjekësve të kishave e të manastireve. Prandaj emri shqiptar *magjup* për jevgët ose është huazim grek përmes serbishtes ose vetëm rastësisht, vetëm fonematikisht është i ngjashëm me greqizmën *mag-jup-* të serbishtes, e cila pra nuk ka të bëjë me romët, por me bukëpjekësit skllavë. As mendmi i panuar nga historiani i merituar kosovar Muhamet Tërnava,[104] sipas të cilit magjupët po u dëshmuakan jo vetëm në krisobulat e Deçanit (khs. ç'u tha më lart), porse edhe në krisobulën e vitit 1348 për manastirin e shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizenit, nuk mund të merret për i qëlluar. Duke e parë termin *magjup'ci* "bujkëpjekës manastiri" për kuptimisht të barasvlerëshëm me termin

[101] Dr. Franz Miklosich Die slavischen Elemente im Albanischen, Wien, 1870, f. 25 dhe Fremdwörter in den slavischen Sprachen, f. 35.

[102] Khs.: "*mancipium* Sclave; μάγκυψ pistor. [...] maǵụp-i: magiụp-i zingaro. R. magụp egizio. B. 1. 118. madjub Zigeuner. Klem. Wind. 85. maǵụp. Knabenschänder. H. khs. Die Fremdwörter in den slavischen Sprachen 107. Die slavischen Elemente in Albanischen. 25. Man vergl. auch span. mancebo junger Mensch, Liebhaber und fz. bougre." te Fr. Mikl. Romanische Elemente im Albanischen, Wien, 1871, Wien, f. 38.

[103] Sh. Die griechischen Lehnwörter im Serbokroatischen, Berlin, 1944, f. 92.

[104] Khs. Popullsia e Kosovës në sekujt 14 – 16, Prishtinë 1995, f. 399–400.

tjetër kishëtar serb *cengarije* M. Tërnava lë të kuptohet që ky kujton se edhe nën këtë term (cengarije) po u dashka të shihet emërtimi (serb. cigan?) për magjupët. Përkundër rrethanës se për kuptimin që mund ta ketë pasur termi *cengarije* janë shfaqur mendime nga më të ndryshmet: se kjo fjalë e kishte kuptimin "magjup; rom" ose "bukëpjekës qyteti" apo edhe "këpucëtar" mua më duket se më i pranueshmi mund të jetë mendimi i historianit të shquar serb St. Novaković i cili tek fjala *crьngarь* e gjente vlerën kuptimore *këpucëtar*, mendim ky i tumirur edhe nga K. Jireček.[105] E para pse nuk është dëshmuar kurrë ndonjëherë që në serbishten të ketë pasur ndonjë distinktiv tjetër për magjupët, romët - përveç atij *cigan* dhe pse nuk është dëshmuar që në greqishten *τζαγκάρης*, prej nga pas gjithë gjasash rrjedh fjala serbe *crьngarь*, nuk do ta kishte kuptimin "këpucëtar". Përveç kësaj, konteksti në të cilin në krisobulën e vitit 1348 përmendet termi *crьngarь* flet kundër paravendimit se ky emër do të mund ta kishte kuptimin e distinktivit për përkatësinë etnike magjupe, për bartësit e atij atributi. Në atë kontekst të krisobulës flitet në të vëretetë shprehimisht për zejtarë të qytetit të Prizenit, ndër të cilët ishte pikërisht dhëndri i (gjykuar mbi bazën e mbiemrit të tij) shqiptarit Kosta *Gonьš'in*-it ai që ishte njëri nga *crьngarь*-ët, përkatësisht "këpucëtarët" e qytetit të Prizrenit. Natyrisht që ky nuk ishte i vetmi zejtar shqiptar në këtë qytet. Në Prizren vepronte edhe poçari *Lěš'ь grnčar*. Edhe emri *Magjer'ci* i katunit të arbanasëve i rrethinave të Prizrenit që i heq rrënjët nga greq. e mesme μαγειρείο, ‚kuzhinë"[106] do ta tregonte marrjen e shqiptarëve me zeje të ndryshme të kohës. I zgjeruar me prapashtesën serbe *-ci* ky term bizantin i hyrë në terminologjinë kishtare serbe do ta ketë pasur kuptimin, ‚kuzhinier, gjellbërës".[107]

Rrethana që magjupët, përkatësisht romët nuk dëshmohen shprehimisht as në defterët osmanë të regjistrimit të kryefamiljarëve të shekullit 15 (nga 1455 deri 1485) sikur i hap udhë paravendimit se romët mund të kenë ardhur në Kosovën e sotme pas shekullit 15, sado që as për këtë kohë nuk mund të gjenden dëshmi të bollshme shkrimore.

---

[105] sh. *cegarь - cьngarь -τζαγκάρης τζάγγα mestve,* në Archiv für slawische Philologie 33 (1911), f. 383 -388); më hollësisht për këtë khs. Konstantin Jireček, Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien, Studium zur Kulturgeschichte des 13. Jahrhunderts, 2 (1912), f. 73.

[106] Max Vasmer, Die griechischen Lehnwörter im Serbokroatischen, Berlin 1944, f. 92.

[107] Para se gjithash nëse nocioni *magjup'ci* do të ketë dalur nga greq. e mesme μάγερος, ‚tregtar perimesh'"; kjo fjalë e bizantinishtes ndeshet në shqipen në trajtën *magjiri,-a*, ‚kopsshtari,-a " (khs. Petar Skok, De l'hortikulture byzantnëe en pays yougoslaves, Extrait nga Εἰς μνημήν Σ. ΛάμπΑου, Athen 1934, f. 215.

E vetmja e dhënë në të cilën shprehimisht përmendet një *cigan* rrjedh nga viti 1591 kur ndër banorë të mëhallës "Xhamia e Vjetër" të qytetit të Prizrenit dëshmohet banori i quajtur *Oruxh*, ndërsa në vend të mbiemrit të mirëfilltë, emri i tij është përcjellë me epitetin të cilin redaktuesi i Defterit e ka përkthyer për *cigan* "rom". Se kjo e dhënë mund t'i qëndrojë sprovës së vërtetësisë e dëshmon mbase edhe rrethana që në vitin 1910 në qytetin e Prizrenit paska pasur, përkrah kinse 3.200 deri 3.400 familje myslimane me 23.800 frymë, 870 familje serbe me rreth 4.350 frymë, 725 shtëpi cincarësh (= vllehsh) grekë me 725 frymë, 190 shtëpi katolike me 950 frymë, edhe 92 shtëpi magjupësh me 460 frymë.[108]

E njëjta gjë vlen edhe për banorin tjetër i cili quhej Hysein, *cigan* me sqarimin e pozitës sociale "i varfër".[109] E pasigurt mbetet mundësia që me një magjup të kemi të bëjmë në rastin e një banori të mëhallës Bogdan pop Stojkoviq e Trepçës të quajtur Daba, pse ai në defter është cilësuar për *sihah* ("i zi").[110] Një "e dhënë" e pasigurt mbi të cilën do të mund të mbështeteshim për përcaktimin kohor të pranisë së magjupëve në Kosovë do të ishte dëshmimi i profesionit të kovaçit. Kjo do të ishte mbështetje relevante nëse mund t'i besohet bindjes së përhapur gjithandej se me zejen e farkëtarisë, përkatësisht të kovaçit, merreshin e merren kryesisht magjupët. E pandashme nga kjo rrethanë është prania mbase individuale e magjupëve nëpër vendbanime rurale. Nëpër jo pak katunde të Kosovës së sotme janë ruajtur mikrotoponime, pjesa e dytë (determinuese) e të cilave është: (*i, e*) *magjupit* dhe janë emra që shënojnë ara, mullinj etj. të magjupëve. Këto mikrotoponime nuk u morën në trajtim sepse, siç shihet nga më lart, nuk shenjojnë ndonjë mikroregjion të banuar ekskluzivisht nga këta, porse emra vendesh që lidhen me individë, rrogtarë e farkëtarë (kovaçë) të përkatësisë etnike rome. Mungesa e kolektiviteteve të magjupëve (romëve: sot të quajtur hashkalinj e "egjiptas") nëpër katunde sqarohet me rrethanën që shumica syresh e preferonin jetesën nëpër qendra urbane, qytete. Një shembull ilustrativ për këtë konstatim e gjejmë tek shënimi sipas të cilit në shek. XIX familje magjupësh kishte pasur madje edhe në katundet Mlikë, Krushevë,

[108] Sipas Projekat Rastko Gračanica - Peć: Istorija: Stara Srbija, geografska i etnografska slika (1912.)

[109] Sh. S. Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shekujve 15-16, Tiranë 1984, f. 510. Nga M. Tërnava, Popullsia e Kosovës në shekujt 14-16, Prishtinë 1995, f. 400 mësohet se në origjinalin turk të këtij Defteri (Tapu ve umum müdürlügünun arşivi defter nr. 55, 999 hixhri, f. 13) emrat e këtyre dy banorëve lexoen si : Uruq Çingjen e Hysejn Çingjen.

[110] Khs. Iljaz Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut tlë Vushtrrisë të vitit 1566/74, në Vjetar 31-32 i Arkivit të Kosovës, Prishtinë 2004, f. 50.

Zlipotok e në ndonjë tjetër të krahinës së Gorës të cilat (familje), si pothuaj gjithkah nëpër Kosovë, gjatë gjysmës së parë të shek. XX u shpërngulën në qytetin e Prizrenit. Familjet e kësaj prejardhjeje po e ditkan edhe sot nga cilat katunde janë zhdjergur në Prizren.[111] Shënimet më të vjetra i kemi nga raporte të vitit 1853 Nga një raport i këtij viti mësohet se në qytetin e Prizrenit paska pasur atëherë 603 shtëpi magjupësh me 3.020 frymë. Po në këtë vit Urban Bogdanoviq njoftonte se në qytetin e Gjakovës paska pasur 300 shtëpi/familje magjupësh; në qytetin e Pejës kishte po atë vit 135 shtëpi të banuara nga magjupë, gabelë, ndërsa në qytetin e Janjevës kishte 10 shtëpi/familje magjupësh. [112]

Disa hashkalinjë e quajnë veten "egjiptian/ë". Liderët e tyre sqarojnë se këta e paskan prejardhjen nga Egjipti i lashtë dhe se në Ballkan i paska sjellë Leka i Madh, përkatësisht se "egjiptianët" tanë paskan ardhur në Ballkan qysh në shekullin V para erës sonë. Kjo "histori" paska mundësi të dëshmohet edhe me të dhëna arkeologjike dhe nga burime natyre tjetër. "Egjiptianët" synojnë që këtij shtegu të distancohen nga romët dhe në këtë mënyrë të njihen si grup etnik i mëvetshëm. Mirëpo arkeologjia e etnologjia klasike nuk e dëshmon deri tani këtë hipotezë të "egjiptianëve".

Nocionet "hashkali" ose "egjiptas" për këtë grup etnik ndeshen vetëm në hapësirën e banuar nga shqiptarët, përkatësisht në Kosovë e në Maqedoni. Në Shqipëri, p.sh. nuk ka as hashkali e as "egjiptas", por vetëm evgjitë.[113.]

9. INTEGRIMI I GUPEVE ROME NË SHOQËRINË KOSOVARE

Përderisa nuk dëshmohet e përkundërta, mund të paravendoset se shqiptarizimi i hashkalinjve ka ndodhur si rezultat i bashkëjetesës dhe jo i presionit që do të ushtrohej në mënyrë të organizuar, institucionale që këta të asimilohen. Asimilimi gjuhësor i hashkalinjve ka ndodhur vetëm si rezultat i jetesës së hashkalinjve në ambiente ku shqiptarët ishin shumicë absolute e popullatës e jo p.sh. përmes stimulimit të martesave të përziera me qëllim asimilimi e aq më pak si pasojë e

[111] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.) dhe Sadik Idrizi Aljabak: Gora – Jedan Pogled Unazad (dorëshkrim).

[112] Sipas Peter Bartl, Geistliche Visitationsberichte als Quellen zur albanischen Volks- und Kirchengeschichte, version i përpunuar i punimit të botuar më parë në anglisht në botimin e përgatitur për shtyp nga Arshi Pipa e Sami Repishti, Studies on Kosova. New York 1984, (Kosova and Macedonia as Reflected in Ecclesiastical Reports, f. 23-39.

[113] Nicolaus v. Holtey, Schalomdiakon, Mitglied der Pax Christi Bewegung, Zwei Reisen zur Erkundung der Lage der Ashkali und Roma im Kosovo, Heidelberg, 22. 2. 2000.

ushtrimit të presionit të pushtetit të cilin shqiptarët nuk e patën as për vete deri pas vitit 1912 në Shqipëri, përkatësisht deri në vitin 2000 në Kosovë.

Në Europën Perëndimore, përkundrazi, duke filluar që nga shek. XVI legjislaturat shtetërore të vendeve të ndryshme nxorrën ligje antirome (gjerm. "Zigeuner"-feindliche Gesetze) që e sanksiononin përndjekjen e romëve. Kështu, urdhëresat policore dhe të qeverive të landeve për Saksoninë, Thüringen-in e Meißen -in të v. 1589 parashihnin p.sh., ndër të tjera, që romëve mund t'u merret pasuria dhe se ata, bashkë me gratë e me fëmijët, mund të dëboheshin nga vendi. Deri në shek. XVIII romët ishin shpallur në shumë lande të Gjermanisë për të jashtë ligjit. Vetëm në Gjermaninë e sotme të viteve 1500 e 1800 u nxorën 148 edikte që kishin të bënin me ciganët, përkatësisht sintit e romët,[114] ndërsa midis viteve 1900 e 1933 po në Gjermani u nxorën rreth 150 urdhëresa e rregullore kundër romëve.[115]

Pamëshirshëm të përndjekur e të masakruar ishin romët edhe në Spanjë - vend ky në të cilin duke filluar nga viti 1499 romëve u prehej gjuha, u nxirreshin sytë dhe ku banorët cyteshin për gjueti mbi romët. Dhe kjo gjueti paralajmërohej madje edhe me të kumbuar të këmbanave të kishave.[116]

Jetën në skllavëri të romëve sikur e dëshmon edhe shprehja rumune *rob* "skllav" e cila edhe sot e gjithë ditën për *gaxhe*-t (rumunët) e ka po atë kuptim si edhe fjala "cigan"[117] Në periudhën e iluminizmit europian u kodifikuan ligje me qëllim të asimilimit të romëve. Kështu me ligj u ndalua gjuha rome, u diktuan lidhje martesore me "joromët", lejohej marrja e fëmijëve nga prindërit romë, për t'ua dhënë në përkujdesje "joromëve" etj. Ligje të këtilla kundër romëve qenkan aprovuar asokohe jo vetëm në lande e në principata të Gjermanisë, porse edhe në Francë, në Skandinavi, në Hungari e madje edhe në shtete të Ballkanit.

Kështu ndodhi në shek. XVIII në Austri. Perandori Karli VI, i ati i Maria Therezës, i shpalli më 1748 romët për të jashtë ligjit dhe e lëshoi një urdhëresë sipas së cilës duhej që të gjithë romët burra të vriten, ndërsa grave dhe fëmijëve romë të moshës nën 18 vjeçe t'u prehet nga një vesh.

Dhe, kjo "*gjueti*" mbi romët ishte legalizuar. Duke qenë se romët ishin bërë tanimë të panevojshëm për ushtrinë perandorake, ata iu shtruan

[114] Sipas Katja Sturm - Schnabl Franz Miklosich - ein "Europäer" im 19. Jahrhundert.
[115] Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.
[116] Katja Sturm / Schnabl, po aty.
[117] Geschichte und Sprache der Roma.

përsëri dëbimit. Kështu ndodhi p.sh. në Burgenlad në kohën e sundimtarit Esterhazy kur u urdhërua që "Romëve nuk u lejohet që as një orë të shihen afër katundit ose sheshit dhe në rast të mosrespektimit të këtij urdhri vetë gjykatësit lokalë do të merren në përgjegjësi dhe shpesh u dënuan me gjobë prej 12 guldenësh".[118]

Trysnia mbi romët drejt asimilimit të tyre u vazhdua nga Maria Theresia dhe i biri Jozefi II. Në kohën e këtyre u ndryshua politika ndaj romëve. Tani këta nuk dëboheshin e përndiqeshin më, porse bëheshin përpjekje që asimilimi i tyre të arrihej me ndërmarrjen e masave të ndryshme në mënyrë që këta të bëheshin banorë ndenjëtarë. Në këtë kuadër shërbimi ushtarak u bë i obligueshëm edhe për romët; u ndalua që romi të guxonte të kishte kal (kështu synohej shuarja e mobilitetit dhe zejet e lidhura me mënyrën nomade të jetesës); martesat e përziera ishin të obligueshme; u ndalua përdorimi i gjuhës rome (ai që kapej duke folur në gjuhën rome dënohej me 24 të rëna shkopi) u ndalua veshja tipike rome; u aplikua mësimi dhe ushtrimi detyrimisht i një zeje; u shfuqizua e drejta zakonore rome (Kris) dhe në vend të saj urdhërohej aplikimi i jurisprudencës lokale (Gjyqtarët e katundeve); regjistrimi i romëve në vendbanimet ekzistuese si edhe numërimi i shtëpive të tyre.[119]

10. JETA SOCIALE

Të gjithë romët i lidh rrethana e përbashkët që këta jetojnë pa formacion të organizuar të shtetit. Ajo që si një unazë i lidh të gjitha fiset dhe nëngrupet e romëve është nocioni *Romanipe*. Struktura sociale e romëve e ka bazën mbi sistemin e farefisërisë, të gjakut në të cilin (sistem) familja e madhe e zë vendin qendror. Bazën e bashkësisë e përbën *satra* "çadër romësh" e cila (satra) përbëhet nga bashkësia prej tre brezash. Më shumë satra përbëjnë një *niamo* "bark; pjesë e një fisi", ndërsa disa barqe e përbëjnë të ashtuquajturin *Vica*.[120]

Edhe pas largimit nga India romët (sintit e kalet etj.) ruajtën elemente, pjesë të sistemit të kasteve. Ky sistem e ndan shoqërinë në numër të madh grupesh sipas prejardhjes, grupe që dallohen njëri nga tjetri por që lidhen ndërmjet veti përmes tri karakteristikave: 1. përmes prikës me rastin e lidhjes së krushqisë dhe të martesës, 2. me ndarjen e punës me ç'rast secili grup e ushtron zejen tradicionale të tij, zeje kjo nga e cila anëtarë të grupit mund të largohen vetëm brenda kufijve, përkatësisht në

[118] http://www.kbk.at/roma/Container/Vortrag-2000-M%E4rz.htm.
[119] Po aty.
[120] Dieter W. Halwachs: Romani - Versuch eines einführenden Überblicks http://www-gewi.kfunigraz.ac.at/romani/ling_all/ling_all.de.html.

kuadër të përmasës së tolerueshme dhe, së fundi, 3. sipas kierarkisë brenda së cilës grupet janë të renditura për të larta apo për të ulëta.[121]

Romët jetonin në gjini, bashkësi. Gjinitë ose fiset drejtoheshin nga kryepari, i cili zgjidhej dhe personifikonte në vete gjyqtarin, predikuesin e fesë dhe ishte gjithherë përfaqësues i fisit të vet përpara organeve të pushtetit. Detyra të tjera të kryeparit ishin: caktimi i drejtimit të shtegtimit dhe caktimi i lokacioneve në të cilat do të vendosej secila familje e madhe e fisit në krye të të cilit qëndronte ai. Përkrah kryeparit, në hierarkinë sociale të romëve një pozitë me peshë e zinte edhe "plaka e fisit" e cila, përveç kompetencave të tjera, për detyrë primare e kishte përkujdesjen për ruajtjen e dokeve e të zakoneve tradicionale të gjinisë. Vendimet dhe këshillat e saj duhej patjetër të përmbusheshin. Përbrenda jetës familjare tek romët, tradhtia e bashkëshortit dënohet me dënimin më të rëndë - me leçitje nga gjinia. Po ashtu ndodh edhe me nusen. Nëse nusja nuk është virgjëreshë, ajo i kthehet familjes së t'et dhe i ati duhet t'ia kompensojë familjes së krushkut të gjitha shpenzimet. Nusja i kthehet gjinisë së vet edhe në rastet kur dëshmohet se ajo është shterpë. Tek disa fise romësh ekziston ende zakoni i "rrëmbimit të nuses". Tek romët nomadë, përkatësisht tek romët *çergari* e *gurbet* hakmarrja është fenomen i shpeshtë. Një veçori kardinale e romëve endacakë është: "Ata janë të lindur të lirë në natyrë, prandaj duan të vdesin në natyrë". Kur vdes romi, i cili në pronësi e kishte edhe nje qerre kuajsh, ajo duhet domosdo t'i shitet një jojevgu ose të kallet për dru zjarri.[122]

Doket e zakonet e këtij grupi etnik, si p.sh. ato të lidhura me ciklin e jetës si doket e lidhura ma lindjen, dasmën dhe vdekjen, kanë karakteristika të veçanta. Pa pretendime se po jepet ndonjë pasqyrë e plotë e aq më pak ndonjë analizë e hollësishme e tyre, duhet konstatuar se doket e zakonet i përballojnë kohës më gjatë dhe edhe në rastet kur ato mund të ndryshojnë, ndryshimi ndodh në të shumtën në formën por jo edhe në përmbajtjen dhe në mesazhin e tyre, i cili vazhdohet nga brezi në brez.

Te ritet e lindjes vërehet shumë shpesh përdorimi i numrit 3 dhe përdorimi i theksuar i drithit; te ritet e dasmës veçohet riti i luftimit të djallit në të mirë të dëlirësisë kozmike si dhe ritet për sjelljen e pjellshmërisë e të harmonisë familjare; te ritet e vdekjes përdoret numri shtatë dhe uji si element i pastrimit.

Në gjithë Gadishullin e Ballkanit kjo etni e preferon martesën endogame, përkatësisht martesën vetëm përbrenda etnisë. Shumë rrallë mund të ndodhë që pjesëtarë të kësaj etnie ta përziejnë gjakun me të tjerë. Të

[121] Zigeuner in Spanien: http://www.villa.spanien-immobilien-costa-blanca.com/index.php?p=42.
[122] Der Grosse Brockhaus, Zwanzigster Band, Leipzig, 1935.

rrallët që veprojnë në kundërshtim me këtë rregull etiketohen dhe përbuzen nga romët për asocialë. Përmbajtja e këtij vendimi i ka ndihmuar mbase ruajtjes së mëvetësisë së këtij grupi etnik deri në ditë tonat. Doket e zakonet që kanë të bëjnë me ciklin e vitit janë të lidhura, edhe tek romët, me ditë që i kremtojnë njerëzit e pothuaj gjithë botës në variacione të ndryshme, si p.sh. Dita e shën Gjergjit (më 6 maj ose "Fillimi i verës") Dita e shën Mitrit ose Shmitri (8 nëntor ose "Fillimi i dimrit"); si edhe festat që lidhen me kalendarin e krishterimit dhe me atë të fesë islame. Rrethana që pjesëtarët e kësaj etnie krahas kremteve të krishtera, që i kremtojnë edhe popujt shumicë, i kremtojnë kremtet e lidhura me fenë myslimane tregon se pjesëtarët e kësaj etnie janë islamizuar pas depërtimit të turqve osmanë në regjionin e Ballkant.[123]

11. DOKE E ZAKONE:

Doket e zakonet e tyre romët i shprehin në gjuhën e tyre me fjalën *puranimata.* Kjo është në të vërtetë fjala rómani / romanes *purano,* me kuptimin "(i, e) vjetër". Bashkë me ato religjioze, ritet e natyrës sociale të romëve ngërthejnë periudhën e jetës nga lindja deri në vdekje. Kryet e vendit ndër ritet sociale e zënë ritet e lidhura me lindjen, martesën, vdekjen e me varrimin. Rëndësi të madhe ka edhe *pativ-i* - një festë që mbahet me rastin e ndodhive fatlume përbrenda familjes ose për nder të ndonjë mysafiri. Ndër rite religjioze bie p.sh. ndezja e qirinjve për Zotin në shenj falënderimi, falja e parave kishës e edhe njerëzve të rënë ngushtë (Në Indi, atdheun e kryehershëm të romëve, vlente parimi: "Unë po mundkam të fal, e pra qenkam gjallë!"; një sentencë e romëve thotë: "Ai që nuk është në gjendje të fitojë sa duhet, e që për Zotin nuk mund të blejë tamian, nuk është i denjë të jetojë").[124] Në dritën e formës së organizimit shoqëror, dokeve e zakoneve, religjionit etj. Djurić përfundon se "pa mëdyshje mund të përfundohet se romët e kishin vetëdijen e identitetit etnik e kulturor që nga koha kur këta jetonin në Indinë Veriperëndimore.[125]

12. RELIGJIONI

"Që nga koha kur romët u shtrënguan të largoheshin nga India, filloi edhe thërrmimi i parafytyrimeve të tyre të religjionit dhe u bënë kështu vend besimeve të popujve nën sundimin e të cilëve ranë për kohë të

[123] Khs. Wir über uns: www. Balkanaegypter.de/einfuehrung.html ; Geschichte.
[124] Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.
[125] Po ai, po aty.

shkurtër apo më të gjatë. Së këndejmi, varësisht nga territoret ku u vendosën, ka romë si të besimit mysliman ashtu edhe të atij të krishterë. Ndërkaq, tek romët ndeshen megjithatë edhe gjurmë e elemente të periudhave të ndryshme të jetës së tyre religjioze në Indi.[126]

Shumica e romëve në Kosovë e në Maqedoni janë sot të fesë myslimane, ndërsa romë të grupeve të ndryshme janë besimtarë orthodoksë (të orthodoksisë serbe ose pjesëtarë të kishës orthodokse maqedone, përkatësisht bullgare) dhe një numër fare i vogël të besimit katolik të ritit roman. Kohëve të fundit, disa romë janë misionuar nga misionarë protestantë të cilët kanë gjetur ithtarë ndër romë.

Për romët, këto ndryshime në besime e konfesione nuk kanë pothuajse kurrfarë rëndësie. Religjioziteti për romët është aq i parëndësishëm sa që këta nuk e kanë kushedi sa vështirë që eventualisht edhe ta ndërrojnë përkatësinë religjioze të tyre

Indiferencën e romëve karshi religjioneve që i kishin marrë e përshkruan udhëpërshkruesi turk i shek. XVII Evlia Çelebi kështu: "*The Rumelian Gypsies celebrated Easter with the Christians, the Festival of Sacrifice with the Muslims, and Passover with the Jews. They did not accept any one religion,. ..*".[127]

Romët e Kosovës (hashkalinjtë e "egjytianët") janë në të shumtën e tyre myslimanë si edhe bashkëkombasit e tyre në Shqipëri, Maqedoni, Bosne, Bullgari e pjesërisht edhe në Serbi e në Greqi. Shumë shpesh romët janë pjesëtarë të sekteve dervishe si p.sh. të sektit *sufi* i cili, për ndryshim nga orthodoksia, ofron në xhami një qasje mistike me Zotin përmes "Shtegut të Zemrës" dhe së këndejmi kanë pak kontakt me xhaminë.[128] Më të rëndësishme se religjionet e grupeve etnike, besimin e të cilave e kanë marrë, janë për romët besimi dhe praktika specifike e besimit të tyre i cili karakterizohet nga elemente të magjisë. Veçori e religjiozitetit të romëve është nderimi i shenjtorëve, sidomos i Shën Gjergjit - festën e të cilit më 6 maj e kremtojnë si romët myslimanë ashtu edhe ata të krishterë - dhe është kremtja e përvjetshme e erdelezit (sipas turq. Hýdrellez) ose Đurđev Dan (Dita e Shën Gjergjit). Elemente të tjera të besimit të romëve janë pelegrinazhet (të lidhura me nderimin e shenjtorëve), besimi në fantazma, besimi në aftësitë magjike të personave konkretë dhe përpjekjet që përmes veprimeve magjike (p.sh. edhe duke

[126] Po ai, po aty.

[127] Sipas Rüdiger Benninghaus: Roma Gruppen in Mazedonien und im Kosovo; http://koelner-fluechtlingsrat.de/nachrichten/0700.doc 2. 2. 2000.

[128] Sipas Nicolaus v. Holtey, Schalomdiakon, Mitglied der Pax Christi Bewegung, Zwei Reisen zur Erkundung der Lage der Ashkali und Roma im Kosovo, Heidelberg

flijuar dhe duke kremtuar kremte të flijimit) me qëllim që t'i detyrojnë ato fantazma që këtyre t'u sjellin fat, mirëqenie dhe jetë të suksesshme.

Martesa e vdekja përcillen nga rite të cilat janë të ndryshme nga ato të shqiptarëve.[129] Ndryshe nga shqiptarët, hashkalinjtë e kremtojnë Ditën e Shën Gjergjit sipas mënyrës si e kremtojnë edhe romët.[130]

Bazë e religjionit të romëve është magjia racionale. Fjala "*o Del*" për "zot" është me origjinë nga sanskritishtja. Në besimin e romëve, si antipod kundërshtar i besimit të tyre është "*beng*"-u, përkatësisht "i fëlliquri, i pëgëri". Në besëtytnitë e romëve kanë vend zana e fantazma dhe demonë që sjellin sëmundje.[131]

13. PROFESIONET

Romët e gjithë shteteve europiane në përgjithësi e edhe *kale*-t e Spanjës, vendoseshin në periferi qytetesh e katundesh dhe aty e zhvillonin zanatin e tyre të tregtisë dhe i ushtronin zejet e tyre tradicionale. Udhëpërshkrues spanjollë të shekullit 19 njoftojnë për romët si zejtarë: mprehës gërshërësh, tregtarë bagëtish, thurës shportash, tregtarë rrugësh me pakicë e shitës ambulantë. Romëve u kishte dalë nami si farkëtarë të mirë dhe në këtë fushë ishin të pakonkurrencë.[132]

Shumica e romëve shtegtarë, nomadë i ushtrojnë edhe sot profesionet e kryehershme të tyre si p.sh.: muziktarë, farkëtarë, tregtarë bagëtish, thurës shportash, kallajxhinjë, ose punues remesh. Përveç këtyre profesioneve karakteristike për romët nomadë, pjesa dërmuese e tyre kanë filluar të merren edhe me bujqësi - qysh gjatë periudhës së sundimit osman - duke u vendosur me banim të përhershëm në çifliqe të bejlerëve turq apo vendës të islamizuar. Jo vetëm në të kaluarën, por edhe sot, gratë e grupeve të romëve nomadë njihen për aftësinë e tyre prej falltoresh. Sa u përket fëmijëve, bie në sy që ata, duke nisur që nga mosha e njomë, merren me gjithfarë punësh për të fituar para.

Edhe në fushën e ushtrimit të profesioneve ka, pra, dallim të madh midis hashkalinjve (duke i përfshirë këtu edhe të ashtuquajturit "egjiptianë") dhe romëve. Kështu, hashkalinjtë dhe "egjiptianët" - me përjashtim të zejes së farkëtarisë - nuk e ushtrojnë asnjërën nga zejet që janë karakteristike për grupin e romëve. Hashkalinjtë e ushtrojnë rëndom profesionin e sharraxhinjve, hamajve, lustraxhinjve dhe të muziktarëve - dajrexhinjve. Rrallë mund të ndeshen gra të hashkalinjve që do të me-

[129] Po ai, po aty.
[130] Po ai, po aty.
[131] Sipas Der Grosse Brockhaus, Zwanzigster Band, Leipzig, 1935.
[132] Zigeuner in Spanien: http://www.villa.spanien-immobilien-costa-blanca.com/index.php?p=42

rreshin me misterin e fallit. Të gjithë hashkalinjtë dhe "egjiptianët" janë pa përjashtim të besimit islam.

14. FESTAT

Përveç Ditës së Shën Gjergjit, të cilën e kremtojnë të gjitha grupet rome, romët që nuk e flasin shqipen dhe që nuk janë të besimit mysliman e kremtojnë edhe festën e quajtur *Bibi*. Ritet religjioze që e përcjellin kremten e hyjneshës *Bibi* janë padyshim me origjinë indase. Ka vend të besohet se edhe tek romët serbishtfolës të Kosovës hyjneshës Bibi i atribuohen veçoritë qenësore të hyjneshës indase *Durga*, e quajtur edhe "Nëna Hyjnore". Romët e nderojnë këtë hyjneshë si patrone, mbrojtëse të tyre, sidomos të fëmijëve.[133] Për këtë festë gatuajnë gjellë e trejte nga më të mirat dhe nga të gjitha këto vihet ngapak nëpër dritare të shtëpisë për Bibin, për të cilën besohej se vjen kah mesnata dhe ha nga të gjitha hajet ngapak.

14.1. Gjys(m)at e Dimnit/Vasilicat/Viti i Ri i romëve

Një festë tjetër e romëve është edhe festa e quajtur "*Gjysat e Dimnit*". Këtë festë e kremtojnë romët (gabelët) e Rrafshit të Dukagjinit, ndërsa romët e Rrafshit të Kosovës nuk po e njihkan këtë festë. Këta e festojnë porse kremten e quajtur *Vasilicat*. Mua më duket se këtu kemi të bëjmë në të vërtetë vetëm me një kremte e cila njihet me dy emra të ndryshëm. Për këtë festë, gabelët prejnë biba e në mungesë të tyre, bën edhe pula. Disa familje prejnë një bibë apo një pulë për gjithë familjen, ndërsa disa familje prejnë nga një bibë apo pulë për krye të anëtarit të familjes. Kjo festë mund të zgjasë deri në dy javë. Rëndom bëhet njëfarë marrëveshje që pjesëtarët e gjithë farefisit ta vizitojnë njëri-tjetrin. Kështu për shembull një mbrëmje mblidhen tek njëri, kurse te nesërmen tek tjetri dhe vazhdohet me radhë. Një i ri rom, gabel i Rrafshit të Dukagjinit, më thoshte se këta po i festuakan edhe *bozhiqet* "Kërshëndellat" orthodokse serbe.

Vasilicat është në të vërtetë një emër më i vjetër për festën që, sipas R. Djurić[134] quhet *Viti i Ri* i romëve dhe janë njëri ndër ritet religjioze që është ruajtur tek romët e Serbisë e tek ata të Maqedonisë. Për këtë festë gatuhet një ëmbëlsirë në të cilën hedhet edhe një monedhë prej argjendi ose prej ari. Atij anëtari të familjes ose atij mysafiri që, në copën e ndarë të të cilit të ëmbëlsirës del ajo monedhë, do t'i takojë - deri në vitin e ardhshëm të ri - epiteti i "fatlumit". Për këtë festë, sqaron më tej autori

[133] Sipas Rajko Djurić, Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

[134] Po ai, po aty.

Djurić, prehen pata në numër cub: tri, pesë ose shtatë krerë. Pas darkës solemne fillon, më 15 janar, Viti i Ri. Nata e Vitit të Ri quhet në gjuhën rómani *phari rat* "Nata e vështirë".

14.2. Dita e Shën Gjergjit

Kjo kremte, në krye të herës pagane, e krishterizuar vetëm me emrin e shenjtorit, kremtohet ditën e 6 majit. Këtë festë e kremtojnë të gjithë qytetarët e Kosovës. Shqiptarët, hashkalinjtë e gabelët, serbët e romët serbishtfolës e quajnë këtë kremte me emrin e shën Gjergjit: shq. Shëngjergj, serb. Djurdjev Dan, ndërsa turqit dhe romët turqishtfolës (grupi rom arli, arlije) e quajnë *herdërlez*.

Derisa shqiptarët këtë ditë e shënojnë kryesisht me rite të lidhura me dëshirën për shëndet të familjarëve e të bagëtisë, tek romët kjo kremte e ka edhe elementin e flijimit. Pothuaj secila familje ther për ditën e Shëngjergjit një qengj. Një i ri gabel i Rrafshit të Dukagjinit më tregonte se për ta nderuar qengjin e flijuar, gjatë procesit të rrjepjes atij i vihen lule në gojë, ndërsa në kuadër të faljes, përkatësisht të shkëmbimit të ndërsjelltë, një pjesë e mishit të tij i shpërndahet farefisit. Shëngjergji numërohet ndër festat më të rëndësishme të të gjitha grupeve rome.

Hashkalinjtë dhe "egjiptianët" i festojnë të gjitha festat fetare (myslimane) që i festojnë edhe shqiptarët.

14.3. Muzika

Madje edhe njoftimet më të vjetra përkitazi me romët dalin në kontekstin e muzikalitetit të tyre. Në dokumente të shkruara iraniane të shekullit 3 flitet p.sh. për muzikantët *Luri* të Indisë. Këta përmenden edhe në burime të veçanta historike e letrare iraniane të shekujve 5., 9. e 10. Si muzikantë, këngëtarë e si valltarë, romët përmenden në shumë burime, duke filluar nga ato bizantine-greke e deri tek ato europerëndimore.[135]

Muzika popullore e romëve është shumë virtuoze. Instrumentet më të shpeshta muzikore të përdorura nga romët janë klarineta, surla, tarabuku dhe tupani nga burrat, ndëra nga gratë defi.

15. "EGJIPTIANËT" OSE SHPIKJA E NJË ETNIE TË RE ?

"*Në vitin 1989 ambasada e Egjiptit në Beograd u konfrontua me një vërshim prej pyetjesh. Kryesorja ishte enigma nëse Egjipti ka shtetas të vet që jetojnë në Kosovë. Një agjenci lajmesh paska përhapur "njoftime" se egjiptasit paskan rënë midis dy frontesh të konfrontimeve etnike midis*

[135] Po ai, po aty.

serbëve e shqiptarëve. Ja zgjidhja e enigmës: Agjencia e paska identifikuar termin shqip "Gypten" (SG: magjup) për romët pa një pa dy me "egjiptas" Në të vërtetë fjala Gypten (SG: magjup) e heq prejardhjen nga fjala "Egyptianos" - kështu u quajtën ciganët me të ardhur të tyre në Ballkan në shekujt 13-14 si, kinse të ardhur nga Egjipti (khs. Gypsies)".[136]

Raportet midis popullatës shumicë shqiptare dhe grupit etnik të quajtur tradicionalisht nga shqiptarët *magjup,-ë,* përkatësisht të hashkalinjve, kanë qenë tradicionalisht të mira. Me përjashtim të mosmartesës, ky grup etnik bashkëjetonte në kuptimin e plotë të fjalës me shumicën shqiptare. Fundja, sikundër edhe u pa më lart, hashkalinjtë e ndjenin dhe e ndjejnë veten për shqiptarë dhe e ndanin gjithmonë të mirën e të keqen me ta. Fëmijët e hashkalinjve tradicionalisht mësojnë në shkollën shqipe dhe identiteti sociokulturor i tyre është Kosova me veçoritë e saj shqiptare.

Sado që për shqiptarët nuk ka ndonjë dallim midis hashkalinjve e romëve (nënkupto grupin rom të gabelëve të Rrafshit të Dukagjinit), të dy grupet etnike quhen nga shqiptarët *magjup*. Përkrah këtij emërtimi, për hashkalinjtë po ekzistueka edhe shprehja "shqiptar i dorës së dytë", e cila qenka në përdorim "që moti", gjë që e përforcon faktin e kryer të inkuadrimit të këtij grupi etnik në shumicën shqiptare të Kosovës.

Shumë nga hashkalinj e romë (nënkupto gabelë), si të arsimuar, ishin dhe janë të integruar në shoqërinë kosovare. Ka midis tyre mjekë, avokatë, mësues, teknikë, infermierë e motra medicinale, zejtarë të shkathtë e tregtarë të suksesshëm. Administrata e komunave inkuardron në punë në masa mbiproporcionale hashkalinj, sidomos në fushën e mirëmbajtjes dhe pastrimit të qyteteve.[137] Pikërisht inkuadrimi në këtë shkallë aq të lartë i hashkalinjve në shoqërinë kosovare dhe sidomos në fushën e punës, i bën plotësisht të paqëndrueshme paragjykimet se romët nuk po e dashkan punën, se po i ushqyekan familjet me hajni e me lypje lëmoshe.

Me motive të ndryshme, pas gjithë gjasësh jo me sosh për ta përforcuar bashkëjetesën ekzistuese apo, siç është thënë një herë, për t'i shpëtuar diskriminimit,[138] disa individë të grupit etnik të hashkalinjve u anga-

[136] Gesellschaft für bedrohete Völker: "Ägypter" im Kosovo von Vertreibung und Tod bedroht!! http://www.muenster.org/frieden/roma.html.

[137] Sipas Im Kosovo droht jetzt eine neue Tragödie (RNZ, 29.12.1999)

[138] Mirjam Karoly, Roma und Ashkalije im Kosovo (November 2001) Ganz normaler Alltag? Die Einsetzung einer intrnationalen Veraltung (UNMIK) http://www-gewi.kfunigraz.ac.at/romani/journ_patrin/2002/rp2002-01-04.de.html.

zhuan që ta krijojnë një etni të re të quajtur "egjiptas" apo së pakut që emrin tradicional hashkali për grupin etnik *magjup* me gjuhë amtare shqipen ta ripagëzojnë duke e interpretuar këtë emër si të barabartë me emrin "egjiptas".

Lëvizja e "Egjiptasve" në Kosovë e arriti kulmin para 18 vitesh, kur shqiptarët e serbët hynë në fazën më të nxehtë të konfrontimeve politike e etnike të tyre. Për pasojë të rrethanës se liderë të nismës së krijimit të etnisë separate "egjiptas" të hashkalinjve u bënë përkrahës të politikës së Serbisë në Kosovë, ndodhi përçarja e minoritetit shqipfolës të hashkalinjve të Kosovës. Liderë të të ashtuquajturve "egjiptas" filluan të propagojnë se të drejtat e tyre prej minoriteti hashkalinjtë mund t'i kenë të mbrojtura (vetëm) nga prania e regjimit serb në Kosovë. Së këndejmi, një shumicë liderësh të romëve (p.sh. të Vushtrrisë) e morën para luftës haptazi anën e regjimit serb, duke e themeluar një parti politike proserbe të "egjiptasve" që ia mbante anën regjimit të Milošević-it.

Në vitin 1990, një vit pas rrënimit të autonomisë së shqiptarëve, përkatësisht të Kosovës, Beogradi i akceptoi edhe zyrtarisht "egjiptasit" si minoritet më vete të Kosovës. Në sy të disa vëzhguesve, kjo u pa si një ndarje e dhunshme e hashkalinjve, pjesë e të cilëve ishin edhe të gjithë ata që tani po bëheshin "egjiptas", në mënyrë që, duke e aplikuar parimin "përçaj e sundo" të mund t'i kontrollonte më mirë kosovarët dhe grupin etnik të hashkalinjve, përfshirë aty tani edhe vetë pjesën separatiste të "egjiptasve".[139]

Ka edhe një mendim sipas të cilit, pas rrënimit më 1989 të autonomisë së Kosovës, Miloševiqi "i mbështeste përpjekjet tona (SG: të "egjiptasve") që të mund të deklaroheshim si egjiptas, në mënyrë që numri i shqiptarëve në Kosovë të mbahej, statistikisht, sa më i ulët. Mirëpo egjiptasit nuk e pranuan ofertën e tij. Në regjistrimin e vitit 1991, shumica e egjiptasve u deklaruan për shqiptarë dhe vetëm një pakicë krejt e vogël për "egjiptas".[140]

Distancimi nga hashkalinjtë i grupit etnik që po formohej ishte shumë intensiv e fort agresiv sidomos në vitin 1999. Në vigjiljen e zgjedhjeve parlamentare të 17 nëntorit, kryetari i bashkësisë etnike të egjiptasve[*] i deklaronte gazetës "Vijesti" se "Ne reagojmë edhe kundër përdorimit

[139] Konstatime të transponuara me ndryshime të terminologjisë, nga Gesellschaft für bedrohete Völker: Volksgruppen mit einem Schicksal: Roma, Aschkali und Kosovo-Ägypter http://www.gfbv.de/voelker/europa/kosovo/kos_ethn.htm.

[140] Nga: Vielfalt 34, Kosova; Zeitschrift für bedrohete Völker, bot. Gesellschaft für bedrohete Völker http://www. Gfbv.ch/pdf/03-00-034.pdf.

[*] Qerim Abazi nga Fushë-Kosova.

shpesh të termit hashkali për ne egjiptasit e Kosmetit, çfare në këtë provincë jugore të Serbisë deri me ardhjen e KFOR-it më 1999 kishte më shumë se 100.000, ndërsa tani s'kemi mbetur më shumë se rreth 30.000. Establishmenti shqiptar e sheh për rrezik të madh rritjen e numrit të njerëzve të cilët deklarohen për egjiptas dhe që e kanë ndërgjegjen e zgjuar etnike. Abazi thotë se ka filluar fushata e frikësimit të egjiptasve që kanë ikur në Serbi se nuk do të mund të kthehen në Kosmet, nëse nuk deklarohen për hashkalinj".[141]

Gjenezën e krijimit të etnisë së re të "egjiptasve", kështu më është mbushur mendja, më mirë se shumëkush tjetër e ka shpjeguar drejt Orhan Galjus. Kur po shkruante rreth lindjes së kësaj etnie të shpikur, ky thoshte: "Njëra ndër lojërat politike që e kishin për qëllim rrënimin e identitetit të romëve (SG: ky i mendon hashkalinjtë) dhe t'i bënte këta viktimë, kurban, ndodhi në Prishtinë në tetor të vitit 1990. Mjetet e informimit njoftonin se në kryeqytetin e Kosovë-Metohisë po mbahej takimi promovues i Lidhjes së Egjiptasve të Kosovës. Shumë qytetarë ishin mahnitur dhe pyesnin "Prej kah po na ardhkan këta farë egjyptasish në Kosovë"?. Në takim të Lidhjes së Egjiptasve u kumtua se egjiptasit në Kosovë nuk paskan kurrfarë ambicjesh politike porse që, në vend të tyre, qëllimi thelbësor i tyre na qenka që ta ruajnë identitetin e tyre etnik dhe në mënyrë të veçantë të mbrohen nga shqiptarizimi, të cilit në të shkuarën i ishin nënshtruar pjesëtarët e kësaj etnie. Disa nga ata, megjithatë, u deklaruan për "romë". Duket se në Kosovë jetojnë rreth 100.000 "egjiptas" "[...] Ali Krasniqi që është shkrimtar i njohur dhe (është) aktivist rom, tha: "Dihet mirëfilli se "hashkalinjtë" "janë ata romë të cilët u shqiptarizuan që herët, kështu që gjuha amtare e tyre është shqipja. Unë kisha dëgjuar për njëfarë takimi të egjiptasve në Beograd në fillim të nëntorit 1990 në ambasadën e Egjiptit me rastin e një feste shtetërore të Egjiptit, në të cilin (takim) ishte i pranishëm edhe "Këshilli i Egjypasve" i vendit tonë, e edhe ai i Ohrit në Maqedoni. Për ne romët, kjo ngjarje ishte fort e dhimbshme. Ne kemi luftuar deri tani për emrin tonë etnik dhe ja tani, disa dikusha po na e servojnë një identitet tjetër. Që nga kjo kohë ne i jemi drejtuar disa herë autoriteteve serbe për njohjen si grup etnik më vete të romëve të Kosovë-Metohisë në mënyrë që të evitohet një përçarje [..] Sadri Avdyli, një burrë i njohur 54 vjeç, nuk e fshihte fare se atij, nën këto rrethana, i shkon mendja që të deklarohet si egjiptas. Ai thoshte: "Ne romëve të Kosovës na ka rënë t'i përjetojmë bukur do vuajtje; ndoshta ju do të habiteni që unë dua të deklarohem si egjiptas? Kjo (deklarimi si

[141] Udruženje Egipcana Kosmeta traži svoja prava: Nece svojatanja; nga http://www.medijaklub.cg.yu/dnevnevijesti/arhiva/2001.

egjiptas) nënkupton në të vërtetë *punë* dhe *më shumë të drejta* për mua dhe për familjen time. Dhe, më besoni, unë nuk do të dija asnjë arsye tjetër, përse do t'më duhej të deklarohesha si egjiptas. [...] Është pikërisht kjo papjekuri politike e cila romëve u solli shumë dëme. Është absurde të flasësh për një "shtet, i cili i përfaqëson katër grupe etnike" (shqiptarë, turq, serbë, egjiptas) sepse shumica e popullsisë e di se vetëm përkatësia zyrtarisht njërit nga këto grupe etnike mund t'ua hap portat e fatit. Në këtë spirale të rrenave që ushqehen nga Maqedonia e nga Kosova, "romë" quhen vetëm ata të cilët marrin pjesë në këtë lojë të mashtrimit politik e religjioz. Në Maqedoni e në Kosovë, këto iniciativa u përkrahën shumë më tepër se ideja e emancipimit të romëve. Nuk është e vështirë t'i biesh n'fije se çfarë qëllimi synon "Grupi Faraonik", pjesëtarët e të cilit e kanë mbështjellë prejardhjen e tyre me rrena. .. "që një ditë do ta zgjuaka interesimin e etnologëve e të etnografëve". Shpikjen e "egjiptasve" aktivistët romë e shohin si akt që më së shumti e dëmtoi unitetin e romëve. [...]. Krijimin e etnisë "egjiptase" e ndihmuan edhe shtete islamike. "Kur e pyetën një përfaqësues të Arabisë Saudite përse vendi i tij nuk e ndihmon pjesën myslimane të romëve në Bosne, ky u përgjegj se kjo është e pamundshme sepse ka edhe romë që jetojnë në Serbinë e krishterë! Kësi argumenti nuk u dëgjua në fillim të viteve të 90-ta, kur shtete myslimane i vizituan me mirësjellje e kënaqësi "egjiptasit" në Kosovë e në Maqedoni - në një kohë kur Jugosllavia ende nuk ishte ndarë. Mendohej se besimi islam do të ketë ndikim më të madh tek romët, sikur shteti i Jugosllavisë ta kishte mbijetuar përmbysjen. Ky lloj i spekulimit në relacion me romët nuk vjen vetëm nga ana islamike. Po u nisëm nga numri zyrtar, del se romët në Kosovë, në kuptimin më të gjerë të fjalës, janë minimizuar".[142]

Edhe përkundër kësaj të vërtete, në punimin programatik për ekzistimin e etnicitetit egjiptas, kumbarët e grupit etnik të imagjinuar të "egjiptasve" janë joshur apo duan vetë të deklarojnë se: "Sipas etnonimeve të para shihet qartë përse këtu është fjala për një grup etnik, i cili ka ndonjë lidhje me Egjiptin. Së këndejmi, intelektualët e këtij grupi etnik kanë vendosur ta quajnë veten egjiptas apo, thënë më qartë "Shtetas me prejardhje nga Egjipti".[143]

[142] Orhan Galjus, Roma im Kosovo: Die vergessenen Opfer (Versioni gjerman i artikullit anglisht "Roma of Kosovo: the Forgotten Victims" aus dem Web-Journal "The Patrin" http://www.geocities.com/~patrin/kosovo.htm) në http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/balkan.htm

[143] Nga "Wir über uns" http://www.balkanaegypter.de/einfuehrung.html.

Si rezultat i kësaj teze, liderët e grupit më të ri etnik të egjiptasve provojnë të distancohen me këmbë e dorë nga romët dhe nga hashkalinjtë. Dhe njohja e identitetit (të ri) u bë e mundshme sipas organizatave joqeveritare, para pak kohësh, përkatësisht falë procesit të demokratizimit. Në regjistrimin e vitit 1981 të popullsisë, ata që do ta kenë ndjerë veten për "egjiptas" na qenkan regjistruar asokohe ndër "të tjerë" ose "të papërcaktuar" - sepse asokohe nuk ishte aplikuar distinktivi "egjiptas". Kjo pjesë e hashkalinjve (?) ishte regjistruar më 1971 p.sh. në Maqedoni si grup etnik i "toskëve"[144] në bazë të emrit të dialektit jugor të shqipes, që këta e flasin. Shumë "egjiptas" deklarohen edhe sot e gjithë ditën shqiptarë ose hashkalinj. Kjo sepse, më herët, për "egjitasit" e Ballkanit nuk paska qenë aq e rëndësishme se kush e çfarë ishin. "Mirëpo thellë në ndërgjegjen e tyre këta e dinin se janë diçka tjetër dhe se nuk u takojnë popujve të tjerë. Ata e quanin njëri-tjetrin "i yni, tanët" ose "dora jonë".[145]

Në vitin 1990, një grup romësh shqipfolës të Ohrit/ Strugës e inauguruan një xhami më vete për ta dhe me këtë rast e ftuan edhe ambabasadorin e Egjiptit në ish-Jugosllavi të merrte pjesë në këtë ceremoni. Duke folur me "ti" me diplomatin, romët i sqaronin këtij se këta na qenkan pjesëtarë të një popullate tanimë të zhdukur të Egjiptit. Pas një viti, nuk është e sigurt para apo pas këtij inaugurimi, Slobodan Milosheviq doli me lajmin senzacional se shumica e shqiptarëve të Jugosllavisë rrum 700.000 të tillë në të vërtetë na qenkan "egjiptas". Ky kërkoi që në regjistrimin tjetër të popullsisë (1991) ky fakt të merret në konsideratë, sepse "kemi të bëjmë me një padrejtësi të madhe e cila duhet të korrigjohet" - thoshte ky. Shefi i Komisionit të Regjistrimit të Popullsisë mendonte porse se në rastin e "egjiptianëve" kemi të bëjmë me *"një grusht magjupësh kaherë të shqiptarizuar, të cilët ja, papritmas, nuk duan të jenë më shqiptarë*".[146]

Dëshira, pas gjithë gjasash e iniciuar dhe e përkrahur po se po nga regjimi i Milosheviqit, e nga kumbarë të tjerë të etnisë së re të "egjiptasve" u përmbush kur në vitin 1991 një pjesë e këtij grupi etnik arriti ta shfrytëzonte të drejtën e legjitimuar nga Serbia që për vete ta zgjedhë distinktivin "egjiptas", ashtu siç veproi edhe një pjesë e hashkalinjve, që përveç si "egjiptianë" nisi ta quante veten edhe me emrin e riaktualizuar rom. Për ndryshim nga romët, "egjiptasit" që po lindeshin nuk donin të dëgjonin më për prejardhjen e tyre nga India, porse donin dhe duan ta

[144] Po aty.
[145] Po aty.
[146] Rüdiger Benninghaus: Roma Gruppen in Mazedonien und im Kosovo; http://koelner-fluechtlingsrat.de/nachrichten/0700.doc

shohin veten ardhës nga Egjipti. Përkundër hashkalinjve, këta nuk duan të kenë asgjë të përbashkët me shqiptarët, sado që edhe këta, si të gjithë hashkalinjtë e Kosovës, për gjuhë amtare e të kulturës e kanë gjuhën shqipe. E këtillë është gjendja pothuaj edhe në gjithë hapësirën gjuhësore të shqipes në Maqedoni. Në qytetet e Ohrit/ Strugës dhe të Resnes "egjiptianët" e flasin variantin toskë, ndërsa në Dibër variantin gegë të gjuhës shqipe. Në Kërçovë, Prilep dhe në një pjesë të Manastirit flasin maqedonisht, në pjesën tjetër të Manastirit dhe në shumë qytete të Maqedonisë Lindore "egjiptianët" flasin turqisht. Në Bullgari, në masivin e Rodopeve, pjesëtarët e këtij grupi etnik, përkrah bullgarishtes, flasin edhe turqisht. Sipas etnologëve bullgarë, në disa familje të "egjiptianëve" ekziston edhe njëlloj gjuhe e fshehtë të cilën e përdorin kur janë krejt vetëm brenda familjes, jo porse edhe në praninë e të tjerëve, përkatësisht të të huajve. Në Serbi "egjiptianët" e preferojnë serbishten.[147]

Megjithatë, "egjiptianët" e Kosovës pohojnë për vete se e paskan prejardhjen nga Egjipti dhe se nuk janë romë. Kështu del sikur "egjiptianët" dhe hashkalinjtë të jenë dy popuj dhe ta kenë prejardhjen nga dy vende të ndryshme - nga Egjipti dhe nga Persia. Mirëpo nëse e pyet një "egjiptian" të papolitizuar dhe një hashkali të tillë se çfarë dallimesh ka midis këtyre dy grupeve, ata thonë se, megjithatë, nuk ka kurrfarë dallimi, por që janë një popull me dy emra. Kjo tregon se as vetë pjesëtarët e këtij grupi nuk janë të sigurt për prejardhjen e tyre dhe se e gjithë kjo është e paqartë sa kohë që nuk ekzistojnë shkrime që do të hidhnin dritë mbi këtë çështje. As "egjiptianët" e as hashkalinjtë nuk e njohin gjuhën *rómane* dhe pothuajse janë shqiptarizuar krejtësisht.

"Rezultat" i shpikjes së etnisë së re të quajtur "egjiptas", përkatësisht separimi me motive politike i një pjese të hashaklinjve në "egjiptas" të "Jugosllavisë" e paska ndalur procesin e shqiptarizimit të romëve shqipfolës, sepse këta të separuar më me dëshirë duan të jenë "egjiptas" sesa shqiptarë. - kujton studiuesi Orhan Galjus.[148]

15.1. "Vërtetimi" shkencërisht i ekzistimit të etnisë "egjiptase" në Kosovë

Ku do të vulosej asokohe projekti serb përveçse në kuzhinën e Tiranës. Aty tezën për mëvetësinë e egjiptasve e kodifikoi "shkencërisht" etnologu Rubin Zemon, Kryetar i Unionit të Egjiptasve në Europën

[147] Nga :Wir über uns http://www.balkanaegypter.de/einfuehrung.html.

[148] Khs. punimin e tij Roma im Kosovo: Die vergessenen Opfer (Versioni gjerman i artikullit anglisht "Roma of Kosovo: the Forgotten Victims" aus dem Web-Journal "The Patrin" http://www.geocities.com/~patrin/kosovo.htm.

Perëndimore, i cili është në të vërtetë autor i shkrimit programatik "Të dhëna etnologjike, historike e arkeologjike për prejardhjen e egjiptasve të Gadishullit të Ballkanit" (Tiranë, 1998) në të cilin ky e lanson tezën se egjiptasit e "Jugosllavisë", përkatësisht të Kosovës së sotme na qenkan dyndur këtu më së voni në kohën e Lekës së Madh para 2. 300 vitesh, përkatësisht para vitit 324 para erës sonë, drejtpërdrejt nga lumi i Nilit, përkatësisht nga Egjipti, ose si mjeshtër, kryesisht si farkëtarë, ose si pre lufte e ushtarëve të tij apo si mbathës kuajsh që ndër kalorës gëzonin orë dhe me të gjithë popujt e kësaj hapësire, me ilirë, thrakas, grekë, sllavë e me shqiparë paskan jetuar në harmoni. Egjiptasit na qenkan dëshmuar, sipas këtij projekti - pamflet - si gjatë periudhës së sundimit të Perandorisë Romake, asaj të Bizantit e të Perandorisë Osmane, por që romët në Ballkan megjithatë (?!) paskan arritur në shek. XIV, sepse tani e 500 vite më parë në Egjipt nuk dëshmohet më asnjë rom.

Zemon e konsideron për të mundshme madje që pararendësit e minoritetit të egjiptasve të Kosovës të kenë shkelur në shtete të sotme të Ballkanit qysh në kohën antike, por e pranon edhe vetë se tezat e tij kanë nevojë që në shumë aspekte të provohen dhe të gjejnë mbështetje shkencore. Ç'është e drejta, ky shkruan se egjiptasit dhe romët e Kosovës paskan filluar të përzihen që në shekullin 14. Mirëpo që këta të pranohen si një grup i vetëm etnik qenka gabim shkencor e historik.

Për hashkalinjtë, duke i përfshirë këtu edhe "egjiptasit" e Kosovës, Zemon e përkrah një herë (për të keq të shpikësve të etnisë "egjiptase") prejardhjen nga India midis shekujve 8 e 12.[149] Sado që deri më sot nuk dihet të jetë dëshmuar ndonjë migrim kaq i ri i njerëzve nga India në Kosovë, ky e sheh për të sigurt se më 1308 nga India qenka dyndur edhe një grup romësh farkëtarë i quajtur *Lohar* dhe rreth vitit 1320 po u dëshmuaka i pranishëm në Europën Lindore. Ky kujton se Lohar-ët (khs. më lart) që na paskan ardhur në shek. XIV (sic!) nga India qenkan në të vërtetë romët e grupit më të madh *kovaçi* të Kosovës, përkatësisht se (edhe) këta po rrjedhkan po nga ai grup i ardhur nga India. Por Lohar-ët nuk paskan ardhur vetëm. Bashkë me ta në Kosovë qenkan vendosur edhe grupe të tjera të cilat po mund t'u dëshmuakan dhe historikisht, kryesisht për shkak të ushtrimit të profesioneve të ndryshme na qenkan distancuar nga njëri-tjetri, si p.sh. arabaxhi (ky e shkruan fjalën si Rabagi) dhe në vend si "karrocier" e shpjegon këtë emër si "transportimi i mallrave" dhe *Gabeli*, emrin e të cilëve e shpjegon gabimisht si "Akrobatë e valltarë" ashtu siç ndodh edhe me shpjegimin e emrit

[149] Rubin Zemon: Ethnologische, historische und archäologische Angaben über den Ursprung der Ägypter auf der Balkanhalbinsel http://www.egjiptianet.de/

arli/*arlia* për si "muziktarë". Pikërisht "shpjegimet" e këtilla e zbulojnë mosnjohjen nga Zemon-i të problemit rom dhe tregojnë se e gjithë godina e tij "shkencore" qëndron mbi themele të lëkundshme.[150]

Njëra ndër "mbështetjet" bazë të prejardhjes së pandehur nga Egjipti të këtij grupi "të ri" etnik është prejardhja e supozuar e emrit të përhapur ndër popuj të tjerë me të cilin fillimisht ata, e më vonë edhe vetë pjesëtarët e etnisë rome, do ta quajnë veten. Sipas tezës së Zemon-it, po u dashka të rezultonte se romët janë të ardhur nga Egjipti, sepse këta po u quajtkan p.sh. në anglosaksonishten *Gypsy*; në frëngjishten *Gitans*; në hapësirën gjuhësore të hispanishtes/spanjolishtes *Gitanos*; në greqishten *Gifti*/*Yifti*; në bullgarishten (që del vetëm ndonjëherë): *Agupti*/*Agjupti*, përkatësisht *g-jupci*, *agupci* në kuptimin "rom; magjup" që rrjedhin nga greqishtja e re γύφτος "rom, magjup" ndërsa vetë termi i greq. së re rrjedh nga greq. e vj. Ἄγυπτος "Egjipt,-i";[151] pse në Maqedoni po u quajtkan kinse edhe *Gjupci*, *Egjupci*, *Jupci*, *Ijupci*, *Ojupci*; pse turqit po i quajkan edhe *Kepti* e *Kýpti* (khs. emrin e Koptëve të Egjiptit) dhe pse një emër më i vjetër për këtë etni në perandorinë osmane paska pas qenë *Faraoni*/ *Fira*(*v*)*uni* - emër që paska depërtuar edhe në hapësirën gjuhësore të sllavishtes së jugut dhe, si përfundim, pse në të gjithë këta emra po u ruajka kuptimi "egjiptas". Me këtë rast u harrua, përveç të tjerash, se edhe variantet maqedone, bullgare e turke janë me përhapje të kufizuar, lokale sepse emrat më të përhapur janë edhe në këto gjuhë *cigan*, përkatësisht *çingene*.

Për ta përligjur këtë tezë, të angazhuarit për vënien e bazës së kësaj etnie "të re" (por sipas tyre fort të lashtë!) për mbështetje të fortë dhe si "argument" kryesor i kanë marrë edhe trajtat shqipe të fjalës *magjup*, përkatësisht variantet kinse të shqipes *gjyp*, *egjyp*, që nuk ekzistojnë fare apo janë skajshmërisht lokale dhe nga varianti po ashtu i rrallë *magjyp* i trajtës së përhapur gjithandej në hapësirën gjuhësore të shqipes *magjup*, si dhe nga variantet që dëgjohen vetëm në Shqipëri: *jevg* e *evgjit*, e që edhe në të gjitha këto po u ruajka emri i Egjiptit. Ky emër i dytë, në kuptimin e pambështetur mbi rezultate të gjuhësisë ballkanike e të albanologjisë për romët (SG: magjup =."egjiptas") territorialisht lidhet me një të ashtuquajtur "Egjipt (i Vogël)" të Peloponezit. Se këtu kemi të bëjmë me një lajthitje duket se e dëshmon rrethana se romët që në kohën e ngulitjes së tyre dhe sidomos të shtegtimit nga Ballkani më saktësisht

[150] Volksgruppen mit einem Schickal: Roma, Ashkali und Kosovo- Ägypter, htp // www.gfbv.de/voelker/europa/kosovo/kos_ethn-htm.

[151] Kiril Kostov, Vъrhu proizhoda na ciganite i tehnija ezik, në Bъlgarski ezik, 2, 1953, f. 343.

nga krahina *Gype* e Kretës dhe nga Peloponezi për në Perëndimin e Europës, e paraqitnin veten rrejshëm si pelegrinë dhe si pendestarë nga Egjipti i Vogël, pa sqarimin se kemi të bëjmë me romë nga kolonia "Egjipti (i Vogël)" e Peloponezit. Kjo paraqitje u besua nga kronistë të kohës së atëhershme të këtij kontinenti duke pasur për rezultat ngatërrimin e Egjiptit "të vërtetë" me koloninë rome të Greqisë. Këtë hutim e ngatërrim të servuar nga romët (që në Ballkan - përveç emrave të tjerë do ta kenë mbajtur edhe emrin e ngjashëm me të shqipes *magjup*) e tregon fakti i padiskutueshëm se ai farë "Egjipti i Vogël" identifikohet në të vërtetë me vendbanimin e madh, koloninë *Gype* të romëve në Greqi, i cili sot quhet Methoni, ose edhe me gjithë Peloponezin", ku në mesjetën e vonë dëshmohet ekzistimi i një kolonie të madhe magjupësh.[152] Sado që është shfaqur mendimi se prania e romëve në territorin bizantin po u dëshmuaka nga viti 835 e këndej; se disa nga këta romë paskan kaluar nëpër Lindjen e Afërme e qenkan vendosur në Egjipt e pastaj në Afrikën Veriore dhe se, si duket, një pjesë e tyre nga Egjipti nëpër Detin Mesdhe paskan ardhur në Europë, dëshmimin më të moçëm të pranisë së romëve në Peloponez, i cili "[...] ishte një kohë të gjatë qendra kryesore e romëve në Gadishullin e Ballkanit" e kemi nga 1326. Aty ekzistonte e ashtuquajtura *Giftoceastrum* ("Kështjella e romëve") e cila u shkatërrua gjatë luftërave të brendshme ose gjatë pushtimeve turke" dhe me dëshmimin e romëve në ishullin e Kretës në vitin 1332 jo porse ndonjë koloni egjiptianësh të mirëfilltë - konstatojnë njohës të mirë të historisë së romëve.[153]

Kjo popullatë njihet, kryesisht në Shqipëri, edhe me emrin *evgjit*. Çabej[154] na mëson se emrat *evgjit* dhe *jevg* rrjedhin nga greq. e re αίγύφτιος (SG: khs. variantet greke *Gifti* / *Yifti*, përkatësisht *Gifto*[155]) ndërsa kjo vetë nga greq. e vj. αίγύπτιος,. [...] Në të folmen shqipe të arvanitasve në Greqi kjo fjalë e ka kuptimin "kovaç". Në të folmen e Kurbinit, emri i kësaj popullate del edhe në trajtën *gjypsh* dhe atje e ka kuptimin "farktuer, kovaç". Edhe kjo trajtë, gjithnjë sipas Çabej, mund të rrjedh nga greq. e re γύπτος. (SG: pse kjo trajtë nuk do të mund të ketë dalë nga emri i kolonisë rome *Gypte* të Peloponezit ?). Me *gjypsh* afrohet

[152] Rüdiger Benninghaus: Roma Gruppen in Mazedonien und im Kosovo; http://koelner-fluechtlingsrat.de/nachrichten/0700.doc.

[153] Khs. Christiane Fennesz - Juhasz/ Dieter W. Hawachs/ Mozes F. Heinschnik: Sprache und Musik der österreichischen Roma und Sinti http:/www-gewi.kfunigraz.ac.at./romani/downlaod/files/_ab5.pdf.

[154] Khs. Studime etimologjike në fushë të shqipes, IV, Tiranë 1996, f. 110-111.

[155] të clat, sipas M. Tërnavës, Popullsia e Ksovës në shek. XIV- XVI, Prishtinë 1995, f. 398, po rrjedhkan - si edhe angl. *Gips* (agipciane), fr. *Gtane* dhe turq. *kipti* - nga emri *kopt* i popllatës orthodokse të Egjiptit.

edhe trajta *xhip* "jevg" që përdoret në Dibër. Është për t'u shënuar që edhe G. Weigand trajtën *jevg* e bie të ardhur nga greq. e re γύπτος.[156]

Ka edhe etnonime të tjera për këtë grup etnik dhe ato mbështeten mbi punët që më së shpeshti kryhen nga ky grup etnik. Kështu, në Mal të Zi po i quajtkan *kovaç*, ndërsa në Kosovë *hashkali*. Por, "Këta emra u lindën nën ndikimin e literaturës mesjetare, në të cilën (literaturë) romët e sintit përmenden si "egjiptas". Vetëm kah fundi i shek. XVIII dijetarët (khs. J. C. Ch. Rüdiger, S. Vally dhe H. M. G. Grellmann) e demantuan (SG: drejt) këtë paravendim, duke arritur ta dëshmojnë prejardhjen e tyre nga India", thotë njohësi me kompetencë i romëve Rajko Djurić: [...], sepse: "Në dokumente, në literaturë dhe në opinionin publik ky popull njihet si cigan, gypsi dhe gitanos. Ky emërtim e shpreh distancën (SG: e distancimin) social e kulturor të popujve shumicë, të cilët janë zotër jo vetëm të të drejtave, porse shumë shpesh edhe të jetës së këtij minoriteti". - thotë më tej Rajko Djurić,[157] ndërsa Robert Dycke shkruan: "Sido e kahdo që do të mund të jetë prejardhja e ciganëve, pasqyra e sotme e dëshmon plotësisht farefisërinë e këtyre me njerëz të Indisë. Shumë shpesh kemi të bëjmë me njerëz me lëkurë ngjyre të mbyllët, me mollëza faqesh paksa të ngritura, me sy ngjyrëkafeje dhe me flokë të zinj".[158] Mendim i pranueshëm në këtë mes është ai që dialektet e gjuhës së romëve janë në lidhje birërie me gjuhët indase të Indisë Veriore.[159]

Ata që janë përcaktuar ta ndjejnë veten për "egjiptianë" dhe ata që e kanë marrë përsipër ta arsyetojnë krijimin e këtij grupi të ri etnik (vetëm) në Kosovë e në pjesë të Maqedonisë të banuara kryesisht nga shqiptarë, shkojnë aq larg sa po gjetkan mbështetje edhe nga fusha e antropologjisë për ta mëvetësuar këtë grup etnik, të cilin e ngrinin madje edhe në shkallë populli. Kështu, në të përditshmen Stuttgarter Zeitung të dt. 8 shkurt të vitit 2000 lexojmë ndër të tjera edhe se "Egjiptasit" dallohen nga popujt e tjerë në rend të parë për nga prejardhja e tyre, për nga tradita, doket e zakonet dhe për nga mënyra e jetesës; nga romët dallohen në rend të parë për nga veçoritë antropologjike (SG: !!!)

Sado që egjiptasit dhe romët janë lëkurëzezë, ata dallohen në aspektin antropologjik: egjiptasit janë brahocefalë, ndërsa romët dolicefalë, gjë që do të thotë se egjiptasit dhe romët ndryshojnë për nga fizionomia. Këto

---

[156] Sipas E. Çabej, po aty, f. 111.

[157] Sh. Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www. kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.

[158] Khs. punimin e tij Zigeuner, ein verfemtes Geschlecht ;orchesterkolleg@gmx.de.

[159] sipas Rüdiger Benninghaus: Roma- Gruppen in Mazedonien und im Kosovo:http.//koelner fluechtlingsrat.de./nachrichten0700.doc.

"dy etni" po ndryshuakan edhe për nga gjuha. Edhe zejtaria tradicionale qenka e ndryshme, thonë këta. Prandaj, sipas kësaj hipoteze "egjiptasit" e Kosovës qenkan pasardhës të egjiptasve (të mirëfilltë) antikë, ndërsa romët po rrjedhkan nga India.[160]

Nga sa mund të shihet nga historia e gjuhës rómani, përkatësisht nga variantet e saj, në asnjë vend të botës, ose më saktësisht në asnjë vend të Europës nuk është dëshmuar se midis atyre 60 nëngrupeve të romëve nuk ka ndonjë grup që do të jetë quajtur ndonjëherë apo që quhet sot "egjiptas". Në gjuhën rómani nuk janë konstatuar ndikime nga arabishtja, përkatësisht nga ndonjë variant i folur në Egjipt. As në Kosovë nuk ka ndonjë variant të gjuhës rómani që do të quhej "varianti egjiptian" (sh. më poshtë). Tri gjëra janë për t'u vërejtur në këtë mes:

1. Së pari që sipas këtij interpretimi, përkatësisht të emrave që kësaj popullate ia dhanë pas ngulitjes së saj p.sh. në Angli, Francë, Spanjë dhe sidomos në hapësirën gjuhësore të shqipes (kujto emrat në anglisht, frëngjisht, spanjollisht dhe shqip e greqisht etj.), do të duhej të rezultonte që të gjithë romët e hapësirës gjeografike të Europës po u dashka të lidhen me emrin Egjipt dhe të quhen pra "egjiptas". Por askund në dynja nuk është vërejtur, përveç në Kosovë e në hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve në Ballkan, që një tendencë e tillë të jetë cytur apo realizuar.

2. Teza sipas të cilës prejardhjen nga Egjipti të magjupëve po e treguaka vetë emri *magjup*, përkatësisht *evgjit* i këtij grupi etnik në gjuhën shqipe, ka nevojë për një shqyrtim më të thellë, sidomos në rrafshin gjuhësor. Së pari, pse nuk kemi kurrfarë sigurie që zbërthimi i emrit *magjup* me emrin e Egjiptit të jetë më i bindshëm se sa zbërthimi i këtij emri me fjalën e greqishtes së mesme, përkatësisht bizantine, *manceps* "bukëpjekës manastiri" dhe me variantin serb mesjetar *magjupac* shm. *Magjupci* të emrit bizantin për bukëpjekësit e manastireve. Pa u ndarë nga ky kontekst, do të duhej parë nëse emri Gype i regjionit grek në të cilin dëshmohet një koloni magjupësh ka me të vërtetë ndonjë lidhje me emrin e shtetit të Egjiptit. Në vazhdim duhet shtuar se në historinë e brendshme të zhvillimit të shqipes nuk ka kurrfarë dëshmie të metatetizimit të emrit *Egjipt* në **Evgjit*. Shqiptarët e quajtën dhe e quajnë këtë shtet gjithmonë ose Egjipt ose edhe Misir, por kurrë *Evgjit.

3. Së treti, pse Kosova duhet të jetë i vetmi vend në botë në të cilin po u dashka të dallohen nëngrupet etnike *hashkali* e "*egjiptas*". Kjo aq më parë pse para viteve të '90-ta të shekullit që shkoi këso nëngrupesh le që

[160] Kështu e njoftonte më 25 nëntor 1995 Ćerim Abazi, përfaqësues i bashkësisë etnike të egjiptasve të Kosovës, opinionin ndërkombëtar në Stuttgarter Zeitung, 8. shkurt, 2000. Kështu thuhet, edhe, në letrën e Qerim Abazit drejtuar J. Dinstbier, shih te *Materiale.*

nuk kishte në Kosovë e në Shqipëri, por as në hapësirën gjuhësore të shqipes në Maqedoni, në Mal të Zi e as në Luginën e Preshevës. Ky fakt do ta arsyetonte plotësisht qëndrimin e mësipërm se egjiptianët janë një grup i shpikur për nevoja politike, në rastin tonë nga regjimi serb i Millosheviqit. Fundja, ky nuk është vetëm mendim i imi i vetmuar. Njëri ndër njohës aktualisht më të mirë të problemit rom, kur po shkruante rreth grupit të egjiptianëve në Maqedoni thoshte: "Duket se shumë nga romët e republikës së Maqedonisë sot nuk deklarohen më si të tillë; numri prej 47.408 personash në regjistrimin e popullsisë së vitit 1994 konsiderohet nga shumëkush për fort i vogël. Duket se deklarimi për si pjesëtarë të grupit të të ashtuquajturve "egjiptas", të cilët në regjistrimin e fundit dalin si grup i veçantë, do të duhej, midis të tjerash, të jetë formuar nga motive antishqiptare. Për si të këtillë janë deklaruar kryesisht (romë) zanatlinj në pjesën veriore të Maqedonisë. Më 1991 të këtillë ishin 3.307, ndërsa më 1994 janë regjistruar 3.351"

Lëvizja e "egjiptasve" e arriti kulminacionin në kohën kur shqiptarët e serbët u ndodhën në fazën më të nxehtë të konfrontimeve të tyre. Për shkak se disa nga "egjiptas" ia mbanin krahun politikës serbe filloi në të vërtetë përçarja midis hashkalinjve shqipfolës. Lideri i "egjiptasve" mori pastaj pjesë në anën e serbëve në bisedimet në Rambouillet. Sidomos që nga ajo kohë jo vetëm në Kosovë por edhe në botën e jashtme në marrëdhëniet midis hashkalinjve dhe atyre që u ndanë nga këta dhe e quajtën veten "egjiptas" ka një rivalitet të ashpër. Në këso raportesh janë p.sh. "Shoqata e Egjiptianëve të Kosovës" dhe "Shoqata Ashkanli Shqiptar" me simbol shkabën dykrerore të shqiptarëve, që zhvillojnë aktivitet në Gjermani. Mirëpo asnjëra nga këta dy palë nuk duan të bashkëpunojnë me romët.

Nuk më ka rënë të mësoj nëse themelimi i shoqatave të të vetëquajturve "egjiptas" të Kosovës ka ndonjë lidhje me shoqatën "Egypt" që më 1919 apo më 1921 në Sofje e kishin themeluar romët që e mbanin veten për të ardhur nga Egjipti,[161] por pas lansimit në fund të viteve të '80-ta të shekullit të kaluar të tezës mbi ekzistimin e grupit etnik të "egjiptianëve" filloi organizimi i tyre nëpër shoqata. Kështu, më 26. 6. 1990 u themelua në Ohër "Shoqata e Egjiptianëve të Jugosllavisë"; "Shoqata e Egjiptianëve të Kosovës e Metohisë" u themelua më 21.10.1990 në Prishtinë; Shoqata e Egjiptianëve të Shqipërisë u themelua më 1992 në Tiranë, por u njoh tek më 1997. Më 26. 9. 1998 të gjitha këto shoqata u bashkëshkrinë në "Shoqatën e Egjiptasve të Ballkanit" me seli në Ohër. "Shoqata e Egjiptianëve të

[161] "Wir über uns" http://www.balkanaegypter.de/einfuehrung.html.

Ballkanit" me seli në Mülheim të Ruhr-it (Gjermani) ekziston që nga gushti i vitit 1999.[162]

Aktiviteti bazë i këtyre shoqatave si në Radolfzell, Allensbach, Konstanz etj., sikundër njoftojnë disa gazeta lokale si Wochenblatt (Stockach) e 18 tetorit 2000; Südkurier (Konstanz) e 25 tetorit 2000 dhe Anzeiger (Konstanz) e 2 nëntorit 2000, është dëshmimi i mëvetësisë nacionale të "egjiptasve", vënia nën mbrojtje e egjiptianëve të mbetur në Kosovë dhe rikthimi aty i pjesës së arratisur të tyre[163] e gjetiu nëpër Europë.

Ideologët e kësaj "etnie të re" shkuan edhe më larg. Agjencia serbe e lajmeve njoftonte më 3 qershor të vitit 2000 se shefi i përfaqësisë diplomatike të Egjiptit në Beograd e kishte pranuar një ditë më parë Qerim Abazin - anëtar i Këshillit Ekzekutiv Krahinor të Kosovë-Metohisë dhe kryetar i bashkësisë etnike të egjiptasve. Ky e paska njoftuar diplomatin e shtetit të Egjiptit se nga më shumë se 100.000 pjesëtarë të kësaj pakice tradicionale të egjiptasve - sa paskan jetuar në Kosovë para marshimit të KFOR-it - tani paskan mbetur vetëm 30.000 sish. Të gjithë të tjerët qenkan vrarë ose qenkan dëbuar nëpër pjesë të tjera të Serbisë nga ekstremistët shqiptarë. Diplomati egjiptas Basem Khalili paska treguar mirëkuptim të madh për problemet e egjyptasve të Kosovës dhe paska theksuar se do të bënte gjithë ç'mundet që opinionin botëror ta njoftojë me të vërtetën mbi krimet e terroristëve shqiptarë".[164]

Si pasojë e ngutisë rreth emancipimit të kësaj etnie të re shpëtuan apo qëllimisht u lansuan edhe shifra të ndryshme përkitazi me numrin e njerëzve që do ta përbënin këtë etni të re. Le ta nisim këtë me shifrën e lansuar nga "Shoqata e Egjiptianëve të Ballkanit", sipas së cilës në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë e në Serbi paska më shumë se 500.000 "egjiptas".[165]

Shoqata për Mbrojtjen e Popujve të Rrezikuar me seli në Heidelberg i ka deklaruar autorit të artikullit që u citua më lart,[166] se para luftës në Kosovë paska pasur 250. 000 "egjiptianë", ndërsa tani këtu paskan mbetur vetëm rreth 30.000 të tillë. Këto shifra Shoqata po i ditka, sado që e thekson shprehimisht se edhe "egjiptasit" bashkë me shqiptarët

[162] Franz J. Schmid, "Ägypter" im Balkan-totgeschwiegen und verjagt - Eine fast unbekannte Volksgruppe kämpft um ihre Identität Von Serben unterdrückt, von Albanern aus dem Land gewiesen.

[163] Nachrichten des Tages: Ägyptische Botschaft: Wahrheit über Verbrechen http://www.amselfeld.com/20000603.htm#AE.

[164] sipas: Verein der Balkan Ägypter in West Europa, http://www.balkanaegypter.de/dokuments/Weneedtobehappydeutsch.pdf.

[165] khs. "Wir über uns http://www.balkanaegypter.de/einfuehrung.html.

[166] nga http://www.balkanaegypter.de/einfuehrung.html.

kishin refuzuar të merrnin pjesë në regjistrimin e popullsisë më 1991 dhe se në të vërtetë "vetëm rreth 5.000 - 10.000 persona në Kosovë do të jenë deklaruar vetë për si "egjiptas".[167] Nga organizata joqeveritare që ose qëllimisht dezinformuan apo vetë ishin viktimë e dezinformimit, shifrat që s'përkojnë me realitetin përpiqen t'i argumentojnë edhe me konstatime kundërthënëse. Sado që ishte thënë njëherë se regjistrimi i vitit 1991 ishte bojkotuar, këta thonë megjithatë se ata (SG: tani zvogëlohet numri) 200.000 "egjiptas" të Kosovës nuk e kanë pasur mundësinë që p.sh. në regjistrimin e popullsisë më 1991 ta shprehin identitetin e tyre të mirëfilltë, sepse popullata shqiptare "vetëm duke i "përfshirë" në vete të gjitha minoritetet etnike mund ta arrinte epërsinë për nga numri karshi popullatës sunduese serbe (rreth 10%).[168] Këtë mendim e gjejmë edhe një raport tjetër.[169]

Në një raport tjetër, po kjo organizatë joqeveritare (GfbV) njofton se "Nga (SG: numri vazhdo të zvogëlohet!) 150.000 pjesëtarë sa kishte në krye të herës ky grup etnik, sot (shkurt, 2002) në Kosovë kanë mbetur vetëm rreth 10.000 sish. Të tjerët u dëbuan nga vendi.[170] Ndonjë organizatë joqeveritare jep edhe shifra të pambështetura edhe përkitazi me numrin e "egjiptasve" të mbetur në Kosovë, pas arratisjes apo dëbimit të disave nga ata të cilët në sy të kosovarëve ishin bashkëpunëtorë të regjimit serb (për këtë sh. kapitullin që pason). Kështu në një raport thuhet se "Para luftës, në Kosovë jetonin rrafsh 150.000 romë, tani kanë mbetur rreth 25.000 deri 30.000. Romët u dëbuan, u persekutuan dhe u plaçkitën".[171]

Sipas vlerësimeve personale, të paverifikuara të vëzhguesve të organizatave joqeveritare, grupet etnike të romëve: romë, hashkalinj, "egjiptas" po e arritkan shkallën prej 10% të popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës, një shifër kjo që po u vërtetuaka e miratuaka nga intelektualë, aktivistë dhe nga shoqata të romëve.[172]

---

[167] http://www.politikforum.de/forum/showthread.php?threadid=44082.

[168] Anelore Hermes, Referentin m Bundesbüro der GfbV (Göttingen):: Sinti und Roma, Basisfakten und Überblick, http://www.gfbv.de/voelker/europa/roma

[169] Sipas Martin Kistner: Albstadts "Ägypter aus Jugoslawien", protestieren gegen Pogrome im Kosovo, aus Albstadt-Bote, 29./30. Januar 2000.

[170] sipas Martin Kistner: Albstadts "Ägypter aus Jugoslawien", protestieren gegen Pogrome im Kosovo, aus Albstadt-Bote, 29./30. Januar 2000.

[171] Sipas Orhan Galjus, Roma im Kosovo: Die vergessenen Opfer (Versioni gjerman i artikullit anglisht "Roma of Kosovo: the Forgotten Victims" aus dem Web-Journal "The Patrin" http://www.geocities.com/~patrin/kosovo.htm) në http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/balkan.htm.

[172] Po ai, po aty

16. LUFTA PËR KOSOVËN DHE ROMËT, HASHKALINJTË E "EGJIPTASIT"

"Romët nuk kanë qenë kurrë rrezik për askënd, sepse këta nuk kanë ambicje territoriale, nuk kanë koncepcione shtetformuese e, megjithatë, përkundër kësaj, ata mbetën si në rrethin e nëntë të Ferrit të Dantes."- thoshte R. Đurić[173] kur po i vlerësonte pësimet e romëve nga luftërat e fundit në hapësirat e Jugosllavisë së zhbërë.

Disa vite para se në Kosovë të shpërthente lufta, Orhan Galjus sikur e parashihte se çfarë mund të ndodh me romët: *"Nëse në Kosovë bëhet luftë, romët do të fajësohen edhe një herë pse, ashtu siç ndodhi në luftën midis serbëve, kroatëve e boshnjakëve, shumica prej tyre do të dezertojnë, nuk do të marrin pjesë në luftë. Pa marrë parasysh se cili do të jetë fitues i luftës në Kosovë, romët do të damkosen për dezertorë, tradhtorë dhe për njerëz që nuk duan të luftojnë për vendin e vet. Por përse dhe për kend do të donin të luftonin romët në këtë lloj lufte? Sa kohë do të munden romët ta ruajnë neutralitetin e tyre nëse flasim për një luftë në kuptimin e saj të përgjithshëm? "*.[174] Vetëm sa për ilustrim bën të përmendet në këtë mes se në pozitë të këtillë u gjendën romët gjithherë, kur duhej të dëboheshin nga vendi. Kështu ka ndodhur p.sh. në Gjermani në vitin 1497 kur Sigismundi, nga viti 1386 mbret i Hungarisë dhe nga viti 1422 Perandor i Rajhut të Shenjtë të Kombit Gjerman, megjithëse romit Ladislaus dhe njerëzve të tij i kishte dhënë një letër mbrojtëse (gjë që do të thotë se poseduesit e kësaj letre nuk bën as të sulmohen e as të dëbohen) në takimin e Reichstag-ut afër vendit Lindau e pezulloi atë letër dhe romët i shpalli për të jashtligjshëm dhe i damkosi si spiunë të Turqisë. Mirëpo romët u larguan vetë. Autori që e sjell këtë të dhënë historike shkruan në parantezë "(shënim: Faji për spiunazh edhe sot: Lufta për Kosovën i akuzoi këta për kolaborim me serbët kundër shqiptarëve)".[175]

Për marrëdhëniet midis shumicës kosovare dhe romëve e "egjiptasve", përkatësisht për liderë e individë nga këta të fundit si bashkëpunëtorë të regjimit serb dhe të ndëshkimit të tyre nga UÇK është shkruar shumë sidomos pas mbarimit të luftës për Kosovën. Më poshtë do të sjellim pjesë artikujsh e njoftime të ndryshme përkitazi me ndëshkimet ndaj romëve, hashkalinjve e "egjiptasve".

---

[173] Në një intervistë në radion "Europa e Lirë" (serbisht) më 8 nëntor 2008.

[174] Geschichte und Sprache der Roma http://www.kbk.at/roma/Container/Vortrag-2000-M%E4rz.htm.

[175] Sipas http://www.balkanaegypter.de/einfuehrung.html. Ky konstatim vërtetohet edhe nga burime të tjera. Khs. psh edhe: Die Verlierer der Balkankriege, Die kleine Völker junger Nationen http://www.taz.de/pt/2003/07/11.nf/mondeText.artikel,a0042.idx,12.

Raportet midis kosovarëve e pjesës së hashkalinjve që u ndanë dhe e ripagëzuan veten "egjiptas" u ftohën në masë të madhe kur liderë të kësaj etnie të re edhe hapur dolën në anën e regjimit serb të Milosheviqit dhe në Konferencën e Rambouillet morën pjesë në anën e palës serbe. Njohës më të mirë të kësaj tematike kanë vlerësuar se "Popujt "e vegjël" të Kosovës e fituan me të drejtë mbresën se shfrytëzohen nga të gjitha palët. Kështu p.sh. Slobodan Milosheviq dërgoi në shkurt të vitit 1999 qëllimisht edhe përfaqësues të grupeve të vogla në bisedimet kosovare-serbe në Rambouillet - pjesëmarrje kjo për shkak të së cilës minoriteteve të Kosovës u doli nami i zi si në sytë e shqiptarëve ashtu edhe në ata të bashkësisë ndërkombëtare. Në anën e palës serbe në këto bisedime mori pjesë edhe lideri i "egjiptasve" të Kosovës.[176] Ose "Gjithashtu edhe rrethana se Milosheviqi i instrumentalizoi disa kolaboratorë në bisedimet e Rambouillet; se disa u detyruan të merrnin pjesë në masakrat mbi shqiptarët ose u përdorën për varrtarë të të vrarëve shqiptarë, të tria grupet etnike (SG: hashkalinjtë, romët e "egjiptasit") u fajësuan paushal nga shqiptarët për kolaborim"[177] me pushtetin serb**.** Në një raport tjetër, mbase duke harruar se ç'ishte thënë një herë, Shoqata për Mbrojtjen e Popujve të Rrezikuar shkruan: "Megjithëse romët, hashkalinjtë dhe egjiptasit e Kosovës u përpoqën për kohë të gjatë që në konfliktin në rritje midis serbëve e shqiptarëve megjithatë të mbeteshin neutralë, sot nga pjesa më e madhe e shqiptarëve të Kosovës (SG: ky neutralitet) u ngarkohet si tradhti; ashtu si edhe rrethana se Milosheviqi i kishte instrumentalizuar disa kolaboratorë në bisedimet e Rambouillet"**.**

Përkundër rrethanës se shumë nga "egjiptasit", kështu thonë përfaqësuesit e shoqatave të tyre nëpër Gjermani, e paskan ndihmuar luftën e shqiptarëve në Kosovë edhe financiarisht e madje edhe me pjesëmarrje aktive me armë në dorë në anën e UÇK-së,[178] "romët e egjiptasit e Kosovës u fajsuan paushal për si bashkëpunëtorë të regjimit serb dhe mbi bazën e këtij fajsimi u bënë viktima të "spastrimit etnik" sistematik. Turqit u sollën para alternativës që të "shqiptarizohen". [...] Shërbimi sekret i UÇK-së, i organizuar mbi parimin e ndëshkimit, po i ndiqka tani romët në Vojvodinë; Propaganda e UÇK-së i fajson romët për krime nga më të tmerrshmet e luftës. Deri më tani unë nuk kam ndeshur ndonjë dëshmitar okular të besueshëm i cili do të mund ta

[176] Gesellschaft für bedrohete Völker: Volksgruppen mit einem Schicksal Roma, Aschkali und Kosovo-Ägypter http://www.gfbv.de/voelker/europa/kosovo/kos_ethn.htm

[177] Volksgruppen mit einem Schicksal Roma, Aschkali und Kosovo- Ägypter http://www.gfbv.de/voelker/europa/kosovo/kos_ethn.ht.

[178] http://www.balkanaegypter.de/einfuehrung.html.

dëshmonte se liderë të romëve do të kenë vrarë shqiptarë ose që shtëpive të tyre t'ua kenë vënë flakën. Një sjellje e këtillë (e UÇK-ës) është në kundërthënie me traditat e popullit të romëve. Po aq e besueshme është edhe rrethana se romët, nën kërcënimet e serbëve se do t'ua marrin jetën, kanë marrë pjesë (si të detyruar) bashkë me serbët në plaçkitjet nëpër shtëpitë e shqiptarëve.

Bashkëpunimi i pandehur nga shqiptarët i romëve me kriminelë serbë të luftës jepet si arsyetim i dëbimit dhe i plaçkitjeve të shtëpive të romëve e të hashkalinjve nga ana e shqiptarëve. Edhe nëse ka pasur një bashkëpunim të romëve me njësitë serbe të çfarëdo formacioni të kishin qenë ato - bashkëpunim që duhet të dëshmohet - nuk mund të merret ashtu që për shkak të veprave të personave romë të ndërmerren pogrome kundër një grupi të tërë etnik. Është e pamundshme që i tërë populli (sic!) rom të ketë marrë pjesë në masakrat që i bënë serbët. Por secili individ nga populli (sic!) rom i cili ka bërë vepër krimi, duhet të japë përgjegjësi për atë. Nga ana tjetër, ka mundësi që ky fajësim për kolaborim kolektiv të romëve të jetë vetëm një arsyetim për qëllimin final që njëherë e përgjithmonë të hiqen qafe "të zinjtë" por edhe që disa të pasurohen"[179] - thuhet në një raport. Pasojë e hakmarrjes së kosovarëve ndaj romëve, hashkalinjve e "egjiptasve" është - konstatohet më tej në raport - se "Që nga fundi i luftës në Kosovë rreth 70.000 "egjiptas", nga ekstremistë shqiptarë që e kanë për synim një shtet të pastër etnik të Kosovës, janë dëbuar, vrarë apo janë marrë nga shtëpitë e tyre dhe nuk janë kthyer më kurrë".[180]

Sipas të dhënave të Shoqatës për Mbrojtjen e Popujve të Rrezikuar, një e katërta e shtëpive të banimit në 27 vendbanime të magjupëve në Kosovë qenkan djegur apo rrënuar nga shqiptarët në shenj hakmarrjeje.[181]

Përkitazi me pasojat e hakmarrjes apo edhe të motiveve të tjera të kosovarëve, të pandehura nga kjo shoqatë, ndaj romëve, hashkalinjve e "egjiptasve" në raporte të kësaj shoqate thuhet edhe se p.sh. nga 1500 persona romë sa kishte më parë p.sh. qyteti i Vushtrrisë, sot nuk gjendet më asnjë. Nga përafërsisht 300 shtëpi banimi të tyre, rreth 250 sosh janë rrënuar plotësisht.[182] Në raporte të kësaj natyre thuhet se rreth 14.000 shtëpive të romëve, hashkalinjve dhe të egjiptasve kosovarë iu vu zjarri.

---

[179] Po aty.

[180] Nicolaus von Holtey: Plattform für ehrenamtliche Hilfe in der Region Rhein – Neckar: Projekt des Heidelberger Shalomdiakons në www.hilfe-hd.de /kosovo/ Plattform für ehrenamtliche Hilfe in der Region Rhein - Neckar: Projekt des Heidelberger Shalomdiakons Nicolaus von Holtey në www.hilfe-hd.de /kosovo/

[181] Po ai, po aty.

[182] Anelore Hermes, Referentin m Bundesbüro der GfbV (Göttingen):: Sinti und Roma, Basisfakten und Überblick, http://www.gfbv.de/voelker/europa/roma.

Nga një i ngarkuar nga Shoqata për Popujt e Rrezikuar u trajtuan 74 nga 314 vendbanime plotësisht të shkatërruara të këtyre grupeve etnike".[183] ndërsa në dy raporte të tjera thuhet p.sh. se "Në Kosovë kanë mbetur sot vetëm rreth 35.000 nga 150.000 romë, hashkali e egjiptas – sa kishte më parë" [...] Nga 2.000 shtëpi të romëve në këmbë mbetën vetëm 40. [...] Nga 800 shtëpi të romëve në Gjilan pa u rrënuar mbetën vetëm 99 dhe në to jetojnë sot serbë e shqiptarë [...]"[184] dhe [...] Lagjja e romëve të Gjilanit gjendet në qendër të qytetit. Nga 6.000 romë sa kishte ktyneherë, në këtë qytet kanë mbetur vetëm 400 sish. Janë shkatërruar 159 shtëpi, 59 nga ato plotësisht. [...] Përbërja etnike e Obiliqit ishte para luftës 90% serbe e rome. Tani 99% e popullatës është shqiptare. Vetëm 36 nga 160 familje janë evidentuar në programin për rikthim".[185]

Sipas raporteve të organizatave joqeveritare, romë e hashkali të dëmtuar në Kosovë në mënyra të ndryshme kishte në Bërnicë, Bresje, Brestovc (?), Dobratin, Dobranjë e Madhe, Doshevc, Fushë-Kosovë, Golesh, Han i Elezit, Klinë ("Para luftës, në këtë qytet kishte 1625 qytetarë hashkali. Pjesa dërmuese e hashkalinjve e vujti represonin serb për shkak se politikisht ishin në anën e shqiptarëve. Rreth 300 shtëpi banoheshin nga hashkalinjtë. Nga pjesa e hashkalinjve e qytetit kanë mbetur tani vetëm rreth 50 shtëpi", Kollubarska (?), Landovicë, Lipjan, Magure, Malishevë, Medvec, Mitrovicë, Obiliq, Piranë në rrethina të Prizrenit (nga 45 shtëpi me 300 banorë romë sa kishte para luftës, këtu paska mbetur vetëm 1), Plemetin, Podujevë, Pomozotin, Prishtinë, Qungur afër Pejës, Rahovec, Rasadnik afër Mitrovicës; Rudicë afër Klinës (40 shtëpi të romëve, të hashkalinjve janë djegur; gati të gjitha të tjerat kanë mbetur shkret. Banorët e tyre kanë ikur, pas gjithë gjasësh, në Mal të Zi), Skenderaj, Subotiq (?), Uji Kuq (Cërvenavodica), Vitomiricë, Vranidoll, Vushtrri ("Nga dikur më shumë se 1500 persona, në qytet nuk jeton më asnjë. Rreth 300 shtëpi janë shkretëruar me teshë e koteshë. Tradicionalisht, romët i dërgonin fëmijët në shkollën serbe"). Në regjionin e Klinës po jetuakan 90 romë, 300 hashkali e 600 egjiptas, ndërsa në regjionin e Pejës paskan mbetur midis 1.500 e 1.800 romë dhe 4.500 "egjiptas".

---

[183] Roma und Ashkalije im Kosovo (November 2001) *Ganz normaler Alltag?* Die Einsetzung einer internationalen Verwaltung (UNMIK).

[184] Kosovo, Makkedonien, Albanien, Montenegro, Serbien,. .. Aktuelle Situation von Roma-Flüchtlingen in Serbien und Kosovo, Landtag Nordrhein-Westfalen; Rüdiger Sagel MdL.

[185] Nicolaus von Holtey Plattform für ehrenamtliche Hilfe in der Region Rhein – Neckar: Projekt des Heidelberger Shalomdiakons në http//www.hilfe-hd./kosovo/.

17. HIMNI I ROMËVE[186] NË GJUHËN ROMANE

Gelem, Gelem
Gelem, gelem, lungone dromensar
maladilem baxtale Rromensar
Ah, Rroma!len kotar tumen aven?
E caxrensar bokhale çhavensar?
R.: Ah, ah, Rroma!len, ah, ah, çhava!len.
Sàsa vi man bari familia
murdardas la i kali lègia
saren çhindas, vi Rromen vi Rromnien,
vi cikne çhavorren

Putar Devl!a te kale udara
te šaj dikhav kaj si me manuša.
Palem ka dzav lungone dromensar
te ka phirav baxtale Rromensar.
Opre Roma, isi vaxt akana
Ušten sa e sundaleske Rroma.
O kalo muj ta e kale jakha
Kamava len sar e kale drakha.

Përkthimi në shqip

Shtigje të gjata kalova
dhe romë të lumtur takova
Ah ju romë, prej kah vini ju?
Me çadrat tuaja, me fëmijët tuaj të uritur?

R.(refren): Ah, ah, ju romë! Ah, ah ju burra të rinj

Familje të madhe kisha unë dikur
legjioni i zi ma shoi atë.
Ata të gjithë i mbytën, burra e gra
e bashkë me ta madje edhe fëmijët e njomë.

[186] http://hlc.unimelb.edu.au/CALL/German/sintiroma.html Roma/Kosovo-Hilfe - Unterstützen Sie das Projekt des Heidelberger Shalomdiakons. Teksti sipas Marcel Courthiade, Fundcioni Romani Raxt, Tirana; marrë nga Plattform fürehrenamtliche Hilfe in der Region Rhein-Neckar: Projekt des Heidelberger Shalomdiakons Nicolaus von Hotley në http//www.hilfe-hd./Kosovo

Hapi o Zot portat e tua të zeza
që të mund të shoh ku i kam të mitë.
Shtigjeve të gjata do të shkoj sërish
dhe me romë të lumtur do të shtegtoj unë

Zgjohuni romë, tani është koha ngrihuni ju,
ju romë të të gjithë botës
Ato fytyra të rreshk'ta dhe ata sy të zinj unë i dua ata,
i dua si rrushin e zi.

Teksti i këtij himni, bashkë me flamurin për romët u aprovua në kongresin e parë të romëve të mbajtur më 8 prill të vitit vitin 1971. Data 8 prill u shpall për Dita Ndërkombëtare e Romëve. Mesazhi i kësaj dite është "Paqe për të gjithë romët në një botë pa diskriminim, pa racizëm dhe pa luftë."

18. PËRFUNDIM

Filologjia shqiptare e veçmas gjuhësia dhe historia shqiptare nuk e shtruan ndonjëherë për temë që do zgjidhje, zbardhjen e prejardhjes, gjuhës e të jetës shpirtërore të minoritetit rom. Duket se arsyeja për mosmarrjen me këtë temë ishte pse minoriteti rom në Shqipëri e sidomos në Kosovë ishte shqiptarizuar në tërësi. Ky element nuk konsiderohej për i vdekur, sepse ishte dhe është fizikisht i pranishëm dhe dallohet nga shqiptarët vetëm nga tipare fizike, përkatësisht të ngjyrës së lëkurës dhe të pozitës sociale. Ndodhi kështu mbase në harmoni me paravendimin se asimilimi i një populli përfundon me të humbur të gjuhës, që është e barabartë me vdekjen e gjuhës e cila ndodh (ashtu sikundër është rasti me shumicën absolute të hashkalinjve të Kosovës) kur grupi etnik heq dorë kolektivisht nga gjuha e tij dhe pajtohet me atë humbje. Dhe me romët e hapësirës gjuhësore të shqipes ndodhi ky fenomen. Për aq sa dihet deri më sot nga historia e popullit shqiptar, shqiptarizimi i elementit rom është bërë pa dhunë institucionale të cilën shqiptarët nuk e patën tani e disa shekuj më parë.

Ardhësit romë në Kosovë e humbën pra elementin kardinal të identitetit nacional - gjuhën. Nëse nisemi jo nga ndonjë teori, por thjesht nga përvoja jetësore e secilit individ se atdheu është në të vërtetë jo gjeografia (mali, lumi, arat), por gjuha, njerëzit, ambienti gjuhën e të cilit e kupton dhe me të cilën komunikon e prandaj edhe e identifikon veten me të, atëherë sikur mbetet e pakuptueshme se si mund të realizohet

deviza e ideologëve karrieristë "egjiptas" se "Në zhvillimin e demokracisë, rindërtimin e vendit dhe në jetën kulturore e shoqërore të Kosovës duam të inkuadrohemi me identitetin tonë të vërtetë" - "egjiptas"? Si do të realizohet ky inkuadrim me epitetin "egjiptas" të romëve kaherë të shqiptarizuar, të cilëve do t'u mungonte toka nën këmbë: atdheu? "Egjiptasit" e Kosovës nuk mund të teatrojnë sikur të ishin p.sh. hebrenj të Baribaxhanit të Rusisë, që s'dinë të flasin hebraisht dhe, sado të vendosur në Izrael, ndjehen dhe trajtohen për të huaj?. Ndryshe nuk e di si mund të kuptohet, si mund të arsyetohet e të mbështetet distancimi i këtyre farë "egjiptasve" nga hashkalinjtë shqipfolës të Kosovës dhe (historikisht) nga sivëllezërit romë që e kanë ruajtur dhe e flasin gjuhën rómani - qofshin ata edhe folës gjuhësh të tjera që - si edhe "egjiptasit" - i kanë marrë qoftë për gjuhë të "prestigjit" apo për "amtare"?

Por zhvillimi i ngjarjeve në këto 30 vitet e shkuara sikur e demantoi këtë "ligj" të natyrës. Iniciator i këtij demanti nuk ishte e nuk është ndonjë ndërgjegjësim i natyrshëm për përkatësinë etnike nga vetë grupi etnik, por e cytur nga jashtë. Qëllimi ishte që duke e paraqitur Kosovën si vend të gjithkujt e të askujt, përveç se të Serbisë; si vend në të cilin ka gjithfarë popujsh, të drejtat prej minoritetesh të të cilëve duhet dhe mund t'i ruajë vetëm Serbia. Nuk është e rastit që ka shkrime në të cilat numërohen: "shqiparët e Kosovës, romët e Kosovës, hashkalinjtë e Kosovës, hebrenjtë e Kosovës, egjiptianët e Kosovës, goranët e Kosovës, boshnjakët e Kosovës, turqit e Kosovës, kroatët e Kosovës"[*] - edhe nëse ka midis këtyre grupe etnike pjesëtarët e të cilëve arrijnë në disa dhjetëra. Duket se sipas këtij modeli po veprohet me favorizimin e elementit aromun në Maqedoni e në Shqipëri, qëllimi final i të cilit mund të jetë dobësimi i pozitës së shqiptarëve në Maqedoni.

Kështu u ndërmorën masa drejt "serbizimit" të minoritetit të goranëve sllavishtfolës të cilët mund të jenë vlleh, bullgarë, pomakë e gjithçka tjetër, por kurrsesi serbë apo boshnjakë. Më shumë sukses pati kjo ndërmarrje me përçarjen e grupit etnik të hashkalinjve të cilët jo vetëm janë shqipfolës, por edhe e ndjejnë veten shqiptarë. Me inicimin e Beogradit dhe me përkrahjen e tij të paarsyeshme politike e madje edhe diplomatike u krijua grupi etnik i "egjiptasve". Ka gjasë që të vetëdeklaruarit për "egjiptas" mund ta kenë përqafuar këtë emër të ri e "prejardhje" të re më shumë për arsye sociale e psikoloogjike se sa për shkak të "argumenteve" me të cilat mund të mbështetet origjina "egjiptase" e tyre. Mirëpo, rrethana që kjo "tezë" e formuluar me shkrim nga një etnolog dhe e propaguar verbërisht nga "egjiptas" në Kosovë e në Perëndim të Europës

[*] khs. psh. http://www.politikforum.de/forum/skowthread.php?threadid=9654

u përqafua symbylltas nga organizata joqeveritare pa kompetenca në fushën e filologjisë, siç është p.sh. rasti me Shoqatën për Mbrojtjen e Popujve të Rrezikuar me seli në Heidelberg, e bën të nevojshëm konfrontimin e kësaj "teze" me rezultatet kompetente të dijetarëve europianë të gjuhësisë e të historisë. Kërkimet në fushën e gjuhësisë indoeuropiane, përkatësisht studimeve lidhur me vendin e gjuhës së romëve në rrethin e gjuhëve indoeuropiane; me historinë e vetë gjuhës së romëve dhe me studimet me karakter historik e dëshmojnë të përkundërtën.

Atdheu origjinar i të gjitha grupeve të romëve është India. Romët nuk dëshmohen historikisht në asnjë kohë në Egjipt, sepse në këtë vend nuk është vendosur ndonjëherë ndonjë grup romësh që ishte larguar nga atdheu i vet i kryehershëm, India. Kjo vërtetohet edhe nga rrethana se në asnjë variante të gjuhës rómani nuk ka asnjë huazim nga gjuhët arabe. Gjuha rómani është gjuhë indoeuropiane, bijë e sanskritishtes nga e cila i ka trashëguar 700 fjalë, ndërsa arabishtja është gjuhë semitike. Përkundrazi, në gjuhën rómani ka 70 fjalë persishte, sepse Persia ishte vendi i parë i dyndjes së romëve si krah pune apo për shkak se ishin dëbuar nga India. Edhe shtegtimet e romëve në Azinë e Mesme në hapësirën gjuhësore të armenishtes, përkatësisht në Anatolinë Perëndimore kanë lënë gjurmë në leksikun e gjuhës rómani në të cilën ka 40 fjalë nga armenishtja dhe janë me rëndësi të veçantë për historinë e romëve dhe për historinë e gjuhës rómani. Këtu, si pasojë e kontakteve me sektin e Atsiganëve, romët e morën mbase për vete edhe emrin e këtij sekti dhe nga ky rrjedh emri më i përhapur në gjithë Europën *cigan* i këtij grupi etnik. Romët do të kenë qëndruar në Azinë e Vogël për kohë të gjatë, sepse këtu ka ndodhur edhe bigëzimi i gjuhës rómani në dy grupe. Vazhdimi i shtegtimit të romëve nga kjo pjesë e Bizantit ka ndodhur para shek. XI, para ardhjes së selxhukëve, sepse në gjuhën rómani nuk ka huazime nga turqishtja, përkatësisht osmanishtja e asaj kohe. Nga Azia e Vogël romët kaluan në Greqi. Atje, në ishullin e Kretës e në atë Gype të Peloponezit dëshmohen në vitin 1322 si banorë të një kolonie rome. Kjo koloni identifikohet në të vërtetë me vendin Modon (sot Methoni) të Peloponezit. Sado që nuk ka ndonjë shënim nëse vendi Gype, përkatësisht kolonia rome mund të jetë quajtur "Egjipti i Vogël" (ashtu siç ka ndodhur gjatë historisë që një pjesë e Greqisë të quhet Megalovlahia "Vllahia e Madhe") ata që duan ta krijojnë një etni "egjiptase" dhe atë vetëm në viset e banuara me shqiptarë! e keqinterpretuan këtë dhe e marrin për "argument" se romët na qenkan të ardhur nga Egjipti. Të gjithë filologët e mirëfilltë europianë janë të bindur se: "Emri i dytë rrjedh nga "Egjipti i Vogël". Romët e parë në Europë u paraqitën pothuajse përherë

si pelegrinë e pendestarë nga Egjipti i Vogël, i cili (vend) nga kronistët u ngatërrua me Egjiptin e "vërtetë". Mirëpo për "Egjipti i Vogël" duhet të shihet në të vërtetë kolonia e madhe e romëve *Gype* afër Modon-it, sot Methoni, ose i gjithë Peloponezi" - thonë këta.

Ky ngatërrim ndodhi konkretisht edhe në Spanjën e shek. XV kur një tufë romësh që donin të zinin vend atje u paraqitën rrejshëm si pelegrinë e pendestarë nga "Egjipti i Vogël" dhe mbreti Alfonsi IV i Aragonës i lejoi të vendoseshin nëpër Spanjë. Të prirë nga kjo gënjeshtër, spanjolët e quajtën këtë popullatë ndonjëherë edhe *egipcianos*, përkrah emrave të tjerë *gitanos*, *griegos*, *zincalés*, *bohemios*, *húngaros*, *faraones* që i kishin në përdorim.

Greqia konsiderohet me të drejtë atdheu europian i romëve. Kjo dëshmohet në bazë të numrit të madh përkatësisht 230 fjalëve me origjinë nga greqishtja e mesme, përkatësisht bizantinishtja e shek. X në gjuhën *rómani*. Sa i madh ishte ndikimi i greqishtes së mesme mbi gjuhën e romëve shihet edhe nga fakti se në gjuhën e kësaj etnie për pesë numërorë themelorë nuk ka leksema sanskrite, përkatësisht indase, por vetëm leksema greke.

As në atdheun e kryehershëm dhe askund në Europë nga rreth 60 nëngrupe romësh dhe 13 variante të dialekteve të gjuhës së tyre as nuk dëshmohet e as nuk ekziston ndonjë grup i quajtur as hashkali e as "egjiptas" apo ndonjë variant, dialekt që do të kishte qenë i hashkalinjve apo i "egjiptasve". Së këndejmi do të shtrohej pyetja si u bë që hashkali e "egjiptas" ka sot vetëm në Kosovë dhe në hapësirën gjuhësore të shqipes në Maqedoni. Këtu "egjiptianët" "mbinë" ose ndoshta më mirë të thuash u shfaqën para pak më shumë se nja dhjetë vitesh" - thotë studiuesi Benninghaus,[187] ndërsa një njohës i mirë i problemit rom konstatonte se "Duket se deklarimi për si pjesëtarë të grupit të të ashtuquajturve "egjiptas", të cilët në regjistrimin e fundit dalin si grup i veçantë, do të duhej, midis të tjerash, të jetë formuar nga motive antishqiptare".

Emra të këtillë nuk ndeshen as në osmanishten, turqishten ku do të pritej të depërtonte si emër etnik midis popujve që ranë nën sundimin e tyre. Edhe vetë prejardhja e termit hashkali/hashkanli mbetet për mua e paqartë, sepse askund në literaturë nuk përmendet ndonjë grup romësh i vendosur në një krahinë Hashk/ Ashk të Persisë, siç sqarohet gojarisht emri i hashkalinjve.

[187] Rüdiger Benninghaus: Roma Gruppen in Mazedonien und im Kosovo; http://koelner-fluechtlingsrat.de/nachrichten/0700.doc.

Arsyetimi i krijimit të etnisë së re "egjiptase" vetëm në Kosovë e në viset e banuara me shqiptarë në Maqedoni, origjina e mirëfilltë e të cilëve është India, me një "histori" të konstruktuar duke e lidhur prejardhjen e tyre që në shek. III para erës sonë me ekspeditat e Lekës së Madh është sa e pambështetur, aq edhe fantastike - për të mos thënë qesharake. Shpikësit e kësaj etnie të re shkuan aq larg sa për ngulitjen e kësaj krijese të re gjetën edhe "argumente" antropologjike. Kështu, në një lloj peticioni që Qerim Abazi, përfaqësues i Bashkësisë Etnike të Egjiptasve të Kosovës ua dërgonte më 25 nëntor 1999 organizatave ndërkombëtare thuhet se "Ç'është e drejta, egjiptasit dhe romët janë me të vërtetë lëkurëzinj, por dallohen në aspektin antropogjik: Egjiptasit janë brahocefalë, ndërsa romët janë dolihocefalë, gjë që do të thotë se egjiptasit dhe romët dallohen për nga fizionomia". Ky mendim i formuluar pak më ndryshe: "Egjytasit nuk duan të identifikohen me grupet etnike me ngjyrë, përkatësisht me romët" u përsëdyt kah fundi i vitit 2003 nga drejtues të partisë së "egjiptasve" të Kosovës.

As mbështetja e dëshirueshme tek kuptimi i supozuar "egjiptas" i vetëm dy (*magjup* var. *magjyp* e *evgjit*) nga më shumë emra e variante me të cilat shqiptarët i emërtojnë romët nuk qëndron në këmbë të forta. Sqarimi i emrit *magjup* si një formim me parashtesën *ma-* nga emri greqisht *Aogyptius* i Egjiptit nuk mund të merret për i bindshëm sa kohë që, nëse me këtë parashtesë në shqipen mund të formohen edhe emra e mbiemra, mund të merret për e mundshme që një kësi emri të jetë formuar më parë nga emri *Gypte* i kolonisë së dëshmuar më 1322 të romëve (jo porse e "egjiptasve") në Peloponez prej nga pastaj romët u përhapën në gjithë Europën. As për variantin *evgjit* Çabej nuk thotë se ka ndonjë lidhje me emrin e Egjiptit, por thotë vetëm se kjo fjalë në shqipen e Greqisë e ka kuptimin "kovaç" si edhe variantet e tjera që ndeshen në krahina të ndryshme të Shqipërisë. Së këndejmi, as mbështetja tek i madhi Sami Frashëri (i cili, megjithatë nuk është i pagabueshëm, sidomos kur bëhet fjalë për tematika kaq të pështjelluara) i cili paska menduar (fundja aspak më ndryshe nga kolegët e tij të Europës Perëndimore - përkrahës të iluminizmit) se evgjitët (magjupët) paskan "origjinë nga shteti i lashtë i Egjiptit", të cilin ky e quan evgjiteri (Misir),[188] nuk ndihmon gjë në të mirë të kërkimit të mbrojtjes së një teze false si i mbyturi i kapur për fije kashte. Bile mund të them me keqardhje që dija shqiptare e filologjisë s'ka sjellë gjë të re përkitazi me problemin e prejardhjes, gjuhës dhe jetës sociale të magjupëve. Kjo dije vetëm i ka ripërtypur

[188] Sipas Xhevdet Neziraj: Kush janë egjiptianët e Kosovës?, "Koha Ditore", 13 nëntor 2003.

rezultatet e dijes europerëndimore, prandaj edhe mbështetja mbi to është mbështetje mbi një lajthitje që dija europerëndimore e ka korrigjuar kaherë. Së këndejmi, përballë rezultateve të sjella nga njohës kompetentë të gjuhësisë indoeuropiane dhe të gjuhës, jetës sociale e dokeve e zakoneve të romëve në Europë e në Ballkan, pohimet e ndonjë etnografi të Shqipërisë (Zija Shkodra), të ndonjë historiani kosovar (Skender Rizaj) apo edhe të tjerëve që në Tryezën / Simpoziumin e mbajtur në Prishtinë mbi prejardhjen e "egjiptasve" e "vulosën" prejardhjen nga Egjipti të hashkalinjve të deridjeshëm, nuk çojnë peshë në kandarin e dijes së papolitizuar mbi historinë e romëve në përgjithësi dhe të atyre në Ballkan e në hapësirën gjuhësore të shqipes në veçanti.

Në të mirë të origjinës nga Egjipti të romëve "egjiptas" nuk flasin as variantet anglosaksone *Gypsy*, as ajo frenge *Gitans*, spanjole *Gitanos*, sepse në asnjërën në këto gjuhë emri i romëve nuk vehet në lidhje me Egjiptin, por e kanë kuptimin thjesht "magjup", përkatësisht rom. Nëse ndokund do të duhej të ruhej dëshmia apo kujtimi i ardhjes nga Egjipti të romëve, atëherë kjo është Greqia, atdheu europian i romëve. Mirëpo emri grek për romët është sot *Asingan*/*Athingani*. Dhe s'ka pse të mos besohet që ky emër nuk mund të ndahet mbase nga emri *Atsingani*/*Adsinkani*, *Athinganoi* i sektit të Frigisë - emri i të cilëve e kishte kuptimin "që s'bën të preket" - me të cilin romët në shtegtim kishin rënë në kontakt para shekullit 11. Ka shumë mundësi që me ndryshim kuptimi nga emri i Atsiganëve rrjedh edhe emri i përgjithshëm *cigan* në kuptimin "farkëtar, kovaç" për të gjitha grupet e romëve. As variantet bullgare A*gupi*/*Agjupti* nuk kanë të bëjnë me Egjiptin, porse janë forma të emrit të regjionit *Gype* të kolonisë së romëve në Greqi, ashtu sikundër edhe variantet (bullgare) *Kepti*, *Kypti* (të cilat "kumbarët" e "egjiptianëve" të Kosovës i krahasojnë me emrin e popullatës së Koptëve të Egjiptit) s'janë tjetër veçse variante të emrit *Gypte* të Greqisë. As mbështetja tek emri i përdorur sporadikisht dhe shumë rrallë në zona territorialisht të vogla *firaun* nuk ndihmon gjë për ta mbështetur prejardhjen nga Egjipti të asaj pjese të hashkalinjve të Kosovës që preferojnë ta quajnë veten "egjiptas", sepse fjala me origjinë arabe *firaun* nuk do të thotë "egjiptas", por vetëm "magjup; "magjupçe; inatxhi, i paedukatë" që në Ballkan ka hyrë me ndërmjetësimin e turqshtes ku fjala *firavun* (nga arab. fira:wn) "faraon" - sikundër e tregon substantivi boshnjak *firaùnluk* nuk ka të bëjë më me faraonin e me Egjiptin, por me "vepra të pamira; me magjupllëk".[189]

Po deshëm të bëhemi zhonglerë me etimlogji atëherë do të bënte të lejohej që sqarimit të emrit magjup do t'i ndihmonte ndoshta edhe emri

[189] Sh. Abdula Škaljić, Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku, Sarajevo, 1966, f. 28.

Gopti i njërit ndër fiset rome (bashkë me Gomana, Tamara e Kalderash) i cili, sipas R. Djurić "katërcipërisht e ka rajtur emrin e vet indas".[190] Në kombinacione të llojit çfarë janë bërë deri sot për ta arsyetuar kuptimin "egjiptas" të fjalëve *magjup* e *evgjit* të shqipes, emri *Gopt* do të ishte shumë i afërm me emrin Gypte të kolonisë së romëve në Peloponez. Pjesëtarë të fisit Gopti të romëve jetonin deri para fundit të Luftës së Dytë Botërore në Bosnje e në Kroaci, ndërsa gjatë asaj lufte u asgjësuan në kampin e përqendrimit Jasenovac të Kroacisë. E pra, nuk është thënë ndokund se këta do të kenë menduar se janë "egjiptas".

Pa marrë parasysh nëse emri më i përhapur etnik *magjup* në Kosovë rrjedh nga termi kishtar i bizantinishtes me kuptimn "bukëpjekës manastiri" apo do të jetë zhvillim nga emri Gypte i kolonisë rome mesjetare të Peloponezit, ky është termi më i përhapur ndër vetë romët e Kosovës, përkatësisht tek hashkalinjtë dhe tek pjesa e separuar e tyre "egjiptasit". Pas emrit të parë *hashkali* të shpikur disa vite para distinktivit të dytë *rom* dhe termit më të ri *"egjiptas"* të emrit etnik - që të tre emra librarë me prapavijë politike e socio-psikologjike për emrin e përgjithshëm *magjup* "bukëpjekës manastiri" i cili ndërkohë pothuajse në tërësi e ka humbur karakterin përbuzës që e kishte marrë në rrjedha të kohës, është shkelur me të dyja këmbët mbi të vërtetën që rrjedh nga rezultatet e dijes filologjike.

Kjo mbase për arsye se shumica e atyre që deri tani kanë shkruar rreth "problemit" të "egjiptasve" të Kosovës janë punëtorë profilesh të ndryshme të shkencave shoqërore të inkuadruar rreth Shoqatës për Popujt e Rrezikuar (Göttingen), nëpër shoqata humanitare kishtare e organaizata joqeveritare të tjera. jo porse p.sh. linguistë e aq më pak psh. indologë apo egjiptologë. "Fryt" i këtij angazhimi është internacionalizimi i një të pavërtete historike për gjoja ekzistimin e një etnie "egjiptasish" vetëm në Kosovë e në pjesët e hapësirës gjuhësore të shqipes në Maqedoni. Përsa i bie anës historike, filologjike të problemit, shkrimet e pakompetencë të punëtorëve të tillë e injoruan konstatimin e bindshëm pikërisht nga filologë gjermanë se në mesjetën e vonë emri i kolonisë *Gype*/*Gyppe* që qenka quajtur edhe "Egjipti i Vogël" të romëve në Greqi, përkatësisht në Peloponez u identifikua gabimisht me Egjiptin e mirëfilltë dhe se këtij identifikimi i kishte ndihmuar atëherë

[190] Sh. Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm. Emri tjetër (i mirëfilltë?) i Goptëve ishte Slivčari ("gardhthurës"; në Slloveni e në Italinë Veriore quheshin edhe istrianë "të Istrias".

edhe paraqitja rrejshëm e romëve gjithandej si pelegrinë e pendestarë nga "Egjipti". Kjo dëshmohet bindshëm me faktin që në gjuhën *romané* nuk ka asnjë fjalë arabe (më gjerësisht sh. më lart). Nga aspekti praktik e politik, shkrimet e kësaj natyre i ndihmuan legjitimimit të një krijese artificiale të etnisë "egjiptase" në Kosovë -embironi i së cilës është politika serbe dhe karrierizmi i disa hashkalinjve.

Politika e lansuar nga regjimi serb i Milosheviqit po vazhdon edhe sot përmes gojës së Partisë së Egjiptianëve të Kosovës (IRDK). Kjo parti deklaron se "Në zhvillimin e demokracisë, rindërtimin e vendit dhe në jetën kulturore e shoqërore të Kosovës duam të inkuadrohemi me identitetin tonë të vërtetë", përkatësisht si "egjiptianë". Për ta betonuar këtë projekt, në një mbledhje të kësaj partie "është marrë vendim që të organizohet një simpozium shkencor, i cili për temë diskutimi do të kishte çështjen e prejardhjes dhe identitetin etnik e kulturor të egjiptianëve. Në këtë takim qenë të pranishëm edhe përfaqësues të degëve të IRDK-së në Zvicër e Gjermani, zotërinjtë: Çelë Kikaj dhe Abdurrahman Ramadani, të cilët e kanë konfirmuar përkrahjen e mërgimtarëve egjiptianë për një simpozium të tillë. Ata kanë sjellë nga diaspora egjiptiane në Zvicër e Gjermani 10.000 euro për simpozium". Dhe, i kënaqur me rezultatet e simpoziumit, Bislim Hoti, kryetar i IRDK-së e anëtar i Parlamentit të Kosovës deklaronte se "Tezat për prejardhjen e këtij komuniteti nga Egjipti kanë mbeshtetje në shkencen e historisë, të gjuhësisë dhe të etnografisë dhe se ato teza i kanë mbeshtetur edhe historianë të shquar, si Bujar Dugolli, Skender Riza, Rexhep Ismajli, Hakif Bajrami, Jahja Drançolli, Maliq Osi, etj". Tryeza e paska dëshmuar se "egjiptianët" qenkan grup etnik që banonte në Kosovë para pushtimit të saj nga turqit dhe se për gjuhë amtare e kanë shqipen. Në këtë simpozium u dëgjua edhe propozimi sipas të cilit emri magjup bën të zëvendësohet me emrin egjiptas në pikpamje etnike, kurse në pikpamje kombëtare, me emnin shiptarë, sepse komb egjiptas nuk ekziston askund në botë e as në Egjipt, as egjiptianët e Egjiptit nuk janë me komb egjiptas, por janë arabë, sepse gjuha dhe kultura e tyre është arabishtja.[191]

19. MATERIALE

I. Teksti integral i letrës së dërguar më 25 nëntor 1999 z. Jir Dinstbier nga z. Qerim Abazi, përfaqësues i egjiptasve të Kosovës dhe sekretar i Lidhjes së Egjiptasve të Kosovës.[192]

[191] "Koha ditore", 7 dhjetor, 2003.

[192] shih http:// www bndlg.de/wplaarre/aegypter =1. htm.

Zonja e zotërinj të nderuar,

Duke e pasur parasysh vlugun e madh të të arratisurve të egjiptasve të Jugosllavisë nga Kosova, vendi i tyre, po Ju drejtohemi me shkrim që t'Ju njoftojmë me këtë realitet të përbërjes demografike të banorëve të Kosovës. Unë dëshiroj t'Ju njoftoj në këtë mes hollësisht përkitazi me këtë bashkësi etnike dhe me problemet e saj.

Kosova është një bashkësi multietnike, ku bashkë me bashkësitë e tjera etnike jeton edhe bashkësia etnike e egjiptasve, pra bashkësia etnike e egjiptasve, shtetase e Jugosllavisë, që e heq prejardhjen nga egjiptasit e antikës. Këta qytetarë u vendosën në Ballkan gjatë më shumë migrimeve përgjatë historisë së tyre.

Kjo bashkësi u përpoq për kohë të gjatë të organaizohej si grup i veçantë etnik, gjë që e arriti pjesërisht në vitin 1970 dhe, në kuadrin e proceseve demokratike të vitit 1990 e arriti plotësisht. Kësokohe, ky grup e formoi shoqatën e vet për ta ruajtur identitetin e vet etnik.

Bashkësia etnike e egjiptasve është një etnikum më vete përbrenda hapësirës ku jeton dhe nuk i takon asnjërës nga bashkësitë me të cilat për shumë shekuj bashkëjeton. Sado që kjo bashkësi flet shqip, e cila njëkohësisht është gjuhë amëtare e saj dhe që u shtrëngua domosdo të deklarohej për shqiptare, intimisht nuk e ndjen veten për të këtillë (S.G. për shqiptare), porse për egjiptase. Para Luftës kjo bashkësi kishte më shumë se 100 000 njerëz, të cilët gjuhën e rrethit e bënë për gjuhë të tyre amëtare.

Për pasojë të mungesës së njohurive historiografike, të lidhura me dyndjen e egjiptasve, këta të fundit identifikohen nga shumë njerëz me romët. Lidhur me këtë identifikim, në Shqipëri u mbajt një seminar me temën "Bashkëjetesa e bashkësisë etnike të egjyyptasve në Shqipëri", në të cilin folën shkencëtarë vendës e të huaj dhe i konstatuan me mbështetje shkencore dallimet e mëposhtme midis egjiptasve dhe romëve:

Egjiptasit dhe romët janë dy bashkësi me kultura të ndryshme dhe me dy etnogjeneza krejt të ndryshme; këta egjiptas janë pasardhës të egjiptasve antikë, ndërsa romët e kanë prejardhjen nga India;

Në Ballkan, egjiptasit përmenden qysh në kohën e Lekës së Madh (324 p. Kr.), por edhe në kohën e Romës, të Bizantit dhe të Perandorisë Osmane, ndërsa romët erdhën në Ballkan në shek. XIV. Shumë dijetarë besojnë që tani e 500 vite më parë në Egjipt nuk jetonte asnjë rom;

Ç'është e drejta, si egjiptasit ashtu edhe romët janë zeshkanë, mirëpo këta ndryshojnë njëri nga tjetri në aspektin antropologjik: Egjiptasit janë brahycefalë, ndërsa romët janë dolihocefalë, gjë që do të thotë se egjiptasit dhe romët dallohen për nga fizionomia;

Gjuha e egjiptasve u zhduk, prandaj egjipytasit e Ballkanit e muarrën gjuhën e ambientit ku jetonin. Edhe në Egjipt u pranua gjuha arabe, ndërsa romët e kanë gjuhën e vet amtare;

Një ndryshim është edhe ky që egjiptasit kosovarë nuk lidhin martesa të përziera as me pjesëtarë të bashkësisë shqiptare e as me atë të romëve;

Egjiptasit i kanë veçoritë e tyre kulturore e të tjera. Edhe doket e zakonet e tyre janë të tjera (feja, martesa, lindja etj.);

Egjiptasit janë të ndershëm, të vyeshëm dhe paqësorë, në të shumtën e herës të varfër dhe bukën e tyre të përditshme e fitojnë me djersë. Këta janë popullatë ndenjëtare dhe merren me bujqësi; shumica nga këta kanë mbaruar shkolla të mesme; më pak sish kanë diploma universiteti dhe merren me çështje të civilizuara;

Egjiptasit kanë aftësi adaptimi dhe respektojnë secilin, pa marrë parasysh prejardhjen etnike. Këta janë njerëz të ndershëm, të vyeshëm paqësorë dhe të respektuar nga ambientet ku jetojnë;

Egjiptasit dallohen edhe nga shqiptarët. Sado që këta (egjiptasit) e flasin të njëjtën gjuhë si edhe shqiptarët, egjiptasit nuk janë shqiptarë. Nga shqiptarët dallohen për nga ngjyra e lëkurës, kultura dhe për nga etnogjeneza. Dallime ka edhe në praktikën e martesave, në doke e në tradita si edhe në veçori të tjera.

Në përmbledhjen e punimeve përkitazi me egjiptasit në Ballkan prof. dr. Miodrag Hadžiristić (Maqedoni), shkruan se për egjiptasit në Ballkan ka distinktiva të ndryshëm: në Kosovë këta quhen "ashkali" ("qymyrxhinj"), në rrethina të Pejës e të Gjakovës i quajnë "egjupë" përkatësisht "magjupë", në Mal të Zi i quajnë "kovači", në Shqipëri "evxhitë". Kjo tregon se edhe emrat lokalë për egjiptasit e tregojnë prejardhjen e tyre nga egjiptasit antikë, gjë që në historinë e etnogjenezës është regjistruar me shembuj të shumtë.

Mimikëria etnike paraqitet nga shumë arsye, në të shumtën e rasteve për shkak të majorizimit ose të presioneve politike të sistemeve sunduese shoqërore ose për shkak të përkatësisë konfesionale. Kjo dukuri është më e theksuar sidomos tek ata popuj të Ballkanit të cilët jetuan në kuadër të perandorive të ndryshme, të Romës, të Bizantit dhe të asaj osmane, nënvizon prof. Hadžiristić.

Pjesëtarët e bashkësive etnike që, duke qenë popull pakicë, iu diktua mimikëria etnike u shtrënguan që ta kundërshtojnë lojalitetin e tyre kundrejt sistemit në pushtet dhe autoriteteve të ekstremistëve, të cilët punonin kundër këtyre sistemeve dhe autoriteteve. Prof. Hadžiristić thkson më tej se pjesëtarët e këtyre grupeve etnike jo vetëm u përndoqën dhe ju asgjësuan shtëpitë, kështu që u shtrënguan në eksodus, porse qenë edhe viktima të krimit që shkuan deri në gjenocid.

Njëkohësisht, me daljen në shesh të bashkësisë etnike të egjiptasve, në opinionin kosovar filluan mospajtime të ndryshme, të cilave ne nuk u kontribuuam as edhe një fije. Ne dëshironim vetëm ta ruanim identitetin tonë etnik, pa pas qenë harrën për thes ose vegël manipulimi për askend. Ne donim që të gjitha problemet të zgjidheshin në mënyrë paqësore.

Me të nënshkruar rë Rezolutës 1244 dhe marshimit të forcave të KFOR-it iu la vend bandave të ekstremistëve shqiptarë që të hakmerreshin mbi joshqiptarët, e pra edhe ndaj egjiptasve. E pse pra mbi egjiptasit? Ç'u kemi bërë ne atyre? Po ndodh ashtu sikur ne do të duhej ta paguajmë haraçin për të gjithë. Ne ishim qytetarë lojalë të këtij shteti dhe e respektonim kushtetutën dhe ligjet e tij. Ne nuk donim të konfrontoheshim me asnjërën nga bashkësitë etnike, sepse ne kultivonim marrëdhënie të mira fqinjësore. Bandat ekstremiste të shqiptarëve na rrahën, na keqtrajtuan, na përzunë e na plaçkitën ndërsa shtëpive tona ua vunë flakën. Pas këtyre erdhën spastrimet etnike, kështu që sot jashtë Kosovës jetojnë më shumë se 30 000 egjiptas - në Maqedoni, Mal të Zi, Serbinë Qendrore, Itali, Gjermani dhe në Zvicër.

Rreth njëmijë egjiptianë jetojnë bashkë me romët në një kamp strehimi nën tenda. UNHCR-i nuk ia doli t'i strehonte, siç kishte premtuar, në dhoma të ngrohta. E ndjejmë rëndë rrethanën që mediat e jashtme dhe qendrat televizive nuk e përmendin fare ekzistimin e këtij kampi në Krushevc afër Obiliqit e as që njoftojnë për problemet e këtij minoriteti. Po iu besua mjeteve të huaja të informimit, fitohet mbresa e gabueshme sikur në kampe të strehimit po u ndodhkan vetëm romët, gjë që nuk është e vërtetë.

Ka gjasë që egjiptasit janë lënë qëllimisht në këso gjendje të keqe në mënyrë që t'i detyrojnë të largohen nga Kosova siç ndodhi me nja njëmijë sish që u arratisën për në Maqedoni. Ekzodusi i tyre nuk u pengua nga KFOR-i; përkundrazi, ai u stimulua. Krejt pak egjiptianë mbetën në shtëpi të vetat, por nuk guxojnë të qarkullojnë lirshëm dhe jetojnë në njëfarë burgu shtëpiak.

Edhe më i vështirë u duket këtyre presioni që të deklarohen për "hashkali", jo porse për egjiptianë, siç e kumtuam qartazi dhe u organizuam në vitin 1990, ashtu sikundër ishte rasti në regjistrimin e popullsisë në kohën e proceseve demokratike. Nocioni "hashkali" është një nocion përçmues që për ne përdoret nga të tjerët. Këto presione e kanë për qëllim që ta rrënojnë identitetin etnik të egjiptasve. Në ditë tonat, në Kosovë mund të jetojnë vetëm "hashkalinjtë". Ata që deklarohen për egjiptas e kanë të vështirë të marrin ndihmë humanitare.

Presioni që ne të deklarohemi për "hashkali" pati jehonë edhe në diasporë. Për pasojë, edhe atje shumë sish nuk deklarohen për egjiptas, porse për "hashkali". Në vitin 1999 ne kishim mbledhur 20.000 nënshkrime dhe kërkonim nga qeveria që ta miratonte deklarimin tonë që neve që jetojmë të Kosovë të na lejohet deklarimi për egjiptas. Qeveria nuk kërkoi më shumë nënshkrime, porse e lejoi në vitin 1990 deklarimin tonë për egjiptas. Pjesëtarët e grupit tonë etnik në Kosovë janë të kënaqur me aktivitetin tonë. Kur ne e bëmë një regjistrim intern të popullsisë, mundëm të konstatonim se në Kosovë jetojnë më shumë se 100.000 egjiptas.

Përkitazi me gjendjen tonë të vështirë ne e informuam bashkësinë ndërkombëtare dhe OKB e cila e ka për obligim që ta sigurojë jo vetëm paqen, porse edhe sigurinë personale të të gjithëve, në mënyrë që pjesëtarët e dëbuar të kësaj bashkësie etnike të ktheheshin në shtëpi të vetat dhe t'i përtërinin vatrat e tyre shekullore dhe shtëpitë e tyre. Një numër i madh egjiptasish jetojnë në vende të Perëndimit dhe shtëpitë e tyre janë asgjësuar plotësisht. Po u kthyen sot, ata nuk do të kishin kulm mbi krye.

Së këndejmi APELOJMË dhe Ju lutemi të ushtroni ndikim tek bashkësia ndërkombëtare dhe tek OKB në mënyrë që UNMIK-u, në harmoni me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB, të krijojë kushte për një jetë në paqe e në siguri të të gjithë qytetarëve të Kosovës, e pra edhe për ne egjiptasit. Dëshirë e jona është që të mund t'ia nisim rindërtimit të shtëpive tona nga të cilat u dëbuam me të padrejtë, me pafytyrësi, me dhunë dhe nën fajësime të gabueshme.

Vetëm kështu bashkësia ndërkombëtare do të arrijë të ketë legjitimitet dhe objektivitet tek të gjithë qytetarët. Kështu, të gjithë egjiptasit e Kosovës do të ktheheshin vullnetarisht dhe do të jetonin edhe më tej në vatrat e tyre në Kosovë.

Me respekt të veçantë

Qerim Abazi, Përfaqësues i egjiptasve të Kosovës

dhe sekretar i Lidhjes së Egjiptasve të Kosovës

Prishtinë, 25 nëntor 1999

II. Letër e z. Qerim Abazi drejtuar më 28 Nëntor 1999 z. Jiri Dienstbier i dërguar i OKB për të drejtat e njeriut

KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB - NEW YORK[193]

Ne, përfaqësuesit e bashkësisë nacionale të egjiptasve të Kosovës iu drejtuam disa herë me shkrim krerëve udhëheqës të UNMIK-ut dhe KFOR-i në Prishtinë dhe iu lutëm këtyre për bisedime të drejtpërdrejta që këto instanca t'i njoftojmë me problemet e pjesës së bashkësisë sonë nacionale të mbetur në Kosovë, por kjo ofertë e jona nuk u jetësua.

Egjiptasit që jetojnë në Kosovë nuk janë të mbrojtur sa duhet. Këta nuk mund të qarkullojnë lirshëm dhe gjenden në njëfarë burgu shtëpiak. Jeta e tyre nuk mbrohet dhe nuk është e sigurt. Këta janë të shtrënguar që nën presione, në rrafshin e përkatësisë nacionale,

[193] shih http:// www bndlg.de/wplaarre/aegypter =1. htm

të deklarohen për "hashkalinj"; ky është një nocion përçmues lokal i të tjerëve për ne, sakohë që ne vetë e quajmë veten egjiptas, sepse në vitin 1990 ne u organizuam me këtë emër dhe për të këtillë u deklaruam edhe në regjistrimin e vitit 1991 që u mbajt në Kosovë. Egjiptasit nuk mund të marrin asnjë ndihmë humanitare e, së këndejmi, ekzistenca e tyre është e rrezikuar.

Për ta arritur dëbimin e pjesëtarëve (të bashkësisë sonë nacionale) bandat ekstremiste shqiptare aplikojnë forma nga më të ndryshmet të frikësimit, të keqtrajtimeve fizike dhe të mbytjes. Përkitazi me krimet më të reja për harkun kohor prej 15 deri më 30 nëntor 1999 mbi pjesëtarët e bashkësisë nacionale të egjiptasve ne mund të sjellim, sipas njoftimeve jozyrtare, shënimet e mëposhtme:

Në katundin Hallaç i Vogël të komunës së Lipjanit, është vrarë Idriz Sula me të birin,

Po në këtë katund në shtëpinë e egjiptasit u hodh një granatë dore. Ne porse nuk e dimë nëse pati të vrarë apo të plagosur.

Në Fushë-Kosovë u vra dhe u masakrua Asllan Osmani,

Blerim Hajolli nga Fushë-Kosova u rrëmbye dhe pas disa ditësh u gjet i vdekur,

Në Fushë-Kosovë, një i ri egjiptas i familjes Martezi u rrah keqas;

Në komunën e Vushtrrisë një granatë dore u hodh në lokalin privat të z. Avdush, si pasojë e së cilës u plagos një person,

Katundet Medvec, Hallaç i Vogël e Vrellë (komuna e Lipjanit) janë plotësisht të izoluara dhe tani e dy muaj nuk marrin kurrfarë ndihme humanitare,

Përkundër premtimeve që çështja e banimit e egjiptasve të zgjidhet sa më shpejt dhe që këta nga tendat e nga barakat të vendosen në lokale të ngrohta, nuk u zgjidh ende, as deri në ditë tonat. Ata egjiptas të cilët, pas dëbimit paraprak, u kthyen në shtëpitë e tyre, u detyruan që këto t'i braktisin rishtazi dhe të arratisen nga Kosova, në mënyrë që të mos bien viktima të terroristëve shqiptarë. Duke qenë se ne nuk kemi mundësi udhëtimi, nuk mund të sjellim ndonjë pasqyrë faktike nga terreni përkitazi me jetesën e bashkëqytetarëve tanë dhe të joshqiptarëve të tjerë që jetojnë në Kosovë.

Vrasjet shkaktuan tek egjiptasit pakënaqësi dhe revolta. Ne jemi të pakënaqur me misionin paqësor të OKB-së në Kosovë sepse, përkundër të gjitha sqarimeve se aty po mbretëruaka paqja dhe se qenka zvogëluar numri i vrasjeve, në të vërtetë po ndodh e përkundërta.

Nga strukturat drejtuese të UNMIK-ut e të KFOR-it ne kërkuam deri tani garanci për të gjitha bashkësitë etnike, sepse ne jemi të vetëdijshëm se nuk ka jetë pa bashkëjetesë. Në vend se të garantonte siguri për të gjithë qytetarët, KFOR-i e reduktoi misionin e vet në tolerimin e spastrimeve brutale etnike, të kidnapimeve, të vrasjeve dhe të shkatërrimit të plangut tonë.

Në dritën e gjithë këtyre të dhënave, ne kërkojmë vënien sa më të shpejtë në jetë të Rezolutës nr. 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në mënyrë që kësisoj të krijohen kushtet për një jetë në paqe e të sigurt të të gjithë qytetarëve të Kosovës si edhe të nisë ngritja dhe rindërtimi i shumë shtëpive të shkatërruara nga flakët e zjarrit, kështu që refugjatët të mund të hyjnë përsëri nëpër shtëpitë e tyre.

Me respekt të veçantë

Qerim Abazi,

Përfaqësues i Bashkësisë Nacionale të Egjiptasve të Kosovës

III. Artikull i botuar në gazetën Stuttgarter Zeitung të dt. 8 shkurt 2000, në emër të Shoqatës së Egjiptasve të Kosovës, me seli në Stockach të Gjermanisë.

"*Egjiptasit*" *në Ballkan - të injoruar e të ndjekur*

Nëntituj:

Një grup etnik pothuaj i panjohur lufton për identitet të vetin

Nga serbët të shtypur, nga shqiptarët të përzënë nga vendi

Njohja i ndihmon të kuptuarit

(?) Pararendësit tanë erdhën me ushtrinë e Lekës së Madh para më shumë se 2.000 vitesh nga Egjipti në vende të Ballkanit. Shkathtësia e pararendësve në fushën e mjeshtërive ishte e njohur dhe nga kalorësit, nga të cilët çmohej fort mbi të gjitha mjeshtëria e punimit të patkonjve.

(?) Shumë njerëz nga Egjipti u vendosën në Greqi, Maqedoni, në Kosovë e në vende të tjera; këta u bënë ndenjëtarë dhe me të shkuar të kohës i morën për të vetat gjuhët e vendeve në të cilat u ngulitën. Egjiptasit vendës të Kosovës e kanë ruajtur deri më sot kulturën dhe traditat e tyre dhe bashkëjetojnë në paqe me grupet e tjera etnike.

(?) Në krye të herës, në Kosovë jetonin rreth 200.000 egjiptas. Duke qenë se popullata shqiptare mund ta ruajë epërsinë numerike karshi popullatës sunduese serbe (rreth 10%) vetëm duke i "përfshirë" më vete të gjitha grupet etnike, jo të gjithë egjiptasit patën mundësi që, p.sh. në regjistrimin e popullsisë në vitin 1991 të mund ta deklaronin identitetin e tyre të mirëfilltë etnik.

(?) Që nga përfundimi i Luftës në Kosovë, nga shqiptarët ekstremistë të cilët e synojnë një shtet të pastër etnikisht shqiptar, u dëbuan, u vranë ose u morën dhe që atëherë janë të zhdukur rreth 70.000 egjiptas. Dhjetëra mijëra bashkatdhetarë tanë dhe sish të minoriteteve të tjera u strehuan, ç'është e drejta, në shtetet fqinje të Malit të Zi, Maqedonisë, të Bosnjës etj. por, për shkak të varfërisë së vetë këtyre vendeve, këta refugjatë jetojnë në një varfëri të paimagjinueshme. Dëbimet, vrasjet dhe zhdukja pa shenj ndodhin para syve të trupave të KFOR-it, të cilat nuk mundën të ofronin kurrfarë mbrojtjeje. Konfliktet, që në Kosovë vlojnë tani e disa vite, nuk qe e mundshme të mënjanoheshin me dhunë ushtarake.

Shoqata e egjiptianëve kosovarë

PREJARDHJA E GORANËVE NË DRITËN
E EMRAVE TË VËLLAZËRIVE E TË VENDEVE

PREJARDHJA E GORANËVE NË DRITËN E EMRAVE TË VËLLAZËRIVE E TË VENDEVE

Përmbajtja

PREJARDHJA E GORANËVE NË DRITËN E EMRAVE TË VËLLAZËRIVE E TË VENDEVE 461

1. VENERIME HYRËSE 461
1.1. Hapësira gjeografike e sotme dhe mesjetare e mikroregjioneve të Gorës e të Opojës 464
2. LËNDA ONOMASTIKE HISTORIKE PËR KRAHINAT E GORËS E TË OPOJËS 470
2.1. Venerime përkitazi me Gorën e me Opojën mbi bazën e të dhënave të burimit kishtar serb të vitit 1348 476
2.2. Vazhdimësi e emrave mesjetarë të vendeve në mikrotoponiminë dhe në emrat modernë të vëllazërive në krahinat e Gorës e të Opojës 479
3. VENERIME PËRKITAZI ME GORËN MBI BAZËN E TË DHËNAVE TË BURIMIT OSMAN TË VITEVE 1451-1452 490
4. GORA E OPOJA NË DRITËN E STUDIMEVE GJUHËSORE, ETNOGRAFIKE E HISTORIKE BULLGARE, SERBE, SHQIPTARE E BOSHNJAKE 505
4.1. Mendime e hipoteza përkitazi me gjuhën dhe me prejardhjen etnike të popullatës së Gorës 505
4.2. Sqarime përkitazi me herezinë ballkanike: bogumilët 522
4.3. Përndjekja e bogumilëve 526
4.4. Rreth emrave: bogumil, babun, kuduger 533
4.5. Rreth mundësisë së barazimit të nocioneve goran, pomak, torbesh, gogë, mijak dhe bogumil 538
5. GJENDJA E SOTME DHE TEZA E BARAZIMIT BOGUMIL - TORBESH - GORAN - BOSHNJAK; POTUR 560
5.1. Bestytnitë në mbështetje të prejardhjes bogomile të goranëve *568*
5.2. Gjurmë të artit e monumente bogumile 571
6. PREJARDHJA E GORANËVE NË DRITËN E ONOMASTIKËS 574
6.1 Metoda e studimit 574
6.2. Paralele midis antroponimisë së banorëve të Gorës dhe të asaj të krahinave fqinje shqiptare 577
6.3. Paralele antroponimike të banorëve të Gorës me ata të krahinave shqipfolëse të Opojës e me të Malësisë së Tetovës 577
7. VENERIME 1 592
8. SHTRESIME GJUHËSORE NË TOPONIMINË DHE NË ETNONIMINË E GORËS 593
8.1. Shtresa latine - ballkanike (vllahe) 593
8.1.1. Emra vendesh 593
8.1.2. Emra vlleh 597
8.1.3. Mikrotoponime me prejardhje aromune-vllahe: 597
8.1.4. Emra vëllazërish (vetëm disa sish) me prejardhje vllahe në pjesën kosovare të Gorës:[320] 598
8.1.5. Emra vlleh të vëllazërive në pjesën e Gorës në Shqipëri:[321] 599
8.1.6. Emra vendesh 600

8.1.7. Emra vëllazërish: 621
8.1.8. Gjurmë leksikore vllahe në të folmen e Gorës 637
9. SHTRESA GREKE 644
9.1. Emra vendesh: 644
9.2. Emra vëllazërish: 650
10. SHTRESA SLLAVE 652
11. SHTRESA TURKE (TEZA E PREJARDHJES TURKE TË GORANËVE) 659
12. SHTRESA SHQIPE 667
12.1. Emra vendbanimesh 667
12.2. Mikrotoponime 669
12.3. Mikrotopnime me prejardhje antroponimike 676
12.4. Emra vëllazërish: Paralele shqiptare-gorane 682
13. AREALI EMËROR I ETNONIMISË SË GORËS 696
13.1. Përputhje të emrave të vëllazërive të sotëm të Gorës me sish të rrethinave të Shkodrës, Ulqinit e të Tivarit 696
13.2. Përputhje të emrave të vëllazërive të goranëve me sish të Malësisë së Tetovës e të Kosovës në shek. 15 697
14. VENERIME PËRKITAZI ME PREJARDHJEN E GORANËVE NË KONTEKSTIN E AREALIT EMËROR 698
14.1 Bashkëjetesa e goranëve me shqiptarët 701
15. VENERIME PËRMBYLLËSE 705
16. REGJISTËR I PJESËRISHËM I PARALELEVE TË EMRAVE TË VËLLAZËRIVE TË GORËS ME SISH TË OPOJËS 715

TURQIT NË KOSOVË 721

MENDIME RRETH DY MINORITETEVE TË SHUARA MESJETARE TË KOSOVËS: KUMANËT E JURUKËT 727

TË DHËNA PËR ÇERKEZËT NË ATDHEUN E TYRE TË KRYEHERSHËM DHE NË KOSOVË 753

BURIMET DHE LITERATURA 765

PREJARDHJA E GORANËVE NË DRITËN E EMRAVE TË VËLLAZËRIVE E TË VENDEVE*

"Zoti nuk i pyeti goranët kur i bëri të tillë. Ata nuk mund të fajësohen e të mbajnë përgjegjësi për veprën e tjetërkujt, aq më pak për atë që e bën zoti. Në këtë kuptim, goranët nuk mund të futen në lëkurë tjetër, për hatër të askujt. [...] *Historia nuk i mori dorë askujt kur ua caktoi goranëve atdheun e ri, sikundër edhe romëve, magjupëve, serbëve, turqve etj. Duke u nisur nga hapësira ku ata jetojnë, të gjithë sikur edhe shqiptarët që bëjnë shumicën absolute, janë kosovarë. Nëse Kosova si njësi politike mban emrin e shqiptarëve, ky paritet është vendosur nga historia e cila, gjithashtu, nuk i ka marrë dorë askujt, kur ua siguroi atyre dy atribute: kohën dhe numrin."*[1]

1. VENERIME HYRËSE

Sa i përket të së kaluarës më të thellë të regjionit që në mesjetën e vonë dhe sot përfshijnë krahinëzat e Gorës e të Opojës, në një trajtesë të botuar nga Muharrem Qaflleshi[2] është shfaqur mendimi sipas të cilit paska

---

* Versioni më i vjetër i këtij punimi, nën titullin *Shtresa shqipe e etnonimisë dhe e toponimisë së Gorës*, është botuar në revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike 10, Prishtinë, 1980 f. 115 - 140 dhe në versionin gjermanisht: Die albanische Schicht in den Sippen- und Ortsnamen in der Region Gora, në revistën Dardania - Zeitschrift für Geschichte, Literatur und Politik, Wien, 8 / 1995, f. 55-85.

[1] Nazif Dokle, Për Gorën dhe goranët, (Artikuj e studime), Prizren, 2002, f. 71. Shënim: Citati i mësipërm nuk është dhënë këtu krejt origjinal në kuptimin e drejtshkrimit dhe të sintaksës. Khs. orgjinalin: "Zoti nuk i pyeti goranët kur i bëri të tillë. Ata nuk mund të fajësohen e të mbajnë përgjegjësi për veprën e tjetërkujt aq më pak zoti për atë që e bën. Në këtë kuptim, goranët nuk mnd të futen në lëkurë tjetër, për hatër të askujt." [...]" Historia nuk i mori dorë kujt kur ua caktoi goranëve atdheun e ri, sikundër romëve, magjupëve, serbëve, turqëve etj. Duke u nisur nga hapësira ku ata jetojnë, të gjithë sikur edhe shqiptarët që bëjnë shumicën absolute, janë kosovarë. Nëse Kosova si njësi politike mban emrin e shqiptarëve, ky paritet është vendosur nga historia, e cila gjithashtu, nuk i ka marrë dorë askujt, kur ua siguroi atyre dy atribute: kohën dhe numrin."

[2] Gjurmë historike të Opojës autoktone dhe goranëve të Gorës, në revistën mujore "Buletini" 1/ 2004, f. 3 - 5, të Kuvendit të Komunës së Dragashit dhe në http://ojq-qendra.webs.com/historikuiopojsdheg.htm.

mundësi që pikërisht me Opojën (e jo edhe me Gorën sic!) paskan të bëjë edhe shënimet e historiografit grek Polybios (i lindur në v. 200 p. e. s në Megalopolis të Peloponezit dhe i vdekur po aty në v. 120 p. e. s. autor i veprës *Historíai*) dhe atij romak Titus Livius (i lindur në Padovën e sotme të Italisë mbase në v. 59 para erës sonë dhe i vdekur po në Padovë rreth vitit 17 të e. s.) në veprën e tij Ab urbe condida, "Që nga themelimi i Qytetit" të Romës 43. 20. 1 përkitazi me rrugëtimin e delegacionit të mbretit të makedonëve (Perseus-it) i lindur në v. 212 e i vdekur në v. 165 p.e.s., i përbërë nga iliri Pleurat që ishte tek ai si i mërguar dhe nga makedoni Adeu nga Beroja për t'u takuar në Lis me mbretin Gent të ilirëve me qëllim të angazhimit të Gentit në një luftë kundër romakëve. Delegatët, sipas Polybios-it *Historíai* "*Historitë*" 23, 1, kishin për detyrë ta njoftonin Gentin për luftërat që Perseu bënte kundër romakëve e dardanëve, ishin nisur nga qyteti *Euneum* (Tetova e sotme?) e kaluan qafën malit të Skardit dhe përshkuan krahinën e quajtur *Illyrici solitudines* "Iliria e shkretëruar". Këtë vend pak kohë më parë e kishin prishur makedonët për t'i penguar dardanët që të dyndeshin në Iliri (dhe në Maqedoni) dhe, pas shumë mundimesh arritën më në fund në Skodra.[3] Nga ky episod i raporteve midis ilirëve të Gentit dhe makedonëve sikur del e qartë se dardanët ishin për ta, si edhe Roma, armik i përbashkët i tyre.

Historianët e lashtësisë e përmendin pra shprehimisht Malin e Sharit i cili nuk do të jetë kurrsesi ndonjë "shkretërirë e Ilirisë", sepse të tilla edhe nuk kishte në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Ka shumë arsye të besohet që Livius-i kallxon për "krahina të shkretëruara të Ilirisë" dhe jo për "shkretëtira të Ilirisë". Nga dijetarë kompetentë të historisë së antikës së Ballkanit është shfaqur mendimi se këto "shkretëtira" mund të kenë të bëjnë me rrethinën e qytetit të Gostivarit dhe se kemi të bëjmë me shkretërime të vetë makedonëve në mënyrë që dardanët të mos mundnin të hynin aq lehtë në Makedoni. Mirëpo, dijetari kosovar Enver Hoxhaj, i cili ka kompetencë profesionale të deklarohet (edhe) përkitazi me këtë çështje, në referencën 253 të tezës së tij të doktoranturës së mbrojtur në Vjenë, shkruan se: "Përkitazi me çështjen se ku duhen kërkuar *Illyrici solitudines* (Liv. 43. 20. 1), në literaturë ka mendime të ndryshme. Nga të dhënat që i sjell Livi mund të nxirret përfundimi që këto shkretëtira do të duhej të kërkohen në Malet e Sharit. Pas një vlerësimi të burimeve literare, J. Kromayer[4] shpreh mendimin se këto shkretëtira po u dashka të lokalizohen në krahinën e Mirditës, në Shqipërinë e Veriut, përkatësisht

[3] Khs. Ilirët dhe iliria te autorët antikë, Bot. i TEONA, Tiranë, 2002, f. 125-126; 67,nën redaktimin e: Selim Islami, Frano Prendi, Hasan Ceka e Skënder Anamali.

[4] Antike Schlachtfelder in Griechenland: Bausteine zu einer antiken Kriegsgeschichte II, Berlin, 1907, f. 260, ref. 4, cit. sipas E. Hoxhaj, khs. ref. 7.

në rrethina të Oroshit e të Lurës. Sipas mendimit të tij, këto shkretëtira do të duhej të identifikoheshn me malet e quajtura Mali i Kuq. Këtij mendimi i doli krah edhe Walbank duke menduar porse që *Scardus montis* SG.: "*Malet* e Sharit" po u dashkan të identifikohen me malet e Shëngjinit. Një pikëpamje interesante e gjejmë te Hamond[5] propozimi i të cilit ngërthen një hapësirë të madhe. Kështu, ai mendon se shkretëtirat e Iirisë do të duhej të lokalizohen në afërsi të burimit të lumit Lepenc dhe të degëve të majta të Drinit të Bardhë, midis qyteteve kosovare Ferizaj e Gjakovë në rrafshnalta. Papazoglu[6] mendon se një trevë që do t'i ndalte sulmet e dardanëve në drejtim të Makedonisë e të Ilirisë më parë do të ketë qenë në ndonjë luginë se sa në rrafshnaltë. Përveç kësaj, nuk do të mund të pritej që në fillim të luftës së tretë romake-makedone ilirët, si aleatë të romakëve, do ta sulmonin Makedoninë. Së këndejmi, treva e përmendur më lart do të duhej të kërkohej diku në afërsi të kufirit midis dardanëve, ilirëve e makedonëve. Mbi bazën e këtyre arsyeve mendimi i shfaqur nga kjo dijetare, sipas të cilit Shkretëtirat e Ilirisë duhen kërkuar në hapësira të qytetit të sotëm të Gostivarit, më duket i pranueshëm."[7] Këtij paravendimi i del krah, sipas mendimit tim, edhe rrethana që në asnjë burim në të cilin përmendet mali *Scardus*/*Scordus* "Malet e Sharit", kurrnjëherë nuk është cilësuar për "shkretëtirë". Përveç kësaj, është e vështirë të paravendohet që, sidomos në kontekstin e armiqësive të përjetshme midis dardanëve e makedonëve, Malet e Sharit të kenë shërbyer pikënisje e sulmeve të dardanëve mbi Maqedoninë.

Mbase pandashëm pikërisht nga Malet e Sharit duhet parë edhe njoftimin e autorit anonim të shek. IV të e. s., sipas të cilit Makedonia eksportonte, përveç tjerash, edhe djathë dardan[8] të cilin e merrte nga Dardania. Djathi dardan "*caesus Dardanicus*" ishte, përkrah atij dokleat "*caseus Docleas*" prodhim i njohur gjatë gjithë kohës së Perandorisë Romake. Barinjtë dardanë nuk ishin të njohur për prodhimin e atij djathi vetëm në vend të tyre, porse edhe andej nga shtegtonin grupe barinjsh siç

[5] Hammond, N., G. L., 1966, The Kingdoms in Illyria *circa* 400-167, 1966, B.C.', *ABSchA* 61, 239-253, cit. sipas E. Hoxhaj, khs. ref. 7.

[6] Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba: Tribali, Autarijati, Dardanci, Skordisci i Mezi (ANUBiH - CBI, Knj. 30/1), Sarajevo, 1969 cit. sipas E. Hoxhaj, khs. ref. 7.

[7] Enver Hoxhaj, Kërkime për historinë e Kosovës në kohën romake, Ushtria, qytetet, shoqëria dhe popullsia, Disertacion për marrjen e gradës së doktoraturës në filozofi, në Faklutletin e Shkencave Humanitare të Universitetit të Vjenës, dorëshkrim, f. 56.

[8] Khs. tek Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Tiranë, 2002, f. 329.; Joseph Matl, Hirtentum und Stammesverfassung als Kulturfaktor, Völker und Kulturen Südosteuropas, Kulturhistorische Beiträge, im Namen der Südosteuropa-Gesellschaft herausgegeben von Wlhelm Gülich, München, 1959, f. 109 shkruan se këtë njoftim e sillte Plinius i cili thoshte se ky djathë sillej nga rrethinat e Shkupit.

mund të jenë barinjtë dardanë të cilët mbase qysh para ndryshimeve të mëdha që ndodhën pas vdekjes së perandorit Mauricius shtegtonin deri në Thesali për kullota dimërore (*saltus*), ashtu si pararendësit e tyre Βλαχοί që, sipas përshkrimeve të Kekaumenos-it në shek. XI e kalonin verën nga prilli deri në shtator në malet e ftohta ώρη τές Βουλγαρίας ndërsa dimrin, porse, e kalonin në Thesali.[9]

Mbetet porse për t'u besuar që hapësira e sotme e këtyre dy krahinëzave do të ketë qenë, së pakut në kohën e sundimit romak, një nyjë e rëndësishme e komunikacionit përgjatë rrugës dytësore që përmes Epicaria-s antike (Pukës së sotme të Shqipërisë së Veriut) e lidhte Durrësin me viset veriore të Ilirisë. Edhe përgjatë kësaj rruge që do të ketë kaluar nëpër këto dy krahinëza do të jenë ngritur në kohën romake *statio*, siç e dëshmojnë mbase edhe vendet e quajtura deri në ditët tonat *Shtatuli* në Opojë e *Statulj* në krahinën e Gorës që, në dritën e toponimeve *Strator* nëpër këtë hapësirë u vazhduan edhe në kohën e sundimit bizantin (për këto sh. më poshtë) dhe *mansio* "bujtina" e *mutatio* "vende për ndërrimin e kuajve". Të këtilla paskan qenë porse, sipas autorit anonim,* duke u mbështetur mbase kryesisht në kuptimin sllavisht të emrit të vendit, vendi i quajtur *Gostil* në veri të Liqenit të Shkodrës, përkatësisht në prefekturën e Kukësit dhe vendi i dëshmuar në mesjetën e vonë për si vendbanim më vete *Zinova* në krainën e Opojës.

1.1. Hapësira gjeografike e sotme dhe mesjetare e mikroregjioneve të Gorës e të Opojës

1.1.1 Gora

Në kufijtë e saj etnografikë tradicionalë, Gora paraqet një tërësi gjeografike, ekonomike, historike, kulturore e gjuhësore. Mbase jo pa të drejtë, autori shqiptar me prejardhje gorane Nazif Dokle i përdor, për këtë kontekst termat *minikulturë* dhe *minigjuhë*,[10] ndërsa gorani kosovar S. Idrizi për këtë ambient dhe për popullatën e saj i përdor edhe termat (kategori) *etnonacionale* e *etnokulturore*.[11]

Regjioni i Gorës ndahet gjeografikisht midis Kosovës e Shqipërisë dhe, me vetëm dy katunde që i takojnë asaj, edhe Maqedonisë. Me emrin e përgjithshëm *Gora* emërtohet gropa midis lartësive të bjeshkëve të

[9] Sipas. K. Jireček, Romani u gradovima Dalmacije. .., f. 40.

* Khs. Historiku i K. K. Dragash, Buletini, Revistë mujore e Kuvendit Komunal Dragash, 1/2004, f. 3. Autori ynë e paska marrë këtë mendim nga N. Dokle, Për Gorën dhe goranët. .., f. 54.

[10] N. Dokle, Për Gorën dhe goranët. .., f. 5.

[11] khs. punimin e tij Gora - Jedan pogled unazad (dorëshkrim)

Sharrit, Zërzës (1347 m), Koritnikut (2397 m.) në veriperëndim, Gjallicës në perëndim e Kallabakut (2334 m) në jugperëndim. Pika të tjera kufizimi të këtij regjioni janë edhe mali Kaçina Gllava (2407 m) në lindje dhe Gemitash (2204 m) në jug.[12] Kjo tërësi unike, në kuptimin etnokulturor, u nda me dhunë në mars të vitit 1923 kur u vunë në jetë vendimet e Konfrencës së Versalles-it - vendime këto që hartën politike të Ballkanit e kishin konfiguruar në dëm të shqiptarëve. Në kuadrin e ndarjes me laps të kufinjve midis Mbretërisë Serbe-Kroate-Sllovene dhe shtetit të cunguar të Shqipërisë, Mbretërisë së favorizuar asokohe nga Perëndimi të sllavëve të jugut i mbetën 19 katunde të regjionit unik të Gorës, ndërsa 9 të tjera mbetën përbrenda kufijve politikë të shtetit që do të quhej dhe ende quhet Shqipëri.[13]

Gora, bashkë me Opojën (për këtë sh. më poshtë), janë zona etno-linguistike të cilat shtrihen midis qyteteve shqiptare të Prizrenit (në Kosovë), Tetovës (në Maqedoni) dhe Kukësit (në Shqipëri).

Pjesës kosovare të Gorës i takojnë sot 19 katunde. Sipas të dhënave, mbase nga statistika bullgare, numri i familjeve në vitet '20 të shekullit 20 do të dukej kështu: *Bačka* [shq. Baçkë] (50 shtëpi), Brod (500 shtëpi), *Globočica* [shq. Glloboçicë] (100 shtëpi**),** Dikance [shq. Dikancë] (85 shtëpi**),** Zli Potok (s'ka të dhëna), *Krstec*, [shq. Kërstec] (120 shtëpi), Kruševo, [shq. Krushevë] (s'ka të dhëna**),** Kukaljane, [shq. Kukolan] (80 shtëpi**),** Orćuša, [shq. Orçushë] (64 shtëpi**),** Restelica, var. Rastelica [shq. Restelicë] (150 shtëpi**),** *Dragaš*, emri më i vjetër, sipas kujtesës kolektive, Krakovište/Krakojšte [shq. Dragash] (50 shtëpi), Ljubovište [shq. Lubovishtë] (70 shtëpi), Mlike [shq. Mlikë] (60 shtëpi), Radeša [shq. Radesh,-i] (90 shtëpi), Vrabča/Rapča [shq. Rapçë] (110 shtëpi), Vraništ [shq. Vranisht] (90 shtëpi) dhe Leštan [shq. Leshtan] (75 shtëpi). Të gjitha këto katunde i takojnë sot, pas ndarjes artificiale me prapavijë politike nga tërësia unike gjeografike ku bien edhe katundet shqiptare të Opojës, komunës së Dragashit, e cila e përfshin më vete *vetëm* popullatën sllavofone.

Sipas të dhënave jozyrtare, në këto katunde po jetuakan rreth 13000 banorë goranë. Nëpër vendbanime të tjera të Kosovës paska edhe rreth 5.000 goranë të tjerë. Po u inkuadruan edhe goranët në Shqipëri dhe në vende të ish-Jugosllavisë, del se paska gjithsej midis 30-40 mijë goranë. Sipas vlerësimeve më të reja, nga rreth 20.000 banorë të dikurshëm, në pjesën kosovare po jetuakan sot[14] vetëm edhe rreth 6.000 frymë,

[12] Nazif Dokle, poaty, f. 12, 53.
[13] N. Dokle, poaty, f. 76.
[14] Sipas Samir Velija, Quo vadis, Goranac? në http: // www.prizren-web.com/magazin/

kryesisht goranë të moshuar. Nga shkrimet në sajtin *Nezavisna Gora* "Gora e Pavarur" mësohet se paska goranë që po kërkuan madje edhe një Gorë të pavarur, me vetëqeverisje në fushat e arsimit, të shëndetësisë dhe të policisë, pa e pas zbuluar porse sekretin se cila do të duhej të ishte gjuha "zyrtare" në këtë regjion.

Katundet gorane nga kjo njësi unike etno-linguistike që sot i takojnë shtetit të Shqipërisë, përkatësisht rrethit të Kukësit, ishin sipas statistikave bullgare të viteve '20 të shek. XX katundet: Borje (me 150 shtëpi), Cërnalevë (me 35 shtëpi), Kosharisht (me 27 shtëpi), Orçikël (me 25 shtëpi), Orgosht (me 70 shtëpi), Oreshk (me 30 shtëpi) Pakish (me 31 shtëpi) Shishtavec/var, Shishtovec (me 200 shtëpi) dhe Zapod (me 40 shtëpi).[15]

Vështruar territorialisht e administrativisht, pjesës së Gorës në territorin e sotëm të Shqipërisë po i takuakan edhe 10 katunde me prapavijë etnike shqiptare, përkatësisht me banorë vetëm shqipfolës: Bele, Brekijë, Kollovoz, Lome, Nimçë, Novosejë, Shtreze, Topojan, Turraj e Xhaferraj, të cilat nuk po bëka të veçohen nga regjioni etnogjeorgafik i quajtur *Gorë*.[16] Pas Luftës së Dytë Botërore, nga tërësia kosovare e Gorës u shkëputën edhe dy katunde: Urvič e Jalovjane të cilat iu dhanë Maqedonisë, për t'u bërë atje një nëngrup më vete. Qeveria e Maqedonisë i ndejti gati punës dhe në këto katunde hapi menjëherë shkolla në gjuhën maqedone. Pjesa më e madhe e banorëve të këtyre katundeve e mbajnë mend se e heqin prejardhjen nga katundet Borje, Restelicë, Kukalan dhe nga katunde të tjera të pjesës shqiptare të Maleve të Sharit.[17]

Një mikroregjion të quajtur *Gorë* ka edhe në perëndim të Korçës. Edhe këtu kemi të bëjmë me një ngulim popullate nga hapësira gjuhësore e bullgarishtes. Ky ngulim duhet të jetë së pakut më i vjetër se shek. XX, sakohë që për popullatën fqinje të krahinës së *Oparit* (Gorën) edhe pinjolli i derës së Muzakajve tregonte në kronikën e familjes së tij se po e heqka prejardhjen nga Bullgaria, se qenkan *schiavoni*, përkatësisht sllavë.[18]

---

[15] Këto shënime u muarrën nga punimi i Prof. Dr. St. Mladenov, Bemerkungen über die Albaner und das Albanische in Nordwestmakedonien und Altserbien, Balkan-Archiv (Fortsetzung des Jaharesberichtes des Instituts für rumänische Sprache) I. Band, Leipzig 1925, f. 59.

[16] Po ai, po aty, f. 53.

[17] Sadik Idrizi, Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k -

[18] Khs. origj. "E più possedi e signoriggiò il paese d'Opari ch' è habità de schiavoni, con li casali de Festazzi, Beci e Maserecchi, Lodari, Manni,e Ceriascelli che tutti habitano. .... d' Albanisi" sh. Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi, bot. nga Charles Hopf në Chronique gréco-romanes, Berlin, 1873, f. 280.

1.1.2. Opoja

Ky emër shënon sot një krahinë të vogël që në vete përfshin katundet Bellobrad (var. Gostil), Blaç, Brezne, Brodosanë (var. shqip Bresanë), Brrut, Buçe, Buzez/Buzezë, Kapre, Kosavë, Kuk/Kukël, Kuklibeg, Pllajnik, Pllavë, Rrenc, Shajne, Zaplugje, Zgatar, Zym e Xerxë.

Duket se dëshmia më e vjetër e emrit *Opoja* të regjionit kosovar do të jetë ajo që del në një shkresë të viteve 1276-1281 të një sundimtari serb të quajtur Dragutin, përmes së cilës ky i falte manastirit të Hilandarit disa katunde. Në vazhdim të tekstit që ka të bëjë me kishën e Shmitrit në Prizren, në këtë shkresë thuhet se ky sundimtar ia falte Hilandarit edhe katundin Llokvica i cili e kishte për kufi Opojën: "Dhe ia dhash katundin Llokvica [...] ndërsa kufirin e ka andej kah shkambi nga Qyteti i Drunjt* shkon kah Qurilci në Kodrën e Shtneskës dhe andej kah rruga bie mespërmes Zborcit në Pres(lan), te Kroi aty kah shkëmbinjtë anojnë kah Opoja dhe në Llokvicë".[19] Pozita e katundit Llokvica del më e qartë në krisobulën e vitit 1348, në vendin ku caktoheshin kufijtë e katundit të sotëm Reçan të rrethinave të Prizrenit. Këtu thuhet: "Katundi Reçan dhe kufiri i tij nga Llokvica (është) lumi Vëshivica. Nga lumi në Garçicë në pjesën e poshtme të *Ligatës, tek *Shkrepi, tek Ara e Bogdanit e tek *Lisi. Tek *Gurët e Shkrepit, te Meli në Rakovc. Nga Rakovci nëpër mal e te Lisi, dhe përtej Lugut e tek *Kryqi i minit e tek *Drizat."[20] Emri i krahinës së Opojës përmendet edhe në krisobulat e Deçanit të vitit 1330. Atëherë, për si kufi i katundit të sotëm Gërkovë të rrethinave të Ferizajt, përmendet "*Udha e Opojës*".[21] Një dëshmi tjetër shkrimore në të cilën përmendet emri i kësaj krahine është krisobula e vitit 1348 e sundimtarit serb Stefan Dushan për manastirin e shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit. Aty është shënuar se kufiri i bjeshkës së katundit Radesh, si edhe ai i katundit Kërstec të Gorës, niste *ot opolija*, përkatësisht *ot*

* Duket se kemi të bëjmë me vendin *Drvengrad* që ndodhet sipri kështjellës së vjetër të Prizrenit dhe manastirit të shenjtorëve Mëhill e Gabriel, përkatësisht në hapësirën e katundit të sotëm Pousko të rrethinave të Prizrenit.

[19] Khs. tekstin origjinal: "I dah sєlo Lokvыcou [...] a megja mou kako grєdє hrъidь ѡ-d-(r)ěvěna grada na Kьrilьcь na Št.. .. nєskou glavou i kako poutь grade po srědě Zborьskoga na prěs(lanь), na Stouděnьcь. kako sє vali kame(n) ѡpolьje i ou Lokvьcou". tek St. Stojanović, Stari srpski hrisovulji, akti, ljetopisi, tipici. .., SPOMENIK SKA III, Beograd 1890, f. 11.

[20] Khs. tekstin origjinal tek Hrisovulja. .., f. 280: "Selo rěčani. a megja mou ѡt lok'vice rěka vьšivica. iz rěkє na gar'čicou na donï krai lok'vє. na grєbnou na bogdanaovoù nivoù na drěvo. na grєbni kamы. na mělь na rakov'cь. Iz rakovca dělomь na drěvo. i prěko dola niže mыšєva krъsta na grъmь. où drěvěni potokъ".

[21] Khs. Dečanske hrisovulje. .., f. 128: " a megja manastir'cu ѡt grъkove luke na sopotь [. ..] do běljeve gari i do puti ѡpolьskoga na prěsloрь. .. ".

opoljà,[22] "nga Opoja", ndërsa në një dokument tjetër dëshmohet edhe lumi i madh i Opojës: *u veliku rěku opolьsku*.[23]

Për njësi më vete territoriale, administrative, regjioni i sotëm i Opojës përmendet edhe në defterin osman/turk të regjistrimit të vitit 1571.[23a] Atëherë Opoja ishte nahije më vete dhe në kuadrin e saj bënin pjesë 24 katunde dhe një truallishtë dhe pikërisht: Bilush [sot Bilushë], Izlatarça [sot Zgatar], Pllajnik[edhe sot Pllajnik], Gzosh [i panjohur me këtë emër], Pandalofic [i panjohur me këtë emër], Hotonova [i panjohur me këtë emër, ndoshta midis Brodosanës e Kuklibegut], Zinova [ndoshta Brodosana e sotme], Zabluzhan (Zaplushje) [sot Zapluxhë], Strela Gostrica [i panjohur me këtë emër; ndoshta ishte midis Bellobradit e Kapres], Zubofic [sot Zhub?], Dimitrofc [i panjohur me këtë emër], Bllaç [sot Blaq], Plava [sot Pllavë], Zolç [i panjohur me këtë emër], Prebiq [i panjohur me këtë emër], Olina, ndryshe quhet Kusaq [sot Kosavë], Buça [sot Buçe], Brezna [sot Brezne], Zirzova [sot Zërzë], Jeniçe Llaz [i panjohur me këtë emër], Sveti Petri [i panjohur me këtë emër; më 1530 kishte qenë regjistruar si *Truallishta Petra* afër katundit Dolna Gostil e Bushat (Pushat); ndoshta lagjja e sotme *Mahalla e Prifte* e Blaçit], Truallishta German [djerrina e sotme Gjerman], Dolina Zabluzhani [sot Zapluxhë], Lopushniq, [sot Llopushnik dikur ishte lagje e Buçes] dhe Gradçanica [i panjohur me këtë emër, ndosha ishte midis Brrutit e Bilushës].

Duket se ka shumë arsye të besohet që emri *Opolja*/*Opolje* nuk shënonte në atë kohë ndonjë vendbanim më vete, porse një hapësirë kullote, toke të përbashkët si antipod i ambientit përreth të quajtur *Gora* nga sllav. *gora* "bjeshkë". Kjo opozitë e konfiguracionit do të shprehej në shqip me *Bjeshka* (= Gora) dhe *Vrrini* (= Opoja), për të dyja popullatat e sotme. Ndoshta pikërisht këtu edhe bën të kërkohen e të gjenden arsyet e substratit të përbashkët ndër emra vëllazërish e mikrotoponimesh të popullatave të këtyre dy regjioneve (për këtë sh. më poshtë). Një vend tjetër që do të quhej Opolje, përkatësisht Opoja nuk ka askund në hapësirën gjuhësore të shqipes e as në ato të gjuhëve sllave të jugut në Ballkan. Kjo edhe është e kuptueshme, meqë në leksikun e asnjërës nga gjuhët sllave të jugut nuk ekziston sot ndonjë apelativ *opole, opolje*.

[22] Sh. Hrisovulja cara Stefana Dušana koiomь osniva monastirь Sv. Arhangela Mihaila i Gavrilja u Prizrenu godine 1348 ? Glasnik Društva Srbske Slovesnosti 15 (1862), bot. Janko Šafarik, f. 300, 301, 281.

[23] Sipas Đuro Daničić, në Glasnik srpskog učenog društva XLIX, f. 365.

[23a] Selami Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë XV- XVI, Tiranë.1983, f. 340 -356.

Një apelativ opole ekziston porse në polonishten: opole me kuptuimin "pronë e bashkisë, të cilën banorët e shfrytëzojnë bashkarisht"; në çekishten: opole "kullotë e katundit",[24] përkatësisht opolé "fushë, regjion i rrafshët, i sheshtë"[25] dhe në sllovenishten opoli "kullotë e katundit; distrikt, pllajë, pland".[26] Një toponim *Opole* (gjerm. *Oppeln*) haset edhe në Poloni. Këtë toponim të Polonisë, por edhe toponimin tonë, P. Skok i supozon për të dala nga një trajtë më e vjetër sllave **Obьpolje*.[27] Më afër hapësirës gjuhësore të shqipes, toponime (por jo edhe vetë apelativi *opole*) të sajuara nga kjo fjalë dëshmohen edhe në territorin e Sllovenisë. Për të këtillë e mban Fr. Bezlaj toponimin e sotëm slloven *Vopole*, i cili në burime gjermanisht të viteve 1238, 1444, 1458 etj. dëshmohet në trajtat *Woppolach*, *Woepulach*, *Wapelach*, *Weppalach* e *Wappolach*. Bezlaj e inkuadron këtu edhe emrin *Opuel* të landit Steiermark të Austrisë. Të gjithë këta emra Bezlaj i nxjerr nga një apelativ i konstruktuar **opolje*/**opoljane*.[28] Si tek forma e konstruktuar me parashtesën *-o* të Bezlajt ashtu edhe në atë me parashtesën *-obь* të paravenduar nga P. Skok, përmbahet fjala sllave *polje* "fushë; kullotë". Në dritën e raporteve gjuhësore sllave-shqiptare, përkatësisht në dritën e reflektimit në trajtën *oborr* nga sllav. **obьdvor* me kuptimin e kryehershëm "vath bagëtish" të fjalës sllave që në shqipen[29] paska hyrë nga serbishtja,[30] duket se etimologjia e propozuar nga P. Skok do të ishte më mbushamendëse, nëse do të sqarohej edhe arsyeja dhe faktori i shkaktimit të kalimit të *b* në *p*. Fjalën sllave *polje* "fushë" e përmban edhe emri i katundit *Nepole/Nepolë* i rrethinave të Prizrenit, i cili, gjithnjë sipas P. Skok, do të jetë zhvillim i një trajte **Dně-polje*, përkatësisht *Dnepole* "fund i fushës; në fund të fushës". Së këndejmi zbërthimi që këtij emri ia bën M. Qaflleshi[31] sipas të cilit "Emrat e disa qyteteve janë

[24] Sipas France Bezlaj, Etimološki slovar slovenskega jezika II, Ljubljana, 1982, f. 252.
[25] Sipas Staročeškŷ slovník, 8, bot. Akademia - Praha, 1976, f. 543.
[26] Sipas France Bezlaj, Etimološki slovar. .. II, f. 252.
[27] Sh. Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika, II, Zagreb 1972, f. 698.
[28] Sipas France Bezlaj, Etimološki slovar. .. II, f. 252.
[29] Sipas Stefan Mladenov, Geschichte der bulgarischen Sprache, Berlin und Leipzig, 1929, f. 67.
[30] N. Jokl, te Zur Geschichte des alb. Diphtongs *-ua-*, *-ue-*, Indogermanische Forschungen 49 (1931), f. 181 tregon se te kjo fjalë kemi të bëjmë me një kompozitë sllave (khs. **obьdvor* të sjellë më lart në tekst) e cila në rus. e ka kuptimin "vath, thark bagëtish", si edhe në pol. e në çek. *obora* "ahur bagëtish", ndërsa në serbishten "rrethojë; thark derrash e gjedhesh, çiflik; bullg.. "thore; rrethojë; hapësirë çifliku; vath; ahër; çek. "ahër".
[31] Khs. Gjurmët historike të Opojës autoktone dhe goranëve të Gorës në http://ojq-qendra.webs.com/historikuiopojsdheg.htm.

formime të përbëra, duke u zgjeruar me mbaresën -o nga një antroponim dhe nga leksema -polis (-pol): Konstantin-o-polis, (Konstantin-o-pol), për Stambollin; Adrian-o-polis, (Adrian-o-pol) për Edrenën; Alban-o-polis, (Alban-o-pol) për Zgerdheshin e Krujës; Adrian-o-polis, (Adrian-o-pol) për Nëprevishat e Gjirokastrës etj.[…] Si duket tek ilirët dhe albrët, leksema polis, pol, do të jetë e një formeje origjinale ilire o-pojë: Konstantinopojë, Adrianopojë, Albanopojë, etj., që i është bashkëngjitur një antroponimi Konstantin, Adrian, Alban etj. Pra, kemi Konstantin- + -o- + -pojë = Konstantinopojë-a dhe kështu me radhë" është joprofesional, përkatësisht "patriotik"

2. LËNDA ONOMASTIKE HISTORIKE PËR KRAHINAT E GORËS E TË OPOJËS

Lëndë për onomastikën historike të krahinës së Opojës ka në një burim kishtar serb të shek. XIV dhe pikërisht në krisobulën e vitit 1348 të sundimtarit serb Stepan Dushan për manastirin e shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit. Më poshtë po i sjell të gjitha pjesët e kësaj krisobule, në të cilat bëhet fjalë për vende e njerëz të këtyre dy mikroregjioneve. Në kursiv janë shkruar nga unë emrat e katundeve të sotme si dhe mikrotoponimet disa nga të cilat i kam identifikuar në terren dhe disa sosh që në aspekte të ndryshme do të trajtohen në këtë punim: "Katundi *Rabça* me popin "priftin" *Glavat* (lexo si shq. G*ll*avat) dhe me popin/"priftin" *Raiko* me familjet e tyre dhe me bashtinat e tyre, ndërsa kufiri i tij (i Rabçës) në Stëllpnik [sot *Slupišta*, në Rapçë të Epërme. Ka mundësi që te ky mikrotoponim kemi po ashtu vazhdimësi të emrit sllav *slapь*/*slap* që sipas N. Jokl,[32] e paska kuptimin "ujvarë" i cili, sipas dokumentit tonë, sajonte mexhë midis vendbanimit të zhdukur Jelenc e katundit të sotëm Buzezë dhe vendit të quajtur Mllaka (ndoshta sot Mlikë): Khs. "A megja jelen'cu sь bozovci. ot desilove voděnice us potokь. gorě nad kraĭ u prekы putь. i vse putemь u veliju rěku u sopotь. i vse uz rěku na slapь. i ot slápa po vrьhu nad mlake." ose/edhe *Sllubëza* në katundin fqinj Buçje të Opojës[**] te *Gropa e Murrme (origj. *sini virь*) te **Kodra e Vllasit*[***] [ndoshta vendi i sotëm *Vlaška*, fushë, rrafshinë midis katundeve Mlikë e Vranisht] në Rudinë. në Çërtezh në Svirilinc, nëpër mal nëpër (f. 280) *Obod* [vendi i quajtur edhe sot *Obot* në katundin

[32] Zur Ortsnamenkunde Albaniens, Zeitschrift für Ortsnamenforschung 10-2 (1934), f. 203.

[**] Të shënuar në terren nga Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, fq, 100.

[***] Të gjithë emrat e përveçëm të shenjuar me yllin e rikonstruktimit janë përkthime nga unë të kuptimit të atyre emrave në shqip, të cilat nuk duhen parë as si emra shqip e as si variante shqipe të tyre.

Kërstec i Vogël të Gorës] te **Ligata e Gjakut* aty ku udha bie në *Shkorret [vendi i sotëm *Çestak* në Rapçë të Epërme dhe të Poshtme] te shkambinjtë dhe udhës teposhtë te *Dy Bredhat, [ndoshta vendi i quajtur sot *Orvanik Bor* në Rapçë të Epërme] në majë të *Shkemzës (në origj. *rujište*), ndërsa kufirin e tij me *Pllavën* ta ruajnë midis vetes ashtu siç e kanë pasur edhe më herët. Të dy kaundet *Kërstec* bashkë me lagjet, me vreshtat e me bjeshkën dhe me të gjitha të drejtat. Kufini i tij deri te mexha e *Rabçës* dhe deri te mexha e *Pakishit*. Katundi *Pakish* me tbanet, ndërsa kufini i tij/tyre në Bratishtevicë e te **Kisha e Mratit* mespërmes **Arës së Knezit* dhe prej aty në Cërtezh në *Lugun e Stipanit në majë nga *Zapogjani* ("banorët e Zapodit"- katundit homonim të rrethinave të Kukësit) dhe deri aty ku âsht caktue me krisobulën për (kishën) e Shën Mërisë. Katundi *Buqje* dhe kufijtë e tij nga *Pllava* përmes *Gurit të Bratosllalit nëpër mal [sot *Pylli*, në katundin Buqe] drejt e në përrue dhe nga përroi te kroi në Luçna [vendi i quajtur sot *Drita e Bjeshkës* në katundin Brezne të Opojës] deri te udha, deri aty (siç është caktue me krisobulën e mitropolitit) dhe kufini i *Buqjes* nga *Breznja* te *Shkemëzat (në origj. *rujište*) teposhtë kodrës nëpër mal deri te udha. Katundi *Radesh* me lagjen e tij *Radeshtica* dhe me bjeshkët dhe me të gjitha të drejtat e tij dhe kufini i tij nga maja Sllavkovc e *Leshtanit*. Nëpër mal teposhtë *Gurëve të Mprehtë deri te *Mllaçishtat* e *Deikut* [vendi i qajtur sot *Dejkine Vode* e *Dejkinje Kamenje* në Krushevë] drejt e në përrue përtej lugut në *Shkrumb [vendi i quajtur sot *Gar*, po në Radesh, khs. edhe mtp. *Garçicë*, në Shajne] dhe prej aty drejt nëpër mal tek shkambinjtë që bien sipri (kishës së ?) Shën Kollit në lug, nga lugu mespërmes Shtedimit [sot *Štedinište, Štedin*, bjeshkë afër katundit Brod] në Qurillovc dhe udhës e në Krak përmes Garçicës [ndoshta vendet e quajtura sot sllavisht *Garčica* e shqip *Shkrumëza* në katundin Bellobrad, përkatësisht Gostil] e te ura mbi *Lumin e madh [sot *Radeška Reka* - lum i katundit Radesh të Gorës], ndërsa (kufini) i *Radeshit* nga Opoja aty siç është caktue me krisobulën (për kishën) e Shën Mërisë te *Shkambi i bardhë, [sot *Beu kamen*, në Brod; një mtp. *Befkamen* është edhe në Radesh] te *Gur't e Rrethuem [ndoshta vendi i quajtur sot *Stenje* "shkëmbenjë" i këtij katundi], drejt kodrës teposhtë te Kupçishtat te **Kisha e Ilit* aty ku udha shpie për në Rudina në Llokva dhe ku udha bie në *Lumin e Madh dhe lumit teposhtë te *Ura e Madhe e te guri i parë i mexhës. Katundi *Brod* dhe Brodi tjetër dhe *priftërinjtë Dikanoviki* (f. 281) [vëllazëria e sotme *Dikanci* në Brod, khs. edhe vëllazërinë shqiptare *Dikajt* në Brodosanë dhe katundin goran *Dikanci*] e familjet e tyne dhe me bashtinat e tyne dhe me lagjen *Gërmljani* [lagja, vëllazëria e sotme Gërmljani në katundin Dikancë] ndërsa kufini i tij me bjeshkën nga Prëvosllavi në Sllap "Tek e

then uji qafën; në ujvare"e te *Kodra e Rrumullak't, [vendi i quajtur sot *Oblo* në katundin Brod] te *Kroni i Thatë, te *Mali i Zi, lumit teposhtë te **Vathet e Milqit* dhe lumit të *Krushevës* teposhtë deri te përroi, aty ku përroi *Zli Potok* "Prroni i Keq" bie në lumë, lumit teposhtë nëpër mal e në Prěobrženije te Kryqi te Kroni i Udhës t'Madhe te p'rroi në *Strator*. [khs. vendet e sotme *Stratorski Potok* e *Stratorje* në Gllloboçicë dhe *Stratorje* në Krushevë]. Pastaj udhës aty ku rruga bie në lumë, në *Vraniq*, ndërsa Malin e Zi[33] dhe Shkorretin (origj. *česte*) ta presin si bashkësi *Orçusha, Gllloboçica* e Brodi. Nga lumi në Jellshije përroit të Kërstecit (ose të Kryqit) ku ky piqet me *Lugun e Madh dhe *Lugut t'Madh aty ku ky del në mal, në Hust dhe prej aty nëpër mal kah shkojnë shkambinjtë këndej e andej në Sllavkovc. Dhe në të gjitha këto katunde (prona) të kishës në Gorë (ato) që janë të bleme dhe prikë e famullisë t'i mbajë, ndërsa ato që i takojnë famullisë të bleme ose prikë e njerëzve të kishës gjithashtu t'i mbajnë, ndërsa kufijtë të mbeten ata që janë përcaktue në krisobulë. (f. 282). [...] Dhe kufini i bjeshkëve *Prëvosllav*, *Grebishte*, *Plloça* e *bjeshkës së Radeshit*, *Fusha e Hrabrit*, *Sopoti*, *Mavra*, [khs. emrin *Mavra* në katundin Brod të Gorës] *Iroshi* dhe kufijtë e tyne nga *Opoja* te **Guri i Rrethuem*, në *Ush të Sopotit* [ndoshta vendi i quajtur sot Ušeljeica në katundin Brod], majës mbi *katundin Milisht*, aty ku mali shkon përkrah **Bërrakës së Përhime* te *Guri i Zi udhës e në përrue aty ku përroi bie në lumë. Në majë të *Dupnic*ës, nëpër mal e në *Krivosh* dhe majës e në Grebishtë, te *Maja e Zallit e në Përvosllav. Dhe bjeshka Sinjavica e me Biljanicën dhe poshtë Sinjavicës **Lugu i Romanit* (vendi i sotëm *Romanice* në Rapçë të Epërme ose në Luboshtë) që rrjedh sipri Krai-t dhe nga Krai drejt e në majen *Ranetc* deri te megja e *Kërstecit* nga Pollogu. Dhe kufijtë e Kërstecit nga *Opoja* aty ku udha nga **Fusha e Brodit* del në *Zanogë* e te *Tbanet e shenjtërisë së tij Mbretit dhe ku kjo udhë piqet me *Udhën e Prizrenit mbi pyll që vie nga *Fusha dhe prej aty përtej *Udhës së Madhe në të djathtë midis *Mllakës* [bjeshkë, kullotë ndoshta emri i kryherëshëm i katundit të sotëm Mlikë; vendi i sotëm *Mlaçishta* në Radesh apo njëri nga vendet e quajtura sot *Mullaka e Madhe* në Brodosanë; *Mullaka Pasulit* dhe *Mullaka Donës* në katundin Kosavë të Opojës[34]] e midis Ostrazhnikut, drejt e nëpër mal e në majë

[33] Duket që nuk është ai mali *črna gora*, përkatësisht "na crьnou gorou" që në f. 286 të po këtij dokumenti përmendet për në kufi të katundit Shikla /Shikaj dhe ai *Mali zii* që për në hapësira të Pukës përmendet edhe nëpër burime venedikase. Duket se kemi të bëjmë me malin më të lartë prej 1318 m. midis katundeve Orçushë, Mlikë e Gllloboçicë të Gorës.

[34] Mikrotoponimet aktuale i ka shënuar në terren J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 141.

(siç është caktue me krisobulën për shën Mërinë) dhe prej aty nëpër mal sipri [*]*Lugut të Tudorqit* [ndoshta vendi ku sot është vëllazëria *Tutarci* e katundit Brod, përkatësisht Vranisht] aty ku shkambinjtë bien në Lugun e Tudorqit dhe deri e te kufini i bjeshkës së Radeshit. Dhe bjeshka në Sogovoi-t e Stepanit. Kufini i saj në brigje të Bistricës deri tek Fusha e Rrafshtë e *Sevastokratit* dhe nga *Tbanet e Kryqit* [Pa pretendime se duhet domosdo të pranohet, kujtoj se vazhdimësia onomastike dhe ajo e banimit të pakëputur të popullatës shqiptare në këtë vendbanim është ruajtur deri në ditë tonat tek mikrotoponimet *Te Kisha, Gurra e Kishave* dhe *Kryqi* në katundin e sotëm Kosavë të Opojës] dhe nëpër mal në Samarnicë, në Opogor e në (qytetin) Elovik. Dhe zabelin *Gnoina* "Plehnishtat" [vendi i quajtur sot *Staro gnojište* në katundin Brod] të kishës në [*]Fushën e Dhenve (origj. na òvči poli) [ndoshta vendi i quajtur sot *Ovništa* në katundin Kukolan] nga Gnoino në Jazvinë e në *Milishor* dhe në Ogradno dhe te [*]Lugu i Shtremt e në Zaton, nga Zatoni teposhtë lumit Zalishnica dhe te Lugu i Nxetë pastaj në Gnoino. Secili që me t'fortë e kullot (bagëtinë) në ato shkorrete të igumanit [kujtimi për një epror të këtij rangu mund të jetë ruajtur tek mtp. *Guri Peshkit*, nëse kjo do të jetë trajtë e sajuar nga etimologjia popullore për *Guri Ipeshkvit në katundin Pllajnik të Opojës ?] ta paguajë pashtrakun siç është në ligj. Secili që vendoset me t'fortë (duhet) t'i paguajë mbretit 100 perperë, ndërsa kishës t'i japë atë që asaj i takon sipas ligjit. [Në vazhdim të tekstit të mësipërm flitet për prona të kishës në regjionin e Toplicës e pastaj vazhdon sërish me Gorën] (f. 300 - 302) Dhe madhnia e tij Mbreti e fali *Draica Gërkovik*-un [kujtimi për ekzistimin e individit të cilësuar për "grek" që mund të ketë qenë vetëm një pjesëtar i një vendbanimi më vete nga grekë apo nga sish që e ndjenin veten për të tillë, është ruajtur tek mikrotoponimet *Grčki potok* në Vranisht dhe tek emri *Grekojec* në Leshtan] me të vëllanë e me fëmijët dhe me katundin *Jelenc* që ia kishte dhënë madhnia e tij Mbreti. [Në katundin shqiptar Bellobrad është edhe sot një vend i quajtur *Kralica* dhe një tjetër *Carica* në katundin Mlikë, ndërsa një vend i quajtur *Jelena*[*] është në katundin shqiptar Brodosanë të Opojës]. Dhe me bjeshkën e *Mllakës* [katundi i sotëm *Mlikë* ?,[**] ku është edhe sot një mikrotoponim Mllaka[***]] dhe kufini i Jelenc-it me *Bozovcën*

* J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006. f. 89, 107.

** Kemi të bëjmë me një vend të quajtur sipas nënllojit të durit të pishës së quajtur *arnen* (bot. Pinus peuce Gris.). Emri i këtij druri, sipas Ilia Mitrushi, Drurët dhe shkurret e Shqipërisë, Tiranë 195, f. 45], pikërisht në krahinat e Pukës e të Tropojës dëshmohet në trajtat *mëlikë, mlikë* e *mërlikë.*

*** Nëse mikrotoponimet *Mullagë* mund të lidhen me variantin *mëllak* të drurit të shpardhit (Quercus Frainetto Tem.) të dëshmuar (?) pikërisht vetëm për në rrethina të

[SG: katundi i sotëm i quajtur shq. Buzezë] nga **Mullini i Desilit* [kujtimi për këtë emër vendi është ruajtur tek emri *Desilovci* i vëllazërisë gorane që do të ketë qenë në katundin Brod të Gorës] përroit (teposhtë) nalt mbi Krai tek *Udha e Përtejme dhe mâ tej udhës e te *Lumi i Madh në Sopot dhe përgjatë lumit e në Sllap (ka mundësi të jetë vendi *Slupishta*, në katundin e sotëm Rapçë) dhe nga Sllapi majës përmbi Mllakë [vendi i sotëm *Mllaka* në katundin Mlikë] pastaj nëpër Malin *Venc* [Mali i quajtur edhe sot kështu, i lartë 2381 m.] e te **Guri i Dërtutit* [ndoshta vendi i quajtur sot *Drdevište* të cilin e banon vëllazëria *Dërdovci* në Dikancë e ndoshta, duke e paravenduar mundësinë e metatezës, edhe emri i vendit *Drindovska Ćesma* e *Drindovci*, të një vendi e vëllazërie në katundin goran të Lubovište-s] dhe kodrës teposhtë te **Përroi i Makoçëve* [vëllazëria e sotme *Makočevci* e katundit Brod të Gorës] dhe përroit teposhtë tek Udha e Përtejme dhe udhës e në Biljanicë deri te përroi që vie nga *Meli i Murrëm (f. 303) dhe katundin *Rabça* të japin taksë. Dhe të gjitha katundet e Gorës dhe Shikla të mbeten nën manastirin [...] e igumanit.[35]

Kukësit apo kemi të bëjnë me specien Ostrya Scop. të gjinisë së drurit të mëllezës [khs. Ilia Mitrushi, Drurët. .., f. 331, 360] është punë që unë nuk po mundem t'i bie në fije për shkak të njohurive të mia të kufizuara nga lëmi i botanikës.

[35] "Selo rab'ča s popomь glavatomь i s popomь raikomь. s níhь ródomь i s nihь baštinámi. à megja mu na stlьlpnikь na sini virь. na vlasovo brьdo na rudine. na črьtežь na svirïlincu. po dělu po (f. 280) òbodu na krьvavu lok'vu kako putь upada u česnь na klětì. i nis putь na dva bóra. na vrьhь ruištьь. à s pláv'mi kako su drьžali ot prežde megju sobomь takozi da si i drьže. Selo oba krьstcà i sь zaselki i s vinográdi i s planinomь i sь v'sěmi pravinámi. A megja mu do megje rabьč'ke i do megje pakiš'ke. Selo pakiša i s košarišti. A megja mu iz rěke na bratištevìcu na mratinju crьkvь posrědě kneže nive. ì ot tùdu na crьtežь. na stipanь dólь na vrьhь ĭzь zapogjáni í do hrïsovula bogorodičina. Selo búćije, a megja mù ot plávni posrěd bratoslalja hridà po dělu pravo u potokь. i s potoka na studen'cь konь luč'na do puti. do mit'ropolitova hrïsovulà. i ot brěz'ne bučiju megjà. na ruištà niz' brьdo dělomь do puti. do hrïsovulà mit'ropolitova. Selo radeša i sь zaselkomь radešticomь i sь pláninamï i sь vsěmi pravinámi. a megja mu ot lěštanïi vrьhь slávkovcь. Po dělu niz ostro kamenije u deikova mlačišta. pravo u potokь prěko dola na brьdo na gárь. i ot tudu pravo dělomь kako se kamы vali na svetago nikolu u dolu. iz dola po srěd štedima na kjùrilov'cь putemь na krakь posrěd gar'čicь na mostь u velïju rěku. à ot ópolja radešì megja do bogorodičina hrisóvula u běli grohotь. ou ograg-jeni kamы. pravo niz brьdo na ku'pčišta u ilinu crьkvь kako putь gred po rudině u lok'vicù. i kako putь slazi u velijù rěku, i niz rěku na velii mostь u prьvы bělěgь. Selo brodь i drugi brodь s popoví (f. 281) dikanovíkы. i s nihь rodomь i s nihь baštinamì. i sь zaselkomь grьmljanì, a megja mu ot planine ot prьvoslava na slapь na oblo brьdo. na suhьi studenьcь. na modrïi mělь. niz rěku na milčeva košarišta. i niz rěku kruševьsku do potoka. kako upada zli potokь u rěku. niz rěke uzdělь na prěobrženije. na krьstь u studen'ca putemь velimь na potokь na stratoriju. tere putemь kako cěsta grede u rěku na vranikjè. à črьni gvozd i čiste da sěku u opkinu orčjušà i

Ekzistimin në kontinuitet të kësaj krahine e dëshmon përmendja e nocionit gjeografik Gora, si nahije më vete, edhe në defterin osman të regjistrimit të viteve 1451-1452 të vilajetit Arvanit si edhe burimi i vitit 1571 kur në katundin Zaplugjë të Opojës shqipfolëse përmendet një *Bashtina e Kola Gorës*, që ishte në dorën e Hasanit, të birit të Memit, kalorës.[36] (sh. më poshtë)

---

glьbočica i brodь. iz rěke u jelšije. us potokъ krъstovьčkьì kako se staje zdolomь velimь. i uz veli dolь kako izlazi na dělь na hustь. i ot tud dělomь kako se kamы vali sěmo i onamo na slavkov'cь. I u sih'zi selěhь u crkovnihь u gorě. što se nahodi koupljenica ì prikija žoup'ska da ju drъže à što se obrěta ou žoupě koupljenica ìli prikija crьkovnьihь ljudi. da si ju takoždє drъže a megja da stoi kako je upisana u hrisovulě." (f. 282) [...] "A megja planinamь prъvoslavu, grebištemь. plóčì. radeškoi planině. hrabrovo polje, sopotь. mavrъ, ĭrošь. à megjà imь ot opolija na ogragjeni kamenь. na ùši na sopotь. po vrьhu nadь milištь katúnь. kako dělь gred mimo sijo lokvu na črьní kamenь. putemь u potokъ kako potokъ u rěku upada. Na vrьhь dupničьskьi. dělomь na krivošiju. po vrьhu na grebište. na pěš'čani vrьhь na prъvoslavà. I planina sinjavica i z bilijanicomь. i niže sinjavice romanь dolь. kako pohodi nadь kraì. i ot krajà pravo u vrьhь ranetьcь. dotlezi megja krstьcù ot pologa. A megja krstьcù ot opoljà. kako putь ìshodi ot borъskoga poljà i ishodьi na zanogù na stanište svetago krala. i tьzi putь kako se staje s putemь prizrěnьskьimь vьiše gvozda koi grede ot polija. i ot tud prěko puti velijega na desno. megju mlake i megju ostražnikь. pravo uz dělь u vrьhь do hrisovula bogorodičina. i tud po dělu nadь tudorьčь dolь. kako se kamы vali u tudorьčь dolь. i ot tud do hrisovula bogorodičína i do megje radeške planine. I planina na sogovoi stepanova. A megja jei na brъši bistrice. do sevastokratove megje ravne. I do stanova krsta. i po dělu na samar'nice. na opogorъ na elovikъ grad. I zabělь crьkovnomù dobitku na òvči poli gnoìna. ot gnoine na jazvine i na *mlišorà* i na ogradno. i na krivьi dolь. i na zátonь. ot zatona nizь rěku zališnicù. i na tople dol'ce. tere po gnoino. i na sije zaběle kto suždene pasti po igumanovu rečeniju. vsakъ da daje travninou kako je zakonь. Ktoli souždєnє posiljemь da plati carou sto pєrpєr. a crьkvi dohodьkь po zakonou" [në vazhdim të tekstit të mësipërm flitet për prona të kishës në regjionin e Toplicës e pastaj vazhdon sërish me Gorën] (f. 300-302) "I priloži carstvomi draicu grьkovikja z bratiomь i z dětiju i selomь jelen'emь, što mu je dalo carstvomi ì s planinomь mlakami. A megja jelen'cu sь bozovci. ot desilove voděnice us potokъ. gorě nad kraĭ u prekьi putь. i vse putemь u veliju rěku u sopotь. i vse uz rěku na slapь. i ot slápa po vrьhu nad mlake. tere po věn'cu na *drьtutovu klětь* i niz brьdo u potokъ makočev'skïi. i nis potokъ u putь preьi. i putemь u biljanicu do potoka koi grede iz modrìhь mělcь" (f. 303) [...] "i selo rabča da daju lučь. à vsa gorьskaa sela i šikljà da stoje u manastьiri na paramune kolicěmь velï igumanь." (f. 305), Hrisovula cara Stefana Dušana koiomь osniva monastirь Sv. Arhangela Mihaila i Gavrilja u Prizrenu godine 1348 ? Glasnik Društva Srbske Slovesnosti 15 (1862), bot. J. Šafarik, f. 282, 300- 303, 305.

[36] Selami Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI, (Studime dhe dokumente),Tiranë, 1983, f. 345.

2.1. Venerime përkitazi me Gorën e me Opojën mbi bazën e të dhënave të burimit kishtar serb të vitit 1348

Në këtë dokument, që është më i madhi për nga vëllimi i shek. XIV dhe që ka të bëjë me krahinat e Gorës e të Opojës, dëshmohen emrat e vendbanimeve gorane: *Rabça, Kërstec, Pakish, Zapod* (khs. mtp.: *Selo pakiša. .. na stipanь dólь na vrьhь ĭzь zapogjáni. ..*), *Radesh* (bashkë me një lagje të tij *Radeshtica*), *Leshtan*, dy katunde që quheshin *Brod* (bashkë me lagjen Gërmljani), *Zli Potok, Vraniq, Orçusha, Glloboçica, Mlika* (?), *Krusheva* (khs. mtp. *rěka kruševьska*), katundi *Borje* (khs. mtp. *ot borskoga polja* e ndoshta edhe vendin *dva bora* që po më 1348 përmendet për kufi i katundit Rabça); katundi *Dikancë* (khs. emrin e vëllazërisë *Dikanoviki*), katundi ose qyteti i zhdukur *Jelenc* dhe emri i vetë regjionit të Gorës. Në këtë burim nuk ka asnjë të dhënë as lidhur me përkatësinë etnike e as me numrin e kryefamiljarëve apo me numrin e banorëve të vendbanimeve që përmenden në këtë dokument.

Mikrotoponime të tipit antroponimik të dëshmuara në këtë burim, që paraqesin interes për temën e shtruar në këtë trajtesë, i konsideroj: *Vllasovo Bërdo, *Ara e Knezit, *Mllaçishtat e Deikut, *Kisha e Ili(u)t, *Kisha e Mratit, *Tbanet e Milqit, Milishor*-i, **Fusha e Hrabrit, *Lugu i Romanit, *Lugu i Tudorqit, *Mullini i Desilit, *Guri i Dërtutit* dhe **Përroi i Makoçëve*, ndërsa nga mikrotoponime apelativike veçojmë: *Stratori, Mavra, Ranetc* dhe **Fusha e Sevastokratit*. Nga fusha e antroponimisë, ky burim përmban vetëm katër emra dhe pikërisht emrat e priftërinjve *Gllavat* e *Raiko*; emrin *Dikanoviki* të një familjeje priftërinjsh dhe emrin e një banori *Draica Grkovik*.

Me interes është në këtë mes rrethana që në këtë dokument dalin më shumë se një distinktiv për kullotat e për tbanet, përkatësisht për *bjeshkën*. Këtu mësohet se *bjeshkë* "kullota" të vetat kishin pasur katundet Kërstec "Të dy katundet Kërstec me lagjet dhe me vreshtat e me bjeshkën dhe me të gjitha të drejtat"; Radesh: Bjeshkët e Radesh-it; Katundi Radesh bashkë me lagjen e tij Radeshtica dhe me bjeshkët e me të gjitha të drejtat";[37] Brod [khs. tekstin në referencën 35 të kësaj trajtese]; Jelenc, që një herë cilësohej për qytet e herën tjetër për katund, të cilit i takonte bjeshka e quajtur Mllakë, përkatësisht vendbanimi i ngritur më vonë i quajtur sot Mlikë. Përveç kësaj, në këtë dokument ka katër nocione për vendbanimin e tipit blegtoral: nocioni më i vjetër që ardhësit sllavë do ta kenë gjetur tek popullata vendëse: *katunь* [khs.

[37] Khs. origjinalet "Selo oba krьstcà i sь zaselki i s vinográdi i s planinomь i sь v'sěmi pravinámi" dhe *Radeške planine*; Selo radeša i sь zaselkomь radešticomь i sь pláninamï i sь vsěmi pravinámi" në referencën 35 të kësaj trajtese.

Milšin katunь]; *stanište* [khs. *stanište svetago kralja*]; *stanь* [khs.: *do stanova krsta*, në Kërstec] dhe *košarišt* bullg. "vath" [në katundin Pakish]. Është çështje që duhet të shihet më tej nëse regjioni i quajtur Gora duhet të mbahet për si një organizim i mirëfilltë prej regjioni blegtorësh siç na paska qenë ai i Kuçëve në Mal të Zi të sotmin[38] apo nëse emri i këtij regjioni dhe i banorëve të saj *Gorani* "bjeshkëtarë" u sajua nga emërtimi përshkrues sllavisht i regjionit malor në të cilin vetëm u strehuan vlleh, romanë ballkanikë të bullgarizuar në hapësirën gjuhësore të bullgarishtes. Në të mirë të mundësisë që vlleht e ardhur të bullgarizuar u quajtën sipas cilësisë së konfiguracionit të kësaj pjese të Maleve të Sharit "bjeshkë" sikur do të fliste mungesa si e emrave të përcjellur me atributin "i, e vllehve" siç kishte ndodhur me sosh në regjionet e Mitrovicës, Llapit e të Podrimes nëpër të cilat dëshmohen vlleh ardhës të bullgarizuar (khs. *katun blgarski* sot Bugariq; *vlasi Bareljev'ski*, sot mali *Barel* në Kovaçicë të Shalës së Bajgorës dhe emrin *Barilevë* të katundit midis Prishtinës e Podujevës si dhe (një pjesë?) të folësve të bullgarishtes në qytetthin e Rahovecit).

Se popullata e krahinës së sotme të Gorës nuk do të ketë qenë në krye të herës (gjysma e parë e shek. XIV) as popullatë etnikisht bullgare e aq më pak serbe nuk do ta tregonte as rregullimi sipas sistemit të vëllazërisë i saj [gjë që më së miri mbase e tregon cilësimi i popëve *Dikanoviki*, emri i të cilëve përcillet me sqarimin *i s nihь rodomь* "*dhe me gjininë, farefisin, fisin, vëllazërinë e tyre*"] - formacion shoqëror ky që nuk ishte karakteristik vetëm për sllavët, porse një formacion të cilin fiset ardhëse të sllavëve e gjetën pikërisht tek shqiptarët e tek vlleht. Të njëjtën gjë e tregon mbase edhe nocioni *općina* që në disa të folme lokale të shqipes e ka sot kuptimin "gjini; vëllazëri; fis" - nocion që në dokumentin tonë kishte të bënte me hapësirë kullotash që do ta shfrytëzonin bashkarisht banorët e katundeve Orçushë, Gllboçicë e Brod të Gorës. Evitimi i përdorimit nga shkruesi serb i termit, pas gjithë gjasash me prejardhje shqipe, *katunь* për tbanin (që në vetë këtë dokument dëshmohet vetëm në mikrotoponimin *milištь katúnь* "katuni Milisht"), do ta tregonte mbase bukur bindshëm karakterin librar të termave sllavë *stanь*, *stanište* e *košarišt*, të përdorur mbase me qëllim të mbjelljes së ndjenjës se këtu paskemi të bëjmë me një ambient serb.

Rrethana që ndër emra vëllazërish të goranëve në gjysmën e parë të shek. XIV nuk kishte emra që domosdo do të merreshin për si karakteristikë serbë (sepse s'pati zhvillime të tilla që do ta diktonin

[38] Përkitazi me shtrirjen territoriale të rrethit (nahijes) të Kuçit khs. Idriz Ajeti Shqiptarët dhe gjuha e tyre, Prishtinë, 1994, f. 41.

ngulitjen e emrave të kësaj provenience) tregon mbase fort qartë se as pushteti e as kisha serbe nuk kishte mundur të shtinte rrënjë në këtë regjion malor të banuar kryesisht nga blegtorë, të cilëve edhe për nga mënyra tradicionale blegtorale e jetesës nuk u interesonte një religjionit i huaj. Kjo mund të shpjegohet mbase me faktin që goranët, qofshin këta romanë ballkanikë/ vlleh të ardhur nga zona bullgare e pjesërisht greke të banuara nga vlleh (siç do ta tregonin mbase emrat *Sarandovci*, *Kërçovci* e *Mijaçovci* (sh. edhe më poshtë) apo në qofshin këta edhe pasardhës bogumilësh/pomakësh, nuk u inkuadruan kurrë në kishën orthodokse serbe. Formacioni jetëshkurtër shtetëror serb dhe kisha e tij me emisarë të dërguar atje me dekret nuk kishin arritur të kishin në këtë zonë kurrfarë ndikimi në drejtim të konvertimit të kësaj popullate baritore në ortodoksinë serbe. Ky formacion shtetëror pushtues nuk kishte arritur të kishte, përkatësisht të evidentonte këndej më shumë se 3 priftërinj e 3 kisha sado që pothuaj i gjithë regjioni ishte bërë pronë e manastirit të shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit, disa nga të cilat ishin prona të igumenit të emëruar zyrtarisht e edhe më pak të tilla që i paskan pas takuar mbretit (Stepan Dushanit). Në vija më të largëta, këto rrethana tregojnë se pararendësit e goranëve të sotëm nuk ishin në gjysmën e parë të shek. XIV blegtorë nomadë, por popullatë ndenjëtare që do të kishte pasur edhe toka buke e madje edhe vreshta, ndërsa tbane e kullota, si rezultat i kultivimit të blegtorisë transhumane krejtsisht normale në varshmëri me konfiguracionin e terrenit, jo larg apo sipri vendbanimeve të tyre të ngulitura relativisht rrafshinore po se po. Kësaj të vërtete i del krah edhe rrethana se popullata e vetëm ndonjë katundi - siç ishte rasti i dy pjesëve të katundit Kërstec, do të jetë marrë edhe me vreshtari. (khs. referencën 35)

Për në krahinën fqinje të Opojës në këtë burim dëshmohen emrat e vendbanimeve *Pllava*,[39] *Buçje*, *Brezne*, *Buzezë*, përkatësisht *Bozovce* dhe emri i vetë krahinës *Opoja*. Në këtë burim nuk dëshmohet asnjë emër personal i banorëve të kësaj krahine.

[39] Duket që katundi i sotëm Pllavë përmendet në një kartë të vitit 1327 përmes së cilës sundimtari serb Kishës së Shën Mërisë në Malin e Shenjtë, Hilandar ia falte disa katunde, khs. tekstin: "Dhe, mbretëria ime, Kishës së Shën Mërisë ia fali dy katunde: Izbishtën dhe Truallishtën e Komanit" dhe të lidhur me këtë kontekst ". .. pas qytetit të Prizrenit edhe katundin Plavino, katundin Dobrodolc, katundin Izbishtë dhe Truallishtën e Komanit", khs. origjinalin: "I ješte priloži kraljevьstvo mi dvě sɛlě: Izbišta i Komanovo Sɛlište Bogorodici hьilandar'skoi." [..] za gradom Prizrenomь i sělo Plavino, selo Dobrodolьcь, sělo Izbišta i Komanovo Selište." te St. Novaković, Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka, Beograd, 1912, f. 396, 398.

Nga lënda onomastike e përmbajtur në këtë dokument del se më shumë se gjysma e emrave të vendbanimeve të kësaj krahine janë me origjinë sllave; të tilla janë edhe pjesa absolute më e madhe e mikrotoponimeve të përmendura në këtë burim. Mikrotoponimet e dëshmuara në këtë dokument janë, në pjesën më të madhe të tyre, të prejardhjes apelative sllave dhe janë të karakterit përshkrues. Sido që të jetë, përveç pjesës mbizotëruese sllave, në mikrotoponiminë e këtij regjioni dhe pikërisht në këtë dokument dëshmohet edhe ndonjë emër me prejardhje nga greqishtja e mesme si emri *Mavra* i malit dhe ai i vendit *Strator*; një emër që përmban termin kishtar bizantin (të hyrë në terminologjinë kishtare serbe); apelativin me prejardhje greke *sevastokrat* e ndoshta edhe vetë praninë e ndonjë greku siç do të jepte të kuptohej mbiemri *Gërkoviq* i banorit të quajtur *Draica*.

Aspak më pak sllave nuk është as antroponimia e banorëve të Gorës, për aq sa ajo dëshmohet në këtë burim. Këtu janë dëshmuar antroponimet e të gjallëve *Gllavat*, *Raiko* e *Draica*, ndërsa nëpër mikrotoponime të sajuara nga antroponime në trajta të tyre të ngurosura e, pra, më të vjetra se koha e lindjes së këtij dokumenti, janë dëshmuar antroponimet *Bratoslal*, *Deik*, *Desil*, *Dikan*, *Hrabar*, *Makoč*, *Miliš*, *Milić*, *Milšor* e *Roman*, përkatësia gjuhësore sllave e të cilave nuk mund të vehet në dyshim, si edhe dy antroponime të cilat mund të jenë me prejardhje romane ballkanike, përkatësisht vllahe: *Dërtut* e *Tudorč* dhe titulli administrativ *knez* që rëndom u jepej kryeparëve të katundeve vllahe.[40] Ka, së fundi, në mikrotoponiminë historike të Gorës edhe dy antroponime, emra shenjtorësh, që i mbajnë dy kisha të dëshmuara në këtë burim: *Mrat* dhe *Il*. = **Hil*? (khs. tekstin origj. në referencën 35).

2.2. Vazhdimësi e emrave mesjetarë të vendeve në mikrotoponiminë dhe në emrat modernë të vëllazërive në krahinat e Gorës e të Opojës

Në mikrotoponiminë aktuale të regjionit të Gorës ka një kontinuitet të pandërprerë të disa mikrotoponimeve të përmendura në dokumentin e vitit 1348. Kështu p.sh., emri stlьlpnikъ i vitit 1348 është ruajtur deri në ditë tonat tek mtp.* *Slupišta* në Rapçë e Epërme;[41] emri *Vlasovo brьdo* është ruajtur mbase tek emri i vendit *Vlaška*, dhe *Vlaški potok* në katundin

[40] Më gjerësisht për kuptimin e këtij termi shih te Desanka Kovačević, Srednjovjekovni katuni po dubrovačkim izvorima, Simpozijum o srednjovjekovnom katunu, Sarajevo, 1963, f.133-135.

* shkurtesë për: *mikrotoponim.*

[41] Të gjitha mikrotoponimet aktuale janë marrë nga libri i Jusuf Osmanit, Qytetet e Kosovës, 20, Shari (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 92, 112, 130, 131, 135, 142.

Vranisht, emri i vendit *česnь* ka mundësi të jetë vendi i quajtur *Çestak* në Rapçë të Epërme dhe të Poshtme; vendi *dva bóra* ka mundësi të jetë mtp. i sotëm *Orvanik Bor* në Rapçë të Epërme; *Štedim* i v. 1348 është vazhduar në trajtën *Štedinište* në katundin Brod; vendi i përmendur *Oblo Brdo* i vitit 1348 për në katundin Brod është ruajtur deri sot si *Oblo* po në këtë katund; lumi i përmendur më 1348 si *Velija Reka* është *Radeška Reka* e sotme - lum i katundit Radesh të Gorës; mikrotoponimi *Beli Grohot* i vtit 1348 është emri i sotëm *Beu kamen* i një shkëmbi në katundin Brod: një tjetër mtp. *Befkamen* është edhe në Radesh; emri *Ogradjeni Kami* i vitit 1348 është vendi i sotëm *Zagrajec* i Radeshit; vendi i quajtur në vitin 1348 *Gar* që përbënte një pikë kufiri midis Radeshit dhe katundit Leshtan të Gorës është ruajtur deri më sot po me këtë emër /*Gar*/ edhe në Radesh edhe në Leshtan [vetëm sa për plotësim po shtoj se një vend i quajtur *Garçicë*, është edhe në katundin Gostil, përkatësisht Bellobrad ku del edhe mtp. korelat semantik *Shkrumëza* i shqipes]; edhe vendi *deikova mlačišta* mund të jetë ruajtur tek mtp. aktual *Dejkine Vode* në Krushevë; vendi *Stlьpnik* i përmendur më 1348 për në katundin Rapçë është ruajtur si *Slupishta* po në Rapçë; kujtimi për tbanet, *Košarišti* të katundit Pakish, që sajonin mexhë me katundin Kërstec, është ruajtur në Kërstecin e Vogël po si *Koshare*; mali i paemër që më 1348 përmendet për si kufi i katundit Buçje me katundin Pllavë të Opojës duket se është ruajtur me emrin *Pylli* që ekziston edhe sot në katundin Buçje; emri *Lučna* i vendit që në vitin 1348 përbënte njërin nga pika të kufinjve midis katundeve Buçje e Brezne të krahinës së Opojës është ruajtur tek emri i sotëm *Drita e Bjeshkës* në katundin e sotëm Brezne; kujtimi për një vend që në vitin 1348 mbase i takonte mitropolitit është ruajtur tek emri i vendit *Guri Peshkit* [Ipeshkvit?] - (një trajtë e dalë si rezultat i etimologjisë popullore) në katundin Pllajnik të Opojës; kujtimi për kishën e Shën Kollit do të jetë ruajtur mbase tek mikroponimet *Lisi i Shën Kollit* dhe *Kishat* në katundin shqiptar Kapre të krahinës së Opojës; përroi *Zli Potok* i vitit 1348 është ruajtur te emri homonim i katundit të krahinës së Gorës; emri *Stratorje* është vazhduar si i këtillë (Stratorje) në katundet Baçkë, Mlikë e Zlipotok,[42] ndërsa po si *Stratorje* e *Stratorski Potok* e ndeshim edhe në Lubovishtë dhe po si *Stratorje* edhe në katundet Glloboçicë e në Krushevë.

Me vazhdimësi të pandërprerë në të banuar kemi të bëjmë mbase edhe me vendin e dëshmuar më 1348 si *Ovče Polje (khs. emrin në rasën vendore *na òvči poli* "në Fushën e dhenve" që e sajonte njërën nga

[42] Mikrotoponimet aktuale të këtij regjioni i huazova nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 84, 88, 92, 91, 100, 111, 118, 121, 129, 131,.150., 115, 118, 143, 142, 125, 105, 112.

mexhët e bjeshkës së katundit Kërstec me krahinën e Opojës). Ky mikrotoponim mesjetar ruhet mbase deri në ditë tonat tek emri *Ovništa* i një vendi në katundin Kukolan të Gorës. Vazhdimësinë në të banuar të goranëve në këtë zonë së pakut qysh para shekullit 14 do ta tregonte mbase edhe mikrotoponimi *Radeškovina* i cili duket të jetë vazhdim i tjetërsuar vetëm përnga prapashtesa e emrit *Radeštica* që si lagje e Radeshit përmendet më 1348 (sh. më lart). Një vazhdimësi onomastike që, në rastin tonë, nënkupton edhe vazhdimësi në të banuar, do të vërehej edhe tek emri *Grmljani* i dëshmuar në vitin 1348 për si lagje-pjesë e katundit Brod të Gorës. Ky emër qenka ruajtur si i këtillë deri në ditë tonat, thotë J. Osmani.[43]

Duket që i pandryshueshëm është ruajtur edhe emri *Venc* i malit që në dokumentin e vitit 1348 shenjonte një hapësirë midis katundeve të sotme Mlikë (*Mllakë) e Rapçë. Në këtë mes duhet vërejtur porse që në hapësirën e banorëve shqipfolës të Opojës ka më shumë se dy mikro-oronime të vazhduara nga latiniteti e nga romaniteti ballkanik, semantikisht të barasvlerëshme me nocionin sllav Venac.[44] Me vazhdimësi kemi të bëjmë edhe tek emri *gnoino* i dëshmuar në vitin 1348, i cili ruhet tek emri i sotëm *Staro gnjoište* "Plehnishta e Vjetër" të katundit Brod. I së njëjtës prejardhje mund të jetë mtp. *Gllojnishta* në Brezne, nëse mund të paravendohet një kalim nga një *Gnojilišta. Korelat semantik i mtp. mesjetar gnoino në Opojë janë emrat *Gjybra* /*Xhybra* (khs. psh. *Xhybra e Madhe* në katundin Kuk; *Gjybra Rrafsh* në katundin Kuklibeg dhe *Xhybret* në katundin Bucje të Opojës,) që e heqin prejardhjen nga fjala turke me kuptimin "pleh".

Dëshmi të vazhdimësisë në të banuar të pararendësve të goranëve në këtë hapësirë, përveç në toponimi, ka edhe në fushën e emrave të vëllazërive të cilët ose janë ruajtur me atë funksion ose e kanë marrë rolin e oikonimeve (emrave të vendbanimeve). Kështu p.sh. emri i katundit goran *Dikance*, që në të vërtetë është një emër vëllazërie i toponimizuar (i cili e ka për rrënjë antroponimin *Dik,-an*) është vazhdim i emrit të familjes së popëve *Dikanoviki* të vitit 1348. Dëshmi e ekzistimit të kësaj familjeje janë ruajtur mbase edhe tek emri i vendit *Dikaçenko* në katundin e sotëm Brod, ndërsa kujtimi për kishën apo njërën nga kishat,

[43] khs. Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 104. Mirëpo, këtu kemi një shembull tipik për brezin e tanishëm të dijetarëve kosovarë që e kruajnë veshin e majtë me dorë të djathtë, përkatësisht që sikur nuk shkruajnë për lexuesin, por vetëm për vetveten. Thënia ime e mësipërme ka të bëjë me rrethanën që nga teksti që e sjell autori nuk mund të kuptohet lehtë se në cilin vend ndodhet mikrotponimi *Gërmljani*: në Brod apo ë Dikancë.

[44] khs. për këtë të dhënat nën njësinë *Koroni* të kësaj trajtese.

ku pjesëtarë priftërinj të kësaj familje e ushtronin aktivitetin e tyre kishtar do të jetë ruajtur tek emri *Crkvište*[45] "Truallishtë kishe", përkatësisht *Crkviče, Pocrkov* e *Popove rupe* në vetë katundin Dikancë të Gorës. Një dëshmi për qenien në përdorim të antroponimit *Dik-* nga banorë të viseve kufitare të Gorës e kemi në vitet 1467-1468 kur për në mbase katundin e sotëm homonin në juglindje të Gostivarit *Gorno Turčani* dëshmohej një kryefamiljar i quajtur Jovan-i, i bir i *Dik-ut* (: Jovan, sin na Dike).[46] Në këtë mes do të duhej shtuar që emri *Dik,-an* është ruajtur edhe tek emri *Dikaj* i një vëllazërie shqiptare të katundit Brodosanë të Opojës. Ky emër është i përhapur edhe në krahinën e Sanxhakut, të banuar në pjesën më të madhe nga shqiptarë Kelmendas të vendosur atje në fund të shek. XVII ku ky, si emër femëror ndeshet në trajtën *Dika*, ndërsa në hapësirën e Rrafshit të Dukagjinit dëgjohet - po si emër femëror - në trajtën *Dykë* por, siç do të tregonte mikrotoponimi *Ledina e Hasan Dyk's*, në katundin Rakoc të Dushkajës së Gjakovës[47] edhe si emër mashkullor.

Në të mirë të mundësisë që këtu kemi të bëjmë me një emër të vjetër të shqiptarëve do të fliste mbase edhe rrethana që këtë e ndeshim edhe shumë larg nga Gora e nga Rrafshi i Dukagjinit, përkatësisht në krahinën e Gallapit, në katundin Makovc i Epërm të të cilit është ruajtur emri *Dikaj* i një vëllazërie, natyrisht, shqiptare.[48] As emri i vëllazërisë gorane *Makoçevci* e katundit Brod nuk mund të ndahet nga mikrotoponimi i dëshmuar më 1348 si *Potok Makočevski* në kufirin midis katundit sot të panjohur Jelenc dhe katundit Bozovci (sot Buzezë) të krahinës së Opojës (khs. tekstin origjinal në referencën 28 të kësaj trajtese) në të cilin ruhet po ashtu një emër vëllazërie që për të parë e kishte një Makoç.

Me raste kontinuiteti jo vetëm emëror, porse edhe territorial, kemi të bëjmë edhe tek emri i vëllazërisë gorane *Drdinci*, var. *Dërdovci* përkatësisht *Drdevište* të katundit Dikancë i cili s'ka si të jetë tjetër përpos emri që përmbahet në mikrotoponimin e shek. XIV *Drëtutova klět* "Shkrepi i Dërtutit" që ndodhej midis katundit Bozovci (sot Buzezë) të Opojës dhe katundit Mlaka (sot Mlika) të regjionit të Gorës.[49] Edhe emri i lugut *tudorъčъ dolь.* duket të jetë ruajtur në trajtë të ndryshuar tek emri *Tutarci* i një vëllazërie të katundit Vranisht.

[45] Emrin e lagjes në katundin Brod dhe topogërmadhën *Crkvishte* (S.G.: Crkvište) i ka shënuar në terren Jusuf Osmani, Venbanimet e Kosovës 20, …, f. 91, 104.
[46] Khs. Tturski dokumenti za istorijata makedonskiot narod. .., f. 371.
[47] Khs. Prof. Skënder R. Hoxha, Toponimia e Dushkajës, Jakova, 2007, f. 247.
[48] Këtë emër e ka shënuar në terren Ali S. Berisha, Gallapi i Prishtinës, 2007, Dorëshkrim.
[49] Hrisovulja …, f. 302.

Me kontinuitet kemi të bëjmë mbase edhe tek emri i kullotës *milištь katúnь* dhe tek emri i tbanit *milčeva košarišta* të cilët duket të jenë të pandashëm nga antroponimet e dëshmuara *Miliš* e *Milić* po në atë dokument të vitit 1348. Në këtë rast, tek emri *Milisht* i katunit/tbaneve do të kishim të bënim me toponimizim përmes prapashtesës sllave *-išt, e* të emrit *Mil, Milić* në *Milišt* që do të tregonte pronësi, apo vend të shfrytëzuar nga vëllazëria *Miliš, Milić*. Pas më shumë se 120 vitesh kontinuiteti, përkatësisht sipas defterit osman të viteve 1451-1452 (khs. më poshtë) këtë emër e mbante edhe banori *Milic* i katundit Brod të Gorës.

Në dritën e këtyre të dhënave onomastike ka arsye të paravendohet që të dyja këto dëshmi kanë të bëjnë jo vetëm me pararendës të vëllazërisë së sotme *Miljkovci* të katundit Radesh të Gorës, përkatësisht me vazhdimësi të pakëputshme onomastike-territoriale të bazës emërore *Mil-* (mbase të sllavishtes) të dëshmuar që në shek. XIV-XV, porse ndoshta edhe me emrat aktualë[50] *Milogojovci* të një vëllazërie po në katundin Vraniq dhe me emrat e vendeve *Milikeja* në katundin Brezne, *Milisos* në katundin Bellobrad dhe *Kodra e Mile* në katundin Brrut të krahinës shqiptare të Opojës.

Fundja, mbase nuk mund të jetë krejt e rastit që edhe në një ambient vllah siç është qyteza e Rahovecit me rrethinë, për mbase si dëshmi e gjëllimit këndej të vllehve, po në vitin 1348 për si pikë kufiri e Rahovecit dëshmohet një vend i quajtur *milšina sєlišta*[51] "Truallishtat e Milshit".

Ka arsye të besohet që në ndonjërin nga këta emra duhet përmbahet trajta e sllavizuar e variantit më të vjetër vllah *Milishor* të këtij mikrotoponimi. Së fundi, kujtimi për grekun e quajtur *Draica* të krisobulës së vitit 1348 do të jetë ruajtur mbase tek mtp. *Grčki potok* në katundin Vranisht [në katundin Leshtan është edhe një vend i quajtur *Grekojec*] të krahinës së Gorës.

Nuk mund mbase të përjashtohet mundësia që edhe tek emri *Gabrojica* i një komleksi toke në katundin Zli Potok të krahinës së Gorës të kemi të bëjmë me njërën nga vreshtat që në dokumentin e vitit 1348 dëshmohet të ketë qenë pronë e kishës së Shënkollit të Prizrenit. Në pronësi të kësaj kishe ishin edhe dy vreshta, njërën nga të cilat kisha e kishte ndërruar për një tjetër në vendin Kurile, me atë në vendin Gabrovci. Khs. tekstin: "Dhe njerëzit e kishës së Shënkollit që janë me vendbanim në qytet: Gin Rakoča, Rad Slepčev, Leiko Stuparevik.[...] Dhe, vreshtat e kësaj kishe [...] dhe vreshta e dytë (tjetër) në Gabrovci, të cilën e ndërruam me pjesën e *kamatnik -u*t Dabiživ në Kurile dhe me dy pjesë

[50] Të shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, f. 95, 97, 106,129, 142.
[51] Khs. Hrisovuilja..., f. 276.

të tjera të vreshtave të Ivanko Tkač-it.[52] "vektorit Ivanko". Mundësia që këtu kemi të bëjmë pikërisht me vendin e sotëm *Gabrojica* të Zlipotokut bëhet e besueshme në dritën e rrethanës së njohur që pronat e manastirit të shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit dhe të kishave nën juridiksionin e tij shtriheshin nëpër gjithë krahinën e sotme të Gorës.

Për i identifikueshëm në terren si rezultat i kontinuitetit në të banuar mund të merret në këtë mes edhe emri i një katundi *Marindol* që qenka përmendur në një burim kishtar serb[53] i cili (katund) paska pas qenë në kuadër të katundit të sotëm Kukajan. Unë e identifikoj emrin mesjetar me mikrotoponimin e sotëm *Marin Dof* të këtij katundi, sado që emra vendesh që e përmbajnë antroponimin *Marin* (i dëshmuar dendur për antroponim i shqiptarëve në Opojën e shek. XVI) ka edhe në ndonjë katund tjetër të këtyre dy regjioneve, khs. psh. *Marino livade* në Baçkë dhe *Marinec* në Rapçë të Poshtme.[54]

Nga identifikimet e mësipërme rezulton se të dhënat aktuale onomastike e dëshmojnë katërcipërisht vazhdimësinë e pakëputshme të emrave të dëshmuar më 1348, qofshin ata mikrotoponime, oikonme apo emra vëllazërish. Kontinuiteti emëror nënkupton edhe kontinuitetin në të banuar. Kjo jo vetëm pse nuk ka ndonjë shënim për ardhje apo largim të ndonjë popullate në e nga ky regjion së pakut para shek. XIV, por pse vetë dokumenti kishtar serb e pasqyron gjendjen onomastike të gjetur në vend në kohën kur kisha serbe ishte në zenitin e përvetësimit të tokave të popullatave mbi të cilat e kishte shtrirë juridiksionin e saj. Kjo rrethanë tregon se pararendësit e popullatës së sotme gorane jetonin në këto vende edhe shumë kohë para gjysmës së parë të shek. XIV, përkatësisht para lindjes së burimit të shfrytëzuar në këtë pjesë të trajtesës sonë.

Sado që nuk dihet ndonjë dokument në të cilin popullata e Gorës do të jetë cilësuar shprehimisht për si vllahe, në të mirë të kësaj origjine do të shkonte e dhëna onomastike, përkatësisht përmendja pikërisht në vitin 1348 në një dokument raguzas e një vllahu të quajtur *Gugna Dragosch(e)vich Blacus*. Ekzistimi deri në ditë tonat i emrit *Gugna* të një vëllazërie/ familjeje në katundin Brod të Gorës,[55] do të mund të mbahej

[52] Khs. origjinalin te Hrisovulja …, f. 271. "A se ljudje koi sou ou gradou i sь stasmi ginь rakoča, radь slěpčevь, leiko stuparevíkь. [...] a se vinogradi crьkve tęi [...] i drougi vinogradь ou gabrov'ci, i zaměnismo ihь kamatnikovoù tkačou na kourilěhь."

[53] Kështu mësohet nga literatura e cituar nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006.20, f. 116.

[54] Mikrotoponimet i ka shënuar në terren J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 84, 131.

[55] Të shënuar në terren nga S. Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

për edhe një dëshmi e ruajtjes së uzusit antroponimik të vllehve të shpërngulur nga pjesa Jugore e Ballkanit që kishte arritur deri para dyerëve të Raguzës dhe deri në Istri.

Burimi, përkatësisht krisobula e sundimtarit serb St. Dushan, i vitit 1348 tregon se edhe regjioni i Gorës dhe popullata e saj ishte në pjesën më të madhe, së pakut sipas asaj sa e siç shkruhej në këtë buirim, e lidhur dhe e inkuadruar *formalisht* në kishën mesjetare ortodokse serbe. Kjo shihet qartë në dritën e rrethanës që në hapësirën aq të madhe të përshkruar të regjionit të Gorës, në këtë burim dëshmohen porse vetëm tri kisha: e *Shën Mratit* në Pakish, e *Shën Ilit* në kufirin midis katundit Radesh të Gorës dhe krahinës së Opojës dhe kisha e *Shën Kollit* në vetë katundin Radesh. (për saktësimin territorial khs. tekstin origjinal në referencën 35 të kësaj trajtese). Çështjen e identifikimit në terren të këtyre tri kishave unë nuk mund ta zgjidh në këtë mes sa kohë që nuk e kam para vetes mikrtoponiminë e katundit Pakish të rrethinave të Kukësit ku do të ketë qenë *Kisha e shën Mratit* dhe sa kohë që në mikrotoponiminë aktuale të katundit Radesh të Gorës nuk ka ndonjë emër vendi që do ta ruante kujtimin e ekzistimit aty të ndonjë kishe kushtuar Shënkollit. Vështruar mbi bazën e shtrirjes së sotme të vendbanimeve, kisha e *shën Ilit* do të duhej të kërkohej në hapësirën e katundeve shqiptare që sot e rrethojnë Radeshin: Pllajnik, Xërxë, e Shajne të Opojës dhe Leshtan e Lubovishtë të Gorës. Në katundin e parë (Pllajnik) fqinj territorial i parë i Radeshit ekziston sot mikrotoponimi *Te Kishëza*, një tjetër i quajtur *Kishëz* dhe mikrotoponimi *Guri i Peshkit*[56] (ndoshta *Guri i Ipeshk'vit); në pjesën lindore të katundit Xërxë ekzistojnë edhe sot mikrotoponimet *Te Kisha* dhe *Livadhi Priftit*; në katundin Shajne (sllav. Šainovci) ekzistojnë po ashtu mikrotoponimet *Zabeli Kishës* dhe *Livadhi Priftit*, ndërsa në katundet gorane të Leshtanit e të Lubovishtës nuk ka ndonjë mikrotoponim që do ta ketë ruajtur kujtimin për ekzistimin aty të ndonjë kishe. Mbështetur mbi mikrotoponiminë aktuale, mua më rezulton që mbase asnjëra nga të dyja kishat: e Shënkollit dhe dhe ajo e shën Ilit nuk ishin në hapësirat e Gorës, porse në ato të Opojës sado që antroponimi *Il* (*Hil) është ruajtur në mikrotoponimin *Ileve mlake* në katundin goran Shishtavet të regjionit të Kukësit.

Përsa i përket dendurisë së përhapjes së kishave në regjionet e Gorës e të Opojës, mikrotoponimia aktuale e këtyre dy regjioneve ofron më shumë të dhëna se sa dokumenti i vitit 1348 i kishës serbe në të cilin dëshmohen, siç u pa deri tani, vetëm tri kisha, ndërsa në defterin osmanturk të viteve 1451-1452 nuk është dëshmuar asnjë kishë apo manastir,

[56] Khs. J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës,. .., 20, f. 125.

por më shumë priftërinj. Nga materiali onomastik aktual i këtyre dy regjioneve gjuhësisht të ndryshme, mësohet se këndej do të ketë pasur më shumë kisha se ç'dëshmohet në dokumentacionin kishtar serb. Kështu, për ekzistimin e ndonjë kishe, mbase të kohës së para ngulimeve bullgare në këto zona, mësohet nga tradita sipas së cilës p.sh. në lagjen *Mahalla e Prifte*, përkatësisht **Priftaj* të katundit Blaç të Opojës (ku është edhe mikrotoponimi *Gurra e Priftës*) në të cilin është ruajtur deri në ditë tona termi shqiptar *prift* (i dëshmuar edhe në regjistrimin turk të vitit 1571, sh. më poshtë) edhe mikrotoponimi *Guri Lekës* që e tregon përkatësinë dikur të banorëve të këtij katundi kishës së krishter mbase të ritit roman, tradita po e ditka që aty dikur paska pasur një kishë [përreth së cilës paska edhe varreza të vjetra], gjurmë të së cilës po u shihkan edhe sot. Dëshmi onomastike për ekzistimin e ndonjë kishe të vjetër paska edhe në katundin shqiptar Brezne të Opojës ku *Te Vorret e Kallabës* është sot mikrotoponimi *Lugi i Kishës*; dëshmi për ekzistimin e ndonjë kishe paska edhe në kompleksin *Kumçari* të katundit Brrut; Lidhjen shpirtërore të banorëve të regjionit të Opojës me krishterimin e dëshmojnë mbase edhe mikrotoponimet *Lisi i Shëngjergjit* dhe *Lisi i Shënkollit* në katundin Kapre të Opojës; *Te Kisha* dhe *Gurra e Kishave* në katundin Kosavë; *Te Kisha* dhe *Kodra e Shën Gjinit* në katundin Zapluxhë si edhe mikrotoponimi *Guri kallugjerit* në katundin Zgatar të regjionit të Opojës. Një kishë e vjetër, madje "si duket manastir parasllav", paska ekzistuar, së fundi, edhe "Ndërmjet fshatrave Kosavë dhe Kapre".[57]

Mikrotoponimia aktuale ofron të dhëna edhe për ekzistimin në hapësirën e mikroregjionit të krahinëzës së Gorës të më shumë kishave, nga ç'përmenden në dokumentin e vitit 1348. Kështu, përveç topogërmadhës *Crkvište, Crkviče* në katundin Dikancë tek e cila mund të shihet një dëshmi e kishës së zhdukur, në të cilën do të kenë shërbyer priftërinjtë *Dikanoviki* të dëshmuar në vitin 1348, mësohet p.sh. se ndonjë kishë e padëshmuar do të ketë ekzistuar edhe në katundin Krushevë të Gorës ku është sot topogërmadha *Crkov*, ashtu si edhe në kryeqendrën aktuale Dragash të këtij mikroregjioni, ku është vendi i quajtur *Crkvište* "Truallishtë kishe". Edhe në këtë regjion tradita beson ta dijë se një kishë paska pasur edhe në vendin *Marinec* të katundit Rapçë e Poshtme ku ekziston mtp. *Crkva*; në Gllobоçicë ku është vendi i quajtur *Crkva*; në Kukoljan ku po ashtu është një vend i quajtur *Crkva*; në Luboshtë ku është vendi *Crkov*; në Mlikë tek vendi *Crkvište* dhe *Crkvišta* në Vranisht, ndërsa kujtimi për priftërinj e murgj është ruajtur në mikroponimet *Kaluđerci* në Kërstec i

[57] Të gjitha shënimet janë marrë nga libri i J. Osmanit, Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 86, 95, 112, 125, 135, 137, 141.

Poshtëm; *Popef kamen* në Radesh; *Popova mlaka* në Restelicë dhe *Popovica* në Zlipotok, për të cilin ka arsye të paravendohet se ruan kujtimin e plangut të ndonjë popi "prifti", që edhe ashtu dëshmohet në regjistrimin osman-turk të viteve 1451-1452 (khs. më poshtë). Nga katunde të pjesës së Gorës në Veri të Shqipërisë, të këtilla janë mikrotoponimet *Kisha* në Borje e në Orçikël. Megjithatë, mikrotoponimia aktuale e regjionit të Gorës nuk ofron të dhëna për identifikimin e kishave të dëshmuara në vitin 1348 me emrat *Kisha e Mratit* dhe *Kisha e Ilit*.

Sa kohë që nuk janë bërë gërmime në vendet e quajtura *Kisha* etj. dhe mungojnë pra edhe studimet gjegjëse kompetente përkitazi me kohën e ngritjes dhe të shuarjes së tyre, me madhësinë dhe tipin arkitektonik të tyre nuk mund të thuhet asgjë e besueshme përkitazi me çështjen themelore: të kujt ishin ato kisha. Megjithatë, në dritën e emrave të vendbanimeve e sidomos të mikrotoponimeve me prejardhje nga latiniteti ballkanik dhe nga greqishtja e mesme që ndeshen sidomos në krahinëzën e Opojës, mund të shfaqet mendimi i vagullt që shumica e atyre kishave mund të jenë të periudhës së krishterimit të hershëm, përkatësisht të periudhës bizantine, kjo sepse është e vështirë të paramendohet që shtetet në ekspansion të shekujve 12-14 të bullgarëve e të serbëve dhe kishat e tyre ta kenë përhapur ritin ortodoks të tyrin në këto zona malore të banuara nga popullata kryesisht baritore, por me traditë të lashtë vendëse të krishterimit dhe me përhapje të dendur të kishave. Kjo vlen sidomos për krahinëzën e Opojës në të cilën ka relativisht shumë mikrotoponime (7 sosh) që ruajnë kujtimin e kishave; 2 vende në të cilat pandehet të ketë pasur kisha, të shenjtorëve (3 sosh), të eprorëve kishtarë (4 sosh) dhe një vëllazëri të quajtur edhe sot Priftaj si edhe fjalët vendëse për ipeshkëv e prift. Në regjionin e Gorës ka, nga ana tjetër vetëm 2 mikrotoponime që ruajnë kujtimin për kishat dhe asnjë nga emrat që ndeshen (khs. më lart) në krahinën e Opojës.

Në të mirë të paravendimit të mësipërm përkitazi me regjionin e Gorës flet mbase edhe rrethana që në gjithë këtë regjion kishte në vitin 1348 vetëm 3 *popë* (priftërinj) ortodoksë: popët *Gllavat* e *Raiko* me familjet e me bashtinat e tyre në katundin Rapçë dhe popët (disa?) *Dikanoviki* me familjet e me barqet,* farefisin e tyre - pararendës të vëllazërisë së sotme gorane *Dikanci* të Brodit, përkatësisht të katundit homonim të krahinës së Gorës e pas gjithë gjasash edhe të vëllazërisë shqiptare *Dikaj* të Brodosanës së Opojës.

* Në origjinal i *s niњь rodomь.*

Vështruar në rrafshin e përkatësisë etnike, lejohet mundësia të besohet që edhe vetë priftërinjtë dhe familjet e tyre të kenë qenë vlleh vendës /goranë në shërbim të kishës ortodokse serbe dhe që, në këtë kontekst emrat *Glavat* e *Vrano* e priftërinjve nuk do të kenë qenë antroponime të mirëfillta porse ofiçe sllavisht të vendësve, sepse, sikundër mendon A. Džogović,[58] edhe të gjithë individët e përmendur në krisobulën e vitit 1348 paskan qenë persona vlleh në shërbim të ritit (ortodoks të variantit serb) zyrtar të kohës dhe i aparatit shtetëror serb.

Megjithatë, në këtë mes nuk bën të përjashtohet krejtësisht mundësia që këta të kenë qenë jo banorë vendës, porse priftërinj të përgatitur e të dërguar në regjionin e Gorës nga kisha serbe për si misionarë. Si gjithandej, edhe këtu priftërinjtë ishin të privilegjuar të kishin bashtina. Kjo sidomos nëse qëndron hipoteza e qenies bogumile të pararendësve të goranëve, që nënkupton se për si bogumilë ata nuk do të kenë mundur të sillnin klerikë të tyre nga Bullgaria e Maqedonia, sepse predikuesit e bogumilizmit përndiqeshin nga të dyja kishat e atyre formacioneve shtetërore. Së këndejmi do të mund të paravendohej që ato pak familje priftërinjsh do të kenë qenë serbishfolëse që me kohë mund të jenë shkrirë në folës të bullgarishtes.

Është për t'u vënë re që në këtë burim; si pothuaj rëndom në gjithë dokumentacionin kishtar serb, nuk përmendet asnjëherë përkatësia e mirëfilltë etnike e banorëve. Në këtë burim nuk përmenden pra as barinjtë "arbanasë" e as ata " vlleh", mbase edhe pse popullata e kësaj zone s'kishte ç'të ishte tjetër përveç baritore. Fundja, blegtorinë për degë kryesore të gjallërimit të popullatës së këtij regjioni ia ka imponuar në rend të parë vetë konfiguracioni i terrenit.

Moscilësimi për vlleh (as në kuptimin etnik e as në atë profesional të barinjve) i banorëve të regjionit të Gorës nga administrata e kishës serbe e lë mundësinë të mendohet se ajo popullatë ishte ngulitur aty shumë kohë përpara shek. XIV dhe për administratën ajo ishte popullatë romane ballkanike ndenjëtare, vendosja e së cilës nuk kishte ndodhur nën mbikëqyrjen e administratës kishtare. Mirëpo praninë e elementit etnik vllah në këtë regjion e dëshmojnë mikrotoponimet në të cilat emri etnik i tij është ruajtur në rasën gjinore të njëjësit e të shumësit të sllavishtes (khs. *Vlaška, Vlaške Livade, Vlaški Put, Vlaški Potok,(V)laškište* në Vraniq e përreth tij si edhe *Vla*(h)*inica* në Borje të Kukësit etj.). Po u nisëm nga rrethana e ditur që vendet me distinktivin etnik e profesional nuk "pagëzohen" nga vetë ato entitete ose grupe profesionale shtrohet pyetja cila

[58] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

ishte ajo popullatë sllavishtfolëse që për " vlleh" i cilësoi fqinjët e saj. Rethana që mikrotoponime të këtij tipi nuk gjenden më gjerë se në trikatër katunde të kësaj krahine e lejon paravendimin që pikërisht ky fenomen e tregon korrektësinë e tezës sime se në këtë regjion pati ngulime të vazhdueshme vllehsh të sllavizuar. Ka mundësi që banorët më të moçëm për nga vendosja i shenjuan për si " vlleh" vëllazëritë që erdhën më vonë apo pse ato mund të kenë qenë edhe pjesërisht folës kryesisht të vllahishtes.

Një çështje që duhet parë më hollësisht është edhe rrethana që në krisobulën e v. 1348 nuk përmenden disa katunde të sotme të regjioneve të Gorës e të Opojës. A mund të sqarohet kjo me natyrën e dokumentit i cili nuk është pra i tipit të regjistrimit të hollësishëm të popullsisë, porse një dokument i cili ka të bëjë kryesisht me përcaktim të mexhëve të katundeve që i faleshin manastirit të shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit, apo duhet kuptuar ashtu që këto krahina ishin të populluara rrallë. Në të mirë të kësaj të fundit do të fliste forma e organizimit shoqëror të ambienteve blegtorale që nënkupton pronësinë mbi kullota, prandaj edhe vendbanimet e tipit të shpërndarë të vëllazërive, përkatësisht të familjeve më të mëdha. Kjo do ta shpjegonte arsyen përse në vitin 1348 në gjithë këtë hapësirë nuk përmenden p.sh. vendbanimet si Dragashi, Shainovci, Kukaljani, Lubovishta, Baçka e madje as katundi më i madh i sotëm territorialisht Restelica i Gorës. I besueshëm më duket paravendimi që katundet e mësipërme nuk ishin asokohe vendbanime më vete, porse që ato u krijuan më vonë si rezultat i zgjerimit territorial të vëllazërive blegtorale vendëse. Këtij paravendimi do t'i dilte krah edhe rrethana që në vitin 1348 në gjithë hapësirën e regjionit të Gorës nuk kishte më shumë se 3 priftërinj dhe po aq kisha. Një sqarim për këtë mund të jetë konfiguracioni i terrenit, ndërsa tjetri, që nuk u vërejt nga përkrahësit e tezës së qenies së goranëve bogumilë, se njëra ndër veçoritë e bogumilëve paska qenë mosrespektimi i tempujve kishtarë. Çështje e lidhur me të mësipërmen është ajo nëse në mungesën e kishave do të ketë ndikuar edhe madhësia/vogëlsia e vendbanimeve të këtij regjioni, sidomos sa kohë që dihet që në defterin osman-turk të viteve 1451-1452 evidentohen edhe jo pak katunde të Gorës që asokohe s'kishin më shumë se 1 deri në 7 kryefamiljarë. Kjo rrethanë e lë të hapur mundësinë që nuk do të ketë pasur as nevojë e as mundësi që për këso minivendbanime të ngriteshin kisha të veçanta. Numri i tyre do të rritet, siç mund të shihet nga të dhënat e regjistrimit osman-turk gjatë ndërmjetëzës kohore prej 103 vitesh, si rezultat i lëvizjeve të brendshme, si pasojë e rritjes së natyrshme të vetë popullatës së këtyre krahinave. Rrallësia e vendbanimeve, organizimi

fisëror i shoqërisë, ndjenja e mëvetësisë etnike do të ketë qenë ledh që e pengoi ndikimin e thellë të ortodoksisë serbe dhe në rend të parë ruajtjen e gjuhës dhe të segmenteve të tjera të etnisë që pararendësit e goranëve të sotëm i kishin sjellë me vete nga hapësira gjuhësore e bullgarishtes – atdheu i kryehershëm i tyre - mbase së pakut dy shekuj para lindjes së dokumentit të vitit 1348.

3. VENERIME PËRKITAZI ME GORËN MBI BAZËN E TË DHËNAVE TË BURIMIT OSMAN TË VITEVE 1451-1452

Të dhëna të vlefshme për territorin dhe banorët e regjionit të Gorës ka edhe në një defter osman të regjistrimit të popullsisë së vilajetit Arvanit në vitet 1451-1452. Në kuadër të këtij regjistrimi janë evidentuar edhe kryefamiljarët e nahijes së Gorës, e cila asokohe ngërthente më vete edhe vendbanime që sot nuk i bien komunës së Dragashit. Ndër vendbanime të Gorës së sotme, në të dyja anët e kufirit politik midis Kosovës e Shqipërisë, në këtë regjistrim janë evidentuar:

Katundi Brod me 50 shtëpi, me këta kryefamiljarë: Brajko, Stojan-i, Dorbromir-i, *Lulko** Bogdan-i, Dabizhiv-i, Pop-i, Bogdan-i (tjetër), Bradislav-i, Rapko, Bogdan-i (tjetër), Beraçan-i, Mlit-i, Rad-i, Dragush-a, Vejislav-i, Dragislav-i, Novak-u, *Gropic*-i, Bogdan-i, Dabic-i, Rapko (tjetër), *Gjergj*-i, Draga-i, Bojko, Radislav-i, *Bardo*, Milic-i, Bogdan-i, Trajan-i, Brato, Radislav-i, Radic-i, *Lazor*-i, Rajko dhe Boja.[59]

Katundi Premta me 24 shtëpi: Në këtë katund jetonin në vitet 1451 - 1452 këta banorë: Dragan-i, Rajan-i, Pop-i, Dabic-i, Nikola, Bogdan-i, Radislav-i, Radi-i, Ravshin-i, *Mitogjin*-i, Popi (SG: tjetër ?), *Spanko*, Bogdan-i (tjetër), Dobric-i, Prip-i, Radilo, Maletiq, Rad-i, Tolko, Gjura, *Bukur*-i, Radmil-i, Pop-i (tjetër) dhe Dimitr-i.

Katundi Radesh, me 13 shtëpi: Gjurko, Bobo, Rapqin-i, Buçiq-i, Bogdan-i, Rajko, Jovan-i, Vlatko, Rajko (tjetër), Rapqin (tjetër), Bogdan-i (tjetër), Radislav-i, Rajko (tjetër).

Katundi Zli Potok, me 11 (?) shtëpi: Dibriko (SG. ndoshta Dobriko), Rajko, Krshev-a, Delko, Rapçin-i, Bogdan-i, Novak-u, Popi dhe Shutko.

Katundi Borja, përkatësisht Borje: Radislav-i, Bogdan-i, Pop-i, Nikol-a, Gropan-i, Raja, Ivan-i, Stojan-i, Bogil-i dhe Rajk-u.

Katundi Kosharisht: Dobrislav-i, Staka, Bojko, Dobrislav-i (tjetër) dhe Dobrislav-i (tjetër)

Katundi Zabut (SG. sot Zapod): Dimitr-i, *Gjergj*-i, Petko, Dab-i, Radin-i, Brajosh-i, Dobrislav-i.

Katundi Urçikla (SG. sot Orçikla) me tri shtëpi: Andreja, Dobromir-i dhe Mel-ko.

Katundi Argjoshta (SG. Orçusha ?) me 3 shtëpi: Rajk-o, Radiq-i dhe Bogoja.

---

* Unë i kam nënvizuar në kursiv të gjithë emrat të cilët i konsideroj për emra shqiptarë ose të shqiptarëve.

[59] Khs. Iljaz Rexha: Një fragment i Defterit të Rumelisë të viteve 1451-1452 ku përfshihen disa vendbanime të Kosovës në kuadër të Arbanonit mesjetar, "Gjurmime albanologjike", Seria e shkencave historike, 33-34, 2003-2004, Prishtinë, 2005, f. 281.

Katundi Arkosta (SG. sot Orgoshta) me 14 shtëpi: Bojk-o, Stank-o, Dobroslav-i, *Span*-a, Stank-o (tjetër), Bogdan-i, Dragoslav-i, Novak-u, Novak-u (tjetër), Pop-i, *Gropan*-i, Petr-i, Dobr-o dhe Dimitr-i.

Katundi Lipovçiq (SG. sot Lubovishtë) me 11 shtëpi: Bogdan-i, Drakin-i, Jovan-i, Bozhidar-i, Nikola, Dabizhiv-i, Radislav-i, Pop-i, Dragoslav-i, Dabizhiv-i (tjetër) dhe Dibr-i (SG. Dobr-i ?).

Katundi Kristash (SG. sot Kërstec) me 7 shtëpi: Pop-i, Dimitr-i, Bogdan-i, Dobroslav -i, Radmir-i, Radislav-i, Bojk-o dhe Rat-ko.

Katundi Rapçë me 9 shtëpi: Nik-a, Prosan-i, Ter-a, Trajko, Trajan-i, Dobromir-i, Sveto, Rajan-i dhe Trajan-i (tjetër).

Katundi Arsha (emri i të cilit mbase mund të lexohet edhe si Orsha e që mund të ketë të bëjë me katundin Orçikël, apo me vendin e sotëm Orashek në Rapçën e Poshtme të Gorës) kishte 7 shtëpi, me këta kryefamiljarë: Pop -i, Bogdan-i, Rad-i, Bogdan-i (tjetër ?), Gropan-i, Dragiq-i dhe Gjergj-i.

Katundi Paksha (SG. sot Pakish) me 4 shtëpi: Gojko, Stajko, Branislav, Dobroslav.

Katundi Krsheva[*] (SG. sot Krusheva), me një kryefamiljar: *Span*k-o.

Katundi Cërnaleva me 6 shtëpi, të drejtuara nga kryefamiljarët: Bogdan-i, Dibr-a (?), Dobr-a, Pop-i, Dragislav-i dhe Ivan-i.

Katundi Leshtan me 5 shtëpi, me kryefamiljarë të quajtur: Stafina, Pop-i, Bogiq-i, Bogdan-i dhe Vlsha / (SG.: Vlksha, Vlasha ose Vlashi ?).

Katundi Kradisht/*Gradisht*.[60] Ky katund, kishte në vitet 1451- 1452 vetëm 4 shtëpi, me kryefamiljarët: Radic-i, Stanimir-i, Drajk-o, dhe Bogoj -i.

Në defterët osmanë-turq të regjistrimeve të kryefamiljarëve në vitet 1530, 1571 dhe 1591 një katund i quajtur *Gradçani* dëshmohet për në nahijen e Opojës. J. Osmani[61] e ka lokalizuar këtë vendbanim diku midis katundeve Brrut e Bilushë të krahinës së Opojës. Ky nuk solli ndonjë emër aktual të vendit që do ta përligjte këtë lokalizim.

Në dritën e ekzistimit edhe në ditë tonat të topogërmadhës *Gradesh* në hapësirën e katundit të sotëm Kuk/Kukoljan të Gorës, kujtoj se ka arsye të mendohet që katundi Kradisht/Gradisht mund të lokalizohet në hapësirën e katundit të sotëm Kukoljan të Gorës, sado që një mikrotoponim *Gradçanica* paska edhe në katundin Bilushë të komunës së Prizrenit.

Katundi *Pllavë* i sotëm i Opojës me vetëm një familje me kryefamiljarin e quajtur *Miliko* ose *Meliko*, i cili e ushtronte zejen e gjahtarit me fajkua.[62]

---

* Shënim: Për këtë katund ekziston edhe një regjistrim i veçantë në vitin 1579 (sh. më poshtë)

[60] I. Rexha: Një fragment i Defterit të Rumelisë. .., f. 282.

[61] Khs. Vendbanimet e Kosovës,. .., 20, f. 153, 155.

[62] I. Rexha, Po aty, f. 282 -283.

Përveç pjesës dërmuese të antroponimeve sllave të variantit serb, prania e të cilave është rezultat i inkuadrimit administrativisht të popullatës autoktone në ortodoksinë serbe, ndër banorë të këtij regjioni kishte edhe kryefamiljarë që ende mbanin edhe disa antroponime shqipe të cilat në këtë burim dalin (edhe) në trajta të zgjeruara me prapashtesa sllave. Të këtilla janë p.sh. antroponimet: *Andreja*, *Bardo*, *Gropic*, *Gjergj*-i, *Lazor* e *Lulko* në katundin Brod dhe *Gropan* në Borje; *Mitogjin* e *Spanko* në katundin sot të panjohur Premta dhe në Zapod; *Gjergj* në katundet Zapod e Orçushë; *Shutko* në katundin Zli Potok, *Gropan* në katundet Borje e Arsha; *Spana* në katundin Orgoshta; *Span-ko* në katundin Krushevë e ndonjë tjetër. Edhe disa emra të evidentuar në këtë dokument janë vazhduar nga popullata vendëse duke i ruajtur ata për si emra të vëllazërive. Kështu p.sh. antroponimi i dëshmuar *Lulo* është ruajtur tek emri aktual, *Mahalla e Lulove*, përkatësisht **Lulovci*, që sajon një vëllazëri sllavishtfolëse të katundit Brod[63] si edhe antroponimi *Bardo* që po në këtë burim del të jetë në funksion të emrit të lagjes në katundin Brod dhe emri aktual i vëllazërisë *Bardovci* të po këtij katundi, i cili si *Bardonik*, për emër i një lagjeje të katundit Brod, dëshmohet në një burim të vitit 1530.[64] Qenien në përdorim të këtij antroponimi shqiptar tek të dyja popullatat e këtyre regjioneve e dëshmon edhe emri *Bardhajt* i një vëllazërie shqiptare në Brodosanë të Opojës.[65]

Midis banorëve të kësaj krahine të evidentuar në këtë regjistrim kishte edhe dy kryefamiljarë me emra për mua jo lehtë të zbërthyeshëm gjuhësisht si: *Prosan*-i i cili s'mund të jetë mbase tjetërsend veçse emri që sot ndeshet tek rumunët në trajtat *Prosa*, *Prosi*, *Prosie*, *Prosiei*, *Prosica* e *Prosin* të cilët N. A. Constantinescu[66] i krahason me bullg. *прoсо* (*proso*) rum. *mei* "të imtë; 2. mel" bot. Panicum miliaceum L. dhe me gr. *προσηνής* rum. *afabil* "i shoqërueshëm; i shkueshëm"; emri *Ter* -a i një banori të katundit Rapçë dhe një banor me emrin *Drakin* -i, që dëshmohet edhe në katundin Lipovçiq (sot Lubovishtë) e që mbase s'është tjetër veçse një trajtë e tjetërsuar e emrit roman-ballkanik / vllah **Dracul*, përkatësisht *Drakun*/*Drokun*.

Njëri ndër banorë të katundit Brod të kësaj krahine mbante sipas regjistrimit osman të v. 1451-1452 antroponimin karakteristik vllah *Bukur*.

---

[63] J. Osmani, Vedbanimet e Kosovës, 20, f. 91, 92. Është keq që autori nuk e ka dhënë këtë emër në trajtën siç e përdor popullata sllavishtfolëse e vendit.

[64] J. Osmani., Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006., f. 92.

[65] Po ai, po aty, f. 88.

[66] Khs. Dictionar Onomastic Romînesc, Bucureşti, 1963, f. 353.

Nga të dhënat e këtij regjistrimi del se në krahasim me vitin 1348 kur kishte 3 apo edhe më shumë priftërinj, tani në 20 katunde të regjionit të Gorës me gjithsej 194 kryefamiljarë (duke i përfshirë këtu edhe priftërinjtë) kishte 12 priftërinj. Kështu, vetëm në katundin Premta me 24 shtëpi ishin në këtë kohë 3 priftërinj (emrat e të cilëve porse nuk janë dhënë në këtë burim); në katundet Zli Potok, Orgosht, Borje, Lubovishtë, Kërstec, Leshtan e Cernalevë kishte tani në secilin së pakut nga një *pop* ortodoks. Të vetmit popë/priftërinj të shenjuar me emër ishin ai i katundit Lubovishtë që e mbante emrin *Dobr*-i dhe ai i katundit Kërstec i quajtur pop *Dobroslav* -i. Duket se midis priftërinjve të angazhuar në këtë regjion kishte porse edhe ndonjë që mbante emër apo mbiemër të prejardhjes shqipe, siç ishte ndoshta prifti *Gropan*-i, i katundit Orgoshtë. Në të mirë të prejardhjes shqipe e ndoshta edhe të ndjesisë etnike shqiptare të bartësit të këtij emri mbase do të fliste edhe rrethana që po këtë emër (Gropa,-aj) (e mbante edhe një derë e njohur fisnike shqiptare lokale, që zotëronte toka jo larg këtij regjioni, përkatësisht jo larg nga qyteti i sotëm i Kukësit - qyteti më i afërm për regjionin e Gorës në rrethina të të cilit ka edhe sot nëntë katunde goranësh.

Nga të dhënat e përmbajtura në këtë regjistrim rezulton ngritja e dukshme e numrit të kryefamiljarëve me emra të përkatësisë thjesht sllave, përkatësisht serbe. Kryefamiljarët e katundeve të regjistruara në këtë defter mbanin në pjesën absolute më të madhe të tyre antroponimet sllave të variantit serb: *Beraçan*, *Bobo*, *Bogdan*, *Bogil*, *Bogiq*, Bogoj /*Bogoja*, *Boja* /*Bojko*, *Bozhidar*, *Bradislav*, *Brajosh*, *Branislav*, *Brato*, *Buçiq*, *Dab*, *Dabic*, *Dabiziv*, *Delko*, *Dibr*/*Dibriko* (SG. ndoshta Dobriko?), *Dimitr*, *Dobriq*, *Dobrislav*, *Dobro*, *Dorbromir*, *Dobroslav*, *Draga*, *Dragan*, *Dragiq*, *Dragislav*, *Dragoslav*, *Dragush*, Drajk-o *Gojko*, *Gjura*, *Gjurko*, *Ivan*, *Jovan*, *Krshev*, *Maletiq*, *Mel-ko*, *Milic*, *Mlit*, *Nikola*, *Novak*, *Petko*, *Prip*, *Radi*, *Radic*, *Radilo*, Radic/ *Radiq*, *Radin*, *Radislav*, *Radmil*, *Radmir*, *Raja*, *Rajko*, *Rajan*, *Rapko*, *Rapqin*, *Rat-ko*, *Ravshin*, *Stafina*, *Stajko*, *Staka*, *Stanimir*, *Stanko*, *Stojan*, *Sveto*, *Tolko*, *Trajko*, *Trajan*, *Vejislav* e *Vlatko*.[67] dhe Vlsha (SG.: Vëlksha; Vlasha ose Vlashi?)

Nga regjistri i mësipërm duhet të veçohen antroponimet e gjithkrishtera *Dimitr*, *Nikola* e *Trajan*, bartës të të cilëve mund të ishin edhe shqiptarët si edhe antroponimi *Tolko* i cili, i shënuar për në trajta të ndryshme, dëshmohet jo vetëm të jetë bartur, porse edhe të jetë vazhduar deri në ditët tona si nga shqiptarët ashtu edhe nga goranët. Shembull për këtë do të jenë emri i vëllazërisë gorane *Toljevci* të krahinës së Gorës dhe emri *Tolaj* i një vëllazërie të katundit shqiptar Shajne të Opojës. Emrat e të

[67] Khs. Iljaz Rexha: Një fragment i defterit të Rumelisë të viteve 1451-1452..., f. 281.

dyja këtyre vëllazërive mund të jenë me prejardhje sllave: ose nga rrënja sllave *toli* = lat. *placere* "pëlqej", siç mendonte T. Maretić për antroponimet sllave *Tolimir, Tolislav,* apo do të jetë trajtë përkëdhelëse e emrit grek *Apostolos*. Ky i fundit ndeshet tek bullgarët në trajtat *Postol, Tole, Tola, Tolica,* ndërsa tek shqiptarët në jugun ortodoks të Shqipërisë si *Toljo,*[68] përkatësisht *Tolo.*

Edhe me një shembull të kontinuitetit të një emri të dëshmuar në shek. XV e të ruajtur deri në ditë tonat në regjionin e Gorës kemi të bëjmë edhe në rastin e antroponimit *Shutko* të dëshmuar në vitet 1451-1452 në katundin Zlipotok (khs. më lart) të regjionit të Gorës. Pa marrë parasysh nëse emri *Shut,-ko* mund të jetë me prejadhje nga mbiemri shqiptar *shyt* "i pa brirë" apo, sikundër mendon B. Koneski[69] sipas të cilit ky emër qenka formuar nga "*fjala sllave šut*" me prapashtesën vllahe *-ul* që e paska kuptimin "shkëmb i shpluar, cullak"], ky emër është vazhduar deri në ditë tonat tek mikrotoponimet *Šutarkovo gumno* "Lama e Shutark-ut" në Restelicë dhe tek emri i vendit *Šutinica* në katundin Brod të Gorës.

Përkundër këtyre pak shembujve të vazhdimësisë në funksion emrash të vëllazërive dhe sidomos në mikrotoponimi të emrave të dëshmuar në këtë dokument të fillimit të gjysmës së dytë të shek. XV, me shumë gjasë për të pasur të drejtë mund të paravendohet që antroponimia e uzusit kishtar serb nuk pati jetë të gjatë. Ajo nuk u vazhdua nga popullatat vendëse të Gorës e të Opojës sa për shkak se për të dy entitetet ajo ishte kishë e huaj, e cila edhe ashtu s'kishte mundur të shtinte rrënjë në këto malësi, ashtu edhe për shkak të lidhjes së fortë shpirtërore e tradicionale të banorëve të këtyre dy regjioneve me uzusin anroponimik të periudhës së para pushtimit serb të këtyre viseve pas shek. XII. Këtë paravendim e mbështet rrethana që si te popullata e Gorës ashtu edhe te ajo e Opojës, në funksion emrash të vëllazërive u ruajt në pjesën dërmuese absolute *vetëm* shtresa latine-ballkanike, vllahe të cilën nuk mundi ta shlyente as edhe islamizimi i të dyja popullatave.

Ajo që bie në sy te materiali i përmbajtur në këtë regjistrim është mungesa dukshëm e madhe e emrave romanë ballkanikë, përkatësisht vlleh. Në dritën e kësaj rrethane ka vend të supozohet që procesi i sllavizimit onomastik e linguistik i elementit vllah pothuajse kishte përfunduar që në fillim të shek. XIV.

---

[68] Prof. Dr. Gustav Weigand: Die bulgarischen Rufnamen, Ihre Herkunft, Kürzungen und Neubildungen, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache (Rumänisches Seminar), 15/1909, f. 118.

[69] Khs. Makedonski mesta i iminja, NIO, "Studentski zbor", Shkup, 1991, f. 32.

Qenien deri vonë të krishterë të ritit ortodoks të goranëve e tregon mbase fort qartë emri *Urumovci* i një vëllazërie gorane (të shpërngulur) të këtij regjioni, emër që është i së njëjtës prejardhje si edhe mikrotoponimi *Mullaka e Urumit* në katundin Brodosanë të Opojës.[70] Në trajtën *urum*, ky nocion gjendet i shënuar nëpër burime osmane që në shek. XIV. Kjo fjalë ka hyrë në turqishten nga arabishtja ku kjo shenjonte Romën e romakët, ndërsa osmanët e shenjonin me këtë grekun, bullgarin dhe përgjithësisht të krishterin. Shkurt, ky nocion i kishte përgjithësuar si kuptimin e Ρωμαίος, ‚romakë", atë *graecus* për "grekë" për të dyja ritet e krishterimit si edhe atë të mëvonshmin Βούλγαροι "Bulgarus" që ishte për një kohë distinktiv për popullsitë sllave dhe josllave, të cilat i ishin nënshtruar perandorisë bullgare dhe ishin qytetarë të saj që i takonin ipeshkvisë së Ohrit.

Këtë nocion nga turqit e kanë huazuar ndonjëherë edhe sllavët e përfshirë në Perandorinë Otomoane, siç është rasti me Bosnjën, ku dëshmohet mbiemri familjar *Uromović*.[71] Kjo rrethanë jep dorë të paravendohet se pushtimi turk i krahinës së Gorës e gjeti popullatën e saj të ishte e besimit të krishterë, të ritit ortodoks dhe që ky emër vëllazërie do të tregonte se kjo (vëllazëri) e kishte ruajtur kujtimin për atdheun e kryehershëm të saj, Ballkanin e Jugut, përkatësisht Bullgarinë ose Maqedoninë.

Me vazhdimësi në të banuar (edhe të shqiptarëve?) paskemi të bëjmë[72] edhe në dritën e barazimit të emrit mesjetar *Glivnik* me atë *Glivničica* të qytezës së sotme të Dragashit, ku më parë paska jetuar një vëllazëri, që në ikje nga sëmundja e murtajës qenka vendosur në katundin e sotëm Mlikë të goranëve. Ky katund, në krye të herës i rajonit të Opojës, po u përmendka në regjistrimet osmane-turke për si *Glunik*.

Për dëshmi të kontinuitetit të banimit nga shqiptarët të vendbanimit Rrenc të Opojës J. Osmani[73] e sjell edhe emrin e truallishtes *Pustomulqa*, të cilën sundimtari serb Stefan Uroš II Milutin-i në një krisobulë të tij të vitit 1326 për ipeshkvinë e Prizrenit, e cila nuk qenka ruajtur, ia falte asaj ipeshkvie: "Dhe mbretëria ime ia shtoi truallishtën *Pustomulqja* që këtë ta popullojë kisha dhe t'ia bashkëngjesë Opojës."[74]

Ky lokalizim e identifikim në të mirë të vazhdimësisë shqiptare në të banuar do të ishte i pranueshëm sikur autori ta kishte dëshmuar këtë edhe

[70] Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 89.
[71] Sipas Petar Skok, Dolazak Slavena na Mediteran, Split, 1931, f. 63.
[72] Sipas J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 155.
[73] Po ai, po aty, f. 134.
[74] Khs. Zakonski Spomenici. .., f. 641: "I ještє prida kraljevъstvo mi sєlište Poustomoulčju, da si je nasєli crъkv i da si je priloži kъ Opoliju".

me praninë e ndonjë mikrotoponimi apo patronimi aktual përbrenda katundit të sotëm Rrenc. Mirëpo nga të dhënat e sjella nga vetë ky autor për vëllazëritë e për mikrotoponimet e këtij katundi nuk mund të ndeshet ndonjë dëshmi që do të fliste për vazhdimësi shqiptare të emrit mesjetar *Pustomulqa*, sado që deklaron se ky vend qenka përmendur edhe në vitet 1761 e 1770. Nga vetë përbërja dypjesëshe sllavisht e emrit: *pusta* "i, e shkretë" dhe **Mulça* kuptohet se këtu kemi të bëjmë me një vendbanim të lënë shkret, gjurmë onomastike të të cilit, edhe nga materiali onomastik që e sjell autori ynë, nuk gjenden sot në terren.

Më e afërmendshme më duket që vendi *Pustomulça*, i cili do të jetë lënë shkret kohë përpara vitit 1326, porse i populluar në ndërkohë me urdhër të kishës, sepse nuk përmendet më në dokumentin gjithëpërfshirës të vitit 1348, të lokalizohet në hapësirën e sotme të qendrës komunale të Dragashit, përbrenda së cilës (hapësirë) janë sot mikrotoponimet *Selište* "truallishtë" dhe *Crkvište* "vend ku kishte pasur kishë" që tregojnë se aty kishte dikurë një vendbanim emri i të cilit **Mulča* mund të jetë ruajtur tek mikrotoponimet *Mlačicje* e *Mlačica*[75],që nuk mund të ndahen nga emri shqip *mllagë, mullagë* dhe sllav. *mlaka* bot. Quercus Frainetto Tem. ose Ostrya Scop. i drurit. (për emrin e të cilit do të bëhet fjalë më poshtë). Unë besoj se vetëm kështu, vështruar në rrafshin jashtëgjuhësor, do të mund të arsyetohej tradita gojore mbi të cilën mbështetet J. Osmani. Ka një mendim sipas të cilit[75a] *Postomullqja* e zhdukur ndodhej në hapësirën e katundit të sotëm Rrenc të Opojës.

Rrethana që në burimin kishtar serb të vitit 1348 për hapësirën aktuale të krahinës së Opojës ka larg më pak shënime se sa për krahinën fqinje të Gorës, nuk mund të merret për si mosprani e popullatës shqipfolëse në këtë regjion. Të përkundërtën e dëshmojnë mikrotoponimet në variantet shqipe të tyre me prejardhje nga brumi leksikor i latinishtes ballkanike, emrat vlleh të disa vëllazërive të sotme shqiptare e të disa mikrotoponimeve me prejardhje nga greqishtja e mesme e periudhës bizantine të kësaj pjese të hapësirës etnolinguistike të shqiptarëve. Autoktoninë e popullatës shqiptare e dëshmon, edhe këtu, jo shumësia e emrave të vendeve e të vëllazërive me prejardhje shqipe, porse pikërisht vazhdimësia historikisht e diktuar e atyre emrave.

Mungesën e dëshmive në dokumentacionin kishtar serb të shek. XIV për hapësirën e sotme të krahinës së Opojës e zëvendëson materiali i ruajtur në defterë osmanë-turq të regjistrimit të kryefamiljarëve dhe të

[75] J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, 137.

[75a] Sipas Muharrem Qafleshi, Gjurmët historike të Opojës autoktone dhe goranëve të Gorës, në http://ojq-qendra.webs.com/historikuiopojsdheg.htm

pronave të tyre në shek. XVI. Kështu, në defterin turk të vitit 1571, në krahinën e sotme të Opojës kishte gjithsej 24 vendbanime dhe një truallishtë.[76] Duke e përjashtuar me arsye mundësinë e dëshirueshme refrenike për dijen serbe të etnologjisë se mund të ketë pasur ndonjë invazion të shqiptarëve në këtë regjion, bën të konstatohet që identikë apo të identifikueshëm me variantet e dëshmuara në vitin 1571 janë emrat e sotëm të vendbanimeve opojare Zgatar, Pllajnik, Zaplugjë, Blaç, Pllavë, Buçe, Brezne, Zërzë, Gjerman dhe *Bilush* (katundi i sotëm Bilushë i komunës së Prizrenit). Përveç kësaj, edhe emrat e evidentuar në shek. XVI që sot nuk shenjojnë vendbanime më vete janë vazhduar pikërisht nga popullata shqiptare, si p.sh.: *Gzosh* (khs. mikrotoponimin *Guri Groshit* vend, mbase shkëmb, në katundin Kukël),[77] *Zinova* (emri tjetër më i vjetër i Brodosanës). Përveç pohimeve nga tradita gojore dhe të ndonjë etnoografi si I. Jastrebov që, mbase po mbi bazën e traditës gojore të vendësve, e mbështesin këtë identifikim, në hapësirën e Brodosanës nuk ka sot ndonjë mikrotoponim që do ta ilustronte këtë paravendim. Përkundrazi, një vend i quajtur *Zinova* është në katundin Brrut të kësaj krahine,[78] *Strela Gostriça* (khs. emrin **Lugu Strellës* në katundin Brrut të Opojës) dhe *Zubofiq* (Zhub?). Ka mundësi që edhe emri *Pandelofic* i vitit 1571 të jetë ruajtur tek emri i kompleksit *Pandlevica* i katundit fqinj Bilushë sot të komunës së Prizrenit,[79] nëse ky emër nuk është i identifikueshëm me vendin *Panteljevac* në katundin e sotëm Kërstec i Madh të Gorës;[80] *Olina*, mbase emri i kryehershëm i katundit të sotëm Kosavë, që ky e ka pagëzuar si *Ulina.*[81] - sado që në vitin 1571 ishte shënuar se ky vend quhej *Olina*, ndryshe *Kusaq*.[82]

Përbrenda kësaj krahine, nahijeje të shek. XVI binin edhe një grusht vendbanimesh të tjera që sot nuk i mbajnë emrat që i kishin asokohe. Kështu, këndej kishte në vitin 1571 një vendbanim i quajtur. *Hotonova* emri i të cilit duket të jetë varianti i kryehershëm**Hotovci*;**Hodovci* i emrit të vëllazërisë, përkatësisht vëllazërive gorane *Odovci* që sot jetojnë

[76] S. Pulaha, Popullsia. .., f. 340 - 356.

[77] Të shënuar në terren nga J.Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 155.;

[78] Sh. J. Osmani., si më lart, f. 97.

[79] Sh. J. Osmani, si më lart, f. f. 153.

[80] Khs. J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 112.

[81] Sipas J. Osmani, Vendbanaimet e Kosovës. , 20 f. 141) Me këtë rast duhet theksuar se është fort e vështirë për t'u besuar që emri Olina na paska qenë emër shqip *Ulina i cili po u dashka ta zëvendësojë emrin (kuptimisht të barasvlershëm) sllav Kosava të këtij vendbanimi - siç mendon J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 141.

[82] S. Pulaha, Popullsia. .., f. 350.

në katundet Leshtan e Baçkë të Gorës; *Dimitrofic* një vendbanim që gjatë gjithë shek. XV s'kishte kurrë më shumë se 3 shtëpi mund të ketë qenë një kishëz ose manastir, vazhdimësia e të cilit bën të kërkohet tek topogërmadhat e tipit *Kisha*, *Kishëza* që ekzistojnë nëpër katunde të Opojës, apo që ky vendbanim të jetë quajtur sipas një familjeje me pararendës një Dimitrin, emri i të cilit - si pasojë e islamizimit - nuk do të jetë vazhduar më nga banorë të atij vendbanimi miniatural që do të jetë bashkëshkrirë në kuadër të ndonjë vendbanimi më të madh fqinj. E njëjta mundësi mund të vlejë edhe për vendbanimin e quajtur *Sveti Petri*, (nëse ky vend mund të jetë quajtur sipas emrit të ndonjë kishe të kushtuar Shën Pjetrit, është çështje që duhet të shihet). Shpjegimet e dhëna nga J. Osmani[83] se pikërisht ky vend qenka quajtur në vitin 1451-1452 *Premta* nuk më duken mjaft bindëse, duke qenë se ndërrimi i emrit të vendit do të paravendonte ndërrimin e popullsisë, të konfesionit apo, po qe se ai ndërrim do të ishte i natyrës administrative, do të pritej që shkruesi të shënonte edhe emrin e kryehershëm të vendit. Dhe katundi ynë dëshmohet së pakut që nga viti 1530 vetëm me emrin *Sveti Petri*. As mendimi i autorit tonë se ky vend, mbase kishë do të ketë qenë në hapësirën e sotme të katundit Blaç, pse këtu kishte në vitin 1571 një kryefamiljar që do ta ketë ushtruar profesionin e priftit dhe quhej Hasan Prifti nuk më duket fort i bindshëm. Kjo sepse nëpër katunde të Opojës ka mikrotoponime të cilat japin dorë të paravendohet se vendi apo kisha *Sveti Petri* mund të ketë qenë jo domosdo në Blaç, por p.sh. në Kapre ku janë mikrotoponimet *Lisi i Shëngjergjit* e *Lisi i Shënkollit* e mbi të gjitha vendi i quajtur *Kishat*; në katundin Kosavë ku janë mikrrotoponimet *Te Kisha*, *Gurra e Kishave* dhe *Kryqi* ose në katundin Xërxë ku po ashtu janë mikrotoponimet *Te Kisha* dhe *Livadhi priftit*; *Lugi Kishës* në katundin Brezne - të gjitha të njohura për autorin J. Osmani. Për plotësisht të injoruara, të harruara, prandaj të panjohura, mbeten vendbanimet *Zolç* e *Prebiq*, *Jenice laz* e *Gradçanica* të vitit 1571, gjurmë të emrave të të cilave nuk janë ruajtur as në mikrotoponimi e as ndër emra vëllazërish. Megjithatë, J. Osmani, kujton se vendbanimi *Gradçanica* "gjendet diku ndërmjet Brrutit e Bilushës".[84]

Nga të dhënat e regjistrimit të nahijes së Opojës të vitit 1571 mësohet se procesi i islamizimit të pjesës dërmuese të popullatës, së pakut në rrafshin onomastik, kishte përfunduar në shek. XVI. Prej këndej mësohet p.sh. se ky proces nuk ishte kryer ende në katundin Bilush (katundi i sotëm Bilushë i komunës së Prizrenit), që atëherë i takonte

[83] sh. Vendbanimet e Kosovös, 20, f. 157.
[84] Po aty, f.155.

administrativisht nahijes së Opojës. Banorët e këtij katundi [me 39 shtëpi e 6 beqarë] mbanin ende antroponime të gjithkrishtera në trajtat sllave e shqipe të tyre dhe në katund kishte ende një prift të quajtur *Bozhidar* dhe një kallogjer "murg" (mbase shqiptar) të quajtur *Nino*. E këtillë ishte gjendja edhe në katundin e sotëm Pllajnik. Të gjithë banorët e këtij katundi, atëherë me 13 shtëpi e 7 beqarë mbanin pa përjashtim antroponime shqipe të sferës katolike të krishterimit. Banorët e katundit *Izlatarça* (sot Zgatar) me 20 çiftë[*] (= kryefamiljarë që kishin tokë, çiflig) shtëpi, 13 benakë[**] (= kryefamiljarë të patokë, pa çiflig) e 10 beqarë; nuk kishin ruajtur asnjë antroponim të krishter, sepse ishin islamizuar; në katundin Gzosh [me 15 çiftë, 8 benakë e 3 beqarë] ekzistonte vetëm emri *Pal* i një ish-pronari të bashtinës dhe patronimi Biba e të islamizuarit Mustafa; në katundin Pandalofic [me 5 çiftë, 1 benak e 3 beqarë] ishin ende vetëm edhe kryefamiljarët *Nina Gika*, e *Gjin Nina* - sado që shkruesi kishte shënuar se aty ishin 4 shtëpi të krishtera; në katundin Hotonova [me 9 çiftë, 2 benakë e 3 beqarë] ishte vetëm kryfamiljari *Premt Ali*-u; në katundin Zinova [me 17 çiftë] vetëm një pronar bashtine i quajtur *Koli*; në katundin Gorna Zabluzhan (sot Zaplugjë) [me 21 çiftë, 2 benakë e 5 beqarë] ishte i islamizuari *Iljas* me mbiemrin *Papasi* "murg,-u"; një banor me emrin karakteristik *Pervane* të vllehve dhe pronarët e bashtinave: *Kola Gora*, *Popa Lapko* e Shak,-a Mustafa-i; në Strela Gostriça [me 6 çiftë] ishte *Memi Doç Rada*; në Zubofic [me 1 çift, 1 benak e 4 beqarë], për të cilin shkruesi kishte shënuar se aty ishte 1 shtëpi e krishter, ishte *Biba Domi* e *Mustafa Papa*; në Dimitrofic [me 7 çift shtëpi e 3 beqarë] ishin dy pronarët e bashtinave: *Papa Gjika* e *Petra* (?) *Pali*; në Blaç [me 7 çiftë, 2 beqarë e 2 benakë] nuk kishte asnjë banor me antroponim të krishterë; në Pllavë [me 10 çifte, 4 benakë dhe 1 beqar, nga të cilat një familje ishte ende e krishter] ishin *Llapa Kola* e *Hysejn Llapa*; në Zolç [me 13 çifte dhe 1 beqar] kishin bashtina të quajturit *Lazar*, *Kola Nina*, *Gjon*, *Bib*(*ë*), *Mërtin Vasil-i* dhe *Rada* që kishte tokë në atë katund; në Prebiq [me 10 çifte, 1 benak e 6 beqarë] nuk kishte asnjë banor me emër të krishterë; në Olina (Kusaq) - sot Kosavë [me 15 çifte, 8 benakë e 5 beqarë, nga të cilat një shtëpi ishte ende e krishter] ishte vetëm *Biba Stepa* nga Debiri; në Buçe [me 11 çifte, 2 benakë e 3 beqarë] nuk kishte

* Sqarim, sipas S. Pulaha, Popullsia..., f. 714: "Në defterët kadastralë kryefamiljarët myslimanë që zotëronin nga një çiflig tokë (një sipërfaqe toke që mund të punohej nga një pendë qe) janë treguar duke shënuar përbri emrave të tyre germën ç, d..m..th. çift, që në këtë rast ka kuptimin e një çifligu toke."

** Sqarim sipas S. Pulaha, Popullsia..., f. 714: "Në defterët kadastralë të martuarit myslimanë që zotëronin tokë (bennak) janë treguar me germën (q), d.m.th. me germën e fundit të fjalës bennak."

asnjë banor me emër të krishter; në Brezne [me 14 çifte, 14 benakë e 3 beqarë] ishin dy pronarë bashtinash: *Lula Gjoni* dhe një i quajturi *Tusha*; në Zirzova/Zrze [me 7 çifte, 2 benakë e 6 beqarë] ishin *Deda Iskenderi*, *Mema Deda* e *Deda Hasani*; në Jenice Llaz [me 4 çifte, 2 benakë, 4 beqarë, me një shtëpi ende të krishterë] ishin kryefamiljarët *Hasan Kola*, *Memi Gjoni*, *Kola Pali* e *Ibrahim Pali*; në Sveti Petri [me 5 çifte e një benak] ishte kryefamiljari *Hasan Prifti* dhe pronarët e bashtinave: *Bogdani*, *Hasan Koka* e *Kola Presi* (*Preshi*); në truallishten German nuk kishte asnjë banor; në Dolina Zabluzhani (sot Zaplugjë) [me 212 çiftë, 2 benakë, 3 beqarë, nga të cilat 6 ishin ende shtëpi/familje të krishtera]: *Iljas Peka*, *Gjeta Peka*, *Hysejn Gjoni*, *Peka Gjoni*, *Deda*, *Shahi Hatuni*, *Gika Nina*, *Peka Tola*, *Marini*, *Biba Doçi*, *Gjin Liljali*, *Ali Roshi*, *Hysejn Koka* e *Memi Gika*; në Lopushniq [me 7 çifte, 4 beqarë, nga të cilat një familje ishte ende e krishterë] kishin bashtina: *Nina Kola*, *Nika Marini* e *Marko Novak*-u dhe, së fundi, në Gradçaniça [me 8 çift shtëpi, 1 benak e 5 beqarë, nga të cilat e krishterë ishte ende 1 familje] ishin kryefamiljarët *Mustafa Dida*, *Hysejn Rada*, *Dida Nina* dhe bashtinari *Nina Llapa*.

Gjykuar në mbështetje të të dhënave nga ky regjistrim (i vitit 1571), rezulton se banorët e nahijes së Opojës, që asokohe e përfshinte edhe katundin e sotëm Bilushë të komunës së Prizrenit, i kishin në përdorim ende antroponimet: *Bib*,-a (5[*]), *Bozhidar* (1), *Ded,-a* (3), *Did,-a*, *Doç,-i*, *Gikë,-a* (3), *Gjet,ë-a*, *Gjin,-i* (2), *Kol,ë -a* (6), *Kol,ë-i*, *Lazar,-i*, *Lul,-a*, *Llap,ë-a*, *Marin,-i*, *Mark,-o*, *Maz-*, *Mërtin,-i*, *Nik,ë-a*, *Nin,-i*/*Nino* (5), *Pal,-i* (2), *Papa*, *Pek,-ëa* (3), **Pjetër Petr,-o*, Premt,-i, *Rad,-i* dhe *Tush-i* dhe patronimet: *Biba*, *Deda* (2), *Dida*, *Doçi*, *Domi*, *Gika* (2), *Gora*, *Gjika*, *Gjoni* (3), *Hatuni*, *Koka* (2), *Kola* (3), *Lapko*; *Liljali*, *Llapa* (2), *Marini* (2), *Nina* (4), *Novak*-u, *Pali* (3), *Papa*, *Papasi*, *Peka*, *Presi* (*Preshi*), *Prifti*, *Rada* (2), *Roshi*, *Stepa*, i ardhur nga Debiri (2), *Tola* dhe *Vasili*.

Vështruar në pikëshikimin e prejardhjes gjuhësore e pra të lidhura me konfesionin, pjesa absolute e antroponimeve dhe e patronimeve të bartura nga popullata e Opojës deri në gjysmën e dytë të shek. XVI janë antroponime të shqiptarëve të sferës konfesionale të krishterimit perëndimor, përkatësisht të katolicizmit të trashëguara nga latiniteti ballkanik dhe nga burimet vendëse. Po u pat parasysh rrethana e ditur historike që Prizreni, duke e përfshirë pra edhe rrethinën e gjerë të tij, ishte njëra nga tri pikat e rëndësishme të shtetit/principatës katolike Arbanon/Arbër të shqiptarëve; shumësinë relative të oikonimeve e mikrotoponimeve dhe të gjurmëve leksikore nga latiniteti ballkanik si

[*] Numrat në kllapa shenjojnë numrin e bartësve të antroponimeve e të patronimeve që qëndrojnë para tyre.

edhe të arealit të emrave të gjithkrishterë në variantet shqipe të tyre deri në fund të shek. XV ka shumë arsye të pohohet me ngulm që shqiptarët e regjionit të Opojës i përkisnin deri në fund të shekullit 16 ritit perëndimor, katolik të krishterimit. Duket pra që kjo do të jetë arsyeja kryesore e ledhit të fortë midis banorëve të krahinëzave të Opojës e të Gorës, përkatësisht faktori bazë i ruajtjes së ardhësve vlleh sllavisht, përkatësisht bullgarishtfolës të goranëve të ardhur këndej qoftë si heretikë bogumilë, qoftë si ortodoksë të versionit sllav. Dëshmitë onomastike për sllavizimi të vëllazërive shqiptare do të mund të sqaroheshin mbase si konseguencë e lëvizjes së vëllazërive të veçanta shqiptare të ngulitura në ambiente gorane. (për këtë proces sh. më poshtë)

Të uzusit antroponimik të konfesionit ortodoks në variantet sllave të tyre janë vetëm antroponimet e patronimet: *Bozhidar*, *Novak*-u, *Rada, Stepa, Tola* e *Vasili.* Kjo rrethanë e padiskutueshme do ta lejonte nxjerrjen e përfundimit që popullata shqiptare e Opojës kaloi në besimin islam nga varianti katolik i krishterimit. Këtë e tregojnë fundja edhe vetë patronimet shqipe, katolike të opojarëve të islamizuar.

Në dritën e dëshmimit të institucionit të *babës* "kryepar i një grupi besimtarësh" që e mbante *Baba Hasani* i katundit të sotëm Zgatar, bijtë e të cilit kishin një bashtinë në Zinovë dhe antroponimit *Dervish* që e mbante një kryefamiljar i po këtij katundi dhe kalorësi *Dervish Sulejmani* i katundit Gorna Zabluzhan (sot Zaplugjë), ka arsye të besohet që të islamizuarit e parë opojarë ishin të ndonjërit nga sekte të dervishëve.

Ndër kryefamiljarë vendës të islamizuar kishte edhe *kalorës* që kryenin obligimin ushtarak, përkatësisht t'i jepte pushtetit ushtarë në rast nevoje, institucion ky i trashëguar nga periudha bizantine e *stratiotëve* dhe ajo e pushtuesit serb të *vojnik*-ëve. Të këtillë ishin kalorësit Ali-u, i bir i Iljas-it nga katundi Dimitrofic; Dervish Sulejmani nga katundi Gorna Zabluzhan (sot Zaplugjë) dhe kalorësi i quajtur Xhafer i katundit Olina (sot Kosavë).

Ndër të islamizuarit opojarë kishte edhe vazhdues të institucionit të *vojvodës*. Pas pushtimit osman-turk, *vojvoda* ishte "person i ngarkuar për të administruar dhe për të mbledhur të ardhurat e haseve, administrator i haseve". Të tillë ishin Xhafer *Vojvoda* dhe Beljan *Vojvoda*, që ishin pronarë bashtinash në Strela Gostriça dhe në Bllaq (sot Blaç). Vazhdimësia në të banuar që nga kohë të mugëta dhe sllavizimin onomastik e pjesërisht edhe etnik të opojarëve shqiptarë e shpjegon edhe arsyen përse disa kryefamiljarë opojarë e gëzonin privilegjin të kishin bashtina, institucion ky i trashëguar nga *pronia* bizantine e nga *baština* serbe e mesjetës së vonë.

Në të mirë të përkatësisë së pararendësve të banorëve shqiptarë të krahinës së Opojës ritit katolik të krishterimit do të shkonin edhe jo pak antroponime me prejardhje nga uzusi antroponimik i kishës së Perëndimit në trajtat karakteristike shqipe të tyre si p.sh. emrat aktualë të vëllazërive shqiptare *Dedaj* (në Zym e në Brodosanë), Dedaqi (në Zym), *Balaj* (në Brodosanë), *Dushaj*/*Tushaj*, (në Bellobrad); *Domne* (në Brrut); *Lezjanët* (në Buçje), *Skeraj* (në Rrenc) si dhe emri shqip *Dasaj*/*Dashët* i një vëllazërie në Bellobrad, në rend të parë porse antroponimet paraislame *Dedë*, *Dilë*, *Doç*, *Dodë*, *Dom*, *Dush*/**Dushman*; *Gegë*, *Gjon*, *Kolë*, *Lekë*, *Lesh*, *Lez*, *Lik*, *Luz*, *Marash*, **Mërtin*, **Mrat*, përkatësisht Martin, *Reç*, *Sker*,/**Skel* e *Tushë*, të përmbajtura në mikrotoponimet si: *Ara Dilës* (në Zym); *Mullakat e Doçit* (në Kuklibeg); *Bashqet e Dodës* (në Zym); *Lugi Gegës* (në Zym); *Kroi i Domnit* (në Brrut); *Ara Kolës* (në Zym); *Kodra e Kurgjonit* (në Buçje); *Guri i Lekajve* (në Kuklibeg); *Rrasat e Lekos* (në Pllavë); *Kroi Lekës* (në Zapluxhë); *Udha e Leshit* (në Kuklibeg); *Topilla Leshit* (në Pllavë); *Kroi Lezit* (në Pllajnik); *Rrinat e Likos* (në Kapre); *Kroi Luze* (në Buçje); *Lisi Marashit* (në Buçje); *Gropat e Mërtaje*, e aty edhe *Troishta Plakë* (në Kuklibeg) dhe *Guri Reçit* (në Brodosanë).[85]

Përveç burimeve që u sollën më lart, ka edhe një regjistër osman-turk i banorëve të katundit Krushevë të Gorës, i përpiluar në vitin 1579. Atëherë banorë të këtij katundi ishin: Abdullah-u, i bir i Ahmet-it; Abdullah-u i bir i Gafer-it; Seyyit Mehmet-i, i bir i Mustafa-it; Dabağğ, i bir i Jusuf-it; Abdullah-u, i bir i Ibrahim-it; Abdullah-u, i bir i Huseyin-it; Abdullah-u, i bir i Sulejman-it; Polat-i, i bir i Avan-it; Polai, i bir i Piri-t; Gun-i, i bir Solmaz-it; Solmaz-i, i bir i Ustuvan-it; Avan-i, i bir i Nigo-s; Tuna, i bir i Nigo-s; Nigo, i bir i Laran-it; Zimmi, i bir i Bisho-s; Bisho, i bir i Usturas-it; Isak Lomiç-i; Ustuvan Nigola; Ustuvan Nigo; Nigo Lale; Juvan Ustuvan-i; Dodo Zampir-i; Dazinlu Ajvan-i; Dodo Javan-i; Javan Ustuva; Guldan Nigo; Nigo Nigola; Landon Domiç-i; Polat Dimitri; Rase Lespo; Zuluf Domaniç-i; Zuluf Gurci; Dimitri Nigola; Niv Zili; Ugras Liponas-i; Marko Navl-i, Lolo Zagol-i; Javan Gurun-i; Juvan Nigo; Zulef Dimitri; Zulef Nigo; Budan Piri; Budan Kurt-i; Kurt Nigo; Deriç Nigo; Zulef Ustuvan-i; Zulef Nigin-i; Polat Ustuva; Niv Istango; Javan Danyo; Javan Nuce; Nigo Laran-i; Javan Zulfikar-i; Javan Ishak-u; Ismail Bukin-i; Meçin Beshe; Domiç Beshe; Budan Nigo; Nigo Ustivane; Bogdan Nigola.[86]

---

[85] Të gjithë emrat e vëllazërive dhe mikrotoponimet e mësipërme u morën nga libri Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 88, 97, 100, 103, 106, 109, 116, 117, 127, 134, 146, 152 i J. Osmanit.

[86] Khs. origjinalin: Abdullah oglu Ahmet, Abdullah oglu Gafer, Seyyit Mehmet oglu Mustafa, Dabağğ oglu Yusuf, Abdullah oglu Ibrahim, Abdullah oglu Huseyin,

Po u analizuan në rrafshin e prejardhjes, mua më rezulton që (duke e marrë këtë për prototip) banorët e këtij katundi dhe pothuaj edhe ata të të gjitha të tjerave të regjionit kompakt të Gorës, mbanin ende shumë antroponime e patronime me prejardhje të uzusit onomastik të shqiptarëve dhe disa antroponime vllahe. Për të uzusit antroponimik të shqiptarëve i mbaj emrat: *Dimitri*, *Dodo*, *Domaniç*, *Domiç*, *Deriç*, *Laran*, *Nuc-e* e *Tuna*, ndërsa për vllahe ato: *Gun* e *Gurun*.

Edhe nga materiali onomastik i banorëve të këtij katundi ka shembuj të vazhdimësisë deri në ditët tona të emrave të dëshmuar në dokumentin e vitit 1579. Kështu, mbiemri *Piri* i dokumentit qenka ruajtur si mikrotoponim *Pirove njive* "Arat e Pirit"; mbiemri *Lipanos* është ruajtur tek patronimi *Ljupanke*; emri *Mečin* është ruajtur përmes toponimit *Mučinova*; mbiemri *Zagol* është ruajtur si patronim *Žagoljče* etj. Studiuesi S. Idrizi sqaron se ka edhe më shumë kësi shembujsh, por që shumica nga ata nuk mund të dëshmohen në terren për shkak se pas vitit 1912 shumë familje të Krushevës janë shpërngulur për në Turqi dhe kësisoj u ndërpre kontinuiteti dhe pse midis dy Luftërave, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, shumë familjeve të Gorës iu vunë mbiemra të rinj[87] të diktuar nga administrata.

Një çështje fort e rëndësishme në kuptimin e rregullimit social të popullatave të Opojës dhe të Gorës është mungesa e institucionit të fisit, në kuptimin e tij në vise të Shqipërisë së Veriut dhe në Kosovë. Në Opojë e në Gorë nuk ka një ose më shumë vëllazëri e barqe që do ta ndjenin veten pjesëtarë të ndonjërit nga numri biblik i të 12 fiseve shqiptare si p.sh. Berisha, Gashi, Krasniqi etj. Kjo do të tregonte, në vija më të largëta, që këndej nuk u zhvillua institucionalizimi, regjionalisht i kushtëzuar, i vëllazërive në një institucion të përbashkësisë së mbajtur më vonë edhe për të të njëjtit pararendës, të të njëjtit "gjak", por që duket në këto dy regjione mjaftoi institucioni i vëllazërisë si njësi autonome

Abdullah oglu Sulejman, Polat veledi **(**Avan, Polat veledi Piri, Gun veledi Solmaz, Solmaz veledi Ustuvan, Avan veledi Nigo, Tuna veledi Nigo, Nigo veledi Laran, Zimmi veledi Biše, Biše veledi Usturas, Isak Lomič, Ustuvan Nigola, Ustuvan Nigo, Nigo Lale, Yuvan Ustuvan, Dodo Zampir, Dazinlu Ajvan, Dodo Javan, Javan Ustuva, Guldan Nigo, Nigo Nigola, Landon Domič, Polat Dimitri, Rase Lespo, Zuluf Domanič, Zuluf Gurci, Dimitri Nigola, Niv Zili, Ugras Liponas, Marko Navl, Lolo Zagol, Javan Gurun, Juvan Nigo, Zulef Dimitri, Zulef Nigo, Budan Piri, Budan Kurt, Kurt Nigo, Derič Nigo, Zulef Ustuvan, Zulef Nigin, Polat Ustuva, Niv Istango, Javan Danyo, Javan Nuce, Nigo Laran, Javan Zulfikar, Javan Ishak, Ismail Bukin, Mečin Beše, Domič Beše, Budan Nigo, Nigo Ustivane, Bogdan Nigola te: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I – IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[87] Sadik Idrizi Aljabak, Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV)

përbrenda hapësirave që i banonte secila nga këto. Kjo do të thotë, në vija më të largëta, që këtu nuk pati një zhvillim e rregullim social të bashkëshkrirjes së vëllazërive në një institucion të zgjeruar të fisit, sepse nuk pati nevojë për ndonjë (ri)ndarje të kullotave. Po të kishte ndodhur kështu, do të duhej pritur që edhe në këto dy krahina ta kishim institucionin e fisit e edhe atë të ndarjes administrative osmane-turke në njësitë e bajraqeve. Një përfundim tjetër logjik që mund të nxirret në dritën e mungesës së institucionit të fisit në këto dy krahina është rrethana që këndej nuk do të ketë pasur ardhje/ngulitje të shqiptarëve nga vise, sot kufitare, në të cilat ishte etabluar institucioni i fisit. Vetëm kështu, mendoj unë, mund të sqarohet çështja përse në regjionin e Gorës nuk njihet institucioni i fisit në kuptimin klasik të tij. Kjo mungesë e anulon mundësinë e shqiptarizimit të vllehve të ardhur si të bullgarizuar në regjionin e Gorës jo për shkak të rezistencës, por pse institucioni i fisit nuk ishte etabluar as në krahinën e Opojës e as në atë të Malësisë së Tetovës. Mungesa e institucionit të fisit do t'i ketë favorizuar martesat midis pjesëtarëve të vëllazërive të së njëjtës bashkësi e pra, në rastin e Gorës, edhe mospërzierjen përmes martesash me popullatën vendëse përreth.

Përveç në rrafshin gjuhësor, lashtësinë në të banuar e, pra, edhe autoktoninë relative të shqiptarëve në këtë zonë para pushtimeve sllave të shek. XII sikur e dëshmojnë edhe të dhënat jashtëgjuhësore. Në këtë kuadër bien në rend të parë segmente të rregullimit shtetëror-social. Sa kohë që pothuajse në të gjitha vendbanimet (edhe) të krahinës së Opojës kishte pronarë të krishterë[88] e sish pasardhësish të tyre të islamizuar[89] bashtinash, rezulton se këtu kemi të bëjmë me një popullatë vendëse që e kishte përjetuar, në vend, së pakut që nga periudha e sundimit bizantin statusin prej *proniarësh*, bashtinarësh edhe gjatë periudhës së sundimit dyshekullor sllav. Edhe rrethana jashtëgjuhëse që në këtë hapësirë nuk kishte më aq shumë *stratiotë*, përkatësisht *vojnikë - vojnukë* e dëshmon inkuadrimin në shek. XVI të popullatës së kësaj pjese të hapësirës etno-

[88] Khs. pronarët e bashtinave të quajtur Dedë (në Bilushë); Pal (në Gzosh); Nina Gika (në Pandelofic), Rada (në Hotonova), Kola Gora e Papa Lapko (në Zaplugjë); Papa Gika e Petra Pali (në Dimitrofic); Beljan (në Blaç); Lazar, Kola Nina, Gjoni, Biba e Mërtin Vasili (në Zolç); Lula Gjonit, Tushës (në Brezne); Koka Gjonit, Bogdanit e Kola Preshit (në Sveti Petri); Dedës, Gjonit, Peka Gjonit, dhe Marinit (në Dolina Zabluzhani); Nina Kolës, Nika Marinit e Marko Novakut (në Llopushnik) dhe Nina Llapës (në Gradçanic)

[89] Khs. pronarët e bashtinave: Hysejn Ballniza (në Zgatar); Dervish Sylejmani dhe Shaka Mustafai (në Zaplugjë); Hasan Abdullahu (në Dimitrofic); Mustafai (në Zolç); e Aliut (në Prebiq); Hysen Abdullahu (në Buçe); Shahi Hatuni (në Dolina Zablugjani).

glotologjike të shqiptarëve në jetën administrative osmane-turke, e cila (popullatë), si e islamizuar, nuk dërgonte më luftëtarë në ekspeditat dhe në luftërat që i zhvillonte perandoria osmane. Përjashtim nga ky rregull i arritur bënin vetëm pak (gjithsej 3) kryefamiljarë. Nga të gjithë kryefamiljarët e nahijes së Opojës, *kalorës* kishte vetëm në katundet Gorna Zabluzhan (sot Zaplugjë), ku jetonte bashtinari Dervish Sylejman-i *kalorës*; në Dimitrofic ku jetonte Ali-u, i bir i Iljasit, *kalorës* dhe në katundin Olina (sot Kosavë), ku jetonte kryefamiljari Xhafer-i, *kalorës*.[90] Përmbushja e obligimit ushtarak në ushtrinë osmane-turke nga vendësit e krishterë dhe të atyre të sapo islamizuar opojarë e dëshmon mbase kontinuitetin shqiptar të sistemit bizantin e sllav dyshekullor të stratiotëve, përkatësisht të vojnikëve/vojnukëve. Në këtë mes nuk duhet ngatërruar bartësit e titullit osman me prejardhje nga sllavishtja, *vojvodë* (çfarë ishin p.sh. vetëm dy të tillë: *Xhafer vojvoda* në Strela Gostriça e *Beljan vojvoda* (në Blaç)[91] sepse këta nuk kishin të bënin gjë me ushtrinë e me ekspeditat ushtarake.

4. GORA E OPOJA NË DRITËN E STUDIMEVE GJUHËSORE, ETNOGRAFIKE E HISTORIKE BULLGARE, SERBE, SHQIPTARE E BOSHNJAKE

4.1. Mendime e hipoteza përkitazi me gjuhën dhe me prejardhjen etnike të popullatës së Gorës

Para se të trajtohen çështje qenësore të lidhura me përkatësinë etnike, me gjuhën, përkatësisht me të folmen, me çështje etnografike e etnologjike të popullatës së kësaj hapësire duhet theksuar se emri *Gora* është, padyshim, i prejardhjes sllave. Ky emër e ka kuptimin "mal, bjeshkë; kullotë". Si i këtillë, ky emër shënon pra vetëm një regjion malor, një bjeshkë, kullotë, prandaj nuk përmban kurrfarë informacioni për përkatësinë etnike të banorëve të këtij regjioni. Ky emër është i ngjashëm për nga formimi e për nga kuptimi p.sh. me emrin *maqedo të* sllavëve jugorë që e banojnë një vend të cilin këta e kishin gjetur të banuar nga një popull po me këtë emër. Në këtë kuptim, as ktetiku *goran* nuk ka ndonjë ngjyrosje etnike: ai tregon vetëm banorin e një regjioni të quajtur Gora. E konsideroj për të qëlluar mendimin e Sadik Idrizit se emri *goran* është një "nocion gjeografik".[92]

---

[90] Khs. S. Pulaha, Popullsia. .., f. 345, 347, 351.

[91] Sipas S. Pulaha,... Popullsia..., f. 720, detyrë e tyre ishte administrimi dhe mbledhja e të ardhurave të haseve; administratorë të haseve.

[92] Khs. Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k -.

Barazimi i emrit *goran* me një popullatë më vete do të tregonte, në vija më të largëta, se këtu kemi të bëjmë me një popullatë të ardhur (për këtë sh. në vazhdim të kësaj trajtese), të vendosur në këtë regjion të cilin pas gjithë gjasësh do ta kenë gjetur me këtë emër. Sakohë që emri *Gora* nuk përcillet me ndonjë atribut siç ndodh rëndom me emra bjeshkësh, kullotash e malesh në gjuhët sllave të jugut, khs. serb. Fruška Gora, Mokra Gora, sllov. Kranjska Gora etj. ka arsye të paravendohet që emrin *Gora* t'ia kenë dhënë kësaj hapësire pararendësit e goranëve të sotëm.

Me rëndësi më duket në këtë mes çështja nëse emri *goran* do të jetë një distinktiv sllav serb për "blegëtor, bari." Në një punim të përshkuar edhe me karakter polemik, dijetari kosovar I. Ajeti, në kuadër të arsyetimit të prejardhjes nga mbiemri shqip *i kuq*, mbase në bazë të ngjyrës së dheut, emrit të fisit, të bashkësisë blegtorale shqiptare të Kuçëve në Mal të Zi, tregonte se nuk mund të jetë i drejtë mendimi i disa etnografëve e historianëve serbë sipas të cilit në krahinën e sotme të Kuçit nuk paska pasur deri në shek. XIV-XV ndonjë bashkësi territorialisht të organizuar të barinjve shqiptarë. Këndej paska pasur porse, sipas dijetarëve serbë, vetëm një bashkësi të organizuar barinjsh serbë përbrenda hapësirës *Gorska Župa* të Zetës mesjetare. Autori kosovar I. Ajeti i bashkëngjitet me të drejtë pyetjes që e shtronte prof. B. Đurđev, përse edhe Kuçët nuk u quajtën *Goran-i* "goranë". Po u ndoq ky shembull i emërtimit *goranë* "barinj",[93] përkatësisht "banorë bjeshkësh; kullotash", atëherë do të dilte paksa problematike nëse emri Gora i regjionit tonë do të jetë një formim në krye të herës nga slav. *goran* "bari" apo nga emri *Gora* i hapësirës së përshtatshme për kullota. Po u nisëm nga rrethana e shtjelluar më poshtë që "goranët" janë pjesë e asaj popullate trakase, përkatësisht romane ballkanike e sllavizuar e cila njihet me shumë emra: pomakë, torbeshë etj. e që vetëm në Kosovë, në Shqipëri e nga fqinjët serbë e maqedonas quhet "goran,-ë", do të rezultonte që ky emër lidhet me emrin e bjeshkës, regjionit Gora dhe është si i këtillë nocion gjeografik e jo etnik i mirëfilltë.

Lidhur me prejardhjen, përkatësisht me përkatësinë etnike të popullatës së regjionit të Gorës janë shkruar deri tani bukur shumë trajtesa. Pjesa më e madhe e tyre janë të karakterit dialektologjik e etnografik. Në këtë kontekst janë bërë përpjekje që materiali onomastik i këtij regjioni të vlerësohet në aspekte të ndryshme, sepse Gora - duke qenë zonë kryesisht blegtorale, si një ishull gjuhësor, një oazë gjuhësore sllavofone mespërmes zonave me banorë shqipfolës, si një ishull sllavofon në detin etnik shqiptar - paraqet njërin ndër regjionet shumë interesante i cili (re-

[93] Idriz Ajeti, Shqiptarët dhe gjuha e tyre, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1994, f. 42-43.

gjion) meriton të studiohet në rrafshe të ndryshme të dijes filologjike. Mbase pikërisht për këtë arsye edhe rezultatet e deritanishme të studiuesve - sidomos për sa i bie përkatësisë së gjuhës, të së folmes që e flasin goranët e prandaj edhe për sa i bie përkatësisë etnike të folësve të asaj gjuhe, janë aq të ndryshme e aq kundërthënëse.

Një tezë, për mendimin tim kryesorja dhe më e bindshmja, përkitazi me prejardhjen e pararendësve të goranëve të sotëm, është ajo e prejardhjes vllahe.

Mua më duket se bazë potencialisht e mundshme e zgjidhjes së çështjes së prejardhjes së banorëve të regjionit të Gorës, çështje kjo që është debatuar deri në sjelljen e saj në një objekt enigmë të barabartë me zgjidhje senzacionale, mund e mbase edhe duhet të jetë konstatimi i njohësit më të mirë të historisë antike e sidomos të asaj mesjetare të shqiptarëve, të kroatit Milan Šufflay i cili, kur po fliste për vlleht, të cilët ky i barazonte thjesht me rumunë, thoshte përkitazi me këta (vlleht) se "Dyndja e sllavëve në Ballkan i coptoi shtratet e rumunëve ose të vllehve, i shtyni thellë kah jugu në Thesali dhe kah perëndimi deri te portat e qyteteve bregdetare dalmatine. Pjesët e forta të rumunëve në kohën e mesme vërehen si vazhdë jugore e zonës së gjatë dalmatine të Morlakëve ose Moro vllehve në trollin e Zetës Lindore ose të Malit të Zi, pastaj në brrylin ma verior të Drinit dhe përtej këtij lumi deri te rrethi i Pukës. Regjioni në veri të Drinit të Zi deri te komplkesi i Bjeshkëve të Nemuna shqiptare formonte në kohën e mesme një brez shum interesant të simbiozës etnike, në të cilën elementi shqiptar dhe rumun i barijve u shkri me elementin sllav bujqësor."[94]

Šufflay e shkoklon këtë mendim të tijin edhe për kohë më të vona, përkatësisht për në shek. XVII, prej nga rezulton se prejardhja e pararendësve të goranëve të sotëm është e pandashme nga dyndjet e elementit vllah nga vendbanimet e tyre në hapësirat e sotme të Bullgarisë (masivi i Rodopeve), të Greqisë e të Maqedonisë. Sado që autori i citatit të mëposhtëm shkruante për fatin e vllehve në një kohë më të re e mbi të gjitha që ky nuk i përmend shprehimisht pararendësit vlleh të goranëve tanë, nga ky vlerësim i përgjithshëm rezulton prejardhja vllahe e goranëve dhe e gogëve. Ja citati i paralajmëruar më lart:

"Sulmi turk mbi fiset rumune të Maqedonis e të Thesalis veprou në të kundërtën se sa një kohë dyndja sllave mbi Rumunët e qarkut romak. Shtretënt, nën sulmin turk, u coptuen prej jugut në veri. Në vjetin 1610 tregonte vendi Molocussi, se afër Krues gjindeshin tepricat e Mala-

[94] Dr. M. Shufflay, Serbët dhe shqiptarët, Prishtinë, 1968, f. 29.

kashvet të jugut. Ndërtimet, që u banë nën monastirin benediktin të Shën Lleshit mbi Malin e Shenjt të Mirditës, muerën emnin *Orosh*; ket êmën u a dhan pa dyshim t'arratisunit rumunë (rum. oroshi d.m.th. varosh). Në Bosnje, në rrethin e Foçës, gjindet nji fshat, që quhet *Paraun*: Zberthimi gjuhuer i këtij êmni, të cilin e shkoklon prof. Skok tregon se aji rrjedh prej Rumunvet, që shkuen atje prej jugut dhe që jetojshin në pjekje me shqiptarët e vjetër (*paraun* vjen prej shqipes *prrue, prrua*, sllav. *potok*). Dhjalekti i Rumunvet të sotëm në Shqipënín e veriut asht maqedon-rumun. Fjalët sllave në dhjalektin e Rumunvet, që në fundin e të 15 tit qindvjet u dyndën në Istri, formojnë tepricat e rinezmit, që të çojnë ke gjuha bullgare e kohës së mesme. [...] Barinjt rumunë n'ikjen e vet u lanë Sllavëvet e Maxharëvet shumë fjalë shqipe të blegtoris" [...] në Bosnje u sllavizuan [...] Po ky fat i priti edhe Maqedho-Rumunët, që mbetën të shpërndam në jug. Për qark Selanikut e Serës u banë Grekë, për rreth Velesës, Perlepit e Prizrendit u shëndrruen në Serbë; rrotull Elbasanit, Beratit e Tiranës u këthyen në Shqiptarë".[95]

Në këtë mes bën të rikujtohet që ka një mendim, i përfaqësuar nga dijetari H. Barić, sipas të cilit shqiptarët na qenkan, në hapësirat që sot i banojnë, të ardhur pikërisht nga malet e Ballkanit dhe nga ato të Rodopeve. Por kundër kësaj teze qenka madje edhe etnografi serb J. Erdeljanović i cili "... i kundërshton shtegtimet e mëdha të shqiptarëve nga Lindja në Jug, sepse ndryshimet në punë të gjuhës që kanë gegët me toskët si dhe zakonet dëshmojnë se shqiptarët që lashti banojnë në truall të sotëm."[96]

Mendimin e Šufflay-t (khs. më lart) e mbështet edhe N. Dokle, sado që ky për sa i përket prejardhjes së goranëve qëndron mbi bazat e teorisë së maqedonasve dhe asaj të bogumilizimit. Autori ynë flet për një *komponente* vllahe dhe jo për prejardhjen vllahe të goranëve, duke e mohuar mundësinë e asimilimit të elementit të substratit roman vendës. Ky vërente se "Prania e vllehve në Kosovë, përgjatë luginave të dy Drinave, është tashmë e dëshmuar. Burimet tregojnë që këta janë të pranishëm edhe në Gorë. Toponimet *Šištevec* i cili rrjedh ndoshta nga Šištofc (katund vllehsh), *Vlahinica* (në Borje), *Vlani Sad* (në Cërnoljevo) flasin qartë për gjurmë vllehsh. Përmendja e vllehve në këngën (S'nce zajde među dve planine,/a ja legna među dve Vlahine), mikrotoponimi *Šundinci* (mahallë në Borje) nga *Šunda* - një patronim tipik vllah në Korçë e në Gjirokastër, huazimet aromune në të folmen e Gorës (*junec, urda, ćulja, čučulj, skut, šljakulj, hrkulj* etj.), patronimi *Vlaca* (në Pakish)

[95] Po ai, po aty, f. 175.
[96] Sipas I. Ajeti: Shqiptarët dhe gjuha e tyre, Prishtinë, 1994, f. 29.

bashkë me toponimet *Ljupanovci* e *Ljupanovo Jabuče* janë argumente të tjera që shkojnë në të mirë të kësaj që u tha më lart."[97]

Jo për prejardhjen vllahe të goranëve, porse vetëm për si një komponentë historikisht "atraktive" në etnogjenezën e goranëve të sotëm flasin edhe vetë pretendentët për prejardhjen serbe të goranëve të sotëm si p.sh. antropologu M. Lutovac, i cili konstatonte se "Gjurmët vllahe janë transparente ndër emra të vëllazërive gorane si p.sh. Ziza - Zizinci, Renda, Bajmakovci, Mandakovci etj."[98]

Pikërisht konstatimi, përkatësisht simbioza e paravenduar me të drejtë dhe me mbështetje historike nga Šufflay, nuk u muarr parasysh nga studiues bullgarë, serbë e të tjerë, prandaj përkatësia etnike e gjuhësore e goranëve mbeti deri edhe në ditët tona një pikë e kontestueshme, sidomos midis dialektologëve e filologëve bullgarë e serbë, sepse filologjia shqiptare nuk është marrë me këtë çështje - sado që kjo nuk do të duhej të ishte kaq indiferente ndaj një problemi të hapësirës së vet etnolinguistike. Kujtoj se mosangazhimi i dijes abanologjike për të kaluarën e regjionit të Gorës nuk duhet kuptuar si heqje dorë nga përkatësia territoriale e Gorës së Kosovës dhe e popullatës së saj si historikisht qytetare e Kosovës.

Më duket i drejtë konstatimi i N. Dokles se [çështjen e Gorës] "shkenca shqiptare e ka heshtur deri në harresë", prandaj, "[...] ndjen njerkun çdo goran, kur sheh përjashtimin, në vend të kujdesit ndaj kulturës së tij nga shteti. Gjithashtu, pasiguri e shqetësim përhap prepotenca e heshtjes së shkencës shqiptare ndaj saj. I njëjtë na duket edhe mohimi me një të rënë lapsit i kësaj kulture, prej disa ulemave që udhëhiqen prej patriotizmit naiv, e jo prej kriteresh shkencore. Argumenti historik është i mjaftueshëm për të mos humbur kohë për të vërtetuar me gjithëfarë sofizmash aksiomën e përkatësisë shqiptare të hapësirës së Gorës. *Kur fillon e i pyet kojshitë për arat e babës, e vë në dyshim këtë përkatësi*".[99] - thotë autori ynë.

Interesimi i filologëve për të folmen e Gorës ishte intensiv sidomos duke filluar nga vitet e '20-ta të shek. XX. Kështu, filologu bullgar St. Mladenov[100] shkruante qysh në vitin 1925 p.sh. se në të folmen e katundeve të Gorës zanorja *ъ* e bullgarishtes së vjetër (= sllavishtes së vjetër) u reflektua këndej në *o*, kurse gjysmëzanorja *ь* u reflektua në *e* si

[97] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[98] Po ai, po aty.

[99] Nazif Dokle, Për Gorën dhe goranët, (Artikuj e studime), Prizren, 2002, f. 54, 72.

[100] Khs. Prof. Dr. St. Mladenov, Bemerkungen über die Albaner und das Albanische in Nordmakedonien und Altserbien, Balkan - Archiv 1 (1925), f. 59.

edhe në bullgarishten e vjetër dhe jo në *a* si në serbishten e vjetër: khs. bullg. *son* serb. *san* "ëndërr", bullg. *pèsok* serb. *pesak* "zall, rërë", bullg. *vòsok* serb. *vosak* "dyll", bullg. *océt* осѣтъ serb. *ocat* "uthull", bullg. *Lèsno* serb. *lako* "lehtë", bullg. *dèneska* serb. *danas* "sot" etj. Së këndejmi, Mladenov e nxjerr përfundimin se "Të folmet e disa katundeve në veri të Maleve të Sharit me Sreckën si qendër dhe sidomos ato të popullatës sllave të Gorës "Gora" (= "Gora e Prizrenit"), në perëndim të Maleve të Sharit [...] i kanë më vete të gjitha veçoritë e bullgarishtes, si në rrafshin e morfologjisë e të sintaksës, ashtu edhe në atë të fonetikës".[101]

Edhe historianë e etnografë të tjerë bullgarë e konsiderojnë popullatën e Gorës për popullatë bullgare. Sipas mendimit të J. Ivanov, (SG: mbase që nga shek. IX) deri në fund të shek. XII p.sh. Prizreni dhe vendbanimet përreth tij paskan qenë të banuara nga një popullatë bullgare. Vetëm pas përpjekjeve të suksesshme të kontit "të Madh" rashian Stepan Nemanja, i cili e synonte bashkimin e fiseve të serbëve dhe sidomos gjatë kohës së sundimit të Stefan Uroshit I (1243-1276) Prizreni, Maqedonia Perëndimore bashkë me Shkupin, Tetovën e me Dibrën ranë nën sundimin serb e prandaj edhe fuqia bullgare qenka vyshkur. Mirëpo popullata bullgare, gjithnjë sipas këtij dijetari, paska mbetur të jetojë edhe më tutje në rrethina të Prizrenit e të Tetovës, përkatësisht në rreth 30 katundet e Gorës dhe, kjo popullatë po e fliska edhe sot e gjithë ditën bullgarishten, sado që kjo (popullatë) është e përkatësisë fetare myslimane. Rrethanën që banorë të disa katundeve gorane po fliskan shqip,* Ivanov e sqaronte, për mendimin tim shumë lehtë, me rrethanën se këtë gjuhë goranët thjesht e paskan marrë nga fqinjët e tyre shqiptarë. Në mbështetje të hulumtimeve të tij, ky dijetar i del zot mendimit se edhe emrat e vendeve si *Celogražda* (shq. sot Sallagrazhdë, në komunën e Suharekës), *Graždanik*, *Leštance*, *Ljubižda*, *Leskovec*, *Krstec*, *Kostrec*, (shq. *Kosterc*, në komunën e Suharekës), *Našec*, *Tupec* (në komunën e Prizrenit), *Bubovec* (shq. Bubavec, në komunën e Klinës), *Gradec* (shq. Grajçec, në komunën e Suharekës) dhe të tjera në rrethina të Suharekës, përkatësisht në regjionin e Gorës, qenkan toponime me prejardhje bullgare.[102]

Në dritën e rrjedhave reale historike, mua më rezulton që pararendësit vlleh bullgarishtfolës të Gorës së sotme nuk mund të jenë të ardhur në këtë

[101] Po ai, po aty, f. 58.

* Duket se këtu është fjala për 10 katundet me popullatë shqipfolëse:të rrethinave të Kukësit (Shqipëri): Bele, Brekijë, Kollovoz, Lome, Nimçë, Novosejë, Shtreze, Topojan, Turraj e Xhaferraj, të cilat territorialisht bien në hapësirën etnogjeografike të quajtur Gorë.

[102] Khs. Bălgarite v Makedonija, Izdiranija i dokumenti za tehnoto poteklo, ezika i narodnosta s etnografskata karta i statistika, Sofija 1917, f. 47, 52 ref. 1.

hapësirë përpara shek. XII, sado që duke nisur nga vitet e ’50-ta të shek. IX e deri në vitin 1018 Kosova ishte nën sundimin e Perandorisë Bullgare e cila, që nga fundi i shek. 9 deri në çerekun e tretë të shek. 10, mbizotëronte në Ballkanin që e kishte pushtuar dhe shtrihej që nga Adriatiku e deri në Detin e Zi dhe sado që rreth vitit 1000 Kosova i takonte perandorisë jetëshkurtër ballkanike të carit bullgar Samuil (976-1014). Kjo sepse Perandoria Bullgare e shek. IX nuk ishte as perondori e as shtet i sllavëve të sotëm bullgarë. Deri në vitet 864/865 kjo perandori drejtohej nga një mbishtresë pagane e të ashtuquajturëve protobullgarë, që ishin folës të tyrkmenishtes. Kjo mbishtresë u bullgarizua tek në shek. X. Kjo u realizua me nënshtrimin nga Bizanti të kësaj perandorie pas luftërave të përgjakshme në vitin 971 që e pati për rrjedhojë përqafimin nga protobullgarët dhe nga pasardhësit e tyre bullgarë sllavë të ortodoksisë bizantine, moment ky që ia hapi dyert ndikimit masiv kulturor bizantin.[103]

Sado që rreth vitit 1000 Kosova i takonte perandorisë jetëshkurtër ballkanike të carit bullgar Samuil (976-1014) kjo, pas shprishjes së saj, iu përngjit Perandorisë së Bizantit, që Kosovën e sundoi deri në fund të shek. XII.[104]

Nën këso rrethanash është plotësisht e kuptueshme që nuk do të ketë pasur nevojë të shënohej në anale lëvizja e popullatës vllahe të bullgarizuar përbrenda hapësirës së perandorisë, shtetas të së cilës ishin edhe vlleht. Duke u nisur nga rrethanat historike, ka arsye të besohet që kjo dyndje të ketë ndodhur gjithsesi para shek. XII, përpara pushtimit të Kosovës nga sundimtarë të bërthamës shtetërore të serbëve të Raška-s.

Teza e mësipërme arsyetohet mjaft bindshëm edhe në dritën e rrethanës që të gjitha elementet orientale në onomastikën dhe në gjuhën e goranëve janë me prejardhje nga osmanishtja-turqishtja mesjetare dhe se nuk ka elemente gjuhësore që do të lidheshin me gjuhën e folur nga pararendësit tataro-mongolë, tyrkmenë të shek. X.

Për ndryshim nga politika tradicionale dhe nga kjo bashkëkohore serbe, dialektologë serbë, nga ana tjetër, ose e konsiderojnë të folmen e goranëve për dialekt serb ose janë paksa më të rezervuar në dhënien e mendimeve të prera.

Me çështjen e gjuhës së banorëve të Gorës ishte marrë në çerekun e parë të shekullit që shkoi edhe antropologu serb Jovan Cvijić, i njohur për panserbizmin e tij të skajshëm. Duket se konstatimi i tij se “Por edhe tani

[103] Oliver Jens Schmitt, Kosovo, Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft, Böhlau, UTB, Wien, Köln, Weimar, 2008, f. 49.

[104] Sipas Oliver Jens Schmitt, Die Kosovo Geschichte, Srpska Pravoslavna Crkva, në http.//www.spsportal.org/index.php.

pothuajse të gjithë shqiptarët (sic.!) e Gorës flasin serbisht, veçse përziejnë shumë fjalë shqipe, turke e bullgare, këto të fundit kryesisht për shkak se këta nga disa muaj në vit i kalojnë si gurbetçarë në Rumeli. [...] dhe "Këta të turqizuar rishtazi, e quajnë veten torbeshë"[105] të mos jetë rezultat i ndonjë pune serioze hulmtuese e këtij dijetari as në literaturë e as në terren.

Ndryshe mendonte dialektologu serb A. Belić. Ky ishte i mendimit se zhvillimi i dialekteve të serbishtes është i pandashëm nga procesi i kolonizimit serb të Kosovës së sotme. Ai thoshte: "Drejtimin e kolonizimit serb (S. G. të Kosovës) mund ta karakterizojmë përgjithësisht sipas qendrave dhe selive të sundimtarëve serbë si para ashtu edhe pas Betejës së Kosovës. Këto qendra e seli u shtrinë në shek. XIII nga *Ras- i* (S.G.: *Arsia* parasllave, serb. Raška, afër Novi Pazar-it) në drejtim të Prishtinës. Prej këndej depërtoi pastaj në shek. XIV, gjatë kohës së sundimit të carit Dušan, në drejtim të Prizrenit e të Shkupit. [...] Në mbështetje të gjithë kësaj mund të thuhet se gjuha e shtetit të vjetër serb e kishte për qendër Rashën. Kjo gjuhë shërbeu për bazë të zhvillimit të këtyre dialekteve. Derisa gjuha jonë (mendohet serbishtja S. G.) në jug të Maleve të Sharit dhe të Shkupit u krijua në drejtim të Prilepit e të Velesit dhe në vende të tjera e ruajti formën e saj arkaike, nën ndikimin e të folmeve jugore maqedone rrënzë Sharit, u krijua në Prizren e në vendbanimet përreth tij në drejtim të Shkupit e të Kumanovës e folmja e Prizrenit, veçoritë më të moçme të së cilës i heqin rrënjët nga shekulli 12".[106] P. Ivić, njohësi më i mirë i historisë së gjuhës serbe, të folmen e goranëve e vendoste në lindje të linjës së izoglosave dhe mendonte esull se megjithatë "për dialekte serbe (SG. duhet) të konsiderohen ato që edhe fliten nga serbët".[107] Në botimin e mëvonshëm të veprës së tij[108] që u citua nën referencën më lart, Ivić e shprehu këtë më qartë duke saktësuar se "Së fundi, popullsia sllave myslimane në Gorën e Prizrenit e flet një dialekt, baza e maqedonishtes perëndimore e të cilit është e qartë",[109] ashtu siç kishte menduar më parë edhe dijetari A. M. Seliščev, ndërsa Radivoje Mladenović, i cili të folmen e Gorës e pati për tezë të disertacionit, e mban këtë për "të folme të për-

[105] Sipas Sadik Idrizi Gora kroz stoljeća, në www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k.

[106] Sh. A. Belić, Stara Srbija s istorisko - jezične tačke gledišta, Beograd 1912, f. 7-9.

[107] Sh. Die serbokroatischen Dialekte, ihre Struktur und Entwicklung, Mouton s' Gravenhage 1958, f. 44.

[108] Iz srpskohrvatske dijalektologije, 1991, cit. sipas Sadik Idrizi, Gora kroz stoljeća, në www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k.

[109] Sipas Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

zier kalimtare maqedone-serbe". Ky e kishte nxjerrë përfundimin kompromis sipas të cilit: "Për të folmen gorane, në gjendjen e saj të tanishme gjuhësore, nuk mund të flitet si për ndonjë të folme maqedone apo serbe, porse ajo mund të definohet për si tip i një të folme kalimtare të hapësirës kufitare midis dy gjuhëve - serbishtes dhe maqedonishtes".[110] Këto përkufizime dijetarësh serbë në të mirë të qenies së të folmes së Gorës një dialekt maqedon, do të jenë dhënë, kështu mendoj unë, për ta neutralizuar faktorin bullgar dhe për ta përligjur kështu hegjemoninë mbi Maqedoninë në kuadër të shtetit gjithnjë në ekspansion të Serbisë. Kundër përkatësisë së mundshme të së folmes sllave të regjioneve të Gorës e të Siriniqit arealit dialektor serb flet kohëve të fundit edhe historiani britanik N. Malcolm. Në tekstin e kumtesës së dërguar për simpoziumin e mbajtur në Regensburg më 24. prill 2009 ky dijetar konstatonte se dialektologjia historike e serbishtes nuk njeh kurrfarë njësie unike gjuhësore të të folmeve serbe, përkatësisht të së ashtuquajturës e folme e Prizrenit dhe e Siriniqit, e aq më pak ndonjë të tillë në hapësira të tjera të Kosovës.

Dijetari serb i gjuhësisë, sipas S. Idrizit,[111] jo fort i suksesshëm në zanatin e tij, Milivoj Pavlović thoshte për "torbeshët" se këtu kemi të bëjmë me një popullatë sllave fort të vjetër të Ballkanit; Obeleiski e Dimitar Angelov përfundonin se këta (torbeshët) na qenkan pararendësit e fundit të bogumilëve të Maqedonisë, ndërsa Cilev i identifikonte këta me pomakët, të cilët paskan jetuar në regjionin e Maqedonisë së Vardarit dhe mendonte që nocioni "torbeš" rrjedh nga fjala turke *torba* të cilën ky e lidhte porse me turq. "dortbeš" - "katër-pesë".

Flaka e luftës midis dijes filolologjike e të politikës shtetërore bullgare dhe të asaj serbe drejt determinimit të përkatësisë gjuhësore të së folmes së goranëve dhe të përkatësisë etnike të tyre u fashit paksa pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo ndodhi në rend të parë pse nga politika e Titos u krijua artificialisht më 1948 një gjuhë e ashtuquajtur maqedonase dhe një komb i ashtuquajtur maqedonas, kështu që luftën e tyre filologjike-historike-politike bullgarët e orientuan tani rreth dokumentimit ngutazi shkencërisht e politikisht aktual se as në vetë Maqedoninë nuk ka ndonjë popull "maqedonas" dhe se nuk ekziston së këndejmi as ndonjëfarë "gjuhe maqedonase". Për konsekuencë, sa më të fortë që maqedonasit e ndjenin veten në sjelljen e dëshmive për identitetin e tyre më vete nacional "maqedonas", gjithnjë e më shumë angazhoheshin që tani ta dëshmonin madje edhe identitetin etnik e gjuhësor maqedonas të minoriteteve sllavishtfolëse të goranëve e të torbeshëve të Kosovës e të

[110] Sipas Sadik Idrizi, Gora kroz stoljeća …
[111] http://bs.wikipedia.org/wiki/Torbe%C5%A1i.

Maqedonisë, të ardhur këndej mbase midis shekujve 10-12, pikërisht - siç do të shihet më poshtë - si vlleh të bullgarizuar dhe të pomakëve, përkatësisht të jurukëve e të grupeve etnike të tjera të besimit islam të sjella në Ballkan nga pushtuesi osman.

Interesimi i dijes maqedonase për Gorën u intensifikua sidomos në vitet e '60-ta të shekullit të kaluar. Božidar Videovski e kishte studiuar të folmen e Gorës, të cilën ky e konsideronte të folme periferike të maqedonishtes dhe kujtonte se "pjesa dërmuese e veçorive dialektore të së folmes gorane lidhet me tipin e së folmes së Dibrës", duke e menduar gjithsesi të folmen e minoritetit sllav të kësaj krahine. Edhe Blaže Ristovski i Institutit maqedonas të Folklorit, bëri punë terreni në katunde të Gorës dhe mblodhi kryesisht lëndë folklorike e muzikore. Përmes kësaj vepre autori mëtoi që krijimtarinë shpirtërore të Gorës ta ngërthente përbrenda kuadrit të arealit kulturor maqedon-sllav.[112]

Me çështjen e Gorës e të goranëve, kohëve të fundit u morën edhe autorë shqiptarë të Kosovës si Hajriz Meleqi,[113] Muharrem Qaflleshi e ndonjë tjetër si edhe autori nga Shqipëria Nazif Dokle, me prejardhje nga zona e banuar nga goranë në rrethin e Kukësit. Përkitazi me gjuhën e folur nga banorë të Gorës, ky i fundit shkruan "Me gjithë huazimet dhe ndikimet, e folmja e Gorës ka një fond leksikor e strukturë gramatikore dhe përfaqëson një dialekt arkaik sllav të formuar në kushte të veçanta konservimi e rinovimi, larg trungut mëmë" [...] për të përfunduar që kjo e folme "Në të gjitha sistemet e saj është më afër maqedonishtes e më larg serbshtes".[114] Veçori kryesore që e përligj përkatësinë bullgare të së folmes së Gorës është kategoria e shquarsisë së emrit, një kategori kjo të cilën nuk e ka serbishtja dhe as varianti boshnjak i sllavishteve të jugut. Dokle i sjell për këtë shembujt për nocionet *kal*, *mollë* e *fëmijë* në emëroren, gjinoren, dhanoren, kallëzoren e rrjedhoren e pashquar në njëjës e në shumës të kësaj të folmje: *kon*, *konov*, *konot*, *konon* "kal" shm. *koni*, *konivi*, *koniti*, *konini* "kuaj"; nj. f. *jabuka*, *jabukava*, *jabukana*, *jabukata* "molla"; shm. *jabuke*, *jabukeve*, *jabukete*, *jabukene* "mollët" dhe asnj. *dete*, *detevo*, *deteno*, *deteto* "fëmija" shm. *deca*, *decava*, *decana*, *decata* "fëmijët" [115] në rasat gjegjëse.

[112] Sadik Idrizi Gora kroz stoljeća në www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k. www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k.

[113] Khs. Mr.Hajriz Meleqi, Opoja dhe Gora (Komuna e Dragashit) Vështrim gjeografik, Dragash, 1994.; Hajriz Meleqi, *Gora dhe goarnët*, dorëskrim; Muharrem Qafleshi, Gjurmët historike të Opojës autoktone dhe goranëve të Gorës në http://ojq-qendra.webs.com/historikuiopojs.

[114] Nazif Dokle, Për Gorën dhe goranët, (Artikuj e studime), Prizren, 2002, f. 10, 56.

[115] Po ai, po aty, f. 56.

Karakterin bullgar të së folmes së banorëve të Gorës e dëshmon edhe shumësia e mikrotoponimeve aktuale[116] bullgare të kësaj hapësire. Në këtë mes duhet theksuar që bullgare nuk janë vetëm mikrotoponimet e sjella më poshtë, porse edhe, në mos të gjitha, shumica e mikrotoponimeve të sajuara nga brumi leksikor i sllavishtes së vjetër/mesjetare. Nga grumbulli i mikrotonimeve thjesht bullgare, më poshtë po i sjell shembujt: *Dlga*, *Dlga strana*, *Lisičina dëpka* dhe *Pešterka* në Bąçkë. Sikur këta emra të rridhnin nga serbishtja, do të pritej të dilnin në trajtat **Duga*, **Duga strana* e **Lisičin dub* e **Peć*, **Pećina*; *Pateljeico* në Brod, nga një trajtë e mundshme bullgare *Patel*, e sajuar nga nga bullg. *pът* "udhë" e zgjeruar me prapashtesën romane-ballkanike/ vllahe *-el*. Karakterin bullgar-vllah të mikrotoponimit të mësipërm do ta dëshmonte jo vetëm tërthorazi mikrotoponimi *Putišta* (në Lubovisht) i sajuar mbase nga serb. *put* "rrugë" me prapashtesën serbe, por edhe bullgare *-ište*/*išta*. Nëse etimologjia e parë është e qëndrueshme, atëherë tek i dyti (*Putišta*) kemi të bëjmë me një emërtim të ri, serb. Me prejardhje bullgare janë edhe mikrotoponimet që e përmbajnë mbiemrin sllav në kuptimin "i, e bardhë" dhe substantivin *kamen* "gur; shkëmb". Të këtilla janë mikrotoponimet *Beu kamen* (në Brod) dhe *Bef Kamen* (në Kukajan), që po të ishin me prejardhje nga serbishtja do të duhej të dilnin në trajtat *Bel*/*Beli* +; mikrotoponime thjesht bullgare janë edhe *Pesoci* "Zallishta; Ranishta" (në Mlikë) dhe *Zobef* (në Kërstec i Vogël), që rrjedhin nga trajtat bullgare *pesok* "zall"dhe *zob* "dhëmb". Po të ishin me prejardhje serbe këto mikrotoponime do të duhej të dilnin në trajtat **Peščara* e **Zub/ *Zubac;* mikrotoponimi *Dabalje* (në Dikancë) rrjedh nga bullg. *bъb* "lis",bot. Quercus petraea i cili, po të ishte me prejardhje serbe do të duhej të dilte në trajtën **Dub*; Me prejardhje të padiskutueshme bullgare është mikrotoponimi *Zat Kušta*, i sajuar nga parafjala bullgare *zat* "pas; prapa" dhe substantivi *kъšt* " shtëpi" i dëshmuar edhe tek mikrotoponimi *Muzakjeve kušte* në krisobulën e Banjskës së viteve 1313-1318 e mbase edhe tek emri *Kashtanjevë* i katundit të komunës së Ferizajt; parafjala *zat* përmbahet mbase edhe tek mikrotoponimi *Zadef* (në Mlikë) nga *zat* "prapa, pas" dhe **del* "mal"; *Koteu* në Brod (ndoshta nga një e bullg. **kotel* 1. "kazan, kaldajë; 2. gjeograf. lugajë"; *Borov Rit*, "Kodra e Pishave" në Dikancë që, po të ishte mtp. serb do të duhej të dilte në trajtën **Borov Rid*. Duke u nisur nga trajta *Marin Dof* e mikrotoponimit aktual të katundit Kukojan të Gorës, i cili në shek. XIV e XV qenka dëshmuar për si vendbanim më vete edhe në trajtën *Marindol*, si edhe,

[116] Të gjithë shembujt janë marrë nga libri i J. Osmanit, Venbanimet e Kosovës, 20, f. 84, 91, 92,104, 105, 11, 114, 115, 119, 120, 121.

sidomos, në dritën e ekzistimit edhe sot të mikrtoponimit *Preko Dof* "Përtej Lugut" (në Kuk) kujtoj se del e qartë që ndajshtimi *dof* i mikrotoponimit të mësipërm do të jetë trajtë lokale gorane/bullgare e sllav. *dol* "lug; luginë" dhe se kuptimi i tij do të jetë prandaj "Lugu i Marinit" ose "Lugu i Marës". Në të dy emrat e mësipërm (*Marin Dof, Preko Dof*) dhe në mikrotoponimet *Marince* në Rapçë dhe *Marino livade* në katundin Baçkë të Gorës, përmbahet antroponimi *Marin* i cili nuk del për si emër aktual i ndonjë vëllazërie gorane por që, përkundrazi, dëshmohet dendur ndër banorë të katundeve të krahinës shqiptare të Opojës në shek.XVI. (khs. p.sh. mbiemrin e banorit Rada *Marini* të katundit Bilushë afër Prizrenit që dëshmohet në vitin 1571.[117]) Duket se me prejardhje bullgare do të jetë edhe mikrotoponimi *Skoçnuo* i katundit Brod, që do të jetë sajuar nga folja sllave *skok* "pup; kërcim" (khs. mikrotoponimin vllah *Skokshor* të rrethinave të Istogut dhe emrin Skoçën/ Skoçna të katundit të rrethinave të Vushtrrisë.) Për si emra bullgarë të variantit lokal/goran duhet të merren mbase edhe mikrotoponimet *Dep Kamen* dhe *Pod Dep*, (në Lubovishtë), në të cilat ka mundësi të përmbahet apelativi sllav del "mal", përkatësisht që këto mikrotoponime ta kenë kuptimin "Guri i Malit" dhe "Nën mal". Së fundi, ka mundësi që tek mikrotoponimi *Llek* (në Glloboçicë), të përmbahet një trajtë e vjetër/bullgare *lъk* serb. *luk,-a* "bërrakë".

Mendimi bazë i Dokles (khs. edhe më lart) është se e folmja sllave e Gorës do të jetë një e folme bullgare, bartës të së cilës do të kenë qenë pjesëtarë të lëvizjes bogumile të përndjekur nga kisha ortodokse greke, bullgare e serbe - të cilët (bogumilët, për këtë sh. më poshtë) gjetën strehim në këto zona malore. Sipas këtij autori, goranët janë një popullatë e ardhur në vendin ku janë sot - tezë që e paska përkrahur edhe historiani e orientalisti S. Pulaha.[118]

Pas dëshmimit të veçorisë karakteristike të shquarsisë së emrave, të cilën nga gjuhë të folura në Ballkan e kanë shqipja, bullgarishtja (përkatësisht maqedonishtja) e rumanishtja, autori ynë konstaton me të drejtë se "Kultura e *gjuha gorane* bashkë me bartësit dhe krijuesit e tyre vazhdojnë të paragjykohen (SG: me të padrejtë) si serbe edhe pse etnogjeneza, natyra dhe tiparet e tyre të qëndrueshme nuk janë aspak të tilla". Mundësinë që goranët të jenë element etnik i serbizuar Dokle e hedh poshtë edhe me argumentin e tij se regjioni i Gorës ndodhet shumë larg nga djepi i kryehershëm ballkanik i serbëve: Limi, Drina bashkë me degët Piva e Tara, Lugina e Ibrit dhe pjesa e sipërme e Moravës si dhe

[117] S. Pulaha, Të dhëna ekonomike dhe demografike. ..
[118] Dokle, Për Gorën dhe goranët,. .. f. 60.

me rrethanën që sundimi serb prej afër 2 shekujsh e gjysmë nuk do të mund të kishte qenë i suksesshëm që ta asimilonte një popullatë baritore. Vetë rrethana që e folmja e tyre nuk është serbe, e tregon më së miri korrektësinë e tezës që kjo popullatë nuk ka as historikisht e as sot gjë të përbashkët me serbët.[119]

Këtë ide, Dokle e formulon edhe një herë tjetër, dhe pikërisht kështu: "Goranët janë bartës të një pasurie kulturore origjinale. Kanë ruajtur shumë mirë gjuhën, folklorin, ornamentikën, zakonet, mendësinë etj. Kjo tërësi e identitetit të tyre i afron me maqedonasit, më tej historikisht me bullgarët dhe i largon nga serbët. Në kulturën materiale dhe folklorin koreografik, përndryshe kulturës shpirtërore, duket mirë integrimi dhe ambientimi i tyre në dimensionimin shqiptar".

Në këtë pikëvështrim, Dokle pajtohet porse, në esencë, me mendimin e dijetarëve bullgarë, sado që ky nuk e citon ndonjë ithtar konkret të kësaj teze. Në këtë mes vlen të përmendet p.sh. mendimi i mbrojtur nga dijetari bullgar Jordan Ivanov i cili në çerekun e parë të shek. që shkoi shkruante: "Krahina e Gorës shtrihet midis Sharit e Koritnikut/Korenikut përgjatë rrjedhave të lumit të Lumës. E gjithë kjo fushëgropë banohet nga popullata e vjetër bullgare e *Goranëve*, *Goralijëve* (nënvizime të miat) të cilët gjatë shekujve XVII e XVIII qenë të shtrënguar ta pranonin muhamedanizmin. Njihen me emrin *torbeshë*, të marrë nga fqinjët e tyre bullgarë. Goranët vetë e quajnë porse veten turq, ndërsa kur bisedojnë njëri me tjetrin e pranojnë se quhen torbeshë dhe se janë popullatë e vjetër vendëse me prejardhje bullgare, por që, janë islamizuar d.m.th. që e kanë pranuar muhamedanizmin. Goranët - torbeshët në shtëpi e flasin gjuhën bullgare".[120] Ky mendim i dijetarit bullgar është aprovuar pothuajse pa asnjë përjashtim nga e gjithë dija filologjike e historike bullgare.

Në kuadër të trajtimit historik, vështruar në rrafshin politik, Dokle i merr parasysh tri teza të mundshme të prejardhjes së popullatës së quajtur *goran, -ë*. Sipas njërës tezë të mundshme, goranët mund të na qenkan popullatë e ardhur në viset që i banojnë përbrenda hapësirës etnolinguistike të shqiptarëve. Në kuadër të përligjjes së kësaj teze, Dokle shkruan se: "Historia nuk i mori dorë kujt, kur ua caktoi goranëve atdheun e ri, sikundër romëve, magjupëve, serbëve, turqve etj. Duke u nisur nga hapësira ku ata jetojnë, të gjithë sikur edhe shqiptarët që bëjnë shumicën absolute, janë kosovarë. Nëse Kosova si njësi politike mban emrin e shqiptarëve, ky paritet është vendosur nga historia, e cila gjithashtu, nuk i

[119] Po ai, po aty, f. 5, 59, 71.

[120] J. Ivanov, në Makedonski pregled 4, Sofija, 1925. Cit. sipas Sadik Idrizi, Gora kroz stoljeća, në www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k -.

ka marrë dorë askujt, kur ua siguroi atyre dy atribute: kohën dhe numrin." Në këtë kuptim historia e goranëve nuk mund të shihet e shkëputur nga historia e Kosovës, por vetëm si pjesë e saj.[121]

Karakterin prej ardhësish të goranëve, Dokle e konfirmon me shprehjen e tij: "Në viset e reja ku ata u vendosën, përkitazi në Gorë, shpejt e verifikuan se rrethoheshin prej një etnie tjetër, apo etnish të tjera, të ndryshme nga e tyrja (shqiptare etj.). Ky ballafaqim duket se për nevojat e brendshme komunitare solli lindjen e etnonimit "nashinci" (nga nash* = ynë) që nuk thotë gjë tjetër pos opozicionit etnik."[122] I çuditshëm porse, sa kohë që unë nuk shoh në këtë shkrim të jetë sjellë ndonjë dëshmi konkrete, më duket konstatimi i N. Dokles se gjuha e goranëve na paska qenë "shkruar që në shekullin IX madje me alfabetin e vet origjinal".[123] Kjo sepse ky konstatim mund të vlejë vetëm për bullgarishten e bogumilëve. Deklarimit të Dokles do t'i besohej vetëm sikur, pikërisht në hapësirën e Gorës, të jetë dëshmuar ndonjë shkrim a mbishkrim në alfabetin *bosančica* që mbahet për alfabet i bogumilëve.

Në një trajtesë tjetër Dokle i mban goranët për popullatë autoktone prandaj e përjashton mundësinë që kjo të jetë popullatë e bullgarizuar (autori e përdor nocionin *e maqedonizuar*) sepse zona maqedone (Lugina e Vardarit bashkë me degët Bistrica dhe Strumica deri te gjiri i Selanikut), ku këta (S.G. bullgarët) dëshmohen që në vitin 615 të kishin zënë vend në këto hapësira dhe se edhe ky regjion është po ashtu shumë larg nga regjioni i Gorës. Bullgarizimi (Dokle: maqedonzimi) nuk do të mund të jetë as rezultat i sundimit të shtetit të stërmadh bullgar të Samuilit,* një shtet që në ato përmasa nuk jetoi më shumë se 20 vite (998-1018). Një arsyetim tjetër racional i Dokles është vlerësimi i tij se Gora nuk është ndonjë hapësirë joshëse, përveç për të përndjekur e për të tillë që s'kishin tjetër hapësirë jetese, prandaj kjo rrethanë edhe do ta përjashtojë mundësinë e sllavizimit në vend, në hapësirën që sot e zë popullata sllavofone e Gorës.

Pak më poshtë Dokle e lanson mendimin se "Sipas të gjitha gjasave, goranët dalin me origjinë maqedonase". Autori e kujton në këtë mes shtetin e makedonëve parasllavë, shtet ky i një populli të huajë e ar-

[121] Po ai, po aty, f. 71, 73.

* Lexo si sllav. *našinci, naš.* "të tanët; i,/e yni".

[122] Nazif Dokle, Për Gorën dhe goranët, (Artikuj e studime), Prizren, 2002, f. 59, 63.

[123] Po ai, po aty, f. 5.

* Duke qenë se të bijtë e tij David, Aron, Mojsej e Samoil mbanin emra thjesht hebrenj, është shfaqur mendimi se edhe ky do të ketë qenë me prejardhje hebreje. Khs. www.ljubav.s10.forumsplace.com.

miqësor për fiset sllave të draguvitëve, saguditëve, velgëzitëve, vajunitëve, vërzitëve që në atë hapësirë i kishin krijuar *sklavinia-t* e tyre "lokalitete apo territore të pushtuara rishtazi nga sllavët". Dokle e nxjerr në vazhdim përfundimin (sipas mendimit tim të shprehur ashtu që është e vështirë të kuptohet dhe që rrezikon të merret si rrëzim i mendimit të shprehur nga ai vetë në krye të fjalisë) se: "Duke pasur parasysh dhe trazimet e mëdha në shekujt 7-11 që ndodhën në këto anë, u desh të kalonte një kohë e gjatë derisa emri "maqedonas" të përvetësohej prej sllavëve e të bëhej emri i tyre kombëtar. Nëse do të besonim se goranët janë pasojë e lëvizjes bogumile, atëherë nuk ka si ta merrnin me vete e ta trashëgonin një emër që nuk e kishin".[124]

Nga sa mund të merret vesh nga punime të shkurtra të N. Dokles, nga hapësira e Bullgarisë mesjetare bogumilët, për si të mallkuar e të përndjekur nga kisha ortodokse bullgare, e paskan marrë botën në sy në tri drejtime: 1. në drejtimin Shkup - Tikvesh - Rekë - Gorë - Gjakovë[**] - Bosnje ku bogumilët e paskan ndalur turrin e tyre të përhapjes; Drejtimi i dytë: Shkup-Manastir-Tërbaç (Gollobërdë) - Tërbaç - (Vlorë) - Milano; Drejtimi i tretë: Maqedoni - Azi e Vogël. Vetëm në drejtimin e parë torbeshët paskan arritur të mbijetojnë duke krijuar ngulime kompakte, ndërsa në ato të tjerat "lanë pas vetes vetëm jehonën e përfundimit tragjik dhe flakën e heretizmit evropian. Këta, nga urrejtja për kishën ortodokse, preferuan kishën katolike, ndërsa nën presionin e osmanëve nuk vonuan të ktheheshin në muslimanë". Në këtë kontekst, Dokle paska shënuar në pjesën e Gorës që i takon Shqipërisë, edhe shprehjen "ti gonim popa i kallugjera"[***] - një shprehje e injorimit dhe e nënçmimit apo, siç thotë Dokle "shprehje (që) sjell kohën e zhgënjimit të masave nga përfundimi i ndeshjes midis kishës (popi) dhe heretikëve (kallugjer)." "Argumentet" që N. Dokle i sjell në të mirë të identifikimit, barazimit të përkatësisë etnike të goranëve me disa shprehje/nocione të përdorura nga popullata shqiptare për goranët, nuk janë - për mua - bindëse, që të mund t'i besohet kësaj hipoteze. Lidhja që Nazif Dokle e vë p.sh. midis distinktivit *potur*, shm. *-i* duke e parë këtë mbase për si sinonim apo rrjedhojë të atij *pataren* (për prejardhjen e këtij emri sh. më poshtë) është "argument" shumë i ligësht sa kohë që nocioni *potur* nuk mund të largohet aq lehtë

[124] Po ai, po aty, f.. 62.

[**] Duket se autori mund ta ketë për mbështetje mbiemrin *Torbeshi* të një familjeje të ardhur e të ngulitur në Gjakovë, emër ky që e mbante edhe heroina Ganimete Tërbeshi. Si i këtillë, emri familiar Torbeshi i Gjakovës nuk mund të merret për si dëshmi e ndonjë vendbanimi të veçantë, të dëshmuar historikisht, të torbeshëve në këtë pjesë të Kosovës, sepse këtu kemi të bëjmë vetëm me një familje torbeshësh të vendosur në këtë vend.

[***] Lexo si serb.:*kaluđera* "murg".

nga atributi sllav me kuptimin "i turqizuar; i muslimanizuar". Vetëm sa për ilustrim po i sjell të dhënat që së pakut një vëllazëri e katundit Duhël si edhe një pjesë e banorëve të katundit Mushtisht të Suharekës mbahen, jozyrtarisht, për poture; se një katund i tërë *Poturovc* ekziston në Rrafsh të Kosovës dhe madje në katundin skajor Bërvenik të Kosovës, në kufirin e sotëm me Serbinë, ekziston burimi i quajtur *Kroni Paturit*,[125] por që përkatësia etnike e asnjërës nga këto nuk është afruar kurrë me atë gorane, torbeshe, patarene. Edhe afrimi nga Dokle i një emërtimi thjesht vllah *Barbula* në Shishtavec të Kukësit (për etimologjinë sh. më poshtë) me nocionin *babun,-ë* për "bogumil" është për mua një etimologji e nxjerrë si me zor. Po aq e vështirë për t'u pranuar është edhe marrja për si dëshmi e mikrotoponimit *Kudugjer* po në katundin Shishtavec dhe afrimi i tij me variantin *Kudugjerë* të emrit grek *kuduger* të bogumilëve, për ta treguar prejardhjen bogumile të banorëve të këtij katundi duke menduar se *kudugjer* na qenka trajtë greke e shtrembëruar e fjalës kallugjer!,[126] sepse vetë kjo e fundit është në të vërtetë variant sllav e shqiptar i fjalës greke καλόγερος. Në këtë mes qëndron paravendimi, jo porse edhe sqarimi i N. Dokles. Kjo sepse është mendim i pranuar që nocioni *kudugerъ*, *kundugerъ* i serbishtes së shek. XV ishte një distinktiv për bogumilët, prejardhja e të cilit kërkohet tek κουδούγεροι e greqishtes së mesme që nga Chalkokondyles II, 27, 4 interpetohej si "omnes qui degund in Sandalis regione" dhe nga Ducange si κουτουγέρος e σταυροπάτης u interpretua si "qui fidem scripto consignatum ac cruce firmatam mentitur".[127]

Prej këndej (khs. më lart) Dokle ia vë themelet tezës sipas së cilës goranët qenkan në të vërtetë *torbeshë* dhe se rrënjët e tyre po u dashka të gjendeshin tek bogumilët. Në të mirë të kësaj teze autori ynë e sjell etimologjinë e propozuar nga prof. Dh. Shuteriqi, sipas së cilës (SG.: madje!) edhe emri *Tërbaç* në katundin Gollobërdë dhe një tjetër në rrethina të Vlorës, po u lidhkan me emrin "torbesh", me të cilin "kisha ortodokse i pagëzoi të përndjekurit masivë të lëvizjes heterike bogumile (shek. XI-XII)" të cilët "të shpërngulur prej dheut të tyre, Bullgarisë, [...] u shpërndanë në vise të ndryshme të Ballkanit e të Evropës, duke përcjellur jehonën e tyre herë si relikte gjuhësore, diku si diasporë etnike e herë si fosile etnokulturore". "Itinerari i shtegtimit të këtij etnonimi: Manastir - Rekë e Dibrës - Gorë që përfundon si patronim në Gjakovë,

[125] I shënuar në terren nga Ali S. Berisha, Gallapi i Prishtinës, 2007 (Doreshkrim).
[126] Për Gorën dhe goranët, (Artikuj e studime), Prizren, 2002, f. 61.
[127] Die greichischen Lehnwörter im Serbokroatischen, Verlag der Akademie der Wissenschaften, Berlin, 1944, f. 85.

flet për një prurje bullgare, përkatësisht maqedone në Gorë" dhe "Shtegtimi i këtij emri e përvijon itinerarin e lëvizjes së tyre në tre drejtime: Maqedoni - Bosnje; Maqedoni – Shqipëri - Itali; Maqedoni - Azi e Vogël- Siri". Torbeshët e krahinës së Gorës po përbëkan një ngulim, një enklavë me popullsi sllave të ardhur brendapërbrenda detit etnik shqiptar dhe po bartka tiparet e një diaspore. Dëshmitë që i kemi në dorë po flitkan për origjinë maqedonase (më tej bullgare) të kësaj popullsie, e cila në kushte të reja, në simbiozë me anasit e (me) të ardhurit vlleh, paska fituar e paska humbur pa (i) dëmtuar tiparet më të qëndrueshme të kësaj origjine.

Ngulimi i torbeshëve të Gorës qenka një produkt historik që shtyhet përtej shek. XII dhe duket se lidhet me lëvizjen bogumile që u përcoll me përndjekje popullatash. Torbeshët e Gorës qenkan njëra prej mbetjeve të këtyre dëbimeve të dhunshme që mundi të mbijetonte.[128]

Nëse do të ketë pasur ndonjë vendosje bogumilësh në hapësirën e sotme të regjionit të Gorës, atëherë kjo (vendosje) do të duhej të kishte ndodhur deri në shek. XII. Mendoj kështu, sepse njoftimi më i vjetër për praninë e heretikëve në Diokle rrjedh nga një shkresë e knjazit Vukan midis 22 shkurtit 1199 e 21 shkurtit të vitit 1200 me të cilën ky e njoftonte papën Inoçenti III se në Bosne qenka paraqitur një herezi të cilën e paska pranuar edhe vetë bani Kulin, farefisi i tij dhe mbi 10.000 të krishterë[129] të tjerë.

Me çështjen e prejardhjes së goranëve u mor kohëve të fundit edhe autori Sadik Idrizi, edhe ky vetë me prejardhje nga katundi Borje i goranëve të Kukësit. Ky i qaset kësaj çështjeje duke e paraqitur këtë si fort të rrëshqitshme, sidomos nëse për këtë do të jepej ndonjë përgjigje e shkurtër, përkatësisht e prerë. Kjo sepse, sipas këtij studiuesi, edhe zgjidhja e çështjes së prejardhjes së goranëve po u dashka të ndiqej nëpër historinë e mjegulluar të Ballkanit. Arsyeja kryesore që po e vështirësuaka zbardhjen e prejardhjes së goranëve qenka fakti që në Ballkan paska pasur shumë lëvizje *popujsh.* Mbase duke e ditur se sllavët s'kanë të thonë gjë për antikën, ky nuk e përmend ndonjë ardhje të tillë që do të ketë ndodhur në harkun kohor të para invadimit sllav të Ballkanit. Me rëndësi për autorin tonë janë vetëm ndodhitë pas pushtimeve bullgare e serbe të hapësirës etnolinguistike të shqiptarëve. Prandaj është e kuptueshme që këtij autori i intereson vetëm fati i kumanëve, i peçenegëve, i hazarëve, jurukëve, tatarëve, për të cilët historia na mëson se as pushteti

[128] Po ai, po aty, f. 9, 13, 14, 45, 63.
[129] http://www.dalmatiahus.com/Hrvatat/BOGOMILI.html

mesjetar serb që solli ca kumanë[130] (ndonjë historian serb flet madje për mijëra të tillë) e as pushtuesi osman që i solli ca bashkësi të vogla turkmenësh si jurukë, tatarë e çerkezë nuk arritën që me ato të popullonin as oaza kompakte (siç është rasti me Gorën) por vendbanime të veçanta me popullatë shqiptare, prandaj edhe, duke qenë pakica të parëndësishme në kuptimin e shumësisë, në detin etnik shqiptar e humbën plotësisht identitetin e tyre etnik. Më e drejta midis pyetjeve retorike që i shtron autori ynë, është ajo se ç'u bë me aromunët. Të gjitha pyetjet retorike të autorit tonë e kanë për qëllim spikatjen e pyetjes së shtruar nga ai të fatit të torbeshëve e të pomakëve në kuadrin e lëvizjes së bogumilëve. Kjo sepse qëllimi bazë aprioristik i tij është lidhja e fatit të goranëve me lëvizjen heterike të bogumilizmit bullgar, përkatësisht e lidhjes posteriori të etnogjenezës së goranëve/torbeshëve e të pomakëve me bogumilët e Bosnjës. Sado që për mbështetje të rëndësishme të kësaj çështjeje e mban mjegullinë ballkanike, autori nuk e sjell as tekstin as interpretimin e "enigmës" së një pllake mbishkrimi në xhaminë e Mlikës së Gorës, e cila për këtë autor qenka fort e rëndësishme[131] (për këtë sh. më poshtë).

4.2. Sqarime përkitazi me herezinë ballkanike: bogumilët

Duke qenë se teza për lidhjen midis bogumilëve - torbeshëve - goranëve ishte lansuar në të vërtetë shumë kohë para se këtë ta përkrahte N. Dokle[*] dhe sidomos autorë të sotëm boshnjakë të Kosovës, e shoh të arsyeshme që në të mirë të zbardhjes së etnogjenezës së goranëve, t'i sjell disa të dhëna përkitazi me bogumilizmin.

Konsiderohet se fillet dhe prejardhja e herezisë sllave, të quajtur *bogumilizëm*, gjenden tek një rrymë e fortë që nën emrin *paulikanë* ishte lindur që në gjysmën e parë të shek. VII në Armeni. Paulikanët qenkan bërë së shpejti të rrezikshëm për pushtetin bizantin dhe kishën e krishterë, prandaj perandori Konstantin, i bir i Léon Walras-it,[132] ose Konstantini V Kopronim (741-775), pra në shek. VIII, shumë nga këta kolonë i vendosi

[130] Çfarë, në vitet 1467-1468 do të ketë pasur edhe në katundet Glu(h)ovo e Breznica në veriperëndim dhe Krushje në juglindje të Shkupit në të cilat, sipas "Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod...," f. 443, 496 dhe 499 jetonin edhe kryemiljarët e quajtur Petko, i bir i Kumaniq-it. (në Gluhovo); Jovan-i, i bir i Kuman-it (në Breznicë).dhe Kuman-i (pa familje) në katundin Krushje.

[131] Sadik Idrizi, Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k – Përkitazi me xhaminë e këtij katundi sh. kap. 11. Shtresa turke.

[*] Khs. librin e tij "Bogumilizmi dhe etnogjeneza e torbeshëve të Gorës së Kukësit", Tiranë (bot. Geer), 2009.

[132] http://translate.google.com/translate?hl=de&sl=fr&u=http://www.regard.eu.org/Livres.2/Pelerinage.douloureux/11Bogoumiles%26hl%3Dde%26sa%3DG.

me dhunë në Konstantinopojë e në Traki, përkatësisht në Bullgari. Më vonë, kah gjysma e shek. X doli një perandor tjetër Jean Zimiscès (969-976) - që ishte vetë një armen - dhe solli pauklikanë të tjerë në Bullgari e në Maqedoni ku, për pasojë, u krijua një fidanishte e herezisë dualiste të cilën në shekujt 9 e 10 e pranoi popullata sllave edhe ashtu ende pagane. Qendra të bogumilizmit ishin bërë Pllovdivi në Bullgari dhe Megleni në Maqedoninë helene. Nga Bullgaria kjo doktrinë ishte përhapur edhe në Maqedoni, e më vonë edhe në Serbi, Shqipëri, Dalmaci, Bosnje e në vende të Europës Perëndimore.[133] Këtu mbase po u dashka të kërkohet arsyeja e paravendimit i cili, sipas mendimit tim, ka nevojë të dëshmohet më mirë, sipas të cilit lëvizja bogumile nuk na paska qenë etnikisht e përkufizuar (SG. vetëm tek elementi trakas i sllavizuar, përkatësisht tek sllavët), sepse kjo (lëvizje) paska qenë, në përmasa më të vogla apo më të mëdha, dukuri e pranishme pothuaj ndër të gjithë popujt e Ballkanit e edhe më gjerë.[134]

Kjo rrymë konsiderohet për "rilindje" e dualizmit gnostik që në të vërtetë i heq rrënjët nga maniheizmi (i quajtur kështu sipas vizionarit e profetit persian Mani (lat. Manes, Manichaeus) (216.-277).[135] Kjo doktrinë i kishte përmbledhur më vete mësimet e Zaratustrës, të Krishtit e të Bud-ha-s.

Dogma armene do të jetë mbështesë më e fortë e lëvizjeve të cilat të dyja kishat i quajtën për heretike, sepse kjo lëvizje u përhap si në Lindje, *bogumilët* në Bullgari e po ashtu edhe në Perëndim: *katarët* (nga greq. *katharos* "i pastër, i mirëfilltë") që në shek. XII-XIII u përhap në jug të Francës, përkatësisht në krahinën e Provancës dhe përgjatë Rinit në qytetet Albi, Argena e Toulouse e edhe në botën gjermane dhe *patarenët* në Itali (të quajtur sipas emrit të lagjes *Pataria* të varfanjakëve në qytetin e Milanos). Katarët quhen ndryshe edhe Albigensë dhe nga disa historianë mbahen për pasardhës të bogumilëve.[136]

Njoftimi i parë për daljen në dritë të herezisë në Perandorinë Bizantine vjen nga një raport i patriarkut Teofilakt dërguar perandorit bullgar Peter (927-969), në të cilin sqaronte se kjo herezi qenka "paulikanizëm" i përzierë me maniheizëm". Më shumë njoftime përmbahen në librin e një prifti të panjohur bullgar ortodoks të quajtur

[133] Le traité contre les bogomiles du prêtre Cosmas, Revue des études slaves, 21, fasc. 1-4, Paris, 1944., f. 47, 51-53, 57, 61, 64; khs. edhe Sipas http://de.wikipedia.org/wiki/Bogomilen.

[134] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[135] Sipas http://www.dalmatiahus.com/Hrvatat/Bogomili.html.

[136] http:www.srpjects.de&Albienserkreuzzug&Abstracts_Di.doc.

Kozma. Mbisundon mendimi që prifti Kozma do ta ketë shkruar librin e tij në kohën e sundimit të mbretit bullgar Peter (927-969) ose në vitin 972. Vepra e tij përbëhet nga dy pjesë: e para është kritikë programatike kundër bogumilizmit, ndërsa e dyta këshilla besimtarëve ortodoksë. Që nga shek. XVII e deri tani dihen, sipas A. Vaillant, nëntë botime të dorëshkrimit të Kozmas, të gjitha në rusisht.

Në pjesën e parë të librit të vet "Kuvendim për herezinë", presbyteri "kryeprifti" Kozma, natyrisht me ton përbuzës, njoftonte se "Ndodhi që në kohën e sundimit të perandorit ortodoks Peter, në tokat bullgare doli një prift i quajtur Bogumil ("i dashur i Zotit"), që më mirë do të ishte të quhej Bogunemil. ("që nuk është i dashur i Zotit") i cili "nëpër tokën bullgare" po e përhapte një besim të ri të gabueshëm."[137] Në këtë pjesë të librit të vet, Kozmai njoftonte se "heretikët jo të dashur të Zotit" "besonin dhe mendonin se po sakrifikoheshin për drejtësinë dhe se për prangat e për burgun do të marrin ndonjë shpërblim nga Zoti", gjë që jep të kuptohet se pushteti në Bullgari i përndiqte ashpër bogumilët që në shek. X.

Nga burimet mësohet që kleriku i quajtur Bogumil do të ketë jetuar gjatë viteve 913-963 ndërsa publikisht në krye të lëvizjes së re paska dalë në vitin 935. Dihet që ky rreth vitit 950 predikonte në regjionet e Prilepit e të Velesit në Maqedoni e që më vonë kaloi në Filipopol të Trakisë (sot Plovdiv në Bullgari). Sipas mendimit të përgjithshëm, edhe vetë termi bogumilizëm do të jetë i pandashëm nga emri i priftit *Bogumil* - nismëtar i kësaj dogme e lëvizjeje sociale. Të tjerë e lejojnë mundësinë që emri i kësaj lëvizjeje t'i heq rrënjët nga atribuiti që vetë themeluesit dhe ithtarët e këtij sekti ia dhanë vetes duke propaguar që pikërisht bartësit e këtij sekti, për shkak të doktrinës së tij dhe mënyrës së sanksionuar të jetesës së ithtarëve të tij, do të jenë *Bogu mili* "Të dashurit e Zotit". Më i bindshëm duket mendimi i parë.

Kjo do të tregonte mjaft mirë që emri *bogumil* për këtë sekt është vetëm njëri nga emra me të cilin, varësisht nga rrethanat e zhvillimit, u quajt lëvizja heretike kundër kishës së Romës e të asaj të Konstantinopojës dhe se kjo nuk është ndonjë "specialitet" sllav. Lëvizjet e katarëve e të patarenëve mbahen për motiv e arsyetim konkret për Reformacionin europerëndimor të kishës së krishterë. Dhe sa kohë që jemi tek Perëndimi, bën të theksohet që ka mendime se "Herezia bogumile [...] që ishte përhapur në Bosnje e në Shqipëri [...] e quajtur

[137] Punimi bazë kritik rreth veprës së Kozmait si dhe të së pakut tetë botimeve nga të tjerët me tituj të ndryshëm e me interpretime të ndryshme të veprës së tij deri në vitet '40 të shek. XX, mbetet ai i André Vaillant, Le Traité contre les bogumiles, Revue des études slaves, XXI, Paris, 1944.

greqisht dhe në kronika latine për si kathareni ose të krishterë të mirëfilltë [...] (një fjalë kjo që s'ka ndonjë kuptim), nuk i kontribuoi pak intolerancës së reformacionit gjerman dhe lehtësimit të kalimit në islam në Bosnje. Kjo ndihmoi që familjet e mëdha të mos i bartnin të drejtat e feudeve tek katundarët shkizmatikë dhe i ruajtën kështu të gjitha të drejtat mbi to.[138]

Nga shkrime përkitazi me bogumilizmin mësohet se "herezia" bogumile cilësohet për lëvizje fetare-sociale e lindur në krye të herës, në mesjetën e hershme, përkatësisht në shek. IX-X në Bullgari, në kohën e sundimit të perandorit bullgar Peter (927-969) dhe në Maqedoni që asokohe ishte nën sundimin e tij. Ky ishte porse nën presion të madh të Bizantit, pas vdekjes së perandorit Simeon. Përqafimi në masë i kësaj lëvizjeje, të cilësuar për drejtim të ri të krishterimit, ndodhi në shekujt 10 e 11. Kjo lëvizje gëzonte tek këta simpati të madhe në rend të parë mbase pse bogumilët e paskan përkrahur rezistencën e popullit sllav kundër Bizantit dhe kishte një komponentë të fortë sociale e politike. Pikërisht "Kjo pjesa politike e dogmës ishte një bazë e fortë e suksesit të tyre. Dëshira e shumë njerëzve që vetë t'i punonin tokat si të lirë ose në bashkësi, në vend se të ishin të nënshtruar dhe të shtypeshin ose të mbeteshin në skllavëri, ia dha kësaj lëvizje forcën sociale dhe u bë njëra ndër arsyet qenësore për përhapjen e saj edhe përtej kufijve gjuhësorë e etnikë. Në shek. X bogumilët dogjën në Bullgari seli të bujarëve e kisha, porse së shpejti u asgjësuan nga pushteti feudal bizantin dhe u arratisën përpjetë Danubit dhe në drejtim të Bosnjës, Malit të Zi, Dalmacisë e Shqipërisë".[139]

Dogma e këtij drejtimi, [e parë me syrin e historiografisë serbe] e lidhte mistikën e krishterë me elemente të traditës popullore sllave. Me dogmën e tyre që nuk ishte larg nga paganizmi dhe duke qenë se ishin kundër dominimit të Bizantit dhe kundër të së ashtuquajturës "kishë e grekëve", bogumilët arritën të përfitojnë për vete shumë sllavë të jugut. Për ipeshkvinë e Ohrit, e dominuar gjithnjë e më shumë nga grekët, nuk ishte e lehtë të depërtohej në botën e dogmës bogumile të kapërthyer nga mite sllave të vjetra. Megjithatë, me shumë durim, Kisha e Lindjes arriti të kishte sukses i cili, porse, paska pasur për pasojë lindjen e mosbesimit të Bizantit ndaj sllavëve dhe, për konsekuencë, emërimin për peshkopë në hapësirat e zëna nga sllavët, kryesisht nga radhët e grekëve. Këtë proces sllavët e paskan parë për dominim të grekëve mbi kishën

[138] http://fr.wikisource.org/wiki/Le_monde_gr%C3%A9co-slave_-_VI ose Revue des Deux Mondes, tome 2, 1843, Cyprien Robert: Le monde gréco-slave,VI.

[139] Sipas http://de.wikipedia.org/wiki/Bogomilen.

ortodokse. Nga kjo situatë e krijuar fitimin më të madh e paska nxjerë Kisha Katolike e Romës e cila në vitin 1089 e ngriti një ipeshkëvi të veten në Tivar.[140]

4.3. Përndjekja e bogumilëve

Dogma e lindur në Azi të Vogël, e përqafuar nga sllavët si rezultat i vendosjes me dhunë nga Perandoria e Bizantit të armenëve - bartës të kësaj dogme - në hapësirën ballkanike të Bizantit, u luftua nga të dyja kishat, pra edhe nga besimtarët ortodoksë e katolikë përmes vazalëve të Konstantinopojës e të Romës. Praktika paska treguar që kisha e krishterë preferoi qërimin e hesapeve me dëbim të pjesëtarëve jo të paktë të herezisë dualiste e jo ta bënte këtë me një duel në rrafshin teologjik.

Kështu, menjëherë pas rënies së Bullgarisë nën Bizantin në vitin 971, një grup bogumilësh nga radhët e bujarisë emigroi në Konstntinopojë, ku gjeti ithtarë tek shtresa e lartë. Disa "paulikanë e maqedonas" ikën për në Itali për shkak të pasojave të kryengritjes në Maqedoni (1040-1041), ndërsa kah fundi i shek. XI nëpër Gadishullin e Ballkanit u përhapën masalianët.

Përndjekjen e bogumilëve e të paulikanëve, të cilët nuk donin ta njihnin autoritetin e kishës zyrtare ortodokse dhe që ngrinin krye kundër pushtetit bizantin e nisi perandori bizantin Alexios I Manuel Komnen (1081-1118). Për vepër e këtij sundimtari konsiderohet zhvillimi gjatë viteve 1140- i shumë gjykimeve të bogumilëve në Konstantinopojë. Megjithatë, përpjekjet e kishës dhe të pushtetit bizantin për t'i asgjësuar këta "njerëz zë këqinj" të cilët veten e quanin "të krishterë të mirë" nuk i dhanë frytet e pritura. Ç'është e drejta, kohë para se në Ballkan të perëndonte lëvizja e bogumilëve, doktrina heretike e tyre ishte përhapur edhe nëpër Europë.

Ndryshe ishte çështja në Kishën e Perëndimit. Mesjeta e hershme ishte në Europë për sa i përket përndjekjes së heretikëve një periudhë e qetë. Kisha merrej këndej më shumë me luftën kundër armiqve të jashtëm dhe me pagëzimin, krishterimin, misionimin e paganëve se sa me devijuesit e brendshëm nga varianti romak i krishterimit.

Heretikët e përhapur në Europën Perëndimore në shek. XII u quajtën këndej me emra të ndryshëm. Njiheshin kryesisht me emrat *katharenë* e *patarenë,* që disa historianë i mbajnë për pasardhës të bogumilëve.

Nën emrin *katharen* (nga greq. καθαρός "të pastërtit"; këta e quanin veten për si *veri christiani* "të krishterë të mirëfilltë" ose *boni homines*/

[140] Sipas http/lexikon.freenet.de/Serbisch-Orthodoxe_Kirche.

Bonhommes "njerëz të mirë" shenjon një lëvizje të besimit të krishterë që gjatë shek. XII-XIV u përhap e jetoi kryesisht në Jug të Francës, por edhe në Itali, në Spanjë e në Gjermani. Pjesëtarët e këtij sekti njiheshin në Francë edhe me emrin albigenë, sipas qytetit Albi të Francës Jugore, i cili ishte kryeqendra e tyre. Në Itali (ku mbase paskan shkuar nga Shqipëria ose nga Bosna), njiheshin me emrin *patarenë/paterinë* (sipas emrit *Patra*/ *Pataria* të një lagjeje varfanjakësh të qytetit të Milanos).[141] Për herë të parë dëshmohen në qytetin e Köln-it në vitin 1143, ndërsa vetëm katër vite më vonë (1147) kjo lëvizje u shtri në hapësirat midis lumit të Rinit dhe Pirinejeve, në Jug të Francës e në Italinë Veriore. Grupe katharësh u përhapën edhe në Spanjë, Austri e në Angli.[142]

Kisha katolike e Perëndimit ndërmori madje edhe kryqëzata për asgjësimin e të gjitha sekteve që ishin kundër doktrinës së katolicizmit. Kryqëzata e parë që zgjati rreth njëzet vite (1209-1229) qe iniciuar nga Papa Innozenz III dhe përfundoi me nënshtrimin e kishës katarene në Francë. Në luftën kundër herezisë katharene Francën e ndihmuan edhe Bavaria e Austria. Përndjekjen e katharenëve dhe të patarenëve e vazhdoi pasardhësi i Papës Innozenz, Papa Grigori IX i cili për këtë qëllim e ngriti institucionin e inkuizicionit. Kishës katolike nuk iu dashtën më shumë se 100 vite që ta asgjësojë herezinë europerëndimore. Sado që asgjësimi kishte marrë fund në vitin 1255, heretiku i fundit qenka djegur në turrë të druve në vitin 1321.[143]

Në kuadrin e Perandorisë Bizantine, në përndjekjen e bogumilëve u inkuadrua edhe principata e Rashës vasale e Bizantit, me në krye zhupanin e Madh Stepan Nemanja. Në kuadrin e lojërave politike për përforcimin e shtetit që po e formonte, duke qenë vasal i Bizantit dhe duke pasur frikë nga Hungaria katolike, Stepan Nemanja i deklaruar vetë për katolik, iu bashkëngjit kryqëzatës së Hungarisë katolike për përndjekjen e bogumilëve. Zhupani i Madh Stepan Nemanja e organizoi në Rashë qysh në vitin 1186 kuvendin kishtar-shtetëror kundër bogumilëve, të cilët në shtetin në formim të serbëve quheshin *babunë*. Kisha serbe i mallkoi bogumilët dha hapi kështu udhë për përndjekjen institucionale të tyre. Duke marrë dorë nga mallkimi, pasuan dënimet e bugumilëve që manifestoheshin me amputimin e gjymtyrëve të shtatit, me djegie në turra drush, me dëbim nga vendi dhe me marrjen/konfiskimin e pasurisë së tyre. Përveç kësaj, St. Nemanja urdhëroi edhe djegien e librave të bogumilëve të cilat, kështu thonë

[141] http://de.wikipedia.org/wiki/Katharer.
[142] Po aty.
[143] http://de.wikipedia.widearea.org/wiki/Albigenserkreuzzug.

studiues sllavë të jugut, sot do të ishin dokumentet më të vjetra të shkollës rasiane e maqedone. Djegia e librave të bogumilëve edhe qenka arsyeja bazë përse sot për bogumilët dihet kaq pak, përkatësisht përse për ta dihet vetëm aq sa e si kanë thënë për ta kundërshtarët e tyre: sundimtarë bizantinë, serbë dhe inkuizicionarët e kishës romake.

Vështruar në rrafshin politik, njëra ndër arsyetimet e përndjekjes së bogumilëve nga St. Nemanja paska qenë refuzimi i bogumilëve të shkonin në ushtri; të merrnin pjesë në ekspeditat luftarake të sundimtarëve vasalë të Bizantit apo ithtarëve të katolicizmit dhe të bartnin armë e të vrisnin /mbysnin jo vetëm njerëz, por as çfarëdo qoftë krijesash që marrin frymë. Besohet që shumë bogumilë të shtetit në ekspansion të Rashës paskan ikur e qenkan vendosur në Bosnje. Kjo mundësi vehet në lidhje me njoftimet sipas të cilave bani Kulin, sundimtar i Bosnes ishte "zyrtarisht" katolik por që, tinëz, i përkrahte bogumilët, ndërsa një herë tjetër thuhet se pikërisht në kohën e sundimit të tij bogumilizmi qenka bërë madje fe shtetërore e Bosnes.[144] Së këndejmi edhe qenka shkaktuar një thyerje midis bërthamës shtetërore serbe të Rashës dhe Bosnjës. Që nga kjo kohë, Bosnja do të ndjekë udhë vetanake të zhvillimit, të pavarur nga shteti i Rashës dhe, sidomos në rrafshin ideologjik, edhe kundër saj.[145]

Duket që brutaliteti i përndjekjes së bogumilëve paska qenë aq i madh dhe pra i papranueshëm sa që me këtë po u lidhka edhe çështja e pasqaruar mirë nëse edhe vetë i biri Rastko në moshë të njomë prej djaloshi 16-vjeçar i Stepan Nemanjës, më vonë themelues i kishës autoqefale ortodokse të serbëve - i revoltuar për shkak të kësaj përndjekjeje të bogumilëve edhe nga i ati - shkoi e u ngujua murg në manastirin Panteleimon (Rusiko) të Republikës së Murgjëve në Athos, arratisje kjo që u mbështet nga dy murgj rusë dhe ku e kur Rastko i njomë e mori emrin Sava të murgjërisë. Në Malin e Shenjtë murgjit qenkan mahnitur nga fakti si u bë që biri i një princi katolik [i Stepan Nemanjës] po bëhej murg ortodoks.[146]

Sido që të jetë, politika e etabluar armiqësore e ndjekur nga St. Nemanja kundër herezisë do të zgjasë rreth 150 vite. Pasardhësi i tij në kuadër të kësaj dinastie, perandori St. Dushan, parashihte në nenin 85 të Kodit të tij qërimin e hesapeve me babunët, përkatësisht me bogumilët. Në paragrafin gjegjës të Kodit të St. Dushanit, për masa ndëshkuese

[144] Sadik Idrizi, Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k –.

[145] Sipas Die serbische Kirche in der Geschichte në http:www.serb-kirche.at/vera/geschichte.html.

[146] Sipas: http/lexikon.freenet.de/Serbisch-Orthodoxe_Kirche.

kundër babunëve ishte paraparë përcëllimi me hekur të skuqur të fytyrës dhe dëbimi nga mbretëria e tij i të gjithë atyre që do ta propagonin këtë herezi.[147]

Duke qenë se ky Kod u hartua në kohën e zenitit të pushtimeve të St. Dushanit dhe që ky do të duhej të vlente, pra, në gjithë "perandorinë" e tij jetëshkurtër, kujtoj se nuk do të jetë punë e mençur nëse ky sanksionim do të interpretohej për si përndjekje pikërisht e pararendësve të goranëve të sotëm. Kjo sepse, sipas njoftimeve nga burime të Perëndimit, lëvizja e heretikëve bogumilë kishte përfunduar pikërisht në këtë shekull.

Në të mirë të së vërtetës së mbështetur në rrjedha të historisë ka vend të paravendohet që sundimtari Dushan me më shumë ashpërsi e konsekuencë do ta ketë luftuar "*herezinë latine*". Atribuimi i sundimtarit St. Dušan të shtetit në ekspansion të serbëve rashianë i përndjekjes së bogumilëve në atë përmasë çfarë u duhet ta shohin e ta vlerësojnë ithtarët e prejardhjes bogumile të goranëve duket të jetë i stërmadhuar, sidomos sa kohë që kemi të bëjmë vetëm me një nen të Kodit të Dushanit. Kjo sepse këtu kemi të bëjmë me një kod të cilin sundimtari serb do të dëshironte të ishte i aplikueshëm në gjithë "perandorinë" e tij jetëshkurtër që përfshinte, sipas apetiteve të tij pushtuese, vise të Maqedonisë së sotme, të Peloponezit, të Shqipërisë, të Dioklesë, përkatësisht të "Serbisë së Bregdetit". Kjo situatë jep dorë të dyshohet që ky urdhër mund të ketë të bëjë edhe me Kosovën e sotme, për në hapësirën e së cilës prania e bogumilizmit nuk mund të dëshmohet me as edhe një dokument të vetëm. Përkundrazi, ka shumë gjasë për t'u besuar që në këtë territor paragrafë të Kodeksit të Dushanit e legjitimonin vetëm rolin e mbretit serb si patron mbrojtës i kishës serbe dhe si "shfarosës" i herezisë katolike. Në Kod kërkohet p.sh. që të gjithë shtetasit e mbretërisë [serbe], të cilët i takojnë një bashkësie të huaj fetare, duhet patjetër të ripagëzohen në kishën serbe. Në të ashtuquajturit "*artkuj kundër herezisë*" ose "*si të pastrohet krishtërimi*" (= ortodoksia) të Kodit të Stefan Dushanit thuhet ndër të tjera: "Dhe për herezinë latine, që të krishterët (= besimtarët e ortodoksisë serbe) i ka kthyer në herezi, të kthehen përsëri në krishterizëm (= ortodoksi); nëse ndokush nuk është i dëgjueshëm dhe nuk i kthehet krishterimit, të dënohet ashtu siç është shkruar në ligjin e etërve të shenjtë".[148]

---

[147] sipas Sadik Idrizi, Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k –

[148] Khs. origj. "I za jeres latinsku: Hrišćani koje su obratili u azimstvo da se vrate opet u hrišćanstvo. Ako li se ko nađe da nije poslušao i nije se vratio u hrišćanstvo, da se kazni kako piše u Zakoniku svetih otaca. " shënim: përveç në citatin që pason, të githa citatet e tjera janë marrë nga: Svetozar Pajić Diak, Zakonik velikog cara Stefana Dušana silnog, në www.oldserbia.plus.co.yu-index.htm.

Në botimin nga St. Novakoviq të Kodit të Dushanit për veprën e konvertimit të ortodoksit në katolik në nenin 137 të Kodit urdhërohet që atij (SG: nënkupto feudalit lokal) "që e shet të krishterin në atë besim të paqenë (= katolicizëm) t'i prehet dora dhe t'i shkallmohet gjuha".[149]

Natyrisht që ky "kthim" i katolikëve në ortodoksi nuk do të mund të bëhej pa pasoja për priftërinjtë katolikë, sepse - kështu parashihet në Kod - "Dhe prifti latin, po u zu duke e konvertuar të krishterin në fenë (SG. ritin) latine, të dënohet sipas ligjit të etërve të shenjtë".[150] Në dritën e dënimit të paraparë për atë "që zihet si i krishterë gjysmak dhe që është martuar me një të krishtere (= ortodokse "serbe"), të pagëzohet për i krishterë (SG. ortodoks serb) e nëse nuk krishterizohet [SG. = ortodoksizohet] t'i merret gruaja dhe fëmijët, njëherë [atyre] t'u jepet gjysma e shtëpisë e pastaj ky [SG: i krishteri gjysmak] të dëbohet", shihet thellësia e kësaj fushate të përndjekjes së besimtarëve të ritit katolik e ndoshta edhe të ortodoksisë joserbe, përkatësisht përndjekja e besimit dhe e riteve të "joserbëve" që në të vërtetë ka të bëjë me katolikë jo domosdo të Kosovës së sotme. Dënime të ashpra parashiheshin në Kod edhe për atë "që kapet se jeton si heretik midis të krishterëve" [= ortodoksëve "serbë"] për të cilin urdhërohet që "t'i damkoset fytyra me hekur të skuqur dhe të dëbohet, ndërsa [edhe] ai që do ta mësheh atë të damkoset fytyrës".

Historiografia moderne serbe e mohon sot ekzistimin e një kishe boshnjake e cila do të ketë qenë kishë e bogumilëve, përkatësisht e patarenëve, paulikanëve e "heretikëve" të cilët nuk paskan dashur asnjëherë t'i mbështeten e aq më pak t'i nënshtrohen kishës katolike të Romës.[151] Kjo historiografi shkel mbi të vërtetën sa kohë që deklaron se pikërisht popullsia "e rrallë" e ritit katolik roman e Bosnjës që binte nën juridiksionin e ipeshkvive katolike të Splitit, Raguzës e të Tivarit si edhe ajo bogumile paskan qenë lënë rehat nga shteti e nga kisha në ekspansion e serbëve. Megjithatë, arsyetimet se mospasja e burimeve vendore për bogumilët dhe rrethana që në shkrime latine të shek. XIV edhe vetë kisha serbe po u cilësuaka për shkizmatike, heretike, sepse ajo nuk ishte katolike, nuk mund të jetë argument kundër ekzistimit të kishës boshnjake.

Përkundër përndjekjes së institucionalizuar të joserbëve, përkatësisht të joortodoksëve në hapësirat e pushtuara nga serbët, historiografia

[149] Stojan Novaković, Zakonik Stefana Dušana cara srpskog 1349 i 1354, Beograd 1870, f. 44: "i kto proda hristianina u inu nevernu veru da (mu) se ruka oseće i ezik ureže."

[150] Khs. origj. *I pop latinski ako se nađe da je obratio hrišćanina u veru latinsku, da se kazni po Zakonu svetih otaca*. "Edhe prifti latin, nëse zinet se e ka konvertuar të krishterin në fenë latine, të dënohet sipas Ligjit të etërve të shenjtë".

[151] http:www.serb-kirche.at/vera/geschichte.html.

moderne serbe përpiqet ende t'ia mbush mendjen Europës Perëndimore se Serbia mesjetare na paska qenë një si livadh me lule. Kështu, në librin voluminoz të botuar viteve të fundit gjermanisht në Zvicër gjejmë të jetë shkruar se në shtetin serb: "Të gjitha shtresat e popullsisë i kishin të njëjtat tradita apo së pakut të së njëjtës prejardhje dhe, këto tradita, e plotësonin jetën e tyre të përditshme dhe pjesëve të atdheut të tyre ua dhuronin njëfarë plotënie shpirtërore, kështu që çdo kaçubë e çdo shkëmb e fliste gjuhën e vet. Serbët ishin një popull i butë, fisnik dhe me ndjesi që sakaq u dorëzoheshin emocioneve. Sado që serbët në pjesën më të madhe ishin bujq që jetonin nëpër çifligje të shtrira gjerë, ata nuk bënin jetë prej asketësh porse grumbulloheshin shpesh në tregje rrëzë kështjellave, sidomos porse rreth kishave e manastireve ku, edhe nëse nuk e përcillnin liturgjinë me sy e veshë, e dëgjonin me ëndje njëri-tjetrin ose tuboheshin rreth ndonjë këngëtari. Sa kohë që kufijtë e shtetit të tyre zgjeroheshin, sundimtarët serbë dhe bujarët e tyre ngrinin feude dhe e përhapnin kështu kulturën e ngritur nga shën Sava." Në relacion me çfarë thonë vetë burimet serbe përkitazi me luftimin e gjithçkafes që do të ishte pjesë e civilizimit europerëndimor, kulmi i ironisë arrihet kur ajka e sotme e historiografisë serbe gjen fytyrë që, në relacion me shqiptarët nuk e pati kurrnjëherë të deklarojë se "Krahas kësaj, në Serbi sundonte një tolerancë e jashtëzakonshme fetare, sepse një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së saj, jo ta zëmë ajo e të huajve, porse edhe e vetë asaj serbe, anonte kah kisha romake dhe luante një rol të dukshëm në administrimin, diplomacinë, financat dhe në ekonominë e vendit".[152]

Historiografia bullgare e sheh pak si më ndryshe çështjen e bogumilëve. Sipas rezultateve të një punimi të prof Jor.(dan) Ivanov, përhapës i dogmës bogumile Φουνδαιτών ήτοι Βογομιλων ishte torbeshi, përkatësisht bogumili i quajtur Joan Čuril-as Τζουρίλας i cili në gjysmën e parë të shek. XI jetonte në viset trakase: έν τοίσ τών Θρακών μέρεσιν, përkatësisht në Azi të Vogël. Por kjo dogmë ishte përhapur që në fund të shek. X dhe në fillim të atij XI edhe në hapësirën e banuar nga bullgarë. Bile, qysh në shek. X kishte në rrethina të Sofjes një peshkop bogumil: *dědьcь Srědьčskы*.[153] Bogumilizmi qenka përhapur në pjesën jugperëndimore të Bullgarisë e madje edhe në Shqipëri. Këtë shtrirje po e dëshmuaka edhe

[152] Khs. punimin Kosovo und Metochien: Aufstieg und Niedergang des serbischen Volkes, në librin Kosovo und Metochien in der serbischen Geschichte, Lausanne 1989, f. 6.

[153] Vetëm sa për informim po përmendi se nocioni *gjysh*, përkatësisht *gjyshatë* përdoret edhe nga pjesëtarët shqiptarë të sektit të bektashinjve e të dervishëve të tjerë, ndërsa për eprorin lokal përdoret termi *bab,ë -a* "atë, ati"

jetëshkrimi i shkruar greqisht i shën Gjonit - Vladimirit. Prania e bogumilëve po u dëshmuaka edhe në pikturimet në Kishën e Shën Klimentit - Shën Mërisë në Ohër në të cilat mrekullitë e shenjtorëve bizantinë Kyrill e Method qenkan pikturuar për si të ndodhura në një ambient malor të banuar nga bogumilët: διώκεται τών Βογομηλον, gjë që po treguaka se prania e bogumilëve e paska tmerruar më vonë gjithë peshkopatën e Ohrit. Kujtimi për bogumilët po u ruajka tek emrat e katundeve *Kudugerci* në rrethina të Ćustendil-it dhe *Kotugeri* në rrethina të qytetit Vodno të Bullgarisë. Këto oikonime paskan dalë nga varianti (grek?) *kuduger* i emrit të bogumilëve: khs. Βογόμυλοι, Κουδούγεροι καλούμενοι. Bogumilë paska pasur, siç po e treguaka edhe emri i katundit *Bogumila*[154] në rrethina të Velesit edhe në Maqedoninë qendrore ku këta qenkan quajtur *babunë* - variant ky që është ruajtur tek emri *Babuna* i katundit dhe i lumit të kësaj hapësire. Prof. Ivanov na mëson se kishës së bogumilëve po i takuakan edhe pararendësit e torbeshëve të sotëm, të quajtur greqisht Φουνδαίται nga greq. φούνδα "strajcë". Kjo etni e grupacion fetar paska jetuar kryesisht në rrethina të qyteteve (mbase edhe në ato vetë) të Tikveshit, Kërçovës, Dibrës, Shkupit dhe në krahinën e Gorës. Ndonjë nga fise torbeshe të vendosura në Veri të Shqipërisë e paska përqafuar krishterimin e ritit katolik, porse e paska ruajtur emrin e kryeherëshëm grek Φουνδαίται në emrin e sotëm Fanda, Fana, përkatësisht "Funda". Dega më e vjetër e dualistëve bogumilë që, sikundër u tha më lart, në Bullgari paraqiten që në shek. 10, vazhdoi të gjallojë edhe me emrin *dragovišti*, sipas emrit (draguviti) të njërit ndër fiset sllave që për si banorë të pjesës perëndimore të Selanikut po u dëshmuaka që në shek. VII. Në shek. 13 torbeshët, përkatësisht pjesëtarë të fisit sllav, bogumil të dragovitëve, po u dëshmuakan në rrethina të Tetovës, ndërsa gjatë shek. 14 edhe në Trakinë fqinje, nën dioçezën e Pllovdivit.[155]

Edhe dijetari shqiptar i letërsisë Dh. Shuteriqi shkruan se historiani bizantin Laoniko Halkokondilos, athinasi, në f. 14 të veprës së tij "Histo-

[154] Unë po shtoj se emri i këtij katundi është dëshmuar në regjistrimin osman të viteve 1467-1468, sh. Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod. .., f. 574. Në mbështetje të rrethanës që ndër banorë të këtij katundi kishte në këtë kohë sish që cilësoheshin shprehimisht për grekë e për armenë dhe që kishte edhe njerëz me antroponime thjesht greke si *Nestor*, ka arsye të besohet që nëse ky vendbanim do të ketë qenë vërtet i bogumilëve, atëherë për i këtillë do të duhej të ishte shumë kohë përpara shek. XV.

[155] Sh. Prof. Jor.(dan) Ivanov, Bogumilski knjigi i legendi, Bălgarska Akademija naaukite, Sofija, 1925, f. 34 - 37.

ria e Bizantit në dhjetë vëllime", të hartuar në shek. XV, kur po e përshkruante Perandorinë e Bizantit midis viteve 1298-1463, njoftonte se heretikët e Ballkanit quheshin *babunë, torbeshë*[*], *patarenë* e *kudugerë*.

4.4. Rreth emrave: bogumil, babun, kuduger

Teza e lidhjes së bogumilëve me pararendësit e goranëve të sotëm u aktualizua kohëve të fundit sidomos nga autorë boshnjakë. Shtylla kryesore mbi të cilën peshon kjo tezë është vlera kuptimore "strajcë" që e ka nocioni grek *fundagiagiti*, me të cilin *grekët* i paskan quajtur sllavët bogumilë. Sipas interpretimi folklorik, epiteti torbesh u paska mbetur bogumilëve pse këta paskan bajtur kraheqafe gjithmonë një strajcë në të cilën kishte një ungjill, ndërsa sipas një tjetri[156] ky emër u paska mbetur pse torbeshët, krahas blegtorisë e ushtronin edhe zejen e muratorisë dhe veglat e punës i paskan bajtë në strajcë. Pothuaj gati të gjithë autorët shqiptarë, goranë e boshnjakë, që kohëve të fundit shkruan përkitazi me prejardhjen e goranëve, e sjellin mendimin e shfaqur nga dijetari shqiptar Dh. Shuteriqi i cili, në kontekstin e mëtimit të vënies së lidhjes etimologjike midis emrit të katundit *Tërbaç/ Tërbash* të Vlorës me nocionin *torbesh*, po thuaka se: "emri Tërbaš - katund i rrethit të Vlorës - mund të përdoret krahas ofiçit "torbesh", me të cilin heretikët janë përçmuar dikur për si lypsarë. Barazimi në rrafshin kuptimor i nocionit *lypsar* me *torbesh* po e gjetka mbështetjen më të fortë tek rrethana që në shek. X në Azi të Vogël kishte filluar që, përkrah nocionit *bogumil*, të përdorej edhe nocioni *fundagiagiti* i cili, i përkthyer në sllavisht e paska kuptimin "ata që bartin strajca", "strajcarë" ose "torbeshë", që kishte nisur të përdorej edhe nga kisha ortodokse.[157] Unë kujtoj se mbështetja tek barazimi etimologjik i toponimeve *Tërbaç/ Tërbash* të Vlorës me nocionin *torbesh* është një mbështetje e ligësht, sepse ka shumë mundësi që edhe toponimet e mësipërme të lidhen më parë, siç do ta tregonin emrat *Trebickë*, *Trebeshinë*, *Trebisht* e ndoshta, pra, edhe emri *Tërbaç*[158] me foljen sllave *trebiti* "shpyllëzim, prerje e malit për ta bërë atë tokë buke apo vend ndërtimi" - një folje kjo nga e cila do të rrjedhë edhe emri Trepça i minierës dhe i vendbanimit kosovar. Sado që territorialisht larg hapësirës gjuhësore të shqipes, emra vendbanimesh të sajuara nga folja sllave *trebiti* "çel; pres

* Unë dyshoj që historiografi grek ta ketë përdorur nocionin sllav *torbeš*. Ka shumë gjasë që ky term të jetë i Dh. Shuteriqit.

[156] Khs, psh. Home ▸Reportaže-Hronike-Komentari ▸Hronike ▸POMACI, njihova prošlost i sadašnjost.

[157] Sipas http://bs.wikipedia.org/wiki/Torbe%C5%A1i".

[158] Sipas Muharrem Qaflleshi, Historiku i Komunës së Dragashit, BULETINI, Revistë mujore e Kuvendit Komunal Dragash, Tetor, 2004, Nr. 1, f. 4.

malin" ka madje edhe në hapësirën gjuhësore të gjermanishtes në Gjermani e në Austri dhe askush nuk i ka lidhur këta emra me nocionin *torbesh*. Kjo bindje përforcohet edhe në dritën e rrethanës që në vetë hapësirën gjuhësore të bullgarishtes ka emra lumenjsh si *Trebuštica* në regjionin Čepino, që në këtë kuadër do të binte ndoshta edhe varanti **Trzebięta* i dalur ndoshta nga emri familjar polak *Trebetowe* i dëshmuar në vitin 1258. J. Zaimov - pa i shkuar mendja që këta emra t'i lidhë me nocionin *torbesh*, *tërbesh* -, dyshon, si për çudi, edhe në korrektësinë e inkuadrimit këtu edhe të varianteve *Trěbětin*, *Trěb'ata* të antroponimit të ndeshur në Çeki.[159] Përveç kësaj, kundër këtij barazimi flet edhe rrethana që fjala *torbë* është me prejardhje turke dhe si e këtillë ajo në shqipen e në gjuhë të tjera të Ballkanit mund të ketë hyrë afër pesë shekuj më herët se koha e ardhjes së paravenduar të bogumilëve me emrin identifikues të tyre me nocionin e strajcës në sllavisht e në greqisht. Kjo sidomos sa kohë që dihet që orientalizma *torba* për *strajcë* në të gjitha të folmet e shqipes gjallon si *torbë* dhe askund nuk është ndryshuar në **tërb*, **tërbë*, ka mbase arsye të paravendohet që as toponimet *Tërbaç/ Tërbash, Tërbaç, Trebickë, Trebeshinë, Trebisht* nuk mund të vehen në lidhje prejardhjeje me fjalën *torbë*, përkatësisht me distinktivin etnik *torbesh*, por me foljen sllave *trebiti* e cila s'ka gjë të përbashkët as me fjalën *torba* e pra as me torbeshët.

Një shembull tjetër nga i cili mund të shihet se në çfarë udhësh pa krye shpijnë kërkimet e pautorizuara etimologjike të historianëve të letërsisë e të historianëve profesionistë e kemi tek libri fort i mirë i Dhori Qiriazit, në të cilin pikërisht toponimi *Tërbaç* i shërbeu për të treguar "se krishterimi nuk mund të jetë përhapur menjëherë në gjithë vendin, por pak nga pak, duke filluar nga qytetet dhe duke u shtrirë pastaj në fshatrat, duke përfshirë të gjithë vendin". Kjo sepse edhe pas shek. I pas Krishtit gjëllinte ende besimi politeist. Këtë po e treguaka "fakti që në Shqipëri ekziston fjala apo toponimi, *Tërbaç*, d.m.th. *tërë besësh* (nënvizim i imi) (politeist)".[160] Së fundi bën të shënohet që edhe në katundin Vranisht të Gorës ka një mikrotoponim të quajtur *Trebeš* për të cilin autori që e ka shënuar këtë në terren,[161] nuk sjell ndonjë të dhënë sqaruese dhe se një katund i quajtur *Trebosh* ekzistonte në lindje të qytetit të Tetovës që në vitet 1467-1468. Asokohe në këtë katund kishte edhe një kryefamiljar me të bijtë

[159] Jordan Zaimov, Bulgarische Gewässernamen, II Zeitschrift für Slawistk, Bd. VI, 1961, Akademie-Verlag, Berlin, f. 246.

[160] Sh. Dhori Qiriazi, Krishterimi në Shqipëri, (Ribotim) Përgatiti Mehmet Gëzhilli, Tiranë: Argeta-LMG, 2000, f. 22.

[161] J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, …, f. 143.

Gjuro, Stale e Mito që e mbante emrin *Janaki*[162] në trajtën karakteristike greke të tij.

Për sa i bie hapësirës aktuale të Kosovës, e vetmja dëshmi e cilësimit për *strajcar* e pra "*punues strajcash*" apo edhe "*lypsar*" të një kryefamiljari rrjedh nga viti 1455 kur është dëshmuar që banori *Radivoj*, i katundit Ropotovë të krahinës së Moravës e mbante për mbiemër atributin *Torbaša*,[163] që jo domosdo do të thotë se kemi të bëjmë me një torbesh, porse me një mjeshtër që punonte torba, strajca.

E metë e lidhjes së goranëve me torbeshët e, në vija më të largëta, me bogumilët është ajo që në burimet e njohura deri tani më të vjetra që i përkasin Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë, përkatësisht hapësirës unike etnoglotologjike të shqiptarëve, nuk ka asnjë dëshmi se sinonim i emrit *bogumil* do të ketë qenë emri sllav *torbeš* që për distinktiv i popullatës/ popullatave myslimane sllavishtfolëse të Bullgarisë e të Maqedonisë përdoret sot. Për si emërtim sinonim për bogumilët në hapësirën e Ballkanit janë dëshmuar vetëm distinktivet greke *Fundaiton* (khs. Φουνδαιτών ήτοι Βογομιλων) dhe *Kudugeroi* (khs. Βογόμυλοι, Κουδούγεροι καλούμενοι "Bullgarët, të quajtur Kudugerë"). Me këtë rast duhet mbajtur parasysh rrethanën që fundaiatët (phundagiagiti) mbahen në të vërtetë për pjesëtarë të një sekti të veçantë të Azisë së Vogël. Ka shumë mundësi që nëpër shkrime greke atributi *fundait*- t'u jetë dhënë edhe heretikëve sllavë mbase për shkak se edhe bogumilët sllavë e kishin përvetësuar atë dogmë. Por kur flitet për afrimin e nocionit *torbesh* me atë *bogumil* duhet vërejtur që kjo lidhje mbështetet vetëm mbi bazën e përkthimit sllav, mbase shumë të vonshëm, të emrit/ atributit grek Φουνδαιτών "strajcar" për fundaiatët/phundagijagitët (që po rrjedhka nga fjala e greqishtes së mesme *funda* "strajcë") për *bogumil* në *torbeš* me të cilin grekët e quanin në krye të herës saktësisht vetëm një sekt dualist, natyrisht josllav, që gjëllinte në hapësirën e Azisë së Vogël e pastaj pas shek. 10 edhe në Ballkan nga gjiri i së cilës (popullatë) nuk mund të përjashtohet as popullata autoktone parasllave e trakasve.

Në vija më të largëta, kjo rrethanë do të tregonte se studiuesit sllavë e përkthyen termin *Fundai* nga greqishtja dhe ua mveshën këtë bogumilëve, sikur nocioni për heretikët e Azisë së Vogël të kishte qenë sinonim për bogumilët sllavë e pra tani edhe për emrin *torbeš*. Këto janë dëshmitë mbi të cilat kryesisht nga dija filologjike bullgare e maqedone është deduktuar emërtimi *torbeš* vetëm duke e përkthyer kuptimin e nocionit grek, por kurrfarë dëshmie se kjo ka të bëjë edhe me goranët.

[162] Khs. Turski dokumenti za istoijata na makedonskiot narod. .., f. 301.
[163] Khs. Oblast Brankovića. .., f. 193.

Kjo sepse greqisht i kanë emrat p.sh. edhe dy degët e sektit dualist të masalianëve/mesalianëve që në shek. IV e V u lindën në Azi së Vogël: pjesëtarët e sektit të parë u quajtën *euhitë*, ndërsa të dytët *horeutë* "valltarë", sepse të parët besonin se nga vetja mund ta largonin qoftlargun përmes lutjesh, ndërsa të dytët se qoftlargu mund të largohej nga kurmi përmes vallëzimit. Duke i marrë këta emra për prototipë të emërtimit, ka mbase arsye që edhe heretikët *Fundaitai* të Azisë së Vogël të jenë emërtuar si "strajcarë" pse ata e preferonin një jetë pa bollëk ekstravagant.

Një pikë tjetër e dobët e barazimit të paravenduar midis nocioneve *bogumil* : *torbesh* : *goran* është edhe rrethana e konstatuar pothuaj nga të gjithë që janë marrë me çështjen e prejardhjes së goranëve, se emri me nuancë përbuzjeje *torbesh* për goranët po u praktikuaka për si shenjim vetëm nga të tjerët dhe qenka vetëm njëri ndër distinktivët përbuzës![*] (: *babunë*, *patarenë*, *kudugjerë*) për bogumilët. Ndryshe, goranët *nuk* e njohin veten për si *torbeshë*.[164] Përkundrazi, është konstatuar më shumë se një herë që goranët nuk kanë për vete ndonjë nocion që do të shprehte ndërgjegje/përkatësi kombëtare. "Ata nuk e quajnë veten serbë, bullgarë ose maqedonas [...]. Prej fqinjëve goranët emërtohen "*goranë*", ose "*torbeshë*", *poturë*, *shkije* dhe gjuha e tyre *nashke* dhe *shkenisht*. Veten e quajnë "*gorani*", "*nashinci*" dhe jo "*arnauti*", dhe gjuhën e tyre "*nashinski*". Ndjenja kombëtare [...] tek ata, lëviz si opcion etnik "*sme nashinci*: *ne sme arnauti*" dhe më rrallë *sme turci. a si turqin*? "jemi turq, a je turk? "- konstaton studiuesi shqiptar - vetë me prejardhje gorane - Nazif Dokle, një sjellje kjo e goranëve që [...] është abuzuar (SG*: nga shqiptarët* ?) që nga patriotizmi naiv deri tek nacionalizmi agresiv, që nga motivimi pragmatist deri te politizimi që rrjedh thundrash".[165] Në kontekstin politik, duhet dhënë të drejtë konstatimit të N. Dokles sipas të cilit "Politika shtetërore (SG. serbe) nën parullat e bashkim-vëllazërimit"

* Vështruar në aspektin etimologjik, asnjëri nga këto nocione nuk e ka kuptimin përbuzës. Kështu p.sh. nocioni *babun* lidhet me një e më shumë vende të quajtura Babun në hapësirën e të clave paska qenë përqendruar ndonjë grupacion bogumilësh; emri *pataren* (i cili nuk është përdorur në Ballkan) ka të bëjë me heretikët në Itali, një bashkësi e të cilëve e mori emrin sipas lagjes Pataria të varfanjakëve të qytetit të Milanos, ndërsa emri *kuduger* i përdorur nga grekët konsiderohet të jetë trajtë e shtrembëruar e fjalës greke kaloger "murg". Për mendimin tim, as sintagma "sme turci. a si turqin?" nuk do të thotë asgjë tjetër përpos një barazim i identitetit nacional (të cilin goranët as e kishin e as e kanë) me përkatësinë fetare. I njëjti proces ka ndodhur edhe në Kosovë, për fat të mirë më shumë sporadikisht, ku janë dëgjuar shprehjet *a je turk*, *kofsha turk*; *kofsha turk i bir i turkut* që përdoreshin për ta shprehur përkatësinë fetare islame dhe jo përkatësinë etnike.

[164]. N. Dokle, Për Gorën dhe goranët, (Artikuj e studime), Prizren, 2002, f. 60.

[165] Po ai, po aty, f. 13, 54, 62, 71.

dhe të "zgjidhjes së problemit të nacionaliteteve" punoi për ftohjen e marrëdhënieve të goranëve me shqiptarët, e më tej i fryu armiqësisë dhe urrejtjes. [...] Mbyllja, naiviteti, heshtja ose gjysmë zëri i shkencës shqiptare që i mohon goranët nga që "nuk ka hije të ketë të tillë në tokën teme" dhe qëndrimi inferior nga pozita "mos e prek se bie erë", ka qenë shërbimi më i mirë që i është bërë propagandës serbe."[166]

Duke u kufizuar në territorin e Ballkanit, përfshirë këtu Bullgarinë, Maqedoninë dhe, përbrenda arealit etnoglotologjik të shqiptarëve, krahinën e Gorës në të dyja anët e kufirit politik midis shqiptarëve, për bartës vendës të herezisë dualiste mund të merren në konsideratë vetëm bogumilët sllavë të njohur nga grekët edhe me emrin *kudugerë* dhe në shtetin e Rashës si *babunë*. Herezitë e tjera: *krstjani* "të krishterët" (siç quheshin bogumilët në Bosne), *patarenët* (emri italian për heretikët e lagjes Patara të qytetit të Milanos), *christiani boni* ose *christiani veri*, *boni homines*, *bonomii*; *katarët* (emër i përdorur për heretikët në Francë e në Gjermani nga greq. *katharos* "i pastër" dhe *Bulgari* ose *Bougres* nga *Bulgarus* (po ashtu në Francë)[167] dhe me shumë emra të tjerë kryesisht në bazë vendeve që i banonin (khs. psh *Albigenses* sipas qytetit Albi në kontenë* e Toulouse) e, ndonjëherë, edhe në bazë të zejes që e ushtronin.

Herezia dualiste dëshmohet në vitin 1143 në Köln (me ermin "varfanjakët e Krishtit"), në vitin 1144-45 në Liegeu, në vitin 1147; në Dordogne të Francës dhe në vitin 1162 kaloi edhe në Angli ku kjo herezi nuk mundi të shtinte rrënjë. Dogma dualiste në Europë e humbi forcën në gjysmën e dytë të shek. 13 dhe në gjysmën e dytë të shekullit të 14 pushoi së ekzistuari.

Asnjëri nga këta emra heretikësh nuk ka të bëjë me hapësirën e Ballkanit, edhe nëse ata heretikë mund të jenë bogumilë sllavë (?) të arratisur nga Shqipëria, Dalmacia e Bosna gjatë shek. XII në Europën Perëndimore. Një shpërngulje, përhapje hipotetike e tillë vështirë se do të mbetej pa u shënuar në analet e historiografisë europerëndimore.

Ndonjë arsyetim i ligësht i vlerës kuptimore "strajcar, skamnor, lypës" i emrit të mëvonshëm të kësaj herezie ndoshta mund të gjendet tek deklarimi i pjesëtarëve të kësaj herezie në qytetin gjerman të Köln -it, të

---

[166] Nazif Dokle, Për Gorën dhe goranët, (Artikuj e studime), Prizren, 2002, f. 78.

[167] Miku im Naim D. Shala më njofton se, mbase nga frengjishtja, ky term ka depërtuar edhe në anglishten. Në anglishten mesjetare po ekzistuaka termi/nocioni *bougre*, *bugger* i huazuar nga frëngjishtja, përkatësisht nga një trajtë e latinishtes mesjetare *Bulgarus*, që asocionte bogumilët e Bullgarisë që akuzoheshin për herezi (sodomi). Në anglishten ky term e paska kuptimin, njeri i keq, i pavlerë.

* Fjalë e barasvlerëshme me gjerm. *Grafschaft*. "territor nën sundimin e një konti".

cilët e quanin veten *pauperis Christi* "varfanjakë të Krishtit". Kështu janë cilësuar heretikët në Perëndim. Sido që të jetë, nocioni bogumil shenjon pjesëtarët e bashkësisë fetare, përkatësisht të lëvizjes sociale e fetare që në mesjetë ekzistonte në Ballkan. Megjithatë ka përkrahës, me pak kompetencë filologjike, të lidhjes së drejtpërdrejtë midis bogumilëve e torbeshëve (nënkupto: goranëve) të cilët bien në kundërshtim me vetveten kur pohojnë se emri i torbeshëve po rrjedhka nga fjala *torba* "strajcë"e sllavishtes që, në vija më të largëta, po u lidhka me një fjalë të prejardhjes persiane me të njëjtin kuptim. Vetë kjo etimologji jokompetente dhe e mangët sikur e arsyeton mosbesimin ndaj përkrahësve të lidhjes që e venin midis bogumilëve e torbeshëve, përkatësisht goranëve. Megjithatë, ithtarët e kësaj teze i mbajnë torbeshët/ goranët për "trashëgimtarë të fundit të bogumilëve të Maqedonisë".[168]

4.5. Rreth mundësisë së barazimit të nocioneve goran, pomak, torbesh, gogë, mijak dhe bogumil

Ka porse edhe një segment të rëndësishëm, në mos edhe vendimtar, i cili nuk është marrë parasysh për si mundësi e prejardhjes së goranëve. Ky segment është në të vërtetë lidhja potencialisht e mundshme në kontekstin historik të popullatës së quajtur torbeshe/gorane me popullatat, grupthet etnike sllavishtfolëse të besimit islam të shpërndarë në disa shtete të Ballkanit, përkatësisht me grupin e madh "etnik", të quajtur *pomak* dhe me grupet e vogla etnike të quajtura *gogë* e *mijak*.

Duke u mbështetur mbi një studim të gjatë të dijetarit bullgar V. Stojanov[169] mbi pomakët mua më rezulton se edhe ky grup etnik (i pomakëve) është gjithsesi pjesë e asaj mbetjeje të popullatës, në krye të herës josllave, përkatësisht trakase e romane ballkanike pjesë të së cilës, me të shkuar të kohës, u quajtën me emra të ndryshëm (khs. termat e sjellur më lart). Gjykuar mbi bazën e gjuhës/gjuhëve që e (i) flasin, mbi veshjen, muzikën e mbi segmente të tjera të jetës materiale e shpirtërore të tyre, fitohet mbresa që *pomak* është vetëm një emër tjetër i një brumi të vetëm etnik pjesë të të cilit njihen edhe me emrat torbeshë, goranë, gogë, mijakë e madje edhe *poturë* ose edhe kurkisë. Edhe tek ky grup është në veprim procesi i formimit të identitetit të etnisë vetëm mbi bazën e veçorive të kulturës materiale, sepse faktori kryesor determinues - gjuha e mëvetëshme e kryehershme: trakishtja, përkatësisht vllahishtja - është humbur njëherë e përgjithmonë. Këtu e gjen shpjegimin rrethana që

[168] http://bs.wikipedia.org/wiki/Torbe%C5%A1i.

[169] www.ihist.bas.bg/sekcii/CV/_private/Valery_Stojanow/VS_Muslime-Mind_Balkan.htm - 50k.

pjesëtarë të grupit etnik të pomakëve/torbeshëve, të gjendur në udhëkryqin e kërkimit të identitetit të humbur etnik, deklarohen sot për bullgarë, maqedonas, turq, grekë, shqiptarë e madje edhe boshnjakë. Fati i këtij entiteti është mjaft i ngjashëm me atë të romëve në përgjithësi dhe me atë të hashkalinjve, egjiptasve, magjupëve dhe nënndarjeve të tjera të romëve në Kosovë. Në të dyja rastet kemi të bëjmë vetëm me emërtime të ndryshme që këtyre ua dhanë të tjerët, pushtete e popuj nën sundimin e të cilëve ranë ose që bashkëjetuan me ta. Emrat e tyre u motivuan herë nga emra vendesh ku u vendosën (si p.sh. *goran* - siç quhen këta vetëm në Kosovë e pjesërisht në Shqipëri) nga emri i një pjese të maleve të Sharit, e quajtur Gora; *gogë* nga emri Gogeria e regjionit me dhe përreth qytetit të Kërçovës; *babunë* sipas emrit të lumit e të vendbanimit Babuna të Maqedonisë ose edhe me emrat *torbeshë*, përkatësisht *fundaitai* e *pomakë* që këtyre ua dhanë të tjerët, kryesisht sllavët e Jugut dhe grekët.

Popullata e quajtur *pomak* gjallon sot e ndarë në pesë shtete. Numri i përgjithshëm i tyre kap shifrën prej rreth 500.000 njerëzish. Nga këta, 80.000 deri në 120.000 po jetuakan në Shqipëri!, gati 40.000 në Greqi e në Maqedoni dhe rreth 150-200.000 në Bullgari: Në Turqi në vitin 1965 ishin regjistruar rreth 20.000 njerëz me gjuhë amtare "pomakça", shumica e të cilëve ishin emigrantë nga Bullgaria dhe gjysma e tyre jetonte kryesisht në Edrene (Adrianopojë) të Turqisë. Në këtë vend, pomakët i qajnë "turq të Rodopeve", sepse në Turqi pomakët u dyndën në vitin 1922, në kuadër të shkëmbimit të popujve midis Greqisë e Turqisë nga pjesa greke e Rodopeve. Sipas regjistrimit të popullsisë më 1992, në Bullgari kishte rreth 65.000 pomakë. Shoqata për Mbrojtjen e Popujve të Rrezikuar me seli në Heidelberg kujton porse se në Bullgari po jetuakan sot 250.000* pomakë që këtu mbahen për bullgarë muhamedanë, ndërsa në Greqi 30.000 pomakë. Në Greqi pomakët jetojnë sot vetëm në Traki, sepse të gjithë pomakët e Maqedonisë greke, përkatësisht Makedonisë së Selanikut, u shpërngulën në vitin 1922 pa dëshirën e tyre për në Turqi, në kuadër të "ndërrimit të popullsisë" midis Greqisë e Turqisë. Së këndejmi, në vitin 1951 në Greqi ishin regjistruar vetëm 18.700 *pomakë* (sot janë rreth 30.000), ndërsa pas këtij viti në vend se me distinktivin etnik, pomakët regjistrohen thjesht për si "myslimanë" të Greqisë, sepse në këtë vend, si edhe arvanitasve e minoriteteve të tjera, pomakëve nuk u është njohur statusi i minoritetit. Sado që më herët pomakët mbaheshin në Greqi për si pjesë e pandashme e një popullate muslimane bashkë me turqit në Trakinë Lindore, në vitet e '90-ta të shek. 20 në Greqi u bënë përpjekje që pomakët

* Disa të tjerë këtë shifër e ngrisin në 400.000.

të paraqiten për si popull më vete në mënyrë që kështu t'u vihej ledhi ndikimeve nga Turqia e nga Bullgaria".[170]

Shkapërderdhja e këtij grupi etnik nëpër shtete në fqinjësi njëri me tjetrin edhe është shkaktar i sqarimeve kontraverze përkiazi me prejardhjen e mundshme të tyre, gjë që ka ndikuar edhe në forimin e imazheve historike të ndryshme lidhur me prejardhjen edhe tek vetë pjesëtarët e etnitetit të ashtuquajtur pomak. Lidhur me përkatësinë etnike të pomakëve, në dijen ballkanike ka mendime të ndryshme. Varësisht nga identiteti nacional i autorëve dhe i shteteve që i financojnë studimet e tyre, pomakët i konsiderojnë për turq të bullgarizuar, për bullgarë të myslimanizuar, për maqedonas e për grekë të islamizuar. Kështu, në Bullgari pomakët i mbajnë për muhamedanë bullgarë, të cilët qenkan islamizuar gjatë harkut kohor të sundimit osman mbi Bullgarinë. Kjo hipotezë po gjetka mbështetje tek gjuha e përbashkët dhe kultura e përgjithshme (bullgare) e tyre dhe tek vetë njoftimet e përmbajtura në burimet osmane. Sipas versionit turk, pomakët sillen në lidhje birësie me "kumanët" ose kipçakinçët. Këta të fundit paskan ardhur në vitin 916 nga Kina Veriore. Qenkan vendosur në Ukrainë dhe gjatë shek. XI e XII përmes Rumanisë paskan arritur deri në veri të Bullgarisë, përgjatë lumenjve Danub e Dobruđa**.** Këto migrime paskan vazhduar drejt jugut dhe arritën deri tek malet e Rodopeve dhe Maqedonia lindore. Pas vitit 1034 peçenegët do t'ia mësyjnë Kosovës, Novipazarit e Bosnje-Herzegovinës. Kah fundi i shek. XI, më saktësisht në vitin 1091, kumanët e peçenegët do ta forcojnë pushtetin e tyre në juglindje të Ballkanit dhe do t'ia mësyjnë Bosnjës, për të emigruar në ndërkohë edhe në Rumani, Hungari, Austri e Çeki.[171]

Mbase këtu e ka mbështetjen teza e ndeshur në literaturën turke, ku pomakët i quajnë turq autoktonë të Rodopeve ose turq të bjeshkëve, duke i parë këta për pasardhës të kumanëve të shek. 12 ose të fiseve të tjera turke që në Malet Rodope banonin kohë para ardhjes këndej të osmanëve e ku qenkan bullgarizuar dhe e paskan harruar gjuhën amtare të tyre. Në këtë mes harrohet dëshmia bazë se pomakët, si dhe torbeshët, e flasin dialektin rodop (sipas emrit të Maleve Rodope ku ishin të përqendruar më shumë pomakë) të bullgarishtes.

---

[170] Prof. Dr.Sc. PhD Valery Stojanow: Die Muslime am Balkan als eine überregionaleMinderheit. Probleme der Identifizierung, në www.ihist.bas.bg/sekcii/CV/_private/Valery_Stojanow/VS_Muslime-Mind_Balkan.htm - 50k.

[171] Sipas Home ▸Reportaže-Hronike-Komentari ▸Hronike ▸POMACI, njihova prošlost i sadašnjost.

Shkrimet nacionaliste propagandistike po folkan për rreth 6 milion pomakë, gjë që i kapërcen të gjithë kufijtë e mendjes së shëndoshë - thotë Valery Stojanov.[172]

Në Shqipëri pomakët po i mbajtkan për minoritet maqedonas, ndërsa në Maqedoni, duke qenë folës të "maqedonishtes", i mbajnë për myslimanë maqedonas, sado që pomakët po gjetkan mbështetje tek minoriteti i fortë shqiptar dhe po u asimiluakan, po u shqiptarizuakan. Procesi i asimilimit të pomakëve/torbeshëve në pjesën jugore të Ovče Polje-s është vërejtur që në vitin 1912: "Në pjesën jugore të Ovče Polje-s [...] ka pomakë e torbeshë, të cilët janë popullatë serbe e islamizuar e vende-vende gjysmë e shqiptarizuar".[173]

Një segment, më i rëndësishmi, që nuk ka mundur të mohohet pothuajse nga asnjë studiues, është gjuha që e flasin pomakët. Gjuha e pomakëve është edhe sot dialekti bullgar i Rodopeve, aq i afërt me bullgarishten (si edhe ajo e goranëve kosovarë) sa që mund të mbahet për një dialekt i saj dhe, kjo nuk është fare e kontestueshme. Prandaj gjuha e pomakëve në Bullgari, Maqedoni, në Greqi e në Shqipëri si edhe ajo e goranëve kosovarë nuk mund të mbahet, siç mund t'ia ketë ëndja dikujt, as për turke, as serbe e as "boshnjake" për të cilën dikujt ia ka andja të besojë se në krye të herës paska qenë turqishtja, të cilën administrata turke e njeh për si gjuhë më vete me termin "pomakça".

Për sa i bie aspektit etnik, është shfaqur mendimi që, duke u mbështetur mbi doke e zakone me prejardhje nga krishterimi (ku këto nuk aplikohen sot), pomakët do të jenë pasardhës të konvertuar të të krishterëve të dikurshëm e pra, në vija më të largëta, (siç janë cilësuar edhe goranët kosovarë) pjesëtarë të herezisë bogumile prandaj më së lehti, si edhe bogumilët e Bosnjës, qenkan konvertuar në islamizëm.

Se çështja e përkatësisë etnike të popullatës myslimane sllavishtfolëse të Ballkanit është ngatërruar më shumë se ç'mund të tolerohet, kryesisht për shkak të emrave të ndryshëm që kjo popullatë unike (sado e ndarë në pesë shtete të Ballkanit) vetë ia dha vetes sipas vendeve të ngulitjes (siç ndodhi me pjesën e kësaj popullate të quajtur *goranë* në bazë emrit të krahinës ku u vendosën; *babunë* po ashtu në bazë të vendit të tyre të ngulitur në katundin përgjatë lumit Babuna etj. khs. më poshtë) në kuadrin e lëvizjeve të popullsisë në shek. XII-XIV apo nga popullata vendëse përreth zonave të banuara nga kjo popullatë, do të shihej edhe nga deklarime të tërthorta të disa studiuesve. Kështu p.sh. dijetari i mirënjohur

[172] Khs. www.ihist.bas.bg/sekcii/CV/_private/Valery_Stojanow/VS_Muslime-Mind_Balkan.htm - 50k.

[173] Sipas Projekat Rastko Gračanica - Peć: Istorija: Stara Srbija, geografska i etnografska slika (1912).

bullgar St. Mladenov shkruante në vitin 1925 se në rrethina të Shkupit e të Dibrës dhe gjithandej në pjesën perëndimore të Maqedonisë ka përplot *pomakë* (nënvizim i im) të cilët "nga vëllezërit e tyre të krishterë" (SG. nënkupto: bullgarët, maqedonasit) po u quajtkan me emrin përbuzës "*torbeši*, *torbešitë*".[174] Për Mladenov-in, pomakët/torbeshët qenkan "bullgarë të muhamedanizuar". Në Bullgari, këta po u quajtkan, siç na mëson dijetari tjetër bullgar Jordan Ivanov,[175] turqisht (edhe) *dilcьzi* "të pagjuhë", përkatësisht "ata që nuk dinë turqisht" dhe se këta në rrethina të Tikvesh-it, Dibrës, Kërçovës e të Shkupit po u quajtkan po ashtu *torbeši*. Pomakët e regjionit të Maqedonisë së Vardarit po i identifikuaka me torbeshët, edhe dijetari bullgar Cilev,[176] me ndryshimin që ky (sh. edhe më poshtë) pomakët i mban për pasardhës trakasish të sllavizuar. Për të dy këta dijetarë bullgarë pomakët/torbeshët qenkan popullatë bullgare e islamizuar e edhe sot, me të padrejtë, për të këtillë e mbajnë në Bullgari e në Maqedoni.

Në të gjitha këto vende, pomakëve u është njohur vetëm identiteti fetar, jo porse edhe ai etnik i tyre.

Mbase të prirur të bëjnë shkencë në shërbim të patriotizmave lokalë me tendencë rrafshimesh etnike, përkatësisht me tendencë asimilimi të atyre që s'janë si ata, asnjë nga dijetarë bullgarë apo grekë nuk e shtroi çështjen e lashtësisë historike, përkatësisht të origjinës së kryehershme të kësaj popullate josllave e johelene. Ishte, sa po mësoj nga literatura, dijetari çek Leopold Geitler (1847-1885) ai i cili mbi bazën e traditës poetike, të mbledhur në vend, të pomakëve të Bullgarisë, të përmbledhur në librin e tij "*Tradita poetike e trakasve dhe e bullgarëve*", të botuar çekisht në Vjenë në vitin 1878, që pomakët e Bullgarisë i mbante për pasardhës të trakasve. Disa vite më parë edhe dijetari frëng Dozon në punimin e tij *Raport sur une mission littéraire en Macédonie*, Paris, 1874 për me prejardhje trakase i mbante (edhe) pomakët e Maqedonisë.[177]

---

[174] Në referencën 1 Mladenov sqaron se ky emër po rrjedhka nga fjala *torbà* "strajcë; strajcë lypsaku" dhe se me këtë emër në krye të herës emërtoheshin bogumilët të cilët e bartnin kraheqafe një strajcë në të cilën gjithmonë kishte edhe një ungjill. Bogumilët u quajtën, sipas J. Ivanov, Вьlgarite v Makedonija. .., f. 55 greqisht *fundaiti*, përkatësisht φουνδατῖαι (sipas St. Mladenov: *fundaité*) nga greq. *funda*, përkatësisht φούνδα = strajcë. Edhe kur bogumilët u islamizuan paskan vazhduar të quheshin torbeshë. Mladenov thotë se edhe bogumilët shqiptarë që kaluan në katolicizëm po i ruajkan ende disa rituale bogumile dhe po u quajkan edhe sot e gjithë ditën *Funda* (SG: fanda?).

[175] Вьlgarite v Makedonija, Izdirvanja i dokumenti za tehnoto poteklo, ezikь i nardnostь s etnografskata karta i statistika, Sofija, Carska pridvorna pečatnica, 1917, f. 55, shën. 1.

[176] sipas http://bs.wikipedia.org/wiki/Torbe%C5%A1i".

[177] Sipas Meyers Konversationslexikon, Band 13 Seite 213:, përkatësisht http://susi.e - technik.uni-ulm.de.8080/Meyers2/seite/werk/meyers/band13/seite/0213/meyers-.

Tezën e prejardhjes trakase të pomakëve e mbështesin në ditët tona edhe dijetarë grekë. Sado që në Greqi, përkatësisht në Makedoninë e Selanikut, pomakët mbahen zyrtarisht për "helenë sllavofonë të islamizuar". Është provuar që mbi bazën e emrit *ahrijani* ose *agarijani* të pomakëve të Rodopeve këta të sillen në lidhje birësie me fisin e lashtë grek të ahrianëve të dëshmuar në shek. III para erës sonë, për të cilët nuk ka kurrfarë dëshmie se kishin jetuar ndonjëherë në Rodope - një tezë kjo për të cilën është fort e vështirë të gjendet ndonjë mbështetje e logjikshme, sa kohë që dihen pretendimet asimiluese të shtetit grek të të gjithë jogrekëve që jetojnë sot përbrenda kufijve politikë të Greqisë. Për të dalë nga kurtha që ia vunë vetes, për ta zbutur naivitetin e diktuar nga politika shtetërore ka dijetarë grekë që sot pranojnë që pomakët qenkan pasardhës të trakasve të vjetër, por patjetër "farefis për nga gjaku i helenëve" të cilët invazioni sllav në shekujt VII-XII i shtyu në malet Rodope ku, me të ardhur të osmanëve, u islamizuan. Bile edhe *analizat e gjakut* (nënvizimi im) po "dëshmuakan" se pomakët qenkan një racë më vete e trakasve arianë përkatësisht banorë të stërlashtë të hapësirës së gjerë helene e të cilët, së këndejmi, nuk paskan asgjë të përbashkët me popuj të tjerë të Ballkanit - natyrisht përveç me helenët.![178] Jo vetëm dijetarët specialistë indoeuropeistë, trakologë e sllavistë të rrallë të pangarkuar politikisht do ta shtronin pyetjen për fatin historik të gjithë asaj popullate trakase. Më duket që përgjigje e logjikshme do të ishte që nuk është e mundshme që një popull aq i madh si ai i trakasve të ketë humbur pa gjurmë sado që invazioni bullgar në pjesën jugore të Ballkanit, si edhe ai i kroatëve në krahun perëndimor të këtij Gadishulli arriti të ishte mbase shumë më shkatërrimtar në rrafshin e sllavizimit të popullatave autoktone trake e ilire të ambienteve të përziera edhe me etni të tjera, se sa invazioni i pararendësve të serbëve në hapësirën homogjene dardane - ilire. Ka shumë arsye të besohet që rrafshimi etnik, përkatësisht sllavizimi etnik i substratit trak nuk rezultoi me sllavizim të plotë të substratit indoeuropian të popullatës së etnisë trakase të hapësirave të sotme politike të Bullgarisë, Greqisë e pjesërisht edhe të Maqedonisë së Vardarit vetëm pse që nga shek. IX (kur protobullgarët u krishterizuan dhe e morën alfabetin qirilik) nuk paska kurrfarë burimesh trakase që do ta dëshmonin praninë e trakasve, përkatësisht të pasardhësve pomakë/ torbeshë/goranë e të tjerë të tyre. Më pak e besueshme më duket teza e mbrojtur nga historianë turq; sipas së cilës pomakët na qenkan pasardhës të sllavizuar të kumanëve e të kypçakëve turkemë.[179]

[178]. www.ihist.bas.bg/sekcii/CV/_private/Valery_Stojanow/VS_Muslime-Mind_Balkan.htm - 50k.

[179] http://de.wikipedia.org/wiki/Pomaken.

Teza e mësipërme e paelaboruar më hollësisht është e lidhur dhe e pandashme pikërisht me vendin e formimit të gjuhës e të etnisë rumune dhe me degët e kësaj gjuhe/populli. Po u nisëm nga teza e G. Schramm-it[180]) sipas së cilës vendi i formimit të vllehve/ rumunëve është hapësira në jug të lumit Danub, përkatësisht në trevat përreth malësive të Pirinit, të Rilës dhe të Rodopit në hapësirën e sotme të Bullgarisë dhe se "ky, etnos i ri [...] nuk ka krijuar as qytete, asnjë vend të posaçëm, as shtetin e vet, sepse forma kryesore e jetesës së tij ka qenë shtegtimi me bagëtinë e tyre (dhe se) gjatë shekujve të mesjetës, ky etnos i ri i romanizuar shpërndahej herë pas here sipas kushteve historiko-etnike për t'u mbledhur rishtas në një krahinë tjetër, duke banuar herë në këtë, herë në atë zonë të Ballkanit të mesëm. Domethënë, sipas Schramm-it, në Evropën Juglindore vazhdimësia e latinitetit ishte një *vazhdimësi e lëvizshme* (continuité mobile). Rezultat i këtyre zhvillimeve është, sipas tezës së gjashtë të G. Schramm-it, krijimi i një *Romanie ballkanike të barinjve*. Dhe në këtë hapësirë gjithnjë sipas Schramm-it, në të njëjtën krahinë për një kohë më të gjatë kishin jetuar bashkërisht stërgjyshërit e shqiptarëve e ata të rumunëve duke e ruajtur identitetin etnogjuhësor sado që, sidomos tek burrat, do të ketë qenë i theksueshëm bilinguizmi. Dhe kjo krahinë është Dardania.

Një çështje vendimtare në këtë kontekst është që elementi roman ballkanik i vazhduar tek popullata e sotme e Gorës nuk bën të përzihet e të ngatërrohet me elementin vendës (ilir), të romanizuar thellë, jo porse plotësisht, sikundër mendojnë shumë dijetarë, midis të cilëve edhe antropogjeografi serb M. Lutovac. Ky i fundit, mbase pa kompetencë profesionale, deklaronte se gjatë shek. 7, kur sllavët erdhën në Ballkan e deri në shek. XII Rrafshi i Dukagjinit ishte i banuar aq sa nga serbë po aq edhe nga ilirë të romanizuar.[181] Kjo sepse, sikundër del nga kjo trajtesë e imja, pararendësit e goranëve të sotëm nuk janë ilirë të romanizuar, porse element trakas i romanizuar e i bullgarizuar gjuhësisht - i ardhur apo i sjellur në hapësirat e sotme të Kosovës në kuadrin e zgjerimit të "Bullgarisë së Madhe" apo edhe si rezultat i përndjekjes së tyre pse e kishin përqafuar doktrinën dualaiste të bogumilizimit - si formë të rezistencës kundër sllavizimit e helenizimit të tyre.

---

[180] E trajtuar në punimin e tij Frühe Schicksale der Rumänischen-Acht Thesen zur Loklalisierung der latienischen Kontinuität in Südosteuropa, në Zeitschrift für Balkanologie, XXII/1; XXII/2, 1986 dhe XXIII/1, 1987cit. sipas Istvan Schütz, Perkimet gjuhësore shqiptare-rumune dhe vazhdimsia etnike në Kosovë, "Studime filologjike" 3/1989,Tiranë, f. 85.

[181] Khs. M. Lutovac, La Metojija,. .., f. 66.: "On peut affirmer que dupuis le VII-e siècle la Metohija été habité aussi bien par les Serbes que par une population de Valakhs, Illyriens romanisés.".

Në favor të tezës për ardhjen e pararendësve të goranëve të sotëm nga hapësira e Bullgarisë do të fliste edhe rrethana e konstatuar nga dijetari gjerman G. Schramm që "gurra e përbashkët e shumicës dërmuese të sllavizmave të rumanishtes dhe të shqipes është bullgarishtja". Një shembull transparent është emri i një fryme të thatë e të ftohtë të cilën banorët shqiptarë të brigjeve të Liqenit të Ohrit dhe të atij të Prespës e quajnë *krivec*, pikërisht ashtu (*crivăț*) sikundër e quajnë edhe rumanishtfolësit e Moldavisë. Ky bullgarizëm i vjetër i shqipes dhe i rumanishtes ka hyrë në të dyja këto gjuhë në shek. IX,[182] kur pararendësit e shqiptarëve e të rumunëve bashkëjetonin në hapësirat e Dardanisë.

Sado që për disa hulumtues nuk paska pasur mundësi të dëshmohet nëse e gjithë popullata autoktone trakase/pomake apo qoftë edhe vetëm një krah i saj të kishte qenë praktikuese e herezisë paulikane, përkatësisht bogumile, e cila do të ketë qenë faktor lehtësues i kalimit të tyre në islamizëm, vetë rrethana e dokeve dhe e zakoneve kriptokrishtere (doke e zakone të krishterimit të hershëm të varantit sllav të përzier me paganizëm që sot nuk ushtrohen më as në ortodoksinë sllave e ndoshta, jo se jo, as në atë greke) tregojnë se tek pomakët, megjithatë, kemi të bëjmë (si edhe te goranët e Kosovës) me pasardhës të të krishterëve të kryehershëm vendës (trakas) ortodoksë të islamizuar.

Në të mirë të tezës që tek popullata e asimiluar trakase, sot sllavishtfolëse e besimit islam kemi të bëjmë me një popullatë unike trakase pjesë nga e cila me kohë mori emra të ndryshëm, do të shkonte edhe mendimi që p.sh. një pjesë të kësaj popullate që jeton në pjesë të Rodopeve e quajnë, përveç pomakë, edhe ahrianë/agrianë;[183] pjesën që jeton në Maqedoninë e Vardarit e quajnë torbeshë dhe, jo rrallë, *poturë* ose *kurkisë*, ndërsa (vetëm) në Kosovë e në Shqipëri i quajnë *goranë* (sepse vetë emri Gora i regjionit qenka emër serbisht) e *torbeshë*.[184]

Një segment që do të fliste në të mirë të qenies në lashtësi të grupeve etnike të cilësuara herë për "bullgarë" e herë për "maqedonas" dhe më rrallë për "sllavë" të islamizuar janë në të vërtetë një tërësi e popullatës trakase, apo edhe (ndoshta) e *popujve ballkanikë*[185] që, në kuadrin e

[182] I. Schütz, po aty, f. 87.

[183] Disa studiues grekë, sipas Home ▸Reportaže-Hronike-Komentari ▸Hronike ▸POMACI, njihova prošlost i sadašnjost, PETAK, 11 APRIL 2008 10:38 e sjellin këtë emër sikur të ketë ndonjë lidhje me ahrijanët që në Greqinë e sotme kishin jetuar në shek. III e IV para e. s., sado që nuk sjellin kurrfarë dëshmie që kjo etni të ketë jetuar edhe në Rodope.

[184] Kështu më rezulton p.sh. nga punimi "Pomaci, njihova prošlost i sadašnjost" në në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[185] Siç thuhet tek Home ▸Reportaže-Hronike-Komentari ▸Hronike ▸POMACI, njihova prošlost i sadašnjost.

shtegtimeve të një mase autoktonësh të "romanitetit në lëvizje", në trevën e Gorës erdhën ekskluzivisht si barinj nga zona të Ballkanit të Jugut, është mbase rrethana që kjo popullatë e banon edhe sot një hapësirë pothuaj homogjene gjeografike të përmbledhur me nocionin "*grupi torbesh*"[186] që, e parë si "lëkurë leopardi", po i ngërthyeka grupet etnike të popullatave në krahinat e Gorës e të Zhupës[*] së Siriniqit (në rrafshnaltën e rrjedhës së epërme të lumit të Lepencit, në verilindje me Malet e Sharit, përkatësisht me Maqedoninë), Rekës, Gollobordës (njësia territoriale që ngërthen vendbanimet Trebishtë, Ostern, Tërbaç, Lladomericë, Otisan, Gjinovec, Pasinkë, Tuçep, Vrbnicë, Klenjë, Stërblevë dhe Xhepishtë të rrethinave të Dibrës, Librazhdit e të Elbasanit) dhe të asaj të Drimkollit (me disa vendbanime midis Strugës e Dibrës) si edhe rrethana që "Shumica e banorëve (SG.: të Gorës, edhe sot) është e orientuar tek blegtoria, kryesisht tek blegtoria nomade, sepse Malet e Sharit ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme për kullota verore. Dhe, më tej, gjatë muajve të dimrit, një pjesë e madhe e blegtorëve posedues grixhash të mëdha, (qehajët) i shpijnë grigjat e tyre në Maqedoni, në Greqi e edhe në Anadoll, sepse (SG. në këtë hapësirë) nuk mund ta sigurojnë ushqimin për bagëtinë e tyre".[187]

Goranë të quajtur *pomakë* ka edhe në vetë hapësirën kompakte të goranëve në Kosovë e në regjionin e Kukësit. Të kësaj përkatësie etnike e mbajnë veten p.sh. të 800-1.000 banorët e katundit Reçan të rrethinës së Prizrenit, të cilët sot po e quajtkan veten boshnjakë. Banorët e këtij katundi për veshje tradicionale të burrave i paskan tierqët e bardhë dhe kësulën e bardhë prej leshi e cila nga këta po u quajtkan me fjalën *kećе* të huazuar nga turqishtja. Një informant imi nga ky katund më shpjegonte se instrumentet bazë muzikore të këtij entiteti qenkan *zurla* e *tupani*, i cili ndryshe po u quajtka edhe *goč*; se këto instrumente na qenkan marrë nga shqiptarët dhe se pjesa më e madhe e riteve, ceremonive të dasmës qenkan të ngjashme me ato të shqiptarëve. Banorët e këtij vendbanimi, kështu më mëson informanti im, në shtëpi po e folkan një variant të bullgarishtes që po ndryshuaka nga ai i folur nga goranët, ndërsa për gjuhë të administratës e paskan variantin e sandardizuar të serbishtes.

Që edhe banorët e këtij vendbanimi (Reçan) që e mbajnë veten për pomakë janë në të vërtetë të së njëjtës etni si edhe të gjithë goranët duket

[186] sipas Sadik Idrizi Aljabak: Gora – Jedan pogled unazad (dorëshkrim)

* Fjala *župa*, nga e cila rrjedh ky epitet, i ka në sllavishten dy kuptime: 1. famulli dhe 2. bashkësi; komunë. Meqë kjo zonë nuk është e njohur për si ndonjë qendër kishtare, duket se këtu kemi të bëjmë me një emërtim gjeografik/administrativ i cili shenjon një bashkësi të ndryshme nga ajo mbizotëruese në atë ambient, pra të ndryshme e që, prandaj duhej të shenjohej ndryshe për t'u dalluar.

[187] S. Idrizi, poaty.

se mund të tregojë rrethana që midis vëllazërive gorane të "Gorës së mirëfilltë" ka edhe një të tillë që emrin *pomak* e ka ruajtur deri në ditët tona. E këtillë është vëllazëria *Pomakovc*i e katundit Brod të Gorës. Kjo në rend të parë pse nëpër burime të pakta të periudhës paraturke nuk ka asnjë dëshmi onomastike për praninë në hapësirën shqiptare të banuar nga goranë të ndonjë grupi etnik të veçantë të quajtur *pomak*, të ndonjë emri të vëllazërisë apo të ndonjë antroponimi që do ta ruante këtë nocion. Emri modern *Pomakovci* i Brodit mund të merret për si indic që do të tregonte se edhe bartësit e këtij emri, si të gjithë goranët, janë vërtet të ardhur nga pjesa jugore e Ballkanit, përkatësisht nga Bullgaria apo Maqedonia, pra nga ajo zonë ku sot popullata myslimane sllavofone e flet po atë gjuhë apo dialekt që e flet edhe popullata e Gorës. Nëse para-rendësit e vëllazërisë gorane të *Pomakovci*-ve u quajtën kështu pse në Gorë erdhën më vonë tek bashkëkombësit e vet apo ky emër ishte emri i kryehershëm i goranëve të sotëm i cili më vonë u mbulua nga emri i ri që e morën ardhësit e vendosur në krahinën që do të quhet Gora, mbetet çështje që duhet të shihet. Kjo sidomos në dritën e etimologjive të propo-zuara e pjesërisht të përqafuara gjithandej. Mendimet e shfaqura përkitazi me prejardhjen e këtij emri i gjejmë në formë të përmbledhur tek një punim i antropologut serb A. Urošević.[188] Ky e sjell një kronologji të tentimeve për interpretimin etimologjik të emrit *pomak*: nga bullg. *pomogati* për arsye se popullata bullgare e islamizuar e Rodopeve paska qenë e detyruar ta ndihmonte ushtrinë osmane në ekspedita ushtarake; nga bullg. *pomamen* "i mashtruar" ose nga folja bullg. *pomъtam* se, *pometnal se* "lëviz, zhvendosem". Të gjitha këto i duken autorit tonë, me të drejtë, për etimologji popullore. Ky vetë propozon që emri etnik *pomak* mund të sqarohet me fjalën turke *bomak* "atdhe; vendlindje; dhe" e cila (fjalë) qenka zgjeruar me prapasdhtesën turke *-ak* që në këtë rast po e treguaka prejardhjen e akëcilit, si p.sh. tek *Bošnjak* "njeri me prejardhje nga Bosnja". Në këtë rast, emërtimi *pomak* po na qenka i pandashëm nga procesi i islamizimit dhe se po e shenjuka myslimanin vendës, indigjen dhe jo turkun e ardhur nga Anadolli etj. Përkitazi me emrin *Pomakovci* të vëllazërisë së katundit Brod të Gorës, autori ynë sqaron se kjo (vëllazëri) do të jetë quajtur *pomak*, sepse mund të ketë qenë e para vëllazëri serbe (!) e islamizuar. Meqë fjala turke u institucionalizua si emër vëllazërie, nuk paska pasur mundësi që ky nocion të përfshijë më vonë të gjithë të islamizuarit, që mua më duket etmologji fort popullore sado që vetë nuk mund ta propozoj ndonjë sqarim tjetër.

[188] Atanasije Urošević, Jedno objašnjenje naziva Pomak, Glasnik Etnografskog Instituta Srpske akademije nauka i umetnosti, XVI-XVIII (1967-1969) f. 121-123.

Po të jetë e drejtë kjo etimlogji, atëherë do të lejohej paravendimi që vëllazëria e pomakëve na qenka ngulitur në këtë hapësirë pas islamizimit të pomakëve. Hipoteza e mësipërme do të mbështetej edhe me anulimin e logjikshëm të mundësisë që ndonjë bashkësi etnike, fisi, vëllazërie do të shpërngulej nga fusha në bjeshkë, por që më parë do të mund të ketë ndodhur e përkundërta, pra ka vend të paravendohet që ndoshta banorët pomakë / torbeshë të Reçanit të Prizrenit do të jenë pjesë e vëllazërisë së *Pomakovci*-ve goranë që do të jenë zhdjergur në rrafsh - si rezultat i fenomenit të "territorializimit" të katundeve blegtorale.

I njëjti fenomen duket të jetë zhvilluar edhe në regjionin e Kukësit. Tradita popullore e atjeshme banorët joshqiptarë të mikroregjionit Çaja po i mbajtka për "*pomakë*", duke i dalluar ata nga "goranët". Pomakët e Çajës po u konsideruakan këndej popullatë në krye të herës shqiptare e islamizuar, ndërsa goranët po i mbajtkan për *poturë* "të turqizuar, të islamizuar", përkatësisht për torbeshë të islamizuar. Edhe ky pështjellim po rënka, sipas autorit Sadik Idrizi,[189] në kuadrin e tezës sipas së cilës torbeshët qenkan popullatë autoktone e cila po i përkitka një substrati etnik aromun që na qenka asimiluar nga pushtues të ndryshëm. Autori ynë e kundërshton këtë tezë duke e shtruar pyetjen, për mendimin tim mbase të panevojshme, përse do të ketë pasur nevojë që popullata e dy regjioneve fqinje të Gorës dhe të Çajës të quhen me emra të ndryshëm. Më tej, autori ynë e shtron pyetjen pse këto dy etni fqinje të kishin qenë të të njëjtit brumë etnik, siç mendojnë dijetarët Cilev e O. Turan, (për këta sh. më poshtë) paska pasur nevojë të quheshin me dy emra të ndryshëm: pomakë e poturë. Unë kujtoj që përgjigja më e kuptueshme për këtë dilemë do të jetë kjo që këtu kemi të bëjmë vetëm me një emër tjetër, të dhënë nga të huajt, të një dege/ mase në krye të herës unike para-e josllave dhe jo me dy etni të ndryshme.

Fryt i pështjellimeve dhe i mjegullimeve sidomos në rrafshin e emrave që nga të tjerët iu dhanë popullatës së vjetër josllave e jogreke kryesisht të jugut të Ballkanit është edhe mbulimi i etnonimit *gogë*. Emri i kësaj popullate dëshmohet së pakut në të nisur të shek. 14, kur në një marrëveshje miqësie midis Karlit të Valois-it dhe të dërguarve të mbretit serb të vitit 1308 dëshmohet se përbrenda kufijve të shtetit serb ishin edhe "Tokat e Kërçovës deri në kufijtë e Gogerisë",[190] që mbase s'do të jetë tjetër përveç Kërçova dhe rrethina e saj e deri në Ohër, e banuar edhe nga një popullatë që do të jetë quajtur *gogë*. Përveç kësaj, një hapësirë e

[189] Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k -.

[190] Sh. Stojan Novakoivć, Zakonodavsto i vladaoci srpski XIV veka i narodnosti u Makedoniji, Otadñbina 19 (1888), 10-11.

quajtur sllavisht *Zemlja gogska* "Vendi i Gogëve" në të cilin (vend, hapësirë) binin Voskopoja dhe katundet Grabo, Nikolica e Belica të Epirit dhe vende në rrethina të Ohrit, përmendet edhe në një dokument të viteve 1765-1770.[191] E popullata e quajtur sot *torbeš* e *pomak* jeton pikërisht në hapësirat që në shek. 14-18 quhej "Tokë e Gogëve". Lidhjen e pararendësve të goranëve me popullatën e quajtur *gogë* dhe me regjionin *Gogeria* të shek. 14 me qendër qytetin e Kërçovës e tregon emri *Goginci* i një vëllazërie të katundit Brod të Gorës, emri i së cilës dëgjohet edhe si *Gago*.

Duket se lidhjet e padiskutueshme të goranëve/torbeshëve/ pomakëve/ gogëve me pjesën jugore të Ballkanit, përkatësisht me Maqedoninë e me Greqinë e dëshmojnë edhe emrat e tri vëllazërive: Kërçovci, Sarandovci dhe Mijaçovci, - e para në katundin Vranisht; e dyta në katundin Brod dhe e treta mëhallë e vjetër (e përbërë nga vëllazëritë e quajtura sot Ramadanovci e Abdullovci) në katundin Kërstec i Vogël të krahinës së Gorës. Vëllazëria e parë e ruan emrin e qytetit të Kërçovës në trajtën shqipe të tij gjë që, në vija më të largëta, nuk mund të shkëputet nga emri *Gogeria* "Vend i Gogëve" të Kërçovës me rrethinë; emri i dytë ka të bëjë me një vëllazëri që e kremtonte festën e të dyzet shenjtorëve* ose që ishte e ardhur nga qyteti i Sarandës në Jug të Shqipërisë, në të cilin që në shek. 6 ishte ngritur një kishë e madhe për 40 shenjtorët "Hagioi Saranda", gjurmët e së cilës u asgjësuan plotësisht me rastin e një sulmi nga ajri gjatë Luftës së Dytë Botërore;[192] emri i tretë më duket të jetë i pandashëm nga emri *mijak* i grupit etnik të romanëve ballkanikë- vllehve, i lidhur territorialisht për nga prejardhja po ashtu me jugun e Ballkanit.

Duke u nisur nga rrethana e njohur e organizimit social të vëllazërisë, përkatësisht farefisit mbi bazën e lidhjeve të gjakut në të cilën pothuaj asnjëherë nuk mund të hyjë një i huaj mashkull,** ka shumë arsye të besohet që sa kohë që pararendësit e vëllazërisë *Kërçovci* e sollën këndej variantin shqip *Kërçovë* të qytetit të quajtur sllavisht *Kičevo*, kjo vëllazëri gjithsesi do të ketë bashkëjetuar me elementin etnik shqiptar nga i cili do

[191] Cit. sipas Gl. Elezović, Rečnik. .. II, f. 241.

* Sipas besimit ortodoks, të 40 shenjtorët paskan qenë ushtarë të krishterë në ushtrinë e perandorit romak Licinius. Për shkak të besimit të tyre tek Krishti, guvernatori Agricolae i Armenisë i arrestoi dhe i ekzekutoi rreth vitit 320. Hiri i tyre u hodh në një liqe në Sevastia të Armenisë. Festa e tyre kremtohet ditën e 9 marsit. sipas http:www.aurora-magazin.at/gesellschaft/rum_wolf_brauch.frm.htm, Bräuche zum Frühlingsbeginn, Irina Wolf, më (01. 02. 2007)

[192] http:wikipedia.org/wiki/Saranda.

** Përjashtim nga ky rregull do të bënte rasti, përkatësisht emri sllav Domazet "dhëndër i sjellur në shtëpi" i një vëllazërie shqiptare të katundit Pllajnik të Opojës.

ta ketë përvetësuar variantin shqip të emrit të qytetit ose ishte në krye të herës një vëllazëri shqiptarësh që me të ngulitur në regjionin me banorë sllavisht-, përkatësisht bullgarishtfolës të Gorës u sllavizua me kohë. Emri *Sarandovci* do të tregonte që pararendësit e kësaj vëllazërie do të jenë vendosur në këtë ambient kompakt "goran" nga hapësirat ortodokse greke apo shqiptare të Jugut ose nga *Gogeria* e rrethinave të Kërçovës në të cilën popullata e islamizuar sllavofone quhej nga të tjerët apo vetë kjo e quante veten *pomak, gogë* e *mijak*, jo porse *torbesh*, sepse krahina e Gorës ishte bërë rezervoar i ngulitjes gati si të sinkronizuar të ardhësve vlleh gjuhësisht të bullgarizuar, të quajtur porse (vetëm në literaturë) me emra të ndryshëm: *pomakë, torbeshë, gogë, mijakë*. Në këtë mes bën të shtohet vërejtja që emri *Sarandovci* i vëllazërisë së ngulitur në Gorë nuk mund të jetë në lidhje me aproponimin *Sarandin* të dëshmuar krejt rrallë në hapësirat e Maqedonisë së sotme.[193] Kjo sidomos edhe pse nga një antroponim *Sarandin* do të pritej, në dritën e formimit standard sllavisht të emrave të vëllazërive, një trajtë **Sarandinovci*, çfare asnjëherë nuk del në këtë zonë as si emër vëllazërie e as si antroponim i veçantë.

Çështjes së vendbanimit origjinar të *Sarandovci*-ve goranë do t'i ndihmonte konstatimi nëse tek kjo vëllazëri mund të gjenden dëshmi për kremtimin e ditës së 40 shenjtorëve, ashtu siç ndodh p.sh. tek rumunët. Te këta të fundit, për ditën e 40 shenjtorëve më 9 mars po u gatuaka një ëmbëlsirë e quajtur me emrin sllav "Mučenici". Kjo ëmbëlsirë gatuhet nga një brumë i përzier nga: 1 kg miell 600 ml. ujë mineral dhe 40 gr tharëm buke. Ky brumë, pasi të jetë ardhur, formësohet në tepsi në trajtë të numrit tetë dhe lyhet sipër me të kuq të vesë. Pasi të jetë pjekur, lehet të ftohet dhe, sipas dëshirës, bën të laget me lëng frutash, të lyhet me mjaltë dhe sipër t'i hedhen thelpinj arrash të grira.[194]

Ndonjëri nga këta emra, si p.sh. emri *gogë* vështirë se mund të ndahet nga nocioni *bari,-u*. Kjo sidomos në dritën e mundësisë që tek emri *goga* (e ndoshta edhe gega) tek i cili disa studiues e gjenin kuptimin "kokëtrashë; budalla" të dalur nga mbiemri rumun *gogoaş* mund të jetë kuptim i mëvonshëm. Një kalim analogjik të kuptimit të mirëfilltë *bari,-u* të emërtimit *gogë* e kemi tek zhvillimi kuptimor i termit shqip për bariun. Është paravendim i pranuar deri tani që fjala latine *baro, baronis* në kuptimin "kokëtrashë, që s'ia kap" konsiderohet për shprehje e huazuar

[193] khs. sa psh. bijtë Vlkashin e Oliver të kryefamiliarit *Sarandin*; Gjorgjii, i bir i një *Sarandin*-i tjetër të katundit Odri të nahijes së Tetovës dhe Petko, i bir i *Sarandin*-it në katundin Lisiçan të Kërçovës në vitet 1467-1468, tek Dokumenti za istorijata na makedonskiot narod. .., f. 383, 227.

[194] Sipas http:www.aurora magazin.at/gesellschaft/rum_wolf_brauch.frm.htm.

ilire në Itali e në Ballkan. Ky ilirizëm i latinishtes zbërthehet me fjalën shqipe *bëruo, bërua,* e cila në shqipen e sotme është vazhduar në trajtën *bari,-u*.[195]

Për lashtësinë e emrit *gogë* si distinktiv sinonimik për elementin roman të jugut të Ballkanit: vllehtë, përkatësisht aromunët / cincarët do të fliste rrethana që si nocioni *gogë* ashtu edhe antroponimet *Goga* var. *Gogo* janë semantikisht të barasvlershme me nocionet Roman/ Romanj (khs. emrin *Fusha e Rmajtit* në Shkodër dhe termat *rëmër rëmenj*) që janë reflekse shqiptare të trajtave rumune *romîn*/*aromăn.* Ndryshe, tek bullgarët e tek maqedonasit ky antroponim ndeshet në më shumë trajta të shkurtra se sa tek shqiptarët. Variante bullgare të antroponimit *Goga* janë (*Gjuka*), *Goto, Goca,, Gočo, Gošo*.[196] Varianti *goga* për distinktivin e pranuar gjithandej *vlah* është i përhapur edhe në Kroaci, në Bosnje e në Serbi.[197] Ka një mendim sipas të cilit emri në trajtën *Gogesh* po rrjedhka nga antroponimi *Jakobus*.

Ka arsye të besohet prandaj që emri *goran* është një *nocion për-mbledhës* i vëllazërive vllahe të sllavizuara të ngulitura në kontinuitet në një mikroregjion të quajtur Gora. Karakterin etnik vllah të kryehershëm të të gjitha vëllazërive gorane ardhëse nga regjione të banuara me vlleh të Jugut të Ballkanit e tregon në rend të parë e folmja bullgare e të gjitha atyre vëllazërive të Gorës dhe, mbi të gjitha, mungesa e theksueshme e emrave serbë të tyre të vëllazërive. Kjo e fundit mund të sqarohet vetëm falë organizimit social, fisnor të popullatës josllave e jogreke të jugut të Ballkanit që deri në ditë tonat ruajti shumë nga emra vëllazërish me prejardhje nga latiniteti ballkanik, përkatësisht vllah.

Një segment që do të fliste në të mirë të lashtësisë së ngulitjeve të vllehve nga Jugu i Ballkanit jo vetëm në Gorë, porse edhe në vise të tjera të Kosovës së sotme, është edhe rrethana që as tradita shqiptare e as ajo e asaj pjese të vjetër, të quajtur *rajë* e serbëve të Kosovës, nuk e njeh nocionin torbesh/torbeš për vllehtë e ardhur. Të dyja këto tradita njohin vetëm nocionet, *vllah*, *cincar*, *gogë* për si distinktive të elementit vllah të ngulitur nëpër Kosovë. Nëpër burime të shkruara të kishës serbe të

---

[195] Më gjerësisht për këtë khs. E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, II (A - B), Tiranë 1976, f. 165-167 dhe njësinë Gogovci bashkë me referencat gjegjëse.

[196] Sipas Prof. Dr. Gustav Weigand: Die bulgarischen Rufnamen, Ihre Herkunft, Kürzungen und Neubildungen, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache (Rumänisches Seminar), 15/1909, f. 112.

[197] Kështu, (sipas Rječnik JAZU. .., III, f. 241, 242) në një dokument të shek. XIII në Kroacinë e sotme përmendet një individ i quajtur *Gogan*; në Bosnen e sotme ekziston një katund i quajtur *Gogići*, ndërsa në Vračar afër Belgradit është hidronimi *Gogin bunar* dhe vendet *Goginac* - kroje në vendet Lojanica, Vukasić dhe Zablać të Serbisë.

shekujve XIII-XV ndeshet vetëm termi vllah. Përkundrazi, për si distinktiv për vlleh të bullgarizuar, të konfesionit ortodoks, nëpër Kosovë gjenden vetëm dëshmi për atë pjesë të quajtur *gogë*.

Derisa nëpër burime të shkruara nuk ka as edhe ndonjë shënim për ardhje të ndonjë elementi etnik që do të quhej *torbesh* apo *pomak*, në defterin osman-turk të regjistrimit të kryefamiljarëve të sanxhakut të Shkodrës ka mjaft dëshmi për ardhjen shumë herët e pra edhe për bashkëjetsën dhe bashkështrirjen e vllehve gogë me shqiptarët mikpritës. Në këtë defter ndeshim, midis të tjerësh, edhe kryefamiljarët: *Goga*, i bir i Gjergj-it (banor i katundit Kuç të rrethinave të Shkodrës), *Goga*, i bir i Radiç-it; *Goga*, i vëlla i Nikoll-ës; *Goga*, i vëlla i Gjon-it (banor i katundit Lunik (sot Junik), midis Deçanit e Gjakovës; Bogdan-i, i bir i *Gog*-ës (banor i katundit Shuma të panjohur në rrethina të Junikut); *Goga*, i vëlla i Gjorgj-it (banor i katundit të zhdukur Sredna Çirna Gonja në rrethina të Gjakovës[198]), *Goga***,** i bir i Nenko-s të birit të Progon-it (banor i katundit Vraniq të rrethinave të Pejës,[199] si edhe kryefamiljarin *Gogo*, i bir i *Gogo*-s (banor i katundit Telovdol të Tetovës.[200] në vitet 1467-1468.

Një dëshmi tjetër të përhapjes së gjerë të vllehve *gogë* të jugut të Ballkanit, jo porse të ndonjë krahu të tyre që do të quhej torbeshë, e kemi edhe në shek. XVIII. Nga një shënim i vitit 1773 mësohet që murgu i manastirit të Deviçit i veçonte dhuruesit gogë nga ortodoksët e tjerë, sepse në regjistrin e dhuruesve, *gogët* janë regjistruar veçmas dhe kishte shënuar këtu një vistër njerëzish me profesione të ndryshme - kryesisht kallajxhinj e argjendarë si: Janko *Goga* (nga Prizreni), Marko *Goga*, Jano *Goga* (nga Rahoveci), *Goga* Dina (nga Peja).[201] Ky shënim tregon, më tej, se një pjesë e gogëve e kishte ruajtuar ende, përveç besimit ortodoks, edhe identitetin etnik të tyre. Ndonjë nga antroponimet e tyre (si p.sh.

[198] Kujtoj se duke e pasur për mbështetje emrin aktiv *Lugu i Çarragojs* të mikroregjionit që më vete ngërthen gjashtë katunde: Pacaj, Sheremet, Rracaj, Ripaj, Dallashaj, Madane e Ramoc të rrethinës së Gjakovës; mund të pohohet së në këtë toponim e gjejmë të ruajtur toponimin Çirna Gonja dhe se katundin e zhdukur po me këtë emër të vitit 1485 duhet ta kërkojmë tani në hapësirën e katundit Dobrosh dhe pikërisht mbi bazën e mikrotoponimit *Lugu i Qarragoj's* i cili edhe ndodhet afër vendit të quajtur *Kishza*. Pikërisht ruajtja e kujtimit për kishën, mbase të përbashkët, e përforcon supozimin për ekzistimin e ndonjë katundi më të madh nga i ci1i e muarrën emrin disa katunde që mund të kenë gravituar më parë në këtë qëndër. Një emër shkëmbi *Kërrshi Gog's* gjendet, sipas Prof. Skënder R. Hoxha, Toponimia e Dushkajës, Jakova, 2007, f. 161, edhe në katundin Kralan të Gjakovës.

[199] Sh. S. Pulaha, Defteri. .., f. 386, 183, 164, 190, 310.

[200] Sh. Turski dokumenti za istorija na makedonskiot narod..., f. 376.

[201] Sh. Gliša Elezović, Rečnik kosovsko-metohiskog dijalekta I, Beograd, 1932, 102.

Jano) e tregon mbase edhe prejardhjen nga hapësira e greqishtes, përkatësisht e Ballkanit Jugor.

Derisa përveç rastit të izoluar të emrit familjar Tërbeshi/ *Torbeshi në Gjakovë, emri *torbesh* nuk dëshmohet askund tjetër në hapësirën e sotme të Kosovës. Por, përkundrazi, në këtë hapësirë dëshmohet shpesh emri i gogëve. Kështu p.sh. emri i gogëve dëshmohet në qytetet e Pejës e të Ferizajt në të cilat jetojnë disa familje të quajtura *Goga*, *Gogaj*; për në katundin Bellopojë në veriperëndim të Pejës e kemi edhe mikrotoponimin**Krojet e Gogës* e shënuar në variantin e përkthyer serbisht *Gogine vode* nga A. Đogović,[202] ndërsa në qytezën e Ferizajt është vëllazëria *Gogaj* e cila qenka e ardhur këtu nga katundi i afërm Nikodim që dikur, historikisht, i takone hapësirës që sot e zë qyteza e Ferizajt.[203] Një autor tjetër (serb, me mbiemër me prejardhje shqipe) e ka shënuar për në krahinën e Dukagjinit edhe emrin e vendit *Gogin han*, një arë e një shtëpi në katundin e banuar me serbë, Jellovc të Klinës,[204] ndërsa autori tjetër, S. Stijović, shënonte për në rrethina të Istogut edhe mikrotoponimin *Gogin jaz*, vijë uji në katundin Muzhevinë,[205] po ashtu të banuar nga serbë.

Një dëshmi të ruajtjes së emrit të kryehershëm, si distinktiv i vllehve ardhës në mikroregjionin midis Rahovecit e Suharekës, e kemi tek emri *Gogiq* i një vëllazërie sot sllavishtfolëse të katundit Hoqë të Madhe. Në këtë katund paska qenë edhe një familje tjetër gogësh, e cila në vitin 1966 e paska ndërruar emrin në *Petrović*.[206]

Përveç kësaj familje, vëllazëri me këtë emër ndeshen edhe në katundin Ribar i Madh, jo larg nga vendi me emrin vllah *Magura* në komunën e Lipjanit ku është vëllazëria shqiptare e quajtur *Gogiq't*. Popullata shqiptare i quan *gogë* edhe banorët sllavishfolës të katundit Krushë e Vogël midis Prizrenit e Suharekës, ndërsa në disa vendbanime, në të cilat sot nuk ka ndonjë mikrotoponim apo vëllazëri që e ruan emrin *gogë*, ka mikrotoponime në të cilat në trajtë të shtanguar është ruajtur nocioni *gogë* "vllah". Të kësaj natyre janë p.sh. mikrotoponimet *Kodra e Ali Gog's* në katundin Çeskovë të rrethinave të Pejës; *Ara e Gogës* në

[202] Sh. Alija Đogović, Toponimija jugoslovenskog dela Prokletija (I Deo), Onomatološki prilozi, IV, SANU, Beograd, 1983, f. 230.

[203] Sipas, Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpca, Prishtinë, 2004, f, 68

[204] Mileta Bukumirović, Onomastika Prekoruplja II, Onomatološki prillozi III, SANU. Beograd 1982 f. 337.

[205] Khs. Svetozar Stijović, Onomastika središnjeg dela Metohijskog (Pećkog) Podgora, Onomatološki prilozi II, Beograd, SANU, 1981, f. 256.

[206] Khs. Mileta Bukumirić: Iz onomastike južne Metohije, në Onomatološki prilozi V, SANU, Beograd 1984, f. 465.

katundin Nagavc të Prizrenit; *Lisi i Gogës* në katundin Golluboc (në hapësirën e quajtur në vitet 1313-1318 për *vlaška zemlja* "Toka, Vendi i vllehëve" me qendër katundin e sotëm Kievë të komunës së Klinës e, mbi të gjitha emri *Vorret e Gogës* në katundin Blaç të krahinës së Opojës.

Se tradita shqiptare nuk njeh ndonjë dyndje vllehsh të Ballkanit Jugor me emrin librar *torbesh* e tregon mungesa e këtij termi për emërtimin e entitetit vllah si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipërinë e Veriut. Në disa vendbanime të kësaj hapësire, si p.sh. në katundet Zagore e Iballe të mikroregjionit Nikaj - Mërtur ndeshen në përdorim aktiv antroponimet si *Gogë*/*-,a* m.; *Gogliq*/*-i* m. *Goge*/*-ja* f.[207] Krahas ruajtjes së këtyre antroponimeve, popullata e kësaj zone po e ditka që emri *gogë* e paska kuptimin "rumun; vllah." Edhe banorë të vjetër të qytetit të Tiranës e dinë, sipas traditës, që gogët paskan qenë përgjithësisht kallajxhinj dhe që këta e paskan folur një gjuhë, për shqiptarët të pakuptueshme prandaj sidomos nga fëmijët këta quheshin me termin onomatopeik "llaci - faci".[208]

Pa i pas afruar shprehimisht, për të një brumi etnik dhe për popullatë me të njëjtin fat historik me goranët, përkatësisht me torbeshët, ndonjë dijetar i mban edhe pjesëtarët e grupit etnik të mijakëve. Kështu, në librin e tij monumental për Ballkanin, dijetari serb J. Cvijić shkruante edhe se "Goranët kanë ngjashmëri me mijakët (torbeshët) e Rekës së Vogël, degë e majtë e Radikës". Përkrahës së mësimeve me tendencë serbomadhe të Cvijić-it i mbajnë mijakët e viseve në jug të Vardarit për serbë, sado që pohojnë se mijakët u takonin në krye të herës fiseve mesjetare maqedone të mijakëve dhe të bërsjakëve.[209]

Në të mirë të ndonjë lidhjeje etnike të goranëve me mijakët e Maqedonisë, kosovari H. Meleqi[210] e sjell emrin "Ura e Torbeshit" që gjendet midis krahinës së Gorës dhe regjionit të Radikës. Për mijakët, Cvijić thoshte se po e fliskan "dialektin serb-dibran", për të vazhduar me konstatimin: "Më duket se mijakët (torbeshët) janë islamizuar në të njëjtën kohë kur edhe goranët në Shar" dhe së fundi "Krahina e mijakëve ishte, në të kaluarën, e populluar nga blegtorë aromunë nëpër vendbanime sezonale verore; në mesjetë aty depërtuan sllavët dhe kështu u përzien".[211] Po këtë tezë e mbron edhe gjuhëtari maqedonas Blaže

[207] Sipas Zef Dukagjini, Antroponimikë nga Shqipnija e Veriut, Dorëshkrim në Institutin për Kulturën Popullore, Tiranë, Inv. Nr. 296/26, Dosja 21.

[208] Komunikim me gojë i të ndjerit Prof. Anton Çetta.

[209] Khs. përr këtë Projekat Rastko Gračanica - Peć: Istorija: Stara Srbija, geografska i etnografska slika, 1912.

[210] Khs.Opoja dhe Gora (Komuna e Dragashit), Vështrim gjeografik, Dragash, 194, f. 51.

[211] Balkansko poluostrvo, Južnoslovenske zemlje, Beograd 1966, f. 488, 491, 493 dhe 494, cit sipas Hajriz Meleqi, Opoja dhe Gora,. .., f. 50.

Koneski i cili mijakët i mban po ashtu për sllavë, jo për serbë, porse për maqedonasit të islamizuar dhe konstaton po ashtu në dëm të hipotezës aprioristike të vet se ndër emra të vjetër të tyre të vëllazërive kishte edhe emra vlleh si *Drakulevci*, *Kuculovci*[212] e ndonjë tjetër. Pikërisht ekzistimi i emrave vlleh të vëllazërive, kështu kujtoj unë, flet në të mirë të paravendimit që edhe mijakët ishin e janë pjesë e korpusit etnik të romanëve ballkanikë të sllavizuar (si edhe goranët, torbeshët, pomakët, gogët) dhe folës të bullgarishtes, përkatësisht të maqedonishtes.

Ky grup etnik (mijakët) i Maqedonisë Perëndimore jeton në viset malore përreth rrjedhës së mesme të lumit të Radikës dhe merret kryesisht me blegtori. Vendbanimet kryesore të mijakëve janë Lazaropolje, Galičnik, Selce, Rosoki, Osoj, Gari, Sušica e Tresonče, të cilat po zbrazen përditë për shkak se të rinjtë po zbresin nëpër qytete. Disa nga mijakët janë shpërngulur në krahina të tjera si p.sh. në katër katunde të rrethit të Dibrës, në rrethina të Velesit, të Manastirit, Smiljevës e të Kërçovës.

Mijakët flasin edhe sot maqedonisht dhe janë pjesëtarë të besimit ortodoks, përkatësisht i përkasin kishës ortodokse (të papranuar) maqedonase. Njihen për mjeshtër e artistë të mirë, sidomos për vizatime të shkëlqyeshme të ikonave e të freskave dhe për drugdhendje (manastiri i shën Gjonit në Bigor). Një pjesë e mijakëve e pranoi islamizmin prandaj mijakët e tjerë, që e ruajtën ortodoksizmin, i paskan quajtur ata *torbeshë*, përkatësisht si të tillë "që e shitën besimin për një torbë".[213]

Një vendbanim i mijakëve do të jetë edhe katundi *Mijači*, në komunën e Valjevos të distriktit të Kollubarës (Serbi), një zonë kjo në të cilën ka edhe sot popullatë vllahishtfolëse.

Dialektologu kosovar Mehmet Halimi e gjurmoi të folmen e një katundi të quajtur *Mjak* të Malësisë së Karadakut, përkatësisht të komunës së Vitisë, në kufirin aktual midis Kosovës e Maqedonisë, lidhja e të cilit me mijakët që u përmendën më sipër mbase nuk mund të vihet në dyshim. Sipas kujtesës kolektive, banorët e kryehershëm të këtij katundi qenkan të ardhur para rreth 150 vitesh nga krahina e Lumës (Kukës, Shqipëri). E folmja e këtij katundi, me gjithë përkimet me të folmen e katundit fqinj të Tanishecit, ka disa veçori të mëvetëshme. As në leksikun blegtoral e as në mikrotoponiminë e katundit Mjak[214] nuk ka ndonjë element që do ta tregonte ardhjen apo ndonjë afrim të tyre me elementin etnik sllavofon, ortodoks e mysliman, të mijakëve, përkatësisht

[212] Khs. Makedonski Mesta i imenja, NIO, "Studentski zbor", Skopje, 1991, f. 24.
[213] http://hr.wikipedia.org/wiki/Mijaci"
[214] Khs. Mehmet Halimi, Skicë e së folmes së fshatrave Mjak dhe Tanishec, "Kërkime dialektologjike", Prishtinë, 1985, f. 353 - 376.

të torbeshëve përveç që ky katund është fqinj me katundin *Korbuliq* - emri i të cilit është me prejardhje vllahe nga *corb,-ul* zool. Corvus corax "korb". Kjo do të thoshte, në vija më të largëta, se këtu kemi të bëjmë me një shqiptarizim të përmbyllur kaherë të elementit etnik vllah.

Është çështje që duhet të shihet përse nga e gjithë kjo masë unike e të islamizuarëve sllavofonë dija e sotme bullgare/maqedonase i ndau goranët, të cilët nuk janë aspak më të ndryshëm nga pomakët as në rrafshin e prejardhjes së kryehershme të tyre josllave e as me doke e zakone, me bestytni e me veshje dhe me muzikë.

Në këtë kontekst nuk mund të lehet anash as emri "poturi". Së pari duhet të themi që kjo trajtë e shumësit të fjalës "potur" (nga serb. /kroat) ka hyrë në shqipen dhe ka mbetur aty e shtanguar duke mos iu nënshtruar ligjeve fonetike të kësaj gjuhe, për shkak të izolimit skajshmërisht të saja fjale. Në serbishten e në kroatishten "potur", "poturica" e ka kuptimin tradhtar, renegat ose të atij që ia ka kthyer shpinën besimit të krishterë; turkoshak". Sipas Ejup Mušović-it, fjalët "poturice", "poturi", "poturčenjaci" nënkuptojnë të gjithë të islamizuarit e hapësirave të sllavëve jugorë, pa e marrë parasysh përkatësinë etnike ose konfesionale të tyre, duke i përfshirë këtu edhe goranët dhe sidomos torbeshët.[215] Në vazhdim të trajtesës së vet, S. Idrizi e shfaq mendimin se me nocionin *potur* autori boshnjak Enver Imamović nuk i nënkupton as muslimanët e as të krishterët dhe se krahasimi nga ai i termave "poturi - patarin" është i pambështetshëm.

Duket se regjioni malor i hapësirës së banuar nga apo edhe nga popullata që e mban veten për gorane, pomake, torbeshe ishte bërë në shek. 14-15 një rezervoar i tubimit në një hapësirë të elementit vllah të sllavizuar gjuhësisht në hapësira të Bullgarisë e të Maqedonisë së sotme, si edhe i ndonjë elementi tjetër i ardhur këndej si bashkësi blegtorale turke. Kështu do të ketë ndodhur mbase edhe me pjesëtarë të grupit etnik të kumanëve e të jurukëve aziatikë, çfare sot paska ende nëpër pjesë të Maqedonisë.*

Me plotë të drejtë mund të thuhet se, për sa i bie pranisë së mundshme të bogumilëve në hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve, nuk ka asnjë dokument që këtë prani do ta dëshmonte shprehimisht. Në asnjë dokument kishtar serb nuk është shenjuar ndonjë popullatë me emrin *bogumil*, *pataren*, *kuduger*, *funda*, *pomak* e aq më pak me emrin *torbesh*. Madje as në njoftimin më të gjatë e më të hollësishëm për regjionin e Gorës që e

[215] http://bs.wikipedia.org/wiki/Torbe%C5%A1i".

* Më gjerësisht për këtë sh. trajtesën Mendime rreth dy minoriteteve mesjetare të shuara të Kosovës: "Kumanët e Jurukët".

kemi deri më tani, përkatësisht në krisobulën e vitit 1348 të sundimtarit serb Stefan Dushan, nuk ka ndonjë shënim për praninë e ndonjë popullate të ardhur, të ndryshme nga ajo vendorja. Nëpër burime kishtare serbe ka, ç'është e drejta të dhëna për popullata të sjella për interesa të ndryshme në hapësira të cilat shteti serb në ekspansion synonte t'i bënte për të vetat. Nga burime të kësaj natyre mësohet për sjelljen nga sundimtari serb Stefan Milutini të disa mijëra kumanëve[216] aziatikë, ndërsa pararendësi i tij Vladislav i kishte sjellë sasët gjermanë e raguzasit romanë. Nuk ka porse asnjë dëshmi të shkruar për sjelljen këndej të etnive blegtorale të stepave apo të ndonjë popullate bullgarishtfolëse. Nga lënda onomastike e përmbajtur në atë pjesë të dokumentit të vitit 1348 që ka të bëjë me Gorën, mësohet se në gjithë këtë hapësirë kishte vetëm diç më shumë 3 priftërinj dhe po aq kisha për të cilat dihet se ishin nën juridiksionin e kishës ortodokse serbe. Gjykuar mbi bazën e materialit onomastik të përmbajtur në këtë dokument, vërehet porse se ka një vazhdimësi deri në ditë tonat të disa emrave të vendeve e të vëllazërive që dëshmohen në vitin 1348. Mbi bazën e gjendjes së këtillë do të mund të nxirrej përfundimi që popullata e Gorës ishte aty shumë kohë para lindjes së këtij dokumenti, përkatësisht para shek. XIV. Do të mund të pritej që, sikur popullata sllavofone e Gorës të ishte e ardhur nga vise bullgare pas shek. XII, ajo do të duhej të shënohej për si e tillë edhe në dokumentacionin kishtar serb - ashtu siç kishte ndodhur p.sh. me vendbanimin *катунь бьlgarski*[217] "katuni i bullgarëve" - siç është dëshmuar në vitet 1313-1318 të jetë quajtur katundi i sotëm Bugariq (serb. Srbobran) i rrethinave të largëta të Mitrovicës. As në regjistrimet osmane-turke të fillimit të shek. XV nuk ka ndonjë shënim tekstual historik apo të dhënë onomastike që do ta dëshmonte praninë e ndonjë popullate të cilësuar për bogumile, përkatësisht të ndonjë popullate që do të ishte e ndryshme nga ajo vendorja. Përkundrazi, ka disa raste që në burime të kësaj provenience dëshmohen banorë të cilët në vend të patronimit të mirëfilltë e mbajnë artibutn, *bullgar* ose i bir i *bullgarit*.[218] Nëse personat e tillë duhet të trajtohen mbetje të ekspansionit të

[216] Sipas Čedomilj Mijatović, "Studije za istoriju srpske trgovine", Glasnik Srpskog Učenog Društva, 37, Beograd, 1873, f. 220.

[217] Khs. Lj. Kovačević, Svetostefanska hrisovulja, Spomenik 4, Beograd, 1890, f. 8.

[218] Khs. p.sh. Radisllav Bulgari dhe Radislav-i (tjetër), i bir i Pogrkov -it "i bir i të greqizuarit."- banorë të katundit Hiravica (Rahovicë, Ferizaj); Radivoj-i, bullgar, banor i kat. Berkovce, i paidentifikuar; Gjura, i bir i Bullgarit, banor i kat. Drobnjaci, Drobnjak (sot Dramjak, Ferizaj); Milladin, Bullgari, banor i kat. Devajë; Bogosllav, i bir i Bullgarit, banor i kat. Rashincë; Radica, i bir i Bullgarit, banor i kat. Sferičina (Svërçin, Lipjan); Rashko, i bir i Bullgarit, banor i kat. Oshlan; Pava, i bir i Bullgarit, banor i kat. Besino (Besi, Podujevë); të dëshmuar në regjistimin e vitit 1455 khs. Oblast Brankovića …, f. 168, 298, 128, 141, 142, ?, 87, 345.

Perandorisë Bullgare të shekujve X-XII në hapësirën e sotme të Kosovës apo shpërngulje jo e vogël e popullatës ortodokse nga Bullgaria në krijesën shtetërore të Serbisë ortodokse, pse shteti mesjetar i Bullgarisë ra më herët nën pushtetin e osmanlinjve,[219] mbetet çështje që duhet të shihet.

Konstatimet e mësipërme tregojnë se teza e prejardhjes bullgare të goranëve mbështetet, megjithatë, në argumentet më të forta të mundshme, përkatësisht mbi karakterin bullgar të së folmes së goranëve dhe mbi veçoritë e kulturës materiale e shpirtërore të tyre. Në këmbë më të ligështa argumentuese qëndron lidhja e kësaj popullate me bogumilët. Kjo sepse kjo tezë mbështetet pothuajse vetëm tek prejardhja, kuptimi dhe barazimi i pambështetur etimologjikisht i nocioneve *torbeš*, *babunë*, *pomakë* etj. me distinktivin përmbledhës *bogumil*. Përveç kësaj, nga materiali relativisht i bollshëm onomastik i përmbajtur në burimet kishtare serbe të shek. 13-14 dhe sidomos në ato edhe më të bollshme të regjistrimeve/kadastrimeve osmane të hapësirës etnolinguistike kompakte të shqiptarëve të viteve 1455 e 1485 nuk ka asnjë dëshmi të ketë pasur këndej ndonjë *torbesh*, *pomak* apo (siç i paska quajtur kisha e administrata serbe bogumilët) *babun* e aq më pak në kohën kur Kosova e sotme ishte despotat i vazalit serb Vuk Brankoviq të pushtetit osman.

Në këtë mes do të duhej të shtrohej, megjithatë, pyetja nëse popullimi me vlleh të bullgarizuar nga Rodopet dhe nga vise të sotme të Maqedonisë ndodhi si rezultat i politikës së shtetit bullgar të shek. XII me qëllim të bullgarizimit të viseve të pushtuara; si rezultat i shkapërderdhjes së vllehve bogumilë të përndjekur nga shteti e kisha bullgare apo nëse vendosja e elemtit roman-ballkanik përkatësisht vllah i Jugut të Ballkanit në viset malore të hapësirës etnolinguistike të shqiptarëve ishte pjesë e rezultat i "romanitetit në lëvizje" të blegtorëve nomadë apo edhe transhumanë romanë ballkanikë.

Se popullata sot sllavofone e Gorës nuk është homogjene në pikëpamje të emrit të përgjithësuar që e mban, e tregon edhe emri *Shop* i një vëllazërie të katundit Brod të Gorës. Emri i kësaj vëllazërie duket të jetë i pandashëm nga emri etnik i shopëve, sllav. *Šopi* ose *Šopovi*. Për territor gjallnimi të shopëve merret hapësira që ngërthen viset e ish-trekufirit midis Serbisë, Bullgarisë e Turqisë duke i përfshirë edhe viset fqinje në Serbi (trevat rreth Pirotit) dhe në Bullgari (trevat rreth Sofjes, Grykës së Iskrit dhe të Dupnicës) pastaj në "Serbinë e Vjetër" e cila konsiderohet për hapësirë qendrore e tyre që shtrihet nga Ovče Polja drejt Pirotit. Këtë hapësirë bullgarët e serbët po e quajtkan *Šopluk* ose *Šopsko*. Popullata e

[219] http:bs.wikipedia/wiki/Bugarska – Historija.

këtij regjioni qenka për nga prejardhja, popullatë e përbërë nga përzierja e sllavëve, peçenegëve e vllehve.[220] Shopët quhen ndryshe edhe *torlak*-ë. Këta e flasin një dialekt që njihet për si "dialekt torlak". Kjo idiomë flitet, si halplotiv* sllav, në regjionin e njohur në literaturë si Vranja e Epërme (Nečista krv, "Gjaku i papastër"). Përveç në Vranjën e Epërme, njerëz që e quajnë veten *shopë* paska edhe rreth Liqenit të Vllasinës. Për të folmen e shopëve, përkatësisht të torlakëve, Rikard Simeon,[221] sqaron se emri *torlak* është i lidhur me emrin e një regjioni bukur të madh përreth qytetit të Pirotit. Termi *torlak* e paska kuptimin "njeri që nuk e flet pastër as bullgarishten e as serbishten". E folmja e tyre po u afruaka, me shumëçka, me bullgarishten. Këtu e ka burimin edhe mendimi i aprovuar gjerë sipas të cilit këtu paskemi të bëjmë me një të folme sllavojugore "të bullgarizuar". Kjo sepse, torlakët ose shopët qenkan etnikum i mëvetshëm sllavojugor i cili, për shkak të zhvillimeve historike, e paska humbur identitetin etnik dhe sot qenka, prandaj, i ndarë midis Bullgarisë, Serbisë e Maqedonisë dhe, varësisht në cilin nga këto tri shtete jetojnë, (duke i përjashtuar qytetet e Dimitrovgradit e të Bosilgradit, qëkur u bënë ndryshime të kufijve në favor të Serbisë) sot konsiderohen për bullgarë, serbë apo për "maqedonas".

Për ndonjë afri gjenetike midis shopëve e goranëve do të fliste edhe rrethana që "Krejt ajo që linguistët serbë e quajnë dialekt serb të Prizrenit-Timokut" qenka në të vërtetë një *better classified* e dialektit torlak/shop. Edhe goranët (po ata të cilët ju mbarojnë petë e byrek e që mendoni se janë shqiptarë!), si edhe *kraşovan*-ët në Rumani, e flasin të njëjtin grup të folmesh që nga jugu i Zaječar-it dhe kryesisht në lindje të Kuršumlija-s. Pa u larguar nga hapësira origjinare e shpërnguljes së pararendësve të goranëve /torbeshëve/ pomakëve /gogëve të hapësirën e sotme të Gorës, mbi të gjitha në të mirë të prejardhjes josllave të kryehershme, do të duhej përmendur edhe paravendimin sipas të cilit shopët po përbëkan sot rreth 70% të kombit maqedonas, ndërsa pjesa tjetër po rrjedhka nga fisi i vjetër serb Bërsjak-ët. Bile shopët dhe e folmja e tyre qenkan themeli i kombësisë dhe i gjuhës së sotme letrare të maqedonishtes të cilat i paska krijuar pushteti komunist. Formimi i "gjuhës maqedonase" paska qenë diktat i nevojës që ajo farë gjuhe të dallohet si nga serbishtja letrare ashtu edhe nga bullgarishtja letrare. Së këndejmi, maqedonishtja e sotme qenka, me disa elemente e afërt me

[220] Projekat Rastko Gračanica - Peć: Istorija: Stara Srbija, geografska i etnografska slika 1912.

* = e folme alternative, lokale.

[221] Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva, II, Zagreb, 1969, f. 622.

serbishten (në leksik) dhe me bullgarishten (në gramatikë). Në këtë kohë po rënka edhe formimi i mbiemrave familjarë (të maqedonasve) me prapashtesën *-ski*. Së këndejmi, pjesëtarë të të njëjtit bark, farefis mbajnë mbiemra me prapashtesa në tri variante: me : *-ić*, *-ski*, *-ov*.

5. GJENDJA E SOTME DHE TEZA E BARAZIMIT BOGUMIL - TORBESH - GORAN - BOSHNJAK; POTUR

Autorë bashkëkohorë që kohëve të fundit po merren me çështjen e përcaktimit të prejardhjes etnike të popullatës sllavofone të Gorës, jo vetëm e kanë aktualizuar sinonimin *torbesh* për *goran* duke e lidhur këtë me lëvizjen e bogumilizmit të pararendësve të boshnjakëve të sotëm (shek. X-XII), porse këtë sqarim po e shtënë në punë edhe për ta mbështetur tezën e tyre, sipas së cilës pararendësit e goranëve të sotëm na qenkan bogumilë nga hapësira gjuhësore e bullgarishtes. Kjo sepse, siç shkruan Sadik Idrizi,[222] "Edhe në këtë korpus etnik ka shenja të ristrukturimit nacional e gjuhësor të (kësaj) bashkësie shumicë etnike. Veçori specifike më vete paraqesin të folmet e popullsisë në hapësirën e Maleve të Sharit, në kuptimin më të ngushtë të folmet e Gorës e të Zhupës dhe, në kuptim më të gjerë të folmet e gjithë regjionit të Maleve të Sharit në izoglosën Prizren-Kukës-Dibër-Radikë-Mavrovë-Tetovë. Në kohë të kaluara, popullata e regjionit të Gorës e të Zhupës që u deklarua herë për turke, serbe, serbe e vjetër, maqedonase e madje edhe bullgare, është quajtur porse edhe me emra të tjerë: torbeshë, "našinci"; janë trajtuar për si "të papërcaktuar" si "myslimanë (ose si myslimanë sllavë), si serbë të besimit mysliman. Kështu ishte deri në vitet e tetëdhjeta të shekullit 20, ndërsa më vonë u deklaruan, kryesisht, për si boshnjakë (në regjistrime e në komunikimin jetësor të përditshëm), sado që një pjesë e vogël syresh u orientua kah Serbia dhe opsioni nacional serb, disa të tjerë kah opsioni maqedonas e bullgar dhe, kohëve të fundit, edhe kah opsioni turk. Ky fenomen nacional në hapësirat e Maleve të Sharit është ende i diskutueshëm edhe në vetë korpusin popullor dhe në shkencë. Që nga Jastrebov-i e M. Lutovac-i pati në qarkullim shumë teori, porse ato u bartën në arkivin e programeve të shkuara politike me qëllime të asimilimit e të konverzionit."[223] (SG. : konvertimit)

Sot gjendja është sa vijon: Goranët, pa përjashtim, i takojnë besimit islam. E folmja e tyre sot është sllave, përkatësisht me veçori mbizotëruese të bullgarishtes. Muzika popullore dhe instrumentet muzikore të goranëve, sidomos *surla* e *tupani* janë, në mos identike, atëherë së pakut

[222] Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k -.
[223] Po ai, po aty.

fort të ngjashme me ato të fqinjëve të tyre shqipfolës të krahinës së Opojës. Goranët e kanë pothuaj po atë veshje si edhe fqinjët e tyre opojarë shqipfolës dhe po atë të shqiptarëve e të goranëve të rrethinës së Kukësit (në Shqipëri) si edhe atë të shqiptarëve të Malësisë së Tetovës. H. Meleqi na mëson p.sh. se burrat goranë bartin në kokë kësulë të bardhë leshi, të ngjashme për nga forma (e rrafshtë) me kësulën që e bartin shqiptarët në krahinën e Lumës dhe banorët e katundit shqiptar të Zhurit.[224] Kjo rrethanë jashtëgjuhësore dëshmohet edhe në katundin Reçan të rrethinave të Prizrenit (khs. më poshtë) që lë të kuptohet se ardhësit sllavofonë erdhën në hapësirën e sotme të Kosovës në një kohë, mbase plotësisht si kjo e sotmja dominonte elementi etnik shqiptar i para kohës së islamizimit të tij. Sikur Kosova e sotme e shek. XII-XIV të kishte qenë e banuar nga serbë, popullata gjithsesi ortodokse e ardhur këndej nga hapësira etnike bullgare-maqedonase nuk do të kishte nga kush të huazonte në mos të tërën, së pakut pjesë nga veshja dhe nga muzika e shqiptarëve. Thënë shkurt, vështruar në aspektin etnografik, goranët nuk kanë gjë të përbashkët në muzikë, në veshje e në besim as me bullgarët e lere më me serbët apo me boshnjakët. Në rrafshin etnografik, këta janë shqiptarë, ndërsa në aspektin gjuhësor, thënë në përgjithësi, bullgarë. Për shkak të lëkundjes së tyre se cilit etnos në të vërtetë i takojnë, goranët kanë qenë dhe janë objekt që për shumë kohë janë përdorur për Kal Troje e për Kolonë e Pestë përbrenda territorit gjuhësor të shqipes: një kohë për bullgarët, serbët e pastaj për maqedonasit.

Kohëve të fundit, sidomos pas mbarimit të Luftës për Kosovën (1999), goranët janë bërë objekt i luftës propagandistike për përfitimin e tyre midis Serbisë e, për çudi, edhe të Bosnjës myslimane. Këtë e ilustron mirë pohimi i studiuesit, ish-ministër i shëndetësisë në qeverinë e Kosovës, Sadik Idrizi: "Ndodhi diçka e pabesueshme. Në një hapësirë kaq të vogël (me nja 30 katunde) një e i njëjti popull mëson shkolla në tri gjuhë - serbisht, shqip, maqedonisht. I mëson tri kultura e tri histori por që, në këtë mes, nuk mëson asgjë për veten. Shkolla serbe u hapën në Brod e në Restelicë në vitin 1912, ndërsa më vonë (mdis dy Luftërave Botërore) edhe në Vranisht e në Rapçë. Më së pari shkolla shqipe ishin hapur në Shishtavec (1924), në Zapod (1927) dhe në Borje (1928). Shkolla maqedonase u hapën në Urviç e në Jalovjan gjatë Luftës së Dytë Botërore. Vetëm pas Luftës për Kosovën (1999), nisën përpjekjet që në pjesën kosovare të Gorës të fillonin nga puna edhe shkollat në gjuhën

[224] Mr. Hajriz Meleqi, Opoja dhe Gora (Komuna e Dragashit) Vështrim gjeografik, Dragash,1994, f. 51.

boshnjake, sado që në disa ambiente ishte e madhe rezistenca që vinte në rend të parë nga punëtorë të arsimit të paguar nga qeveria serbe. Gjë krejt e kuptueshme. Ata që e kishin përjetuar dekadën e tëhujësimit nuk mund të dilnin jashtë kallëpit ideologjik. Shumë sish e identifikuan veten me librat që i kishin lexuar".[225] - thotë autori ynë.

Sipas "shkollës boshnjake" që po synon ta përligj tezën e lansuar në shërbim të "boshnjakizimit" gjuhësisht të të gjithë myslimanëve (punë kjo që pothuajse e mbaroi me shqiptarët në krahinën e Sanxhakut dhe me Plavën e me Gucinë) në Ballkan, studiues - kryesisht kosovarë sllavisht-folës - ia kanë mësyrë tani edhe boshnjakizimit të goranëve dhe të gjithë banorëve joshqiptarë të zonës së Maleve të Sharit. Në shënjestër të autorëve militantë boshnjakë janë tani, pra, banorët e krahinave të Gorës, të Zhupës dhe të Podgorit të Prizrenit. Të gjithë këta (natyrisht duke përfshirë edhe sish që po jetuakan edhe në hapësirën e qyteteve shqiptare të Pejës e të Istogut, në Mitrovicë si dhe në Prishtinë, në Ferizaj e në ndonjë qytet tjetër të Kosovës) qenkan, për këta studiues "boshnjakë me prejardhje autoktone".[226] Kjo popullatë autoktone myslimane, pra "boshnjake", përkatësisht goranët, po u quajtka edhe me emrin *torbeš* që këta po e ndjekan për emër përbuzës.

Kjo sepse të gjitha popullatat e gjithë zonës së Sharit qenkan popullatë autoktone* ballkanike e lashtë me prejardhje të njëjtë apo të afërt. Mirëpo, si për çudi, pikërisht ithtarët e panboshnjakizmit në Ballkan pranojnë se më e madhja për nga numri në këtë hapësirë do të ketë qenë popullata me prejardhje aromune (vllahe). "Kjo tezë dëshmohet në shumë rrafshe edhe në terren, edhe në shkencë, prandaj ka gjasë që popullata e këtij brezi gjeografik-etnik e ka prejardhjen nga etnosi lashtoballkanik, trak, e më tej edhe nga ato grupe (etnike) që shumë kohë para erës sonë erdhën nga Lindja, u infiltruan në bashkësitë e lashta ballkanike dhe u asimiluan".[227] E gjithë kjo hipotezë po u dëshmuaka edhe nga regjistrimet osmane-turke të popullsisë, të bëra menjëherë pas pushtimit osman të Ballkanit, nga të cilat po rezultuaka se këndej mbizotëronte "sistemi antropologjik aromun (vllah) dhe se ky u rezistonte ndikimeve bizantine

[225] S. Idrizi, Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k -

[226] Sipas http; bs. Wikipedia.org/wiki/Bo% C5%, A1njaci_ Kosova.

* Termi "autokton" për elementin sllav të ardhur si pushtues i krishtenizuar së pakut trekatër shekuj para ardhjes së tyre dhe themelues të shteteve të tyre në hapësirat e autoktonëve të mirëfilltë dardanë e trakë të Ballkanit duhet të merret me shumë rezervë sepse sllavët, përveç rrënimit, nuk kanë asgjë të përbashkët me kulturën antike të Ballkanit.

[227] Nga http; bs. Wikipedia.org/wiki/Bo% C5%, A1njaci_ Kosova.

e romake - sidomos atyre fetare-konfesionale (krishterizimit me dhunë dhe raporteve sociale feudale). Kjo e dëshmon, më tej, tezën që në kuptimin fetar, konfesional e gjithë popullata e Trakisë së dikurshme (nga Janina në Greqi, deri në Gjerdap në veri - përfshirë këtu sistemin malor të Rodopeve e të Maleve Dinarike, në perëndim deri përtej Bosnjës e pjesërisht edhe të Kroacisë) - ishte vllahe, bogumile",[228] gjë që - sipas tezës panboshnjake, panmyslimane, do të duhej kuptuar si një zonë që më shumë se gjithçka tjetër po u dashka të ketë qenë e lidhur dhe e pandashme nga boshnjakët e ditëve tona. Dhe kjo lidhje po u dashka të shihej si pasojë e paravendimit agresiv sikur bartës të lëvizjes bogumile të na paskan qenë pararendësit e boshnjakëve të sotëm në ofensivë.

Prepotenca naive e bartësve të tezës që pikërisht boshnjakët e sotëm myslimanë po u dashka të shihen për vazhdues të tharmit të vllehve, të bogumilëve bullgarë shprehet në hipotezën e lansuar nga autorë kosovarë sllavishtfolës se bogumilët na qenkan strehuar në Rodope, në Malin Ballkan, në Malet e Sharit, në Bjeshkët e Nemuna e në ato Dinarike ku ata i paskan rezistuar për kohë të gjatë krishterimit.[229] Që kjo "pjatë fluturuese" të gjejë vend për aterim në tokën e realitetit, autorët e kësaj teze propagojnë se në këtë kontekst po biekan edhe *bogumilët* në Sanxhak, në Bosne-Hercegovinë e në Mal të Zi - pra gjithandej kah ka sot popullatë të besimit islam, pa marrë parasysh p.sh. se pjesa dërmuese e popullatës myslimane e Sanxhakut dhe ajo e Plavës e Gucisë në Malin e Zi të sotmin është në pjesën më të madhe të saj (sikundër e tregojnë edhe emrat shqip të vëllazërive, veshja nacionale shqiptare dhe reliktet gjuhësore, substratike, shqipe në të folmet e popullatave të këtyre regjioneve) me origjinë të kryehershme shqiptare.

Sado që nga militantë politikë, të veshur me petkun e filologjisë, konstatohet se "situata gjuhësore e këtij regjioni paraqet, në kuptimin e gjerë të saj, standarde të ndryshme [...] tipi goran i së folmes (me qendër Dragashin) mund të ndahet në dy nëndialekte ose tipe të së folmeve (të Sevcës së Epërme - regjioni i Goroištës dhe të Sevcës së Poshtme – rajoni i Doloištës). Vija ndarëse midis këtyre tipeve të të folmeve është në lindje të Dragashit. Dallimet midis këtyre dy tipeve janë kryesisht fonologjike [...]" dhe përdorimi i parafjalës *vь* në vend të *u* "në". Në pjesën maqedonase të Maleve të Sharit vërehen ndikime të nduarnduarshme të maqedonishtes, prandaj gjuhësia maqedonase i mban këto për të folme të maqedonishtes veriperëndimore.[230]

[228] Po aty,
[229] Sh. Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k -
[230] sipas Historija kosovskih bošnjaka bs.wikipedia.org/wiki/Bošnjaci_Kosova - 32k –

Propaganda e sotme boshnjake për përvetësimin e goranëve mbi bazën e bogumilizmit nuk është aspak më e ndryshme se tentimi i viteve të fundit të shek. 20 kur "nën sugjerimin e arabëve u lind një tezë, e cila la në hije të gjitha interpretimet e deriatëhershme të prejardhjes së pomakëve. Sipas këtij interpretimi pomakët po e heqkan prejardhjen nga të dërguar pejgamberë të vetë profetit Muhamet, të cilët me urdhër të tij paskan ardhur në Ballkan qysh para ngulitjes këndej të sllavëve e të turqve në mënyrë që këndej ta përhapnin fjalën e Allahut. Kësisoj në këtë kontest u përzier tani edhe një "lojtar" tjetër i cili synon që pomakët t'i nxjerrë pasardhës të arabëve, madje konkretisht për si pakistanezë", konstatonte Valery Stojanow. Kjo mitologemë nuk mund t'i bëjë ballë asnjë kritike serioze. Kësaj duhet porse, përkundrazi, t'i kushtohet vëmendje serioze sepse "kufijtë e besimit islam[231] i "vizaton" ashtu si-kundër i paska paracaktuar vetë Profeti". Sado pa ndonjë lidhje me gjuhësinë, onomastikën e me etnologjinë, në këtë mes duhet theksuar që edhe qytetarë të rëndomtë boshnjakë ëndërrojnë për një hapësirë institucionale, politike: Bosnja, pjesët e Sanxhakut në Serbi e në Mal të Zi, Shqipëria, Kosova, pjesa shqiptare e Maqedonisë do të jenë jo shumë larg një shtet i madh mysliman në Ballkan - natyrisht me dominimin e variantit boshnjak të gjuhëve të sllavëve të jugut.

Mbetet porse fakt që, pa e marrë parasysh përkatësinë e tyre të kryehershme etnike vllahe të bullgarizuar, siç ka mundësi të dalë për e dëshmuar mbi bazën e analizës materialit onomastik të kësaj hapësire (për këtë sh. kapitullin gjegjës të kësaj trajtese), goranët kanë jetuar dhe jetojnë në një simbiozë të fortë me fqinjët shqipfolës të tyre dhe për pasojë janë ndikuar nga ata dhe mund të kenë ndikuar edhe këta vetë mbi fqinjët e tyre shqiptarë, me të cilët kufizohen në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, nga të katër anët e horizontit. Gjurmët dhe pasojat e simbiozës me shqipfolësit janë të forta sidomos në mentalitetin, veshjen, muzikën, besimin, porse edhe në fushë të leksikut dhe sidomos në rrafshin e paraleleve - prejardhjes së përbashkët (substratike?) të shumë emrave të vendeve (mikrotoponimeve) dhe të emrave të familjeve, përkatësisht të vëllazërive që këta nga një shtresë e përbashkët josllave e joorientale i kanë të përbashkët me shipfolësit e regjionit të Opojës (khs. për këtë nënkapitullin 17). Përveç kësaj, goranët mbajnë mbiemra familjarë në trajtën e shquar të tyre, përkatësisht të shqipes.

Teza më e re përkitazi me prejardhjen etnike të goranëve është teza e etnisë boshnjake të këtij entiteti. Kështu p.sh., në një shkrim përkitazi me

[231] www.ihist.bas.bg/sekcii/CV/_private/Valery_Stojanow/VS_Muslime-Mind_Balkan.htm - 50k.

"Boshnjakët e Kosovës", të publikuar në faqe të internetit,[232] që në krye të artikullit thuhet se në Kosovë: "Bashkësia numerikisht më e madhe pas shqiptarëve e serbëve janë boshnjakët [...] dhe se "Pjesa më e madhe e boshnjakëve të Kosovës jetojnë në Prizren, Zhupë, Gorë, Podgurin e Prizrenit, përkatësisht në regjionin Prizren-Dragash përreth Malit të Sharit". Në këtë hapësirë po jetuakan rreth 35.000 boshnjakë, gjë që duhet kuptuar se në kuadër të kësaj shifre janë përfshirë banorët e regjionit të Gorës, të cilët qenkan boshnjakë me "prejardhje autoktone të vendosur kryesisht në pjesën jugore të Kosovës [...] në hapësirën e Maleve të Sharit, përkatësisht në mikroregjionet e Gorës, Zhupës dhe Podgurit të Prizrenit. Goranët qenkan, sipas kësaj hipoteze, pjesë identike me grupin etnogjuhësor të boshnjakëve të cilët në të kaluarën, kryesisht gjatë shekujve XVIII., XIX. e XX, përkatësisht pas Kongresit të Berlinit janë vendosur në këto anë, kryesisht si muhaxhirë në shtegtim drejt Lindjes dhe janë adaptuar në ambiente të tjera etnike e gjuhësore. Boshnjakë paskan ardhur në Kosovë edhe pas Luftës së Dytë Botërore nga Sanxhaku, Mali i Zi, Bosnje-Hercegovina, Serbia e nga Kroacia.

Duke dashur në mënyrë shumë naive ta përligjin hipotezën e pabesueshme të qenies boshnjake të goranëve, ithtarët e kësaj teze shkelin mbi çdo ligjësi gjuhësore që katërçipërisht nuk jep asnjë element logjik për ndonjë lidhje të kësaj të folmeje me variantin "boshnjak" të serbishtes, përkatësisht të kroatishtes. Sipas një parimi shumë popullor, të ngjyrosur porse politikisht, ithtarët e kësaj teze më të re e zgjidhin çështjen e prejardhjes së gjuhës së goranëve kështu: "Sa i përket gjuhës së popullatës së regjionit gjeografik të Maleve të Sharit, kjo çështje do të mund të absolvohej kështu: Areali i gjithmbarshëm gjuhësor është, në aspektin linguistik, homogjen, specifik e koherent, i pavarur edhe nga sisteme të afërta gjuhësore: të maqedonishtes e të serbishtes. Kjo e folme është specifike në gjithë qenien e saj gjuhësore: fonologjike-fonetike, morfologjike, sintaksore e leksikore. Këto dallime mund të hetohen me një analizë të hollësishme studioze të lëndës gjuhësore të kësaj të folmje në diakroninë historike e në sinkroni, ndërsa edhe më shumë të materialit gjuhësor aktual." Konstatimi i mësipërm nuk sjell kurrfarë mbështetje për prejardhjen "boshnjake" të goranëve, sado që këtu është qortuar qëndrimi se në "Shkencën serbe të gjuhësisë, kjo zonë e së folmes është trajtuar si njëri nga dialekte të serbishtes ose si dialekti më i vjetër i kësaj gjuhe; ndërsa në hartën dialektologjike të maqedonishtes kjo zonë gjuhësore është trajtuar si pjesë e së folmes (dialektit, nëndialektit) veriperëndimore të maqedonishtes.

[232] http; bs. Wikipedia.org/wiki/Bo% C5%, Alnjaci_

Ky qëndrim, natyrisht në kontekstin e lidhjes së paravenduar bogumilë - torbeshë - goranë, do të arsyetohej, gjithnjë sipas Sadik Idrizit, me rrethanën se "Procesi i lindjes dhe i formimit të kombeve në botë dhe sidomos në Ballkan zgjat ende dhe ecën përpara. Të gjitha mëtimet për ndaljen apo për revidimin e këtij procesi janë të gjykuara me mossukses. Pesë shekuj në rrethin islam dhe disa shekuj më parë në bogumilizëm janë hark kohor i gjatë që dikush të mund të luajë me historinë dhe t'ia përshtat këtë shijes së vet".[233]

Të këtillë (torbeshë) po jetuakan edhe në krahinën e Rekës, Gollobërdës e të Drimkolit (mikroregjion në rrethina të Strugës). Ithtarët e tezës së pejardhjes bogumile të torbeshëve në të gjitha këto zona, i quajnë "Grupi torbesh". Në të kaluarën e afërt ky grup "i qe ekspozuar pothuaj nga të gjitha anët presioneve dhe synimeve për t'i përvetësuar. Gati të gjithë autorët, si ata serbë ashtu edhe ata bullgarë-maqedonas "islamizimin" e këtij populli e përjetojnë për si katastrofë". Qëndrim të njëjtë apo të ngjashëm lidhur me këtë çështje kanë edhe disa autorë të cilët edhe vetë i takojnë këtij korpusi (N.[ijazi] Limanovski, N[azif] Dokle, Xh[evat] Hasani e të tjerë) të cilët, si në garë janë në vrap duke kërkuar motive pagane në doke e zakone e në toponimi, me të vetmin qëllim për të gjetur rrënjë historike e lidhje me popujt ndaj të cilëve këta autorë ushqejnë simpati."- thotë Sadik Idrizi.[234]

Përkundër konstatimeve të mëparshme, pjesërisht të përkundërta, autori ynë konstaton se "Edhe në këtë korpus etnik ka shenja të ristrukturimit nacional e gjuhësor në një njësi më të madhe të shumicës. Specifika të veçanta sajojnë të folmet e popullsisë në regjionin e Maleve të Sharit, në kuptimin më të ngushtë të folmet e Gorës e të Zhupës dhe në kuptimin më të gjerë të gjitha regjionet e Maleve të Sharit në izoglosën Prizren - Kukës - Dibër - Radikë - Mavrovë - Tetovë. Në të kaluarën popullata në Gorë e në Zhupë është deklaruar në mënyra të ndryshme, si popullatë: turke, serbe, serbe e moçme, maqedone e madje edhe bullgare; janë quajtur porse edhe me emra të tjerë: torbeshë, "našinci"; janë trajtuar për si "të padeklaruar", si myslimanë (ose si myslimanë sllavë), si serbë të besimit mysliman. E këtillë ishte gjendja deri në vitet e tetëdhjeta të shekullit XX, ndërsa më vonë u deklaruan kryesisht për si boshnjakë (në regjistrime e në kominikimin e përditshëm), sado që për si e këtillë nuk u deklarua një pjesë e vogël që është e orientuar kah Serbia dhe opsioni etnik serb e disa edhe kah opsioni maqedonas e bullgar, ndërsa kohëve të

[233] Sadik Idrizi, Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k -.

[234] Poai, poaty.

fundit edhe kah opsioni turk. Ky fenomen i përcaktimit nacional në treva të Malit të Sharit është ende i diskutueshëm edhe në vetë këtë korpus nacional e edhe në shkencë. "[...] Pa u studiuar e të lëna në heshtje kanë mbetur edhe shumë argumente nëpër kronika greke e romake, pastaj ato që kanë të bëjnë me dhunën e ushtruar mbi popullsinë bogumile nga Bizanti e nga Nemanjidasit (khs. *Žitije sv. Save* nga murgu Bogumil, si dhe jetëshkrimet e vjetra serbe të sundimtarëve e të klerikëve dhe sidomos kronikat e vjetra greke e bizantine rreth qërimit të hesapeve me bogumilët dhe dëbimeve të tyre). Bogumilët nuk paskan qenë kurrsesi pjesëtarë të një sekti, porse të një besimi më vete, dokrtina e të cilëve mbështetej tek mësimet e dualizmit, që rrjedhin nga Manas-i.

Megjithatë, propaganda e sotme boshnjake për përvetësimin e goranëve mbi bazën e bogumilizmit nuk është aspak më e ndryshme se tentimi në vitet e '90-ta i "misionarëve nga bota arabe dhe nga Pakistani, që mëtonin ta "përmirësonin" besimin e pomakëve në Bullgari".[235]

Përkrahësit e tezës për prejardhjen e mundshme bogumile/ boshnjake të goranëve, autorë si S. Idrizi e ndonjë tjetër kujtojnë se mund ta gjejnë një mbështetje të ligsht edhe tek nocioni "*potur*" që në ndonjë mikroambient të izoluar përdoret për distinktiv të torbeshëve, goranëve apo edhe të pomakëve. Ithtarët e kësaj teze besojnë të gjejnë mbështesë p.sh. tek nocioni "potur" që po i emërtuaka p.sh. banorët e vendbanimit Çaja të rrethinave të Kukësit në kufi me pjesën kosovare të Gorës, të cilët po u quajtkan kështu nga popullata përreth. Në këtë mes S. Idrizi ngul këmbë që sikur goranët/torbeshët/poturët/ pomakët të ishin, siç mendojnë Cilev e O. Turhan, një dhe i vetmi entitet me emra të ndryshëm, nuk do të kishte arsye të quheshin me emra të ndryshëm, përkatësisht që goranët do të duhej të quheshin *pomakë*.

Termi "potur" i serbishtes e i kroatishtes ka hyrë në shqipen dhe ka mbetur në këtë gjuhë i shtanguar pa iu përshtatur ligjeve fonetike etj. të shqipes për shkak të karakterit fort të izoluar të kësaj fjale. Në serbishten e në kroatishten fjalët "potur" e "poturica" e kanë kuptiminm e tradhtarit, ose të atij që e ka braktisur besimin e krishterë; turkoshak". S. Idrizi na mëson se sipas Ejup Mušović-it, fjalët "poturice", "poturi", "të turqizuarit" nënkuptojnë të gjithë të islamizuarit e hapësirave të sllavëve jugorë, pa marrë parasysh përkatësinë etnike e religjioze, duke i përfshirë këtu edhe goranët, dhe sidomos torbeshët.[236] Enver Imamović-i me fjalën

[235] Khs. për këtë www.ihist.bas.bg/sekcii/CV/_private/Valery_Stojanow/VS_Muslime-Mind_Balkan.htm - 50k-.

[236] http://bs.wikipedia.org/wiki/Torbe%C5%A1i"-

"poturi" nuk i nënkupton as muslimanët e as të krishterët. Krahasimi nga ky i fundit i fjalës *potur* me atë *patarin* është i paqëndrueshëm.

5.1. Bestytnitë në mbështetje të prejardhjes bogomile të goranëve

Ithtarët e lidhjes midis bogumilizmit sllav (bullgar) dhe sidomos të derivimit të kësaj herezie në të mirë të lidhjes së etnisë së goranëve me atë boshnjake, autorë si N. Dokle dhe sidomos Sadik Idrizi, sjellin edhe elemente të besëtytnive që do ta mbështesnin si qenien bogumilë ashtu edhe lidhjen gjenetike të goranëve me boshnjakët. Në të mirë të kësaj teze, S. Idrizi shkruan : "Forca e magjisë është e fortë sidomos tek besimi i grave. Kemi shënuar shumë raste të bindjes së thellë që magjia mund ta shkaktojë impotencën, mungesën për krijimin e familjes, nxitjen e ngatërrimeve në bashkëshortësi; anulimin e fatit për fejesë e për martesë, ndryshimin e sjelljes morale dhe të përkundërtën; se magjia asgjësohet nëse gjendet lënda e saj. Edhe sot merren për si të vërteta gojëdhënat për vetëtimën e për Hënën. Deri në vitet e '50-ta të shek. të kaluar (SG.: 'XX) praktikoheshin rituale për mbrojtjen nga sëmundje epidemike dhe nga zjarri, si p.sh. *odmetujene*, kapërcimi i zjarrit nëpër e përmes rrotës së mullirit; me të pirë të tamlit të gomareshës; lëkundjes në ajër të sitave etj. me ç'rast besonin se epidemia e murtajës mund të shuhej. Në një rast të këtillë do të gatuhej një bukë e kallamojt sepse, po u gatua me miell të grynjtë, murtaja do të shkaktonte dëme edhe më të mëdha. Pjesa më aktive e mendimit popullor të torbeshëve na ofron shumë shembuj të doktrinës bogumile të besimit. Sipas bogumilëve, Bota është sajuar në përpjesëtime të barabarta nga *E Mira* dhe nga *E Keqja* dhe se shkak i formimit të këtillë qenkan engjëjt e djajtë. Më konkretisht: krahas me Zotin e së Mirës, i cili e ka krijuar botën shpirtërore, po ekzistuaka edhe Zoti i së Keqes i cili e ka krijuar botën materiale. Ky besim i pranuar nga bogumilët pas islamizimit të tyre, komentohet si: "Allah-u është Zot i Mirë i cili e ka krijuar botën shpirtërore, ndërsa në Tokë sundon Zoti i së Keqes, për shkak të të cilit njerëzit janë përherë në luftë." Në esencë, kemi të bëjmë me kundërthënien midis botëkuptimit islam sipas të cilit Allah-u është një, nga njëra anë, dhe pranimit të ekzistimit të Botës së të Keqes, nga ana tjetër. Njeriu na qenka sfidë midis koftlargut e errësirës, të cilët mëtojnë që tek njeriu t'i asgjësojnë dy cilësi: aftësinë e shumëzimit dhe përkryerjen shpirtërore, atribute këto që Zotin e afrojnë me të. Kështu, duke besuar se vdekshmëria e ferishteve, për shkaqe imunologjike, *ogrejšanica* "të shkelurit në vend të keq", të *uborok*-ut "mësyshi-t" dhe të *vija*-s "epilepsisë" ose shterpësia janë vepra të koftlargut i cili e sundon Botën, sepse njeriu nuk e respekton Zotin. Njerëzit shpenzojnë

energji duke kërkuar metoda e mjete se si të ikin nga e Keqja ose t'i kundërvihen asaj. Shfaqje të tjera të mendimit bogumil janë paragjykime, tabu, kulte, disa rituale të lidhura me vdekjen dhe me foshnjat, besimi tek *kumire-t*, shq. "fatijet"; besimi në aftësinë e vendeve, objekteve që shërojnë ose nga mbrojtja përmes hajmalive. Midis relikteve të bogumilëve tek banorët e sotëm të Bosnje-Hercegovinës Enver Imamović-i i thekson disa veçori të karakterit dhe të sjelljes, të cilat nuk po u ndeshkan në asnjë hapësirë tjetër: sjellja ndaj më të moshuarve, fëmijëve, gruas, ndjesia ndaj së drejtës, durimi, entuziazmi për punë, mikpritja dhe përkujdesja ndaj prindërve. Të gjitha këto veçori qenkan spikatur ose po i spikatka secili individ që ka pasur apo do të ketë mundësi ta njohë së pakut qoftë edhe një torbesh të vetëm. Bogumilët e refuzojnë simbolin e kryqit, adhurimin e ikonave dhe kierarkinë e krishterë. Sado që për këtë që u skicua më lart mund të flasim fare pak, gjurmë të saj nuk mungojnë. Për ta vlerësuar një punë për si të pavlefshme edhe sot përdoren frazeologjitë: "Popi, duke mos pasur çfarë të bëjë, i kryqonte (pagëzonte) pelat"[*] ose ekuivalenten e saj në Podgur të Prizrenit "Popi, duke mos pasur punë, kryqonte (pagëzonte) kecin".[**] Me rëndësi janë edhe urimet: "Popit i rafshin zjarmia e ethet, ty shëndeti e gazi" e ndonjë tjetër [...]. Vërtetimi i dogmës bogumile tek torbeshët nuk do të ishte i plotë po qe se nuk do të merreshin në konsideratë edhe qeniet mitologjike të traditës popullore. Midis tyre *Sotona* (Satana), *Grobnik* (shpirti i të varrosurit), lugati, djalli, xhebraili, (purgatori), engjulli, perritë (xhindët), që ishin pjesë përbërëse e besimit, e mitologjisë së torbeshëve. Gjurmimet kanë treguar se besimi në këto qenie është zbehur ose është shuar i tëri, me përjashtim të atij të djallit. Edhe sot besohet se ai (djalli) ekziston dhe se ka fuqi të madhe rrënuese. Ja edhe një jehonë të dualizmit bogumil. Në jetën e torbeshëve të Gorës, vend të veçantë ka zënë kënga [...] Edhe në jetën e katarëve, njërës nga degët e bogumilëve në Europë, vend të veçantë zinin kënga dhe muzika.".[237]

Unë kujtoj që asnjëri nga besimet e mësipërme nuk mund të mbahen (vetëm) për veçori të bogumilizmit. Kjo sepse të gjitha këto bestytni ndeshen edhe te shqiptarët e te elemeti turqishtfolës i Kosovës dhe më gjerë. Kështu, në Opojë, krahinën fqinje të Gorës, vazhdojnë të shenjohen po ashtu shumë kremte pagane si *Jeremia*, *Verëza* dhe *Shënkolli* e *Shëngjergji* dhe besohet në figurat mitologjike si divi, dragoi, dodoli (gogoli), kuçedra, lugati, Plaka, shtrigat, Tormadja, dhampiri/vampiri e ndonjë

* Origj. Pop. ka nemaf rabota, krstif kobile.

** Khs Pop, ka nemaf rabota krstif jariča.

[237] http://bs.wikipedia.org/wiki/Torbe%C5%A1i".

tjetër.[238] Përqeshja e priftit është e përhapur gjithandej ndër shqiptarët besimtarë të të dyja riteve të krishterimit, ashtu si edhe përqeshja e hoxhës që manifestohet në shumë barcoleta. Shprehja gorane "Popit i rafshin zjarmia e ethet, mua shëndeti e gazi" mund të jetë potencialisht një element i vonë i huazuar e i përkthyer fjalë për fjalë nga turqishtja : "*Papaza sëtma, bana saglık*" që dëgjohet ndër besimtarë islamë turqishtfolës të Kosovës. As besimet në djaj, vampirë, lugatë, në gjindë, në perritë, fatijet etj. nuk mund të merren për elemente të bogumilizmit, sepse ato për si elemente të paganizmit, të ngjyrosura paksa ndryshe nga krishterimi e nga besimi islam, gjallojnë edhe tek të tria besimet e shqiptarëve.

Për si dëshmi të vazhdimësisë së dogmës bogumile dhe të praktikimit të saj, së pakut tek goranët në katunde përreth Kukësit, S. Idrizi e sjell edhe konstatimin e tij se ndër doke të praktikuara nga gratë e atjeshme nuk paska asgjë as nga krishterimi, as nga feja islame. Në përgjithësi, nga krishterimi paskan depërtuar vetëm disa emra shenjtorësh që po u ruajtkan në trajta të tyre të shtanguara nëpër mikrotoponime.

Në të mirë të prejardhjes së kryehershme vllahe të goranëve të sotëm sillen edhe dëshmitë e kremtimit të festave të "*Plakave*"[239] dhe të

[238] Sipas Dr. Naser Pajaziti, E folmja e Opojës, Prishtinë, 2005, f. 16.

[239] Duket se ky shenjim i ciklit të fenomeneve klimaterike të motmotit mund të jetë i lidhur me kalendarin bizantin. Tek rumunët dita e parë e muajit mars kremtohet si ditë e emrit të shna Evdokias. Në tregimet gojore rumune kallxohet se si para shumë kohësh i biri i një gruaje fort shpirtkeqe, e quajtur Doccia, edhe përkundër dëshirës së t'ëmës qenka martuar. Që ta torturante të renë, Dochia vendosi ta vente më 1 mars atë përpara një vargu sprovash të mundimshme: Nusja duhej të shkonte në lumë dhe aty të lante lesh të zi dersa ai të zbardhej dhe, megjithë se ishte stinë e ftohtë, të gjente dredhëza. Zoti u mëshirua kundrejt nuses dhe i ndihmoi asaj që t'i përmbushte të dyja detyrat. Sapo Dochia i pau dredhëzat, kujtoi se paska ardhur pranvera dhe me grixhën e saj të dhive ia mësyu brof e në kullota të bjeshkës. Megjithatë, ajo kishte veshur gëzof prej leshi të dhenve. Mirëpo Zoti bëri të reshte shi dhe plaka u shtrëngua t'i zdishte gëzofët njërin pas tjetrit. Në ndërkohë, shiu u shndërrua në borë dhe acari e shtangoi atë dhe dhitë e saj së pari në akull e pastaj i bëri gur/shkëmb. Këto krijesa të shtanguara/gurëzuara po u shihkan edhe sot në bjeshkët Bucegi të Rumanisë. Tradita rumune kallëzon edhe se, pikërisht pse Eudochia gjatë këtyre ditëve e zhvesh gëzofin me lesh deleje për ta shkundur nga ai shiun e borën, nëntë ditët e para të marsit karakterizohen për ndryshim të theksueshëm të motit. Çdo rumun po e zgjedhka edhe sot e gjithë ditën njërën nga nëntë ditët e marsit për "Plakë"duke besuar që fati i tij gjatë ditëve të tjera të kalendarit po u varka nga moti që merr atë ditë të zgjedhur: Nëse dita e zgjedhur është e mirë, atëherë moti do të jetë i mirë gjatë gjithë vitit; nëse ajo ditë është e vranët, i tillë do të jetë moti gjatë gjithë vitit. Pas ditëve të "Plakave", të kalimit nga dimri në pranverë, po filluakan më 10 mars "Ditët e Pleqve", të ngrohta. Sipas http:www.aurora-magazin.at/gesellschaft/rum_wolf_brauch.frm. htm. Një tregim po me këtë përmbajtje, i përcjellur madje edhe me një mikrooronim *Guri Plakës*, dëgjohet edhe në rrethina të Kaçanikut.

"*Gjysmës së Dimrit*" nga goranët. Derisa përkitazi me kohën dhe me mënyrën e kremtimit nuk thuhet asgjë, për *Gjysmat e Dimnit* jepet sqarimi se kjo festë na qenka e lidhur me shën Athanasin, për të cilën (festë) sqarohet se po u ditka që qenka festë e të gjithë blegtorëve vlleh. Kremtimi i kësaj dite qenka i gjallë në katundin Brod dhe sidomos në katundet gorane që i bien Shqipërisë.[240]

Sado që sot nuk ka tek shqiptarët ndonjë kremte për ndonjë hyjni apo shenjtor mbrojtës të barinjve, rrethana që vllehtë e bullgarizuar të Gorës po e njohkan një hyjni, shenjtor tjetër nga hyjnia e blegtorëve që e njihnin ilirët, tregon se pararendësit e goranëve të sotëm mund të jenë pasardhës të një entiteti (trakas?)

Unë nuk mund të jap më shumë shënime për këto kremte përveç të konstatoj me habi që "Gjysmat e Dimnit" në Kosovë kremtohen vetëm nga jevgët, përkatësisht hashkalinjtë e romët e Kosovës, ndërsa "Plakat" nga kosovarët vetëm shenjohen si ditë e ciklit kalendarik të ndërrimit të stinëve të motmotit, jo porse edhe si kremte.

5.2. Gjurmë të artit e monumente bogumile

Në të mirë të lidhjes bogumil-torbesh - goran-boshnjak autori ynë[241] e sjell të dhënën sipas së cilës në krahinën e Gorës ky paska ndeshur, disa gjurmë pikturimi të cilat, sado të pakta për nga numri, janë edhe një dëshmi se etnogjeneza e torbeshëve të Gorës qenka e lidhur me lëvizjen bogumile. Në këtë përfundim po na shpënka krahasimi i kujdesshëm me përmbajtjen të cilën dijetarët e quajnë *rrethi kulturor boshnjak* (nënvizimi mi; S.G) ku inkuadrohet edhe arti bogumil. Nëpër Bosnje e Hercegovinë haset numër i madh monumentesh bogumile të gdhendura shpesh aq mirë sa mahnitnin. Kjo dukuri artistike e përjetoi lulëzimin e vet në shek. XII e XIII dhe figurat më të shpeshta që u shfrytëzuan për motive ishin: dielli, gjysmëhëna, yjet, rozetat* etj. Këto figura i ndeshim edhe në Gorë. Motive të gjarprit, gjysmëhënës, yjeve e të diellit kemi gjetur të gdhendur në gurë të veçantë, të murosur nëpër mure shtëpish, ndërsa motivin e rozetës nëpër gurë varresh mbi krye të të varrosurit, kryesisht në katundet Borje e Shishtavec. Përkitazi me këto motive Edit Durham [S.G. : kur po fliste për bogumilizmin] thoshte: "Dielli dhe hëna që në këtë besim adhuroheshin më së shumti puqen, pas gjithë gjasash, me paganizmin

[240] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[241] Sadik Idrizi, http://bs.wikipedia.org/wiki/Torbe%C5%A1i".

* Term me prejardhje nga frëngjishtja *rosette* "trandafile e vogël". Motiv ornamental në formë rrethi me një trandafile të stilizuar përbrenda.

sllav të parakrishterimit" [...] ndërsa kur po fliste për figurat e gdhendura në monumente (të bogumilëve) shënonte edhe veshjen e luftëtarëve me fustanella". Këto dy elemente dhe sidomos këtë të fundit S. Idrizi e merr për mbështetje të hipotezës se kemi të bëjmë me një element të përbashkët paraboshnjak e paragoran, të kohës kur bogumilët nuk ishin dëbuar ende nga hapësirat e Maqedonisë.[242] Do të dëshiroja të besoj që autorit tonë nuk i ka shpëtuar për shkak të mosnjohjes së historisë së lashtë të Kosovës, porse për ndonjë arsye që unë nuk mund ta di, ta marrë në peshim faktin e njohur që në hapësirën e Dardanisë antike (Kosovës së sotme) ka shumë dëshmi të traditës së nderimit të Diellit, të Hënës, të gjarprit dhe të motivit të rozetës shumë kohë para ardhjes së sllavëve në Ballkan. Vetëm për si ilustrim të asaj që u tha më lart, po i sjell më poshtë fotografitë e një rozete, të gjetur në gërmadhat e qytetit-kështjellës antike *Labutza* të lokalizuar në vendin *Gradina* të katundit të sotëm Smirë të komunës së Vitisë dhe gdhendjen në gur të një motivi të svastikës.

Në këtë mes do të duhej të theksohej që as elementi i fustanellës, të cilin autori ynë e lidh me ndonjë lashtësi të pamundshme historikisht nuk thotë gjë as për ndonjë lashtësi të thellë të pararendësve të goranëve në hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve, përveç asaj që pikërisht fustanella dëshmon se në mos të gjithë, së pakut një pjesë e madhe e pararendësve të goranëve janë të ardhur (edhe) nga krahu jugor i Ballkanit dhe se kjo veshje nuk është me origjinë sllave.



Foto nr. 1. 2 Rozeta të gjetura në kështjellën Labutza, (sot Gradina) në katundin Smirë të komunës së Vitisë.[243]

[242] Sadik Idrizi, http://bs.wikipedia.org/wiki/Torbe%C5%A1i".

[243] sh. Edi Shukriu, Gradina e Gushicës dhe Municipiumi Labutza, Vjetar XVII-XXVIII i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë, 2002.

Një gjetje nga fusha e artit që merret për dëshmi e pasqyrimit të besimit të bogumilëve është një pllakë bronzi në trajtë trekëndëshi e dimensioneve 9, 12 cm që është gjetur në vitin 1966 në katundin goran të Shishtavecit në rrethina të Kukësit. Në këtë pllakë, të punuar sipas teknikës së drugdhendjes, janë paraqitur dy figura: ajo e klerikut me oreolë në kokë i cili në dorë të djathtë e mban librin, ndërsa në të majtën pendën. Nën të, pak më djathtas është cjapi me brirë, gjithashtu me oreolë dhe me krihë. Në të dyja anët e kokës së klerikut janë gdhendur nga dy shkronja.

Pllaka e gjetur mbahet për gjurmë e parë konkrete (e goranëve) e artit të periudhës së paraislamizimit, përkatësisht e pararendësve bogumilë të goranëve të sotëm në këtë hapësirë. Paravendohet që kjo pllakë do të ketë qenë pjesë e një objekti tjetër, pas gjithë gjasash e fiksuar me tre thumba mbi kopertinën e një libri. Po të jetë kështu, kjo pllakë do ishte gjurma e parë e letërsisë kishtare në hapësirat e Gorës e pra, ndoshta, gjurmë e librit më të madh "Çelësi i Sollomonit" të bogumilëve në hapësirat e Gorës.

Pllaka prej bronzi e gjetur në katundin Shishtavec të Kukësit

Duke u mbështetur tek rrethana që në pllakë oreolat janë gdhendur në përmasa pothuaj të barabarta si mbi kokën e priftit ashtu edhe mbi atë të edhit/apit, S. Iidrizi.[244] konstaton se kjo pllakë "na jep dorë të pa-ravendojmë se i ramë n'gjurmë paraqitjes ikonografike të dualizmit bogumil në këto hapësira." Mbështetje të fortë për këtë hipotezë të veten autori gjen tek interpretimi popullor, sipas të cilit koftlargu i përfytyrohet njeriut më së shpeshti në trajtë të edhit/capit.

[244] http://bs.wikipedia.org/wiki/Torbe%C5%A1i".

6. PREJARDHJA E GORANËVE NË DRITËN E ONOMASTIKËS

6.1 Metoda e studimit

Pa pretendime që përmes këtij punimi do të zgjidhet njëherë e mirë çështja e përkatësisë etnike të goranëve, sepse në rastet e minoriteteve që regjimet serbe të të gjitha kohërave i krijuan dhe sidomos i keqpërdorën për ta zvogëluar forcën vendimmarrëse politike të popullatës prej mbi 90% shqiptare të Kosovës, nuk e kanë respektuar dhe nuk e respektojnë historinë, synim i kësaj pjese të kësaj trajtese është hedhja dritë mbi historinë e këtij regjioni mbi bazën e gjurmëve onomastike të mbetura nga substrati roman ballkanik, grek-bizantin, shqiptar dhe të atyre të superstrateve sllave e orientale në emrat e vëllazërive dhe në mikrotoponiminë e regjionit të Gorës në relacion me atë të krahinës fqinje shqipfolëse të Opojës. Këtë prerje kohore të shtresimeve gjuhësore e etnike e bëjnë të mundshme pikërisht emrat e vëllazërive. Kjo për shkak se emrat e vëllazërive jetojnë më gjatë se emrat personalë, sado që këta të fundit shumë shpesh mund të ngriten mbi bazën e emrave personalë të pararendësve të familjeve të mëdha, të fisit, apo të vëllazërisë. Derisa emrat personalë, duke iu përshtatur uzuseve onomastike të diktuara nga rrethanat e krijuara pas pushtimeve nga shtete bartëse të besimeve të ndryshme nga ai i vendorëve, mund ta ndërrojnë fizionominë e tyre për sa i përket prejardhjes gjuhësore, emrat e familjeve një metamorfoze të tillë i nënshtrohen shumë më ngadalë. Familja e madhe mund ta ndërrojë emrin e vet, normalisht, sapo kujtimi, respekti dhe lidhja emocionale ndaj një pararendësi të saj të jetë zbehur plotësisht. Përveç kësaj, emrat e familjeve janë më të qëndrueshëm në rrjedhën e kohës dhe më pak të nënshtruar ndonjë mode. Ata janë së këndejmi emra personalë të pasivizuar dhe shumë prej tyre ndeshen vetëm në forma të shtanguara, të "pasivizuara" dhe arkaike të tyre, jo vetëm në funksion emrash të vëllazërive, por edhe nëpër mikrotoponime të tipit antroponimik.

Në këtë kontekst dëshmohet se shumë emra familjesh të banorëve të Gorës, të parë në kuadrin e arealit onomastik që këta e krijojnë bashkë me emrat e familjeve e të vëllazërive të banorëve të viseve të tjera të banuara nga shqiptarët, janë më të vjetër se shtresimet e mëpastajme (sidomos më të vjetër se shtresat sllave e orientale të emrave personalë) të këtij regjioni.

Gjurmimi dhe klasifikimi i emrave të vëllazërive e të familjeve është një punë më e ndërlikuar se sa gjurmimi dhe klasifikimi i emrave personalë, edhe pse shumë emra familjesh e kanë burimin tek emrat personalë. Emrat e familjeve dhe të fiseve përbëjnë një sistem më të zhvilluar e më të ndërlikuar emëror. Pikërisht për shkak të kësaj cilësie të

tyre, emrat e vëllazërive e të familjeve, me veçoritë e tyre tipike, janë larg më të larmishëm se sa antroponimet, prandaj edhe klasifikimi i tyre është më i ndërlikuar.[245] Prerja kronologjike e tyre bëhet edhe më e vështirë, sidomos kur kemi të bëjmë me një ambient, siç është ky i Gorës, në përcaktimin e identitetit etnik të banorëve të të cilit kanë ndikuar larg më shumë faktorë të rivalitetit politik bullgar, maqedon, serb e tani edhe boshnjak se sa prejardhja e mirëfilltë e tyre e cila është zbehur plotësisht.

Ky tentim i parë për ta shtruar problemin e prerjes kohore të shtresimeve në emrat e vëllazërive e të familjeve të popullatës sllavishtfolëse të Gorës nuk ndërmerret për ta gjetur etimologjinë e emrave, sepse ndërmarrja e kësaj natyre mësheh në vete gjithmonë një faktor pasigurie që del si rezultat i njohjes dobët apo i mosnjohjes fare të vlerës kuptimore të emrave personalë,[246] sidomos kur kemi të bëjmë me emra që nuk janë sajuar nga brumi i gjuhës të cilën e flasin bartësit e atyre emrave. Me këtë rast jam nisur nga parimi bazë që e kanë propozuar A. Ernout dhe A. Meillet, përkatësisht nga parimi që e propozonin këta se është e pamundshme "ta bësh etimologjinë e një fjale [...] nëse lehet jashtë arealit, përbrenda të cilit asaj mund t'i gjenden korrespondentet".[247] Në këtë trajtesë unë i kam ndjekur edhe parimet që i ka vënë P. Noton - sidomos parimin e përputhjes midis njësive leksikore dhe atyre toponimike.[248] Shtegu kryesor që do të ndiqet në këtë punim është, së këndejmi, konstatimi i arealeve emërore të materialit onomastik të popullatës së Gorës dhe ngritja pastaj e tezave mbi bazën e tyre për sa i bie përkatësisë etnike të kryehershme të goranëve, sado që disiplinat onomastike janë të ndryshme nga ato gjuhësoret, po aq sa edhe rezultatet e tyre.[249]

Kriteriumi bazë për vlerësimin e emrave të përveçëm në regjionin e Gorës, në aspektin e etimologjisë së tyre, nuk është pra vetëm përkatësia gjuhësore e emrave, porse në rend të parë areali emëror në

---

[245] Cit. sipas Ante Šupuk, Najstarija matica Šibenskog predgradja Dolac (Liber baptizatorum Parochie Sancti Marci a die 8 octobris 1685 isque annum 1700 inclusie), Čakavska Rič, 2/1974.

[246] Cit sipas Radoslav Katičić, recension për librin e Vladimir Georgiev, Hethitisch und Etruskisch. Die hethitische Herkunft der etruskischen Sprache, Balkansko ezikoznanie V, 1 Bălgarska Akademija nauka, Sofija 1962, në Živa antika 15, 1., Shkup 1965, f. 241.

[247] Dictionaire étymologique de la langue latine, Paris, Quatrième édition, 1967, f. IX (e parathënies).

[248] Dialektologie et Toponymie, disciplines connexes (À propos d un article récent), Revue de linguistique romane XIII, 1958, f. 47-75.

[249] Dalibor Brozović, Doseljenje Slavena i njihovi dodiri sa starosjediocima u svjetlu lingvističkih istraživanja, Simpozijum "Predslavenski etnički elementi na Balkanu u etnogenezi južnih slavena", 24 - 26 tetor 1968 në Mostar, Sarajevë 1969, f. 133.

të cilin shtrihen ata emra, dendësia e përhapjes së tyre, ngulitja dhe tradita e tyre, si edhe përputhja e atyre me emrat familiarë të shqiptarëve të Opojës dhe të krahinave fqinje me banorë autoktonë shqipfolës.

Po ky kriter do të aplikohet edhe për rastet kur përshtatjet fonetike të atyre emrave të vëllazërive apo të vendeve janë zhvilluar në përputhje me ligjet fonetike të shqipes - pa marrë parasysh prejardhjen gjuhësore të mirëfilltë të atyre emrave.

Sikundër u tha më lart, në këtë zonë dëshmohet një numër i konsiderueshëm emrash që, shikuar në pikëvështrimin e prejardhjes gjuhësore të tyre, janë të përbashkët si për popullatën (shqipfolëse) të Opojës, ashtu edhe për atë (sllavishtfolëse) të Gorës.

Burimet kryesore mbi të cilat mbështetet gjurmimi im krahasimtar i materialit onomastik të regjioneve të Gorës e të Opojës janë librat: *Gora i Opolje* i antropogjeografit serb Milisav Lutovac, i botuar në serinë "Naselja i poreklo stanovništva", vëllimi 35, Beograd, 1955; libri i arkivistit kosovar Jusuf Osmani: Venbanimet e Kosovës 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, punime të autorit Sadik Idrizi dhe shënimet e mia personale të marra në këtë regjion para rreth 30 vitesh më parë. Një gjë që më ka rënë në sy e që duhet ta dijë edhe lexuesi është ky që pasqyrimi i lëndës onomastike në veprat e autorit serb e të atij kosovar janë të ndryshme. Një sqarim mbushamendës për këtë konstatim timin duhet parë tek rrethana që autori serb lëndën onomastike të kësaj krahine e kishte shënuar që në vitet '30 të shekullit 20, ndërsa autori kosovar e bëri këtë punë para tri vitesh. Kështu mund të sqarohet mbase rrethana përse tek autori serb ka më shumë emra që gjuhësisht i përkasin shtresës onomastike të periudhës së para islamizimit se ç'mund të gjenden tek autori kosovar. Kjo sqarohet edhe me rrethanën e konstatuar nga studiuesi Sadik Idrizi,[250] i cili na mëson që zhdukja e disa emrave të vëllazërive duhet të shpjegohet si pasojë e shpërnguljes së jo pak familjeve gorane në Turqi, shtegtimi dhe vendosja e disave syresh si krah pune, gurbetçarë nëpër qytete të hapësirës që dikur ngërthente shteti i quajtur Jugosllavi dhe sidomos ndërrimi, ndryshimi i emrave familjarë me urdhër apo me sugjerim nga forca e pushtetit që në këtë regjion ishte ushtruar para, por sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, kur shumë familje gorane morën mbiemra të rinjë.

[250] sipas: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I – IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

6.2. Paralele midis antroponimisë së banorëve të Gorës dhe të asaj të krahinave fqinje shqiptare

6.3. Paralele antroponimike të banorëve të Gorës me ata të krahinave shqipfolëse të Opojës e me të Malësisë së Tetovës

Me qëllim të përfitimit të një pasqyre më të plotë të antroponimisë së banorëve të krahinës së Gorës dhe të regjionit fqinj të Opojës, më poshtë do të merret në trajtim materiali onomastik i dëshmuar më 1467-1468 për Malësinë e Tetovës; lënda antroponimike që përmbahet në defterin e vitit 1571 të regjistrimit të kryefamiljarëve të regjionit të Opojës si edhe, në kuadër të ndjekjes së arealit antroponimik, ai që përmbahet në Kadastrin e Shkodrës të vitit 1416. Mbi të gjitha, porse, do të mbështetem tek analogjitë në fushën e emrave aktualë të vëllazërive dhe të mikrotoponimeve të tipit antroponimik të regjionit të Opojës që përputhen me emrat e vëllazërive të popullatës së Gorës dhe me mikrotoponime aktuale të tipit antroponimim të këtij regjioni. Do të merren në konsideratë dhe do të përpunohen në pikëvështrimin onomastik e gjuhësor sidomos disa antroponime të vjetra në trajtat e tyre të shtanguara nëpër mikrotoponime që nga kohë të mugëta, për të cilat nuk kemi dëshmi shkrimore, por që rezulton se do të kenë qenë të përbashkëta për të dyja popullatat që sot flasin gjuhë të ndryshme. Mbështetja bazë për krahasimet në sinkroni të emrave të vëllazërive jo vetëm të këtyre dy krahinave porse edhe të asaj të Malësisë së Tetovës është lënda onomastike që e kam shënuar vetë në rajonin e Opojës, lënda onomastike e Malësisë së Tetovës e shënuar nga Fadil Sylejmani dhe lënda onomastike e krahinës së Gorës e shënuar nga Milisav Lutovac, Jusuf Osmani dhe pjesërisht edhe nga unë vetë.

Kështu, në katundin Blaç të Opojës unë i kam shënuar vetë mikrotoponimet *Reka e Kipit, Livadhi Kasës* dhe *Shkarpat e Kasës* (në Brodosanë), *Lisi i Kasës*, (këtu do të hynte ndoshta edhe emri *Kastrake* i një vëllazërie, lagjeje të katundit Brrut), *Kodra Polakit* e *Gjybra e Lilës* dhe *Rrahi i Lilës* (në Blaç)[251] në të cilat s'ka dyshim që në forma të tyre të shtanguara janë ruajtur antroponimet *Kip, Kas, Polak* (?) dhe *Lil*.

Në krahinën sllavofone të Gorës, nga ana tjetër, gjallojnë edhe sot emrat e vëllazërive *Kiprinci, Kasovci* (në Orçushë)[252] ku do të duhej të përfshihej mbase edhe emri i shënuar nga J. Osmani si *mahalla e Kosovës* për në katundin Mlikë të Gorës,[253] *Poljakovci* (në Vraniq) dhe *Lilovci* (në Brod). Emri *Kiprinci* i vëllazërisë gorane është pas gjasësh me prejardhje

[251] Të shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 86.

[252] I shënuar nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 123, me pahirë apo qëllimisht, gabimisht si *Kosovci*.

[253] Khs. Vendbanimet e Kosovës 20, f. 121.

nga trajta greke *Kiprios*[254] dhe e ka për etimon emrin e gjithkrishter *Kiprijan* < *Cyprianus* i cili tek popullata romane del në trajtat *Cebrus, Cibre, Cibriulus, Cibrole.* Në dritën e fenomenit të konstatuar se emërtimet e kësaj gurre kanë dalë ndër sllavë në faza të moçme në trajtat *Čeprljinac* < *Čeprljan* ndërsa në kohë më të vona në ato *Čubrijan, Čubra, Čubran, Čibur, Čubranić* dhe tek bullgarët si emër personal femëror në trajtat *Čubra, Čubrica, Čubravička* (për të cilët G. Weigand ka një shpjegim tjetër).[255] Tek emri *Kiprinci* i vëllazërisë gorane duhet parë mungesën e ndërmjetësisë së zhvillimeve fonetike të sllavishtes, përkatësisht ruajtjen e një trajte të vjetër e cila vetëm me ndërmjetësimin e sllavishtes do të mund të palatalizohej në *Čiprinci. Përkitazi me praninë e këtij antroponimi në funksion të emrit të vëllazërisë tek popullata e Gorës së pari duhet thënë se një kësi emri nuk është dëshmuar as në shkrimet kishtare serbe të shek. 13 - 15 as ndër emra banorësh të ambienteve të cilësuara për vllahe tek të cilat ndeshen antroponime të prejardhjes latine ballkanike e as ndër antroponime të banorëve të vendbanimeve të blegtorëve të cilësuar për arbanasë. Mosdëshmimi i këtij antroponimi në këso ambientesh, popullata e të cilave s'ka si të mos merret për si autoktone, sikur e lejon paravendimin se këtu mund të kemi të bëjmë me një emër të vjetër të trashëguar nga koha e bashkëjetesës së popullatës vendëse me atë latine-ballkanike.

Antroponimi bazë *Kas-* i emrit të vëllazërisë gorane *Kasovci* do të jetë i së njëjtës prejardhje, përkatësisht latine-ballkanike, si edhe emrat, e dëshmuar larg këtij regjioni: *Cassianus, Cassia* të dëshmuara në mbishkrimet epigrafike: *D*(is) *m*(anibus) // *L. Cassianus* // *Potens mil*(es) // *leg*(ionis) *VII Cl*(audiae) // *mil*(itavit) *annis XI,* // *vixit annis XXVIII. Cassia* //*Valentina* // *b*(ene) *m*(erenti) *fratri* // *posuit* i gjetur në Ćajir të Kostolac-it afër Viminacium-it antik[256] dhe në mbishkrimin *Temp*(lum) *effectum* // *per Cas*(sium) *Achilleu*(m) *et* // *P. Val*(erium) *Crescente*(m) *opi* // *fices, inst*(ante) ose *antibus*) e gjetur në rrënojat e kishës Sv. Trojica të katundit Ravna në Serbi.[257]

---

[254] I cili, sipas Prof. Dr. Gustav Weigand: Die bulgarischen Rufnamen, Ihre Herkunft, Kürzungen und Neubildungen, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache (Rumänisches Seminar), 15/1909, f. 125, tek bullgarët dëshmohet në trajtat: *Kiprijan, Kipré,* f. *Kipra*.

[255] Ky mendon, në f. 138 të trajtesës së tij të cituar më lart, se emrat femërorë të dhënë më lart po rrjedhkan nga emri bullgar *čubra* i bimës, saturej gjerm. Bohnenkraut.

[256] Khs. Nikola Vulić, Antički spomenici u Srbiji, Spomenik, SKA, 39, Beograd, 1909, Mbishkr. 15, f. 117.

[257] Khs. N. Vulić, Antički spomenici u Srbiji, SPOMENIK, SKA, XLVII,, Beograd, 1934, Mbishkr. nr. 96, f. 161.

Mbiemrin *Cassianus* e mbante edhe një murg i kohës së krishterimit të përbashkët i lindur mbase rreth vitit 360 në provincën romake Scythia minor të rrjedhës së poshtme të Danubit, në krahinën e sotme Dobrudja. Mbase jo krejt rastësisht mbiemri *Casian* (nga *Cassianus* < *Cassius*) ndeshet tek rumunët në trajtat *Casian*, *Căstian*, *Casan*, *Casota*, *Caşota* etj. dhe e paskan vlerën kuptimore "lakuriq".[258]

Territorialisht pak më afër, gjurmët e emrit me prejardhje latine janë hetuar nga gjuhëtarë kroatë tek emri i vendit në rrethina të Splitit *Sukojišan*, të cilin e kanë zbërthyer si një bashkëshkrirje të një emri të kryehershëm *Sanctus Cassianus* dhe mbahet për shenjtor i kishës katolike,[259] sado që ky jetoi e veproi në kohën e krishterimit të përbashkët.[260] Për shembull dëshmi të mirë të ndonjë lidhjeje midis goranëve të sotëm sllavishtfolës dhe shqiptarëve në kohën e para pushtimeve bullgare e serbe të kësaj hapësire do të fliste, pra, edhe emri *Kasaj* i një vëllazërie të katundit Brodosanë të Opojës, ku është edhe mikrotoponimi *Livadhi Kasës* dhe emri *Kasa* i një vëllazërie (natyrisht) shqiptare të katundit Rekë të Kaçanikut, në të cilin është madje edhe topogërmadha *Kisha e Kasës*. Një vend i quajtur *Livadhi Kasës* është edhe në katundin Dobrushtë të komunës së Prizrenit.[261] Lidhjen ngusht të antroponimisë e të toponimisë së rajoneve të Opojës e të Gorës e, në këtë kontekst, edhe ardhjen e elementit goran në hapësirën e Gorës nga hapësira gjeografike e Maqedonisë së sotme do ta tregonte ndoshta edhe ekzistimi i emrit të vëllazërisë *Kasallarët*[*] në lagjen Teqe të katundit Zajas të Kërçovës dhe emri *Kaset* i një familjeje/vëllazërie në katundin Sllupçan të Kumanovës.[262]

---

[258] N. A. Constantinescu, Dicționar. .., f. 28 - 29.

[259] khs. Konstantin Jireček, Romani u gradovima Dalmacije. .., f. 61.

[260] Nga historia e krishterimit dihet për një murg të quajtur Johannes CASSIANUS, i lindur rreth vitit 360 e i vdekur midis viteve 430-35 në Dobruxha, përkatësisht në provincën romake Scythia minor të rrjedhës së poshtme të Danubit. Një kohë të gjatë qëndroi në Egjipt. Prej këtu kaloi në Konstantinopojë. Ishte nxënës i entusiazmuar i patriarkut Johannes Chrysostomus. Ky u përpoq që në Perëndim ta fuste jetën murgjërore orientale me pak ndryshime. I lutur nga arkigjakoni Leo i Romës, që më vonë u bë papë ky shkroi - si avokat i ortodoksisë - trajtesën "De incarnatione domini contra Nestorium", që mbeti i vetmi shkrim polemizues europerëndimor kundër Nestorius -it., sipas http://bautz.de(bbkl).

[261] Të shënuara në terren nga Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 10, Kaçaniku, Prishtinë, 2004, f. 139, 186.

* I formuar nga antroponimi Kas/ë,-a me prapashtesën *-llar* me prejardhje turke e jo ndoshta nga fjala aromune *casa* "shtëpi" sikundër mendon autori Q. Murati në punimin e cituar në referencën që pason.

[262] Të shënuara në terren nga Dr. Qemal Murati: Deshmi onomastike per autoktonine e shqiptareve në trojet etnike të tyre në Maqedoni, Tiranë, 1993, f. 42.

Në katundin Brrut të Opojës e kam shënuar edhe mikrotoponimin me prejardhje antroponimike *Livadhi Bazës*, ndërsa në katundin Pllavë mikrotoponimin *Mullaga e Bazës* dhe *Arat e Bazës* në Brodosanë. Para se të shfaqet ndonjë mendim që s'bën të jetë këmbëngulës rreth prejardhjes së emrave të vëllazërive gorane, duhet parë së pari nëse në mikrotoponimet opojare përmbahet me të vërtetë një emër vëllazërie apo një apelativ. Së dyti duhet parë përse ai emër vëllazërie apo apelativ, përkatësisht emri i shpendit *bajz*/*ë*,*-a* zool. Fulica nuk del në trajtën me *j* (Bajzës) por në atë pa *j* (Bazës). Tek trajta (i,e) *Bazës* ose duhet parë një trajtë lokale të emrit të shpendit *bajzë* ose një apelativ sllav të vjetër *bъzъ* "shtog" bot. Sambucus nga i cili rrjedhin emrat e vendeve *Bazovice*, *Bazovik*, *Pod Bazom* e *Bazovi* të territorit të Sllovenisë ku bien edhe trajtat serbe e kroate *baz, baza, bazd, bazag, bázga* të cilat janë po ashtu zhvillime nga sllav. e vjetër *bъzъ* "shtog" si edhe trajtat serbe e kroate *bzóva, zóva, bzóvina* e *zobovina*.

Vetë kryefjala *Mullaga* në të cilën ruhet emri i drurit *mullagë, mllagë, mllakë* bot. Ostrya carpinifolia Scop[263] tregon se te pjesa e dytë e këtyre mikrotoponimeve nuk kemi të bëjmë me një apelativ tjetër (p.sh. sllav) i cili do ta shënonte emrin e ndonjë druri tjetër apo një emër tjetër të po këtij druri, porse se te pjesa e dytë kemi të bëjmë me një antroponim nga i cili rrjedhin edhe emrat e vëllazërive **Bajzovci* e *Bazdinci* (sh. më poshtë) të krahinës së Gorës, përkatësisht të katundit Restelicë të këtij regjioni. Sikur në pjesën e dytë të këtij mikrotoponimi të përmbahej fjala sllave *baza* "shtog" bot. *Sambucus*, atëherë do të kishim një emër të pakuptimtë *Mullaga e Shtogut. Gati po aq i pakuptimtë do të ishte edhe një mikrotoponim *Livadhi i Shtogut.

Në këta emra ruhet pas gjihtë gjasësh emri i zogut *bajz, ë -a* që në Veri (të Shqipërisë) del edhe në trajtën *balz, ë -a* zool. Fulica - një emër shpendi që, sipas E. Çabej. është një zhvillim i brendshëm i shqipes nga mbiemri shqip (i, e) *balë* "i bardhë". Pikërisht në këtë trajtë të vjetër ky mbiemër i shqipes, gjithnjë sipas Çabejt, ruhet edhe në emrat e vendeve *Mrizi i Bálzavet* (në Mërtur të Gurit) dhe *Balza* në rrethina të Elbasanit, ndërsa në trajtën *bajzë* tek emrat e katundeve *Bajza* (e Kastratit) dhe *Bajza* (e Kërrabës).[264]

Tek mikrotponimi opojar *Kodra Polakit* dhe tek emri i vëllazërisë gorane *Poljakovci* në kat. Vraniq vështirë se mund të përmbahet apelativi slav *polak* që e shënon rojtarin e fushës së katundit, sepse në asnjë shkrim

[263] Sipas Ilia Mitrushi, Drurët dhe shkurret e Shqipërisë, Tiranë, 1955, f. 321.

[264] Khs. Eqrem Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, II, A- B, Tiranë, 1976, f. 134-135.

kishtar serb nuk dëshmohet kategoria sociale e rojtarëve të fushës që do të quhej *polak*. Punën e mbikëqyrjes së tokave të bukës së një katundi e bënte në mesjetën e vonë të sunduar nga shteti serb e nga kisha serbe *potrogjeri* (nga greq. *ποτρογεροσ*.[265] Përveç punës së lajmëtarit për tubime e ngjarje me rëndësi në katund, potrogjeri e kishte edhe detyrën e mbikëqyrjes, ruajtjes së tokave të bukës nga dëmtimet. Më parë do të jetë që në këta dy emra të përmbahet antroponimi *Pol-* që me zgjerime të ndryshme prapashtesore dëshmohet për antroponim i banorëve të Kosovës së sotme se sa fjala sllave *poljak* "rojtar fushe".

Në katunde të Opojës më ka rënë ta shënoj edhe mikrotoponimin e tipit antroponimik në të cilin ruhet një trajtë e shkurtër apo edhe një antroponim i mirëfilltë *Ec-*. Kështu, në katundin Pllavë e kam shënuar mikrotoponimin *Liadhi Ecëc*, ndërsa në katundin Zaplugjë ato *Lugi Ecëc, Ura Ecëc* dhe *Kurti*[266] *Ecëc* dhe mbase s'ka dyshim se emri i përmbajtur në mikrotoponimet e mësipërme është po ai që në trajtën e tij të zgjeruar me prapashtesën sllave *-ovci* përmbahet në emrin e vëllazërisë gorane *Ese/Esovci* dhe në mikrotoponimin *Eseska* në katundin Restelicë të kësaj krahine.

Në katundin Pllavë të Opojës e kam shënuar edhe mikrotoponimin *Rrasat e Lekës* dhe emrin e burimit *Kroni Lekës*. Antroponimi i përmbajtur në këto dy mikrotoponime s'ka si të mos jetë i së njëjtës prejardhje si edhe emri i vëllazërisë gorane *Lekovci*, përkatësisht antroponimi Aleksandër[267] në trajtën e tij të shkurtër karakteristike shqipe *Lekë* - të zgjeruar tek popullata gorane me prapashtesën sllave *-ovci*.

Në territorin e sotëm të katundit Brodosanë dhe në pjesën e kullotave, tbaneve të këtij katundi, para shumë vitesh i kam shënuar emrat e vendeve *Soha e Vesës* (të cilin J. Osmani[268] e ka rishënuar si *Soha Vesos*)

---

[265] Max Vasmer, Die greichischeen Lehnwörter im Serbokroatischen, Berlin, 1944, Verlag der Akademie der Wissenschaften, f. 125.

[266] Rreth etimologjisë së fjalës *kurt*,-**i**, "oborr" si një huazim i shqipes nga latinishtja ballkanike sh. Petar Skok, Curtis, në Starohrvatska Prosvjeta, Arheološko-historijski časopis, Nova serija II, 1-2, jan.-juni, Zagreb-Knin, 1928, f. 113. P. Skok e nxjerr këtë fjalë nga lat. *cochors* "oborr shtëpie, rrethije". Sipas Skok, kjo fjalë është formuar nga kompozita lat. *co* (*cum*) dhe nga fjala bazë *hortus* "kopsht, oborr". Khs. te Miklosich, Romanische Elemente im Albanischen. 18: 234: corte it., chors, vulgo curtes. kōrt-i corte. R. kurt. K. 204. *kurtetār-i* corteggiano Höfling. R. B.. 2.. 41; rum. mrum, *kurte.* Schuchardt 2.123. Diez 1. 151.

[267] Ky antroponim rrjedh nga emri grek Aleksandros. sh. për këtë E. Çabej: Der Name Alexander in der albanischen Volkssprache, Eteria Makedhonikon Spudhon - Makedhoniki Vivliothiki, A. P. 57, Thessaloniki 1980, f. 157-159. Ndër shqiptarët, ky emër del edhe në trajtat e shkurtëra Lesh/Llesh, Sandër e Lekë.

[268] Khs. Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 98.

dhe *Gropat e Vesës*; *Rrasa e Kokës; Guri Ali Bashës*[*] dhe *Guri Leknaj* të cilat mbase janë të së njëjtës gurrë prej nga rrjedhin edhe emrat e vëllazërive të Gorës *Vesilovci*,[269] *Bašinci* (në Restelicë, e shpërngulur), *Lekovci* (në Brod, e shpërngulur) dhe *Kokljevci* (në Zlipotok). Në katundin Zaplugjë është hidronimi *Prroj i Bajtit* dhe emri i lartësirës *Kodra Alës*, të cilat na i përkujtojnë emrat e familjeve *Bajmakovci* (në Restelicë e në Brod) dhe *Aljevci* të Gorës.

Po në katundin Zaplugjë të Opojës e kam shënuar edhe mikrotoponimin *Livadhet e Rushtës*. Ky emërtim i tipit antroponimik do ta ketë të njëjtin etimon si edhe emri i vëllazërisë gorane *Ruštevci*, ndërsa dëshminë e pranisë së këtij emri edhe tek shqiptarët e rrethinës së Suharekës e gjejmë në burimet kishtare serbe të shek. 15, përkatësisht në vitin 1454, kur në një dokument të kishës serbe dëshmohet se njëri ndër pjesëmarrësit (përveç pleqnarëve me emra dhe me mbiemër shqiptarë siç ishin Petko *Ginçeviq*, Petko *Bushat* dhe Bozhik *Mzija*) në zgjidhjen e kontestit rreth përcaktimit të mexhëve të katundit Mamushë, ishte edhe personi i quajtur *Ruš Ginovikъ* nga katundi i sotëm Studençan i Suharekës.[270] Në dritën e rrethanës që adjektivi latin *russus* në bullgarishten e në serbishten është reflektuar si *rusъ* "bjond; i kuq - bjond" dhe në greq. e re si ρουσσος "njeri bjond"[271] ka vend të besohet që reflektimi i këtij mbiemri latin si *Ruš-* është një reflektim shqiptar e jo sllav i këtij mbiemri latin. Në dritën e kësaj mundësie ka mbase vend të paravendohet procesi i sllavizmit etnik të pararendësve shqipfolës të kësaj vëllazërie të sotme gorane.

Këtu bien edhe mikrotoponimet opojare *Livadhi Dukës*, *Zabeli Lajës* (në) *Gropa Qolës* dhe *Qungari* (në Shajne të Opojës), të cilat janë të së njëjtës pejardhje, pa hyrë këtu në hollësi përkitazi me etimologjinë e emrave, si edhe emrëtimet e vëllazërive gorane *Dukarinci*, *Lajkovci* (në Glloboçicë), *Gjolevci* e *Qunkovci* të regjionit të Gorës.

Në katundin Zaplugjë të Opojës i pata shënuar edhe emrin e lagjes *Çadelt /Çadejt* dhe mikrotoponimin *Livadhet e Çadelit* të cilat janë të lidhura me emrin e vëllazërisë, lagjes *Çadelet* të po këtij katundi e që duket se s'kanë si të mos jenë të së njëjtës prejardhje prej nga rrjedh edhe

* Një vend i quajtur *Fushat e Bashës* është edhe në katundin Rrenc të Opojës.

[269] Tek Fr. Miklosich : Die Bildung. .., 254 për të dalur nga rrënja *vesel* "fatlum, i lumtur" dalin të jenë antroponimet: *Vesela*, *Veselin*, *Veselica* dhe toponimi *Weselowo*, s'ka porse emra të dalë nga ndonjë formë *Vesil*. Kjo e lejon mundësinë që bartësit josllavë të këtij emri do ta kenë kuptuar këtë mbiemër sllav si apelativ.

[270] Sh. Aleksandar Solovjev, Odabrani spomenici srpskog prava, Beograd 1928, f. 216.

[271] Më gjerësisht për këtë khs. Dr. St. Romansky: Lehnwörter latenischen Ursprungs im Bulgarischen, Revue des études slaves, Tome quatorzième, Paris, 1934, f. 121.

emri i vendit *Çadelovo* dhe emri i vëllazërisë gorane *Çadelovci* të katundit Kërstec i Madh[272] të krahinës së Gorës.

Në dritën e kësaj përputhjeje mund të paravendohet mbase me të drejtë se këtu kemi të bëjmë me një bigëzim gjuhësor si rezultat i lëvizjeve të brendshme dhe të asimilimit të ndërsjellët të dy popullatave etnikisht e gjuhësisht të ndryshme.

Një vëllazëri e katundit Brodosanë quhet *Kutijaj* (khs. edhe mikrotoponimin *Kroni Kutisë* gjithashtu në Brodosanë), i cili është pikërisht një antroponim që në funksion të emrit të vëllazërisë ndër goranët sllavofonë del në trajtën *Kutinci;* mikrotoponimi, mbase me prejardhje shqipe, (për këtë sh. më poshtë) *Livadhi Çokit* në Zaplugjë ta përkujton emrin e vëllazërisë gorane *Çokovci* (në Restelicë)*;* emri i burimit *Kroi Macës* në katundin e vogël Kukël të Opojës na e përkujton emrin e një pjese të territorit të katundit më të madh goran Brod, ku ruhet emri me prejardhje vllahe (khs. më poshtë) *Maćina*; mikrohidronimi *Reka Beganës* jo vetëm është i ngjashëm me emrin e vëllazërisë gorane *Bežanovci*, porse e dëshmon edhe ruajtjen më tej të emrit të këtij tipi në trajtën e tij të sllavizuar, me ndërmjetësimin e zhvillimeve fonetike, përkatësisht me zgjerimin me prapashtesa të sllavishtes. Mikrotoponimi *Lama Durakit* në lagjen Begaj, përkatësisht në Kuklibeg të Opojës dhe sidomos emri *Duraj* i njërës nga vëllazëritë e katundit Brodosanë të Opojës[273] është i së njëjtës prejardhje si edhe emri i vëllazërisë gorane *Durakovci* të Zli Potokut, ndërsa emri i një vëllazërie të quajtur *Shurdhaj* të katundit Blaç e ka të njëjtën vlerë kuptimore si edhe emri me origjinë vllahe, romane (nga vllah. *surd* "i shurdhër") i vëllazërisë gorane *Surdulovci*, emër ky që dëshmon se në këtë zonë kishte një bashkëjetesë shqiptare-vllahe dhe se kjo e dyta në Opojë u shqiptarizua me kohë, ndërsa në krahinën e Gorës ky emër roman ballkanik u ruajt i mveshur me prapashtesë sllave. Me një rast transparent të bashkëjetesës shqiptare-vllahe, përkatësisht të sllavizimit të shqiptarëve e të vllehve e kemi tek emri i njërës nga vëllazëritë e katundit "boshnjak" Jabllanicë 11 km në lindje të Prizrenit. Këtu përkrah vëllazërisë me emër të prejardhjes vllahe *Mutovci* dhe vëllazërive të quajtura *Panxhovci* (khs. *Panxhajt* shqiptarë të rrethinave të Deçanit) dhe *Gërkoci* (ndoshta nga *Grkovci) është edhe vëllazëria e quajtur *Shurdiqi*.[274] Ky emër është

[272] Të shënuar së voni në terren edhe nga Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 112. Ky i ka shënuar këta emra si Qadelovci dhe dhe Cadelovo.

[273] I shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 88.

[274] Këtë emër e ka shënuar në terren J. Osmani Vendbanimet e Kosovës 18, Prizreni, Prishtinë 2006, f. 132.

mbase variant sllav i përkthyer i ofiçit shqip **Shurdhajt*, kuptimisht i barasvlershëm me emrin *Surdulovci* me prejardhje vllahe dhe me të njëjtin kuptim.

Edhe mikrotoponimi *Shelegarniku* i katundit Brodosanë të Opojës dhe emrat *Šilegarnik* në katundet Dikancë e Radesh (i përkthyer nga J. Osmani "me autoritet të pushtetit" si *Rrunza*)[275] e ndoshta edhe emri *Shiljarik* i një vëllazërie në katundin Restelicë të krahinës së Gorës, e kanë të njëjtën prejardhje, përkatësisht nëse këta emra rrjedhin nga fjala *shileg* "dash i sivjemë; që s'e ka mbushur ende një motmot; që ruhet për farë" nga lat. *selectum* "i zgjedhur",[276] apo ndoshta term i huazuar nga greqishtja συλλεγω, siç mendon M. Pavlović.[277] Edhe ky emër vendi është dëshmi e një bashkëjetese të lashtë të këtyre dy popullatave. Çështje që mbetet për t'u sqaruar në këtë mes është ajo nëse pararendësit ardhës të goranëve këtë fjalë e sollën me vete si thesar të trashëgimisë ballkanike apo e gjetën dhe e huazuan këtë në vendin e ngulitjes. Sa kohë që nuk ka ndonjë dëshmi as edhe të tërthortë që popullata e Opojës të jetë e ardhur këndej, mbetet të besohet se edhe këtu kemi të bëjmë me një element leksikor të latinitetit ballkanik, që pararendësit e goranëve të sotëm do ta kenë (ri)huazuar nga shqiptarët.

Për e sigurt se është e sjellë nga vlleh bullgarishtfolës do të jetë trajta *stërga* e fjalës *shtrungë* e cila gjendet e ngurosur në mikrotoponime. Të kësaj prejardhjeje janë mikrotoponimet *Stërgat* dhe *Kepat e Stërgave* në katundin Brodosanë; *Stërga* në katundin Kuklibeg; *Stërga e Poshtër* dhe *Mugallat e Stërgës* në katundin Kuk. Këto mikrotoponime janë të së njëjtës prejardhje si edhe mikrotoponimi *Strunga*[278] në kaundin Zgatar të Opojës. Mikrotoponimet e sajuara nga apelativi *stërga* janë trajta bullgare, të dalura nga *străga* (trajtat dialektore *straga*, *struga*) e cila në bullgarishten, përveç të tjerash, i ka kuptimet "vendkalim, vendkalim i ngushtë për grahjen e bagëtisë; vend i ngushtë në vath delesh nëpër të cilin lëshohen delet pasi të jenë mjelë; vend i ngushtuar nëpër të cilin delet hyjnë e dalin nga vathi" etj. Nëpër dialekte të serbishtes e të kroatishtes kjo fjalë ndeshet si *strűga*. Shumë dijetarë ballkanologë e konsiderojnë këtë fjalë për të prejardhjes substratike: disa për huazim nga

[275] Khs. Vendbanimet e Kosovës, 20. f.104, 129, 132.

[276] Sqarim i huarzuar nga Nedeljko Bogdanović, Nazivi i imena brava u okolini Svrljiga, Onomatološki prilozi, I, Beograd, 1979, f. 160.

[277] khs. Toponimija okoline Vranja, Vranjski glasnik, 4, Vranje, 1968, f. 322.

[278] Të gjitha mikrotoponimet i ka shënuar në terren J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), f. 88, 114, 117.

dakorumanishtja e të tjerë për huazim nga shqipja[279] apo (edhe) nga sllavishtja.[280] Në shqipen kjo fjalë është ruajtur në trajtën *shtrungë*, e cila porse nuk ndeshet në të folmen e opojarëve. Për nocionin *shtrungë* në këtë të folme përdoret fjala *burg*. Një çështje që mua më mbetet e paqartë është përhapja e variantit bullgar *stërga* të kësaj fjale vetëm në mikrotoponiminë e krahinës shqipfolëse të Opojës, jo porse edhe në atë bullgarishtfolëse të Gorës. E vetmja dëshmi e ruajtjes së kësaj fjale substratike ose shqipe në të folmen e goranëve mbetet mikrotoponimi *Struga* në katundin Dikancë të Gorës, të cilin autori kosovar J. Osmani e ka shënuar në trajtë jokorrekte si *Struka*.[281] Së këndejmi, kujtoj se nuk e kanë mirë ata studiues, si p.sh. S. Idrizi, [282] që këtë term blegtoral dhe ndonjë toponim a emër vëllazërie, si p.sh. emrin *Struga*, të sajuar nga ky apelativ, e marrin për si të sigurt me prejardhje vllahe.

Duke vazhduar me krahasimin e emrave bashkëkohorë të vëllazërive të këtyre dy regjioneve, do të shihet se analogjitë që dalin në këtë hapësirë lënë shteg për të pohuar se gjuha dhënëse e emërtimeve identike të shqiptarëve e të goranëve është një dhe e vetme, prandaj edhe se nuk kemi të bëjmë me analogji të rastit, përkatësisht me sosh që mund të merren për sporadike. Kështu, një vëllazëri e katundit Buçe të Opojës quhet *Çuçur*, emër ky që e ka të njëjtën gurrë si edhe të dy emrat e vendeve *Çuçul*:[283] njëri në katundin Brod ku ky emër shenjon një lagje të vjetër të katundit dhe tjetri në katundin Restelicë të Gorës. Mungesa e kalimit të mbaresës *-ul* në *-ur* që vërehet tek rum. *măgura* shq. *magulë* "kodër e zhveshur; kullotë"; rum. *viezure* shq. *vjedull*; rum. *mozăre* shq. *modhull*; shq. *avull* rum. *abur* shq. *thumbull* rum. *sîmbure*[284] etj. do të tregonte që këtu ndoshta nuk kemi të bëjmë me ndonjë kontinuitet vllah por/ose me konservim të një gjendjeje që korrespondon me latinitetin ballkanik të para dyndjes mesjetare së " vllehve" nga Jugu i Ballkanit në hapësirën e Kosovës së sotme ose me një konservim të këtij latiniteti nga folësit shqip të banorëve të kryehersëm të këtij ambienti. Ka arsye të

[279] Më gjerësisht për prejardhjen dhe shtrirjen e kësaj fjale khs. Ivan Duridanov, Balkanski etimologii, Bălgarski ezik, 4-5, 1968, f. 404-406.

[280] Kështu mendon p.sh. dijetari çek Karandžalov, La terminologie pastorale commune chez les peuples balkaniques, Actes du premier congres international des études balkaniques et sud-est européennes, VI, Sofia, 1968.

[281] Toponimin e ka shënuar në terren J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 104.

[282] Sh. Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[283] E shënuar nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 91 si *Ququll*.

[284] Shembujt janë huazuar nga libri monumental Istoria limbii române, Bucureşti, 1968, f. 262 të Al. Rosetti.

paravendohet që i njëjti fenomen do të ketë ndodhur edhe tek emri i katundit Çyqylagë i rrethinave të Lipjanit, përkatësisht jo larg nga bjeshkët e Çiçavicës që është sajuar nga emri i çiqëve vlleh, nga të cilët rrjedh edhe emri *Magura* i malit dhe i vendbanimit rrëzë tij *Magura* i këtij regjioni. Emri *Gegica* i një vëllazërie të katundit Blaç të Opojës na e përkujton emrin e vëllazërisë gorane *Gagovci*; emrat e vëllazërive shqiptare *Mariq* e *Maruk/Marluk* të Breznes dhe ai *Marukaj* i Pllavës së Opojës i takojnë të njëjtës shtresë gjuhësore - konfesionale (përkatësisht shtresës vllahe). Duket se emrat e mësipërm të vëllazërive shqiptare nuk mund të ndahen për nga origjina nga emri i sotëm *Marindof* i vendit në katundin Dikancë të Gorës.[285] Emrat e mësipërm mund të rrjedhin (edhe) nga mbiemri vllah *mărunt* "i vockël, shumë i vogël" [khs. antroponimin rumun, *Măran*, *Mărunta*].[286] Në katundin Kosavë të Opojës ekziston vëllazëria *Tërtin* - një emër i ngjashëm me emrin e vëllazërisë gorane *Drnda*/*Drdinci* (në Brod), ndërsa emri *Usulaj* (sot po u shqiptuaka edhe *Ysyl* dhe mëhalla po u quajka *Ysylët*[287]) i një vëllazërie të katundit Brrut të Opojës është padyshim i së njëjtës prejardhje (pa e marrë parasysh procesin e ndryshimit fonetik që ky emër ka pësuar në gojën e opojarëve shqipfolës) si edhe emri i vëllazërisë *Ursulovci* të kaundit Rapçë të Gorës. Emrat *Tërtin* e *Dërdinci* të vëllazërive opojare e gorane duket se nuk mund të ndahen lehtë nga antroponimi *Drdut* që më 1348 për si vend në kufi me katundin e sotëm Buzezë të Opojës është dëshmuar në mikrotoponimin në rasën gjinore -vendore *ou drъtutovu klětь*[288] "tek Guri i Dërtutit", ndërsa emrat e vëllazërive *Usulaj* të shqiptarëve e *Ursulovci* të goranëve janë me prejardhje vllahe dhe rrjedhin nga fjala rumune *urs,-ul* "ari, -u". Ka mundësi që emri *Ursulovci* të jetë zgjerim me prapashtesën sllave *-ovci* i antroponimit *Urs* dhe të shënojë kështu pasardhësit e një pararendësi të quajtrur *Urs,-ul*. Lidhjen kuptimore të këtij emri me të lat. *ursus* "ari,-u" e tregon mbase mjaft qartë emri *Mečkovci* mbase i së njëjtës vëllazëri në katundin Radesh të Gorës, që s'është tjetër pos përkthim sllav i emrit latin ballkanik, vllah *Ursul*-ovci. E njëjta gjë vlen dhe për mbiemrin *Shurdhaj* të katundit Blaç, që në shqipen e ka të njëjtën vlerë kuptimore çfarë në rumanishten e ka edhe emri *Surdulovci* i vëllazërsë në katunsin Rapçë të Gorës. I pandashëm nga ky kontekst do të jetë edhe emri *Kućkovci* bashkë me variantin e tij *Kučkarevci* të vëlla-

[285] Ky emër vendi është shënuar në terren nga Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë 2006, f. 104.

[286] N. A. Constantinescu, Dictionar onomastic romînesc, Bucareşti 1963, f. 319.

[287] Sipas Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë 2006, f. 97.

[288] Khs. Hrisovulja …, f. 302.

zërisë gorane në katundin Brod që më parë se nga mbiemri *kuç* "vorbë me vegëz" apo "i kuq" mund të jetë kuptimisht i barasvlershëm me emrin *Mečkarovci* pasardhës të një vëllazërie që janë quajtur sipas emrit sllavisht *mečka* të arushës (khs. *Meçka*, mtp, në Rapçë e Epërme) ndërsa të dytë bashkë do të jenë përkthime në sllavisht të emrit roman *Ursulovci*.

Nëpër katunde të Opojës gjenden sot edhe emra vëllazërish si *Trupaj* (në Kosavë), *Mangalaq,-ët* (në Zaplugjë), *Rrenakët* (një lagje e katundit Zaplugjë, në të cilin jetojnë vëllazëritë Mahallar e Sahallar), *Velaj* (në Kukël), *Çadelët* (në Zaplugjë) dhe *Tolaj* e *Kozaj* në katundin Shajne.[289] Emrat e vëllazërive opojare janë të të njëjtit burim gjuhësor si edhe emrat e vëllazërive sllavofone të goranëve: *Trupçevci, Mangovci,* (në Brod khs. edhe *Mangrice*, në Lubovishtë), *Rendovci, Veljanovci, Toljevci* dhe *Kozinci.*(khs. emrin e vendit *Kozmina* (në katundin Krushevë).

I trajtuar i shkëputur nga kjo lidhje e mundshme, emri *Rendovci* i vëllazërisë gorane mund të jetë i pandashëm nga emri *Renda*, i ndeshur edhe në trajtën *Rendite*, në çarkun Godečko të Bullgarisë. Dijetari bullgar B. Simeonov[290] e lejon mundësinë që ky emër të ketë dalë nga fjala bullgare *rădъ* me ndërmjetësimin e arumanishtes *rendă*, i përmbajtur edhe në emrat e vendeve *Redava, Redah, Redenicala* të Bullgarisë.

Ka shumë arsye të besohet që emri i vëllazërive shqiptare *Rrenakët* në katundin Zaplugjë të Opojës dhe ai *Rendovci* të Gorës mund të kenë ndonjë lidhje me emrin e katundit shqiptar *Rrenc* të Opojës.

Unë kujtoj se tek emri i këtij katundi ka ndikuar etimologjia popullore e cila me këtë fjalë e ka mbuluar emërtimin e pazbërthyeshëm, të pakuptueshëm *Ranetc* së pari në *Ranec* e më vonë në Rrenc.

Ka shumë mundësi që emri i sotëm Rrenc i këtij katundi të jetë në të vërtetë emri *Ranetc* i majës së malit në kufirin midis katundit Kërstec të Gorës dhe regjionit të Pollogut, që përmendet në krisobulën e vitit 1348 për manastirin e shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit.[291] Dijetari rus që si konzull i Rusisë në Prizren punoi shumë për Serbinë, Ivan Jastrebov, thotë se ky emër po u përmendka edhe në një dokument të gjysmës së parë të shek. XIV dhe e identifikon këtë, për mendimin tim me të padrejtë, me katundin e sotëm Rapça të Gorës.[292] Prejardhjen e

[289] Ky emër është toponimizim i apelativit turk *şahin* "fajkua, gjahtar me fajkua", prej nga rrjedh edhe anroponimi *Şahin.* M. Lutovac, Gora i Opolje e përkthen këtë emër në serb duke u mbështetur në paravendimin se ky vend edhe do të jetë quajtur në krye të herës serbisht [*]*Sokolar*.

[290] Khs. Etimologičen rečnik na mestnite nazvanija ot Godečko. .., f. 209.

[291] Sh. Hrisovulja cara Stefana Dušana (1348), f. 301, 304.

[292] Khs., Stara Serbija i Arbanija, Beograd, 1901.

mirëfilltë të këtij emri e ruan më mirë emri i vëllazërisë gorane *Rendovci*, përkatësisht *Renda* të katundit Brod të Gorës. Do të jetë e vështirë në mos edhe shterpë secila përpjekje që do të përpiqej që emrin e kësaj vëllazërie ta ndante nga fjala shqipe *rænd, rændës* "vrapues, rendës'' e cila, sipas N. Jokl,[293] ka depërtuar edhe në greqishten si ρένται "decursiones equorum vel campus, ubi decurrunt". Lashtësinë e këtij emri shqip të vëllazërisë gorane e tregon pikërisht ruajtja e togut konsonantik *nd* tek trajta Rendovci, fenomen ky që tek shqipfolësit e ka ndjekur zhvillimin që në të folme gege e kanë përjetuar edhe togje të tjera. Togu konsonatik *-nd-* është reduktuar në këtë të folme në *-n-*, prandaj edhe do të mund të paravendohej një zhvllim *rend- ak*, si emër vëllazërie shq. **Rendaj* → sllav. **Rendci* e më vonë *Rendovci*. Po nga kjo fjalë e shqipes, me ndikimin e etimologjisë popullore shqiptare, do të rrjedhë edhe emri i vëllazërisë *Rrenak* i katundit Zaplugjë të Opojës. Unë nuk mund t'i bie në fije as motivit e as mbështetjes së pritur gjuhësore, që për fat të keq mungon, përse ky emër i vëllazërisë na qenka, sipas M. Lutovac[294] me prejardhje vllahe.

Një tezë, për mendimin tim kryesorja dhe më e bindshmja, përkitazi me prejardhjen e pararendësve të goranëve të sotëm është ajo e prejardhjes vllahe. Sado që edhe vetë pretendentët për prejardhjen serbe të goranëve të sotëm si p.sh. antropologu M. Lutovac konstatonte se "Gjurmët vllahe janë transparente ndër emra të vëllazërive gorane, si p.sh. *Ziza*/*Zizinci*, (SG: sot *Ziza*, në katundin Brod) *Renda*, (SG: në katundin Brod) *Bajmakovci* (SG*:* sot *Bajmak* në kat. Restelicë e Brod), *Mandakovci* (SG.: sot Mandak në katundin Brod) etj.'' Analogji onomastike në këto dy krahina ka jo vetëm tek ato emërtime të dala nga antroponimet që, pa e marrë parasysh etimologjinë dhe trajtat shqipe të emrave të gjithkrishterë, porse edhe në emërtime me prejardhje nga antroponime të gjithëkrishtera dhe nga apelativi grekë e vlleh. I kësaj natyre do të jetë p.sh. analogjia midis antroponimit *Marin* të një banori të katundit Bilushë afër Prizrenit (khs. Rada *Marini*) i cili dëshmohet më 1571[295] dhe emrit të vendit *Marince* në katundin Rapçë të Gorës, një vend në të cilin, sipas gojëdhënës dikur paska pasur një kishë.[296]

Në këtë kategori emrash bie edhe paralelja midis emrit të familjes

[293] Khs. Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen, Berlin-Leipzig, 1923, f. 280.

[294] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak, Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I – IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[295] S. Pulaha, Të dhëna ekonomike dhe demografike. ..

[296] Sipas M. Lutovac, Gora i Opolje..., f. 72.

Dikanoviki e cila, spas dokumentit të vitit 1348, kishte dhënë disa priftërinj dhe emrit modern të katundit *Dikance* të Gorës, në të cilën edhe sot ka një vëllazëri *Dikanci* dhe vëllazërisë shqiptare *Dikaj* të katundit Brodosanë të Opojës.[297] Në këtë mes duhet vërejtur që si rezultat i toponimizimit të emrit të një vëllazërie mund të jetë formuar edhe emri i vendbanimit *Dikavec* në rrethina të Shkupit. Ky emër po mundka të rrjedhka nga emri personal shqiptar *Dika* dëshmi të ruajtjes së të cilit po u gjendkan tek mbiemrat familjarë *Dika* në Strugë dhe *Dikanet* në katundin Serbicë të Kërçovës.[298] Nëse kjo shtrirje e muros tezën e ardhjes nga vise të Ballkanit Jugor të vëllazërisë *Dikanoviki* e të banorëve të katundit *Dikance* të Gorës, porse edhe të vëllazërisë shqiptare *Dikaj* të Brodosanës së Opojës apo që ky emër mund të jetë një mbetje e substratit ballkanik të shqiptarëve mbetet çështje që duhet të shihet. Për në mesjetë të vonë, një dëshmi të qenies në përdorim të antroponimit *Dikan* e gjejmë në katundin Sushicë të Istogut, të cilësuar në burimin e vitit 1330 si *vlasi sušičane* " vlleht e Sushicës": Në këtë vendbanim që bashkëjetonin vlleh e shqiptarë kishte më shumë kryefamiljarë me emra tipikë vlleh si *Altoman*, *Baldovin*, *Bolica*, *Bunilovik*, *Hërsçor* dhe dy kryefamiljarë me emra shqip: *Gin* e *Lumsha*. Pikërisht në një kësi ambienti dëshmohet edhe kryefamiljari Jara Bratijakoviq me të vëllain *Dikan*-in e *Tol*-in.[299] Se edhe këtu mund të kemi të bëjmë me një emër të formësuar sipas modelit sllav nga vlleh të sllavizuar, ndoshta tregon rrethana që njëra ndër trajtat e shkurtëra (përveç atyre *Kosta*, *Kosté*, *Kosto*, Koté, *Koto*, *Kojo*; *Koca* m. e f. *Koco*, *Kočo*; f. *Kostena*; *Dinjo*, *Dinko*, *Dinčo*, *Dino*, *Dico*, *Dičo*, *Dito*, *Didjo*, *Dila*; f. *Dina*, *Dinica*; *Kostake*,) të emrit grek *Konstantinos* është në përdorim edhe tek bullgarët edhe trajta *Diko*, ndërsa tek shqiptarët emri grek ndeshet në trajtat *Kostan*, *Kostë*, *Kotë*, *Koto*, f. *Kotinë*, *Koc*, *Kotšo* (lexo *Koço*), *Dini*, *Konin*, *Ndin* e *Nin*.[300]

Mirëpo rrethana që tek shqiptarët në Rrafsh të Dukagjinit gjallon antroponimi (vetëm) femëror *Dyke*, i cili edhe ndër banorë sot sllavishtfolës të krahinës së Sanxhakut vazhdo të jetojë në trajtën *Dika.* Po u mor parasysh rrethana e njohur historikisht që një pjesë e madhe e sanxhakasve janë me prejardhje shqiptare, do të mund të pohohej se në

[297] Këtë emër vëllazërie e ka shënuar në terren J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 88.

[298] Sipas: Dr. Qemal Murati, Deshmime onomastike per autoktonine e shqiptareve ne Trojet etnike të tyre në Maqedoni, Tiranë, 1993.

[299] Khs. Dečanske hrisovulje. .., f. 122.

[300] Prof. Dr. Gustav Weigand: Die bulgarischen Rufnamen, Ihre Herkunft, Kürzungen und Neubildungen, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache (Rumänisches Seminar), 15/1909, f. 126.

rastin e emrave *Dikan-* të goranëve kemi të bëjmë me një emër të vjetër (edhe) të shqiptarëve, të përhapur në një hapësirë më të gjerë se Gora, përfshirë këtu edhe krahinën shqipfolëse fqinje të Opojës.

Po të kihet parasysh fenomeni i përtëritjes së emrave dhe ai i vazhdimit në shumë raste të tyre nga njëri brez tek tjetri, edhe përkundër ndërrimit të fesë apo vetëm të konfesionit, bën të thuhet që tek emrat e shqiptarëve dhe tek emrat shqiptarë të dëshmuar tek banorët e regjionit të Opojës ka një kontinuitet të pandërprerë onomastik. Mbi bazën e analogjisë po kjo gjë duhet të vlejë edhe për emrat e sotëm të vëllazërive të regjionit të Gorës, sado që për këtë regjion nuk e kemi një regjistrim të pronave e të kryefamiljarëve siç e kemi për regjionin e Opojës.

Përveç analogjive në rrafshin e emrave të vëllazërive e të toponimeve me krahinën fqinje të Opojës, materiali onomastik i goranëve sllavofonë ka analogji të shumta edhe me emra vëllazërish e me toponime të regjionit të Malësisë së Tetovës si me sish të dëshmuar ndër burime të shek. XIV ashtu edhe me emra aktualë të vëllazërive e të vendeve. Kështu p.sh., në një dokument kishtar serb të hartuar midis viteve 1337-1346,[301] i cili është në të vërtetë një regjistër i pronave të kishës së Tetovës, përmendet ndër të tjera edhe një vendbanim i quajtur *Stençe selo*. Emri i këtij katundi është i së njëjtës prejardhje si edhe emrat *Shtezna*/ *Shtenza* i krahinës së Opojës dhe *Stenza/Stezno* i vendit në katundin Rapçë të Gorës. Ka shumë gjasë të paravendohet se tek këta emra ruhet fjala e shqipes *shtezë* "kthina më e thellë në një anije", e cila duke e paravenduar një bartje kuptimi në "gropë e thellë" si term i konfiguracionit të terrenit mund ta emërtojë edhe ndonjë gropë të thellë në stere. Por këtë fjalë e ka edhe rumanishtja dhe pikërisht si *ştează* gjerm. Wolkmühle "dërstilë; valavicë" dhe këto dy fjalë dijetari rumun Al. Rosetti,[302] i radhit në grupin e fjalëve që sajojnë të ashtuquajturin union gjuhësor ballkanik.

Për emrin *Štenče* të vendit autori maqedonas B. Koneski mendon se mund të jetë një formim analogjik sipas *Kršten* apo edhe vetëm një trajtë e këtij të fundit.[303]

Nëse këtu kemi të bëjmë me një fjalë e cila vetëm fonematikisht është e ngjashme me emrin *Štenar*, që në krahinën e Dibrës qenka shënuar

[301] Khs. Ljub. Stojanović, Stari srpski hrisovulji, akti, biografije, ljetopisi, tipici, pomenici, zapisi i dr., Spomenik SKA II, Beograd 1890, f. 36.
[302] Shih. Istoria limbii române, Bukuresht, 1968, f. 276.
[303] Po ai, po aty, f. 25, 86.

gjatë mesjetës edhe si *Šten* e i cili, siç mendon B. Koneski,[304] qenka vetëm shembull i produktivitetit të prapashtesës *-ar* përmes së cilës formohen emra të prejardhur mbi bazën e profesionit, përkatësisht të mjeshtërisë që i shkon përdore personit përkatës, mbetet çështje që duhet të shihet. Qemal Murati për emrin Shtençe e pranon mendimin e dijetarit maqedonas duke e parë këtë emër me prejardhje shqipe dhe sjell dëshmitë patronimike: *Leko,* i bir i *Shtenar*-it; Rasha *Shtenar* -i; Petko, i bir i *Shtenar*-it; Gjuro, i bir i *Shtenar*-it të evidentuara në vitet 1467-1468 nëpër katunde të nahijes së Tetovës si edhe emrin aktual *Shtenar* të një lagjeje të qytetit të Prilepit.[305]

Nga emrat aktualë të vëllazërive në krahinën e Gorës, të cilët përputhen me emra vëllazërish të Malësisë së Tetovës bien p.sh. emrat e vëllazërive gorane *Veljçovci, Macina, Çadelovci, Kutinci, Kasovci, Lilovci* (ky i fundit në katundin Brod) të cilët janë identikë jo vetëm për nga forma, porse edhe për nga kuptimi, me emrat e vëllazërive *Velkit* (një pjesë e katundit Bozovcë të Tetovës), *Velet* (një bark i vëllazërisë *Shiket* të Gajres së Tetovës) dhe me emrin e vëllazërisë *Lilet* (një lagje e katundit Lisec) të Malësisë së Tetovës. Disa nga gjurmë të shtresimeve të përbashkëta etnonimike gjuhësore siç janë ato të Gorës janë ruajtur, si gjithandej, edhe ndër mikrotoponime të Malësisë së Tetovës.[306] Kështu p.sh. mikrtoponimi *Shpell e Kukës* në Lisec, *Rrafsha Kozarit, Vorri Hut Macit* në Shipkovicë, *Kroj Memishit* në Bozovcë, *Reka Duranit* dhe *Arapka* në Sellcë të Malësisë së Tetovës na i përkujtojnë emrat e vendeve e të vëllazërive gorane *Kukovci, Kosel*/*Kozel, Macina,* mtp. *Hutov brek* e *Hutov vir* (në Glloboçicë), *Memishevci* (vëllazëri në katundin Radesh të Gorës), *Durakovci* e *Arapovci,* të zgjeruar këtu, si edhe në gjithë onomastikën gorane me prapashtesa sllave. Këtu bien edhe paralelet *Gabrijet* e *Shilegarnik* (në Sellcë të Tetovës), të cilat janë të një prejardhjeje me emrat e vendeve *Gabrojica* (në Zlipotok) e *Shilegarnik* (në Dikancë) të krahinës së Gorës.

Përputhja në rrafshin etimologjik e kuptimor e emrave të vëllazërive e të vendeve të regjionit të Gorës me sish të Malësisë së Tetovës, sado që emërtimet e kësaj kategorie u përkasin kohëve të ndryshme, e lejon nxjerrjen e përfundimit se në etnoniminë e banorëve të regjionit të Gorës ka mjaft edhe asi emrash të cilët janë të së njëjtës gurrë si edhe ata të

[304] Khs. Blaže Koneski, Makedonski mesta i imenja, NIO, "Studentski zbor", Skopje, 1991, f. 25, 26.

[305] Qemal Murati, Deshmime onomastike …, f. 24.

[306] Të gjithë shembujt e emrave të vëllazërive të Malësisë së Tetovës i kam nga kolegu im Fadil Sylejmani, të cilit i falënderohem përzemërsisht.

Malësisë së Tetovës që dëshmohen qysh në shek. 14. Me një shembull katërçipërisht të qartë të vazhdimësisë gorane deri në ditë tonat të emrave të dëshmuar në shek. XIV kemi të bëjmë edhe tek emri i vëllazërisë *Prco*, përkatësisht *Përcanovci* në Krushevë (e ndoshta edhe në kat. Brod) të regjionit të Gorës. Ky emër është mbase i pandashëm për nga prejardhja nga emri i dëshmuar në vitin 1395 në gjinoren sllave *Parcanova* "i, e Parcan-it" që shenjonte njërën ndër prona të kishës së Shën Mërisë së Tetovës.[307]

Këto analogji dëshmojnë, më tej, se antroponimia e banorëve të të dyja këtyre regjioneve në pjesën më të madhe të saj ishte mbuluar nga një shtresë e vetme antroponimike me prejardhje të huaj për popullatën e të dy këtyre regjioneve. Rrethana që për në shek. 14 është dëshmuar se (edhe) në regjionin e Malësisë së Tetovës gjëllinte etnosi shqiptar, përputhjet onomastike të këtyre dy regjioneve e lejojnë nxjerrjen e përfundimit se këto dy popullata i takonin dikur të njëjtës shtresë autoktone parasllave etnike-gjuhësore. Dhe kjo shtresë do të jetë shqiptare e romane ballkanike mbi të cilën u zgjerua elementi ardhës sllav.

7. VENERIME 1

Emrat e vëllazërive të popullatës sllavishtfolëse të Grorës, të krahasuar me ata të popullatës shqipfolëse të regjionit të Opojës dhe të viseve përreth të banuara me shqiptarë formojnë një areal të vetëm, të kryehershëm emëror. Në mbështetje të analogjive të emrave të vëllazërive të këtyre dy krahinave fqinje mund të thuhet se ka mjaft të dhëna të cilat e bëjnë të mundshme që të flitet për një popullatë homogjene shqiptare, romane ballkanike parasllave në të dyja krahinat.

Të dhënat më të rëndësishme që e dëshmojnë jo vetëm përkatësinë gjuhësore të etnonimeve, porse mbase edhe atë etnike josllave dhe bashkëjetesën e bashkëshkrirjen e elementeve etnike shqiptare e vllahe në lashtësi dhe të asaj sllave më vonë, janë pikërisht emrat me prejardhje të romanitetit ballkanik, përkatësisht shtresa vllahe e tyre. Emrat e kësaj provenience tregojnë se popullata josllave e këtij regjioni ishte romanizuar e pastaj edhe sllavizuar për nga onomastika deri në atë shkallë që i afrohet totales, jo porse deri në atë shkallë sa të mos ketë ruajtur edhe emra të trashëguar vendës. Në vazhdim ja një prerje shtresimesh gjuhësore në materialin onomastik të regjionit të Gorës:

[307] Zakonski spomenici. .., f. 423.

8. SHTRESIME GJUHËSORE NË TOPONIMINË DHE NË ETNONIMINË E GORËS

8.1. Shtresa latine - ballkanike (vllahe)

8.1.1. Emra vendesh

Statulj /Shtatul:

Në shenj respekti ndaj lexuesit po deklaroj se hulumtimet në terren në regjionin e Gorës i kam bërë para 35 vitesh, prandaj nuk më është më i njohur katundi goran në të cilin e kam shënuar emrin që do ta trajtoj më poshtë, për të cilin nuk po e gjej të jetë shënuar në literaturën më të re.

Sido që të jetë, këtë mikrotoponim të regjionit të Gorës e mbaj për të së njëjtës prejardhje si edhe mikrotoponimi me prejardhje nga latiniteti ballkanik *Shtatuli* që e kam shënuar vetë në katundin Blaç të Opojës. *Shtatul* quhet në këtë katund një kullotë pas shkëmbit të quajtur *Kisha*. Edhe gërmimet arkeologjike të bëra në këtë vend e paskan dëshmuar se këtu paska qenë një *statio* romake.[308] Jo vetëm konstatimi i arkeologëve, por edhe vetë pozita e vendeve të quajtura e *Statulj* e *Shtatul* e lënë të hapur shtegun për të paravenduar se prejardhjen latine të këtyre emrave do ta tregonte edhe emri *Staćulina* i një vendi afër Trogirit në brigje të Adriatikut, emër ky të cilin P. Skok e sqaronte me fjalën latine *statio* "stacion"[309] Në rastin e emërtimeve kosovare kemi të bëjmë me dy mikrotoponime të së njëjtës gurrë, por me ndërmjetësimin e dy gjuhëve të ndryshme. Kontinuiteti shqiptar i emrit të periudhës romake në trajtën *Shtatul* është konform kalimit të togut konsonantik *st* në *sht* të huazimeve latine të shqipes (khs. ndër të tjera lat. *stratum* shq. shtrat; lat. *striga* shq. shtrigë; lat. *mustum* shq. musht etj.). Trajta gorane Statulj, nga ana tjetër, e paravendon një trajtë **Statul* e cila u ruajt në trajtën me *S-*, përkatësisht *St-* nga romanë ballkanikë që nuk flisnin shqip. Dihet mirëfilli se fjala latine *statio* nuk do të reflektohej në rumanishten e në arumanishten në **ştatul* por në **statule* "qytet i vogël" përkatësist në *staţio* "stacion". Mungesa e ndërmjetësimit shqiptar në kalimin e st -sht vërehet edhe tek emri goran i vendit *Stratorje* dhe *Stratorski potok* (të katundit Glloboçicë), *Stratorje* në katundin Zlipotok dhe *Stratorje* në katundin Krushevë. Ky emër me prejerdhje greke i periudhës bizantine është ruajtur në trajtën e tij me St-, përkatësisht nuk u reflektua si **Shtratorje*, sepse nuk pati ndërmjetësim të shqipfolësve sikundër ndodhi, anasjelltaaz, p.sh. me emrin *Shtatinoc* të një katundi të zhdukur që dikur ishte pjesë e katundit të sotëm Grejkoc të rrethinave të Suharekës. Trajta e kryehershme e emrit të vendbanimit të zhdukur do të ketë qenë **Stratinovc*, një trajtë kjo që gjithsesi është sajuar mbi bazën e termit bizantin *stratiotes* "ushtar"(më gjerësisht për këtë shih më poshtë)

[308] N. Vulić, Antički spomenici naše zemlje, Spomenik, SKA, LXXI, Beograd, 1931, f. 91.
[309] Khs. Prilozi k ispitivanju hrvatskih imena mjesta, III, Nastavni Vjesnik XI, f. 348.

Kapra:

Në punimin e tij polemizues[310] Gustav Weigand thoshte se emri *Kapra* i katundit në rrethin e Gorës, me 157 banorë, mund të jetë me prejardhje nga dalmatishtja e vjetër, por edhe nga arumanishtja. Mundësia e fundit i duket më e besueshme, sepse këndej paska, sipas tij, edhe emra të tjerë rumunë si *Berbati*, *Bukareshti i Madh* e *Bukareshti i Vogël*, i quajtur edhe Gorica.

Shtresës latine-ballkanike i përket edhe mikrotoponimi *Kapra* - një pjesë e bjeshkës, e kullotave të katundit Restelicë të Gorës. Në të mirë të vazhdimësisë shqiptare dhe pra të mungesës së elementit sllavishtfolës si marrës i kësaj fjale latine ballkanike, flet ruajtja në leksikun e shqipes të nocioneve *kaprece, kapricë* që në terminologjinë blegtorale të shqiptarëve shenjojnë delen me brirë, të ngjashëm me sish të dhisë.

Këlkere:

Emra vendesh të sajuara nga goja e shqipfolësve me fjalë të huazuara nga këta prej latinishtes ballkanike janë edhe *Kilikerja* e *Guri Kilikerës* në katundin Blaç dhe *Kërkele*, në katundin Zgatar.[311] Në mikrotoponimet e mësipërme përmbahet fjala *calcaria*, përkatësisht *calcarea* [312] "gëlqere; vend ku del guri i gëlqeres" që në ndonjë të folme shqipe dëgjohet edhe si *këlqere*. Në të mirë të kontinuitetit shqiptar, përkatësisht të qenies në përdorim të përditshëm të fjalës këlkere nga shqipfolësit, pa ndërmjetësim p.sh. të sllavishtes,* shkon edhe zëvendësimi shumë më vonë i kësaj fjale me turqizmën çireq "gëlqere", që në fushën e emrave të vendeve, e gjejmë tek mikrotoponmi *Qyreqost* në katundin Kapre të krahinës së Opojës. Emra vendesh që e përmbajnë këtë latinizëm të shqipes kam gjetur e shënuar para shumë vitesh në: Junik e në Voksh të Gjakovës : *Këlkerja*; *Ledina e Këlkerave* dhe *Këlkerja* në Planejë të Prizrenit.

Orçusha:

Duket se emri i këtij vendbanimi të pjesës kosovare të Gorës mund ta ketë prejardhjen nga një antroponim **Orcus* i gurrave latine. Ky paravendim mbështetet tek rrethana se në një mbishkrim të gjetur në malin Avalla të rrethinave të Beogradit (qytetit të kryehershëm Singidunum "qytet i bardhë" të

[310] Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrier oder der Thraker?, Balkan-Archiv III, Leipzig 1927, f. 232.

[311] Këto mikrotoponime i ka shënuar në terren J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, f. f., 86, 108,148.

[312] Khs. Franz Miklosich, Albanische Forschungen II, Die romanische Elemente im Albanischen, Wien, 1871, f. 8. njësia 107: "*calx* kęlk'ére-ja, kęrk'ele-ja Kalk. H. chelchiere-ja. Bl. chelchiere-a. R. chelchiere calcina. R. kęlk'ér-a, kęrk'él-a, kalkerrę. Tetr. 4. kercele-ja. Dalm.; asl. klakъ; serb. klak; ahd. chalch. Das alb. Wort ist auf calcarea zurückzuführen."; Khs. edhe Carlo Tagliavini: Misvellanea etimologica balkanica, Revue des études balkaniques, I, 3, Beograd, 1936, f. 192.

* Khs. referencën e mësipërme.

keltëve) është dëshmuar emri i hyjneshës *Orchea*, ndërsa ky emër femëror konsiderohet të jetë refleks i emrit mashkullor *Orchinum*/*Urchinium*. Për një tjetër toponim parasllav pikërisht të rrethinave të kryeqendrës së sotme të serbëve të Beogradit, I. Popović e konsideron edhe emrin e katundit *Vŗčīn* të rrethinave të Beogradit. Ky, duke u pajtuar me sqarimin që më parë e kishte dhënë dijetari serb V. Čorović, e rindërton për këtë toponim një trajtë latine **Urcinum*, **Urcinium* (templum) të një tempulli që i paska qenë kushtuar hyjnisë *Orcea*. Lat. **Orcinum*, **Urcinium* emër ky që në serb. rregullisht po u reflektuaka në *Vърčинъ Vrčin. khs. për këtë edhe kalimet *Vrm* nga ’Ορμος, *Vrsar* nga **Ursaria* (ital. Orsera), Vrdovo; Ἄρδιον όρος etj. Tek zhvillimi më tej i këtij emri nuk paska ndodhur likuidometateza, karakteristike për sllavishfolësit “romanishtja anonte kah një kalim në rom. në *o*- kundrejt kalimit në *ŭ*- dhe tingulli **ъ*-, i serbishtes e dha një **ъ*- **ịъ*-. Tingulli palatal *č*- i takon romanishtes së Ballkanit Lindor (“protorumanishtes”) dhe jo sllavishtes (në sllavishten do të pritej vetëm një *c*, si tek *Cavtat* nga *Civitate* etj.”)[313]

Nga burimet osmane mësojmë se një vendbanim i vogël i quajtur *Orçusha* qenka evidentuar në regjistrimin e hollësishëm të popullsisë së Shkupit e të Tetovës në vitin 1455. Ky vendbanim është evidentuar edhe në defterin e viteve 1467-1468 për në nahijen e Tetovës, por tani në trajtën *Orxhusha*. Venbanimi i quajtur kështu është lokalizuar në jugperëndim të Gostivarit, afër katundit të sotëm Reçan.[314] Sado që nuk kemi ndonjë shënim për dyndje banorësh të cilitdo nga këto dy katunde në tjetrin, megjithatë dëshmimi i këtij emri në hapësira të Maqedonisë, kah ka pasur e ka edhe sot torbeshë, dhe ndeshja e tij edhe në hapësirën e Gorës nuk më duket punë krejt e rastit. Kjo aq më parë pse hapësira e sotme e Maqedonisë edhe është atdheu i kryehershëm i goranëve të ardhur në zonat malore shqiptare. Fundja, ky nuk do të ishte rasti i vetëm që në ambiente malore të Kosovës, madje pikërisht në sosh të cilësuara për vllahe, të ketë emra vëllazërish (vendbanimesh) të së njëjtës prejardhje si edhe disa sosh në Maqedoni. Për rast tipik mund të merret emri i katundit Pagarushë i malësisë së Suharekës, banorët e të cilit që në vitin 1348 cilësoheshin për vlleh (khs. *vlasi paragušani*) dhe katundin *Pagarusha* në juglindje të Shkupit, i dëshmuar në shek. XV. Në dritën e mundësisë që goranët e sotëm të jenë pjesë e popullatës së bogumilëve apo e popullimit të zonave të Gorës në kohën e pushtimit bullgar të këtij regjioni do të rezultonte që emri Orçusha të jetë bartur nga hapësira gjuhësore e bullgarishtes ndoshta që para pushtimit serb në shek. XII të këtij regjioni dhe të pjesëve të tjera të Kosovës së sotme.

Orgosht

Me prejardhje romane do të jetë mbase edhe emri i katundit *Orgosht* i krahinës së Gorës. Ky propozim mbështetet jo tek ndonjë etimologjizim imi,

[313] Khs.Ivan Popović: Bemerkungen über die vorslavischen Ortsnamen in Serbien, f. 103
[314] Khs. Turski dokumenti za istorijata na makedonski narod,. .., f. 321.

porse vetëm tek analogjia e vlerësimit nga Vl. Georgiev[315] për si i prejardhjes romane të emrit të vendbanimit *Ogosta* të Bullgarisë, të cilin ky nuk e zbërtheu më hollësisht. Prejardhja romane e propozuar nga unë e këtij emri do të bëhej e besueshme sikur të mund të sqarohej drejt e bindshëm prania e tingullit *r* në variantin shqiptar *Orgoshta*. Të dy këta emra, pa pas dhënë ndonjë sqarim gjuhësor për të prejardhjes vllahe, përkatësisht romane ballkanike, i mban edhe Sadik Idrizi.[316]

Fugaj/Kalander

Emra të tjerë të përkatësisë romane ballkanike të krahinës së Opojës do të jenë mbase emri *Fugaj* i një vëllazërie të katundit Kapre. Ka gjasë që ky emër të rrjedh nga fjala latine-romane *fugere*, e cila në shqipen, e shënuar tek Frang Bardhi si folje *fugúem* lat. currere; rum. fug fugio "ai që ik / ikën, ikës, shpejtak"[317] apo nga rum. *a fugi* "ik" siç ndeshet në të folme lindore të serbishtes[317a] si edhe emri *Kalander* i një vëllazërie të katundit Kosavë të krahinës së Opojës. Në një vlerësim librit të Th. Capidan*-it, dijetari i merituar kroat P. Skok vlerësonte se Th. Capidan-i po bëka shumë supozime. P. Skok e shtronte në këtë mes pyetjen nëse ekzistonte ndonjë dallim midis aromunëve dhe vllehve të Serbisë dhe çfarë ishte ky dallim. Kësaj pyetjeje retorike Skok i përgjigjej me paravendimin e arsyeshëm se përkitazi me këtë çështje "sot nuk mund të dihet asgjë", duke konstatuar se "Analiza e emrave serbë me prejardhje josllave na e lejon përfundimin, se "nuk guxojmë që të gjithë vllehtë e Serbisë t'i marrim për rumunë. Antroponimet *Kalèmber* dhe *Muzhdeka* rrjedhin p.sh. pa një pa dy nga dy burime të ndryshme. I pari është emër aromun: *Calimbară* (udhë e mbarë), një emër personal si emri shqip Mirdita (kroat. "dobar dan") në Shqipëri. [...]"[318] Për emrin e dytë, P. Skok e propozonte, mbase gabimisht, prejardhjen shqipe të tij.

Puga

Një mikrotoponim me prejardhje nga latiniteti ballkanik i krahinëzës së Opojës do të jetë vendi i quajtur *Pugat* dhe mikrotoponimi tjetër i lidhur me të parin *Maspuget*, në katundin Rrenc dhe *Pugat* në katundin Kapre të Opojës. Në

[315] Khs. Vladmir Georgiev, Značenieto na geografskite imena za vъprosite etnogenezisa, Bъlgarski ezik, V, Sofia, 1955, f. 6.

[316] Sadik Idrizi: Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k -.

[317] Fr. Miklosich, Romanische Elemente im Albanischen. .., njësia 359, f. 28.

[317a] Ivan Popović, Vlacho-Serbica (Der rumänische Spracheinfluß auf das Serbokroatische und dessen Geographie), Südost-Forschungen, Bd. XXI, 1962, f. 371.

* Në trajtesën e tij Raporturile albano-române, Dacoromania II, 1922, cit. sipas P. Skok, Iz Rumunske Literature o Balkanskim Vlasima. ..

[318] Khs. Petar Skok: Iz Rumunske Literature o Balkanskim Vlasima, në Glasnik Skopskog Naučnog Društva, Vëllimi II, Fashikulli 1-2, Shkup, 1927, f. 308.

të dy këta emra vendesh përmbahet mbase apelativi latin *pūga* që në shqipen nuk dëshmohet të jetë ruajtur në kuptimin "mollaqe, vithe".

8.1.2. Emra vlleh

Bazë e gjurmimit tim të elementeve latine-ballkanike në regjionet e Gorës e të Opojës nuk ka qenë e nuk është punimi i S. Idrizit i botuar tani vonë. Megjithatë, për hir të plotnisë së tezës së shtruar, po i sjell më poshtë mikrotoponimet dhe emrat e vëllazërive të hapësirës së Gorës këndej e andej kufirit politik midis pjesëve të krahinës së Gorës në Kosovë e të asaj në rrethina të Kukësit në Shqipëri, të cilat nga S. Idrizi konsiderohen për me prejardhje aromune-vllahe.:[319]

8.1.3. Mikrotoponime me prejardhje aromune-vllahe:

Atinica (mahallë në Restelicë), *Balevo brdo* (vend në Krushevë), *Barbula* (vend në Krushevë), *Berova vodenica* (vend në Borje, Shqipëri), *Bijanec* (vend në Globoçicë), *Bogdanica* (vend në Radesh), *Bogdanov potok* (vend në Rapçë), *Bogdiçe* (vend në Cërnolevë, Shqipëri), *Bojçin potok* (vend në Radesh), *Borilojca* (vend në Zli Potok), *Budev rit* (vend në Rapçë), *Budinoec* (vend në Borje, Shqipëri), *Bureshevec* (vend në Orgostë), *Def* (bjeshkë e Restelicës), *Dërbuloec* (vend në Pakish, Shqipëri), *Dërshofora* (vend në Orgostë), *Dragaš* (vendbanim në Gorë), *Dukance* (vend në Vranisht), *Galaiç* (bjeshkë në Gorë, Shqipëri), *Garje* (vend në Globoçicë), *Gërçke rupe* (vend në Restelicë), *Gërçko tërlo* (vend në Shishtevec, Shqipëri), *Gërkov dof* (vend në Pakish, Shqipëri), *Gimitash* (bjeshkë e Restelicës), *Gostil* (topnim, dikur katund), *Gramada* (vend në Restelicë), *Gramatnikoec* (vend në Globoçicë), *Gurelj* (mahallë në Restelicë), *Ileve mllake* (vend në Shishtevec, Shqipëri), *Julica* (vend në Cërnolevë, Shqipëri), *Kalabak* (bjeshkë e Shishtevecit, Shqipëri), *Kalina* (vend në Krushevë), *Kapesh* (vend në Rapçë), *Klise* (vend në Cërnolevë), *Korije* (vend në Rapçë), *Kozmina* (vend në Krushevë), *Krakoshta* (pjesa e poshtme e Dragashit), *Krastaec* (vend në Restelicë), *Kukaljane* (katund në Gorë), *Loticka* (vend në Orgostë), *Lucino* (vend në Dikancë), *Lupanovo jabuçe* (vend në Borje, Shqipëri), *Mangrece* (vend në Mlikë), *Mavra* (bjeshkë midis Zli Potokut i Brodit), *Midov izvor* (vend në Brod), *Mijalove mllake* (vend në Dikancë), *Muçinova* (vend në Krushevë), *Murixha* (vend në Brod), *Murga* (vend midis

[319] Khs.: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I–IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.): Materialin e shenjuar në këtë paratezë ma dërgoi vetë autori S. Idrizi, të cilit i falënderohem përzemërsisht. Këtë material unë e transliterova në shqip dhe e radhita sipas rendit alfabetik të shqipes. Pa pas propozuar asnjë etimologji konkrete, të gjithë këta emra z. S. Idrizi i konsideron për me prejardhje vllahe. Unë mund ta mbështes prejardhjen vllahe vetëm të disave nga emrat e propozuar nga autori. Mirëpo unë heq dorë nga polemizimi, prandaj në këtë trajtesë për të prejardhjes romane-ballkanike do t'i trajtoj vetëm ata emra për prejardhjen romane ballkanike të tyre gjeta mbështetje në literaturën profesionale, kompetente nga fusha e romanistikës.

Krushevës e Shishtevecit), *Nikelo bërdo* (vend në Borje, Shqipëri), *Okletec* (bjeshkë e Krushevës), *Orçikle* (katund në Gorë, Shqipëri), *Orqusha* (katund në Gorë), *Oreshek* (katund në Gorë, Shqipëri), *Orgosta* (katund i Gorës, Shqipëri), *Pakisha* (katund në Gorë, Shqipëri), *Paraspor* (vend në Vranisht), *Peterce* (mahallë në Radesh), *Pirova njiva* (vend në Krushevë), *Pleote* (vend në Dikancë), *Priporishte* (vend në Restelicë), *Qelepino* (bjeshkë e Restelicës), *Racevo bërce* (vend në Zli Potok), *Radesha* (katund në Gorë), *Radov kamen* (vend në Krushevë), *Radunica* (vend në Ljuboshtë), *Romanice* (vend në Ljuboshtë), *Roša* (bjeshkë në Brod), *Selishta* (mahallë në Glloboçicë), *Stratorje* (vend midis Zli Potokut, Glloboçicës e Krushevës), *Struga* (vend në Dikancë), *Shishtejec* (katund në Gorë, Shqipëri), Shtedin (bjeshkë në Brod), *Shtezno* (vend në Rapçë), *Shutman* (vëllazëri në Zlipotok dhe bjeshkë midis Zli Potokut e Brodit), *Tumba* (vend në Krushevë), *Uboza* (vend në Krushevë), *Vagançe* (vend në Zli Potok), *Viljan* (vend midis Vranishtit e Dragashit), *Vla(h)inica* (vend afër Borjes, Shqipëri), *Vlani sad* (vend në Cërnolevë, Shqipëri), *Vlaška* (vend në Vranisht), *Vlaške livade* (vend në Vranisht), *Vlaški potok* (vend në Vranisht), *(V)laškište* (vend në Vranisht), *Vraca* (bjeshkë e Restelicës), *Zabosovo* (vend në Mlikë), *Xhurxhevica* (vend në Vranisht).

8.1.4. Emra vëllazërish (vetëm disa sish) me prejardhje vllahe në pjesën kosovare të Gorës:[320]

Në katundin Brod: *Amada, Barbut, Baska, Bengo, Bogdan, Bojda, Bufle, Butalen, Buza, Cako, Caro, Cura, Çajko, Çapar, Çiço, Çuç, Çuçul, Doçka, Dërnda, Drango, Drindo, Fixhgo, Gago, Gosho, Gugna, Kalinka, Kango, Karpaq, Kesasi, Kërto, Krzho, Koço, Kolo, Kotro, Kurt, Lala, Lika, Lila, Lokan, Lusha, Llompar, Mandak, Mango, Mento, Mido, Mokoç, Paçka, Pajçe, Palosh, Panda, Përçko, Puhto, Pupe, Pure, Qaja, Rahte, Renda, Seba, Shata, Shatkala, Shisho, Shokar, Shop, Shurban, Shuta, Tananaz, Tota, Tuqka, Tunko, Tutar, Veqka, Veljan, Zijade, Ziza, Zhila, Xhafçe, Xhamper, Xhaxho, Xhejmen, Xholopan, Xhurxho*

Në katundin Glloboçicë: *Čukulj, Hočko, Kajkuš, Kojčin, Ljajko, Nelja, Pajko, Piro, Šola, Tatar, Tudžar*

Në katundin Leshtan: *Anxhurovci*

Në katundin Krushevë: *Aljabak, Bero, Duro, Dute, Kajrak, Kendo, Ljupan, Përco, Toro, Xhajko, Zhagul*

Në katundin Zlipotok: *Kare, Kërço, Kokle, Mërço, Shutman.*

Në katundin Restelicë: *Bajmak, Bale, Bazda, Boza, Çoko, Çolda, Doda, Efe, Gorde, Gurgushka, Kaqka, Kalo, Kokora, Kuka, Kushi, Liko, Mekaça, Mikina, Mushe, Mutash, Parko, Pasha, Reka, Sulta, Shiko, Shuplja, Shusha, Tuçe, Xhinxho, Xhuzel, Zhuljka*

Në katundin Dikancë*: Drangovci, Tonga*

[320] Sipas S. Idrizi, në referencën 318.

Në katundin Rapçë: *Balaban, Surdulovci*

Në katundin Radesh: *Sharda, Xhurashkovci*

Disa mbiemra e emra vëllazërish në Gorë (Shqipëri)

Në katundin Borje: *Bungurovci, Çabrakovci, Çaçkinci, Çekorinci Çinarovci, Çkepërnovci Çkorovci, Çuçinci Çupinci, Dalaçinci, Dapkovci, Debrusovci, Dishovci, Dupeshovci, Fuçkovci* (vëllazëri e ardhur nga Pakishi), *Gixhevci, Goxhovci, Kapanovci, Karevci, Kushkovci, Lakovci Niketevci, Piljuljevci, Shkorovci, Shoshinci, Xhaklevci, Shundo-Shundinci*

Në katundin Shishtevec **a)** emra vëllazërish: *Damatovci, Doçovci, Drajçinci, Groshovci, Kumaniçovci, Maretovci, Markočovci, Zhivkovci*

b) mbiemra: *Çaka, Draga, Grisha, Kalabak*

c) toponim dhe mbiemër: *Murga*.

Në katundin Pakish: *Puravinci* (vëllazëri); *Vllaça* **(**toponim dhe mbiemër)

Në katundin Zapod: *Shushljakovci*

8.1.5. Emra vlleh të vëllazërive në pjesën e Gorës në Shqipëri:[321]

Bungurovci (vëllazëri në Borje), *Cekovci* (vëllazëri në Borje), *Çabrakovci* (vëllazëri në Borje), *Çaçkinci* (vëllazëri në Borje), *Čaka* (mbiemër në Shishtevec), *Çekorinci* (vëllazëri në Borje), *Çinarovci* (vëllazëri në Borje), *Çkeprnovci* (vëllazëri në Borje), *Çkorovci* (vëllazëri në Borje), *Çupinci* (vëllazëri në Borje), *Çuçinci* (vëllazëri në Borje), *Dalaçinci* (vëllazëri në Borje), *Damatovci* (vëllazëri në Shishtevec) *Dapkovci* (vëllazëri në Borje), *Debrusovci* (vëllazëri në Borje), *Dishovci* (vëllazëri në Borje), *Doçovci* (vëllazëri në Shishtevec), *Draga* (mbiemër në Shishtevec), *Drajçinci* (vëllazëri në Shishtevec), *Dupeshovci* (vëllazëri në Borje), *Fuçkovci* (vëllazëri në Orgoshtë, e ardhur nga Pakishi), *Gixhevci* (vëllazëri në Borje), *Goxhovci* (vëllazëri në Borje), *Groshovci* (vëllazëri në Shishtevec), *Kapanovci* (vëllazëri në Borje), *Karevci* (vëllazëri në Borje), *Kumaniçovci* (vëllazëri në Shishtevec), *Kushkovci* (vëllazëri në Borje), *Lakovci* (vëllazëri në Borje), *Markoçovci* (vëllazëri në Shishtevec), *Maretovci* (vëllazëri në Shishtevec), *Niketevci* (vëllazëri në Borje), *Piljuljevci* (vëllazëri në Borje), *Puravinci* (vëllazëri në Pakish), *Shkorovci* (vëllazëri në Borje), *Shoshinci* (vëllazëri në Borje), *Shushljakovci* (vëllazëri në Zapod) *Xhaklevci* (vëllazëri në Borje), *Kalabak* (mbiemër në Shishtevc), *Grisha* (mbiemër në Shishtevec), *Zhivkovci* (vëllazëri në Shishtevc), *Murga* (toponim dhe mbiemër në Shishtevc), *Vlaça* (toponim dhe mbiemër në Pakish), *Šundo-Šundinci* (vëllazëri në Borje).[322] Në një punim të tijin, të cilin autori S. Idrizi ma dërgoi në dorëshkrim, për emra romanë i mban edhe antroponimet: Polat, Tuna, Nigo, Rase, Niv, Avan e Ugras.[323]

[321] Lëndë e huazuar nga punimi në dorëshkrim i Sadik Idrizi Aljabak: Gora - Jedan pogled unazad, i renditur nga unë sipas alfabetit të gjuhës shqipe.

[322] Si në referencat 318, 319.

[323] Sadik Idrizi Aljabak: Gora - Jedan pogled unazad (dorëshkrim).

Sado që e solla më sipër, unë nuk mund t'i pranoj për si me prejardhje vllahe toponimet me prejardhje greke-bizantine *Stratorje*, *Mavra* e *Paraspor*; nuk mund t'i marr për toponime vllahe emrat me prejardhje shqipe si *Balevo*, *Baljevo brdo*, *Gurelj*, *Ileve mlake*, *Klise*, *Murga*, *Muridža*, *Struga*, *Štezno*, *Tumba*; së pakut sa kohë që nuk është dëshmuar mundësia që këta emra nuk do të jenë sjellur apo që nuk janë sajuar nga vllehë, unë nuk mund t'i marr për emra vllehë toponimet sllave *Dragaš*, *Krakošta*, *Radeša*, *Radov kamen*, *Orešek*, *Torce*, *Viljan*, *Gostil*, *Bogdanov potok*, *Bogdanica*, *Zabosovo*, *Radunica*, *Pleote*, *Krastaec*, *Bijanec*, *Mef*, *Uboza*, *Radočel*, *Mijalove mlake*, *Budev rit*, *Bojčin kamen*, *Garje*, *Borilojca*, *Budinoec*, *Berova vodenica*, *Grdov dof*, *Bogdiče*, *Rapušnica*, *Selišta*, *Koselj*, *Mef*, *Korije*, *Kozmina*, *Štedin*, *Ploš*, *Def* sa kohë që nuk mund të dëshmohet që popullata ardhëse vllahe, bullgarishtfolëse, këta emra nuk do t'i ketë sjellë në atdheun e tyre të dytë të zgjedhur.

Po të njëjtin qëndrim e kam edhe përkitazi me emrat e vëllazërive gorane *Liko, Balje, Doda, Kaljo, Reka, Čoko, Lika, Nelja, Lila, Cako, Ljokan, Kokle, Caro, Kajkuš, Kuka, Karpać, Šata, Kuši, Drango, Renda, Dočka, Ljuša, Koljo, Čapar, Paljoš, Bufle, Cura, Buza, Lala, Tuče, Tućka, Paša, Mata, Hoda,* të para nga S. Idrizi për si me prejardhje vllahe.

Është e vështirë për mua ta marr vesh përse emrat *Cekovci, Čačka-Čačkinci, Čekorinci, Činarovci, Čupinci, Dišovci, Dočovci, Šošinci, Džaklevci, Griša* e *Murga* do të duhej të ishin me prejardhje vllahe, së pakut sa kohë që autori nuk ka sjellë zbërthime konkrete etimologjike të këtyre emrave e as nuk ka sqaruar se mbiemra nga i njëjti burim mbajnë edhe shqiptarët e krahinave të Opojës e ata të rrethinave të Kukësit dhe më gjerë.

Unë nuk mund ta miratoj as mendimin që edhe emrat e vëllazërive *Ćaja*, *Đuzel*, *Tudžar*, *Kurt*, *Đafče*, *Balaban*, *Tatar*, *Čajko* e ndonjë tjetër në pjesën e Gorës në rrethina të Kukësit na qenkan me prejardhje vllahe, sa kohë që katërçipërisht duket se këta mund të jenë me prejardhje turke-orientale.

8.1.6. Emra vendesh

Për një komponente të fortë vllahe në trungun etnik të kryehershëm të goranëve shkruan edhe Sadik Idrizi. Në vazhdim po e sjell një pasus të gjatë nga punimi i tij, më shumë vetëm për të parë se teza e substratit vllah e trakas në etnogjenezën e goranëve e mbase edhe të pomakëve, jurukëve e "torbeshëve" të tjerë të cilën shpresoj ta kem dëshmuar në dritën e onomastikës, është një tezë që duhet marrë seriozisht në konsideratë. Autori S. Idrizi shkruan se [...] Edhe në kërkimet shkencore moderne po zbulohet gjithnjë e më shumë palimpsesti etnik historik dhe po zbardhet prejardhja dhe historia e këtij populli, në rend të parë në dritën e argumenteve historike të cilat deri tani ishin nën hijen e aspiratave politike, pastaj në dritën e pjesës substratatike të onomastikës, në dritën e pasurisë dhe të autenticitetit të traditës dhe të të gjitha farëve të folklorit, por edhe në dritën e specifikave gjuhësore të kulturës antropologjike. Në këtë kontekst etnik bën të thuhet se e gjithë popullata e zonës së Maleve të Sharit

është popullatë autoktone me prejardhje të përbashkët ose krejt të afërt; se është popullatë e lashtë ballkanike; se më e madhja për nga numri në këto hapësira do të ketë qenë popullata me prejardhje aromune (vllahe) dhe se përkrah vllehve, përmenden edhe Jurukët, pastaj Karakaçanët (në hapësirën nga Janina në Greqi, nëpër Rodope e Malin Ballkan deri tek Sliveni [SG.: Svileni?] në Bullgari). Kjo tezë gjen mbështetje të fortë edhe në terren edhe në shkencë, prandaj do të mund të ndodhë që popullata e vjetër e këtij brezi gjeografik-etnik e ka prejardhjen nga etnosi lashtoballkanik i trakëve të stërlashtë e pastaj, edhe nga ato grupe të cilat shumë kohë para erës së re ishin ardhur nga Lindja, u infiltruan në bashkësitë etnike të lashta të Ballkanit dhe u asimiluan me ato, sipas modelit të bullgarëve dhe të konvertimit të tyre.

Këndej kishte ujgurë, kumanë, peçenegë, tatarë, mongolë, prototurq e, më vonë, edhe sllavë. Kjo bashkësi sllave ishte etnikisht imune dhe në të u shkrinë grupet më të vogla etnike duke i pranuar resurset gjuhësore (dialektet) dhe traditën sllave. Kadastrimet/regjistrimet që osmanët/turqit i bënë pas ngulitjes së tyre në Ballkan në fillim të shek. 15 tregojnë se sistemi dominues antropologjik ishte ai aromun (vllah) dhe se ky (sistem) u opononte ndikimeve bizantine e romake - sidomos në rrafshin e besimit (krishterizimit të dhunshëm dhe raporteve feudale në shoqëri). Kjo e dëshmon gjithashtu tezën që në rrafshin e besimit e gjithë popullata e Trakisë së dikurshme (nga Janina në Greqi deri në Gjerdap në Veri - nëpër brezin e sistemeve malore të Rodopeve e të Maleve Dinarike në Perëndim, deri përtej Bosnes e pjesërisht edhe përtej Kroacisë) - ishte vllahe, bogumile dhe se nga ky civilizim kanë mbetur shumë monumente, shkrime, makro e mikrotoponime (khs. *Dragovica* në Bullgari, *Dragaš*, *Dragobia* në Shqipëri, *Dragodan*, e ndoshta edhe *Dragačevo* e ndonjë tjetër). Kanë mbetur edhe shumë argumente të pagjurmuara e të lëna anash nëpër anale greke e romake, pastaj ato përkitazi me dhunën e ushtruar nga Bizanti e nga Nemanjidasit mbi popullatën bogumile (khs. Žitije sv. Save nga murgu Bogumil, si dhe biografitë e vjetra serbe të sundimtarëve e të klerikëve dhe sidomos analet e vjetra greke e bizantine mbi qërimin e hesapeve dhe me përndjekjet e bogumilëve). Bogumilët nuk ishin kurrsesi ndonjë sekt, porse religjion, dogma e të cilit mbështetej tek dualizmi i Manas-it. Në mbështetje të kësaj teze mund të paravendohet që bogumilët u strehuan në Malet e Rodopeve, në Malet e Sharit, në Malin Ballkan, në Bjeshkët e Nemuna e në Malet Dinarike, - ku për kohë të gjatë e përballuan krishterimin. Në këtë kontekst mund të flitet edhe për bogumilët në Sanxhak, Bosne e Hercegovinë, Mal të Zi. ..".[324]

Tezën e mundshme që te popullata e quajtur *goran*, *tobesh*, *pomak* të kemi të bëjmë me një popullatë autoktone të substratit roman ballkanik që do të jetë asimiluar nga pushtues të ndryshëm, e kundërshton mjeku goran Sadik Idrizi. Autori ynë mendon se, "Krahas me torbeš-ët, në Gorë është dëshmuar edhe prania e vllehve, e jurukëve/jyrykëve (tanimë të asimiluar) porse edhe e

[324] Sadik Idrizi: Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k -

shqiptarëve. Megjithatë, teza mbi asimilimin e substratit të popullatës autoktone aromune vështirë se mund të qëndrojë në këmbë të veta. Së pari pse ndikimi i pushtimeve në këto zona aq të largëta edhe në mos ketë qenë i parëndësishëm, do të ketë qenë, së pakut, tejet i dobët. Së dyti, edhe sikur ta pranonim të përkundërtën, reflekset në gjuhë, kulturë etj., për shkak të sundimit të gjatë dhe të ndikimit të kishës ortodokse të tyre do të ishte edhe më i gjatë në këtë zonë. Duke qenë se kjo nuk ndodhi dhe pse reflekset janë më shumë maqedonase, na mbetet të besojmë se kemi të bëjmë me një popullatë ardhacake, ku elementi torbesh sllav, sado që qëkur i maqedonizuar, dominoi në rrethana të një simbioze bukur të gjatë. Duke e lënë të hapur çështjen se cilat janë ato elemente që bënë që *torbeš*-ët t'i përvetësojnë nga kultura e vllehve, jyrykëve e shqiptarëve, e përtërijmë shtegun përmes të cilit e kaluan torbeš -ët, derisa arrijnë në hapësirat e sotme, në mënyrë që të mund ta zbardhim etnogjenezën dhe identitetin e tyre.[325]

Mirëpo siç do të rezultojë në vazhdim të kësaj trajtese, mikrotoponimia aktuale si dhe emrat e vëllazërive të këtij regjioni e ka ruajtur kujtimin për ekzistimin e popullatës romane ballkanike të quajtur nga sllavët për vlleh, sado që në burime kishtare serbe për në këtë regjion ajo popullatë nuk është dëshmuar shprehimisht. Kështu p.sh. në katundin Brod të regjionit të Gorës ekziston vëllazëria e quajtur *Kucovlasi*. Sikundër dihet, popullata romane e Ballkanit Qendror dhe e atij Jugor përveç nën emrin e përgjithshëm *vllah* njihet edhe me emrat *Aromun, Morovllah***,** *Makedorumun* dhe me emrat sinonimikë *Kutzovlah,* (lexo: Kucovllah), *Karagun* e *Cincar*, ndërsa vllehtë e Istrisë (Kroaci) dhe të Bosnes njihen nga sllavët ballkanikë dhe nga grekët me emrat *Karagun, Čići, Čiribići, Crnovunci* etj. Njohësi më i mirë i historisë së shqiptarëve, kroati Milan Šufflay, i përmend vetëm shkarazi *Kucovllahët* dhe pikërisht në zona skajore të Kosovës. Për vlleht Šufflay flet në të vërtetë si për rumunët të cilët në mesjetë paraqisnin një "*Kontinuitet të zonës dalmate të Morlakëve/Morovllëheve të Zetës Lindore ose të Malit të Zi. Kjo degë* (e vllehve) *në perëndim të Drinit të Zi deri në masivin e Bjeshkve të Nemuna shqiptare paraqiste në mesjetë një brez interesant të simbiozës etnike, në të cilin popullata blegtorale shqiptare e rumune u shkri me bujqërit sllavë*".[326] Emri *kucovllasi* i vëllazërisë gorane nuk mbetet i vetmuar. Në të mirë të prejardhjes vllahe të goranëve, apo të ekzistimit të një komponentje vllahe midis tyre mund të merret cilësimi për "i vllehve" në fund të shek. 15 i vilajetit të sanxakut të Prizrenit [Eflakan-i Prizren] që ka të bëjë me një njësi të veçantë territoriale e cila përfshinte blegtorët e Gorës.[327]

Konstatimin e mësipërm e dëshmon prania e disa mikrotoponimeve deri në ditët tona (sado të padëshmuara nëpër burime të shkruara) në të cilat është ruajtur emri "vllah" i popullatës romane ballkanike, përkatësisht vllahe. Të këtillë janë emrat: *Vlaška / (V)laškište, Vlaške livide* e *Laški potok* ← **Vlaški*

[325] N. Dokle, Po aty.
[326] Khs. Serbët dhe Shqiptarët, Prishtinë, 1968, f. 29.
[327] Sipas Mr. H. Meleqi, f. 59, i cili mbështetet në një punim të S. Rizajt.

potok [në Vranisht], *Vlaška*, e *Vlaška ravn* [fushë, kullotë midis katundeve Mlikë e Vranisht të Gorës], *Vlaška padina*, *Vlaška ravn* (tjetër); *Laški put* ← **Vlaški put*, [në Zli Potok]; të cilat i përmend madje edhe vetë pretendenti i tezës së prejardhjes serbe të goranëve - M. Lutovac.[328] Këtu bien edhe mikrotoponimet *Vlahinica* e ndoshta edhe ai *Vlani sad* (i pari në Borje e i dyti në Cërnolevë të rrethinave të Kukësit-Shqipëri) si edhe patronimi *Vllaša* në katundin goran Pakish të rrethinave të Kukësit.[329]

Vetëm duke e paravenduar mundësinë e rënies së tingullit nistor *v-* të emrit *vllah*, siç ka ndodhur tek emri Llashkadrenoc (nga një *Vlashki Drenovac "Drenovci i vllehve" i katundit të komunës së Klinës, këtu mund të bie edhe emri i vendit *Gryka e Vllakut* në katundin Zgatar të Opojës.[330] E gjithë kjo do të mund të besohet nëse as ky e as emrat e përmendur më sipër: *Laški potok* e *Laški put* nuk do të jenë sajuar nga apelativi sllav në trajtën e tij jo domosdo vetëm bullgare *lăk* "kënetë" khs. serb. *luka*[*] dhe emrin Llashticë të katundit në komunën e Gjilanit dhe nëse tek mikrotoponimi opojar nuk kemi të bëjmë me apelativin lokal *vllak,-u* të cilin në një katund të Opojës e kam shënuar vetë para më shumë se 30 vitesh me prejardhje sllave me kuptimin e sajit të madh që përdorej për zhdjergien e drunjve të prerë të mëdhenj nga lartësi malesh deri në vend prej nga mund të barten me qerre ose me ndonjë mjet tjetër.

Përveç në ndonjë emër vëllazërie e në ndonjë mikrotoponim, elementi etnik vllah në këtë zonë po u dëshmuaka edhe në vargje të një kënge popullore gorane: *Săнce zajde među*[**] *dve planine, a ja legna među dve vlahine*.[331] "Leu Dielli midis dy bjeshkësh, e unë u shtriva midis dy vlleheve".

Duke u bazuar në konfiguracionin e terrenit i cili në kushte të mesjetës së vonë s'mund të ketë qenë i përshtatshëm për asgjë tjetër përpos për blegtori, më drejt se për kudoqoftë tjetër mund të përjashtohet hipoteza e historiogafisë serbe se nën nocionin *vlahь* duhet të kuptohet në përgjithësi blegtori (edhe sllav), sepse këtu kemi të bëjmë, mbase pa kurrfarë dyshimi me blegtorë të përkatësisë etnike romane-ballkanike, përkatësisht vllahe. Këtu do të binin edhe mikrotoponimet aktuale. Çështje jashtëgjuhësore, por e rëndësishme për kthjellimin e gjithë problematikës është zgjidhja e emërtuesit. Cila ishte ajo popullatë vendëse që elementin roman ballkanik e quajti vllah dhe që emrat e vendeve që e përmbajnë këtë distinktiv i formësoi sllavisht, përkatësisht serbisht.

Se në këtë hapësirë vlleh kishte edhe në shek. 14 e dëshmon edhe

---

[328] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[329] Të cilat i ka shënuar N. Dokle sh. librin e tij Për Gorën dhe goranët, (Artikuj e studime), Prizren, 2002, f.. 58.

[330] Të shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 148.

* Duhet vërejtur në këtë mes që në hapësirat e të dyja këtyre krahinëzave (Opojës dhe Gorës) nuk ka asnjë mikrotoponim *Luka/Lluka.

[**] Ndoshta do të duhej të jetë shkruar *mežду*.

[331] Nazif Dokle, Për Gorën dhe goranët, (Artikuj e studime), Prizren, 2002, f.. 58.

mikrotoponimi *Vlahov grob* "Varri vllahut" i dëshmuar për në katundin Klishani, krejt afër territorit të Gorës, në vitin 1348.[332] Për praninë e vllehve në këtë rajon dëshmon edhe mikrotoponimi *Kneževa njiva "Ara e knezit" i dëshmuar më 1348 (khs. tekstin në referencën 32) në gjenitivin, përkatësisht lokativin sllav *kneže nive.* Kjo sepse fjala, përkatësisht titulli *knez* nuk e ka, siç e merr historiografia glorifikuese serbe, kuptimin e mbretit duke e aluduar prejardhjen e mundshme të fjalës *knez* nga gjerm. *König* "mbret", por kuptimin e eprorit në hierarkinë e rregullimit social të bashkësive të katundeve vllahe, përkatësisht "kryepar i katunit; kryepar lokal". Ky funksion i *knez* -it, si kryepar i katundeve vllahe, del i qartë në një dëshmi raguzase të 15 janarit të vitit 1382 kur një raguzas deklaron se nga "a Vlcoslauo Plescich comitem Vlacorum omnium domini regis Rassie et Bossnie" d.m.th. nga knezi i të gjithë vllehve të Rashës e të Bosnjës iu kompensua i gjithë malli i plaçkitur. Nga ky njoftim del i definuar shumë qartë funksioni dhe roli i knezit vllah: ai ishte njëkohësisht përfaqësues i pushtetit dhe ndërmjetësues midis katundit, përkatësisht katundeve dhe shtetit.[333] Se titulli *knez* mbahej vetëm nga vllehtë dhe në aso ambiente emërtonte kryeparin e katundit do ta tregonte edhe rrethana se në shumicën e vendbanimeve të cilësuara për të vllehve si edhe në katundet shprehimisht të vllehve të Kosovës në shek. XIV siç janë vllehtë e Barelit, Bobojev'ci, Dragoljev'ci, Kostrčani kishte edhe *primeçurë/primiqurë*.[334] Përkitazi me kuptimin e këtij termi ka mendime paksa të ndryshme për sa i përket kuptimit të tij. Kështu, Max Vasmer[335] sqaronte se fjala **primićur* "kryepar, shef" në serb. e vjetër si *primikjurъ* e kishte kuptimin "kryeplak katundi" dhe se në serbishten e në kroatishten kjo fjalë paska hyrë nga greq. e mesme πριμικήρι(ο)ς "epror suprem", ndërsa në bizantinishten ka hyrë nga latinishtja *primicērius* po me kuptimin që e ka edhe në bizantinishten (khs. më lart). Në latinishten kjo fjalë e kishte në krye të herës kuptimin "ai që i pari e shënon emrin e vet në pllakën prej dylli" *cēra*. Ka porse sqarime të tjera sipas të cilave termi me prejardhje nga lat. e mesme *primicērius* (nga *primus in c*(*a*)*era*) emërtonte kryetarin, kryeparin që ishte në krye të vllehve qiraxhinj karavanesh dhe *feçorë*, nga rum. *ficior*/ *fecior* "ndihmësi i vogël i bariut; më vonë edhe "ndihmës i muratorit". Dijetari gjerman G. Schramm e ka shfaqur mendimin se kjo fjalë e greq. së mesme/bizantinishtes paska hyrë jo më herët se shek. IX, si në rumanishten ashtu edhe në shqipen. Autori ynë një herë thotë se kjo fjalë në shqipen paska hyrë si përkthim shqiptar i termit grek *primikyrios* (< lat. *primicērius*), si në funksion të foljes (me) *këshyrë* ashtu dhe si apelativ *përmbikqyrës* duke pohuar porse që kjo paska ndodhur (!) falë ndërmjetësimit të sllavishtes, sepse në

[332] Khs. Hrisovulja. .., f. 283: *vlahovъ grobъ*.

[333] Khs. Desanka Kovačević, Srednjovjekovni katuni po dubrovačkim izvorima, në Simpozijum o srednjovjekovnom katunu, Sarajevo, 1963, f.133 - 135.

[334] Stojan Novaković, Selo, Beograd, 1065, reprindt, f. 48, 83.

[335] Khs. Die greichischen Lehnwörter im Serbokroatischen, Verlag der Akademie der Wissenschaften, Berlin, 1944, f. 123.

serbishten mesjetare kjo fjalë po u dëshmuaka në trajtën *primikjur*. [336] Pa asnjëfarë pretendimi se do ta korrigjoj ndonjërin apo të gjitha interpretimet e vlerës kuptimore të nocionit *primiqur*, e lejoj veten të rrëfej që në kohën e fëmijërisë sime të njomë, nga pararendës të mij e kam dëgjuar shprehjen "*çka po m'rri si primiqur*" si reagim ndaj personit që tjetrit i rri mbi krye, që e luan rolin e mbikëqyrësit të imponuar. Kuptimin e mbikëqyrësit, atij që t'rri mbi krye, në rrethin familjar timin e kam dëgjuar edhe si shprehje simbolike të prepotencës së gjelit karshi pulave. Në mbështetje të kujtimeve të mia të para 60 vjetëve, më duket që kuptimi bazë i termit *primiqur* do të ketë qenë ai i autoritetit të *mbikëqyrë*sit. Këto venerime të përjetuara të miat, në vija më të largëta, do ta përligjnin kuptimin e kryehershëm "*mbikqyrës*" të termit bizantin.

Pa hyrë në çështjen nëse termat administrativë të hyrë nga burime të ndryshme, përkatësisht nëse edhe termi, titulli administrativ *knez* mund ta ketë po atë kuptim si edhe primikuj, emrin e arës *kneže nive* të vitit 1438 e radhis ndër emra vlleh pikërisht për shkak se një titull të tillë mund ta mbante vetëm kryepari i secilit katund blegtoral të vllehve, jo porse edhe kyepari i katundit bujqësor, ndërsa në regjionin e Gorës kemi të bëjmë me regjion blegtoral në të cilin ka edhe mikrotoponime të tjera me prejardhje vllahe. Këto do t'i trajtoj më poshtë, të radhitura sipas rendit alfabetik të shqipes.

Barbula

Një mikrotoponim thjesht latin-ballkanik, përkatësisht vllah është edhe emri i vendit *Barbulja* në katundin Krushevë të krahinës së Gorës.[337] Ky emër është i së njëjtës gurrë si edhe emri *Bărbăliţa* i vendit në Bullgarinë qendrore, për të cilin A. Rosetti[338] nuk jep ndonjë sqarim më të hollësishëm, por e mban për emër vllah. Këtu bien edhe emrat *Barbatovac* (khs, edhe emrin familjar *Bërbatovci* të shqiptarëve të dëbuar me dhunë nga Serbia e sotme e Jugut në vitin 1876 dhe emrin *Berbati* të familjeve të rrethinave të Kukësit që sot jetojnë në Kosovë) e *Barbeš* në hapësirën e sotme të Serbisë[339] për të cilët nuk jep ndonjë sqarim. Po kështu vepron edhe Sadik Idrizi i cili, pa pas dhënë ndonjë sqarim, e sjell mendimin e studiuesit serb M. Lutovac, i cili emrin që e kishte shënuar në trajtën *Barbula* e mbante për emër me prejardhje vllahe.[340] Unë kujtoj që këtu kemi të bëjmë me fjalën vllahe/rumune *barbă* "mjekërr". Fundja, pikërisht në këtë zonë edhe kemi shtresime e variante homonime rivale në fushën e oikonomisë. Fjala është për toponimin *Mjekërrbadhë*, përkatësisht për

[336] Khs.Anfänge des albanischen Christentums, Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen, Zweite, überarbeitete Auflage, Freiburg im Breisgau, 1999, f. 139.

[337] Këtë emër vendi e ka shënuar mbase në terren Dr. Jusuf Osmani, Vdendbanimet e Kosovës, 20, f. 112.

[338] Istoria limbii romane …, f. 431.

[339] Sipas St. Novaković, Selo, Beograd, 1965 (reprindt), f. 188.

[340] Khs.: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I – IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

ekuivalentin sllav të përkthyer të tij *Bellobrad* të katundit të krahinës së Opojës në të dyja variantet e të cilit përmbahet nocioni *mjekërr* në shqip e në sllavisht.

Barbut

Edhe emri *Barbut* i një vëllazërie të katundit Brod të Gorës[341] do të rrjedh nga fjala rumune *barbă* "mjekërr" përkatësisht *barbăt* "mjekrrosh" veçse, në rastin tonë, i zgjeruar me prapashtesën *-ut*.

Carina

Emri i këtij vendi në Mlikë rrjedh nga fjala rumune/vllahe që e ka kuptimin "fushë, arë" etj. Mikrotoponime që e përmbajnë fjalën rum. *ţară* të zgjeruar me prapashtesën *-ina*, përkatësisht. *ţărină* " fushë, arë, ugar, 2. tokë e katundit" dëshmohen përbrenda Kosovës edhe në Rahovec, ku janë vendet *Carina*, një kompleks livadhesh dhe *Vorret e Carinës*. Këso mikrotoponimesh ka edhe në Hoçë të Madhe (: *Carinat*), në Zoqisht (: *Carinat*), në Opterushë (: *Carinat*) dhe në Lubizhdë të Prizrenit (: Carinat). Fjala rumune *ţărină* ka hyrë, me ndërmjetësimin e blegtorëve vlleh edhe në ukrainishten, polonishten e në bullgarishsten.

*Čičo /*Čičevci*

Duket se emri i kësaj vëllazërie të katundit Brod s'ka si të ndahet nga emri i degës *Čići*, *Čiribići* të vllehve të Istrisë (Kroaci), të cilët në Bosnje quhen *Karagun*, *-ci* e në Serbi *Crnovunci*. Kjo lidhje nuk mund të jetë mbase vetëm në rrafshin e prejardhjes së përbashkët të emrit, porse ndoshta të prejardhjes së kryehershme të përbashkët. Ruajtja deri në ditë tonat e emrit *Qiqavica* të malit në kompleksin e bjeshkëve në të cilin bie edhe emri vllah *Magura* në hapësirën midis Prishtinës, Lipjanit e Gllogovcit sikur e përforcon tezën e dijetarit Miklosich i cili Çiçët e Istrisë i sillte për të vendosur atje në harkun kohor para shek. 14 nga vise të jugut të Ballkanit. Nëse Çiçët e Gorës janë pjesë e ndalur më afër vendit të prejardhjes dhe, së këndejmi, farefis i Çiçëve të Istrisë, mbetet çështje për t'u parë.

Çuçul

Duket se tek emri *Čučul/Ćućul kamen* i vendit në katundin Restelicë të krahinës së Gorës[342] si edhe tek emri *Čučulj*[343] (Çuçul) i një lagjeje, vëllazërie të katundit Brod, e quajtur kështu mbase në bazë të vendit ku është e vendosur, kemi të bëjmë me një emërtim vendi me prejardhje vllahe. Tek emri *Čučulj*[344] (Çuçul) i vëllazërisë kemi të bëjmë me një emër në krye të herës dypjesësh si

[341] I shënuar në terren nga S. Idrizi, si në ref. 321.
[342] Të shënuar në terren nga Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 132.
[343] I shënuar nga J. Osmani, po aty, f. 92 për si *Ququll*.
[344] I shënuar në terren nga J. Osmani, po aty, f. 91, 92.

edhe ato *Čučina češma* e *Čučulja rupa* të po këtij katundi, nga i cili është ruajtur vetëm pjesa e dytë e tij. Emri i kësaj vëllazërie të vendosur në vendin *Çuçul* dëgjohet edhe si *Čučulova* e *Čučulovci*. Duket se si emri i vendit në Restelicë ashtu edhe ai i lagjes dhe i vëllazërisë në Brod të Gorës bashkë me emrin *Čuč*/*Čučinci* të vëllazërisë në katundin Borje të rrethinave të Kukësit[345] s'kanë si të largohen nga fjala rumune *cuc*, *cucul* "qyqe" në trajtën e saj të palatalizuar *čuč*.[346] Pejardhjen e këtyre emrave nga apelativi vllah *cuc-ul* e tregon mbase emri *Kukuljuje* i një vendi në katundin Brod të Gorës e ndoshta edhe varianti i kryehershëm *Kukuljan- i emrit Kukajan të sotëm të Gorës dhe emri *Kukulica* i një vendi në katundin Burnik të Ferizajt[347] tek të cilët fjala vllahe për qyqen është ruajtur në trajtën e saj të vjetër, të papalatalizuar. Këtu do të binte mbase edhe emri *Kukaljski vr*, njëra nga majat e Malit të Moknës, e lartë 1887 m dhe patronimi *Kukalj* që del në Shekullar të Malit të Zi.[348]

Në të mirë të prejardhjes së këtij emri nga rum. *cucul* "qyqe" do të shkonte mbase edhe konstatimi i dijetarit të merituar kosovar I. Ajeti i cili tek shprehja *Uh, ćućava ja* "qyqja unë" që është shënuar për tek folësit kosovarë të serbishtes "mund të shpjegohet lehtë, meqë *y*-në e shqipes serbokroatishtja nuk e ka dhe zakonisht e zëvendëson me *u*, ndërsa *-va* është mbaresë e mbiemrit, si në fjalët e tjera, *čor*, *čorava*".[349]

Ka shumë arsye të besohet se emri *Čučulova* është në të vërtetë pjesë e një emri sintagmatik të tipit ku bie edhe emri rumun **Deal Cucului* "Kodra e qyqes". Po nga ky apelativ i heq rrënjët edhe emri *Čučunjski potok* i një përroi në regjionin e Gorës.

Nuk ka kurrfarë dyshimi se i po kësaj gurre të jetë edhe emri i vëllazërisë shqiptare *Çuçur*- ët të katundit shqiptar Buç(j)e të Opojës. Prejardhjen vllahe të këtyre emërtimeve e dëshmon edhe rrethana që në të folmen lokale të goranëve në të dyja anët e kufirit midis Kosovës e Shqipërisë është në përdorim edhe fjala *çuçul* "zogu i vogël i pulës sa ka dalë prej veje", e cila mbahet për me prejardhje vllahe. (sh. më poshtë)

Është për t'u vërejtur në këtë mes që zgjerimi prapashtesor i temës *cuc*/kuk e ndoqi rrugën e përkundërt të trajtësimit të fjalëve të konsideruara për të substratit të përbashkët të shqipes e të rumanishtes (khs. rum. *măgură* shq. *magulë* "kodër e zhveshur, kullotë"). Sipas këtij rregulli, do të duhej të pritej që emrat e goranëve të dilnin në trajtën **Čučur*, ndërsa emri i vëllazërisë shqiptare si **Çuçul* ose **Çuçull*. Fundja, trajta *Çuçur* (khs. kryefamiljarin e quajtur Gruban *Čučur*) dëshmohet në regjistrimin osman të viteve 1467-1468 në katundin e

[345] I shënuar në terren nga S. Idrizi, si në ref. 321.

[346] Për fenomenin e palatalizimit sh. Al. Rosetti, Istoria limbii române, Bukuresht,1968, f. 432, 599.

[347] Këtë emër e ka shënuar në terren Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpca, Prishtinë, 2004, f. 61.

[348] Këta emra i ka shënuar në terren Alija Đogović, Toponimija jugoslovenskog dela Prokletija (I Deo), Onomatološki prilozi, IV, SANU, Beograd, 1983, f. 317.

[349] Khs. I. Ajeti:Shqiptarët dhe gjuha e tyre, Prishtinë, 1994, f. 75.

madh Vrapçisht me 240 shtëpi, 17 beqarë e 2 të veja të rrethinave të Gostivarit, në të cilin kishte edhe banorë me antroponime e me patronime vllahe e shqipe dhe me nocionet *arbanas* e *vllah.*[350]

Një mundësi tjetër e interpretimit të emrit Çuçul do të ishte prejardhja e tij nga fjala *çuç* e cila e ka kuptimin "zogu i vogël i pulës sa ka dalë prej veje", por që shënon edhe diçka të vogël e pas gjasë edhe majuke. Në Shqipëri, mbase të Jugut paska, sipas Prof. E. Çabejt, edhe emra familjesh të sajuara nga kjo fjalë, gjë që po fliska për një farë moshe të fjalës.[351] Për si mundësi të interpretimit në rrafshin semantik të emrave *Çuç* me fjalën *çuç* "zog i vogël", ndoshta mund të merret emri *Zog, Zogaj* i shqiptarëve si një deminutiv paralel me *Vogli, Vogla, Voca, Voci* që ndeshen tek shqiptarët. Kjo aq më parë pse në rastin tonë kemi të bëjmë me emra vëllazërish të sajuara nga emra vendesh, unë besoj që këtu do të duhej të kërkohej kuptimi i vogëlisë dhe i objektit majuk. Po të jetë kështu, tek emri i kodrës *Čučul*/*Čučulj* të Restelicës dhe tek emri *Čučulova* nga i cili e ka marrë emrin vëllazëria *Čučulovci* e Brodit do të duhej parë dy kodra të vogla majuke.

Gjithashtu ka mundësi që emri *Çuçulovci* i vëllazërisë së Brodit të jetë trajtë e shquar vllahe e antroponimit *Čuč* të dëshmuar në ambiente vllehsh. Kështu kur mbreti serb Stefan dhe i biri Radoslav po e themelonin manastirin e Žiča-s i falnin këtij të fundit edhe disa katunde të mikroregjionit *Patkovo* përreth Pejës e bashkë me këto edhe vllehtë e atjeshëm. Midis këtyre vllehve ishte edhe një i quajtur *Čuč*.[352] Dëshmi të tjera të qenies në përdorim të këtij emri kemi edhe në vitin 1455 kur për në katundin Brainë të Malësisë së Gallapit ishte evidentuar kryefamiljari Ivaniš, sin *Čučkova*, "Ivanish-i i bir i *Çuçk*-ut" dhe në vitin 1485 kur në katundin Trepça (ndoshta Triepshi/Trieshi i shotëm) të Malit të Zi është evidentuar edhe e veja *Çuça* (që mund të lexohet porse edhe Çoça).[353] Nga fusha e toponimisë, këtu do të binte emri *Ćućavac* i një shkëmbi të çarë nën të cilin njerëzit luten kur bie shi në katundin Suhogerllë të Istogut.[354]

Në këtë mes po shtoj se në hapësirën e sotme të Kosovës ka edhe emra të tjerë të vëllazërive shqiptare e të mikrotoponimeve të dala nga apelativi *çuç*. Të këtillë janë p.sh. *Çuçollët* vëllazëri dhe mtp. *Mullini i Rashit Çuçollit* në kat. Krajkovë të Drenicës; *Çuçët*, vëllazëri dhe mtp. *Kodra Çuç've, Shpati Çuç've, Rogat e Shpatit t' Çuç've, Kershi Kodrës t'Çuç've, Kodra Shpatit t'Çuç've, Kershi i Çuç've t'zi* në kat. Koshutan të krahinës së Rugovës; *Çuça*, fushë e vogël në kat. Mramuer të Prishtinës; *Maja Çuçelit* - majë mali në kat. Bênë të Shqipërisë së Veriut. I kësaj prejardhjeje do të jetë edhe emri *Çyçylagë* (Qyqylagë) i komunës së Lipjanit, i zgjeruar porse me prapashtesën *-aga*.

---

[350] Khs. Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod. .., f. 406.
[351] E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, III, Tiranë, 1987, f. 136.
[352] Khs. Fr. Miklosich, Monumenta serbica. .., f. 12.
[353] Khs. Oblast Brankovića …, f. 253;. S. Pulaha, Defteri. .., f. 88.
[354] Të shënuar në terren nga Svetozar Stijović, Onomastika Istoćkog dela Metohijskog (Pećkog) Podgora, Onomatološki prillozi I, SANU, Beograd, 1979 f. 354.

Nga këta shembuj mikrotoponimikë sikur dëshmohet bindshëm se apeltaivi *çuç* e ka (edhe) kuptimin "majë, thep", përkatësisht gati po atë kuptim që tek fjala rum. *cucul* e gjente P. Skok: "terren në të cilin ka gurë/shkëmbinj në të cilët njeriu e ka të vështirë të ngjitet, sepse janë të rrëpinët si cucul-et" ashtu siç e ka edhe fjala *kukulec* që në të folmen e Gallapit shenjon po ashtu majë mali, majë shkëmbi.(khs. edhe më poshtë nën *Kukël*)

Erevci

Duke qenë se nuk kam kompetenca të shfaq ndonjë mendim përkitazi me prejardhjen e këtij emri të vëllazërisë së katundit goran të Baçkës, kujtoj se nuk është e parëndësishme të vërehet që emri i kësaj vëllazërie nuk gjen paralele me ndonjë emër vëllazërie apo vendi në hapësirën aktuale të Kosovës. E vetmja mundësi e afrimit emëror-gjeografik të këtij më mbetet emri *Erinovci* të një katundi në verilindje të Kërçovës, i dëshmuar në vitet 1467-1468.[355] Ky afrim do të tregonte, pa e marrë parasysh prejardhjen e emrit që unë nuk kam zotësi t'i bie n'fije, se edhe këtu kemi një dëshmi që edhe pararendësit e vëllazërisë Erevci, si shumica absolute e goranëve të sotëm, është e ardhur nga hapësira gjuhësore e bullgarishtes/maqedonishtes, përkatësisht në rastin konkret nga rrethinat e Kërçovës.

Feriq

Një emër vllah i vendit do të jetë mikrotoponimi *Kroi i Firiqit* në katundin Blaç të krahinëzës shqipfolëse të Opojës. Emri i shënuar në këtë trajtë[356] i heq rrënjët nga apelativi vllah, përkatësisht rumun *fèrigă* "fier". Korrektësinë e këtij paravendimi e përforcon mbase rrethana që nëpër katunde të tjera të Opojës, nëpër të cilat s'pati një substrat vllah, dalin mikrotoponime të sajuara nga fjala shqipe *fier*: khs. *Firishtat* në Brodosanë, *Firishta* në Buzezë, *Firishtat* në Kapre; *Fieri Madh* në Zym; *Firishta* në Shajne dhe *Firishtë* në katundin Kuklibeg.[357]

Grosh

Mikrotoponim me prejardhje vllahe në regjionin e Opojës është edhe *Guri Groshit* vend, mbase shkëmb, në katundin Kukël,[358] tek i cili ruhet mbase kujtimi për një vend me sipërfaqe më të madhe, ndoshta vendbanim më vete. Duket se ky mikrotoponim ka të bëjë me emrin e dalë nga përdorimi të një vendbanimi më vete i cili në njërin ndër defterë osmanë-turq të regjistrimit të kryefamiljarëve të shek. XVI, përkatësisht në vitin 1530, për si katund më vete i nahijes së Opojës ishte evidentuar me emrin *Grosh*,[359] ndërsa në dy regjistrime

[355] Sh. Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod. .., f. 550.
[356] Nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës. .., 20, f. 86.
[357] Khs. J. Osmani, po aty, f. 116, 127, 131, 146.
[358] Të shënuar në terren nga J.O., Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 155.
[359] Sipas J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 155.

të mëvonshme: në ato të viteve 1571 e 1591 ishte evidentuar si *Gzosh*.[360] Në dritën e ekzistimit të mikrotoponimit *Groshi*, përkatësisht *Guri Groshit* mua më duket se jo vetëm që trajta korrekte e emrit të vendbanimit do të jetë *Grosh*, por që ka mundësi që ky të ketë qenë edhe emri i kryehershëm i katundit të sotëm Kukël i cili mund ta ketë marrë këtë emër si pasojë e forcimit më vonë të familjes Kukli të këtij katundi. Në këtë mes duhet vërejtur porse që në katundin goran Shishtojec në rrethina të Kukësit paska një vëllazëri, familje e quajtur *Grošovci*.[361]

Në hapësirën gjuhësore të shqipes ka jo pak toponime të sajuara nga kjo fjalë. Për ilustrim po i sjell këtu mikrotoponimet: *Groshi* - kompleks me kullota në bjeshkën Ostrokople të katundit Selac të krahinës së Shalës së Bajgorës; *Groshet* - livadhe me fier dhe *Nergroshet* në katundin Kleçkë të krahinës së Drenicës;[*] *Majgroshet* - kompleks me ara lëndina dhe *Ara Majgroshit* në katundin Brainë të krahinës së Gallapit; *Groshi i Kol' Ded's* - lëndinë në katundin Bekaj të regjionit të Trieshit[362] (Mal i Zi).

Përveç në mikrotoponime, ky adjektiv dëshmohet në vitet 1438 e 1485 edhe në funksion të emrit familjar: khs. *Petcho Grossa de Vragne*[363] (lexo Petko Grosha de Vranje) banor i qytezës së Vranjes (Serbi) dhe Nikolla *Grosh*-i - banor i katundit *Dolni Trumshi*[364] (sot Trumsh) në rrethina të Shkodrës. Mundësinë që tek këta dy mbiemra familjarë kemi të bëjmë me antroponime të kryehershme e jo me toponime të ngritura në funksion patronimesh e ilustron rrethana që në hapësirat e Shqipërisë së Veriut dhe në Mal të Zi gjallojnë edhe sot antroponimet *Grosh -i* m. dhe *Grosh-e/ja* f.; emri i vëllazërisë i përmbajtur në mikrotoponimin *Sheu i Groshe* - përrua në katundin Nokshiq të regjionit të Plavës,[365] ndërsa në rrethina të Deçanit (Kosovë) ndeshet edhe mbiemri *Groshi*.

Duket se me rastin e përpjekjeve për sqarimin e prejardhjes së këtyre emrave duhet pasur parasysh rrethanën që këtu kemi të bëjmë *1*. me emra vendesh të emërtuara sipas cilësisë dhe *2* me emra njerëzish të dhënë me dëshirë që bartësit të jenë të shëndoshë. Në këtë kuptim emri *Grosh* i katundit të Opojës/Gorës nuk mund të ndahet nga emrat e vendeve *Groşi*, *Groşii Noi*, *Valea Groşilor*, *Groşul*, *Groşul Mare*, *Groşul Mic*, *Groşiori*, Groşani, *Groşeni*, *Groşeşti*, *Groşarea*, *Groşeriţa, Groşetul*, *Vîrful Groşetului*, *Groşovul* e të tjerë të

[360] Sipas S. Pulaha, Popullsia. .., f. 171, 342.

[361] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/

* Këtë emër e kanë shënuar në terren edhe J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 5, Lipjani, Prishtinë, 2003, f. 70 dhe Dr. Rexhep Doçi. Ky i fundit, khs. Onomastika e Drenicës I, Prishtinë 2005, f. 90 e propozon sqarimin e këtij toponimi nga emri i barit *groshë të egër* që, për mua, s'është tjetër veçse etimologji popullore.

[362] Këto mikrotoponime i kam shënuar vetë në terren.

[363] Khs. M. Dinić, Iz Dubrovačkog arhiva I., f. 73.

[364] Khs. S. Pulaha, Defteri. .., f. 385.

[365] Khs. Idriz Xh. Ulaj, Toponimia e fshatit Nokshiq, "Koha", 5/6, Titograd, 1969, f. 583.

së njëjtës prejardhje në hapësirën aktuale gjuhësore të rumanishtes;[366] ndërsa antroponimet e patronimet *Groshi-* të shqiptarëve nuk mund të ndahen, në pikëvështrimin etimologjik p.sh. nga mbiemrat dhe nga antroponimi i dëshmuar në vitin 1198. tek popullata romane e brigjeve të Adriatikut, përkatësisht në ujdhesat Kërk e Rab: khs. *Drossia filia de Grossa*; *Grossa filia de Negula*; *Petrus Grossus*[367] etj. e as nga emrat familjarë *Groş-a*, *Groşescul*, *Grosu*, *Grosar*, *Groaseş*, *Grosila*, *Groşneala* të hapësirës gjuhësore të rumanishtes,[368] të cilat konsiderohen për emra semantikisht të motivuar me përmasat e dëshiruara trupore të individëve të pagëzuar me këtë mbiemër, përkatësisht me mbiemrin rumun m. *gros* (f. *groàsă*) "i trashë; i plotë 2. i shpeshtë";[369] "i përthurt"; f. *grosìme* "shpeshtak"; *grosolàn* "trashaman, kallaba"; *grosolănìe* "vend, mal i shpeshtë", bullg. *debelština* që, sipas Nița Silvia - Armaş[370] e të tjerë po rrjedhka nga mbiemri latin *grossus*.

Sqarimi i propozuar më sipër do të tregonte se si oikonimi *Grosh* i Opojës, ashtu edhe mikrotoponimet dhe antroponimet e patronimet e hapësirës gjuhësore të shqipes (khs. shembujt e sjell më lart) janë, në të vërtetë, me prejardhje vllahe. Rrethana që, në këtë mes, do të duhej të theksohej veçmas është kjo që këtu nuk kemi të bëjmë me një huazim leksikor roman - ballkanik që do të jetë huazuar nga shqiptarët të cilët nga ky mbiemër do të sajonin edhe emra personalë e sish të vëllazërive, porse thjesht me emra romanësh ballkanikë të shqiptarizuar, duke i përjashtuar ata të ujdhesave të Adriatikut. Këtë paravendim do ta mbështeste mbase rrethana që tek shqiptarët etnikë të kohës kur dëshmohen antroponime e patronime të sajuara nga ky mbiemër i gurrave latitne-ballkanike dëshmohen edhe mbiemra shqip kuptimisht të barasvlershëm. Shembull tipik i këtij paravendimi do të ishte mbiemri *Mtrasa* i banorit Pavl (*pav'lь mьtrasa*) të katundit Kuševo (Kshevë) në Mal të Zi, i dëshmuar në vitin 1330[371] si edhe emri femëror *Trashe* tek shqiptarët e Malit të Zi të sotmit, që është një korelat semantik me emrat e dëshmuar që nga shek. 12 ndër romanë të brigjeve të Adriatikut dhe tek rumunët e sotëm.

Vlerën kuptimore si edhe mbiemri aktual "trash; i, e trashë" të shqipes, mbase në kuptimin e shëndetit të mirë të famullit të pagëzuar me këtë adjektiv, e

---

[366] Khs. Al. Rosetti, Istoia limbii romîn,. .., f. 425.

[367] Khs. K. Jireček, Romani u gradovima Dalmacije, tokom srednjega veka, Zbornik Konstantina Jirečeka, II, Beograd, 1962, f. 172, 290; N. A. Constantinescu, Dicționar onomastic. .., f. 289.

[368] Sipas N. A. Constantinescu, Poaty, f. LI

[369] Sipas Spasca Kanurcova, Dicționar român –bulgar (Rumъnsko-bъlgarski rečnik), Editura Ştiințifica & Nauka i izkustvo, Sofia-Bucureşti, 1962, f. 174.

[370] Khs. L' influence roumaine sur le lexique de langues slaves, Romanoslavica, XVI (1968), f. 87.; B. Simeonov, Latinskite imena v blgarskija ezik, Bălgarski ezik, VII, 1957, f. 56.

[371] sh. Dečanske hrisovulje. .., f. 121.

[372] khs. për këtë Stuart E. Mann, An Albanian Historical Grammar, Hamburg 1977., f. V.

gjejmë të dëshmuar edhe tek ilirët, në uzusin antroponimik të të cilëve është dëshmuar edhe antroponimi mashkullor *Trosius*[372]

Se emri *Trassa* është me të vërtetë me prejardhje mbiemërore dhe semantikisht i motivuar me nocionin e trashësisë në kuptimin e shëndetshmërisë do ta tregonte edhe korelati sllav *Debeli Rag foxer* i dëshmuar në vitin 1438, edhe nëse kjo dëshmi nuk do të mund e duhej të shihej si një calque linguistique, përkthim i fjalëpërfjalshëm i emrit shqiptar, por qoftë edhe vetëm si një përputhje semantike serbe-shqiptare. Qenien në përdorim tek shqiptarët e një antroponimi të motivuar me dëshirën për shëndet sikur e tregon rrethana se ndër shqiptarë në Malin e Zi të sotmin dhe në krahinën e Rugovës (në Kosovë) vazhdo të bëjë jetë antroponimi femëror *Trashe*.

Në dritën e rrethanës që në gjysmën e parë të shek. 15, përkatësisht në vitet 1438-1440 pikërisht në një zonë në të cilën kishte e ka mjaft gjurmë onomastike vllahe siç është rrethina e Novobërdës, dëshmohet një vendbanim i quajtur *Grosheta* në të cilin, midis shumë sish jetonte edhe banori *Dmitar* me mbiemrin shqiptar* *Buxatouich de Groxeta* (lexo si shq. Dmitar Bushatoviq de Grosheta)[373] ka arsye të besohet emri *Grosh* i Opojës/Gorës nuk mund të ndahet nga emri i rrethinave të Novobërdës, i cili po këtë emër e mbante edhe në fund të shek. XV: khs. "*Katundi Grosheta që i takon nahjes Glama*. ..", të cilin botuesi i materialit të këtij defteri e lë të paidentifikuar,[374] ndërsa historiani serb M. Dinić para më shumë se 50 vitesh këtë katund e kishte lokalizuar e identifikuar, me të drejtë, në hapësirën e katundit sotëm me popullatë serbe Draganc të komunës së Kamenicës, në të cilin edhe sot po ekzistuaka një kompleks me ara që popullata e atyshme serbe po e quajtka *Grošeta*.[375]

Emri në trajtën *Grosheta* i katundit të rrethinave të Novobërdës do të jetë sajuar nga folës të latinishtes ballkanike, përkatësisht të vllahishtes, nga mbiemri *gross-* i latinishtes, i zgjeruar me prapashtesën *-et* që, duke qenë me prejardhje latine nga *-etum/êtum*) ndeshet si në gjuhën shqipe (khs. psh. *Arrnjet, Frashnjet, Kallmet, Kashnjet, Shkorret, Shkozet* e ndonjë tjetër) ashtu edhe në rumanishten (khs. shembujt e sjellur më sipër: *Groşetul, Vîrful Groşetului*). Nëse sqarimet e

*Kjo sepse në fund të shek. XV pjesa dërmuese e banorëve të këtij katundi mbante antroponime apo patronime shqipe. Vetëm sa për ilurstim po i sjell shembujt e evidentuar në fund të shek. XV: *Nino*, i bir i *Blino*-s; *Gjon* lopçari; Vlad *Arbanash*-i e Pava *Arbanash*-i të sjellë nga Iljaz Rexha, Regjistrimi vendbanimeve dhe i popullsisë …, f. 86, ndërsa në defterin e viteve 1566-1574 ishin evidentuar edhe kryefamiljarët *Nua Stepa* e *Tushko*, i bir i Pejak-ut, khs. Prof. Dr. Iljaz Rexha, Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566/74, në Vjetar 31-32 i Arkivit të Kosovës, Prishtinë 2004, f. 37, 115.

[373] Sh. Miailo Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I, Beograd 1957, f. 51.

[374] Khs. Iljaz Rexha: Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës sipas defterit të fundshekullit XV, në "Vjetar" XXVII-XXVIII i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë 2002, f. 86.

[375] Sh. Mihailo Dinić, Za istoriju rudarstva u srednjovekovnoj Srbiji i Bosni, I, Beograd 1962, f. 33.

mësipërme do të jenë të pranueshme do kishte arsye linguistike të paravendohet që emri *Grosheta* i vendbanimit të rrethinave të Novobërdës ta ketë po atë kuptim që e ka emri i sotëm *Debëllde* (i sajuar nga sllav. *debel* "i, e trashë" dhe *del* "mal") i komunës së Vitisë e ndoshta edhe si i njëjti kuptim i mundshëm i përmbajtur tek emri i kompleksit *Debeçinat* të arave të katundit Xerzë midis Rahovecit e Prizrenit që, për si vendbanim më vete, është dëshmuar në vitin 1571.[376] Për aq sa lejohet të nxirret nga analiza gjuhësore do të rezultonte që adjektivi roman - ballkanik *gors* u ruajt në trajtën *grosh* andej kah elementi etnik vllah u shqiptarizua kohë përpara shek. 14, ndërsa në ambiente ku ky element u serbizua apo ku tendenca e kishës serbe drejt sllavizimit etnik e onomastik të romanëve ballkanikë pati më shumë sukses, ky adjektiv u përkthy në serbisht.

Gugna

Me prejardhje vllahe do të jetë edhe emri *Gugna* i një vëllazërie në katundin Brod të Gorës. Këtë antroponim e mbante në vitin 1579 edhe një banor i katundit Krushevë të Gorës. Ka mundësi që këtu kemi të bëjmë me një variant të tjetërsuar të rum. *gugla* "kapuç" - fjalë kjo që nga rumanishtja ka depërtuar në bullgarishten.[377] Çështjen e prejardhjes së vetë fjalës *gugla* dhe të toponimeve të sajuara nga ajo e trajtoi edhe autori serb V. Mihajlović.[377a] Ky është i mendimit që emri *Gugalj*, i dëshmuar që në shek. 15 si *Gouglь*, i katundit malor i ngritur mbi shkëmbenj sipri lumit Morava e heq prejardhjen nga rrënja *Gug-* e cila është dëshmuar e përmbajtur edhe në antroponimin e dëshmuar në Krisobulat e Deçanit dhe në funksion mbiemri edhe në Serbi e në Rusi. Për si apelativ, fjala *guglja* po shenjuaka në serbishten, bullgarishten e në maqedonishten një lloj kapele (serb. šiljasta kabanica) majuke në formë të stogut të sanës. Autori ynë e pranon për të drejtë mendimin që fjala *gugla* e bullgarishtes rrjedh nga lat. *cucullus*, (S.G: *cŭcŭlus*?) kujton porse që në serbishten kjo duhet parë si element gjuhësor i hyrë në këtë gjuhë me ndërmjetësimin e ilirëve.

Në dritën e shtrirjes së kësaj fjale në gjuhët sllave të jugut nuk do të ishte i pavend paravendimi që këtë fjalë e sollën me vete sllavishtfolësit e sotëm të krahinës së Gorës që në krye të herës ishin vlleh të bullgarizuar të cilët u vendosën më vonë në krahinën e sotme të Gorës. Po për si rezultat i lëvizjes së blegtorëve vlleh do të duhej parë mbase edhe emrin *Gugulovci* të një katundi serbësh në rrethina të Novobërdës, përkatësisht të Kamenicës.

Guri Hakulit

Me prejardhje vllahe do të jetë mbase edhe mikrotoponimi *Guri Hakulit* në katundin Kuk të Opojës. Në dritën e rrethanës që në hapësirën e këtij katundi ka mjaft mikrotoponime të sajuara nga fjalë të shqipes në trajtat të tyre të vjetra si

[376] Khs. S. Pulaha, Të dhëna ekonomike dhe demografike. ..

[377] Sh. Al. Rosetti, Istoria limbii române, Bucureşti, 1968. f. 430.

[377a] Khs.Iz toponomastike Srbije (Kruševac, Gugalj), Zbornik za filologiju i lingvistiku, XVII/2, Novi Sad, 1974, f. 175.

like,-ni (khs. mtp. *Lekeni kuq*, *Lekeni Zenelit*); *karpë* (khs. mtp. *Karpa*) ka vend të pohohet që ky ishte vendbanim i vjetër shqiptar, në kuadrin e të cilit mund të kishte edhe një familje që mbante një emër vllah. Në të mirë të paravendimit që në këtë katund do të ketë pasur vlleh ardhës do të fliste ruajtja deri në ditë tonat e mikrotoponimit *Guri Groshit* dhe sidomos e atij *Kroi Gogos*.[378]

Kalina

Duket që me prejardhje vllahe do të jenë edhe: emri *Kalina* i një vendi/lagjeje të katundit Krushje/Krushevë; mbiemri *Kalinka* i një vëllazërie në kat. Brod[379] si edhe mikrotoponimi *Kalanovci* në katundin Lubovishtë të Gorës.[380] Të gjithë këta emra, të zgjeruar me prapashtesa të ndryshme, mund të rrjedhin nga fjala rumune, përkatësisht vllahe *cale* "rrugë".

Kërcul

Me prejardhje romane ballkanike (vllahe) do të jetë edhe antroponimi *Kërcul*, i përmbajtur në mikrotoponimin *Vorri i Kërcullit* në katundin shqiptar Rrenc të krahinës së Opojës.[381] Ky interpretim do të ishte i besueshëm vetëm duke e paravenduar mundësinë e ndikimit të fenomenit të metatezës *Krec* në *Kërc*. Në këtë rast, këtu do të kishim të bënim me një emër të sajuar nga rum. *creț* që, sipas Al. Rosetti, ndeshet edhe në shprehjen serbe *krecava kosa*[382] "flokë kaçurrelë".

Koroni

Kështu (*Koroni*) po u quajtka, sipas J. Osmanit[383] një vend në katundin Rrenc të Opojës. Në atë katund është edhe mikrotoponimi tjetër *Shullani Koronit*. Vetë atributi *Shullani* tregon se kemi të bëjmë me një ngriturinë, mal - maja e të cilit mund të ketë formë kurore.

Në kërkim të prejardhjes së këtij emri, me theks të veçantë në të mirë të prejardhjes latine ballkanike të tij, po e sjell sqarimin e P. Skok sipas të cilit në hapësirën gjuhësore të sllavëve të Jugut* paska shumë shpesh emra vendesh të sajuar nga apelativi *vĕnьcь* "kurorë". Khs. emrin *mons Corone*; *mons Coruna* në

[378] Të gjitha mikrotoponimet e cituara më lart janë shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 114.

[379] Të shënuar nga Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/. J. Osmani, khs. më poshtë, e ka shënuar këtë emër si *Kaljçeve*

[380] Të shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 112, 119.

[381] Të shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f.. 134.

[382] Istoria limbii române. .., f. 430.

[383] Khs. Vendbanimet e Kosovës, 20, f..134.

* Që, duke qenë të ardhur në hapësirën bizantine, e mbulojnë hapësirën e quajtur kushtimisht edhe *Slavia orthodoxa*.

ujdhesën Pašman në Dalmaci,[384] si edhe konstatimin e St. Romansky-t[385] se në bullg. ekziston fjala që në këtë gjuhë ndeshet si *koróna* e *korúna* "kunorë"; në ndonjë të folme të bullgarishtes shenjon edhe emrin e një pjese të vekut; në serb. e kroat. si *kòruna* paska hyrë drejtpërdrejt nga lat. *corona* e këtu nga greq. κορώνη, ndërsa rum. *cunună*, *curună* "kunorë" edhe arum. e meglenorum. *curună* konsiderohen për fjalë të trashëguara të rumanishtes. Al. Rosetti, na mëson që kjo fjalë paska hyrë në bullgarishten - përmes arumanishtes - si *koruna* në kuptimin rum. "o piesă a războiului de țesut"[386] Romanski mendon se fjala rumune rrjedh porse pas gjithë gjasash nga greq. κορώνα, κουρούνα "kurorë", nga lat. *corōna*, prej nga e heq prejardhjen edhe e shqipes *koronε*, *kurorε*. Për me prejardhje nga ky apelativ i rumanishtes, përkatësisht i vllahishtes, St. Novaković e shihte edhe emrin *Korona* të njërit nga malet në kompleksin e bjeshkës së Kollubarës (edhe ky vetë një emër me prejardhje nga latiniteti ballkanik) në Serbi.[387]

Ka mundësi që nga kjo fjalë e burimit roman ballkanik të rrjedhin edhe mikrotoponimet *Kodra e Koronës* në Istog dhe *Koroniqet* në katundin Cercë të rrethinës së Istogut[388] si edhe mbiemri *Korunet* në katundin Novosellë të Kërçovës dhe mbiemri *Korunoski* i maqedonasve* në katundin Tuhin të Kërçovës, ku është edhe mtp. *Ar'e Koronit* si edhe emrat *Korunoski* e *Korunov Dol* të dy burimeve të ujit në katundet Belicë e Izbishtë të Kërçovës. Maqedonas me mbiemrin *Korunoski* paska edhe në katundet Knezhinë, Reshtan e Klladnik në rrethina të Kërçovës.[389]

Kukël

Edhe emri i këtij katundi shqiptarësh të krahinëzës së Opojës mund të jetë me prejardhje romane-ballkanaike, përkatësisht vllahe. Ky emër mund të jetë sajuar nga apelativi vllah *cucul* që shenjon shkëmb të madh, shkallë, ngriturinë të madhe prej guri; çukë". Si i këtillë, ky emër do të ishte, në mos i sjell nga pararendësit ardhës të goranëve të sotëm, së pakut i së njëjtës prejardhje si edhe

[384] Khs. : Iz srpsko-hrvatske toponomastike, Južnoslovenski Filolog, VI, Beograd 1926-1927, f. 87.

[385] Khs. punimin e tij Lehnwörter latenischen Ursprungs im Bulgarischen, Revue des études slaves, Tome quatorzième, Paris, 1934, f. 114:

[386] Khs. Istoria limbii române …, f. 430.

[387] Khs. Selo, Beograd, 1965 (reprindt), f. 188.

[388] Këto mikrotoponime i ka shënuar në terren Dr. Jusuf Osmani, Venbanimet e Kosovës 12, Burmi (Istogu), Prishtinë, 2004 f. 79, 88.

* Lidhja e emrave familjarë me këtë fjalë do të mund të ishte e pranueshme nëse këta do të jenë sajuar nga emri i vendit në të cilin banonin apo prej nga kanë ardhur familjet gjegjëse.

[389]. Khs. Qemal Murati, Deshmime onomastike për autoktonine e shqiptareve në trojet etnike të tyre në Maqedoni, Tiranë, 1993, f. 33, 36.

emrat *Kukla* e *Kukle* të hapësirës gjuhësore të bullgarishtes.[390] (khs. edhe më lart, në *Çuç*-)

Kurotica

Duke e paravenduar mundësinë që, për arsye psikologjike, përkatësisht të konotacionit të mundshëm me emrin sllavisht të organit gjenital mashkullor, trajta e kryehershme e këtij emri të vendit do të ketë qenë **Kuratica*, kujtoj që për emër me prejardhje vllahe do të jetë edhe mikrotoponimi *Kurotica* i katundit Restelicë të Gorës. Më duket se është punë e vështirë që mikrotoponimi i mësipërm të mos lidhet me adjektivin rumun apo aromun *curàt* "i pastër, i kthjellët", që përmbahet (edhe) në emrin *Kuràtska reka* në regjionin Godeč të Bullgarisë.[391]

Leporice

Për si dëshmi fort e besueshme e një bashkëjetese të shqiptarëve me pararendësit vlleh të goranëve të sotëm mund dhe duhet të merret në këtë mes edhe mikrotoponimi i sotëm *Dolnji Ljeporice* - vend në katundin Rapçë e Epërme, prejardhja e të cilit nuk mund të ndahet nga fjala e shqipes *lepur* në trajtën romane-ballkanike *lepore*, përkatësisht vllahe *liepure* të saj. Në trajtën shqipe të saj kjo fjalë përmbahet në mikrotoponimet *Prroji Leprit* në Pllavë dhe *Guri Leprit* në Zapluxhë të krahinës shqipfolëse të Opojës. [392]

Emri i sotëm i vendit do të jetë toponimizim i vonshëm i një mikrotoponimi dypjesësh, sintagmatik. Nuk është pa rëndësi të përkujtohet që fjalën në trajtën romane-ballkanike *lepor* e ndeshim edhe në vitin 1330 kur ndër banorë të katundit të madh të Çabiqit (në komunën e sotme të Klinës) dëshmohet edhe një banor me mbiemrin *Lĕporek*. Përkatësia etnike vllahe e këtij banori dëshmohet edhe me rrethanën që në këtë ambient kishte edhe banorë të tjerë me emra karakteristikë për vlleht dhe ndonjë tjetër, emri i mirëfilltë i të cilit ishte zëvendësuar me distinktivin etnik apo të profesionit *vllah*.[393] Jashtë hapësirës glotoetnike të Kosovës, një emër vendi të sajuar nga varianti roman *lepor* e gjejmë të dëshmuar në vitet 1208 e 1280 si *Leporaria* që ka të bëjmë me ishullin e sotëm *Levrera* (përkatësisht Zvečevo)[394] në brigjet kroate të Adriatikut ndërsa

[390] Të cilat për si emra të lashtë, pra jo bullgarë, i trajton B. Simeonov, Etimologićen rečnik na mestnite nazvania ot Godedečko. .., f. 175.

[391] Sh. për këtë Boris Simeonov, Etimologićen rečnik na mestnite nazvanija ot Gorečko, Godišnik na Sofijskija Univerzitet, Faklultet po slavjanski filologii, Tom LX, 1966, f. 175.

[392] Mikrotoponimet aktuale janë shënuar në terren nga Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës,20 …, f. 131.

[393] Khs. Dečanske hrisovulje. .., f. 25: "bєrislavъ lĕporekъ. .. vlahъ dobromirъ".

[394] Khs. tek K. Jireček, Romani u gradovima Dalmacije, në Zbornik Konstantina Jireceka II, Beograd, 1962,. .., f. 75.

në qytetin e Drishtit ishte në shek. 14 e 15 dera aristokrate emri i së cilës nëpër burime romane është shënuar si *de Leporibus*.[395]

Mikov Potok

Duke u mbështetur tek kuptimi "Përroi i Miku-t" i këtij emri të vendit, ka mbase arsye të paravendohet që te ky emër më parë se trajta e sllavizuar e antroponimit të gjithkrishter *Michael*, ruhet vetë emri vllah *Mucul* "i vogël; Vogli". Në të mirë të mundësisë së dytë do të shkonte rrethana që në hapësirën gjuhësore të shqipes ka edhe një emër vendi, përroske, lumi, që e përmban adjektivin rumun *micul* "i vogël". Kemi të bëjmë me një rrjedhë uji dhe me vendbanimin që në vitet 1313-1315 dëshmohet në trajtën *Mikulštica*, përkatësisht në lokativin serb *ou mikul'štnicu*,[396] sot Mikushnicë në komunën e Skenderajt.

Milshor

Sado që antroponimi *Mil-* i përmbajtur në këtë emër mund të jetë me prejardhje sllave, toponimizimi i tij me prapashtesën karakteristike vllahe (rumune) *-şor* jep arsye që dhe ky emër vendi të merret për gjurmë onomastike vllahe në këtë regjion. Duket se ky do të jetë emri i kryehershëm i vendit, të cilin shkruesi serb do ta ketë evidentuar në dokumentin e vitit 1348 për si *milištь katúnь* (khs. më lart). Një emër vendi, në ambient të banuar edhe me vlleh, të formuar me këtë prapashtesë vllahe e gjejmë të dëshmuar po në vitin 1348 tek emri *Vinishor*, përkatësisht *Vinišorski grab*[397] i vendit që ka të bëjë me katundin e sotëm Nishuer/Nishor,-i të rrethinave të Suharekës. Ndoshta këtu do të binte edhe mtp. *Srbčevo Gmno* në katundin Radesh. Ky emër do të duhej të jetë i së njëjtës prejardhje si edhe antroponimi i dëshmuar në trajtën *Sîrbşor* edhe në funksion prej emri të vendit si *Sîrbşorii*. Te ky emër nuk shihet domosdo, me Rosetti-n, një antroponim me vlerën kuptimore të emrit etnik "serb", porse një emër personal kuptimin e të cilit sot nuk e dimë. Fundja, kjo prapashtesë e rumanishtes ka depërtuar edhe në shqipen, ku kjo dëshmohet p.sh. tek fjalët *kupshuer*, *kupshore*, *nanshore*, *trimshor*, *trimshore*, sado që ka mundësi që kjo prapashtesë, siç do ta tregonte rasti (gur) *katërshor* i shqipes, të jetë prapashtesë (edhe) e shqipes si një konglutinat i prapashtesave thjesht shqipe *-sh* e *-or*.[398]

Rosha

Pa pas treguar se ku ndodhet e çfarë është, S. Idrizi[399] për toponim vllah e mban edhe emrin *Rosha* të një vendi i cili, sipas J. Osmanit,[400] po u ndodhka në

[395] K. Jireček, Romani u gradovima Dalmacije …, f. 113, 296.

[396] Khs. crьkv' i u vlьčiju poljanu. u lьništ'ni potokъ gdě spada u mikul'štnicu., te Lj. Kovačević, Svetostefanska Hrisovulja. .., f. 3.

[397] Khs. Hrisovulja. .., f. 295.

[398] Khs. Prof. Dr. Alesandër Xhuvani dhe Prof. Eqrem Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë, 1962, f. 87.; Al. Rosetti, Istoria limbii române. .., f. 428.

[399] Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k –

katundin Brod të Gorës. Unë do t'i shtoja këtu edhe mikrotoponimet *Rosh*, livadh i rrafshtë në katundin Kaliqan të Istogut,[401] dhe *Rosheli* i **Labajve* mal me pisha te Livadhet e Istogut, të quajtura "sipas Laboviqëve shqiptarë", i shënuar nga Stijović [402] si *Rošel Labovića*.

Emri i regjionit të Gorës, bashkë me ata të Istogut e të rrethinës së tij, janë të emërtuar mbase në bazë të ngjyrës së dheut dhe, si të këtillë, do të jenë të pandashëm nga emrat familjarë të rumunëve të formuar nga mbiemri *ròşu* "i,e kuq; lule e kuqe" me prapashtesa të ndryshme si: *Roşa*, *Roşeni*, *Roşia*, *Roşeşti*, *Roşile*, *Roşoara, Roşori* etj.[403]

Mundësinë potenciale të prejardhjes romane të këtij emri e tregon mbase edhe toponimi *Rožat* (it. *Rogiatto* i rrethinave të Dubrovnikut, sado që K. Jireček e afronte këtë me *rosetum*, përkatësisht e mbante për si emër të sajuar me prapashtesën romane *-êtum* nga një e gjermanishtes *raus* në kuptimin e gjerm. së re *Rohr* "gyp".[404] Me më shumë kompetencë përkitazi me këtë mbiemër duhet marrë qëndrimin e romanistit, ballkanologut e sllavistit P. Skok. Kur po bënte fjalë përkitazi me mbiemrin *kuq* të shqipes, ky vërente që ky mbiemër është formuar nga e lat. *cocceus* sipas modelit siç u formuan mbiemrat *rojo* e spanjolishtes, *roxo* e portugalishtes dhe e bizantinishtes ρο□σ(σ)εος(-ιος). Ky mbiemër, gjithnjë sipas P. Skok, në dakorumanishten është reflektuar si *rus* "e kuqe; e lëkuqme, bjonde" vetëm për shenjimin e ngjyrës së qimeve të shtatit të lopës; në arumanishten si *arus* "blond, bălau, plăvit"; në greq. ρο□σσος "blond" dhe në serbokroatishten *ruš* (edhe në antroponimet *Rusin, Rusko*) në shqipen po u dëshmuaka vetëm tek emri i vendit dhe antroponimi Barbullush [nga *barba russa*] i dëshmuar në vitin 1402 për në rrethina të Shkodrës. Në dritën e rrethanës që ky mbiemër dëshmohet në Ballkan nën trajtat *rush*, *rus* Skok e lë të hapur çështjen nëse *roş* e dakorumanishtes dhe *oroş* e arumanishtes rrjedhin nga e lat. *roseus* apo *russeus*. Kjo në rend të parë sepse lëkundje të këtilla midis *o* në vend të *u* dëshmohen edhe ndër gjuhë të tjera në të cilat, nga latinishtja, ka depërtuar ky nocion.[405] E. Çabej në një recension për fjalorin e Tache Papahagi-t *Dicţionarul dialectului general şi etimologic*, këtë fjalë e shihte të dalë nga lat. *russus* "i kuq"[406] Emra të sajuar

[400] Khs. Vendbanimet e Kosovës, 20. .., f. 91.

[401] Sh. Svetozar Stijović, Onomastika zapadnog dela Metohijskog (Pećkog) Podgora, Onomatološki prilozi, III, SANU, Beograd, 1982, f. 256.

[402] Sh.Svetozar Stijović, Onomastika zapadnog dela Metohijskog (Pećkog) Podgora, Onomatološki prilozi, III, SANU, Beograd, 1982, f. 256.

[403] Khs. N. A. Constantinescu, Dicţionar romînesc. .., f. 363.

[404] Khs. Petar Skok, Iz srpsko-hrvatske toponomastike, Južnoslovenski Filolog, VI, Beograd 1926-1927, f. 83.

[405] Khs. Petar Skok, Zum Balkanlatein, Zeitschrift für romanaische Philologie, XLVIII, 1928.

[406] Khs. Zur aromunischen Wortforschung, Studii şi cercetări lingvistice, 1-XXVII/1976, f. 5.

mbase nga ky mbiemër, në trajtën *roš* ndeshen edhe në hapësirën gjuhësore të bullgarishtes.[407]

Duke u nisur vetëm nga mundësia potenciale që e lejon grafia osmane, këtu do të mund të inkuadrohej edhe dëshmia e shek. 16, në të cilën i gjejmë të evidentuar edhe kryefamiljarët e katundit të sotëm Zaplugjë të Opojës: *Hysen Roshi* dhe *Ali Roshi*.[408] Më e sigurt është e dhëna që në hapësirën e Rrafshit të Dukagjinit ishte në përdorim edhe emri femëror *Roshe*. Rrethana që një mbiemër në trajtën *Roshi* dëshmohet edhe për emër vëllazërie ndër shqiptarë të Veriut të Shqipërisë, jo porse shumë larg nga regjioni i Gorës, mund të shërbejë për dëshmi e mirë e asimilimit, e shqiptarizimit të elementit aromun në hapësirën gjuhësore ku këta erdhën më vonë.

Rugove

Emri i këtij vendi në katundin Kukoljan të goranëve mund të jetë pjesë i pandashëm nga antroponimi *Rug* i dëshmuar dendur në ambiente të cilësuara në burime kishtare serbe të shek. 13-14 shprehimisht për katunde të vllehve.

Kështu, në krisobulën e sundimtarit Stefan dhe të të birit Miroslav që paravendohet të jetë e viteve 1222-1228 për themelimin e manastirit të Žiča-s në rrethina të Kralevës së sotme nga vlleht e hapësirës së Hvosnos i faleshin atij manastiri shumë vlleh midis të cilëve ishte edhe një i quajtur Rug.[409] Banorë të quajtur *Rug-ja* dëshmohen në vitin 1330 në katunin e vllehve të Sushicës (vlasi sušičani) të Istogut dhe në katunin *Guncati*, sot Ngucat të Malishevës dhe një banor i katundit Botushë të Gjakovës;[410] një banor i katundit Mariniq të Bjellopavliqëve (Palabardhajve) quhej në v. 1485 *Rugaç*-i, i bir i Mihalit,[411] ndërsa në vitin 1455 është evidentuar një truallishtë e quajtur *Rugovica* të cilën e punonin banorët e katundit, po ashtu të panjohur me këtë emër, Klasçiq.[412] Meqë kjo truallishtë dhe kat. Klasçiq ishin në një timar me katundin e sotëm Gllogovicë të krahinës së Gallapit, ka arsye të mendohet që kjo truallishtë ishte afër Gllogovicës apo ka të bëjë me lagjen e sotme Laçiq të Desivojcës së Kamenicës.

Sikundër e tregon vetë trajta aktuale *Rugove* e emri në rasën gjinore e emrit në Kukoljan të Gorës, antroponimi Rug do të ketë qenë pjesë e parë e sintagmës toponimike objekti + pronari, përkatësisht X + e *Rug*-ut.

Sharbanica

Duket se emri *Šarbanica* i vendit në katundin Brod të Gorës do të ketë qenë në krye të herës toponim dypjesësh në njërën nga të cilat do të jetë përmbajtur

[407] Khs. Boris Simeonov, Latinskite imena v bălgarskiija ezik, Bălgarki Ezik, VII, Sofje, 1957, f. 56.
[408] Sh. S. Pulaha, Të dhëna ekonomike dhe demografike. .. dhe Popullsia. .., f. 355.
[409] Khs. tek Fr. Miklosich, Monumenta serbica. .., f. 12.
[410] Khs. Dečanske hrisovulje. .., f. 121-122; 290-291; 59.
[411] Khs. te S. Pulaha, Defteri. .., f. 123.
[412] Sh. tek Oblast Brankoviča, … f. 196.

antroponimi karakteristik *Šarban*, përkatësisht *Şarban*/*Şerban* i vllehve, i dëshmuar dendur në burime shkrimore të shek. XIII-XV. Të gjithë dijetarët që janë marrë me prejardhjen e këtij emri pajtohen që ky rrjedh nga emri më i vjetër **Servus* **Serva*,[413] përkatësisht nga rum. *şerb* "bujkrob".

Është për t'u përmendur në këtë mes që, sipas I. Duridanov, [414] *Šarbânica* quhet (edhe) një kullotë me tëbane afër katundit Zagažene në rrethin e Sofjes.

Shtubeja

Një mikrotoponim me prejardhje të padiskutueshme romane ballkanike është edhe emri i burimit *Štubeja* në regjionin e Gorës. Ky emër rrjedh nga fjala rumune *ştiubei* "burim"[*], që në hapësirën gjuhësore të rumanishtes ndeshet e përmbajtur në emrat e vendeve *Dealul Ştubeilor, Ştubeiul, Ştubeiul-Oroşti*.[415] etj. Jashtë territorit gjuhësor të rumanishtes, ky apelativ ndeshet edhe në emrin e vendit *Ščubejski izvor* afër vendit Slatina të regjionit të Banat-it. Kuptimin "burim, krua" të rum. *ştiubei* e tregon më së miri pikërisht emri *Ščubejski izvor* i regjionit të Banat-it, në të cilin emër kemi të bëjmë me një tautologji, përkatësisht me përkthim të emrit rumun *ştiubei* "burim" me serb. *izvor* "burim".[416] Emri *Štubeja* i vendit të krahinës së Gorës nuk mbetet i vetmuar. Një emër burimi të quajtur *Shtubeja* e kam shënuar para shumë vitesh edhe në katundin Poklek të rrethinave të Gllogovcit në krahinën e Drenicës.

Valloshica

Mua më duket që mikrotoponimi *Valošica*[417] lexo si shq. *Valloshica* (nga *val-* e zgjeruar me prapashtesat *-oš* e *-ica*, për të shenjuar kështu ndonjë luginëz, përroskë) i katundit Radesh të Gorës mund ta ketë për rrënjë apelativin latin, *valle*(*m*) "luginë" përkatësisht roman-ballkanik *vale* "luginë". Kjo fjalë është ruajtur në rumanishten si *vàle* "luginë, përrua" dhe si zhvillim lokal në arumanishten si *văligă* "luginë e vogël" e si *văloàgă* "fushë e vogël". Me prejardhje nga kjo fjalë e rumanishtes, përkatësisht e vllahishtes në Bullgari ka disa toponime, midis të cilave edhe emri *Valòg* në krahinën Godečko.[418] Në hapësira të Bullgarisë e të Serbisë, për të cilat dihet se ishin të banuara me vlleh, ka edhe shumë mikrotoponime të formantit *Valja*, *Valej* etj. Të kësaj familje (romane ballkanike) janë mbase edhe emri *Vallç* i katundit të rrethinave të Mitrovicë dhe mikrotoponimet kosovare si *Valeq*, *Valishtë*, *Valushë*; emri

[413] Sipas P. Charamanu, L' heritage. .. 1112.

[414] Khs. Ivan Duridanov: Кьм etimologijata na njakoi starinni mestni nazvania, 164

* Në fjalorin rum. - bullgar është dhënë për me kuptimin e bullg. "košer, тръvna".

[415] Sipas M. Scărlatoiu, Emprunt roumains dans les lexique serbocroate, Revue des études sud-est europeennes, 10 (1972), f. 120.

[416] Khs. Otto Franck, Studien zur serbokroatischen Ortsnamenkunde, Leipzig, 1932, f. 104.

[417] I shënuar në terren nga Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 129.

[418] Sipas Boris Simeonov, Etimologičen rečnik na mestnite nazvanija ot Gorečko, Godišnik na Sofijskija Univerzitet, Faklultet po slavjanski filologii, Tom LX, 1966, f. 13.3

Valbona i lumit në Veri të Shqipërisë dhe mikrotoponimet e atjeshme *Valesh, Valth, Valkal, Valor* etj; pjesa e parë e emrit *Valdanoz* të rrethinave të Ulqinit, por edhe pjesa e dytë e emrit Kur*valla* të rrethinave të Junikut e të mos flasim për mikrotoponimet homonime *Val*(l)*oga* të Kosovës e të Bullgarisë e aq më pak për emrat *Valelunga* e të shumë të tjerëve të hapësirës gjuhësore të rumanishtes në të cilat përmbahet apelativi latin-ballkanik *vale* nga lat. *valle*(m) "luginë", që do të jetë përhapur përmes barinjve shtegtarë vlleh, pa e përjashtuar edhe mundësinë që, në hapësirën gjuhësore të Dardanisë antike, emrat e kësaj prejardhjeje të jenë ruajtur edhe nga popullata vendëse e romanizuar thellë apo tërësisht. Duke qenë se këtë temë e kam trajtuar më gjerësisht në një punim tjetër timin, më poshtë po i sjell vetëm titujt e punimeve të autorëve që janë marrë me këtë çështje dhe që unë i kam cituar në punimin tim në dorëshkrim Vlacho-Albanica.[419]

8.1.7. Emra vëllazërish:

Bazda/Bazdovci/Bazovci:

Mua më duket që ky emër vëllazërie, bashkë me emrin *Bazdina rupa* të vendit në Restelicë nuk do të ketë ndonjë lidhje me mbiemrin e dëshmuar shumë rrallë (dëshmia më e vjetër dhe mbase e vetmja e të cilit rrjedh nga viti 1886) *Baza* të boshnjakëve. Së këndejmi, kujtoj që lidhja hipotetike e këtij emri me një trajtë të mundshme të përkëdhelisë së emrit oriental *Abas*, nuk është mbushamendëse. Me më shumë mundësi për t'u besuar më duket afrimi i këtij emri me trajtat rumune *Bazu, Bazul, Bazan, Bazaci, Bazoi* që propozohen nga vetë autori i burimit që po e shfrytëzoj[420] e ndoshta edhe me mbiemrin *Bazescu* të rumunëve.

Ese, Esovci

Për emër me prejardhje vllahe merret edhe *Esovci* i vëllazërisë gorane të katundit Restelicë duke i inkuadruar këtu edhe mikrotoponimet në katunde shqiptare të Opojës që e përmbajnë këtë antroponim. Ky emër dëshmohet në regjistrimin e viteve 1467-1468 për në katundin Senokos të nahijes së Tetovës ku jetonte kryefamiljari Teodor,-i, i bir i *Es*-it.[421] Nëse ky emër është

[419] D. Scheludko, Lateinische und rumänische Elemente im bulgarischen, Balkan-Archiv, III (1927), f. 117; Jordan Zaimov, Grьčki i romanski elementi v Pridopskata toponimija, Izledvanija v čest na Akad. Dimitьr Dečev po slučoi 80 -godišnata mu, Sofija 1958, f. 172-173;. Emil Lafe, Toponime latine-romane në truallin e shqipes. .., f. 133.; N. Jokl, Zur Ortsnamenkunde Albaniens, Zeitschrift für Ortsnamenforschung 33 (1934), f. 119;.I. Moïse. Neskolьko balkanskih toponimičeskih nazvanii rumunskoga proishoždenia, Actes de Xie congres international des sciences onomastiques, I., Sofija, 1972, f. 61-82 dhe Th. Capidan, Raporturile lingvistice slavo-romane, Dacoromania 3(1924) f. 234.

[420] http: wikipedia.org/wiki/Bošnjaci_Kosova32k.

[421] Khs. Defter nr. 4. .., fq 339, i transliteruar këtu në gjinoren sllave si *Eš*, përkatësisht *Aš*

megjithmend me prejardhje vllahe, duket që më e mundshmja do të ishte lidhja e tij me trajtën e shkurtër rumune *Ese* të antroponimit Josif, siç del tek rumunët.[422]

Gogovci

Kështu quhet një vëllazëri në katundin Vranisht; një livadh **Gagove livade* në Lubovishtë, përkatësisht në Mlikë dhe një burim uji *Kroi Gogos* në katundin shqiptar të Kuklit të Opojës.[423]

Ky emër vëllazërie është sajuar nga varianti *gogë* që është një sinonim për emrin *vllah*. Nocioni *gogë* e ka po atë kuptim si edhe *rumun*, *cincar*, *aromun*. Ky nocion shënonte në Shqipërinë e Veriut kryesisht muratorët vlleh; mbiemri *gogërisht* ishte një sinonim për gjuhën/ të folmen aromune, ndërsa nocioni *gogëreshë* shenjonte bashkëshorten e muratorit; vllahen. Kjo përputhet me mendimin e P. Skok,[424] i cili vërente porse që *goga* qenka një ballkanizëm me prejardhje të panjohur, pas gjithë gjasash porse një onomatope e shqipes, mirëpo kuptimi i kryehershëm i këtij emri ishte "cincar, vllah i Maqedonisë, vllah, aromun < Romanus".[425] Edhe për G. Elezović-in etnonimi *goga* qenka kuptimisht i barabartë me *cincar* përkatësisht me "vllah" konstaton porse që *gogët* nuk paskan qenë marrë kryesisht me mjeshtrinë e murimit, porse edhe me atë të kallaitjes dhe me atë të përpunimit të arit.[426] Shumë kohë përpara këtyre dy dijetarëve, Fr. Miklosich e kishte shfaqur mendimin që etnonimi *gogë* është ". .. një ofiç për vlleht që jetojnë në Shqipëri. ..".[427]

Sipas mendimit pothuaj të të gjithë ballkanologëve që janë marrë me çështjen e prejardhjes dhe të kuptimit të këtij nocioni, rezulton që emri *gogë* dhe derivatet e tij, përfshirë këtu edhe emrat familjarë *Goga* / *Gogo* ndër rumunë e ndër bullgarë dhe *Gogoman*/*Guguman* "marroq, budalla" në Moldavi, po rrjedhkan nga mbiemri rumun *gogoaş* "trashanik, budalla".[428] Për si element

[422] Khs. N. A. Constantinescu, Dicționar. .., f. 53.

[423] Të shënuar në terren nga Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, f. 142, 121, 114.

[424] Sh. Etimologijski rječnik. .., I, f. 585.

[425] Sh. Rečnik kosovsko- metohiskog dijalekta I, Beograd, 1932, f. 102.

[426] Rječnik, po aty, f. 100.

[427] Über die Wanderungen. der Rumunen in den dalmatinischen Alpen und den Karpaten, Denkschriften der Philosophisch-historischen Classe der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften XXX, Wien, 1880, f. 3.

[428] Khs. G. Meyer, Etymologisches Wörterbuch. .., f. 126; L. Spitzer, Albanesische Etymologien, Mitteilungen des Rumänischen Instituts an der Universität Wien, Heidelberg 1914, f. 320. Ka mbetur çështje ende e hapur nëse fjala *goga* në krye të herës e kishte kuptimin "*bari,-u*", por që më vonë e ruajti vetëm kuptimin e ndryshuar në "trashanik, budalla", që iu dha kësaj fjale. Është për t'u vërejtur në këtë mes që në shqipen zhvillimi kuptimor i fjalës *bari,-u* përputhet me atë të fjalës *gog*/*ë.-a*. Kështu, nga shumë dijetarë është pranuar mendimi që fjala latine *baro, baronis* "budalla, që s'kupton" për në Itali e në Ballkan konsiderohet për shprehje me prejardhje ilire. Ky ilirizëm i latinishtes zbërthehet me fjalën shqipe *bëruo, bërua*, e cila në shqipen e sotme ka dhënë *bari, -u* (për më shumë hollësi sh. E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të

ballkanik i terminologjisë së blegtorisë, kjo fjalë po u ndeshka si term abstrakt edhe në pjesën ukrainase të Karpateve edhe si *gogoman*.[429]

Hatulinci

Me prejardhje vllahe do të jetë edhe emri i *Hatulinci* i vëllazërisë në katundin Brod të Gorës. Karakterin, roman ballkanik, përkatësisht vllah të këtij emri e tregon jo vetëm trajta e tij e shquar me prapashtesën latine ballkanike, përkatësisht rumune *-ul*, porse edhe dëshmimi i tij në funksion emrash personalë e mbiemrash ndër rumunë në trajtat *Hăți*, *Hățe*, *Hățul*, *Hăteș*, *Hătaș*, *Hătaşī*,[430] por edhe dëshmimi i tij në shek. 15 nëpër ambiente në të cilat kishte pjesëtarë të etnisë vllahe. Një dëshmi të kësaj natyre e kemi nga qytetthi i sotëm i Vushtrrisë në vitn 1455 kur për këtu është evidentuar një banor i tij i quajtur Radovan-i, i bir i *Hatul*-it.[431] Një dëshmi tjetër të këtij emri e kemi edhe nga shek. 16 (1571), kur dëshmohet se këtë emër, në trajtën *Hatun*-i e mbante edhe një banor, pronar i një bashtine, i katundit të sotëm shqiptar Zapluxhë të krahinës së Opojës, i quajtur Shahi Hatuni.[432] Shtrirjen e këtij emri në pjesën më të madhe të truallit gjuhësor të shqipes dhe vazhdimësinë e tij tek shqiptarët, sikur e dëshmon ruajtja e këtij deri në ditë tonat si emër vëllazërie *Hatoll*-ët dhe tek mikrotoponimet *Mali i Hatoll've* e *Lisat e Hatoll've* në katundin Tuxhevc të krahinës së Gallapit.

Jankulovci

Vëllazëria gorane *Jankulovci* e katundit Brod të Gorës, e ka për rrënjë të emrit të saj antroponimin e gjithkrishter greq. Ιωάννες, lat. Ioannes në trajtën romane, përkatësisht vllahe *Iancu*, *Iancul*. Prejardhjen vllahe të këtij emri të vëllazërisë e tregon më së kthjellti trajta e zgjeruar e antroponimit bazë me prapashtesën karakteristike romane ballkanike *-ul*.

Karovci:

I përkatësisë vllahe është edhe emri *Kare/Karovci* i një vëllazërie të katundit Zlipotok të Gorës, në hapësirën e të cilit është edhe një vend i quajtur *Karevo*.[433] Ky është njëri ndër emra që, në burimet shkrimore serbe e osmane të shek. 14-15, nuk është dëshmuar të ishte bartur nga banorët e sotëm të këtij katundi të

---

shqipes, II (A-B), Tiranë 1976, f. 165-167). Krejt ndryshe mendon F. Miklosich, Die Wanderungen. .., f. 3, i cili tek kjo fjalë sheh ". .. një ofiç që ka të bëjë me vlleht që banojnë në Shqipëri".

[429] Khs. D. Karandžalov.: La terminologie pastorale commune chez les peuples balkaniques, Aktes du preemeier congres international des études balkaniques et sud-est européennes, Sofia, 1968.

[430] Sh. A. Constantinescu. .., f. 294.

[431] Khs. Oblast Brankovića,. .., f. 30.

[432] S. Pulaha, Popullsia. .., f. 535.

[433] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I – IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

regjionit të Gorës. Kjo rrethanë e lë të hapur paravendimin që (edhe) këtu mund të kemi të bëjmë me një familje/vëllazëri vllehsh (khs. psh. emrat e vëllazërive *Kërçovci* e *Sarandovci*) të ardhur nga ndonjë vis i Maqedonisë së sotme dhe i Jugut të Shqipërisë. Ky është emër i së njëjtës gurrë prej nga rrjedh edhe mbiemri *Karev* i heroit nacional "maqedonas" Nikola, burrit të parë të "Republikës së Krušev -ës". Në vija më të largëta, ky emër përputhet me emrin më të vjetër *Karanovo* të qytetit të sotëm *Kragujevac* të Šumadia-s, "Zemrës së Serbisë", për emrin e të cilit s'ka ndonjë prejardhje tjetër të propozuar përveç që është emër *proprie dicti* i gurrave vllahe.

Kutinci

Duket se, sipas I. Duridanoiv[433a] emri i kësaj vëllazërie nga rrënja emërore *Kut-* e zgjeruar me prapashtesën sllave *-inci* që tregon përkatësinë e një vëllazërie apo një vendbanimi, nuk mund të largohet nga emrat m. Κουτυς, *Kutius, Kuties* dhe atij fem. Κουθειν dhe varianteve të zgjeruara të tij të trakasve, të cilët (emra) s'do të kenë gjë të përbashkët në rrafshin etimologjik me emrat e tipit Kuta, Kutov në funksion patronimi apo ofiçi që ndeshen ndër sllavë, meqë këndej ky emër qenka sajim onomatopeik i dalë nga nocioni *kut - kut* i ndjelljes së qenit.

Lajkovci

Duket se emri i kësaj vëllazërie gorane të katundit Glloboçicë të Gorës, që në funksion mbiemri familjar përdoret në trajtën *Ljajko*.[434] nuk mund të ndahet lehtë nga mbiemri *laiu* i vllahishtes i cili nuk ka hyrë në gjithë leksikun e shqipes, por që megjithatë, për sa i përket hapësirës etnolinguistike të shqipes, ndeshet vetëm në Shqipërinë e Jugut, ku shërben si term blegtoral për të shenjuar delen e zezë, përkatësisht *dele llajë* "dele e zezë; galë, galushë". Vëllazëria gorane do të jetë quajtur kështu më parë pse do të jetë shquar për mbajtjen e më shumë deleve të zeza sesa pse do të jenë shquar për ngjyrën më të errët të tyre të lëkurës. Nëse ky shpjegim është i qëndrueshëm, atëherë do të mund të thuhej që ky emër vëllazërie e dëshmon së pari përkatësinë e kryehershme vllahe të pararendësve të kësaj vëllazërie e pastaj edhe mundësinë që ata pararendës të kenë qenë folës të vllahishtes të vendosur në zonën e Gorës nga jugu i Ballkanit. Në të mirë të këtij paravendimi do të fliste edhe rrethana që fjala *laja*, bashkë me atë *kulastra-kuřtasva* shq. "kulloshtër" dhe disa nga të 120 termave të tjerë mbahet për term blegtoral i përhapur në gjuhë të Ballkanit,[435] mbase me prejardhje vllahe. Përveç tek emri i kësaj vëllazërie, mbiemri rumun

[433a] Khs. Die thrakische Einfluß auf die bulgarische Anthroponymie,Balkansko Ezikoznanie-Linguistique Balkanique II, Sofia, 1960, f. 79.

[434] Khs. Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[435] Khs. D. Karandžalov, La terminologie pastorale commune chez les peuples balkaniques, Aktes du premeier congres international des études balkaniques et sud-est européennes, Sofia 1968.

laiu është ruajtur ndoshta edhe tek mikrotoponimi *Zabeli Lajës* në një katund shqiptar të Opojës dhe tek emri *Llajshevc* i lagjes së dikurshme të katundit Dragovc, tani vendbanim më vete në komunën e Prishtinës si dhe tek emri homonim i një katundi të komunës së Ferizajt.

Kjo aq më parë, sepse edhe në krisobulën e sundimtarit serb St. Uroš Milutin të vitit 1321 mbase pikërisht katundi i sotëm Dragovc është dëshmuar për i banuar nga vëllazëria vllahe e *Dragobratić*-ëve, e cila në këtë dokument është cilësuar edhe shprehimisht për vëllazëri vllehsh khs tekstin: "Dhe për vlleht Dragobratići, të cilët ia pata dhënë (SG manastirit) Shën Stefanit, ipeshkvisë së Lipjanit ia dhash, për zëvendësim, vlleht komanë"[436] me 26 familje.

Ka një mendim sipas të cilit edhe vetë vlleht që shquheshin për mbajtjen e deles së zezë *crna vlaška ovca* "dele e zezë vllehsh" ose *karakačanka* nga maqedonasit përreth e paskan marrë emrin vllehtë e Zinjë ose Karavllahët.

Lupanovci; *Ljupanka*

Element onomastik vllah (autori e përdor termin *aromun)* është, sipas N. Dokles[437] edhe emri i vëllazërisë *Lupan*/*Lupanovci* i katundit Borje të Kukësit, në të cilin (katund) është edhe mikropoponimi *Lupanovo jabuqe* "Molla e Lupanit". Pa e pas dhënë shënimin e saktë në cilin katund ndodhet, Sadik Idrizi e sjell për emër vllah edhe emrin *Ljupan* /*Ljupanka* të një vëllazërie në katundin Krushevë të pjesës kosovare të Gorës. Në të tre këta emra përmbahet fjala vllahe *lupul* "ujk". Unë nuk kam kaçik nga dija e romanistikës të përcaktoj nëse bazë e këtyre emërtimeve është apelativi vllah *lupul* apo antroponimi *Lupul i sajuar nga ai apelativ. Sido që të jetë, emrat vlleh të Borjes janë të pandashëm për nga prejardhja e përbashkët dhe për nga kuptimi nga mikrotoponimi *Maja Volpul* në Veri të Shqipërisë, të sqaruar nga N. Jokl po ashtu për si toponim vllah me kuptimin gjerm. *Die Spitze des Wolfes* "*Maja e Ujkut*".[438] Këtyre unë ua shtoj edhe emrin *Dërllupa*, siç quhet një pjesë e katundit Gllamnik të komunës së Podujevës. Mbase edhe në pjesën e dytë -*llupa* të emërtimit *Dërllupa*, për pjesën e parë të të cilin nuk di të them gjë, përmbahet gjithashtu fjala lat. *lupus* "ujk" në variantin e romanitetit ballkanik të tij. Vështruar në aspektin jashtëgjuhësor, rrethana që një emër i tillë me prejardhje latine-ballkanike dëshmohet pikërisht në katundin e sotëm Gllamnik, i cili si në aspektin gjeografik ashtu edhe në atë arkeologjik është dëshmuar se gjatë sundimit romak ishte *statio* e njohur me emrin *Vindenis*, do të dëshmonte që të gjitha emërtimet e trajtuara në këtë kuadër duhen parë për dëshmi të latinitetit ballkanik, bartës të të cilit do të jetë popullata vendëse, qoftë ajo e romanizuar apo vetëm vazhduese e emrave që i

[436] Khs. tekstin origjinal: I za vlahe Dragobratikє, koje dahь Svetomou Stefanou, dahь za ne zaměnou jepiskoupii lipljanьskoi Komane vlahe,. .. te Fr. Miklosich, Monumenta serbica. .., f. 562 dhe te St. Novaković, Zakonski spomenici. .., f. 635.

[437] Nazif Dokle, Për Gorën dhe goranët, (Artikuj e studime), Prizren, 2002, f. 57.

[438] N. Jokl, Linguistisch - kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen, Berlin 1923; Balkanlateinische Studien f. 204 etj.

trashëgoi nga sundimi romak. Rrethana që *Dërllupa* nuk është vendbanim apo pjesë e një vendbanimi në zona blegtorale, sikur e përforcon mundësinë që këtu nuk kemi të bëjmë me ndonjë emërtim të para kohës së territorializimit të katundeve vllahe të mesjetës së vonë.

Llopushnik

Me një dozë jo të vogël rezerve, në radhën e emrave me prejardhje vllahe e inkuadroj edhe emrin e katundit të sotëm Llopushnik. Ky sqarim i imi mbështetet vetëm tek një interpretim i N. Joklit i një toponimi *Lpusha* - vend i sheshtë në Qafën e Predelecit në krahinën e Kelmendit. Emri i këtij vendi po u sqaruaka, gjithnjë sipas Jokl-it, me rum. *la apusă* "në rrafsh" nga pjesorja *apune* "zbres, zhdirgjem, bie poshtë"; aromun. *apunere* "shtrihem, ul, zbres, ulem" khs. edhe arum. *apus* "i ulët, i rrafshtë". Kjo etimologji do të forcohej, duke u mbështetur tek autori ynë edhe me rrethanën që në shqipen ka depërtuar edhe pjesëza *la* e rumanishtes/arumanishtes: khs. *me u lavierrë, lavierrc, lavjerrës* nga *vjerr*; *lëfyt* nga *fyt* etj. [439] e ndoshta, shtoj unë, edhe tek emri *Llakatund* i një vendbanimi në jug të Shqipërisë. Megjithatë, unë e lë të hapur edhe mundësinë e afrimit të emrit *Llopushnik* edhe me emrin sllav. *lopusa*, shq. *Llapushë bot.* Petasides officinalis, *llopushtër* bot. Rumex obtusifolius, *lëpushë, lëbushë* të bimës.

Macina

Prejardhje të përbashkët nga latiniteti ballkanik kanë emri *Macina* e *Mackino* i një lagjeje në katundin Kërtec i Madh të Gorës; emrat *Maqekët* i një lagjeje të katundit Kosavë dhe *Maqketa* i një tjetre të katundit Blaç si dhe antroponimi që mbase përmbahet në mikrotoponimin *Kroi *Macos*[*] në katundin Kuk të Opojës.

Përkitazi me një emër të kësaj familjeje shkruante edhe dijetari bullgar B. Simeonov[440] Ky kujtonte që emrat *Macinci* dhe *Macùkova mala* i një vëllazërie dhe lagjeje në regjionin Godečko të Bullgarisë rrjedhin nga emri personal *Màca*, ndërsa ky vetë nga rum. *macuka*, përkatësisht nga arum. *măţucă*, *maciucă*, *măciuc* bullg. "sopa, tojaga, brvo". Për si gjurmë onomastike aromune në hapësirën e bullgarishtes, Al. Rosetti e shihte edhe emrin *Mačeš*.[441] Antroponimi *Mac-* i gurrave aromune dëshmohet në shek. 15 edhe në hapësirën që sot e zë shteti i quajtur Maqedoni.[442]

[439] Jokl, Norbert: Zur Ortsnamenkunde Albaniens, Zeitschrift für Ortsnamenforschung, Bd. 10, Heft 2.,1934. f. 197.

* I shënuar nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, f. 114 si *Kroi macos.*

[440] khs. Etimologičen rečnik na mestnite nazvanija ot Gorečko, Godišnik na Sofijskija Univerzitet, Faklultet po slavjanski filologii, Tom LX, 1966, f. 185.

[441] khs. Istori limbii romin …, f. 431.

[442] khs. për këtë Turski dokumenti za istorijata na makedoskiot narod, Defter Nr. 4

Rethana që emrat e këtyre lagjeve nuk përmenden nëpër burime që kanë të bëjnë me popullatën e këtyre dy krahinave, nuk bën të jetë arsye që edhe këta emra të mos konsiderohen për të vjetër, përkatësisht për me prejardhje nga shtresa e latinitetit ballkanik, kjo sepse një vend i quajtur *Maqinci*, afër katundit të sotëm Senik të Rahovecit, dëshmohet qysh në vitin 1348.[443] Në dritën e mikrotoponimeve *Maqina* - një kompleks i gjerë kullotash; *Vorret e Maqinës* dhe *Ara Maqinës* që i kam shënuar vetë, vendbanimin e shek. XIV *Maćinci* e lokalizoj në territorin e katundit Drenovc në periferi të Rahovecit. Trajta e dëshmuar *maćinci* e vitit 1348 është zgjerim me prapashtesën *-ci* në funksion të emrit të vëllazërisë ose të banorëve të një vendi, në rastin tonë "banorë të vendit Maćina". Si emri i këtij vendbanimi, ashtu edhe emri *Macina* i vëllazërisë gorane mund të shpjegohen me foljen rumune *a mácina* "bluaj" i zgjeruar me prapashtesën serbe *-ci* me të cilën, në rastin tonë, tregohet edhe mjeshtëria me të cilën merret një vëllazëri konkrete. Vetë folja *mácin*/*maćina* rrjedh, sipas Sextil Puscariu,[444] nga lat. **machino*, *machinare* ose *macinare*; khs. lat. *machĭnāri* (prej nga rrjedhin ital. *machināre*, span. *maznar*, velot. *maknur*; arum. e meglenorum. *maţin*, istrorum. *moţiru*.)[445] Tek emrat e mësipërm kemi të bëjmë me emra vlleh të motivuar nga puna, e bluarjes, të vëllazërive gjegjëse. Përkatësia vllahe e këtyre emërtimeve gjen mbështetje edhe tek rrethana që as fjala latine *machina* nuk ka hyrë në shqipen (siç mendon Miklosich) në kuptimin e moknës, e as folja *macinare* në kuptimin e veprimit të bluarjes, sepse shqipja e kishte huazuar fjalën mokën më heret nga *makhana* e greqishtes së vjetër dhe folja *bluaj* duket të jetë e vetë shqipes.[446]

Kujtoj se mund të lehet e hapur çështja nëse në këtë kuadër do të binin edhe mikrotoponimet *Kroi Macës* në katundin Pllajnik të Opojës dhe *Maćkina Dupka* në katundin Radesh të Gorës, sidomos në dritën e mundësisë potenciale të ndikimit të etimologjisë popullore. Sido që të jetë, në këtë mes duhet pasur parasysh që këtu nuk bën të inkuadrohen trajtat e palatalizuara *Maq, Maqo, Maqodat* etj. të antroponimit, i cili ka prejardhje krejt tjetër.

Duket se me prejardhje vllahe do të jetë edhe emri *Macina* i vendit në katundin Dobërçan të komunës së Gjilanit. Kjo aqë më parë që në këtë katund ka edhe dy emra të tjerë me prejardhje nga latiniteti ballkanik:

---

[443] Khs. Hrisovulja. .., f. 276: "Selo sěnjàni. a mєgja mou z doubljanьı ѡt potoka ouzdolь na dělь koudě bělegě postavisьmo. a ѡt mєgje doubljanьske poutєmь po dělou do bělěga. i vьıou sěnjamь megjà s potočanьı i s maćinci. ..".

[444] Khs. Etymologisches Wörterbuch der rumänischen Sprache (Lateinisches Element), Heidelberg 1905; Alejandro Cioranescu, Dictionario etimologico rumano, Madrid, 1966, f. 492.

[445] Fr. Miklosich, Die Romanischen Elemente im Albanischen,. .., f. 37 i shkruan fjalët italiane si *mácina* "mokën"; *macinare* "bluaj" dhe rum. *mátsin*; mrum. *matzen* "bluaj".

[446] Khs. për këtë E. Çabej, Stdime etimologjike në fushë të shqipes, II, A-B, Tiranë, 1976, 270-271.

Mushninca (për etimologjinë khs. *Muševci*) dhe *Monacelle*,[447] që duket se s'mund të ndahet nga emri *Mundel* i katundit të dëshmuar në defterin e viteve 1566-1574.[448]

Mandak:

Ka gjasë që ky emër ta ketë prejardhjen nga lat. *mando* bullg. "дъvča" (mandibula), që në italishten tingllon si *mangiare* "ha".[449] Në këtë rast, kujtoj unë, emri *Manda* do të jetë një ofiq në kuptimin "grykës, llupës, *hamës*."

Mango/Mangovci

Duket që emri *Mangovci* i vëllazërisë në katundin Brod të Gorës është ndoshta i pandashëm nga emri *Mangalaçët* i një vëllazërie të katundit shqiptar Zaplugjë të krahinës së Opojës dhe, në vija më të largëta, nga emri i vëllazërisë gorane *Mangrece*/*Mangrice* në katundin Lubovishtë. Të gjithë këta emra mund të lidhen mbase me apelativin *mandza* të rumanishtes, i cili në të folmen gorane (jo porse edhe në atë të Opojës) është ruajtur[450] në trajtën *mandža* në kuptimin "hae, gjellë". Nëse ky sqarim mund të qëndrojë në këmbë të veta, atëherë prejardhja e përbashkët vllahe e emrave të vëllazërive shqiptare e gorane do ta dëshmonte edhe procesin e bashkëshkrirjes së këtyre dy popullatave: ose pararendësit e Mangalaqëve shqiptarë u sllavizuan, ose ndodhi e kundërta. Në të mirë të sllavizimit të një pjese, familjeje, të Mangalaqëve do të fliste rrethana që vëllazëria Mango jeton sot në Brod, katundin qendror në të cilin janë vendosur vëllazëri me prejardhje shumë heterogjene.

Muše/Muševci/Mushku:

Emri i kësaj vëllazërie gorane, që sipas S. Idrizit për në funksion mbiemri të një familjeje ndeshet në katundin Restelicë të Gorës, nuk ka si të ndahet nga antroponimi *Muşat* i dëshmuar dendur ndër vlleh, një mbiemër që rrjedh nga adjektivi rumun, vllah *muşat* me kuptimin "i bukur, fort i bukur", përkatësisht fr. "gentil, joli, joliet".[451] Vetë mbiemri vllah, përkatësisht aromun *muşat* është refleks i mbiemrit latin *formosus*: (for)mosatus > *muşat* i cili ndeshet në gjithë zonën e rrjedhës së poshtme të Danubit, tek meglenorumunët e Greqisë e deri edhe tek istrorumunët. Megjithatë, pikërisht për shkak të trajtës në të cilën reflektohet, antroponimi *Muşat* konsiderohet për antroponim karakteristik i

[447] Këta emra i ka shënuar në terren Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 6, Gjilani, Prishtinë2004, f. 132. (sipas: Sadik Idrizi Aljabak, Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I–IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[448] Khs. Tapu ve kadastro ümüm. .., f. 237, S. Pulha, Populsia. .., f. 708.

[449] P. D. Skorčev, Čuždata duma v našata kuhnja, në Bălgarski ezik VI, 2/1956, f. 162.

[450] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak, Aromunsko-vlaški tragovi u Gori. ..

[451] Për kuptimin khs. psh. T. Papahaghi, Dictionarul aromân general şi etimologic, Bucureşti 1974, f. 841; Alejandro Cioranescu, Dictionario etimologico romano, Madrid 1966, f. 548.

vllehve, përkatësisht i aromunëve. Antroponimi *Muşat* bie ndër emra të shpeshtë personalë të rumunëve, si shprehje e dëshirës së prindërve që famulli i tyre të jetë i bukur, i pashëm. Së këndejmi, ky emër ndeshet si në format e trashëguara nga latinishtja *Frumuşelul, Frumuşica*, *Frumu*, *Fruma* dhe shumë shpesh në trajta rumune të zgjeruara me prapashtesa të ndryshme në funksion mbiemrash dhe toponimesh me prejardhje antroponimike: *Muşat*, *Muşata*, *Muşiu*, *Muşu*, *Muşa*, ndërsa nëpër mikrotoonime si: *Muşata*, *Fundul Muşatei*, *Muşatul*, *Muşateasca Finteşti*, *Muşateşti*, *Muşteasca*, *Muşata Locului*, *Muşata muşatilor* etj. Këtyre shembujve po ua shtoj edhe *Petru Muşat* emri i një sundimtari në Moldavi, që dëshmohet në një kronikë moldaviane të viteve 1359-1399.[452] Në të gjithë emrat e mësipërm I. Iordan e gjen të përmbajtur antroponimin *Muşat*, pradaj i konsideron këta (emra) për kuptimisht të barasvlershëm me emrat e vendeve *Lunca Frumoasa*, *Frumuasele*, *Muntele Frumuasele*, *Frumosul*, *Dealul Frumos*, *Iezerul Frumos*, *Runcul Frumos*, *Tîrgul Frumos*, *Frumuşani*, *Frumuşei*, *Frumuşelele*, *Frumuşelele Popeşti*[453] etj. Jashtë hapësirës aktuale gjuhësore të rumanishtes, i prejardhjes rumune, përkatësisht aromune është edhe emri *Muşat* i një katundi afër vendbanimit Tetovena në Bullgari, prejardhjen aromune të të cilit, po nga antroponimi rumun *Muşat* "i bukur", G. Weigend[454] e përforcon edhe me rrethanën se jo larg nga ky vendbanim ndodhet edhe katundi me emrin *Hubavene*, që është kuptimisht i barasvlershëm me emrin rumun, sepse edhe oikonimi bullgar rrjedh nga mbiemri bullgar *hubav*, që po ashtu e ka kuptimin "i bukur".

Duket se deklarimi i dijetarit kroat P. Skok i cili në një recension të gjatë përkitazi me një punim të Th. Capidan-it e shprehte mendimin se patronimi *Muzhdeka* (SG: mund të shqiptohet edhe *Mushdeka*) i shqiptarëve na qenka një emër shqip i përbërë nga *müs* "mushkë" + *deka* "vdekje" dhe se e paska kuptimin "njeri që i mbyt mushkat",[455] është një zgjidhje etimologjike e papranueshme. Ky dijetar e kishte mirë që emrin Muzhdeka e shihte për një kompozitë si p.sh. emri Mirdita i krahinës së veriut të Shqipërisë, jo porse edhe vlerën kuptimore të emrit që ky e propozonte, sepse tek emri *Muzhdeka*, trajta e kryehershme e të cilit mund të ketë qenë **Mushdeka*, kemi të bëjmë me antroponimin *Mush* të dëshmuar në Veriun e Shqipërisë[456] dhe me një antropopnim të vjetër *Dek* të shqiptarëve, të dëshmuar si *Dekajush* - emri i një Shaljani, sipas gojëdhënës, të dëbuar nga fisi dhe i ruajtur deri në ditë tonat në funksion emri të vëllazërisë, përkatësisht si mbiemër në trajtat *Deka*, *Dega* të shqiptarëve. Dëshmi për qenien në përdorim të antroponimit *Mush* tek shqiptarët kemi tek mbiemri i sotëm *Mushkolaj* i shqiptarëve, i përbërë nga *Mush* dhe

[452] khs. khs. George Pascu, Die Anfänge der rumänischen Geschichtsschreibung, Süddeutsche Forschungen, III, 1938, f. 697.

[453] Toponimia romînească, Bucureşti, 1963, f. 521, 113, 350.

[454] Rumänen und Aromunen in Bulgarien. .., f. 44.

[455] Khs. punimin e tij Iz Rumunske Literature o Balkanskim Vlasima, në Glasnik Skopskog Naučnog Društva, Vëllimi II, Fashikulli 1-2, Shkup, 1927, f. 308.

[456] Khs. psh. tek Ndoc Papleka, Kulte, rite, magji në traditën orale, Tiranë, 1999.

Kolaj. Për emrin e dytë, (Dekaj) mendoj që ky vështirë se mund të jetë një trajtë e emrit *Benedikt* të kishës së Perëndimit, i cili (emër), me sa dimë deri sot, tek shqiptarët është refletuar si *Bdek* e si *Bekë* dhe po aq vështirë të mos largohet nga antroponimi *Degur* i vllehve, i dëshmuar në ambiente vllahe të Kosovës mesjetare. Dëshmi nga vetë regjioni i Gorës për qenien në përdorim dhe vazhdimin e emrit Mush gjejmë edhe tek mbiemri familjar i një vëllazërie shqiptare në trajtën *Mushku* në katundin Restelicë të Gorës.[457]

Mutaš

Ky emër familjar i vëllazërisë gorane të katundit Restelicë është i pandashëm etimologjikisht nga mbiemrat rumunë të sajuar me prapashtesën karakteristike romane ballkanike -ul (khs. emrin *Mutul* të dëshmuar në shek. 17)[458] me prapashtesë rumune *-escu* dhe me prapashtesën *-ovici* të rumanishtes me prejardhje sllave dhe me ndonjë prapashtesë tjetër si p.sh. *-aş; -cu e* ndonjë tjetër.[459] Duket që ky emër nuk mund të ndahet nga mbiemri rumun *mut* "si i pagojë; memec; i qetë" apo nga folja rumune *mutàre* "lëvizje, rivendosje". Po të jetë kështu, emri i vendit Mutivodë i krahinës së Gallapit nuk do të ketë gjë të përbashkët me ndonjë emërtim serb në kuptimin e etimologjisë popullare "ujë i turbullt", porse do të jetë edhe ky një emër vllah me kuptimin "ujë i qetë".

Mbiemrin *Mutovci* që është i po kësaj prejardhjeje e mban edhe një vëllazëri e katundit Jabllanicë të rrethinave të Prizrenit.[460][459]

*Paskinci/*Paskojevci*

Një emër vëllazërie i kësaj hapësire që i takon shtresës gjuhësore onomastike të latinitetit ballkanik është mbase edhe *Paskinci* - një vëllazëri e katundit Brod, më të madhit të krahinës së Gorës. Tri janë arsyet që e mbështesin prejardhjen latine-ballkanike të këtij emri: Në pikvështrimin gjuhësor ky emër rrjedh, sipas P. Skok, nga fjala me prejardhje arameje *pasha* në kuptimin e kryehershëm "ha, korr, bëj gati". Prej këndej këtë fjalë e paskan marrë latinët, përkatësisht romakët. Gustav Meyer, nga ana tjetër, kur po e gjurmonte prejardhjen e fjalës *pashkë* të shqipes, hetonte se në Ballkan kjo fjalë ka hyrë e kryqëzuar me fjalën e latinishtes klasike *pascua* "kullotë; ushqim". Në gjuhët romane popullore kjo fjalë u reflektua në trajtën *pascua*, ndërsa me të shtuar të prapashtesës *-alis* doli edhe mbiemri (tempus) *pasqualis* që shënon kohën e kremtes së pashkëve. Prej këndej rrjedh edhe antroponimi *Pasquale*,

[457] Khs. shënimin e këtij emri në artikullin e Bedri Halimit, Veprimet destruktive të misionarëve serbë në Gorë, në të përditshmen "Epoka e re", Prishtinë, 10.gusht, 2004, f. 9.

[458] I shënuar nga Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[459] Dicționar onomastic …, f.., 330.

[460] Këtë emër e ka shënuar në terren J. Osmani Vendbanimet e Kosovës 18, Prizreni, Prishtinë 2006, f. 132.

Pascal, ndër romanë dhe *Pashk* m. e *Pashke* f. ndër shqiptarë; ndër kroatë e serbë antroponimi *Paskal* del në trajtat *Pasko, Paskoje, Paske, Paska, Paskać, Paskalin, Paskaš, Paškal* etj., ndërsa tek bullgarët në trajtat *Pasko*, *Pato*, *Paco*, *Pačo*[461] Në dritën e mungesës tek varianti goran i emrit të vëllazërisë të kalimit *s* → *sh*, përkatësisht *sk* → *shk*, që është një veçori karakteristike e lëndës leksikore e onomastike të shqipes me prejardhje latine, del se tek trajta gorane duhet parë një trajtë të amulluar, të fosilizuar të një emri që nuk është zhvilluar sipas ligjeve fonetike të gjuhës shqipe. Kjo lë të kuptohet se si marrësit ashtu edhe vazhduesit e këtij emri nuk ishin në krye të herës folës të gjuhës shqipe.

Emri *Paskinci* i vëllazërisë gorane duhet parë së këndejmi për emër me prejardhje vllahe, i zgjeruar porse me prapashtesën sllave *-inci*. Le të përmendim këtu, jo vetëm sa për krahasim, se në regjionin përreth katundit të sotëm Kievë të komunës së Klinës është shënuar në krisobulën serbe për manastirin e Shën Stefanit, përkatësisht të Banjskës së Mitrovicës të viteve 1313-1318 edhe mikroregjioni *vlaška zemlja*[462] "vend, tokë, regjion i vllehve" dhe pikërisht këndej, në territorin e katundit Shtitaricë të Klinës është shënuar më 1327 dhe është ruajtur deri në ditë tonat edhe mikrotoponimi *Paskalica.*[463]

Prco /Përcanovci

Pa e pas propozuar zbërthimin etimologjik e kuptimor të emrit, Sadik Idrzi për emër vllah e mban edhe emrin *Prco* të një vëllazërie në katundin Krushevë të Gorës. Kujtoj se ka shumë mundësi që *Prco* të jetë trajtë e shkurtër e emrit Përcanovci, nga një *Parcanovci.

Me çështjen e prejardhjes së këtij emri është marrë dijetari maqedonas B. Koneski. Ky kujton se emri personal *Prčo* i maqedonasve qenka një nga antroponimet të sajuara nga emra shtazësh, në shërbim të mbrojtjes së bartësit të emrit.[464] Sado që ky studiues nuk e sqaron më hollësisht propozimin e tij, mua më duket se etimolgjia e propozuar nga ai nuk mund të arsyetohet pa u pas mbështetur tek vlera kuptimore, ‚që kundërmon; që i vie era" që e ka fjala *prč*. Si i këtillë, emri Përco, Përcan do të jetë më parë një atribut me karakter përçmues se sa një emër personal i mirëfilltë. Kjo sidomos nëse qëndron

[461] Khs. për këtë Prof. Dr. Gustav Weigand, Die bulgarischen Rufnamen, Ihre Herkunft, Kürzungen und Neubildungen, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache (Rumänisches Seminar), 15/1909, f. 110.

[462] Studiuesi serb A. Loma (sh. Toponimija Banjske hrisovulje, Beograd, 103, f. 45) e barazon këtë emër me atë Vlaški brod "Vau i vllehve" që paska qenë në kufi me katundin e sotëm Përçevë, përkatësisht në katundin e sotëm Klinavc në të cilin Gl. Elezovic paska pas shënuar mikrotoponimin Vlaški brod që sot po u quajka vetëm Brod. Ka porse mundësi që nën emrin "*vlaška zemlja*" mund të jenë përfshirë katundet e sotme Përçevë, *Llashkadrenoc* dhe *Lubizhdë* (i dëshmuar në burime serbe edhe si "*vlaška Ljubižda*") me qendër katundin e sotëm Kievë të komunës së Klinës.

[463] J. Šafarik, Pamatky. .., f. 96.

[464] Blaže Koneski, Makedonski Mesta i iminja, NIO„ ‚Studentski zbor", Skopje, 1991, f. 17.

mendimi i dijetarit kosovar I. Ajeti, se në gjuhë sllave të jugut kjo fjalë ka hyrë, nga shqipja.[465]

Punjevci

Në e parë, duket që ky emër nuk ka si të largohet nga antroponimi *Plnoš* dhe emri i vendit *Plnoševci* (sot Punashec/Ponashec i komunës së Gjakovës) i dëshmuar në vitin 1330. Nëse emri i kësaj vëllazërie dhe i katundit të Gjakovës mund të kenë dalë në këto trajta për shkak të alternimit të *b* në *p*, përkatësisht nga një trajtë e mundshme**Bunjevci* mbetet për t'u parë, sepse ka mundësi që ky emër të jetë i zbërthyeshëm me mbiemrin *рьln*, ‚i plotë, i trashë" të serbishtes. Nga ana tjetër, sidomos në dritën e së vërtetës së dëshmuar që pararendësit e popullatës së sotme të Gorës janë të ardhur nga hapësira gjuhësore e bullgarishtes/maqedonishtes, duket që ky emër mund të lidhet domosdo me emrin e ruajtur *Punini* e *Puninci* të një vëllazërie dhe lagjeje në regjionin e Godeč-it të Bullgarisë që, sipas B. Simeonov[466] po rrjedhkan "nga emri *Puna* i gjyshit", pararendësit të kësaj vëllazërie.

Pupe/ Pupevci *

Kur në një punim të tijin në të cilin i ndiqte gjurmët e trakishtes në Bullgari, dijetari i merituar Ivan Duridanov e interpretonte emrin *Pupe*(*n*)*sis* të një katundi në rrethina të Filipopolis-it (sot Pllovdiv) konsideronte se Pupe(n)sis qenka trajtë e latinizuar e një emri të kryehershëm *Pupa, -as ose **Pupai* të trakishtes. Midis mundësive të lejueshme përbrenda gjuhëve indoeuropiane, autori ynë e lejonte edhe lidhjen e këtij emri me fjalën shqipe *pupë*, kuptimi i së cilës qenka identik me bullg. *hълm*, ‚kreshtë; majë mali".

[465] Ky kujton se si emri i vendit *рьr'če brege*, i cili shënonte një vend në kufi të Bjeshkëve të Altinit, ashtu edhe emri *prьčevo* i katundit të sotëm Përçevë të komunës së Klinës, të dëshmuar në vitin 1330, janë me prejardhje shqipe. Ky kujton se fjala shqipe *përç,-i*, ‚përçor, ogiç", e cila, përkrah fjalës me shtrirje në gjithë hapësirën gjuhësore të shqipes *sqap,-i* / *sjap,-i*, paska depërtuar si albanizëm në serbishten në trajtën foljore *prčiti*, ‚futuere" (ndërzim, i dhive); po nga kjo rrënjë po rrjedhka, sipas I. Ajetit edhe varianti serb *prca'ti se, prcam se*, ‚ndërzehem, ethem, mbarsem". sh. I. Ajeti, Studije iz istorije albanskog jezika, Prishtinë, 1982, f. 114-115. Krejt ndryshe përkitazi me këtë fjalë mendonte Fr. Miklosich sh. Die slavischen Elemente im Albanischen, Wien, 1870, f. 31 i cili fjalën pertšák-u gjerm., ‚unverschnittener Bock, Widder" (edhe në kuptimin e gjerm. bespringe) të shqipes, që e kishte shënuar Hahn–i, e shihte me prejardhje nga sllav. *prč***:** *prčevina***,** ‚kundërmim i erës së dashit". Në Kosovë nuk dëgjohet sot fjala *përçor* (sikundër ndodh p.sh. në dialektin e jugut të Shqipërisë). Por është ruajtur folja "me përçitë" për ta shënuar ndërzimin, përkatësisht përçitjen e dhisë.

[466] Sh. Etimologičen rečnik na mestnite nazvanija ot Gorečko, Godišnik na Sofijskija Univerzitet, Faklultet po slavjanski filologii, Tom LX, 1966, f. 204.

* Trajta *Shisho* është shënuar nga S. Idrizi: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori …, ndërsa e dyta ishte shënuar nga M. Lutovac.

Dijetari rumun I. Moise,[466a] nga ana tjetër, njofton për një emër vendi *Pupeza* me prejardhje rumune në qarkun Madansko të Bullgarisë. Meqë nuk e ndjej veten profesionalisht kompetent të shfaq ndonjë mendim meritor përkitazi me korrektësinë e këtij zbërthimi, ia lejoj vetes vetëm të rekomandoj që në këtë mes të merret në konsideratë emri shqip *pupëz* i shpendit zool. Upupa epops, i cili nuk mund të ndahet, përbrenda shqipes, nga vlera kuptimore e xhufkës; ngriturinës që edhe ashtu propozohej nga I. Duridanov. Emri *Pupe Pupevci* i një familjeje në katundin Brod të Gorës nuk mund të merret për emër, shqip, por më shumë se gjithçka tjetër, si edhe një dëshmi më shumë e ardhacakshmërisë së goranëve nga zona gjuhësore e bullgarishtes.

Shisho-Shishovci[*] (shih edhe Shishtavec)

Me prejardhje bullgare, i sjell me vete nga pararendësit vlleh të goranëve të sotëm, është edhe emri *Shishovci* i vëllazërisë në katundin Brod të krahinës së Gorës. Ky emër vëllazërie është i së njëjtës prejardhje si edhe emri *Šišman* i mbretit të fundit të mesjetës bullgare. Ky emër ka hyrë edhe tek rumunët dhe atje ndeshet edhe në trajtat *Shish, Shishat, Shishoje, Shishman,* por edhe në ato *Şuşman, Şăşman, Şuşan, Şuşul* etj. Dëshmohet edhe për antroponim i vllehve mesjetarë në Serbi.[467] Duke e ditur rrezikun që mban në vete barazimi i përkatësisë gjuhësore të emrit me përkatësinë etnike të batrtësit, për bartësit e këtij emri mund të thuhet që emri i tyre i takon sferës gjuhësore bullgare. Si të këtillë, pararendësit e kësaj vëllazërie mund të shihen për vlleh të ardhur në krahinën e Gorës nga hapësira gjuhësore e bullgarishtes. Një mundësi potenciale e vendit origjinar të kësaj vëllazërie mund të jetë emri *Šiševo* i katundit të rrethinave të Shkupit i dëshmuar në vitet 1467-1468.[468] Rrethana që, në mbështetje të të dhënave të defterit, del katërçipërisht se banorët vendës të këtij katundi nuk kishin antroponime vllahe, tregon se shpërngulja e mundshme e pararendësve të vëllazërisë së sotme të Gorës do të ketë ndodhur shumë kohë përpara shekullit 15. Përkatësinë etnike vllahe të bartësve të antroponimit bullgar Šišman do ta tregonte tërthorazi edhe emri *Šišatovьci* i njërit nga katunet vllahe që i takonin manastirit të Banjskës më 1313-1318.[469] Ky katund përmendet, bashkë me *katunь blьgarьskьi* "katuni i bullgarëve", emrin mesjetar të të cilit e kanë ruajtur vetëm shqiptarët si *Bugariq,* por jo edhe serbët, të cilët këtë toponim e kanë ripagëzuar me emrin *Srbobran*. Ndoshta ka arsye të supozohet se ky katund ndodhej jo larg nga katundi i sotëm Bugariq i Mitrovicës. Në këtë burim përmendet edhe banori *šiš'ka* i katunit *Ursulovci* të

[466a] Khs. I. Moise, Neskolьko bolgarskih toponimičeskih nazvanii rumьnskogo proishoždenija, Actes du XI congres international des sciences onomastique, 2, Sofia, 1975.

* Trajta *Shisho* është shënuar nga S. Idrizi: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori …, ndërsa e dyta ishte shënuar nga M. Lutovac.

[467] Khs. N. A. Constantinescu, Dictionar onomastic romîn, Bucureşti, 1963, f. 282 – 283.

[468] Khs. Turski dokumenti na istorijata na makedonskiot narod. .., f. 451.

[469] Sh. Svetostefanska hrisovulja, f. 7: "a se vlasi. .. katunь šišatov'sьь."

vllehve,[470] i cili ndodhet në rrethina të Sjenicës së krahinës së Sanxhakut. Ndër banorë të katundeve blegtorale të feudit të Deçanit dëshmohen më 1330 edhe banorët *Shishoje* i Gramaçelit dhe *Shishman* i katundit Luboliq.[471] Sot ka në rrethina të Deçanit një vendbanim i quajtur *Shishmani i Bok's*. Në regjistimin osman të vitit 1455 për në katundin e quajtur Bijočinci, ndoshta katundi i sotëm Beçiq në lindje të Klinës është evidentuar kryefamiljari *Shishoje*, i bir i Vladislav-it.[472]

Përkundër prejardhjes vllahe të emrit, karakterin bullgar të këtij emërtimi e tregon prapashtesa bullgare *-ec*, e cila ndeshet edhe në disa emra vendbanimesh në rrethina të Prizrenit, si edhe në variantin shqip *Rahovec*, jo porse edhe në atë serb *Orahovac*, të emrit të qytezës. Fundja, prejardhjen e ardhësve vlleh të bullgarizuar në Rahovecin e sotëm e tregojnë jo vetëm disa veçori bullgare të së folmes së Rahovecit, porse edhe mikrotoponimet jo të pakta vllahe të rrethinës së kësaj qyteze (khs. p.sh. mikrotoponimin *Carina* nga rum. *ţărină* "arë, ugar, 2. tokë e katundit"; *Maqina* "vend ku bluhet; ku ka një mulli") e ndonjë tjetër.

Për element vllah në hapësirën e banuar nga goranë të rrethinave të Kukësit, Dokle e sheh edhe emrin Shishtavec/Shishtovec të katundit, duke e paravenduar një trajtë të kryehershme *Shishtofc.

Shundo/Shundinci

Me prejardhje vllahe qenka, sipas N. Dokle, edhe emri i vëllazërisë *Shundinci* të katundit Borje. Autori ynë e mbështet këtë konstatim të tijin tek rrethana që ndër vlleh të Korçës e të Gjirokastrës mbiemri "Shunda" mbahet për emër tipik i vllehve.[473]

Tutar/Tutorci

I përkatësisë vllahe do të jetë edhe emri familjar *Tutar*[474] që në funksion si emër vëllazërie përdoret në trajtat *Tutorci*/*Tutarci*[475] i një vëllazërie të katundit Vranisht të Gorës. Si i këtillë, ky mbiemër do të ishte i pandshëm nga emrat familjarë të dëshmuar në Rumani e në Moldavi nën trajtat *Tutana, Tutela, Tutila, Tutaleşti* etj., prejardhja e të cilëve nxirret nga rus. *tut*, ‚memec" dhe shihen pra për emra sllavë të rumunëve.[476]

Mirëpo duke u mbështetur tek dëshmia në vitin 1348 e emrit *Tudorč dol* (khs. referencën 35) që do të ketë qenë në territorin e vetë katundit Vranisht apo kullotë e ndonjë vëllazërie të këtij katundi, ka arsye të paravendohet mundësia

[470] Sh. Svetostefanska hrisovulja, f. 8.
[471] Dečanske Hhrisovulje...,. f. 9.
[472] Khs. Oblast Brankovića. .., f. 99.
[473] Khs. Gora dhe Opoja. .., f. 57.
[474] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak, Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.
[475] J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, f. 142 e ka shënuar si *Tutarci*.
[476] Khs. A. Constantinescu, Dictionar onomastic romînesc,. .., f. 394.

që tek emri *Tutorci* i sotëm kemi të bëjmë me kalimin e trajtës karakteristike vllahe, rumune *Tudor* në *Tutor* të antroponimit të gjithkrishter me prejardhje greke *Theodoros,*[477] si zhvillim lokal i këtij procesi. Për prejardhjen e vetë antroponimi *Tutor*, nëse ky nuk është variant i *Tudor* (nga *Theodoros*), do të duhej të merrej parasysh prejardhja e mundshme trakase e tij. Në këtë rast, ky emër do të mund të afrohej me emrat e dëshmuar Tutius, Τουτενες m. Τουτα f. me variantet Τιουτα, Τιοτη të trakasve dhe me emrat ilirë *Tutia* m.,Τευτα f. dhe me emrin *Tuta* të shqiptarëve.[477a]

Ugleš

Ndër emërtime me interes të shtresës së latinitetit ballkanik është edhe emri *Ugleševčka* i një lagjeje, përkatësisht vëllazërie të kaundit Krushevë të regjionit të Gorës. Emri i kësaj lagjeje e ka për rrënjë antroponimin *Ug* të zgjeruar me prapashtesën *-lesh*. I formuar për të shërbyer në funksion të emrit të vëllazërisë, ky emër u zgjerua nga popullata sllavishtfolëse edhe me prapashtesat gjegjëse sllave. Antrponimi *Ug* përmbahet edhe tek emri *Ugovići* i heronjve të epikës serbe të lidhur me Betejën e Kosovës. Ky variant dëshmohet në një version raguzas që mbahet për i shekullit XVII të këngës për Betejën e Kosovës.[478]

Po u mor për mbështetje kjo dëshmi raguzase, që rrjedh nga koha kur kjo këngë ende nuk ishte bërë instrument politik për luftën çlirimtare të serbëve, të kombinuar me mëtimet për përtëritjen e perandorisë serbe jetëshkurtër të car Stefan Dushan-it, do të rezultonte se këtij emri iu ndajmbath më vonë emri *jug* "ana jugore e horizontit", tingulli *g* i së cilës ra për shkak se e kishte emri bazë, të cilit iu parashtua kjo fjalë.

Në të mirë të prejardhjes vllahe apo edhe shqipe[479] të këtij emri flet në rend të parë rrethana që ky emër ndeshet më shpesh në hapësira për të cilat dihet se banoheshin më dendur edhe nga popullata vllahe, siç janë rrethinat e Kërçovës e të Tetovës në Maqedoni dhe të Novobërdës në Kosovë. Në viset e banuara me shqiptarë në Maqedoni gjenden mjaft dëshmi të qenies në përdorim të emrit personal Ug. Nga ajo shumësi dëshmishë, këtu më poshtë po i sjellim vetëm disa: Petko, i bir i *Ugiq*-it dhe Millosh-i, i bir i *Ugiq*-it, tjetër (banorë të katundit Blizansko - Poreče - Kërçovë,); *Uglesha*, i bir i Radihna-s (Palçishtë - Tetovë); *Uglesha,* i bir i Bogdan-it (Odri, Tetovë); Uglesh-i, i bir i Gollubçiq-it (Kaçanik) Dimitri, i bir i *Ugiq*-it (Kërvenik - Kaçanik); Radovan-i, i bir i *Uglesh*-it (Pustenik - Kaçanik); Miladin-i, i bir i *Ugiq*-it (Carevc - Kaçanik,); *Uglesha*, i

[477] Khs. te Rosetti, Istoria. .., f. 430 "capră de muls etc".

[477a] Për shtrirjen e këtij emri tek bullgarët e kroatët dhe prejardhjen e tij khs. I, Duridanov, Der thrakische Einfluß auf die biulgarische Anthroponymie …, f. 81.

[478] Khs. V. Jagić, rec. për punimin e Dr. T. Maretić, Kosovski junaci i događaji u narodnoj epici, RAD JAZU, 97, 1889, f. 97.

[479] Ka, sidomos orietalistë shqiptarë, që mendojnë se ky do të jetë emër dypjesësh, i bashkëshkrirë nga *Ukë* dhe *Lesh(a).*

bir i Nenad-it; Gjuro, i bir i *Uglesh*-it (Semenište- Shkup).[480] etj. Më shpesh se në hapësirën nën zotërimin e Brankoviqëve vazalë (1455) dhe në atë të Maqedonisë (1467-1468) ky antroponim del në sanxhakun e Shkodrës (1485), përkatësisht në veriun e Shqiprisë së sotme, në Mal të Zi dhe në Rrafshin e Dukagjinit. Në këto hapësira ky antroponim roman dëshmohet shumë shpesh në vendbanime banorët e të cilëve mbanin kryesisht antroponime shqipe e vllahe, përkatësisht romane dhe krejt rrallë në ndonjë ambient në të cilin banorët mbanin antroponime kryesisht sllave. Ky antroponim del në këtë hapësirë në trajtat *Uglesh* e *Ugjlesh*.[481]

Sa për trajtën *Jugović* duhet vërejtur që edhe kjo është e lidhur me aktivitetet e vëllazërisë së Hrebeljanović-ëve vlleh, nga të cilët kishte dalë edhe dera sunduese e knezit Lazar dhe e pasardhësve të saj.

Pas gjithë shembujve e sqarimeve të sjella më sipër, më duket e vështirë për të qenë i besueshëm sqarimi i B. Koneski-t[482] sipas të cilit emri në trajtën *Ugleša* na qenka emër i vjetër sllav në trajtën serbe të tij, sepse vetë rrënja emërore *Ug-* (khs. psh *Ugolini* tek italianët) është emër latin-roman. Nën ndikimin e etimologjisë popullore serbe, ky emër u tjetërsua në *Jugovići*.

Zizinci

Emri i kësaj vëllazërie gorane duket të jetë në mos i pandashëm për nga prejardhja nga mikrotoponimi *Ziza* i katundit shqiptar Buçje të Opojës, ndërsa në vija më të largëta as nga emrat familjarë që tek rumunët dëshmohen në trajtat *Ziza*, *Zizi*, *Zizoae*, *Zizica*, për të cilët N. A. Constantinescu[483] nuk jep ndonjë sqarim as për prejardhjen e as për kuptimin e këtij emri. Në dritën e dëshmimit të antroponimit *Zize* (?) të një banori të katundit *Sveta Petka*, (*Shna Prenja) që për në rrethina të Shkupit dëshmohej në vitet 1467-1468,[484] ka arsye të besohet

[480] Khs. Turski dokumenti …, f. 238, 318, 383, 503, 457, 459, 506, 521.

[481] Khs. Uglesha Todor-i banor i katundit Mushani të rrethinave të Shkodrës. Banorët e këtij katundi me gjithsej 5 shtëpi kishin të gjithë antroponime shqipe; Uglesh-a, i bir i Dançul-it në katundin Tuzina të nahijes së Bihorit; vojnuk Uglesha, i bir i Pekul-it (Pkul-it) në Budimlje; Nikolla, i biri i Uglesh-a Zeqanin-it, banor i mahallës së Radiçit të qytetit të Pejës; Bogoi, i bir i Ugleshës, banor i katundit Maçta, sot Mashte i Budimljes; Uglesha, i vëlla i Dejan-it, të birit të Hralës në katundin Gorni Zagrad të Budimljes; Melash-i, i bir i Ugjlesh-ës, banor i katundit Lomenica të Budimljes; Uglesha, i bir i Bërçin-it në nahijen e Komaranit (Mal i Zi); Ugjlesha, i bir i Stepës dhe Ugjlesha, i vëlla i Dimitrash-it në katundin Ribar të Plavës; Uglesha, i bir i Gjorgj-it në katundin Çaçuni të Plavës; Uglesha Vukosaliq-i dhe UgjleshaVukoslav-i, në katundin Radona të nahijes së Kuçëve; Uglesha, i bir i Priboi-t në katundin Otomaniça, që varej nga Uglesha, i bir i Bogosal-it, banor i katundit të sotëm Grabanicë të Klinës dhe Nikolla Ugjlesha, banor i katundit Velika të Gusisë te S. Pulaha, Defteri..., f. 368, 410, 412, 52, 80, 86, 90, 96, 97, 118, 121, 122, 161, 248, 107...

[482] Khs. Makedonski mesta i imenja,. .. f. 59.

[483] Khs. Dicționar. .., f. f. 414.

[484] Khs. Turski dokumenti za itorijata na makedonskiot narod. .., f. 440.

që edhe ky emër do të jetë rezultat i sjelljes me vete nga vlleh të bullgarizuar të emrit të vendbanimit të kryehershëm, në hapësirën e ngulitjes së re të tyre. Fundja, këtë paravendim do ta përforconte edhe dëshmimi në vitet 1313-1318 i mikrotoponimit *Zizine gomille* "tumbat e Zizit" në rrethina të katundit shqiptar Dinosh të Malit të Zi. Në dritën e sqarimeve të mësipërme, ka arsye të besohet që edhe emri *Zinova* (khs. më poshtë) i vendbanimit, të mbajtur nga tradita e të përqafuar edhe nga "studiues" s'do të jetë tjetër përpos një emër vendbanimi i sjellur nga vlleh të ardhur të bullgarizuar të cilin (emër) mund ta kishin pasur edhe në atdheun e tyre të kryehershëm.

8.1.8. Gjurmë leksikore vllahe në të folmen e Gorës

Përveç në emra vendesh e të vëllazërive të shkokluara në këtë trajtesë, relikte vllahe ka edhe si në të folmen e banorëve sllavishtfolës të krahinës së Gorës ashtu edhe në atë të shqipfolësve të krahinës së Opojës.

Fondit leksikor vllah (aromun) në të folmen e goranëve të rrethinave të Kukësit po i takuakan, sipas Sadik Idrizit,[485] fjalët *bate* "baba,-i"; *dada*, "nëna; motra e madhe"; *dropul* "i pëgërë, i papastër; që s'e mban veten"; *hërkul*, "pështymore"; *junec* "bagëti e njomë"; *kërluk* "shkop i bariut; kërrutë; kërrabë"; *manxha* "hae, ushqim",[*] *mendilj*, "lloj faculete", *mërsul* "qyrra"; *porta* "portë, derë";[486] *qaja* "pronar grixhe të madhe delesh; kryebariu"; *pallavra*, "dokrra; zhurmë"; *qula* "lloj kësule"; *skut* "prehër";[**] *tarxhuk* "tarçuk, lloj strajce bariu nga lëkura e deles ose e dhisë" dhe *urda* "lloj djathi i butë".

Më poshtë, kryesisht në mbështetje të rezultateve të tjerëve në fushën e romanistikës, do t'i shfaq mendimet e mia përiktazi me prejardhjen e këtyre fjalëve, të radhitura sipas rendit alfabetik të shqipes:

Dada

Mendimi i këtyre studiesve sipas të cilëve fjala *dada* qenka, si në shqipen ashtu edhe në folmen e Gorës, me prejardhje vllahe duket paksa i ngutshëm dhe i paargumentuar sa duhet

Dijetari bullgar I. Duridanov vërente që kjo fjalë përmbahet tek mbiemri *Dado, Dadov* të bullgarëve; në emrin *Dadeşti* të një vendi në Rumani; në top. *Dadince* dhe në mbiemrin *Dadić* në Serbi. Ky vërente në këtë mes se emrat e

[485] Khs. Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k –.

* Në literaturë e kam ndeshur me kuptimin "dhi që milet".

[486] Për të cilën nuk ka arsye (mbështetje) as historike e as sociale të paravendohet se këtë fjalë do ta kenë sjellur me vete blegtorët vlleh të ardhur në hapësirat dardane e ilire jo më heret se në shek. X Kjo aq më parë që, si pasojë e ndikimit të latinishtes ballkanike, në shqipen mund të ketë hyrë që para instalimit të vllehve në pjesën perëndimore të Ballkanit.

** Në literaturë e kam ndeshur me kuptimin "mburojë"; 2. fig. marrje nën sjetull; përkrahje"

përveçëm të këtij formanti përbfrenda familjes së gjuhëve sllave ndeshen vetëm në bullgarishten e në serbishten.

Në të gjithë emrat e përveçëm të formantit *Dada, Dado,* Duridanov e gjente fjalën *dada* që në shqipen e ka kuptimin "motra e madhe" ashtu si edhe në rum. dadă "titull për motrën e madhe", ndërsa në serb. dialektore si *dáda* me kuptimin "nënë". Për sa i bie vetë prejardhjes së këtyre emrave, dijetari ynë i shihte këta të jenë me prejardhje nga antroponimia e trakasve tek të cilët janë dëshmuar antroponimet mashk. *Dada, Δαδας, Dades* dhe *Dada Δαδα* si emra femërorë.[487]

Ka edhe një mendim, sipas të cilit kjo fjalë qenka jo vetëm në shqipen, porse edhe në gjuhë të tjera të Ballkanit, (khs. p.sh. edhe serb. e kroat. *dadilja*) një formim onomatopeik i fëmijëve apo një huazim nga turqishtja.[488]

Dropul

Mua më duket që pikënisje e sqarimit etimologjik të kësaj fjale nuk mund të ndahet nga emri Dropull i krahinëzës në jug të Shqipërisë. Dijetari i merituar shqiptar i gjuhësisë E. Çabej[489] sqaronte, përkitazi me emrin e kësaj krahine, se "Sikundër dihet, Drini ushqehet nga dy degë lumore. Drini i Zi e Drini i Bardhë. *Drin* shfaqet edhe në jug, tek emri i lumit të Gjirokastrës, në trajtën shkollore greke Drinos, po në thelb *Drin*, sikundër ruhet edhe në emrin e krahinës *Dropull* të përshkuar prej këtij lumi me burim prej një **Drinopull, *Drnopull, *Drropull,* gr. *Δρινόπολις*". Nëse kjo fjalë, e konsideruar për vllahe, e së folmes së goranëve mund të jetë bartje e emrit *Dropull* të regjionit si vend i prejardhjes së ndonjë vëllazërie ardhëse vllahe të padëshmuar me këtë emër, mbetet çështje që duhet të shihet. E vetmja mundësi që do të shkonte në të mirë të lidhjes së kësaj fjale me emrin Dropull të krahinës më mbetet ajo e ngjyrimit, më vonë, përbuzës për atë bashkësi të ardhur, të padëshmuar, në regjionin e Gorës.

Hërkul

Përkitazi me fjalën *hërkul* paravendoj që këtu kemi të bëjmë me zgjerim kuptimi të variantit bullgar *húrka*, që në këtë gjuhë del edhe në trajtat *vúrka* e *úrka* të latinizmës *furca* e cila është e përhapur në të trija gjuhët e mirëfillta ballkanike dhe që në shqipen e në rumanishten e ka ruajtur kuptimin e mirëfilltë: shq. *furkë*, "tfurk; furkë"; në të gjitha dialektet e rumanishtes del si *furcă* "furkë, tfurk" dhe në greq. e mesme e të re φο□ρκα "trekëmbësh; vendi ku i gjykuari do të ekzekutohet me varje" φουρκίζω "var, vjerr".[490] Në bullgarishten, sipas B.

[487] Khs.Ivan Duridanov, Der thrakische Einfluss auf die bulgarische Anthroponymie,, Balkansko Ezikoznanie/Linguistique Balkanque II, Sofia, 1960, f. 72-73.

[488] Më gjerësisht për këtë fjalë sh. tek Dr. St. Romansky: Lehnwörter latenischen Ursprungas im Bugarischen, f. 107 dhe tek K. Jireček, Romani. .., f. 42, 61.

[489] Sh. Studime etimologjike në fushë të shqipes, III, Tiranë, 1987, f. 319.

[490] Khs. E. Çabej, f. Studime etimologjike në fushë të shqipes IV, DH-J, Tiranë, 1996, f. 226; khs. edhe Ivan Popovic, Vlacho-Serbica, Der rumänische Spracheinfluß auf das Serboikroatische und dessen Geographie, Südost-Forschungen XXI, 1962, f. 371.

Simeonov[490a] kjo fjalë ndeshet në trajtën *hurka*. Një çështje që për mua mbetet e hapur është nëse këtu do të duhej të inkuadrohej edhe emri *hërkë,-a* "një lloj gunje", fjalë që përdoret në të folmen e rrethinave të Junikut, Deçanit e të Gjakovës. Kujtoj se në këtë mes duhet të sqarohen arsyet përse kjo fjalë në të folmen e goranëve e paska kuptimin "pështymore".

Junec

Sa i përket fjalës *junec* më duket se këtu ka vend të paravendohet që kemi të bëjmë me një element leksikor vllah të lashtë. Këtë do ta tregonte mbase edhe rrethana që pikërisht në një zonë blegtorale si krahina e Hotit - sot në Mal të Zi - midis kryeparëve *capitaneus montane Ottorum* përmendet në vitin 1348 edhe një *Junch Hoth iam dominus in partibus Albanie*.[491] Antroponimi *Jun* është ruajtur deri në ditët tona kryesisht në Shqipëri të Veriut, në qytetin e Ulqinit e në rrethinë të tij dhe në regjionet e Hotit, Grudës, Krajës e të Triepshit në Mal të Zi. Ky emër përmbahet pas gjithë gjasësh në emrin aktual *Junkaj*/*Junçaj* të vëllazërisë shqiptare në krahinëzat e Hotit e të Triepshit në Mal të Zi, emri i së cilës lidhet me ndonjë nga pararendës të atij *Junch Hoth*-it të dëshmuar më 1348 dhe në emrin e grave *June* (në Ulqin).

Lashtësinë e pasjes në përdorim të antroponimit *Jun* nga shqiptarët do ta dëshmojë mbase një dokument i carit serb Dushan në të cilin del i shënuar emri i vendit, përkatësisht i shkëmbit *junovь Kamenь* "Guri, shkëmbi i Jun-it", vendi i saktë i të cilit nuk mund të përcaktohet në bazë të dokumentit ku përmendet. Nga dokumenti mësohet se ky vend shenjonte, bashkë me vendin *Gjegjevь Kamenь*, "Guri i Gjegjit", njërën ndër mexhët e katundit Ulitišta[492] (në Mal të Zi). Antroponimi *Jun* në trajtën e tij të sllavizuar me prapashtesën *-ota*, dëshmohet edhe për emër i një banori të katundit Strellc të Deçanit më 1330.[493]

[490a] Khs. Latinskite imena v blgarskija ezik, B lgarski ezik, VII, 1957, f. 56.

[491] Sipas M. Šufflay, Srbi i Arbanasi. .., f. 61;.khs. edhe Skadarski zemljišnik od godine 1416, Priobćio u sjednici fiologičko-historičkoga razreda jugoslavenske akademije znanosti i umjetnosti dne 10. studenoga 1881, Pravi član Sime Ljubić, në STARINE, JAZU, Knj. XIV, Zagreb 1882, f. 61.

[492] Sh. St. Stojanović, Stari srpski hrisovulji, akti, biografije. .., f. 27:, ‚Priloži kraljevьstvo mi [...] (i selo Ulitišta [...] A sije (megje selu) [...], na Gjegjevь Kamenь, preko strane niže gradišta na [...] junov Kamenь..."

[493] Khs. **"**beroje a sinь mu dobrěi i milet'ko. dobrovoi prědojevikь a děd mu junota" Dečanske hrisovulje..., f. 74. Për si emër i shqiptarëve, antroponimi *Jun* është dëshmuar në shek. XV (në vitin 1485): khs. Kosan Marshen Junak-u (= Qws"n M"ršyn Ywn"q), Duka Junak (= Dqh Ywn"q), Pepa Junak (= Pph Ywn"q) në katundin Marshejn (= M"rš"yn), Junak-u, i bir i Junak-ut (= Yw"nq wld Ywn"q) në katundin Gruda (= rwdh) në krahinën Pantalesh (= P"nthlš) në Shqipëri e në Mal të Zi (sh. S. Pulaha, Defteri. .., f. 396, 369). Se ky antroponim do të ketë qenë në përdorim edhe tek shqiptarët e Kosovës duket se na e dëshmon mikrotoponimi *Ara Junit* në katundin Kaçanuell të krahinës së Shalës (Mitrovicë). Përveç kësaj, unë mendoj se edhe emri i tipit antroponimik-patronimimik *Junakovьcь* i një vendbanimi që në vitin 1356 (khs. St. Stojanović, Stari

Antroponimi *Jun* është edhe sot në përdorim nga shqiptarët po në ato vise në të cilat në shek. 14 dëshmohet në burimet shkrimore të kishës serbe. Vlera kuptimore e këtij emri do të jetë: "i ri; i njomë; i sapolindur" Tek rumunët[494] ky antroponim ndeshet në trajtat *Junc*, *Junca*, *Juncă*, *Junincă* dhe në funksion mbiemrash në trajtat *Juna*, *Junele*, *Juneşti* etj.

Kërluk; kërlik

Për fjalën *k(ë)rluk*, e përmbajtur edhe në mikrotoponimin *Brija e Kërlikut*, në katundin Zgatar të Opojës, duhet sqaruar që, në mos qoftë huazim i drejtpërdrejtë i shqiptarëve nga fqinjët e tyre vlleh, atëherë ka arsye të besohet që pikërisht me ndërmjetësimin e vllehve goranë bullgarishtfolës në të folme lokale të Opojës dhe në të folme të Veriut të Shqipërisë do të ketë hyrë fjala *kërlik*/*kërlig* që shenjon shkopin në formë kërrabe që i shërben bariut për ta zënë delen që do ta mjel në shtrungë. Kjo fjalë do të rrjedh nga apelativi rumun *cîrlig*, *cîrligat* "kërrabë, çengel, grep", khs. edhe mbiemrin *cîrligat* "i shtrembër; i lakuar" Fjala rumune *cîrlig*, ka hyrë, sipas Th. Capidan-it në dialektin toskë të shqipes si *kërrigë* e *kërljuk* në kuptimet "gjilpërë për qëndisje; shkop bariu; grep; kërrabë". Fjalët me këto nocione paskan hyrë në të folmen shqipe të jugut të Shqipërisë përmes vllehve Frăşerot, përkatësisht Frashëriotëve aromunë. Th. Capidan e shton në këtë mes edhe një mendim tjetër që trajta *kërljuk* e Jugut shqiptar qenka në të vërtetë një bullgarizëm i shqipes.[495] Ky apelativ i rumanishtes paska depërtuar, sipas A. Rosetti-t[496] në polonishten si *garlyga*, ndërsa sipas B. Nastev,[497] me ndërmjetësimin e arumunëve edhe në maqedonishten si *karluk, krlik* dhe në bullgarishten si *kърlik*. Sipas S. Armaş kjo fjalë ka hyjë edhe në Ukrainë. si *kyrlyk*, *kyrlyka*, *gyrlyga* dhe në rusishten si *gerluga*[498] dhe e ka gjithandej kuptimin e *kërrutës së bariut*. I mendimit të përkundërt është dijetari bullgar D. Scheludko[499] i cili, fjalët bullgare *kърlig* (khs.

srpski hrisovulji, akti, biografije f. 31:, „. .. upravъ na Junakovьcь„. ..„)" dëshmohet për jo larg nga katundi i sotëm Obrijë i Skënderajt rrjedh po ashtu nga antroponimi *Jun* (i zgjeruar me prapashtesat *-ak* e *-ovc*). Në vija më të largëta, këtu bie për nga prejardhja edhe emri *Zhunët* i një vëllazërie në katundin Biçevc të Kaçanikut. Ruajtja e gjurmëve të këtij antroponimi pikërisht nëpër zona të Kosovës për të cilat gjatë mesjetës së vonë dëshmohen katune vllehsh, do të jetë argumenti më i mirë që do të fliste në të mirë të prejardhjes vllahe si të adjektivit *jun* "i ri; rinak" ashtu edhe të emrave të dalë nga ky mbiemër.

[494] Sipas N. A. Constantinescu. Dicţionar onomastic. .., f. 306.

[495] Sh. Raporturile albano-române, Dacoromania 2, 1924, f. 497; Elemente româneşti in limba albanese, Dacoromania VIII, 1922, f. 151-152.

[496] Istoria limbii române. .., f. 81.

[497] Khs. Sur les éléments aromains en macedonien, Associatiton internationale d' études de sud-est européenne, VI, Linguiistiques, Sofia 1968…, f. 736.

[498] Khs. L'influence roumaine sur le lexique des langues slaves, Romanoslavica 16 (1968), f. 81.

[499] Khs. Lateinische und rumänische Elemente im Bulgarischen, Balkan-Archiv III, Leipzig 1927, f. 279-280.

edhe trajtat *karljuga*, *karlik* "shkop bariu i krryluar"; *kъrlici* "ashkël"; ukr. *karkljuka*, "degë e shtrembër, kërrabë") i konsideron për me prejardhje nga bullgarishtja.

Mandža "dhi që milet"

Nuk më ka rënë të mësoj që kjo fjalë të ndeshet në këtë trajtë apo si derivat nga kjo edhe në shqipen. Dijetari i merituar rumun A. Rosetti[500] shënon porse që fjala rumune *mandzára capră de muls etc*. "dhi që milet" ka hyrë në bullgarishten, jo porse edhe në shqipen. Por ka një mendim i përqafuar nga më shumë se një studiues që i kësaj prejardhjeje do të jetë edhe emri *Mandak*/*Mandakovci* i një vëllazërie të Gorës.[501] Duke e paravenduar mundësinë e palatalizimit, përkatësisht të kalimit të *g* në *gj*/*xh*, këtu do të mund të inkuadrohej edhe emri Mango/*Mangovci* i vëllazërisë në katundin Brod të Gorës e pra edhe emri *Mangalaqët* i vëllazërisë shiptare të katundit Zaplugjë të Opojës.

Pallavra

Sikundër dihet nga historia e gjuhës shqipe, kjo është njëra ndër krejt pak fjalët që në shqipen, përmes katalanëve të Spanjës, kanë hyrë në gjuhën shqipe. Së këndejmi kujtoj që kjo fjalë më parë mund të mbahet si një huazim "goran" nga shqipja sesa për fjalë të ruajtur tek goranët si pjesë e korpusit leksikor vllah të kësaj të folmeje.

Porta

Fjala *porta* e të folmes së goranëve mund të jetë sjellë me vete si huazim (*pórta*) i bullgarishtes nga greq. e mesme dhe ajo e reja πόρτα, sado që në të gjitha dialektet e rumanishtes, në shqipen dhe në bizantinishten kjo fjalë ka hyrë nga lat. *porta*. "portë".[502]

Qaja

Në Kosovë kjo fjalë dëgjohet si *qehaja* dhe shenjon mbase poseduesin e tufave të bagëtisë, rëndom të deleve. Kjo fjalë qenka porse me prejardhje persiane dhe e paska, sipas A. Škaljić,[503] kuptimin "ndihmës, përfaqësues i vezirit, i pashait, i defterdarit apo i ndonjë latifundisti në Perandorinë Osmane-turke." Nëse ky shpjegim është i drejtë, atëherë nuk mund të gjenden arsye që kjo fjalë të shihet si e prejardhjes vllahe.

---

[500] Istoria limbii romane, Bucureşti, 1968, f. 430.

[501] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[502] Khs. për këtë Dr. St. Romansky: Lehnwörter latenischen Ursprungas im Bugarischen, Revue des études slaves, Tome quatorzième, Paris, 1934, f. f. 126.

[503] Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku …, f. 186.

Skut

Edhe propozimi i dijetarëve të pakompetenca në fushën e romanistikës e të albanologjisë për prejardhjen vllahe të fjalës *skut* është mbase i gabueshëm. Pështjellim në këtë mes sjell rrethana që asnjëri nga propozuesit nuk e jep vlerën kuptimore të fjalës që ata e mbajnë për me prejardhje vllahe sepse, së pakut në shqipen ka më shumë se një fjalë *skut-* e cila në këtë gjuhë ka kuptime nga më të ndryshmet: në trajtën *skutë* kjo fjalë e ka kuptimin 1. "kënd, qoshe, buxhak, vrimë për t'u mëshehur" 2. "përparje", ndërsa trajta *skutinë* "ndriza, shpërgâj" nuk është as vllahe e as shqipe, porse rrjedh nga greq. e re σκουτί "habit, fr. vêtement".[504]

Urda

Nuk ka dyshim që pjesa më e madhe e këtyre fjalëve i takon sferës së blegtorisë, pikërisht asaj sfere të jetesës në të cilën shprehet më së miri bashkëjetesa e gjatë e shqiptarëve me vllehtë e pra edhe raportet dhënës - marrës dhe anasjelltas midis këtyre dy etnive. Ka së këndejmi, midis këtyre fjalëve, siç është p.sh. rasti i fjalës *urda* të vllahishtes, përkatësisht të rumanishtes, të cilat mbahen për huazime të vjetra të rumanishtes nga shqipja ose për element nga fondi leksikor i substratit të përbashkët ballkanik të këtyre dy gjuhëve e popujve. Kështu, kur po fliste për shtrirjen e leksikut shqip në Hercegovinë, V. Ćorović vërente se midis shumë fjalëve shqipe në Hercegovinë ndeshet edhe fjala *úrda* e ndoshta edhe *šulina* dhe pas gjithë gjasash edhe shprehja *bačije* e *bačevanje*.[505] Në kapitullin për unionin linguistik ballkanik të historisë monumenale të gjuhës rumune Al. Rosetti[506] na mëson se këtu kemi të bëjmë me fjalën që në arumanishten del si *urdă* e *urdă*, në meglenorum. si *urdă* dhe e ka kuptimin fr. "fromage blanc tiré d'un petit lait qui est resté après la fabrikation du fromage à la pie" "djathë i bardhë i nxjerrë nga pak qumësht që në tpî ka mbetur pas fabrikimit të djathit". Në shqipen kjo fjalë dëshmohet si *urdha* "lloj djathi" dhe lidhet me të shqipes *udhos* "djathë". Fjalën *urdă* e *urdă* dijetarë rumunë e shohin për huazim të ri aromun nga shqipja. Nëse është kështu, atëherë do të mund të paravendohej që kjo fjalë e shqipes u përhap tek serbët, bullgarët e tek maqedonasit me ndërmjetësimin e vllehve. Në të tria këto gjuhë një lloj djathi quhet "vlaška urda". Mbase pikërisht për këtë djathë të prodhuar nga vllehtë që në shek. 12 ishte fort i kërkuar në Konstantinopojë (ashtu si edhe qëndisjet e grave vllahe), shkruante edhe poeti, gramatikani dhe oratori bizantin Theodoros Prodromos që jetoi në shek. XII, përkatësisht midis viteve 1100 e 1158.[507]

[504] Khs. E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, VII, Tiranë, 2006, f. 17-18. Në këtë mes bën të merret në konsideratë edhe shpjegimi për fjalën *skundill.*

[505] Khs. Napomene o arbanaškim tragovima u Hercegovini, Arhiv za anbanasku starinu, jezik i etnologiju, libri I, vëllimi 1-2, Beograd, 1923, f. 202.

[506] Istori lmbii române, f. 275.

[507] Sipas Josef Matl, Hirtentum und Stammesverfassung als Kulturfaktor, në Völker und Kulturen Südosteuropas, Kulturhistorische Beiträge, im Namen der Südosteuropa-Gesellschaft herausgegeben von Wlhelm Gülich, München, 1959, f. 109.

Përveç djathit dhe qëndismave, mbase po në këtë poezi të Prodromos-it po u përmendka edhe guna vllahe, tallagani vllah - një mbështjellëse e gjerë, pa mëngë që edhe sot mund të shihet mbi shpatulla të barinjve të Ballkanit.[508]

Që edhe në hapësirën e Kosovës do të ketë pasur prodhues të këtij lloji të djathit duket se e tregon edhe emri *Urdovci* i një vëllazërie serbe të katundit Budrikë të komunës së Gjilanit.

Një element vllah në të folmen e Opojës do të jetë trajta *stërgë* e cila shenjon *shtrungën*, fjalë që, duket se s'ka ç'të jetë tjetër veçse variant opojar i trajtës së mirëfilltë strungë/shtrungë të shqipes ose të substratit ballkanik por që në këtë të folme (ri)hyri me ndërmjetësimin e goranëve sllavishtfolës. Rrethana e konstatuar nga Th. Capidan që e sjell P. Skok[509] se disa terma blegtoralë të cilat për arumanishten e sotme janë të humbura, por që janë ruajtur në gjuhë të tjera të Ballkanit si p.sh. ". .. *strunga ţarcu* dhe *negru* "i zi" (sot thuhet *laiu*, sh. më poshtë) e dëshmon jo tërthorazi, por drejtpërdrejt bashkëjetesën dhe bashkëshkrirjen-shqiptarizimin e elementit vllah, përkatësisht aromun në hapësirat e sotme të Kosovës. Ky paravendim do të dëshmohej edhe në rrafshin gjuhësor sa kohë që, sipas mendimit tim, tek shrehja aromune *strunga ţarcu* mund të shihet një formim tautologjik nga ballkanizma apo albanizma e vjetër *shtrungë* dhe nga fjala me të njëjtin kuptim *ţarcu* e cila do të jetë edhe një albanizëm i arumanishtes nga fjala thjesht shqipe *thark,-u*. Kësaj duhet shtuar edhe rrethanën që edhe termi *cutar* i aromunishtes kroat, "trlo" ruhet në të folmen e krahinës së Gallapit si *kotar* që është vetëm një sinonim për *thark*-un; që mbiemri *negru* i zhdukur në arumanishten është ruajtur tek emri *Negrovc* i katundit të komunës së Shtimes.

Përveç materialit leksikor katërçipërisht të prejardhjes romane ballkanike, përkatësisht aromune/vllahe, nga ndonjë dijetar pa kurrfarë kompetence në fushën e gjuhësisë, siç ishte Jovan Cvijić, qenka hetuar se në të folmen e Gorës paska edhe konstrukte gjuhësore si p.sh. "*imam videno, čujeno, razbrano*" (në vend të : *vidio sam*, *čuo sam*, *razabrao sam*) që, midis të tjerash, ta kujtojnë edhe perfektin e shqipes: *kam pa, kam ndigjue, kam kuptue*". Dijetari i paautorizuar në fushën e gjuhësisë e paska vërejtur në këtë të folme edhe përdorimin jo konsekuent të nyjes e cila e ka edhe kuptimin dhe funksionin e përemrit dëftor si edhe të folurit e shpejtë me theks të veçantë të theksimit të shkurtër.

Për me prejardhje vllahe Sadik Idrizi i konsideron edhe emrat e vendeve si *Mavra*, *Stratorje*, *Kozmina*, *Orćuša*, *Orgosta*, *Krakošta* e *Dragaš*. Dy emrat e parë (*Mavra* e *Stratorje*) janë, siç e kam treguar në këtë trajtesë, emra grekë. I këtillë mund të jetë edhe emri *Kozmina*; emrat *Orćuša* e *Orgosta* janë emra me prejardhje të latinitetit ballkanik, ndërsa dy emrat e fundit (*Krakošta*, e *Dragaš*) mund të jenë emërtime vllahe me material leksikor të sllavishtes, në rastin tonë

[508] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[509] Sh. Iz Rumunske literature o balkanskim Vlasima, Glasnik Skopskog Naučnog Društva, Vëllimi II, Fashikulli 1-2, Shkup, 1927, f. 300.

të bullgarishtes. Për gabim lëndor e konsideroj pohimin e autorit tonë se "nga gjuhë romane janë marrë (SG. në të folmen e Gorës) disa forma gramatikore". Kjo për shkak se mbi të folmen e goranëve nuk ka pasur ndikim të ndonjë gjuhe romane, sepse gjuha mëmë e tyre e parasllavizimit ishte pikërisht varianti vllah i latinitetit ballkanik. Prandaj këtu nuk mund të flitet për ndikim, por për relikte gjuhësore të mbetura në vllahishten, pas sllavizimit të folësve të kësaj gjuhe.

Rrethana që për emrat vlleh të vendeve e të vëllazërive të goranëve mund të besohet se nuk janë emra të administratës, ka arsye të pohohet që gjendja onomastike e dëshmuar në dokumentacionin kishtar serb të shek. XIV, përkundër tendencës së njohur të pushtetit dhe sidomos të kishës nacionale serbe për serbizimin së pari onomastik e më pastaj edhe etnik të të nënshtruarëve të tij - do të jetë reflektim i realitetit onomastik të gjetur në vend. Mikrotoponimet dhe ndonjë leksem me prejardhje nga brumi gjuhësor i latinitetit ballkanik që ndeshen në regjionin shqipfolës të Opojës (khs. emrat *Blaq*, *Kapre*, *Kilikere*, *Shtatul* dhe leksemi *kurt*,*-i* e ndoshta edhe *burg* për "vath"), tregojnë që në këtë hapësirë kishte një popullatë vendëse të ndikuar thellë nga latiniteti ballkanik, por që individualitetin e vet gjuhësor e etnik ua përcolli pasardhësve të tyre shqipfolës të sotëm. Mbi këtë shtresë latine ballkanike vendëse të formësuar në harmoni me ligjet fonetike të shqipes u shtresua më vonë edhe një superstrat "vllah" i formësuar nga folës të romanishtes ballkanike jugore. Bartës të kësaj mbishtrese do të jenë vllehtë mesjetarë, pasardhësit e trakasve e të dakasve të lashtë të romanizuar të goranëve të sotëm, të ardhur nga hapësira gjuhësore e bullgarishtes më parë, porse nga masivi i Rodopeve nga i cili (substrat) është ruajtur një pjesë bukur e mirë emrash të vëllazërive e të mikrtoponimeve me prejardhje "vllahe" sidomos të popullatës gorane, por edhe të asaj shqiptare..

9. SHTRESA GREKE

9.1. Emra vendesh:

Mavra

Me prejardhje greke është emri *mavrъ* i malit të dëshmuar në burimin e vitit 1348,[510] për bjeshkën që i takonte katundit të sotëm Radesh të krahinës së Gorës, përkatësisht mali i sotëm *Mavra* midis katundeve Zlipotok e Brod.

Emri i kësaj bjeshke rrjedh nga mbiemri grek μαυρος "i zi". Sa për analogji, le të përmendet toponimi *Mavrogi* në territorin e Maqedonisë së sotme, të cilin dijetari i merituar serb I. Popović e konsideron për toponim grek dhe e nxjerrte nga greq. e mesme, përkatësisht bizantine, μαυρόγη "tokë e zezë".[511] Prejardhjen e padiskutueshme greke të këtij emri do ta dëshmonte edhe rrethana që pikërisht në katundin me emër grek Gramatik/-ovo në juglindje të Voden-it, ishin evidentuar në vitet 1467-1468 edhe banorët Lazar Mavrić e Kosta

[510] Khs. Hrisovulja. .., f. 300.

[511] Sipas I. Popović, Die Einwanderung der Slaven in das Oströmische Reich im Lichte der Sprachforschung, Zeitschrift für Slawistik, Bd. III, 1958, f. 711.

Mavrić[512] Ky mbiemër grek përmbahet edhe tek emri *Mavriq* i katundit të regjionit të Llapit, kah ka edhe emra të tjerë me prejardhje greke si p.sh. *Metehi,-a* e ndonjë tjetër.

Myskepojë

Një emër vendi me prejardhje nga greqishtja i cili do ta përforconte tezën time për ardhjen e vllehve sllavishtfolës edhe nga jugu i Ballkanit në regjionin e Gorës do të ishte edhe emri *Myskopojë* i vendit në katundin Zapluxhë të krahinës shqipfolëse të Opojës. Pa e marrë parasyh rrethanën që fjala *myshk* e shqipes (kuptimi i së cilës përmbahet në emrin e mësipërm) rrjedh[513] nga lat. *muscus*, ky emër vendi duket mbase i pandashëm, së pakut për nga fjalëfomimi, nga emri Moskopojë/Voskopojë që do ta lejonte mundësinë e sjelljes së këtij emri nga ndonjë vëllazëri e padëshmuar në hapësirat e Opojës dhe të Gorës nga vlleh të hapësirës së sotme të jugut të Shqipërisë. Po të jetë kështu, në këtë rast do të kishim të bënim me një vëllazëri gorane, të padëshmuar, të shqiptarizuar. Kundër prejardhjes shqipe, vllahe/rumune të këtij emri do të fliste rrethana nga fusha e fonetikës historike që fjala latine e përmbajtur në këtë emër nuk reflektuaka as në trajtën shqipe *myshk* e as në ato rum. *muschiu* apo vllahe *musclu*. Sado që mund të mos e ketë vendin këtu, bën të shtohet se në të folme kosovare kjo fjalë dëgjohet si *lmashk* dhe si *myjë*, përkatësisht *dru i myjavt.*

Paraspor

Kështu quhet një kompleks toke në territorin e katundit Vranisht, ndërsa në Dragash, qendrën administrative të sotme të kësaj krahine, ekziston edhe mikrotoponimi në trajtën *Paraspur*. Një mikrotoponim që e përmban të njëjtën fjalë dhe që është i së njëjtës prejardhje si edhe toponimi i Gorës sllavishtfolëse e kam shënuar edhe në katundin Brodosanë të Opojës. Këtu e kam shënuar mikrotoponimin *Parasporet* që shqiptohet edhe si *Paraspure*. *Paraspor* po u quajtka edhe një vend në katundin Brrut dhe dy *Paraspore* paska në katundin e vogël Kuk[514] të krahinës së Opojës. Një mikrotoponim. *Paraspuret* është edhe në katundin Tupec të Prizrenit.[515]

Të gjithë emrat e mësipërm rrjedhin nga fjala greke πάρασπορος "*tokë jopjellore, e ligë*" (greq. e vj. παρασπορά; greq. e re. παρασπόρι). Sado që në të folmen shqipe të Opojës fjala *paraspóre* e ka kuptimin "tokë e papunueshme, ledinë, tokë shterrpë, kullotë", ndërsa në terminologjinë e serbishtes mesjetare me këtë fjalë emërtoheshin tokat të cilat zotëruesi i feudit i punonte me krahë pune të njerëzve të vaur nga ai[516] përkatësisht "arë e spahiut, të cilën në kohën e

[512] Khs. Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod. .., f. 568.
[513] Sipas E. Çabej, Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe, XIV, "Studime filologjike" 3/1964, f. 48.
[514] Sipas J. Osmani, Vendbanmet e Kosovës 20,. .., f. 97, 114, 138.
[515] Sipas J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 18, Prizreni, Prishtinë 2006, f. 249.
[516] Sipas St. Novaković, Selo, f. 229, 243

sundimit turk duhej ta punon katundarët",[517] ky toponim shënon në Brodosanë një kompleks toke të punueshme, tokë buke. Ky kompleks arash ndodhet përreth topogërmadhës *Zinova*, për të cilën tradita di të tregojë se në kohë të mugëta paska qenë qytet, ndërsa ndonjë studiues i huaj, si p.sh. Jastrebov[518] e konsideronte vendin *Zinova* truall të një qyteti bizantin apo të një pjese të tij.

Rrethana se në kujtesën kolektive të popullatës së këtij regjioni është ruajtur kujtimi për ekzistimin e një qytetit të periudhës bizantine si edhe rrethana se në këtë zonë ka edhe mikrotoponime të tjera nga leksiku i greqishtes së mesme (khs. *Mavra, Stratorje*) nuk është e guximshme të besohet se këtu kemi të bëjmë me një vazhdimësi jo vetëm të toponimeve, por edhe atë që nënkuptohet nga kjo vazhdmësi: praninë e kësaj popullate në këtë zonë edhe në periudhën bizantine të Kosovës së sotme.

Paraskovci

Ka shumë mundësi që emri i këtij vendi në katundin Gllloboçicë të jetë i pandashëm nga varianti *Paraskeva* i emrit të shenjtores së kishës bizantine dhe të ketë shenjuar një vend në të cilin do të ketë pasur një kishë kushtuar kësaj shenjtorje. Ka shumë mundësi që këtu kemi të bëjmë me emrin e kryehershëm që tani quhet thjesht vetëm *Crkva* "Kisha" të këtij katundi, e cila do t'i ketë qenë kushtuar shenjtores së quajtur greq. Παρασκευή, e që lidhet me apelativin παρασκευή që shenjon emrin e ditës së premte, përkatësisht ditën kur është lindur kjo shenjtore. Emri dhe kulkti i kësaj shenjtorje është i përhapur tek ortodoksët e Ballkanit: khs. *Paraskeva, Paraškeva, Paraska, Keva* por edhe si *Petka* tek bullgarët si edhe Petka tek serbët; *Vinera*, tek rumunët; *Parasqevi, Paruqe* e *Qevë*[518a] tek shqiptarët ortodoksë, ndërsa tek shqiptarët e ritit katolik si emër femëror *Prene* e *Prende* dhe si emër mashkullor *Pren, Prend, Prek, Prenk* e *Prekoq*. Në kishën e ritit roman kjo shenjtore njihet me emrin *Venera* e *Veneranda* i cili, sipas K. Jireček[519] tek shqiptarët qenka reflektuar edhe si *Ránjë, Ránja.*

**Perivojth*

Një mikrotopinim me prejardhje greke në krahinën e Opojës do të jetë edhe emri *Pirivojth* i një vendi në katundin Pllajnik,[520] si edhe mtp. *Perívolji* në katundin goran Shishtevec të rrethinave të Kukësit dhe emri *Perivoj* i vendit

[517] Die greichischen Lehnwörter im Serbokroatischen, Berlin, 1944, f. 115.

[518] Khs. punimin e tij Sinan - paša i Kukli -beg, Beleške iz Stare Srbije povodom knjižice prof. Srečkovića, në Glasnik Srpskog Učenog Društva XLIII, Beograd 1876, f. 22.

[518a] Sipas Prof. Dr. Gustav Weigand: Die bulgarischen Rufnamen, Ihre Herkunft, Kürzungen und Neubildungen, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache (Rumänisches Seminar), 15/1909, f. 129.

[519] Romani u gradovima Dalmacije. .., f. 66.

[520] Këtë mikrotoponim e ka shënuar në terren J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 125.

midis qendrës komunale të Vitisë dhe katundit Mogillë të rrethinave të saj.[521] Mikrotoponimet e mësipërme rrjedhin nga fjala *περιβόλι*(*o*)*v* "kopësht" e greqishtes së mesme.[522]

Rrethana që toponimi opojar është një formim deminutiv e tregon ngulitjen thellë, përkatësisht qenien në përdorim të përditshëm për kohë të gjatë të kësaj fjale në gjuhën shqipe. Kjo fjalë e sferës së shtëpisë, bashkë me fjalën me prejardhje latine ballkanike të shqipes *kurt,-i* "oborr,-i" flet, më tej për një lashtësi të thellë në të banuar të shqiptarëve në këtë krahinë.

Ka arsye të besohet që mikrotoponimi bizantin i këtij katundi është një dëshmi e tërthortë që në vendin e sotëm *Te Kishëza* të ketë ekzistuar një kishë e periudhës bizantine, aq më parë që këtu kemi të bëjmë me një fjalë të sferës së shtëpisë e të kishës.

Ivan Duridanov[523] tregon se ka dijetarë që këtë fjalë të latinishtes (*corte* nga *cohortem* bullg. "dvor za dobitък" e kërkojnë edhe në pjesën e parë të emrit Κουρτουξο□ρα (Kurtusura) të kështjellës në Traki, në veri të Hebros-it që e përmend Procopius.

Stratorje

Kështu quhen një lëndinë në katundin Gllobоçicë, ku është dhe përroi *Stratorski potok*; një vend (Stratorje) në katundin Krushevë;[524] një kompleks toke në katundin Zli Potok; një vend në katundin Mlikë dhe një pjesë e bjeshkës, kullotës së katundit Baçkë të krahinës së Gorës.

Në të tria këto emërtime përmbahet fjala greke e periudhës bizantine *stratiotes* - fjalë kjo e cila ka hyrë edhe në venecianishten dhe në italishten e vjetër. Kjo etimologji bëhet më e pranueshme nëse mund t'i besohet Jastrebov -it se kjo kullotë e katundit Baçkë qenka quajtur më parë *Stratos*.[525] Më shumë se kjo e dhënë e Jastrebovit, në të mirë të korrektësisë së kësaj etimologjie shkon edhe konstatimi i Meyer- Lübke- s që tek fjala e venecianishtes *stratiotes* duhet parë një fjalë greke *stratiotes* që e ka kptimin "ushtar", fjalë që në venecianishten e lashtë ishte reflektuar fillimisht në trajtën *stradioto* si edhe në italishten e vjetër *stradiotto* "kalorës i armatosur lehtë i Levantit venedikas". Një gjë që duhet pasur parasysh me këtë rast është prania jo e rrallë e toponimeve të këtij formanti edhe në territorin e Francës tek të cilat (toponime) A. Dauzat e gjen jo fjalën bizantine *stratiotes*, por atë latine *strata* "udhë" duke e përligjur këtë etimologji me konstatimin se vendet e quajtura *Strata* janë pothuaj rregullisht "lokalitete të vendosura kryesisht brinjë ndonjë rruge romake/*via strata lapide*".

---

[521] I shënuar në terren nga A. Urosević, Gornja Morava i Izmornik,. .., f. 14.

[522] Për etimologjinë dhe kuptimin e kësaj fjale khs. M. Vasmer : Die greichischen Lehnwörter. .., f. 115.

[523] Latinski ili trakijski (resp. Dakijski) mestni imena?, Studia Linguistica in Honorem Vladimir I. Georgiev, Sofia, 1980, f. 218.

[524] Sipas J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 105,112.

[525] Khs. punimin e tij Sinan - paša i Kukli -beg. ..

Në dritën e zgjerimit prapashtesor sllav të vetë emrit Strat- *or* - *ije* ka më shumë arsye të paravendoset se këtu kemi të bëjmë me një emër grek se sa me një të tillë të shtresës gjuhësore të latinitetit ballkanik. Vështruar nga pikëshikimi jashtëgjuhësor, shkallës së korrektësisë së këtij interpretimi tim do t'i ndihmonte edhe rrethana se institucionin e stratiotëve, përkatësisht të kalorësve, ushtarëve si pjesë e rregullimit social bizantin e kishin përvetësuar edhe pushtuesit serbë dhe kjo kategori sociale vazhdoi të njihej edhe nga pushtuesit osmanë. Si në dokumentacionin kishtar serb të shek. XIII-XV ashtu edhe ndër defterë osmanë-turq dëshmohen *voinik*-ët përkatësisht *vojnuk*-ët. Kështu p.sh. në krisobulat e Deçanit të vitit 1330 dëshmohet për banor i katundit Bulubi të veriut të Shqipërisë edhe njëfarë Bogoje *Strator*- në të cilin (katund) kishte edhe banorë që mbanin antroponime vllahe.[526] Në një dokument të sundimtarit serb Stefan Dushan të vitit 1355, me të cilin ky i vërtetonte edhe një herë pronat e manastirit të Shën Kollit në Dobrushtë afër Prizrenit, ndër njerëz që duhej të rrogonin për këtë manastir përmendet edhe "luftëtari" *Ginь Běli*,[527] përkatësisht **Gjin Bardhi*. Në dritën e mungesës së fenomenit të kalimit të *s* → *sh*, respektivisht *st* → *sht* që e kishim hetuar se mungonte edhe te disa emërtime me prejardhje nga latiniteti ballkanik (khs. *Statulj* në Gorë, shq. *Shtatuli* në Opojë) e që, përkundrazi, e ndeshim te mikrotoponimi *Shtatul,- i* i katundit Blaç të Opojës, del sikur edhe te emërtimi *Stratorje* kemi të bëjmë me një amullim të këtij fenomeni apo, thënë ndryshe, me ruajtjen e këtij emërtimi nga një popullatë që qysh para ardhjes së fiseve sllave (bullgare e serbe) s'do të ketë folur shqip. Në të mirë të kësaj do të shkonte edhe trajta me *sh* nën të cilën nga popullata shqipfolëse e rrethinës shqiptohet emri i vendit *Shtatinoci* (dikur pjesë e katundit të sotëm Grejkoc të rrethinave të Suharekës),[528] i cili ndër burime shkrimore joshqiptare të shekullit XVI është shënuar në trajtën *Stratinovci*.

Interpretimi i mësipërm do të bëhej më i besueshëm sikur të sqarohej arsyeja e zgjerimit të fjalës bazë të këtij emërtimi me parashtesat *-in* dhe *-ovci*. Kjo sepse trajta *Stratinovci* e variantit shqip Shtatinovc do të duhej të ndahej nga mikrotoponimi *Stratorje* i krahinës së Gorës dhe të shihej si një emër me prejardhje nga antroponimi grek *Estratios*,[529] i cili tek bullgarët ndeshet në trajtat *Stratija, Strato, Stratil*. Në këtë rast do të kishim të bënim me një emër vendi që në hapësirat e Kosovës do ta kishin sjellur me vete vlleht e bullgarizuar, prararendës të goranëve të sotëm.

---

[526] Khs.Dečanska Hrisovulja..., f. 38.

[527] Sh. S. Novaković, Zakonski spomenici. .., 719. Në botimin e po këtji dokumenti, T. F1orinski (Afonskie akty i fotografičeskie snimki s nih v sobranijah P. I. Sevastjanova, S. Petersburg 1880., f. 64) - konsideron se ky dokument është i vitit 1344 (?) - emri i këtij personi është shkruar këtu si *Ginьběli Vasylь*.

[528] Sh. për këtë punimin tim. Rreth lokalizimit të disa vendbanimeve të Kosovës, në "Rilindja", 18 janar 1975, f. 13.

[529] Prof. Dr. Gustav Weigand: Die bulgarischen Rufnamen, Ihre Herkunft, Kürzungen und Neubildungen, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache (Rumänisches Seminar), 15/1909, f. 120.

Le të shënohet së fundi që dijetari i mirënjohur Max Vasmer midis greqizmave të serbishtes e radhiste edhe fjalën *stratoъ* me kuptimin "një titull, gradë në manastir" nga greq. e mesme στράτωρ dhe kujtonte se nga kjo fjalë e heq prejardhjen edhe emri *Stratorija* i dëshmuar në vitin 1348.[530]

Tupan

Kështu quhet një kodër, mal në katundin Brod. Sado që fort më i lehtë do të ishte sqarimi popullor i emrit të këtij mali me fjalën *tupan* që si në shqipen ashtu edhe në bullgarishten e ka kuptimin e lodrës, *tupan*-it si instrument muzikor; po e sjell më poshtë mendimin e Z. Pavlović e cila, kur po e trajtonte prejardhjen e emrit *Tupan* të një rrjedhe të ujit në sistemin e hidronimisë së Moravës së Jugut shënonte se këtu paskemi të bëjmë me një emërtim të motivuar nga *burimi*. Sipas kësaj, emri i kësaj rrjedhe qenka i pandashëm nga gjinorja e emrit *Pan* të shenjtorit e cila qenka një adoptim e adaptim serb i një fjale homofone (τύμπαν (ov) të greqishtes dhe e paska kuptimin "Burimi i Panit". Ky emër po dalka shpesh edhe si emër malesh në të cilat ka edhe burime ujërash dhe i paravendohet ekzistimi i një burimi dhe qenka i lidhur me organizimin e jetës dhe të aktivitete të shoqërive blegtorale.[531]

Zinova

Pa pasur kompetencë ta vlerësoj korrektësinë e interpretimit të mëposhtëm, po e sjell këtu mendimin e N. Jokl-it, sipas të cilit një emër grek i periudhës bizantine i hapësirës së krahinës së Mirditës në kufi me atë të Matit në Shqipërinë e Veriut qenka edhe emri *Kodra Zinorit*. Ky emër po rrjedhka nga greq. *Synorion* "kufi; mexhë", përkatësisht nga greq. σύνορον. Në rrafshin historik, Jokli e arsyeton këtë etimologji me rrethanën që Mati ishte për kohë të gjatë kufi me trevën e Durrësit e me atë të Shkodrës dhe se në shqipen gjallon edhe apelativi, sinuar (SG: sinuer) sinor.[532] Nëse kështu mund të sqarohet edhe emri Zinova i vendit, për të cilin pandehet të ketë qenë vendbanim i tipit të qytetit e pra edhe vend kufiri me ndonjë famulli apo qytet për të cilin nuk dimë gjë, mbetet çështje që duhet të shihet.

Pa pretendime se po sqarohet njëherë e mirë origjina e tij, bën të shtohet se në hapësirën gjuhësore të bullgarishtes ky emër ndeshet në funksion antroponimi femëror *Zina* në katundin Slavovica të çarkut Pazardžik dhe si emër vendi *Zinovska* në katundin Leska të qarkut Ćustendil dhe në hapësirën e kroatishtes po si toponim *Zinajevac*. Dijetari bullgar I. Duridanov e lejon mundësinë e afrimit të këtyre emrave me trajtat e shkurtëra Zinovius e Zinaida

[530] Khs. Die griechischen Lehnwörter im Serbo-Kroatischen, Berlin, 1944, f. 238.

[531] Z., Pavlović, Un cas d'ambiguite mixoglottique, Actes de Xie congres international des sciences onomastiques, Sofia 1972, Academie Bulgare des Sciences – Centre de linguistique et litterature, Sofia, 1975, f. 119.

[532] Norbert Jokl, Zur Ortsnamenkunde Albaniens, Zeitschrift für Ortsnamenforschung, Bd. 10, Heft 2., 1934.

mbase me prejardhje greke të këtij antroponimi. Meqë ky antroponimin është "jo i popullarizuar" tek bullgarët, këtij i duket më mbushamendës që prejardhja e tij të kërkohet tek antrop. Trakase Zina, Ζεινης, Zines, Zinnaeus[532a] etj.

9.2. Emra vëllazërish:

Čujkovci

Me prejardhje nga emra të shenjtorëve të kishës ortodokse greke do të jetë edhe emri *Čujkovci* i vëllazërisë gorane të katundit Brod, i cili na e përkujton emrin e shenjtorit Shën *Çurku*/*Çulku*, që ruhet edhe tek emri i katundit *Ćulkovci* të rrethinave të Novobërdës të shënuar në vitin 1455[533] dhe tek mikrotoponimi *Roga e Çulkut* në katundin Marec, rrëzë majës në të cilën është Kalaja e Novobërdës. Tek të gjithë këta emra përmbahet antroponimi *Çulk* që është refleks i antroponimit grek të periudhës bizantine Κουριακος.

Kiprinci

Emri i kësaj vëllazërie rrjedh nga antroponimi grek *Kirprios*, ndërsa ky vetë nga lat. *Cyprianus*.

Konturovci

Duke e paravenduar kalimin, që ndodh shumë shpesh, të *o* në *a* dhe anasjelltas, ndër emra me prejardhje greke të vëllazërive të krahinëzës së Gorës do të binte edhe emri *Konturovci* i një vëllazërie në katundin Leshtan, një bark i së cilës mund të ketë qenë edhe në katundin Brod, i quajtur atje, apo vetëm i shënuar gabimisht, *Kanturovci*. Emri në trajtën *Konturovci* i kësaj vëllazërie nuk mund të ndahet mbase nga një fjalë më e vjetër e cila në trajtën dialektore të greqishtes së re në Epir del si κούντουρος në kuptimin "i gjymtuar". Gjykuar mbi bazën e trajtimit nga M. Vasmer të fjalës *kòndura* "këpucë", rezulton që, kryesisht për shkak të vendit të theksit, emri i vëllazërisë gorane s'do të ketë gjë të përbashkët me variantin osman-turk *kundura* "këpucë", të huazuar nga greq. κόθορος e gjerm. "Kothurn", përkatësisht nga greq. re κουντούρα "pantofël".[534]

Po të jetë kështu, edhe ky emër do të tregonte që edhe pararendësit e kësaj vëllazërie do të jenë të ardhur këndej nga hapësira e ndikimit të greqishtes, përkatësisht si element etnik jogrek i hapësirave të Ballkanit të Jugut.

**Pantelej*

Shtresës greke të periudhës bizantine (shek. XI-X) i takon edhe emri i kodrës *Panteljevac* të katundit Kërstec i Madh, në të cilën mund të ketë qenë e vendosur vëllazëria gorane e quajtur **Pantelejci*.

[532a] Khs. Der thrakische Einfluß auf die bulgarische Anthroponymie, Balkansko Ezikoznanie/Linguistique Balkanque II, Sofia, 1960, f. 82.

[533] sh. Oblast Brankovića, f. 169.

[534] M. Vasmer, Die griechischen Lehnwörter. .., f. 82.

Këtu do të ketë qenë mbase edhe vendi i një kishe të kushtuar shenjtorit Panteleimon të kishës bizantine,[535] e dëshmuar në vitin 1348: "Katundi Ograxhenik me lagjet Nashec e Borshinci të tij dhe kufiri i tij nga qyteti në Preçnik dhe kufiri i tij nga Lluka dhe nga Mllaçna nëpër Preçnik deri tek Thana dhe prej Thanës nëpër mal tek Ligata tek Hardhia e Mjellun dhe nga Ligata malit teposhtë tek Kisha e Shën Panteleimonit, ku piqen Bistrica me Drinin, Drinit teposhtë tek *Gjyteti aty ku Sushica bie në Dri".[536] Duket se pikërisht ky vend do të jetë vendbanimi me krejt 3 shtëpi i regjistruar në vitin 1451-1452 si *Pandalosha* dhe në regjistrimet e viteve 1571 e 1592 si *Pandelofic*. Emri i kësaj kodre dhe i vëllazërisë së vendosur aty e ka për rrënjë antroponimin e krishterë të sferës greke ortodokse Παντελείμον i cili ndër popuj të krishterë të ritit ortodoks ndeshet në shumë variante trajtash të shkurtra. Ky emër del p.sh. tek bullgarët në trajtat *Pantelej*, *Pandilej*, *Pandelimon*, dial. *Pančelim*, *Panto*, *Pantjo*, *Pančo*; tek serbët në trajtën *Pandelejmon*, ndërsa te shqiptarët ortodoksë si *Panto*, *Ljimón*, *Mon*,-i[537] dhe *Pandeli*. Ka mbase shumë arsye të besohet që me prejardhje nga vlleh ardhës të bullgarizuar të jetë edhe emri i katundit të sotëm serb *Pançillovci* i komunës së Gjilanit.

Se tek emrat me prejardhje greke nuk kemi të bëjmë vetëm me një ndikim literar apo me emërtime të formuara me fjalë greke që kanë hyrë në këtë të folme, porse mbase edhe me dëshmi për praninë e elementit etnik grek qoftë ky vetëm edhe përmes famullitarëve, sikur e tregon përmednja në vitin 1348 e një banori të quajtur *Draica Grković* me të vëllain e me fëmijët dhe me katundin *Jelenc* që ia kishte dhënë madhnia e tij Mbreti [duket se *Jelenc* -i mund të ketë qenë në hapësirat e katundeve të sotme Bellobrad ose Brodosanë]. Kujtimi për ekzistimin e individit të cilësuar për "grek" që mund të ketë qenë vetëm një pjesëtar i një vendbanimi më vete nga grekë apo nga më shumë sish që e ndjenin veten për të tillë, është ruajtur tek mikrotoponimet *Grčki potok* në Vranisht; tek emri *Grekojec* në Leshtan dhe në mikrotoponimin *Grčke rupe* "Gropat e grekëve" - një pjesë bjeshke, kullote në katundin Restelicë të Gorës dhe *Grkinica*, vend në Glloboçicë. Këtu bie edhe

[535] Pantaleon, greq. Panteleimon, shenjtor i vdekur rreth vitit 305 në kohën e përndjekjes së të krishterëve nga perandori Dioklecian. Mbahet për njërin ndër të 14 ndihmësit dhe patron i mjekëve, mamive e i motrave medicinale. Dita e tij e kremtes është, sipas kalendarit roman, më 27 korrik. Sipas Biographisch-Bibliographisches Kirchenlexikon, në http://bautz.de/bbkl/p.

[536] Sado që, sipas tekstit të krisobulës, ky vend paska pas qenë aty ku përpiqeshin Bistrica e Drini, përkatësisht në vendin ku një lumë i quajtur Sushica derdhej në Dri. Khs. tekstin tek Hrisovulja,. .., f. 279: "Selo ogradjenikъ i sь zaselkomь naaš'cem ì bor'šin'ci a megjà mou ѡt grad ou prěč'nikь. ì megja mou ѡt louke. ì ѡt m'lačna. prěč'nikomь. do drěnà. ì ѡt drěna ouzdělь na lokvù do sagjene loze. ì ѡt lokve niz'dělь ù crьkvь svetago pantelejà, gdě se stajè bьístrica zdrimomь, ouzdrimь do gradišta kako oupada sušica ú drimь. "

[537] Prof. Dr. Gustav Weigand: Die bulgarischen Rufnamen,. .., f. 129.

mikrotoponimi *Grčko trlo*, për të cilin autori S. Idrizi[538] nuk sjell ndonjë të dhënë për vendndodhjen e tij dhe emri; *Grćka rupa* i vendit në Staro Selo dhe emri *Gërkoci* (ndoshta Grkovci) i një vëllazërie në katundin "boshnjak" Jabllanicë të komunës së Prizrenit.[539]

Sarandovci

Etimologjikisht, emri i kësaj vëllazërie është gjithsesi me prejardhje greke. Mund të shpjegohet si emër vëllazërie i lidhur me katërdhjetë shenjtorët e kishës ortodokse, ose me emrin Saranda të qytetit të jugut të Shqipërisë. Sido që të jetë, kemi të bëjmë me një vëllazëri të ardhur nga hapësirat e Gorës nga sfera ortodokse e jugut të Ballkanit.

10. SHTRESA SLLAVE

Elementet onomastike sllave në nomenklaturën topike të regjionit të Gorës, ashtu siç ato pasqyrohen në krisobulën serbe të shek. 14 e edhe në regjistrimet osmane- turke të shek. XV-XVI e lejojnë nxjerrjen e përfundimit që procesi i sllavizimit onomastik të hapësirës së këtij regjioni kishte përfunduar ose, në pjesën më të madhe të tij - sidomos emrat e vëllazërive - para shek. XIV. Në dritën e kësaj rrethane nuk vlen prandaj trimërimi i historianëve e i albanologëve patriotë, që kjo gjendje të shihet e të shpjegohet me deklarime paushalle, refrenike se, si në gjithë Kosovën, edhe këndej paskemi të bëjmë me ndonjëfarë sllavizimi administrativ dhe me "përvetësim" të kishave iliro-dardane. Kjo sepse shtresa mbizotëruese sllave në këtë regjion nuk është, thënë figurativisht, një freskë e re, pas gërvishjes së të cilës do të dilte ajo freska e kryehershme.

Bačka

Kemi të bëjmë me një emërtim që e ka për rrënjë fjalën *bač*, të zgjeruar me prapashtesën *-ka* dhe tregon kështu një vend në të cilin kishte tbane. Të njëjtën prejardhje e kuptim e ka edhe mikrotoponimi *Bačevac*,[540] në katundin Lubovishtë dhe *Bačila* në katundin Kërstec i Vogël po në regjionin e Gorës.

Duket se prejardhja e emrit të katundit dhe e mikrotoponimeve të Gorës nuk mund të ndahen nga nocioni i *tbanit, bunit*, përkatësisht nga termi blegtoral me përhapje në gjithë Ballkanin e që shenjon kryebariun e tbanit dhe punën e tij në fushën e përgatitjes së bylmetit: khs. shq. *bac*, *baç* "kryebari, gjizar, stopan, djathar; vëlla i madh"; rum. *baciu*, *bač* që në trajta të ndryshme haset edhe në serbishten, bullgarishten, greqishten e re, çekishten, hungarishten e në polonishten.[541] Në këtë gjuhë,[542] kjo fjalë paska hyrë nga rumanishtja *baciu* në

[538] Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[539] J. Osmani Vendbanimet e Kosovës 18, Prizreni, Prishtinë 2006, f. 117, 132.

[540] J. Osmani Vendbanimet e Kosovës 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë 2006, f. 120.

[541] Khs. Al. Roseti, Istoia limbii române, Bucureşti, 1968, f. 262, 265.

trajtën *baca, bacza, bacs*(*a*) "bariu më i moçëm; bari,-u". Dijetarët ballkanologë e kanë shfaqur mendimin se kjo fjalë është përhapur nëpër gjuhë të Ballkanit përmes barinjve vlleh, ndërsa për sa i bie prejardhjes së vetë fjalës ka mendime që ajo të jetë fjalë e shqipes, e rumanishes ose një fjalë e substratit të përbashkët të këtyre dy gjuhëve.[543] Duke u mbështetur mbi rrethanat e ndërlikuara mbi të cilat mbështeten interpretimet për disa fjalë e emra vendesh që mund të rrjedhin nga një substrat ballkanik, toponimi Bačka mund të merret, megjithatë, për një variant sllav (në rastin tonë bullgar/goran) të një emërtimi vllah

Borje

Emër sllav i vendit i sajuar nga emri *bor* i lisit të familjes së breut bot. "Abies alba". Fundja, vështruar lokalisht, një emër vendi i sajuar nga emri i këtij druri dëshmohet edhe në vitin 1348 si mikrotoponim *dva bóra*, "dy brejt" në kufi të katundit Rapçë të Gorës (khs. referencën 35). Por një vend i quajtur *Pisha* po ekzistuaka edhe në katundin Buçje të Opojës.[544]

Brod

Një emërtim përshkrues i diktuar nga rrethanat gjeomorfologjike të terrenit, i sajuar nga apelativi sllav *brod* "va, -u". Kështu quhet edhe një katund shqiptar i komunës së Shtërpcës. Është për t'u vërejtur në këtë mes që apelativi sllav *brod* nuk ka hyrë në leksikun aktiv të shqipes.

Crnaljevo

Një oikonim gjithsesi me prejardhje sllave i përbërë nga dy fjalë sllave. Çështja e motivimit sematik të këtij vendi si edhe i emrit të grykës dhe vendbanimit Carralevë, serb. Crnoljevo, nëpër të cilin kalon lumi homonim, nuk do të sillte ndonjë sqarim më të plotë nga ky i dhënë më lart.

Gabre

Me prejardhje sllave, midis shumë mikrotoponimeve të tjera, është edhe *Gabrovnik* që për në hapësirën e Gorës përmendet në krisobulën e vitit 1348. Ky mikrotoponim është me prejardhje nga terminologjia sllave e fushës së bimësisë. Rrjedh nga emri sllav *gabr* i lisit[545] bot. Carpinus betulus, shq. "shkozë e bardhë".[546]

---

[542] Sipas A. Brückner, Słovnik etyomologiuny języka polskiego, Warszaua, 1974, f. 10.

[543] Më gjerësisht për këtë khs. E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes II, A - B, Tiranë, 197, f. 122- 24.

[544] Khs. Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 100.

[545] Khs. edhe Blaže Koneski, Makedonski mesta i imenja, NIO, "Studentski zbor", Skopje, 1991, f.18, 31.

[546] Emri botanik i sistematizimit sipas Ilia Mitrushi, Drurët dhe shkurret e Shqipërisë. .., f. 333.

German /Gjerman

Sado që *Gjerman*-i i dëshmuar në vitin 1571 edhe si *Truallishta (*S.G. e pabanuar*) German* [547] në katundin Zgatar është një hapësirë kryesisht prej kodrash të zhveshura, në të cilën nuk ka ndonjë burim uji të nxehtë apo ndonjë vend i karakterizuar nga fenomeni i nxehtësisë dhe nuk i takon sot krahinës së Gorës,[548] unë po e inkuadroj në këtë trajtesë për arsyen se, në bazë të etimologjive të propozuara nga të tjerë, ky emër qenka me prejardhje të vjetër (khs. më poshtë), përkatësisht pse ky emër vendi po mundka të paravendohet sa për emër vendës, parasllav, aq edhe për emër me prejardhje trakase i sjellur nga vlleh që në këto hapësira erdhën gjuhësisht të bullgarizuar. Kështu p.sh., dijetari austriak K. Treimer konsideronte se emrat e vendeve të tipit *Germania* në Europën Perëndimore dhe në Ballkan: khs. emrin e kryehershëm *Germania*/*Germana* të Würm-it të sotëm në Gjermani dhe *Germania* në rrethina të Sofjes mund të afrohen me fjalën shqipe *zjarm* duke e parë këtë për si një monument gjuhësor ilir të shqipes.[549] Edhe A. Mayer[550] kujtonte se me prejardhje ilire janë edhe toponimet *Germus*, *Germullus*, *Germanus* dhe se, pra, si këto ashtu edhe toponimet homonime në hapësirën gjuhësore të trakishtes janë të zbërthyeshme me fjalën shqipe *zjarm*. Në këtë kontekst do të mund të mendohej që këtë hapësirë ta kenë emërtuar ndoshta pikërisht këta vlleh të bullgarizuar që erdhën pra nga hapësira gjuhësore e bullgarishtes në të cilën, reflekse të antroponimit *Germanós* të trakasve, të trashëguar nga gjuha mëmë indoeuropiane, janë: *German*, *Gero*, *Gera*, *Gerčo*, fem. *Germana*, *Gera*, *Gerana*, dial. *Džerman*, *Džermana*, *Žerman*, *Žermana*. Përveç këtyre, në Bullgari ka edhe dy emra vendesh: *German* e *Džerman* si edhe një emër lumi *Džerman*, që mund ta heqin prejardhjen nga një gurrë e vetme e përbashkët. Në frymën e mendimit të shfaqur nga G. Weigand, do të rezultonte që emrat e mësipërm po u lidhkan me emrin *Germanós* të një hyjnie trakase të motit që për tek bullgarët qenka i vetmi emër i ruajtur nga lashtësia trakase.[551] Mirëpo, në përmbledhjen monumentale të dijetarit bullgar D. Dečev[552] të mbetjeve leksikore e onomastike trakase në Ballkan, nuk gjendet ndonjë emër hyjnie trakase të motit. Për gjurmë trakase në hapësirën e Ballkanit dhe të Azisë së Vogël, natyrisht për të trashëguara nga begatia indoeuropiane, ka vetëm emra

[547] S. Pulaha, Popullsia. .., f. 354.

[548] Sado që banorët e katundeve opojare të Brrutit e të Zgatarit (sipas J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 97, 148 -149) i kanë në përdorim edhe mikrotoponimet *Dushki Gjermanit* dhe *Gjermanëza*, (në Brrut) përkatësisht *Gjermani*, *Guri Gjermanit* dhe dinë për vendin me varreza të banorëve të kryehershëm të Zgaratit të sotëm që paskan pas banuar sipri katundit Lubiçevë të Prizrenit.

[549] Karl Treimer, Illyriertum -Wesen und Bedeutung, Studia albanica, Univrsite d' etat de Tirana, Institut de Histoire et de la linguistique, 2/1965, f. 102.

[550] Die Sprache der alten Illyrier II, Österreichische Akademie der Wissenschaften, Schriften der Balkankommission, XVI, Wien, 1959, f. 50.

[551] Prof. Dr. Gustav Weigand, Die bulgarischen Rufnamen, Ihre Herkunft, Kürzungen und Neubildungen, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache (Rumänisches Seminar), 15/1909, f. 123.

[552] Khs. Die thrakischen Sprachreste, Wien, 1957, f. 102-103.

qytetesh, kështjellash e, kryesisht, të burimeve termale si *Germania*, *Germane*, *Germanos*, *Germenne*, *Germas*, *Germe*, *Germai* e ndonjë tjetër, emri i asnjërës nga të cilat nuk është afruar me emrin e ndonjë hyjnie (të propozuar nga G. Weigand, khs. më lart) sepse, më parë se me emrin e ndonjë hyjnie trakase të padëshmuar, të gjithë këta (emra) mund e mbase edhe duhet të lidhen me rrënjën indoeuropiane g□*herm* "(i,e) ngrohtë; nxehtë". Për sa dihet deri më sot, e vetmja dëshmi onomastike trakase në hapësirën gjuhësore të dardanëve e të ilirëve fqinjë është emri Κουμέδαβα/*Quimedava* i një vendi ende të paidentifikuar në Shqipëri të Veriut.

Çështje më vete është emri *Theranda*, *Thermanda* i dëshmuar në burime të antikës,* për vendndodhjen e të cilit (gjithsesi përbrenda Kosovës së sotme, përkatësisht në Prizren apo në rrethina të Suharekës) janë shfaqur mendime të ndryshme. Pa pretendime se këtu domosdo mund të kemi të bëjmë me vazhdimësi shqiptare të një emri antik, ka vend të paravendohet që vetë ky emër tregon se mund të mos e kishin mirë as dijetarët bullgarë që për ta "dëshmuar" origjinën dako-mizase të shqiptarëve, e pra edhe atdheun e kryehershëm të tyre në viset trako-dakase e sosh të kontaktit të tyre me mizët, edhe emrin *Jerma* të lumit në Bullgari e shihnin për të zbërthyeshëm me fjalën shqipe *zjerm*, *zjarm* nga ieur. g□*herm*.[553]

Glloboçica

I substratit sllav, sipas Stefan Mladenov,[554] në relacionin midis bullgarishtes e serbishtes, do të ishte edhe emri *Globočica*, bashkë me mikrotoponimin *Globočka Planina*, i katundit të krahinës së Gorës. Emri i këtij vendi, gjithnjë sipas Mladenov-it, rrjedh nga mbiemri bullgar *glьbok* "i thellë" në kuptimin konfigurativ "vend në luginë". Po të ishte me prejardhje nga serbishtja, ky toponim do të duhej të dilte në trajtën **Dlьbočica*, përkatësisht **Dubočica.*

Kërstec

Për në trajtën e dëshmuar në shkrimet serbe të mesjetës dhe të asaj të sotme, emri i këtij katundi do të lidhet me fjalën sllave krst "kryq". Mirëpo në dritën e rrethanës që në burime venedikase ky vend dëshmohet në trajtën Kristi lë vend për paravendimin që trajta Kërstec është në të vërtetë një variant sllav i dalur si rezultat i etimologjisë popullore. Duket se edhe këtu do të ketë ndodhur i njëjti fenomen i sllavizimit si edhe në Dalmaci ku maja malesh shenjohen edhe me *crista*. Kështu quhej p.sh. në vitet 1261, 1312, një kishë e Shën Mëhillit në

* Përkitazi me këtë çështje kam shkruar më gjerë në trajtesën time përkitazi me kishat dhe "Gjytetet" e Kosovës (ende në dorëshkrim).

[553] Sh.Vl. Georgiev: Introduzione alla stroia delle lingue indoeuropee, Roma, Edizione dell Ateneo, 1966, f. 166-167; Paul Kretschmer, Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache, Göttingen, 1970 (reprindt), f. 102-103; Fanula Papazoglu, Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba, Sarajevo, 1969, f. 193 etj.

[554] Geschichte der bulgarischen Sprache, f. 68.

vendin *Cresta*. Në shek. XIV-XV, si rezultat i ndikimit të etimologjisë popullore, ky emër u sllavizua si *Cresteç, Crestez, Krectecz*. "Në rrethina të Kotorit ka gjithashtu një *Krstac* që dëshmohet në vitin 1331 si *Karstaz*. Nuk dihet nëse ky emër mund të jetë sllavizim i lat. *crĭsta.*"[555] "kreshtë, tufë, xhufkë".

Kosharisht

Me prejardhje sllave, përkatësisht bullgare mund të jetë emri i katundit *Košarišt*. Ky emër rrjedh nga fjala sllave, serbe *košara, košarišti* që në serbishten e ka kuptimin "vend i thurur me thupra në të cilin ushqehet bagëtia", shqip: "vath, torishtë". Është me rëndësi të theksohet në këtë mes se kjo fjalë sllave e ka vetëm në vllahishten kuptimin e vathit, jo porse edhe në shqipen. Megjithatë, në oikoniminë e Kosovës ka dy katunde të quajtura *Koshare*: njëri në kufirin politik të Kosovës me Shqipërinë dhe tjetri në komunën e Ferizajt.

Krakojšte

Emri më i vjetër, i kryehershëm i kryeqendrës së sotme Dragaš të kësaj krahine e komune. Kujtimi për këtë emër të vjetër është ruajtur mbase tek mikrotoponimi aktual *Krakoviško og(r)agje* në hapësirën e sotme të Dragashit. Emri Dragaš do të jetë sajuar më vonë, si pasojë e mbisundimit të vëllazërisë *Drgaševci* që ekziston edhe sot në këtë vendbanim. Ky emër vendi rrjedh nga apelativi sllav. *krak, krajk* "skaj, bërryl", që në burime shkrimore të kishës serbe dëshmohet edhe në disa mikrotoponime të Kosovës.

Kruševo

Emër vendi i formuar, si shumë shpesh e gjithandej në hapësira të banuara nga sllavishtforës, nga apelativi sllav *kruša /kruška* "dardh/ë-a".

Ljubovišta

Emër vendbanimi i sajuar nga adjektivi sllav ljub me kuptimin "i dashur; i mirë" që ndeshet dendur në hapësirat që sllavët të jugut i banauan pas depërtimit të tyre me dhunë në hapësirën e Perandorisë së Lindjes, përkatësishtt të Bizantit.

*Mlikë > *Mllakë*

Duket se kështu do të jetë quajtur në krye të herës katundi i sotëm Mlikë i krahinës së Gorës. Në dokumentin më të vjetër që dihet deri tani e që ka të bëjë me regjionin e Gorës, në krisobulën e vitit 1348 nuk përmendet ndonjë vendbanim me emrin Mlika, porse tri bjeshkë, kullota të quajtura *Mllaka. Njëra (bjeshka *mlake* "Mllakat" ishte në kufijtë e katundit Kërstec të Gorës, të cilët shkonin nga *Fusha e Borjes [...] deri tek një udhë që quhej *e Prizrenit* dhe

[555] Petar Skok, Iz srpsko-hrvatske toponomastike, Južnoslovenski filolog, VI, Beograd, 1926-1927, f. 88.

ngjitej me bjeshkët, kullotat e katundit Radesh; tjetra ishte jo larg nga katundi i sotëm Buzezë (në dokument: *bozovci*) i cili në vitin 1348 bëhej pronë e kishës bashkë me banorin *draica grъkovik** dhe e treta *ωt m'lačna* "nga Mllaka" në rrethina të katundeve të sotme Graxhenik e Nashec të periferisë së qytetit të Prizrenit. Në rastin e parë kemi të bëjmë pas gjithë gjasësh me një hapësirë në të cilën bie sot pikërisht katundi Mlikë i Gorës, ndërsa në të dytin me një kullotë tjetër e cila do të ketë qenë përreth katundit të sotëm Buzezë të Opojës. Kjo e dhënë do të tregonte se emri i mëvonshëm Mlikë i këtij katundi është tjetërsim i emrit të kryehershëm të bjeshkës *Mllaka*. Në të mirë të këtij paravendimi shkon edhe rrethana që askund në hapësirën e Gorës e të Opojës nuk ka sot ndonjë mikrotoponim **Mlikë*. Përkundrazi, ka shumë mikrotoponime të variantit *Mllakë*. Një kësi mikrotoponimi e gjejmë madje edhe në vetë katundin Mlikë. Më shumë mikrotoponime të kësaj prejardhjeje gjenden në krahinën shqipfolëse të Opojës: *Mllaka e Xhaferit* dhe *Mllaka e Danës* në katundin Blaç; *Mllaka e Madhe* e *Mllaka e Urumit* në Brodosanë; *Mllakat* në Buçje; *Mullaka Rrystemit* dhe *Mullaka Danës* në Kuk; *Mullaka e Doçit* në Kuklibeg; *Kroi Mullakës Madhe* në Pllajnik; *Mullaka e Bazës* në Pllavë; *Mullakat* në Rrenc; *Mullakat* në Shajne; *Mullaka pasulit* dhe *Mullaka Danës* (edhe) në Kosavë, ndërsa nëpër vendbanime të Gorës, mikrotoponime të kësaj prejardhjeje janë *Mlaka* në Lubovishtë, *Miajlova Mlaka* në Dikancë, *Sunčeve Mlake* në Lubovishtë, *Mlačice* në Glloboçicë, *Mlačišta/Mlačište* në Radesh dhe *Mlašica* në Dragash.[556]

Ndoshta pikërisht me katundin Mlika ka të bëjnë edhe dëshmia e vitit 1348 (shih orogjinalin) kur përmendet një vendbanim i quajtur *Mlačna* që ndodhej midis katundit të sotëm Ogragjenik/Grazhdanik dhe vendit Lotovci, ndoshta Landovica e sotme e Prizrenit.[557]

Emri i këtij katundi, në trajtën *Mllaçna*, do të jetë me prejardhje sllave. Në rrafshin gjuhësor del çështje e vështirë për t'u përcaktuar nëse ky emër do të jetë me prejardhje nga bullg. *mlaka* "vend i lagësht" apo nga serb. *mlaka* "vend i lagësht, ligatë". Në këtë kontekst bën të përmendet që emra vendesh të dalura nga kjo fjalë ndeshen në hapësirën gjuhësore të bullgarishtes. Khs. për këtë emrat e vendeve *Mlàžina padina*, *Mlakà*, *Mlakàta*, *Mlakète*, *Mlačkьin klàdenъc* dhe *Mlačkьino torìšte.*[558]

Nga të dhënat e mësipërme mësohet se tek emri i sotëm Mlikë i katundit të Gorës kemi të bëjmë me një bjeshkë (kullotë), emri i së cilës do të jetë sajuar në krye të herës nga emri *mllagë*, mllakë, *mullagë*, *mullakë* i barishtes Malva sylvestris apo nga emri i ndonjë specie: Althea officionalis; Arbutus andrachne; Quercus frainetto dhe Ostyra carpinifolia Scop. të drurit (emrat e sistematizimit

* Më gjerësisht khs. referencën 35 të kësaj trajtese.

[556] Sipas Dr. Jsuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 84, 88, 100, 104, 105,114, 117, 119, 121, 125, 127, 129, 134, 135, 137, 141.

[557] J. Osmani Vendbanimet e Kosovës 18, Prizreni, Prishtinë 2006, f. 158

[558] Sipas B. Simeonov, Etimologicen recnik na mestnite nazvanija od Godečko, Sofija, 1966, f. 188.

sipas Sh. Sejdiut:[559]) apo nga emri *mëllak,-u* i drurit të shpardhit (Quercus Frainetto Tem.) të dëshmuar (?) pikërisht vetëm për në rrethina të Kukësit dhe të Gjakovës (khs. mtp. *Ledina e Mllak's* në katundin Jabllanicë[560]) apo kemi të bëjmë me specien Ostrya Scop. të gjinisë së drurit të mëllezës[561] është punë që unë nuk po mundem t'i bie në fije për shkak të njohurive të mia fort të kufizuara nga lëmi i botanikës.

Sido që të jetë, sidomos në dritën e rrethanës që për emrin shqip *mëllagë, mullāgë* e mbase edhe për variantin *mllagë* bot. Malva officinalis; *mëllagë uji* bot. Althea officinalis propozohet prejardhja nga një gjuhë joinodoeuropiane nga e cila rrjedhin edhe greq. μαλάχη dhe lat. *malva* "mëllagë",[562] ka arsye të paravendohet që në rastin e variatit të dëshmuar më 1348 *Mllaka* të katundit të sotëm Mlikë dhe të mikrotoponimeve të dëshmuara në trajata të palatalizuara në *mlač, mlaš* nëpër katunde gorane (khs. më lart) dhe tek të gjitha mikrotoponimet, jo të pakta për nga numri e për nga shtrirja e tyre, kemi të bëjmë me emërtime të sajuara drejtpërdrejt nga emri shqip *mëllagë, mllagë, mullagë, mllak, mllakë* i drurit apo edhe nga varianti lokal *mëllezë* bot. Ostrya carpinifolia; Ostrya Scop. i drurit.

Në rastin e variantit më të ri *Mlikë*, nga **Mllakë* të oikonimit të Gorës kemi të bëjmë me emra të dy llojeve të drurit: *mllakë* e *mlikë*. Ky i fundit[563] shenjon nënllojin e drurit të pishës (bot. Pinus peuce Gris.) të quajtur shqip *arnen* që, pikërisht në krahinat e Pukës e të Tropojës gjallon në trajtat *mëlikë, mlikë, mërlikë* e *molikë*.

Orešek

Emri i katundit *Orešek* të Gorës është po ashtu me prejardhje bullgare. Ky emër i vendbanimit rrjedh nga varianti bullg. *oreh*, serb. *orah* "arrë". Sikur të ishte me prejardhje nga serbishtja, emri i këtij vendi do të duhej të dilte në trajtën *Orašak, *Orašje.

Sllup

Bashkë me emrin *Sllup* të katundit të rrethinave të Deçanit, ndër mikrotoponime sllave të vjetra të regjionit të Opojës bien edhe mikrotoponimet *Sllubet* në Brezne dhe *Sllubëza*, në Buçe të Opojës.[564] Bazë e këtyre emrave është fjala sllave **slop* e cila po si *słop* e si *słopiec* ndeshet në polonishten, ndërsa në çekishten si *slupec* në kuptimin e gjerm. Falle "rrëpinë, theqafë, rënie" *slupice* "rrëpina e drenit", khs. edhe emrin *Na Slupi*/*Ve Slupech* - të një pjese të

[559] Fjalorth etnobotanik i shqipes, Prishtinë, 1984, f. 146, 39.
[560] Khs. Prof. Skënder R. Hoxha, Toponimia e Dushkajës, Jakova, 2007, f. 127.
[561] Khs. Ilia Mitrushi, Drurët. .., f. 331, 360.
[562] Khs. për këtë E. Çabej, Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XIV, "Studime filologjike" 3/1964, f. 30.
[563] Sipas Ilia Mitrushi, Drurët dhe shkurret e Shqipërisë, Tiranë 195, f. 45.
[564] Të shënuara në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, f. 95, 100.

qytetit të Pragës. Në toponiminë e hapësirave gjuhësore të sllavishtes ky apelativ del edhe i zgjeruar me parafjalën *pry-*, përkatësisht *pri-* (khs. top. polake *Prysłop*, *Prisłopy*; *Pryzłop* dhe çek. *Přislop* me kuptimin "rrëpinë e thikshme e një shale të një mali të lartë". Ky apelativ sllav është bartur nga serbët ardhës edhe në toponiminë e Kosovës. Një dëshmi e depërtimit të këtij apelativi sllav edhe në hapësirën gjuhësore të gjermanishtes ndeshet tek toponimi *Schloppenhof* në kufirin e Bavarisë me Çekinë. [565]

Vraništ

Emër i sajuar nga apelativi sllav *vrana* i shpendit "korb", që ndeshet shpesh në hapësirat e banuara nga sllavët ardhacakë të Ballkanit.

Zapod

Një emër vendi i formësuar sllavisht nga ndajfolja *za* "përtej; pas" dhe apelativit *pod* "rrafsh; ultësirë".

Zli Potok

Emër sllav, në krye të herës i përroit të parë, me rastin e emërtimit nga elementi ardhacak sllavishtfolës, për si i rrëmbyeshëm, i rrezikshëm prandaj (edhe) *i keq*. Emri është sajuar pra nga mbiemri sllav **zao*, përkatësisht *zli* "i keq" dhe fjala sllave potok "përrua". Si i këtillë, ky emër është i tipit përshkrues, prandaj mund të jetë edhe i përkthyer. Por nuk kemi ndonjë dëshmi shkrimore që ky vend të jetë shënuar si **Prroni i Keq*.

11. SHTRESA TURKE (TEZA E PREJARDHJES TURKE TË GORANËVE)

Pjesëtarë të një grushti goranësh të kësaj trohe trualli ishull gjuhësor bullgarishtfolës të Kosovës e përqafojnë me ëndje edhe hipotezën e prejardhjes turke të tyre. Bazë e këtij besimi me nuancë propagande politike është teza e prejardhjes tyrkmene, përkatësisht kumane e peçenege e goranëve. Kjo tezë është elaboruar në kuadër të një projekti për studimin e etnisë, shoqërisë, kulturës e të folklorit të popujve që jetojnë në shtete të Europës nga të cilat u tërhoq Perandoria Otomane. Bartëse e këtij projekti qenka organizata "ndërkombëtare" turke për Prosperitet e Bashkëpunim (UKID: Uluslararasi Kalkinma ve Isbirligi Dernegi). Ky asociacion e organizoi në nëntor të vitit 2006 një ekspeditë kërkimore në Gorë. Me këtë rast këndej erdhën afër dhjetë profesorë të Universsitetit të Sakarjas (Sakarya Üniversitesi) me në krye prof. dr. Musa Taşdele. Rezultatet e këtyre kërkimeve u përmblodhën në dy libra të veçantë, të botuar nga kjo organizatë ndërkombëtare: *Gora Abidesi*, "Monument për Gorën" dhe *Kayip*

[565] Sh. Ferdinand Liewehr, Beiträge zur slavischen Ortsß- und Flussnamen, Franz Spina zum 65. Geburtstag, Zeitschrift für slavische Philologie, XI, Leipzig, 1934, f. 372-374.

Mirasin Izinde Gora Halk Sanatlari "Gjurmëve të trashëgimisë së zhdukur të popullit të Gorës".

Pikërisht këta dhjetë profesorë, tezën mbi prejardhjen turke të popullatës së Gorës e mbështetën tek "zbulimi" *pas disa shekujsh* i tyre që midis viktimave/dëshmorëve në betejën e Qanakalasë të rënë në mbrojtje të Perandorisë Otomane, paska pasur edhe pjesëmarrës kumanë e peçenegë të etnisë tyrkmene pikërisht (edhe) nga regjioni i sotëm i Gorës. Njëri nga profesorët turq (Ebu Bekir Sofuoglu) i këtij grupi të Universitetit në Sakarija thoshte se "duke i gjurmuar dëshmorët kosovarë në Qanakala, në Kosovë i gjetëm gjurmët e kumanëve e të peçenegëve të cilët nën komandën e sundimtarit selxhuk Alp Arslan në vitin 1071 (SG. sipas hixhrit) luftuan në betejën e quajtur e Malazgirt-it. Ky konstaton më tej se enigma ku jetonin kumanët e peçenegët që u sakrifikuan në këtë betejë, u zgjidh duke e parë që të dyja këto entitete tyrkmene do të jenë populli i quajtur *goran*, që sot jeton në jug të Kosovës, përkatësisht në Gorë. Një mbetje onomastike e ruajtur si dëshmi për vendosjen pas pushtimit osman-turk të ndonjë apo të më shumë bashkësive familjare kumane në hapësirën e Gorës do të ishte emri *Kumaničovci* i një vëllazërie gorane në katundin Shishtovec/Shishtojec të rrethinave të Kukësit, sado që autori S. Idrizi[566] ndoshta ngutas e mbante për emër aromun, përkatësisht vllah. Rrethana që islamizimi i goranëve ndodhi në hapësirën në të cilën këta jetojnë në një grusht toke midis hapësirave të banuara nga shqiptarët, tregon se nuk mund të jetë me vend dhe e pranueshme lidhja e kësaj popullate në kontekstin e islamizimit të popullatës trakase-vllahe të hapësirave të Bullgarisë e të Maqedonisë së sotme. Këtu kemi të bëjmë me fatin e njëjtë të një popullate në krye të herës josllave, të sllavizuar por të islamizuar në ambiente të ndryshme. Sado që për pomakët/torbeshët/goranët flitet për si një element etnik sllav të islamizuar, një gjë e qartë në rastin e pjesëtarëve të paktë të kësaj popullate të vendosur në hapësirat etnoglotologjike të shqiptarëve, është kjo që ajo vështirë se do të ketë ardhur këndej si e islamizuar. Si edhe popullata shqiptare në gjithë hapësirën e saj etnolinguistike, ajo do të jetë islamizuar disa shekuj pas ngulimit të saj në regjionin e Gorës. E pranueshme më duket edhe rrethana e konstatuar se islamizimi i bogumilëve të Ballkanit ishte mbase më shumë vullnetar se sa i dhunshëm. Së pari pse islamizmi ishte më afër doktrinës së tyre teologjike dhe së dyti pse si goranët, ashtu edhe ata pak pomakë, si edhe në hapësirën e tyre të kryehershme, zgjodhën për vendbanim të ri përsëri vise të izoluara malore, larg nga udhë të mëdha të frekuentueshme e nga fortifikime të tipit të qyteteve në të cilat, përkundrazi, u përqendruan masa të sjella me vete nga pushtuesit osmanë ushtarakësh e administratorësh. Po u nisëm nga rrethana që pjesa absolutisht më e madhe e xhamive, teqeve e ndonjë namazxhahu në krahinën e Gorës u ngritën kryesisht duke filluar nga shek. 17 (khs. më poshtë), do të mund të pohohej se popullata gorane u islamizua njëkohësisht kur ky proces po merrte këmbë edhe tek shqiptarët gjithandej. Në këtë proces, siç dihet nga të dhënat historike e

[566] Khs. punimin e tij Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

etnologjike, ishin përfshirë pothuaj se vetëm burrat. Këtu e gjen sqarimin edhe rrethana përse elemente të besimit e të jetës materiale paraislamike janë ruajtur kryesisht nga gratë.

Së këndejmi, në përcaktimin etnik të goranëve për si turq nuk luan kurrfarë roli as naiviteti i ndihmuar nga propaganda të ndryshme sipas të cilit "barazimi deri në vitin 1912 e më vonë i banorëve të Gorës në rrafshin etnik me turqit (khs. pyetjen retorike ndër goranë: *A si Turčin, a što si?* "A je turk a çka tjetër"*)* do ta përligjte ndonjë përkatësi etnike turke të goranëve. Më duket shumë i drejtë sqarimi i S. Idrizit[567] se ky identifikim lidhet para se gjithash me përkatësinë fetare dhe shenjon përkatësinë shtetërore të turqve. Kjo sepse qenia për pesë shekuj shtetas të Perandorisë Osmane e kishte zhvilluar ndjenjën që perandoria ishte për ta mburojë dhe faktor sigurie në relacion me pushtuesit e rinj. Rrethana që në Gorë pothuajse nuk ndeshet asnjë mikrotoponim i sajuar nga ndonjë apelativ turk tregon se goranët nuk e kanë folur kurrë gjuhën turke, prandaj edhe nuk mund të konsiderohen për të përkatësisë etnike e gjuhësore turke.

Shtresa onomastike orientale-turke, si shtresë më e re dhe e fundit gjuhësore onomastike e popullatës së këtij regjioni ka lënë edhe këtu, si pothuaj kurrkund në hapësira të banuara nga shqiptarët, krejt pak dëshmi emrash të vendbanimeve me prejardhje turke, përveç në aso rastesh kur toponimet e kësaj prejardhje janë me prejardhje nga antroponime orientale-turke të vendësve të islamizuar e shumë rrallë me prejardhje nga ndonjë apelativi oriental që vendësve u është dhënë nga pushteti osman-turk në bazë të profesionit që do ta kenë ushtruar vendësit e vendbanimit gjegjës, (khs. p.sh. emrin Shajne të vendbanimit të Gorës).

Shtresës osmane-turke të etnonimisë së banorëve të Gorës i takojnë emrat e vëllazërive: *Bajrovci* (në Lubovishtë), *Alitovci* e *Zejbekovci* (në Mlikë), *Šabanovci*, *Sulejmanovci* e *Musovci* (në Orçushë), *Hajdarovci*, *Muratovci* e *Ramadanovci* (në Glloboçicë); *Ramadanovci*, *Abdulovci* e *Mustafovci* (në Kërstec i V.), *Smajlovci* (në Kërstec i M.); *Jusufovci* e *Dervišovci* (në Bačkë), *Limanovci*, *Eminčevci*, *Fetiševci*, *Mamutovci*, *Ademčevci*, *Hadžinci* (në Zli Potok), *Balabanovci* e *Ibrovci* (në Rapçë), *Bajrovci* e *Arapovci* (në Restelicë) *Jusufovci*, *Dervishevci* (në Bačkë) dhe *Pelivanovci* (në Krushevë). Këta emra vëllazërish janë formuar nga emra goranësh të islamizuar: *Bajro* (trajtë e shkurtër e emrit Bajram), *Halit*; nga apelativi *zèjbek* që në krye të herës shenjonte një fis të vilajetit Ajdin të Azisë së Mesme, nga i cili u rekrutua një gjini fort e vjetër e ushtrisë së Perandorisë Osmane. Në këtë rast do të kishim të bënim me një popullim të qëllimshëm të pushtetit osman të këtij regjioni me shtetas "më pak të dhembshëm", mbase jo turq të mirëfilltë osmanë, siç ishin mbase edhe jurukët e pomakët, që po ashtu ishin sjellë në këtë zonë me qëllim osmanizimi, turqizimi të terrenit të pushtuar. Më pak e besueshme më duket mundësia e lidhjes së këtij etnonimi me emrin turk të një loje që, e mbarsur edhe me motive erotike, zhvillohej nga pjesëmarrës të gjinisë mashkullore e femërore); nga antroponimet

[567] Sadik Idrizi, Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k -.

orientale *Şaban, Syleyman, Musa* [trajtë orientale e emrit hebreit Moisse], *Haydar, Murat, Ramadan, Abdyl, Mustafa, Ismail, Jusuf*, emrit *deriviş* të sektit, të emrave *Emin, Feti, Mahmud / Mahmut, Adem*; të antroponimit *Haxhi* që shenjonte atë që e dëshironte apo e kishte përmbushur detyrimin e pelegrinazhit në Mekë dhe të një emri që mund të ketë lidhje me ndonjë familje që e kishte apo e kishte trilluar ndonjë lidhje me popullatën jo osmane, arabe.

Pejzazhi i kësaj shtrese gjuhësore të etnonimisë së banorëve të Gorës e pasqyron vetëm të vërtetën historike të ditur gjithandej të islamizimit të kësaj popullate në atdheun e dytë të saj, ku kjo popullatë ishte ardhur disa shekuj më parë dhe që, në këtë rrafsh, e pati të njëjtin fat si edhe pjesa më e madhe e popullatës shqiptare përreth hapësirës që e zinin pararendësit dhe goranët e sotëm. Një fakt që duhet vërejtur këtu është ai që emrat osmanë-turq të vëllazërive të goranëve janë zgjeruar me prapashtesa sllave. Edhe kjo veçori e emrave tregon se goranët ishin edhe në shek. XVII-XVIII, përkatësisht në kohën që merret për si periudhë e islamizimit të saj, folës të bullgarishtes.

Duket se me prejardhje turke do të jetë edhe emri *Kečaćevci*, i një vëllazërie të katundit Brod të Gorës. Edhe përkundër rrethanës që në krisobulat e Deçanit të vitit 1330 dëshmohet mikrotoponimi *Bankećjeve glade* dhe në një burim tjetër kishtar serb edhe një antroponim *Kečedža*, mua më duket më e drejtë që tek emri i kësaj vëllazërie të kërkohet apelativi *kеč*, shm. *kečeta*, "kapelë e bardhë prej leshi të lënurur që e bëjnë shqiptarët; kapelë nga lëkura e regjur e bagëtisë" me prejardhje nga turq. *keçe*[568] me të cilin në të folmen lokale sllave shenjohet plisi, qeleshja - kapela nacionale e shqiptarëve. Në këtë rast, vështruar edhe në rrafshin jashtëgjuhësor, do të kishim të bënim me njerëz, vëllazëri që e mbanin kapelën shqiptare, plisin

Si rrethanën që krahinat e Gorës e të Opojës ishin qysh nga lashtësia e mugët zona blegtorale, të banuara rrallë dhe nga shoqëri larg nga ndikimi i të gjitha pushteteve e kishave në antikë e në mesjetë si edhe islamizimin e tyre masiv e tregon edhe numri i paktë i dëshmive materiale të lashta të jetës kulturore e shpirtërore të banorëve të këtyre hapësirave.

Duke u mbështetur mbi analizën e hollëshme kompetente të gjendjes në hapësirën e komunës aktuale të Dragashit (e cila përfshin më vete pra vendbanimet e Gorës dhe të Opojës përbrenda shtetit të Kosovës) të dhënë nga studiuesi (që një kohë ishte edhe kryetar i kësaj komune) H. Meleqi[569] mësohet që në hapësirën që zë kjo komunë sot dihet vetëm për një tumë parahistorike në katundin shqiptar Zaplugjë të Opojës dhe për një misar (*lter*?) antik në katundin Krushevë të Gorës; që gërmadha fortifikatash (kalash) mesjetare paska në katundet Zinovë (Bellobrad) e Bresanë/Brodosanë të Opojës; dhe që në katundin Kosavë të Opojës paska një gërmadhë manastiri mesjetar.

[568] Khs. Abdulah Škaljić, Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku, Sarajevo, 1966, f. 404-405.

[569] Hajriz Meleqi: http:/www /komuna-dragash.org/shqip/images/Analiza-Hapsinore.pdf., përkatësisht Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i Qeverisë së Kosovës, Instituti për Planifikim Hapësinor, Kuvendi komunal - Dragash, Nëntor, 2006, f. 19.

Pjesa dërmuese absolute e monumenteve të kultit në këtë hapësirë janë dy xhami të shek. 16: në katundet Shajne e Buzezë të Opojës; xhami të ngritura në shek. XVIII në katundet Bresanë / Brodosanë, Zgatar dhe njëra nga dy xhamitë e katundit Kapre të Opojës. Të shek. 19 qenkan xhamitë e ngritura në katundet: Brrut, Zapluxhë, Kosavë, Bellobrad, Zym e Blaç, ndërsa të shek. XX qenkan xhamitë e ngritura në katundet Kapre, Rrenc, Xerxë e Pllajnik të krahinës shqiptare të Opojës. Nën ndikimin e dervishëve nga qyteti i Prizrenit edhe në Gorë (në katundet Brod, Restelicë, Radesh, Zlipotok e në ndonjë tjetër) vepronin në fillim të shek. XX *tarikate* "rreguj", dervishësh përkatësisht kishte "shehë, shehlerë"[570] ashtu si edhe në Opojë (në Blaç, Pllajnik e në ndonjë vendbanim tjetër). Përkundër mendimit të S. Idrizit, tyrbet e pranishme në këto hapësira, autorë të tjerë i mbajnë për të ngritura në shek. XIX. Nëpër vendbanime të krahinës së Gorës xhami të ngritura në shek. XIX ka në katundet: Mlikë, Restelicë, Zlipotok, Krushë, Radesh, Lubevisht, Kukajan, Leshtan, Rapçë, Kuk, ndërsa në katundet Rapçë e Brod paska edhe nga një tyrbe, të gjitha të ngritura në shek. 19. Në katundin Buzezë qenka një namazgjah i shek. XVI dhe në katundin Bellobrad një dërstilë e shek. XIX * dhe, së fundi, në Orçushë të Gorës edhe një objekt i shek. XIX.

Duke u mbështetur në defterë osmanë-turq të regjistrimit të popullsisë, S.Idrizi e nxjerr përfundimin që procesi i islamizimit të popullatës së Gorës paska "filluar në vitin 1559 e vazhdoi deri në vitin 1579 dhe deri në fund të shek. XVI"[571] Depërtimin vonë të konfesionit islam në krahinat e Opojës dhe të Gorës e dëshmon tërthorazi edhe rrethana që xhami nuk u ngritën, siç ishte pothuajse rregull, së pari nëpër kështjella e më pastaj edhe në vendbanime jashtë mureve të kështjellave/kalave ndoshta pse në këto krahina, duke qenë zona thjesht blegtorale, nuk kishte ngriturina të tilla, apo pse besimi islam u përhap këndej, megjithmend, shumë më vonë se në qendra urbane të mirëfillta. Por kohëve të fundit janë sjellë të dhëna sipas të cilave xhamia e kryehershme e katundit Mlikë qenka ngritur nga anëtarë të familjes arabe "Al Aga" të cilët në këtë katund paskan ardhur nga qyteti Halep (Alepo) i Sirisë brenda harkut kohor 1205-1291 dhe e paskan ngritur edhe xhaminë e këtij katundi. Autori i shkrimit përkitazi me këtë xhami, pandeh që kjo do të jetë ngritur 100 vite para Betejës së Kosovës, përkatësisht 170 vite para pushtimit të Prizrenit nga Perandoria Osmane. Kjo xhami nuk qenka ruajtur në formën e saj të kryehershme, sepse këtë objekt e përpinë flakët e rastësishme në vitin 1822-1823, me ç'rast qenkan djegur

[570] Sipas Sadik Idrizi Aljabak: Gora – Jedan Pogled unazaD (dorëshkrim)

* Sado që në mikrotoponiminë aktuale të këtij katundi nuk ka ndonjë dëshmi për këtë dërstilë. Përkundrazi, një mikrotoponim që e ruan kujtimin për ekzistimin e një dërstile/valavice është në katundin Brodosanë, ku është ruajtur mikrotoponimi *Valavica*, i shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, f. 89.

[571] Khs. Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

edhe dokumente, libra e edhe vetë tapia e xhamisë. Mbi themelet e saj u ngrit xhamia e sotme - thotë autori Parim Kosova.[572]

Këto të dhëna po u përligjkan mbi bazën e një mbishkrimi arabisht në rrasë guri e murosur në minaren e xhamisë së katundit, në të djathtë të hyrjes. Teksti i përkthyer i këtij mbishkrimi është: "Këtë xhami ndër më të bukurat e rindërtoi Ahmet aga në vitin 1268, ashtu siç ishte ndërtuar në vitin 688 sipas hixhrit.



Mbishkrimi në xhaminë e Mlikës[*]

[572] Khs. punimin e tij Faltorja e familjeve të shpërngulura myslimane arabe në "Koha Ditore", 14 maj 2008, f. 25. Në oborrin e kësaj xhamie, përreth tyrbes së rrënuar, paska, sipas J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, f. 121 disa mbishkrime mbivarrore me dekorin e "Yllit të Davidit".

[*] Huazuar nga F:\magazin\images\pz\ploca-mljike.jpg.

Pyetjes së shtruar nga shumë autorë si u bë që në Gorë të ketë xhami shumë kohë para ardhjes së osmanëve në Ballkan i përgjigjen në bazë të traditës gojore dhe të dokumenteve ashtu që gjatë kohës së kryqëzatave në hapësirat e rrjedhës së poshtme të Vardarit e më vonë edhe në Gorë paska ardhur një numër i madh refugjatësh, kryesisht mjeshtër, zanatlinj, nga Siria. Kujtimi për këta refugjatë po u ruajtka edhe sot tek mbiemri *Halepovci* (Aljabakovci) në katundet Mlikë, Krushevë, Dragash e Restelicë e edhe në qytetin e Prizrenit ku këta qenkan farkëtarë e zanatlinj, gjë që po e vërtetuaka paravendimin se ardhësit paskan qenë nga qyteti Halep i Sirisë.



Faksimili i letrës nga Damasku

Dëshmi për këtë tezë të autorit tonë është një letër nga Damasku që ky e ka marrë në vitin 1995 nga ministria e vakëfeve e Republikës Arabe të Sirisë, me tekstin: "Ne, zyra e Miftarit e qarkut të Halepit, në Republikën Arabe të Sirisë, vërtetojmë se Al-Aga është një familje e fortë dhe e vjetër disa pjesëtarë të së cilës u shpërngulën në vitin 1095, shpërngulje kjo që vazhdoi deri në vitin 1291. Këta (pjesëtarë të kësaj familjeje) e ngritën në vitin 1291 xhaminë në katundin e tyre të Mlikës që kjo (xhamia) t'u shërbejë për mbajtjen e ceremonive fetare. Nga sa u tha më lart, kjo xhami është megjithmend pronë e këtyre familjeve, përkatësisht e familjeve myslimane arabe të shpërngulura dhe nuk bie ndër ngriturina osmane. Ne e vërtetojmë me këtë pronësinë e tyre dhe lusim zyrtarët kompetentë që t'u dalin në ndihmë atyre (familjeve)" Pasojnë vula dhe nënshkrimet

Gjurmuesi M. Qaflleshi e vë në dyshim korrektësinë e përkthimit të tekstit në mbishkrimin në xhaminë e Mlikës. Sipas këtij, eksperti i osmanishtes Nehat Krasniqi këtë mbishkrim e lexon si: "Këtë xhami të nderuar e ka rinovuar, me pasuri të fituar në mënyrë të lejueshme (hallall), Ahmed Aga, Zoti e mëshiroftë, në vitin 1238" sipas hixhrit, përkatësisht 1822 sipas kalendarit tonë. M. Qaflleshi paravendon se fjala e palexueshme në këtë mbishkrim mund të jetë: "ishte kishë në vitin 688", [573] përkatësisht 1289.

Ndryshe e shihte këtë punë vetëm dy vite më parë J. Osmani, i cili kujtonte se është interesante-e çuditshme që kjo xhami të mund të jetë ndërtuar në vitin 1353. Kjo punë mund të ketë ndodhur, sipas këtij autori, vetëm nëse kemi të bëjmë me ndonjë islamizim lokal përmes misionarësh apo ndoshta që ajo pllakë (khs. fusnotën e mëposhtme) mund të jetë sjellë prej dika tjetër dhe, ndoshta, ajo edhe mund të mos jetë lexuar korrekt.[574] Megjithëse nuk kam kompetenca profesionale ta vlerësoj korrektësinë e këtij "zbulimi", ia lejoj vetes të shfaq mendimin se as ky punim nuk është shumë larg nga shkrime me vëllim jo të vogël prej sensacioni e pra edhe kapërcim mbi realitetin historik. I kësaj natyre në këtë kontekst më duket edhe mendimi i J. Osmanit përkitazi me organizimin kishtar në hapësirën e Opojës, Gorës, Sreckës dhe të Malësisë së Tetovës. Pasi e sjell konstatimin e murgut Brocardus i cili s'ka të bëjë as edhe një fije me këto hapësira, autori ynë e nxjerr konstatimin se, si pasojë e pushtimeve bullgare e serbe, "*Qendra* kishtare *shqiptare* (nënvizime të miat) në Ulinë (SG: Kosavë), e cila tubonte pranë vetes të gjitha kishat e Opojës, Gorës, Sredskajve dhe një pjesë të fshatrave të rrethinës së Tetovës u la pas dore, si dhe shtresa e ngritur feudale shqiptare për t'u favorizuar ajo skizmatike në mënyrë që përmes saj të bëhet sllavizimi i kësaj treve të pastër iliro-shqiptare, u bë ndërrimi i dhunshëm i emrave të banorëve, mikro- dhe makrotoponomisë".[575] Komponentja myslimane, si formë rezistence e goranëve për të mos u deklaruar shqiptarë, apo pjesëtarë të ndonjë etnie tjetër, sado që ka një grusht të tillë që deklarohen për serbë, maqedonas, turq, të papërcaktuar etj., bënë që goranët të jenë entitet shumë i lakmueshëm, i gatshëm edhe ky vetë të bie nën ndikimin e politikave të ditës. Kjo shihet më së miri kohëve të fundit kur kjo popullatë, e ngopur nga propagandat bullgare, maqedone e serbe po deklarohet për boshnjake. Në këtë kontekst krerë lojalë, më së shumti mësues, të hutuar

[573] Muharrem Qafleshi, Gjurmët historike të Opojës autoktone dhe goranëve të Gorës, në http://ojq-qendra.webs.com/historikuiopojsdheg.htm.
[574] Khs. J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 121.
[575] Khs. Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 21.

të goranëve shfrytëzojnë edhe kundër njëri-tjetrit privilegje të pritura p.sh. nga Bullgaria për marrjen e vizave të BE-së, së cilës po i konkuron qeveria e Maqedonisë e cila në *katundin* (nënvizim i imi) Brod e hapi[576] në maj të vitit 2008 madje një zyrë të veten edhe formimin në perspektivën iluzore të një shteti të madh të myslimanëve në Ballkan, i cili nën patronatin e Bosnjës do të përfshinte Bosnjën, Sanxhakun, pjesët myslimane e boshnjake dhe shqiptare të Malit të Zi, gjithë Shqipërinë, Kosovën e pjesën shqiptare të Maqedonisë.

12. SHTRESA SHQIPE

Sa i bie elementit onomastik shqiptar në regjionin e Gorës duhet të vërehet që në fillim se këtu nuk kemi të bëjmë me *ndikim* të shqipes e të folësve të saj, porse me mbetje substratike të përbashkëta nga kohë më të lashta, përkatësisht pjesërisht nga periudha e bashkëjetesës midis pararendësve vendës parasllavë të paromanizuar dhe të atyre të romanizuar. Sikundër e tregojnë disa emra vendesh të origjinës nga latiniteti ballkanik (khs. shq. *Shtatul* - sllav. *Statulj*); elementet e përbashkëta nga romaniteti ballkanik, përkatësisht vllah (khs. sa për shembull emrat e vëllazërive shq. *Ququrët* - sllav. *Čućulovci*; shq. [*]*Ursulaj* - sllav. *Ursulovci* e ndonjë tjetër); mikrotoponimet e ngjashme tek të dy entitetet e sotme me prejardhje nga bizantinishtja, përkatësisht nga greqishtja e mesme si edhe elemente të përbashkëta të shtresës sllave, të cilat në këto zona, në pjesën më të madhe të tyre, u sollën nga vlleht e bullgarizuar të ardhur në hapësirën e sotme të Gorës.

12.1. Emra vendbanimesh

Premta/Premja

Emër i një vendbanimi të Gorës, që sot nuk njihet më me këtë emër. Përmendet së pari në defterin osman-turk të regjistrimit të kryefamiljarëve të vitit 1451-1452, kur është shënuar si *Premta* (me 24 shtëpi); në atë vitit 1530 si *Premija* (me 26 shtëpi), ndërsa në defterin e vitit 1571 përsëri si *Premta.* Më 1451-1452 del të ketë qenë pjesë e katundit (po ashtu sot të panjohur), *Hotonova,* ndërsa më 1571 për si vendbanim më vete. Në vitin 1451-1452, banorët e katundit *Premta* mbanin antroponime thjesht serbe, porse midis tyre kishte edhe dy kryefamiljarë që mbanin emra shqip: *Mitogjin*[*]-i e *Spanko* dhe një tjetër

[576] Sipas Sadik Idrizi Aljabak, Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[*] Ka arsye të besohet që emri i këtij kryefamiljari (i cili mund ta ketë pasur për mbiemër emrin e vëllazërisë që i takonte) të jetë në lidhje me emrin e evidentuar si *Migjon* të një

që mbante emrin tipik për vllehtë *Bukur*. Në këtë katund nuk kishte asokohe ndonjë kryefamiljar që do të mbante emrin shqip *Premt*. Kësi antroponimi mbante porse banori *Premt Ali*-u i po këtij katundi të regjistruar në vitin 1571. Një dëshmi tjetër më e moçme se kjo e vitit 1571 që tregon se ndër banorë të hapësirës së Malësisë së Tetovës e pra edhe të atyre të Opojës e të Gorës ishte në përdorim antroponimi Premt, e kemi tek patronimi *Premović* i kryefamiljarit Bogdan të katundit Vejce, që paska qenë në veriperëndim të Tetovës, sipër katundit Staro Selo.[576a] [

Meqë nuk ka ndonjë dëshmi se në kuadër të katundit të zhdukur Hotonova do të ketë pasur ndonjë lagje/vëllazëri *Premta*, për prejardhjen e emrit *Premta* të vendbanimit të zhdukur mund të flitet me më shumë siguri kur ky (më 1571) del të jetë evidentuar për venbanim më vete me po këtë emër. Një mundësi e vagullt e sqarimit të prejardhjes së këtij emri do të ishte lidhja e këtij me atroponimin Premt i cili ka mundur të jetë emër vëllazërie dhe si rrjedhojë e toponimizimit të emrit shqip *Premt* apo emrit të vëllazërisë, të ketë përfunduar si emër vendbanimi.

Mirëpo, rrethana që emri në trajtën e dëshmuar *Premta* nuk është zgjeruar me ndonjë prapashtesë që emërton një kolektivitet tregon se këtu nuk kemi të bëjmë me ndonjë emër vëllazërie. Fundja ndonjë vëllazëri që do ta mbante antroponimin *Premt* as nuk është dëshmuar e as nuk ekziston sot as ndër goranë e as ndër opojarë. Së këndejmi, lidhja e këtij emri me antroponimin *Pren* duket jo mjaft bindëse. Një mundësi tjetër, po ashtu e vagullt, do të ishte lidhja e këtij toponimi me ndonjë kishë e cila do ta kishte mbajtur emrin e Shna Pren(d)es, sado që s'ka dëshmi shkrimore se do të ketë ekzistuar ndonjë e tillë, sado që në vendbanim kishte jo një por 3 priftërinj. Një *kishë e Shna Prenes* (origj. Sveta Petka) ishte në vitin 1348 në kufi të katundit Sreckë, në vendin ku fillonte kufiri me bjeshkën e atij katundi. khs. tekstin: "Katundi Sreckë me bjeshkën, ndërsa mexha e tij me Planejën kisha e Shna Prenes dhe nga kisha drejt lugut n'përrue përmjet Kodrës te Guri Bletës dhe nëpër *Elbishtë (origj. ošlak) majës e deri te kufini i Selcës, ndërsa nga Shna Prenja udhës që shkon për në *Pojata (origj. živinjan) e te kufini i

katundi të krahinës së Gorës, të evidentuar në defterin e vitit 1530, khs. J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20 Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 158.

[576a] Metodija Sokoloski, & Aleksandar Stojanovski Dr., (red.), Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod, Opšien popisen defter Nr. 4 (1467-1468), Shkup, 1971, f. 373.

Reçanit."[576b] (Vendi Reçan ka të bëjë me katundin e sotëm Reçan të rrethinave të Prizrenit, të banuar nga torbeshë, që tani kanë nisur ta quajnë veten "boshnjakë").

Në përmbyllje, ka arsye të paravendohet që varianti *Premija* i emrit të këtij vendbanimi apo vëllazërie të jetë rezultat i evidentimit jo korrekt të regjistruesit osman-turk apo sllavishtfolës.

12.2. Mikrotoponime

Brinja

Ky emër vendi i katundit Rapçë të Gorës rrjedh nga fjala *brinj* "shpat, brinj mali" e shqipes.

Gos

Duket se emri i këtij vendi në katundin Glloboçicë të Gorës nuk mund të largohet nga fjala *gosë*,-a "ujë amull; kënetë" e shqipes.

Gurelj

Njërin ndër emra shqip të vendeve ose emra, që në trajta çfare i kanë sot, kanë dalur në harmoni me ligjet fonetike të gjuhës shqipe, e konsideroj edhe emrin *Gurelj* të mahallës në katundin Restelicë të Gorës I të njëjtit burim do të jetë edhe emri *Gurrence* i një vendi në katundin shqiptar Pllajnik të Opojës.[577] Në dritën e rrethanës që në katundin Voioz të Rumanisë del emri i vendit *Prigurel*[578] lejohet të mendohet se ose etimologjia jonë mund të mos jetë e drejtë ose që toponimi rumun do të jetë me prejardhje shqipe nga fjala shqipe *gurr/ë, -a* "burim; krua" e zgjeruar me prapashtesën romane *-el*.

Karpa

Mikrotoponime të prejardhjes shqipe të krahinës së Gorës janë edhe: *Gazine Karpe* "Karpat e Gaz'it" dhe *Karpišta* në katundin Brod dhe *Karpa*, vend në katundin Glloboçicë, *Karpa* në Rapçë të Epërme, *Karpa* në Restelicë, *Karpe* në Radesh, *Ramne karpe* në Zli Potok, *Potkarpe* në Leshtan etj. të Gorës, të cilat janë të së njëjtës prejardhje (shqipe) si edhe mikrotoponimet e katundeve shqiptare *Karpi* në Brodosanë, *Karpa* në

[576b] Khs. origjinalin tek Hrisovulja …, f. 280.

[577] Të shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 125, 132.

[578] Khs. M. Oroş, Din Toponimia vaii Bistrei (judetul Bihor), në Studi şi materiale de onomastica, Bucarest 1969, f. 193.

Kuk(ël) dhe *Karpa* në Shajne të krahinës së Opojës.[579] Të gjithë këta emra janë sajuar nga fjala shqipe *karpë,-a* "shkëmb". Nga kjo fjalë e heq prejardhjen edhe emri *Karpać* i një familjeje/vëllazërie në katundin Brod të Gorës.[580] Ky sqarim duket se bëhet i besueshëm në dritën e rrethanës që gjithandej në të folmen sllave të Gorës po gjalluaka edhe fjala *karpa*, të cilën S. Idrizi[581] e sheh për si ndikim të shqipes në këtë të folme. Duke u mbështetur tek sqarimi pothuaj se i pakontestueshëm sipas të cilit edhe vetë emri i maleve të Karpateve, njëri nga viset e banuara me vllehë po mundka të sqarohet me fjalën e vjetër shqipe *karpë* "shkëmb", mbase do të mund të mbrohej mendimi që elementi etnik roman i bullgarizuar ardhës këtë fjalë apo vetë emrin e vendit e gjeti përkatësisht e huazoi në vend nga banorët e stërlashtë shqipfolës të kësaj hapësire apo që, për si pjesë të fondit "substratik" e solli me vete. Në këtë rast do të lejohej edhe mundësia që ky toponim të lidhet me emrin rumun *cárpen* të drurit *carpinus betulus* shq. "ah i bardhë; shkozë; kaçë", i cili po në këtë trajtë dëshmohet edhe në arumanishten dhe në meglenorumanishten prej kah, nga trajta *carpeniş,* rrjedh edhe emri i vendit Καρπενήσί që për në hapësira të Greqisë mbase dëshmohet që tek Ana Komnena[582] në shek. 11.

Murga/Murgan

Me prejardhje apelative shqipe është edhe oronimi *Murga/Murgan* i Orçushës, i cili rrjedh nga fjala shqipe *murg,-u* e cila përveç kuptimit të murgut i ka edhe kuptimet "i errët, i zi, i përhimët; i pikëlluar". Ka mendime se kjo fjalë e shqipes është një relikt lashtoballkanik, ndoshta me origjinë ilire.[583] Kjo fjalë është në shqipen më e vjetër se latinizma *murg* dhe tek kjo latinizëm, në kuptimin *murg* (i, e) "errët, zi, zezë" kemi të bëjmë mbase me një fjalë të hyrë më vonë nga latinishtja. Kjo fjalë e shqipes, sipas E. Çabej, ka hyrë edhe në vetë latinishten në trajtat *amurcus/amurgus*. Përmes shqipes kjo fjalë do të ketë depërtuar edhe në sllavishten, ku ndeshet në trajtat *mrk/mrko* "i errët, i murrëm, i zi".[584] Sipas H. Barić në trajtën *murg* "ngjyrë gështenje; i murrmë" kjo fjalë ka

[579] Të shënuara në terren nga Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë 2006, f. 8, 90, 92, 105, 112, 114, 135.

[580] Të shënuar në terren nga S. Idrizi, Aljabak: Aromunski-vlaški tragovi u Gori …

[581] Sipas Sadik Idrizi Aljabak: Gora - Jedan Pogled Unazad (dorëshkrim).

[582] Khs. Max Vasmer, Zur Ortsnamenkunde der Balkanländer, zeitschrift für Slavistik 18, 1942, f. 384-387.

[583] Khs. Georgi Šoptrajanov, Amurca, murga, murg vo romanskite i balkanskite jazici - od romanskata i balkanskata lingvistika, patronimika i toponomastika, Godišnjak, vëll. I, Balkanološki Institut, Sarajveo, 1957, fq 118.

[584] Khs. edhe E. Çabej, Studime gjuhësore II, Prishtinë 1977, f. 358.

hyrë edhe në rumanishten dhe në trajtën *murgo* "i zi, zijosh" ka hyrë edhe në bullgarishten,[585] ndërsa I. Petkanov këtë fjalë, për si albanizëm, e gjen edhe në rumanishten në trajtat *amurg* fr. "brune", *amurgul* a cupiri huara fr. "la brune couvrit le village" *murg* fr. "gris, brun". Me fjalën *murg*, sipas Petkanov-it arumunët i quajnë rëndom kuajt dhe qentë e murrëm. Mbi bazën e origjinës shqipe të kësaj fjale, Petkanov për emërtime shqiptare i konsideron 1. emrin e një pjese të masivit malor të Malit Ballkan të quajtur *Murgaš* 2. emrin *Murgaš* që e mban një katund afër Carigrad-it / sot Dimitrovgrad (në Bullgari); 3. emrin e një katundi *Murgaš* në rrethina të Kumanovës (në Maqedoni); 4. emrin e katundit *Murgaš* afër Valjevo-s (në Serbi); 5. emrin e malit *Murgaš* në krahinën e Vasojeviqëve (në Mal të Zi) etj. Petkanov konstaton se emrat e dalë nga fjala shqipe *murg* dëshmohen kryesisht në hapësirën gjuhësore të gjuhës shqipe. Kjo hapësirë përfshin sipas tij territoret që nga qyteti i Nishit e deri në Danub nga Sofia deri në Adriatik, territor që Petkanov e sheh si [...] "bastion d`Albanité et de Romanité".[586] Një gjuhëtar tjetër bullgar dhe pikërisht B. Simeonov e konsideron fjalën *murg* për të substratit ballkanik dhe së këndejmi e gjen këtë në emrin e katundit *Murgaš* në rrethina të Sofjes, në komunën e Godeč-it dhe në Karpate.[587] Ndryshe mendojnë G. Weigand[588] e I. Scărlatoiu.[589] Me prejardhje nga kjo fjalë e shqipes janë, sipas mendimit tim, edhe emrat e katundeve kosovare *Murga* në komunën e Skënderajt dhe *Murgulla* në komunën e Podujevës. Se tek emri i malit të Gorës kemi të bëjmë me një emër vendi i cili është emërtuar shqip nga ngjyra e errët që ka ky mal, mbase e tregon edhe rrethana se në katundin Brod të Gorës kemi malin e quajtur Mavra, emri i të cilit s'ka si të mos ketë dalë nga mbiemri greqisht "i zi" (> gr. μαυρος), por që mund të jetë edhe përkthim grek i emrit më të vjetër Murga.

Këtu do të duhej të hynte edhe emri *Murgash* i një bjeshke, kullote në Bjeshkët e Nemuna në verilindje të Moknës; i zgjeruar me prapashtesën -*ash*[590] emri *Murgiq* i një livadhi "Paklen" në Bjeshkët e Nemuna, në

[585] Sh. Albano-rumänische Studien I, Sarajevo 1919, f. 154.

[586] Sh. Les éléments romans dans les langues balkaniques, Linguistique et Philologie romane, XI congres international des sciences onomastiques, 2, Sofia 1975, f. 128.

[587] Sh. Vaprosu o substratnih frakiiskih elementah v bolgarskom jezike, THRACIA, Primus congressus studiorum thracicorum, Serdicae, f. 322.

[588] Khs. Rumänen und Aromunen in Bulgarien, Leipzig 1907, f. 44.

[589] Sh. Romanian elements in macedonian and serbocroatian, Revue des études sud - est européennes, XII (2), 1979.

[590] Për shtrirjen, funksionin dhe prejardhjen e kësaj prapashtese sh. Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani - Prof. Eqrem Çabej, Prapashtesat e Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1962, f. 22-23.

veriperëndim të Pejës[591] dhe *Murgjelovica*, një emër tjetër i shkëmbit të lartë që popullata serbe po e quajka *Troićki krš*, në Suhogerllë të Istogut.[592]

Muridža/ Murixha

Me prejardhje shqipe duket të jenë edhe mikrotonimet *Tumba*, vend në katundin Zli Potok dhe *Muridža*, livadhe në katundin Brod të Gorës.[593] Emri i parë rrjedh nga fjala shqipe, me prejardhje nga latinishtja, *tumbë*/ *tumë*, ndërsa i dyti mund të rrjedh nga emri shqip *murriz/morriz*[594] i shkurres bot. Cartaegus orientalis, të cilin e gjejmë tek mikrotoponimet *Morrizi* në Pllavë dhe *Morrizos* në Pllajnik[595] të Opojës. Së këndejmi, unë nuk mund ta pranoj për të drejtë mendimin e shfaqur nga dijetarë serbë e të pranuar nga sish boshnjakë se emri *Muridža* na qenka me prejardhje vllahe.

Duke u mbështetur tek sqarimi pothuajse i pakontestueshëm sipas të cilit edhe vetë malet e Karpateve po mundkan të sqarohen me fjalën shqipe *karpë* mbase do të mund të mbrohej mendimi se elementi etnik roman i bullgarizuar e gjeti këtë fjalë dhe e huazoi në vend nga banorët e stërlashtë shqipfolës të kësaj hapësire.

Si rezultat i ndërmjetësimit të shqipes mund të trajtohen edhe toponimet *Osuje* dhe *Prisuje* (në Kërstec dhe në Radesh të Gorës). Tek këto toponime duhet gjetur trajtën shqipe *osue* të zgjeruar me prapashtesën sllave *-je* të sllavizmës[596] *osoj* të shqipes. Kjo fjalë e sllavishtes ka depërtuar pothuaj në të gjitha të folmet shqipe, ndërsa në të folmen e Opojës del pikërisht në trajtën *osue*. Prandaj ky ndërmjetësim i shqipes duhet të shihet tek oronimi *Osuje* i Gorës, i cili tregon në vija më të largëta se opojarë e goranë bashkëjetonin dhe në mos e kishin folur të njëjtën gjuhë si ajo me ndërmjetësimin e së cilës ka arritur trajta *Osue* e emrit të këtij mali, këta të fundit do ta kenë marrë këtë emër nga goja e shqipfolësve.

[591] Të shënuar në terren nga Alija Đogović, Toponimija jugoslovenskog dela Prokletija (I Deo), Onomatološki prilozi, IV, SANU, Beograd, 1983, f. 296, 317,

[592] Të shënuar në terren nga Svetozar Stijović: Onomastika Istoćkog dela Metohijskog (Pećkog) Podgora, Onomatološki prillozi I, SANU. Beograd 1979 f. 354.

[593] Të shënuara në terren nga J. Osmani, poaty, f. 112, 92.

[594] Hollësisht, për etimologjinë (shqipe) të kësaj fjale khs. E. Çabej, Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe, XIV, Studime filologjike 3/1964, f. 46-47.

[595] J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f.,125, 127.

[596] Sipas Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë 1984, f. 631.

Këtu bien edhe mikrotoponimet *Golemi Pažić* në Rapçë dhe shumë mikrotoponime *Pazhik* në katunde të Opojës (khs. p.sh. Pazhiku, mtp. në Blaç). Pjesa determinuese *pažić* është një formë e palatalizuar e apelativit të shqipes *pazhik* (nga sllav. *pozitь* "livadh; bar".[597] Mikrotoponimi *Logovački potok* ta përkujton një emër të formuar sipas frymës së shqipes **Prroni i logut*, sado që apelativi *log,-u*, m., shm. *logje, -t* "lëndinë e vogël (rëndom në mal ose midis pyllit); vend i vogël e i rrafshtë" është po ashtu një sllavizëm e shqipes (khs. sllav. kishtare *log* lat. "nemus, silva"; serb. *lug*, maq. *lag*, bullg. *lъg* (*ът*) rus. *lug*, pol. *luga*, ukr. *luh* gen. *luhu*, br. *lug*, p. *lag*, *leg*, g. *legu*, c. sllav. e vj. *luh -u*, luzh. *lenge* "vend i rrafshtë").që i sjell F. Bezlaj.[598] Formimin *Logovački potok* nuk e marr për si mkrotoponim të formuar nga ndonjë popullatë sllave gorane së pari pse në asnjë nga gjuhë moderne sllave të jugut nuk gjendet fjala në trajtën *log* (sh. më lart) dhe së dyti, pse sikur ky vend të ishte emërtuar nga sllavishtfolësit do të duhej që ky, si emër i formuar nga fjala log, të dilte në trajtën **Loški Potok* - sikundër ka ndodhur p.sh. me 5 hidronime të territorit gjuhësor të sllovenishtes, të cilat e kanë pra burimin tek një trajtë e vjetër sllave *log*.[599]

Përkitazi me rolin ndërmjetësues të shqipes si gjuhë dhënëse e sllavizmave të së folmes së goranëve duhet të merret në konsideratë edhe emri i vëllazërisë gorane *Krčovci* në katundin Brod të Gorës, tek i cili është ruajtur varanti shqip i emrit Kërçova të qytetit në Maqedoni. Sikur emri i kësaj vëllazërie të ishte formuar nga sllavofonët, përkatësisht nga bullgarët ose nga maqedonasit, emri i kësaj vëllazërie do të dilte në trajtën *Kičevci* që do të ishte refleks i emrit bullgarisht, përkatësisht maqedonisht *Kičevo* të këtij qyteti. Një toponim i përkthyer nga shqipja, përkatësisht një emër vendi i formuar sipas fjalëformimit të gjuhës shqipe është edhe toponimi *Đakove Rupe*/*Đakovo rupište* "Gropat e dijakut/gjakonit" në Orçushë, *Đakovo polje* "Fusha e dijakut/gjakonit" në Dragash dhe *Đakove Livađe* në Dikancë të Gorës.

Duket se emrat e këtyre vendeve s'kanë të bëjnë drejtpërdrejt me emrin e qytetit të Gjakovës. Sikur ky toponim të ishte formuar nga goja e sllavishtfolësve së pari atributi "Đakove" do të duhej të ishte pjesë e parë e sintagmës p.sh. **Đakovaćke Rupe* dhe së dyti vetë emri i qytetit të Gjakovës do të duhej të dilte në trajtën sllave *Đakovica*. Këto mikrtoponime të Gorës, si edhe emri Gjakovë i qytetit të Kosovës, rrjedhin nga

[597] France Bezlaj, Etimološki slovar slovenskega jezika II, Ljubljana 1982, f. 147-148.
[598] Khs. Slovenska vodna imena I, Ljubljana, 1961, f. 354.
[599] por: "… nuk është e mundshme të konstatohet se kur kemi të bëjmë me derivate nga **log**ъ e kur nga **loka** "- thotë Bezlaj, po aty.

varianti sllav *đak* i termit kishtar lat. *diaconus*, greq. *diákonos* që në shqip është dëshmuar si *dijak*, *dhjak*, *gjakon* e *xhakon*.

Një mikrotoponim që tek popollata sllavofone e Gorës do të ketë hyrë me ndërmjetësimin e shqipes do të jetë edhe mikrotoponimi *Gumno* në katundin Baçkë të këtij regjioni. Emri i këtij vendi rrjedh, sikundër dihet, nga fjala me prejardhje sllave *guvno* "lëmë". Dihet tanimë që grupi konsonantik *-vn-* në toponimet sllave në hapësirën gjuhësore të shqipes kalon në shqipen në *- mn-* dhe në *-m-*, si p.sh. shq. *Gumnasellë* serb. *Guvno selo*; shq. *Ramaba*(*n*)*jë* serb. *Ravna Banja*, shq. *Ramabuçë* serb. *Ravna Buča*; shq. *Randubravë* serb. **Ravna Dubrava* - të gjitha këto katunde në territorin e Kosovës.[600] Me ndërmjetësimin e shqipes do të jetë krijuar edhe mikrotoponimi *Strga* i regjionit të Gorës. Ky emër rrjedh në të vërtetë nga fjala shqipe *strungë*, *shtrungë* e cila porse në të folmen shqipe të Opojës dëgjohet si *stërgë*. Sikundër dihet, fjala shqipe *shtrungë*, *strungë* ka depërtuar si albanizëm në gjuhë të Ballkanit. Në këtë mes duhet të lehet porse e hapur mundësia që ky emër të mund të jetë ndoshta me prejardhje nga fjala sllave e vjetër *strugati* / *stregati* lat. "radere, caelare, tornare", e cila ndeshet dendur në toponiminë e viseve të banuara me sllavë. Vetëm në territorin e Sllovenisë ndeshen p.sh. 11 emra rrjedhash të ujit që janë formuar nga kjo folje.[601]

Një emër vendbanimi me prejardhje nga shqipja është emri *Poštarovci* i një lagjeje të katundit Rapçë të Gorës. Ky emër mund të rrjedh nga ndajfolja shqipe *poshtë* i zgjeruar me prapashtesat *-ar* dhe *-ovci* dhe t'i ketë emërtuar kështu banorët e pjesës së poshtme, më të ulët të katundit. Së këndejmi, etimologjia popullore sipas së cilës banorët e kësaj lagjeje qenkan quajtur kështu, sepse një pararendës i tyre na e paska bartur postën në relacionin Beograd - Nish (!) është plotësisht e paqëndrueshme. Emri i vëllazërisë gorane është i së njëjtës prejardhje si edhe emri *Poshtar*(aj) i vëllazërisë në Kuk dhe në Zërzë emrin e së cilës M. Lutovac[602] e sqaron/përkthen serbisht si Donja mahala "Lagjja e Poshtme". Duket se korrektësinë e interpretimit tim e mbështet edhe emri *Zgatar* i njërës nga dy lagjet e katundit Xerzë të Opojës, emër që është formuar me të njëjtën prapashtesë (*-ar*) si edhe toponimi i regjionit të Gorës.

---

[600] Për këtë fenomen khs. Latif Mulaku, Mbi asimilimin e togut *vn* në *n*, Gjurmime albanologjike, 1 / 1965 Prishtinë, 323-326; S. Gashi, Cili është katundi Arbanash i vitit 1485 ?, "Rilindja", 12. 02. 1977, f. 14.

[601] Khs. te F. Bezlaj, Slovenska vodna imena …

[602] M. Lutovac, Gora i Opolje, f. 75.

Ndajfolja *poshtë* e shqipes ndeshet e përmbajtur edhe në leksikun e të folmes së Raguzës (Dubrovnikut) ku në terminologjinë e peshkatarëve dalmatë *poštarnica* shënon një vend buzë detit i cili është i përshtatshëm për gjueti peshku dhe prej nga madje mund të shihen edhe peshqit. Sipas P. Skok-ut kjo fjalë ndeshet edhe si emër i një ishulli të vogël i cili dëshmohet në burime raguzase më 1344 si: "scolium Postarnicia et homines ipsus scolii. ..". Rrethana që ndër banorë të ishullit Šolta perkatësisht në katundin Gornje Selo ka një emër vëllazërie *Poštar*,[603] sikur dëshmon se edhe te ky emër i mbajtur për me prejardhje romane duhet të shihet ndikimi i shqipes, përkatësisht ndajfolja e vendit *poshtë* e shqipes.

Në këtë mes do të duhej të liheshin të hapura edhe mundësitë që tek emri i kësaj vëllazërie të kemi të bëjmë ose me tjetërsim të emrit *Pustoshar* që në vitin 1571, në kontekstin e lagjeve të katundit Gorozhup, përmendej menjëherë pas katundit Ivranishta (SG: Vraništ i Gorës).[604] ose që ky emër të shihet për si i dalë, si pasojë e ndikimit të etimologjisë popullore, nga shtrembërimi i nocionit *pashtrak* "taksa e kullotës" të zbehur në kujtesën kolektive që është ruajtur porse në trajtën e tij të shtanguar, të pasivizuar tek emri aktual i vëllazërisë *Pashtraj* në katundin Kuk(ël) të Opojës.[605]

Duket se një dëshmi e fortë e bashkëjetesës së popullatave të Opojës e të Gorës është emri i vreshtave *Kuculat:* "*lozje u Kuculate*" në të cilin ka arsye të kërkohet emri i nëndegës *Kucovlasi* të vllehve të njohur edhe me emrin *Karaguni*, të quajtur kështu në bazë të tirkut të zi që e bajnë, përkatësisht mauro vllehve " vllehve të zinj". Nëse kjo etimologji mund të qëndrojë në këmbë të veta, atëherë do të rezultonte se vëllazëria gorane e quajtur sot *Zizinci*, pas gjithë gjasash nga mbiemri shqip *i zi*, ishte në krye të herës një vëllazëri vllahe, emri i së cilës Μαυρο Βλαχοι "vllehtë e zinj", përkatësisht κουτσο Βλαχοι u përkthye në shqip porse u trajtësua sllavisht, me prapashtesën *-inci*. Në të mirë të këtij paravendimi do të shkonte prania edhe e mikrotoponimeve të tipit antroponimik posesiv *Zizov ploš* e *Zezov kamen* në Brod.

Me këtë emërtim do të mund të afrohej njëherë, vetëm kushtimisht, mikrotoponimi i tipit antroponimik *vr*/ *zizine gomile* që sipas dokumentit të vitit 1315-1318 sajonte njërën ndër mexhë të

[603] Khs. I. Robić, Podrijetlo stanovništva otoka Šolte, Naselja i poreklo stanovništva, 36, Beograd, 1960.
[604] S. Pulaha, Popullsia..., f. 227.
[605] Të shënuar në terren nga J. Osmani., Vendbanimet e Kosovës, 20, f., 114.

katundit Dinosh të sotëm në Mal të Zi.[606] Ky afrim do të mund të qëndronte nëse tek shkronjat *vr*, siç mendon V. Jagić, bën të paravendohet fjala sllave *vrh* "majë mali" e shkruar me shkurtesë.

Ka dëshmi që tema emërore *Ziz-* p.sh. në funksion të mbiemrit familjar ishte në përdorim edhe në gjysmën e dytë të shek. 15, kur dëshmohet që banori bartës i antroponimit shqiptar *Gjergj* i katundit Gorna Voroniça të sanxhakut të Shkodrës e mbante mbiemrin Zizjovi.[607]

Këtë pjesë të paraleleve onomastike po e mbyll me paralelet midis mikrotoponimve *Hodofka* (në Kosavë të Opojës), *Kalatina* - ujvare në katundin Zaplugjë dhe *Kroj i Boçe*[608] në katundin Brrut, të cilat s'ka si të mos jenë të së njëjtës prejardhje si edhe emrat e vëllazërive *Odovci*/*Hodofci* në Leshtan, *Kalinovci*/*Kalinkovci* në Restelicë dhe Bozovci të goranëve sllavishtfolës.

12.3. Mikrotopnime me prejardhje antroponimike

Alizotoviqi

Ky mikrotoponim i katundit Kukoljani ruan më vete emrin shqip **Alizotaj* i sajuar nga antroponimi oriental *Ali* dhe ai shqiptar *Zot*-o.

Berisha

Ka mundësi që ky emër vendi i katundit Dikancë të Gorës të ketë lidhje me emrin Berisha të fisit të shqiptarëve.

---

606 sh. Vatroslav Jagić, Svetostefanski hrisovulj kralja Stefana Uroša II Milutina; Wien, 1890. dhe Lj. Kovačević, Svetostefanska hrisovulja. .., f. 5.

607 S. Pulaha, Defteri. .., f. 380.

608 Antroponimi *Boç* dëshmohet si në burimet kishtare serbe ashtu edhe në defterët osmanë të regjistrimit të kryefamljarëve e të pronave në veitet 1455 e 1485 në trajta të zgjeruara me prapashtesa të ndryshme. Kështu, midis banorëve të "tokës së vllehve" që përfshinte katundin e sotëm Kijevë dhe disa të tjera përreth, përmendet edhe banori *Boçan*, vëlla i Bolin-it (khs. Dečanske hrisovulje. .., f. 125), ndërsa më 1485 një banor i katundit Piranë të Prizrenit quhej *Boçil*-a, një banor i katundit Gllogjan të Deçanit quhej *Boçul*, një banor i katundit Jashanicë e Poshtme quhej *Boç* (khs. Bogdan-i, i bir i *Boç*-ës), në katundin e quajtur Virçovica në rrethina të Prizrenit jetonte një Jovan *Boçtin*-i; në kat. Shushicë, Kaçiq e Kolaniça të Vushtrrisë ishtin banorët Stepan-i, i bir i *Boç*-ës; Jovan-i, i bir i Boç-ës dhe *Boça*, i vëlla i pop Miliç-it; në katundin Krushiça të Prizrenit jetonte banori *Boça*, i bir i Lin-it; e të tjerë në nahijen e Kelmendëve, të Piperëve, në Tuz, në Gosturan etj. (khs. Selami Pulaha, Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, Tiranë, f. 220, 290, 216, 313, 202-203, 261, 224.).

Gjelov/Xhelov dof

Në emrin e quajtur kështu të katundit Krushevë të Gorës ruhet antroponimi *Gjel-* i shqiptarëve, i cili më dendur ndeshen si antroponim femëror *Gjelinë* tek shqiptarët e ritit katolik të krishterimit.

Shok

Në këtë emër në katundin Gllboçicë ruhet antroponimi i rrallë i shqiptarëve *Shok*, i sajuar nga fjala *shok* që shenjon(te) të afërmin e ndarë nga zjarri e gjaku, përkatësisht kushëririn e një brezi më të vjetër. Një paralele semantike apo përkthim i këtij është ruajtur tek mikrotoponimi *Družin potok* "Përroi i Shokut" në katundin Kukoljan të Gorës.

Tanushevc

Në këtë mikrotoponim të katundit Kukoljan të Gorës ruhet antroponimi karakteristik i shqiptarëve Tanush.

Ukovci

Vendi i quajtur kështu në katundin Kukoljan është sajuar nga nga antroponimi Uk/Ukë (nga uk/ujk) i shqiptarëve, i zgjeruar me prapashtesën sllave *-ovci*.

Ndër mikrotoponime me prejardhje antroponimike të regjionit të Gorës bien edhe mikrotoponmet *Baljevo Gumno* "Lama e Balës" dhe *Baljevo Brdo* "Kodra e Balës" - që të dyja në katundin Krushevë. I kësaj prejardhjeje është edhe emri i vëllazërisë *Balje* të katundit Restelicë të Gorës. Në të gjithë këta emra përmbahet antroponimi shqip *Balë*,-a, i ndonjë pararendësi të vëllazërisë ndeshur shpesh në funksion emri të vëllazërive në trajtat *Balaj*, *Baliq* etj. dhe ndër mikrotoponime në të cilat ky emër del si i fosilizuar. Antroponimi Bal/ë,-a është një zhvillim tjetër i antroponimit *Bardh* i cili dëshmohet edhe tek pararendësit ilirë të shqiptarëve në trajtat Βάρδυλις, *Bardus*, *Bardulis*, *Bardibalus* dhe tek mesapët si *Barzidihi*.[609]

Këtu bie pas gjithë gjasash edhe hidronimi *Ginivoda* i katundit Brod të cilin S. Idriz[*] e ka shënuar si *Điní-vode,* - i cili duket se, në të vërtetë, është një trajtë e konglutinuar e emrit dypjesësh **Gjinova Voda* "Ujt, kroni, gurra e Gjinit". I kësaj prejardhjeje është edhe mikrotoponimi *Đinov potok* në katundin Krushevë. Në këta emra ruhet antroponimi

[609] Sh. Eqrem Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes (A - B), Tiranë, 1977, f. 161, 163, 164.

[*] Në materialin në dorëshkrim që ma ka vënë në dispozicion

shqiptar Gjin në trajtën *Gin* e *Gjin*, përkatësisht *Xhin* e i cili po si i këtillë dëshmohet tek emri i katunit të arbanasëve *katunь arbanasь ginov'ci* në vitin 1348[610] (katundi i stëm Gjinovc në rrethina të Suharekës), *Ginovo brdo* në rrethina të Cetinjes së Malit të Zi i dëshmuar në vitin 1485 në një kartë të sundimarit të Zetës Ivan Crnojević i cili i fali prona manastirit të Cetinjes.[611]

Me prejardhje shqipe do të jetë edhe hidronimi *Rečikova česma* *"Kroni i Reçit" në katundin goran të Zli Potok-ut, tek i cli, pa gërmuar thellë në raportet etnike-gjuhësore sllave-shqiptare del e qartë se kemi të bëjmë me një hidronim në të cilin përmbahet antroponimi i *Reç* shqiptarëve. Një dëshmi nga mikrotoponimia aktuale është për këtë mtp. *Guri Reçit* në katundin Brodosanë[612] të Opojës. Ky antroponim dëshmohet dendur ndër banorë të Kosovës në shek. 15.[613]

Në këtë grup emërtimesh shqipe bie edhe emri i kodrës *Kačina Glava* i katundit Brod të Gorës. Këtu kemi të bëjmë me oronimin homonim *Kačina glava* "Kodra e Kaç-it" që për në regjionin Patkovo (sot Has), përkatësisht në rrethina të largëta të katundit Klishani (sot Kishaj) të Kukësit dëshmohet më 1348.[614] Këtu duhet të bie edhe emri i vëllazërisë gorane *Kačinci* i katundit Restelicë të kësaj krahine. Vetë trajta e zgjeruar me prapashtesën sllave *-inci* tregon se këtu kemi të bëmë me një zgjerim të emrit personal *Kaç* të ngritur në funksion të emrit të vëllazërisë. Në katundin Brod të Gorës ndeshet edhe emri i vendit *Kačina* dhe *Kačiji Dol* "Lugu i Kaçit", ndërsa në katundin Kukoljan të Gorës paska një vëllazëri *Kaqkovci*. Duket se te këta emra s'ka si të mos kërkohet e gjendet një trajtë e toponimizuar e antroponimit *Kaç* të fosilizuar në rasën gjinore sllave të tij. Këtu bie mbase edhe emri *Kaçanikët* i një vëllazërie në katundin shqiptar Zapluxhë dhe i një tjetre në katundin Buzezë të Opojës të cilat (vëllazëri) tradita i mban për të ardhur, prandaj emrin e tyre e lidh me emrin e qytezës së Kaçanikut.[615]

Nëse ky sqarim mund të qëndrojë në këmbë të vetat, përkatësisht nëse tek këta emra vendesh është ruajtur një antroponim *Kaç*, vlerën kuptimore të të cilit porse ende nuk e dimë, del porse megjithatë e sigurt

[610] Sh. Hrisovulja cara Stefana Dušana koiomь osniva monastirь S. Arhangela Mihaila i Garila u Prizrenu 1348? godine, Glasnik Društva Srbske Slovesnosti 15, Beograd, 1862, f. 278.

[611] Sh. St (ojan) Novaković, Zakonski spomenici srpskih država sredjega veka, Beograd 1912, f. 780.

[612] J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 88.

[613] Khs. për këtë dëshmitë tek S. Pulaha, Defteri …

[614] Sh. Hrisovulja cara Stefana Dušana … 1348 ?,… f. 283.

[615] J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, f. 102, 146.

se ky antroponim nuk do ta ketë vlerën kuptimore *gjarpër* të sllavishtes dhe se së këndejmi ky antroponim nuk mund të jetë me prejardhje sllave nga *kača* "gjarpër"- sikundër mendonte Fr. Miklosich.[616] Nga po ky antroponim, por i zgjeruar me papashtesën *-ot*, rrjedh edhe mikrotoponimi *Kačotosko Tulbe* "Tyrbja e Kaçotit" në vendbanimin qendër të regjionit të Gorës - Dragashit.

Se në shembujt e mësipërm kemi të bëjmë me një antroponim *Kaç* - kuptimin e të cilit nuk e dimë, por që sigurisht nuk rrjedh nga fjala sllave *kača* "gjarpër" duket se mund ta tregojë edhe emri i katundit Keçekollë të malësisë së Prishtinës, emër ky që ka gjasë të jetë formuar me bashkëshkrirjen e një toponimi dypjesësh **Kačino kolo* "Gropa e Kaçit". Ky interpretim e ka mbështetjen edhe tek rrethana se edhe në këtë katund, si në shumë sish përreth minierës së famshme mesjetare të Novobërdës, ka gjurmë që e dëshmojnë shfrytëzimin e, përkatësisht shkrirjen e mineraleve. Emri Keçekollë i katundit është i së njëjtës prejardhje (sllave) dhe i të njëjtit tip si emrat: Nizhnakollë nga **Nikšino Kolo* "Gropa e Nikshit" dhe Rekekollë, nga **Rajkovo Kolo* "Gropa e Raikut" të dyja këto vende janë lagje të katundit Marec dhe me emra të këtillë dëshmohen që në gjysmën e parë të shek. XV.[617]

Në dritën e dëshmimit të emrave të derës aristokrate të Trogirit (1227 - 1233) : *Casottus canonicus primicerius* (1267-1282) dhe *Casottus Nicolae* (1316), *Ser Casottus de Casottis* (1406)[618] si edhe rrethanës se në vendbanime - miniera si Novobërda e Çuka e Drashnjes kishte edhe popullatë të mirëfilltë romane të vendosura, andej nga qytete të brigjeve të Adriatikut, kujtimi për të cilën p.sh. në Orllan, në Marec e në Keçekollë është ruajtur edhe tek emrat e vendeve të quajura *Trojet e Gjenovizit* (ardhës nga qyteti i Gjenovës ose thjesht romanë) ka arsye të besohet se emri Keçekollë mund ta ketë për prejardhje antroponimin ndoshta me prejardhje romane *Kaç*. Ky antroponim, në funksion emrash të vëllazërive, ndeshet i ruajtur deri në ditë tonat në trajtat: *Kaçot* në Prapashticë; *Kaçur* në Prugovc afër Podujevës; *Kaçi*, *Kaçijaj* në Gjakovë e në rrethinë të saj etj.

Antroponimi i toponimizuar *Muç* i përmbajtur në mikrotponimin posesiv *Mučinova Livada* në katundin Restelicë të Gorës lidhet me antroponimin e njërit nga pararendësit e një vëllazërie gorane *Mučinci "pasardhësit e Muç-it". Ky antroponim ndeshet tek shqiptarët në Kosovë

[616] Sh. Die slawischen Personen- und Ortsnamen. .., f. 323.

[617] Khs. Mihailo Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva, I, Beograd 1957, f. 39, 79 : *Nichxino cholo*; *Raichouo cholo.*

[618] K. Jireček, Romani …, f. 156.

në trajtat *Muça, Muçaj* në rrethina të Pejës dhe *Muçiqi* e *Muçolli* në krahinën e Llapit. Në hidronimin *Mazka česma*[619] ruhet tema emërore *Maz-* e cila, e zgjeruar me prapashtesa të tjera, dëshmohet dendur për antroponim e patroponim i shqiptarëve.

Dëshmitë më të vjetra *të shkruara* të bashkëjetesës së goranëve bullgarishtfolës me shqiptarët vendës edhe në krahinën e sotme *të Gorës*, një bashkëjetesë kjo që përfundoi me sllavizim të pjesërishëm të shqiptarëve, e kemi tek emri *Lulo*, përkatësisht *Mahalla e Lulove* të një vëllazërie aktuale të katundit Brod të Gorës.[620] Këtë paravendim e mbështes mbi rrethanën që në defterin osman të regjistrimit të vitit 1451-1452 të kryefamiljarëve, pikërisht në këtë katund ishte evidentuar edhe kryefamiljari *Lulko*.[621] Nuk do të jetë mbase punë e lehtë të hedhet poshtë mundësia që ky kryefamiljar ta ketë mbajtur emrin shqip *Lul*, sa kohë që, nga njëra anë, nëpër burime kishtare serbe e sosh osmane e ndeshim edhe korelatin sllav *Cvetko* të tij dhe, sidomos pse në këtë katund kishte në vitet 1451-1452 edhe banorë të tjerë që mbanin antroponime apo patronime me prejardhje shqipe. Të këtillë do të jenë kryefamiljarët *Gjergji, Bardo* (shih edhe më poshtë) *Lazor*, *Gropiq* e ndoshta edhe *Rap -ko*.

Këtu do të hynin edhe emrat e dy lagjeve, të cilat nuk ekzistojnë më, të katundit të sotëm goran të Brodit - të regjistruara në një defter turk të vitit 1530: mahalla *Bardonik* me 6 shtëpi e 5 beqarë dhe mahalla *Gjonoviq* me 9 shtëpi e 6 beqarë.[622]

Vëllazëria - lagjja *Bardonik* e mban emrin e një pararendësi të vëllazërisë shqiptare *Bardhaj të sllavizuar në *Bardoniki/Bardonići mbase pse kishte qenë aty më parë dhe, për pasojë, kishte bashkëjetuar dhe ishte sllavizuar. Për sa u tha më lart do të ilustrohej edhe me rrethanën që në defterin e viteve 1451-1452 pikërisht në këtë katund jetonte edhe kryefamiljari i quajtur *Bardo.*[623] Përveç në katundin Brod më të madhin

[619] Ka arsye që te ky hidronim të shihet rrënja emërore Maz- e cila ndër emra familjesh e vëllazërish të shqiptarëve të Kosovës ndeshet i zgjeruar me prapashtesa të ndryshme. Për ilustrim po i sjell mikrotoponimet e mëposhtme: *Kroni Maziqit, Ara Kronit t'Maziqit* në katundin Çabiq të komunës së Klinës, i cili në dokomentacionin kishëtar serb që më 1330 ishte cilësuar për katund i vllehve të mikroregjionit *vlaška zelmja* "Toka, regjioni i vllehve" me qendër katundin e sotëm Kievë të krahinës së Llapushës. Me shtresime dhe formime prapashtesore të ndryshme, ky emër dëshmohet edhe në Dalmaci: *Mazucat Johannes filius* [...] *Mazurana Gaspera filia Jacobi et Mathie* dhe në trajtën *Masnik: Masnich Johannes filius Nicolai et Helene* etj. sh. Ante Šupuk, Hibridni antroponimi, Čakavska Rič 2, Split 1974, f. 17.

[620] Emër i shënuar në terren nga Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kososës, 20, f. 91, 92.

[621] Khs. Iljaz Rexha, Një fragment i defterit të Rumelisë të viteve 1451-1452,. .., f. 281.

[622] Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë 2006, f. 92.

[623] Iljaz Rexha, Një fragment. .., f. 281

të Gorës, emrin shqip *Bardh* të një vëllazërie sot sllavishtfolëse - gorane e gjejmë edhe në katundin Leshtan të goranëve,[624] ku jeton vëllazëria *Bardovci*. Në të mirë të këtij pravendimi-konstatimi shkon edhe rrethana që një vëllazëri shqipfolëse e quajtur *Bardhajt* qenka në katundin Brodosanë të krahinës shqipfolëse të Opojës.[625]

Me prejardhje shqipe dhe shembull i besueshëm i sllavizimit të vëllazërive shqiptare që ishin gjendur në bashkëjetesë me bullgarishtfolësit e katundit më të madh Brod të goranëve do të jetë edhe emri *Gjonoviq* i një lagjeje të Brodit, që gjithashtu përmendet në një burim osman të vitit 1530. Pjesëtarët e kësaj vëllazërie tanimë të sllavizuar e kishin për pararendës bartësin e antroponimit tipik gjithshqiptar të periudhës së krishterimit të hershëm, *Gjon* - sado që në regjistrimin e viteve 1451-1452 në këtë katund nuk dëshmohej ndonjë kryefamiljar me këtë antroponimi.

Një dëshmi edhe më e vjetër, jo porse e drejtpërdrejtë, si për kontinuitetin ashtu mbase edhe për sllavizimin gjuhësor (edhe) të një toponimi ashtu edhe sllavizimin më vonë etnik të një vëllazërie shqiptare me po atë emër, është edhe vazhdimësia e emrit **Črna Gora*, në variantin e tij shqip, që përbënte njërin ndër kufijtë midis lagjes Kruimada (Kryemadh) dhe lagjes Shiklja (katundi i sotëm Shikaj i rrethinave të Kukësit) i përmendur në krisobulën e vitit 1348: "Dhe lagjen Kruimada me vreshtat. Dhe kufiri i tij burimi tek (kisha e) Shën Gjergji(t) nëpër mal tek (kisha e) Shën Ili (t). Tek Balta e Thatë deri tek kufiri i Shiklës. Dhe përgjatë kufirit të Shiklës në Dri. Përtej Drinit përroit teposhtë e tek (kisha e) Shën Kolli (t) dhe përroit teposhtë e tek Gurra e Gavçit nëpër mal e te *Mali i Zi*. Te Qershia udhës teposhtë nëpër lug tek Gështenjat në lum në Tëmna. Dhe lumit në Drin. Dhe lagjja Kërsti, ndërsa kufiri Kryqi në Udhën e Shiklës përtej Lugut te Arra e Madhe."[626] Në këtë mes nuk bën të lehet pa u përmendur rrethana që po në këtë burim përmendej edhe një vend i quajtur *črьni gvozd* "Mal i zi" në të cilin bashkësive të katundeve Orçushë, Gllobоçicë e Brod[627] u lejohej të prenin dru.

---

[624] Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 20, f. 117.

[625] Po ai, po aty,. .., f. 88.

[626] Khs. tekstin origjinal: "I zaselьk krouimadà s vinogradi. a megja moù vrělo svetы gєωrgьje. po dělou na svetago iliju. Na souho blato do megjè šikьlskє. i šikьlьskomь megomь ou drimь. Prěko drima potokomь na svetago nikolou. i potokomь na gavčьna vrěl po děloù na črъnou gorou. Na črěšnju poutеь nizь dolь na koštanje ou rěkou ou tьm'nou. i rěkomь ou drimь. I zaselьkъ krsti, a mєgja mou krstь na šikьlьskomь pouti prěko dola na vєlii Orahь. .." te Hrisovulja. .., f. 286.

[627] Khs. referencën 35 të kësaj trajtese.

Mbase nuk është fort i guximshëm paravendimi që ky emër vendi u ruajt tek emri *Malezinci* i vëllazërisë, sot sllavishfolëse, të Gorës. Pikërisht trajta e derivuar me prapashtesën sllave *-inci* të kolektivitetit *Malezinci* "banorët e Malit të Zi" i emrit të kësaj vëllazërie gorane do të fliste në të mirë të përkthimit në serbisht (në dokumentin e vitit 1348) *črьni gvozd* të një emri në krye të herës shqiptar *Mali i Zi. Po të mos ishte kështu, do të duhej pritur që vëllazëria gorane të quhej **Črnogorci* ose **Crnogorci*. Sado që jo pikërisht në këtë katund, një dëshmi për vazhdimësinë shqiptare të emrit të kryehershëm shqip e kemi mbase tek mikrotoponimi *Shpati Malzezëve* në katundin Grazhdanik të rrethinave të Prizrenit.[628] Procesin e sllavizimit sporadik të shqiptarëve, për shkak të bashkëjetesës së shkaktuar si rezultat i lëvizjeve të brendshme shqiptare-"gorane" do ta tregonte edhe emri *Luminci* i një vëllazërie gorane në katundin Restelicë.

12.4. Emra vëllazërish: Paralele shqiptare-gorane

Paralelet onomastike shqiptare-gorane/sllavobullgare të kësaj krahinëze janë shumë më të thella në fushën e emave të vëllazërive. Kështu, p.sh. emrin e vëllazërisë *Bagaljevci* të Zlipotokut dhe tek ai *Balibaginci* (në Brod) duhet parë për si një formim të të njëjtit formant si edhe patronimet shqiptare kompozita si p.sh. *Palabardhaj* (nga *Pal* + *Bardh* + prapashtesa karaketeristike shqiptare *-aj*), *Nikprelaj* (nga *Nik/ë* + *Prel /ë -a* + prapashtesa. *-aj*), *Gjonbalaj* (nga *Gjon* + *Bal /ë - a* + prapashtesa *-aj*) etj. Nëse emri *Balibaginci* bie në këtë kategori, atëherë këtu do të duhej të kërkohej një bashkëshkrirje joautentike e dy antroponimeve të ndryshme. Në këtë rast këtu do të kishim të bënim me antroponimin shqiptar *Balë* ose Bali (khs. mtp. *Kroi Balisë*, në katundin shqiptar Rrenc të Opojës dhe antroponimi i dytë *Bag-* i zgjeruar me prapashtesën sllave *-inci* (me ç'rast do të duhej sjellur ndërmend antroponimet *Bagalj, Bagar, Bagatur*[629] - mbase me prejardhje sllave.

Me prejardhje shqipe mund të jetë edhe emri *Çokovci* i vëllazërisë gorane të katundit Restelicë, i sajuar nga fjala *çok-u* me prejardhje të diskutueshme e cila në shqipen moderne del në trajta dhe në kuptime të ndryshme, kryesisht si term i konfiguracionit të terrenit,[630] midis të cilave

[628] Këtë emër vendi e ka shënuar në terren Dr. J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 18, Prizreni, Prishtinë 2006, f. 120.

[629] khs. Selami Pulaha, Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës. .., f. 301-302, ku ky emër del shumë dendur i zgjeruar me prapashtesa të ndryshme.

[630] Khs. për këtë Fjalor i Shqipes së Sotme, Tiranë, 1984, f. 168-172, 999.

porse, sipas E. Çabej,[631] edhe si distinktiv për shpendin "qukapik i gjelbër", përkatësisht për shpendin *qok-u, qokth*-i e *stërqok-u, stërqok/ë,a* zool. Corvus monedula, shpend i familjes së korbave, me trup pak më të vogël se sorra, me bisht të gjatë, me penda të zeza në trup e të bardhëm në trup e në qafë,[632] por edhe si sinonim krahinor për emrin e hutit, bufit. Apelativi *çok* në trajtën *çog-* ndeshet edhe në mikrotoponimi: khs. *Çogza*, vend (livadh e bahçe) në katundin Jabllanicë; *Çogzat* dhe *Mali Çogzave* - kodër me gunga në katundin Llugaxhi të Dushkajës së Gjakovës, të cilat S. Hoxha i sheh të kenë dalë nga apelativi *çukë* në kuptimin e *suk*-ës.[633] Në kuadër të interpretimit tim hipotetik të këtij emri nga *qok, qokth* të emrit shqip të shpendit të familjes së qukapikthit, të llojit të sorrës apo të hutit unë do t'i inkuadroja edhe emrat: *Livadhi Çokit* në Zaplugjë të Opojës dhe emrin e vëllazërisë - mahallës *Çoku* në katundin Koliq të komunës së Prishtinës, duke i parë këta më shumë si të motivuar nga emri i njërit nga llojet e shpendit se sa si term i konfiguracionit të terrenit.

Shtresës shqipe i takojnë emat e vëllazërive *Lika* (në Brod), *Likovci* e *Baljevci* (në Restelicë), *Šukekinci* e *Bašinci* (në Zli Potok - të shpërngulur në Turqi).[634] Në emrin e vëllazërisë *Likovci* përmbahet antroponimi i dëshmuar dendur *Lik/ ë -a; Lik, -u* sidomos në funksion emrash të vëllazërive në trajtat *Lika, Liku, Likaj* e edhe ndër emra katundesh të krijuara mbi bazën e emrave të vëllazërive siç janë p.sh. emrat e katundeve *Likovc* e *Likoshan* të regjionit të Drenicës.[635] Për antroponimin *Lik* është shfaqur mendimi se ky qenka një antroponim me prejardhje ilire[636] dhe i dëshmuar edhe për si antroponim i shqiptarëve ndër burime të shekujve XV-XVI.[637] Emri *Baljevci* është në të vërtetë zgjerim me

[631] Khs. Studime Etimologjike në Fushë të Shipes, III, Tiranë, 1987, f. 130-131.

[632] Sipas Fjalor i gjuhës së sotme shqipe,. .., f. 1113.

[633] Khs. Prof. Skënder R. Hoxha, Toponimia e Dushkajës, Jakova, 2007, f. 130, 177, 178, 384-385.

[634] Sipas një gojëdhane.

[635] Të sajuar nga antroponimi Lik- e të zgjeruar me prapashtesën *-ovc*, atë të zvogëlisë *-osh* dhe prapashtesën *-an.*

[636] Khs. psh. M. Lambertz, Zwei Albanica, Indogermanische Forschungen 60. (1952), f. 307 i cili kujtonte se ky emër qenka emër shqiptar i trashëguar nga këta prej pararendësve ilirë të tyre. Ky e krahasonte këtë emër të shqiptarëve me emrat e dëshmuar të bartur nga ilirët *Licaius, Licca, Liccaeus, Liccaius, Liccavus, Licco, Licovius* dhe me disa toponime të konsideruara për vende të banuara nga ilirë si *Paccolicus* (lumë në Bruttium), *Licus, Epilicus* dhe me emrin e krahinës *Lika* të Kroacisë. Ka porse mundësi që bazë e këtij antroponimi të jetë antroponimi në trajtën latine *Licinius* të tij.

[637] Khs. shembujt tek Skadarski zemljišnik od 1416. .. dhe Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës.

prapasshtesën sllave *-evci* i antroponimit shqip *Bal,ë -a* që është një sinonim i vjetër i emrit Bardh, i dëshmuar gjithashtu edhe si emër i ilirëve (khs. më lart shembujt Βάρδυλις e të tjerë), ndërsa tek emri i vëllazërisë *Šukekinci* kemi të bëjmë me një emër i cili dhe tek shqiptarët në trajtën deminutive të tij del si *Shuk* (nga *Pashk, -u* ← lat. *Pascal*); *Bašinci* i ka rrënjët tek antroponimi shqiptar *Basha*, i cili është dëshmuar dendur në funksion patronimi të shqiptarëve, ndërsa tek emri *Meškovci*, përkundër ndikimit të etimologjisë popullore shqiptare mbase duke e parë këtu antroponimin e shqiptarëve *Mes*/*Mesh*, i cili gjatë shek. 16 është dëshmuar dendur ndër shqiptarët.

Ndër emra vëllazërish të kësaj krahinëze, të cilët edhe sot ndeshen tek shqiptarët, bie edhe emri i vëllazërisë gorane *Alabakovci* (në katundin Mlikë), i cili (emër i vëllazërisë) na e përkujton emrin homonim *Halabakët* në katundin Pozharan afër Vitisë dhe emrin e katundit *Halabak* në rrethina të Podujevës;[638] *Veljćovci* (në Restelicë) na e përkujton emrin e vëllazërisë *Velça* të shqiptarëve dhe në vija më të largëta edhe patronimin Petri *Veljan*, të një banori të katundit Bilushë të rrethinave të largëta të Prizrenit,[639] edhe nëse këta dy emra nuk do ta kishin të njëjtën gurrë të prejardhjes. Sado territoialisht larg, ky emër përputhet për nga prejajrdha edhe me antroponimet e dëshmuara në shek. XVI të nahijes Župa të krahinës së Dibrës në shek.16.[640]

Të së njëjtës prejardhje si edhe emrat e vëllazërive shqiptarë të Opojës e më gjerë janë edhe emrat e vëllazërive gorane *Cekovci* në katundin Vraništ të Gorës (me këtë rast do të duhej sjellur ndërmend mbemrin *Ceka* të përhapur gjer e gjatë ndër shqiptarët); *Milkovci* në katundin Radesh (le të na përkujtohet emri Millaku i vëllazërisë së katundit Ujmirë të Klinës, i cili emër është dëshmuar po më 1330 edhe në emrin e vendit *Milakova strana*[641] dhe emri aktual i vëllazërisë *Milaj* në rrethina të largëta të Prizrenit.

---

[638] Një emër fonematikisht i ngjashëm me emrin që po trajtohet më lart përmbahet në mikrotoponimin rumun *Fața Halbocii* "Ora, zana e Halboc-ut" (khs. E. Janitsek, Toponimia văii superioare e Rîului şieu, Studi şi materiale de onomastica, Bukuresht, 1969, q. 128-129). Antroponimi *Halboc* me variantet prapashtesore të tij konsiderohet për me prejadhje nga ukrainishtja. *hylboko*.

[639] Khs. Selami Pulaha, Të dhëna ekonomike dhe demografike për krahinën e Opojës, "Studime historike" (Tiranë) 3/1975, f. 141

[640] Khs. M. Sokoloski, Nahijata Župa (Materijal izvlečen od opširniot popisen defter Nr. 25 od 1583 g. za Ohridskiot sandžak), Makedonski jazik, 1974; S. Gashi, Antroponimia e popullatës së nahijes Zhupa të Dibrës së shek. XVI, "Gjurmime albanologjike", Seria filolologjike, 7/1997, (Prishtinë)

[641] sh. Miloš S. Milojević, Dečanske hrisovulje. .., f. 57: *ou milakovou stranou.*

Emri *Ćuftinci* i vëllazërisë gorane dhe i asaj shqiptare *Çufta* tani me banim në Dragash, nuk është vetëm fonematikisht i ngjashëm, porse ky edhe rrjedh nga i njëjti burim prej nga do ta ketë prejardhjen edhe mbiemri i shqiptarëve *Çufaj* në rrethina të Deçanit, e ndoshta edhe si mbiemri *Shufta* i shqiptarëve. Trajta *Ćuftinci*[642] duhet të shihet mbase si rezulat i ndikimit të etimlogjisë popullore dhe jo zhvillim sipas ndonjë rregulli fonetik.

Përveç emrave të vëllazërive, që në trajta të zgjeruara me prapashtesa të ndryshme ndeshen aktualisht si te shqiptarët e Opojës ashtu edhe te goranët e Gorës, ka edhe mbiemra me prejardhje thjesht shqipe. Le t'i përmendim që në fillim emrat me prejardhje shqipe të vëllazërive gorane të katundit më të madh të regjionit të Gorës - Brod, ku jetojnë vëllazëritë: *Lekovci, Likovci, Cakovci, Lalinci, Bufle* dhe emri *Cekovci* i një vëllazërie në katundin Vranisht. Emrat e mësipërm në trajtat sllave të tyre i kanë rrënjët tek emat shqiptarë të vëllazërive *Lekaj* *(khs. mikrotoponimin *Guri Lekaje* në Kuklibeg,[643]) *Lilaj, Cakaj, Lalaj* dhe *Bufaj*, që rrjedhin nga antroponimet shqiptare *Lekë, Lil, Cak, Lalë, Buf* - (i dalë nga ofiçi *buf-* sipas variantit *hut,-i* të emrit të shpendit zool. Bubo bubo, Strix nebulosa etj.)[644] dhe antroponimi *Cekë*.

Ndër emra me prejardhje shqipe bën të radhitet edhe emri i vëllazërisë *Ljokanovci* i cili, vështruar në pikëpamje të etimologjisë, mbase do t'i takojë shtresës romane të emrave të vëllazërive të të dyja regjioneve në shqyrtim. Prejardhjen romane të këtij emri e mbështesim në dëshmimin e këtij emri në funksion të mbiemrit ndër banorë të pjesës Dolac të qytetit të Šibenik-ut ku në vitin 1529 janë regjistruar atëherë banorët *Lochia Michael filius Jacobi et Margarite* dhe një tjetër, nga prindër të tjerë, *Lochichich Matteus*.[645]

Kriteri bazë dhe rrethanat që na japin të drejtë që këta emra t'i cilësojmë për të prejardhjes shqipe janë si shtrirja, ashtu edhe denduria e dëshmimit të emrave të kësaj natyre tek shqiptarët, kryesisht në ato vendbanime të vendosura rrëzë apo në shpatije të Maleve të Sharit (si

[642] Po u muarr në konsideratë ndikimi i etmologjisë popullore drejt rrafshimit semantik, atëherë edhe ky emër i ka paralelet e veta me emrat e familjeve të popullatës romane të brigjeve të Adriatikut. Mbase emri i vëllazërisë Gorane nuk përputhet vetëm fonematikisht me emrin e derës bujare *Cuffecti* të Kotorrit: *Nicolaus e Matheus Petri Cuffecti* i. v. 1330 (khs. K. Jireček, Romani u gradovima Dalmacije. .., f. 273.)

[643] Të shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 117.

[644] Për kuptimin e këtij emri khs. Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1984, f. 115-116.

[645] Khs. Ante Šupuk, Najstarija matica Šibenskog predgradja Dolac (Liber Baptizatorum Parochie Sancti Marci a die 8 octobris 1665, usque ad annum 1700, inclusive), Čakaska Rič, 2/1974, Split, 1975, f. 16.

p.sh. në Kotlinë të Kaçanikut) dhe në vendbanime të Bjeshkëve të Nemuna (si p.sh. në Junik), përkatësisht pikërisht në ato zona nëpër të cilat gjallojnë edhe sot gjurmë onomastike e leksikore të latinitetit ballkanik siç janë p.sh. oronimi *Këlkerja*[646] në Junik; *Udha pukë*[647] (nga një e lat. *via publica*) dhe fjala *kurt,-i* "oborr" në katunde të krahinës së Opojës (khs. mtp. *Livadhi kurtës* në katundin Shajne,[648] një trajtë e parëndomt në rrafshin e gjinisë së pritshme, normale mashkullore të emrit, që mbase do të ketë ndodhur të shkak të zbehjes së domethënies aktive të fjalës së huazuar nga latinishtja ballkanike). Një tjetër apelativ me prejardhje nga latiniteti ballkanik në të folmen e Opojës është edhe termi *burg*-u i cili në këtë zonë e ka kuptimin "vath". N. Jokl[649] sqaronte se kuptimi i mirëfilltë dhe i kryehershëm i kësaj fjale, përkundër mendimeve të shfaqura më parë nga dijetarë të tjerë, do të jetë ai i lat. *burg*, *burgus* me kuptimin "mal, kurriz mali, gungë shkëmbore" që në shqipen, ashtu si edhe në sllavishten, e paska marrë kuptimin "gjytet; rrënojë". Unë kujtoj që tek *burg* i së folmes së Opojës kemi të bëjmë me një kuptim të bartur tek *vath rrënzë mali*; *rrënzë shkëmbi* dhe jo gjithmonë vend nën kështjellë, gjytet, sepse në këtë krahinë gati që edhe nuk ka ndonjë topogërmadhë të quajtur gjytet.

Tek popullata e katundit Brod të Gorës gjallojnë edhe emrat e vëllazërive *Trupčevci*, *Krtovci* dhe *Ćunkovci*, të cilat për si emra vëllazërish ndeshen edhe nëpër vendbanime të Kosovës si nëpër burime shkrimore të mesjetës së vonë ashtu edhe në trajta të shtanguara, të toponimizuara, nëpër mikrotoponime. Kështu p.sh. emri *Trupčevci* i vëllazërisë së këtij katundi na e përkujton emrin *Trupaj* (khs. shq. *trup,-i* + prapashtesa *-aj*) të një vëllazërie në katundin Kosavë të Opojës. Ndryshe, në vija më të largëta, ky emër duket të jetë korelat semantik i emrit *Kurmaj* (nga shq. *kurm,-i* "shtat; trup" i zgjeruar me prapashtesën

[646] Një mikrotoponim *Këlkere*, për si dëshmi të ekzistimit të një shtrese latine ballkanike në toponiminë e Kosovës, ekzisaton edhe në katundin Planejë të krahinës së Hasit. I kësaj natyre do të jetë edhe mikrotoponimi *Kërkele* në trajtën e tij të metatetizuar që është në katundin Zgatar të krahinës së Opojës i shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 148. Tek këto mikrotoponime përmbahet reflektimi i vjetër shqiptar *këlkere* i fjalës latine ballkanike *calcaria* khs. Carlo Tagliavini, Miscellanea etimologica balcanica, Revue internationale des études balkaniques 1/37, 1936, f. 192.

[647] Për kuptimin e mbiemrit khs. Fr. Miklosich,. Romanische Elemente. ..,. f. 58.: *puke*: *uδe puuch* via publica. Bl. (SG. = Frank Bardhi). Miklosich e rekomandon edhe krahasimin *puuk*-a *viuzza*. R. publica.

[648] Të shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 135.

[649] khs. Zur Ortsnamenkunde Albaniens, Zeitschrift für Ortsnamenforschung, Bd. 10, Heft 2.,1934, f.183-184.

tipike shqipe *-aj*) të një vëllazërie të Opojës.[650] Emri *Krtovci* i vëllazërisë gorane do të jetë i së njëjtës prejardhje si edhe emri i katundit *Krtog* në të ashtuquajturën "Serbi e Jugut" dhe emri *Kërtok* i një lagjeje të katundit Gllamnik të Podujevës.[651]

Emri *Ćunkovci* i vëllazërisë gorane s'do të jetë tjetër përpos antroponimi shqiptar *Çun*, (khs. fjalën shqipe *çun, çunak* "djalosh" dhe emrat e vëllazërive shqiptare *Çun*,-i e *Çunaj* në krahinën e Rugovës dhe *Çunaku* në krahinën e Llapit që në të vërtetë janë korelate semantike të emrit *Pupevci*[652] e *Mikul* (khs. rum. *micul* "i, e vogël") të shtresës romane dhe të emrave shqiptarë *Voka, Vokrri, Vogli, Voca* e *Vokshi* të shqipes (nga mbiemri shqip. *vogël*) dhe të një *Mikul* të shtresës vllahe.

Ndër emra vëllazërish të katundeve Brod, Zli Potok e Dikancë të Gorës ka edhe emra vëllazërish si *Kokica*, e *Kokljevci* të sajuar me të zgjeruar përmes prapashtesash sllave *-ica* dhe *-evci* të antroponimi shqip *Kok*/*ë* që s'mund të largohet nga antroponimi *Kokë*, *Kokal* dhe nga patronimi *Kokaj* i shqiptarëve; pastaj *Koljovci, Cekanovci* e *Kangovci*, të cilat ndeshen edhe në korpusin antroponimik të shqiptarëve; emri i dytë na e përkujton emrin shqip **Kolaj* (nga shq. Kol,-a, në trajtën e tij deminutive nga lat. *Nicolaus*), ndërsa tek emri i tretë ka arsye të kërkohet një lidhje me antroponimin *Çesk* të shqiptarëve që në këtë rast s'do të jetë tjetër veçse një trajtë deminutive shqipe e emrit *Françesk*. Po ky fenomen do të ketë ndodhur mbase edhe tek emri *Çesolli*, i vëllazërisë që e banon një pjesë të katundit Prapashticë të komunës së Prishtinës, emri i së cilës (vëllazëri) është formuar me një prapashtesë tjetër. Emri *Kangovci* i vëllazërisë gorane duket se ruan shenja të lashta të leksikut e të fonetikës së shqipes. S'ka dyshim që tek emri *Kang- ovci* duhet parë trajtën e tij të

---

[650] Përputhja kuptimore midis këtyre dy emërtimeve është aq e madhe sa që e përjashton mundësinë e një rastësie. Së këndejmi duket më e besueshme që këtu kemi të bëjmë me një *calque onomastique*.

[651] Khs. Tapu ve kadastro ümüm müdürlügünün Arşivi, Ankara, Defter (i pabotuar në tërësi) i regjistrimit të kryefamiliarëve të sanxhakut të Vushtrrisë, pas gjithë gjasësh i viteve 1566 - 1574, i transliteruar nga Qemal Haruni, (Shkup) (Dorëshkrim). Ky defter citohet në punimin tim edhe sipas versioneve të lexuara nga S. Pulaha, M. Tërnava e I. Rexha.

[652] Sh. Franz Miklosich, Die slawischen Personen- und Ortsnamen. .., 303., ku janë evidentuar emrat *Pupic, pupec*, në të cilat përmbahet apelativi *pup*, porse pa e pas dhënë sqarimin e vlerës kuptimore të kësaj fjale. Nëse, nga ana tjetër, ky emër do të mund të kishte gjë të përbashkët në rrafshin e prejardhjes me toponimin *Pupe*(n) *sis vicus* (katund në rrethina të Pllovdivit të sotëm të Bullgarisë) që e trajtonte Ivan Duridanov, Ezikът na Trakite, Izdatelstvo "Nauka i izkustvo", Sofia 1976, f. 45.) unë e lë për çështje të hapur.

vjetër e cila gjatë shek. XV[653] e më vonë tek shqiptarët (si rezultat i kalimit, normal përbrenda shqipes, të *g* në *gj*) dëshmohet në trajtën *Kangj-*, ndërsa tek shqiptarët e ardhur në Kosovë në vitin 1876 nga e ashtuquajtura "Serbi e Jugut" është ruajtur si *Kongjel* (mbase nga një **Kangjel*, më e vjetër). Në dritën e emrit *Kangjovit* të një vëllazërie të katundit Orllan dhe të mikrotoponimit *Fusha e Kangjit* në katundin Mramuer afër Prishtinës dhe mbi të gjitha në dritën e rrethanës që trajta që shqiptohet si *Ka(n)g* dëshmohet edhe nëpër burime venedikase, mund të nxirret përfundimi që trajta më e vjetër e këtij emri është *Kang*. Për e zhvilluar në harmoni me fonetikën e shqipes duhet të merret trajta *Kangj*. Se këta dy emra që dalin sot në krahinën e Gallapit nuk janë të vetmit e të vetmuar dhe as të rastit duket se e vërteton dëshmimi i patronimit *Kangovic* të një konti, patrici mbase roman të Novobërdës në gjysmën e parë të shek. 15, i cili mbase nuk mund të ndahet as historikisht nga emri *Kangjovit* i vëllazërisë shqiptare të Orllanit.

Me prejardhje nga shqipja do të jenë edhe emrat e vëllazërive *Kajkuševci* (në Gllboçicë) dhe *Kajqovci* në Lubovishtë që duket se rrjedhin nga antroponmet *Kaj*/*ë*, *-a*, dem. *Kajo* dhe *Kush*; *Kuševci* nga antroponimi *Kush*, si edhe *Kaloševci* (i shënuar edhe si *Koljoševci*) nga trajta deminutive Kolosh e antroponimint *Nikollë*, *Kolë* ose nga antroponimi Kal, (khs. emrin familiar *Kalaj* të shqiptarëve) në trajtën e tij deminutive *Kalosh*.

Përveç kësaj kategorie prej emrash të vëllazërive, në këtë regjion ka edhe emra që janë karakteristikë për shqiptarët shumë nga të cilët tek këta të fundit gjallojnë edhe sot. Këtu bien emrat e vëllazërive gorane: *Čavdarovci* (khs. mikrotoponimin *Çavdakas* në katundin Zaplugjë dhe emrin *Çavdërbasha* të vëllazërisë shqiptare), *Kuklevci* (khs. emrat *Kukleci, Kuka, Kukaj* të vëllazërive shqiptare); *Orućovci* [në Orçushë të Gorës] (kujto emrat *Oruçi*, *Oruçaj* të vëllazërive shqiptare); *Čokovci* [në Restelicë të Gorës], që ta përkujton emrin e një vëllazire/lageje *Çok* të katundit Koliq të komunës së Prishtinës (khs. edhe më lart); *Gagovci* të Gorës që na e përkujton emrin *Gagica* të katundit Desivojcë të Kamenicës, ashtu sikundër emri *Memiševci* i vëllazërisë gorane [në Vranisht], na e përkujton p.sh. emrin homonim të vëllazërisë që ndër shqiptarë dëshmohet në regjistrimin turk të popullsisë së nahijes Zhupa të Dibrës në shek. 16,[654] por që dëshmohet edhe në trajtën e mirëfilltë Memi pa u pas zgjeruar me prapashtesa të tjera si p.sh. *Memiš; Memiševci* etj.

[653] Khs. te M. Dinić, Iz Dubrovačkog arhiva I., f. 82.
[654] Sh. M. Sokoloski, Nahijata Župa. .., f. 235.

Këtu dalin edhe emrat *Odovci* (në katundet Leshtan e Bačkë) dhe *Bašinci* (në Zli Potok), të cilët na i përkujtojnë emrat e përhapur gjerë të vëllazërive shqiptare[655] *Hodaj*, *Karahoda* dhe *Basha*, që gjallojnë në treva të ndryshme të hapësirës gjeoetnike të banuara nga shqipfolës.

Në përmbyllje të kësaj pjese të krahasimeve bën të përkujtohet që edhe emrat e vëllazërive gorane *Brićkovci, Malekovci* (në Rapçë) *Šuke* (sot Ibrovci), *Paćarizovci* dhe *Poštarovci* (në Rapçën e Epërme) janë edhe emra të shqiptarëve. Emri i parë është i ngjashëm me emrin *Biçku* të një vëllazërie të katundit Hogosht si dhe me mbiemrin *Brisku* të shqiptarëve, ndërsa emri *Malekovci* do ta ketë për rrënjë antroponimin shqiptar *Mal*, i cili në krisobulat e sundimtarit serb St. Dushan të vitit 1330 dëshmohet në trajtat *malik* e *malc*,[656] si edhe në krisobulën e vitit 1348 të këtij sundimtari.[657] Ky emër gjendet edhe në trajtën e tij mesjetare tek emri *Maleta* i një vëllazërie të regjionit të Shalës së Bajgorës dhe në trajtën e toponimizuar tek emri i vëllazërisë dhe i katundit *Malaj* të krahinës së Rugovës. Tek emri *Šuke* i vëllazërisë gorane duhet parë një emër të njëtë me emrin **Shukaj* i cili është mveshur me prapashtesë sllave, përkatësisht është formuar sipas formantit sllav. Emri *Šuke* nuk ka si të ndahet nga trajta e zvogëlisë e emrit *Pashk* të shqiptarëve.[658] Emrin shqiptar *Pashk* në trajtën e tij deminutive të formantit serb e kam ndeshur edhe tek emri *Šukići* i një vëllazërie të katundit Drajkovc, të banuar nga serbë në Malet e Sharit.[659]

---

[655] M. Pavlović, Altsächsische Bergbauterminologie im Serbokroatischen, Südost-Forschungen 17, 1959, 78. Emrat e vendeve *Hodinci* afër Jastrebac -it, *Hodovo* afër Stolac-it (në Bosne) Vl. Škarić i konsideron për të prejardhjes sase, sepse ky i mban këta emra për trajta të toponimizuara të temës emërore, antroponimike *Hod-* për të cilën po ashtu e paravendon prejardhjen sase.

[656] Sh. Miloš S. Milojević, Dečanske hrisovulje. .., f. 47 ku është evidentuar banori i quajtur *Malc*, në katundin Serosh të rrethinave të Rahovecit, një ambient në të cilin jetonte edhe banori bartës i antroponmit tipik shqiptar *Prenko*.

[657] Sh. Hrisovulja cara Stefana Dušana. .., f. 293.

[658] Duket se mendimit të përhapur në gjuhësinë e në dijen onomastike shqiptare i kundërvehen dëshmitë: *Succo: Johannes Succo* (1030) dhe *Such* në Kotor (1430) e ndonjë tjetër të cilat sikur e vënë në dyshim ndërmjetësimin shqiptar dhe e bëjnë të domosdoshëm kërkimin e burimit të këtij fenomeni tek dëshmitë onomastike romane duke i parë emrat e regjistruar në Split e në Kotor për si emra të pjesëtarëve të sllavizuar të popullsisë romane e shqiptare të kësaj hapësire. Apo vetëm se një përputhje të rastësishme fonematike të trajtës deminutive *Shuk* të emrit *Pashk* të shqiptarëve (më shumë shembuj të dëshmuar të këtij emri ka tek K. Jireček, Romani u gradovima Dalmacije. .., f. 345).

[659] Vetëm sa për ilustrim të kompleksitetit në rrafshin e përcaktimit të përkatësisë etnike të banorëve të sotëm, sidomos serbë, të Kosovës po e sjell të dhënën që unë vetë e kam shënuar në fund të viteve '70 të shekullit të kaluar, nga një informator vendës sipas të

Tek emri *Pačarizovci* i ruajtur edhe si mikrotoponimi si *Paçarizov* në Rapçë e Epërme duhet parë një emër që t'i përkujton emrat e vëllazërive shqiptare *Paçarrizi, Paçarrizaj* dhe *Paçarada*, ndërsa këta të fundit mund të shihen, në vija më të largëta, t'i heqin rrënjët nga antroponimi *Pak-*, përkatësisht *Pac-*. Pa pretenduar se po e zgjidh çështjen e prejardhjes së këtij emri, po shtoj vetëm se emri *Pac-*, *Paç- Pak-* i shqiptarëve mund të jetë në lidhje birësie me patronimin *Pakola* (khs. *Jon* Pakola e *Prvul* Pakola) të banorëve të Ključ-it e të Krajina-s shumica e banorëve të të cilëve mbanin antroponime vllahe[660] dhe me emrin e vëllazërisë *Pachosiane*, përkatësisht Pakošćane që për në ambientin katolik të rrethinës së Zarës dëshmohet në vitet 1518-1520. Të ngjashëm me emrat e vëllazërive shqiptare të Opojës janë edhe emrat e vlëllazërive gorane *Toljovci* (në Brod), *Kučkovci*, i cili dëgjohet edhe në trajtën *Kučkarevci*, *Kukomarovci* (në Vranisht) dhe emri i vëllazërisë *Šata*/*Štatinci* që në katundin Brod dëgjohet edhe për si Štanovci. Këtu do të binte edhe mikrotoponimi *Šatovo* i katundit Restelicë. Tek këta emra vëllazërish të goranëve përmbahen antroponimet që në funksion emrash të vëllazërive si p.sh. *Tolaj*, tek shqiptarët janë ruajtur deri në ditët tona në rrethina të Deçanit - emër ky që pikërisht për në këtë zonë është dëshmuar edhe në shek. 14. Edhe nëse pranohet për i qëlluar dhe i besueshëm mendimi i sllavistit të mirënjohur Fr. Miklosich dhe ai i dijetarit serb M. Pavlović[661] del, megjithatë, paravendimi që për faktor vendimtar si në marrjen ashtu edhe në dhënien e këtij emri ishte gjuha shqipe, përkatësisht folësit e saj në Bjeshkët e Nemuna e në Bjeshkët e Sharit. Emri *Šatinci* i vëllazërisë gorane është i ngjashëm me antroponimin e tipit *Shat.-i*, përkatësisht *Šate* të cilin në shek. 15 e gejmë të dëshmuar për patronim të banorit Pejo, i bir i Shate-s të katundit Vrapçishtë të Tetovës[662] në një kohë kur, në dritën e shembujve të sjellë më lart, procesi i kalimit *s* → *sh* te ky emër në regjionin e Gorës nuk kishte filluar ende. Fenomenin e kalimit *s* → *sh* e dëshmojnë antroponime të popullatës shqiptare të sanxhakut të

cilit popullata serbe e këtij katundi qenka e fisit Hot dhe se nga serbët e "Serbisë së Mirëfilltë" këta serbë kosovarë po u quajkuan *arbanaši* "të shqiptarizuar".

[660] Khs. Rdmila Trickovic, Dva turska popisa Krajine i Ključa iz 1571 godine, ekstrakt nga Miscellanea 2, Beodrad, 1973, f. 207.

[661] Khs. Franz Miklosich, Die Bildung der slavischen Personennamen, Denkschriften der Philosophisch-historischen Classe der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften X, Wien, 1860, f. 320.); Milivoj Pavlović, Alsächsiche Bergbauterminologie. .., f. 77. dhe Ostaci dubrovačkih i saških govornih osobina u Janjevu, Istoriski Časopis, II, Beograd, f. 297 - 302, se tek emrat *Toloje, Toljen, Toliša* dhe tek emrat e vëllazërive që janë sajuar nga ky antroponim po u lidhkan me apelativin sllav *tol, toli* lat. *placatio, placere.* "pëlqej, kënaqem".

[662] Khs. Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod. .., f. 405.

Shkodrës të regjistruar në vitin 1485, kur janë evidentuar banorët myslimanë të Pejës e të Shkodrës: Ali, Abdi, Hazer dhe Jusuf *Sati*; Mehmet *Sat'ami* dhe Ahmet *Sati* dhe një person i quajtur Rasko, i bir i *Satko* -s nga katundi Lasko-Zhupa i krahinës së Piperëve[663] (Mal i Zi). I ngjashëm me emra të këtij tipi është edhe ai që, ndër banorë të katundit Vrapçishtë të Tetovës, në të cilin kishte edhe ndonjë shqiptar: khs. *Pejo*, i bir i *Arbanasit*, dëshmohet në trajtën *Shat* –i, khs. emrin familiar: Pejo, i bir i Shat-it, përkatësisht *Pejo, sin na Šate* të njërit nga kryefamiljarë të këtij katundi.[664] Lidhur me këtë emër duhet theksuar, bashkë me Bezlaj,[665] se një burim, prejardhje tjetër duhet kërkuar për emrat *Šatrina* e *Šatrinci* të hapësirave gjuhësore të serbishtes e të kroatishtes. Tek emrat e mësipërm po u dashka të kërkohet fjala *šatra* ("tenda e tregtarit në treg", hung. *šatšr* dhe një burim tjetër për toponimin *Šatrovec* të Sllovenisë dhe për apelativet kroate *šatronje, šatrenje, šatrija, šatrenik* e *šatriga*, për të cilat Mažuranić e pandehte një prejardhje nga *striga* "shtrigë"e burimit latino-roman. Zgjidhja e çështjes së prejardhjes së emrit *Šatinci* me fjalën shqipe *shat*, siç propozonte E. Çabej,[666] jo për këtë porse për toponimin

[663] Khs. Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës. .., f. 50, 135, 158, 418.

[664] Sh. Turski izvori na istorija na makedonskiot narod. .., Defter Nr. 4, f. 405.

[665] Sh. Slovenska vodna imena, II, Ljubljana 1962, f. 232.

[666] Pikërisht këtë apo një emër fonematikisht të ngjashëm me tonin e kishte për objekt studimi edhe E. Çabej, khs. Studime gjuhësore VI (Gjon Buzuku dhe gjuha e tij), Prishtinë, 1977, f. 9. Tek emri mesjetar *castrum Satti* i vitit 1396 ky shihte më parë trajtën e vjetër rumune *sat* "katund, fshat" se sa emrin e veglës së punës bujqësore *shat,-i*. M. Šufflay, Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters, Wien, 1924, f. 34. gjente, nga ana tjetër, në këtë dhe në emrin e vendbanimit *Ndenshat* fjalën shqipe të veglës së punës *shat, -i, shate, shat.* Në dritën e rrethanës që në një letër të Lekë Dukagjinit, drejtuar Republikës së Venedikut në vitin 1458 ON (khs. St. Novaković, Zakonski spomenici. .., f. 292) përmendet qyteti *Sati* i dukagjinëve të cilin Leka ua dorëzonte venedikasve, ka arsye të besohet që, nëse jo me një emër homonim, kemi të bëjmë pikërisht me katundin apo kështjellën *castrum Satti* të vitit 1396. që ishte pra në dukatën e Dukagjinëve. Për shkak të mungesës së dëshmive të shkruara të emrit të vëllazërisë gorane nuk mund të thuhet nëse edhe ky do të duhej të shqiptohej **Shat* apo ndoshta edhe emri *Satti* i shek. XIV- do të jetë shqiptuar si *Shati.* Sido që të jetë, të dy këta emra e kanë një prejardhje të përbashkët. Nëse duhet që emri i shek. XIV të lexohet si *Sati*, atëherë do të duhej paravenduar që emri *Shatinci* i Gorës do të jetë një formim që në këtë trajtë mund të dalë vetëm nëse është trajtësuar nga goja e shqipfolëseve, ndërsa po qe se *Satti* do të duhej shqiptuar si *Shati*, atëherë do të kishim dy emra të njëjtë dhe diç më shumë. Kjo "më shumë" lidhet me çështjen e territorializimit të katuneve blegtorale mesjetare, me urbanizimin dhe me profesionet e popullatës. E gjithë kjo që u shtrua këtu do të mund të ishte e besueshme nëse nuk ka ndonjë lidhje midis emrave të hapësirës gjuhësore të shqipes me emrin *Satnik*: *Petrus Satnich* (khs. Konstantin Jireček, Romani u gradovima Dalmacije. .., f. 334, 342) të një banori të qytetit të Splitit të dëshmuar në vitin 1398 d.m.th. nëse këtu

Ndenscaati, që në vitin 1641 përmendet tek Frang Bardhi,[667] më duket i bindshëm, jo porse edhe në rrafshin onomastik-semantik. Trajta nën të cilën është ruajtur emri i vëllazërisë gorane (pra me prapashtesën *-inci*, tregon përkatësi, prejardhje dhe lidhje gjaku e, së fundi, edhe dyndje. Vlera kuptimore që e ka fjala *shat* në kuptimin e veglës së punës është e vështirë të pranohet si motiv emërtimi i një vëllazërie. Duke u nisur nga ky paravendim, më e pranueshme më duket prejardhja e këtij emri nga një antroponim. Po të jetë kështu, atëherë ky dhe emra të tjerë homonimë duket të jetë me prejardhje nga latiniteti ballkanik. Në këtë kontekst, emri ynë mund të jetë refleks i një antroponimi latin, roman *Satianus*, dëshmi të shkruara të të cilit gjejmë në mbishkrimin varror "*I*(ovi) *o*(ptimo) *m*(aximo) // *Q. Val*(erius) *Sati*-II *anus l*(*ibens*) *p*(osuit)", të gjetur në katundin Karan të Serbisë.[668]

Një çështje që në këtë kontekst do të duhej pasur parasysh është reflektimi i *s*- nistore tek lënda leksikore e onomastike e shqipes, e huazuar nga latinishtja ballkanike. Në dritën e fenomenit të kalimit të *s* → *sh*, që është zhvilluar edhe në shembujt e sjellë më lart, do të duhej të rezultonte (duke i pasur parasysh shembujt: lat. *sanitates* → shq. *Shëndet*, *sollanum* → *shulla*, *salix* → *shelg*, *septem* → *shtatë*, *sambucus* → *shtog*, *sanctus* → *shenjt* etj.), se trajta *Šatinci* e emrit të vëllazërisë gorane do të ketë dalë në harmoni me këtë rregull fonetik të gjuhës shqipe.[669] Po të jetë kështu, do të duhej lejuar paravendimi që në hapësirën e sotme të krahinës së Gorës kishte një shtresë popullate autoktone e cila e përçoi fenomenin e kalimit të *s* në *sh* para se në këtë hapësirë të nguliteshin pararendësit vlleh të bullgarizuar të popullatës së sotme sllavishtfolëse të Gorës.

Në dritën e mungesës së këtij emri në këtë trajtë në atë hapësirë e cila gjatë mesjetës, më heret e edhe sot është e banuar nga popullata shqip-

nuk kemi të bëjmë me një emër të shtresës romane që u ruajt edhe pas sllavizimit të popullatës romane. Një sqarim, pas gjithë gjasësh bukur i pranueshëm i këtij emri do të ishte afrimi i tij me apelativin *satъ* "pjesë e veshjes" të gjuhëve sllave të Perëndimit khs.: sorb. *sat* gjerm. "Kleidungsstück, Kleid, Wäschestück, Leinwand"; polab. *saty* "Wäsche, Gewand, Kleid, Kostüm, Zeug"; çek. *sat* "Kleid, Gewand, Tuch"; pol. *szata* "Kleid, Gewand" dhe bjellorus. *sata* "Kleid, Gewand"). (khs. Max Vasmer, Ältere germanische Lehnwörter im Slavischen, Zeitschrift für slavische Philologie, 11, Leipzig 1934, f. 50).

[667] Po ai, po aty (si në referencën e mësipërme)

[668] Sh. Nikola Vulić, Antički spomenici u Srbiji, Spomenik, SKA, XLVII, Beograd, 1909, 185, mbishkrimi nr. 125.

[669] Përkitazi me këtë fenomen sh. Franz Miklosich, Albanische Forschungen II, Die romanischen Elemente im Albanischen, Wien, 1871, f. 61.

tare, do të lejonte të shtrohej hulumtimi i lashtësisë së këtij reflektimi tek popullata e Gorës. Variantet me *S* (kujto shembujt *Sati*, *Sat'mi*, *Satko*) të këtij emri dhe variantet me *Sh* të tij tek popullata e Gorës flasin mbase për një heterokroni të hyrjes së elementit onomastik roman në hapësirat e banuara nga shqiptarët. Kjo (heterokronia) do të ishte mbase edhe i vetmi sqarim i reflektimit dyfarësh fonetik i këtij emri tek shqiptarët.

Tek emri *Kukokmarovci* duhet parë njërin nga emra të përbërë nga antroponimi *Kuk* që dëshmohet edhe në trajtën *Kukoq*. Duket që ky emër është, pas gjithë gjasash, i formantit të emrave të përbërë të tipit *Burrëmadh*, *Gojëmadh*, *Bythëdosë*, *Bukëmirë* etj. të shqiptarëve. Po i takoi kësaj kategorie, atëherë te ky emër do të mund të kërkohej një trajtë e kryehershme **Kokëmadh*. Kjo do të ishte e mundshme në rrafshin semantik, por në rrafshin e fjalëformimit dhe për shkak të analogjisë fonetike ky emër qëndron më afër rumanaishtes. Ka mundësi që në pjesën e dytë të emrit, përkatësisht tek mbiemri *mare* të përmbahet mbiemri rumun *mare* "i madh". Në dritën e përmbajtjes së mbiemrit rum. *mar* në pjesën e dytë të emrit, do të shihej qartë bashkëjetesa e shqiptarëve të kësaj treve me atë popullatë, e cila procesin e romanizimit e kishte përjetuar më thellë ose, siç thuhet tradicionalisht, me elementin vllah të kësaj pjese të hapësirës gjuhësore të shqipes. Duket, megjithatë, që këtë emër ta ketë sjellë në këtë regjion pikërisht ndonjë vëllazëri vllehsh sllavisht- përkatësisht bullgarishtfolës të ardhur nga hapësira gjuhësore e greqishtes. Kjo sepse ka dëshmi, ç'është e drejta vetëm shkrimore të shek. XV, sipas të cilave fjala *kukumarъ* e serbishtes së vjetër, sipas M. Vasmer-it[670] po rrjedhka nga greq. e mesme κουκουμάριον "enë e madhe". Duke qenë se, gjithnjë sipas Vasmer-it, edhe vetë fjala e greqishtes është me prejardhje nga *cucumārium* e latinitetit ballkanik, ka mundësi që fjala serbe (S.G. edhe bullgare ?) të jetë huazuar drejtpërdrejt nga romanishtja.

Vështruar në pikëshikimin e formimit prapashtesor dhe në pikëpamje të traditës emërore, me prejardhje shqipe do të jenë edhe emrat e vëllazërive *Kološevci*, përkatësisht *Koljevci* të katundit Baçkë të Gorës, në të cilin është edhe mikrotoponimi *Kolin rid*[671] "Guri i Kolës" e *Koljoshoska*, vend në Restelicë; *Bibarovci* dhe *Luminci* (në Restelicë). Mbase nuk mund të shihet për hap i guximshëm afrimi i mundshëm i emrit *Kološevci* të vëllazërisë gorane me emrin *Kalusina* të katundit që

[670] Khs. Die griechischen Lehnhwörter im Serbo-Kroatischen (Einzelausgabe aus den Abhandlungen der Preußischen Akademie der Wissenschaften, Jahrgang 1944, Phil.-hist. Klasse. Nr. 3.), Berlin, 1944, f. 86.

[671] I shënuar në terren nga J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 68.

në vitin 1530 i takonte krahinës së Gorës dhe kishte 5 shtëpi myslimane, 25 të krishtera dhe 4 beqarë.[672] Si tek emri i dëshmuar më 1530 ashtu edhe tek emri modern ka arsye të kërkohet trajta shqipe *Kolë* të emrit të gjithkrishter Nicolaus, përkatësisht Nikollë. Emri i dytë është i të njëjtit burim prej nga rrjedh edhe emri që ndër shqiptarë sot përdoret në funksion emrash të vëllazërive në trajtat *Biba, Bibaj, Bibi* (khs. edhe mtp. *Kroi Bibës*, në katundin Zym të Opojës. Emri i tretë duket se ruan kujtimin për një katund, përkatësisht për një vëllazëri me 15 shtëpi e 3 beqarë që, për në krahinën e Opojës, në defterin osman të vitit 1530 ishte regjistruar si *Lumja* (mund të lexohet edhe *Lubja*).[673] Duket se ka vend për paravendimin që, si rezultat i lëvizjeve të brendshme, vëllazëria që mbante për emër kolektiv të vetin emrin e një pararendësi të quajtur *Lum* të jetë vendosur në ambient sllavishtfolës dhe me kohë të jetë sllavizuar. Emri *Luminci* s'është tjetër veçse zgjerim prapashtesor me *-inci* i antroponimit shqiptar *Lum*, i sajuar mbase nga folja bëj *lum* "gëzohem; lumnohem; shendohem" e shqipes. Përveç këtu, këtë antroponim në funksion të emrit të vëllazërisë e gjejmë në katundin Bllacë të Suharekës, ku jeton vëllazëria e quajtur *Lumi*. Antroponimi *Lum* ndeshet sot gjithandej nëpër Kosovë. Duket se emrat e vëllazërive *Ćesasevci, Ljušinci*, *Zizinci*, *Dočka*/*Dočkinci* (në Brod), *Alovci* e *Ćafševci* nuk mund të ndahen lehtë nga antroponimet e shqiptarëve *Çesk* (nga Françesk); nga trajta e shkurtër *Lush e* antroponimit të shqiptarëve; në dritën e rrethanës se emri i dytë, mbase i kryehershmi, i kësaj vëllazërie ishte *Kucovlasi* që mund të jetë një variant i emrit *Karagunid/Karavlasi*, " vlleht e zinj" lejohet paravendimi që goranët e ruajtën për emër të tyre variantin në përkthimin shqip të emrit të kryehershëm të asaj vëllazërie vllahe, i formuar sipas modelit shqip që ndeshet tek mbiemrat e shqiptarëve *Zeza*, *Ziu*, (khs. edhe trajtat *Mziu*, *Mzija*, *Mzeza*); nga antroponimi *Doç*; nga emri *Alaj* i vëllazërisë që edhe në ditët tona, përveç gjetkë, gjallon në rrethina të Deçanit; nga emrat e vëllazërive shqiptare të tipit *Qafleshi*, *Qafzezi* e nga ndonjë tjetër.

Duket se me prejardhje shqipe do të jenë edhe emrat e vëllazërive gorane: *Aginci* (në Restelicë) dhe *Shokarovci* (në Brod). Unë kujtoj që emri i parë nuk mund të ketë ndonjë lidhje prejardhjeje me fjalën turke *aga* me kuptimin primar "pronar; qytetar i situuar mirë ekonomikisht, kryepar, latifundist".[674] Mua më duket, sado që hipotetik, mendimi i J. G. von Hahn

[672] Khs. referencën e mëposhtme.

[673] Për të dhënat burimore sh. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 158.

[674] Për zgjerimet e tjera kuptimore të kësaj fjale në variantin boshnjak të sllavishtes së jugut, sh. A. Škaljić, Turcizmi u srpskohrvatsom jeziku. .., f. 72-73.

e i Dh. Kamardës se te ky emër bën të kërkohet kuptimi i kryehershëm "zot i dritës, i ditës, i agimit" se sa lidhja e tij me atributin turk *aga*.[675] Së këndejmi, edhe emri *Agallarët* i një vëllazërie shqiptare në Brodosanë bën të shihet vetëm si krijim i mëvonshëm duke barazuar këtë me nocionin administrativ turk. Fundja, në të mirë të mendimit tim do të fliste shtrirja e emrave të këtij formanti sidomos në vise malore, blegtorale të banuara nga shqiptarët, kah dalin emrat *Agani*, *Agaj*, *Agolli* e ndonjë tjetër. Emri *Šokar/Šokarovci* i vëllazërisë gorane (në Brod) nuk ka mbase si të ndahet nga mbiemri *Šoć* në Mal të Zi, i sajuar nga fjala shqipe *shok*/*shoq* me kuptimin e kryehershëm "kushëri; i afërm i gjakut". Kjo aq më parë pse emri *Šoć* dëshmohet edhe në krisobulat e Deçanit të vitit 1330 dhe pikërisht në vendbanime, banorët e të cilëve mbanin jo pak antroponime shqipe. Kështu, në katundet e sotme Rostovicë e Strellc të rrethinave të Deçanit jetonin nga një kryefamiljar të quajtur *šokъ*.[676] Se emri *šokъ* e kishte kuptimin e vjetër, "kushëri, i afërm i gjakut, i ndarë fisi" të shqipes *shoq* duket se e dëshmon korelati semantik *drougъ,* përkatësisht *drug* "shok"- i ndeshur si emër personal i një kryefamiljari të katundit Babe (sot Babaj t'Bok's e Babaj t'Slloqit); i dy banorëve të katundit Gramaçel të rrethinave të Deçanit dhe i dy kryefamiljarëve të katundit Serosh në rrethina të Rahovecit, e ndoshta edhe emri *prijatelj* "mik; shoq" i një banori të katundit Luboliq të rrethinës së Deçanit).[677]

Ndër emra shqip të vëllazërive gorane do të binte mbase edhe emri *Počarinci* i një vëllazërie të katundit goran Rapçë e Epërme. Ky emër do të jetë sajuar mbase nga fjala shqip *poç*, , kënatë, shtambë/shtëmbë" e zgjeruar me prapashtesën *-ar* e cila, për si *nomen profesionis* e shenjon poçarin, përkatësisht shtëmbarin. Një dëshmi për ushtrimin nga shqiptarët të zejes së poçerisë e gjejmë në vitin 1348 kur ndër banorë të qytetit të Prizrenit dëshmohet edhe një i quajturi "Lesh shtëmbari" përkatësisht *lěšь grьnčar*.[678] Se tek emri *Počarinici* i vëllazërisë gorane kemi të bëjmë me një emër shqip *poçar*, të zgjeruar me prapashtesën sllave *-inci* e cila shenjon edhe njerëz që merren me një zeje konkrete, sikur e tregon edhe *Čupevđija* (nga turq. *çüp* "vegësh") i një vëllazërie/ lagjeje në katundin Restelicë të Gorës.

---

[675] Khs. për këtë E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, II (A-B), Tiranë, 1976, f. 15-16.

[676] Khs. Dečanske hrisovulje f. 9,75.

[677] Khs. Dečanska hrisovulja f. 9, 11, 14, 17, 46, 47, 98.

[678] Khs. Hrisovulja cara Stefana Dušana. .. 270; 272:, ‚A se imena ljudemъ sp(a)sove koi su u gradù. .. lěšь grьnčar [...] gωnь; [...] i priloži c(a) r (s) tvomi vlasteličik'ja c(a) r(s)tvami, novaka peciju..."].

13. AREALI EMËROR I ETNONIMISË SË GORËS

Në dritën e shtrirjes territoriale (arealit) të emrave të vëllazërive të krahinës së Gorës e rrjedhimisht edhe të asaj fqinje të Opojës, mund të pohohet që pjesa dërmuese e emrave përputhet me sish të trevave veriore të hapësirës së gjuhës shqipe dhe me sish të Malit të Zi të sotmit, ndërsa një pjesë më e vogël përputhet me emra të Malësisë së Tetovës dhe të krahinave të tjera të Kosovës.

13.1. Përputhje të emrave të vëllazërive të sotëm të Gorës me sish të rrethinave të Shkodrës, Ulqinit e të Tivarit

Përveç me emrat e vëllazërive të banorëve shqipfolës të krahinës fqinje të Opojës, të regjionit të Malësisë së Tetovës dhe të Kosovës si tërësi etnilinguistike gati për gati ekskluzivisht shqiptare, shumë nga emra të vëllazërive të banorëve të regjionit të Gorës përputhen edhe me emra personalë e me emra vëllazërish të rretheve të Shkodrës, të Ulqinit e të Tivarit. Këto përputhje i dëshmon më së miri lënda onomastike e përmbajtur në Kadastrin venecian të ashtuquajtur Kadastri venecian i Shkodrës i vitit 1416, në të cilin përmbahet material onomastik pikërisht në fushën e antroponimisë edhe për Ulqinin e për Tivarin. Në këtë kadastër dëshmohen p.sh. edhe banorë të cilët mbanin antroponime apo mbiemra familjesh të mëdha, çfarë dëshmohen sot edhe ndër emra vëllazërish jo vetëm të regjionit të Gorës, por edhe të atyre në gjithë hapësirën gjuhësore të shqipes. Në vazhdim po e japim një paraqitje panoramike të përputhjeve të tilla: Andrea *Lochay* [lexo Lokaj] nga katundi Grissa[679] (në Gorë: Ljokanova, *Ljokanovci lagje* në Brod); Jon *Renesi*, Lazaro *Renesi*, Andrea *Renesi* - banorë të katundit Marsen, Bencho *Renesi* - banor i katundit Bard në la Saldia, Stefano *Renesi* nga katundi Xamorag, Martin *Renesi*, banor i katundit Renisse në Medoa dhe Stefano *Renesi* nga Sarachinopol (në Gorë: *Rendovci*); Petro e Pali *Cucula* nga San Serzi (lexo shën Sirgji) Adam *Cucholo* nga Charachi (Kakarriqi i sotëm i rrethinave të Shkodrës?) dhe toponimi "ville clamade *Chucholi*, (në Gorë: *Kukljevci*); *Ciproe* Sugor nga vendbanimi Copenico* (në Gorë: *Kiprinci*); Menchesi dhe Jon *Satin* nga katundi Martani, Martin *Satin* e Jon *Satin* nga katundi Gostoli e Misgoy (në Gorë: *Šatinci*); *Macon* Petico nga Chaldironi, Radomir *Macelay* nga Podegora dhe Martin *Machanare* (në Gorë: *Makočevci*, *Maćkovci*, *Maćorovci*); Radosclauo *Mantoci* nga Grouemira Grandi (në Gorë: *Mentovci*); *Chiurcho* Tusi, banor i katundit

[679] Sh. Skadarski zemljišnik od 1416, priobčio Sime Ljubić, Starine JAZU, XI, Zagreb 1882 (në krejt dokumentin).

* Sot Koplik, në rrethina të largëta të Shkodrës..

Grissa (në Gorë: *Čurkovci*); Nica *Durago* nga katundi Ruscoli (në Gorë: *Durakovci*, në Zlipootok); Pop Bitri *Cochien* nga katundi Caldiron (në Gorë: *Kokljevci*) etj., khs. edhe emrin Durakaj të një vëllazërie në katundin Kuk(ël).[680] të Opojës.

Shembujt e përputhjes etimologjike - semantike të emrave të krahinës së Gorës me ata të rrethinës së Shkodrës dhe të hapësirës së Malit të Zi dëshmojnë se popullsia e Gorës kishte jetuar nën të njëjtat rrethana historike (të reflektuar pra edhe në onomastikën gjegjëse) dhe, për rrjedhojë, edhe sajon një areal onomastik identik me atë të emrave të vëllazërive të dëshmuara në Kadastrin venecian të Shkodrës.

13.2. Përputhje të emrave të vëllazërive të goranëve me sish të Malësisë së Tetovës e të Kosovës në shek. 15

Emrat e vëllazërive të banorëve të regjionit të Gorës përputhen me patronime banorësh të dëshmuara në regjistrimin osman të kryefamiljarëve në vitet 1467-1468,[681] të Malësisë së Tetovës, të rrethinave të Prilepit, Kërçovës, Gostivarit, shkurt të viseve të banuara nga shumica shqiptare. Nga materiali i këtij regjistrimi mësohet se në vendbanime të hapësirës gjuhësore të shqipes në Maqedoninë e sotme dëshmohen individë që patronime i kanë po ata emra që tek populata gorane gjenden sot në funksion të emrave të vëllazërive. Më poshtë po i sjellim disa sish, sa për ilustrim: Dimitri *Mećkata*, banor i mahallës së të krishterëve të qytetetit të Tetovës, *Radić*,[682] i bir i *Mećijan*-it, në katundin Sv. Nikola afër Shkupit (në Gorë: *Mećkarovci*); Mihal, i bir i *Car*-it in Pustenik të Kaçanikut (në Gorë: *Carovci*, *Sarovci*); Marić, i bir i *Paskać*-it në Zajaz të Kërçovës, *Paskać*-i, i bir i Radoja-s në Selcë të Tetovës (në Gorë: *Paskinci*); Dušman-i, i bir i *Rendić*-it në Orlanci të Kërçovës (në Gorë: *Rendovci*); Pejo, i bir i *Sat*-it, në Vrapçisht të Gostivarit, Radislav, i bir i *Satkat*-it në Terstenë të Kaçanikut (në Gorë: *Šatinci*); Rajan, i bir i *Prčko*-s dhe Petko, i bir i *Prčko-s* në Lepenac - sot Novo Selo afër Shkupit, Stepan-i, i bir i *Prčko*- s në Gluhovo afër Shkupit (në Gorë: *Prcanovci*); Dojćin, i bir i *Al*-it në Osinqani afër Shkupit (në Gorë: *Alevci*); Todor, i bir i *Es*- it në Senekos të Tetovës (në Gorë: *Esovci*); *Cipo* Manko, në njërën nga lagjet e Prilepit, *Ciprijani* - katund i zhdukur në rrethina të Tetovës (në Gorë: *Kiprinci*); Petko, i bir i *Sarandin*-it në Lisiqan të

[680] Emër i shënuar në terren nga Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 114.

[681] Sh. Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod, Opširen popisen defter Nr. 4 (1467-1468), Shkup, 1971, bot. Metodija Soko1oski e Dr. Aleksandar Stojanovski.

[682] Sh. Selami Pulaha, Të dhëna ekonomike dhe demografike për krahinëen e Opojës, "Studime historike", 3/1975.

Kërçovës, (në Gorë: Sarandovci); Hasan *Saro* e të tjerë në Prilep, Pejo, i bir i *Sardzin*-it e të tjerë në rrethina të Velesit (në Gorë: *Sarovci*/*Carovci*); Mustafa, i bir i *Kasid*- it në katundin Selcë të Tetovës, *Kasud*-i, i bir i. ..,* në Gorancë të Kaçanikut (në Gorë: *Kasovci*); Trajko, i bir i Hokal-it (mund të lexohet dhe si *Çokal*), Ralće, i bir i *Čekal*-it në katundin Gradec të Tetovës (në Gorë: *Čekanovci*); Rajćo, i bir i *Makoč*-it në katundin Gordmanc të Shkupit (në Gorë: *Makočevci*)

14. VENERIME PËRKITAZI ME PREJARDHJEN E GORANËVE NË KONTEKSTIN E AREALIT EMËROR

Paralelet gorane-opojare në rrafshin e emrave të vëllazërive janë aq të shumta sa që lejojnë të thuhet se gati të gjitha vëllazëritë e entiteteve të sotme gorane e shqiptare kanë për pararendës kryebarinj me emra të njëjtë. Këta emra ndryshojnë vetëm me ngjyrimet prapashtesore: në Opojë, emrat e vëllazërive të formuara nga antroponime të përbashkëta për të dyja entitetet janë formësuar me mjete morfologjike të shqipes, ndërsa tek banorët goranë me prapashtesa sllave. Kjo gjendje e lejon pravendimin e arsyeshëm e të arsyetueshëm që emrat e vëllazërive të të dyja këtyre popullatave, sot gjuhësisht e etnikisht të ndryshme, rrjedhin nga një shtresë e përbashkët etnolinguistike. Rrënjët dhe arsyet e kësaj gjendjeje duhet parë dhe mund të sqarohen vetëm në kontekstin e historisë së lashtë dhe tek faktori jashtëgjuhësor, përkatësisht tek rregullimi social i shoqërisë në këto regjione.

Sa kohë që edhe vendbanimet e goranëve janë të ngritura mbi bazën e vëllazërive, të lidhjes së gjakut në vijën mashkullore, përkatësisht të hapësirës së përbashkët të kullotave që u takonin vëllazërive gjegjëse dhe barqeve të tyre, mund të thuhet se kjo strukturë sociale është plotësisht e ngjashme me atë të shqiptarëve dhe e shpjegon kështu fort mirë rrethanën përse në gjithë këtë zonë nuk ka as sot vendbanime etnikisht të përziera dhe as martesa të përziera. Mbetet porse të shihet cilat janë arsyet e gjithë atyre paraleleve midis emrave të vëllazërive shqiptare e gorane. A rrjedhin ato nga një substrat i përbashkët latin-ballkanik; a janë ato rezultat i lëvizjeve të brendshme midis goranëve e shqiptarëve apo kemi të bëjmë me sllavizim të shqiptarëve ose me shqiptarizim të goranëve.

Rrethana që tek popullata fqinje, shqiptare e krahinës së Opojës janë ruajtur më shumë emra, kryesisht vendës dhe, sidomos, disa sish me prejardhje nga latiniteti ballkanik (khs. mtp. *Shtatuli*, *Kapra*, *Kilikerja*/*Kërkele*, *Udha pukë* dhe fjalët *burgu* e *kurti*), ndërsa në regjionin e Gorës

* Emri i atit të Kasud-it mungon edhe në orinigjinal.

pothuajse nuk gjendet asnjë i tillë e lejon paravendimin që elementi etnik vendës i Opojës - si rezultat i autoktonisë, e pra edhe i kontinuitetit shqiptar të raporteve etnike-gjuhësore të antikitetit dardan - ilir, këto elemente të latinitetit ballkanik i kishte huazuar në vend, ndërsa mbishtresa e ardhur e prararendësve të goranëve sllavofonë ndonjë nga këto elemente (të latinitetit ballkanik) që mund t'i ketë gjetur në vendin e ri të tij të ngulitjes vetëm i formësoi sllavisht. Kjo popullatë solli, porse, me vete vetëm emrat vlleh të vëllazërive, sepse këndej erdhën pas sllavizimit gjuhësor të tyre në hapësirën gjuhësore të bullgarishtes, përkatësisht e sollën një gjendje të prararendësve të tyre rumunë të pas shekullit X - pas shkëputjes dhe vendosjes së degës së quajtur *vlleh* të rumunëve dhe *vllahisht* të idiomës së tyre në jug të Danubit. Së këndejmi, ky element mund të shihet për si rishtresim etnik në gjirin e pjesës gjuhësisht të romanizuar thellë të Ballkanit, përkatësisht të shqiptarëve.

Për shtresën e përbashkët tek emrat e vëllazërive të opojarëve e të goranëve, që e paravendon qenien dikur një dhe i vetmi element etnik, flet edhe rrethana që ndër emra të vëllazërive gorane ka edhe jo pak emra me prejardhje shqipe (khs. emrat shqip të lagjeve e të vëllazërive, të dëshmuara në gjysmën e dytë të shek. 15 dhe sidomos emrat aktualë të tyre) të cilat (vëllazëri) mund të jenë porse edhe më të vjetra se koha e tyre e dëshmimit dhe, anasjelltasi, mungesën e emrave sllavë, me ndonjë përjashtim, si p.sh. vëllazëria e *Domazet-ve* në Pllajnik dhe *Kozajve* në Shajne, të vëllazërive tek opojarët. Për një substrat të përbashkët, gjegjësisht për përkatësinë e përbashkët, të njëjtë onomastike e etnike të të dyja këtyre popullatave të sotme pas ardhjes së elementit vllah të bullgarizuar në këto zona, përveç emrave të përbashkët të shtresës së latinitetit ballkanik (khs. më lart) flasin edhe mikrotoponimet me prejardhje nga greqishtja e mesme/bizantine si psh. *Mavra*, *Paraspor*, *Perivoj* (khs. mtp, gorane *Paraspor* në Dragash e *Perivolji* në Shishtavec, Kukës). Më shumë se çfarëdo segmenti tjetër për një të kaluar të përbashkët më së pakut që nga shek. X-XII të këtyre të dy popullatave flet shumësia e emrave, të vendeve e të vëllazërive, me prejardhje të latinitetit ballkanik, përkatësisht emrat me prejardhje vllahe.

Veçori shquese në rrafshin sociologjik e shqiptarëve të Opojës dhe sllavishtfolësve të Gorës është mungesa e institucionit të fisit. Megjithëse në pak katunde opojare gjenden sot emra Krasniqi, Gashi, Shala (në Brezne), Berisha (mahallë në Buçe e në Pllajnik) e ndoshta edhe në Zgatar ku është vëllazëria *Brisha* emrin e të cilit J. Osmani[*] e merr për si *Berisha*, ka arsye të paravendohet që në këtë zonë kemi të bëjmë jo me

[*] Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006, f. 148.

fisin, por vetëm me institucionin e vëllazërisë/familjes së madhe dhe se këta emra (të fiseve) do të kenë hyrë, si rezultat i lëvizjeve të popullatës shqiptare, nga rrethinat e Kukësit, përkatësisht nga krahinëza e Lumës shumë më vonë se shek. XV për kur mendohet që tek shqiptarët u (ri)lind institucioni i fisit.

Një segment i lënë deri tani krejtësisht pas dore është ai i ndikimeve të ndërmjetvetshme gjuhësore shqipe-sllave (bullgare), me theks të veçantë mbi ndikimin e shqipes në gjithë hapësirën etnografike të Gorës.

Vetëm sa për ta marrë në shenjim për si cytje për ndonjë analizë kompetente dialektologjike, po e sjell mendimin sipas të cilit "Ndikimi i shqipes është më i theksueshëm në katundet gorane të Shqipërisë, ndërsa në sosh të Kosovës pothuajse i parëndësishëm." Nën ndikimin e shkollës e të administratës, në pjesën e Gorës brenda Shqipërisë kanë ndodhur ndryshime të dukshme në strukturën e gjuhës. Shumë shprehje të reja janë konstrukte shqipe që u modifikuan e u inkuadruan në gramatikën e gjuhës sonë: *se takojsalje* ("u takuan"), *ga burgojsalje* ("e burgosën"), go lirojsalje (("e liruan"), *završila tetvječare* ("e mbaroi klasën e tetë"), *davam mesim vo čikli ult* ("mbaj mësim në klasë të ulëta"). Nga ndonjëherë njohja e gjuhës shqipe është e nevojshme që të mund të ndiqet biseda. Ka një anekdotë e lidhur me katundin Orçikël. Për banorët e tij thonë se paradreke flasin "našinski", ndërsa pasdreke shqip. Ndryshe, bilinguizmi (përdorimi në komunikim i dy gjuhëve) është një veçori e pranishme ndër popuj të Ballkanit. Kështu ndodh edhe në pjesën e Gorës matanë kufirit (në Republikën e Shqipërisë) ku gjuhë zyrtare është shqipja, ndërsa gjuhë e folur e përditshme është ajo "*našinski*", përkatësisht bullgare e goranëve. Në krahinëzën e Zhupës, nën rrethana konkrete, përdoret gjuha e "fshehtë" *boškački*.[*] Edhe në vetë Prizrenin përbrenda një familjeje përdoren disa gjuhë. Kjo është pasuri, e kurrsesi pengesë". Në pjesën kosovare të Gorës "përdoren fjalët: *karpa, krepica, st'rga, grika, nusa* ("nuse,-ja") e ndoshta edhe ndonjë tjetër."[683] Përveç këtyre albanizmave që kujtoj se janë të vjetra, sidomos në dritën e ruajtjes tek goranët të fjalës *karpë* e cila në të folmen e përditshme të opojarëve shqiptarë nuk është më aktive, po e shtoj edhe sugjerimin e një mjeku shqiptar, njëkohësisht drejtor i Departamentit të Shëndetësisë në komu-

[*] Kjo gjuhë e fshehtë (dialekt argo) qenka shpikur nga serbë të krahinës së Zhupës së Prizrenit - muratorë e mjeshtër zejesh të tjera - që punonin në ambiente shqiptare, (p.sh. në Tetovë) në shek. XVI. Ka një mendim sipas të cilit nën emrin *boškački* të kësaj të folmje po u mëshehka emri i bogumilëve.

[683] Sipas Sadik Idrizi Aljabak: Gora - Jedan pogled unazad (dorëshkrim)

nën e Dragashit i cili në vitin 2007 më kumtonte se në të folmen sllave të goranëve paska shprehje si: *tera me srce*; *săm teška; a si stana* e ndonjë tjetër, të cilat qenkan përkthime të fjalpërfjalshme të shprehjeve lokale shqipe: *po m'qet zemra* "më shkon barku, kam kolit"; *jam e rândë* "jam me barrë; shtatzënë" dhe *a u çove*?

14.1 Bashkëjetesa e goranëve me shqiptarët

Elementi më i rëndësishëm që do të ndihmonte për ta zgjidhur realitetin e pështjelluar, të sjellë deri në shkallë enigme, të prejardhjes së goranëve duket se janë dëshmitë onomastike që jo vetëm e pasqyrojnë por edhe e dëshmojnë bashkëjetesën dhe bashkëshkrirjen e elementeve etnike romane ballkanike, shqiptare e bullgare të hapësirës etnolinguistike të pararendësve të goranëve dhe të vazhduesve të realitetit gjuhësor etnik të sotëm të tyre.

Ky realitet reflektohet më së miri me përputhjen e emrave me origjinë të përbashkët, të vëllazërive të popullatës së Gorës me emrat e vëllazërive të popullatës shqipfolëse të krahinës së Opojës, të Malësisë së Tetovës, të vendbanimeve të Kukësit e më gjerë. Kjo rrethanë e lejon nxjerrjen e përfundimit se prejardhja shqipe e disa emrave të vëllazërive të goranëve si: *Baljevci* (nga shq. *i, e balë* "i, e bardhë"), *Bardovci*, (nga mb. shq. *bardh*); *Bibarovci* (nga shq. *Bib, Bibë* e ky vetë nga lat. *Bibius*), *Bufle* (nga shq. *buf,-i* var. *hut,-i* zool. Uhu); *Cakovci* (khs. shq. *Caka*, *Cakaj*), *Cekovci* (khs. patronimin shq. *Cek*; *Cekë*), *Ćafševci* (khs. emrin e vëllazërisë shqiptare *Qaflleshi* nga shq. *Qaf'-lesh*); *Krčovci* (khs. variantin shqip të emrit *Kërçovë* të qytetit, sllav. Kičevo); *Kokljevci* (khs. Mbiemrat e shqiptarëve *Koka*, *Kokaj*); *Kolješevci* (khs. mbiemrat e shqiptarëve *Kolaj*, *Kolshi*, *Koleci* etj.); *Lekovci* (khs. mbiemrat e shqiptarëve *Leka*, *Lekaj*); *Likovci* (khs. antroponimin e shqiptarëve *Lik* dhe emrat e vëllazërive *Likaj*, *Liku* etj.); *Ljokanovci* (khs. mbiemrin *Lokaj* të shqiptarëve), *Luminci* (khs. antroponimin e shqiptarëve *Lum* dhe emrat e vëllazërive *Lumaj*, *Lumi*); *Malezinci* (nga emri i vendit të quajtur Mali i Zi, në rrethina të Pukës); *Rendovci* (nga fjala shqipe *rendës* "vrapues"); *Shatinci* (nga fjala shqipe *shat*, *fshat* "katund"); *Shukekinci* (nga trajta e shkurtër shqipe *Shuk* e antroponimit të shqiptarëve *Pashk*) etj. e dëshmojnë sllavizimin etnik të shqiptarëve si pasojë e bashkëjetesës me pararendësit e popullatës së sotme bullgarishtfolëse më heret se shek. 14.

Ndryshe do të ishte e vështirë, për të mos thënë e pamundshme, të gjendet ndonjë sqarim tjetër për inkuadrimin plotësisht të emrave të vëllazërive, të mikrotoponimeve e pjesërisht edhe të emrave të vendbanimeve të Gorës në arealin gjuhësor të shqipes që nga lashtësia mesjetare.

Thellësinë e bashkëjetesës dhe të bashkëshkrirjes shqiptare-gorane e ilustrojnë mjaft bindshëm

a) Disa emra me prejardhje të përbashkët të vëllazërive në Gorë e në Opojë, si p.sh.:

në G.[*] *Bašinci*, [*Bashaj* dhe mtp.dhe mtp. *Guri Ali Bashës*; *Fushat e Bashës* dhe *Fusha e Bashos* në O.[**]]; në G. *Bengo* [*Beneke* në O.]; në G. *Cako, Cakovci* [*Cakaj* në O.]; në G. *Ćolovci*, [*Çollaj* dhe mtp. *Gropa e Çollës* në O.]; në G. *Čučulovci, Čučulova*, Čučulj [Çuçur (tani Berisha), në O.]; në G. *Čufćinci*/*Čifčinci* [*Çufta* vëllaz. shqiptare në Gorë]; në G. *Dikanci* [*Dikaj* në O.]; në G. *Dišovci*, [*Dishallarët*, në O.]; në G. *Drdinci*, [*Tërtin* në O.], në G. *Durakovci*, [*Durakaj, Duraj* dhe mtp. mtp. *Lama Durakit* në O.]; në G. *Đuzel*, [*Xhyzelaj* në O.]; në G. *Gago*/*Gagovci*, [*Gegica* dhe mtp. *Kroi Gogos*, në O.]; në G. *Gurguška*, [*Gurzhdaj* të dhe *Guzhdaj* në O.]; në G. *Kasovci*,[*Kasaj* në O.]; në G. *Kočo*/ *Kočevci*/ *Kočovci*, [*Koçaj, Koçinaj* në O.]; në G. *Kozinci*, [*Kozaj* në O.]; në G. *Kutinci*, [*Kuteli, Kutijaj* dhe mtp. *Kroni Kutisë* në O.]; në G. *Maćkovci*, [*Maqekët*, në O.]; në G. *Mango*/*Mangovci*, [*Mangalaq*,-ët, në O.]; në G. *Muše/Muševci*, [*Mushku* vëllaz. shqiptare në Gorë]; në G. *Pačarizovci* [*Paçarrizi* dhe *Paçarrizaj* në O.]; në G. *Parko*, [*Parkaq* (*Pirkaq*) dhe mtp. *Kroni Parkaqit* në O.]; në G. *Piro*/**Pirevci*,**Pirovci* [*Pirkuqi* dhe *Piraj* në O.]; në G. *Poshtarovci* [*Poshtraj* në O.]; në G. *Renda /Rendovci*, [*Rrenakët* në O.]; në G. *Surdulovci*, [*Shurdhaj* në O.]; në G. *Toljevci*, [*Tolaj* në O.]; në G. *Trupçevci*, [*Trupaj* në O.]; në G. *Ursulovci*, [*Ysylët*/**Ursulaj* në O.]; në G. *Veljan/Veljanovci, Veljçovci* [*Velaj* në O.]; në G. Vesilovci [*Vesellarët, Vesaj* dhe mtp. *Soha e Vesos* dhe *Gropat e Vesos* në O.]; në G. *Zurápovci* [*Zyrapi* në O.]

b) Disa emra të vëllazërive gorane që tek shqiptarët janë ruajtur vetëm në mikrotoponime:

khs. në Gorë *Aljevci* [*Kodra Alës* në O.]; *Bajmak/Bajmakovci* [*Prroj i Bajtit* në Opojë]; në Gorë *Bazda/ Bazdinci*: [*Livadhi Bazës, Mullaga e Bazës Arat e Bazës*, në O.]; në G.*Bibarovci* [*Kroi Bibës* në O.]; në G. *Čadeljovci* [*Çadelt/Çadejt, Livadhet e Çadelit* në O.]; në G. *Čavdarovci* [*Çavdakos* në O.]; në G. *Čoko/Čokovci/Čoklevci*, [*Livadhi Qokit* në O.];

[*] Shkurt për *Gorë*
[**] Shkurt për Opojë.

në G. *Dočka/Doćkinci, Dočovci,* [*Mullakat e Doçit* në O.]; në G. *Ese*/*Esovci* [*Liadhi Ecës, Lugi Ecëc, Kurti Ecëc* dhe *Ura Ecëc* në O.]; në G.**Hodofci/ Odovci,* [*Hodofkat* në O.]; në G. *Jurukovci*/*Urukovci* dhe mtp. *Juručko Grobište, Júruka* [*Lama Jyrykut, Vorras i Jyrykut* në O.] në G. *Kajkuševci* [*Vorri Kajkushit* në O.]; në G. *Kiprinci* [*Reka e Kipit* në O.]; në G. *Kokle*/*Kokljevci* [*Rrasa e Kokës* në O.]; në G. *Kuka*/*Kukovci* [*Verrishta e Kukit* në O.]; në G. *Lajkovci* [*Zabeli Lajës* në O.]; në G. *Lekovci* [*Rrasat e Lekës, Kroi Lekës, Guri Lekna,j Guri Lekaje* dhe *Guri Lekës* në O.]; në G. *Lika, Liko*/*Likovci,* [*Rrinat e Likos* në O.]; në G. *Lila/Lilovci,* [*Gjybra e Lilës* në O.]; në G. *Luminci,* [*Lumja,* 1530 në O.]; në G. *Maci/Macina,* [*Kroi Macës* në O.]; në G. *Makoçevci,* [*Vorri Makos* në O.]; në G. *Milkovci, Milogojovci, Miljašinovci* dhe mtp. *Milkišov kamen* e *Miljkove strane* [*Milikeja, Milisos* dhe *Kodra e Mile* në O.]; në G. *Poljakovci,* [*Kodra Polakit* në O.]; në G. *Ruštevci, Rúškovci* [*Livadhet e Rushtës* në O.], në G. *Rečikovci,*[*Guri Reçit* në O.]; në G. *Urumovci,* [*Mullaka e Urumit* në O.]; në G. *Ziza*/*Zizinci* [*Ziza* në O.] dhe

c) Një mtp. i Gorës, i ngjashëm me një emër vëllazërie në Opojë në G. *Hulicevo bačilo* në Borje (Shqipëri) [*Hulaj,* vëllaz. në O.]

Nga shembujt e mësipërm rrjedh përfundimi që pararendësit e goranëve dhe të opojarëve të sotëm i kishin për të përbashkët (pa e marrë parasysh prejardhjen e emrave) antroponimet *Bashë, Ben-, Cak,-o, Çol/Çoll-; Çuft,-; Dik-; Dish,-; Dërd-/Tërt-, Durak,-; Gag-,ë/; Gogë; Gurg-,/Gurzh-;Hul-; Kas-; Koç,-o; Koz-; Kut-, Maq-; Paç-; Park,-; Pir-o; Poshtar-; Ren-d; Tol-; Vel-; Ves-o/Ves-il; Zurap* dhe patronimet *Baj-; Bazd-a; Çad-el; Çavdar-; Çok-; Doç; Es-/Ec-; Hod-o; Juruk; Kaj-o e Kush; Kip-; Kok-; Kuk-; Laj-; Lek,ë; Lik,o; Lil-; Lum; Mac-; Mak-; Mango; Mil-; Mush-; Pol(j)ak; Rush-; Reç-; Surdul; Ursul; Urum-; Ziz-*

Në dritën e shembujve të sjellë më sipër të emrave të vëllazërive (khs. edhe Regjistrin nën 17) rezulton se pjesa absolute më e madhe e tyre, pa e marrë parasysh prejardhjen e tyre shqipe, romane ballkanike, greke/bizantine, sllave apo orientale, janë të së njëjtës prejardhje, të formësuara në harmoni me gjuhët e me uzuset antroponimike sllave/ bullgare e shqipe të diktuara edhe nga konfesionet e krishterimit të cilave u takonin pararendësit e tyre: goranëve në krye të herës bogumilë, më vonë ortodoksë të variantit sllav dhe të opojarëve në krye të herës katolikë. Çështje që duhet të zbardhen janë harku kohor i gjendjes onomastike kur të dy këto entitete ishin aq identike në rrafshin onomastik sa që mund të flitet për një uzus të pandashëm dhe ajo e ortodoksizimit, përkatësisht

inkuadrimi i pararendësve të goranëve të sotëm në ortodoksinë serbe. Për zbardhjen e pjesës së parë të çështjes, çështje më vete është ajo se kur dhe në ç'ambient u mundësua lindja e emrave të njëjtë të vëllazërive gorane e shqiptare.

Në këtë mes duhet mbajtur parasysh rrethanën që pararendësit e goranëve u vendosën në atë hapësirë e cila, praktikisht, do të ketë qenë *Bjeshkë* "kullota e tbane" kryesisht të opojarëve. Këtë realitet, fundja, e tregon edhe vetë prejardhja e emrave *Opoja* "Fushë, Vërri" e *Gora* "Bjeshkë" (khs. për këtë më lart nën 1. 1. 2 e 1.1.3). Është për t'u besuar që kontaktet dhe fillet e bashkëjetesës e të bashkëshkrirjes midis goranëve ardhës dhe opojarëve vendës të kenë nisur jo në vendbanimet rrafshinore të opojarëve dhe e shqiptarëve të Malësisë së Tetovës, porse në tbanet e tyre, përkatësisht në Gorën, e sotme e cila para ngulitjes së pararendësve të goranëve të sotëm do të ketë qenë pra pjesa kryesore e kullotave dhe e tbaneve të opojarëve. Dhe, pikërisht në këtë hapësirë, fillimisht, do të jenë takuar, bashkëjetuar e bashkëshkrirë *katunarët* opojarë e blegtorët e ardhur vlleh bullgarishtfolës. Përkundër përkufizimit sipas të cilit përbrenda institucionit të *vëllazërisë* të ngritur mbi lidhjet e gjakut në vijën mashkullore nuk do të mund të hynte faktori i huaj mashkull, vëllazëritë gorane e opojare me emra pararedësish të përbashkët i paravendon domosdo edhe lidhjet martesore midis pjesëtarëve të këtyre dy entiteteve, sot të ndara si me brisk kirurgu njëri nga tjetri. Kjo do të ketë ndodhur pas humbjes së primatit të kishës, përkatësisht të pushtetit të perandorisë jetëshkurtër bullgare të shekujve 10-12 dhe etablimit formal të kishës e të pushtetit serb në këto hapësira, pas shtrirjes së pushtetit e të kishës serbe së principatës së Raška-s që ishte vasale e perandorisë së Bizantit, që e nënkupton edhe imponimin (së pakut onomastik) e variantit serb të ortodoksisë e me këtë edhe imponimin e antroponimisë sllave të variantit serb. Ky realitet shihet qartë në dritën e antroponimisë kryekreje serbe së banorëve të Gorës në regjistrimin osman-turk të vitit 1451-1452. (sh. për këtë nënkapitullin 3) kur popullata gorane del me antroponimi serbe brenda së cilës ishte ruajtur porse edhe ndonjë emër shqip dhe vllah. Emrat me prejardhje serbe nuk janë as në këtë ambient ndonjë dëshmi se kemi të bëjmë me një popullatë që në krye të herës do të ketë qenë e përkatësisë etnike serbe, por se këta (emra) e reflektojnë gjendjen e antroponimisë nën rrethana të ndryshuara historike që u shkaktua si pasojë e pushtimit serb.

Në këtë mes bën të vërehet që ky serbizim i antroponimisë do të ketë qenë i përkohshëm, meqë asnjë nga antroponimet e variantit serb nuk mori funksion të emrit të vëllazërisë pikërisht sepse këta (emra) të

vëllazërive gorane i takojnë kohës së para rënies së kësaj zone nën pushtetin serb dhe kishën e tij.

Mbase pikërisht kjo ndërmjetëz historike do të ketë qenë shkas i ndërprerjes së kontakteve dhe të bashkëjetesës midis goranëve ortodoksë e opojarëve katolikë. Është për t'u vërejtur në këtë mes që ndonjë bashkëjetesë e bashkëshkrirje nuk pati as pas islamizimit të të dy këtyre popullatave. Këtu edhe duhen parë arsyet përse pjesa më e madhe e emrave në krye të herës të përbashkët për të dyja këto entitete etnike e gjuhësore tek goranët vazhdojnë të jenë aktivë ndërsa tek opojarët ndeshen vetëm në trajta të tyre të ngurosura nëpër mikrotoponime.

Për një bashkëjetesë intensive që e paravendon edhe bashkëshkrirjen e ndërsjelltë të popullatave shqipfolëse të krahinës së Opojës dhe asaj sllavishtfolëse të Gorës ndoshta që para ortodoksizimit të goranëve dhe po se po para islamizimit të të dyja palëve, flet edhe ruajtja dhe praktikimi nga këto entitete i besimeve dhe i riteve pagane të lidhura me ujin, shiun, zjarrin, vatrën, tokën, gurin, besimet rreth shtazëve të buta e të egra dhe sidomos kremtimi i festave të motmotit: Dita e Verës, Dita e Shëngjergjit etj., të cilat i ka shënuar e trajtuar shkencërisht etnologu kosovar Ukë Xhemaj.[684]

15. VENERIME PËRMBYLLËSE

Në bazë të një interpretimi të pasaktë është shfaqur mendimi hipotetik, sipas të cilit paska mundësi që hapësira e sotme e Gorës, e ndoshta edhe e Opojës, të jetë përmendur që në gjysmën e dytë të shek. I p. e. s., përkatësisht në librin 43. 20. 1 të veprës Ab urbe condita të historiografit romak Titus Livius si *Illyrici solitudines* "Shkretëtirat e Ilirisë", që do të duhej kuptuar si "krahina të shkretëruara të Ilirisë" dhe jo për "shkretëtira të Ilirisë".

I besueshëm mund të mbetet porse paravendimi që në periudhën e sundimit romak të Dardanisë, përkatësisht të pjesës më të madhe të Kosovës së sotme, nëpër këtë krahinë do të ketë kaluar një rrugë dytësore (në krahasim me atë kryesoren Lissus - Naissus), gjë që mbase e dëshmon edhe toponimi *Shtatuli* në krahinëzën shqipfolëse të Opojës, që rrjedh nga fjala latine *statio*, e trajtësuar me prapashtesën karakteristike të latinitetit ballkanik *-ul* që në këtë rast mund ta ketë edhe kuptimin deminutiv.

[684] Khs. Shtresime kulturore, bot. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005, f. 79-96; 115-125 dhe 293-312.

Dëshmia e parë e shkruar e përmendejes së Gorës mbase për si rajon më vete, porse pa kufij të përcaktuar saktësisht, rrjedh nga viti 1348. Për territor i mëvetshëm po me këtë emër, Gora është evidentuar edhe në të gjitha regjistrimet osmane-turke të kryefamiljarëve e të pronave gjatë shekujve XVI-XVIII.

Që nga vitet e ’20-ta të shek. 20, njësia mbase dikur unike etnografike e gjuhësore e Gorës është e ndarë me kufij politikë midis Kosovës e Shqipërisë dhe midis Kosovës e Maqedonisë. Së këndejmi, në pjesën kosovare të hapësirës gjuhësore të shqipes bien sot 19 katunde; në atë të rrethinave të Kukësit të Shqipërisë 9 dhe në atë të Maqedonisë 2 katunde, banorët e të cilave e quajnë, përkatësisht e mbajnë veten për goranë.

Një gjë që duhet mbajtur parasysh në këtë mes është rrethana që as në dokumetacionin kishtar serb të shek. XIV e as në defterë osmanë/turq të regjistrimit të kryefamiljarëve të shekujve 15-18, që edhe janë të vetmet nga të cilat do të mund të pritej një gjë e tillë, sikur të kishte pasur ndonjë emër etnik më vete i cili më vonë do të vazhdohej deri në ditë tonat, nuk përmendet shprehimisht ndonjë grup etnik me emrin goran/ë. Në të dyja këto lloje të dokumentacionit përmendet vetëm nocioni gjeografik *Gora* që përmbahet, vetëm një herë, edhe si emër i prejardhjes së ndonjë banori, jo porse si distinktiv i përkatësisë së tij etnike.

Rrethana e konstatuar më sipër tregon se atributi *goran* është distinktiv që i shenjon ardhësit e quajtur në bazë të emrit Gora të regjionit ku u vendosën dhe se, fundja, emri goran nuk është, pra, kurrfarë distinktivi për përkatësi etnike, gjuhësore e religjioze më vete për banorët e vendosur aty (për këtë sh. më poshtë). Që ky fakt ka të bëjë pikërisht (edhe) me goranët, bëhet më e pranueshme edhe po u tërhoq një paralele p.sh. me popullatën fqinje shqipfolëse të Opojës e cila nuk e ka për emër etnik emrin e regjionit, por emrin e mirëfilltë nacional: shqiptar, e vërtetë kjo që vlen edhe për popullatën e viseve të tjera përreth të banuara kryesisht me shqiptarë.

Për t’u sqaruar mbetet koha e mundshme e ardhjes së popullatës së quajtur sot gorane në këtë hapësirë. Dokumenti më i vjetër dhe më përmbledhës që dihet deri më sot përkitazi me hapësirën që e banonte popullata e quajtur sot me emrin “goran” e Malësive të Prizrenit, Kukësit e pjesërisht edhe të Tetovës, rrjedh nga gjysma e parë e shek. XIV. Ky dokument është krisobula e sundimtarit serb St. Dushan e vitit 1348, përmes së cilës ai ia falte manastirit në ngritje të shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit edhe shumicën e katundeve të sotme të

hapësirës që zënë krahinëzat e Gorës e të Opojës. Duke qenë se ky dokument nuk është regjistrim i popullsisë, porse një urdhëresë/dekret, në të cilën përcaktohen vetëm kufijtë e katuneve "tbaneve" dhe të katundeve që në atë kohë bëheshin pronë e manastirit të lartpërmendur, këtu ka krejt pak të dhëna përkitazi me antroponiminë e banorëve të këtij regjioni.

Duke qenë se gati të gjithë emrat e bashkësive blegtorale të gjakut në vijën mashkullore, përkatësisht emrat e katundeve e të vëllazërive apo barqeve të përmendura në dokumentin e vitit 1348 të kishës e të pushtetit serb në ekspansion janë ruajtur deri në ditë tonat po si emra aktivë/aktualë të vëllazërive ose në trajta të tyre të ngurosura nëpër mikrotoponime e lejon jo paravendimin, porse përfundimin e mbështetur, se edhe popullata e sotme bullgarofone e regjionit të Gorës jetonte në shek. XIV po në këtë regjion, ashtu si edhe popullata edhe sot shqipfolëse e krahinave fqinje të Opojës, Malësisë së Tetovës dhe të regjionit të Kukësit, përkatësisht që pararendësit e goranëve të sotëm ishin vendosur këtu shekuj përpara se të lindej dokumenti kishtar serb i vitit 1348. Një shembull tipik i kontinuitetit onomastik e territorial të një emri të dëshmuar në shek. 14 është emri *Dikanoviki* i familjes së priftërinjve të vitit 1348 (të cilët nuk kanë mundur t'i takojnë kurrnjë kishe tjetër përpos asaj ortodokse serbe) që është ruajtur tek emri i vëllazërisë së sotme *Dikanovci*, përkatësisht tek emri *Dikance* i katundit më vete, tek emri *Dikovllëk* në Lubizhdë dhe tek emri *Dikaćenko* i një mahalle-vëllazërie të katundit Brod të regjionit të Gorës si edhe kontinuiteti territorial emëror i mikrotoponimit mesjetar me prejardhje antroponimike *potokъ makočevski* tek emri homonim i vëllazërisë gorane po në katundin Brod të Gorës (më gjerësisht khs. 2. Lënda onomastike historike për krahinat e Gorës e të Opojës dhe sidomos referencën 35). Konstatimi i shprehur më sipër përforcohet edhe nga rrethana që kjo vazhdimësi dëshmohet edhe në defterin osman-turk të regjistrimit të pjesërishëm të kryefamiljarëve të këtij regjioni në vitet 1451-1452. Një shembull për këtë është p.sh. antroponimi Shutko i kryefamiljarët të dëshmuar më 1451-1452 i cili është ruajtur deri në ditë tonat në mtp. *Šutkarovo Gumno* në Restelicë e mbase edhe tek emri *Šutinica* në Brod të Gorës.

Autoktoninë relative të goranëve që e banojnë këtë hapësirë do ta dëshmonte edhe fakti që në këtë regjistrim osman ka disa vendbanime të këtij regjioni që nuk përmenden në dokumentin e vitit 1348. Ky fakt e dëshmon jo ardhjen e serishme, porse rritjen e natyrshme dhe zgjerimin e natyrshëm territorial të pararendësve të goranëve të sotëm.

Përkitazi me lashtësinë e kësaj popullate në këtë hapësirë ka porse mendime të ndryshme. Teza më e përqafueshme nga shumica e dijetarëve që janë marrë me këtë çështje është ajo që pararendësit e goranëve të sotëm qenkan popullatë e ardhur. Për hapësirë nismëtare nga e cila këta u dyndën për në shpatije të Sharit merren malet e Rodopeve të shtetit të sotëm të Bullgarisë, por edhe nga Maqedonia e sotme, nga Greqia, përkatësisht Shqipëria e Jugut.

Pararendësit romanë ballkanikë/ vlleh të goranëve të sotëm si pjesë e një *Romania në lëvizje*,[685] erdhën në hapësirën që e banojnë sot në kuadrin e lëvizjes në kontinuitet të barinjve trakas së pari të romanizuar e më pastaj të bullgarizuar gjuhësisht që në atdheun e tyre të kryehershëm.

Pararendësit ardhës të goranëve të sotëm nuk kanë mundur as të romanizohen e as të sllavizohen, bullgarizohen në atdheun e ri të rrethuar gjithandej nga shqiptarë. Kjo sepse në rastin e Gorës kemi të bëjmë me një hapësirë të populluar rrallë, të organizuar mbi bazën e vëllazërive, mbi bazën e lidhjes së gjakut në vijën mashkullore, në të cilat vështirë se mund të depërtonte elementi i huaj mashkull dhe së dyti pse kjo nuk ishte zonë e banuar me sllavë, porse me shqiptarë e ndoshta edhe me pak vendës të romanizuar, përkatësisht me " vlleh" vendës.

Karakterin vllah të mesjetës së vonë të pararendësve të goranëve të sotëm e tregon mungesa e kontinuitetit në të folmen dhe në onomastikën e tyre e leksikut të mirëfilltë të latinishtes popullore/vulgare, gjë që sqarohet me të vërtetën e njohur gjithandej që elementi sllav i Ballkanit s'ka histori të antikës, por vetëm të mesjetës, prandaj as tek popullata gorane nuk gjendet ndonjë emërtim apo leksemë nga latiniteti ballkanik që nga sllavishtfolës, çfarë në antikën ilire-romake as që kishte në këtë zonë, do të ishte trajtësuar sipas veçorive fonetike të sllavishtes.

Se goranët e sotëm ishin vlleh të ardhur në këtë hapësirë e tregon edhe ruajtja deri në ditë tonat e emrave të vëllazërive gorane të formuar sipas modelit të vllehve të hapësirës së Jugut të Ballkanit. Të këtillë janë p.sh. emrat: *tudorč dolь* i një lugu që përbënte kufirin midis bjeshkës së katundit Radesh të Gorës dhe regjionit të Opojës; një pikë tjetër e kufirit të kësaj bjeshke e quajtur Milšor dhe vendi tjetër i quajtur *Milšin katunь* i cili mbase mund të identifikohet me pjesën *Milčeva bačila* të kullotave të katundit Brod. Toponimi i parë (*tudorč dolь*) është i tipit antroponimik. Në këtë emër vendi ruhet antroponimi i

[685] Për këtë nocion khs. Istvan Schütz, Përkimet gjuhësore shqiptare-rumune dhe vazhdimsia etnike në Kosovë, "Studime filologjike" 3/1989,Tiranë, f. 86.

gjithkrishterë me origjinë greke θεόδωρος *Theódoros* në trajtën karakteristike rumune, vllahe të tij *Tudor*; në toponimin e dytë ruhet një trajtë e shkurtër e një baze antroponimike sllave *Mil-* i zgjeruar këtu me prapashtesën karakteristike vllahe të përkëdhelisë *-şor* që ndeshet edhe në mikrotoponime të tjera vllahe të Kosovës të emërtuara nga vllahishtfolës dhe është njëkohësisht edhe prapashesë e shqipes e hyrë nga rumanishtja. (khs. emrin e zhdukur *Skokšor* të një ujvarje në rrethina të Istogut, të përmendur që në fillimet e shek. 13; emrin *Dabšor* të një vreshti në rrethina të Prizrenit që përmendet në vitet 1198-1199; emrin e vjetër *Vinishor* të katundit të sotëm Nishor të Suharekës; emrin *Brajshor* të vëllazërisë në katundin me emrin po ashtu vllah *Sharban* të Prishtinës; emrin *Nekshor*, i shënuar në shek. XVI për katund më vete e lagjes/vëllazërisë së sotme të katundit Prapashticë të Prishtinës e ndonjë tjetër). Kjo prapashtesë e rumanishtes dëshmohet edhe në emrin e një truallishte të qajtur *Srbšor* që për në hapësira të Maqedonisë së sotme përmendet në vitin 1332.[686]

Se këto mikrotoponime, që e dëshmojnë praninë e elementit roman ballkanik, përkatësisht vllah nuk janë të rastit, e tregon rrethana se edhe sot ka ndër emra vëllazërish të goranëve sish me prejardhje vllahe. Të këtillë janë p.sh. emrat *Surdulovci* në katundin Rapçë nga rum. *surd*-ul "i shurdhët"; *Çuçulovci*, nga rum. *cucul* "qyqe" *Ursulovci* nga rum. *ursă* "arushë"; *Muševci* (khs. antroponimin vllah *Muşat*, emrin e vëllazërisë *Muşateşti* tek rumunët dhe emrin e katundit *Mushtisht* të Kosovës) që rrjedh nga mbiemri sinonim *muşat* "i bukur" i mbiemrit *bucur*, përkatësisht *a se bucura* "i lumtur, gazmor" i rumanishtes e ndonjë tjetër.

Ndryshe qëndron puna, në këtë rrafsh, me popullatën shqipfolëse të krahinës së Opojës në të cilën ndeshen fjalë si *kurt,-i* "oborr i thurur me mur apo me gardh; 2. kopsht" nga lat. ballkanike *curtis*, e dalë nga *cohors* e kjo nga *co*(*cum*) dhe rrënjës *hortus* "kopsht". Kjo fjalë e dalë nga përdorimi në latinitetin dalmat që në shek. 12, e ka ruajtur në të folmen e Opojës vlerën kuptimore të kryehershme të oborrit, pikërisht ashtu siç është ruajtur në frëngjishten, rumanishten e në greqishten e re, përkatësisht vlerën që e kishte *curtis* i latinitetit ballkanik si dhe fjalën *burg*-u e cila në këtë zonë e ka kuptimin e bartur "vath; vath rrëzë mali; rrënzë shkëmbi" dhe rrjedh nga lat. *burg*, *burgus* me kuptimin "mal, kurriz mali, gungë shkëmbore"

[686] St. Novaković, Zakonski spomenici …, f. 404, 494.

Ky fenomen ka ndodhur edhe tek mikrotoponimi opojar *Kilikerja* (nga lat. *calcaria* "gëlqere" me të njëjtin kalim të *c*/k të lat. në *g* si edhe tek lat. *castania*, shq. *gështenjë*) dhe tek mikrotoponimi opojar *Udha pukë* në katundin e sotëm Zgatar të Opojës që rrjedh nga një **Via publica* e latinitetit ballkanik. Në të mirë të pranisë së një popullate shqiptare të vërshuar nga elemente romane ballkanike do të fliste edhe trajtja e ruajtur deri në ditë tonat e mikrotoponimit latin-ballkanik si *Shtatuli*; e emrit *Blaq* të katundit opojar (nga antroponimi me prejardhje latine *Blasius*) dhe e katundit Kapre (nga lat. *capra* "dhi,-a") që tregojnë se shqiptarët autoktonë i trajtësuan e ruajtën ato fjalë e emra vendesh me origjinë nga latiniteti ballkanik (pjesë e të cilit ishin edhe këta vetë) në harmoni me ligjet fonetike të shqipes si në gjithë hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve. Në dritën e ç'u tha më lart rezulton që as varianti goran i mikrotoponimit **Statio* në trajtën *Statulj* të latinitetit ballkanik, nuk do të mund të merrej për ndonjë dëshmi e kontinuitetit sllav të një emri antik, porse trajtë të cilën pararendësit vlleh të goranëve të sotëm do ta kenë adaptuar nga trajta shqipe *Shtatul*, që edhe dëshmohet tek mikrotoponimi homonim në katundin Blaç të shqiptarëve të Opojës. Kjo rrethanë do të tregonte që pararendësit romanë ballkanikë të goranëve të sotëm ishin bartës të një gjuhe në të cilën elementet latine ballkanike u zhvilluan ndryshe në krahasim me atë në shqipen. Dhe kjo do të jetë gjuha e trakasve të romanizuar, përkatësisht e romanëve/ vllehve ballkanikë. Në rastin tonë konkret kemi të bëjmë me fenomenin e shprehur figurativisht nga dijetari gjerman Gotfried Schramm e një vazhdimësie të lëvizshme të latinitetit ballkanik nga blegtorë romanë të Ballkanit, përkatësisht me një "Romani ballkanike të barinjve".

Ata nuk u sllavizuan pra në atdheun e tyre të ri edhe për faktin që nuk erdhën me hope, porse përnjëherë si kolektivitet. Këta erdhën pra në këtë hapësirë me identitet të formuar gjuhësor, si bullgarishtfolës, nga hapësira gjuhësore e bullgarishtes. Po të mos ndodhte kështu, do të ishte e vështirë të shpjegohej arsyeja përse e folmja aktuale e goranëve është një variant i bullgarishtes. Sikur këta të mos kishin ardhur si grup i formuar gjuhësor që në atdheun e kryehershëm të tyre, përkatësisht sikur kjo ngulitje të mos ishte masive, vështirë se do të mund të sqarohej rrethana përse kjo popullatë, e vendosur në një ambient të rrethuar nga të katër anët nga popullata autoktone shqipfolëse, nuk e mori gjuhën shqipe, përkatësisht nuk u shqiptarizua e as nuk u serbizua, siç ndodhi gjithandej nëpër Kosovën e sotme ku vëllazëri të veçanta që ishin ngulitur në ambiente shqiptare dhe kishin sajuar të ashtuquajturat

katune vllehsh të cilat - kryesisht në Rrafshin e Dukagjinit dhe në krahinën e Drenicës - shumë shpejt u shqiptarizuan, ndërsa në Rrafsh të Kosovës, në krahinat e Llapit, Gallapit, të Moravës e të Karadakut pjesërisht edhe u serbizuan.

Në filologjinë sllave (bullgare, maqedonase, serbe) çështja e prejardhjes së goranëve nuk ndiqet më thellë e më larg se harku kohor midis shek. 10-12 dhe lidhet vetëm me herezinë armene të përhapur së pari tek popullata e Bullgarisë dhe e quajtur bogumilizëm. Ky është pra harku kohor i lindjes dhe i përndjekjes së lëvizjes bogumile (më gjerësisht për këtë sh. nënkapitullin 4. 2.) në e nga Bullgaria, nga Maqedonia e Selanikut dhe nga Maqedonia e Vardarit e ndoshta edhe nga Serbia.

Në relacion me kishën e me pushtetin serb dhe me banorët serbë çfarë në zonën e Sharit nuk pati asnjëherë, banorët e regjionit të Gorës janë autoktonë relativë, përkatësisht të vendosur para shtrirjes këndej të pushtetit serb. Më mirë se gjithçka tjetër këtë e tregon varianti bullgar i të folmes së banorëve të kësaj krahinëze. Bullgarishtja, nga ana tjetër, nuk ka mundur të jetë gjuhë e vendit e kësaj hapësire porse vetëm gjuhë e "kolonëve" në rastin tonë e blegtorëve vlleh bullgarishtfolës dhe jo e "bullgarëve" etnikë siç ia ka ënda të besojë filologjia bullgare. Në kontekstin historik, e folmja e banorëve të regjionit të Gorës nuk ka mbështetje të mbahet për e folme maqedonase, sa kohë që jo vetëm atëherë, por madje as sot nuk pranohet për gjuhë më vete "maqedonase" një e tillë që u farkua kryesisht për shkaqe politike.

Po u pat parasysh konstatimi që pjesa dërmuese e vllehve, duke qenë blegtorë transhumanë, ishin gjithmonë e kudo bilingualë, sidomos burrat, e në të shumtën e rasteve edhe u asimiluan, do të rezultonte që pararendësit e goranëve të sotëm e sollën me vete bullgarishten jo si gjuhë të dytë, porse si gjuhë të komunikimit, ndërsa veçorinë etnike vllahe e ruajtën me pak fjalë vendëse dhe me më shumë emra familjarë që u kishin shpëtuar procesit të bullgarizimit.

Arsyeja e parë përse në atdheun e ri nuk u zhvillua procesi i asimilimit të ardhësve vlleh bullgarishtfolës në shqiptarë është mbase në rend të parë rrethana që këta ardhës do të kenë zënë vend këndej si grup relativisht kompakt në një hapësirë bjeshkësh të banuara rrallë nga popullata vendëse shqiptare, e pranishme ndoshta vetëm me kullota e tbane, e romanizuar thellë, mbi të cilën (hapësirë) elementi ardhës pati mundësi jo vetëm ta ruajë mëvetësinë gjuhësore e etnike porse, madje, edhe ta bullgarizojë ndonjë vëllazëri shqiptare që mund ta kenë gjetur në atë zonë. Ky paravendim mund ta ketë për mbështetje ruajtjen e disa

toponimeve me prejardhje nga latiniteti ballkanik në hapësirën e krahinëzës fqinje të Opojës.

Arsyeja e dytë që ndikoi në ruajtjen e mëvetësisë së pararendësve të goranëve është rrethana që këta nuk gjetën në këtë zonë një institucion të fortë kishtar të asnjërit nga dy ritet e krishterimit, gjë që ua mundësoi ta vazhdojnë jetën si paganë, përkatësisht si ithtarë të dogmës së bogumilizimit.

Pararendësit vlleh të bullgarizuar të goranëve të sotëm do të jenë ngulitur në hapësirën e Gorës (në Kosovë e në Shqipëri) gjatë periudhës së pushtimit/sundimit bullgar të Kosovës së sotme në shek. 10-12. Sikur kjo masë vllehsh të ishte e ardhur më vonë, do të pritej që kjo ardhje të shënohej në anale jo vetëm të kishës bizantine, porse edhe në sosh të asaj serbe. Në të mirë të paravendimit të mësipërm duket se flet edhe rrethana që megjithë shtrirjen së pakut të përkohshme të kishës serbe mbi këtë regjion në shek. XIV, pikërisht vetë kjo administratë kishtare, pushtuese, i gjeti e prandaj edhe u bartën, u ruajtën deri më sot, pothuajse të gjithë emrat e vendeve e të vëllazërive me prejardhje vllahe, që janë shënuar në ato burime. Në këtë mes është për t'u vërejtur rrethana që në shkrime kishtare serbe të cilat kanë të bëjnë me Gorën, asnjëherë nuk del nocioni *vlah* as në kuptimin etnik e as në atë të "barinjve". Kjo mbase sepse elementi vllah i bullgarizuar kishte ardhur në këtë zonë para shtrirjes jetëshkurtër të pushtetit, përkatësisht të kishës serbe në këtë zonë. Lashtësinë e ngulitjes së vllehve para pushtimit/sundimit serb të dinastisë së Nemanjidasve të Raška-s/Rashës në krahinën e sotme të Gorës sikur e ilustron shumë mirë rrethana që administrata e kishës pushtuese serbe me shtrirje (në rastin e Gorës) shumë të dobët të saj, regjistronte në vitin 1348, megjithatë, oikonime e mikrotoponime me prejardhje të latinitetit ballkanik/vllah që rrjedhin nga kohëra më të mugëta se ngulitja e kishës dhe e pushtetit serb në gjithë Kosovën e sotme, e pra edhe në regjionin e Gorës.

Komponentë vendimtare që dëshmon se pararendësit vlleh të goranëve ishin folës të bullgarishtes është e folmja e sotme (bullgare) e popullatës së këtij regjioni. Kjo e folme përmban dy veçori shquese fonetike e morfologjike të bullgarishtes: kalimin e zanores *ъ* të bullgarishtes së vjetër (= sllavishtes së vjetër) në *o* dhe të gjysmëzanores *ь* në *e* si edhe në bullgarishten e vjetër dhe jo në *a* si në serbishten e vjetër. Fenomeni i ndryshimit të *a* > *o* në të folmen e goranëve, që dëshmohet edhe në huazimet më të moçme të shqipes është, siç mësohet nga dija e gjuhësisë sllave, jo më i vjetër se shek. 9. Përveç kësaj, karakterin bullgar të së folmes së Gorës e dëshmon edhe ruajtja deri në ditët tona e kategorisë së

shquarsisë së emrave në këtë të folme, cilësi kjo që në Ballkan e kanë vetëm shqipja, rumanishtja e bullgarishtja, përkatësisht maqedonishtja, jo porse edhe serbishtja e aq më pak varianti boshnjak i saj. Së këndejmi, të gjitha pretendimet që e folmja e goranëve të nxirret për e folme serbe, maqedonase apo, që është madje edhe qesharake, boshnjake, duhet të mbahen vetëm për teza të politizuara të cilat nuk kanë vend në vathin e dijes objektive të gjuhësisë.

Nga aq burime sa ka për këtë regjion, mësohet se emrat e sotëm të vendbanimeve të këtij regjioni janë po ata që dëshmohen më 1348 dhe këta emra nuk janë shënuar në atë burim në trajtat bullgare të tyre, porse në sosh serbe. Sado që në dokumentin e vitit 1348 nuk ndeshen mikrotoponime me prejardhje bullgare, mundësinë që banorët e kryehershëm të kësaj krahine e flisnin bullgarishten do ta tregonte fakti i pamohueshëm që disa nga mikrotoponime të dëshmuara në vitin 1348 në trajta serbe të tyre janë ruajtur nga vendësit deri në ditë tonat në trajtat bullgare të tyre. Kjo rrethanë do të tregonte se procesi i serbizimit librar të toponimisë së këtij regjioni, si edhe në gjithë hapësirën gjuhësore të shqipes, kishte përfunduar para shek. 14.

Qenien bullgare të mikrotoponimisë së Gorës edhe në kohën e lindjes së dokumentit të kishës serbe, përkatësisht karakterin bullgar të së folmes sllave të goranëve si edhe të kolonëve bullgarë të rrethinës së Prizrenit e dëshmojnë jo krejt tërthorazi edhe trajtat bullgare të disa emrave të vendbanimeve të vetë regjionit të Gorës si *Globočica*, *Krstec*, *Shishtavec*, *Košarišt* të përmendura në burimin e vitit 1348, disa oikonime të rrethinave të Prizrenit, si *Nashec*, *Tupec*, të Suharekës si *Rahovec*, *Sallagrazhdë* e madje edhe të Klinës si *Bubavec* e të Kamenicës *Zajçec* që përmenden nëpër burime kishtare serbe të shek. XIII-XV. Kjo rrethanë do ta përligjte bullgarishten jo vetëm për gjuhë të goranëve, porse edhe rolin e saj si gjuhë dhënëse e sllavizmave më të vjetra të shqipes së folur në Kosovë dhe pushtuesin më të vjetër sllavishtfolës të hapësirës etnolinguistike të shqiptarëve.

Gjykuar mbi bazën e të dhënave onomastike, sado të pakta, nga defterë osmanë-turq të shek. 15-16, del për pothuajse e vërtetë e palëkundshme që pararendësit e goranëve të sotëm nuk erdhën këndej as si "bullgarë", as si "maqedonas" e as si të islamizuar, porse u islamizuan në hapësirën që e banojnë sot - ashtu si edhe popullata shqiptare që krahinëzën e Gorës dhe popullatën e saj e rrethon, thënë thjesht, nga të gjitha anët e horizontit.

Komponentja myslimane, si formë rezistence e goranëve për të mos u deklaruar shqiptarë, bullgarë, maqedonas, e aq më pak serbë (sado që ka të

tillë që deklarohen për serbë, maqedonas, turq, të papërcaktuar etj.) bënë që goranët të jenë entitet shumë i lakmueshëm, i gatshëm edhe ky vetë të bie nën ndikimin e politikave të ditës. Kjo shihet më së miri kohëve të fundit kur kjo popullatë, e ngopur nga propagandat maqedonase e serbe, po deklarohet për boshnjake. Në këtë kontekst, krerë lojalë, më së shumti mësues, të hutuar të goranëve shfrytëzojnë, edhe kundër njëri-tjetrit, privilegje të pritura p.sh. nga Bullgaria për marrjen e vizave të BE-së edhe formimin në perspektivën iluzore të një shteti të madh të myslimanëve në Ballkan, i cili nën patronatin e Bosnes do të përfshinte Bosnjën, Sanxhakun, pjesët myslimane e boshnjake dhe shqiptare të Malit të Zi, gjithë Shqipërinë, Kosovën e pjesën shqiptare të Maqedonisë.

Teza e lidhjes së prejardhjes së popullatës së Gorës me boshnjakët nuk është më e moçme se 15 vite dhe është, vështruar politikisht, e pandashme nga procesi i zhbërjes së ish-Jugosllavisë. Në deklarimin për boshnjakë të një pjese të popullatës së Gorës do të ketë ndikuar mbase në rend të parë përkatësia fetare islame e popullatës së këtij miniregjioni, me ç'rast nuk është marrë fare në konsideratë rrethana që banorët e Gorës e flasin një gjuhë të variantit sllav i cili (variant) nuk ka ndonjë lidhje gjenetike me variantin boshnjak të serbishtes, përkatësisht të kroatishtes. Mbase duke e heshtur faktorin e propagandës, deklarimi i një pjese të goranëve për boshnjakë arsyetohet p.sh. nga autori S. Idriz me rrethanën që "procesi i formimit të kombeve i nisur në Ballkan në shek. XIX po vazhduaka edhe sot e gjithë ditën."[687] Në këtë kontekst më duket i drejtë reagimi i autorit Samir Velija[688] sipas të cilit goranëve ua imponuan termin boshnjak, të cilin goranët e refuzuan, ashtu siç do të vepronte secili njeri që e heton se me terma që atij nuk i janë fare të njohur po i kërcënohet me të fortë identiteti. Kjo aq më parë që goranët as që paskan ditur gjë përkitazi me boshnjakët e aq më pak për ndonjë përkatësi imagjinare të tyre grupit të etnik të boshnjakëve. Në rrafshin gjuhësor, ky autor vëren më tej, edhe që "gjuha e bashkësisë gorane i ngjet më fort maqedonishtes, por që duke mos qenë e standardizuar, hapësira për manipulime mbetet e gjerë." Ky autor shton edhe konstatimin se kjo propagandë po i shtynë goranët drejt boshnjakizimit, sado që deri vonë goranët s'dinin gjë për boshnjakët, prandaj autorit tonë i ka rënë jo rrallë të dëgjojë: "unë nuk mund të jem boshnjak, sepse nuk e kam nështetësinë e Bosne-Hercegovinës".

[687] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak, Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[688] Quo vadis, Goranac? http: // www.prizren-web.com/magazin/.

16. REGJISTËR I PJESËRISHËM I PARALELEVE TË EMRAVE TË VËLLAZËRIVE TË GORËS ME SISH TË OPOJËS

Vëllazëri në Gorë:	**Vëllazëri e/apo mtp. në Opojë:**
Aljevci/ Alovci në Gorë[*]	khs. mtp. *Kodra Alës* në Zaplugjë.
Baljevci (në Restelicë)	khs. vëllaz. Balaj (në Mahallën Beqiraj) në Brodosanë.
Bajmak/Bajmakovci në Restelicë e në Brod dhe mtp. *Bajmakue-báćilo*, *Bajmakóŭ-peš*, në Brod	khs. mtp. *Prroj i Bajtit* në Zaplugjë.
Bardovci, në Leštan	khs. vëllaz. *Bardhajt* në Brodosanë.
Bazda/ Bazdinci: vëllaz. dhe mtp. *Bazdina Rupa* në Restelicë	khs. mtp. *Livadhi Bazës* në Brrut; *Mullaga e Bazës* në Pllavë dhe *Arat e Bazës* në Brodosanë.
Bašinci, në Zli Potok	khs. vëllaz. *Bashaj* dhe mtp. *Guri Ali Bashës* në Brodosanë; *Fushat e Bashës* në Rrenc dhe *Fusha e Bashos* në Pllavë.
Bengo, në Brod;	khs. vëllaz. *Beneke* në Zgatar.
Bibarovci, vëllaz. në Restelicë	khs. mtp. *Kroi Bibës* në Zym.
Cako, *Cakovci* mb. /vëllaz. në Brod	khs. vëllaz. *Cakaj* në Shajne.
Ćunkovci, vëllazëri në Brod	khs. mtp. *Qungari*, në Shajne.
Čadeljovci (*Dólovci*): vëllaz. dhe mtp. *Čadelovo* në Kërstec i Epërm	khs. mtp. *Çadelt/Çadejt* liqe në Brezne; vëllaz. *Çadelet /Çadelët* dhe mtp. *Livadhet e Çadelit* në Zaplugjë.[689]
Čavdarovci, në Restelicë	khs. mtp. *Çavdakos* në Zaplugjë dhe vëllaz. *Çavdërbasha* në Prizren.
Čekukovci në Kukajan	khs. *Çekaj*, *Çeku* në Kosovë.
Činarovci në Borje, Kukës	khs. vëllaz. *Qinaj* në Brodosanë.
Čoko/Čokovci/Čoklevci në Restelicë;	khs. mtp. *Livadhi Qokit* në Zaplugjë.
Ćolovci në Vraništ;	khs. vëllaz. *Çollaj* dhe mtp. *Gropa e Çollës* në Shajne.

[*] Vëllazëri e shpërngulur.

[689] Këta emra i ka shënuar në terren J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 146.

Čučulovci, vëllaz.në Brod; mtp. *Čučulj* që dëgjohet edhe si *Čučulova* e *Čučulovci* në Restelicë; *Čuč*/ *Čučinci* vëllaz. në Borje (Kukës)	khs. vëllaz. *Çuçur* (tani Berisha) në Buçe.
Čufćinci/*Čifčinci* vëllaz. në Brod	khs. vëllaz. shqiptare *Çufta* në Restelicë.
Desilovci, vëllaz. e shpërngulur nga Gora	khs.**Mullini i Desilit* në Buzezë.
Dikanci në Brod	*Dikaj* në Brodosanë.
Dišovci, në Borje, Kukës;	khs. *Dishallarët* në Brezne; *Disha* në Prizren.
Dočka/Doćkinci, në Brod; *Dočovci*, në Shishtevec, Kukës	khs. mtp. *Mullakat e Doçit* në Kuklibeg.
Drdinci në Lubovishtë	khs. vëllaz. *Tërtin* në Kosavë.
Durakovci, në Zlipotok	khs. vëllaz. *Durakaj* në Kuklibeg; *Duraj* në Brodosanë; mtp. *Lama Durakit* në lagjen Begaj, Kuklibeg.
Đuzel, familje/vëllazëri në Restelicë	khs. vëllaz. *Xhyzelaj* në Brodosanë.
Ese/*Esovci*, vëllaz. dhe mtp. *Esma* e *Eseska*, në Restelicë	khs. mtp. *Liadhi Ecës, Lugi Ecëc, Kurti Ecëc* dhe *Ura Ecëc* në Pllavë dhe në Zaplugjë.
Gago/*Gagovci*, në Brod e në Vranisht mtp. *Gagove livade* në Mlikë	khs. vëllaz. *Gegica* dhe mtp. *Vorret e Gogës* në Blaç dhe mtp. *Kroi Gogos* në Kukël.
Gurguška, mb./vëllaz. në Restelicë;	khs. mb. *Gurzhdaj* të vëllaz. në Brezne dhe *Guzhdaj* në Brrut.
Hulicevo bačilo në Borje (Shqipëri)	khs. emrin *Hulaj* të vëllazërisë në Pllavë të Opojës.
**Hodofci/ Odovci*, në Leshtan	khs. mtp. *Hodofkat* në Kosavë.
Jurukovci/*Urukovci* në Brod dhe mtp. *Juručko Grobište* në Zli Potok dhe *Júruka* në Restelicë	khs. mtp. *Lama Jyrykut* në Pllajnik dhe *Vorras i Jyrykut* në Kosavë.
Kajkuševci, në Gllloboçicë,	khs. mtp. *Vorri Kajkushit* në Buçe.
Kaljo/Kalinovci/Kalinkovci, në Restelicë); Kalánovci në Luboshtë	khs. emrin *Kalatina* të një ujvarje në Zaplugjë.

Kasovci, në Mlikë dhe në Orçushë	khs. vëllaz. *Kasaj* në Brodosanë.
Kiprinci, vëllaz. në Brod	khs. *Reka e Kipit* në Blaç.
Kočo/*Kočevci*/*Kočovci*, në Brod,	khs. vëllaz. *Koçaj* të Mahallës së Epërme në Brezne.
Kokle /*Kokljevci*, në Zlipotok/Dikancë	khs. mtp. *Rrasa e Kokës* në Brodosanë.
Kozinci dhe mtp. *Kozmina* në Krushevë;	khs. vëllaz. *Kozaj* në Shajne
Kuka/*Kukovci*, në Restelicë	khs. emrat e kat. *Kuk* e *Kuklibeg* dhe mtp. *Verrishta e Kukit* në Kosavë të Opojës.
Kutinci, në Zli Potok	khs. vëllaz. *Kuteli* në Kosavë, vëllaz. *Kutijaj* dhe mtp. *Kroni Kutisë* në Brodosanë.
Lajkovci, në Vranisht e në Gllboçicë	khs. mtp. *Zabeli Lajës* në Opojë.
Lekovci në Brod	khs. mtp. *Rrasat e Lekës*, *Kroi Lekës* në Pllavë, *Guri Leknaj* në Brodosanë, *Guri Lekaje* në Kuklibeg dhe *Guri Lekës* në z. në Brod dhe
Liko/*Likovci*, vëllaz. në Restelicë	khs. mtp. *Rrinat e Likos* në Kapre.
Lila/Lilovci, në Brod	khs. mtp. *Gjybra e Lilës* në Blaç.
Luminci, vëllaz. në Restelicë	khs. vëllaz. ose kat. Lumja të Opojës, të përmendur në v. 1530
Maci/Macina, lagje në Brod	khs. mtp. *Kroi Macës* në Kukël.
Maćkovci, në Gorë	khs. vëllaz. *Maqekët* në Kosavë.
Makoçevci, në Brod dhe mtp. *Makojec* në Restelicë	khs. mtp. *Vorri Makos* në Pllajnik.
Mango/*Mangovci*, në Brod e në Vranisht	khs. vëllaz. *Mangalaq*,-ët në Zaplugjë.
Milkovci, në Radesh; *Milogojovci* në Vraniq; *Miljašinovci* në Kërstec i Epërm dhe mtp. *Milkišov kamen* e *Miljkove strane* në Kërstec të Poshtëm	khs. mtp. *Milikeja* në Brezne, *Milisos* në Bellobrad dhe *Kodra e Mile* në Brrut.
Muše/Muševci, vëllaz. dhe Muškina, krua në Restelicë dhe vëllaz. në Brod	khs. vëllaz. shqiptare *Mushku* po në Restelicë.

Pačarizovci vëllaz. dhe mtp. *Paçarizov* në Rapçën e Epërme	khs. vëllaz. *Paçarrizi* dhe *Paçarrizaj* në Opojë.
Parko, vëllazëri në Restelicë	khs. vëllaz. *Parkaq* (*Pirkaq*) dhe mtp. *Kroni Parkaqit* në Brezne.
*Piro/*Pirevci,*Pirovci*, në Globoçicë dhe mtp. *Pirove njive* në Krushevë	khs. vëllaz. *Pirkuqi* në Mahallën e Epërme të Breznes dhe *Piraj* në Pllavë.
Poljakovci, në Vraniq;	khs. mtp. *Kodra Polakit* në Blaç.
Poshtarovci në Glloboçicë	khs. vëllaz. *Poshtraj* në Kuk dhe në Zërzë.
Rečikovci, Rečkova češma në Zli Potok	khs. mtp. *Guri Reçit* në Brodosanë.
Renda /Rendovci, në Brod	khs. vëllaz. *Rrenakët* në Zaplugjë dhe emrin *Rrenc* të katundit të Opojës.
Rúškovci.(të quajtur edhe *Malékovci*) në Rapçë dhe *Ruštevci*, në Restelicë	khs. mtp. *Livadhet e Rushtës* në Zaplugjë.
Surdulovci, në Rapçë	khs. vëllaz. *Shurdhaj* në Blaç. khs., për nga kuptimi edhe mtp. *Shurdhaki* në Zgatar.
Toljevci në Gorë	khs. vëllaz. *Tolaj* në Shajne.
Trupçevci, në Brod	khs. vëllaz. *Trupaj* në Kosavë dhe, kuptimisht, *Trupaj* të Opojës
Ursulovci, në Rapçë	hs. vëllaz. *Ysylët*/**Usulaj* në Brrut.
Urumovci, në Gorë	khs. mtp. *Mullaka e Urumit* në Brodosanë.
Veljan/Veljanovci në Brod dhe *Veljçovci* në Restelicë	khs. vëllaz. *Velaj* në Kukël.
Vesilovci, në Gorë	khs. vëllaz. *Vesellarët* në Buçje, *Vesaj* në Kuklibeg dhe mtp. *Soha e Vesos* dhe *Gropat e Vesos* në Brodosanë.
Ziza/*Zizinci* (Kucovllasi), në Brod	khs. mtp. *Ziza* në Brodosanë.
Zurápovci në Kukaljan	khs. vëllaz. *Zyrapi* në Opojë.

Paralele toponimike[*]

Bojčin potok, vend në Radeš,	khs. mtp. *Prroi Bojos* në Bellobrad, Gostil dhe *Kroi Bojës* në Kuklibeg.
Bureševec vend në Orgoshtë, Kukës të Opojës	khs. mtp. *Arat e Buros* në Kapre
Çuçul. vend. në Brod	khs. vëllaz. shq. *Çuçur* në Buçe.
Karpišta, Gazine Karpe, në Brod; *Karpa*, në Glloboçicë; *Karpa* në Rapçë të Epërmee në Restelicë; *Karpe* në Radesh; *Ramne karpe* në Zli Potok, *Potkarpe* në Leshtan etj	khs. mtp. *Karpi* në Brodosanë, *Karpa* në Kuk(ël) dhe *Karpa* në Shajne të krahinës së Opojës.
Koloshka, rrugë në Restelicë	khs. vëllaz. *Kaloshët* në Brezne
Muridža, në Zli Potok dhe në Brod.	khs. mtp. *Morrizi* në Pllavë dhe *Morrizos* në Pllajnik.
Paraspor në Vranisht e Dragash.	khs. *Parasporet/Paraspure/*, *Paraspor* në Brodosanë dhe *Paraspore* në Kukël.
Pažić (Golemi), në Rapçë	khs.shumë mtp. *Pazhik* në katunde të Opojës.
Perívolji, në Shishtevec	khs. *Pirivojthi*/**Perivojth* në Pllajnik
Rečikova ćesma, në Zli Potok	khs. mtp. *Guri Reçit* në Brodosanë të Opojës.
Šilegarnik në Dikancë e Radesh	khs. *Shelegarnik* në Brodosanë.
Statulj në Gorë (?)	khs. *Shtatuli* Blaç të Opojës.
Stenza/Stezno në Rapçë.	khs. Shtenza/Shtezna në Opojë.
Struga/ Struka në Dikancë.	khs. *Strunga* në Zgatar; *Stërgat* dhe *Kepat e Stërgave* në Brodosanë; *Stërga* në Kuklibeg; *Stërga e Poshtër* dhe *Mugallat e Stërgës* në Kuk.

[*] Pjesa më e madhe e mikrotoponimeve të krahasuara në këtë nënkapitull janë marrë nga vepra e J. Osmanit, Vendbanimet e Kosovës, 20, f. 88, 109, 114, 134, 135, 137, 138, 143, 146.

TURQIT NË KOSOVË

NJOFTIME PËR PREJARDHJEN, EMRIN DHE GJUHËN E TURQVE[*]

"Turqit (turq. *Türkler*) janë një etni, hapësira kryesore e banimit të të cilëve shtrihet në Anatoli (Anadoll), Qipro e në Europën Juglindore. Pjesa dërmuese e turqve, përkrah grupeve të tjera etnike, jetojnë në hapësirën e cila që nga viti 1923, kur e ngriti Mustafa Kemal-i, quhet Republika e Turqisë e cila është vazhduese e Perandorisë Osmane.

Distinktivi etnik *türk* është përmendur për herë të parë në kronika kineze të shek. VI si *T'u-küe* dhe shenjonte atëherë një klan/fis në kuadrin e një konfederate më të madhe fisesh nomade që e quante veten "Türk", por që prejardhja dhe gjuha e atij fisi nuk është sqaruar përfundimisht. Me forcimin e "Türk"-ve emri i tyre u përhap e mbuloi, si nocion politik, një vistër popujsh të tjerë nomadë dhe, përfundimisht, përmes një procesi që as deri në ditë tonat nuk është tfilluar kuptueshëm, nocioni "Türk" u përgjithësua dhe u muar për si shenjim për një familje të tërë gjuhësore e popujsh. Prej këndej rrjedh edhe emri i popullatës turke të Anatolisë. Përhapës të këtij emri etnik ishin së pari dinjitarët myslimanë e pastaj u përhap edhe në Europë.

Përkundër përdorimit shpesh në kuptimin pezhorativ, në tekste historike e letrare në Perandorinë Osmane, nocioni *türk* ose *türki* si term për popullin dhe gjuhën nuk u kufizua vetëm tek grupet etnike nomade e katundare.

Turqit e Turqisë së sotme e kanë vendin në kontekstin gjuhësor e etnik të popujve *Türk-menë*. Hapësira e banimit e popullit më të vjetër të njohur me emrin *Türk* ndodhej në pjesën lindore të Azisë Qendrore, në një territor që shtrihej nga Bjeshkët Altai deri tek Tianshan në perëndim dhe nga Liqeni i Baikalit në veri, deri në Altun-in në jug.

Në fund të antikës së vonë u lind perandoria e parë e *Türk*-ëve, përkatësisht ajo e *Göktürk*-ëve e cila, që nga mesi i shek VI, për dy shekuj me radhë do të luajë rol të rëndësishëm në historinë e pjesëve perëndimore e jugperëndimore të Azisë. Sipas definimit të sotëm ky territor shtrihet nga Deti Mesdhe, Deti i Kuq në perëndim, Deti i Zi,

malet e Kaukazit dhe Deti Kaspik në veri, ndërsa në lindje kufizohet me vargmalet e Iranit dhe në jug me Oqeanin e Indisë.

Ngritja e *türk*-ëve në një Fuqi të Madhe islame filloi në të nisur të shek. XI kur fisi i madh i i Selxhukëve të Mëdhenj, me prejardhje oguze, e pushtuan një hapësirë tejet të madhe që shtrihej nga Deti Mesdhe deri në Azinë Qendrore. Si rezultat i fitores së selxhukëve në Betejën e Manzikert-it në vitin 1071, me ç'rast u rrënua administrimi i Azisë së Vogël nga Bizanti dhe u bë i mundshëm pushtimi turk i Anatolisë.

Pas pushtimit të pjesëve të tjera të Anatolisë nga luftëtarë fisesh *türke* të prirë nga Suleiman ibn Kutalmiş, që ishte një princ selxhuk, kjo pjesë e Anatolisë u pavarësua. Për pasojë, Suleiman ibn Kutalmiş e themeloi *Sultanatin Rum* që në të vërtetë është arritja më e madhe e parë e sundimit kulturor e politik të *türk-ëve* në Anatoli deri në fillim të shek. XIV kur e zmbrapsën, me fare pak përjashtime, sundimin bizantin të Azisë së Vogël. Njëra nga principatat e krijuara në këto territore ishte ajo e Osmanëve të cilët, duke ikur nga sulmet e mongolëve, ishin strehuar në tokat e selxhukëve.

Emri Turqi është dëshmuar për herë të parë në një kronikë (*Historia Peregrinorum*) përkitazi me kryqëzatën e Friedrich Barbarossa-s në vitin 1190, ndërsa në shek. XIII përdoret në shumë burime europerëndimore. Në arabishten, nocioni *barr al-turkiyya* ("Toka e Türk"-ëve) është dëshmuar që në të nisur të shek. XIV.

Për një kohë, përkrah arabishtes persishtja ishte gjuha kryesore e arsimit dhe e letërsisë. Në këtë gjuhë ishin hartuar madje shumë kronika të Rum-selxhukëve. Mirëpo pas shuarjes së Perandorisë së Rum-selxhukëve, turqishtja u bë shumë shpejt gjuhë komunikimi e një pjese të popullsisë. Kjo u institucionalizua në vitin 1277 kur pushtetin e mori sundimtari Karaman Oğulları Mehmed Bey i Konya-s dhe urdhëroi që në zyrat e shtetit duhej të përdorej turqishtja. Kështu, që nga shek. XIII shkrimet letrare anatolike dhe ato të administratës shtetërore nisën të hartoheshin në turqisht.

Gjuhë më të rëndësishme të arsimit të popullatës së krishterë ishin arameishtja siriane, armenishtja dhe arabishtja. Kjo e fundit u përdor në Perandorinë Osmane deri në fund të shek. XVI në defterë të regjistrimit, në kartëdhurata e në mbishkrime.

Vendin dhe rolin e selxhukëve e zunë osmanët turq, të cilët shumë shpejt u bënë sundimtarë të pjesës më të madhe të Anatolisë dhe në vitin 1453 e pushtuan Konstantinopojën. Si rezultat i fushatave luftarake/ pushtuese, osmanët e krijuan një perandori që shtrihej që nga Armenia deri në Hungari, nga stepet e jugut të Rusisë deri në Afrikën e Veriut.

Pjesë të kësaj perandorie u bënë edhe pjesë të mëdha të Gdishullit Arabik dhe të Mesdheut.

Në gjithë botën, për turq e mbajnë veten rrafsh 65 milion njerëz, nga të cilët në Turqi jetojnë rreth 58 milion. Minoritete autoktone turke jetojnë në Qipro (265.000) dhe në Europën Juglindore përkatësisht në Bullgari (746.664), në Greqi (157.000), në Maqedoni - kryesisht në Shkup e në Gostivar - (79.000), në Rumani (44.500) dhe në Kosovë - kryesisht në Prizren e në Mamushë - (22.500).

Pjesa dërmuese e turqve religjiozë janë myslimanë sunitë të drejtimit hanefi. Grupi i dytë më i madh religjioz në Turqi janë alevitët."

Pas ngadhënjimit në vitin 1389 mbi koalicionin e të krishterëve (midis të cilëve kishte edhe kosovarë vendës e sish nga Shqipëria e sotme) dhe pushtimit definitiv (në vitin 1455) të Kosovës së sotme, e cila asokohe ishte nën sundimin e Brankoviqëve që ishin bërë vazalë të osmanëve nën sundimin e kësaj perandorie, edhe popullata shqiptare e Kosovës ra nën sundimin osman. Përqafimi i besimit islam, kryesisht në shek. XVII, nga pjesa dërmuese e kosovarëve bëri që të orientalzoheshin të gjitha fushat e jetës: arkitektura, veshja, kuzhina dhe mbi të gjitha, gjuha shqipe të vërshohet nga orientalizma dhe të gjithë shqiptarët myslimanë (duke pasur arabishten për gjuhë të lutjes) të mbajnë emra personalë me prejardhje orientale. Shqiptarët, pararendësit dardanë të cilëve ishin populli i parë i Ballkanit që e përqafoi ritin roman të krishterimit dhe më vonë popull shtetas i komenuelltit bizantin me krishterimin ortodoks, u bënë kësisoj trup i huaj në vend të vetin në relacion me civilizimin europerëndimor.

Sado që pas tërheqjes definitive të Perandorisë Osmane, përkatësisht të Turqisë (edhe) nga hapësira etnolinguistike e shqiptarëve (Kosovë, Maqedoni) në këto territore mbetën fare pak turq etnikë dhe nuk paraqitnin kurrfarë rreziku për shtetet e sllavëve të jugut, ndërsa kjo rrethanë historike u përdor si pretekst për shpikjen e turqve në mënyrë që të realizohej synimi shekullor i Serbisë për spastrimin etnik të hapësirave shqiptare të pushtuara, që nënkupton dëbimin e shqiptarëve (të besimit islam) nga Kosova e nga Maqedonia.

Ka të dhëna statistikore sipas të cilave dëshmohet se në Kosovë kishte, p.sh. vitin 1948 gjithsej 1.315 turq ndërsa në vitin 1953 u bënë (sipas N. Malcolm). 34.583 turq.[1] Numri i të vetëquajturve turq u rrit në vitet 1955/1956 për shkak të trysnisë së pushtetit jugosllav/serb gjatë aksionit për mbledhjen e armëve që në të vërtetë ishte diktat për

[1] Sh. Flaka Surroi, Koha net. 25gusht, 2014.

shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi. Dhe, për ta "gëzuar" këtë të drejtë, shqiptarët duhej të vetdeklaroheshin për turq, sepse kështu ishte paraparë së pakut në tri projektet serbe (Čubrilović; Andrić; Tito-Ranković) të pranuara nga Turqia, sipas të cilave në Turqi do të gjenin vend vetëm kosovarët e deklaruar për turq. Kjo nuk qe e vështirë të arrihej për pushtetet jugosllave/serbe sepse politika serbe e propagonte aksiomën sipas së cilës secili mysliman ishte automatikisht "turk". Në mbështetje të akteve shtetërore të nënshkruara midis Jugosllavisë dhe Turqisë rezulton se në periudhën midis viteve 1945 e 1966, nga e gjithë Jugosllavia e asokohshme (Bosnja; Sanxhaku, e Maqedonia), në Turqi u shpërngulën rreth 246.000 njerëz, së pakut 100.000 nga të cilët ishin shqiptarë.

Turqit në Kosovë nuk mund të jenë pjesë e diasporës autoktone. Kjo sepse dihet mirë se Perandoria Osmane, për ndryshim nga ardhësit sllavë, nuk solli me vete popullatë turke për t'i kolonizuar viset e pushtuara dhe se as pas tërheqjes së kësaj perandorie nga tokat e shqiptarëve nuk pati asnjëherë vendosje të popullatës turke në këto hapësira. Ata janë mbetje minimale e turqve nga mesjeta që erdhën si ushtarakë, nëpunës (që e kontrollonin tregtinë me xehe dhe doganat e Kosovës) e ndoshta edhe si zanatlinj të vendosur fillimisht në kështjella të rëndësishme, përkatësisht në qytete. Shumica e turqve janë në të vërtetë shqiptarë të turqizuar.

Kemi të bëjmë me fenomenin që u zhvillua në qytetet e Prizrenit, Mitrovicës, Vushtrrisë, Gjilanit e të Prishtinës, në të cilat katundarët e vendosur në ato ambiente urbane, ku turqishtja ishte gjuhë e komunikimit me pushtetin dhe gjuhë e prestigjit social nisën ta quanin veten turk për t'u dalluar kështu nga bashkëkobmasit e ndoshta nga të afërmit e tyre të gjakut, të fisit, që nuk u zhdorgjën nëpër këto qytete.

Në të mirë të këtij qëndrimi flet në rend të parë rrethana që një pjesë e mirë e turqve të Kosovës kanë për mbiemra familjarë emra si *Berisha*, *Bytyçi*, *Gashi*, *Hoti*, *Kastrati*, *Krasniqi*, *Kryeziu*, *Luma* që në të vërtetë janë emra të fiseve të shqiptarëve, porse edhe mbiemra të tjerë si dhe antroponime/emra personalë me prejardhje shqipe.

Këtu e gjejnë mbështetjen historianë kosovarë që mendojnë se turqit janë në të vërtetë etni e shpikur nga pushtetet jugosllave/serbe me qëllim të paraqitjes së Kosovës si hapësirë multietnike dhe si pretekst për t'i dëbuar shqiptarët.

Vendimi politik për krijimin e "kombësisë turke" në Kosovë, me kërkesën e Beogradit dhe nën presionin e tij, u muarr më 20 mars 1951 nga Këshilli Populluer i Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë, këshill

ky që dominohej nga serbë e malazezë. Vendimi u bë publik në vitin 1955.[2]

Edhe pse nuk ka të dhëna statistikore të besueshme, mendohet se popullsia që e mban veten për turke përbën rreth 1% të numrit të gjithmbarshëm të popullsisë së Kosovës, përkatësisht që në Kosovë ka rreth 19.000 turq.

Komuniteti turk jeton kryesisht nëpër qytete. Kështu, nga popullsia e gjithmbarshme në komunën e Prizrenit me rrethinë turq janë 6,9% e popullsisë; në qytetin e Mitrovicës (3%); në qytetin e Ferizajt 0.02%; në qytetin e Gjilanit me rrethinë 1.3%; në qytetin e Prishtinës. 0.7% dhe në qytezën e Vushtrrisë. 0.45%.

Turqit në Kosovë flasin një dialekt lokal të turqishtes. Krahas kësaj gjuhe, ata i flasin, në të shumtën e herës, edhe shqipen e serbishten. Në kuadër të "multietnicitetit" e të "multikulturalitetit" artificial të Kosovës, në Gjilan, Prizren dhe në katundin/komunën Mamushë të tij, turqishtja është edhe gjuhë zyrtare.

[2] Sipas Xhevat Bislimi, Shqiptarët e Turqisë dhe "Turqët" e Kosovës, Revista "Drini", në internet.

MENDIME RRETH DY MINORITETEVE TË SHUARA MESJETARE TË KOSOVËS: KUMANËT E JURUKËT

I. KUMANËT

Venerime hyrëse

Para shumë vitesh, përkatësisht në vitin 1977 në një punim timin[1] ku i ndiqja dëshmitë e pranisë së shqiptarëve në Kosovë e në pjesë të tjera të hapësirës kompakte etnolinguistike të shqiptarëve mbi bazën e dokumentacionit kishtar serb të shek. XIV-XV, me entusiazëm e më pak i përgatitur se sot me njohuri nga historia, ndër dëshmi të vazhdimësisë shqiptare e merrja edhe emrin *Komanovo selište* "Truallishta e Komanit" i përmendur në një kartëdhuratë të vitit 1327 (sh. më poshtë referencën 26).

Sado që as atëherë nuk thosha që emri *Koman* do të jetë emër shqiptar, po se këtë e shihja vetëm si të vazhduar nga shqiptarët, pa marrë parasysh prejardhjen e emrit, për këtë më qortonte jo krejt me të padrejtë, dijetari hungarez - profesori i nderuar Ishtvan Shyc.[2] Ky e sillte në këtë mes, me të drejtë, komponenten kumane, që unë nuk e kisha theksuar në mënyrë të veçantë.

Duke e pranuar hapakrahaz qortimin dashamirës të profesorit të nderuar Shyc, sot e përsëdys që emrin Kuman/Koman të përmbajtur tek mikrotoponimi *Truallishta e Komanit* nuk e mbaj as sot për emër shqip, porse për emër të shqiptarëve, tek i cili ndoshta ruhet kujtimi i emrit etnik të kumanëve aziatikë.

---

[1] Prania e etnosit shqiptar në Kosovë gjatë shekujve XIII-XIV në dritën e burimeve kishtare serbe, në Onomastika e Kosovës, Simpozium i mbajtur më 25-27 shkurt 1977, botim i Institut albanologjik të Prishtinës, Prishtinë 1979, f. 72.

[2] Sh. Përkimet gjuhësore shqiptare-rumune dhe vazhdimsia etnike në Kosovë, Mendime rreth monografisë së Gotfried Schramm, Frühe Schicksale der Rumänen - Acht Thesen zur Lokalisierung der lateinischen Kontinuität in Südosteuropa, bot. në Zeitschrift für Balkanologie XXII/1, XII/2 1986 dhe XXIII/1 1987, "Studime filologjike" 3/1989, f. 90-95.

Rreth prejardhjes së kumanëve

Kumanët janë popullatë tyrkmene, degë e kimak-ëve e quajtur edhe *Qiptschaq, Qibchaq* - lexo. Kipçak, Kibçak si edhe *Qipcaq*, gjerm. *Polowezer, Polowcer*. Populli turk i Kipçakëve, si degë e Kimakëve për atdhe të kryehershëm e kishte vendin *Irtysh*. Gjuha e tyre quhej kipçakish. Emra të tjerë të tyre ishin edhe *Kuman* ose *Polovec*. Në burimet kineze ky popull përmendet me emrin *Gaogüy*, përkatësisht si *Kao-kü*. Për pararendës të këtij populli konsiderohen, midis të tjerësh, fiset e popullatës *Tölö*. Emri "Kıpçak" rrjedh nga iranishtja e mesme: *kıp*- "i kuq" ose "i shndritshëm; i bardhë" dhe *çak* = "Sak" ose "Skit" (*Sake/ Skit* ishte shpesh emër i thjeshtësuar për secilin popull të stepave). "Kipçak" do të thotë pra "banor lëkurëbardhë i stepave"; "Skitë të bardhë" dhe pas gjithë gjasësh rrjedh nga iranishtja e mesme. Varianti *kuman* i emrit të kësaj popullate lidhet me emrin e lumit *Kuma* të regjionit të Kaukazit.

Ky popull turk me prejardhje nga stepat euraziatike shihet para së gjithash si një popull kryesisht i përzier iranian-turk, ndërsa *kimekët* e afërt për nga gjaku me këta (para së gjithash fisi kryesor *Kyngly*) mbahet sot për popullatë e mirëfilltë turke.

Në shek. 7 kipçakët u sulmuan nga turkutët dhe u dëbuan më në veri. Nën udhëheqjen e kanit Bolus, këta u vendosën rreth vitit 1054 në hapësirën në brigje të lumit Volga dhe në stepet e Ukrainës prej nga i përzunë peçenegët e atjeshëm vendës dhe i ndoqën deri përtej Danubit. Kipçakët/kumanët i zhvilluan disa luftëra kundër rusëve (*Rus*-ëve *të Kievit*). Ndryshe, kipçakët/kumanët bënin jetë gjysmënomade, kishin porse edhe qendra/qytete të vogla tregtare. Megjithatë, një pjesë e këtij populli mbeti në Lindje dhe në gjysmën e shek. 12 mori pjesë në themelimin e Perandorisë së Koresmi-t.

Lufta e kipçakëve me rusët përshkruhet në *Këngën e Igorit* - një epos i lashtë rus. Me këtë ka të bëjë edhe opera e Aleksandër Borodin-it "Princi Igor". Në muzikën klasike janë të njohura në mënyrë të veçantë "Vallet polovece", që u atribuohen kipçakëve, përkatësisht kumanëve.

Edhe kipçakët kishin, si edhe të gjithë popujt turko-mongolë disa princër. Pas disfatës vendimtare të peçenagëve, përmenden kanët kipçakë: *Altunopa, Tugokan, Sharukan* dhe *Boniak* (rreth vitit 1091). Tugorkan-i, p.sh. e drejtoi në vitin 1096 një luftë kundër Kiev-it, të cilën e humbi bashkë me jetën e vet. Boniak-u qe, pas gjithë gjasash pas vdekjes së Tugorkhan-it, për kohë të gjatë kani i rangut më të lartë, prandaj edhe "Hero" i shumë kronikave ruse. Sharukan-i (rreth vitit 1107) kishte në zotërim katër nga gjashtë qytetet e kipçakëve. I bir i tij ishte Otrok-u, i cili pas dy fitoreve të princërve rusë kundër kipçakëve në

brigjet e Don-it në vitet 1111 dhe 1116 u detyrua të ikte tek gjeorgjiasit. Përmes martesës me një vendëse, ky i vuri aty themelet e aleancës kipçake-gjeorgjiase. Pas vdekjes së princit të madh Wladimir Monomah të Kiev-it në vitin 1125, Otrok-u kthye sërish në stepet e Ukrainës. (Tradita gojore thotë që bashkatdhetarët e tij të mbetur në vend i paskan sjellë këtij bar ose dhé të stepës për t'i marrë erë, gjë që bëri që ky të kthehej në vendin e vet).

Bijë të Otrok-ut ishin Eltut-i dhe Könchek-u (rreth 1172-1201). Të dytë morën pjesë alternativisht në luftërat kundër princërve rusë. Në një luftë të zhvilluar në vitin 1180 ra Eltut-i. Edhe Köbek (Kobyak), një *kann* tjetër i kypçakëve e humbi luftën në vitin 1183 dhe u zu rob bashkë me krejt familjen e tij. Könchek-u udhëhoqi disa kundërsulme dhe në fund pati sukses. Në vitin 1185 dështoi ekspedita e princit Igor që këndohet në *Këngën për Igorin*. Könchek nuk ishte, megjithatë, i vetmi princ - aleat dhe rival i tij ishte sundimtari Kza Khan.

Në stepet jugore të Rusisë u shfaqën në vitin 1223 mongolët e bashkë me ta edhe aleatët e tyre *turko-tatarët* me në krye gjeneralët Jebe (Jelme) dhe Subutai.

Disfata vendimtare e kipçakëve erdhi si pasojë e ofensivës së Khanit Batu gjatë viteve 1236–39, në vendin e quajtur Kalka këta e thyen aleancën ruse-kipçake. Kipçakët u zhdukën me ekspeditën e Batu Khan-it të viteve 1236-39, në mënyrë të veçantë porse me disfatën e Baçman-it, i cili u vra në një ishull të Volgës. Një pjesë e popullit të tij, 40.000 familje iku nën udhëheqjen e Kotjan Khan-it (1202-1241) në vitin 1239 para mongolëve në Hungari, ku i strehoi mbreti Bela IV i Hungarisë. Këto 40.000 familje kumane u vendosën në territorin që zënë krahinat përreth qendrave Marosch, Temesch dhe Körösch, prej kur dhe ku këta shërbyen edhe si mercenarë. Kur ndaj këtyre u rrit presioni për ta pranuar krishterimin (një pjesë e kiptçakëve ishin të besimit mysliman, pjesa më e madhe e tyre porse ishte pagane), rivalitetet me fisnikërinë (aristokracinë) hungareze, përkatësisht gjermane u ashpërsuan dhe kur u vra Kuthan-i (Kötöny-i), kumanët u larguan përkohësisht nga Hungaria dhe u vendosën në krahinën e Dobruxhas, ku strehim u ofroi cari bullgar Koloman.[3] Gjetiu thuhet se pas disfatës në betejën e Kalka-s më 1239 "ata (kumanët) që jetonin si nomadë në Bullgari, kaluan në shërbim të Baldwin-it II. [..] Kjo ia bëri të mundshme mbretit të Hungarisë që ta shtrinte "protektoratin e vet mbi vendin e tyre (madje duke u vetëquajtur mbret i

[3]Sipas http://www.google.at/search?hl=de&source=hp&q=Kumanen dhe http://www.uni-protokolle.de/Lexikon/Kumanen.html.

Kumanisë, ose *rex Cumaniae*)"[*] dhe i [..] lejoi misionarët dominikanë të bëjnë aq konvertime për Papën, sa të krijohej, në 1229(!) një peshkopatë e "Kumanëve" [..] Nga ky moment, mbreti hungarez i përdori kipçakët si mercenarë personalë të tij. Këta përmenden edhe në shek. 14 si gardë e mbretit Sigismund."[4] I pandashëm nga ky zhvillim është edhe çështja e konvertimit fetar të kumanëve. Në *Wikipedia*, autori ynë e paska gjetur konstatimin sipas të cilit "Gjatë shekullit XIII kumanët perëndimorë adoptuan katolicizmin roman (në Hungari këta u bënë pastaj të gjithë kalvinistë), ndërsa Gagauz-ët u bënë pravoslavë/ortodoksë; kumanët lindorë u konvertuan në Islam."[5] Duket se kjo do tö jetë pasojë e rrethanës që kumanët paskan "luajtur rol të rëndësishëm në historinë e Ballkanit mesjetar; herë duke u përplasur me Bizantin e herë në aleancë me të. Zbritja e tyre në gadishull mendohet të ketë lidhje me trazirat që shoqëruan dyndjet mongole gjatë shekullit XIII; përndryshe prania e tyre është dëshmuar veçanërisht dhe gjerësisht në zonat e Vllahisë dhe të Moldavisë së sotme.[6]

Në Hungari gjurmë të kipçakëve ose kumanëve (hungarisht: *Kun*) ruhen deri në ditë tonat tek emrat e trevave *Nagykunság* (Kumania e Madhe, me selinë *Karcag*) dhe në emrat e vendbanimeve si *Kunszentmárton*, *Kunszentmiklós*, *Kiskunfélegyháza* (qendër e Kumanisë së Vogël) dhe *Kiskunság*.

Sipas historiografisë turke, e cila po i dalluaka *kumanët* e *kipçakët* për etnitete të ndryshme, atdheu i kryehershëm i këtyre të fundit qenka pjesa veriore e Kinës, prej nga në vitin 916 qenkan vendosur në Ukrainë. Në rrjedha të shek. 11 e 12, përmes Rumanisë, këta kishin arritur deri në pjesën veriore të Bullgarisë dhe qenkan vendosur buzë brigjeve të Danubit e të Dobruđa-s. Migrimi, shtrirja e tyre në drejtim të jugut paska vazhduar me arritje, përhapjen e tyre deri në Rodope dhe në pjesën lindore të Maqedonisë. Ka ndonjë studiues që pikërisht me këtë lëvizje e lidh edhe prejardhjen e pomakëve, përkatësisht të torbeshëve/goranëve të Ballkanit. Sipas një sqarimi tjetër, kumanët e peçenegët e kishin forcuar pushtetin e tyre në pjesën juglindore të Ballkanit dhe midis viteve 1034-1091 qenkan përhapur në hapësirat e sotme të Kosovës, Sanxhakut e

[*] Hapësira e banuar nga kumanët në Hungari ngërthente më vete pjesën veriore të regjionit midis Danubit dhe Tisës duke i përfshirë edhe territoret përreth vendeve Körös e Maros.

[4] Xha Xhai, Kur nuk laheshim, në: http://xhaxhai.wordpress.com/2009/09/30/arber-dhe-kumane/.

[5] Po ai, po aty.

[6] Xha Xhai, po aty.

Bosnes. Më vonë porse paskan emigruar në Rumani, Hungari, Austri, Çeki e në Sllovaki.[7]

Kumanët në Ballkan dhe në hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve

Është thënë se kumanët paskan luajtur rol të rëndësishëm në historinë e Ballkanit mesjetar; herë duke u përplasur me Bizantin e herë në aleancë me të. Zbritja e tyre në gadishull mendohet të ketë lidhje me trazirat që shoqëruan dyndjet mongole gjatë shekullit XIII; përndryshe prania e tyre është dëshmuar veçanërisht dhe gjerësisht në zonat e Vllahisë dhe të Moldavisë së sotme.[8]

Dëshmi për ekzistimin e popullatës turke nomade të kumanëve në Ballkan paska që nga shek. 11. Rol të veçantë kumanët paskan luajtur në formimin dhe në zhvillimin më tej të Perandorisë së Dytë Bullgare të shek. XII. Perandoria e Bizantit i paska marrë këta (kumanët) në shërbim ushtarak, prandaj të tillë paska pasur, si mercenarë, edhe në kohën e sundimit të mbretit serb Milutin. Konsiderohet që kujtimi për kolonizimin e kumanëve qenka ruajtur në emrat e vendeve *Kumanovo* (qytet në Maqedoni), *Kumane* e *Kumanica*[9] në Serbi (?). Këtu bie, sipas autorit Xha Xhai, edhe *Kumaniçevo* në zonën e Kosturit, Maqedoni[10] si edhe *Kumanski*; *Kumansko ostrvo* në Vidin; *Kumana* në Nikbol dhe *Kumanitčka* në Lofča, në Bullgari.[11]

Nuk ka ndonjë burim historik të drejtpërdrejtë nga i cili do të mësohej nëse pati ndonjë invadim apo kolonizim të kumanëve në hapësirat etnolinguistike të shqiptarëve. Nga burimet kishtare serbe të shek. XIV mësohet porse që ndonjë sundimtar serb paska pas sjellë në krijesën shtetërore të tyre, në shtetin e tyre të zgjeruar të Rashës, edhe pjesëtarë popujsh të tjerë. Kështu, mendohet p.sh. që sasët i paska sjellë këndej mbreti serb Stefan Uroshi II. (1282-1321) në kohën kur Hungaria e Bullgaria ishin të zëna me mbrojtjen nga sulme të tatarëve. Në këtë kohë mbreti serb e paska organizuar tregtinë dhe financat si dhe paska sjellur minatorë gjermanë (sasë) për të nxjerrë ar, argjend, plumb, bakër e hekur dhe i paska kontribuar kështu forcimit të shtetit serb në shek. XIV.

---

[7] Khs. për këtë Reportaže-Hronike-Komentari »Hronike »POMACI, njihova prošlost i sadašnjost.

[8] Xha Xhai, Kur nuk laheshim,, në: http://xhaxhai.wordpress.com/2009/09/30/arber-dhe-kumane/.

[9] Khs. Atanasije Urošević, Neki detalji iz prošlosti Kosova, "Onomatološki Prilozi I", Beograd 1979, f. 30.

[10] Xha Xhai, po aty.

[11] Këta emra i citoj sipas "Pomaci, njihova prošlost i sadašnjost" në në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

Sjellja e të huajve në mbretërinë mesjetare serbe ndodhi, sipas studiuesit serb. Č.(edomilj) Mijatović,[12] në kuadër të masave për popullimin e tokave të mbretërisë, përkatësisht për popullimin e hapësirës së pushtuar nga principata serbe e Rashës. Për realizimin e këtij projekti pasardhësit e Nemanjës paskan ndjekur rrugë më të mençur nga ajo e pararendësit të tyre. Në vend se të merrnin masa për shtrëngimin e popullatës që ajo t'i popullonte viset rrafshinore e të merrej me bujqësi, mbretërit Vladislav, Stefan Milutin-i dhe Stefani, i quajtur *i Deçanit*, e paskan nisur popullimin e hapësirave të pushtuara me kolonistë të sjellë nga jashtë.

Kështu paska vepruar edhe mbreti serb Stefan Uroš Milutini. Për këtë dihet që në shtetin që e mbante për të vetin i paska vendosur *disa mijëra* kumanë. Në një kartë të tijën, sundimtari serb i përmend disa truallishta të paemër, të cilat që nga kohë të mugëta kishin pas qenë lënë shkret e të cilat ky i populloi me njerëz të sjellë nga jashtë.[13] Në burim nuk jepen, porse kurrfarë shënimesh prej kah u sollën dhe në cilat vende konkretisht qenkan ngulitur ata mijëra kumanë për të cilët po fliska sundimtari serb. Në e parë duket sikur ka arsye historike të besohet që kumanët do të jenë sjellë nga hapësira të Hungarisë ku ata, duke ikur përpara sulmit të mongolëve e të tatarëve, kishin gjetur strehim e mbrojtje tek mbreti hungarez Bela IV.[14] Mirëpo siç do të shihet më poshtë, ka më shumë arsye të pravendohet që ata kumanë do të jenë sjellë nga hapësira të Bullgarisë ose nga ajo e Maqedonisë së sotme. Fundja, nga këto zona kanë ardhur si të gjithë vlleht - me përjashtim të vllehve *Sremljani*, sot Cërmjan në rrethina të Gjakovës, për të cilët besohet, sipas K. Jireček,[15] se janë të ardhur nga *Sirimium*-i, përkatësisht sllav. *Srem-i* i Panonisë së atëhershme hungareze - ashtu edhe pararendësit e goranëve të sotëm.

---

[12] Sh. punimin e tij Studije za istoriju srpske trgovine, Glasnik Srpskog Učenog Društva, 37 (Beograd, 1873), f. 240-241.

[13] Po ai, po aty.

[14] Njëri nga kumanët, përkatësisht bir i një kumanje e fisit të Arpadëve Ladislaus IV, u bë madje edhe mbret i Hungarisë, si trashëgimtari i Belas. Për shkak se i favorizonte kumanët paganë dhe për shkak se çonte jetë të shfrenuar me jaraneshat e tij kumane, ky shkaktoi pakënaqësi të mëdha të brendshme në vendin e tij. [sipas Georg Weber, Geschichte des Mittelalters, Vollständig bearbeitet von Prof: Dr. Alfred Baldamus), Fouierverlag, Herausgegeben von A. Kleine., Köln. 2003, f. 975. dhe Čedomilj Mijatović, Studije za istoriju srpske trgovine, Glasnik Srpskog Učenog Društva, 37 (Beograd, 1873), f. 220.] prandaj edhe [sipas Dipl. Ing. Neidenbach Norbert në http://www.jetscha.de/banat/hog/grj/eig_grj/Das%20Banat.htm] e vranë vetë kumanët në vitin 1290.

[15] Sh. Romani u gradovima Dalmacije tokom srednjega veka, Zbornik Konstantina Jirečeka, 2, Beograd, 1962. f. 45.

Çështje më vete që do të duhej sqaruar mbetet ajo se në ç'cilësi do të jenë sjellur ata kumanë. Për këtë ka dy paravendime: sipas njërit, që e mbron dijetari serb Čedomilj Mijatović, ata do të jenë sjellur për t'i populluar viset bujqësore të mbretërisë serbe, ndërsa sipas tjetrit, që e përfaqëson antropologu A. Urošević, ata qenkan sjellur si mercenarë.[16]

Në kuadrin e sjelljes së mercenarëve, nga historiografia serbe dihet që për t'i mbajtur nën zapt (mbase sidomos) shqiptarët e vlleht që i kishte pushtuar, sundimtari serb Stefan Dušan kishte sjellur në perandorinë jetëshkurtër të tij edhe mercenarë gjermanë.[17]

Për shkak të mungesës së burimeve të shkruara, dritë në ndjekjen e gjurmëve të grupit etnik të kumanëve hedhin vetëm mbetjet onomastike.

Përmendja e parë e antroponimit *Kuman* që do ta lejonte paravendimin se kemi të bëjmë me ndonjë ose disa individë që do ta kenë ruajtur emrin etnik të kumanëve, rrjedh nga vitet 1222-1228. Në krisobulën e mbretit serb Stefan (Nemanja) dhe të të birit Radoslav mbi themelimin e manastirit të Žiča-s tregohet që atij manastiri i faleshin, midis të tjerash, edhe vlleht e Hvostne-s (më vonë shq. Rrafsh i Dukagjinit, serb. Metohija). Ndër ata banorë me emra tipik vlleh si *Buç*, *Bukor*, *Bun*, *Bunilo*, *Çuç*, *Mik*, *Rug*, *Tudor* e ndonjë tjetër kishte edhe tre kryefamiljarë të quajtur: *Kuman*.[18]

Pak vite më vonë, përkatësisht në krisobulën e Banjskës të viteve 1313-1318, përkatësisht në kartëdhuratën për manastirin e Shën Stefanit

---

[16] Khs. punimin e tij Neki detalji iz prošlosti Kosova (Po toponimima), në Onomatološki prilozi I, SANU, Beograd,1979, f. 30.

[17] Kjo bëhet e ditur nga një epizod i jetës familiare të këtij sundimtari serb, përkatësisht nga rrethana që "bashkëshortësia e tij me mbretëreshën Helena nuk kishte fëmijë; rreth vitit 1336 po punohej për prishjen e kësaj kurore. Ndërmjet Dushanit dhe kontit austriak Oton u zhvilluan në vitin 1336 negociata që e mbesa Eleizabeta e Otonit, e bija e mbretit gjerman Filipit të Bukur, të martohej me Dushanin. Të dërguar austriakë kishin ardhur asaj pranvere në Serbi, duke udhëtuar nëpër det nga Istria deri në Kotor. Duket se ndërmjetësues në këtë punë ishte kalorësi Palman, *kryekomandant i mercenarëve gjermanë në Serbi* (nënvizimi im). Elizabeta e re, të cilën nuk e kishin pyetur nëse pajtohej me këtë martesë të propozuar, u neverit nga ideja që të katandisej dikund në një botë të panjohur, në një vend barbarësh në Lindje dhe të martohej për një mbret me fe tjetër e, edhe ashtu të martuar, u sëmur rëndë dhe ndërroi jetë që në vjeshtën e atij viti. Me vdekjen e saj u varros edhe një tragjedi sentimentale intime, e lidhur për një personalitet të historisë sonë, (SG: serbe) një tragjedi e pazakonshme si për nga lindja dhe lidhjet e pasojat së pakut përgjysmë mistike. Kur mbretëresha Helena kishte marrë vesh për ato plane të Dushanit, ajo u ngut të pjellte, madje pikërisht një djalë, dhe e qetësoi kështu Dushanin. Dhe, megjithmend, në dimirin e vitit 1336 ose në fillim të vitit 1337 ajo e lindi të vetmin djalë Uroshin dhe kështu e përforcoi pozitën e saj në oborrin mbretëror." khs. Vladimir Ćorović, Istorija srpskog naroda, në www.rastko.org.yu/rastko-bl/istorija/corovic/istorija, f. 3.

[18] Fr. Miklosich, Monumenta spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii, Viennae, 1871, f. 13.

të këtij lokaliteti, midis banorëve të cilësuar shprehimisht për vlleh të vendosur në bjeshkën e quajtur Barel (: *Katounь Bareljev'ski*) - ndonjëri nga katundet e sotme përreth bjeshkës Bareli në Bajgorë, të krahinës Shalë e Bajgorës - përmendet edhe banori i quajtur *kumanicь*. Dëshmimi i këtij antroponimi në një ambient vllehsh (në të cilin kishte kryefamiljarë me emra vlleh dhe sish të formuar sipas natyrës së vllahishtes si: kostadin *primikjorь*, *nëgulь*, *šarbanь*, *bounislavь*, *bouniša* dhe *nëgoulь*)[19] si dhe rrethanës që pothuaj të gjitha bashkësitë blegtorale/katunet e vllehve të përmendura në këtë dokument do të jenë të ardhur nga hapësira e Rodopeve të Bullgarisë (khs. p.sh. edhe emrin *Katounь blьgar'ski* - sot shq. *Bugariq*, serb. *Srbobran* në rrethina të Mitrovicës) do të tregonte që edhe nëse banori *kumanicь* do ta ketë ruajtur emrin etnik të kumanëve si mbiemër të vetin, ky nuk do të ketë qenë kuman etnik, porse vllah si të gjithë pjesëtarët e asaj vëllazërie vllahe blegtorale të ardhur këndej nga vise të Bullgarisë dhe kurrsesi si mercenar. Po ky përfundim (shih më poshtë) vlen edhe për të gjitha dëshmitë që do të sillen më poshtë.

Dëshmia e parë onomastike mbi bazën e së cilës do të mund të paravendohej prania e ndonjë kolektiviteti, përkatësisht vëllazërie të kumanëve si bashkësi në hapësirën e sotme të Kosovës përmbahet në Kartëdhuratën e Graçanicës të vitit 1321 të mbretit serb Stefan Urosh Milutin. Në kontekstin e faljes së pronave dhe të njerëzve të lidhura me to manastirit të Shën Stefanit të Banjskës, sundimtari kumtonte që për kompensim të vllehve Dragobratići që ia kishte falë atij manastiri, ipeshkvisë së Lipjanit ia falte vlleht *komanë*.[20] Është çështje jo pak e vështirë të merret vesh përse komanët, nëse nën këtë emër do të duhej vërtet të kuptoheshin kumanët etnikë me prejardhje aziatike, cilësohen për vlleh. Jo vetëm distinktivi *vlah* që i paraprin emrit të kësaj vëllazërie, porse edhe antroponimia e vetë banorëve të asaj vëllazërie[21] nuk lë derë të pohohet se, në aspektin onomastik, kemi të bëjmë me kumanë aziatikë. Një sqarim i mundshëm në të mirë të qenies kumanë do të ishte

[19] Lj. Kovačević, Svetostefanska hrosovulja, Spomenik SKA, IV, Beograd, 1890, f. 8.

[20] Khs. tekstin origjinal: " [...] i za vlahe Dragobratikє, koje dahь svetomou Stєfanou, dahь za ne zaměnou jepiskoupiji ljiplanьskoi Komane vlahє [...]" te Franz Miklosich: Monumenta spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii, Viennae, 1871, f. 563.

[21] Khs. antroponimet e banorëve të këtij vendbanimi: *Nëgoslavь* me të vëllanë; *Dragovьcь* me fëmijët; *Dražanь* me të vëllanë; *Dragoslavь* me fëmijët; *Koukolь* me fëmijët; e shoqja e *Goikin*-it; me fëmijët; *Stanislavь* me të vëllanë; *Berislavь* me fëmijët; *Dragoslavь* me fëmijët; *Inekavь* me fëmijët; *Toudorь* me të vëllanë; *Bratoslavь*, *Martinь*, dhëndurët e *Berislav*-it; *Gjurg*-u me të vëllanë; *Doubravьcь*-i me të vëllanë e me të motrën; *Hrane Grьbešikь*, *Vladь*, kushëri i *Dobronja*-s; *Dobre* me të vëllanë; *Toupe* me të bijtë; *Družoje* me të vëllanë; *Ljube Bratoslalikь* me fëmijët dhe të bijtë e *Balin*-it; *Radomir*-i dhe *Mrьša* [khs. Fr. Miklosich, Monumenta serbica. .., f. 563.

paravendimi që këtu kemi të bëjmë me kumanë të ardhur nga vise në të cilat këta, duke qenë kryesisht blegtorë, kishin bashkëjetuar me vlleh dhe ishin asimiluar në ta. Si procesi i vllahizimit etnik ashtu edhe i sllavizimit onomastik të kumanëve do të jetë kryer në atdheun e tyre të kryehershëm. Kjo sidomos në dritën e rrethanës që kjo gjendje onomastike e kumanëve dëshmohet njëkohësisht me njoftimin për sjelljen e tyre në hapësirën e sotme të Kosovës.

Përcaktimin e vendndodhjes së vëllazërisë së kumanëve vlleh të përmendur në vitin 1321 e ndihmon mirë një e dhënë e vitit 1330. Atëherë në krisobulat e Deçanit përmendet edhe një katund i quajtur *Kumanovo*. Këtë katund sundimtari e ndërronte tani në të mirë të arqipeshkvit Danilo (të Lipjanit?) me katundin Jablanica. Në katundin Kumanovo, për përkatësinë etnike të banorëve të të cilit nuk thuhet asgjë, jetonin në vitin 1330 banorët: popi *Burja* me të bijtë *Ranko* e *Radić*, i vëllai *Bratan*, i biri *Daboje* dhe gjyshi i tyre *Kramol*; *Pobrat*-i me të birin *Bogoslav* dhe me të bijtë *Dabiživ* e *Peter* dhe me gjyshin e tyre *Gradihna*; *Priboje Miroslalić* dhe i biri *Dragoslav* dhe gjyshi i tyre *Dragibrat*; *Mileša Mildružiq*; Drag*an Bratković* dhe i biri *Bogdan*-i dhe gjyshi i tyre *Radovan*-i; *Milko Dobroslalić* dhe gjyshi i tij *Pribislav*-i; *Bogoslav Smilović*-i dhe i gjyshi *Bratun*; *Bogdan*-i dhe të bijtë *Hranc*, *Voisil* e *Ranko*; *Dragan*-i dhe i biri *Goislav* dhe gjyshi i tij *Dragibrat.*[22] Në krisobula, katundi *Kumanovo* përmendet bashkë me katundet *Arhidijača* (sot shq. Halilaq), *Belakievc*i (sot shq. Bellaqevc) dhe *Radoievo* (sot serb. Radevo, shq. Radevë) - që të gjitha këto katunde të Rrafshit të Kosovës. Përveç këtyre në krisobulë përmendet edhe një katund tjetër, *Kuzmin* (katund i populluar me serbë, po me këtë emër, në Rrafsh të Kosovës, përkatësisht në komunën e Lipjanit) dhe një katund i zhdukur, *Srednje selo* si dhe lumi Sitnica.

Në këtë kontekst duhet të kihet parasysh edhe rrethana që një vend i quajtur *kriva vĕja*,[23] të cilin unë e identifikoj me kompleksin me tokë buke, me mal e me lëndina midis Prishtinës e Gllogovcit dhe quhet *Krivovë*[24] ishte i rezervuar për kullotë dimërore për banorët e katundeve *Kumanovo* dhe *Srednje Selo*. Rrethana që banorët e këtyre dy katundeve i takonin gjithashtu feudit të manastirit të Deçanit lë vend për paravendimin se edhe këta ishin ose bujkrobër ose blegtorë, përkatësisht ose

[22] Sh. Dečanska hrisovulja. .., f. 27.

[23] Khs. Dečanska hrisovulja. .., f. 96; 247: "Ase megje ot radujeva [...], megju dobroglĕgje i arhidijače [...] kako putь izlazi is krive vĕje. ..".

[24] Ky emër është dëshmuar edhe në vitin 1455, kur është regjistruar në trajtën Krivina (= Mzr'h Qry t(n)h), khs. Oblast Brankovića. .., f. 88.

vlleh ose arbanasë. Mirëpo mundësia e dytë (që këta të kenë qenë arbanasë) bie poshtë në dritën e rrethanës se manastirit të Graçanicës i takonin më 1321-1322 edhe vlleht *Kumainci*, emri i të cilëve është dëshmuar që më 1326 në një kartë të Stefan Uroš-it III të njohur si, ‚i Deçanit", përmes së cilës ai i falte prona arqipeshkvisë së Prizrenit në Levishë, e midis tyre edhe katundin Komanovo.[25] Po u nisëm nga mundësia potenciale që emri *Kumanovo* i katundit e mbase edhe nga emri i vëllazërisë Kumainci (i cili ka shumë gjasë të jetë asgjë tjetër përpos një trajtë e emrit Kuman të kolonëve kaukazikë që në hapësirën e sotme të Kosovës i kishte sjellur sundimtari serb Urosh Milutini I, të zgjeruar me prapashtesë sllave -*inci* që e tregon përkatësinë, atëherë do të dilte se as banorët e katundit Kumanovo e as, ‚vllehtë" *Kumainci* nuk ishin as, , vlleh" e as, ‚arbanasë", porse barinj etnikë *kumanë*. Nëse ky paravendim i mi mund të qëndrojë, atëherë do të mund të paravendohej njëherë e mirë se atributet *vlah* e *arbanas* e kishin në shkrimet serbe të shek. XIV vërtet vetëm kuptimin e, ‚blegtor"-it nën të cilin ishin përfshirë edhe kumanët aziatikë, qofshin ata të sjellë vullnetarisht nga vetë sundimtarë serbë me qëllim popullimi të territoreve të pushtuara apo edhe pjesë e mbetur e kësaj popullate aziatike që mund të kishte mbetur këndej pas depërtimit të tyre në këtë hapësirë si rezultat i sulmeve bullgare-kumane të vitit 1253. Ka historianë serbë që besojnë se edhe bartja e selisë së kishës serbe nga Žiča në Pejë ka ndodhur si pasojë e djegies së asaj selie nga kumanët.[26] Duhet parë më hollësisht e pastaj të shfaqet ndonjë mendim i pranueshëm nëse edhe banori *Giergi Cumani* i katundit Buzëzezi i vitit 1416[27] në rrethina të Shkodrës e ruante emrin e kumanëve aziatikë.

Me çështjen e identifikimit në terren të katundit *Kumanovo* u muarr më 1956 Atanasije Urošević. Sipas këtij autori, katundi Kumanovo i zhdukur i Kosovës do të ketë qenë në territorin e katundit të sotëm *Vragoli*[28] afër Fushë-Kosovës, në të cilin del emri *Kumanovka* i një kompleksi arash të këtij katundi. Këtë lokalizim e pranon kohëve të

[25] Që ndodhej në hapësirën e sotme të katundit Vragoli midis Prishtinës e Fushë-Kosovës.

[26] Për një sulmim mbi shtetin në ekspansion të Rashës shkruan M. Dinić, khs. Nastanak dva naša sednovekovna grada, në "Prilozi za knjževnost, jezik, istoriju i folklor", nr. 31, bleu 1-2, Beograd, 1965, f. 196.

[27] Khs. Villa clamada *Busesessi* në të clin ishte evidentuar banori *Giergi Cumani*, te S. Ljubić, Skadarski zemljišnik. .., f. 50. Duket se patronimi Cumani mund e duhet të lidhet me emrin e kumanëve aziatikë. Ka arsye të besohet që i kësaj prejardhjeje do të jetë edhe emiri në trajtën Koman,-i i shqiptarëve mesjetarë e të sotëm, si dëshmi e asimilimit, shqiptarizimit të atyre pak kumanëve që u sollën në këtë hapësirë për popullimin e vendeve të rralluara apo të mbetura shkret.

[28] Atanasije Urošević, O iščezlom selu Kumanovu na Kosovu, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, Prishtinë, 1956, f. 225-228.

fundit edhe J. Osmani.[29] Autori ynë thotë porse, me ton patriotik, se Vragolia (që ky e quan *Livragona*, mbase pse ndonjë huaj e paska shënuar emrin e këtij vendbanimi vetëm një herë si Livragona) na qenka "[...] një prej vendbanimeve të vjetra autoktone shqiptare, që është shtrirë rreth 5-6 km në perëndim të Fushë-Kosovës" duke kaluar heshtazi mbi dëshmitë që i sjell ky vetë se ai vendbanim është banuar pas vendimeve të Kongresit të Berlinit me shqiptarë të dëbuar nga vise të hapësirës që sot quhet Serbi e Jugut, gjë që e tregojnë edhe vetë emrat Prebrezët, Sllamnikët, Gërgurët, Pllanakët, Dedincët, Kurshumlitë e Bërbatofcët të vëllazërive/mbiemrave të tyre në bazë të emrave të katundeve prej nga e heqin prejardhjen. Ka edhe një mendim sipas të cilit në Kosovë nuk kishte ndonjë katund të quajtur *Kumanovo*, porse që edhe në këtë rast paskemi të bëjmë vetëm me qytetin e sotëm të Kumanovës në Maqedoni.[30]

Së fundi duhet theksuar që, me këtë emër, katundi i zhdukur *Kumanovo* nuk përmendet më nëpër burime të mëpastajme, madje as në ato më të bollshme e më të hollësishme të shekullit XV e më vonë.

Që kumanët, nëse mbreti serb me të vërtetë paska pas sjellur "mijëra" të tillë - siç thuhet në burim (khs. më lart) kishin ardhur porse si *vlleh* do të tregonte edhe rrethana që ata (vetëm me emrin etnik të tyre dhe jo si etnitet kaukazik) ndeshen të jenë pa përjashtim banorë të ambienteve shprehimisht të cilësuara për të vllehve. Kjo vërtetohet, ndoshta, p.sh. me rrethanën që jo larg vendit të vendosjes së tyre (në hapësirat e katundit të sotëm Vragoli), në dokument pikërisht midis katundit të zhdukur *Kumanovo* dhe katundit të sotëm Halilaq (në dokument: Arhidijača) përmendet edhe një vend i quajtur *Vlaška kućišta* "Truallishtat e vllehve", khs. tekstin: atje ku rruga del nga *Venja e shtremt dhe përgjatë rrugës në përrua dhe përgjatë përroit tek Tuallishtat e vllehve dhe nëpër mal tek udha e cila (udhë) bie midis Kumanovës e Bellaqevcit".[31]

---

[29] Sh.Venbanimet e Kosovës, 1, Prishtina, Kastrioti dhe Fushë-Kosova, Prishtinë, 2003, f. 333-334.

[30] Kështu po menduakan, sipas A. Urošević, O iščezlom selu Kumanovu na Kosovu,. ..J. Vasiljević e Kosta N. Kostić. Për këtë ata u mbështetën jo vetëm tek ngjashmëria fonematike e emrit Kumanovo të Kosovës dhe atij të Maqedonisë, porse edhe në përputhjen midis emrit *Belakievc* të krisobulës (sot Bellaqë(v)c në Kosovë) dhe emrit të katundit Beljakovc 24 km larg Kumanovës së Maqedonisë si edhe në ngjashmërinë e imagjinuar nga ata midis emrit të transkribuar gabimisht si Arhidnjača (do të duhej Arhiljača) të Kosovës dhe ermit Jačince të një katundi të rrethinave të Kumanovës.

[31] Khs. origjinalin "kako putь izlazi iz krive veje takore pres' putь u dolь i uzь dolь u vlaška kukišta i pakii delomь u putь koi putь slazi megju kumanovo i megju belakjev'cь" sh. Dečanske hrisovulje, f. 27.

Unë e lejoj mundësinë që vendi *Vlaška kućišta* të jetë hapësira e një vëllazërie vllahe të shek. XIV e cila më vonë do të dalë me emrin *Vragolia*.

Përkatësia e kryehershme etnike e gjuhësore vllahe të banorëve dhe të vendit të quajtur *Vragoli* do të dëshmohej duke e paravenduar mundësinë që ky vend të jetë quajtur në krye të herës *Drakul/*Dracul (?) me vlerën kuptimore si shqip *Dreq*, i cili më vonë do të jetë përkthyer në serbisht si *Vragol*, përkatësisht *Vragolija* nga serb. *vrag* "dreq" i zgjeruar me prapashtesën *-ija* me kuptimin vend i banuar nga vëllazëria e Vragolëve.

Po në dokumentin e vitit 1321 (khs. më lart) dëshmohet edhe një mikrotoponim në të cilin mbase ruhet emri etnik i kumanëve: *Maja e Kumanit*. Khs. tekstin: "I shkrova në krisobulë këto katunde me emrat Graçanicë e Sushicë dhe Selcë me lagjet dhe me kufijtë e tyre. .. kroi. .. *janja* drejt fushës e në *Brestije* (SG. katundi i sotëm Bresje i Fushë-Kosovës) te kisha e Shën Spasit mespërmes fushës tek *Mullinjtë e Skullanovës* drejt e në lumin e *Gradçankës* (SG. të Graçanicës) dhe drejt e tek *Mullinjtë e Majsllavit*. .. në *Krushevc*. .. drejt e në *Butovc* nëpër mal tek *Fusha e korrun* në *Majen e Kumanit* tek *Nedelja* (*Kisha e Djellës?) nëpër mal sipri *Brusit* dhe nga *Brusi* nëpër mal drejt e tek *Maja e Mpreht* dhe nga *Maja e Mpreht* në *Veleten* (sot Veletin në Janjevë) midis *Sushicës* e midis *Gushtericës* nëpër mal. .. tek udha që shkon nga qyteti i *Prishtinës*."[32]

Në bazë të të dhënave gjeografike-onomastike nga teksti i mësipërm rezulton se vend i quajtur **Maja e Kumanit* do të ketë qenë në hapësirën midis katundeve të sotme Mramuer e Brus që u përkasin komunave të Prishtinës e të Lipjanit. Ky nuk është, pra, ai katundi i cilësuar për i *vllehve kumanë*, që ishte në hapësirën e katundit të sotëm Vragoli të Fushë-Kosovës.

Pa u larguar nga kjo hapësirë e Kosovës, vlen të shtohet në këtë mes se një banor që për mbiemër mbase e mbante distinktivin etnik të kumanëve dëshmohet edhe në Librin e borxhlinjve të tregtarit raguzas Mich. De Lucari të viteve 1438-1440. Këtu është shënuar se *Tanushi*, që ishte bir i Hanzo-s, bashkë me minatorin Tomko e paguanin, duke qenë

[32] Khs. tekstin origjinal: "vьpisahь hrisovulь sii sela imen Gračanica i sušica i Selce sь zaselijami ihь i sь megjami. .. stude. .. janja pravo po polju u Brěstije kь spasove crьkvi prěs-pole pravo na Skulanovo voděnićište pravo u rěku gradčansku i kovь (f. 562) pravo u Majslavle voděnićište. ... u Kruševьcь. .. pravo u Butovьcь po dělu na ωranu poljanu na Kumanju glavu na nedělju po dělu pravo nadь Brusь i ωdь Brusa po dělu pravo na Ostrьi Vrьhь i ωdь Ostroga Vrьha na Veletěnь megju Sušicu i megju Gušteričju po dělu. .. na putь koi grede izь grada u Prištinu." Fr. Miklosich, Monumenta serbica. .., f. 562-563.

se do të kishin qenë dorëzanë, borxhin për një borxhlinj të Mich. de Lucari-t, i quajtur *Chumanin* (lexo: Kumanin = "kuman-in") dhe të së shoqes Radosava, për shkak se, në ndërkohë, kishin vdekur që të dytë.[33] Në burim nuk është dhënë as emri personal i atij kumani e as vendbanimi.

Një emër vendi në të cilin ruhet antroponimi *Koman*/*Kuman* në funksion të ndonjë ofiçi ose të identifikimit mbi bazën e përkatësisë etnike është mikrotoponimi **Truallishta e Komanit*. Ky vend përmendet në një kartë të vitit 1327 përmes së cilës sundimtari serb ia falte Kishës së Shën Mërisë në Malin e Shenjtë, Hilandar disa katunde khs. tekstin: "Dhe, mbretëria ime, Kishës së Shën Mërisë ia fali dy katunde: Izbishtën dhe Truallishtën e Komanit" dhe ". .. pas qytetit të Prizrenit edhe katundin Plavino, katundin Dobrodolc, katundin Izbishtë dhe *Truallishten e Komanit*"[34] të rrethinave të Prizrenit. Sado që për vendet e përmendura në dokument dimë se kemi të bëjmë me qytetin e Prizrenit, katundin Pllavë të Opojës, Dobërdolan të Suharekës, vendndodhja e mikrotoponimit *Truallishta e Komanit* mbetet mbase e lidhur me katundin e përmendur në dokument si Izbishta. Në këtë mes është e qartë që vendi i quajtur në vitin 1327 Izbishta nuk është katundi i sotëm Izbicë i krahinës së Drenicës, porse vendi i quajtur *Izbishtë* në territorin e katundit Randobravë të rrethinës së Prizrenit.[35] Sipas traditës gojore, komplekset e quajtura *Maskisha* dhe *Izbishta* mbahen për lokacione të kryehershme të këtij katundi.[36]

Nëse *Koman* është varianti *Kuman* atëherë do të mund të thuhej që antroponimi që asocion emrin etnik të kumanëve aziatikë do të ketë qenë shtrirë edhe në Rrafsh të Dukagjinit e në Shqipërinë e Veriut. Këtë paravendim do ta mbështeste dëshmimi i këtij emri në funksion patronimi e antroponimi aktiv në vitin 1485. Asokohe janë regjistruar (edhe) kryefamiljarët: Radovan *Komaniç*-i në katundin Rosuha që varej nga Peja; *Komaç*-i, i bir i Boriç-it në katundin Gril të Shkodrës; Lazar-i, i bir *Koman*-it dhe *Kom*-i, i bir i *Lum*-it në katundin Içpaja, afër vëllazërisë/ katunit *Leshoviq* në Mal të Zi të sotmin; Vuçet-a, i bir i *Komar*-it në ka-

[33] Sh. Mihailo Dinić, Iz Dubrovačkog Arhiva I., Beograd, 1957. f. 53, 70.

[34] Khs. origjinalin: "I ješte priloži kraljevьstvo mi dvě sělě: Izbišta i Komanovo Sělište Bogorodici hьılandar'skoi." [..] za gradom Prizrenomь i sělo Plavino, selo Dobrodolьcь, sělo Izbišta i Komanovo Selište." te Lj. Stojanović, Stari srpski hrisovulji, akti, biografije, ljetopisi, tipici, pomenici, zapisi i dr., Spomenik SKA 3, Beograd, 1890, f. 11; St. Novaković, Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka, Beograd, 1912, f. 396, 398.

[35] Këtë mikrotoponim e ka shënuar në terren J. Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 18, Prizreni, Prishtinë, 2005, f. 231.

[36] Sipas J. Osmani, po aty.

tundin Lubice të Malit të Zi; Radiç-i, i bir i *Koman*-it dhe Gjon-i, i bir i *Koman*-it në katundet Grava (Greva?) e Mavriq të nahijes Petrishpan dhe Pava, i bir i *Koman*-it në katundin *Djakoviça*.[37]

Në dritën e dëshmive që bartësit e antroponimit apo të patronimit *Koman* etër apo bijë të individëve që mbanin antroponimet shqipe *Lum* e *Gjon* si antroponime të gjithkrishtera të shqiptarëve në trajta sllave të tyre *Lazar* e *Pava* ka arsye të paravendohet që procesi i shqiptarizimit të kumanëve kishte përfunduar kohë më parë se çereku i fundit të shek. 15. Dëshmi e fortë është në këtë mes vazhdimi deri në ditë tonat i mbiemrave *Komoni* (nga një **Komani*) dhe *Kumnova* (nga një **Kumanova*?) në Gjakovë, përkatësisht në Rrafsh të Dukagjinit.

Nga dëshmi aktuale në të mirë të ardhjes në hapësirën etnolinguistike shqiptare të ndonjë vëllazërie kumane e përzierë me vlleh të sllavizuar të ardhur para shek. 14 do të ishte emri *Kumaničovci* i një vëllazërie gorane në katundin Shishtevec të rrethinave të Kukësit. Emri *Kumaniçovci* i kësaj vëllazërie të katundit goran Shishtevec të Shqipërisë tregon nga ana tjetër, se në këtë zonë kishte ardhur, bashkë me jurukët, edhe ndonjë familje apo vëllazëri kumanësh. Ka gjasë që ajo vëllazëri kumane do të jetë vendosur këndej pas pushtimit osman dhe se s'ka ndonjë lidhje me kumanët që i kishin sjellur sundimtarët serbë (khs. më poshtë). Siç e tregojnë disa emra vendesh të sajuara nga emri etnik i kumanëve: *Kumanovo* në Maqedoni; *Kumanski* në Bullgari; *Kumansko ostrvo* në Vidin; *Kumana* në Nikbol dhe *Kumanitčka* në Lofča,[37a] edhe kjo vëllazëri do të ketë ardhur nga hapësira gjuhësore e bullgarishtes, përkatësisht e maqedonishtes. Duket se vendi i kryehershëm i banimit i kësaj vëllazërie ardhëse është i pandashëm nga emri *Kumaničevo* i një katundi në zonën e Kosturit në Maqedoni.

Këtë paravendim e mbështet jo krejt drejtpërdrejt autori S. Idrizi i cili, kur po e gjurmonte përmasën vllahe në kuadër të komponenteve që e formuan grupin etnik të goranëve, rekomandonte që në atë amalgam po u dashka pasur parasysh edhe prania e kumanëve dhe e peçenegëve "ndoshta edhe në vetë Gorën",[38] porse nuk shfaqte mendim të prerë nëse emri *Kumaničovci* duhet parë për emër vllah apo nëse mund të lidhet me kumanët.

---

[37] S. Pulaha, Defteri. i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, Tiranë, 1974, f. 128, 145, 149, 211, 297, 369, 432, 434.

[37a] Këta emra i citoj sipas Pomaci, njihova prošlost i sadašnjost në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[38] S. Idrizi-Aljabak, Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

Rrethana që ky emër vëllazërie dëshmohet në ambient goranësh, për të cilët besoj ta kem dëshmuar se janë pasardhës të trakasve të romanizuar e më vonë të bullgarizuar dhe të ardhur, pra, në hapësirën e Gorës nga vise të Bullgarisë, tregon se edhe në këtë rast mund të kemi të bëjmë me vlleh të kryehershëm apo që ndoshta pararendësit e vëllazërisë së sotme mund të kenë ardhur bashkë me ndonjë bashkësi jurukësh që këndej i kishte sjellë Perandoria Osmane. Edhe në këtë rast përjashtohet pra hipoteza që kumanët t'i ketë sjellë në Kosovën e sotme ndonjë sundimtar serb qoftë për popullim visesh të pabanuara apo si mercenarë.

Kumanët në veri të Shqipërisë

"Kohëve të fundit është lansuar ideja sipas së cilës po u ditka që *Komani* dhe mikroregjioni *Dushmani* në hapësira të regjionit të Pukës mund të kenë qenë ngulime të kumanëve."[39] Në *Shtojcë 1* të trajtesës së tij, autori sqaron se [...] Rastet kur një vendbanim të emërtohet sipas etnisë së banorëve ndeshen rëndom në rrethanat kur vendbanimi rrethohet nga popullsi e një etnie tjetër. Mjafton të përmend këtu fshatra arbëreshësh si *Arbanasi* në Bullgari ose *Arbëneshi*[*] në Dalmaci; edhe pse dukuria është shumë e përhapur - në Shqipëri gjen fshatra të tillë si *Bulgarec*[**] ose *Rëmenj*, të emërtuar sipas përkatësisë etnike të banorëve. Është afërmendsh të supozohet se emërtime të tilla i përdorin vendësit në kuptimin që edhe Komani do të jetë quajtur ashtu nga arbrit që ka pasur përreth, jo nga etnia që e ka themeluar." Në *Shtojcë 2* autori vazhdon me sqarimin: "Natyrisht, Komani i Pukës njihet në histori dhe në arkeologji edhe si vendi ku është zbuluar e ashtuquajtura "*kulturë e Komanit*", e cila ka rëndësi për të konfirmuar vijueshmërinë iliro-shqiptare në mesjetën e hershme. [...] Nuk më rezulton që varrezat e Komanit të jenë datuar me mjete të sigurta (radiokarbon) por vetëm nëpërmjet datimit të tërthortë të objekteve të gjendura aty: fibula, qafore bronzi, varëse rrethore, vathë bronzi me varëse në formë ylli apo gjysmëhëne, unaza etj., sikurse edhe armë të ndryshme. Shumë prej arkeologëve që i kanë studiuar këto objekte, kanë vënë në dukje ngjashmërinë e tyre me zbukurimet e

[39] Xha Xhai, Kur nuk laheshim, në: http://xhaxhai.wordpress.com/2009/09/30/arber-dhe-kumane/

[*] Ky vendbanim edhe nga vetë arbëreshët quhet *Arbanas* e jo *Arbënesh*. Arbënesh quhet një katund i regjionit të Krajës (sot në Mal të Zi).

[**] Unë po shtoj në këtë mes se prof. E. Çabej, në Studime etimologjike në fushë të shqipes, II, A-B, Tiranë 1976, f. 355, ka treguar se ky emër vendi rrjedh në të vërtetë nga fjala *bujgër*/*bulgër* e shqipes, që shenjon llojin Quercus macedonica "qarr i kuq, qarr mali" të drurit. Trajta *bulgër* është zhvillim i brendshëm /dialektor i shqipes i emrit *bung* të drurit.

malësorëve shqiptarë të zonës. Më pas arkeologu shqiptar Hasan Ceka arriti në përfundimin se varreza e Komanit ishte e shekujve X-XI, dhe i përkiste kulturës arbëre." Autori Xha Xhai ssqaron në vazhdim se "... ardhja e kumanëve aziatikë në Ballkan i përket një periudhe të mëpasme, pikërisht shekujve XII-XIII; prandaj nuk përjashtohet që këta të jenë vendosur në një vendbanim të braktisur prej arbërve sikurse nuk përjashtohet që një pjesë e objekteve të gjetura në Kalanë e Dalmacës t'u përkasin këtyre të ardhurve të vonë."

Gjurmët e kumanëve në trojet e Shqipërisë së Veriut i paska hetuar mirë studiuesi hungarez Iştvan Schütz. Në një punim të tijin përkitazi me kontaktet shqiptare-komane gjatë mesjetës në dritën e onomastikës së Kosovës, autori vërente se "në defterin e Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 gjenden një numër toponimesh me prejardhje kumane, të tilla si *Boshuçi, Bugjani, Kalkandelen, Orhanje, Shipçani, Shishmançi*. Edhe më të rëndësishme se toponimet më duken, vazhdon autori ynë, antroponimet (emrat e njerëzve); meqë po në atë defter gjejmë të evidentuar kryefamiljarët *Leka* dhe *Pavli*, bij të një *Derman-i*; *Andrija, Llesh-i* dhe *Gura*, bij të një *Derman-i* tjetër; *Leka* bir i një *Shishman-i*, e kështu me radhë (këtyre shembujve u duhet shtuar edhe ai i familjes bujare të *Dushmanëve*, bashkëkohës të Skënderbeut, të cilët ishin gjithashtu të krishterë) dhe që emri i kësaj familjeje të njohur arbre mesjetare të dëshmuar para shfaqjes së osmanëve në Ballkan; por edhe si emër i një katundi përsëri në afërsi të Komanit, [...] është e vështirë të shpjegohen me ndikimin osman.[40]

Që antroponimet *Derman, Shishman* dhe *Dushman* qenkan emra dhe fjalë me prejardhje kumane, po u konfirmuaka nga shumë burime të pavarura në Ballkan. Schütz vëren se, në rastin e defterit të Sanxhakut të Shkodrës, përjashtohet mundësia që personat në fjalë të jenë osmanllinjë; jo vetëm nga që emra si *Andrija, Lleshi, Leka* etj. i përkasin sistemit antroponimik të krishterë, por edhe nga që përkatësia osmane do të ishte shenjuar në defter. Që këtej, autori nxjerr përfundimin se kumanët e ngulimeve në veri të Shqipërisë e kishin përqafuar ndërkohë fenë e krishterë."[41] Unë shtoj në këtë mes se autori ynë do të duhej të precizonte se në këtë rast kemi të bëjmë me krishterimin shqiptar të ritit roman përkatësisht se, në dritën e antroponimeve *Andrija, Dushman*-i, *Lek*-a, *Lesh*-i, *Palvl*-i të sjellë më

[40] Les contacts médievaux albano-comans reflétés par l'onomastique de Kosovo, Acta Orient. Hung. XL, 1986, f. 296-297; Xha Xhai, Kur nuk laheshim, në: http://xhaxhai.wordpress.com/2009/09/30/arber-dhe-kumane/

[41] Po ai, Po aty.

lart rezulton se pjesëtarët e paktë të entitetit të kumanëve ishin shqiptarizuar kohë përpara çerekut të fundit të shek. 15.

Interpretimit të I. Schütz sipas të cilit emri i mikroregjionit *Dushman* mund të jetë emërtim nga kumanët unë ia kundërvë rrethanën që antroponimi *Dush-*, i zgjeruar me prapashtesat *-le, -ol, -ul* dhe *-man* dëshmohet ndër banorë që në burime kishtare serbe të shek. XIV kryesisht në katunde të cilisuara shprehimisht për të vllehve. Në ambiente vllehsh të Kosovës së sotme, ky antroponim dëshmohet në Krisobulat e Deçanit të vitit 1330 në trajtat *dušle* (një kryefamiljar në katunin e vllehve *Gjuraševci* - ndoshta njëri nga katundet Gjurgjevik i Madh e i Vogël të komunës së Klinës dhe një tjetër në atë të *vllehve Sremljani* - katundi i sotëm Cërmjan i krahinës së Dushkajës të komunës së Gjakovës); *dušolь* në katunin *Vardištani* të vllehve - mbase në katundin e sotëm Kralan të Gjakovës apo në hapësira të komunës së sotme të Istogut; *dušoulь* në katunin e vllehve *Tudoričevci*;[42] (katundi i sotëm Turiçevc i komunës së Skënderajt) *dušmanь* në katunin *Dragoljevci*.[43] (katundi i sotëm Dragolevc/Dragulevc i komunës së Istogut). Antroponimi *Dushman* dëshmohet në fundshekullin 15 edhe në hapësira të krahinës së sotme të Gallapit. Atëherë në katundin e shënuar nga shkruesi osman si *Ivlah* (në vend të *Vlah*), përkatësisht në katundin e sotëm Vllasë të komunës së Kamenicës ose në lagjen/vëllazërinë e quajtur sot *Vllasalitë* të katundit Marec të komunës së Prishtinës është regjistruar kryefamiljari i quajtur Dimitr-i *Dushman*-i, që duket se ishte edhe pronar i një bashtine në katundin e paidentifikuar në terren Vojmilovc, si dhe kryefamiljari (vëlla apo kushëri i *Dimitr*-it) i quajtur Jovan *Dushman*-i.[44] Përveç këtyre, këtu e atëherë ishin evidentuar edhe bashkatundarët *Tuna*, i bir i *Marin*-it me emra të uzusit onomastik të krishterimit të ritit roman; priftërinjtë (popët) *Radovan* e *Marko* si dhe kryefamiljari *Jovan* me titullin *knez*, karakteristik për eprorë përfaqësues përpara pushtetit të banorëve të ambienteve të banuara nga entiteti vllah, që ishin pronarë llazesh "shkorretesh" në katundin e paidentifikuar *Vojmilovc.*

Antroponimi *Dushman* dëshmohet edhe në katundin e sotëm Hatishtë në juglindje të Kërçovës, i cili në defterin osman të viteve 1467-1468 është shënuar po si Hatišta (= X"tšth).[45] Në territorin e këtij katundi ishte më parë (së pakt që nga shek. 14) një vendbanim i quajtur *Arbanasinec*,

[42] Miloš S. Milojević, Dečanska hrisovulja, f. 53, 123, 125.

[43] Sipas J. Šafarik, Hrisovulja cara Stefana Dušana …, f. 297.

[44] Iljaz Rexha: Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës …, f. 129, 136.

[45] Khs. Metodija Sokoloski & Dr. Aleksandar Stojanovski, (red.): Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod, Opšien popisen defter Nr. 4 (1467-1468), Shkup, 1971, f. 283.

kujtimi për të cilin është ruajtur tek emri *Arbanasinec* i një burimi në territor të këtij katundi.[46] Në katundin Hatište (ish *Arbanasinec*) jetonin, sipas defterit të viteve 1467-1468 edhe kryefamiljarët *Dušman* Novica (= Dwsm"n Nwyc); dhe Rale, i bir i *Dušman*-it (= R"ln wld Dwsm"n).[47]

Unë kujtoj se si antroponimi ashtu edhe emri *Dushman* i mikrorajonit në Veri të Shqipërisë e, rrjedhimisht, edhe emrat e katundeve *Dush* në Rrafsh të Dukagjinit (Kosovë) e kanë për rrënjë antroponimin *Dush* që ndër vlleh të Kosovës së shek. 14 ndeshet i zgjeruar me prapashtesat *-ol*, *-ul* dhe *-man*, ndërsa tek shqiptarët në rrafsh të Dukagjinit ruhet edhe sot në si *Dush*-i, m. dhe *Dushe-ja* f.

Kundër paravendimit të I. Schütz-it se emër me prejardhje kumane na qenka edhe antroponimi *Shishman* do të fliste dëshmimi i emrit *Šišatovьci* të njërit nga katundet vllahe që i takonin manastirit të Banjskës më 1313-1318.[48] Ky katun përmendet, bashkë me *katunь blьgarъskыi* "katuni i bullgarëve", emrin mesjetar të të cilit e kanë ruajtur vetëm shqiptarët si *Bugariq*, por jo edhe serbët, të cilët këtë toponim e kanë ripagëzuar me emrin *Srbobran*. Ndoshta ka arsye të supozohet se ky katun ndodhej jo larg nga katundi i sotëm Bugariq i Mitrovicës. Në këtë burim përmendet edhe banori *šiš'ka* i katunit *Ursulovci* të vllehve,[49] i cili ndodhet në rrethina të Sjenicës së krahinës së Sanxhakut.

S'ka mbase dyshim që emri i këtij katundi është sajuar nga antroponimi Sish i zgjeruar me prapashtesat *-at* e *-ovci*. Po ky antroponim, porse tani i zgjeruar me prapashtesën *-man*, përkatësisht si *Shishman* dëshmohet në vitet 1330 e 1348 pikërisht në vendbanime të cilësuara shprehimisht për të vllehve. Kështu, ndër banorë të vllehve të Vardishtës (*vlasi vardištane*[**])

[46] Përkitazi me lokalizimin khs. Spomenici za srednovekovnata i ponovata istorija na Makedonija, Shkup 1981, f. 91 dhe Toma Smiljanić, *Kičevija*, Naselja i poreklo stanovništva 28 (1935), f. 359, 372, 460.

[47] Khs. Turski dokumenti. .., f. 283.

[48] Sh. Lj.(ubomir) Kovačević, Svetostefanska hrosovulja, Spomenik SKA, IV, Beograd, 1890, f. 7: "a se vlasi. .. katunь šišatov'cь."

[49] Po ai, po aty, f. 8.

[*] Duket se ky venbanim i paidentifikuar në terren i vllehve mund të ketë qenë në hapësirën që sot e zë katundi Kralan i krahinëzës Dushkajë të komunës së Gjakovës. Në këtë katund është p.sh. një kompleks toke i quajtur *Vardishta*. Në këtë kompleks ndodhen edhe mikrohidronimet *Kroni Vardisht's*, *Livadhet e Vardisht's*, *Roga e Vardisht's*, *Lugi Vardisht's*, *Malet e Vardisht's*, *Udha e Kodrës t'Vardisht's*/*Udha e Kodrav t'Vardisht's*.[sipas Prof. Skënder R. Hoxha, Toponimia e Dushkajës, Jakova, 2007, f. 162, 164., 165, 166, 167, 169, 443.] *Vardishte* po u quajka edhe një kodër në katundin Radavc të Istogut në të cilën (kodër), kështu po besuakan vendësit, dikur paska pasur gëlqere, përkatësisht që kjo kodër paska qenë [sipas Svetozar Stijović, Onomastika

në vitin 1330 është evidentuar edhe kryefamiljari i quajtur *šiš'manь* dhe banorët e quajtur *šišoje* në katunin e Gramaçelit dhe *šišmanь* në katunin Luboliq të rrethinave të Deçanit,[50] në vitin 1348 në *Katounь guncati* (katundi i sotëm Ngucat midis Suharekës e Malishevës, mbase në shek. XIV po ashtu vendbanim i vllehve) dëshmohet po ashtu një kryefamiljar i quajtur *šišmanь*.[51] Pa ndonjë lidhje me kumanët, të kësaj prejardhjeje do të jetë edhe emri *Shishman* (me lagjet *Shishmani i Rrafshit, Shishmani i Bok's* dhe *Mazrreku* e *Krazhnja*[52]) i një katundi të komunës së sotme të Gjakovës.

Një kryefamiljar me emrin *Shish*, të zgjeruar me prapashtesën sllave -*oje*, përkatësisht *Šišoje*, i bir i Vladislav-it.[53] është evidentuar edhe në regjistrimin osman të vitit 1455 për në katundin e quajtur Bijočinci, ndoshta katundi i sotëm Beçiq në lindje të Klinës.

Fundja, edhe ndonjë filolog serb si St. Stanojević,[54] e shihte emrin *Šišoje*, të dëshmuar në krisobulat e Deçanit, për emër (në relacion me serbishten) me prejardhje të huaj.

Në të mirë të mundësisë që emri *Shish*- të jetë sjellë në Kosovën e sotme nga vlleh të sllavizuar që këndej (në Kosovë) do të kenë ardhur në shekujt 12-13 nga hapësira gjuhësore e bullgarishtes flasin disa rrethana. Së pari duhet përmendur rrethanën që emrin *Šišman* e mbante edhe mbreti i fundit i "perandorisë" bullgare të mesjetës. Së dyti, ky emër ndeshet edhe tek rumunët në trajtat *Şiş*, *Şişat*, *Şişoje*, *Şişman*, por edhe në ato *Şuşman, Şăşman, Şuşan, Şuşul* etj. Dhe, së treti, ky emër dëshmohet edhe për antroponim i vllehve mesjetarë në Serbi.[55]

Duke e ditur rrezikun që mban në vete barazimi i përkatësisë gjuhësore të emrit me përkatësinë etnike të bartësit/bartësve, për me prejardhje bullgare, i sjell me vete nga pararendësit vlleh të sllavizuar të goranëve të sotëm, mund të jetë edhe emri *Shishovci*, përkatësisht *Shisho* i vëllazërisë në katundin Brod të krahinës së Gorës.[56] Një mundësi

---

zapadnog dela Metohijskog (Pećkog) Podgora, në Onomatološki prilozi, III, SANU, Beograd, 1982, f. 250.] vend ku piqej guri për gëlqere.

[50] Milojević S. Miloš: Dečanska hrisovulja, f. 123.

[51] Šafarik, J.:. Hrisovula cara Stefana Dušana …, f. 290.

[52] Të shënuara në terren nga Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 14, Gjakova, Prishtinë, 2005, f. 250.

[53] Khs. Oblast Brankovića. .., f. 99.

[54] Lična imena i narodnost u Srbiji srednjega veka, Južnoslovenski filolog VIII, Beograd 1928-1929, f. 153.

[55] Khs. N. A. Constantinescu, Dictionar onomastic romîn, Bucureşti, 1963, f. 370.

[56] Trajta *Shisho* është shënuar nga S. Idrizi: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori …, ndërsa e dyta ishte shënuar nga M. Lutovac.

potenciale e vendit origjinar të kësaj vëllazërie mund të jetë emri *Šiševo* i katundit të rrethinave të Shkupit i dëshmuar në vitet 1467-1468.[57] Rrethana që, në mbështetje të të dhënave të defterit, del katërçipërisht se banorët vendës të këtij katundi nuk kishin antroponime vllahe, tregon se shpërngulja e mundshme e pararendësve të vëllazërisë së sotme të Gorës do të ketë ndodhur shumë kohë përpara shekullit XV.

Si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin, kundër prejardhjes kumane të këtyre emrave do të fliste edhe prapashtesa *-man* për të cilën nuk asnjë dëshmi që në Ballkan do të jetë sjellë nga kumanët aziatikë, aq më parë që kjo prapashtesë ndeshet në dy gjuhët më të vjetra të Ballkanit: rumanishten e në shqipen.

Prapashtesa *-man*, që ndeshet edhe në rumanishten (khs. *gogoman* "budalla"; *grosman* "i trashë, trashaman"; *toroman* "emër qeni") mund të jetë me prejardhje sllave: khs. rus. *dikoman* "kopuk", serb. *vukoman, vukman,* bullg. *sukman* "njëfarë veshje" etj. Kjo prapashtesë është porse mjaft produktive edhe në shqipen: khs. *cucman, fjalaman, çakraman, çalaman, grindaman, pordhaman, qullaman, qyrraman, rreckaman, shurdhaman, trashaman, zeshkaman* etj.[58]

Në trajtesën e cituar më lart Schütz e parashtron hipotezën, gjithnjë sipas Xha Xhai se gjurmë të kumanëve po u ndeshkan edhe në këngën "Muji e Jevrenija" të ciklit të kreshnikëve. Në këtë këngë po u rrëfyeka për Tanushën që në këtë variant po dalka bijë e Krajle Kapidanit, e quajtur tani *Jevrenia,* e cila kishte rënë në dashuri me Sokole Halilin, një mysliman; për çka i jati i Jevreminës(!), i zemëruar, vendosi t'ua japte për nuse "*gumanave t'zez.*" *Guman(ë)at* e këngës kreshnike nuk mund të jenë igumanë - siç ka menduar ndonjë studiues me famë i folklorit shqiptar, sepse Schütz po e shihka këtë për absurditet - meqë është vështirë të gjesh tridhjetë igumenë të mbledhur bashkë, e aq më pak të armatosur."

Studiuesi Xha Xhai kujton se "Kjo hipotezë më duket se konfirmohet, tërthorazi, nga çfarë i kanë thënë pleqtë malësorë Durham-it (SG. sh. më poshtë): që nga krahasimi me *tartarët*, të cilët përmenden edhe në këngën më sipër dhe që i kanë ngatërruar rëndom me kumanët në mesjetë; aftësia e tyre për të mbarështruar kuajt (por edhe përdorimi i mishit të kalit si ushqim) e deri te përcaktimi *Gumanat e zez*, i cili ndoshta ka të bëjë me

[57] Khs. Turski dokumenti na istorijata na makedonskiot narod. .., f. 451.

[58] Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani dhe Prof. Eqrem Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë, 1962, f. 68. Unë (S.G.) shtoj në këtë mes se është mirë të dihet se disa nga këto atribute janë formuar në shqipen edhe me prapashtesa të tjera, si p.sh. -an (qyrran; zeshkan;); -aq (pordhaq); -ec (grindavec; qyrravec); -llak (trashullak).

ngjyrën e zeshkët të komanëve (që do të kenë qenë së paku më të zeshkët sesa vendasit)."

Autori ynë shton në këtë kuadër se "Ndofta nga kumanët e ka prejardhjen edhe loja e dikurshme e fëmijëve kur, pasi dalloje kundërshtarin nga larg, e eliminoje duke e quajtur "kuman, kuman"? Loja quhej "kumançe".[59]

Në trajtesën e cituar të këtij autori bukur shumë hapësirë i është kushtuar mundësisë hipotetike që kumanët të kenë qenë bartës/sjellës të judaizmit në hapësirat e veriut të Shqipërisë, një hipotezë kjo e mbështetur kryesisht në gojëdhëna që i kishte shënuar Edith Durham, por që autori ynë i zgjeron dhe pjesërisht edhe u beson. Duke u mbështetur mbi gojëdhënat, autori ynë përfundon se: "Meqë shumë fise e tregojnë këtë histori njëlloj, duket e sigurt që, pjesa më e madhe e atyre që erdhën në malësi për t'iu shpëtuar turqve dhe themeluan aty fiset e tanishme, gjetën aty një popullsi të zeshkët, të cilën e mundën (*conquered*). Në disa raste shkëmbyen gra me ta, në raste të tjera i dëbuan. Fakti që banorët më të vjetër gjithnjë përshkruhen si të errët, provon se të ardhurit rishtas do të kenë qenë të çelët (nga flokët, lëkura dhe sytë). Në tërësinë e vet, të gjitha fiset që e nxjerrin prejardhjen e vet nga Rasha,[*] janë më të zeshkët dhe më të vegjël nga trupi sesa ato të Malësisë së Madhe, që thonë se vijnë nga Bosnja.

Nga gojëdhëna të tilla është vështirë të nxjerrësh ndonjë përfundim për prejardhjen ose identitetin e këtyre fiseve "të zeshkëta", edhe pse disa karakteristika, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me ushqimin ("hanin lende lisi dhe mish kali"), u referohen vetvetiu fiseve nomade me prejardhje nga Azia që u dyndën në Ballkanin mesjetar prej fundit të antikitetit; ndërsa të tjera karakteristika ("nuk ishin sllavë, por ishin shumë të vjetër"), të bëjnë të mendosh se malësorët e dinin që banorët që kishin gjetur në malësi e më pas (të) asimiluar nuk kishin qenë arbër (shqiptarë) si ata.[60]

Nëse kumanët erdhën apo u sollën nga hapësira të Europës Juglindore (khs. më lart) do të shtrohej pyetja a ka mundësi që shpërnguljet dhe ardhjet e grupeve etnike nuk u shënuan në anale të historisë, sepse Perëndimi ishte kapluar gjatë shek. 12-14 nga udhëtimet, përkatësisht kryqëzatat drejt Vendit të Shenjt (Jerusalemit) dhe luftërave kundër heretizmit - siç thoshte në vitin 1852 G. D.Teutsch në veprën e tij për histo-

[59] Xha Xhai, Kur nuk laheshim, në: http://xhaxhai.wordpress.com/2009/09/30/arber-dhe-kumane/.

[*] Raška, bërthama e principatës serbe.

[60] Po ai, po aty.

rinë e sasëve të Transilvanisë[61] kur konstatonte se pikërisht për arsyen që u tha më lart nuk u shënuan as dyndjet e popujve e pra as ajo e sasëve.

Për shumë hipotetike e mbaj, megjithatë, si ekzistimin e një vendbanimi më të madh në hapësirën e sotme të qytezës së Gjakovës dhe shkatërrimin e tij dhe të vendbanimeve të tjera nga ndonjë nga popuj islailitë, siç pretendohet një kartëdhuratë të konteshës Milica, apo, siç njihet ajo me emrin Jevgenija të murgjërisë, e vitit 1397, e cila mbahet për si krisobulë e tretë e Deçanit.

Përmes kësaj kartdhurate shtesë kontesha (murgesha) Milica jo vetëm që manastirit ia kthente ndonjërën nga pronat e mëparshme që mbase i paska humbur në ndërkohë, porse ia falte atij edhe disa të tjera. Ajo e kishte nënshkruar shkresën në të cilën, ndër të tjera thuhej: " … dhe duke e shikuar këtë vend të bukur dhe të përshtatshëm për të jetuar murgjët, para sysh më doli një pamje me të vërtetë e dhembshme ku gjithë ajo përkujdesje dhe përzemërsi e themeluesit të shenjtë me lejen e Zotit, për shkak të mëkateve tona, nga popuj armiqësorë *ismailitë* ishte djegur e rrënuar dhe nga ata që kanë sunduar para nesh ishte shkatërruar e rrënuar ndërsa metohet janë rrëmbyer dhe pothuajse plotësisht janë lënë shkret. […] Së këndejmi katundet e rrëmbyera më parë, të cilat janë regjistruar në krisobulën e themeluesit të parë shekullor, i ktheva me të gjitha pronat, që gjenden në shtetin tonë. Zonja krishtdashëse Jevgenija i ktheu: kt. Çabiq me të gjithë kufijtë, kt. Brestovc me të gjithë kufijtë. Ndërsa vetë i shtoi këto: kt. Botushë me të gjithë kufijtë dhe me lagjet e tij, kt. *Ribnica* (nënvizim i imi) me të gjithë kufijtë dhe me lagjet e tij, kt. Dobrosh me të gjithë kufijtë dhe me lagjet e tij, kt. Çërnegojno (SG. Kompleksi i sotëm *Lugu i Çarragoj's* afër katundit Dobrosh) me të gjithë kufijtë, kt. Planejë me të gjitha lagjet dhe me mexhët, kt. Potok me të gjithë kufijtë, kt. Çeskovë, lagjen Put, (ndoshta të këtij katundi) me të gjithë kufijtë e saj, kt. Nepole me lagjet dhe me të gjithë kufijtë. Lagjet e katundeve të cilat i ktheu zonja Jevgenija: lagja Tromle e Rahovecit, lagja Orashac, lagja Jejbuci, lagja Bohoriqi; lagjet Brestovc, Smolicë, Popovc, Punashac; lagjet e Planejës: Dojenci, Dobrevine, Vrella, Zamornici; Serosh me të gjithë kufijtë dhe me lagjet e tij, Lluka e Poshtme me të gjithë kufijtë e tij".[62]

[61] Khs. Geschichte der Siebenbürger Sachsen, Erster Band (Text von 1852.

[62] Khs. tekstin serbisht në "Dečanska povelja kneginje Milice iz 1397. godine, në //Kosovo.com / Projekat Rastko / Projekat Rastko Gračanica - Peć //: "… i sagledavši krasno mesto i prikladno za boravak monaha, videh zaista žalostan prizor, gde je toliko staranje i usrdnost svetoga ktitora po dopuštenju Božjem zbog naših grehova od zločastivih naroda izmailićanskih spaljeno i oboreno, i od onih koji su pre nas vladali upropašćeno i porušeno i metosi oteti i skoro potpuno zapusteli [...] Zbog toga ranije oteta sela, koja su upisana u hrisovulji prvog svetskog ktitora, vratih sa svom

Ky deklarim, që përmbahet edhe në f. 139 të variantit të krisobulës së Deçanit që citohet në këtë trajtesë, nuk mund të ketë mbështetje historike sepse nuk ka asnjë burim që do ta dëshmonte ndonjë sulm apo pushtim të ismailitëve, përveç nëse këto shkretërime mund t'i kenë bërë kumanët të cilët porse i kishin sjellë vetë sundimtarët serbë e që nuk janë ismailitë.

Venerime përmbyllëse

Unë kujtoj ta kem dëshmuar mbi bazën e burimeve të shkruara se vëllazëritë që në krye të herës do të kenë qenë të etnitetit etnik *kuman* janë përhapur si element ardhës bashkë me vllehtë nga hapësirat e Bullgarisë dhe të shtetit të ashtuquajtur sot Maqedoni. Në të mirë të këtij paravendimi shkon rrethana që të dyja këto etnitete ishin kryesisht popullatë blegtorale në bashkëjetesë.

Në hapësirën e Republikës së Kosovës nuk ka sot ndonjë grup etnik që do ta mbante veten për me prejardhje kumane. Ndonjë pohim në të mirë të gjëllimit këndej të ndonjë etniteti të tillë nuk ka as në traditën gojore. Mirëpo burimet historike na mësojnë për një dyndje të kumanëve nga stepet e Ukrainës dhe vendosjen e tyre, kryesisht si të strehuar në Hungari, Rumani, Bullgari. Nga historiografia serbe mësohet që ndonjë sundimtar serb, si p.sh. Stefan Uroshi II. (1282-1321) paska sjellë disa mijëra kumanë për të populluar hapësira të mbetura zbrazët të shtetit të tij ose që ndonjë sundimtar tjetër paska sjellur kumanë si mercenarë në ushtrinë e tij.

Mirëpo nga analiza materialit të pakët onomastik i cili mund të jetë në lidhje me kumanët nuk dëshmohet për i besueshëm asnjëri nga dy sqarimet e historiografisë serbe. Në dritën e dëshmimit të antroponimit *Kuman* midis vllehve që në vitin 1220 i faleshin manastirit të Žiča-s do të krijohej bindja që kumanë, nëse vërtet do të ketë pasur, në hapësirat e perandorisë jetëshkurtër serbe paska pasur rreth 100 vite para kohës së sundimit të Stefan Uroshit II. Sqarimi sipas të cilit kumanët do të jenë sjellë nga ndonjë sundimtar serb i mëvonshëm si mercenarë zhvleftësohet nga rrethana që si antroponimi Kuman/Koman ashtu edhe toponimet që e përmbajnë këtë

imovinom, koja se nalazi u državi našoj. Ovo je vratila hristoljubiva gospođa Jevgenija: selo Čabić sa svim međama, selo Brestovac sa svim međama. A ovo priloži: selo Batušu sa svim međama i zaseocima, selo Ribnicu sa svim zaseocima i međama, selo Dobroš sa svim međama i zaseocima, selo Črnegojno sa svim međama, selo Planjani sa svim zaseocima i sa međama, selo Potok sa svima međama, selo Českovo, Put, zaselak sa svim međama, selo Dnepolje sa zaseocima i sa svim međama. A ovo su zaseoci selima koje je vratila gospođa Jevgenija: zaselak orahovički, zaselak Tromlje, zaselak Orašac, zaselak Jejbuci, zaselak Bohorići; zaselci Brestovca: Smoljice, Popovci, Plnoševc i; zaselci Planjana: Dojenci, Dobrevine, Vrelo, Zamornici; Seroš sa svim zaseocima i međama, Luka Donja sa svim međama."

antroponim janë dëshmuar, pa asnjë përjashtim, vetëm në ambiente blegtorale të vllehve, prandaj është e vështirë të besohet që këtu kemi të bëjmë me individë mercenarë. Përveç kësaj, me përjashtim të emrit të katundit të zhdukur *Kumanovo* të rrethinave të Fushë-Kosovës, në asnjë burim nuk ndeshet të jetë shënuar ndonjë "katund i kumanëve". Nga materiali onomastik i përmbajtur në burime kishtare serbe mësohet vetëm se kishte individë, banorë të katuneve vllahe, që e mbanin antroponimin *Kuman* dhe ndonjë mikrotoponim posesiv në të cilin përmbahet ai emër.

Pikërisht këto rrethana e lejojnë nxjerrjen e përfundimit që në Kosovën e sotme nuk kishte grup etnik kumanësh që do të jetë sjellë nga sundimtarë serbë, porse individë të quajtur *Kuman* në kuadrin e vëllazërive/katuneve vllahe të ardhura para shek. XIV nga vise të Bullgarisë. Në të mirë të këtij paravendimi do të shkonte mbase edhe rrethana që emra vendesh, të sajuar nga etnonimi i kumanëve, edhe dalin më shpesh në hapësirën gjuhësore-etnike bullgare. Khs. për këtë p.sh. *Kumanski*; *Kumansko ostrvo* në Vidin; *Kumana* në Nikbol dhe *Kumanitčka* në Lofča të Bullgarisë.[63]

II. Jurukët

Jo me ndonjë grup etnik të veçantë, me ndonjë minoritet që do të kenë banuar vendbanime të veçanta apo ndonjë mikroregjion më vete, porse vetëm me një apo më shumë vëllazëri pjesëtarë të një etnie joshqiptare që do të ketë ardhur dhe me kohë do të jetë asimiluar në popullatën shumicë të ndonjë regjioni të Kosovës, kemi të bëjmë tek rasti i popullatës së quajtur *juruk*/*jyryk*. Ndonjë gjurmë onomastike (sh. më poshtë) e jurukëve gjendet vetëm në krahinëzat e Gorës dhe të Opojës.

Jurukët/jyrykët janë popullatë nomade, baritore e degës turkmene me origjinë nga Azia e Vogël. Kjo popullatë, e paktë për nga numri, u soll nga ushtria osmane që në kohën e pushtimit të Ballkanit, pikërisht në fillim të shek. XV. Njëkohësisht me këta nomadë, pushteti osman solli në Ballkan edhe bujqër e zanatlinj të kësaj popullsie të hapësirës aziatike.[64] Bashkë me jurukët, pushteti osman paska sjellur në pjesën jugore të Ballkanit edhe pjesëtarë të fisit të *konjar*ëve, të quajtur mbase sipas qytetit Konja të Azisë së Vogël, gjurmë të së cilës (popullatë) nuk ka në Kosovë.

Pjesëtarë të minoritetit juruk jetojnë në Bullgari e në Maqedoni. Gjuhë amtare e kësaj bashkësie të vogël është turqishtja. Nga Jyrykët ka

[63] Këta emra i citoj sipas "Pomaci, njihova prošlost i sadašnjost", http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[64] Khs. për këtë edhe www.ihist.bas.bg/sekcii/CV/_private/Valery_Stojanow/VS_Muslime-Mind_Balkan.htm - 50k.

depërtuar në bullgarishten e në serbishten, jo porse edhe në shqipen e në rumanishten (në të cilat ekzistojnë fjalët vendëse apo të trashëguara nga një subsrat ilir-trakas i përbashkët për të dyja këto gjuhë, khs. shq. *dhallë*, rum *zară*) fjala *jogurt*.[65]

Edhe ekzistimi dikur i pjesëtarëve të etnisë juruke/jyryke dëshmohet vetëm mbi bazën e gjurmëve onomastike dhe pikërisht, siç u tha më lart, vetëm në regjionin e Gorës.

Duket se regjioni malor i hapësirës së banuar nga apo edhe nga popullata që e mban veten për gorane, pomake, torbeshe ishte bërë në shek. XIV- XV një rezervoar i tubimit në një hapësirë të elementit vllah të sllavizuar gjuhësisht në hapësira të Bullgarisë e të Maqedonisë së sotme si edhe i ndonjë elementi tjetër i ardhur këndej si bashkësi blegtorale turke. Kështu do të ketë ndodhur mbase edhe me pjesëtarë të grupit etnik të jurukëve aziatikë, çfarë sot paska ende nëpër pjesë të Maqedonisë. Po u vërtetua për i qëndrueshëm paravendimi i S. Idrizit se antroponimet *Gun*, *Guldan*, *Kurt*, *Zulfikar*, *Dazinlu* të dëshmuara në regjistrimin e banorëve të katundit Krushevë të Gorës në vitin 1579 do të jenë emra jurukësh,[66] atëherë do të rezultonte që prania e këtij elementi etnik dëshmohet për në këtë zonë së pakut kah fundi i shek. XVI. Dëshmi onomastike e pranisë së jurukëve është edhe emri *Jurukovci* / *Urukovci* i një vëllazërie të katundit Brod të krahinës së Gorës. Në këtë katund paska sipas S. Idrizit edhe dy mikrotopoime: *Juruka* e *Juručka grobišta* "Vorret e jurukëve" si edhe dëshmia sipas së cilës edhe një kryefamiljar i katundit Brod i quajtur *Ahmed Juruk* paska qenë njëri ndër blegtorë nomadë, qehaja i njohur. Një vëllazëri jurukësh po u përmendka edhe për në katundin Kukaljan[67] të regjionit të Gorës.

Prania e padiskutueshme e jurukëve kolonë në hapësirat e Gorës po u dëshmuaka edhe në folklorin goran. Kështu, në një këngë popullore gorane të shënuar nga Alija Đogović[68] përmbahen edhe vargjet:

---

[65] Më gjerësisht për shtrirjen dhe për përkatësinë etnike të jurukëve khs. Ćiro Truhelka: Über die Balkan-Juruken, Revue intrnational des études balkaniques I [Beograd], 1934 dhe Fehim Bajraktarević, O Jurucima, në Politika 6, 7, 8, 9 I, 1933, XXXX, Nr. 8858).

[66] Khs. Gora - Jedan pogled unazad (dorëshkrim)

[67] Sadik Idrizi, Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k; Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

[68] Sipas: Sadik Idrizi Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I-IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.

"Han'me mlade kad'ne,
Ne me zimajte naduša,
Juruci će me utepaje-
Juruci ni se v' planina,
Da strižet vovna jarina."

Është me interes të shënohet që emri etnik i jurukëve/jyrykëve është ruajtur edhe në dy mikrotoponime: *Lama Jyrykut* dhe *Vorras i Jyrykut* në katundin Kosavë e mbase edhe tek *Lomat e Yrykit* në katundin Pllajnik të Opojës shqipfolëse, jo porse edhe si emër vëllazërie. Kujtimi për këtë popullatë tek sllavishtfolësit e Gorës është ruajtur në mikrotopinimin *Juručko Grobište* "Vorret e Jurukëve" në katundin Zli Potok, tek mikrotoponimi *Júruka* dhe tek emri i vëllazërisë *Jurukovci* në katundin Restelicë.

Mikrotoponimet opojare dhe emri i vëllazërisë gorane e përmbajnë emrin e popullatës nomade, baritore të degës turkmene të jyrykëve me origjinë nga Azia e Vogël. Pjesë të kësaj popullate, e paktë për nga numri, u sollën nga ushtria osmane që në kohën e pushtimit të Ballkanit, pikërisht në fillim të shek. 15. Njëkohësisht me këta nomadë, pushteti solli në Ballkan edhe bujqër e zanatlinj të kësaj popullsie të hapësirës aziatike.[69] Bashkë me jurukët, pushteti osman paska sjellur në pjesën jugore të Ballkanit edhe pjesëtarë të fisit të *konjar*ëve, mbase të quajtur sipas qytetit Konja të Azisë së Vogël. Në hapësirën e Gorës nuk është dëshmuar ndonjë relikt onomastik i kësaj popullate. Mikrotoponimet e hapësirës së Opojës dhe emri i vëllazërisë gorane tregojnë tërthorazi se popullatat e sotme të këtyre dy regjioneve (Opojës dhe Gorës) pushtimi osman-turk i gjeti këtu si popullatë vendëse. Këtë realitet historik do ta tregonte edhe fakti se sot në asnjërën nga këto dy krahinëza nuk ka individë apo vëllazëri që e deklarojnë veten për jurukë, përkatësisht jyrykë. Asimilimi i tyre në goranë e ndoshta edhe në shqiptarë e dëshmon lashtësinë e këtyre dy popullatave: shqiptare (në Opojë) dhe të asaj bullgarishtfolëse, gorane (në Gorë).

[69] Khs. për këtë edhe www.ihist.bas.bg/sekcii/CV/_private/Valery_Stojanow/VS_Muslime-Mind_Balkan.htm - 50k.

TË DHËNA PËR ÇERKEZËT NË ATDHEUN E TYRE TË KRYEHERSHËM DHE NË KOSOVË*

TË DHËNA PËR ÇERKEZËT DHE GJUHËN E KULTURËN E TYRE

Nuk ka asnjë vend në botë në të cilin fliten aq shumë gjuhë e në të cilin jetojnë njëri pranë tjetrit aq shumë popuj si në Kukaz. Këtu jetojnë rreth 40 popuj të ndryshëm dhe fliten rreth 60 gjuhë të ndryshme. Në rrjedhë të historisë, një dyzinë popullatash, në kuadër të shtegtimeve të tyre, mbetën të kurthuruar në bjeshkët midis Detit të Zi e Detit Kaspik. Luginat malore gjeografikisht të mbyllura e penguan përzierjen e kulturave të njerëzve që zunë vend në to, kështu që në ambiente të ngushta u krijua një shumësi babilonike e gjuhëve. Shumë gjuhë janë ruajtur vetëm në disa katunde malore dhe u kanoset rreziku akut i zhdukjes së tyre. Këto gjuhë janë në rrafshin linguistik me shumë rëndësi, sepse janë gjuhë që nuk i takojnë familjes indoeuropiane të gjuhëve.

Nocioni çerkez është një shenjim përmbledhës që emërton fise bjeshkatare fort të afërta si në rrafshin kulturor ashtu edhe në atë gjuhësor të pjesës veriore të Kukazit. Nën këtë nocion përmblidhen fiset: Abzeh, Besleney, Bjedugh, Cemguy, Hakkucu, Hatikhuay, Khabardey, Maxhuesch, Mamkeyh, Natixhuay, Schapsigh dhe Yecerikhuay.

Përgjatë historisë çerkezët kanë qenë njohur me emra të ndryshëm si: *Cercetae, Siraces, Kassogen, Keschaks* ose *Kerket.* Prej këndej, përkatësisht nga varianti "Circassian", po i heqka rrënjët nocioni europian "Çerkez", pas gjithë gjasash me ndërmjetësimin e turqishtes.

Në atdheun e tyre kaukazik çerkezët e quajnë veten Adyge, Adighe “fisnik”, ndërsa më herët Zerkassi. Çerkezët qenkan banorët më të lashtë të dëshmuar të Kaukazit dhe ishin populli më i madh për nga numri dhe më i rëndësishmi në pjesën veriore të Kaukazit. Pandehet se ka dy gjuhë çerkeze: çerkezishtja perëndimore ose adygeishtja dhe çerkezishtja lindore

* Të gjitha të dhënat përkitazi me historikun e Çerkezëve në atdheun e tyre (në Kukaz) i huazova nga http://de.wikipedia.org/wiki/Tscherkessen, ndërsa të dhënat për praninë dhe fatin e popullatës çerkeze në Kosovë i huazova nga libri *Çerkezët në Kosovë*, Prishtinë, 2014 të autorit Prof. Dr. Jusuf Osmani.

ose kabardinishtja. Disa herë këto gjuhë mbahen për të folme të një gjuhe të përbashkët çerkeze nga e cila gjatë shek. XIII-XIV qenka ndarë kabardinishtja. Çerkezët vetë nuk e përfillin këtë ndarje. Çerkezët nuk kanë alfabet të vetin. Me t'u islamizuar, gjuha e tyre shkruhej me alfabet arab.

Në të nisur të shek. XX, çerkezët e përdornin alfabetin latin, ndërsa që nga vitet 1937/38 përdoret alfabeti cirilik me disa shkronja plotësuese. As deri në ditë tonat nuk ka ndonjë alfabet unik për të gjithë çerkezët. Përdoren kryesisht dy alfabete të ndryshme: ai i çerkezishtes perëndimore i ngritur mbi bazën e dialektit të temirgoishtes dhe alfabeti i çerkezishtes lindore për dialektin kabardinisht të çerkezishtes.

Çerkezët janë banorët në të lashtë të Kaukazit dhe ishin dikur populli më i rëndësishëm i kësaj hapësire.

Grupit të popujve çerkezë i takojnë edhe abhazët e ybykët; këta janë për nga kultura pothuajse të ngjashëm me çerkezët por kanë, megjithatë një të kaluar pjesërisht të mëvetshme historike. Të gjithë këta i takojnë familjes gjuhësore adyge-abhaze e cila i takon degës veriperëndimore të familjes gjuhësore të kaukazishtes, në të cilën bien edhe çeçenishtja, lesgishtja dhe georgishtja.

Hapësira që në krye të herës e banonin çerkezët arrinte deri në brigjet e Detit Azov dhe përfshinte stepet e Rusisë së sotme të jugut. Për shkak të luftërave dhe dyndjeve të popujve, çerkezët u shtynë vazhdimisht drejt jugut. Në shek. XVIII kufi i tyre verior ishte lumi Kuban. Çerkezët shtriheshin asokohe përgjatë brigjeve lindore të Detit të Zi, përgjatë rrjedhës së mesme e të poshtme të lumit Kuban, përgjatë bregut perëndimor të lumit Terek dhe pjesës më të madhe të Kabardisë deri tek qyteti i sotëm Mosdok në Osetinë e Veriut. Në shek. XIX, pas mbarimit të luftërave ruso-kaukazike, rreth 750.000 banorë të Kukazit të Veriut u dëbuan me dhunë dhe u vendosën në hapësirat e asokohshme të Perandorisë Osmane. Vendbanimet e hapësirave të çerkezëve u populluan nga rusë të sjellë nga brendia e Perandorisë Ruse.

Shumica e çerkezëve jetojnë sot jashtë Kaukazit: në Turqi rreth 1 milion e gjysmë, në Siri 80.000, në Jordani 40.000, në BE 10.000, në Izrael 3000 dhe rreth 1000 në SHBA. Fise çerkezësh ka edhe në Kosovë (në qytezën e Obiliqit) dhe në Jug të Serbisë (për këtë khs. pjesën II të kësaj trajtese).

Në Kaukaz ka mbetur vetëm një minoritet çerkezësh që jetojnë në tri republika të ndryshme autonome. Në Adygeja me kryeqytetin Maikop, nga 450.000, përkatësisht 480.000 banorë të dikurshëm kanë mbetur vetëm rreth 130.000, përkatësisht 95.000 çerkezë; Në republikën Karaçai-Çerkezia me kryeqytetin Çerkesk nga rreth 422.000, përkatësisht

431.000 banorë kanë mbetur vetëm 50.000 çerkezë; Në Republikën autonome të Kabardino-Balkarisë me kryeqytetin Nalçik nga 780.000 përkatësisht 800.000 banorë kanë mbetur rreth 390.000 përkatësisht 364.000 çerkezë dhe 10.000 çerkezë të tjerë jetojnë në rrethina të qytetit Tuapse në brigje të Detit të Zi. Me përjashtim të Kabardino-Balkarisë, çerkezët janë minoritete në atdheun e tyre.

Përveç regjionit autonom të Adygeja-s, republikat autonome të çerkezëve binin që nga viti 1921 nën juridiksionin e Republikës Autonome Sovjetike Socialiste Malore (RSFSR) që, natyrisht, nuk është në përputhje me hapësirën e banuar nga çerkezët.

Emërtimet e ndryshme të republikave përkatëse provokojnë shpesh mendimin se adygejët, çerkezët e kabardinët na qenkan tre popuj të ndryshëm. Në esencë, që të tri nocionet shenjojnë një të vetmin popull. Nocioni përmbledhës"“Çerkezë" përdoret shpesh në Europë.

Religioni

Sado që çerkezët që në shek. 5 e kishin përqafuar krishterimin, ata nuk u ndikuan fort nga ai. Çerkezët vazhduan të nderojnë zotër të natyrës. Si të gjithë popujt natyrorë, edhe çerkezët kultivonin sjellje me plot respekt kundrejt natyrës. Në kohë të shkuara asnjë lis nuk bënte të prehej pa vendimin e Këshillit të Pleqve. Secila familje apo vëllazëri e kishte lisin e vet të caktuar dhe special, nën hijen e të cilit takohej para tubimeve ose vendimeve të rëndësishme. Çerkezët besonin në zotin e bubullimës (Shible), zotin e zjarrit (Tlepsh), zotin e ujit (Soserez), zotin e malit (Mezisha) etj.

Nën ndikimin e tatarëve të Krimesë, çerkezët kabardinë u konvertuan në myslimanë në shek. XV. Që nga kjo kohë çerkezët kabardinë e përhapën besimin islam edhe tek fise të çerkezëve dhe tek popuj fqinjë. Përveç një numri krejt minor të çerkezëve kabardinë, në rrethina të qytetit Mozdok, të cilët janë të krishterë të ritit ortodoks, shumica dërmuese e çerkezëve janë myslimanë sunitë.

Si çerkezët në Kaukaz, ashtu edhe ata në diasporë pothuajse gjithmonë janë konsideruar për myslimanë liberalë e modernë të cilët ndeshen shpesh të tubuar rreth partive, organaizatave e shoqatave demokratike. Jo vetëm në Turqi, porse edhe në Jordani ose në Siri, çerkezët janë forca cytëse që ia mbajnë krahun demokratizimit e liberalizimit. Çerkezët e mbetur sot në Kaukaz, sado që janë myslimanë, nuk e praktikojnë besimin e tyre dhe nuk kanë njohuri të funguara për besimin e tyre.

Kultura

Duke qenë se çerkezët arritën shumë vonë ta kenë një historiografi të veten, historia e tyre në përgjithësi e në këtë kuadër edhe historia kulturore e tyre duhet të rindërtohet mbi bazën e njoftimeve me karakter historik të sajuara nga fqinjë të tyre dhe të plotësohet mbi bazën e folklorit të pasur të vetë çerkezëve. Sipas këtyre të dhënave, çerkezët janë njëra ndër popullatat më të moçme që e banonin Kaukazin. Diku rreth 4.000 vjet para Krishtit, çerkezët e kultivuan kulturën Myekuape (Maikop), e cila bie ndër kulturat më të vjetra të botës. Çerkezët ushtruan ndikimin e tyre në zhvillimin kulturor të Kaukazit të Veriut dhe të pjesëve të Rusisë së jugut. Ata (Çerkezët) zhvilluan që herët forma demokratike: Parimi i monarkisë, në formën në të cilën më parë mbisundonte në pjesën më të madhe të popujve të Kaukazit, mbeti për çerkezët qëkur mbahet mend formacion i huaj për dhe i urryer nga ata. Çerkezët e zhvilluan një sistem vetanak të feudalizmit, i cili mbështetej mbi idenë/parimin e ndërsjellshmërisë e cila do të jetë bartëse dhe ruajtëse e drejtësisë dhe e rregullit midis njerëzve.

Kodi që sublimon traditat dhe mënyrën e jetesës së çerkezëve është *Adyge Chabze*“, që në krye të herës ishte kod i kaberdinëve, i vlefshëm porse për të gjithë popujt çerkezë, të cilin madje deri në shek. 20 e kishin për model edhe popuj fqinjë të Kaukazit. Ky është *Kodi i nderës*, që ngërthen ligje të pashkruara të çerkezëve që e rregullonin jetën sociale dhe ishte kulturë, traditë dhe madje ligj për çerkezët. Ky kod e ka për bazë nderimin dhe respektin e ndërsjelltë dhe i cili nga të gjithë kërkon para se gjithash përgjegjësi, disiplinë dhe vetpërmbajtje. Këto janë ligje të çerkezëve të cilat, ç'është e drejta, nuk janë shkruar ndonjëherë, por që në kohë të shkuara, megjithatë, e rregullonin/kodifikonin jetën e tyre të përditshme. Sipas këtij kodi, për si veçori/virtyte kryesore e më të domosdoshmet e një kalorësi sanksionoheshin trimëria, guximi, zemërgjerësia dhe njerzishmëria, ndërsa lakmia, instinkti për të bërë prona, pasuria dhe krekosja cilësoheshin për turp ("Haynape").

"Adyge Chabze" e lashtë më shumë se njëmijë vite e çerkezëve, shpirti luftarak, kalorsiak i tyre, u përqafua që nga oborrtarë të Krimesë dhe nga mbretër të Gjeorgjisë për si ideal i fisnikërisë. Këta të fundit i dërgonin fëmijët e tyre si nxënës tek edukatorë çerkezë në mënyrë që atje ta mësojnë idealin e fisnikërisë.

Fëmijët e çerkezëve nuk rriteshin në shtëpinë e prindërve, porse ata u besoheshin për edukim të huajve në mënyrë që t'i ruanin nga lazdrimi. Me rastin e përzgjedhjes së edukuesit nuk merrej parasysh pasuria e tij, porse preferoheshin prioritetet shpirtërore/morale: trimëria dhe oratoria.

Edukatori i mësonte konviktorët/nxënësit e tij që nga rinia e hershme e tyre të shpreheshin shkurt, shpejt e qëllueshëm, në mënyrë që këta t'i aftësonte që në ardhmen të zinin vend dhe ta kishin të drejtën e fjalës në këshillin e burrave të armatosur të fiseve të tyre. Pas edukimit, fëmija u kthehej prindërve të tij në mënyrë ceremoniale. Fëmija mbante gjatë gjithë jetës raporte të mira me edukatorin e tij.

Në retrospektivën historike, historia e çerkezëve dhe e Kaukazit mund të cilësohet si një vargua i tentativave të pasuksesshme të Fuqive të Mëdha, që këtë territor e këta popuj luftarakë t'ua bashkëngjesin perandorive të tyre. Pa marrë parasysh nëse ata ishin grekë, romakë, osmanë apo më vonë rusë, të gjitha këto Fuqi bënë luftëra të përgjakshme në këtë regjion, të cilin e plaçkitën e edhe e pushtuan, porse kurrënjëherë nuk mundën që në kuptimin e plotë të fjalës ta sundojnë.

Për çerkezët, të gjitha luftërat ishin të imponuara dhe ishin pothuaj gjithherë luftëra për t'u mbrojtur.

Mikpritja

Çerkezët ishin popull natyror, prandaj shkencat e artet u lanë pas dore. Dy veoritë kryesore të çerkezëve: dëshira për të qenë të lirë dhe mikpritja. Krenaria e çerkezit është pandashme nga shpata për ta mbrojtur lirinë e vet dhe që atë t'ua lënë fëmijëve si trashëgim të dlirë.

Mikpritja kultivohet tek çerkezët si një detyrë e shenjtë. Mysafiri, qoftë ai i kamur apo skamnor, i klasës më të lartë apo më të ulët është gjithandej i mirëseardhur. Të gjithë ngrihen në këmbë, e ulin në krye të vendit; madje vetë i zoti i shtëpisë ulet vetëm pasi ta urdhërojë mysafiri. I ardhuri nuk është mysafir vetëm i familjes, porse i gjithë vendbanimit dhe i gjithë farefisit. I zoti i shtëpisë e garanton me jetë të veten sigurinë e mysafirit. Edhe sikur të ndodhë që mysafiri të jetë i armiqësuar me të zotin e shtëpisë, ai do të pritet e trajtohet me respekt dhe nuk do t'i ndodhë gjë e keqe as sa e asaj e flokut të kresë, derisa të jetë mysafir i të zotit të shtëpisë.

Vend të veçantë në shoqërinë çerkeze ka gruaja. Ndalohen grindjet në prani të gruas. Nëse ndodh që gjatë një grindjeje ia beh një grua, grindja apo përleshja përfundon menjëherë. Me dëshirën e kërkesën e gruas mund të pajtohen palët në grindje. Tek çerkezët fenomeni i poligamisë është pothuajse plotësisht i panjohur.

Fundi tragjik i çerkezëve

Kaukazi u gjend në konkurrencën midis turqve e rusëve. Tentimet e shumta të rusëve për ta pushtuar Kaukazin dështuan. Me këtë rast nuk ishte i mjaftueshëm vetëm pushtimi, problem ishte se si kjo zonë do të mbahej përgjithmonë nën kontroll. Në shek. XIX rusët e nisën një luftë koloniale, me pretendime për ta pushtuar hapësirën e Kabardei-së. Një arsye apo shkas u gjet tek rrethana që në shek. XVI e bija e princit Temrjuk paska qenë grua e carit rus. Rusia, sipas motos përçaj e sundo, e përdori mjetin më efikas për asgjësimin e popujve. Ata mbollën përçarje midis çerkezëve Kabardinë dhe gjithë popujve të tjerë Zwietracht. Përçarja dhe mospajtimet e brendshme e të jashtme të çerkezëve e lehtësuan ekspansionin e Rusisë në vitin 1825.

Rusët zhvilluan një luftë shumë brutale duke ndjekur taktikën e *tokës së djegur* që do të thotë se u bënë rrafsh me tokë çdo katund e çdo shtëpi. Nuk pati mëshirë ndaj askujt. Fillimisht rusët deshën që Kaukazin ta pushtojnë brenda 3 vitesh, por ky pushtim zgjati disa shekuj, sepse hasën në qëndresë të fortë të popujve të pjesës veriore të Kaukazit.

Ndër të gjithë popujt e Kaukazit, e cila në vitin 1864 i dorëzoi armët ishte pikërisht populli i çerkezëve. Në këto luftëra, Rusia humbi rreth 200.000 njerëz. Para këtyre luftërave kishte rreth 3 milionë çerkezë. Rusia e shkroi kapitullin më të zi të çerkezëve. Rusia e nisi dëbimin e çerkezëve nga atdheu i tyre me tokë pjellore e të pasur me xehe. Shumë çerkezë që nuk deshën të largoheshin nga vendi u mbytën nga rusët. Flitet për gjysmë apo madje një milion çerkezë të mbytur. Rusia i populloi tokat e çerkezëve me popullatë ruse të sjellë nga brendia e Rusisë. Sado që shpërngulja me dhunë e çerkezëve u zhvillua në shumë periudha, për si ditë zyrtare e zisë çerkezët e mbajnë ditën 21 maj të vitit 1864.

Fati i çerkezëve është i ngjashëm me tragjedinë e hebrenjve e me atë të indianëve. Megjithatë, fatit tragjik të çerkezëve i kushtohet pak vëmendje, sepse çerkezët vetë nuk ditën që situatën e tyre t'ia sqarojnë opinionit të gjerë botëror.

II. Çerkezët në Kosovë

Bashkë me çerkezë, në Kosovë erdhën edhe abhazë që jetonin përbrenda hapësirës së çerkezëve. Pjesa dërmuese e çerkezëve kosovarë u përkasin fiseve çerkeze *Abadzeha* dhe *Shapsuga*, porse ka pasur (p.sh. në Ferizaj e rrethinë të tij) edhe sish të fisit *Abuha* dhe sish të fisit *Aphaz*, në Stanovc të Poshtëm.

Po u gjykua në bazë të të dhënave që përmbahen në libra, kryesisht me karakter udhëpërshkrimi, në Kosovë kishte në shek. XIX dhe në fillim të shek. XX larg më shumë vendbanime çerkezësh. Kështu, në librin "Deteilbeschreibung des Sandzaks Pljevle und des Vilajets Kosova" të botuar në Vjenë në vitin 1899 thuhet p.sh. se një vendbanim i çerkezëve *Tscherkesen- Dorf* (turq. Çerkes köy), midis Prishtinës e Vushtrrisë - jo larg nga lumi i Llapit paska pasur 200 shtëpi; se në katundin çerkez Azizije (sot Milloshevë), paska pasur 500 kasolle; se në rrugën Prishtinë - Pejë, midis Bresjes e Dobrevës, paska pasur një katund të vogël çerkezësh dhe në Sllatinë, që kishte 100 shtëpi, kishte pasur edhe disa shtëpi çerkezësh.

Shkrimtari serb Branislav Nushiq thoshte në librin e tij të botuar në vitin 1902, se midis viteve 1858 e 1862 nga Krimea paskan ardhur në Kosovë 6.000 familje çerkeze.

Çerkezë kishte pasur edhe në vendbanime të Kosovës, në të cilat sot nuk ka të tillë. Kështu, vendbanimi i sotëm Hajvali në rrethina të Prishtinës, qenka formuar në vitin 1864 nga çerkezët, të cilët porse u shpërngulën nga këtu për në brendi të Turqisë pas luftërave të viteve 1877/78. Kujtimi për ekzistimin e çerkezëve në këtë vendbanim qenka ruajtur tek mikrotoponimi *Fusha e Çerkez've* i këtij vendbanimi. Çerkezë të ardhur në vitit 1864 paska pasur edhe në katundin Bellaçevc i Madh, të cilët qenkan shpërngulur po ashtu për në Turqi; Kështu paska ndodhur edhe me koloninë çerkeze të themeluar po në vitin 1864 në katundin e sotëm Miradi e Epërme, një pjesë e banorëve të së cilës pas pushtimit serb të sanxhakut të Nishit u shpërngul për në Turqi, ndërsa pjesa tjetër në vendbanime më në jug; Edhe në hapësirat e Fushë-Kosovës së sotme, kur kjo ishte e pabanuar, ishin vendosur në vitin 1864 disa familje çerkeze, të cilat u larguan nga ky vend pas dy vitesh, për shkak të një dergje që ishte përhapur andejpari. Një koloni çerkezësh e ngritur po në vitin 1864 paska qenë edhe në katundin e sotëm Pomozetin në perëndim të Fushkosovës. Edhe çerkezët e këtushëm qenkan larguar për në Turqi në vitin 1878. Kujtimi për këta çerkezë qenka ruajtur në mikrotoponimin Vorreth e *Çerkez've* të këtij katundi; disa familje çerkeze të ardhura në vitin 1864 paska pasur edhe në katundin Sllatinë e Madhe. Një pjesë e çerkezëve të këtushëm qenkan shpërngulur për në Turqi në vitin 1878, pjesa tjetër ndërmjet viteve 1913, 1924, ndërsa disa të tjera u shpërngulën edhe në Sarajevë e në Shkup. Kujtimi për ekzistimin e çerkezëve në këtë lokalitet është ruajtur te mikrotoponimi *Ara e Çerkezit*.

Për rikthimin e ndonjë, përkatësisht disa familjeve çerkeze në atdheun e tyre të kryehershëm prej nga kishin ardhur në vitin 1864, ka ndonjë

shënim sipas të cilëve gjatë viteve 1998-1999 qenkan shpërngulur 23 familje çerkeze me rreth 117 anëtarë. Në Kirkizi (Çerkezi) u rikthyen 18 familje (Hasani, Cej dhe Abaj) me 99 banorë nga Stanovci i Poshtëm; 3 familje (Abazi e Bahtiri) me 16 banorë nga Millosheva (Azizija); 1 anëtar i familjes Kafkazi nga Ribari i Vogël dhe 3 persona nga Prishtina; Për çerkezët e katundit të sotëm Milloshevë (Azizije) thuhet se në vitin 1864 ishte populluar nga 300 familje çerkeze. Këto familje ishin të ndara në dy lagje: Mahalla e Abdzahut (sipas fisit Abaddzeha të çerkezëve) dhe Mahalla e Shapsit (sipas fisit Shapsuga të çerkezëve). Shumë nga çerkezët e këtushëm u kthyen në Turqi në vitet 1878 dhe 1913/14; në lokalitetin Hamidije, në veriperëndim të Obiliqit, çerkezët e ardhur nga regjioni i Toplicës e ngritën në vitin 1878 një koloni të tyre e cila kishte pasur 25, përkatësisht rreth 40 shtëpi/familje çerkezësh. Familjet çerkeze u shpërngulën nga këtu në vitin 1913 e më vonë. Kujtimi për çerkezët e këtushëm është ruajtur tek mikrotoponimet *Vorret e Çerkezv'e*; *Fushat e Çerkezv'e*, *Arat e Çerkezv'e*, *Prroni i Hrum Çerkezit*, *Arat e Mehmet Çerkezit*, *Shpija e Haxhi Çerkezit* etj.; disa familje çerkeze (po ashtu të ardhura në vitin (1864) paska pasur në katundin Dumosh të komunës së Podujevës, të cilat qenkan shpërngulur për në Turqi para vendosjes së muhaxhirëve (1877/1878) në këtë katund. Këta të fundit paskan gjetur në katund vetëm dy familje çerkeze, të cilat në vitin 1956 u shpërngulën në Obiliq. Edhe në këtë katund, kujtimi për banorët çerkezë është ruajtur tek mikrotoponimi *Arat e Çerkezv'e*; në vitin 1864 disa familje çerkeze ishin vendosur midis katundeve Sibovc i Epërm dhe Sibovc i Poshtëm. Pas ardhjes së shqiptarëve të shpërngulur nga viset e tyre në sanxhakun e Nishit, pjesa më e madhe edhe e çerkezëve të këtushëm u shpërngul, kësaj radhe në Arabi (ndoshta në Siri), ndërsa të tjerat, 3-4 sosh, në katundin çerkez Stanovc i Poshtëm. Në katundin e sotëm Velikorekë (Lumbardh) në vitin 1864 ishin vendosur 5 vëllazëri çerkezësh të barqeve *Naq* e *Zhjau* të fisit çerkez të Abadzehëve me rreth 50 familje. Të gjitha këto familje ndërruan truall rreth vitit 1871 dhe u vendosën në katundin Stanovc i Poshtëm. Edhe në këtë katund, kujtimi për banorët çerkezë është ruajtur tek mikrotoponimi *Arat e Çerkezv'e*; Sipas traditës gojore, në vitin 1864 në katundin e sotëm Stanovc i Poshtëm, kur ky paska qenë i pabanuar, paskan ardhur rreth 90 familje çerkezësh. Në vitin 1912 ishin 100 sosh. Të gjithë këta paskan qenë barqe të fisit çerkez Abadyeha. Edhe nga ky vendbanim, dhjetra familje çerkeze u kthyen në Turqi në vitet 1878, në vitet 1913/1814 edhe 50 sosh të tjera, ndërsa numër i madh sish (kryesisht të familjeve Abaj e Naq) u shpërngul edhe gjatë viteve 1956/57. Në vitet e 70-ta të shek. 20 në këtë katund jetonin ende 21 familje çerkeze me 121 anëtarë; Çerkezë të ardhur në vitin 1864 paska

pasur edhe në katundin Suhadoll i Muhaxherëve/Çerkezëve të komunës së Mitrovicës. Ata qenkan vendosur në pjesën afër kalasë së Vogël (të quajtur edhe *Çerkez*) të këtij katundi. Në vitin 1900, një pjesë e këtij katundi qenka evidentuar me emrin *Suhadoll-çerkez*. Në vitin 1910 këtu kishte 10 familje çerkeze. Çerkezë të ardhur në vitin 1864 e të shpërngulur më vonë paska pasur edhe në lokalitetin Shipol të Mitrovicës. Kujtimi për banorët çerkezë të këtij lokaliteti është ruajtur tek mikrotoponimi *Bunari i Çerkezv'e*; në vetë qytetin e Mitrovicës, çerkezë të ardhur këtu u kthyen në atdheun e tyre të kryehershëm ose emigruan në Perëndim të Europës. Sot në Mitrovicë ka 77 familje çerkeze që mbajnë mbiemrat Çerkezi, Apuk, Musiq e Hasani dhe antroponimin çerkez *Eldar*; disa familje çerkeze, të shpërngulura në Turqi pas Luftës së Parë Ballkanike, paska pasur edhe në Zveçan. Kujtimi për këta çerkezë qenka ruajtur tek mikrotoponimi *Vorret e Çerkezv'e*; familje çerkeze të ardhura në vitet 1864 e 1878 paska pasur edhe në katundin Magurë. Këta çerkezë u shpërngulën për në Turqi në vitet 1913/1914; rreth 25 familje çerkeze ishin vendosur në vitin 1864 edhe në katundin Babush i Muhaxhirëve, i quajtur edhe *Babush i Çerkezëve* të komunës së Lipjanit. Familjet çerkeze të këtij lokaliteti nisën të shpërngulen për në Turqi në vitin 1878; nga 32 familje çerkeze të vendosura në vitin 1864 në katundin Ribar i Vogël të komunës së Lipjanit, 28 sosh u rikthyen pas viteve 1877/1878 e 1912/1913 në Turqi e në Siri, ndërsa në vitet e 60-të shek. 20 në këtë lokalitet mbetën të jetonin 4 familje me 27 anëtarë, që e mbanin mbiemrin Kafkazi (e fisit çerkez *Tuzh* "ujk"), disa nga të cilat u shpërngulën në Gjermani, në Stamboll e ndonjë u kthye në Çerkezi. Kujtimi për gjëllimin e çerkezëve në këtë lokalitet është ruajtur tek mikrotoponimet *Vorret e Çerkezv'e* dhe *Arat e Çerkezv'e*; Pushteti osman kishte vendosur në vitin 1864 disa familje çerkeze edhe në katundin Dobrajë e Vogël të komunës së Lipjanit. Popullata shqiptare përreth e njohu për një kohë këtë vendbanim edhe me emrin *Dobraja e Çerkezëve*. Familje çerkeze të këtij lokaliteti ndërruan truall pas vitit 1878 dhe u vendosën në katundin fqinj të Mgurës, ndërsa pas vitit 1913, 15 familje çerkezësh u rikthyen në Turqi; thuhet se në katundin Vrellë e Goleshit të komunës së Lipjanit në vitin 1864 ishin vendosur 50 familje çerkezësh, të cilat porse në vitin 1878 qenkan rikthyer në brendi të Turqisë; familje çerkeze të ardhura në vitin 1864 e të rikthyera në Turqi pas vitit 1878 paska pasur edhe në katundin Rufc i Vjetër të komunës së Lipjanit; reth 45 familje çerkezësh të ardhura në vitin 1864 nga Çerkezia ishin vendosur në katundin Livoç i Poshtëm të komunës së Gjilanit. Të gjitha familjet e ardhura çerkeze u rikthyen në Turqi gjatë viteve 1877/1878. Kujtimi për gjëllimin e çerkezëve në këtë lokalitet është

ruajtur tek emri i kompleksit me ara të quajtura *Çerkezkat*. Thuhet se në katundin Sllakovc i Epërem, i quajtur edhe edhe *Sllakovci i Çerkezëve*, të komunës së Gjilanit kishte pasur rreth 100 familje çerkeze. Edhe çerkezët e këtushëm u rikthyen në Turqi në vitet 1878 e 1913. Kujtimi për gjëllimin e çerkezëve në këtë lokalitet është ruajtur tek mikrotoponimet *Vorret e Çerkezv'e* dhe *Arat e Çerkezv'e*; rreth 50-60 familje çerkeze të ardhura në vitin 1864 dhe të rikthyera në Turqi në vitin 1878 paska pasur edhe në katundin Dobresh të komunës së Vitisë; një lagje më vete çerkezësh paska pasur edhe në hapësirat e katundit të sotëm Pozharan të komunës së Vitisë, banorët e së cilës qenkan rikthyer në Turqi në vitin 1878. Kujtimi për praninë e çerkezëve në këtë lokalitet qenka ruajtufr në mikrotoponimet *Vorret e Çerkezv'e*, *Arat e Çerkezv'e* dhe *Shpijat e Çerkezv'e*; rreth 65 familje çerkeze ishin vendosur në vitin 1864 në katundin që edhe sot quhet *Sadovina e Çerkezëve* të komunës së Vitisë. Në katund ekziston edhe sot mikrohidronimi *Bunari i Çerkezv'e*; nuk dihet me siguri nëse dhe sa çerkezë mund të ketë pasur në lokalitetin Katuni i Ri, 10 km në veriperëndim të Vitisë. Pandehja se edhe këtu m,und të ketë pasur çerkezë mbështetet tek emri *Te Çerkez't* - siç quhet një mriz në këtë vendbanim; i banuar nga 20 familje çerkezësh të ardhur në vitin 1864 dhe të shpërngulur në vitin 1877/1878 pjesërisht në Ferizaj e pjesërisht në Turqi ishte edhe katundi *Talinovci i Çerkezv'e*, i quajtur sot Talinovci i Muhaxher've i komunës së Ferizajt; 20 familje çerkeze ishin vendosur në vitin 1864 edhe në katundin Sazli të rrethinave të Ferizajt, të cilat u rikthyen në Turqi në vitin 1878. Kujtimi për çerkezët në këtë lokalitet është ruajtur tek mikrotoponimi *Vorret e Çerkezv'e*; vendbanim i çerkezëve ishte edhe *Prelezi i Çerkezëve* (i quajtur sot Prelez i Muhaxher'*ve*), banorët e të cilit kishin nisur të shpërnguleshin që nga vitet 1877/1878; në vitin 1864 familje çerkeze, 12 sosh, ishin vendosur edhe në katundin Softaj të Ferizajt. Disa nga familje të këtushme çerkeze u shpërngulën në vitin 1878 për në Kumanovë, ndërsa pas vitit 1913 edhe për në Siri. Deri në vitin 1910, 1912 edhe në vetë Ferizajn kishte 25, përkatësisht 5 familje çerkezësh, të ardhura nga Nishi, por të shpërngulura në Turqi pas Luftës së Dytë Botërore. Kujtimi për banorët çerkezë të këtij qyteti qenka ruajtur tek emri *Mahalla e Çerkezv'e* të një pjese të këtij qyteti; para se të shpërnguleshin në vitin 1878, 35 shtëpi çerkezësh kishte pasur edhe në katundin Godanci i *Çerkezv'e* (i quajtur sot Godanci i Poshtëm) i komunës së Shtimes; dëshmi bindësse se çerkezë kishte edhe në qytetin e Gjakovës është mikrotoponimi *Kodra e Çerkezit* në katundin Vraniq të rrethinave të këtij qyteti.

Sipas shënimeve që i sjell autori J. Osmani, në Kosovë ka sot vetëm edhe 67 familje çerkeze, të shpërndara më 10 vendbanime dhe pikërisht: në katundin Stanovc 6 familje; në Milloshevë (Azizije) 11 familje; në Velikorekë (Lumbardh) 1 familje; në Gjilan 5 familje; në Mitrovicë 7 familje; në Prishtinë 6 familje, ndërsa udhëpërshkruesit njoftojnë se në vitin 1888 këtu paska pasur 40 shtëpi çerkezësh me 200 banorë; në Ribar i Vogël 1 familje; në Lipjan 1 familje; në Obiliq 20 familje dhe në Gjakovë 10 familje.

Mbi bazën e monografisë së prof. dr. Jusuf Osmanit rezulton se në hapësirat e sotme të Kosovës në vitin 1864 nga Perandoria Osmane ishin themeluar larg më shumë koloni/katunde çerkezësh se ç'ka sot në Kosovë. Çerkezët ishin vendosur kryesisht në vise rrafshinore dhe buzë lumenjve Llap e Sitnicë të Kosovës. Me përjashtim të çerkezëve në vendbanimet e sotme kosovare, të përmendura më lart, pothuaj se pjesa dërmuese e ardhacakëve çerkezë nuk jetoi në Kosovë më shumë se 20 vite, sepse shumica syresh (për shkak të frikës nga persekutimet që do të shkaktoheshin si pasojë e pushtimit serb të sanxhakut të Nishit) u rikthyen në territore të Perandorisë Osmane, përkatësisht në Turqi e në Siri, ose zunë vend në shtete të Ballkanit e në ndonjë sish të Perëndimit të Europës. Përveç kësaj, pati edhe lëvizje të çerkezëve përbrenda hapësirës së Kosovës, duke kaluar nga një katund në ndonjë tjetër ku kishte më shumë çerkezë. Dëshmitë më të besueshme për jetesën e çerkezëve edhe në katunde të Kosovës, në të cilat sot nuk ka të tillë, janë mikrotoponimet pjesë e dytë/determinuese e të cilave është emri etnik i çerkezëve. Pothuajse të gjitha vendbanimet/kolonitë e çerkezëve në Kosovë u emërtuan me emra sulltanësh turq apo thjesht me emra orientalë, të cilët porse nuk patën jetë të gjatë. Është për t'u vënë në spikamë rrethana që vendosja dhe largimi i çerkezëve në e nga Kosova është i lidhur ngushtë me dyndjen/vendosjen në Kosovë të shqiptarëve të dëbuar pas vitit 1876 nga atdheu i tyre i kryehershëm, Sanxhaku i Nishit të cilët, në shumë raste, u vendosën në vendbanime nga të cilat ishin larguar çerkezët.

Për t'u mbajtur mend është edhe rrethana që çerkezët, në çdo vendbanim ku ndejtën më gjatë ngritën xhami kryesisht të ndërtuara me material të dobët, përkatësisht nga druri e balta.

Përkatësia edhe etnike çerkeze dhe e çerkezëve të Kosovës dëshmohet edhe në dritën e rrethanës që këta kishin ruajtur dhe ruajnë edhe sot mbiemra çerkezë familjarë, të barqeve e të fiseve si p.sh. *Abaj*, *Alkas*, *Apuk*, *Cej*, *Eda*/*Edar*, *Kfkasi*, *Metin*, *Namuk*, *Nart*, *Nefën*, *Pshiz*, *Shevemah*, *Xhonsuhan* e ndonjë tjetër.

Çerkezët, që edhe sot jetojnë në Kosovë, nuk e njohin më gjuhën e tyre amtare. Kryesisht për shkak të martesave të përziera me shqiptarë, çerkezët e kishin mbase kohë më parë e edhe sot e kanë për gjuhë "amtare" shqipen, por ka edhe krejt pak të tillë që në shtëpi flasin "boshnjakisht" apo edhe turqisht.

BURIMET DHE LITERATURA

Abazi, Ekrem: Përçaj e sundo, A- Hashkalit me prejardhje nga Persia, nga Ashkalloni, apo nga Italia !!!?, webmaster: www.egjiptianet.de.

Abazi, Ćerim: në Stuttgarter Zeitung, 8. shkurt, 2000.

Abdullahu Faton: Hebrenjtë e Prishtinës dhe shqiptarët, Kosova Press, 04 dhjetor 2011.

Abdyli, Ramiz: Karta e Aleksandrit, sundimtarit të Vlorës dhe Kaninës, dërguar Raguzës më 1368, Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave historike, 14/1984.

Adae Guillelmus - Brocardus: Directorium ad passagium Faciendum, pjesë të zgjedhura të botuara në Dardania, Zeitschrift für Geschichte, Kultur und Information, 4/1995, Wien.

Agolli Ilirian, Libri "Pavarësia" i Elez Biberajt, Zëri i Amerikës, e premte, 16 nëntor, 2012.

Ajeti, Idriz: Mbi gjuhën e divanit të sheh Maliqit, Studime gjuhësore I, Prishtinë, 1971.

-: Shqiptarët dhe gjuha e tyre, Prishtinë, 1994.

-: Studije iz istorije albanskog jezika, Prishtinë, 1982.

-: Neki zajednički izrazi šiptarske i srpskohrvatske leksike, Buletin i punimeve shkencore të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, III, Prishtinë 1966.

Antunović, Milovan-Kobliska: Za pravilno tumačenje značenja i porekla nekolikih starih rudarskih i topioničarskih naziva, Onomatološki prilozi, 3, Beograd, 1982.

Armaş- Silvia: L'influence roumaine sur le lexique des langues slaves, Romanoslavica 16 (1968).

Bahlow, Hans: Deutsches Namenlexikon, bot. Suhrkamp Taschenbuch Verlag, Baden-Baden, 1967.

Bajraktarević, Fehim, O Jurucima, "Politika", (Beograd) 6, 7, 8, 9 I, 1933, XXXX, Nr. 8858.

Bangert, Yvonne: http://www.gfbv.de/voelker/europa/greece/209_roma.htm; entnommen aus pogrom - bedrohte völker Heft 2 / 2001.

Barić, Henrik: Albano-rumänische Studien I, Sarajevo, 1919.

Bartl, Peter: Geistliche Visitationsberichte als Quellen zur albanischen Volks- und Kirchengeschichte, version i përpunuar i punimit të botuar më parë në anglisht në botimin e përgatitur për shtyp nga Arshi *Pipa* e Sami *Repishti*, Studies on Kosova. New York 1984, (Kosova and Macedonia as Reflected in Ecclesiastical Reports, f. 23-39).

Baxhaku, Fatos: Einige Ethnische Angaben über die Bevölkerung der Grenzzone zwischen Albanern, Serben und Bulgaren (Zweite Hälfte des 19. Jhd.) Dardania, Zeitschrift für Geschichte, Kultur und Information, 2-3, Wien, 1995.

Baxhaku, Gëzim: Porodica Rezniqi - zaštitnici Jevreja, në http://www.slobodnaevropa.org/content/porodica_rezniqi/1941282.html dhe http://www.fildzanviska.ba/clanak_510.htm

Belić, A. (leksandar) : Stara Srbija s istorisko-jezične tačke gledišta, Beograd, 1912.

Benninghaus, Rüdiger: Roma Gruppen in Mazedonien und im Kosovo; http://koelner-fluechtlingsrat.de/nachrichten/0700.doc.

Berisha, S. Ali : Gallapi i Prishtinës, 2007, Dorëshkrim.

Bezlaj, France: Etimološki slovar slovenskega jezika II, Ljubljana, 1982.

-: Slovenska vodna imena I, Ljubljana, 1961.
-: Slovenska vodna imena, II, Ljubljana, 1962.
Boeglin, Y. E., La rivière "Lab" en Serbie, ONOMA 12 (1968), 2-3.
Birnbaum, Henrik: Überlegungen zum mittelalterlichen Serbien, Südost -Forschungen, Bd. 53, 1994.
Bislimi, Xhevat: Shqiptarët e Turqisë dhe "Turqët" e Kosovës, Revista Drini, në internet.
Boeckh, Katrin: Von den Balkankriegen zum Ersten Weltkrieg, www. Hagail.com/antisemitismus/osteuropa/jogoslawien.htm
Bogdanović, Nedeljko: Nazivi i imena brava u okolini Svrljiga, Onomatološki Prilozi, I, Beograd, 1979.
Böcker, Simone: Leben, lernen und Ladino, www.juedische-allgemeine.de/article/view/id/10536.
Borcea, Jon: Deutsche Sprachelemente im Rumänischen, Jahresbericht des Institutes für Rumänische Sprache, 10 (1904), II.
Bozhori, Koço: Dokumente bizantine për historinë e Shqipërisë (shek. VII-XV), Tiranë, 1978.
Brockhaus (Der Grosse), Zwanzigster Band, Leipzig, 1935.
Brozović, Dalibor: Doseljenje Slavena i njihovi dodiri sa starosjediocima u svjetlu lingvističkih istraživanja, Simpozijum "Predslavenski etnički elementi na Balkanu u etnogenezi južnih slavena", 24-26 oktobra 1968 u Mostaru, Sarajevo, 1969.
Brückner, Aleksander: Słovnik etyomologiczny języka polskiego, Warszawa, 1974.
Brüm, Max: Es gibt noch Juden im jüngsten Staat der Welt, Jüdische Zeitung, 17.03. 2010.
Brym, Max: Historische Debatte in Kosova/Kosovo: Die Juden in Kosova und Albanien, http://www.hagalil.com/archiv/2004/05/kosova.htm
Bukumirić, Mileta: Onomastika Prekoruplja II, Onomatološki prillozi III, SANU, Beograd, 1982.
-: Iz onomastike južne Metohije, Onomatološki prilozi V, SANU, Beograd, 1984.
Capidan, Th.: Raporturile albano-române, Dacoromania 2, 1924.
Cioranescu, Alejandro: Dictionario etimologico rmano, Madrid, 1966.
Constantinescu, A. N.: Dicţionar Onomastic Romînesc, Editura Academiei Republicii Socialiste România, Dicţionar onomastic romînesc, Bucareşti, 1963.
Çabej, Eqrem: Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe, XIV, "Studime filologjike" 3/1964.
-:Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XIV, "Studime filologjike", Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 3 /1964.
-: Ilirishtja dhe shqipja, në Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, Sesion shkencor, 3-4 mars 1969, Tiranë, 1969.
-: Der Name Alexander in der albanischen Volkssprache, Eteria Makedhonikon Spudhon - Makedhoniki Vivliothiki, A. P. 57, Thessaloniki 1980.
-: Zur aromunischen Wortforschung, Studii şi cercetări lingvistice, XXVII, Bukureşti,1976.
-: Studime gjuhësore II, Prishtinë, 1977.
-: Studime gjuhësore VI (Gjon Buzuku dhe gjuha e tij), Prishtinë, 1977.
- :Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe, "Përparimi", 10-11, Prishtinë, 1972.
-: Studime etimologjike në fushë të shqipes, II, A-B, Tiranë, 1976.
-: Studime etimologjike në fushë të shqipes, III, Tiranë, 1987.
-: Studime etimologjike në fushë të shqipes, IV, Tiranë, 1966.
-: Studime etimologjke në gushë të shqipes, VII, Tiranë, 2006.
Çefta, Kolec: Një letër e pabotueme e Fishtës në mbrotje të Joklit publikuar tek Trepca.net, 25 gusht 2003.

Chaim, Frank: von.www.hagalil.com/antisemitismus/osteuropa/jugoslawien.htm
Čolak, Nikola - Mažuran, Ive: *Janjevo*, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000.
Ćorović, Vladimir: Istorija srpskog naroda, në www.rastko.org.yu/rastko-bl/istorija/corovic/istorija, 3.
-: Napomene o arbanaškim tragovima u Hercegovini, Arhiv za anbanasku starinu, jezik i etnologiju, libri I, vëllimi 1-2, Beograd, 1923.
Dagmar, Eklaude, Roma rücken ins Rampenlicht http://www.kfunigraz.ac.at/ainst/unizeit/archiv/2002/heft4/2_04_01.html
Daničić, Dj.: Rječnik iz književnih starina srpskih, I., Beograd, 1863.
-: Tri srpske hrisovulje, Prepisao Dj. Daničić, Glasnik Društva Srpske Slovesnosti, XI, Beograd, 1859
-: në Glasnik Srpskog Učenog Društva XLIX, Beograd, 1881.
Dedijer, Dr. Jevto: Projekat Rastko Gračanica - Peć: Istorija: Stara Srbija, geografska i etnografska slika (1912) www.rastko.rs/kosovo/.../vdedijer-stara_srbija.html
Dema P. Benedikt, O. F. M.: Shqypnija Katolike në vjetë 1671, Hylli i Dritës, 7-8, 1932.
Detschew Dimiter: Die thrakischen Sprachreste, Wien, 1957.
Diaconița- Djamo, Lucia: Elemente lexicale de origine germană (primate prin diferite filiere), in slavona românescă, Omagiu lui Iorgu Iordan, Bucureşti, 1958.
Diak Pajić Svetozar: Zakonik velikog cara Stefana Dušana silnog, www.oldserbia.plus.co.yu-index.htm.
Dinić, Mihailo: Iz dubrovačkog Arhiva I, Beograd, 1957.
-: Za istoriju rudarstva u srednjovekovnoj Srbiji i Bosni I, II, Beograd, 1962.
-: Nastanak dva naša sednovekovna grada, Prilozi za knjževnost, jezik, istoriju i folklor, nr. 31, bleu 1-2, Beograd, 1965.
Dinić J. Mihailo: O nazivima srednjovekovne srpske države [Sklavonija, Srbija, Raška], Prilozi za književnost, jezik, istoriju i folklor, 1-2 (19669).
Dino, Luan: Organizata politike për barazi, dinjitet, drejtësi, Dega Tiranë - Shqipëri, publikuar në http://www.egjiptianet.de/gjurmime.htm
Djurić, Rajko: Zigeuner des Lexikons Die Roma in Nachschlagewerken: Ein Vorschlag zur Korrektur http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/lexikon.htm.
-: Intervistë në radion "Europa e Lirë" (serbisht) më 8 nëntor 2008.
Dobruna, Exhlale: Motivi i dorës në monumentet mbivarrore të Dardanisë si dëshmi e pranisë së hebrenjve gjatë antikitetit në këtë trevë, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 30/2, Universiteti i Prishtinës- Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2011.
Doçi, Dr. Rexhep :Onomastika e Drenicës I, Prishtinë, 2005.
Dokle, Nazif: Për Gorën dhe goranët, (Artikuj e studime), Prizren, 2002.
-: Bogumilizmi dhe etnogjeneza e torbeshëve të Gorës së Kukësit, Tiranë (bot. Geer), 2009.
Drançolli, Dr. Jahja: Raguzanët në Kosovë, Prishtinë, 1986.
-: Qytetet e Kosovës gjatë mesjetës, Buletin i Fakultetit Filozofik XXVI, Prishtinë, 1996.
Drançolli, Dr. Jahja: Feja në Kosovë gjatë mesjetës, Dardania sacra, 2, Prishtinë, 2000.
Dukagjini, Zef: Antroponimikë nga Shqipnija e Veriut, Dorëshkrim në Institutin për Kulturën Popullore, Tiranë, Inv. Nr. 296/26, Dosja 21.
Duridanov, Ivan: Ezikът na Trakite, Izdatelstvo "Nauka i izkustvo", Sofia, 1976.
-: Illyrische Flussnamen in Serbien, Linguistique balkanique V, Sofia, 1963.
-: Balkanski etimologii, Bălgarski ezik, 4-5, 1968.
-: Latinski ili trakijski (resp. dakijski) mestni imena, Studia Linguistica in Honorem Vladimir I. Georgiev, Sofia, 1980.

-: Kьm etimologijata na njakoi starinni mestni nazvania, Izsledvanija v česta na Dimiter Dečev, Sofija, 1958.
-: Der thrakische Einfluss auf die bulgarische Anthroponymie,, Balkansko Ezikoznanie/Linguistique Balkanque II, Sofia, 1960.
Dycke, Robert: Zigeuner, ein verfemtes Geschlecht orchesterkolleg@gmx.de**;** http:// www. Karpatenwilli. com/zigeuner. Htm.
Đogović, Alija: Toponimija jugoslovenskog dela Prokletija (I Deo), Onomatološki prilozi, IV, SANU, Beograd, 1983.
Đonov, Bojan: Etničeskoto nazvanie na rudarite, ‚Sasi", na Balkanite i v prosă za tehnija proizhod, Izvestija na Institut za bălgarski ezik, 16 (1968), f. 203.
-: Saskite rudarsko-pravni zaemki v bălgarskite redakciji na "Saskija zakon", God. na Sof. Univ., Fak. za filolog., 65/2 (1972)
Đurđev, Branislav: Turski prevod rudarskog zakona za Novo Brdo despota Stefana Lazarevića, Prilozi za orijentalnu filologiju 15, Beograd, 1975.
-: Odnos između Ohridske arhiepiskopije i srpske crkve od pada Smedereva (1459) do obnavljanja Pećke Patriajšije (1557) Radovi knj. 38, Odeljenje društvenih nauka Akademije Nauka i Umjetnosti BiH, Sarajevo, 1970.
Eklaude, Dagmar: Roma rücken ins Rampenlicht http://www.kfunigraz.ac.at/ainst/unizeit/archiv/2002/heft4/2_04_01.html.
Elezović, Gliša: Rečnik kosovsko-metohiskog dijalekta I, Beograd, 1932.
-: Rečnik Kosovsko-metohiskog dijalekta II, Beograd, 1934.
Fennesz, Christiane - Juhasz/ Dieter W. Hawachs/ Mozes F. Heinschnik: Sprache und Musik der österreichischen Roma und Sinti http:/www-gewi.kfunigraz.ac.at./romani/downlaod/files/_ab5.pdf.
Ferri Naser: Gjurmët e judeo-krishtërimit në Dardani, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 30/2, Universiteti i Prishtinës- Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2011.
Fischer, J. Bernd : Hebrejtë e Shqipërisë gjatë periudhës zogiste dhe Luftës së Dytë Botërore, http:albanisches-institut.ch/pdf/tex9pdf.
Filipović, S. Milenko: Strukutra i organizacija srenjovekovnog katuna, në Simpozijum o srednjovjekovnom katunu, Sarajevo, 1963.
-: Das Erbe der mittelalterlichen sächsischen Bergleute in den südslawischen Ländern, Südost-Forschungen 22/1963.
Filipović, Nedim: Iz istorije Novog Brda u drugoj polovini XVI vijeka, Godišnjak Istorijskog Društva Bosne i Hercegovine 6, 1954.
Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë 1984.
Frank, O(tto): Zur serbokroatischen Ortsnamenkunde, Leipzig, 1932.
Franck von Chaim, www. Hagail.com/antisemitismus/osteuropa. Jugoslawien.htm.
Galjus, Orhan: Roma im Kosovo: Die vergessenen Opfer (Versioni gjerman i artikullit anglisht, ‚Roma of Kosovo: the Forgotten Victims", aus dem Web-Journal, ‚The Patrin".
Gashi, Skënder: Cili është katundi Arbanash i vitit 1485?, "Rilindja", 12. 2. 1977.
-: Antroponimia e popullatës së nahijes Zhupa të Dibrës së shek. XVI, "Gjurmime albanologjike", Seria filologjike, 7/1977.
-: Emrat e shqiptarëve në shekujt 13-15 në dritën e burimeve kishtare serbe. (dorëshkrim).
-: Prania e etnosit shqiptar në Kosovë gjatë shekujve XIII-XIV në Dritën e Burimeve kishtare serbe, në Onomastika e Kosovës, Simpozium i mbajtur më 25-27 shkurt 1977, botim i Institut Albanologjik të Prishtinës, Prishtinë 1979.
-: Ku ishte qyteti Damastion?; "Rilindja", 6.12.1976.

-: Rreth lokalizimit të katër vendbanimeve të krahinës së Gallapit, Fjala, 6, 1977.
-: Rreth lokalizimit të disa vendbanimeve të Kosovës, në "Rilindja", 18 janar 1975.
-: Biblioteka e pasur - shkak i likuidimit (Të dhëna të reja përkitazi me likuidimin e Norbert Joklit dhe fatin e bibliotekës së tij)
Georgiev, Vladimir: Značenieto na geografskite imena za vъprosite na etnogenezisa, Vъlgarski ezik, V, Sofia, 1955.
-: Introduzione alla stroia delle lingue indoeuropee, Roma, Edizione dell Ateneo, 1966.
Gesellschaft für bedrohte Völker: Übergriffe auf Roma im Kosovo Gesellschaft für bedrohte Völker appelliert an KFOR: Schützen Sie die Minderheiten http://www.gfbv.de/voelker/europa/kosovo/roma.htm.
-: "Ägypter" im Kosovo von Vertreibung und Tod bedroht!! http://www.muenster.org/frieden/roma.html.
-: Volksgruppen mit einem Schicksal Roma, Aschkali und Kosovo-Ägypter http://www.gfbv.de/voelker/europa/kosovo/kos_ethn.htm.
Geschichte und Sprache der Roma http://www.kbk.at/roma/Container/Vortrag-2000-M%E4rz.htm* Titulli i origjinalit: "Von der Sprache und Herkunft der Zigeuner aus Indien".
Geschichte der Juden von São Tomé, http://de.wikipedia.org/wiki/Geschichte_der_Juden_von_S%C3%A3o_Tom%C3%A9.
Grabež, Nebojša: Radio "Slobodna Europa", 11 dhjetor, 2009.
Gstein, Heinz: Albanerglaube, në: G2W, cit. sipas Heinz Gstein: Albanerglaube, në: G2W, -Glaube in der 2. Welt (Ökumenisches Forum für Religion und Gesellschaft in Ost und West) Nr. 5 /2002.
Grup autorësh: Istorija Crne Gore I (2), Titograd, 1972.
Grup Autorësh: Kosovo und Metochien: Aufstieg und Niedergang des serbischen Volkes, në librin Kosovo und Metochien in der serbischen Geschichte, Lausanne, 1989.
Grup autorësh: Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Bot. i Toena, Tiranë, 2002, redaktorë: Selim Islami, Frano Prendi, Hasan Ceka e Skënder Anamali.
Grup autorësh: Novi Pazar i okolina, NIP Književne Novine, Beograd.
Guzeta, Antonino: Trace della lingua albanese del secolo XV nella documentazione veneta dell' epoca, Palermo, 1968.
Gjini, Gaspër: Ipeshkvia Shkup - Prizren nëpër shekuj, bot. Drita, Ferizaj, 1992.
-: Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća, Zagreb, 1986.
Hadžibegić Hamid, Handžić Adem & Kovačević Ešref, Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455. godine, Orijentalni Institut u Sarajevu, Sarajevo, 1972.
Hahn, Johann Georg von: Putovanje kroz porečinu Drina i Vardara, Belgrad, 1876 (harta).
Halimi, Bedri: Veprimet destruktive të misionarëve serbë në Gorë, në të përditshmen "Epoka e re", Prishtinë, e10 gusht, 2004.
Halimi, Mehmet: Skicë e së folmes së fshatrave Mjak dhe Tanishec, Kërkime dialektologjike, Prishtinë, 1985.
Halwachs, Dieter W: Romani - Versuch eines einführenden Überblicks http://www-gewi.kfunigraz.ac.at/romani/ling_all/ling_all.de.html.
-: Gurbet, Geschichte und Sprache, http:// romani. Kfunigraz.ac.at/rombase/cd/data/ethn./groupsat/data/at-gurbet de.pdf.
Handžić, A.(dem) Nekoliko vijesti o Arbanasima na Kosovu i Metohiji sredinom XV vijeka, në Simpozijum o Skenderbegu, Prishtinë, 1969.
Hermes, Annelore - aus: pogrom 199/1998 Europa muss die Roma schützen Noch in keinem Land sind ihre Menschen- und Bürgerrechte gesichert http://www.gfbv.de/voelker/europa/roma2.htm

-: Referentin im Bundesbüro der Gesellschaft für bedrohete Völker) (Göttingen): Sinti und Roma, Basisfakten und Überblick, http://www.gfbv.de/voelker/europa/roma.
Hopf, Charles: Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi, Chronique gréco-romanes, Berlin, 1873.
Holtey, von Nicolaus: Hymne der Roma: http://www.hlc.unimelb.edu.au/Call/German/sintiroma.html Roma/Kosovo-Hilfe-Unterstützen Sie das Projekt des Heidelberger Shalomdiakons.
Hopf, Charles: (bot.) Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi, në Chronique gréco-romanes, Berlin, 1873.
Hoxha R. Skënder, Prof.: Toponimia e Dushkajës, Jakova, 2007.
Hoxhaj, Enver: Kërkime për historinë e Kosovës në kohën romake, USHTRIA, QYTETET, SHOQËRIA DHE POPULLSIA, Disertacion për marrjen e gradës së doktoratës në filozofi, në Faklutletin e Shkencave Humanitare të Universitetit të Vjenës, dorëshkrim.
Idrizi, Sadik Aljabak: Aromunsko-vlaški tragovi u Gori (I- IV), fejton në http: // www.prizren-web.com/magazin/.) dhe Sadik Idrizi Aljabak: Gora - Jedan Pogled Unazad (dorëshkrim)
-: Gora kroz stoljeća, www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k.
Iordan, Ion: Toponimia românească, Bucureşti, 1963.
Islami, Sami: Pse shqiptarët i mbrojtën hebrejtë nga nazizmi?, http://www.thealbanian.co.uk/aktualitet/
Ivanov, Jordan.: Bьlgarite v Makedonija, izdirvanja i dokumenti za tehnoto poteklo, ezikъ i narodnostъ s etnografskata karta i statistika, Sofija, Carska pridvorna pečatnica, 1917.
-: Bogumilski knjigi i legendi, Bălgarska Akademija na Naukite, Sofija, 1925.
-: në Makedonski pregled 4, Sofija, 1925.
Ivić, Pavle: Die serbokroatischen Dialekte, ihre Struktur und Entwicklung, Mouton s' Gravenhage, 1958.
-: Iz srpskohrvatske dijalektologije, Beograd, 1991.
Jagić, Vatroslav: rec. për punimin e Dr. T. Maretić, Kosovski junaci i događaji u narodnoj epici, Rad JAZU, 97, 1889.
-: Svetostefanski hrisovulj kralja Stefana Uroša II Milutina, Wien, 1890
-: Život Stefana Lazarevića, në Glasnik Srpskog Učenog Društva XLII, 1875.
Janitsek, E.: Toponimia văii superioare a Rîului Şieu, Studi şi materiale de onomastică, Editura Academiei Republicii Socialiste România, 1969.
Jastrebov, Ivan : Podaci za istoriju crkve u Staroj Srbiji, Glasnik Srpskog Učenog Društva XLII, Beograd, 1875.
-: Nešto o Gornjoj Moravi, Glasnik Srpskog Učenog Društva, 60, Beograd 1885
-: Stara Serbija i Arbanija, Beograd, 1901.
-: Sinan - paša i Kukli -beg, Beleške iz Stare Srbije povodom knjižice prof. Srečkovića, në Glasnik Srpskog Učenog Društva XLIII, Beograd, 1876.
Jireček, Konstantin: Ugovor Stefana Prvovenčanoga s Dubrovčanima iz god. 1215-1219, Glasnik Srpskog Učenog Društva, XLVII, Beograd, 1879.
-: Die Beziehungen der Ragusaner zu Serbien unter car Uroš und König Vlkašin, Sitzungsberichten der königl. Böhm. Gesellschaft der Wissenschaften, Mitgetheilt am 19. Oktober 1885, Prag, 1885.
Jireček, Dr. Constantin: Das christliche Element in der Topographischen Nomenclatur der Balkanländer, Sitzungsberichte der. Kais. Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch-Historische Classe, Band CXXXVI, Wien, 1897.
-: Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters, Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Bd. LXVIII, Wien, 1908.

-: Romani u gradovima Dalmacije, Zbornik Konstantina Jirečeka II, Beograd, 1962.
-: Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien, Studien zur Kulturgeschichte des 13-15 Jahrhunderts, I, II, Denkschriften des Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch- Historische Klasse, Band LVI, Wien, 1912.
-: Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien Studien zur Kulturgschichte des 13-15 Jahrhunderts, III, Denkschriften des Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Philosophisch- Historische Klasse, Band LVI, Wien, 1912.
-: Kruja e qarku i saj bërthamë e Shqipnis mesjetore, në Vëzhgime iliro-shqiptare, Shkodër, 2004.
-: Shqipnija në të kaluemen, në Vëzhgime iliro-shqiptare / Përpiluem prej Ludwig von Thallóczy-t, Shkodër, 2004.
-: Spomenici Srpski, Spomenik XII, Beograd, 1892.
-: Die Bedeutung von Ragusa in der Handelsgeschichte des Mittelalters, Wien, 1899.
-: Trgovački drumovi i rudnici Srbije i Bosne u srednjem veku, Zbornik Konstantina Jirečeka I, Beograd 1957.
Jireček, K - Radonić, J.: Istorija Srba II, Beograd, 1952.
Jokl, Norbert: Die magyarischen Bestandteile des albanischen Wortschatzes, Wortgeschichte - Studien aus der südosteuropäischen Sprachen, Ungarisches Jahrbuch 7 (1927).
-: Balkangermanisches und Germanisches im Albanischen, separat nga "Festschrift der 57. Versammlung deutscher Philologen und Schulmänner in Salzburg", 1929.
-: Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen, Berlin - Leipzig, 1923.
-: Zur Geschichte des alb. Diphtongs *-ua-*, *-ue-*, Indogermanische Forschungen 49 (1931)
-: Zur Ortsnamenkunde Albaniens, Zeitschrift für Ortsnamenforschung, Bd. 10, Heft 2.,1934.
Iordan, Iorgu : Toponimia romineasca, Bucarest, 1963.
Jović, Momir: Dubrovačka vlastela u Novom Brdu, Studia humanistica 10, Prishtinë, 1975.
Justiz und NS-Verbrechen Lfd.Nr.690a (Ausschnitt), http://www1.jur.uva.nl/junsv/excerpts/690002.htm.
Klajić, Bratoljub: Veliki Rječnik stranih riječi, Zagreb, 1968.
Kaiser, Christina: Roma von und auf dem Balkan: Kosovo, Makedonien, Albanien, Montenegro, Serbien,http://www. kath-zigeunerseelsorge.de/balkan.htm.
Kanurcova, Spasca: Dicţionar român-bulgar (Rumъnsko-bъlgarski rečnik), Editura Ştiinţifica & Nauka i Izkustvo, Sofia-Bucureşti, 1962.
Karandžalov, D.: La terminologie pastorale commune chez les peuples balkaniques, Actes du premier congres international des études balkaniques et sud-est européennes, VI, Sofia, 1968.
Karoly, Mirjam: Roma und Ashkalije im Kosovo (November 2001) Ganz normaler Alltag? Die Einsetzung einer internationalen Verwaltung (UNMIK),http://wwwgewi.kfunigraz.ac.at/romani/journ_patrin/2002/rp2002-01-04.de.html.
Katičić, Radoslav, rezcension për librin e: Vladimir Georgiev, Hethitisch und Etruskisch. Die hethitische Herkunft der etruskischen Sprache, Balkansko ezikoznanie V, 1 Bălgarska Akademija nauka, Sofija 1962, në Živa antika 15, 1., Shkup, 1965.
Kistner, Martin: Albstadts "Ägypter aus Jugoslawien", protestieren gegen Pogrome im Kosovo, aus Albstadt-Bote, 29./30. Januar 2000.

Knežević Gordana: Radio Evropa e Lirë, e shtunë, 10 korrik, Intervistë me zonjën Shërli Klojs DioGuardi, këshilltare për çështjet e Ballkanit në Lidhjen Qytetare Shqiptaro-Amerikane.
Kretschmer, Paul: Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache, Göttingen, 1970 (reprindt).
Knutsson, Knut: Zur Frage über die ältesten germanischen Lehnwörter im Slavischen, recension në Zeischrift für slavische Philologie, Bd. XV, Leipzig 1938.
Kona, Denisa: Të pathënat mbi shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri, në http://dielli.blog.al/page/86/., që së pari ishte botuar në gazetën shqiptare Ballkan.
Koneski, Blaže: Makedonski mesta i imenja, NIO, "Studentski zbor", Shkup, 1991.
Kosova, Parim: Faltorja e familjeve të shpërngulura myslimane arabe, "Koha Ditore", 14 maj 2008.
Kostić, Kosta N: Trgovinski centri i drumovi po srpskoj zemlji u srednjem i novom veku (istorisko- geografska rasprava), Beograd 1899.
Kostov, Kiril: Vъrhu proizhoda na ciganite i tehnija ezik, Bъlgarski ezik, 2, Sofia, 1953.
Kotani, Apostol: Disa të dhëna mbi qëndrimin dhe trajtimin e izraelitëve në Shqipëri, "Studime historike", 4/1990.
Kovačević, Desanka: Srednjovjekovni katuni po dubrovačkim izvorima, në Simpozijum o srednjovjekovnom katunu, Sarajevo, 1963.
Kovačević. Lj.: Svetostefanska hrisovulja, Spomenik SKA 4, Beograd, 1890.
Lacaj, Henrik & Fishta, Filip: Fjalor latinisht-shqip, Tiranë, 1966.
Lambertz, M.: Zwei Albanica, Indogermanische Forschungen 60. (1952).
Laurent, Juliette: Jüdische Traditionen in Belmonte (Portugal) (September 2007), në http://www.dw-world.de/dw/article/0,,2763572,00.html.
Lazić, M.: Ostaci nemačkih dijalekata na tlu Jugoslavije, Balcanica, VII, Beograd, 1976.
Lecaj, Ismet: Përpjekje për të identifikuar elementet protoshqiptare në trevën e Gorës, Goranët (përgatitur nga Bedri Halimi), bot. Shoqata Kulturore, ,Ymer Prizreni", Sharr, 2012.
Lettenbauer, Birgit: Roma in der Slowakei Dann soll ich mich auch als Roma bekennen, në Wikipedia
Lexers, Mathias: Mitteldeutsches Taschenwörterbuch, 36 Auflage, Stuttgart, 1981.
Liewehr, Ferdinand: Beiträge zur slavischen Orts- und Flussnamen, Franz Spina zum 65 Geburtstag, Zeitschrift für slavische Philologie, XI, Leipzig, 1934.
Ljubić, Sime: Opis jugoslovenskih novaca, Zagreb, 1875.
-: Skadarski zemljišnik od 1416, Starine JAZU, XI, Zagreb 1882.
Lutovac, M. Gora i Opolje, Naselja i poreklo stanovništva, knj. 35, Beograd, 1955.
-: La Metojija, Étude de géographie humaine, Paris, 1935.
Mackensen, Lutz: Das große Buch der Vornamen, VMA-Verlag, Wiesbaden, 1990.
Maksuti, Izer,: Norbert Jokl - Figurë e shquar e albanologjisë të publikuar në www.illyria.de - Albanischer Studentenverein - Unioni i Studentëve Shqiptarë - Hamburg.
Manoschek, Walter,, ,Gehst mit Juden erschießen?", über die Vernichtung der Juden in Serbien, www.wsws.org/de/1995/apr1995/wehr-a14.shtml - 36k -.
Matl, Josef: Hirtentum und Stammesverfassung als Kulturfaktor, Völker und Kulturen Südosteuropas, Kulturhistorische Beiträge, im Namen der Südosteuropa-Gesellschaft herausgegeben von Wlhelm Gülich, München, 1959.
Matoshi, Halil: Racizmi dhe lajmi pa etikë, Koha. Net, 28.09.2013.
Mayer, Anton: Die Sprache der alten Illyrier I, Wien, 1957.

-:Die Sprache der alten Illyrier II, Österreichische Akademie der Wissenschaften, Schriften der Balkankommission, XVI, Wien, 1959.
Meillet, A.: Dictionaire étymologique de la langue latine, Quatrième édition, Paris, 1967.
Meleqi, Hajriz: Opoja dhe Gora (Komuna e Dragashit), Vështrim Gjeografik, Dragash,1994.
Meyer, Gustav: Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache, Straßurg, 1891.
Mijatović, Čedomilj: Studije za istoriju srpske trgovine, Glasnik Srpskog Učenog Društva, 37, Beograd, 1873.
Miklós, Takács: Sächsische Bergleute im mittelalterilichen Serbien und die "sächsische Kirche" von Novo Brdo, Südost-Forschungen, Bd. L, 1991.
Miklosich, Franz: Munumenta serbica Spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii, Viennae, 1858.
-: Albanische Forschungen II, Die romanischen Elemente im Albanischen, Denkschriften der Philosophisch-historischen Classe der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften, XX, Wien, 1871.
-: Die slawischen Ortsnamen aus Appellativen I., Denkschrift der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften, XXI, Wien, 1872.
-: Die Fremdwörter in den slawischen Sprachen, Denkschriften der Wiener Akademie der Wissenschaften 15 (1866).
-: Die slavischen Elemente im Albanischen, Wien, 1870.
-: Die Blutrache bei den Slaven, Wien, 1887.
-: Die Bildung der slavischen Personennamen, Denkschriften der Philosophisch-historischen Classe der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften X, Wien, 1860.
-: Die Bildung der Ortsnamen aus Personennamen im Slavischen, Denkschriften der Philosphischßhistoriscen Classe der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften XIV, Wien, 1865.
-: Über die Wanderungen der Rumunen in den dalmatinischen Alpen und den Karpaten. Denkschriften der Philosophisch-historischen Classe der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften XXX, Wien, 1880.
Mil. Ant. Vujičić: Rečnik mesta u oslobodjenoj oblasti Stare Srbije (po službenim podacima), Belgrad, 1914, f. 53.
Mihajlović, V. : Iz toponomastike Srbije (Kruševac, Gugalj), Zbornik za filologiju i lingvistiku, XVII/2, Novi Sad, 1974, f. 175.
Milojević S. Miloš: Dečanska hrisovulja, Glasnik Srpskog Učenog Društva, 12, Beograd, 1880.
Mirdita, Zef: Studime dardane, Tiranë, 1981.
Mitrushi, Ilia, Drurët dhe shkurret e Shqipërisë, Tiranë, 1955.
Mladenov, Stefan, Geschichte der bulgarischen Sprache, Berlin und Leipzig, 1929.
Mladenov, Stefan: Bьlgarite v Makedonija, izdirvanja i dokumenti za tehnoto poteklo, ezikь i nardnostь s etnografskata karta i statistika, Carska pridvorna pečatnica, Sofija, 1917.
Mladenov. Dr. Prof St(efan), Bemerkungen über die Albaner und das Albanische in Nordmakedonien und Altserbien, Balkan - Archiv 1, 1925.
Moise, I., Neskolьko bolgarskih toponimičeskih nazvanii rumьinskogo proishoždenija, Actes du XI congres international des sciences onomastique, 2, Sofia, 1975.
Moór, Clemér: Die ehemaligen "Sachsenorte" an der oberen Theis, Süddeutsche Forschungen, III, 1938.
Mulaku, Latif: Mbi disa toponime mesjetare shqipe të Kosovës, Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979.

-: Mbi asimilimin e togut **vn** në **n**, "Gjurmime albanologjike", 1/1965, Prishtinë.
Murati Dr. Qemal: Dëshmime onomastike për autoktonine e shqiptareve në trojet etnike të tyre në Maqedoni, Tiranë, 1993.
Müller, K. B.: Die Bedeutung von deutschen Blutes in Südosteuropa, Süddeutsche Forschungen, III, 1938.
N. N: Despot Stefan Lazarević: Predgovor i pogovor Zakona o rudnicima i Zakona Novog Brda iz 1412. godine. në //Kosovo.com / Projekat Rastko / Projekat Rastko Gračanica - Peć //:
N. N: Reportaže-Hronike-Komentari Hronike Pomaci, njihova prošlost i sadašnjost në në http: // www.prizren-web.com/magazin/. 11 prill 2008. Përkthim nga maqedonishtja në boshnjakisht/serbisht nga : Idriz Vučitrna.
N. N: www.muenster.org/frieden/roma.html (Presseerklärung: Ägypter im Kosovo von Vertreibung und Tod bedroht !!): Eine vergessene Minderheit.
N. N.-: Sallnamja e Kosovës, Regjistrim i popullsisë i viteve 1896/97 (dorëshkrim).
N. N: Jevrejska zajednica postoji samo u tragovima, Radio Slobodna Evropa, 27.01.2010.
N. N.: Mbijetesa e hebrejve në Kosovë, Zëri.info, 27. 01. 2013.
N. N.: Hebrenjtë me fe zyrtare në Shqipëri http://www.zeri.info/kategoria/1 14-09-2011.
N. N.: Juden in der Welt: Griechenland, http://www.hagalil.com/.
N. N.: në Radio "Deutsche Welle", 27.01.2010.
N.N.: në radio "Slobodna Europa", 21.04.2013.
N. N.: në Radio "Zëri i Amerikës", 30 qershor, 2010
N. N.: në Radio "Zëri i Amerikës" 12.03. 2012.
N. N.: Justiz und NS-Verbrechen Lfd.Nr.690a (Ausschnitt), http://www1.jur.uva.nl/junsv/excerpts/690002.htm.
Nachrichten des Tages: Ägyptische Botschaft: Wahrheit über Verbrechen http://www.amselfeld.com/20000603.htm#AE.
Namani, Qazim: Lashtësia iliro-shqiptare në Malësinë e Gallapit, Vjetari i Arkivit Kombëtar të Kosovës, 29 - 30, Prishtinë, 2003.
Neziraj, Xhevdet: Kush janë egjiptianët e Kosovës?, "Koha ditore", 13 nëntor 2003.47.
Noton, P.: Dialektologie et Toponymie, disciplines connexes (À propos d un article récent), Revue de linguistique romane XIII, 1958.
Novaković, Stojan: Srpski pomenici XV-XVI veka, në Glasnik Srpskog Učenog Društva XLII, Beograd, 1875.
-: Novo Brdo i Vrajsko Pomoravlje u istoriji srpskoj 14. i 15. veka, Beograd, 1880.
-: Grad, Trg, Varoš, separat nga libri Gradovi i trgovi u staroj srpskoj državi, Beograd, 1892.
-: Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka, Beograd 1912.
-: Zakonik Stefana Dušana cara srpskog 1349 i 1354, Beograd 1870.
-: Zakonodavsto i vladaoci srpski XIVV veka i narodnosti u Makedoniji, Otadñbina 19 (1888).
-: Selo, (Reprindt), Beograd, 1965.
Novaković, Relja: O granicama Srbije i srpske države u X veku, Zbornik folozofskog fakulteta 11/ Beograd.
Oflidis- Kalaitzi- Lena & Oflidis, Simos: "Neunzehnhundertdreiundvierzig nach Christus" http://www.hagalil.com/europa/griechenland/5768/thesaloniki.htm.
Oroş, M.: Din Toponimia vaii Bistrei (judetul Bihor), në Studi şi materiale de onomastica, Bucarest 1969.
Osmani Dr. Jusuf: Vendbanimet e Kosovës, 1, Prishtina, Kastrioti dhe Fushë-Kosova, Prishtinë, 2003.

-: Vendbanimet e Kosovës, 6, Gjilani, Prishtinë, 2004.
-: Vendbanimet e Kosovës, 7, Vitia, Prishtinë 2004.
-: Vendbanimet e Kosovës 8, Mitrovica, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, Prishtinë, 2002.
-: Vendbanimet e Kosovës 11, Peja dhe Deçani, Prishtinë, 2004.
-: Vendbanimet e Kosovës 12, Burimi (Istogu), Prishtinë, 2004.
-: Vendbanimet e Kosovës, 13, Dardana (Kamenica) dhe Artana (Novobërda), Prishtinë, 2004.
-: Vendbanimet e Kosovës, 14, Gjakova, Prishtinë, 2005
-: Vendbanimet e Kosovës 16, Vushtrria, Prishtinë, 2005.
-: Vendbanimet e Kosovës, 18, Prizreni, Prishtinë, 2005.
-: Vendbanimet e Kosovës, 20, Sharri (Dragashi), Prishtinë, 2006.
-: Çerkezët në Kosovë, bot. i "Olymp", Prishtinë, 2014.
Oschlies, Wolf: Geschichte und Ende der Juden in Serbien www.shoa.de/content/view/218/46/ - 89k.
Oz, Benji: Roli i mbretit Zog në shpëtimin e hebrenjve në vitet 1928-1939, Intervistë me Dr Patrice Najbor nga http://ardhmëria.co.uk/? P. 213 Mars 17, 2011.
Pajic Dijak, Svetozar: Zakonik cara Stefana Dušana, http//www.oldserbia.plus.co.yu/index.htm.
Papahaghi, T. Dictionarul aromân general şi etimologic, Bucureşti 1974.
Papazoglu, Fanula: Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba, Sarajevo, 1969.
Papleka, Ndoc: Kulte, rite, magji në traditën orale, Tiranë, 1999.
Pascu, George, Die Anfänge der rumänischen Geschichtsschreibung, Süddeutsche Forschungen, III, 1938.
Payne, Robert: Die Kreuzzüge, Zweihundert Jahre Kampf um das Heilige Grab, Patmos Verlag, GmbH & Co. KG; Albatros Verlag, Düsseldorf, 2001.
Pavlović, Milivoj: Altsächsische Bergbauterminologie im Serbokroatischen, Südost-Forschungen 18, 1959.
-: Ostaci dubrovačkih i saških govornih osobina u Janjevu, Istoriski Časopis, 7/, Beograd, 1957.
-: Govor Janjeva, Novi Sad, 1970.
-: Toponimija Okoline Vranja, Vranjski Glasnik 4, Vranje, 1968.
Pavlović, Z.: Un cas d'ambiguite mixoglottique, Actes de Xie congres international des sciences onomastiques, Sofia 1972, Academie Bulgare des Sciences – Centre de linguistique et litterature, Sofia, 1975.
Peco, Asim: Nazivi dolina uz reke u srpskohrvatskom jeziku, Južnoslovenski filolog, XXX, 1-2, Beograd 1973.
Peçi,Admira:http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/344519/titulli/Shaban-Sinani-Si-u-priten-hebrenjte-ne-Shqiperi më 02/11/2009 dhe në http://www.revistakuvendi.net/Publicistike/207.html.
Pešikan, Mitar: Zetsko-humsko-raška imena na početku turskoga doba (prvi deo) në Onomatološki prilozi, III, SANU, Beograd 1982.
Petkanov, Boris: Les éléments romans dans les langues balkaniques, Linguistique et Philologie romane, XI congres international des sciences onomastiques, 2, Sofia 1975.
Petrovici, Emil: Istoria poporului român aglindită în toponimie, Studi de dialektologie şi toponimie, Bucureşti, 1970.
Petrusi, Agostino: Martino Segano di Novo Brdo, Vescovo di Dulcigno (Un umanista serbo-dalmata del tardo Quattrocento), Vita e Opere, Roma, 1981.
Pirraku, Dr. Muhamet: Për kauzën e shtetësisë së Kosovës, bot. Radio Frée Kosova, Prishtinë, 2008.

Popović, Ivan: Die Einwanderung der Slaven in das Oströmische Reich im Lichte der Sprachforschung, Zeitschrift für Slawistik, Bd. III, 1958.
-: Bemerkungen über die vorslavischen Ortsnamen in Serbien, Zeitschrift für slavische Philologie Bd. XXVIII, Heidelberg, 1960.
-: Vlacho-Serbica, Der rumänische Spracheinfluß auf das Serbokroatische und dessen Geographie, Südost-Forschungen XXI, 1962.
Popoviq, Ivan: Elemente të gjuhës shqipe në gjuhët tjera, Përparimi 1-2, 1957.
Preißig, E.: Deutsche Bergmannswörter in den Balkansprachen nach einem Zeugnis der französischen Renaissance, Germanoslavica, III, 1-2 (1935).
Pulaha, Selami: Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, Tiranë, 1974.
-: Krahinat e sanxhakut të Dukagjinit gjatë shekullit XVI (I), "Studime historike", 3/1973.
-: Të dhëna ekonomike dhe demografike për krahinën e Opojës, "Studime historike", 3/1975.
-: Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shekujve 15-16, Tiranë, 1983.
Puscariu, Sextil: Etymologisches Wörterbuch der rumänischen Sprache (Lateinisches Element), Heidelberg 1905.
Qaflleshi, Muharrem, Historiku i Komunës së Dragashit, Buletini, Revistë mujore e Kuvendit Komunal Dragash, Tetor, 2004, Nr. 1.
-: Toponimi Opojë që nga koha antike, Buletini i Kuvendit të Komunës së Dragashit, 1/ 2004.
-: Gjurmët historike të Opojës autoktone dhe goranëve të Gorës, në revistën mujore Buletini 1/2004, të Kuvendit të Komunës së Dragashit dhe në http://ojq-qendra.webs.com/historikuiopojsdheg.
Qiriazi, Dhori: Krishterimi në Shqipëri, (Ribotim) Përgatiti Mehmet Gëzhilli, shtëpia bot. Argeta-LMG, Tiranë, 2000.
Radio "Deutsche Welle", 27.01.2010.
Radio "Slobodna Evropa", 27.01.2010 Jevrejska zajednica postoji samo u tragovima.
Radio "Zëri i Amerikës", 30 qershor, 2010.
Radusinović, Pavle: Stanovništvo Crne Gore do 1945, Beograd, 1978.
Ramaj, Albert Bedrängte Juden im Kosovo im Zweiten Weltkrieg, në http://david.juden.at/kulturzeitschrift/70-75/73-ramaj2.htm dhe në: G2W (Zürich), 2/2007.
-: Rettung von Juden in Albanien, në: G2W - Glaube in der 2. Welt (Ökumenisches Forum für Religion und Gesellschaft in Ost und West) 2/2007 35. Jahrgang dhe në www.albansiches-institut.ch.
Rexha, Prof. Dr. Iljaz: Një fragment i defterit të Rumelisë të viteve 1451-1452 ku përfshihen disa vendbanime të Kosovës në kuadër të Arbanonit mesjetar, "Gjurmime albanologjike", Seria e Shkencave Historike, 35, Prishtinë, 2005.
-: Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novabërdës sipas defterit të fundshekullit XV, Vjetar 27-28 i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë, 2002.
-: Sllavizimi i onomastikës së vendbanimeve mesjetare arbane në arealin e Novabërdës, Nishit, Vranjës dhe Shtipit, Vjetar i Arkivit Kombëtar të Kosovës XXIX - XXX, Prishtinë, 2003.
-: Disa vendbanime mesjetare të Kosovës sipas defterit të sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566/74, në Vjetar 31 - 32 i Arkivit të Kosovës, Prishtinë 2004.
Rigutini, Giuseppe e Bulle, Oscar: Neues italienisch-deutsches und Deutsch-italienisches Wörterbuch I, Milano 1896.
Rizaj, Skender: Rudarstvo Kosova i susednih krajeva, Prishtinë, 1968.
Rječnik hrvatskoga ili sprskoga jezika JAZU, IV.

Rječnik JAZU XV, Zagreb, 1955.
Rječnik JAZU 18
Robelli, Enver: Udhëtarët e dobishëm, në "Koha ditore", 12 shkurt, 2013.
Robić, I.: Podrijetlo stanovništva otoka Šolte, Naselja i poreklo stanovnitva, 36, Beograd, 1960.
Romani - Versuch eines einführenden Überblicks http://www-gewi.kfunigraz.ac.at/romani/ling_all/ling_all.de.html.
Romansky, Dr. St.: Lehnwörter latenischen Ursprungs im Bugarischen, Revue des études slaves, Tome quatorzième, Paris, 1934.
Rosetti, Al. : Istoria Limbii Române, de la prigini pînă în secolul al XVII-lea, Editura Pentru Literatură, Bucureşti 1968.
Rüdiger, Sagel MdL : Kosovo, Makedonien, Albanien, Montenegro, Serbien,. .. Aktuelle Situation von Roma- Flüchtlingen in Serbien und Kosovo Landtag Nordrhein-Westfalen.
Rüdiger Benninghaus: Roma Gruppen in Mazedonien und im Kosovo, http://koelner-fluechtlingsrat.de/nachrichten/0700.doc.
Scărlatoiu, M.: Emprunt roumains dans les lexique serbocroate, Revue des Jtudes sur-est europeennes, 10 (1972).
Sedaj, Engjëll: Relacionet e Pjetër Bogdanit mbi gjendjen shpirtërore të Shqipërisë e të Serbisë, "Gjurmime albanologjike" (Seria e shkencave historike), 14, Prishtinë, 1984.
Sekira, Maximilian (2008) Die Vernichtung der Juden in Serbien und Griechenland. Diplomarbeit, Universität Wien. Historisch-Kulturwissenschaftliche Fakultät BetreuerIn: Suppan, Arnold, në http://othes.univie.ac.at/2015/.
Simeon, Rikard: Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva, II, Zagreb, 1969.
Simeonov, Boris: Vaprosu o substratnih frakiiskih elementah v bolgarskom jezike, Thracia, Primus Congressus Studiorum Thracicorum, Academia Litterarum Bulgarica, Serdicae, 1974.
-: Romanian elements in macedonian and serbocroatian, Revue des études sud - est européennes, XII (2), 1979.
-: Latinskite imena v bălgarskiija ezik, Bălgarki ezik, VII, Sofje, 1957.
-: Etimologičen rečnik na mestnite nazvanija ot Gorečko, Godišnik na Sofijskija Univerzitet, Faklultet po slavjanski filologii, Tom LX, 1966.
-: Latinskite imena v blgarskija ezik, Вьlgarski ezik, VII, 1957.
Simić, V. Rudarstvo i prerada gvožđa u toponmastici i terminologiji Vlasinskog kraja, në Onomatološki Prilozi I, Beograd, 1979.
Simiçia, Ardita, Ekspozita "Besa: Kodi i Nderit" në Strasburg, "Zëri i Amerikës". 29. 04. 2009.
Sinti und Roma, Eine Studie der Evangelischen Kirche in Deutschland http://www.wuwien.ac.at/usr/h92/h9251606/bal/Jenisch/Jenisch_Geschichte.htm.
Skarić, Vl.: Stari turski rukopis o rudarskim poslovima i terminologiji, Spomenik SKA, vëll. 79, Beograd, 1935.
-: Staro rudarsko pravo i tehnika u Srbiji i Bosni, Beograd, 1938.
-: Stara rudarska terminologija u Srbiji i Bosni, Beograd, 1938.
-: Toponomastički prilozi, Časopis za slovenski jezik, književnost in zgodovino, Ljubljana, 1928.
-: Zum Balkanlatein, Zeitschrift für romanische Philologie, XLVIII, 1928.
-: Etimologijski rječnik hrvatskog ili srpskog jezike I, Zagreb, 1971.
-: Etimologiski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika, II, Zagreb, 1972.
-: Prilozi k ispitivanju hrvatskih imena mjesta, III, Nastavni Vjesnik XI Zagreb, 1921

-: Prilozi k ispitivanju srpsko-hrvatskih imena mjestâ, Rad JAZU, knj. 224, Zagreb, 1921.
-: Iz Rumunske Literature o Balkanskim Vlasima, Glasnik Skopskog Naučnog Društva, Vëllimi II, Fashikulli 1-2, Shkup, 1927.
-: Iz srpsko-hrvatske toponomastike, Južnoslovenski Filolog, VI, Beograd, 1926-1927.
-: Curtis, Starohrvatska Prosvjeta, Arheološko - Historijski Časopis, Nova serija II, 1 - 2, jan. -juni, Zagreb - Knin, 1928.
-: Dolazak Slavena na Mediteran, Split, 1931.
Skorčev, P. D. : Čuždata duma v našata kuhnja, në Bălgarski ezik VI, 2/1956.
Smiljanić, Toma: *Kičevija*, Naselja i poreklo stanovništva 28 (1935).
Sokoloski, M.(etodija): Nahijata Župa (Materijal izvlečen od opširniot popisen defter Nr. 25 od 1583 g. za Ohridskiot sandžak), Makedonski jazik, 1974.
Sokoloski, Metodija&Stojanovski Aleksandar Dr., (red.): Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod, Opšien popisen defter Nr. 4 (1467-1468), Shkup, 1971.
Solovjev, Aleksandar: Nepoznat ugovor Dubrovnika s arbanaškim vladarom iz početka XIII veka, Arhiv za društvene i pravne nauke, XVII (LXIV), Beograd, 1933.
-: Odabrani spomenici srpskog prava, Beograd, 1928.
-: Povelja kralja Stefana Dušana o crkvi Sv. Nikole u Vranju, Prilozi za književnost, jezik, istoriju i folklor, 7 (1927).
Solovjev, Aleksandar - Vasenko, P. G.: Serbskie zapisi na grečeskoi rukopisi 16 veka, Recension në Jugoslovenski Istoriski Časopis 1-4, Beograd, 1937.
Spahiu, Nexhmedin: Mbrojta e Novi Pazarit dhe standardet e patriotizmit, Zëri Info, 31. 08. 2012.
Spitzer, L. : Albanesische Etymologien, Mitteilungen des Rumänischen Instituts an der Universität Wien, Heidelberg 1914.
Spomenici za srednovekovnata i ponovata istorija na Makedonija, red. Vladimir A. Mos□in, Krasimira Ilievska, bot. Arhiv na Makedonija, Shkup, 1981.
Stanojević, St.: Lična imena i narodnost u Srbiji srednjega veka, Južnoslovenski filolog VIII, Beograd 1928-1929.
-: Vizantija i Srbi II, Novi Sad, 1906.
Stanojević, Ljub(omir) : Pristupna akademska beseda, govorena na sevečanom skupu Akademije 11. jan. 1896, GLAS, SKA, LII, Drugi razred, 34, Beograd, 1896.
-: Stari srpski rodoslovi i ljetopisi, Beograd 1883
Staročeškŷ slovník, 8, Československá Akademie Věd Ústav pro Jazyk Českỳ, bot. Akademia - Praha, 1976.
Stijović, Svetozar: Onomastika središnjeg dela Metohijskog (Pećkog) Podgora, Onomatološki prilozi II, Beograd, SANU, 1981.
-: Onomastika zapadnog dela Metohijskog (Pećkog) Podgora, Onomatološki prilozi, III, SANU, Beograd, 1982.
Stojanow, V. Prof. Dr. Sc. PhD Valery: Die Muslime am Balkan als eine überregionale Minderheit. Probleme der Identifizierung,www.ihist.bas.bg/sekcii/CV/_private/Valery_Stojanow/VS_Muslime-Mind_Balkan.htm - 50k.
Stojanović, Ljub(omir).: Stari srpski rodoslovi i ljetopisi, Beograd, 1883.
-: Stari srpski hrisovulji, akti, biografije, ljetopisi, tipici, pomenici, zapisi i dr., Spomenik SKA 3, Beograd, 1890
Suić, Mate: Nekoliko primjera toponomastičke stratifikacije u srednjoj Dalmaciji, SIMPOZIJUM, Pretslavenski etnički element na Balkanu u etnogenezi južnih slavena, Sarajevo 1969.
Surroi, Flaka: Koha net. 25.gusht, 2014.

Šafarik, J.: Hrisovulja cara Stefana Dušana koiomь osniva rnonastirь Sv. Arhangela Mihaila i Gavrilja u Prizrenu godine 1348 ? Glasnik Društva Srbske Slovesnosti 15 (1862).
-: Pamatky drevniho pisemnctivi jihoslovanov, Dil predechazi serbal i vydal Pavel Josef Šafarik, v Praze, 1873.
Scheludko, D. : Lateinische und rumänische Elemente im Bulgarischen, Balkan-Archiv III, Leipzig, 1927.
Šišić, F. : Ljetopis Popa Dukljanina, Beograd - Zagreb, 1928.
Škaljić, Abdula: Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku, Sarajevo, 1966.
Škrivanić, Gavro: Putevi u srednjovekovnoj Srbiji, Beograd, 1974.
Schmitt Jens Oliver, Die Kosovo Geschichte, Srpska Pravoslavna Crkva, në http.//www.spsportal.org/index.php.
-: Kosovo, Kurze Geschichte einer Zentralbankanischen Landschaft, Böhlau- Wien-Köln-Weimar, 2008.
-: Die Kosovo Geschichte, Srpska Pravoslavna Crkva, në http.//www.spsportal.org/index.php.
Schmid J. Franz: "Ägypter" im Balkan - totgeschwiegen und verjagt, Eine fast unbekannte Volksgruppe kämpft um ihre Identität Von Serben unterdrückt, von Albanern aus dem Land gewiesen.
Šoptrajanov, Georgi: Amurca, murga, murg vo romanskite i balkanskite jazici - od romanskata i balkanskata lingistika, patronimika i toponomastika, Godišnjak, I, Balkanološki Institut, Sarajveo 1957.
Schramm, Gottfried: Anfänge des albanischen Christentums, Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen, Zweite, überarbeitete Auflage, Freiburg im Breisgau, 1999.
Sturm-Schnabl, Katja: (Wien) Franz Miklosich - ein "Europäer" im 19. Jahrhundert: http:/www.inst.at/studies/sektion01.htm.
Schuchardt, Hugo: Albanisches und romanisches, Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung Bd. XX, Berlin 1872.
Šufflay, Milan: Serbët dhe shqiptarët, Prishtinë, 1968.
-: Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters, Wien, 1924.
Schwartz, Stephen: Kosova, Prejardhja e një lufte, Prishtinë, "Rokullia", 2005.
Shukriu, Edi: Gradina e Gushicës dhe Municipiumi Labutza, Vjetar XVII-XXVIII i Arkivit Kombëtar të Kosovës, Prishtinë, 2002.
-: At Shtjefën Gjeçovi -arkeolog dhe mbrojtës i trashëgimisë kulturore, Vjetar i Arkivit të Kosovës, XXXI-XXXII, Prishtinë, 2004.
Šupuk, Ante: Najstarija matica Šibenskog predgradja Dolac (Liber baptizatorum Parochie Sancti Marci a die 8 octobris 1685 isque annum 1700 inclusie), Čakavska Rič, 2/1974, Split 1975.
-: Hibridni antroponimi, Čakavska Rič 2, Split, 1974.
Schüler Duden- Fremdwörterbuch, Dudenverlag, Mannheim -Wien - Zürich, 1984.
Schütz Istvan: Përkimet gjuhësore shqiptare-rumune dhe vazhdimësia etnike në Kosovë, Mendime rreth monografisë së Gotfried Schramm, Frühe Schicksale der Rumänen - Acht Thesen zur Lokalisierung der lateinischen Kontinuität in Südosteuropa, bot. në Zeitschrift für Balkanologie XXII/1, XII/2 1986 dhe XXIII/1 1987, "Studime filologjike", 3/1989.
-: Les contacts médievaux albano-comans reflétés par l'onomastique de Kosovo, Acta Orient. Hung. XL, 1986, f. 296-297, cit. sipas Xhai, Xha, Kur nuk laheshim, në http:/xhxhai.wordpress.com/2009/09/30/arber dhe kumane/.

Tagliavini, Carlo, Miscellanea etimologica balcanica, Reue internationale des études balkaniques 1/3, Beograd, 1936.
Takács, M. Sächsische Bergleute im mitteraalterlichen Serbien und die "sächsische Kirche" von Novo Brdo, Südost - Forschungen, Bd. L, 1991.
Thallóczy Dr. Ludovicus, Jireček Dr. Constantinus et Šufflay Dr. Aemilianus, Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia, Volumen II (Annnos 1344-1406) Vindobonae, MXMXVIII.
Theiner, A.: Vetera Monumenta Slavorum Meridionalum Historiam Illustrantia, Zagrabiae 1875.
Tapu ve kadastro ümüm müdürlügünün Arşivi, Ankara, (Defteri Nr.124 i papublikuar i sanxhakut të Vushtrrisë, pas gjithë gjasësh i viteve 1566 - 1574, i transkribuar nga Qemal Haruni, Shkup (Dorëshkrim).
Tërnava, Dr. Muhamet: Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI, Prishtinë, 1995.
-: Bellasica gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVI, "Gjurmime albanologjike", Seria e Shkencave Historike, 35, Prishtinë, 2005.
Treimer, Karl: Illyriertum -Wesen und Bedeutung, Studia albanica, Univrsite d' etat de Tirana, Institut de Histoire et de la Linguistique, 2/1965.
Tričković, Rdmila: Dva turska popisa Krajine i Ključa iz 1571 godine, ekstrakt nga Miscellanea 2, Beodrad, 1973, f. 207.
Truhelka, Ćiro: Über die Balkan-Juruken, Revue intrnational des études balkaniques I [Beograd], 1934.
Tudor, Dimitru & Vlădescu, Cristian: Die Dardanen in Romula- Malva, në Dardania, Zeitschrift für Geschichte, Kultur, Literatur und Politik, Nr. 11, Wien, 2001.
Udruženje Egipčana Kosmeta traži svoja prava: Neće svojatanja; nga http://www.medijaklub.cg.yu/dnevnevijesti/arhiva/2001.
Urošević, Atanasije: Kosovo, Beograd, 1965.
-:Toponimi Kosova, Beograd, 1975.
-: Neki detalji iz prošlosti Kosova, (Po toponimima) Onomatološki Prilozi I, Beograd, 1979.
-: O iščezlom selu Kumanovu na Kosovu, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, Prishtinë, 1956.
-: Jedno objašnjenje naziva Pomak, Glasnik Etnografskog Instituta Srpske akademije nauka i umetnosti, XVI-XVIII (1967-1969).
-: Gornja Morava i Izmornik, Antropogeografska Ispitivanaja, Beograd, 1931.
Übergriffe auf Roma im Kosovo Gesellschaft für bedrohte Völker appelliert an KFOR: Schützen Sie die Minderheiten http://www.gfbv.de/voelker/europa/kosovo/roma.htm.
Vaillant, André: Le traité contre les bogumiles, Revue des études slaves, XXI, fasc. 1-4, Paris, 1944.
Valentini, Josephi: Acta Albaniae Veneta, Seculorum XIV et XV; S. O., Pars Prima.
Vasmer, Max: Beiträge zur slavischen Altertumskunde, XVII Balkangermanisches und Verwandtes, Zeitschrift für slawische Philologie XVIII, Heft 1- Leipzig, 1941.
-: Ältere germanische Lehnwörter im Slawischen, Zeitschrift für slavische Philologie, 11, Leipzig, 1934.
-: Die griechischen Lehnhwörter im Serbo-Kroatischen (Einzelausgabe aus den Abhandlungen der Preußischen Akademie der Wissenschaften, Jahrgang 1944, Phil.-hist. Klasse. Nr. 3.), Berlin, 1944.
Velija, Samir: Quo vadis, Goranac? në http: // www.prizren-web.com/magazin/)
Verein der Balkanägypter in West- Europa, http://www.balkanaegypter.de/dokuments/Weneedtobehappydeutsch.pdf.

Die Verlierer der Balkankriege, Die kleine Völker junger Nationen http://www.taz.de/pt/2003/07/11.nf/mondeText.artikel,a0042.idx,12.
Vielfalt 34, Kosova; Zeitschrift für bedrohte Völker, bot. Gesellschaft für bedrohte Völker http://www. Gfbv.ch/pdf/03-00-034.pdf.
Volksgruppen mit einem Schicksal Roma, Aschkali und Kosovo-Ägypter http://www.gfbv.de/voelker/europa/kosovo/kos_ethn.htm.
Vulić, Nikola: Antički spomenici u Srbiji, Spomenik SKA, XLVII, Beograd, 1909.
-: Antički Spomenici u Srbiji, Spomenik SKA, 39, Beograd, 1909.
-: Antički spomenici naše zemlje, Spomenik SKA LXXI, Beograd, 1931.
Warrander Gail & Knaus, Verena: Kosovo (Brandt Travel Guide) (Paperback), 2008.
"Washington Times": "Shqipëria e shënon Hollokaustin", "Radio Zëri i Amerikës", 19.04.2008.
Weber, Georg: Geschichte des Mittelalters, Vollständig bearbeitet von Prof: Dr. Alfred Baldamus), Fouierverlag, Herausgegeben von A. Kleine, Köln, 2003.
Weigand, Gustav: Die rumänischen Dialekte der Kleinen Walachei, Serbiens und Bulgariens, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache 7/1900.
-: Gustav: Die bulgarischen Rufnamen, Ihre Herkunft, Kürzungen und Neubildungen, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache (Rumänisches Seminar), 15/1909.
-: Rumänen und Aromunen in Bulgarien, Leipzig 1907.
-: Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrier oder der Thraker?, Balkan-Archiv III, Leipzig 1927.
Wijk van N.: Les langues slaves (de l`unité à pluralité), Hage, 1956.
Wir über uns: www. Balkanaegypter.de/einfuehrung.html.
Wolff, Barbara : A ishte Ajnshtajni "shqiptar" ?, publikuar në Alb info. ch më 13.02.2013./ 18.12.2012.
Zaimov, Jordan : Bulgarische Gewässernamen, II Zeitschrift für Slawistk, Bd. VI, 1961, Akademie-Verlag, Berlin.
Zajmi, Ukshin: Gjurmë lashtësie në trevat e Gallapit, GALLAPI, Revistë periodike e trevës, nr. 6, 2010.
Zamputi, Injac & Malltezi, Luan, Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV, Vëllimi 1, Tiranë, 1987.
Zemon, Rubin: Ethnologische, historische und archäologische Angaben über den Ursprung der Ägypter auf der Balkanhalbinsel http://www.egjiptianet.de/.
-: Të dhëna etnologjike, historike dhe arkeologjike për origjinën e Egjiptjanëve në Gadishullin Ballkanik-referat për Konferencen Kombëtare, organizuar prej Shoqatës Egjiptjane te Shqipërisë "Nefreta" dhe Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, në daten 28.I.1999 në Tiranë, Tiranë, 1999 sh.: http://www.egjiptianet.de/rubin.htm.
Zigeuner in Spanien: http://www.villa.spanien-immobilien-costa-blanca.com/index.php?p=42.
Zur Geschichte und aktuellen Situation, Autochtone Minderheiten Roma und Sinti; http://www.gruene.at/10bl/auto/rosi2.html.
Zülch, Tilman: und Paul Polansky Unter den Augen der KFOR: Massenvertreibung der Roma, Aschkali und Kosovo-Ägypter aus dem Kosovo, Report von Tilman Zülch und Paul Polansky mit einem Appell von Günther Grass http://www.gfbv.de/dokus/roma2_d.htm.
Zülch, Tilman: Bis der letzte "Ziegeuner" das Land verlassen hat (Massenvetreibung der Roma und Aschkali aus dem Kosovo) Report von Tilman Zülch www.gfbv/ gfbv.ch. /pdf/02-01-031. pdf. (Roma Serbien)

Zweite Reise zur Erkundung der Lage der Roma und Ashkalia im Kosova Vierzehn Tage Augenzeuge in einer eingeschlossenen und bedrohten Enklave der Ashkalija.
Xhai, Xha: Kur nuk laheshim, në: http://xhaxhai.wordpress.com/2009/09/30arber -dhe-kumane.
Xharra, Fahri: Pse shqiptarët mercenarë? Publikuar në Kosova.Info, më 01.05.2013.
Xhemaj, Ukë: Shtresime Kulturore, bot. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005.
Xhuvani Prof. Dr. Aleksandër dhe Çabej Prof. Eqrem: Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë, 1962.
Lëndë e shfrytëzuar nga interneti:
http://www.fildzanviska.ba/clanak_510.htm.
http://www.revistakuvendi.net/Publicistike/207.html.
http //www.ljubav.s10.forumsplace.com.
http://www srp.anarchopedia.org/index.php/Bogumili.
http://www.dalmatiahus.com/Hrvatat/BOGOMILI.html.
http//www de.wikipedia.org/wiki/Bogomilen.
http//www//translate.google.com/translate?hl=de&sl=fr&u=http://www.regard.eu.org/Livres.2/Pelerinage.douloureux/11Bogoumiles%26hl%3Dde%26sa%3DG.
http://fr.wikisource.org/wiki/Le_monde_gr%C3%A9co-slave_-_VI ose Revue des Deux Mondes, tome 2, 1843, Cyprien Robert: Le monde gréco-slave, Le Monde gréco-slave – VI.
http//www.srpjects.de&Albienserkreuzzug&Abstracts_Di.doc.
http//www lexikon.freenet.de/Serbisch-Orthodoxe_Kirche.
http//www.serb-kirche.at/vera/geschichte.html. njësia Die serbische Kirche in der Geschichte.
http//www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k -.
http:www.bosnjaci.net/aktuelnosti.php?id=56&polje=historija - 90k : Sadik Idrizi, Gora kroz stoljeća.
http://bs.wikipedia.org/wiki/Torbe%C5%A1i"storija - 90k.
http//bs.wikipedia/wiki/Bugarska – Historija.
http: // www.prizren-web.com/magazin/.) POMACI, njihova prošlost i sadašnjost.
http; bs. Wikipedia.org/wiki/Bo% C5%, A1njaci_.
http:wikipedia.org/wiki/Saranda.
http://de.wikipedia.org/wiki/Katharer.
http:www.aurora-magazin.at/gesellschaft/rum_wolf_brauch.frm.htm.
http://ususi.-technik.uni de.8080/Meyers2/seite/werk/meyers/band13/seite/0213/meyers b13_s0213.html #Pomaken.
http// bs. wikipedia.org/wiki/Bo% C5%, A1njaci_ Kosova, përkatësisht Bošnjaci_Kosova32k.
http://de.wikipedia.org/wiki/Pomaken http://susi.e - technik.uni-ulm.de.8080/Meyers2/seite/werk/meyers/band13/seite/0213/meyers-t tek Meyers Konversationslexikon, Band 13 f. 213.
http://www.jetscha.de/banat/hog/grj/eig_grj/Das%20Banat.htm nga autori Dipl. Ing. Neidenbach Norbert.
http://www.google.at/search?hl=de&source=hp&q=Kumanen.
http://www.uni-protokolle.de/Lexikon/Kumanen.html.
http://de.wikipedia.org/wiki/Geschichte_Kirgisiens.
http://www.jetscha.de/banat/hog/grj/eig_grj/Das%20Banat.htm.
http://www.uni-protokolle.de/Lexikon/Skythen.html.
http:// www bndlg.de/wplaarre/aegypter =1. Htm.

http://www.pragerzeitung.cz/?c_id=3014.
http://www.egjiptianet.de/rubin.htm.
http://www.revistakuvendi.net/Publicistike/207.html.
http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/344519/titulli/Shaban-Sinani-Si-u-priten-hebrenjte-ne-Shqiperi më 02/11/2009.
http; bs. Wikipedia.org/wiki/Bo% C5% A1njaci_ Kosova dhe Historija kosovskih Bošnjaka në bs.Wikipedia.org/wiki/Bošnjaci_Kosova - 32k –
http. www. Rudolf Flotzinger, Österreichisches Musiklexikon, ac. at.
hr.wikipedia.org/wiki/Povijest_Srba_prije_Nemanji
Urheimat der Slawen,Universität Potsdam.
www.doew.at/projekte/holocaust/shoah/flucht/serb.html - 5k.
www.david.juden.at/kulturzeitschrift/70-75/73-ramaj2.htm - 20k.
www.doew.at/projekte/holocaust/shoah/flucht/serb.html - 5k.
http://www.geocities.com/~patrin/kosovo.htm) në http://www.kath-zigeunerseelsorge.de/balkan.htm.
www.david.juden.at/kulturzeitschrift/70-75/73-ramaj2.htm - 20k.
wikipedia.org/wiki/Serbien_im_Zweiten_Weltkrieg - 49k -.

Skënder Gashi
KËRKIME ONOMASTIKE-HISTORIKE
PËR MINORITETE TË SHUARA E AKTUALE TË KOSOVËS
2015

Botues:
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektura:
Mr. Shefqet Riza

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 49 tabakë shtypi
Tirazhi: 300 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

811.18'373.2
316.347.2(496.51)

Gashi, Skënder
Kërkime onomastike-historike për minoritete të shuara e aktuale të Kosovës / Skënder Gashi. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2015. – 784 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm. - (ASHAK : Botime të Veçanta ; CXLVII : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë ; Libri 52)

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze.

Burimet dhe literatura : f. 765-783

ISBN 978-9951-615-48-8